

Prof. Dr. Enver Hasani / Prof. Dr. Ivan Čukalović

Komentar

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Botimi 1



I publikuar nga

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Autorët:

Enver Hasani & Ivan Čukalović

Kontribuesit:

Flakron Sylejmani, bashkëpunëtor profesional, në emër të projektit për reformë ligjore-GIZ GmbH

Fisnik Korenica, bashkëpunëtor profesional

Jovica Čukalović, bashkëpunëtor profesional

Lektorët:

Isa Bajçinca

Skënder Berisha

Mehmet Dashaj

© 2013 Enver Hasani, Ivan Čukalović dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Të gjitha të drejtat rezervohen. Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH nuk pranon kurrfarë përgjegjësie për përmbajtjen e pasqyruar dhe nuk është përgjegjëse për aktualitetet, korrektësinë, tërësinë apo cilësinë e informacioneve të paraqitura. Prandaj do të refuzohen të gjitha pretendimet rreth dëmit të shkaktuar nga shfrytëzimi i informatave të dhëna, përfshirë edhe informatat të cilat janë të pakompletuara apo të pasakta.

Informacion

Të drejtat e autorit për materialet e krijuara nga autorët dhe GIZ janë të rezervuara. Nuk lejohet kopjimi/dyfishimi i materialit apo shfrytëzimi i objekteve, siç janë imazhet etj. në publikimet e tjera pa pëlqimin e GIZ-it dhe autorëve.

Nëse ndonjë pjesë apo shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme apo korrekte, përmbajtja apo vlefshmëria e pjesëve të tjera mbetet e paprekur nga ky fakt.

Dhjetor 2013

Shtypur në Prishtinë

Hartimi dhe botimi i këtij Komentari është mundësuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti Reforma Juridike në Kosovë, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ)

FALËNDERIM

Përpjekjet për komentim të një kushtetute, si çdo përpjekje njerëzore, kërkojnë mbështetje financiare, institucionale dhe, mbi të gjitha, kërkojnë mbështetje njerëzore. Ato resurse nuk mund t'i posedojë një institucion i vetëm, lëre më një njeri apo disa njerëz. Përpjekja e tillë mund të realizohet me sukses vetëm kur ekziston një përpjekje e koordinuar e të gjithëve. Duhet mbështetje, në rend të parë financiare dhe institucionale, e atyre që janë në Kosovë për ta ndihmuar shoqërinë e saj që të modelohet sipas standardeve, sipas parimeve, sipas normave dhe sipas veçorive të konstitucionalizmit perëndimor. I tillë ka qenë rasti me Komentarin, i cili është realizuar me mbështetjen financiare e institucionale, të pakursyer asnjëherë, të Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik të Republikës Federale të Gjermanisë (Bundesministerium für Wirtschaftliche Zusammenarbeit der Bundesrepublik Deutschland) dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit, GIZ). Duam të shprehim falënderimin tonë të thellë për këtë ndihmë të madhe të taksapaguesve gjermanë në prodhimin e Komentarit. Besojmë se, përgjatë këtyre dy vjetëve të punës sonë në Komentari, nuk e kemi bezdisur stafin e vyeshëm të projektit implementues “Këshillimi për reformën juridike në Kosovë” (Rechtsreformberatung in Kosovo), dhe sidomos udhëheqësin e këtij projekti, z. Volkmar Theobald, me kërkesat tona të vazhdueshme për mbështetje logjistike dhe për mbështetje tjetër gjatë hartimit të Komentarit.

Përfitojmë nga ky rast që të falënderojmë shumë sinqerisht stafin e Projektit dhe vetë z. Theobald për këtë mbështetje të pakursyer. Do të bënim padrejtësi të madhe sikur ta harronim me këtë rast z. Flakron Sylejmani, këshilltarin e Lartë ligjor në Projektin e reformës ligjore në GIZ, për mbështetje të gjithanshme dhe të papërtësë gjatë punës sonë, për sugjerime e për komente profesionale, si dhe për koordinim të shkëlqyeshëm të aktiviteteve për përfundimin e punës së Komentarit.

Falënderim krejt i veçantë i dërgohet recensentëve gjermanë dhe të tjerë, të cilët kanë pasur durimin për ta derdhur dijen profesionale dhe përvojën e tyre për të komentuar tekstin final të punës sonë. Rekomandimet e tyre profesionale, thellësia dhe elokuenca me të cilën janë paraqitur, kanë qenë të rëndësishme për ne në përpilimin e versionit aktual, të cilin ia prezantojmë publikut kosovar dhe më gjerë.

Nuk ka asnjë dyshim se, puna jonë si gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe përvoja kolosale e fituar gjatë këtyre katër vjetëve të punës së Gjykatës Kushtetuese, kanë qenë një ndihmë e jashtëzakonshme në komentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, marrë parasysh rastet krejt specifike dhe me ndikim të pafund në proceset e juridifikimit dhe të konstitucionalizmit të proceseve sociale, politike, ekonomike dhe kulturore në shoqërinë kosovare. Kjo na shtyn të falënderojmë nga zemra krejt gjyqtarët dhe krejt stafin e Gjykatës Kushtetuese, që, me punën e tyre të vyeshme, kanë lehtësuar dukshëm krijimin e një praktike gjyqësore të gjyqësisë kushtetuese kosovare, të cilës ia ka zili çdo gjykatë në rajon dhe më gjerë.

Familjet tona meritojnë një falënderim të posaçëm për respektin që kanë treguar ndaj përkushtimit dhe ndaj punës sonë të përbashkët në përpilimin e Komentarit, rrethanë që nuk ka qenë pa shqetësime të jetës dhe të punës në familjet tona. Jo rrallë, gjatë punës sonë dyvjeçare, kemi bërë prishjen e rehatisë familjare, si pasojë e përpjekjeve tona të shtuara për ta nxjerrë në dritë Komentarin në kohën që na kërkohej nga të tjerët, nga mbështetësit, nga miqtë e nga dashamirët tanë të shumtë.

Prof. dr. Enver Hasani
Prof. dr. Ivan Čukalović

PARATHËNIE

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, në emër të Ministrisë Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), si pjesë e përpjekjeve të saja të drejtuara në përmirësimin e kualitetit të literaturës juridike në Kosovë, ka kënaqësinë ta paraqes para opinionit këtë Komentari të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Duke pasur parasysh faktin se deri më sot procesi i zbatimit të Kushtetutës së Kosovës është përballur me pengesa, në veçanti për shkak të mungesës së interpretimit uniform të dispozitave të saj, është konsideruar si e nevojshme të sigurohet një interpretim nga ekspertët në mënyrë që të arrihet deri te kuptimi i drejtë dhe i saktë i saj.

Komentari jep shpjegime dhe sqarime të neneve të Kushtetutës dhe udhëzime për zbatimin e drejtë dhe adekuat të saj, bazuar në teorinë dhe praktikën vendore dhe ndërkombëtare, duke mos lënë anash edhe arritjet juridike në këtë drejtim. Prandaj, ky komentari do t'i ndihmojë profesionistëve juridik në institucionet e Kosovës, duke filluar nga Ministritë, Gjykatat, Prokuroritë, Fakultetet Juridike, si dhe bashkëpunëtorët profesional për të kuptuar dhe zbatuar drejt Kushtetutën gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Kjo do të kontribuojë më tej në krijimin e sigurisë juridike, mbrojtjen e interesave të palëve në procedurë dhe ngritjen e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë.

Duke qenë i pari i këtij lloji, ne presim që Komentari të jetë një mjet i vlefshëm për komunitetin e profesionistëve juridik, dhe një kontribut i çmueshëm për drejtësinë në Kosovë.

GIZ – Projekti i Reformës Juridike në Kosovë – dëshiron të falënderojë autorët e këtij Komentari dhe personelin akademik, ekspertët juridik dhe bashkëpunëtorët e tyre të cilët kontribuuan në këtë punë, në mënyrë që ky publikim, dhe të tjerët në të ardhmen, të jetë i dobishëm për profesionistët në fushën e drejtësisë, shkencës juridike, dhe po ashtu t'i shërbejë popullit të Kosovës në përgjithësi.

Volkmar Theobald

Menaxher i Projektit

Projekti i Reformës Juridike GIZ

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

FJALA E AUTORËVE

Kosova, si shoqëri ish-komuniste, ka pasur një trajektore zhvillimi krejt më të ndryshme se shoqëritë e tjera të Evropës Juglindore. Ai ndryshim buron nga historia tragjike e vetë Kosovës, e viteve të fundit pas rënies së komunizmit: ndërkohë që tërë ish-universi komunist po shkonte drejt rimodelimit sipas standardeve, sipas parimeve, sipas normave dhe sipas cilësive të konstitucionalizmit perëndimor, regjimi i diktatorit serb, Slobodan Milosheviq, në Beograd, instaloi në Kosovë një sundim absolut diskriminues dhe represiv të cilin Evropa nuk e kishte parë që nga koha e viteve 1939-1945. Tragjedia boshnjake tejkaloi këtë trend ogurzi, të cilin e nisi diktatori serb, sepse po kryhej një gjenocid i pastër në truallin e Evropës dhe me këtë po diskreditohej çdo përpjekje dhe ide për një Evropë të bashkuar. “Koha e Evropës ka ardhur”, siç e pat thënë Giani de Michelis, ish-ministër i Jashtëm italian, në vitet e para pas rënies së komunizmit, nuk mbeti veçse një fjali boshe dhe një farsë, çmim që do ta paguajnë (populli boshnjak dhe ai kosovar, më pastaj, gjatë viteve të luftës 1998-1999). Kosova, megjithatë, me përpjekje të koncentruara të aleatëve euroatlantikë, të mbledhur në NATO, pati fatin të ketë vuajtje më të shkurtra dhe të fitojë lirinë e shumëpritur prej kohësh dhe prej brezash. Hyrja e trupave të NATO-s në Kosovë, më 10 qershor 1999, shënon ndërprerjeje radikale të dy kohëve: të një Kosove plot dhunë dhe të një Kosove që po lindte nga përpjekja e jashtëzakonshme e vendeve dhe e popujve të të dy anëve të Atlantikut për të ndaluar vuajtjet dhe sakrificat e kosovarëve gjatë dekadave të dhunës diktatoriale të regjimit serb të Milosheviqit.

Instalimi i administrimit ndërkombëtar në Kosovë, nën ombrellën e Kombeve të Bashkuara, i njohur si UNMIK, përkundër qëllimit të mirë dhe synimit që kishte, pati defektet e veta serioze, të cilat u reflektuan në krijimin e një sistemi krejt kaotik juridik. E themi juridik sepse sistemi kushtetues, ashtu siç kuptohet në konstitucionalizmin modern, nuk mund të thuhet se ekzistonte, nisur nga fakti se bëhej fjalë për administrim, e jo për qeverisje, të territorit të Kosovës. Ky administrim bëhej në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KS i OKB), të 10 qershorit 1999. Sipas kësaj rezolute, krejt pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, i takonte Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSP). Rrethanat që u krijuan pas 10 qershorit 1999 vlejten deri në shpalljen e pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008. Pas kësaj date, Kosova nxori Kushtetutën e vet, nxori ligjet dhe infrastrukturën tjetër independente dhe i la vend një transicioni gradual nga infrastruktura e vjetër në infrastrukturën e re juridiko-kushtetuese. Ky fakt, dhe rrethanat që krijoi ai, më pas u përkrahën nga mendimi këshillëdhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND), më 22 korrik 2010.

Miratimi i Kushtetutës së Kosovës, më 9 prill 2008, dhe hyrja e saj në fuqi, më 15 qershor të po atij viti, shënoi një fazë të re të zhvillimit kushtetues-juridik të Kosovës. Pas kësaj, u shtrua nevoja e qartësimi përfundimtar të statusit juridik-kushtetues të tri sistemeve juridike pararendëse: atij të Kosovës ish-komuniste, të regjimit diktatorial të Milosheviqit dhe, së fundi, të sistemit juridik të instaluar nga administrata ndërkombëtare e Kombeve të Bashkuara. Këtë qartësim na e dha Kushtetuta e Kosovës, si tekst i parë kushtetues i një Kosove të pavarur dhe sovrane. Interpretimi i

këtij teksti, si i çdo teksti tjetër që përmban parime dhe norma të përgjithshme kushtetuese, pra norma e parime më të përgjithshme se çdo tekst tjetër juridik, përbën një detyrë të vështirë. Në fakt, detyra e interpretimit të një teksti kushtetues paraqet një detyrë jashtëzakonisht të vështirë. Në rastin tonë, kjo vështirësi, që nxiste dilema fillestare, buronte edhe nga fakti se për herë të parë po bëhej një interpretim i tillë i tekstit kushtetues të Kosovës sovrane dhe të pavarur. Ne, megjithatë, pranuar këtë detyrë, me të vetmin qëllim që të japim themelet fillestare të një komentimi të parimeve e të normave kushtetuese në frymën e standardeve profesionale akademike për publikun e gjerë në Kosovë e jashtë saj, për komunitetin juridik e akademik në vend dhe jashtë vendit. Puna ka qenë e vështirë dhe e gjatë, mbi dyvjeçare, por në fund u kurorëzua më këtë produkt tonin të përbashkët që ia ofrojmë lexuesit tonë.

Qëllimi primar i çdo norme e parimi të përgjithshëm juridik, siç dihet krejt mirë, është rregullimi i raporteve *pro futuro*, pa efekt retroaktiv. Në esencë, ndalimi i retroaktivitetit të parimit, apo i normës juridike, paraqet një të arritur civilizuese, e cila mund të këtë përjashtime të rralla – dhe atë – në të mirë të individit. Kjo temë, këtu, nuk ka rëndësi për momentin. Ajo çka duam të themi me këtë rast është se, përveç këtij qëllimi primar, parimi apo norma e përgjithshme në vendet në transicion, siç është rasti edhe me Kosovën, ka edhe një qëllim dytësor, krahas qëllimit primar të normimit të raporteve në shoqëri *pro futuro*, pa efekt retroaktiv në parim. Ky qëllim i parimeve e i normave të shoqërive në transicion konsiston në faktin se parimet e normat ligjore e kushtetuese të këtyre shoqërive synojnë të jenë transicioni vetë, pra vetë ndryshimi i pritur. Janë, me një fjalë, e tanishmja që përcakton të ardhmen e një shoqërie në transicion. E tillë është edhe Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet që dalin prej saj: Kushtetuta e Kosovës bën një prerje cezariane ndërmjet të kaluarës së hidhur të Kosovës dhe qytetarëve të saj, duke ia hapur dyert një perspektive të re, të modeluar në tërësi sipas parimeve, sipas normave e sipas cilësive të konstitucionalizmit perëndimor. Kësaj filozofie të sanksionuar me Kushtetutë i përmbahet edhe çdo fjalë e çdo rresht i Komentarit, me shpresë se lexuesit tonë i ofrojmë një perspektivë të llojit tjetër nga ajo që gjendet aty-këtu në tekstet juridiko-kushtetuese në vend dhe në rajonin e Ballkanit, në përgjithësi. U mor vesh, si çdo punë njerëzore, edhe kjo jona mund të ketë ndonjë gabim të natyrës jo të qëllimshme, për çka, megjithatë, ne marrim tërë përgjegjësinë, sot dhe në të ardhmen. Shpresojmë se edhe lexuesi do t'i kuptojë kështu gabimet eventuale që mund ta hasen në tekstin e Komentarit.

Prof. dr. Enver Hasani
Prof. dr. Ivan Čukalović

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I	DISPOZITAT THEMELORE	11
NENI 1	[PËRKUFIZIMI I SHTETIT]	11
NENI 2	[SOVRANITETI]	15
NENI 3	[BARAZIA PARA LIGJIT]	21
NENI 4	[FORMA E QEVERISJES DHE NDARJA E PUSHTETIT]	26
NENI 5	[GJUHËT]	35
NENI 6	[SIMBOLET]	37
NENI 7	[VLERAT]	40
NENI 8	[SHTETI LAIK]	48
NENI 9	[TRASHËGIMIA KULTURORE DHE FETARE]	49
NENI 10	[EKONOMIA]	51
NENI 11	[VALUTA]	52
NENI 12	[PUSHTETI LOKAL]	53
NENI 13	[KRYEQYTETI]	57
NENI 14	[SHTETËSIA]	57
NENI 15	[SHTETASIT JASHTË VENDIT]	60
NENI 16	[EPËRSIA E KUSHTETUTËS]	62
NENI 17	[MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE]	63
NENI 18	[RATIFIKIMI I MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE]	67
NENI 19	[ZBATIMI I SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE]	70
NENI 20	[BARTJA E SOVRANITETIT]	72
KAPITULLI II	TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE	76
NENI 21	[PARIMET E PËRGJITHSHME]	78
NENI 22	[ZBATIMI I DREJTPËRDREJTË I MARRËVESHJEVE DHE INSTRUMENTEVE NDËRKOMBËTARE]	82
NENI 23	[DINJITETI I NJERIUT]	85
NENI 24	[BARAZIA PARA LIGJIT]	85
NENI 25	[E DREJTA PËR JETËN]	88
NENI 26	[E DREJTA E INTEGRITETIT PERSONAL]	90
NENI 27	[NDALIMI I TORTURËS, TRAJTIMIT MIZOR, ÇNJERËZOR OSE POSHTËRUES]	91
NENI 28	[NDALIMI I SKLLAVËRISË DHE I PUNËS SË DETYRUAR]	92
NENI 29	[E DREJTA E LIRISË DHE SIGURISË]	96
NENI 30	[TË DREJTAT E TË AKUZUARIT]	102
NENI 31	[E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË DHE TË PAANSHËM]	105
NENI 32	[E DREJTA PËR MJETE JURIDIKE]	111
NENI 33	[PARIMI I LEGALITETIT DHE PROPORCIONALITETIT NË RASTET PENALE]	112
NENI 34	[E DREJTA PËR TË MOS U GJYKUAR DY HERË PËR TË NJËJTËN VEPËR]	115
NENI 35	[LIRIA E LËVIZJES]	116
NENI 36	[E DREJTA E PRIVATËSISË]	122
NENI 37	[E DREJTA E MARTESËS DHE FAMILJES]	129

NENI 38	[LIRIA E BESIMIT, E NDËRGJEGJES DHE E FESË]	131
NENI 39	[KONFESIONET FETARE]	137
NENI 40	[LIRIA E SHPREHJES]	139
NENI 41	[E DREJTA E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE]	142
NENI 42	[LIRIA E MEDIEVE]	146
NENI 43	[LIRIA E TUBIMIT]	150
NENI 44	[LIRIA E ASOCIIMIT]	154
NENI 45	[TË DREJTAT ZGJEDHORE DHE TË PJESËMARRJES]	159
NENI 46	[MBROJTJA E PRONËS]	168
NENI 47	[E DREJTA PËR ARSIMIN]	176
NENI 48	[LIRIA E ARTIT DHE E SHKENCËS]	179
NENI 49	[E DREJTA E PUNËS DHE USHTRIMIT TË PROFESIONIT]	181
NENI 50	[TË DREJTAT E FËMIJËVE]	186
NENI 51	[MBROJTJA SHËNDETËSORE DHE SOCIALE]	191
NENI 52	[PËRGJEGJËSIA PËR MJEDISIN JETËSOR]	197
NENI 53	[INTERPRETIMI I DISPOZITAVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT]	201
NENI 54	[MBROJTJA GJYQËSORE E TË DREJTAVE]	203
NENI 55	[KUFIZIMI I TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE]	211
NENI 56	[TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE GJATË GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME]	215

KAPITULLI III TË DREJTAT E KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE

NENI 57	[PARIMET E PËRGJITHSHME]	235
NENI 58	[PËRGJEGJËSITË E SHTETIT]	239
NENI 59	[TË DREJTAT E KOMUNITETEVE DHE PJESËTARËVE TË TYRE]	245
NENI 60	[KËSHILLI KONSULTATIV PËR KOMUNITETE]	248
NENI 61	[PËRFAQËSIMI NË PUNËSIM NË INSTITUCIONET PUBLIKE]	250
NENI 62	[PËRFAQËSIMI NË ORGANET E PUSHTETIT LOKAL]	250

KAPITULLI IV KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

NENI 63	[PARIMET E PËRGJITHSHME]	257
NENI 64	[STRUKTURA E KUVENDIT]	259
NENI 65	[KOMPETENCAT E KUVENDIT]	262
NENI 66	[ZGJEDHJA DHE MANDATI]	266
NENI 67	[ZGJEDHJA E KRYETARIT DHE NËNKRYETARËVE]	270
NENI 68	[SEANCAT]	276
NENI 69	[ORARI I SEANCAVE DHE KUORUMI]	281
NENI 70	[MANDATI I DEPUTETËVE]	285
NENI 71	[KUALIFIKIMET DHE BARAZIA GJINORE]	302
NENI 72	[PAPAJTUESHMËRIA]	310
NENI 73	[PAMUNDËSIA E KANDIDIMIT]	312
NENI 74	[USHTRIMI I FUNKSIONIT]	328

NENI 75	[IMUNITETI].....	330
NENI 76	[RREGULLORJA E PUNËS].....	337
NENI 77	[KOMISIONET].....	344
NENI 78	[KOMISIONI PËR TË DREJTAT DHE INTERESAT E KOMUNITETEVE]	352
NENI 79	[NISMA LEGJISLATIVE]	356
NENI 80	[MIRATIMI I LIGJEVE]	360
NENI 81	[LEGJISLACIONI ME INTERES VITAL].....	372
NENI 82	[SHPËRNDARJA E KUVENDIT]	374
KAPITULLI V	PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS	380
NENI 83	[STATUSI I PRESIDENTIT].....	386
NENI 84	[KOMPETENCAT E PRESIDENTIT]	392
NENI 85	[KUALIFIKIMI PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT].....	413
NENI 86	[ZGJEDHJA E PRESIDENTIT]	414
NENI 87	[MANDATI DHE BETIMI].....	416
NENI 88	[PAPAJTUESHMËRIA]	418
NENI 89	[IMUNITETI].....	419
NENI 90	[MUNGESA E PËRKOHSHME E PRESIDENTIT].....	421
NENI 91	[SHKARKIMI I PRESIDENTIT]	422
KAPITULLI VI	QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	425
NENI 92	[PARIMET E PËRGJITHSHME]	431
NENI 93	[KOMPETENCAT E QEVERISË]	436
NENI 94	[KOMPETENCAT E KRYEMINISTRIT]	445
NENI 95	[ZGJEDHJA E QEVERISË]	454
NENI 96	[MINISTRITË DHE PËRFAQËSIMI I KOMUNITETEVE].....	459
NENI 97	[PËRGJEGJËSIA]	463
NENI 98	[IMUNITETI].....	465
NENI 99	[PROCEDURAT].....	466
NENI 100	[MOCIONI I VOTËBESIMIT]	467
NENI 101	[SHËRBIMI CIVIL].....	469
KAPITULLI VII	SISTEMI I DREJTËSISË	472
NENI 102	[PARIMET E PËRGJITHSHME TË SISTEMIT GJYQËSOR]	472
NENI 103	[ORGANIZIMI DHE JURISDIKSIONI I GJYKATAVE]	498
NENI 104	[EMËRIMI DHE SHKARKIMI I GJYQTARËVE]	503
NENI 105	[MANDATI DHE RIEMËRIMI]	508
NENI 106	[PAPAJTUESHMËRIA]	509
NENI 107	[IMUNITETI].....	510
NENI 108	[KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS].....	512
NENI 109	[PROKURORI I SHTETIT]	520
NENI 110	[KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS].....	550
NENI 111	[AVOKATURA]	552

KAPITULLI VIII GJYKATA KUSHTETUESE	554
NENI 112 [PARIMET E PËRGJITHSHME]	564
NENI 113 [JURISDIKSIONI DHE PALËT E AUTORIZUARA].....	571
NENI 114 [PËRBËRJA DHE MANDATI I GJYKATËS KUSHTETUESE]	600
NENI 115 [ORGANIZIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE].....	605
NENI 116 [EFEKTI JURIDIK I VENDIMEVE]	605
NENI 117 [IMUNITETI].....	607
NENI 118 [SHKARKIMI].....	608
KAPITULLI IX MARRËDHËNIET EKONOMIKE	609
NENI 119 [PARIMET E PËRGJITHSHME]	609
NENI 120 [FINANCAT PUBLIKE].....	613
NENI 121 [PRONA].....	615
NENI 122 [PËRDORIMI I PASURISË DHE BURIMEVE NATYRORE].....	616
KAPITULLI X QEVERISJA LOKALE DHE ORGANIZIMI TERRITORIAL	618
NENI 123 [PARIMET E PËRGJITHSHME]	623
NENI 124 [ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I VETËQEVERISJES LOKALE].....	629
KAPITULLI XI SEKTORI I SIGURISË	638
NENI 125 [PARIMET E PËRGJITHSHME]	639
NENI 126 [FORCA E SIGURISË E KOSOVËS]	642
NENI 127 [KËSHILLI I SIGURISË I KOSOVËS].....	644
NENI 128 [POLICIA E KOSOVËS]	646
NENI 129 [AGJENCIA E KOSOVËS PËR INTELIGJENCË]	648
NENI 130 [AUTORITETI CIVIL I AVIACIONIT].....	649
NENI 131 [GJENDJA E JASHTËZAKONSHME].....	650
KAPITULLI XII INSTITUCIONET E PAVARURA	655
NENI 132 [ROLI DHE KOMPETENCAT E AVOKATIT TË POPULLIT]....	656
NENI 133 [ZYRA E AVOKATIT TË POPULLIT]	659
NENI 134 [KUALIFIKIMI, ZGJEDHJA DHE SHKARKIMI I AVOKATIT TË POPULLIT]	661
NENI 135 [RAPORTIMI I AVOKATIT TË POPULLIT]	664
NENI 136 [AUDITORI I PËRGJITHSHËM I KOSOVËS]	665
NENI 137 [KOMPETENCAT E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË KOSOVËS].....	667
NENI 138 [RAPORTIMI I AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM TË KOSOVËS].....	667
NENI 139 [KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE]	668
NENI 140 [BANKA QENDRORE E KOSOVËS].....	670
NENI 141 [KOMISIONI I PAVARUR I MEDIEVE].....	671
NENI 142 [AGJENCITË E PAVARURA].....	672

KAPITULLI XIII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	673
NENI 143 [PROPOZIMI GJITHËPËRFSHIRËS PËR ZGJIDHJEN E STATUSIT TË KOSOVËS]	674
NENI 144 [AMENDAMENTIMI]	676
NENI 145 [VAZHDIMËSIA E MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE DHE E LEGJISLACIONIT TË APLIKUESHËM]	678
 KAPITULLI XIV DISPOZITAT KALIMTARE	684
NENI 146 [PËRFAQËSUESI NDËRKOMBËTARË CIVIL]	687
NENI 147 [AUTORITETI PËRFUNDIMTARË I PËRFAQËSUESIT NDËRKOMBËTARË CIVIL]	688
NENI 148 [DISPOZITAT TRANSICIONALE PËR KUVENDIN E KOSOVËS]	689
NENI 149 [MIRATIMI FILLESTAR I LIGJEVE ME INTERES VITAL]	691
NENI 150 [PROCESI I EMËRIMIT TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE]	691
NENI 151 [PËRBËRJA E PËRKOHSHME E KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS]	694
NENI 152 [PËRBËRJA E PËRKOHSHME E GJYKATËS KUSHTETUESE]	696
NENI 153 [PRANIA NDËRKOMBËTARE USHTARAKE]	699
NENI 154 [TRUPAT E MBROJTJES TË KOSOVËS]	700
NENI 155 [SHTETËSIA]	701
NENI 156 [REFUGJATËT DHE PERSONAT E ZHVENDOSUR BRENDA VENDIT]	703
NENI 157 [AUDITORI I PËRGJITHSHËM I KOSOVËS]	703
NENI 158 [AUTORITETI QENDROR BANKAR]	704
NENI 159 [PRONAT DHE NDËRMARRJET NË PRONËSI SHOQËRORE]	704
NENI 160 [NDËRMARRJET NË PRONËSI PUBLIKE]	706
NENI 161 [TRANSICIONI I INSTITUCIONEVE]	707
NENI 162 [HYRJA NË FUQI]	707

Bibliografia

1. Additional Protocol to the European Charter of Local Self-Government on the right to participate in the affairs of a local authority, *CETS No. 207*, Utrecht, 16.XI.2009. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/207.htm>;
2. Adler, D. G. (2012) ‘*The Law: The Framers and Executive Prerogative: A Constitutional and Historical Rebuke*’. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 42, No. 2, p. 376-389.
3. Agamben, (2005), “*State of Exception*”, University Of Chicago Press; Chicago;
4. Agamben, Giorgio (2005) ‘*State of Exception*’. Chicago: University of Chicago Press.; Barzilai, Gad (1996) ‘*Wars, Internal Conflicts, and Political Order*’. Albany: State University of New York Press. Në internet: <http://www.press.uchicago.edu/Misc/Chicago/009254.html>;
5. *AKTGJYKIM në Rastet K045/12 dhe K046/12. Kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për fshatin Hoqa e Madhe dhe të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit*, Nr. Ref.:AGJ 255/12, Prishtinë: 25 qershor 2012.
6. Aktgjykim në Rastin nr. KI 108/10. Parashtruesi: Fadil Selmanaj. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. or. 170/2009, të 25 shtatorit 2009. Datë: 5 dhjetor 2011. Nr. Ref.: AGJ. 163/11);
7. Aktgjykim në Rastin nr. I04/12. Parashtruesi: Esat Kelmendi. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, të 30 nëntorit 2011. Datë: 20 korrik 2012. (Nr. Ref.: AGJ 285/12).
8. Aktgjykim në Rastin nr. 150/ 12. Parashtruesi: Agush Lolluni. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011, dhe Vendimit nr. 02 (207) 2010, të 4 tetorit 2010, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga Komuna e Junikut. Datë: 16 korrik 2012 (Nr. ref.: AGJ/279/12);
9. *Aktgjykim në Rastin nr. K098/11. Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës* (Datë: 20 shtator 2011 (Nr. ref.: AGJ138/11).
10. Aktgjykim në Rastin nr. KI 129/11. Parashtruesi: Viktor Marku. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. Dr. 158/2011 të 5 korrikut 2011 dhe vendimit nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga ana e Komunës së Klinës. Datë: 17 korrik 2012. (Nr. ref.: AGJ/282/12);
11. Aktgjykim në Rastin nr. KI 55/11. Parashtruesi: Fatmir Pireci. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010. Datë: 16 korrik 2012(Nr. ref.: RK/277/12);
12. Aktgjykim në Rastin nr. KI47/12. Parashtruesi: Islam Thaçi. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 188/2009, të 7 dhjetorit 2011. Datë: 16 korrik 2012 (Nr.ref.: AGJ 278/12);
13. Aktgjykim, 5 U.S. 137, 177-78 (1803);

14. Aktgjykim, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (Ref. Nr.: AGJ 07/10): datë 18 mars 2010;
15. Aktgjykim, Nr. K057/12, Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit Nr. 04/1-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë të Kosovës, datë 20 shtator 2012, Nr. ref.: AGJ297/12, paragrafët 62-77.
16. Aktgjykim, Rasti nr. KI 47/10, ‘Naim Rrustemi dhe 31 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së tij Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës’, datë 28 shtator 2010, Nr. ref.: AGJ 43/10.
17. Aktgjykim. Rasti nr. K.O. 80/10, ‘Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij Dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska’, datë 7 tetor 2010, Ref. nr. AGJ.: 46/10.
18. Aktgjykim. Rasti nr. K.O. 97/10, ‘Kërkesa e parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK)’, datë 22 dhjetor 2010, Ref. nr. AGJ 78/10.
19. Aktgjykim: Rastet K.O.29/12 dhe K.O. 48/12, ‘Amandamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars dhe 4 maj 2012, datë 20 korrik 2012’, Nr. ref.: AGJ 284/12.
20. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Belgjikës (atëbotë quhej: Gjykata e Arbitrazhit) Nr. 35/94, i datës 10 maj 1994).
21. Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, No. 1 BvR 1595/92; 1BvR 1606/92, i datës 14 korrik 1994).
22. Aktgjykimi në rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/, ‘Amandamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012’, datë 20 korrik 2012, Ref.: AGJ 284/12.
23. Aktgjykimi në rastin K.O.29/11, ‘Sabri Hamiti dhe deputetët e tjerë: Vlerësimi kushtetues i vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 04-V-04, i 22 shkurtit 2011, përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës’, datë 30 mars 2011, Ref.: AGJ.: 107/11.
24. *Aktgjykimi në Rastin nr. KI 25/10. Parashtruesi i kërkesës: Agjencia Kosovare e Privatizimit. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC 09—89, të 4 shkurtit 2010.*
25. Aktgjykimi në Rastin KO 29/11: *Sabri Hamiti dhe Deputetët e tjerë. Vlerësimi Kushtetues i Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 04-V-04, përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës të 22 shkurtit 2011 (Ref. No.: AGJ 107/11). Datë: 30 mars 2011*
26. *AKTVENDIM PER PAPANUESHMËRI në Rastin nr. K0 148/11. Parashtruesi: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 11 par. 1, nenit 32 par. 1 e 2, nenit 34 par. 2, dhe të nenit 38 në lidhje me nenet 11, 32 e 34 të Ligjit për Avokatin e Popullit, Ligji Nr. 03/L-195 i 27 gushtit 2010, dhe i kërkesës për masë të përkohshme. Prishtinë: 26 tetor 2012 (Nr. ref. K33S/12)*

27. Alastair Mowbray, (2012), “*Cases and Materials and Commentary on the European Convention on Human Rights*”, Oxford University Press: USA;
28. Stone, Alec (2002) ‘Constitutional Courts and Parliamentary Democracy’. *West European Politics*. Vol. 25 (1): p.77-100;
29. Allain R. Brewer-Carias (ed.), *Constitutional Courts as Postive Legislators. A Comparative Law Study*. Cambridge: Cambridge University Press, 471-495, nw p. 476-477; Boyron, Sophie (2011) “France”;
30. Amar, Reed, Akhil and Katyal, Kumar, Neal (1995) ‘Executive Privileges and Immunities: The Nixon and Clinton Cases’. *Harvard Law Review*. Vol. 108, No. 3, p. 701-726.
31. Sajo, Andras (1999) ‘Limiting the Government. An Introduction to Constitutionalism’. Budapest: CEU Press, p. 180-183 & 173-204 & 158-159 & 190-193;
32. Heard, Andrew (2007) ‘Just What Is a Vote of Confidence? The Curious Case of May 10, 2005’. *Canadian Journal of Political Science / Revue canadienne de science politique*. Vol. 40 (2): p. 395-416;
33. Heywood, Andrew (1997) *Politics*. London: Macmillan Foundations. (chapter 16);
34. Andrews, W.G., (1963), “*Constitutions and Constitutionalism*”, Van Nostrand: Princeton, New Jersey, fq.161-165;
35. Anson, W. R., (1907), “*The Law and Custom of the Constitution*”, The Clarendon Press: Oxford, fq. 85;
36. King, Anthony & Allen, Nicholas (2010) 'Off With Their Heads': British Prime Ministers and the Power to Dismiss'. *British Journal of Political Science*. Vol. 40 (2): p. 249-278;
37. Sayers, M. Anthony & Moon, Jeremy (2002) ‘State Government Convergence and Partisanship: A Long-Run Analysis of Australian Ministerial Portfolios’. *Canadian Journal of Political Science / Revue canadienne de science politique*. Vol. 35 (3): p. 589-612;
38. Ljiphart, Arend (1969) ‘Consociational Democracy’. *World Politics*. Vol. 21, No. 2, p. 207-225;
39. Arsenov, S., (1987), “Pravo na rad, zaposlenost i nezaposlenost u suvremenoj teoriji i praksi”. *Socijalna politika*, nr. 6, fq. 49-54;
40. Atwood, K., Melissa (1998) ‘Who Has the Last Word: An Examination of the Authority of State Bar Grievance Committees to Investigate and Discipline Prosecutors for Breaches of Ethics’. *Journal of Legal Profession*. Vol. 22, pp. 201;
41. Aucoin, Louis M. (1992) ‘Judicial Review in France: Access of the Individual Under French and European Community Law in the Aftermath of France’s Rejection of Bicentennial Reform’. *Boston College International & Comparative Law Review*. Vol. 15: p. 443-469. Nē internet gjendet nē: <http://lawdigitalcommons.bc.edu/iclr/vol15/iss2/7>).
42. Australian Bar Association (2004) ‘Charter of Judicial Independence’, available at: http://www.austbar.asn.au/index.php?option=com_content&view=article&id=27:general-papers&catid=33&Itemid=42.
43. Bačić, A. (ed.), (1992), “*Ustav i ustavna diktatura*”. Knjizevni krug: Split;

44. Baer, Susanne (1998-1999) 'Equality: The Jurisprudence of the German Constitutional Court'. *Columbia Journal of European Law*. Vol. 5: p. 249-260;
45. Bagehot, W., (2001), "*The English Constitution*", Cambridge University Press: Cambridge;
46. Bantekas, Ilias dhe Oette, Lutz (2013), "*International Human Rights Law and Practice*", Cambridge University Press: Cambridge, Kapitulli 8 ("Civil and Political Rights");
47. Bard A. Andreassen and Marks, P. Stephen (eds.), (2007), "*Development As a Human Right: Legal, Political, and Economic Dimensions*", Harvard Series on Health and Human Rights, (FXB Center for Health and Human Rights: Harvard);
48. Barnett, A., (1997), "Constitutional Possibilities". *The Political Quarterly*. Vol. 68 Issue 4 (October-December fq. 361-371);
49. Barnstedt, Elke Luise (2009) 'Differences Between Constitutional Complaints That Challenge Court Rulings And Those That Challenge Statutes'. European Commission For Democracy Through Law. Fourth Conference of Secretaries General of Constitutional Courts and Courts of Equivalent Jurisdiction, Ankara, Turkey, 1-2 October 2009. Venice Commission. CDL-JU(2009)055;
50. Bass, Evan, Peter (1987) 'Ex-Head of State Immunity: A Proposed Statutory Tool of Foreign Policy'. *The Yale Law Journal*, Vol. 97, No. 2, p. 299-319.
51. Basta-Posavec, L., (1993), "Pravna država i konstitucionalna demokratija, *Anali Pravnog Fakulteta u Beogradu*", nr. 1-2, fq. 26-31;
52. Baum, R., Jeeyang (2007) 'Presidents Have Problems Too: The Logic of Intra-branch Delegation in East Asian Democracies'. *British Journal of Political Science*. Vol. 37, p. 659-684,
53. Beasley, H. (2010), "*Maurine Eleanor Roosevelt: Transformative First Lady*", University Press of Kansas: USA, fq. 214, 220-221;
54. Belamy, Richard (2008), "Citizenship: A Very Short Introduction", Oxford University Press: Oxford; kapitulli 4 ("Rights and the "Right to Have Rights") fq. 78-96; dhe kapitulli 5 ("Participation and Democracy") fq. 97-123
55. Belletti, Michele (2009) 'Il sistema di giustizia costituzionale portoghese'. Në Luca Mezzetti (ed.), *Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale*. Padova: CEDAM, p. 267-29;
56. Ben-Naftali, Orna (ed.), (2011), "*International Humanitarian Law and International Human Rights Law*", Oxford University Press: Oxford;
57. Beth, Loren P. (1962) 'Politics, the Constitution, and the Supreme Court; an Introduction to the Study of Constitutional Law'. New York: Harper & Row;
58. *Blanco Callejas v. Spain* (dec.), GjedNj, no. 64100/00, 18 June 2002
59. Reka, Blerim (ed.) (2011). *Dhjetë vite nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit*. UEJL: Tetovë.
60. Bogdanor, V., (1997), "*The Monarchy and the Constitution*", Oxford University Press: Oxford;
61. Bogdany, Armin Von (2000) 'The European Union as a Human Rights Organization? Human rights and the core of the European Union'. *Common Market Law Review*. Vol. 37: p. 1307-1338;
62. Borowski, M. (2003) 'The Beginnings of Germany's Federal Constitutional Court'. *Ratio Juris*. Vol. 16: p. 155-186;

63. Bosnić, P., (1988), "O državljanstvu u jugoslovenskom pravu i međunarodnim ugovorima", *Zbornik radova Pravnog fakulteta u Splitu*, Vol. 25, fq. 35-48;
64. Bracher, D., Karl (1964) 'Problems of Parliamentary Democracy in Europe'. *Daedalus*. Vol. 93, No. 1, A New Europe?, p. 179-198.
65. Bradshaw, K., and Pring, D., (1972), "*Parliament and Congress*", Quartet Books: London;
66. Brewer-Carias, R., Allan (2011) 'Constitutional Courts as Positive Legislators. A Comparative Law Study'. Cambridge: Cambridge University Press, Kapitulli 5 'Constitutional Courts as Legislators on Matters of Judicial Review', fq.173-188.
67. Briffault, Richard (1990) 'Our Localism: Part I--The Structure of Local Government Law'. *Columbia Law Review*. Vol. 90 1): p. 1-115;
68. Brown, A. J. (2002) 'Subsidiarity or Subterfuge? Resolving the Future of Local Government in the Australian Federal System'. *Australian Journal of Public Administratio*. Vol. 61: p. 24-42;
69. Brown, Wendy (2006), "*Regulating Aversion: Tolerance in the Age of Identity and Empire*", Princeton University Press: Princeton, New Jersey;
70. Brownlie, I., (1981), "*Basic Documents on Human Rights*", 2nd edition, Oxford University Press: Oxford;
71. Bruff, H., Harold (2007) 'The Incompatibility Principle'. *Administrative Law Review*. Vol. 59, No. 2, pp. 225-268.
72. Bunce Valerie, 'Comparing East and South', në 'Democracy After Communism',
73. Jacobsohn, J., Gary (2006). An unconstitutional constitution? A comparative perspective. *Intnernational Journal of Constitutional Law*. Vol. 4, No. 3, pp. 460-475.
74. Bustamante, Thomas & Bustamante, Evanilda de Godoi (2010) 'Constitutional Courts as "Negative Legislators": The Brazilian Case'. *Revista Jurídica Piélagus*, pp. 137-156;
75. C. Morgan (1964) 'Selecting a Prime Minister'. *The Australian Quarterly*. Vol. 36 (2): p. 35-43;
76. Calabresi, G., Steven and Larsen, L., Joan (1994) 'One Person One Office: Separation of Powers or Separation of Personnel'. *Cornell Law Review*. Vol. 79, p. 1045-1057;
77. Calise, Mauro (1994) 'The Italian Particracy: Beyond President and Parliament'. *Political Science Quarterly*. Vol. 109, No. 3, Conference Issue: Presidential and Parliamentary Democracies: Which Work Best?, p. 441- 460.
78. Canadian Supreme Court, *Manitoba Prov. Judges Assn. v. Manitoba (Minister of Judges)*, Judgement, 1997.
79. Cappelletti, Mauro (1970) 'Judicial Review in Comparative Perspective'. *California Law Review*. Vol. 58 (5): p. 1017-1053;
80. Cappelletti, Mauro, Merryman, Henry, John, and Perillo, M., Joseph (1967) 'The Italian Legal System'. Stanford: Stanford University Press;
81. Carey, M. John, (2008), "*Legislative Voting and Accountability*. Cambridge Studies in Comparative Politics", Cambridge University Press: Cambridge;
82. Cartabia, Marta (1990-1991) 'The Italian Constitutional Court and the Relationship between the Italian Legal System and the European Community'. *Michigan Journal of International Law*. Vol. 12: p. 173-203;

83. Cassese, A. (ed.), (2009), "UN Law - Fundamental Rights - Two Topics in International Law", Springer: New York;
84. Haines, Grove Charles (1922) 'Ministerial Responsibility Versus the Separation of Powers'. *The American Political Science Review*. Vol. 16 (2): p. 194-210;
85. Charlie Jeffery (2006) 'Devolution and Local Government'. *Publius*. Vol. 36 (1);
86. Cholewinski, Ryszard (1998) 'The Protection of Human Rights in the New Polish Constitution'. *Fordham International Law Journal*. Vol. 22 (2): p. 236-291;
87. Kelleher, A. Christine & Wolak, Jennifer (2007) 'Explaining Public Confidence in the Branches of State Government'. *Political Research Quarterly*. Vol. 60 (4): p. 707-721;
88. Anderson, J. Christopher & Tverdova, V. Yuliya (2001) 'Winners, Losers, and Attitudes about Government in Contemporary Democracies'. *International Political Science Review / Revue internationale de science politique*. Vol. 22 (4), 'The Dynamics of Democratic Satisfaction. Dynamique de la satisfaction démocratique': p. 321-338;
89. Cohler, M., Anne, Miller, C., Basia, and Stone, S. Harold, (eds.) (1989) 'Montesquieu. Spirit of Laws'. Cambridge Texts in the History of Political Thought. Cambridge: Cambridge University Press.
90. Čok, V., (1993) "Jezik u sistemu prava manjina", *Jugoslovenska Revija za Medjunarodno Pravo*, nr. 1-2, fq. 134-144;
91. Čok, V. (1985), "Evolucija shvatanja o pravima žena kao pravima čoveka - od osnivanja Ujedinjenih nacija do danas", *Jugoslovenska Revija za Medjunarodno Pravo*, nr. 1-2, fq. 242-262;
92. Čok, V., (1978) "Neki preduslovi za ostvarivanje prava na obaveštenost", nē: Zvonimir Separevic (ed.), *Odgovornost u informativnoj djelatnosti* (Centar za strucno usavršavanje i suradnju s udruženim radom Pravnog Fakulteta: Zagreb, fq. 171-179.
93. Čok, V., (1987), "Državljanstvo deteta u pravu savremenih država", *Strani pravni život*, Seria D, fq. 73-85.
94. Čok, V., (1989) "Svojina kao pravo čoveka" *Jugoslovenska Revija za Medjunarodno Pravo*, nr. 1-2, fq. 38-49.
95. Čok, V., (1993), "Dvojno državljanstvo u uporednom i međunarodnom pravu", *Jugoslovenska Revija za Medjunarodno Pravo*, nr. 3, fq. 259-280.
96. Čok, V., (1995), "Pravo na državljanstvo - uticaj Ujedinjenih nacija na njegov razvoj", *Jugoslovenska Revija za Medjunarodno Pravo*, nr. 1-3, fq. 188-202.
97. Cole, Taylor (1959) 'Three Constitutional Courts: A Comparison'. *The American Political Science Review*. Vol. 53 (4): p. 963-984;
98. Comella, F. Victor (2004) 'The European model of constitutional review of legislation: Toward decentralization?'. *International Journal of Constitutional Law*. Vol. 2 (3): p. 461-491;
99. Comella, Victor Ferreres (2003-2004) 'The Consequences of Centralizing Constitutional Review in a Special Court: Some Thoughts on Judicial Activism'. *Texas Law Review*. Vol. 82 (7): p. 1705-1715;
100. Comments on the Draft Law on the Constitutional Court of the Republic of Serbia, European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Opinion no. 445/2007, 7 November 2007, CDL□AD (2007) 039;

101. Commission Staff Working Document: 'Kosovo 2011 Progress Report'. Commission of the European Communities, SEC(2011) 1207, Brussels; Commission Staff Working Document: 'Kosovo 2010 Progress Report'. Commission of the European Communities, SEC(2010)1329, Brussels;
102. Congleton, D. Roger (2010), *"Perfecting Parliament: Constitutional Reform, Liberalism and the Rise of Western Democracy"*, Cambridge University Press: Cambridge;
103. Constitutional Court of Kosovo, *AAB University LLC v. Government of the Republic of Kosovo*, Case 41/09, Decision on Inadmissibility.
104. Constitutional Court of South Africa, *TFH van Rooyen and Two Others v The State and Six Others*, Judgment, Case No 21/01.
105. Consultative Council of European Prosecutors (CCPE), 'Opinion on the Role of Prosecution Services outside the Criminal Law Field, the Consultative Council of European Prosecutors', No. 3 (2008), adopted by the CCPE at its 3rd plenary meeting, Strasbourg, October 2008. CCPE(2008)3.
106. Corrado, Michael Louis (2004) 'Comparative Constitutional Review: Cases and Materials'. Durham, NC: Carolina Academic Press;
107. Corwin, Edward S. (1934) 'The Twilight of the Supreme Court - A History of Our Constitutional Theory'. New Haven: Yale University Press;
108. Council of Europe (1994) 'Recommendation of the Committee of Ministers to Member States on the Independence, Efficiency and Role of Judges', No. R (94) 12, adopted by the Committee of Ministers, 13 October 1994 at the 518th meeting of the Ministers' Deputies, available at: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=534553&SecMod=1&DocId=514386&Usage=2>.
109. Council of Europe (2010) 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report'. Strasbourg: Council of Europe Publishing;
110. Council of Europe, 'Role of the public prosecutor's office in a democratic society governed by the rule of law', Recommendation 1604 (2003) of the Parliamentary Assembly.
111. Council of Europe, European Charter on the statute for judges and Explanatory Memorandum', DAJ/DOC (98) 23, adopted on multilateral meeting on the statute for judges in Europe, organized by the Council of Europe, between 8-10 July 1998, available at: http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/European-Charter-on-Statute-of-Judges_EN.pdf.
112. Council of Europe, Parliamentary Assembly, (2003) 'The institution of Ombudsman', Recommendation 1615, 8 September 2003. Nē internet: <http://assembly.coe.int/documents/adoptedtext/TA03/EREC1615.htm>.
113. Cross, Sharyl, Kentera, Savo, Vukadinovic, Radovan dhe R. Craig Nation (eds.), (2013), *"Shaping South East Europe's Security Community for the Twenty-First Century: Trust, Partnership, Integration. New Security Challenges"*, Palgrave Macmillan: United Kingdom;
114. Csongor Kuti, (2009), *"Post-comunist Restituion and the Rule of Law"*, CEU Press: Budapest;
115. Csongor Kuti, (2009). *Post-Communist Restitution and the Rule of Law*. Central European University Press: Budapest/New York.

116. *D. Wolf v. Panama*, UN Human Rights Committee, UN Doc. GAOR, A/48/40 (vol. 2).
117. Dammer, R. Harry, Albanese, S. Jay (2010), ‘*Comparative Criminal Justice Systems*’, 4 edition, Cengage Learning: Belmont, USA;
118. Daniel Diermeier & Razvan Vlaicu (2011) ‘Executive Control and Legislative Success’. *The Review of Economic Studies*. Vol. 78 (3): p. 846-871;
119. Daniel Diermeier, Hülya Eraslan and Antonio Merlo (2003) ‘A Structural Model of Government Formation’. *Econometrica*. Vol. 71 (1): p. 27-70;
120. Danilenko, G. M. (1994) ‘The New Russian Constitution and International Law’. *The American Journal of International Law*. Vol. 88(3): 451-470;
121. Dann, P. (2003) ‘European Parliament and Executive Federalism: Approaching a Parliament in a Semi-Parliamentary Democracy’. *European Law Journal*. Vol. 9, p. 549-574.
122. Darke, W. Paul, (2009) ‘Between Tyranny and Anarchy: A History of Democracy in Latin America, 1800-2006’. Stanford: Stanford University Press, p.. 34-39.
123. David J. Bederman (2008) ‘The Classical Foundations of the American Constitution’, Cambridge: Cambridge University Press; Martin van Geldren and Quentin (eds.) (2002) ‘Republicanism. A Shared European Heritage: Vol. I and II’, Cambridge: Cambridge University Press.
124. David P. Baron (1998) ‘Comparative Dynamics of Parliamentary Governments’. *The American Political Science Review*. Vol. 92,(3): p. 593-609.
125. Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), *How Constitutions Change. A Comparative Study*. Oxford and Portland, Oregon: Hart Publishing, p. 115-142, nw fq. 139-142;
126. Decision on ‘Criminal Prosecution. Power of Court to Appoint Private Attorney to Conduct Prosecution’. *Columbia Law Review (1936)* Vol. 36, No. 2, pp. 323-324;
127. Degan, V.Đ., (1989), “Pojam i sadržaj "naročito teških kršenja" prava čovjeka“, *Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu*, nr. 5-6, (Supplement), fq. 755-772.
128. Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, datë 17 shkurt 2008
129. Desmond, Matthew and Emirbayer, Mustafa, (2009), “*Racial Domination, Racial Progress: The Sociology of Race in America*”, McGraw-Hill: New York;
130. Diamon, Larry and Plattner, F. Marc (eds.) (2002). Baltimore and London: The John Hopkins University Press, fq. 18-32.
131. Dicey, A., (1992), “Opsadno stanje“, në: Bačić, A. (ed.), *Ustav i ustavna diktatura* (Knjizevni krug: Split;
132. Diehl F. Paul (ed.), (2010), “*The Politics of Global Governance: International Organizations in an Interdependent World*”, Lynne Rienner Publishers: Boulder, Colorado;
133. Dieter Fleck (ed. 2001) ‘The Handbook of The Law of Visiting Forces’. Oxford: Oxford University Press: Oxford, ne vecanti fq. 3- 47.
134. Dobrković, N., (1992), “Južni Tiroi - model za rešavanje položaja i statusa nacionalnih manjina?“, *Međunarodni problemi*, nr. 3-4, fq. 272-286.
135. Doli, Dren & Korenica, Fisnik (2010) ‘Kosovar Constitutional Court’s Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses’. *German Law Journal*. Vol. 11:

- 803-836, në internet: <http://www.germanlawjournal.com/index.php?pageID=11&artID=1268>;
136. Campus, Donatella and Pasquino, Gianfranco (2006) 'Leadership in Italy: The Changing Role of Leaders in Elections and in Government'. *Journal of Contemporary European Studies*. Vol. 14 (1): 25-40;
 137. Donnelly, J., (1996), "Ljudska prava kao prirodna prava", *Pravni život*, nr. 12, fq. 945-962;
 138. Donnelly, Jack (2013), "*Universal Human Rights in Theory and Practice*", Cornell University Press: USA; fq. 75-92.
 139. Dorsen, Norman, Rosenfeld, Michel, Sajo, Andras, and Baer, Susanne (2003) (eds.), 'Comparative Constitutionalism. Cases and Materials'. West Group: St. Paul, MN, p. 127.
 140. *Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetët e Kuvendit të Kosovës. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 4 dhe 60 të Ligjit mbi Shëndetësinë nr. 04/L-125, miratuar nga Kuvendi më 13 dhjetor 2012*. Aktgjykimi në Rastin KO. 131/12. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Datë: 10 prill 2013. (Ref. No.: MPM 406/13).
 141. Duhamel, Oliver, (2001) 'France's New Five - Year Presidential Term. BROOKINGS, 1 March 2001. Në internet, në këtë ueb-faqe: <http://www.brookings.edu/research/articles/2001/03/france-duhamel> (herën e fundit shikuar në nëntor 2012).
 142. Dummet, M., (1984), "*Voting Procedures*", Oxford University Press: Oxford;
 143. Duverger, Maurice, (1980) 'A New Political System Model: Semi-Presidential Government'. *European Journal of Political Research*. Vol. 8 (Spring), p. 52-69.
 144. Dyzenhaus, David (1997) 'Legality and Legitimacy. Carl Schmitt, Hans Kelsen and Herman Heller in Weimar'. Oxford: Oxford University Press, p. 51-58 & 70-84;
 145. Easterly, Russell William (2000); "*Can Institutions Resolve Ethnic Conflict?*", The World Bank Research Development Group Macroeconomics and Growth: Washington;
 146. Easton, Kent, (2000) 'Parliamentarism versus Presidentialism in the Policy Arena'. *Comparative Politics*. Vol. 32 (April), p. 355-76;
 147. Edwards, L., John, (1964) '*Law Officers of the Crown: A Study of the Offices of Attorney General and Solicitor General of England, with an Account of the Office of the Director of Public Prosecutions of England*'. London: Sweet & Maxwell;
 148. Elazar, D.J. (ed.), (1994), "*Federal Systems of the World: A Handbook of Federal, Confederal and Autonomy Arrangements*", 2nd ed., Cartermill International: Harlow;
 149. Elgie, Robert (1998) "The Classification of Democratic Regime Types: Conceptual Ambiguity and Contestable Assumptions'. *European Journal of Political Research*. Vol. 33, No. 2, p. 219-238.
 150. Krauss, S. Ellis & Nyblade, B. (2005) 'Presidentialization' in Japan? The Prime Minister, Media and Elections in Japan'. *British Journal of Political Science*. Vol. 35 (2): p. 357-368;
 151. Elly, John (1980) 'Democracy and Distrust: A Theory of Judicial Review'. MA: Harvard University Press. fq. 43-73;

152. Engle, Eric, (2003) 'Extraterritorial Corporate Criminal Liability: A Remedy For Human Rights Violations?'. *St. John's Journal of Legal Commentary*. Vol. 20, No. 2, pp. 287-329.
153. Hasani, Enver (2006) 'The Evolution of the Succession Process in Former Yugoslavia'. *Thomas Jefferson Law Review*. Vol. 29(1).
154. O'Malley, Eoin (2007) 'The Power of Prime Ministers: Results of an Expert Survey'. *International Political Science Review / Revue internationale de science politique*. Vol. 28 (1): p. 7-27;
155. Epstein, Jack Knight & Shvetsova, Olga (2001) 'The Role of Constitutional Courts in the Establishment and Maintenance of Democratic Systems of Government'. *Law and Society Review*. Vol. 35 (1): p. 117-164, (që citon një intervistë nga Leonid Nikitinsky me Boris Ebzeev, botuar në shkrimin "Justice of the Constitutional Court of the Russian Federation". *WINTER E. EUR. CONST. REV.* 83-85, 87 (1997);
156. Posner, A. Eric & Vermeule, Adrian (2007) 'The Credible Executive'. *The University of Chicago Law Review*. Vol. 74 (3): p. 865-913;
157. Chemerinsky, Erwin (2001) 'Against Sovereign Immunity'. *Stanford Law Review*. Vol. 53 (5), *Symposium: Shifting the Balance of Power? The Supreme Court, Federalism, and State Sovereign Immunity* (May, 2001), p. 1201-1224.
158. *European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report* Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe Council of Europe (March 2010) 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report'. Strasbourg: Council of Europe Publishing;
159. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), (1994) 'Models of Constitutional Jurisdiction'. Strasbourg: Council of Europe Press, p. 40-45.
160. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) (2010) 'Report on the Independence of the Judicial System Part I: The Independence of Judges', adopted by the Venice Commission at its 82nd Plenary Session. Venice, 12-13 March 2010. CDL-AD(2010)004.
161. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the Compatibility with Constitutional Principles and the Rule of Law of Actions Taken by the Government and the Parliament of Romania in Respect of Other State Institutions and on the Government Emergency Ordinance on Amendment to the Law No. 47/1992 regarding the Organisation and Functioning of the Constitutional Court and on the Government Emergency Ordinance on amending and completing the Law No. 3/2000 regarding the Organisation of a Referendum of Romania', No. 685/2012, adopted by the Venice Commission at its 93rd Plenary Session, Venice, December 2012. CDL-AD(2012)026, paragraph 70.7.
162. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the draft constitution of the Nakhichevan Autonomous Republic (Azerbaijan Republic)', approved by the Commission at its 33rd Plenary Meeting, Venice, December 1997. CDL-INF (97) 6, p.6.

163. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) 'Judicial Appointments', No. 403/2006, adopted by the Venice Commission at its 70th Plenary Session Venice, March 2007. CDL-AD(2007)028, paragraph 40.
164. European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the Draft Law on the Public Prosecutors' Service of Moldova', No. 473/2008, adopted by the Venice Commission at its 75th Plenary Session, Venice, June 2008. CDL-AD(2008)019.
165. European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Report on European standards as regards the independence of the judicial system'. CDL-AD(2010)040.
166. European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the Regulatory Concept of the Constitution of the Hungarian Republic', adopted at the Commission's 25th Plenary Meeting, Venice, November 1995, kapitulli 11. CDL(1995)073Rev.
167. European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), CDL-AD(2005)014. Opinion on the Federal Law on the Prokuratura (Prosecutor's Office) of the Russian Federation;
168. European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the Draft Law amending the Law of Ukraine on the Office of the Public Prosecutor', CDL-AD(2004)038;
169. European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on the Draft Law on the Public Prosecutors Office and the Draft Law on the Council of Public Prosecutors of "the former Yugoslav Republic of Macedonia', CDL-AD(2007)011;
170. European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on the Draft Constitution of Ukraine (Text approved by the Constitutional Commission on 11 March 1996 (CDL (96) 15)', adopted at the 27th meeting of the Venice Commission on May 1996. CDL-INF (96) 6;
171. European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on the Draft Law on Judges and Prosecutors of Turkey', Opinion No. 610/2011, adopted by the Venice Commission at its 86th Plenary Session, Venice, March 2011. CDL-AD(2011)004.
172. European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on the Draft Law of Ukraine on the Office of the Public Prosecutor', adopted by the Venice Commission at its 79th Plenary Session, Venice, June 2009. CDL-AD(2009)048;
173. European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the regulatory concept of the Constitution of the Hungarian Republic' adopted at the Commission's 25th Plenary Meeting, Venice, 24-25 November 1995, chapter 11, CDL(1995)073rev., chapter 11.
174. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the Draft Amendments to the Law on the State Prosecutor of Montenegro', No. 467/2008, adopted by the Venice Commission at its 74th Plenary Session, Venice, March 2008. CDL-AD(2008)005;
175. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the Constitution of Montenegro' No. 392/2006, adopted by the

- Venice Commission at its 73rd Plenary Session, Venice, December 2007. CDL-AD(2007)047, para. 110-111;
176. European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), ‘Opinion on the Draft Law of Ukraine Amending the Constitutional Provisions on the Procuracy’, No. 380/2006, adopted by the Commission at its 68th plenary session, Venice, October 2006. CDL-AD(2006)029.
 177. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Study on Individual Access to Constitutional Justice* (Adopted by the Venice Commission at Its 85th Plenary Session: Venice, (17-18 December 2010). Study No. 538/2009 (Strasbourg, 27 January 2011);
 178. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the Draft Constitutional Law on Changes and Amendments to the Constitution of Georgia (Chapter VII - Local Self-Government)’, adopted by the Venice Commission at its 82nd Plenary Session, (Venice, 12-13 March 2010) Strasbourg, 15 March 2010 Opinion no. 543/2009, CDL-AD(2010)008;
 179. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Compilation of the Ombudsman Institution’ adopted up to and including the Venice Commission’s 87th Plenary Session, 17-18 June 2011, Strasbourg, 1 December 2011, CDL(2011)079. Nē internet: [http://www.venice.coe.int/docs/2011/CDL\(2011\)079-e.pdf](http://www.venice.coe.int/docs/2011/CDL(2011)079-e.pdf);
 180. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the possible reform of the Ombudsman Institution in Kazakhstan adopted by the Venice Commission at its 71th Plenary Session’, Venice, 1-2 June 2007, CDL-AD(2007)020;
 181. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on Amendments to the Law on the Human Rights Defender of Armenia adopted by the Venice Commission at its 69th Plenary Session’, Venice, 15-16 December 2006, CDL-AD(2006)038.
 182. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the Draft Law on Amendments to the Law on Ombudsman for Human Rights in Bosnia and Herzegovina adopted by the Venice Commission at its 60th Plenary Session’, Venice, 8-9 October 2004, CDL-AD(2004)031.
 183. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the Draft Law on the Public Attorney of “The former Yugoslav Republic of Macedonia” adopted by the Venice Commission at its 54th Plenary Session’, Venice, 14- March 2003, CDL-AD(2003)007.
 184. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Consolidated Opinion On the Law on Ombudsman in the Republic of Azerbaijan’, Strasbourg, 7 September 2001, CDL(2001) 083; dhe European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on Amendments to the Law on the Human Rights Defender of Armenia adopted by the Venice Commission at its 69th Plenary Session’, Venice, 15-16 December 2006, CDL-AD(2006)038.
 185. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Joint Opinion on the Law on the Protector of Human Rights and Freedoms of Montenegro’ prepared by the Venice Commission and the OSCE Office for

- Democratic Institutions and Human Rights (OSCE/ODIHR) and adopted by the Venice Commission at its 88th Plenary Session (Venice, 14-15 October 2011).
186. Ewing, K. D. (2012) 'Economic Rights', në Michel Rosenfeld and Andras Sajó (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*. Oxford Oxford University Press..
 187. Fabbrini, Federico (2008) 'Kelsen in Paris: France's Constitutional Reform and the Introduction of a Posteriori Constitutional Review of Legislation'. *German Law Journal*. Vol. 9: p. 1297-1312, available at <http://www.germanlawjournal.com/index.php?pageID=11&artID=1020>;
 188. Fabre, M.H., (1967), "*Principes républicains de Droit Constitutionnel*", LIBRAIRIE GENERALE DE DROIT ET DE JURISPRUDENCE: Paris;
 189. *Fadil Hoxha dhe 59 të tjerët kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit*, Aktgjykim, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. *Datë: 15 dhjetor 2009 (Ref. No.: MP 06/09)*;
 190. Farr, K., Ann (1984) 'Administration and Justice'. *Criminology*. Vol. 22, pp. 291-319. doi: 10.1111/j.1745-9125.1984.tb00302.x;
 191. Ferejohn, John and Pasquino, Pasquale 'Constitutional Courts as Deliberative Institutions: Towards an Institutional Theory of Constitutional Justice', në *Wojciech Sadurski (ed.) (2010) 'Constitutional Justice, East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in A Comparative Perspective'*. *The Hague: Kluwer Law International*, fq. 21-36;
 192. Filloux, J.C., Filloux, J.C., (1987), "*Durkheim i sociologija prava čovjeka*", në: Josip Obradovic & Dusko Sekulic (ed.), *Suvremena sociologija*, (Sociolosko društvo Hrvatske: Zagreb, fq. 43-45.
 193. Finnouala, Gross. Oren, & Ni Aolain, (2006), "*Law in Times of Crisis: Emergency Powers in Theory and Practice*", Cambridge University Press: Cambridge;
 194. Fisher, L. (2008) 'The Law Treaty Negotiation: A Presidential Monopoly?'. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 38, p. 144-158.
 195. Fisher, Louis (1988) 'Foreign Policy Powers of the President and Congress'. *Annals of the American Academy of Political and Social Science*. Vol. 499, Congress and the Presidency: Invitation to Struggle, p. 148-159.
 196. Fisher, T., Michael (1988) 'Harmless Error, Prosecutorial Misconduct, and Due Process: There's More to Due Process than the Bottom Line'. *Columbia Law Review*. Vol. 88, No. 6, pp. 1298-1324;
 197. Fisher, Z., Stanley, (1988) 'In Search of the Virtuous Prosecutor: A Conceptual Framework'. *American Journal of Criminal Law*. Vol. 15, pp. 204-215;
 198. Frank Stark (1973) 'The Prime Minister as Symbol: Unifier or Optimizer?'. *Canadian Journal of Political Science / Revue canadienne de science politique*. Vol. 6, No. 3: p. 514-515;
 199. Frase, S., Richard (1990) 'Comparative Criminal Justice as a Guide to American Law Reform: How Do the French Do It, How Can We Find Out, and Why Should We Care?'. *California Law Review*. Vol. 78, No. 3, pp. 539-683.
 200. Fredrik Ugglå (2004) 'The Ombudsman in Latin America', *Journal of Latin American Studies*, Vol. 36 (3), p. 423-450;
 201. Fridrich, C.J., "Ustavna diktatura i vojna vlada", ska vit

202. Fridrih, K., (1996), “Konstitucionalizam (ograničavanje i kontrola vlasti)”, CID: Podgorica;
203. Fridrih, K.J., (2005), “Konstitucionalna demokratija - teorija i praksa u Evropi i Americi”, (CID: Podgorica,.
204. Friedrich, C., (1950), “*Constitutional Government and Democracy: Theory and Practice in Europe and America*”, Ginn and Co., Boston, fq. 151;
205. Frowein, J., Peukert, W., (1985), “*Europäische Menschenrechtskonvention: EMRK - Kommentar*, Kehl am Rhein/Strassbourg/Arlington;
206. Gajinov, M., (1988), “Deklaracija o pravu na razvoj“, *Jugoslovenska Revija za Međunarodno Pravo*, nr. 2, fq. 235-250.
207. GAP, *Rregulli 61: Ligjet e Ahtisarit - pasojat dhe mësimet e nxjerra nga miratimi i ligjeve në procedurë të përshpejtuar* (Prishtinë: dhjetor 2010). Në internet: http://www.institutigap.org/documents/41927_Rregulli_61.pdf;
208. Gardbaum, Stephen (2001) ‘The New Commonwealth Model of Constitutionalism’. *American Journal of Comparative Law* Vol. 49: p. 714-715;
209. Garlicki, Lech (2007) ‘Constitutional Courts Versus Supreme Courts’. *International Journal of Constitutional Law*. Vol. 5 (1): p. 44-68;
210. Gashi, Haxhi (2011). Konflikti Lidhur me Privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore: Ndryshimi i Ligjit për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, i Ligjit për AKP-në dhe Ligjet Relevantet. *E DREJTA/LAW* Nr. 2/2011, fq. 47-63.
211. Geneva Centre for Democratic Control of Armed Forces, tw titulluar si *Parliamentary Oversight of the Security Sector* (IPU and DCAF: Geneva, 2003).
212. George Sutherland (1910) ‘The Internal and External Powers of the National Government’. *The North American Review*. Vol. 191, No. 652: p. 373-389;
213. Gewirth, A., (1978), “Osnova i sadržaj ljudskih prava”, *Dometi*, nr. 4, fq. 133-148.
214. Gezim Krasniqi (2010) ‘The challenge of building an independent citizenship Regime in a partially recognized state: the case of Kosovo’. Working Paper no. 2010/04, Edinburgh: Scotland, 2010.
215. Gillis, W. John, Belooof, E., Douglas (2001) ‘Next Step for a Maturing Victim Rights Movement: Enforcing Crime Victim Rights in the Courts’. *McGeorge Law Review*. Vol. 33, No. 3, pp. 689-704.
216. GjedDNJ *Martinie v. France* [GC], GjEDNj, No. 58675/00, ECHR 2006-VI.
217. GjEDNj *F.W. v. France*, No. 61517/00, § 27, 31 March 2005
218. GjEDNj *Padovani vs. Italy*, [1993].
219. GjEDNJ, *Airey v. Ireland*, 11 September 1979, Judgment Series A, No 32.
220. GjEDNj, *Akdivar and Others v. Turkey* Judgment of 16 September 1996, Reports of Judgments and Decisions 1996-IV, p. 1210-1211, paras. 65-68;
221. GjEDNj, *Amuur v. France*, 17/1995/523/609, Judgement, Chamber, ECtHR, 25 June 1996;
222. GjEDNJ, *Artico v. Italy*, May 13 1980, Judgment Series A, No 37.
223. GjEDNJ, *Assenov and Others v. Bulgaria*, §102);
224. GjEDNj, *Azinas v. Cyprus*, No. 56679/00, decision of 28 April 2004, ECtHR;
225. GjEDNj, *Borgers v. Belgium*, 30 October 1991, § 24, Series A no. 214-B
226. GjEDNj, *Brandstetter v. Austria*, 28 August 1991, Judgment, Series A. No. 21,.

227. GjEDNJ, *Brandstetter v. Austria*, Judgment, 28 August 1991, Series A. No. 21, f. 28, para. 68.
228. GjEDNJ, *Brumărescu v. Romania*, Application no. 28342/95, 28 October 1999, Judgment.
229. GjEDNJ, *Brusco v. France*, 14.10.2010, Judgment,
230. GjEDNj, *Bulut v. Austria*, 22 February 1996, Judgment, Reports 1996-II,.
231. GjEDNJ, *Campbell and Fell v. The United Kingdom*, Application No. 8342/95, 28 June 1984, Judgment.
232. GjEDNj, *D. H. et al. v. The Czech Republic*, Application no. 57325/00, Judgment, Grand Chamber, GjEDNj, 13 November 2007 (referring to İlhan v. Turkey [GC], no. 22277/93, ECHR 2000-VII);
233. GjEDNj, *Daktaras v. Lithuania*, 10 October 2000, Judgment, Para. 30-32.
234. GjEDNj, *De Cubber vs. Belgium*, [1984].
235. GjEDNJ, *Delcourt v. Belgium*, 17 January 1970, Judgment, Series A No. 11.
236. GjEDNj, *Ettl and others v. Austria*, [1987].
237. GjEDNJ, *Fayed v. the United Kingdom*, 21 September 1994, Judgment, Series A no. 294-B,
238. GjEDNj, *Findlay v. the United Kingdom*, 25 February 1997, Judgment, *Reports of Judgments and Decisions 1997-I*,
239. GjEDNJ, *Garcia Ruiz v. Spain*, 21 January 1999, Judgment,.
240. GjEDNJ, *Golder v UK*, 21 February 1975, Judgment, Series A No 18,
241. GjEDNj, *Gorraiz Lizarraga et al. v. Spain*, Application no. 62543/00, Judgment, Chamber, 27 April 2004 (para. 38);
242. GjEDNj, *Hauschildt v. Denmark*, 24 May 1989, Judgment, Series A No. 154,.
243. GjEDNJ, *Hornsby v. Greece*, 19 March 1997, Judgment, Reports 1997-II,.
244. GjEDNj, *Huber vs. Switzerland*, [1990] ECHR.
245. GjEDNJ, *Immobiliare Saffi v. Italy*, Application No. 22774/93, 28 July 1999, Judgment.
246. GjEDNj, *Incal v. Turkey*, 9 June 1998, Judgment, Reports 1998-IV, f.1571, paragraph 65.
247. GjEDNJ, *John Murray v. the United Kingdom*, 25.01.1996, Judgment.
248. GjEDNj, *Kamasinski v. Austria*, Judgment, 19 December 1989 in, § 79
249. GjEDNj, *Karner v. Austria*, Application no. 40016/98, Judgment, Chamber, ECtHR, 24 July 2003;
250. GjEDNj, *Kelly and Others v. the United Kingdom*, No. 30054/96, §§ 96-97, 4 May 2001
251. GjEDNj, *Kenneth LEHTINEN v. Finland*, Application no. 39076/97, Decision as to Admissibility, Chamber of ECtHR (referring to the Cardot v. France judgment of 19 March 1991, Series A no. 200, 18);
252. GjEDNj, *Klein and others v. The Netherlands*, [2003].
253. GjEDNJ, *Kress v. France* [GC], no. 39594/98, § 72, ECHR 2001-VI
254. GjEDNJ, *Kreuz v. Poland*, 19 June 2001, Application No 28249/95, Judgment
255. GjEDNj, *Lanko v. Slovakia*, 2 September 1998, Judgment, Reports 1998-VI, f. 2497-2498, para. 12-17.
256. GjEDNj, *Laventsv. Latvia*, [2002].
257. GjEDNj, *Le Compte, Van Leuven and De Meyere v. Belgium*, [1981].

258. GjEDNj, *Lilly France v. France*, No. 53892/00, § 25, 14 October 2003
259. GjEDNj, *Lithgow et al v. The United Kingdom*, Application no. 9006/80; 9262/81; 9263/81; 9265/81; 9266/81; 9313/81; 9405/81, 8 July 1986, Judgment.
260. GjEDNj, *Lobo Machado v. Portugal*, 20 February 1996, Judgement, Report 1996-I.
261. GjEDNJ, *Magee v. the United Kingdom*, 06.06.2000, §40, Judgment.
262. GjEDNJ, *Marini v. Albania*, Application No. 3738/02, 18 December 2007, Judgment.
263. GjEDNj, *McCann et al. v. The United Kingdom*, Application no. 18984/91, Judgement, Grand Chamber, ECtHR, 27 September 1995;
264. GjEDNj, *Menchinskaya v. Russia*, No. 42454/02, 15 January 2009, paragrafi 32.
265. GjEDNj, *Morris v. the United Kingdom*, No. 38784/97, § 58, 2002-I.
266. GjEDNJ, *Nideröst-Huber v. Switzerland*, 18 February 1997, § 23, Reports of Judgments and Decisions 1997-I;
267. GjEDNj, *Nortier vs. The Netherlands*, [1993].
268. GjEDNj, *Osman v. the United Kingdom*, §§ 115-117 dhe *Rees v. the United Kingdom*, § 37.
269. GjEDNj, *Piersack vs. Belgium*, [1984].
270. *GjEDNJ, Pinkney v. Canada*, UN Human Rights Committee, Communication No. 7/27.
271. GjEDNj, *Ramsahai and Others v. the Netherlands* [GC], No. 52391/99, ECHR 2007-VI
272. GjEDNj, *Reinhardt and Slimane-Kaïd v. France*, Judgment of 31 March 1998, Reports of Judgments and Decisions 1998-II
273. GjEDNj, *Remli v. France*, [1996].
274. GjEDNj, *Scordino v. Italy* (no. 1), Application no. 36813/97, Judgement, Grand Chamber, ECtHR, 29 March 2006;
275. GjEDNj, *Selmouni v. France*, No. 25803/94, decision of 28 July 1999, ECtHR;
276. *GjEDNJ, Stafford v. the United Kingdom* [GC], No. 46295/99, § 78, ECHR 2002-IV.
277. GjEDNJ, *Stubbings et al v. the United Kingdom*, 22 October 1996, Judgment Reports 1996-IV.
278. GjEDNJ, *Sutter case*, 22 February 1984, Judgment, Series A no. 74,.
279. GjEDNj, *Thorgeirson vs. Ireland*, [1992].
280. GjEDNJ, *Van de Hurk v. The Netherlands*, Application No. 16034, 19 April 1994, Judgement.
281. GjEDNj, *Van Oosterwijck v. Belgium*. Judgment of 6 November 1980, Series A no. 40.
282. GjEDNj, *Varbanov v. Bulgaria*, No. 31365/96, ECHR 2000-X.
283. GjEDNj, *Vasilescu v. Romania*, Judgment of 22 May 1998, Reports of Judgments and Decisions 1998-III.
284. GjEDNj, *Vijayanathan & Pusparajah v. France*, Application no. 17550/90; 17825/91, Judgement, Chamber, ECtHR, 27 August 1992;
285. GjEDNj. *Fey vs. Austria*, [1993]
286. Glendon MA, Carozza PG, Picker CB., (2008) ‘*Comparative Legal Traditions*’. Brand: West Law School, Thomson-West;
287. Glintić, T., (1995), “*Pravda, sloboda, jednakost: Rols i Valcer*”, Beogradski centar: Beograd;

288. Goebel, Jr., Julius, and Naughton, T., Raymond, (1944) *'Law Enforcement in Colonial New York: A Study in Criminal Procedure'*. New York: Commonwealth Fund, p. 1664-1776;
289. Goldstein S., A., & Marcus M., (1977) 'The Myth of Judicial Supervision in Three "Inquisitorial" Systems: France, Italy, and Germany'. *The Yale Law Journal*. Vol. 87, No. 2, pp. 240-283.
290. Goldsworthy, J., (1999), *"The Sovereignty of Parliament: History and Philosophy"*, Oxford University Press: Oxford;
291. *Gómez v. Spain*, UN Human Rights Committee, Communication No. 701/1996.
292. Gonenc, Levent (2002) 'Prospects for Constitutionalism in Post-Communist Countries'. The Hague: Kluwer Law International, fq. 3-25 & 103-208 & 280-318;
293. Goodhard, A.L., (1959), "The Rule of Law and Absolute Sovereignty", *Anales de la Faculte de Droit D' Istanbul*, (Istanbul) No. 12., fq. 259-284;
294. Gozler, Kemal (2008) 'Judicial review of Constitutional Amendmenets. A Comparative Study'. Bursa: EKIN PRESS;
295. Grabenwarter, Christoph (2011) 'Separation of Powers and the Independence of Constitutional Courts and Equivalent Bodies'. Keynote Speech, 16 January 2011, 2nd Congress of the World Conference on Constitutional Justice, Rio de Janeiro;
296. Green, A., Bruce (1995) 'Policing Federal Prosecutors: Do Too Many Regulators Produce Too Little Enforcement'. *St. Thomas Law Review*. Vol. 8, pp. 69-79.
297. Grosman, A., Brian, (1978) 'The Prosecutor. An Inquiry into the exercise of discretion'. Toronto: University of Toronto Press;
298. Guerra, Luis Lopez (1994) 'The Role and Competences of the Constitutional Court, in The Role of the Constitutional Court in the Consolidation of the Rule of Law'. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), UniDem Seminar Bucharest, 8-10 June 1994, CDLSTD (1994) 010, [http://www.venice.coe.int/docs/1994/CDLSTD\(1994\)010_e.asp](http://www.venice.coe.int/docs/1994/CDLSTD(1994)010_e.asp);
299. Guggan, Lisa (2004), *"The Twilight of Equality?: Neoliberalism, Cultural Politics, and the Attack on Democracy"*, Beacon Press: Boston Massachusetts;
300. *Guigue and SGEN-CFDT v. France* (dec.), GjEDNj, No. 59821/00, 6 January 2004
301. Gunther, Richard, Diamandouros, P. Nikoforos, and Hans-Jurgen Puhle (eds.) (1995). Baltimore and London: The John Hopkins University Press, fq. 77-123;
302. H. Kelsen, (1951), *"Opšta teorija države i prava"*, Arhiv za pravne i društvene nauke: Beograd;
303. Hajns, V., (1974) "Legitimitet - prilog jednoj kategoriji građanskog društva", *Gledišta*, nr. 7-10;
304. Hall, J., Donald (1975) 'The Role of the Victim in the Prosecution and Disposition of a Criminal Case'. *Vanderbilt Law Review*. Vol. 28, No. 5, pp. 931-985;
305. Hamilton, Alexander, Madison, James and Jay John, 'The Federalist', in Pole, R., J., (ed.) (2005) 'The Federalist'. Indianapolis: Hackett Publishing Company, Inc;
306. Hanna Bäck and Patrick Dumont (2008) 'Making the First Move: A Two-Stage Analysis of the Role of Formateurs in Parliamentary Government Formation'. *Public Choice*. Vol. 135 (3/4): p. 353-373;

307. Hannis Taylor (1895) 'The Outlook for Parliamentary Government'. *The North American Review*. Vol. 160, No. 461: p. 479-491;
308. Kelsen, Hans "Ko treba da bude cuvar Ustava". Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Olduka*, fq. 256-297. Titulli në original: Hans Kelsen, *Wer soll der huter der verfassung sein?* (Dr. Walther Rothschild, Berlin-Grunewald, 1931);
309. Harel, Alon (2003) 'Rights-Based Judicial Review: A Democratic Justification'. *Law and Philosophy* Vol. 22 (3/4), pp. 247-276;
310. Hart, L.A., (1989), "Postoje li prirodna prava?" në: Matulovic, Miomir (ed.), *Ljudska prava* ICR: Rijeka;
311. Mansfield, Jr. C. Harvey (1987) 'The Modern Doctrine of Executive Power'. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 17, No. 2, Bicentennial Issue: The Origins and Invention of the American Presidency: p. 237-252;
312. Hasanbegović, J., "Državljanstvo kao pravo čoveka", *Jugoslavenska Revija za Medjunardno Pravo*, nr. 1-3, 1995, fq. 203-222.
313. Hasani, E *et al* (2012) 'Individual Complaint Mechanism as a Means to Protecting Fundamental Human Rights and Freedoms: The Case of the Constitutional Court of Kosovo'. *European Yearbook of Human Rights*. The Hague: Intersentia.
314. Hayek, F.A., (1960), "*Constitution of Liberty*", University of Chicago Press: Chicago;
315. Held, David., (2006), "*Models of Democracy*", Stanford University Press: Stanford;
316. Steinberger, Helmut 'Models of Constitutional Jurisdiction, European Commission for Democracy Through Law' (Venice Commission), 1993, CDL□STD (1993) 002;
317. Henning, J., Peter (1999) 'Prosecutorial Misconduct and Constitutional Remedies'. *Washington University Law Quarterly*. Vol. 77, No. 3, pp. 713-832.
318. Heper, Metin and Çinar, Menderes (1996) 'Parliamentary Government with a Strong President: The Post-1989 Turkish Experience'. *Political Science Quarterly*. Vol. 111, No. 3, p. 483-503.
319. Schwartz, Herman (2000) 'The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe'. Chicago: The University of Chicago Press, p. 164-193;
320. Herman, Valentine and Pope, John (1973) 'Minority Governments in Western Democracies'. *British Journal of Political Science*. Vol. 3, No. 2, p. 191-212.
321. Hiber, D., (1995), "Pravno informisanje i svojina" *Pravni zivot*, nr. 10, fq. 65-79;
322. Hirst, P., (1990), "*Representative Democracy and its Limits*", Cambridge University Press: Cambridge;
323. Holmes, Stephen, 'Constitutions and Constitutionalism', në Michel Rosenfeld and Andras Sajó (eds.) (2012) '*The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*'. Oxford: Oxford University Press, p. 189-216.
324. Hostettler, Honorable John N. and Washburne, Thomas W. (1997) 'The Constitution's Final Interpreter: We the People'. *Regent University Law Review*. Vol. 8: 13-32;
325. Hunt, Lynn (2008), "*Inventing Human Rights: A History*", W. W. Norton & Company: New York and London, fq. 113-175;
326. International Bar Association (1982) 'Minimum Standards of Judicial Independence 1982', available at: http://www.ibanet.org/About_the_IBA/IBA_resolutions.aspx.

327. Issacharkopp, Samuel., Karlan, S. Pamela and Pildes, H. Richard (2007), "*The Law of Democracy. Legal Structure of the Political Process*", Foundation Press: New York, NY,;
328. J. A. Griffith, (1997), "*Politics of the Judiciary* ". 5th edition, HarperCollins Publishers: London;
329. Juan, J. and Valenzuela, Arturo (eds.) (1994) 'The Failure of Presidential Democracy, Vol. 1'. Baltimore-Maryland and London: The Johns Hopkins University Press.
330. Jabloner, Clemens (1998) 'Kelsen and His Circle: The Viennese Years'. *European Journal of International Law*. Vol. 9: 368, 374;
331. Jackson, H., Robert (1941) 'The Federal Prosecutor'. *Journal of Criminal Law and Criminology*. Vol. 31, No. 3, p. 3-6.
332. Jackson, Robert Sovereignty, (2007), "*The Evolution of an Idea*", Polity Press: Cambridge;
333. Jacob, Herbert, Blankenburg, Erhard, Kritzer, M., Herbert, Provine, M., Doris, and Sanders, Joseph (eds.) (1996) 'Courts, Law, and Politics in Comparative Perspective'. New Haven and London: Yale University Press.
334. Jacobsohn Jeffrey Gary, (2006) 'An unconstitutional constitution? A comparative perspective'. *International Journal of Constitutional Law*. Vol. 4, No. 3, p. 460-487.
335. Garner, W. James (1914) 'Cabinet Government in France'. *The American Political Science Review*. Vol. 8 (3): p. 353-374;
336. Janis, W. Richard, Mark Kay, S. and Bradley, W. (2008), "*Anthony European Human Rights Law: Texts and Materials*", Oxford University Press: USA;
337. Jankuloski, Z., (1991), "Status izbeglica u međunarodnom pravu", *Forum - Čovek i pravo*, nr. 2, fq. 28-38;
338. Janoski, Thomas. (1998), "*Citizenship and Civil Society: A Framework of Rights and Obligations in Liberal, Traditional, and Social Democratic Regimes*", Cambridge University Press: Cambridge;
339. Jellinek, G., (1892), "*System der subjektiven öffentlichen Rechte*", Mohr: Freiburg;
340. Jennings, V.I., (1964), "*The Law and the Constitution*", University of London Press: London;
341. Martinez, S. Jenny (2006) 'Inherent Executive Power: A Comparative Perspective'. *The Yale Law Journal* Vol. 115 (9): p. 2482-2511;
342. Jensen H T, Plum V. (1993) 'From centralised state to local government. The case of Poland in the light of Western European experience'. *Environment and Planning D: Society and Space*. Vol. 11(5): p. 565 - 581;
343. Joel R. Paul (1998) 'The Geopolitical Constitution: Executive Expediency and Executive Agreements'. *California Law Review*, Vol. 86 (4): p. 671-773;
344. John and Pasquino, Pasquale (2004) 'The Law of Exception: A Typology of Emergency Powers'. *International Journal of Constitutional Law*. Vol. 2, No. 2, p. 210-239.
345. John D. Huber and Cecilia Martinez-Gallardo (2008) 'Replacing Cabinet Ministers: Patterns of Ministerial Stability in Parliamentary Democracies'. *The American Political Science Review*. Vol. 102 (2): p. 169-180;

346. John R. Lott, Jr. (2001) 'The American Bar Association, Judicial Ratings, and Political Bias'. *Journal of Law & Politics*. Vol. 17, p. 41-61.
347. Jowell, J., (2004), "The Rule of Law Today", në J. Jowell, D. Oliver (eds.), *The Changing Constitution*. (Oxford University Press: Oxford, fq. 5-25;
348. Joy, A., Peter (2006) 'Relationship between Prosecutorial Misconduct and Wrongful Convictions: Shaping Remedies for a Broken System'. *Wisconsin Law Review*. Vol. 2006, No. 2, pp. 399-431;
349. Juan J. Linz, Alfred Stepan and Richard Gunther, 'Democratic Transition and Consolidation in Southern Europe, with Reflections on Latin America and Eastern Europe', në 'The Politics of Democratic Consolidation. Southern Europe in Comparative Perspective'
350. Kaarbo, Juliet (1997) 'Prime Minister Leadership Styles in Foreign Policy Decision-Making: A Framework for Research'. *Political Psychology*. Vol. 18 (3): p. 553-581;
351. Kamali, Masoud, (2008), "*Racial Discrimination: Institutional Patterns and Politics*", Routledge Research in Race and Ethnicity, Routledge: New York;
352. Karl Smit, "Cuvar Ustava". Në Samardzic, Slobodan (ed.), (2001) 'Norma i Odluka. Karl Smit i njegovi kriticari', Beograd, Filip Visnjic, fq. 211-253, në fq. 211-238. Titulli i origjinalit: Schmitt, Carl, (1929) 'Der huter der verfassung'. Archiv des offentlichen rechts, Neue Folge 16 Band J.C.B. Mohr (Paul Siebeck), Tübingen 1929;
353. Karl Smit, *Tri vrste pravnonaucnog misljenja* (Biblioteka Parerga: Beograd, 2003) fq. 16-17; 34-42; 46-54. Titulli në origjinal: Carl Schmitt, *Über die drei Arten des rechtswissenschaftlichen Denkens* (Hamburg, Hanseatische Verlag-sanstalt, 1934).
354. Karmis, Dimitrios Norman, Wayne (eds.), (2005), "*Theories of Federalism: A Reader*", Palgrave Maxmillan: New York;
355. Kartag-Odri, A., (1996), "Kulturna prava kao ljudska prava", *Pravni život*, nr. 12, fq.1065-1075;
356. Kasapović, M., Šiber, I, Zakošek, N., (1998), "*Birači i demokratija*", Alinea: Zagreb;
357. Kavran, D., (1979), "Kadrovske evidencije i zaštita prava ličnosti u upravnom postupku", *Pravni život*, nr. 12, fq. 3-22;
358. McRae, K.D. (1974) (ed), *Consociational Democracy: Political Accommodation in Segmented Societies*. Toronto: McClelland & Stewart; Lijphart, A (1977) 'Democracy in Plural Societies'. New Haven: Yale University Press;
359. Kelsen, H. (1945) 'General Theory of Law and State'. Cambridge, MA: Harvard University Press, p. 268/269;
360. Kelsen, Hans (1942) 'Judicial Review of Legislation: A Comparative Study of the Austrian and the American Constitution'. *Journal of Politics*. Vol. 4: p. 185-86;
361. Kelsen, Hans, 'Ko treba da bude cuvar Ustava', në Samardzic, Slobodan (ed.), Norma i Olduka, fq. 256-297, titulli në original: Kelsen, Hans, (1931) 'Wer soll der huter der verfassung sein?', Dr. Walther Rothschild, Berlin-Grunewald.
362. Kemal Gozler, (2008). *Judicial Review of Constitutional Amendmenets*.

363. Kent, James, (1851) 'Commentaries of American Law. Volume I. Seventh Edition'. New York: William Kent- Van Norden&Ameeman, Printers, p. 316-319; and Cohens v. Virginia, 6 Wheat. R. 384.
364. King, Jerome B. (1965) 'Constitutionalism and the Judiciary in France'. *Political Science Quarterly*, Vol. 80 (1): p. 62-87;
365. Kisigiro, Xhon. Innocent (2011), "*Human Rights Law In International And National Context: Challenges, Violations, Derogation, and Enforcement*", LAP LAMBERT Academic Publishing: Germany;
366. Kloth, Matthias (2010) 'Immunities and the Right of Access to Court under Article 6 of the European Convention on Human Rights'. The Hague: Martinus Nijhoff.
367. Kommers, Donald P. (1991) 'German Constitutionalism: A Prolegomenon'. *Emory Law Journal*. Vol. 40 (1): 837-873; Kommers, Donald P. (1997) 'The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany'. Second Edition. Durham and London: Duke University Press, p. 3-60;
368. Kommers, Donald P. (1994) 'The Federal Constitutional Court in the German Political System'. *Comparative Political Studies*. Vol. 26: p. 470-491;
369. Konventa Evropiane për Shtetësinë (Strasburg, 6 nëntor 1997). Ne internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/166.htm>.
370. Korenica, Fisnik & Doli, Dren (2010) 'The Politics of Constitutional Design in Divided Societies: The Case of Kosovo'. *Croatian Yearbook of European Law and Policy*. Vol. 5: p.265-292;
371. Korenica, Fisnik and Doli, Dren (2011) 'Constitutional Rigidity in Kosovo: Significance, Outcomes, and Rationale'. *Pace International Law Review Online Companion*. at 1;
372. Krasner, D. Stephen, (1999), "*Sovereignty*", Princeton University Press: Princeton;
373. Krbek, I., (1961), "Dva djela Gerharda Leibhoza: Jednakost pred zakonom i bistvo reprezentacije", *Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu*, nr. 2, fq. 127-129;
374. Krutz, G. S. and Peake, J. S. (2006) 'The Changing Nature of Presidential Policy Making on International Agreements'. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 36, p. 391-409.
375. Kushtetuta e Republikës së Kroacisë;
376. Kymlicka, W., (1995), "*Multicultural Citizenship*", Clarendon Press: Oxford;
377. LaFREE, G. D. (1985) 'Adversarial and Non-adversarial Justice: A Comparison of Guilty Pleas And Trials'. *Criminology*. Vol. 23, pp. 289-312. doi: 10.1111/j.1745-9125.1985.tb00338;
378. Landfried, Christine (1992) 'Judicial policy-making in Germany: The federal constitutional court'. *West European Politics*, Vol. 15 (3): p. 50-67;
379. Langbein, H. John, (1979), 'Land Without Plea Bargaining: How the Germans Do It'. *Michigan Law Review* Vol. 78, No. 2, pp. 204, 225
380. Langbein, H., John, (1977) 'Comparative Criminal Procedure: Germany'. St. Paul, Minnesota: West Group.
381. Langbein, H., John, (1993) 'The Origins of Public Prosecution and Common Law'. *American Journal of Legal History*. Vol. 17, No. 4, p. 313-335;
382. Lazin, Đ., (1995) "Pravo na sudsku kontrolu lišenja slobode", *Pravni život*, nr. 9, fq. 421-435.

383. Lazin, Đ., (1996) "Zabrana samovoljnog lišenja slobode", *Pravni život*, nr. 9, fq. 393-411;
384. Ward, Lee (2005) 'Locke on Executive Power and Liberal Constitutionalism'. *Canadian Journal of Political Science / Revue canadienne de science politique*. Vol. 38 (3): p. 719-744;
385. Lee, B. W., Gross, D. A. and Kim, J.-S. (1992) 'A Presidential or Parliamentary System: The South Korean Debate'. *Pacific Focus*. Vol. 7, p. 117-139;
386. Lewis, C. Daniel, (2012), "*Direct Democracy and Minority Rights: A Critical Assessment of the Tyranny of the Majority in the American States*", Routledge: New York and London;
387. Lhamsuren Munkh-Erdene (2010) 'The Transformation of Mongolia's Political System: From Semi-parliamentary to Parliamentary?'. *Asian Survey*. Vol. 50 (2): p. 311-334;
388. Ligji Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i 21 majit 2008
389. Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i datës 15 qershor 2008, me ndryshimet dhe plotësimet e datës 20 prill 2012 (Ligji Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike).
390. *Ligji Nr.04/L-148 Për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë*, i shpallur nga Presidentja e Republikës, znj. Atifete Jahjaga, me Dekretin Nr. DL - 039-2012, datë 7 shtator 2012.
391. Ligji që rregullon këtë materie, është Ligji Nr. 03/L-117 për Avokatinë i datës 20 nëntor 2008, i shpallur me Vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 03-V-085, datë 12 shkurt 2009.
392. Lijphart, A (1968) 'The Politics of Accommodation: Pluralism and Democracy in the Netherlands'. LA: University of California Press;
393. Lijphart, A (1979) 'Consociation and Federation: Conceptual and Empirical Links'. *Canadian Journal of Political Science*. Vol. 12: p. 499-515;
394. Lijphart, A (1981) (ed), *Conflict and Coexistence in Belgium: the Dynamics of a Culturally Divided Society*. Institute of International Studies. Berkeley: University of California;
395. Lijphart, A (2008) 'Thinking about Democracy. Power-sharing and Majority Rule in Theory and Practice'. New York: Routledge;
396. Lijphart, Arend (1999) 'Patterns of Democracy: Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries'. New Haven: Yale University Press;
397. Lijphart, Arend., (1995), "*Electoral Systems and Party Systems: A Study of Twenty-Seven Democracies*", 1945-1990, (Oxford University Press: Oxford);
398. Lijphart, Arendt (1969) 'Consociational Democracy'. *World Politics*. Vol. 21: p. 207-225.
399. Lindseth, Peter L. (2003-2004) 'The Paradox of Parliamentary Supremacy: Delegation, Democracy, and Dictatorship in Germany and France, 1920s-1950s'. *Yale Law Journal*. Vol. 113: p. 1343-1412;
400. Linz J., Juan 'Presidential or Parliamentary Democracy: Does It Make a Difference,' në 'The Failure of Presidential Democracy', Linz, J., Juan and Valenzuela, Arturo (eds.) (1994). Baltimore, MD: Johns Hopkins University Press, pp. 48-62.

401. Linz, Juan J. (1990) 'The Perils of Presidentialism'. *Journal of Democracy*. Vol. 1 No. 1, p. 51-69 & 84-91;
402. Locke, J., (1764), "*The Two Treatises of Civil Government*" (Hollis ed.), A. Millar et al.: London;
403. Long, Jennifer L., (1995) 'How to Sue the President: A Proposal for Legislation Establishing the Extent of Presidential Immunity'. *Valpo University Law Review*. Vol 30. No. 1, p.283-333.
404. Lopez-Guerra, Luis (1994) 'The Role and Competences of the Constitutional Court', in THE ROLE OF THE CONSTITUTIONAL COURT IN THE CONSOLIDATION OF THE RULE OF LAW, European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), UniDem Seminar Bucharest, 8-10 June 1994, CDL-STD (1994) 010, available at [http://www.venice.coe.int/docs/1994/CDL-STD\(1994\)010.e.asp](http://www.venice.coe.int/docs/1994/CDL-STD(1994)010.e.asp);
405. Loughlin, Martin and Walker, Neil (eds.) (2008) '*The Paradox of Constitutionalism. Constituent Power and Constitutional Form*'. Oxford: Oxford University Press;
406. Louis L. Jaffe (1958) 'The Right to Judicial Review I'. *Harvard Law Review*. Vol. 71 (3): p. 401-437;
407. Omari, Luan dhe Anastasi, Aurela (2008) 'E Drejta Kushtetuese'. Tiranë: Shtëpia Botuese ABC, fq. 10-11 dhe literaturën e cituar aty.
408. Lucky, Christian (1993) 'Tables of Presidential Power'. *East European Constitutional Review*. Vol. 2, No. 4 and Vol. 3, No. 1, p. 81-94.
409. Ludwikowski, Rett R. (2000) 'Constitutional Culture of the New East-Central European Democracies'. *Georgia Journal of International & Comparative Law*. Vol. 29 (1):
410. Lukács, G., (1991), "*The Process of Democratization*", State University of New York Press: New York;
411. *M. Robinson v. Jamaica*, UN Human Rights Committee, Communication No. 731/1996,.
412. Maas, Willem., (2013), "*Multilevel Citizenship: Democracy, Citizenship, and Constitutionalism*", University of Pennsylvania Press: Philadelphia;
413. *Magee v. the United Kingdom*, 06.06.2000, §40.
414. Marc Debus (2009) 'Pre-Electoral Commitments and Government Formation'. *Public Choice*. Vol. 138 (1/2): p. 45-64;
415. Ferguson, Robertson Margaret (2003) 'Chief Executive Success in the Legislative Arena'. *State Politics & Policy Quarterly*. Vol. 3 (2): p. 158-182;
416. *Marrëveshja e Konçulit*, datë 13 shkurt 2001. Teksti i plotë në: <https://vargmal.org/lg/dan5806>.
417. *Marrëveshja e Ohrit*, datë 13 gusht 2001. Teksti i plotë në: <http://www.bdi.mk/documents/MARREVESHJA-E-OHRIT.pdf>.
418. Marrëveshja e Parë Ndërkombëtare që Rregullon Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, parafuar më 19 prill 2013 nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë, miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 22 prill 2013, Vendimi Nr. 01/126, dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 22 prill 2013, Rezoluta Nr. 04-R-10.

419. Marrëveshja për Statusin e Forcave në mes të SHBA-ve dhe Kosovës e nënshkruar më 18 shkurt 2012 në Prishtinë. ‘*Signing of Status of Forces Agreement between The United States of America and The Republic of Kosovo*’. US Embassy in Pristina, Kosovo (February 18, 2012) (Në internet: http://pristina.usembassy.gov/sofa_eng_0218_20122012.html)
420. Marriot, J.A.R., (1927), “*The Mechanism of the Modern State A Treatis on The Science and Art of Government*”, Vol. I-II, Oxford Unversity Press: Oxford;
421. Marshall, G., (1971), “*Constitutional Theory*”, Clarendon Press: Oxford;
422. Martin, L. L. (2005) ‘The President and International Commitments: Treaties as Signaling Devices’. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 35, pp. 440-465.
423. Massias, Jean - Pierre (2008) ‘Droit constitutionnel des Etats d’ Europe de l’ Est’. Paris: Press Universitaire de France, p. 13-140 & 421-563.
424. Bertrand, Mathieu (2011) ‘Le Conceil Constitutionnel “legislateur positif”. Ou la question des interventions du judge constitutionnel francais dan l’ exercice de la fonction legislative”.
425. Soberg, Matthew and Carey M., John (1992) ‘Presidents and Assemblies. Constitutional Design and Electoral Dynamics’. Cambridge: Cambridge University Press;
426. May, Stephen (2011), “*Language and Minority Rights: Ethnicity, Nationalism and the Politics of Language*”, 2 edition, Routledge: New York, NY;
427. McClellan, James (1989) ‘Liberty, Order, and Justice: An Introduction to the Constitutional Principles of American Government’. (3rd ed.). Indianapolis: Liberty Fund: në vecanti pjesa e shtatw (7) (“Changing the Constitution - Toghether with an Explanation of the Amendments Added Since 1791);
428. McConville, M., (1984) ‘Prosecuting Criminal Cases in England and Wales: Reflections of an. Inquisitorial Adversary’. *Liverpool Law Review*. Vol. 6, No.1, p. 15-30;
429. McGann, Anthony (2006), “*The Logic of Democracy: Reconciling Equality, Deliberation, and Minority Protection*”, University of Michigan Press: Michigan;
430. McIlwain, C.H., (1969), “*Constitutionalism and the Changing World*”, Cambridge University Press: Cambridge;
431. McMahan, K. J. (2007) ‘Presidents, Political Regimes, and Contentious Supreme Court Nominations: A Historical Institutional Model’. *Law and Social Inquiry*, Vol. 32, p. 919-954.
432. Meir Ydit (1961) ‘Internationalized Territories From the “Free City of Cracow” to the “Free City of Berlin”. A Study in the Historical Development of a Modern Nation in International Laë and Relations’. Leiden: A. W. Sythof; Rasti i territorit të Brekos është sanksionuar me nenin V të Aneksit 2 të Marrëveshjes së Dejtonit (nëntor 1995).
433. Melilli, Kenneth J. (1992) ‘Prosecutorial Discretion in an Adversary System’. *Brigham Young University Law Review*. Vol. 1992, No. 3, pp. 669-704.
434. Mertus, A. Julie and Flowers, Nancy (2008), “*Local Action/Global Change: A Handbook on Women's Rights*”, Paradigm Publishers: Boulder, Clorado;
435. Mezey, Gluck. Susan, (2011), “*Elusive Equality: Women's Rights, Public Policy, and the Law*”, Lynne Rienner Pub: Boulder, California;
436. Mezzeti, Luca (2011) (ed.), *Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale*. Tomo I (CEDAM: Padova, 2009) et Tomo II. Padova: CEDAM, pjesët e autorëve që

- flasin për vendet ish-komuniste (kapitujt 10, 11 e 18 të vëllimit I, dhe kapitulli 5 i vëllimit II).
437. Michael Edinger & Lars Vogel (2005) 'Role Perceptions, Party Cohesion and Political Attitudes of East and West German Parliamentarians: Findings from the Jena Parliamentary Survey (2003-4)'. *Sociologický Časopis / Czech Sociological Review*. Vol. 41 (3): p. 375-399;
 438. Michael J. Glennon (1986) 'Can the President Do No Wrong?'. *The American Journal of International Law*, Vol. 80, No. 4, p. 923-930.
 439. Michael J. Ireland & Scott Sigmund Gartner (2001) 'Time to Fight: Government Type and Conflict Initiation in Parliamentary Systems'. *The Journal of Conflict Resolution*. Vol. 45 (5): p. 547-568;
 440. Michael Laver (2008) 'Governmental Politics and the Dynamics of Multiparty Competition'. *Political Research Quarterly*. Vol. 61 (3): p. 532-536;
 441. Michalska, A., (1980), "Primjena međunarodnih paktova o pravima čovjeka", *Zbornik radova Pravnog fakulteta u Splitu*, Vol. 17, fq. 157-170;
 442. Michel Meyer, (2012), "*Qu'est-ce que le refoulement?*", [Kindle Edition], L'Herne: Paris;
 443. Miller, H., Arthur Wattenberg, P., Martin and Malanchuk, Oksana (1986) 'Schematic Assessments of Presidential Candidates'. *The American Political Science Review*. Vol. 80, No. 2, p. 521-540.
 444. Mj. J. C. Vile (1998) 'Constitutionalism and the Separation of Powers'. Indianapolis: Liberty Fund; Kapitulli i Trembëdhjetë ("Epilogue: The Separation of Powers and the Administrative State), p. 285-420;
 445. Moderne, F., (1996) "Osnovne slobode i prava stranaca", *Pravni život*, br. 12, fq. 945-962.
 446. Monaghan, Paul, Henry (1988) 'The Confirmation Process: Law or Politics'. *Harvard Law Review*. Vol 101, No. 6, p. 1202-1212.
 447. Monteskje, (1989), "*O duhu zakona*", *Savremena administracija*: Beograd, fq. 175-176;
 448. Montesquieu, C.S., (1874), "*De l'esprit des lois*", Garnier Frères: Paris;
 449. Morgenstern, Scott and Nacif, Benito (eds.), (2002), "*Legislative Politics in Latin America. Cambridge Studies in Comparative Politics* ", Cambridge University Press: Cambridge;
 450. Morison, H., (1954), "Government and Parliament. A Survey From Inside", Oxford University Press: London;
 451. Morton J. Frisch (1987) 'Executive Power and Republican Government—1787'. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 17 (2), Bicentennial Issue: The Origins and Invention of the American Presidency (SPRING 1987): p. 281-291;
 452. Murphy, Walter F. (2007) 'Constitutional Democracy: Creating and Maintaining Just Political Order'. Baltimore: The John Hopkins University Press;
 453. Naimark, M. Norman., (2002), "*Fires of Hatred: Ethnic Cleansing in Twentieth-Century Europe*", Harvard University Press: Harvard;
 454. Nalini, Rajan (2002), "*Democracy and the Limits of Minority Rights*", SAGE Publications Pvt. Ltd: New Delhi and London.;
 455. Nello, Senior Susan "The Impact of External Economic Factors. The Role of the IMF", ska vit

456. Nelson, William E., Hull N.E.H. and Hoffer, Peter Charles (2000) 'Marbury v. Madison: The Origins and Legacy of Judicial Review'. Lawrence, Kansas: University Press of Kansas. në vecanti kapitujt 2 ("The Politics of Constitutional Changes) dhe 3 ("John Marshall");
457. Neni 28 i Ligjit [Mbikëqyrja dhe bashkëpunimi me organet e tjera];
458. Neni 6.1.3 ("Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë") i Aneksit I të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 maj 2007.
459. Neto, A., Octavio and Strøm, Kaare (2006) 'Breaking the Parliamentary Chain of Delegation: Presidents and Non-partisan Cabinet Members in European Democracies'. *British Journal of Political Science*. Vol. 36, pp. 619-643'
460. Nidiry, Rosemary (1996) 'Restraining Adversarial Excess in Closing Arguments'. *Columbia Law Review*. Vol. 96, No. 5, pp. 1299-1334.
461. Nowak, M., (1989) "*UNOPakt ueber buergerliche und politische Rechte und Fakultativprotokoll: CCPR-Kommentar*", Engel Verlag, Kehl am Rhein-Strasbourg;
462. Nowak, M., (1996), "Pravo na život", *Pravni život*, nr. 9, fq. 3-26.
463. OECD, Convention on Combating Bribery of Foreign Public Officials in International Business Transactions, Art. 2, 1997; UN, Optional Protocol to the Convention on the Rights of the Child on the sale of children, child prostitution and child pornography (Article 3 § 4), 2000;
464. Öhlinger, T. (2003) 'The Genesis of the Austrian Model of Constitutional Review of Legislation'. *Ratio Juris*. Vol. 16: p. 206-222;
465. Oliver, D., Jowell, J. (ed.), (2004) '*The Changing Constitution*', Oxford University Press: Oxford;
466. *Avokati i Popullit. Velrësimi i Kushtetutshmërisë së neneve 90, 95 (1.6), 110, 111 e 116 të Ligjit mbi Bankat, Institucionet mikrofinanciare dhe Institucionet jobankare br. 04/L-093 i 12 prillit 2012*. Aktgjykimi në rastin K0. 97/12. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Datë: 12 prill 2013 (Nr. ref.: AGJ403/13).
467. Omejec, Jasna (2013) '*Konvencija Za Zastitu Ljudskih Prava I Temeljnih Sloboda U Praksi Evropskog Suda Za Ljudska Prava. Strasbourski Acquis*'. Zagreb, fq. 618-630; 642-644; 660-672.
468. Opinion on the Draft Law on the Constitutional Court and Corresponding Amendments of the Constitution of the Republic of Moldova, European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Opinion no. 200/2002, 15 July 2002, CDL□AD (2002) 16;
469. Opinion on the Draft Law on the Constitutional Court of Montenegro, European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Opinion no. 479/2008, 24 October 2008, CDL□AD (2008) 030;
470. Opinion, 'The Nature and Consequences of Forensic Misconduct in the Prosecution of a Criminal Case'. *Columbia Law Review*. Vol. 54, No. 6 (Jun., 1954), pp. 946-983;
471. O'Regan, K. (2012) 'Text Matters: Some Reflections on the Forging of a New Constitutional Jurisprudence in South Africa'. *The Modern Law Review*. Vol. 75, p. 1-32.
472. Orenstein, A., Aviva (1983) 'Presidential Immunity from Civil Liability: Nixon v. Fitzgerald'. *Cornell Law Review*. Vol. 68, No. 2.

473. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë (Janar 2012) 'Pavarësia e Gjyqësorit në Kosovë: Dimensionet Institucionale dhe Funksionale'. Prishtinë.
474. P.H.P.H.M.C. van Kempen, Human Rights and Criminal Justice Applied to Legal Persons. Protection and Liability of Private and Public Juristic Entities under the ICCPR, ECHR, ACHR and AfChHPR, vol. 14.3 Electronic Journal of Comparative Law, (December 2010), <<http://www.ejcl.org/143/art143-20.pdf>>.
475. Packer, L. Herbert (1968), "*The Limits of the Criminal Sanction*". 1st edition, Stanford University Press; Sanford, California;
476. Paine, Th., (2001) "*Rights of Man, Common Sense and Other Political Writings*", Oxford University Press: Oxford, (ed. by Mark Philip)
477. *Pajtueshmëria me të Drejtën Ndërkombëtare e Shpalljes së Njëanshme të Pavarësisë në lidhje me Kosovën. Mendim Këshilldhënës*. Datë: 22 korrik 2010. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND).
478. Paravina, D., (1979), "Naçelo prava na rad", *Pravni život*, br. 12, str. 23-40.
479. Dumberry, Patrick 'State Succession to International Responsibility'. (Leiden, Boston: Martinus Nijhoff Publishers, 2007);
480. Weiler, Patrick (1985) 'First Among Equals: Prime Ministers in Westminster Systems'. Sydney: George Allen & Unwin;
481. Peleš, A., (1973), "Pravo na peticiju u Međunarodnoj konvenciji o uklanjanju svih oblika rasne diskriminacije", *Jugoslovenska Revija Medjunarodno Pravo*, nr. 1-3, fq.113-136.
482. Bass, Evan Peter (1987) 'Ex-Head of State Immunity: A Proposed Statutory Tool of Foreign Policy'. *The Yale Law Journal*. Vol. 97 (2): p. 299-319;
483. Petersen, M., (1993) 'Legislating Together: The White House and Capitol Hill from Eisenhower to Reagan'. Cambridge, MA: Harvard University Press;
484. Pfiffner, J. P. (2011) 'Federalist No. 70: Is the President Too Powerful?'. *Public Administration Review*. Vol.71, No. s1, p. s112-s117;
485. Pizzi, T., William (1993) 'Understanding Prosecutorial Discretion in the United States: The Limits of Comparative Criminal Procedure as an Instrument of Reform'. *Ohio State Law Journal*. Vol. 54, pp. 1325-1375.
486. Pizzi, T. William & Marafioti, Luca (1992) 'The New Italian Code of Criminal Procedure: The Difficulties of Building an Adversarial Trial System on a Civil Law Foundation'. *Yale Journal of International Law*. Vol. 17, No. 1, pp. 15-27.
487. Ploscowe, Morris (1932) 'Development of Inquisitorial and Accusatorial Elements in French Procedure'. *Journal of Criminal Law and Criminology*. Vol. 23, No. 3, pp. 372-394;
488. Poserina, J., John, (1959) 'Appointed Attorney General's Power to Supersede an Elected District Attorney,' *Temple Law Quarterly*. Vol. 33, pp. 78—88,
489. Prémont, D., Stenersen, C., and Oseredczuk, I. (1996) (eds.), *Non Derogable Rights and States of Emergency*'. Brussels: Bruylant, p. 644;
490. Propozimi Gjithpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës (2 shkurt 2007). neni 6 ("Vetëqeverisja Lokale dhe Decentralizimi"); Neni 8 Decentralizimi/Vetëqeverisja Lokale" në kuadër të Dispozitave Kushtetuese të Propozimit); pastaj Aneksi III ("Decentralizimi") dhe Shtojcë Aneksit III ("Përkufizimi i komunave të reja");

491. Qok, V., (1996), “Shtetësia në sistemin e lirive dhe të drejtave të njeriut”, Jeta juridike, nr. 9, faqe 493-507;
492. Rhodes, R. A. W. and Dunleavy, Patrick (1995) ‘Prime Minister, Cabinet and Core Executive’. Basingstoke, Hants.: Macmillan;
493. R. C. Van Caengem, (1995), “*An Historical Introduction to Western Constitutional Law*”, Cambridge University Press: Cambridge,;
494. Alderman, R. K. and Cross, J. A. (1985) 'The Reluctant Knife: Reflections on the Prime Minister's Powers of Dismissal'. *Parliamentary Affairs*. Vol. 38 (4): p. 387-407;
495. *Radio Evropa e Lirë*, datë 14 mars 2013. Në internet: <http://www.evropaelire.org/content/article/24928887.html>
496. Raporti mbi Punën e Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, 29 tetor 2010,.
497. Rasti K038/12. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga kryetari i Kuvendit të Republikës më 12 prill 2012 (Nr. Ref.:K 234/12 më 15 maj 2012.
498. Rasti i Mongolisë, në: Lhamsuren Munkh-Erdene (2010) ‘The Transformation of Mongolia's Political System: From Semi-parliamentary to Parliamentary?’. *Asian Survey*. Vol. 50 (2): p. 311-334;
499. Rasti KI Nr. 47/10, Aktgjykim, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 28 shtator 2010 (nr. ref.: AGJ 43/10);
500. Rawls, John (2005), “*Political Liberalism*”, Columbia University Press: New York,;
501. Recommendation Rec(2003)13 of the Committee of Ministers to member states on the provision of information through the media in relation to criminal proceedings;
502. Reiss, J., Jr, Albert (1975) ‘Public Prosecutors and Criminal Prosecution in the United States of America’. *Juridical Review*. New Series, Vol. 20: 1-21;
503. Report on Constitutional Amendment, adopted by the Venice Commission at its Plenary Session, Venice, 11-12 December 2009.
504. Report on Constitutional Amendment, No. 469/2008, adopted by the Venice Commission at its Plenary Session, CDL-AD (2010) 001, Starsbourg, 19 January 2010 Venice, 11-12 December 2009. Në internet mund të gjendet në: www.venice.coe.int, me këtë shenjë: CDL-AD (2010) 001.
505. Reter, R. F. (1982) ‘President Theodore Roosevelt and the Senate's “Advice and Consent” to Treaties’. *Historian*. Vol. 44, p. 483-504.
506. Reynolds, Andrew (2002), “*The Architecture of Democracy: Constitutional Design, Conflict Management and Democracy*”, Oxford University Press: Oxford,;
507. Roach, Kent, (2010) ‘Wrongful Convictions: Adversarial and Inquisitorial Themes’. *North Carolina Journal of International Law and Commercial Regulation*. Vol. 35, No. 2, pp. 388-444;
508. Robert C. Angel (1988-1989) ‘Prime Ministerial Leadership in Japan: Recent Changes in Personal Style and Administrative Organization’. *Pacific Affairs*. Vol. 61 (4): p. 583-602;

509. Robert Elgie, 'The Politics of Semi-presidentialism', in 'Semi-presidentialism in Europe', Robert Elgie (ed.) (1999). Oxford: Oxford University Press, p. 1-21.
510. Rola, Giancarlo and Groppi, Tania (2010) 'Between Politics and the Law: The Development of Constitutional review in Italy', në Wojciech Sadurski (ed), *Constitutional Justice, East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in A Comparative Perspective*. The Hague: Kluwer Law International, p. 143-159;
511. van Alebeek, Rosanne (2010) 'Immunity and Human Rights? A Bifurcated Approach'. *Proceedings of the Annual Meeting (American Society of International Law)*. Vol. 104, (March 24-27, 2010), p. 67-72;
512. Rose, Richard (1977) 'The President: A Chief but Not an Executive'. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 7, No. 1.
513. Rose-Ackerman, Susan (2012) 'The Regulatory State', në Michel Rosenfeld and Andras Sajó (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*. Oxford: Oxford University Press, p. 671-685;
514. Rosenfeld, Michel (2002) 'Constitutional Adjudication in Comparative Perspective: The European Model as Against the American in Terms of Politics, Law and Interpretation'. Association of American Law Schools, Conference on Constitutional Law, Washington, 5-8 June 2002, available at: <http://www.aals.org/profdev/constitutional/rosenfeld.html>;
515. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, me ndryshime. Datë: 13 qershor 2002.
516. Rregullorja Nr. 200/13 mbi Regjistrin Qendror Civil e UNMIK-ut, Kosovo
517. Sadurski, Wojciech (1990) 'Rights Before Courts. A Study of Constitutional Courts in Post-Communist States of Central and Eastern Europe'. The Netherlands: Springer, kapitujt 2 ("Constitutional Courts in Search of Legitimacy") dhe 3 ("The Model of Judicial review and Its Implications");
518. Sadurski, Wojciech (ed.) (2010) 'Constitutional Justice East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in A Comparative Perspective'. The Hague Kluwer Law International;
519. Sajó, Andras (1999) 'Limiting Government: An Introduction to Constitutionalism'. Budapest, CEU Press;
520. Samardzic Slobodan (ed) (2001). *Norma i Olduka: Karl Smit i Njegovi Kriticari*. Filip Visnjic: Beograd, fq. 85-124.
521. Samuel Issacharoff, Pamela S. Karlan and Richard H. Pildes (eds.) (2007) 'The Law of Democracy: Legal Structure of the Political Process'. New York, NY: Foundation Press, p. 1202- 1207.
522. Samuels J., David and Shugart Soberg Matthew (2003) 'Presidentialism, Elections and Representation'. *Journal of Theoretical Politics*. Vol. 15, No. 1, p. 33-60.
523. Sarat, A. and Clarke, C. (2008) 'Beyond Discretion: Prosecution, the Logic of Sovereignty, and the Limits of Law'. *Law & Social Inquiry*. Vol. 33, pp. 387-416;
524. Sartori në Lorch, Maristella (1994) 'Italian Parliamentary Democracy: Discussion'. *Political Science Quarterly*. Vol. 109, No. 3, 'Conference Issue: Presidential and Parliamentary Democracies: Which Work Best?', p. 461- 479;

525. Sathyamurthy, T. V. (1996) 'Centralised State Power and Decentralised Politics: Case of India'. *Economic and Political Weekly*. Vol. 31 (13): p. 835-843;
526. Schick, R and Zeh, W., (1999), "*The German Bundestag - Functions and Procedures*, Neue Darmstadter Verlagstalt", Rheinbreitbach: Berlin,;
527. Schmitt, C. *Verfassungslehre* (1928) "Duncker und Humblot", München und Leipzig;
528. Schmitt, Carl (1985) 'Political Theology. Four Chapters on the Concept of Sovereignty'. Chicago: The University of Chicago Press, Kapitulli 1 ("Definition of Sovereignty");
529. Schmitt, Carl (2005). *Political Theology; Four Chapters on the Concept of Sovereignty*. (The University of Chicago Press: Chicago);
530. Schroth, Peter W. (1979) 'Marbury and Simmenthal: Reflections on the Adoption of Decentralized Judicial Review by the Court of Justice of the European Community'. *Loyola Law Association Law Review*. Vol. 12: p. 869-902, available at: <http://digitalcommons.lmu.edu/lr/vol12/iss4/4>;
531. Schwartz, Bernard (1993) 'A History of the Supreme Court'. Oxford: Oxford University Press;
532. Schwartz, Herman (1998) 'Eastern Europe's Constitutional Courts'. *Journal of Democracy*. Vol. 9 (4): p. 100-114;
533. Schwartz, Herman (2000) '*The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe*'. Chicago: The University of Chicago Press, kapitujt 1 ("The Beginning") dhe tetë ("Conclusion"); p. p. 1-21 & 164-193 & 226-248;
534. Scott, P., Arthur (1930) '*Criminal Law in Colonial Virginia*'. Chicago: University of Chicago Press; Surrency, C., Erwin (1967) 'The Courts in the American Colonies'. *American Journal of Legal History*. Vol. 11, No.3, p. 253-276;
535. Fabbrini, Sergio (2000) 'Political Change without Institutional Transformation: What Can We Learn from the Italian Crisis of the 1990s?'. *International Political Science Review / Revue internationale de science politique*. Vol. 21 (2): p. 173-196;
536. Shafir, Gershon (1998) "*The Citizenship Debates: A Reader*", University of Minnesota Press: Minnesota;
537. Shane, Peter M., (1993) 'Who May Discipline or Remove Federal Judges a Constitutional Analysis'. *University of Pennsylvania Law Review*. Vol. 142, No. 1, p. 209-242.
538. Shapiro, Martin (1981) 'Courts. A Comparative and Political Analysis'. Chicago: The University of Chicago Press;
539. Shartel, Burke (1930) 'Federal Judges: Appointment, Supervision, and Removal: Some Possibilities under the Constitution'. *Michigan Law Review*. Vol. 28, No. 5, p. 485-529.
540. Shugart, Matthew Soberg and Carey, M., John (1992) 'Presidents and Assemblies: Constitutional Design and Electoral Dynamics'. New York: Cambridge University Press.
541. Silverstein, M., (1994) 'Judicious Choices: The New Politics of Supreme Court Confirmations'. New York: W.W. Norton and Company.

542. Smilov, Daniel, 'The Least Dangerous Branch?', në Michel Rosenfeld and Andras Sajó (eds.) (2012) *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*. Oxford: Oxford University Press, p. 859-873;
543. Smit, Karl (2001) 'Cuvar Ustava' në Slobodan Samardžić (ed.), *Norma i Odluka. Karl Smit i njegovi kritičari*. Beograd: Filip Visnjic, fq. 211-253. Titulli i origjinalit: Carl Schmitt, "Der huter der verfassung". *Archiv des öffentlichen rechts*. Neue Folge 16 Band J.C.B. Mohr (Paul Siebeck), Tübingen 1929;
544. Smit, Karl, (2003) 'Tri vrste pravnonaucnog misljenja', Biblioteka Parerga, Beograd, fq. 34-42; 46-54, titulli në origjinal: Schmitt, Carl, (1934) 'Über die drei Arten des rechtsëissenschaftlichen Denkens', Hamburg, Hanseatische Verlagsanstalt;
545. Smith, E. Michael (2003), "*Europe's Foreign and Security Policy: The Institutionalization of Cooperation*", Cambridge University Press;
546. Smith, Eivind (2005) 'Courts of people, not of norms? Law and fact in constitutional review as performed by courts of general or administrative jurisdiction'. *International Conference Law and Fact in Constitutional Jurisprudence*, 30 June-1 July 2005, Vilnius, Lithuania. Venice Commission. CDL-JU(2005)022 (p. 4);
547. SMITH, Eivind (2010) 'Constitutional Courts As "Positive Legislators"'. Paper presented at the: International Academy Of Comparative Law. XVIII International Congress of Comparative law. Washington, D.C., July 25-31, 2010;
548. Smooha, Sammy and Hanf, Theodor, (1992), "The Diverse Modes of Conflict-Regulation in Deeply Divided Societies". *International Journal of Comparative Sociology* (Publisher: BRILL), Volume 33, Numbers 1-2, fq. 26-47 (22);
549. Sokol, S., Smerdel, B., (1988), "*Organizacija vlasti*". Vëll. I dhe II, Globus: Zagreb;
550. Solis, D. Gary., (2010), "*The Law of Armed Conflict: International Humanitarian Law in War*", Cambridge University Press: Cambridge;
551. Golder, Nadenichek Sona (2006) 'Pre-Electoral Coalition Formation in Parliamentary Democracies'. *British Journal of Political Science*. Vol. 36 (2): p. 193-212;
552. Srivastava, Meetika (2009) 'Good Governance - Concept, Meaning and Features: A Detailed Study'. Në internet: <http://ssrn.com/abstract=1528449> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.1528449>;
553. Štark, K., (1988), "Istorijski razvoj i aktuelni značaj supremacije ustava", *Anali Pravnog fakulteta u Beogradu*, br. 5;
554. Steele, W., Jr., Walter (1984) 'Unethical Prosecutors and Inadequate Discipline'. *So¹ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission)*, 'Opinion on European Standards As Regards The Independence of The Judicial System: Part II - The Prosecution Service'. CDL-AD(2010)040, paragrafi 51 & 52;
555. Steering Committee on Local and Regional Authorities 'Definition and Limits of the Principle of Subsidiary: Report prepared for the Steering Committee on Local and Regional Authorities (CDLR), Local and regional authorities in Europe', *Report No. 55*. Në internet: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?Index=no&command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1276048&ScMode=1&DocId=1348640&Usage=2>;

556. Steinberger, Helmut (1993) 'Models of Constitutional Jurisdiction'. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), 1993, CDL_STD (1993) 002;
557. Steinberger, Helmut (1994) 'Models of Constitutional Jurisdiction'. Venice Commission: Strasbourg, 1994, Kapitulli I ("Review of the Constitutionality of Laws"), p. 5-20;
558. Stepan, Alfred and Cindy Skach (1993) 'Constitutional Frameworks and Democratic Consolidation. Parliamentarism versus Presidentialism.' *World Politics*. Vol. 46, p. 1-22.
559. Steve Martin, *et al* (2010) 'Validity, Utilization and Evidence-Based Policy: The Development and Impact of Performance Improvement Regimes in Local Public Services'. *Evaluation*. Vol. 16: p. 31-42;
560. Strøm, K. (2000) 'Delegation and Accountability in Parliamentary Democracies'. *European Journal of Political Research*. Vol. 37, p. 261-289.
561. Strong, C.F., (1963), "*Modern Political Constitutions*", Putnam: London;
562. Stupar, M., (1996), "*Teorija opolitičkim dužnostima*(Savremena Administracija)", Beograd;
563. Suleiman, N. Ezra, 'Presidentialism and Political Stability in France' in Linz,
564. Supreme Court of Canada, *Valiente v. The Queen*, Judgment, 1985,.
565. Sutherland në Fisher, Louis (1988) 'Foreign Policy Powers of the President and Congress'. *Annals of the American Academy of Political and Social Science*. Vol. 499, Congress and the Presidency: Invitation to Struggle, p. 148-159.
566. Sweet, Alec Stone (1992) 'The Birth of Judicial Politics in France: The Constitutional Council in Comparative Perspective'. New York: Oxford University Press;
567. Sweet, Alec Stone (2002) 'Constitutional Courts and Parliamentary Democracy'. *West European Politics*. Vol. 25 (1): p.77-100;
568. Sweet, Stone Alec 'Constitutional Courts', në Rosenfeld, Michel and Sajo, Andras (eds.) (2012) '*The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*'. Oxford: Oxford University Press, p. 816-830.
569. Takanori Adachi and Yasutora Watanabe (2008) 'Ministerial Weights and Government Formation: Estimation Using a Bargaining Model'. *Journal of Law, Economics, & Organization*. Vol. 24 (1): p. 95-119;
570. The Bangalore Draft Code of Judicial Conduct (2001) adopted by the Judicial Group on Strengthening Judicial Integrity, as revised at the Roundtable Meeting of Chief Justices held at the Peace Palace, The Hague, November 25-26, 2002.
571. *The General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina*, e njohur si Marrëveshja e Dejtonit, është një marrëveshje e paqes që është arritur në bazën ajrore ushtarake amerikane Wright - Patterson afër qytetit Dejton në shtetin Ohajo në nëntor 1995, kurse formalisht është nënshkruar në Paris më 14 dhjetor 1995.
572. The OSCE High Commissioner on National Minorities (HCNM), *The Lund Recommendations on the Effective Participation of National Minorities in Public Life* (1 September 1999).
573. Baylis, A. Thomas (1996) 'Presidents versus Prime Ministers: Shaping Executive Authority in Eastern Europe'. *World Politics*. Vol. 48 (3): p. 297-323;

574. Thomas G Weiss, David P Forsythe, Roger A Coate and Kelly-Kate Pease, (2013) “*The United Nations and Changing World Politics*”, Westview Press: United States, fq. 102-105.
575. White, W. Thomas (1977) ‘Reliance on Apparent Authority as a Defense to Criminal Prosecution’. *Columbia Law Review*. Vol. 77, No. 5, pp. 775-809;
576. Thornberry, P., (1992) “*International Law and Rights of Minorities*”, Oxford University Press: Oxford;
577. *Tomë Krasniqi kundër RTK et Al*. Vendim. Masë e Përkohshme (MP) në Rastin KI 11/09. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 16 tetor 2009. Nr. ref.: MP 01/09;
578. Tomkins, A., (2005) “*Our Republican Constitution*”(Oxford University Press: Oxford).
579. Toroman, M.M., “Zakonsko regulisanje prava na štrajk“, *Anali Pravnog Fakulteta u Beogradu*, br. 3-4, 1993, fq. 243-258.
580. *Trashëgimtarët e Ymer Loxhës dhe Sehit Loxhës kundër Vendimit Nr. PKL Nr. 21/07 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës*. Rasti Nr. 14/09., i datës 17 dhjetor 2008. Vendimi për Papranueshmëri. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Datë: 15 tetor 2010 (Nr. ref.: RK 47/10);
581. Treanor, William Michael (2005) ‘Judicial Review before "Marbury"’. *Stanford Law Review*. Vol. 58 (2): p. 455-562;
582. Tribunali Kushtetues i Polonisë K-37/05 i datës 25.10.2005.
583. Troper, Michel (2007) ‘Judicial Power and Democracy’, in 1 *European Journal Of Legal Studies* (EJLS) No.2 1;
584. Türk, D., “Neka aktuelna pitanja ostvarivanja ekonomskih, socijalnih i kulturnih prava čoveka u svetlu rasprava u organima UN“, *Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu*, nr. 5-6, 1989. (Supplement), fq. 691-696. SKA VIT
585. Türk, D., “Osvrt na međunarodno-pravno regulisanje zaštite manjine u Ujedinjenim nacijama“, *Jugoslovesnka Revija za Medjunarodno Pravo*, br. 1-2, 1976. SKA VIT
586. U.N. Doc. CCPR/C/46/D/387/1989, *Karttunen v. Finland*, Communication No. 387/1989, at 108 (1992).
587. Udhëzimit Administrativ Nr. 200/8 i datës 27 prill 2008, UNMIK Kosovo
588. UN Human Rights Committee, *D. Wolf v. Panama*, UN Doc. GAOR, A/48/40, (vol. 2),
589. United Nations Congress on the Prevention of Crime and the Treatment of Offenders, ‘Basic Principles on the Independence of the Judiciary’, adopted on the Seventh United Nations Congress on the Prevention of Crime and the Treatment of Offenders held at Milan from 26 August to 6 September 1985 and endorsed by General Assembly resolutions 40/32 of 29 November 1985 and 40/146 of 13 December 1985.
590. United Nations, *No Entry Without Strategy: Building the Rule of Law under UN Transitional Administration Paperback* (United Nations University Press: Tokyo, 2008) fq. 120-186;
591. *Universiteti AAB - RIINVEST L.L.C, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*. Rasti nr. KI 41/09. Aktvendim për Papranueshmëri. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 27 janar 2010 (Nr. ref.: RK 04/10);

592. UNMIK Administrative Direction 2008/2 (Neni, Para. 11). Neni 2.13 i Urdhëresës Administrative 2008/2 saktëson se të gjithë kandidatët pa përjashtim duhet të kalojnë testin e Kodit të Etikës. Cf. edhe Raportin e Punës së Këshillit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, 29 tetor 2010.
593. Urdhëresa Administrative 2008/2, UNMIK Kosovo.
594. *V. Francis v Jamaica*, UN Human Rights Committee, Communication No. 320/1988.
595. *Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë*. Aktgjykim. Rasti KI 06/10. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 30 tetor 2010 (Nr. Ref.: AGJ 63/10);
596. Van Alstyne, M. Scot, (1952) 'The District Attorney: A Historical Puzzle'. *Wisconsin Law Review*. Vol. 11, No. 3, pp. 125-138;
597. van Alstyne, M., Scot, (1952) 'The District Attorney: A Historical Puzzle'. *Wisconsin Law Review*. Vol. 11, No. 3, pp. 125-138;
598. Van Dijk, F., Van Hoof, F. Van Rijn, A. and Zwaak, Leo, (2006) "*Theory and Practice of the European Convention on Human Rights*". Fourth Edition, Intersentia: Antwerp - Oxford;
599. Vause, W. Gary (1995) 'The Subsidiarity Principle in European Union Law--American Federalism Compared'. *Case Western Reserve Journal of International Law*. Vol. 27: p. 61-75;
600. Vendim i Gjykatës Federale Supreme të Brazilit Nr. 2617 i datës 23.02.2005;
601. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë Nr. 19/97 i datës 10.01.1998;
602. Vendim i Gjykatës Kushtetues të Sllovenisë U-I-196/97 i datës 29.10.1997;
603. Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë 1 BvR 1508/96 i datës 07.06.2005;
604. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të B&H U 1/99, i datës 20.01.2000;
605. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bjellorusisë, Nr. J-18/95 i datës 27.10.1995.
606. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë 01/10 i datës 31.03.2010;
607. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë 01/99 i datës 14.01.1999;
608. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë 13/02 i datës 16.12.2002;
609. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë 16/95 i datës 19.09.1995;
610. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë, nr. 12/96, i datës 23.07.1996;
611. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Federatës Ruse (nuk ka numër), i datës 17.07.1998;
612. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Federatës Ruse (nuk ka numër), i datës 24.01.1997;
613. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Federatës Ruse, i datës 01.12.1999. Paragrafët 162-167;
614. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë 29/2011, i datës 07.04.2011;
615. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë 4/1997, i datës 22.01.01.1997;
616. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të IRJM-së U.br. 140/99, i datës 14.06.2000;
617. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të IRJM-së U.br. 161/98, i datës 20.01.1999;
618. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-I-200/1996, i datës 12.06.1996;
619. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-I-241/1998, i datës 31.03.1999;
620. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-I-3760/2007 et al, i datës 08.12.2010;
621. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-I-3789/2003 et al i datës 08.12.2010;

622. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-II-1095/1995, U-II-1021/1995, i datës 27.12;
623. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-II-1315/2001, i datës 09.07.2003;
624. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-III-317/1996, i datës 03.02.1999;
625. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-IIIB-1005/2004, i datës 08.07.2004;
626. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-IV-947/1996, i datës 08.01.1997;
627. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, nr. U-VII-700/1997, i datës 11.06.1997
628. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Letonisë 04-07(99), i datës 24.03.2000;
629. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë 35/03-11/06, i datës 21.09.2006;
630. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë 70/06, i datës 23.05.2007;
631. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë nr. 6/97, i datës 13.11.1997;
632. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë nr. 16/98, i datës 21.12.1999;
633. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, 3/95, i datës 06.12.1995;
634. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, nr. 24/04, i datës 25.05.2004;
635. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, Nr. 7/08, i datës 07.09.2010
636. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Moldavisë nr. 21, i datës 02.09.2004;
637. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë, nr. 976/96, i datës 27.07.1996.
638. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke I. US 394/97, i datës 04.03.1998;
639. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke IV. US 61306, i datës 08.04.2007;
640. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke Pl. US 39/08, i datës 06.10.2010;
641. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Jug-Afrikane CCT 23/96, i datës 06.09.1996);
642. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Jug-Afrikane, Nr. CCT 27/95 i datës 22.09.1995.
643. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Jug-Afrikane, Nr. CCT 42/09 i datës 30.09.2009.
644. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Jug-Afrikane, Nr. CCT 54/09, i datës 23.02.2010.
645. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë i datës 31.09.1995 (nuk ka numër te vendimit);
646. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë i datës 07.01.2005;
647. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë Nr. 57 I datës 04.11.1998;
648. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë PL. US 1/86 I datës 14.11.1996;
649. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë PL. US i datës 10.09.1996);
650. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë PL.US 7/96 i datës 27.02.1997;
651. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, No. I. US 7/96 i datës 11.07.1996.
652. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, Nr. II.US 31/97, i datës 21.05.1997.
653. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, Nr. II.US 65/97 i datës 10.12.1997.
654. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, Nr. PL. US 8/97, i datës 24.06.1998.
655. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës 4-rp/2000 I datës 11.04.2000);
656. Vendim i Gjykatës së Lartë të Greqisë Nr. 45/97 I datës 25.06.1997;
657. Vendim i Gjykatës Supreme Federale të Brazilit ADI 2.797 i datës 15.09.2005;
658. Vendim i Gjykatës Supreme të Estonisë 3-4-1-5-2000, I datës 15.05.2000;
659. Vendim i Gjykatës Supreme të Meksikos, Nr. 198 i datës 28.05.2003.
660. Vendim i Gjykatës Supreme të Qipros (pa numer) i datës 01.12.2010;

661. Vendim i Tribunalit Kushtetues të Polonisë K41/97 I datës 08.12.1998;
662. Vendim i Tribunalit Kushtetues të Polonisë SK 30/05 I datës 16.01.2006;
663. Vendim i Tribunalit Kushtetues të Polonisë U 5/95 I datës 17.06.1997;
664. Vendim i Tribunalit Kushtetues të Polonisë W 1/95 i datës 05.09.1995.
665. *Vendim mbi Kërkesën për Masë të Përkohshme në Rastin KI 22/09. Dode Gecaj kundër Vendimit PKL-KZZ 76/08 të Gjykatës Supreme të Kosovës* (Ref. Nr. MP 03/09). Prishtinë: 15 dhjetor 2009.
666. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. 45/1995 (X. 21.) AB hatarozat i datës 18.10.1994;
667. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë Nr. 4/94 i datës 21.06.1994;
668. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë nr. 8/2011 I datës 18.02.2011;
669. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë 39/06 I datës 28.05.2008;
670. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Moldavisë, Nr. 1/2008 i datës 03.04.2008.
671. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke III. US 206/98 i datës 09.07.1998;
672. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Jug-Afrikane, Nr. CCT 53/11, 54/11, 62/11, i datës 29.07. 2011.
673. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë II.US 94/95 i datës 13.12.1995
674. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës, Nr. 3-rp/2008, i datës 01.04.2008. Mbetet për interpretim nëse Neni 84 i kushtetutës duhet shikuar si *ndalues* për kompetenca shtesë për presidentin me anë të ligjeve të Kuvendit.
675. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Federale Gjermane Nr. 1BvR 1693/92 i datës 8 shkurt 1994;
676. Vendimi i Kuvendit Nr. 04-V-436 i datës 7 shtator 2012. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* Nr. 25 (datë: 7 shtator 2012).
677. Vendimi i Kuvendit të Kosovës, Nr. 04-V-436, datë 7 shtator 2012. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, Nr. 25, datë 7 shtator 2012.
678. Vendimi i Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar të Zyrës Civile Ndërkombëtare (PCN i ZCN), zt. Piter Feith, No. 17/2012 dhe 18/2012 të datës 17 korrik 2012 mbi emërimin e gjyqtarëve Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova,
679. Vendimi No 19/2012 të datës 22 gusht 2012 mbi emërimin e gjyqtarit Robert Carolan; Për Auditorin e Përgjithshëm, Cf. Vendimin e PCN të ZCN No. 2012/16 të datës 16 korrik 2012.
680. Venice Commission (2004) ‘Joint Opinion on the Law on the Ombudsman of Serbia by the Venice Commission, the Commissioner for Human Rights and the Directorate General of Human Rights of the Council of Europe’, CDL-AD(2004)041, Strasbourg, 24 November 2004.
681. Venice Commission Report, “Reflections on the Execution of Constitutional Court Decisions in a Democratic State under the Rule of Law on the Basis of the Constitutional Law Situation in the Federal Republic of Germany” by Mr Siegfried BROSS, Judge of the German Federal Constitutional Court. Strasbourg, 27 January 2009, CDL-JU(2009)00;
682. Venice Commission, CDL-JU(2008)026 Seminar On “Models Of Constitutional Jurisdiction”, Ramallah, 25-26 October 2008;
683. Venice Commission. ‘The Binding Effect Of Federal Constitutional Court Decisions Upon Political Institutions’. Report by Ms Anke Eilers, Federal Constitutional Court, Karlsruhe. Seminar on “The effects of Constitutional Court decisions”. (Tirana, 28-29 April 2003) CDL-JU (2003) 1.

684. Venice Commission. ‘The Relationship Between Constitutional Courts, Legislators And Judicial Power In The European System Of Judicial Review Towards A Decentralised System As An Alternative To Judicial Activism?’ Strasbourg, 7 July 2010, CDL-JU(2010)012;
685. Venice Commission. Report “Some Comparative Comments To The Introduction Of Constitutional Review In The State Of Palestine” by Mr Arne Marjan MAVČIČ (Liaison Officer, Constitutional Court, Slovenia) CDL-JU(2008)026 Seminar On “Models Of Constitutional Jurisdiction”, Ramallah, 25-26 October 2008;
686. Venter, M. Christine (2012) “*International Women's Rights, Equality and Justice*”, Carolina Academic Press; USA;
687. *Vermeulen v. Belgium*, GJEDNj, Judgment of 20 February 1996, Reports of Judgments and Decisions 1996-I.
688. *Victor P. Domukovsky, Zaza Tsiklauri, Petre Gelbakhiani and Irakli Dokvadze v. Georgia*, Communications N 623/1995, 624/1995, 626/1995, 627/1995, U.N. Doc. CCPR/C/62/D/623/1995, CCPR/C/62/D/624/1995, CCPR/C/62/D/626/1995, CCPR/C/62/D/627/1995 (29 May 1998)..
689. Vienna Convention on the Law of Treaties, 1155 U.N.T.S. 331, 8 I.L.M. 679, entered into force 27 January 1980, Art. 56. Në internet në: http://untreaty.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/1_1_1969
690. Vile, M.C.J., (1967) “*Constitutionalism and the Separation of Powers*” (Oxford University Press: Oxford,)
691. Vile, M.J.C., (1969) “*Constitutionalism and Separation of Powers*”, Oxford University Press: Oxford;
692. *Vlerësim i kushtetutshmerise së propoimeve të Qeverise për amendamentimin e Kushtetutës, dorëzuar nga Kr yetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 12 prill 2012*. Rasti KO 38/12. Vendim. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (Nr. Ref.: K 234/12), datë 15 maj 2012;
693. *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Panelit të Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtrësia*. Rasti KI 22/11. Aplikues: Bojana Denic., A. No. 263/2010. Aktvendim për Papranueshmëri. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Datë: 19 maj 2011 (Ref. No.: RK 124/11);
694. *Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara kushtetuese nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars dhe 4 maj*. Aktgjykim në Rastet KO 29/12 dhe KO 48/12 (Nr. Ref.:AGJ 284/12). Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Datë: 20 korrik 2012;
695. Vodinelić-Rakić, V., (1989) ”Prava treće generacije“, *Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu*, nr. 5-6,. (Supplement), fq. 789-814.
696. Volcansek, Mary I. (2000) ‘Constitutional Politics in Italy: the Constitutional Court’. St. Martin's Press. p. 1- 15;
697. Vukas, B., (1971) “Zabrana rasne diskriminacije po općim aktima o pravima čoveka usvojenim u Ujedinjenim narodima“, *Jugoslovenska Revija za Medjunarodno Pravo*. nr. 2 fq. 208-220.
698. W. Philips Shively, (2003) “*Power and Choice. An Introduction to Political Science*”. Eighth Edition, McGrawHill: New York: f.q. 204-222

699. Weisman, Amy J. (1995) 'Comment, 'Separation of Powers in Post-Communist Government: A Constitutional Case Study of the Russian Federation'. *American University Journal of International Law and Policy*. Vol. 10 (4): p. 1365-1398;
700. Wellman, C., (1989) "Nova koncepcija ljudskih prava", nē: Matulovic, Miomir (ed.), *Ljudska prava*, ICR: Rijeka;
701. Wheare, K.C., (1966) "*Modern Constitutions*", Oxford University Press: USA;
702. White, Robin and Ovey, Clare (2010), "*The European Convention on Human Rights*", Oxford University Press: USA;
703. White, W., Thomas (1977) 'Reliance on Apparent Authority as a Defense to Criminal Prosecution'. *Columbia Law Review*. Vol. 77, No. 5, pp. 775-809;
704. Whitefield, Stephen and Evans, Geoffrey, (2001)"Attitudes Towards the West, Democracy and the Market", nē Zielonka, Jan (ed.), *Democratic Consolidation in Eastern Europe. International and Transnational Factors Volume II*, Oxford University Press: Oxford, fq. 192- 230;
705. William Rawle, (2009) 'A View of the Constitution f the United States of America'. USA: BiblioLife (reprinted). Chapter, 21, p. 199.
706. Wolfe, C. (2004) 'The Rise of Modern Judicial Review: From Constitutional Interpretation to Judge-Made Law'. London: Rowman & Littlefield Publishers;
707. Wolf-Philips, L., (1992) "Komparativni ustavi", nē: Bačić, A. (ed.), *Ustavna diktatura: Hrestomatija ustavnopravne i politicke znanosti*, Knjizevni krug: Split, fq. 125;
708. Wollstonecraft, Mary., (2013) "*A Vindication of the Rights of Woman*", Flipside Publishing: Philippines,
709. Woodrow Wilson (1897) 'Leaderless Government'. *The Virginia Law Register*. Vol. 3 (5): p. 337-354;
710. Wouters, Kees., (2009) *International Legal Standards for the Protection from Refoulement*, Intersentia: UK and US;
711. Zacharias, C., Fred (2001) 'The Professional Discipline of Prosecutors'. *North Carolina Law Review*. Vol. 79, pp. 721-778;
712. Zeh, W., (1987) "*Parlamentarismus: historische Wurzeln, moderne Entfaltung*", R. v. Decker & C.F. Müller: Heidelberg;
713. Zielonka, Jan (ed.), (2001), "*Democratic Consolidation in Eastern Europe. International and Transnational Factors*" Volume II (Oxford University Press: Oxford, Volume II, fq. 76-111.
714. Zink, H.(1962) "*Modern Governments* D.Van Nostrand Company Inc.": New York;
715. *Zlinsat, spol. s r.o., v. Bulgaria*, GjedNj, No. 57785/00, § 78, 15 June 2006
716. Zumbansen, Peer (2012) 'Carving Out Typologies and Accounting for Differences Accros Systems: Towards a Methodology of Transnational Constitutionalism'. u Michel Rosenfled and Andras Sajo (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*. Oxford: Oxford University Press, p. 75-97;
717. 'The Division of Powers in Government' (1913). *Harvard Law Review*, Vol. 26, No. 8: p. 744-747;
718. "Is Romania Worse Than Hungary?" *The Economist* (OpEd): 17/07/2012. Nē internet: <http://www.economist.com/blogs/easternapproaches/2012/07/romanian-politics>;

719. Abraham, Herry J. (1998) 'Judicial Process - An Introductory Analysis of the Courts of the United States, England, and France'. New York: Oxford University Press (seventh edition).

Shqyrtime hyrëse

1. Libri "Komentari i Kushtetutës së Republikës së Kosovës" paraqet një koment mjaft të vëllimshëm dhe të detajuar të kësaj Kushtetute, të shpallur më 15 prill 2008. Ky është komenti i parë i kompletuar i Kushtetutës në literaturën juridike që nga nxjerrja e saj. Sa i përket përmbajtjes, libri paraqet koment të bazuar shkencërisht të zgjidhjeve juridike që përmban Kushtetuta dhe i ofron lexuesit një pamje të plotë në sistemin kushtetues-juridik të Kosovës. Me këtë ofrohet analiza e parimeve themelore kushtetuese të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të drejtave dhe lirive të komuniteteve, sistemit të organizimit të pushtetit, Një kontribut i veçantë i këtij komenti është vështrimi kritik i zgjidhjeve juridike të përfshira në Kushtetutë, ku ofrohen përgjigje dhe alternativa. Në këtë mënyrë lexuesit i ofrohet mundësia që në të vërtetë "të lexojë" Kushtetutën, pa marrë parasysh njohuritë e tij në lëmin e së Drejtës Kushtetuese, ngase në koment janë shikuar institutet juridike në mënyrë sistematike, kritike dhe analitike. Për këtë arsye, ky libër mund të shërbejë si material njohës jo vetëm për juristët, por edhe për lexuesin që është i interesuar të zgjerojë njohuritë e veta mbi funksionimin dhe vlerat themelore të rendit juridik të Republikës së Kosovës.

Vetë ideja e kushtetutës rrjedh nga tri burime, **dhe kjo:**

- 1) Ligji më i lartë kryesor;
 - 2) Të drejtat individuale; dhe
 - 3) Karta, dokumenti i shkruar.
2. Paraqitjen e kushtetutës e shënojnë tekstet e para të shkruara, me të cilat ka filluar të kufizohet pushteti i pakufizuar deri atëherë. Tekste të tilla të shkruara u paraqitën, së pari në Anglinë e mesjetës, si djep i parlamentarizmit¹ dhe, përmes tyre, qysh në shekullin XIIIvunë themelet e pushtetit të përfaqësues demokratik në vend.²

Prandaj kushtetuta definohet në kuptimin *material* (në kuptim më të gjerë) dhe në atë *formal* (në kuptim më të ngushtë). Të dy kuptimet e kushtetutës përbëjnë **konceptin normativ të kushtetutës**, i cili nënkupton se kushtetuta paraqet një tërësi normash. Kushtetuta në kuptimin material paraqet tërësi normash, që janë rregulla, me të cilat rregullohen bazat e organizimit shoqëror në një komunitet politik, mënyrën e ushtrimit të pushtet shtetëror në të dhe kufijtë e pushtetit³

¹ Këtu duhet theksuar se parlamentarizmi, me gjithë kuptimin e vet më të gjerë, nga modelet konkrete të sistemeve parlamentare, nuk mund të jetë identik me nocionin e demokracisë parlamentare (për të ekzistuar një demokraci e vërtetë parlamentare duhet të ekzistojnë edhe shumë kushte dhe premisa - kultura politike, tradita dhe të ngjashme, të cilat do të kontribuonin në vendosjen e një rendi demokratik parlamentar).

² Anglia, vendi i cili ishte djepi dhe "vendlindja" e parlamentarizmit dhe demokracisë parlamentare, ishte njëherësh edhe vendi me lehtësime të jashtëzakonshme të brendshme dhe me pozitë të privilegjuar ndërkombëtare, në të cilin janë kristalizuar gradualisht institucionet dhe procedurat e parlamentarizmit demokratik.

³ Kufinj të tillë janë liritë dhe të drejtat e individit dhe kolektivit.

shtetëror. Kushtetuta në kuptimin formal është një akt juridik i shkruar dhe i përgjithshëm me fuqinë më të madhe ligjore.⁴

3. Këtu duhet posaçërisht të cekim se secili shtet ka kushtetutë në kuptimin material, por jo edhe çdo shtet ka kushtetutë në kuptimin formal. Natyrisht, për dallim nga kohët e hershme, sot numri më i madh i shteteve kanë kushtetutë në kuptimin formal. Si koncept më i gjerë, kushtetuta në kuptimin material, përfshin kushtetutën në kuptimin formal.
4. Për dallim nga numri më i madh i kategorive juridike, të cilat në një mënyrë, pak a shumë të plotë, gjejnë përkufizimin e tyre bazë në vetë sistemin juridik; si rregull nuk ekziston "përkufizimi kushtetues i kushtetutës". Për këtë arsye përkufizimi i kushtetutës, dhe rrjedhimisht edhe përcaktimet e nocionit të kushtetutës, i lihen shkencës. Megjithatë, kjo çështje nuk i ka preokupuar vetëm shkencat juridike, po gjithmonë ka qenë fushë interesimi edhe e shkencave të tjera shoqërore, para së gjithash shkencave politike, po edhe e sociologjisë dhe filozofisë. Prandaj janë krijuar përkufizime të ndryshme të nocionit të kushtetutës, të kufizuara me postulatet e disa disiplinave shkencore.⁵
5. Edhe pse Anglia, vendi që konsiderohet si atdheu i kushtetutshmërisë moderne, në të vërtetë, edhe sot, shfaqet si vendi që nuk ka kushtetutë në kuptimin formal, por, pavarësisht nga kjo, në botën moderne pa dyshim mbizotëron praktika e ekzistimit të kushtetutës formale.
Shteti më i ri në Evropë është **Kosova**, e cila shpalli pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008. Para saj, shteti më i ri ishte Mali i Zi, i cili u bë shtet i pavarur më 3 qershor 2006, pasi qytetarët e Malit të Zi, në referendumin e mbajtur më 21 maj 2006, u deklaruan për pavarësi dhe ndarje nga unioni shtetëror Serbi dhe Mali i Zi. Që nga viti 1990 janë krijuar 28 shtete të reja. Shumë prej tyre u krijuan nga rënia e Bashkimit Sovjetik (14 shtete) dhe e RSF të Jugosllavisë (7 shtete).
6. Nga 195 shtetet e pavarura të botës, tashmë numri më i madh i tyre kanë kushtetuta në kuptimin formal ose janë në procesin e nxjerrjes së tyre. Forma e kushtetutës është cilësia e saj më e rëndësishme (kjo edhe e dallon kushtetutën nga ligji dhe aktet e tjera të përgjithshme juridike). Elementet që përcaktojnë cilësitë e kushtetutës në kuptimin formal, janë:
 - a) organi i veçantë që vendos për nxjerrjen ose amandamentimin e kushtetutës,
 - b) procedura e veçantë, me të cilën nxirret ose amendamentohet kushtetuta, dhe
 - c) mënyra e veçantë e rregullimit të procedurës së revizionit të kushtetutës.
7. Meqë i kushtohet vëmendje e veçantë përpjekjes për të përkufizuar kushtetutën në shkencat juridike, është e logjikshme që ka pasur dhe vazhdon të ketë në qarkullim

⁴ Për më tepër shih; Jennings, V.I. (1964), "The Law and the Constitution", University of London Press: London.

⁵ Filloux, J.C., Filloux, J.C., (1987) "Durkheim i sociologjia prava čovjeka", në: Josip Obradovic & Dusko Sekulic (ed.), *Suvremena sociologija*, Sociolosko drustvo Hrvatske: Zagreb, fq. 43-45.

shumë përkufizime juridike të kushtetutës. Ndoshta përcaktimi më përfaqësues i kushtetutës, thjesht me elemente juridike, është ai që ka të bëjë me juristin austriak, që është korifeu dhe themeluesi i teorisë normative bashkëkohore - Hans Kelsenin. Ai në librin e tij monumental *Teoria e Përgjithshme e Shtetit dhe së Drejtës* ka theksuar se përkufizimi thelbësor i kushtetutës në kuptimin material të fjalës, është që të përcaktojë mënyrën e krijimit të normave të përgjithshme juridike, pra, të përcaktojë organet ligjvënëse dhe procedurën e ligjvënies, si dhe - deri në një masë të caktuar - përmbajtjen e ligjeve të ardhshme.⁶ Për një kohë të gjatë, me problemin e përcaktimit të Kushtetutës është marrë edhe Carl Schmitt në veprën e tij *Teoria e Kushtetutës* ("Verfassungslehre"), në të cilën mund të gjendet edhe një përkufizim juridik tipik i kushtetutës. Sipas tij: "Kushtetuta në kuptimin absolut mund të nënkuptojë një rregullim bazë, pra, një dhe të vetmin, sistem të mbyllur të normave më të larta dhe të fundit (Kushtetuta = norma e normës)."⁷

8. Autorë të shumtë, veçanërisht nga shkencat e tjera të afërta shoqërore, janë përpjekur që në përkufizimin e kushtetutës të sjellin elemente jashtë-juridike. Në përcaktimet e kushtetutës me elemente jashtë-juridike, për herë të parë dhe për një kohë të gjatë grupi i përkufizimeve më të rëndësishme është ai që ka bazë religjioze dhe filozofike. Vëllimi i përkufizimeve të tilla të kushtetutës është aq i madh, sa është e vështirë të nxirret ndonjë shembull përfaqësimi; megjithatë, po cekim ato që kushtetutën e konsiderojnë emanim të vullnetit të Perëndisë (*Civitas dei*), shprehje dhe realizim të frymës absolute, rendin bazë të gjërave në shoqëri.
9. Përveç përkufizimeve të lartpërmendura, në përdorim është edhe **nocioni politik i kushtetutës**, i cili ndodh kur ndrydhet subjektiviteti, sundon arbitrariteti dhe abuzimi i pushtetit nga bartësit e pushtetit shtetëror. Elementet më të plota të nocionit politik i ka dhënë Carl Levenstein. Ato janë: ndarja e pushteteve⁸, mekanizmi juridik i përshkruar më lart për bashkëpunimin e disa pushteteve, metoda racionale e ndryshimeve kushtetuese dhe njohja e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit.⁹ Kushtetuta në kuptimin politik është proces politik i kufizimit efektiv të pushtetit shtetëror. Andaj, sipas Karl Fridrih-ut, një vend ka kushtetutë në kuptimin politik, nëse me të kufizohet efektivisht pushteti shtetëror. Ekzistimi i kushtetutës së shkruar nuk është garanci e ekzistimit të kushtetutës në kuptimin politik. Simbolet e rendit kushtetues, në të cilin ekziston kushtetuta në kuptimin politik, janë: pushtetet e ligjvënies, ekzekutivit dhe gjyqësorit, të drejtat e njësive federale, liria e shprehjes, federalizmi, qeverisja lokale. Në të vërtetë, ky përkufizim pak a shumë është në përdorim në shkencat politike, ku me kushtetutë nënkuptohet një tërësi rregullash, të cilat rregullojnë ndarjen e pushteteve dhe mënyrën e ushtrimit të atij pushteti mes anëtarëve të një komuniteti.¹⁰

⁶ H. Kelsen, (1951), "Opšta teorija države i prava", Arhiv za pravne i društvene nauke: Beograd, fq. 257.

⁷ C. Schmitt, (1928), "Verfassungslehre", Duncker und Humblot: München und Leipzig, fq.7.

⁸ Vile, M.J.C., (1969), "Constitutionalism and Separation of Powers", Oxford University Press: Oxford, fq. 97.

⁹ Barnett, A., (1997), "Constitutional Possibilities". *The Political Quarterly*. Vol. 68 Issue 4, fq. 361-371.

¹⁰ Shively, W. Philips (2003), "Power and Choice. An Introduction to Political Science". Eighth Edition, McGrawHill: New York: f.q. 204-222.

10. Në mospërputhje të së vërtetës dhe normatives, është krijuar edhe një nocion i kushtetutës, **nocioni sociologjik i kushtetutës**. Ferdinand Lasal, është teoricieni më i njohur në këtë fushë dhe ai dallon **kushtetutën e vërtetë nga ajo e shkruar**. Kushtetutat e vërteta janë reale, raportet faktike të forcave që ekzistojnë në një shoqëri. Kushtetutat e shkruara, sipas Lasalit, janë një fletë e zakonshme letre. Kushtetuta të vërteta ka pasur secili shtet në çdo kohë. Kushtetutat e shkruara janë më të vonshme, dhe vlejnë vetëm nëse shprehin saktë raportet e vërteta të forcave që ekzistojnë në një shoqëri.
11. Në bazë të këtyre vlerësimeve, kushtetuta, mund të përkufizohet si akti më i lartë juridik i një vendi, i cili institucionalizon ekzistimin dhe funksionalizimin e pushteteve politike, rregullon marrëdhëniet socio-ekonomike dhe politike, siguron një sferë të caktuar të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe paraqet mjetin e kufizimit të bartësve të pushtetit politik.
12. Po ashtu, këtu është e rëndësishme të theksohen **funksionet bazë të kushtetutës**. Pra që kushtetuta është një akt solemn, normativ, i cili e ka fuqinë juridike të ligjit. Ideja kryesore e nxjerrjes së kushtetutës, pavarësisht nga lloji i kushtetutshmërisë, është që me këtë akt të përgjithshëm të përcaktohen rregullat juridike për ushtrimin e pushtetit shtetëror, në mënyrë që ky pushtet shtetëror të ushtrohet sipas atyre rregullave, të përcaktuara paraprakisht, dhe jo sipas vullnetit subjektiv të atyre që sundojnë, pra, në duart e të cilëve është ky pushtet.
13. Përveç kësaj, **qëllimi i kushtetutës** është sigurimi që pushteti shtetëror të ushtrohet në interesin e përbashkët të të gjithë qytetarëve (d.m.th. për të mirën e gjithë bashkësisë shoqërore), e jo vetëm të pushtetit. Me anë të Kushtetutës, shteti legjitimohet para botës së jashtme si pushteti më i lartë në territorin e vet, prandaj kushtetuta është simboli i parë i pavarësisë së shtetit. Megjithatë, përjashtimi i arbitraritetit të pushtetit shtetëror dhe sjellja e sundimit të së drejtës objektive paraqet funksionin themelor të kushtetutës, përderisa pamundësimi i pushtetit të tepërt në situatat e përgjithshme socio-politike në një vend, është funksioni kryesor politik i kushtetutës. Kushtetuta vendos kufijtë e pushtetit shtetëror dhe me këtë ndalon keqpërdorimet e tij, që do të mund të ndodhnin, po të mos ekzistonte një mjet i tillë.
14. Në fund, kushtetuta vendos siguri juridike dhe garanton liritë dhe të drejtat e individëve e të shoqërisë si dhe paraqet mjetin e legjitimitetit demokratik të pushtetit shtetëror. Me të sigurohet paqja dhe përparimi shoqëror, ajo paraqet simbolin e unitetit kombëtar dhe është simbol i unitetit, i integritetit.
15. Kur është fjala për **materien, gjegjësisht përmbajtjen e kushtetutës**, kushtetuta u referohet dy grupeve çështjesh: grupi i parë i çështjeve lidhet me pushtetin shtetëror, ndërsa grupi i dytë me shoqërinë dhe pjesëtarët e saj. Të dy grupet e çështjeve përbëjnë të ashtuquajturën materie kushtetuese (përmbajtjen e kushtetutës). Grupi i parë i çështjeve përfshin mënyra të ndryshme të formimit të pushtetit (zgjedhjen, vendosjen, ndarjen e pushtetit në organe të ndryshme

shtetërore, marrëdhëniet në mes organeve shtetërore, aktet që ata nxjerrin), kurse grupi i dytë i çështjeve përfshin parimet dhe institucionet përmes të cilave zhvillohet jeta ekonomike e politike në shoqëri, si dhe kartën e të drejtave dhe lirive të njeriut.

16. Kur është fjala për **kushtetutën në kuptimin formal**, duhet cekur se kjo kushtetutë bazohet në cilësi të ndryshme. Kushtetuta është, pra, akt juridik i cili rregullon çështjet bazë në bashkësinë politike, por ajo është, njëkohësisht, edhe ligji bazë, në bazë të të cilit nxirren ligjet si dhe aktet juridike më të ulëta se ajo. Për këtë arsye dallojmë **cilësitë juridike dhe jojuridike** të kushtetutës në kuptimin formal.

Cilësitë juridike të kushtetutës tregojnë se ajo është ligji bazë dhe akti më i lartë i përgjithshëm juridik.

Kushtetuta është ligji themelor në 4 kuptime:

1. Nxirret nga organi i posaçëm kushtetues ose nga organi i zakonshëm ligjvënës, por me procedurë më të komplikuar sesa procedura e zakonshme legjislativë,
2. Kushtetuta parasheh cili është organi ligjvënës dhe çfarë është procedura legjislativë,
3. Kushtetuta përmban rregullat më themelore (më abstrakte, më të rëndësishme) juridike nga ato që përmban ligji,
4. Ajo është akt i përgjithshëm juridik, pra, ligj i cili përfshin materien më të gjerë juridike të normuar (*materia constitutionis*).

Kushtetuta është akti i përgjithshëm juridik më i lartë (me të cilin duhet të përputhen të gjitha aktet e tjera juridike), pra akti juridik që rregullon çështjet bazë në komunitetin politik. Si e tillë, ajo garanton dhe mbron liritë dhe të drejtat e njeriut, rregullon organizimin e pushtetit¹¹ dhe kufizon pushtetin politik. Mu për këtë thuhet se kushtetuta është ligji themelor, në bazë të të cilit nxirren ligjet, si akti i përgjithshëm juridik më i rëndësishëm, ngase:

1. Nga ajo rrjedh sistemi juridik i vendit në tërësi,
2. Nga ajo kushtëzohet vlefshmëria e të gjitha dispozitave të tjera juridike,
3. Qëndron në krye të piramidës së akteve të përgjithshme juridike,
4. Është shprehje dhe vepër e pushtetit sovran ligjor,
5. Nxirret nga një bartës ligjërishtr sovran, juridikisht i lirë, që nuk ka kufizime ligjore (ky është një pushtet kushtetutëformues, pushtet origjinar dhe me të drejta të pakufizuara).

Pushteti kushtetutëformues është origjinar, pushtet me të drejta të pakufizuara në aspektin juridik. Kushtetuta është i vetmi akt juridik, i cili rregullon fuqinë e vet juridike. Megjithatë, ajo përcakton fuqinë juridike edhe për të tjerat akte të përgjithshme juridike. Për këtë arsye, fuqia më e madhe e kushtetutës ka edhe sanksionin e saj (heqjen e fuqisë juridike të të gjitha atyre akteve juridike, të cilat nuk janë në pajtim me kushtetutën).

¹¹ Organizata është kategori instrumentale, pra, formë e ndërmjetësimit mes parimit dhe praktikës. Për më shumë shih: Lukács, G., (1991), “*The Process of Democratization*”, State University of New York Press: New York, fq. 31. Këtë përkufizim Lukács e ndërlidh me arsyet e të qenit dhe rolin e partive politike si organizata, të cilat luftojnë për përvetësimin e pushtetit politik.

Cilësitë jojuridike të kushtetutës vënë në dukje faktin se ajo është akt ideologjiko-politik dhe programor-deklarativ.

Cilësitë jojuridike paraqiten për shkak të ndikimit të mendimeve filozofike dhe teorive e ideologjive politike. Për këtë arsye, kushtetuta është njëkohësisht edhe akt ideologjiko-politik, *edhe pse ajo, para së gjithash është akt juridik*. Përveç kësaj, edhe pse kushtetuta është në thelb tekst pozitiv-juridik, me të cilin përcaktohet rregullimi i tanishëm kushtetues (përmban norma kushtetuese të vlefshme), ajo është edhe program për të ardhmen. Ajo pritet të vlejë për një kohë të gjatë. Andaj thuhet se kushtetuta është akt programor-deklarativ. Dallojmë bilancet kushtetuese (që i përkushtohen së tashmes) dhe programet kushtetuese (i përkushtohen së ardhmes).

17. Kushtetuta e Republikës së Kosovës paraqet aktin më të lartë juridik të Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera ligjore duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me këtë Kushtetutë, ngase kjo, si edhe çdo kushtetutë tjetër, paraqet aktin më të lartë të përgjithshëm juridik të një vendi, pra, sistem drejtimi i cili vendos themelet e të gjitha rregulloreve si dhe parimet bazë të një shteti të pavarur. Kushtetuta përcakton parimet themelore politike, strukturën, procedurën, fuqinë dhe përgjegjësitë e institucioneve më të larta politike në vend. Duke shikuar historinë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duhet përmendur fakti se projekti i kësaj Kushtetute është përgatitur dhe kryer në prill 2008. Shumë nga nenet e projektit të kësaj Kushtetute të re ishin bazuar në Propozimin Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, i njohur si Plani i Marti Ahtisarit, i 26 marsit 2007, prandaj kjo Kushtetutë u garanton të drejta të posaçme komuniteteve pakicë dhe siguron mjedis të sigurt për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës është shpallur shtet i pavarur më 17 shkurt 2008, në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Deklarata e Pavarësisë është akt i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i pranuar njëzëri nga të gjithë 109 deputetët e pranishëm në Kuvend. Komisioni kushtetues ka miratuar tekstin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës më 2 prill 2008, kurse më 7 prill 2008 Kushtetutën e Republikës së Kosovës e ka nënshkruar Presidenti i Republikës së Kosovës. Teksti i Kushtetutës u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 9 prill 2008, ndërsa më 15 prill 2008 kjo Kushtetutë hyri plotësisht në fuqi, si akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës.
18. Para nënshkrimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kosova ishte nën administrimin në kuadër të Kornizës së përkohshme kushtetuese, në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të 10 qershorit 1999. Sipas asaj Rezolute, Përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara ishte pushteti më i lartë ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor në territorin e Kosovës.¹² Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ashtu si në

¹² Në periudhën kur Kosova ishte nën administrimin e Kombeve të Bashkuara, për më tepër shih: United Nations, *No Entry Without Strategy: Building the Rule of Law under UN Transitional Administration Paperback* (United Nations University Press: Tokyo, 2008) fq. 120-186; Weiss, G. Thomas, Forsythe, P. David, Coate, A. Roger, and Pease, Kelly-Kate. (2013), *“The United Nations and Changing World Politics”* Westview Press: United States, fq. 102-105.

secilën kushtetutë në përgjithësi, pjesa më e fuqishme dhe thelbësore është **pjesa normative**, d.m.th. pjesa që përbëhet nga normat juridike. Pa këtë pjesë nuk ka kushtetutë, ngase pa këtë kushtetuta nuk është kushtetutë. Normat juridike formulohen në nene, të cilat, sipas rregullit, rregullojnë një çështje konkrete. Këto nene rregullojnë çështje në lëmin e materies kushtetuese në mënyrë parimore dhe abstrakte, dhe, nëse kjo çështje shqyrtohet e rregullohet nga këndvështrime të ndryshme, atëherë neni përmban paragrafë, si norma të posaçme. Megjithatë, nëse në një nen numërohet¹³ diçka, atëherë ai nen ndahet në pika. Sipas tematikës, nenet grupohen në seksione dhe krerë, sa kohë që pjesët janë njësitë më të mëdha të sistematizimit të normave kushtetuese. Domethënë, pjesët përfshijnë seksionet ose krerët me nenet e tyre në atë lëmë tematik, dhe prej aty paraqesin fushat më të gjera të kushtetutës.¹⁴ Megjithatë, në secilën kushtetutë ekziston një tekst i cili u paraprin normave dhe nuk është i stilizuar në formë nenesh. Ai tekst paraprin vetë titullin e kushtetutës dhe dikcioni në të është më i lirë, mund të thuhet se është më oratorik dhe më solemn. Ajo është **preambula** ose, siç e thotë vetë emri i saj, parathënia e kushtetutës, hyrja e kushtetutës, e cila mund të formulohet në shumë mënyra. Përcaktimi i motivit për nxjerrjen e kushtetutës, qëllimi i rregullimit të ri kushtetues, përcaktimi i parimeve në të cilat bazohet gjithë rregullimi shtetëror, paraqitja e theksimeve politike nga historia e vendit e të tjera - paraqesin përmbajtjen e zakonshme të preambulës.

19. Kushtetutën e Republikës së Kosovës e nxori Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kjo Kushtetutë ka preambul të shkurtër dhe gjithsej 162 nene, të grupuara në 14 kapituj, të shënuar dhe posaçërisht të emëruar:

Kapitulli I	- Dispozitat themelore;
Kapitulli II	- Të drejtat dhe liritë themelore;
Kapitulli III	- Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre;
Kapitulli IV	- Kuvendi i Republikës së Kosovës;
Kapitulli V	- Presidenti i Republikës së Kosovës;
Kapitulli VI	- Qeveria e Republikës së Kosovës;
Kapitulli VII	- Sistemi i drejtësisë;
Kapitulli VIII	- Gjykata Kushtetuese;
Kapitulli IX	- Marrëdhëniet ekonomike;
Kapitulli X	- Qeverisja lokale dhe organizimi territorial;
Kapitulli XI	- Sektori i sigurisë;
Kapitulli XII	- Institucionet e pavarura;
Kapitulli XIII	- Dispozitat përfundimtare;
Kapitulli XIV	- Dispozitat kalimtare.

20. Kushtetuta Republikës së Kosovës fillon me preambul. Për natyrën juridike të preambulës, në përgjithësi në aktet kushtetuese, ekziston një kontest i vjetër, jetëgjatësia e të cilit vazhdon edhe në ditët e sotme. Sipas një këndvështrimi,

¹³ Për shembull, kompetencat e organit shtetëror dhe ngjashëm.

¹⁴ Pjesët kanë emërtimet e tyre, si p.sh. "dispozitat themelore", "rregullimi shoqëror", "organet e pushtetit" dhe ngjashëm.

preambula nuk duhet konsideruar si pjesë e Kushtetutës, ngase ajo nuk përmban norma kushtetuese dhe në fakt vetë titulli "Kushtetutë" vjen pas preambulës. Sipas këndvështrimit tjetër, preambula është, megjithatë, pjesë e Kushtetutës, meqë, edhe pse nuk përmban norma juridike, në të gjenden konstatime kushtetuese, të cilat nuk mund të ndahen nga tërësia e Kushtetutës, domethënë, të cilat janë juridikisht të mbrojtura, si i gjithë teksti kushtetues.

21. Preambula përmban, sipas rregullit, orientime ideologjike, të cilat me futjen në preambul - konstitucionalizohen. Ky konstitucionalizëm ofron bazë juridike për vënie të mëvonshme në jetë, që në shtetin ligjor kryhet përmes përpunimit legjislativ, i cili, në mes të tjerash, i nënshtrohet kontrollit kushtetueso-gjyqësor. Megjithatë, në preambul, manifestohet drejtpërsëdrejti marrëdhënia e drejtpërdrejtë në mes ideologjisë dhe së drejtës, madje, sipas mendimit tonë, kjo demanton tezën për "deideologjizim" të plotë të Kushtetutës. Analiza të afërta krahasuese do të tregojnë se kjo vlen për shumicën e kushtetutave moderne të botës.
22. Preambula është deklarata hyrëse ose parathënia e Kushtetutës. Nuk është e domosdoshme që Kushtetuta të përmbajë preambul dhe shumë kushtetuta të botës nuk e kanë këtë. Gjithashtu, është vështirë të përgjithësohet tema e preambulës, duke pasur parasysh llojllojshmërinë e natyrës së deklaratave hyrëse që përfshijnë ato. Megjithatë, mund të thuhet që shumica e preambulave janë kryesisht të shkurtra dhe shpesh, si rasti i Kushtetutës së Francës ose të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përmbajnë jo më shumë se një ose dy paragrafë hyrës. Zakonisht, preambula përmban tekst mjaft objektiv, i cili afirmon lojalitetin me parimet më të rëndësishme kushtetuese, dhe ky obligim, më së shpeshti ka të bëjë me të drejtat e njeriut. Përveç kësaj, në preambul përdoret një gjuhë që afirmon unitetin e shoqërisë¹⁵ së përçarë më parë.
23. Kosova nuk ishte e obliguar të përfshinte preambulën në Kushtetutën e saj të re. Megjithatë, me Planin e Ahtisarit është kërkuar që Kushtetuta të sigurojë kornizë për ndërtimin e shoqërisë së bashkuar multietnike, të bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut, ku mbrohen të drejtat e të gjitha komuniteteve. Preambula e Kushtetutës së Republikës së Kosovës thotë:

"Ne, Populli i Kosovës,

Të vendosur për të ndërtuar një ardhmëri të Kosovës si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës, i cili do të jetë atdhe i të gjithë qytetarëve të vet;

¹⁵ Për shembull, Kushtetuta e SHBA fillon me frazën e njohur: "Ne populli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me qëllim të formimit të një bashkësie më të përkryer..." Preambula e Kushtetutës së Bosnjë e Hercegovinës është shembull i mëvonshëm i shtetit postkonfliktuoz, që ka ngjashmëri të shumta me përvojën kosovare. Ajo proklamon paqen dhe bashkimin në paragrafin hyrës, ku thuhet si vijon: "Të bindur se institucionet demokratike të qeverisë dhe procedurat e rregullta më së miri i kontribuojnë ndërtimit të marrëdhënieve paqedashëse në shoqërinë pluraliste..."

Të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit;

*Të zotuar që Kosova të jetë shtet i mirëqenies ekonomike dhe i prosperitetit social;
Të sigurt që shteti i Kosovës do të kontribuojë në stabilitetin e rajonit dhe të mbarë Evropës, duke krijuar marrëdhënie të fqinjësisë dhe të bashkëpunimit të mirë me të gjitha shtetet fqinje;*

Të bindur që shteti i Kosovës do të jetë anëtar i denjë i familjes së shteteve paqedashëse në Botë;

*Me synimin që shteti i Kosovës të përfshihet në proceset integruese Euro-Atlantike;
Në mënyrë solemne, miratojmë Kushtetutën e Republikës së Kosovës".*

Kapitulli I: Dispozitat Themelore

Shqyrtime hyrëse

1. Me dispozita ose rregulla, nënkuptojmë urdhrat e karakterit të përgjithshëm. Ato janë norma të drejtuara një numri të madh personash dhe përmbahen vetëm në ligje. Meqë Kushtetuta është ligj, madje ligji themelor (me fuqinë më të madhe formale sesa cilido ligj tjetër), disa nga urdhrat dhe përcaktimet e saj quhen po ashtu dispozita. Kjo do të thotë se të gjitha dispozitat e natyrës së përgjithshme, të cilat janë cekur në Kapitullin I të kësaj Kushtetute, janë të përgjithshme, jo vetëm për shkak të rëndësisë së tyre (në atë kuptim të gjitha dispozitat e Kushtetutës janë të përgjithshme), por janë të përgjithshme edhe për shkak të përmbajtjes së tyre: nuk kanë të bëjnë vetëm me një çështje, nuk rregullojnë vetëm një marrëdhënie, siç është rasti me dispozitat në kapitujt e tjerë të Kushtetutës, por vendosin parimet bazë të rregullimit shtetëror dhe paraqesin shenjat e jashtme të qenies shtetërore.
2. Në Kapitullin e parë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me titullin "DISPOZITAT THEMELORE", janë gjithsej 20 nene. Disa nga këto dispozita janë, me të vërtetë themelore, ngase rregullojnë marrëdhëniet themelore nga të cilat rrjedhin të tjerat dispozita ose të cilat përcaktojnë qëndrimin e përgjithshëm, i cili operacionalizohet në përpunimin e mëtejshëm, por disa¹⁶ vështirë se do të mund të arsyetonin një cilësim të tillë - themelore. Atyre, me siguri, më shumë do t'u përshtatej, besojmë, termi po ashtu preciz - dispozita të përgjithshme.
3. Dispozitat themelore të Kushtetutës, si të tilla, nuk mund të shërbejnë të vetme si bazë për vendosje. Kjo domethënë se dispozitat themelore mund të përdoren si bazë vetëm bashkë me dispozita konkrete (operative) të Kushtetutës dhe jo si të vetme.

Neni 1 [Përkufizimi i Shtetit]

- (1) **Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm.**
- (2) **Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet. Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj.**
- (3) **Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti dhe nuk do të kërkojë të bashkohet me asnjë shtet ose pjesë të ndonjë shteti.**

¹⁶ Të tilla janë, për shembull, dispozitat për simbolet shtetërore dhe për kryeqytetin.

Neni 1

1. Kushtetuta fillon me dispozitën e cila definon Republikën e Kosovës, përcakton karakterin e saj, cek parimet bazë në të cilat mbështetet Kosova si komunitet politik dhe shtet kushtetues. Sipas formës së organizimit të pushtetit, Kosova është republikë, dhe këtë e thekson në mënyrë eksplicite neni 1 i Kushtetutës.
2. Në paragrafin e parë të këtij neni theksohet se Republika e Kosovës është e pavarur. Kosova ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008. Në bazë të Rezolutës 1244 të KB, ishte nën administrimin e Kombeve të Bashkuara (KB) që nga viti 1999. Ajo Rezolutë ka urdhëruar administratën e KB që të promovojë krijimin e "autonomisë dhe vetëqeverisjes përmbajtjesore" për Kosovën, deri në "marrëveshjen përfundimtare", në bazë të negociatave të të dy palëve. Pas 17 shkurtit 2008, kur Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë e vendit, Kosova ka nisur fushatën për njohje ndërkombëtare nga ana e të gjitha shteteve si dhe vendosjen e marrëdhënieve bilaterale me shtetet që e kanë njohur Kosovën.
3. Këtu duhet theksuar se shtet sovran është secili shtet me territor të caktuar, i cili ka sovranitet të brendshëm e të jashtëm, popullsi të përhershme, qeveri, pavarësi nga shtetet e tjera dhe mundësi të hyrjes në marrëdhënie ndërkombëtare me shtete të tjera sovrane. Vetëm shteti, në raport me të tjerët, posedon pushtetin sovran, që do të thotë se vetëm shteti ka supremacinë ndaj pushteteve të tjera ndaj popullsisë së caktuar në territor të caktuar, dhe se në këtë mënyrë, ai nuk i nënshtrohet asnjë pushteti tjetër. Me zbërthimin e termit sovranitet, arrihet në përfundimin se ai përfshin tri elemente: 1) sovraniteti i jashtëm - nënkupton pavarësinë e pushtetit shtetëror në raport me shtetet e tjera, kështu që pushteti shtetëror, me rastin e nxjerrjes së vendimeve të tyre, është juridikisht i lirë nga çfarëdo ndërhyrje e jashtme (sovraniteti si pavarësi); 2) sovraniteti i brendshëm - përfshin supremacinë e pushtetit shtetëror në raport me të gjitha pushtetet e tjera dhe institucionet në territorin e vet (sovraniteti si supremaci); 3) sovraniteti sintetik - pasojë logjike e lidhjes së dy elementeve paraprake, nga të cilat rrjedh moskufizimi juridik i pushtetit shtetëror, që do të thotë se pushteti shtetëror mund të përcaktojë normat juridike sipas zgjedhjes së vet, pa ndonjë kufizim të jashtëm ose të brendshëm.
4. Shoqëria demokratike kërkon lirinë e njëjtë për të gjithë qytetarët, dhe kjo është kërkesë e përhershme e demokracisë. Secili pushtet, dhe sidomos ai shtetëror, duhet t'i shërbejë, para së gjithash, realizimit të idesë së barazisë së të gjithë qytetarëve para ligjit, sigurimit të mundësisë dhe dhënies së mundësisë për të gjithë pjesëtarët e shoqërisë që të jetojnë një jetë të lirë që e bën njeriun të dinjitetshëm.¹⁷
5. Shteti i së drejtës, si domosdoshmëri e ndërtimit dhe ekzistimit të secilës shoqëri demokratike, para së gjithash, paraqet kufizimin e shtetit dhe depersonalizimin e

¹⁷ Për të drejtën e gëzimit të lirisë, ushtrimin e drejtësisë dhe barazisë para ligjit, shihni më gjerësisht në: Glintić, T., (1995), "Pravda, sloboda, jednakost: Rols i Valcer", Beogradski centar: Beograd,

funksiioneve shtetërore dhe të atyre publike në shoqëri. Kjo do të thotë se në një shtet të tillë nuk sundon individi ose grupi, po sundon e drejta dhe të gjithë janë të detyruar t'i nënshtrohen atij sundimi. Natyrisht, ky është ideali i secilit shtet demokratik dhe i aktit të tij më të lartë - Kushtetutës, e cila, me dispozitat e saj, më së shpeshti parashihet dhe garanton shtetin¹⁸ e së drejtës. A realizohet kjo në jetën reale, është çështje në vete, ngase shpesh ndodh që në numrin më të madh të të ashtuquajturave shtete "demokratike", shkaktohen diskrepanca dhe mospërputhje në mes normatives dhe reales. Diçka tjetër parashihet me Kushtetutë e ligje, e diçka tjetër ndodh në jetën reale.

Neni 1.1

1. Paragrafi 1 i nenit 1 përcakton, po ashtu, se Republika e Kosovës është shtet unik, ndërsa, kur është fjala për një shtet të tillë, duhet thënë se dallojmë shtetin unik të thjeshtë dhe shtetin unik të ndërlikuar. Kriteri i ndarjes është ai nëse brenda një shteti ekziston një apo ekzistojnë më shumë organizime shtetërore. Kështu, sipas shkallës së centralizimit, **shteti unik i thjeshtë** mund të jetë: 1) qendror - gjithë pushteti shtetëror është i përqendruar në një apo më shumë organe qendrore, 2) i centralizuar - organet joqendrore ushtrojnë punë shtetërore në varësi të plotë nga organet qendrore, 3) i decentralizuar - organet joqendrore ushtrojnë disa punë shtetërore pavarësisht, në raport me organet qendrore. **Shtet unik i ndërlikuar** mund të jetë: 1) rajonal - i përbërë nga organe politikisht dhe territorialisht të decentralizuara, të cilat kanë pushtet të konsiderueshëm politik, 2) federatë - shteti federativ, në të cilin nuk ekziston e drejta e shfuqizimit dhe e drejta e recesionit. Për vetë faktin që Kushtetuta qysh në fillim përcakton se Republika e Kosovës është unike (neni 1 paragrafi 1), rrjedh se rendi juridik i këtij shteti është unik dhe se parimi i unitetit të rendit juridik paraqet njërin nga elementet që e përbëjnë përmbajtjen e parimit të sundimit të ligjit në kuptimin e tij juridik.
2. Cilësia e fundit dhe shumë e rëndësishme e këtij paragrafi ka të bëjë me pandashmërinë e shtetit. Kjo cilësi e këtij paragrafi të Kushtetutës përcakton edhe parimin e pacenueshmërisë së kufirit, dhe vendos edhe themelet për rregullimin dhe procedurën, sipas së cilës vendoset për ndryshimet eventuale të kufijve të Republikës së Kosovës, për çfarë nevojitet shumica e kualifikuar e dy të tretave (2/3) të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, çfarë rregullohet me nenin 18, paragrafi 1, pika 1 e Kushtetutës (Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me çështjet e territorit, paqes, federatës, si dhe me ato politike e ushtarake). Kushtetuta e Republikës së Kosovës me këtë dispozitë thekson se cilado pjesë e territorit të Kosovës është pjesë përbërëse dhe e pandashme e rendit unik dhe të pandashëm kushtetues e juridik të Republikës së Kosovës, dhe se të gjitha institucionet politike janë të obliguara të zbatojnë Kushtetutën dhe ligjet, si dhe të respektojnë gjithë rendin juridik, i cili vlen në këtë territor. Ky obligim vlen

¹⁸ Për supremacinë e Kushtetutës dhe rëndësinë e saj, si akti më i lartë, më i përgjithshëm dhe më i rëndësishëm juridik, i cili gjendet në krye të hierarkisë (piramidës) së të gjitha akteve, shih më gjerësisht në: Štark, K., (1988), "Istorijski razvoj i aktuelni značaj supremacije ustava", *Anali Pravnog fakulteta u Beogradu*, br. 5, fq. 497.

edhe për të gjitha institucionet dhe organet shtetërore të Republikës së Kosovës, të përcaktuara me Kushtetutë, të cilat kanë për obligim të ndërmarrin të gjitha aktet kushtetuese e ligjore dhe masat, me të cilat sigurohet dhe mundësohet uniteti dhe pandashmëria, e cekur më sipër, e Republikës së Kosovës.

Neni 1.2

1. Në paragrafin 2 Kushtetuta përcakton se Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të vet, kurse në nenin 3, paragrafi 1, se parimi i shtetit qytetar e jo atij kombëtar, është, në themel, përkufizimi kushtetues i Kosovës. Në këtë mënyrë Kosova përcaktohet si shtet qytetar. Në lidhje me paragrafin 1 të nenit 3, Kosova, përveçe është shtet qytetar, është edhe shtet i një shoqërie multietnike, e cila përbëhet nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera. Kjo do të thotë se Kosova është shtet multietnik, ngase ajo nuk është vetëm shtet i shqiptarëve, por edhe i gjithë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Domethënë, kjo dispozitë përcakton cilësinë e shtetit qytetar në Kosovë, që është qytetaria. Kjo qytetari në rend të parë përcaktohet me shtetësi, siç parashihet qartë në këtë pikë, por edhe lidhjet e tjera juridike të qytetarëve me autoritetin publik.
2. Shtetësia¹⁹ është marrëdhënie e veçantë juridike, e karakterit të qëndrueshëm, që ekziston në mes të shtetit dhe individit (gjegjesisht qytetarit të saj).²⁰ E drejta për shtetësi²¹ është parakusht i domosdoshëm për gëzimin e të drejtave dhe lirive qytetare. Megjithatë, si parakusht i fitimit të të drejtave qytetare, shtetësia është kusht i lejueshëm i devijimit nga parimi se të gjithë njerëzit janë të barabartë në të drejta. Në bazë të ekzistimit të shtetësisë, si marrëdhënie e veçantë juridike (e veçantë për arsye se kjo është një marrëdhënie në mes të personit fizik dhe shtetit sovran), krijohen disa të drejta, po edhe obligime, si për shtetin ashtu edhe për individin. Gjegjesisht, secili shtet përcakton rregullat e tij, me të cilat rregullon çështjet e shtetësisë, veçanërisht ato nga të cilat varet se cilët persona dhe sipas cilave kushte do t'i konsiderojë shtetas të vet, respektivisht, sipas cilave kushte disa persona pushojnë së qeni shtetas të tij. Kështu edhe Konventa Evropiane për shtetësinë, e viti 1997 (neni 3), parasheh se secili shtet me legjisllacionin e vet përcakton se cilët janë shtetasit e tij. Sipas dispozitave të nenit 3 të Ligjit për shtetësinë e Kosovës, parashihet e ashtuquajtura shtetësi e shumëfishtë, që do të thotë se, sipas këtij Ligji, "shtetasi i Kosovës mund të jetë edhe shtetas i një apo më shumë shteteve të tjera", ndërsa fitimi dhe mbajtja e shtetësisë tjetër nuk rezulton me humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës.
3. Në pjesën e dytë të dispozitës kushtetuese të përfshirë në paragrafin 2 të nenit 1 të Kushtetutës, parashihet se autoriteti i Republikës së Kosovës bazohet në

¹⁹ Më gjerësisht për shtetësinë shih në: Hasanbegović, J., (1995), "Državljanstvo kao pravo čoveka", *Jugoslavenska Revija za Medjunardno Pravo*, nr. 1-3, fq. 203-222.

²⁰ Bosnić, P., (1988), "O državljanstvu u jugoslovenskom pravu i međunarodnim ugovorima", *Zbornik radova Pravnog fakulteta u Splitu*, Vol. 25, fq. 35-48.

²¹ Čok, V., (1995), "Pravo na državljanstvo - uticaj Ujedinjenih nacija na njegov razvoj", *Jugoslavenska Revija za Medjunardno Pravo*, nr. 1-3, fq. 188-202.

respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të saj dhe gjithë individëve brenda kufijve të saj. Këtë dispozitë e konfirmon edhe neni 21, i cili përcakton parimet e përgjithshme, që gjenden në kuadër të Kapitullit II ("të drejtat dhe liritë themelore"). Përkatësisht, paragrafi 2 i këtij neni përcakton se Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të parapara me këtë Kushtetutë, dhe se të gjithë janë të obliguar që të respektojnë të drejtat dhe liritë elementare të të tjerëve (paragrafi 3). Kjo dispozitë është shumë e rëndësishme për faktin se në mes të krijimit të të drejtave dhe realizimit të tyre, duhet të ekzistojë korrelacion i ndërsjellë, pra, nuk mund të ekzistojnë njëra pa tjetrën. Domethënë, nëse qytetarëve në një territor të caktuar, me aktin më të lartë juridik, pra, me Kushtetutë dhe me ligje, u caktohen liri të caktuara, porse nuk është paraparë dhe rregulluar mënyra e mbrojtjes së tyre, - atëherë ato dispozita kushtetuese dhe ligjore mbeten vetëm shkronjë në letër. Po ashtu, është shumë e rëndësishme që të drejtave dhe lirive të garantuara, nga njëra anë, t'u përgjigjen detyrimeve të respektimit të tyre, nga të gjithë të tjerët, në anën tjetër, dhe për çdo mospërfillje eventuale të këtyre detyrimeve, shkelësit bartin sanksione të caktuara. Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh mu këtë në dispozitat e saj, duke ua lënë ligjeve konkretizimin e dispozitave të veta, të cilat janë caktuar në mënyrën më abstrakte dhe më të përgjithshme.

Neni 1.3

1. Ajo që është shumë e rëndësishme për ruajtjen e paqes në botë, e veçanërisht në rajonin e Ballkanit, është fakti i paraparë me paragrafin 3 të nenit 1, i cili parasheh se Republika e Kosovës nuk ka kurrfarë pretendimesh territoriale ndaj asnjë shteti ose pjese të ndonjë shteti, dhe as nuk do të kërkojë të bashkohet me ndonjë shtet ose me pjesë të ndonjë shteti. Secili pretendim territorial ndaj cilitdo shtet ose pjese të tij, krijon jostabilitet dhe tensionim në rajon e më gjerë në botë, çka përbën kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.

Neni 2 [Sovraniteti]

- (1) **Sovraniteti i Republikës së Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.**
- (2) **Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.**
- (3) **Republika e Kosovës, me qëllim të ruajtjes së paqes dhe mbrojtjes së interesave shtetërore, mund të marrë pjesë në sisteme të sigurisë ndërkombëtare.**

Neni 2

1. Sovraniteti i shtetit, si nocion që fitohet kur të krahasojmë shtetin me institucionet e tjera, e që paraqet raportin e shtetit ndaj atyre institucioneve.²² Nocioni sovranitet përfshin tri elemente:²³
 - 1) **Elementi i jashtëm** (shprehet si pavarësi e pushtetit shtetëror) - nënkupton pavarësinë e pushtetit shtetëror në raport me shtetet e tjera, që do të thotë se pushteti shtetëror me rastin e marrjes së vendimeve të veta, juridikisht është i lirë nga çfarëdo implikimi i jashtëm (thënë juridikisht, kjo do të thotë se ai nuk obligohet t'u bindet urdhrave të cilat do autoritet të jashtëm, që ndodhet jashtë territorit shtetëror);
 - 2) **Elementi i brendshëm** (shprehet si supremaci e pushtetit shtetëror) - përfshin supremacinë e pushtetit shtetëror në raport me gjithë pushtetet dhe institucionet në territorin e tij (pushteti shtetëror është sovran nëse vendos për kushtet sipas të cilave ekzistojnë dhe për mënyrat sipas të cilave funksionojnë subjektet dhe organizatat në territorin e tij);
 - 3) **Elementi sintetik** (pasojë logjike e lidhjes së këtyre dy elementeve paraprake) - nënkupton moskufizimin juridik të pushtetit shtetëror, që do të thotë se pushteti shtetëror mund të përcaktojë norma ligjore sipas zgjedhjes së vet, pa kurrfarë kufizimesh të jashtme a të brendshme (pushteti shtetëror, i cili krijon rendin juridik, është sovran, ngase rregullon vetë rendin e tij juridik).
2. Supremacia e lartpërmendur e pushtetit shtetëror nuk është vetëm parim abstrakt, porse konkretizohet në një varg aktesh tipike, përmes të cilave jepen dhe përmbahen urdhrat dhe shprehet supremacia. Akte të tilla, të cilat i nxjerrin organet që janë pjesë e aparatit shtetëror, janë: ligji, akti juridik dhe aktgjykimi. Megjithatë, përderisa çështja e sovranitetit të shtetit, siç e thamë edhe më lart, lidhet me krahasimin dhe raportin e shtetit me institucionet e tjera politike, ndërkaq, çështja e sovranitetit të popullit lidhet me bartësin, pronarin e sovranitetit në shtet. Sovraniteti i popullit është vetëm një nga përgjigjet që marrim për pyetjen prej kujt, në fund të fundit, rrjedh pushteti (sovraniteti) më i lartë. Sovraniteti i shtetit (pushtetit shtetëror) është cilësi e shtetit dhe, si i tillë, është plotësisht i ndarë çështja e selisë së sovranitetit në kuadër të shtetit, kujt i është besuar ushtrimi i funksioneve më të larta shtetërore, pra kush është titullar i tyre.

Neni 2.1

1. Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kur është fjala për sovranitetin dhe përkatësinë e tij, është pranuar qasja e teorisë për marrëveshjen shoqërore, çka

²² Një analizë mjaft interesante për këtë mund të gjendet në: Krasner D. Stephen (1999), "Sovereignty", Princeton University Press: Princeton; Jackson, Robert Sovereignty (2007) "The Evolution of an Idea", Polity Press: Cambridge; Diehl F. Paul (ed.), (2010), "The Politics of Global Governance: International Organizations in an Interdependent World", Lynne Rienner Publishers: Boulder, Colorado,

²³ Goodhard, A.L., (1959), 'The Rule of Law and Absolute Sovereignty', *Anales de la Faculte de Droit D' Istanbul*, (Istanbul) No. 12., fq. 259-284.

shihet nga fakti se parimi i sovranitetit të popullit, i bazuar në qytetari, rregullohet qysh në fillim të Kushtetutës (Kapitulli I, neni 2, paragrafi 1), që tregon se ky parim konsiderohet si një nga parimet bazë (themelore) të sistemit kushtetues. Në paragrafin fillestar përveçqë "sovraniteti i shtetit të Kosovës buron nga popullsia",²⁴ përcaktohen më hollësisht format e realizimit praktik të parimit të sovranitetit të popullit. Vendimmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve, pra, ushtrimi i pushtetit, është një formë e realizimit të sovranitetit të popullit. Kushtetuta thekson në mënyrë eksplicite se sovraniteti i takon popullit dhe se, në përputhshmëri me dispozitat kushtetuese, ky zbatohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur ose në forma²⁵ të tjera.

2. Dispozita kushtetuese e cila parasheh se sovraniteti i shtetit të Kosovës ushtrohet përmes përfaqësuesve të zgjedhur, tregon se, përveç formave të drejtpërdrejta të vendimmarrjes, parimi i sovranitetit të qytetarëve realizohet edhe në formën e sistemit përfaqësues të qeverisjes. Kjo do të thotë se ky parim ushtrohet përmes përfaqësuesve të cilët zgjidhen drejtpërdrejt nga qytetarët në zgjedhjet e lira, demokratike dhe të drejtpërdrejta.
3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duke paraparë se sovraniteti i takon popullit të Kosovës dhe se ushtrohet "nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur ose në forma tjera", nuk përmend në mënyrë eksplicite se cilat janë ato forma të ushtrimit të sovranitetit nga populli përveç referendumit (në versionin shqip). Megjithatë, me shikimin e kushtetutshmërisë krahasimtare, mund të thuhet se, siç kemi cekur më lart, ato janë më së shpeshti, përfaqësuesit e zgjedhur lirisht, referendumi dhe iniciativa qytetare. Pra, referendumi karakterizohet nga fakti se qytetarët kanë mundësinë që të ndikojnë dukshëm nëse do të miratohet apo jo ndonjë vendim i caktuar. Referendumi është institucion politik, gjegjësisht institucioni përmes të cilit trupi zgjedhor shpreh vështrimet e veta me votim të drejtpërdrejtë, pra, vullnetin e vet ndaj masave që tashmë ka ndërmarrë ose që ka ndërmend t'i ndërmarrë ndonjë pushtet. Ai, si i tillë, paraqet sqarimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve për dy alternativa të ofruara ("PËR" ose "KUNDËR"). Ajo çfarë është karakteristike për referendumin, është se ai zbatohet shumë rrallë, ndërsa akti i miratuar në të ka po të njëjtën fuqi juridike, si edhe akti përkatës i miratuar në parlament. Megjithatë, duhet theksuar se ai akt i miratuar në referendum, mund të ndryshohet apo të shfuqizohet vetëm ashtu siç është nxjerrë, pra, me votim të drejtpërdrejtë, e jo me vendimin e parlamentit. Sipas Kushtetutës së Republikës së

²⁴ I njëjti paragraf në gjuhën shqipe përdor shprehjen "popull", ngjashëm me versionin në anglisht, në vend të "popullsisë".

²⁵ Në versionin në gjuhën shqipe, mes fjalëve "përfaqësuesve të zgjedhur" ose "formave të tjera", ekziston edhe shprehja "referendum", që do të thotë se edhe referendumi njihet si mënyrë e ushtrimit të sovranitetit të shtetit të Kosovës. Në versionin në gjuhën shqipe fjala "referendum" përmendet edhe në dispozitat vijuese të Kushtetutës: n. 2.1; n. 65.3; n. 81.2; n. 113.3 (2); dhe n. 139.1. Në versionin në gjuhën serbe nuk përdoret shprehja "referendum" përveç në nenin 1, i cili edhe po komentohet këtu. Duhet cekur se tani për tani nuk ka asnjë ligj për referendumin, me të cilin do të rregullohej më hollësisht mënyra edhe procedura e zbatimit të referendumin si një mënyrë e ushtrimit të vullnetit të qytetarëve të Kosovës.

Kosovës (neni 65, pika 3) Kuvendi i Republikës së Kosovës "shpall referendum, në pajtim me ligjin", kurse neni 81, paragrafi 2, parasheh që asnjë nga ligjet me interes vital nuk mund t'i nënshtrohet referendumi.

4. Në bazë të disa vlerësimeve të ndryshme, referendumi mund të klasifikohet kështu:
- Sipas **lëndës**, dallojmë: 1) kushtetutëformues; 2) ligjvënës; 3) administrativ; 4) financiar; 5) referendum në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe në të drejtën ndërkombëtare.
 - Sipas **kohës së zbatimit**, dallojmë: 1) paraprak; 2) pasues.
 - Sipas **efektit** dallojmë: 1) konstitutiv; 2) abrogativ (shfuqizues).
 - Nga pikëpamja e **bazës juridike**, dallojmë: 1) detyrues; 2) fakultativ.
 - Nga pikëpamja e **detyrueshmërisë së vendimit të nxjerrë me referendum**, dallojmë: 1) të detyrueshëm; 2) këshillëdhënës.

Dallojmë edhe **referendumin arbitrar**, i cili ndodh kur një organ i posaçëm shtetëror, më së shpeshti kreu i shtetit, dërgon në arbitrazh kontestin i cili ka ndodhur në mes tij dhe parlamentit, gjegjësisht në mes dhomave të parlamentit.

5. Përveç faktit se me dispozitat kushtetuese të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk është cekur cilat janë "format e tjera" të ushtrimit të sovranitetit (përveç referendumi në versionin shqip), nuk është cekur as për cilat çështje është e obligueshme të vendoset me referendum, si dhe cilat janë çështjet që nuk mund të jenë fare subjekt i vendimmarrjes me referendum. Duke vështruar kushtetutshmërinë krahasimtare, më së shpeshti, me Kushtetutë në mënyrë eksplicite përjashtohet mundësia e të qenit subjekt referendumi çështjet në vijim:

- 1) Detyrimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare;
- 2) Ligjet që rregullojnë të drejtat dhe liritë e njerëzve dhe pakicave;
- 3) Ligjet për taksa dhe financa;
- 4) Buxheti dhe deklarata financiare;
- 5) Vendimi për shpalljen e vënies së masës së jashtëzakonshme;
- 6) Vendimi për amnisti;
- 7) Çështjet në fushën e kompetencave zgjedhore të Kuvendit dhe të ngjashme.

6. Formë tjetër e ushtrimit të sovranitetit të popullit, e cila mund të zbatohet edhe në Republikën e Kosovës, është iniciativa qytetare, e cila paraqet një formë të vendimmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve. Për këtë formë është karakteristike se qytetarët, duke shfrytëzuar instrumentet e iniciativës popullore që i kanë në dispozicion, iniciojnë vetë vendimmarrjen (iniciojnë vendimmarrje ose paraqesin propozim formal për fillimin e procedurës së vendimmarrjes). Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk përmban dispozitën e përgjithshme për iniciativën popullore, dhe as nuk rregullon në mënyrë të posaçme disa forma të iniciativës popullore. Nga një vështrim i hollësishëm i kushtetutshmërisë krahasimtare, mund të thuhet se forma të caktuara të iniciativës popullore, që përmbushin kushtet formale dhe të tjera për fillimin e procedurës së vendimmarrjes, janë:

- 1) Iniciativa ligjvënëse (e drejta e qytetarëve për të propozuar ligje);
- 2) Iniciativa kushtetuese (e drejta e qytetarëve për të propozuar revizionin e Kushtetutës);

- 3) Kërkesa për mbajtjen e referendumit (e drejta e qytetarëve për të kërkuar mbajtjen e referendumit, që është në kompetencë të Kuvendit) dhe të tjera.
7. Ajo që është e rëndësishme të thuhet për iniciativën popullore, është fakti se kjo paraqet autorizim të një pjese të caktuar të elektoratit për të nisur procedurën për ndryshimin e Kushtetutës ose për nxjerrjen e ligjit formal. Pra, kjo u mundëson zgjedhësve që të sigurojnë ndonjë ligj që e konsiderojnë më të favorshëm. Më oportune, madje edhe nëse parlamenti është kundër ose e kundërshton, është interesante të ceket edhe ndryshimi në mes iniciativës popullore dhe referendumit, ngase referendumi popullit i garanton se nuk do t'u nënshtrohet ligjeve që nuk i duan, kurse iniciativa popullore i mundëson popullit të sigurojë ligjet që i do. Gjithashtu, referendumi do të thotë pjesëmarrje e qytetarëve në nxjerrjen e ndonjë akti, kurse iniciativa popullore paraqet pjesëmarrje të qytetarëve për propozimin dhe nxjerrjen e ndonjë akti. E përbashkëta e referendumit dhe iniciativës qëndron në faktin se, qytetarët nuk marrin pjesë në seancë (këtë e kanë të mundur vetëm deputetët e kuvendit).

Neni 2.2

1. Sovraniteti i qytetarëve dhe format në të cilat qytetarët mund të shprehin lirshëm qëndrimin e tyre ndaj pushtetit (me ushtrimin e drejtpërdrejtë të pushtetit ose me zgjedhjen e lirë të përfaqësuesve të tyre), përbëjnë vlerat themelore të secilit rend kushtetues, çfarë parashihet edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ndonëse shumë organizata posedojnë territor dhe popullsi, ato megjithëkëtë nuk paraqesin shtete, ngase u mungon elementi i tretë, elementi konstitutiv, që është sovraniteti. Sovraniteti²⁶ është *differentia specifica* më e lartë, absolute dhe e pandashme e një shteti në raport me organizatat²⁷ e tjera.
2. Në të vërtetë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbron këtë vlerë dhe në mënyrë eksplicite parashihet që sovraniteti (si dhe integriteti) i Republikës së Kosovës është "i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm" dhe se e mbron me të gjitha mjetet e përcaktuara me vetë Kushtetutën dhe me ligj (neni 2, paragrafi 2, i Kushtetutës). **Pacenueshmëria** e sovranitetit dhe integritetit të Republikës së Kosovës, nënkupton se asnjë organ tjetër shtetëror, organizatë politike, grup dhe as individ, nuk mund të përvetësojë, pra, të cenojë apo shkelë sovranitetin e popullsisë (qytetarëve), as të vendosë pushtetin kundër vullnetit të shprehur lirshëm të qytetarëve. Gjithashtu, këto dy elemente të rëndësishme të shtetësisë, nuk mund të kontestohen nga askush. **Mostjetërsimi** i sovranitetit dhe integritetit të Republikës së Kosovës²⁸ nënkupton se sovraniteti, si vullnet i përgjithshëm i

²⁶ Krahaso: Goldsworthy, J., (1999). "The Sovereignty of Parliament: History and Philosophy", Oxford University Press: Oxford,

²⁷ Kështu p.sh, Bashkimi Evropian nuk është shtet, ngase atij i mungon ky element, edhe pse ai posedon ingerenca të caktuara, të cilat na kujtojnë themelimin e ndonjë pushteti të ri suprem në truallin evropian.

²⁸ Sovraniteti dhe tërësia territoriale (integriteti) janë nga të mirat më të mëdha shtetërore, të cilat fitojnë gjithnjë e më shumë njohje ndërkombëtare-juridike dhe mbrojtje. Kjo nënkuptohet,

popullit, dhe integriteti, si tërësi territoriale, nuk mund të barten as të përfaqësohen, dhe as të mos pushojë së ekzistuari vullneti i përgjithshëm i popullit si i tillë (kjo është e një rëndësie të veçantë, pasi populli ka mundësinë e ndryshimit të formës së pushtetit). **Pandashmëria** e këtyre dy vlerave nënkupton se ato janë unike dhe të pandashme, pra, të pandashme madje si ndërmjet vetes, pra nga njëra-tjetra, ashtu edhe në raport me vetë Republikën e Kosovës, duke pasur parasysh se pushteti është vullnet, e vullneti nuk mund të ndahet, prandaj sovraniteti dhe integriteti duhen mbrojtur me të gjitha mjetet e parapara me këtë Kushtetutë dhe me ligjet përkatëse.

Neni 2.3

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 2, paragrafi 3, parasheh se mbrojtja e paqes dhe interesave shtetërore janë qëllimi i vetë shtetit dhe se, kështu, ai mund të marrë pjesë në sistemin e sigurisë ndërkombëtare. Siguria ndërkombëtare përbëhet nga masat e ndërmarra nga shtetet dhe organizatat ndërkombëtare (siç janë, p.sh, Kombet e Bashkuara, NATO etj.), për të siguruar mbijetesën dhe sigurinë në botë. Këto masa përfshijnë veprimet ushtarake dhe marrëveshjet diplomatike, traktatet dhe konventat. Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore, u paraqit një lëndë e re studimi, e cila u përqendrua në sigurinë ndërkombëtare, si qendër e marrëdhënieve ndërkombëtare. Meqenëse nuk ka përkufizim universal për sigurinë ndërkombëtare, përmbajtja e këtij përkufizimi u zgjerua gjatë viteve të kaluara, kështu që sot përfshin çështje të ndryshme botërore të ndërlidhura, të cilat kanë ndikim në mbijetesën e njeriut dhe në sigurinë e tij. Ai përmban në vete mënyra të ndryshme të arritjes së fuqisë ushtarake, shkaqet dhe pasojat e luftërave në mes shteteve, fuqinë ekonomike, etnike, konfliktet fetare dhe ideologjike, furnizimin me energji, shkencën dhe teknologjinë, si dhe kërcënimet ndaj sigurisë dhe stabilitetit të shteteve nga degradimi i mjedisit jetësor, sëmundje ngjitëse, ndryshime klimatike e të tjera. Duke pasur parasysh rëndësinë e ruajtjes së paqes në botë si dhe të interesave shtetërore, Republika e Kosovës mund të marrë pjesë edhe në sistemin e përgjithshëm të ruajtjes dhe mbrojtjes së sigurisë ndërkombëtare, e cila, për shkak të globalizimit, rritjes së terrorizmit ndërkombëtar, interesit të Fuqive të Mëdha, krizës ekonomike botërore, mungesës së ushqimit dhe ujit, ndryshimeve klimatike dhe katastrofës së mundshme ekologjike, në ditët e sotme rrezikohet më shumë se kurrë.

nëse kemi parasysh se territori dhe pushteti sovran janë elemente të rëndësishme të shtetit. Edhe pse në fillim janë kuptuar si shenjime të rëndësishme për njohjen e shteteve, ato njëkohësisht janë kuptuar edhe si shenjime themelore pa të cilat nuk ka shtet. Kjo nënkupton se ato janë të lidhura pandashmërisht me shtetin dhe se me të krijohen, e, nëse zhduken, me to zhduket edhe shteti. Për këtë arsye, në të drejtën ndërkombëtare është krijuar me kujdes kuptimi për të drejtën e sovranitetit, si një nga të drejtat themelore dhe të patjetërsueshme të shtetit.

Neni 3 [Barazia para Ligjit]

- (1) Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.
- (2) Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

Neni 3

1. Klasifikimi i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarëve (përfshirë edhe ndarjen e tyre në të drejta individuale, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore),²⁹ kanë një shtrirje të kufizuar. Në të vërtetë, nuk mund të klasifikohen të gjitha të drejtat, gjegjësisht disa të drejta, në ndonjë grup të caktuar në varësi nga efekti, nuk mund të përfshihen në dy a më shumë kategori. I tillë është rasti, para së gjithash, me barazinë e qytetarëve (si dhe me të drejtën e shtetësisë). Përveç kësaj, parimi i barazisë³⁰ është parimi bazë i rendit shtetëror-juridik, pra, themeli në të cilin bazohet dhe ndërtohet ai, si dhe e drejtë themelore e qytetarëve e garantuar me Kushtetutë. Kështu, qysh në Deklaratën e Pavarësisë Amerikane, të vitit 1776, dokument i karakterit kushtetues, qe përfshirë edhe ky parim dhe qe formuluar me fjalët " të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë...". Ky parim, u konfirmua më pastaj në Deklaratën Franceze të të Drejtave të njeriut dhe Qytetarëve të vitit 1789, me fjalët: "Njerëzit lindin dhe mbesin të lirë dhe të barabartë në të drejta". Që atëherë e sot barazia e qytetarëve është parim juridik i pakontestueshëm, formalisht i njohur në të gjitha deklaratat, në tekstet kushtetuese dhe në dokumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.
2. Barazia e qytetarëve manifestohet, në kuptimin formalo-juridik, si barazia para ligjit dhe barazia para gjykatës, pra, si parim i mosdiskriminimit ose ndalim i diskriminimit në mes njerëzve. Askush nuk mund të diskriminohet në kuptimin e gëzimit të të drejtave e lirive dhe secili duhet të gëzojë mbrojtje të njëjtë gjyqësore me kushte të njëjta, pa marrë parasysh dallimet në mes njerëzve.³¹ Ligji duhet të jetë i njëjtë për të gjithë, qoftë për t'i mbrojtur a për t'i dënuar, çfarë kishte paraparë cekur edhe Deklarata Franceze e të Drejtave e vitit 1789. Natyrisht, këtu

²⁹ Krahaso: Türk, D., (1989), "Neka aktuelna pitanja ostvarivanja ekonomskih, socijalnih i kulturnih prava čoveka u svetlu rasprava u organima UN", *Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu*, nr. 5-6. (Supplement), fq. 691-696.

³⁰ Krbek, I., (1961), "Dva djela Gerharda Leibhoza: Jednakost pred zakonom i bistvo reprezentacije", *Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu*, nr. 2, fq. 127-129.

³¹ Shihni për shembull: Vukas, B., (1971), "Zabrana rasne diskriminacije po općim aktima o pravima čoveka usvojenim u Ujedinjenim narodima", *Jugoslovenska Revija za Medjunarodno Pravo*. nr. 2 fq. 208-220.

është e rëndësishme të thuhet se, për shkak të faktit se të gjithë qytetarët kanë dinjitet të barabartë shoqëror, çfarëdo dallimi i palejueshëm në mes njerëzve ose grupeve paraqet arbitraritetin e pushtetit.³² Megjithatë, diskriminimi pozitiv, sidomos për pakica dhe gjininë e bukur, nuk përbën dallim të palejueshëm. Gjithashtu, nuk është shkelje e parimit të barazisë as dhënia funksionale e privilegjeve të posaçme për anëtarët e trupit përfaqësues, p.sh, imuniteti i deputetit.

3. Neni 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës fillon me dispozitën e cila Republikën e Kosovës e përkufizon si shoqëri multietnike dhe shtet kushtetues.³³ Ajo çfarë duhet theksuar menjëherë, është fakti se neni 3 dhe neni 24 i kësaj Kushtetute mbajnë të njëjtin titull, pra "barazia para ligjit", edhe pse dallimi mes tyre, para së gjithash, qëndron në faktin se neni 3 i përket (Kapitullit I) "DISPOZITAT THEMELORE", ndërsa neni 24 (Kapitullit II) "TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE". Siç u tha më herët, dispozitat themelore dhe parimet juridike nuk mund të shërbejnë si bazë e pavarur juridike për vendimmarrje para Gjykatës Kushtetuese, përveç në rastet kur kjo bëhet në kuadër të ndonjë neni konkret. Kjo do të thotë se neni 24 i Kushtetutës ka përmbajtje normative dhe shërben si bazë për vendimmarrje të pavarur, pa pasur nevojë për citimin e disa prej dispozitave themelore ose primeve të Kushtetutës.
4. Sipas formës së organizimit të pushtetit, Kosova është republikë dhe kjo në mënyrë eksplicite thuhet në nenin 1, paragrafin 1, të Kushtetutës, duke shtuar se Kosova është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm. Përcaktimi për republikë³⁴ apo monarki³⁵ në ditët e sotme, si dhe përcaktimi për forma të tjera të rregullimit (federativ, unitar, sistem presidencial, sistem parlamentar dhe ngjashëm),³⁶ mund të kushtëzohet dhe të motivohet, si nga arsye parimore, teorike,

³² Më gjerësisht në: Kamali, Masoud, (2008), "Racial Discrimination: Institutional Patterns and Politics", Routledge Research in Race and Ethnicity, Routledge: New York.; Desmond, Matthew and Emirbayer, Mustafa, (2009), 'Racial Domination, Racial Progress: The Sociology of Race in America', McGraw-Hill: New York,

³³ Shihni rastet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KO 01-09 dhe KO 119-10. Në rastin KO01-09 (Cemajl Kurtishi kundër Kuvendit Komunal në Prizren) i 18 marsit 2010, Gjykata Kushtetuese ka vendosur se vendimi i Komunës ishte jokushtetues kur ka vendosur vetëm shenjat shqiptare të Lidhjes së Prizrenit (1878) në stemën e Komunës së Prizrenit. Me këtë veprim, Komuna e Prizrenit nuk i ka kushtuar vëmendje komuniteteve të tjera, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtat e komuniteteve joshumicë.

Në rastin KO119-10 (Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës: Vlerësim i kushteutshmërisë së nenit 14 paragrafi 1 pika 6, nenet 22, 24, 25, dhe 27 Ligjit për të drejtat dhe liritë e deputetëve, nr. 03/L-111 i 4 qershorit 2010) i 8 dhjetorit 2001, Gjykata Kushtetuese ka vendosur se pensionet e deputetëve, përveç tjerash, paraqesin edhe shkelje të parimit të barazisë, sundimit të së drejtës, mosdiskriminimit dhe të drejtës sociale.

³⁴ Shih me shumë në: Cf. Tomkins, A., (2005), 'Our Republican Constitution', Oxford University Press: Oxford.

³⁵ Shih më shumë në: Bogdanor, V., (1997), 'The Monarchy and the Constitution', Oxford University Press: Oxford.

³⁶ Shih: Elazar, D.J. (ed.), (1994), 'Federal Systems of the World: A Handbook of Federal, Confederal and Autonomy Arrangements', 2nd ed., Cartermill International: Harlow.; Karmis,

ashtu edhe nga arsye interesi dhe nevojash praktike, gjegjësisht si nga njëra ashtu edhe nga tjetra njëkohësisht. Si duket arsyet parimore (teorike) në ditët e sotme kanë, deri diku, rëndësi më të paktë, duke pasur parasysh se edhe republika (në formën e saj demokratike) edhe monarkia kushtetuese-parlamentare favorizojnë sistemin politik demokratik dhe gjithë atë që nënkupton demokracia si sistem politik (të drejtat dhe liritë, sistemi shumëpartiak, zgjedhjet e lira etj.). Sipas kësaj, përcaktimi për monarkinë kushtetuese-parlamentare nuk nënkupton kurrsesi diskualifikimin (ose degradimin) e republikës (në formën e saj demokratike), por as anasjelltas.³⁷

Sipas përkatësisë etnike, popullsinë e Kosovës e përbëjnë shqiptarët, mbi 90%, kurse përqindjen tjetër të popullsisë e përbëjnë serbët dhe të tjerët (boshnjakë, goranë, romë, turq, ashkalinj, egjiptas). Banorët që i takojnë nacionalitetit a etnisë, grupit fetar a gjuhësor të njëjtë, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Kosovës (komunitetet), gëzojnë të drejta të posaçme, të cilat janë paraparë me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parapara në Kapitullin II të Kushtetutës (neni 57, paragrafi 1.). Është e rëndësishme të thuhet se Kushtetuta e Kosovës përdor termin „komunitet“ për të treguar në mënyrë simbolike se të gjithë janë të barabartë para Kushtetutës. Ky term është bartur nga Plani i Ahtisarit.

Neni 3.1

1. Kushtetuta përcakton se Republika e Kosovës është "shoqëri multietnike, e cila përbëhet prej shqiptarëve dhe komuniteteve tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektimin e sundimit të ligjit përmes institucioneve të veta legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore" (neni 3, paragrafi 1). Demokracia, respektivisht mënyra demokratike e qeverisjes, mund të sigurohet vetëm nëse në një shoqëri ekziston sundimi i ligjit, si parakusht bazë i Kushtetutës, e cila bazohet në të drejtat e patjetërsueshme të njeriut.³⁸
2. Për sigurimin e demokracisë, pra, mënyra demokratike e qeverisjes (siç thuhet në nenin 3, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës), është e domosdoshme që Kushtetuta të veçojë ato fusha që janë më të rëndësishme dhe që janë si shtylla të shtetit të së drejtës. Kështu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në disa nene të saj, garanton disa prej këtyre elementeve të domosdoshme të demokracisë, pra, të shtyllave që përbëjnë shtetin e së drejtës, që janë:
 - 1) Zgjedhjet e lira dhe të drejtpërdrejta - mënyra e konstituimit të pushtetit, baza dhe burimi i legjitimitetit të tij (neni 63.);

Dimitrios & Norman, Wayne, (2005), (eds.), *Theories of Federalism: A Reader*, Palgrave Maxmillan: New York.

³⁷ Shih gjerësisht në: Fabre, M.H., (1967), *Principes republicains de Droit Constitutionnel*, LIBRARIE GENERALE DE DROIT ET DE JURISPRUDENCE: Paris.

³⁸ Për zhvillimin historik të idesë dhe praktikës të demokracisë kushtetuese dhe formave tjera të qeverisjes demokratike, më tepër shih në: Fridrih, K.J., (2005), *Konstitucionalna demokratija - teorija i praksa u Evropi i Americi*, CID: Podgorica

- 2) Garancia kushtetuese e të drejtave dhe lirive themelore - garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, si kuptim dhe arsye e Kushtetutës (neni 21, paragrafi 2);
 - 3) Ndarja e pushteteve - instrument i kufizimit të pushtetit (neni 4, paragrafi 1);
 - 4) Pavarësia e gjyqësorit - siguria juridike dhe mbrojtja e të drejtave (neni 102, paragrafët 2 e 4);
 - 5) Pushteti i nënshtrohet Kushtetutës dhe ligjit - qeverisje në kufij të shtë drejtës (neni 16.).
3. ushtetuta e Republikës së Kosovës në fund të paragrafit 1, neni 3, parasheh që Republika e Kosovës qeveriset prej "institucioneve të legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit". Në të vërtetë, **pushteti i legjislativit** është një nga tri degët e pushtetit dhe detyrë kryesore e tij është nxjerrja e ligjeve nga ana e parlamentit. Në demokracitë liberale, qytetarët zgjedhin përfaqësuesit e tyre në parlament (në zgjedhje) dhe me këtë atyre u japin autoritet që të votojnë në emër të tyre për ligjet. Procesi i votimit të ligjit varet nga mënyra e rregullimit parlamentar të një shteti. Në demokracitë liberale kemi parlamente dydhomëshe (bikameralizmi) dhe njëdhomëshe. Parlamente dydhomëshe janë Kongresi Amerikan dhe Parlamenti Britanik. **Pushteti ekzekutiv** ka për detyrë të zbatojë ligjet të cilat janë nxjerrë nga pushteti legjislativ dhe janë interpretuar nga pushteti i gjyqësorit. Në kuptimin e përgjithshëm, pushtetin ekzekutiv e përbën qeveria. Në varësi nga sistemi politik, në krye të qeverisë mund të jetë kryeministri (p.sh. në Britaninë e Madhe) ose presidenti (p.sh. SHBA) - i ashtuquajtur, sistem monoqefal i pushtetit ekzekutiv, kurse disa shtete janë hibride, që do të thotë se kanë edhe kryeministër edhe president (p.sh. Franca, Kosova etj.) - i ashtuquajtur sistem biqefal (dykrerësh) i pushtetit ekzekutiv. **Pushteti gjyqësor** ka për detyrë të zbatojë dhe të interpretojë ligjet që i ka nxjerrë pushteti i legjislativit (ligjvënësi). Në demokracitë liberale, pushteti i gjyqësorit duhet të ketë pavarësinë absolute nga degët e pushteteve të tjera.
4. Respektimi i parimit të barazisë është/nënkupton obligim, jo vetëm për pushtetin ekzekutiv e gjyqësorin,³⁹ por edhe për legjislativin. Në fakt, për pushtetin e legjislativit parimi i barazisë nënkupton obligim për krijimin e së drejtës, e cila do të jetë e njëjtë për të gjithë. Vështruar nga këndi negativ, nuk lejohet e drejta e pabarabartë për disa individë ose disa grupe. Prandaj parimi i barazisë konsiderohet edhe e drejtë për barazi. Parimi i barazisë së qytetarëve, sipas kësaj, vlen si parim juridik, pra, parashihet e drejta juridike, barazia para ligjit dhe sipas ligjit. Një parim i tillë kushtetues, nuk lejohet të shkelet nga ligjet e zakonshme. Nga ky parim rrjedh se edhe ata që zbatojnë ligjet, pra, pushteti kushtetues, duhet t'i zbatojnë ato njësoj ndaj të gjithëve, dhe secilit t'i ofrojnë të njëjtën mbrojtje. Sipas parimit të barazisë së qytetarëve, nuk do të ishte e mundur asnjëherë nxjerrja e asnjë ligji special apo krijimi i ndonjë privilegji për të tjerët.

³⁹ Për parimin e barazisë dhe rolit të gjyqësorit në realizimin e këtij parimi, shih në: J. A. Griffith, (1997), 'Politics of the Judiciary'^{5th} edition, HarperCollins Publishers: London; dhe Guggan, Lisa (2004), 'The Twilight of Equality?: Neoliberalism, Cultural Politics, and the Attack on Democracy', Beacon Press: Boston Massachusetts.

Neni 3.2

1. Dispozita e paragrafit 2, neni 3, të Kushtetutës përcakton se ushtrimi i pushtetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimin e barazisë së të gjithë qytetarëve para ligjit dhe të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njohura ndërkombëtarisht. Në korpusin e disiplinave të cilat merren me organizimin dhe funksionimin e pushtetit publik, rol i rëndësishëm i takon administratës publike (shtetërore). Nga raporti i saj me legjislativin, ekzekutivin dhe pushtetin e gjyqësorit, varen korrelacionet e shtetit, ekonomisë dhe shoqërisë, e kështu edhe pozita e njeriut në shoqëri (nga pushteti lokal deri tek ai qendror). Mu për këtë, modernizimi i sektorit të pushtetit publik, respektivisht i institucioneve të tij, në mënyrë vendimtare ndikon në karakterin e kapaciteteve demokratike të secilit komunitet. Prandaj gjithë proceset reformuese të shoqërive në tranzicion, në plan të parë të ndryshimeve vendosin modernizimin e institucioneve të administratës publike (shtetërore), dhe kompetencave të tyre e burimeve njerëzore⁴⁰. Ky lloj orientimi hap fusha të reja, mundësi më të mëdha bashkëpunimi me institucionet përkatëse ndërkombëtare, si dhe nevojën për një harmonizim shumë-etapësh me legjislacionin dhe rregullativin ndërkombëtar.⁴¹
2. Marrëdhëniet e organeve publike me qytetarët, si dhe të drejtat e qytetarëve në procedurat para këtyre organeve, janë të rregulluara me ligjet për sistemin e administratës publike dhe me procedurën e përgjithshme administrative, me ligjin për nëpunësit shtetëror, si dhe me ligjet e tjera përkatëse. Të gjitha këto ligje duhet të rregullojnë me saktësi marrëdhëniet e pushtetit lokal me qytetarët, të cilat duhet të jenë të tilla që nëpunësit të cilët punojnë në organet e administratës publike, ligjërisht të jenë përgjegjës që marrëdhëniet e tyre me qytetarët, si dhe marrëdhëniet e qytetarëve ndaj tyre, të bazohen në bashkëpunim dhe besim të ndërsjellë, si dhe në respektimin e personalitetit dhe dinjitetit njerëzor.
3. Organet e administratës shtetërore janë të obliguara që qytetarëve, të cilët u drejtohen atyre, t'u ofrojnë të dhënat e kërkuara, dhe t'u japin ndihmë profesionale. Me procedimin dhe zgjidhjen e ndonjë procedure tek organet e pushtetit publik,

⁴⁰ Në dekadën e fundit të shek XX, periudha e tranzicionit ka qenë joefikase, para së gjithash, për shkak të krijimit të tensioneve të shumta politike në këto vende dhe përreth tyre. Pas ndryshimeve të shumta politike, nisi të depërtonte më shpejt kursit reformues, i cili, me gjithë modifikimet dhe përshtatjet e disa specifikave të shteteve në tranzicion, në thelb, bazohej në konceptin neoliberal ekonomik. Ky koncept neoliberal, i cili në fillimet e tij, ishte shprehur në formë mjaft të vrazhdë (të rëndë dhe të ngurtë) të ashtuquajtur terapi shok, në praktikë ka dhënë rezultate modeste, madje diku edhe katastrofike. Për këtë arsye, në rrethet shkencore jashtë dhe në ato vendore, si dhe në opinionin e gjerë publik, gjithnjë e më tepër rritet vetëdija e përdorimit të modifikimit dhe futjes së specifikave rajonale në reformat dhe proceset ekonomiko-shoqërore.

⁴¹ Marriot, J.A.R., (1927), *The Mechanism of the Modern State A Treatis on The Science and Art of Government*, Vol. I-II, Oxford University Press: Oxford, fq. 48; Mbi trendet e reja pas mbarimit të Luftë së Ftohtë, shih më shumë në: Zielonka, Jan., (2001), (ed.), *Democratic Consolidation in Eastern Europe*. Volume I, Institutional Engenering, Oxford University Press: Oxford.; Zielonka, Jan., (2001), (ed.), *Democratic Consolidation in Eastern Europe*, Volume II, International and Transnational Factors, Oxford University Press: Oxford

këto organe janë të obliguara t'u mundësojnë qytetarëve mbrojtje dhe realizim sa më të lehtë të të drejtave të tyre, duke pasur kujdes që realizimi i të drejtave të një qytetari të mos jetë në dëm të të drejtave të qytetarëve të tjerë, dhe as në kundërshtim me interesat e përgjithshme. Qytetarët shpesh kërkojnë të dhëna nga organe të ndryshme të pushtetit publik, por nganjëherë nuk marrin përgjigje për pyetjet e tyre. Megjithatë, sipas rregullave ligjore, secilit qytetar i takon e drejta e marrjes së informatave nga organet e pushtetit publik. Qytetarët nga këto organe kanë të drejtë të kërkojnë informata të caktuara dhe, me këtë rast, nuk është e nevojshme të ceket arsyeja pse kërkojnë qasje në një informacion. Të drejtat e qytetarëve për procedura para organeve të pushtetit publik, si p.sh. e drejta e qytetarit të paditur për ndihmë në ndonjë procedurë, janë të rregulluara me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative dhe me Ligjin për punonjësit publikë.

4. Një marrëdhënie e tillë e organeve përgjegjëse ndaj qytetarëve në ushtrimin e pushtetit publik, duhet të jetë edhe në Republikën e Kosovës, çka është paraparë pa dyshim edhe me dispozitën kushtetuese të përfshirë në paragrafin 2 të nenit 3. Po ashtu, ushtrimi i pushtetit publik duhet të bazohet në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore që janë të njohura me dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare, me konventat dhe deklaratat. Ajo që është shumë e rëndësishme për Republikën e Kosovës si shoqëri multietnike, e cila përbëhet nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera, është fjalia e fundit e nenit të cekur, e cila tregon se ushtrimi i pushtetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në mbrojtjen e të drejtave dhe të pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre. Në të vërtetë, secili pjesëtar i komuniteteve (banor që i përket të njëjtit grup nacional ose etnik, gjuhësor apo fetar, e që tradicionalisht është i pranishëm në territorin e Kosovës) gëzon të drejta të posaçme, të cilat janë paraparë me këtë Kushtetutë, përveç të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute, i cili emërtohet "të drejtat dhe liritë themelore". Natyrisht, kur është fjala për komunitetet dhe pjesëtarët e tyre, nuk është e rëndësishme vetëm që atyre t'u garantohen të drejtat dhe liritë me Kushtetutë, si akti më i lartë juridik, por edhe t'u mundësohet realizimi i atyre të drejtave dhe lirive.

Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit]

- (1) **Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë.**
- (2) **Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ.**
- (3) **Presidenti i Republikës së Kosovës përfaqëson unitetin e popullit. Presidenti i Republikës së Kosovës është përfaqësues legjitim i vendit brenda e jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë.**
- (4) **Qeveria e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar.**

- (5) Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat.
- (6) Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.
- (7) Republika e Kosovës ka institucionet e veta për mbrojtjen e rendit kushtetues dhe të integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.

Neni 4

1. Siç është e njohur, dallojmë dy lloje themelore të sundimit/qeverisjes, dhe kjo: monarki dhe republikë. Sipas nenit 4, paragrafi 1, të Kushtetutës, Kosova është republikë e bazuar në parimet demokratike, organizimi i pushtetit të së cilës ushtrohet sipas parimit të ndarjes së pushtetit.⁴² Në mënyrë që të përcaktohet nga afër natyra e formës së qeverisjes republikane në Republikën e Kosovës, është e domosdoshme të shqyrtohen detajisht pozita kushtetuese, të drejtat e përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të institucionit të Presidentit të Republikës.
2. Emërtimi "republikë" rrjedh nga fjalët latine *res publica* (çështje publike, e mirë e përgjithshme, çështje me të cilën nuk mund të tregtohet) dhe, krahas monarkisë, paraqet formën tjetër themelore të sundimit. Në republikë i gjithë populli, ose një pjesë e tij, realizon sovranitetin drejtpërdrejt ose nëpërmjet përfaqësuesve të tij të zgjedhur. Sipas kësaj, republikat mund të jenë demokratike dhe aristokrate. Në krye të republikës gjendet Presidenti, i cili zgjidhet për një kohë të caktuar (sipas rregullit zgjidhet për 4, 5 ose 7 vjet), kurse në raste të veçanta - përjetësisht, por pa të drejtë trashëgimie. Disa norma republikane janë krijuar në Romë, ndërsa republika e parë demokratike (politeja) ka qenë Athina. Pas rënies së republikës së Romës, monarkia është bërë formë dominuese e sundimit, deri në shekullin XVIII, kur SHBA dhe Franca u bënë republika. Sot në botë ekzistojnë 153 republika dhe 42 monarki. Numri më i madh i republikave bashkëkohore, sipas rregullimit shoqëror, janë demokraci përfaqësuese. Në raport me pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ, dallohen republikat presidenciale dhe parlamentare. Sundimtari (Presidenti i republikës) vjen në pozitë me zgjedhjen nga ana e qytetarëve ose e parlamentit. Monteskjë dallon republikën demokratike (sovraniteti i takon gjithë popullit) dhe republikën aristokrate (sovranitetin e ka një pjesë e popullit).⁴³
3. Republika demokratike paraqet, siç e thotë edhe vetë emërtimi, model demokratik të organizimit të shtetit. Ky është emërtim për formën e qeverisjes, e cila është e kundërt me monarkinë dhe në të cilën i gjithë populli është bartës i pushtetit, ndërsa kreu i shtetit ushtrues i funksioneve të caktuara pa privilegje personale, politikisht dhe penalisht përgjegjës, më së shpeshti i zgjedhur për atë pozitë. Një numër i madh shtetesh, posaçërisht në ditët e sotme, këtë formë qeverisjeje e theksojnë edhe në emrin e tyre. Republika, si formë politike në të cilën organet më të larta të pushtetit

⁴² Për mënyrën dhe sistemet e organizimit të pushtetit në një shtet, shih më gjerësisht në: Sokol, S., Smerdel, B., (1988), 'Organizacija vlasti', Vëll. I dhe II, (Globus: Zagreb).

⁴³ Montesquieu, C.S., (1874), 'De l'esprit des lois', Garnier Frères: Paris, fq. 37.

zgjidhen, paraqet institucionin adekuat për arritjen e aspiratave të shumta të popullit, për fitimin e të drejtave demokratike, prandaj në luftën e popullit me aristokracinë feudale dhe absolutizmin e disa monarkëve, është bërë simbol i atyre aspiratave, e shpallja e saj - shenjë fitoreje ndaj diktaturës indivi-duale dhe autokracisë.

4. Në shtetet e organizuara demokratikisht, në zgjedhjen e Presidentit të republikës mund të marrin pjesë ose drejtpërdrejt të gjithë qytetarët, ose ai mund të zgjidhet nga "të zgjedhurit" e zgjedhur drejtpërdrejt nga populli, ose nga organi më i lartë përfaqësues, siç është parlamenti. Në çfarëdo rasti, ekziston mandati i caktuar, pra, periudha e caktuar për të cilën zgjidhet kreu i shtetit. Vetëm në shtetet jodemokratike ose në kushtet e jostabilitetit politik, kreu i shtetit nuk është organ i zgjedhur. Megjithatë, dallimi më i madh në mes republikës dhe monarkisë, reflektohet në faktin që, një individ apo një grup individësh, të cilët kryejnë funksionin e kreut të shtetit, nuk kanë ndonjë privilegj të posaçëm, paprekshmëri dhe as mospërgjegjësi juridike. Përkundrazi, ata individë janë përgjegjës juridikisht sikur edhe të gjith organet e tjera dhe qytetarët e zakonshëm.
5. Analiza e institucioneve kushtetuese duhet të përfshijë, si statistikën⁴⁴ ashtu edhe dinamikën⁴⁵ e tyre. Për këtë arsye, analiza e institucioneve nënkupton edhe diskutimin për parimet në të cilat bazohen ato, e ato janë, në fakt, parimet bazë kushtetuese. Të kuptuara në këtë mënyrë, institucionet kushtetuese japin një pamje të plotë në sistemin kushtetues. Në një sistematikë të tillë të ekspozimit të materies, udhëzon tërthorazi edhe vetë kushtetutëformuesi, i cili në Kapitullin I, me titullin DISPOZITAT THEMELORE, ka renditur parime të rëndësishme kushtetuese, në të cilat bazohen institucionet kushtetuese.
6. Forma e qeverisjes është kriter tradicional dhe i pakontestueshëm i klasifikimit të shteteve, i njohur, i zbatueshëm dhe i përpunuar qysh nga mendimi antik. Duke u nisur nga emërtimi zyrtar i shtetit, i paraparë me Kushtetutë, Kosova është, siç thamë edhe në fillim, për nga forma e qeverisjes - republikë. Qëndrimin të tillë të kushtetutëformuesit, nuk ka diçka të veçantë për t'iu kundërvënë nga pikëpamja e precizitetit të nevojshëm. Përcaktimi për formën e qeverisjes republikane gëzon legjitimitet⁴⁶ demokratik. Pas secilit interpretim konkret të dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duhet konkluduar se kjo Kushtetutë ka paraparë republikën si formë të qeverisjes, kështu që forma e qeverisjes republikane është universalizuar dhe nuk mund të hiqet dorë prej kësaj pa ndryshimin e Kushtetutës. Një zgjidhje e tillë është gjerësisht e pranueshme edhe në kushtetutshmërinë botërore. Kështu që, kjo ekziston edhe në federatën më të vjetër të botës - SHBA. Kushtetuta e SHBA-së (e cila në fakt është mjaft e shkurtër) shtetet anëtare obligon të pranojnë formën republikane të qeverisjes.⁴⁷

⁴⁴ Pozita kushtetuese, përbërja, struktura.

⁴⁵ Funksionimi, procedura që zbatohet, dhe marrëdhëniet e ndërsjella.

⁴⁶ Për legjitimitetin, shih më gjerësisht në: Hajns, V., (1974), "Legjitimitet - prilog jednoj kategoriji građanskog društva", *Gledišta*, nr. 7-10, fq. 33.

⁴⁷ Shih me shumë në: Oliver, D., Jowell, J. (2004), (ed.), 'The Changing Constitution', Oxford University Press: Oxford.

7. Parimi i ndarjes së pushtetit⁴⁸ është asi mënyre e rregullimit të marrëdhënieve mes pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, në të cilën secili nga këto tri pushtete ushtron pushtetin e vet pavarësisht nga dy të tjerat. Njëra nga arsyet kryesore për vënien e këtij modeli qëndron në kufizimin e pushtetit, duke pasur parasysh se ndarja e pushtetit historikisht është krijuar në procesin e luftës së borgjezisë kundër pushtetit feudal. Ajo luftë njëkohësisht ishte edhe luftë për liri dhe demokraci kundër absolutizmit të monarkisë feudale. Në monarkinë feudale që të tri pushtetet (legjislativi, ekzekutivi dhe gjyqësori) ishin të lidhura në një organ - monarki. Ai ka nxjerrë ligje dhe akte administrative dhe ka gjykuar. Një unitet i tillë i pushtetit nënkupton pakufizimin e pushtetit. Megjithatë, arsye po aq e rëndësishme aplikimin e ndarjes së pushteteve, është nevoja që disa organe specializohen për ushtrimin e disa funksioneve, që t'i kryejnë ato në mënyrë më të suksesshme.
8. Përfaqësuesi më i njohur i modelit të ndarjes së pushteteve ishte Monteskje, i cili në veprën e tij "De l'esprit des lois", publikuar në vitin 1748, paraqet teorinë më të plotë për ndarjen e pushteteve. Kur thotë se "gjithçka do të humbej sikur i njëjti njeri ose organi i njerëzve të shquar, qofshin ata fisnikë ose njerëz të popullit, do të ushtronte tri pushtetet e përmendura, pra pushtetin e nxjerrjes së ligjeve, pushtetin e ekzekutimit të vendimeve publike dhe pushtetin e gjykimit për krime ose kontesteve të personave privat", Monteskje mendon se do të humbej liria, ngase, thotë ai "është përvojë e përrjetshme se secili njeri i cili ka pushtet është i prirur për ta keqpërdorur atë dhe e keqpërdor derisa nuk has në kufizime".⁴⁹ Andaj është e nevojshme të kufizohet pushtetit të cilitdo organ, ashtu që asnjë organ të mos ushtrojë pushtetin e plotë shtetëror, pra, është e nevojshme që secili nga tri pushtetet t'u besohet organeve të ndryshme, ashtu që "njëri pushtet ndalon pushtetin tjetër".⁵⁰
9. Është tendencë e përgjithshme për t'iu kthyer ndarjes së pushteteve në të gjitha sistemet të cilët kanë kaluar nëpër fazën e socializmit, që janë në tranzicion. Në të gjitha vendet të cilat kanë pësuar ndryshime të tilla, modeli i ndarjes së pushteteve ka përjetuar renesancën e vet. Prandaj, dispozitat në kushtetuta, me të cilat shpallet parimi i ndarjes së pushteteve, nuk janë deklarata të thjeshta. Shpallja në mënyrë eksplicite e atij parimi është e rëndësishme me rastin e interpretimit të kushtetutës në rastet kur normat kushtetuese nuk thonë në mënyrë eksplicite, cilat organe shtetërore do të duhej të ushtrojnë veprimtarinë konkrete. Në rastet e tilla, me referimin në ndarjen e pushteteve të shpallur në kushtetutë, veprimtaria e tillë i lihet në kompetencë organit i cili kryesisht kryen funksionin nën të cilin bie edhe veprimtaria përkatëse nga pikëpamja materiale.

⁴⁸ Format themelore të organizimit të pushtetit, të cilat bazohen në këtë parim janë parlamentarizmi dhe sistemi presidencial. Parlamentarizmi bazohet në ndarjen fleksibile të pushtetit, përderisa sistemi presidencial në ndarjen më të fortë dhe të ngurtë të pushtetit.

⁴⁹ Monteskje, (1989), 'O duhu zakona', Savremena administracija: Beograd, fq. 175-176

⁵⁰ Për këtë, gjithashtu, ka shkruar edhe Xhon Llok, më herët, pra para Montesksesë. Shih: Locke, J., (1764), 'The Two Treatises of Civil Government', (Hollis ed.), A. Millar et al.: London.

10. Parimi i ndarjes së pushteteve në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, sipas Kushtetutës, është parim në të cilin mbështeten marrëdhëniet mes tri degëve themelore të pushtetit në sistem kushtetues. Pushteti nuk u nënshtrohet vetëm kufizimeve të parapara me Kushtetutë dhe ligje, por edhe atyre kufizimeve të cilat i parasheh edhe parimi i ndarjes së pushtetit dhe të cilat nuk lejojnë që në duart e një organi të jenë funksione të ndryshme pushteti. Ndarja e pushteteve është aranzhman institucional, i cili raportet mes pushteteve të ndryshme i vendos në mënyrë (institucionale, organizative dhe funksionale) që punët të cilat i ushtrojnë organet e pushtetit u besohen, varësisht nga përmbajtja e tyre, organeve të ndryshme të pushtetit. Pushteti i legjislativit i besohet organit të pushtetit i cili i përfaqëson qytetarët dhe të cilin ata e zgjedhin drejtpërdrejtë. Ky është Kuvendi i Republikës së Kosovës. Punët e pushtetit ekzekutiv janë kompetencë e organeve ekzekutive (presidentit dhe kryeministrit të Republikës së Kosovës). Pushtetin e gjyqësorit e ushtrojnë gjykatat e përgjithshme (gjykatat themelore, të apelit dhe Gjykata Supreme).

Neni 4.1

1. Parimet në të cilat bazohen raportet mes organeve të të "tri pushteteve" janë "parimi i ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre", përderisa "pushteti i gjyqësorit është unik, i pavarur dhe e ushtrojnë gjykatat e pavarura". Sa i përket parimit të ndarjes së pushtetit, këtu nuk mund të negociohet dhe është plotësisht e qartë dhe saktë e përcaktuar në nenin 4 paragrafi 1 të Kushtetutës së Kosovës, si republikë demokratike bazohet në këtë parim.

Neni 4.2

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në paragrafin 2 të këtij neni parasheh se Kuvendi i Republikës së Kosovës ushtron pushtetin legjislativ. Legjislativi tradicionalisht trajtohet si cilësi e kompetencave të parlamentit. Megjithatë, e vërteta është se parlamenti nuk ushtron gjithë pushtetin e legjislativit në vend, dhe se nuk është pushteti i legjislativit i vetmi juridiksion i tij. Prandaj më e saktë do të ishte të thuhet se parlamenti jep vetëm fjalën e fundit për ligjet. Në të vërtetë, pushteti ligjvënës i parlamentit ka kufirin e vet të epërm dhe mëposhtëm. Kufiri i epërm është tërheqë në favor të Kushtetutës, përderisa kufiri i poshtëm është tërhequr në favor të rregullores. Pushteti ligjvënës i parlamentit nënkupton se parlamenti është ai organ shtetëror i cili nxjerr rregulla origjinere, të cilat në mënyrë origjinere rregullojnë marrëdhëniet shoqërore. Në kuptimin e një pushteti të tillë përfshihet edhe pushteti kushtetutformues, i cili në shumicën e shteteve, në përgjithësi ose pjesërisht, është në juridiksion të parlamentit. Kjo është për arsye se Kushtetuta në kuptimin material, nuk është asgjë tjetër përveç se ligji themelor i vendit. Sa është dominues funksioni ligjvënës në kompetencat e parlamentit, më së miri shihet në atë se, në disa shtete emërtimi për parlamentin është, në tërësi apo për një nga dhomat e tij - "organ ligjvënës".⁵¹

⁵¹ Kështu, në Kushtetutën e Francës të vitit 1793, organi përfaqësues njëdhomësh quhej "organi ligjvënës". Edhe sot në shumë shtete të botës, parlamenti definohet përmes funksionit ligjvënës,

2. Grupi i parë dhe më i rëndësishëm i punëve të cilat në kuadër të kompetencave të veta i ushtron kuvendi i Republikës së Kosovës, është veprimtaria e tij normative, ngase ai krijon të drejtën, pra, është bartës i pushtetit kushtetutformues dhe ligjvënës. Në këtë cilësi ai, miraton Kushtetutën dhe vendos për ndryshimin e saj në bazë të 2/3 të votave të të gjithë deputetëve (neni 65 paragrafi 2) dhe miraton ligjet, rezolutat dhe aktet e tjera të përgjithshme (neni 65 neni 1) nga domeni i kompetencave të Republikës së Kosovës, mes të cilave edhe buxhetin e Republikës së Kosovës (neni 65 paragrafi 5), ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare (neni 65 paragrafi 4) të cilët, më pastaj bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik (neni 19 paragrafi 1). Përveç këtij funksioni bazë Kuvendi ka edhe funksionin e rëndësishëm të zgjedhjes, propozimit, mbikëqyrjes dhe kontrollës (për këto funksione do të flasim më shumë, kur të komentojmë Kreun IV të Kushtetutës i cili i kushtohet Kuvendit të Republikës së Kosovës).

Neni 4.3

1. Duke pasur parasysh se, sipas Kushtetutës, është paraparë republika si formë e qeverisjes, presidenti i Republikës së Kosovës paraqet unitetin e popullit, si përfaqësues legjitim dhe unik edhe jashtë vendit (neni 4 paragrafi 3 i Kushtetutës). Pozita e tij, si organ shtetëror, varet nga ajo nëse ai institucion është në sistemin parlamentar apo presidencial të pushtetit. Nga zgjidhja e kësaj çështje parimore të organizimit shtetëror të pushtetit, varet zgjedhja dhe autorizimet e presidentit të republikës.
2. Në sistemin presidencial të pushtetit, presidenti i republikës, sipas rregullit, zgjidhet drejtpërdrejtë nga votuesit, ndërsa autorizimet e tija janë të përafërta me ato të cilat i ka monarku në monarki. Në sistemin parlamentar, i cili zbatohet në Republikën e Kosovës, presidenti i republikës zgjidhet nga përfaqësuesit e popullit, pra, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me vota të fshehta (neni 86 paragrafi 1), me shumicën prej dy të tretave të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Mënyra e tillë e zgjedhjes së kreut të shtetit ka për pasojë se ai nuk ka më shumë pushtet se monarku parlamentar, ai zakonisht ka ndikim më të pakët dhe reputacion se ky. Në realitet, një president i tillë, i zgjedhur nga ana e parlamentit (e jo nga qytetarët në zgjedhjet e drejtpërdrejta, me vota të fshehta në përputhje me ligjin), ushtron në mënyrë simbolike autorizimet të cilat i janë dhënë. Pushtetin e vërtetë ekzekutiv dhe shumë më tepër se kaq e ushtron qeveria, e cila rrjedh nga parlamenti dhe politikisht i përgjigjet atij. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, qeverinë e zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe ajo konsiderohet si e zgjedhur, nëse për zgjedhjen e saj kanë votuar shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve (neni 95 paragrafi 3).
3. Presidenti i Republikës së Kosovës, si organ shtetëror, ka kompetencat të cilat përfshijnë dy grupe kryesore të punëve. Njëri grup i punëve përbëhet nga

si pushteti legjislativ. Në vijim të kësaj, ta zëmë, Kushtetuta e Bullgarisë e 1991 (neni 62) thotë: "Kuvendi popullor realizon pushtetin legjislativ dhe ushtron kontrollën parlamentare". Sidoqoftë, edhe sot mes parlamentit dhe organit ligjvënës vëhet shenja e barazimit.

kompetencat e përfaqësimit, të cilat në sistemin parlamentar tradicionalisht i kryen kreu i shtetit. Grupi tjetër janë kompetencat e kreut të shtetit në sistemin presidencial dhe gjysëpresidencial, ndërsa sipas përmbajtjes përfshin pjesën e punëve të pushtetit ekzekutiv. Mes kompetencave tradicionale të presidentit të Republikës së Kosovës bien:

- 1) përfaqësimi i Republikës së Kosovës brenda dhe jashtë vendit (neni 84 pika 1);
 - 2) shpallja e ligjeve (neni 84 pika 5);
 - 3) cakton mandatarin për formimin e qeverisë (neni 84 pika 14);
 - 4) nxjerrja e vendimeve për misionet diplomatike e konzullare të Republikës së Kosovës (neni 84 pika 24);
 - 5) dhënia e amnistisë në përputhje me ligjin (neni 84 pika 29) e tjera.
4. Përveç kësaj, presidenti i Republikës së Kosovës ushtron edhe kompetenca të tjera, të cilat dalin jashtë rrethit të autorizimeve tradicionale të kreut të shtetit, dhe këtu bëjnë pjesë:
- 1) punët në lidhje me lëmin e mbrojtjes së vendit - vendos për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, në bashkëpunim me kryeministrin (neni 84 pika 22);
 - 2) formulimi dhe udhëheqja e politikës së jashtme, duke pasur parasysh se ajo është aktivitet shtetëror në të cilin marrin pjesë Kuvendi, qeveria dhe presidenti i Republikës, secili në kuadër të kompetencave të veta dhe në pajtim me to - një pjesë të punëve në lëmin e politikës së jashtme e ushtron presidenti i Republikës, ashtu që përfaqëson Republikën në vend dhe jashtë, kryen punë protokollare, pranon letra kredenciale dhe letrat për tërheqje të përfaqësuesve diplomatik të shefave të misioneve të akredituar në Kosovë, emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës me propozim të qeverisë (neni 84 pikat 11 dhe 25);
 - 3) të drejtat në lidhje me veprimtarinë kushtetutformuese dhe ligjvënëse, të cilat janë instrument me të cilin presidenti i Republikës merr pjesë në krijimin e pushtetit kushtetutformues dhe ligjvënës dhe ka mundësinë të ndikojë në procesin kushtetutformues, gjegjësisht ligjvënës - të drejtat e presidentit për të propozuar ndryshime e amendamente të Kushtetutës, në bazë të rregullores së punës së Kuvendit (neni 144 paragrafi 1 dhe neni 84 pika 8), të ushtrojë veton ligjvënëse vezulluese dhe t'i kthejë Kuvendit për rishqyrtim ligjet e miratuara, të cilat i konsideron të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës, apo për një, a më shumë komunitete (neni 84 pika 6), të ngris çështje të caktuara para Gjykatës Kushtetuese (neni 84 pika 9).
5. Gjithë ato që u thanë, si dhe aktivitetet e tjera të presidentit të Republikës së Kosovës, janë paraparë si garancione për funksionimin demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë. Për këtë do të bëhet fjalë me rastin e komentimit të dispozitave të Kapitullit V të Kushtetutës për presidentin e shtetit (nenet 83-91).

Neni 4.4

1. Për zbatimin e ligjit dhe politikës shtetërore është përgjegjëse qeveria e Republikës së Kosovës (neni 4 paragrafi 4 i Kushtetutës). Gjegjësisht, qeveria është organ i pushtetit ekzekutiv. Për dallim nga kreu i shtetit, i cili ekziston në të gjitha sistemet e pushtetit, qeveria është karakteristike për pushtetin e sistemit parlamentar, në të cilin ekziston egzekutivi biveal. Në sistemin presidencial qeveria nuk ekziston si organ formal kushtetues, por vetëm si grupim faktik i bashkëpunëtorëve të afërt të presidentit të shtetit, të cilët ai i cakton dhe shkarkon sipas bindjes së vet. Qeveria është organ shtetëror i pushtetit ekzekutiv e cila përfaqëson një grup funksionarëve më të lartë (ministrash), të cilët, sipas rregullit, gjenden në krye të disa resorëve të administratës. Qeveria e Republikës së Kosovës (si dhe qeveria e secilit shtet tjetër në të cilin ekziston pushteti i sistemit parlamentar) përcakton drejtimin e përgjithshëm të politikës shtetërore. Krahas kësaj është detyrë e saj që të zbatojë ligjet dhe të organizojë, koordinojë, drejtojë dhe kontrollojë veprimtarinë në kuadër të të gjitha lëmive (resorëve) administrative.
2. Duke pasur parasysh se qeveria, si organ i pushtetit ekzekutiv, themelohet nga parlamenti, ajo i përgjigjet atij për punën e saj. Në të vërtetë, presidenti i Republikës së Kosovës, pas përfundimit të zgjedhjeve dhe konsultimit me partitë politike (apo koalicionet) të cilat kanë fituar shumicën e nevojshme për formimin e qeverisë në Kuvend, i propozon Kuvendit kandidatin për kryeministër (neni 95 paragrafi 1), i cili në afat prej 15 ditësh nga dita e emërimit, i prezanton Kuvendit qeverinë, dhe kërkon nga Kuvendi të votojë për zgjedhjen e qeverisë (neni 95 paragrafi 2). Pikërisht për shkak të faktit se qeveria për t'u konsideruar e zgjedhur, pasi që për zgjedhjen e saj të ketë votuar shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve të Kuvendit të Kosovës (neni 95 paragrafi 3) dhe se anëtarët e qeverisë, pas zgjedhjeve, bëjnë betimin para Kuvendit (neni 95 paragrafi 6), po e njëjta qeveri për punën e saj i përgjigjet parlamentit republikan (neni 97 paragrafi 1) dhe i nënshtrohet kontrollës parlamentare (neni 100).
3. Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat janë bashkëpërgjegjës për vendimet të cilat i nxjerrë qeveria dhe individualisht përgjegjës për vendimet të cilat nxirren në domenin e përgjegjësive të tyre (neni 97 paragrafi 2). Shih për këtë, nuk mund të fillohet votimi i besimit (neni 100 paragrafi 2), të cilin mund ta kërkojë kryeministri ose votimi i mosbesimit të qeverisë (neni 100 paragrafi 1), që mund ta propozojnë së paku 1/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Neni 4.5

1. Duke pasur parasysh se pushteti në Republikën e Kosovës sipas Kushtetutës, organizohet sipas parimit të ndarjes së pushteteve (neni 4 paragrafi 1), kjo nënkupton se, përveç pushtetit të legjislativ dhe ekzekutiv (si politik), ekziston edhe i treti - pushteti i gjyqësorit (si profesional). Ajo çka është e rëndësishme të thuhet për pushtetin e gjyqësorit është se për secilën shoqëri, e cila dëshiron të jetë demokratike, ky pushteti i tretë duhet të jetë "boshti kurrizor i rendit juridik", e për

të qenë kështu, është e nevojshme që të jetë i pavarur dhe autonom. Për këtë arsye paragrafi 5 i këtij neni parasheh se pushteti i gjyqësorit është unik e i pavarur dhe se ushtrohet nga gjykatat e pavarura. Natyrisht se duhet theksuar faktin se e vërteta dhe normativja duhet të përputhen, pra, që ajo që thuhet në Kushtetutë të realizohet në jetën reale.

Neni 4.6

1. Mbrojtja e kushtetutshmërisë, si dhe interpretimi përfundimtar i Kushtetutës, i është besuar Gjykatës Kushtetuese (neni 4 paragrafi 6), e cila sipas Kushtetutës është "autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën" (neni 112 paragrafi 1), ndërsa që të mund të realizojë këtë funksion të vetin jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe sensitiv, ky organ është "plotësisht i pavarur në kryerjen e përgjegjësive të veta" (neni 112 paragrafi 2). Në kuadër të Kapitullit VIII, i cili i kushtohet Gjykatës Kushtetuese, Kushtetuta bazohet në parimin themelor, në bazë të të cilit rendi juridik i Republikës është unik dhe rregullon hierarkinë e rregullave ndërkombëtare dhe rregullave të përgjithshme të së drejtës vendore, shpallja e ligjeve dhe hyrja në fuqi e ligjit, përputhshmëria e ligjeve, dekretëve të presidentit e kryeministrit, si dhe rregulloreve të qeverisë me Kushtetutën. Gjykatës Kushtetuese, pra, për t'i kryer e papenguar përgjegjësitë e saja, i është mundësuar autonomia dhe pavarësia.
2. Për pozitën e Gjykatës Kushtetuese në sistemin kushtetues së Republikës së Kosovës, është i rëndësishëm rregulli kushtetues i cili flet për natyrën dhe efektin e vendimeve të saja. Në të vërtetë, vendimet e kësaj Gjykate janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe gjithë personat (fizik dhe juridik) dhe institucionet e Republikës së Kosovës (neni 116 paragrafi 1) dhe si të tilla shpallen në Gazetën Zyrtare.
3. Autonomia dhe pavarësia e Gjykatës Kushtetuese janë shumë të rëndësishme për punën e saj, ngase kjo gjykatë paraqet llojin e veçantë të organit shtetëror, me organizim të ndarë nga organet e tjera shtetërore, për të cilat vlejnë rregulla të posaçme të organizimit. Me pavarësinë e saj nënkuptohet liria nga çfarëdo ndikimi nga jashtë, nxjerrja e lirë e vendimeve gjyqësore, pra, që asnjë bartës i ndonjë pushteti tjetër shtetëror nuk mund të ndikoj në ushtrimin e pushtetit gjyqësor, që nuk mund të përzihet në punët e kësaj Gjykate. Në komentin e dispozitave të Kapitullit VIII për Gjykatën Kushtetuese (nenet 112-118) do të flitet më gjerësisht për këtë institucion të rëndësishëm të sistemit kushtetues të Kosovës.

Neni 4.7

1. Në fund të këtij neni, me dispozitë kushtetuese është e paraparë që Republika ka institucionet e saja për mbrojtjen e rendit kushtetues (neni 4 paragrafi 7), i cili "bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës në pronë, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushteteve shtetërore

dhe ekonomisë së tregut" (neni 7 paragrafi 1). Kështu që, Kushtetuta parasheh edhe mundësinë që mandati i Kuvendit të Kosovës (i cili zgjat 4 vjet, filluar nga dita e mbajtjes së seancës konstitutive të parlamentit republikan) mund të zgjatet në rast rrezikimi të rendit kushtetues ose sigurisë publike të Republikës Kosovës. Natyrisht se, zgjatja e mandatit të Kuvendit mund të zgjas vetëm derisa të zgjas një rrezik i tillë për rendin kushtetues (neni 66 4). Përveç kësaj, presidenti i republikës mund të shpall gjendjen e jashtëzakonshme, kur ekziston rreziku i brendshëm për rendin kushtetues dhe sigurinë publike (neni 131 paragrafi 1 pika 2).

2. Nëse ekziston rreziku për rendin kushtetues apo sigurinë publike të Republikës së Kosovës ose mundësia e fatkeqësisë natyrore në gjithë territorin apo një pjesë të territorit të Republikës së Kosovës, presidenti i Republikës së Kosovës në konsultim me kryeministrin, mund të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme (neni 131 paragrafi 4). Gjithashtu, duke pasur parasysh se sovraniteti dhe integriteti i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe se mbrohet me të gjitha mjetet e parapara me Kushtetutë dhe me ligj (neni 2 paragrafi 2), Republika e Kosovës ka institucionet e saja edhe për mbrojtjen e integritetit territorial, i cili sipas Kushtetutës është i paprekshëm.
3. Përfundimisht, me këtë paragrafin e fundit të nenit 4 të Kushtetutës, i cili është subjekt i komentit tonë, parashihet se Republika e Kosovës ka institucionet e saja për mbrojtjen e rendit dhe qetësisë publike, çfarë paraqet gjendjen e harmonizuar të marrëdhënieve të ndërsjella të qytetarëve, të krijuar me sjelljen e tyre në vende publike dhe me veprimet e organeve dhe organizatave në jetën publike, për hir të sigurimit të kushteve të barabarta për realizimin e të drejtave të qytetarëve në siguri personale dhe pronësore, qetësi dhe rehati, jetë private, liri të lëvizjes, ruajtje të moralit dhe dinjitetit njerëzor. Sipas kësaj, veprimet me të cilat priset rendi dhe qetësia publike, paraqesin një grup mjaftë të rëndësishëm të shkeljeve dhe të një rëndësie të posaçme në kuadrin e veprimeve të organeve të punëve të brendshme, ngase mu këto organe kanë rol vendimmarrës në parandalimin, zbulimin dhe lajmërimin e këtij lloji të shkeljeve. Respektimi i rendit dhe qetësisë publike, njëkohësisht është edhe respektimi i rendit publik, i cili është i rregulluar me rregulla të shumta e të llojllojshme të sjelljes. Me gjithë ato rregulla sigurohet funksionimi i papengueshëm i sistemit shoqëror, politik e ekonomik si dhe rendit juridik. Me shkeljet e rendit publik dhe qetësisë priset disiplina e përgjithshme shoqërore, e cila përbëhet nga harmonia e marrëdhënieve të ndërsjella të qytetarëve, funksionimi i shërbimeve, ushtrimi i veprimtarive, ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësisive.

Neni 5 [Gjuhët]

- (1) Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe.**
- (2) Gjuha Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune ose do të jenë në përdorim zyrtar në cilindo nivel në pajtim me ligj.**

Neni 5

1. Dispozitat e nenit 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës parashohin përdorimin e gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës. Po ashtu me këtë nen përcaktohen gjuhët të cilat kanë statusin e gjuhës zyrtare në nivel komunal ose cilat do të përdoren si gjuhë zyrtare në të gjitha nivelet, në përputhje me ligjin.⁵²

Neni 5.1

1. Në Republikën e Kosovës në përdorim zyrtar janë gjuha Shqipe dhe ajo Serbe (neni 5 paragrafi 1 i Kushtetutës), në bazë të vetë Kushtetutës. Megjithatë, Kushtetuta ka lënë mundësinë që me ligj të rregullohet përdorimi i gjuhëve të tjera (turke, boshnjake dhe rome), si gjuhë zyrtare në të gjitha nivelet (lokal dhe qendror). Në lidhje me përdorimin e gjuhëve, është nxjerrë edhe Ligji për përdorimin e gjuhëve, i miratuar më 27.07.2006, dhe i shpallur nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) me Rregulloren nr. 2006/51 të 20.10.2006.

Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë:

- 1) Përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe gjuhëve të komuniteteve, gjuha amatore e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, në institucionet e Kosovës dhe në organizata e ndërmarrje tjera që ushtrojnë funksione dhe shërbime publike;
- 2) Statusin e barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe, si gjuhë zyrtare të Kosovës, të drejta të barabarta për përdorimin e tyre në të gjitha institucionet e Kosovës;
- 3) Të drejtën e të gjitha komuniteteve në Kosovë për të ruajtur, mbajtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor;
- 4) Karakteri shumëgjuhësor i shoqërisë kosovare që përfaqëson vlerat e veta unike shpirtërore, historike dhe kulturore.
- 5) Ky Ligj përcakton kriteret e përdorimit zyrtar të gjuhëve të komuniteteve tjera (turke, boshnjake dhe rome) në nivel të përgjithshëm. Kur është fjala për përdorimin e gjuhëve në institucionet e Kosovës, atëherë duhet thënë se, sipas ligjit të përmendur, gjuha shqipe dhe serbe dhe alfabetet e tyre kanë status të barabartë, si gjuhët zyrtare në Kosovë. Sa i përket përdorimit të këtyre gjuhëve zyrtare në institucionet kosovare, të gjithë personat kanë të drejta të barabarta.

⁵² Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KI37-10 të 5 korrikut 2012 (Aktvendimi për papranueshmëri në rastin nr. KI37/10. *Nebojša Stanojević, Dragan Marinković dhe 118 ish punëtorët e ndërmarrjes "Banja e Kllokotit"*. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme Nr. SCEL-06-0016 të 10 tetorit 2006 dhe Aktvendimit Nr. CEL 06-016 të 31 janarit 2007). Në këtë rast është dhënë edhe mendimi mospajtues i dy gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Altay Suroy dhe Ivan Čukalović, të cilët kanë theksuar shkeljen specifike të së drejtës së përdorimit të gjuhës të ish punëtorëve të ndërmarrjes "Banja e Kllokotit" si arsye për shkeljen e dispozitave të Kushtetutës për barazinë e gjuhëve zyrtare në Kosovë.

Neni 5.2

1. Ajo çfarë është karakteristike për Kosovën, është fakti se në të jetojnë komunitete të numërta, duke pasur parasysh se edhe me vetë Kushtetutën (neni 3 paragrafi 1) është paraparë se Republika e Kosovës është shoqëri multietnike. Për këtë arsye, është me interes të veçantë, zgjidhja e përdorimit të gjuhëve në komunat me përqindje të vogël të popullsisë në raport me popullatën e përgjithshme të komunës, e gjuhë amtare e të cilëve nuk është gjuha zyrtare,⁵³ as ndonjëra prej gjuhëve zyrtare në Kosovë (neni 5 paragrafi 2 i Kushtetutës). Ashtu, në komunat e banuara me komunitete, gjuhë amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, të cilat përbëjnë së paku 5% të popullatës së përgjithshme të komunës, gjuha e komunitetit do të ketë status të gjuhës zyrtare në komunë dhe do të përdoret barabartë me gjuhët zyrtare.
2. Pa marrë parasysh atë që u tha më parë, posaçërisht, në komunën e Prizrenit, gjuha Turke ka status të gjuhës zyrtare. Ngjashëm me këtë, Ligji parasheh se në ato komuna ku jetojnë komunitete, gjuha amtare e të cilave nuk është asnjëra nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe të cilat përbëjnë më shumë se 3% të numrit të përgjithshëm të popullsisë së komunës, gjuha e atij komuniteti do të ketë statusin e gjuhës në shërbim zyrtar në atë komunë dhe do të jetë në përdorim të barabartë sipas dispozitave të parapara me këtë Ligj (neni 8). Përveç kësaj, gjuha e një komuniteti, e cila tradicionalisht është përdorur në një komunë, ka statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në atë komunë. Neni 35 i Ligjit për përdorimin e gjuhëve, në lidhje me këtë çështje, parasheh përgjegjësinë e atyre komunave që të nxjerrin rregullore më të përafërta, në afat prej 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Ligji. Është përgjegjësi e institucioneve të Kosovës që të sigurojnë të drejta për përdorimin e gjuhës personave të cilët u takojnë komuniteteve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, sipas dispozitave të Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Neni 6 [Simbolet]

- (1) **Flamuri, stema dhe himni janë simbolet shtetërore të Republikës së Kosovës të cilat pasqyrojnë karakterin shumëetnik të saj.**
- (2) **Pamja, mënyra e përdorimit dhe mbrojtja e flamurit dhe të simboleve të tjera shtetërore rregullohen me ligj. Mënyra e përdorimit dhe e mbrojtjes së simboleve kombëtare rregullohet me ligj.**

Neni 6

1. Në dispozitat themelore të të gjithë Kushtetutave, vend standard zënë dispozitat për simbolet shtetërore, ashtu që flamuri, stema dhe himni paraqesin simbolet shtetërore, të cilat pasqyrojnë karakterin e tij multietnik, dhe formalisht simbolizojnë subjektivitetin dhe identitetin e tij. Ashtu është edhe me dispozitat e përfshira në nenin 6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

⁵³ Për më tepër shih: Čok, V., (1993), “Jezik u sistemu prava manjina“, *Jugoslovenska Revija za Medjunarodno Pravo*, nr. 1-2, fq. 134-144.

Neni 6.1

1. Republika e Kosovës ka flamurin e vet, stemën dhe himnin (neni 6 paragrafi 1 i Kushtetutës). Kushtetuta rregullon cilat janë simbolet shtetërore (flamuri, stema dhe himni), përdërisa pamja, mënyra e përdorimit dhe mbrojtja e flamurit dhe simboleve tjera shtetërore rregullohen me ligj.
2. Me flamurin, stemën dhe himnin e Republikës së Kosovës, përfaqësohet Republika e Kosovës ashtu që këto simbole paraqesin identitetin e Republikës së Kosovës. Ato përdoren në pajtim me Ligjin për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës dhe me aktet nënligjore përkatëse, të cilat janë nxjerrë për zbatimin e këtij Ligji. Sipas këtij neni 3 paragrafi 1 i po të njëjtit Ligj, formën, dimensionet e flamurit dhe stemën, përmbajtjen e tekstit dhe partiturën e himnit, e përcakton Kuvendi i Republikës së Kosovës. Gjithashtu, rregullat gjeometrike për pamjen dhe ngjyrën për formimin e stemës, flamurit dhe notat e melodisë së himnit, i përcakton Kuvendi i të Republikës së Kosovës, çfarë është edhe pjesë përbërëse e këtij Ligji (neni 3 paragrafi 2). Originali i simboleve të Republikës së Kosovës ruhet në arkivin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 6.2

1. Rregullimi i mënyrës së përdorimit dhe mbrojtja e flamurit dhe të simboleve kombëtare me Kushtetutë është përcaktuar në dobi të ligjit. Më ligjin për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës (të miratuar në Kuvend më 20 shkurt 2008, dhe të shpallur me dekretin e Presidentit nr. DL-006-2008, 15 maj 2008), është përcaktuar përdorimi i flamurit, stemës dhe himnit, si simbole shtetërore të Republikës së Kosovës. Flamuri i Kosovës është miratuar më 17 shkurt 2008 në Kuvendin e Kosovës. Ai, në sfondin e kaltër, që i përngjan flamurit të Bashkimit Evropian, në mes përmban hartën e Kosovës mbi të cilat në port janë vendosur gjashtë yje të bardha, të cilët që paraqesin gjashtë bashkësitë më të mëdha etnike që jetojnë në Kosovë. Kuvendi i Kosovës, me shpalljen e pavarësisë, në të njëjtën seancë mori një vendim për pamjen, jo vetëm të flamurit por edhe të stemës. Stema vazhdon me të njëjtin model si të flamurit, ka pamjen (formën) e mburojës, dhe është i rrethuar me ngjyrë të verdhë. Himni quhet „Evropa“, kurse melodia nuk ka tekst. Para saj është transmetuar „Oda e Gëzimit“, kënga solemne e BE, tekstin e së cilës e ka shkruar Fridrih fon Shiler (Friedrich von Schiller): “Ëndrrat tuaja lidhen me nyje/që largojnë shumë të këqija/të gjithë njerëzit do të bëhen vëllezër/dh do të lidhin krah ët tuaj”.
2. Përdorimi i flamurit shtetëror të Republikës së Kosovës nga ana e institucioneve shtetërore është e rregulluar me nenin 4 të Ligjit të cekur. Sipas nenit 1 të këtij neni, flamuri shtetëror përdoret në mjediset e brendshme dhe të jashtme të institucioneve, për të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës mund të nxjerrë akte përkatëse nënligjore. Në mënyrë që të theksohen dallimet dhe identifikimi i tyre, disa institucione të caktuara politike, kanë të drejtë në flamurin e vet, i cili dallon nga të tjerët (neni 10 paragrafi 1). Në këto institucione bëjnë pjesë:

- a) Kryetari i Republikës së Kosovës;
 - b) Qeveria e Republikës së Kosovës;
 - c) Ministria për FSK;
 - d) Ministria e Punëve të Brendshme;
 - e) Ministria e Punëve të Jashtme;
 - f) Forcave të Sigurisë së Republikës së Kosovës;
 - g) Trupat Mbrojtëse të Republikës së Kosovës;
 - h) Policia e Republikës së Kosovës; dhe
 - i) Komunitet e Republikës së Kosovës.
3. Në pajtim me nenin 11 paragrafi 1 të Ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Kosovës, stema e Republikës së Kosovës vendoset në hyrje të institucioneve shtetërore, së bashku me emërtesën e tyre, në të gjitha aktet zyrtare, në vulat e institucioneve shtetërore; në dokumentet dhe marrëveshjet ndërshtetërore të Republikës së Kosovës në bazë të reciprocitetit.
4. Intonimi, respektivisht ekzekutimi i himnit shtetëror të Republikës së Kosovës rregullohet me nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit të theksuar. Ai ekzekutohet në ceremonitë zyrtare, në veprimtaritë ndërkombëtare, ku Republika e Kosovës përfaqësohet si palë dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligjet përkatëse. Himni mund të intonohet/ekzekutohet me rastin e solemnitetit zyrtar kur Kryetari i Republikës së Kosovës shkon nga republika e Kosovës në shtete e huaja dhe në rastet e pritjes kur kthehet në Republikën e Kosovës, me rastin e arritjes dhe përcjelljes së kryetarëve të shteteve të huaja ose të zyrtarëve të lartë apo përfaqësuesve të autorizuar të organizatave ndërkombëtare, si dhe me rastin e vënies së kurorave, të cilat i vënë përfaqësuesit zyrtar të Republikës së Kosovës, përkatësisht përfaqësuesit e shteteve të huaja ose të organizatave ndërkombëtare pranë përmendoreve në varreza të dëshmorëve apo të ngjashme (neni 14 paragrafi 5).
5. Përfundimisht, duhet përmendur se ekziston edhe pasaporta kosovare që përfaqëson dokument udhëtimi, e cila u lëshohet qytetarëve të Republikës së Kosovës. Dokumenti lehtëson udhëtimin jashtë vendit dhe shërben si vërtetim i shtetësisë. Lëshimi i pasaportës është prerogativë e posaçme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me përjashtim të pasaportave diplomatike që i lëshon Ministria e Punëve të Jashtme. Pasaporta kosovare plotëson të gjitha standardet e rekomanduara nga Organizata ndërkombëtare e aviacionit civil (ICAO), për pasaportat e lexueshëm kompjuterik (siç janë madhësia, teknologjia, siguria, planifikimi etj). Pamja e pasaportës është shpalosur më 14 mars 2008. Dizajni i pasaportës është ngjyrë e kaltër e mbyllët, me stemën e Republikës së Kosovës. Fjala „pasaportë“ është e shkruar në kopertina të dokumentit në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Të gjitha informatat domethënëse për identitetin e bartësit, janë gjithashtu të shtypura në këto gjuhë. Për të gjithë qytetarët e moshës madhore (18 vjet e më shumë), pasaporta është e vlefshme 10 vjet nga data e lëshimit.⁵⁴

⁵⁴ Para paraqitjes së pasaportave të reja vendore, janë dhënë dokumentet e udhëtimit nga Administrata e Kombeve të Bashkuara, me afat përdorimi deri në 2 vite maksimum. këto dokumente udhëtimi, janë valide deri në kalimin e afatit të tyre.

Neni 7 [Vlerat]

- (1) Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.
- (2) Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore.

Neni 7

1. Ky nen i kushtohet analizës së primeve në të cilët bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës.⁵⁵ Në këto parime, të cilat sipas dispozitave kushtetuese, paraqesin vlerat më të rëndësishme, hyjnë në mes tjerash parimet e lirisë, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe parime tjera. Ajo që është shumë me rëndësi të përmendet është se me aktin më të lartë ligjor, pra me Kushtetutë, garantohet barazia gjinore dhe atë, si vlerë themelore e domosdoshme për zhvillimin demokratik të shoqërisë.

Neni 7.1

Rregulli kushtetues, gjegjësisht rendi kushtetues i Republikës së Kosovës është i bazuar, sipas Kushtetutës, në disa parime (neni 7 paragrafi 2 i Kushtetutës) ku bëjnë pjesë:

- 1) **parimi i lirisë** - ky është parimi pa të cilin rendet e reja kushtetuese nuk mund të mbijetojnë. Në vete përmbledh edhe vlerën e individit, por edhe përgjegjësinë për njerëzimin në përgjithësi. Liria nënkupton mundësinë që secili qytetar bën atë që dëshiron, deri në atë masë që nuk cenon liritë dhe të drejtat e qytetarëve të tjerë, si dhe lirinë e qytetarëve prej çfarëdo varësie, e cila kufizon potencialin dhe energjinë e saj. Vetëdija njerëzore duhet të jetë gjithmonë e lirë dhe e papenguar në përpjekje për të përcjellë risitë, pajtueshmërinë dhe harmoninë. Çdo njeri lindë i lirë dhe i barabartë në të drejtat dhe obligimet ndaj njerëzve të tjerë, dhe ndryshimi mund të vijë vetëm më vonë, në bazë të meritave të tij të punës dhe përpjekjeve.⁵⁶ Kjo liri e qytetarit mund të vijë në shprehje vetëm nëse ekzistojnë pozita të ndryshme klasore, shtesore, racore, gjinore ose ndonjë pengesë tjetër diskriminuese, që do të ia pamundësonte qytetarit realizimin e të drejtave të tij themelore. Në kohën e re dallohet edhe liria nga detyrimi (shtërngimi) si dhe liria nga

⁵⁵ Shih rastin KO119/10 dhe KO01/09 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe komentet në nenin 3 dhe më lartë. Në të dy rastet, Gjykata merret me parimet kushtetuese siç janë barazia, sundimi i së drejtës, mosdiskriminimi etj.

⁵⁶ Krahaso: Hayek, F.A., (1960), 'Constitution of Liberty', University of Chicago Press: Chicago.

dominimi i ideologjive. Prandaj, bashkësitë e reja njerëzore garantojnë edhe të drejtën në lirinë e ndërgjegjes, mendimit dhe të shprehurit, duke përfshirë edhe të drejtën për ide dhe ideologji, të cilat nuk duhet të ndalohen. Por gjithashtu, këto bashkësi të reja nuk mund të tolerojnë dominimin ose sundimin e cilësdo ideologji ose dogme (politike apo religjioze) dhe është e ndaluar që me forcë të imponohet çfarëdo dogme apo ideologjie apo shpallja e saj mbizotëruese, dominante ose superiore;

- 2) **parimi i paqes** - paqja është një gjendje shoqërore ku nuk ka asnjë konflikt përkatësisht luftë.⁵⁷ Përveç mungesës së luftës, paqja mund të nënkuptojë dhe mirëqenien sociale, personale dhe shoqërore. Në historinë e civilizimit paqja ka qenë gjithmonë një gjendje ideale e shoqërisë sepse historinë e karakterizon edhe gjendja e luftës dhe zgjidhjes së armatosur të situatave konfliktuoze. Që lufta është mënyrë dominuese e zgjidhjes së konflikteve në historinë e civilizimit, është treguar edhe kur shfaqet nevoja që bashkësia ndërkombëtare të rregullojë situatën e luftës, që të mund të parandalohen krimet e luftës, përkatësisht „civilizimi“ i gjendjes së luftës me konventat e Gjenevës, të cilat edhe sot janë aktuale, edhe pse, për fat të keq, në konflikte të veçanta luftarake nuk respektohen.⁵⁸
- 3) **parimi i demokracisë** - përkufizimi i thjeshtuar i këtij parimi thekson se ai paraqet vendimin e shumicës, duke respektuar të drejtat e pakicës.⁵⁹ Sigurisht kjo nuk është e lehtë të arrihet, sepse parimi bazë i demokracisë qëndron në faktin se shumica marrin vendime me të cilat udhëhiqen të gjithë në shoqëri. Megjithatë, parimi i vendimmarrjes nga ana e shumicës nuk duhet të jetë absolut, sepse në atë rast, ai i cili fiton në zgjedhjet e para demokratike, fiton edhe në të ardhshmet. Për këtë arsye, duket se zgjedhjet e para janë njëkohësisht edhe të fundit. Gjithashtu, parashtrahet pyetja nëse është e mundur që të kontrollohet shumica.
- 4) Në të vërtetë, në demokracitë e konsoliduara, të pjekura dhe paqësore, respektimi i pakicave është si e mirëqenë. Nuk ka një model ideal të demokracisë, sepse çdo model, respektivisht, ka mangësi të caktuara. Sipas teoricienëve të shumtë, modeli më i afërt me atë ideal është modeli anglez, sepse kushtet të cilat mundësojnë demokracinë janë thelbësore, e Britania e Madhe⁶⁰ në atë fushë të kulturës ka traditë të gjatë;

⁵⁷ Koha e konfliktit mes dy ose më shumë palëve quhet luftë. Lufta është nocion i kundërt me nocionin paqe.

⁵⁸ Shih më shumë rreth kësaj, në: Solis, D. Gary., (2010), *'The Law of Armed Conflict: International Humanitarian Law in War'*, Cambridge University Press: Cambridge; dhe Ben-Naftali, Orna (ed.), (2011), *'International Humanitarian Law and International Human Rights Law'*, Oxford University Press: Oxford.

⁵⁹ Shih zhvilliminë të drejtës për demokraci duke respektuar të drejtat e pakicave, në Nalini, Rajan (2002), *'Democracy and the Limits of Minority Rights'* SAGE Publications Pvt. Ltd: New Delhi and London; McGann, Anthony (2006), *'The Logic of Democracy: Reconciling Equality, Deliberation, and Minority Protection'* University of Michigan Press: Michigan; dhe Lewis, C. Daniel, (2012). *'Direct Democracy and Minority Rights: A Critical Assessment of the Tyranny of the Majority in the American States'*, Routledge: New York and London

⁶⁰ Shih më afër, në Bagehot, W., (2001), *'The English Constitution'*, Cambridge University Press: Cambridge.

- 5) **parimi i barazisë** - ky parim nënkupton se të gjithë qytetarët janë të barabartë dhe gëzojnë status të barabartë dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, pavarësisht nga karakteristikat personale. Secili është i obliguar të respektojë parimin e barazisë, që është, ndalimi i diskriminimit. Vështirësitë e sotme mund të tejkalohen vetëm nëse vendet demokratike vazhdojnë të përparojnë në rrugën që i qon deri te realizimi i parimit të barazisë. Asnjë qytetar nuk duhet të jetë në pozitë të pafavorshme apo të diskriminohet për shkak të përkatësisë etnike, gjinisë, racës, prejardhjes etnike, religjionit apo besimit, paaftësisë, moshës apo orientimit seksual. Të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe ky parim gjithashtu do të thotë se asnjë shtet nuk duhet të ketë përparësi ndaj tjetrit;
- 6) **parimi i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut** - të drejtat dhe liritë e njeriut kuptohen si ideale demokratike⁶¹. Qëllimi i konceptit "të drejtat dhe liritë e njeriut" është përcaktimi i standardeve të përbashkëta në dispozicion të njerëzve, që duhet t'i arrijnë të gjithë popujt dhe kombet, ashtu që secili individ dhe secili qytetar i shoqërisë të përpiqet për respektimin e të drejtave dhe lirive të vendosura.⁶² Edhe pse pjesa më e madhe e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Kapitulli II - Të drejtat dhe liritë) i është dedikuar të drejtave dhe lirive të njeriut, që përmban edhe dispozitat e përbashkëta për këtë lëmi, dispozitat themelore të Kushtetutës përmbajnë parimin se qeverisja e Republikës së Kosovës është e bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të saj dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj (neni 1, paragrafi 2).
- 7) Gjithashtu, në Kapitullin II, ekziston parimi për garantimin e pacenueshmërisë dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut (neni 21.2) i cili përcakton se Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky parim mbështetet në atributin e deklaruar të shtetit të së drejtës. Pra, Kushtetuta përcakton se Republika e Kosovës garanton dhe mbron të drejtat dhe liritë dhe mbi bazën e një vendimi të tillë është krijuar detyrimi për shtetin dhe organet e tij që çdokujt në territorin e vet t'i garantohen të drejtat dhe liritë, të cilat paraqesin trashëgimi të botës së qytetëruar dhe të fusin mekanizmat efektiv për realizimin dhe mbrojtjen e tyre duke siguruar zbatimin e tyre praktik. Kështu, Kushtetuta i referohet pacenueshmërisë së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe në këtë mënyrë thekson integritetin e tyre, që i bën bartësit e këtyre vlerave sociale të pacenueshëm në gëzimin e tyre. Kushtetuta përcakton se çdokush është i obliguar që të respektojë të drejtat dhe liritë e të tjerëve, dmth. "se të gjithë duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të të tjerëve" (neni 21.3- „Parimet e Përgjithshme“). Me këtë dëshmohet për kufijtë e lirive dhe të drejtave të cilat sipas natyrës së tyre nuk janë absolute, por të kufizuara nga të

⁶¹ Donnelly, J., (1996), "Ljudska prava kao prirodna prava", *Pravni život*, nr. 12, fq. 945-962. dhe Hart, L.A., (1989), "Postoje li prirodna prava?" në: Matulovic, Miomir (ed.), *Ljudska prava*, ICR: Rijeka, fq. 41.

⁶² Analizë shumë interesante e të drejtave të njeriut në botën bahkëkohore, ka dhënë: Wellman, C., (1989), "Nova koncepcija ljudskih prava", në: Matulovic, Miomir (ed.), *Ljudska prava* (ICR: Rijeka, fq. 83.

drejtat dhe liritë e të tjerëve. Kjo nënkupton se bartësi i të drejtave dhe lirive mund t'i shfrytëzojë ato vetëm deri në atë masë që nuk do të cenonte të drejtat dhe liritë e barabarta të të tjerëve. Kjo është një detyrë e përgjithshme e të gjitha subjekteve në vend;

- 8) **parimi i sundimit të ligjit**- koncepti i shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit bazohen në idenë se funksioni primar i shtetit është administrimi i punëve publike. Në fillim të shekullit XX vjen deri te formësimi i kësaj ideje dhe shteti paraqet organizatë që ka të ashtuquajturin funksion social dhe detyra e tij primare shihet në ofrimin e shërbimeve publike ndaj qytetarëve. Sundimi i ligjit është një temë nga fusha e filozofisë, politikës dhe ligjit. Përmbajtja e këtij nocioni zakonisht është shprehur me termin „kushtetutshmëri“ që nënkupton nënshkrimin e shtetit, pra, të organeve shtetërore ndaj së drejtës objektive, si dhe ndaj të drejtave të garantuara të individëve.
- 9) Qysh në kohërat antike, Platoni ka folur se „askush nuk duhet të jetë mbi ligjin“, por se çdokush, pra edhe autoriteti më i lartë duhet të jenë në varësi të ligjit, i cili është sunduesi i vërtetë dhe udhëheqës në shtet. Juristët romakë në të drejtën dhe në ligjet e zbatueshme kanë gjetur lidhjen e cila shoqërinë politike, pra shtetin, e mban së bashku (nën pushtet). Përveç shumë dallimeve në të kuptuarit dhe interpretimin e sundimit të ligjit, të gjitha idetë dhe të menduarit kanë diçka të përbashkët. Kjo është ideja se sundimi i ligjit është gurthemel i shtetit modern. Ai siguron të drejtat dhe liritë e individit, por gjithashtu siguron edhe masa efektive të sanksionimit në rast të shkeljes së tyre. Për këtë arsye, sot, çdo shtet modern kushtetues nuk mund të imagjinohet pa ekzistencën e parimit të sundimit të ligjit;
- 10) **parimi i mosdiskriminimit (ndalimi i diskriminimit)** - ky parim, bashkë me parimin e barazisë para ligjit dhe mbrojtjen e barabartë ligjore pa kurrfarë diskriminimi, përbën parimin themelor dhe të përgjithshëm që ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kështu neni 2 paragrafi 1 i Konventës ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, obligon çdo shtet pjesëmarrës që të respektojë dhe sigurojë të gjithë qytetarët brenda territorit dhe juridiksionit të saj, me të drejtat e garantuara me Konventë, pa kurrfarë dallimi, veçanërisht në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, religjionit, ideve politike apo të tjera, prejardhjes kombëtare dhe sociale, pronës, lindjes apo ndonjë statusi tjetër. Për shkak të rëndësisë dhe karakterit të përgjithshëm, parimi i ndalimit të diskriminimit, sikurse parimi i barazisë para ligjit dhe mbrojtjes së barabartë ligjore me nenet e kësaj Konvente, që kanë të bëjnë me kategori të caktuara të të drejtave të njeriut, shprehimisht u referohen atyre. Diskriminimi i qytetarëve paraqet një pengesë të madhe për zhvillimin e çdo shoqërie. Komunitetet me diskriminim të veçantë juridik dhe segregacion të institucioneve që kryesisht orientohen vetëm ndaj një pjese të qytetarëve, eliminojnë qytetarët me aftësi të caktuara. Në shoqërinë e sotme, askush nuk duhet të jetë mbi apo jashtë ligjit;
- 11) **parimi i të drejtës së pronës (e drejta në pronë)**- e drejta në pronë është degë e ligjit që merret me format e pronësisë dhe mbrojtjen e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme. Prona⁶³ është një grup i të drejtave subjektive civile që i

⁶³ Për çdo qytetar është shumë e rëndësishme që me kohë të jetë i informuar për të drejtat e veta,

përkasin një personi dhe në një kuptim më të ngushtë, këto janë gjërat dhe vlerat e tjera ekonomike, të cilat janë objekt i një prone. Kjo do të thotë se në pronë hyjnë jo vetëm gjërat, por edhe të drejta të tjera sidomos ato që kanë vlerë ekonomike.⁶⁴ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Protokolli i parë, neni 1) mbron të drejtën e ushtrimit paqësor të pronës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, me nenin 46, ofron mbrojtje të pasurisë kryesisht me dispozitën e paragrafit 1, me të cilin garantohet e drejta në pronë. Gjithashtu, i njëjti nen në paragrafin 2 përcakton se shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik dhe,, askush nuk duhet të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Për këtë arsye edhe në Rezolutën 1096 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës shkruan se prona, e cila merret/konfiskohet, duhet t'u kthehet pronarëve fillestarë *in integrum*, përveç nëse me këtë cenohen të drejtat e pronarëve të rinj të fituara „në mirëbesim“, pra të fituara në mënyrë të ndershme dhe ligjore;

- 12) **parimi i mbrojtjes së mjedisit** - konsiderojmë së këtu duhet të shtojmë fjalën „jetësor“, sepse neni 52 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcakton „përgjegjësinë për mjedisin jetësor“, duke paraparë se „natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin“. Mjedisi jetësor përfaqëson një grup të resurseve natyrore dhe të krijuara, ndërlihdja komplekse e të cilave përbën ambientin, përkatësisht hapësirën dhe kushtet e jetës.
- 13) Shumica e legjislacionit, sot, në mënyrë që të sigurojnë mbrojtjen e nevojshme të mjedisit jetësor, përcaktojnë parimet e përshtatshme të mbrojtjes, të cilat përfshijnë për shembull: parimin e integritetit (organet e shtetit dhe organet e pushtetit lokal sigurojnë integrimin e mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimin e mjedisit jetësor), parimi i parandalimit dhe masave parandaluese (çdo aktivitet duhet të planifikohet dhe mendohet mirë me rastin e vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor), parimi i ruajtjes së resurseve natyrore, parimi i zhvillimit të qëndrueshëm dhe parimet tjera. Në realizimin e së drejtës për një mjedis të shëndetshëm, rëndësi të madhe ka sidomos parimi i informimit, i cili mundëson që çdokush të jetë i informuar për gjendjen e mjedisit jetësor dhe të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes zbatimi i së cilës mund të ndikojë në mjedisin jetësor. Përfundimisht, në këtë pikë nuk mund të mos theksojmë parimin e së drejtës për një mjedis të shëndetshëm dhe qasjen në drejtësi, të cilat çdo qytetari apo grupi të qytetarëve, shoqatave të tyre, organizatat profesionale, u sigurojnë mundësinë që të drejtën e tyre kushtetuese për një mjedis të shëndetshëm jetësor ta ushtrojnë para organeve kompetente, përkatësisht gjykatave, në pajtim me ligjin;
- 15) **parimi i së drejtës / drejtësisë shoqërore (sociale)**- të drejtat e njeriut nuk përfshijnë vetëm të drejtat civile dhe politike por edhe kulturore, ekonomike dhe shoqërore (sociale). Të drejtat shoqërore (sociale) janë një numër i normave ligjore që sigurojnë standardin e jetesës në shoqëri. Këto të drejta

që kanë të bëjnë me pronën. Më shumë rreth kësaj shih: Hiber, D., “Pravno informisanje i svojina“ *Pravni zivot*, nr. 10, 1995, fq. 65-79.

⁶⁴ Rreth kësaj më gjerësisht: Cok, V., (1989), ‘Svojina kao pravo coveka’ *Jugoslovenska Revija za Medjunarodno Pravo*, nr.1-2, fq. 38-49.

përfshijnë një shumëllojshmëri të shërbimeve dhe përfitimeve në fushën e shëndetit, arsimit, sigurisë sociale etj. Sipas Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, të drejtat sociale janë trajtuar si një element i standardit të jetesës. Sipas këtij orientimi, çdokush ka të drejtë për një standard të jetesës që siguron shëndet dhe mirëqenie të individit dhe të familjes së tij. Këtu përfshihen: ushqimi, veshmbathja, banimi, kujdesin mjekësor, shërbimet sociale dhe të drejtën për siguri në rast sëmundjeje, papunësie, paaftësie, vejtshërie, pleqërie apo mungesa të tjera të jetesës në rrethana përtej vullnetit të tij;

- 16) ***parimi i pluralizmit*** - pluralizmi (shumëllojshmëria) përfaqëson të kundërtën e monizmit dhe përshkruan idenë e jetës së përbashkët paqësore të njerëzve me interesa, besim dhe mënyrë jetese të ndryshme. Në të kundërtën e ideve totalitariste, pluralizmi njih diversitetin ekzistues të interesave dhe qëndrimeve politike. Konsiderohet ekzistenca e tyre individuale, përfaqësimit individual si dhe shfaqja e qëndrimeve të ndryshme në mënyrë legjitime dhe të dëshirueshme. Përveç tolerancës parimi më i rëndësishëm i përgjithshëm i sistemit politik pluralist është parimi i subsidiaritetit. Në fakt, të gjitha çështjet që nuk mund të zgjidhen në nivelin politik u janë lënë organizatave të caktuara sociale, si për shembull, bashkësia fetare për besimtarët e saj. Hallka më e rëndësishme në zinxhirin e pluralizmit është liria e çdo individi që të ketë mundësinë për shkëmbim pikëpamjesh (opinionesh) dhe mundësia për përfaqësimin e interesave dhe pikëpamjeve të përbashkëta. Dallojmë disa lloje pluralizmash siç janë: politik, partiak, kulturor, religjioz, pronësor, sindikal dhe pluralizma të tjerë;
- 17) ***parimi i ndarjes së pushtetit shtetëror*** - ky parim në teorinë dhe praktikën e shteteve juridike moderne, paraqet parimin kyç dhe themelin e organizimit të pushtetit shtetëror si dhe marrëdhëniet mes tri degëve të pushtetit (ligjvënësë apo legjislativë, përmbarimore apo ekzekutive dhe gjyqësore apo judikative). Për të shmangur përkatësisht për të zvogëluar dukshëm mundësinë e keqpërdorimit të pushtetit, është e domosdoshme që pushteti shtetëror të jetë i ndarë në mënyrë që të tri degët e pushtetit të jenë të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese, por edhe që në mënyrë të ndërsjellë të kufizojnë dhe kontrollojnë njëra-tjetrën. Pushteti i përgjithshëm shtetëror nuk humb cilësinë e tërësisë organizative dhe funksionale, por ka të bëjë me ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësive të përbashkëta shtetërore, dhe me ndarjen e punës të zbatuar në organet shtetërore. Kështu pengohet edhe koncentrimi i pushtetit në një person ose organ si dhe ushtrimi arbitrar i pushtetit dhe arrihet kontrolli i ndërsjellë si dhe baraspesha në sistemin e ndarjes së pushtetit. Në pikëpamje të raporteve organizative dhe funksionale të tri degëve të pushtetit në shtetet bashkëkohore juridik çështja kyçe është raporti mes pushtetit legjislativ dhe përmbarimor. Këto dy pushtete janë të karakterit politik dhe mes tyre në kuadër të sistemit të pushtetit parlamentar, ekziston një marrëdhënie e drejtpërdrejtë funksionale, një shkallë e lartë e ndërvarësisë, kontroll dhe baraspeshë e ndërsjellë. Këtë baraspeshë në praktikën bashkëkohore në mënyrë të rrezikshme e dëmton roli gjithnjë në

ritje i degës së ekzekutivit e cila, si një emanacion i shumicës parlamentare, dominon mbi pushtetin parlamentar, shpesh duke e zvogëluar në mekanizëm të vet ekzekutiv votues. Për dallim nga marrëdhënia e këtyre dy degëve të pushtetit, pushteti gjyqësorë (si pushtet ekspertësh), është i pavarur në punën e vet në raport me dy degët e tjera (sa i përket pushtetit politik) dhe ka të bëjë vetëm me kushtetutën dhe ligjin. I rëndësisë së veçantë është roli i gjykatave kushtetuese si gardianë të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, e me këtë edhe gardianë të parimit kushtetues të ndarjes së pushtetit;

- 18) **parimi i ekonomisë së tregut** - ekonomia e tregut është sistem i tillë i ekonomisë që bazohet në sistemin e ndërmarrësisë dhe konkurrencës së lirë, dhe duke vepruar nëpërmjet mekanizmave të tregut, ku oferta dhe kërkesa përcaktojnë çmimet në treg. Tregu dhe mekanizmi i tregut si të tilla janë të bazuara në teorinë ekonomike. Pjesëmarrësit janë të lirë për të vepruar në kushtet e konkurrencës së lirë dhe ekonomisë së tregut, kurse ekonomia e lirë e tregut përfshin fushat e mallrave, shërbimeve, prodhimeve, punës, tokës dhe kapitalit. Ekonomia e tregut nënkupton konkurrencën dhe zgjedhjen e lirë të konsumatorit, e parakushti kryesor për funksionimin e saj është ekzistimi i pronës private. Në ekonominë e tregut, përveç parimit *laissez faire*,⁶⁵ shteti ka obligim për të vendosur rregullat e përgjithshme të lojës së aktiviteteve ekonomike dhe për të siguruar sundimin e ligjit.⁶⁶ Për kalimin në ekonominë e tregut janë të domosdoshme: privatizimi, liberalizimi i çmimeve dhe tregtisë së jashtme, konvertimi i valutës, një buxhet i balancuar shtetëror dhe zvogëlimi i të gjitha formave të rregullimit të tregut.⁶⁷ Kjo qasje ndaj parimeve të tregut është realizuar plotësisht në Kosovë, ashtu si në vendet e universiteteve ish-komuniste të Evropës.⁶⁸ Kjo do të shihet në komentin e Kreut të IX (Marrëdhëniet ekonomike) të Kushtetutës (nenet 119-122).

⁶⁵ Laissez-faire (gjerm. Liberalismus) është deviza e liberalizmit ekonomik dhe do të thotë: "Le të bëjë kush të dojë çfarë të dojë dhe gjithçka le të shkojë sipas rrjedhës së vet". Kjo doktrinë bazohet në kërkesën për eliminim të intervenimit të shtetit në rrjedhat e ekonomisë dhe tregtisë, duke ia lënë veprimtarisë së lirë të ligjshmërive ekonomike dhe konkurrencës së pakufizuar tregtare.

⁶⁶ Në teorinë ekonomike kjo doktrinë konsiderohet për një kohë të gjatë si bazë më e fortë e ekonomisë politike. J.M.Keznes dhe teoria e tij, paraqesin iniciativë në braktisjen e doktrinës *laissez faire* dhe vendosjen e kufizimit të nevojshëm të iniciativës private dhe kapitalit, si dhe kontrollin e tregut.

⁶⁷ Modelin e lirisë për ekonominë e tregut, për herë të parë e ka përshkruar Adam Smith (1723-1790). Prodhimi dhe konsumimi janë nën kontrollin e tregut. Shteti vepron drejtpërdrejtë në treg, me anë të ofrimit të të mirave publike dhe krijimit të sistemit juridik

⁶⁸ Rreth përvojave të vendeve komuniste të Evropës, krahaso: Whitefield, Stephen and Evans, Geoffrey, (2001), "Attitudes Towards the West, Democracy and the Market", në Zielonka, Jan (ed.), *Democratic Consolidation in Eastern Europe. International and Transnational Factors Volume II* (Oxford University Press: Oxford, fq. 192- 230; dhe Nello, Senior Susan (2001), "The Impact of External Economic Factors. The Role of the IMF", në Zielonka, Jan (ed.), *Democratic Consolidation in Eastern Europe. International and Transnational Factors Volume II* (Oxford University Press: Oxford, *Volume II*, fq. 76-111.

Neni 7.2

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës është një nga kushtetutat e rralla në të cilën garantitë kushtetuese të barazisë gjinore kanë gjetur vend në dispozitat themelore të Kushtetutës (neni 7, paragrafi 2 i Kushtetutës). Pra, në paragrafin e mësipërm parimisht sigurohet (garantohet) barazia e grave dhe burrave si një vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.⁶⁹ Kushtetuta e bën këtë në mënyrë që të sigurojë mundësi të barabarta politike, që parimi i garantimit të statusit të barabartë të burrave dhe grave të mund të realizohet në mënyrë efektive.
2. Republika e Kosovës siguron këtë barazi për të ofruar mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e të dy gjinive në jetën politike, sociale dhe kulturore si në të gjitha fushat dhe sferat e jetës shoqërore. Kjo politikë e mundësive të barabarta obligon shtetin e themeluar mbi parimet e drejtësisë shoqërore dhe sundimit të ligjit (neni 7 paragrafi 1 i Kushtetutës) dhe që garanton barazinë e grave dhe burrave për të vendosur dhe përdorur një shumëllojshmëri të instrumenteve (ligjet, masat e veçanta, strategjitë dhe aktivitetet), qëllimi i të cilit është të eliminojë kryesisht pabarazinë faktike ndërmjet grave dhe burrave duke krijuar kushte që gratë dhe burrat nën kushte të barabarta të mund të shfrytëzojnë të gjitha të drejtat e tyre. Pikërisht për të siguruar barazi gjinore, me aktet më të rëndësishme të përgjithshme të Republikës së Kosovës, është paraparë një përqindje e caktuar e grave në Kuvend, Qeveri, dhe institucione komunale. Përkatësisht, në Kuvend gratë kanë pjesëmarrje të garantuar me 30%, në Qeveri përfaqësohen me 14 %, derisa në institucione komunale me 34 %. Barazia gjinore është një nga vlerat themelore të zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, dhe prandaj, është obligim i gjithë shoqërisë për eliminimin e pengesave dhe për të garantuar sjelljen, pozitën, mundësitë e përfitimeve të barabarta për të dy gjinitë në të gjitha sferat e jetës.
3. Çdo trajtim i pabarabartë i një individi në krahasim me një individ të gjinisë së kundërt në rrethana të njëjta ose të ngjashme, konsiderohet diskriminim i drejtpërdrejtë në bazë të gjinisë. Në mënyrë që të zbatohen këto kërkesa për pjesëmarrje më të madhe të grave në Kuvend, në Qeveri dhe struktura komunale, si dhe në të gjitha sferat shoqërore, politike, kulturore dhe ekonomike të jetës në Republikën e Kosovës, në çdo ministri të Qeverisë ekziston njësi e të drejtave të njeriut si organ për mbikëqyrje dhe këshillim në të gjitha fushat e administratës mbi çështjet gjinore. Gjithashtu me publikimin e Ligjit për Barazi Gjinore, është themeluar edhe Zyra për Barazi Gjinore e cila më vonë është transformuar në Agjencinë për Barazi Gjinore. Kjo Agjenci është përgjegjëse për promovimin e vlerave dhe mundësive të barabarta për të gjithë pavarësisht gjinisë. Kështu neni 21 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në Parimet e përgjithshme, përcakton se Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të përcaktuara me këtë Kushtetutë, dhe se të gjithë janë të obligueshëm

⁶⁹ Krahaso: Mezey, Gluck. Susan, (2011), *Elusive Equality: Women's Rights, Public Policy, and the Law* Lynne Rienner Pub: Boulder, California dhe Venter, M. Christine (2012), *International Women's Rights, Equality and Justice* Carolina Academic Press; USA.

që të respektojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve (paragrafi 3). Këto të drejta dhe liri themelore të përcaktuara me Kushtetutë vlejnë edhe për personat fizikë për aq sa janë të zbatueshme (paragrafi 4).

4. Grupi i grave deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës (gjithsej ka 38 gra deputete nga 120 deputetë, nga përbërja e përgjithshme e parlamentit të Republikës) është e i angazhuar që të përfaqësojë gratë kosovare dhe të bëhet zëri i tyre në të gjitha institucionet kosovare. Ky grup është i bashkuar në ndërtimin e një Kosove demokratike, në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrja e grave në të gjitha fushat e shoqërisë dhe të vendimmarrjes. Askush nuk mund të paramendojë një vend demokratik pa pjesëmarrjen e grave në të gjitha sferat e jetës shoqërore dhe politike.

Neni 8 [Shteti Laik]

Republika e Kosovës është shtet laik dhe neutral në çështje të besimeve fetare.

Neni 8

1. Në dispozitat shoqërore, Kushtetuta përcakton parimin e shtetit sekular (botëror, laik) dhe në pajtim me këtë parim themelor, shprehimisht parashikon se Republika e Kosovës është neutrale në çështjet e besimit fetar d.m.th. nuk ka religjion shtetëror. Kjo do të thotë se kisha dhe bashkësitë fetar janë të ndara nga shteti dhe se asnjë religjion nuk mund të vendoset si i detyrueshëm (shtetërore).⁷⁰
2. Në kontekst e parimeve të shtetit sekular (laik), garantohet liria e besimit, ndërgjegjes dhe e fesë (neni 38, paragrafi 1), që përfshin të drejtën për të pranuar dhe shprehur besimin, të drejtën për shfaqjen e bindjeve personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar anëtarësimin në ndonjë grup apo bashkësi fetare. Me Kushtetutë është parashikuar që Ligji mund të kufizojë lirinë e garantuar për manifestimin e besimit, ndërgjegjes dhe fesë, vetëm nëse kjo është e domosdoshme për të mbrojtur sigurinë publike dhe rendin publik, shëndetin ose mbrojtjen e të drejtave të personave tjerë (neni 38 paragrafi 4).
3. Kur është fjala për sekularizmin, duhet përmendur se është një lëvizje që përkrahë ndarjen dhe minimizimin e rëndësisë së fesë në jetën publike, prandaj është i njohur me emërtimin materializëm. Është për ndarjen e kishës nga shteti dhe lirinë e mendimit, dhe vetë termi „sekularizëm“, u krijua nga mesi i shekullit të XIX, si

⁷⁰ Në rastet KO45/12 dhe KO46/12 të 25 qershorit 2012 (Aktgjykim sipas kërkesës së Liburn Aliut dhe 11 deputetë të Kuvendit të Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Hocën e Madhe dhe Ligjit për Qendrën Historike në Prizren) Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se parimi i laicizmit dhe neutralitetit të shtetit në çështjet religjioze nuk nënkupton se shteti duhet të jetë neutral në çështjet e mbrojtjes së të mirave kulturore dhe të mirave të pakicave ashtu siç përcaktojnë dispozitat e Kreut II (Të drejtat dhe Liritë Themelore) dhe III (të Drejtat e Bashkësive dhe Anëtarëve të tyre).

kundërshtim për ngritjen e një religjioni shtetëror ose favorizimin e një religjioni në dëm të religjioneve tjera. Gjithashtu duhet përmendur se shoqëria sekulare përbëhet nga populli, qeveria e tij dhe institucionet socio-kulturore, të cilat janë të bazuara në njohuri dhe vlera të cilat nuk janë pesë e traditës apo doktrinës fetare.

4. Fjalët sekularizëm dhe sekular rrjedhin nga gjuha e re latine dhe përkthehen me fjalët: botërorizim (kalimi nga kishtarë në diçka botërore), pra, diçka që i takon kësaj bote dhe jo kishës (fesë). Edhe fjalët nga gjuha greke, më vonë të marra nga latinishtja e re, siç janë: laik, laike, gjithashtu përkthehen me fjalët: laik (person sekular që nuk është prift), popullor, folklor, botëror, laike. Kështu sekularizmi (laicizmi, shtetëzimi) i jetës ka histori shumëshekullore, dhe me vet këtë edhe domethënie të shumta. Megjithatë, sot, me këtë term nënkuptohet ndarja e fesë nga shoqëria dhe nga institucionet e ndryshme të saj.

Neni 9 [Trashëgimia Kulturore dhe Fetare]

Republika e Kosovës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare.

Neni 9

1. Trashëgimia kulturore dhe fetare i takon të gjithëve dhe të gjithë duhet ta kenë të qartë, pavarësisht mosmarrëveshjeve dhe pakënaqësive politike. Këto mosmarrëveshje dhe keqkuptime të ndërsjella mes njerëzve sidomos pjesëtarëve të kulturave dhe besimeve të ndryshme fetare, mund të shprehen në mënyra tjera e jo me shkatërrimin e monumenteve fetare dhe kulturore. Për këtë qëllim, Misioni i OSBE-së në Kosovë, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore,⁷¹ dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, organizojnë bashkërisht një sërë diskutimesh për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me nevojën për të mbrojtur trashëgiminë kulturore dhe fetare. Këto diskutime organizohen sipas një plani të caktuar në kohë të ndryshme në të gjithë Republikën në më shumë vende. Ligji për Trashëgiminë Kulturore, i miratuar në vitin 2006, parasheh përgatitjen e listës së trashëgimisë kulturore, arkeologjike dhe arkitektonike për të cilat kërkohet mbrojtja. Ruajtja e kësaj trashëgimie është e një rëndësie të madhe, pasi përfaqëson një pasuri të paçmuar për gjeneratat e ardhshme.
2. Monumentet kulturore dhe fetare të rëndësisë së veçantë për komunitetin, duhet të kenë sigurinë e nevojshme, me ç'rast përgjegjësia kryesore për të siguruar trashëgiminë fetare dhe kulturore të Kosovës, duhet të jetë mbi agjencitë kosovare për mbajtjen e rendit dhe qetësisë, e veçanërisht të shërbimit policor të Kosovës. Mbrojtja e monumenteve fetare dhe kulturore, së pari e kishës serbe, manastireve

⁷¹ Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore është organ i cili themelohet nga Kuvendi i Kosovës dhe përcakton objektin dhe veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore. Këshilli përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët zgjidhen në mandat prej tre vjetësh nga ana e Kuvendit të Kosovës, me respektimin e përbërjes etnike të Kosovës.

dhe ndërtesave tjera fetare, sipas planit më të fundit, do të jetë detyrë e veçantë operacionale e Shërbimit policor të Kosovës. Një numri të objekteve kulturore dhe fetare të rëndësisë së veçantë duhet t'u jepet mbrojtje e veçantë në formën e krijimit të zonave të mbrojtura. Synimi i zonave të mbrojtura, para së gjithash, është për të siguruar për ekzistencën paqësore dhe funksionimin e vendeve të mbrojtura, dhe për të ruajtur mjedisin e tyre historik, kulturore dhe natyror.

3. Me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore (i miratuar nga Kuvendi më 09.10.2006, i shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të OKB më 06.11.2006 - zbatohet së bashku me Rregulloren e UNMIK-ut për shpalljen e tij Nr. 2006/52 të datës 06.11.2006), përcaktohet se objekt i këtij ligji janë vlerat e trashëgimisë kulturore që janë krijuar gjatë shekujve, si dhe mjetet ligjore dhe teknike për inventarizimin, dokumentimin, përzgjedhjen, mbrojtjen, konservimin, restaurimin, administrimin, prezantimin dhe përhapjen e kësaj pasurie në përputhje me kartat dhe konventat ndërkombëtare, pavarësisht nga pronësia e trashëgimisë kulturore që është nën mbrojtje. Vlera historike dhe kulturore e kësaj trashëgimie janë pasuri për të gjithë qytetarët (neni 1, paragrafi 1).
4. Trashëgimia kulturore, e cila parashikohet me këtë Ligj përfshin trashëgiminë arkitekturale, arkeologjike, të luajtshme dhe shpirtërore, pavarësisht nga koha e krijimit dhe ndërtimit, tipi i ndërtimit, përdoruesit, krijuesi dhe zbatuesi i biznesit. Gjithashtu, trashëgimia kulturore që ndërlidhet ose derivon nga konfesionet fetare, do të rregullohen nga legjislacioni që rregullon statusin e komuniteteve fetare në Kosovë (neni 1, paragrafi 3). Objektivi kryesor i këtij Ligji është që të rregullojë fushën ligjore të trashëgimisë kulturore në aspektin e ruajtjes, mbrojtjes, qasjes publike dhe sigurimin e kësaj trashëgimie, me qëllim që të shfrytëzohet nga brezi i tanishëm, por edhe për të kaluar tek gjeneratat e ardhshme, si dokument historik dhe kulturor. Çdo person fizik ose juridik është i obliguar që të sigurojë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, dhe në qoftë se një person dëmton trashëgiminë kulturore, dënohet ose sanksionohet sipas Kodit Penal të Kosovës, Ligjit për Kundërvajtje, dhe në përputhje me këtë Ligj. Trashëgimia kulturore shpirtërore përfshin format e shprehjes kulturore të traditave popullore, zakonet, gjuhën, festat, ritmet, vallet, muzikën, këngët dhe veprat krijuese artizanale. Kjo trashëgimi është një pjesë integrale e trashëgimisë kulturore të civilizimit në përgjithësi. Kjo është një ndërveprim shpirtëror, i nevojshëm dhe i pakalueshëm si dhe formë e komunikimit. Prandaj, trashëgimia kulturore shpirtërore mbrohet në forma të ndryshme të dokumentimit dhe regjistrimit, ruhet dhe promovohet në pajtim me Ligjin dhe parimet ndërkombëtare, standardet dhe me praktikën juridike.⁷²

⁷² Në rastet KO45/12 dhe KO46/12, të theksuara më lart, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës qartazi ka bërë me dije se ekziston një detyrim kushtetues i shtetit për të mbrojtur dhe për tu kujdesur për të gjitha bashkësitë që jetojnë në Kosovë, në mënyrë të barabartë dhe pa kurrfarë diskriminimi, duke përfshirë këtu edhe marrjen e hapave dhe masave pozitive për të arritur atë qëllim.

Neni 10 [Ekonomia]

Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës.

Neni 10

1. Rregullimi ekonomik në Republikën e Kosovës bazohet në dy parime themelore, të cilat janë të përcaktuara në Kushtetutë. Këto janë ekonomia e tregut dhe tregu i lirë. Ne konsiderojmë se ky nen për shkak të rëndësisë së tij për shtetin, duhet të zgjerohet edhe në disa parime, në mesin e tyre, sigurisht që bie liria e ndërmarrësisë, vetë-mbështetja e subjekteve ekonomike, barazia e pronës private dhe të gjitha formave të tjera të pronës.⁷³
Natyrisht, nuk duhet harruar se, këto dy parime themelore, të përcaktuara me nenin 119 (Kapitulli IX), me të cilin parashihet se “ Republika e Kosovës siguron mjedisin ligjor për tregti, ndërmarrësinë e lirë dhe sigurimin e pronës private dhe publike“. Gjithashtu, me paragrafin 2 të këtij është përcaktuar që të gjithë investitorët dhe të gjithë ndërmarrësit vendas dhe të huaj kanë të drejta ligjore të barabarta, derisa me paragrafin 3 parashihet ndalimi i të gjitha veprimeve me të cilat kufizohet konkurrenca e lirë, krijimi dhe keqpërdorimi i pozitës monopolistike ose dominuese (përveç nëse, në ndonjë mënyrë të veçantë lejohet me ligj).
2. Çka është e rëndësishme për ekonominë e tregut, është se nënkupton konkurrencën, prandaj, në këtë pikë është me rëndësi që të theksohet neni 119.3 tashmë i përmendur i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, metë cilin janë: “të ndaluara veprimet me të cilat kufizohet konkurrenca e lirë, krijimi dhe keqpërdorimi i pozitës monopolistike ose dominuese”. Në këtë ekonomi, prodhimi dhe konsumi janë të kontrolluara nga tregu, ndërsa shteti vepron vetëm në mënyrë indirekte në treg, përmes ofrimit të të mirave publike dhe krijimin e sistemit ligjor. Konkurrenca mes prodhuesit dhe ofruesit të shërbimeve ndihmon në përmirësimin e cilësisë dhe uljen e çmimit.
3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 10) përcakton se bazë e rregullimit ekonomik është ekonomia e tregut, por me konkurrencë të lirë që paraqet kusht të domosdoshëm për krijimin e kësaj forme të aktivitetit ekonomik. Karakteristikat më të rëndësishme të tregut të lirë janë:
 - 1) liria e kontratës;
 - 2) liria e ndërmarrësisë;
 - 3) liria e konsumatorëve;

⁷³ Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KO97-12 të 12 prillit 2013. Në këtë rast (*Aktgjykimi në rastin KO: Kërkesë e Avokatit të Popullit të Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 90, 95 (1.6), 110, 111,116 të Ligjit për Banka, institucione mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare, nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012*), Gjykata në paragrafët 113 deri 137 ka elaboruar çështjet më të detajuara të pronës dhe ekonomisë, barazia në treg dhe siguria pronësore si dhe raportet tjera në ekonomi.

- 4) liria e tregtisë;
- 5) liria e pronës private;
- 6) liria e formimit të çmimeve të prodhimit, siç përcaktohet sipas kërkesës dhe ofertës;
- 7) Qasje e lirë në treg për konsumatorët dhe prodhuesit mundëson një shpërndarje të konsiderueshme të burimeve;
- 8) Konkurrenca e lirë.

Pikërisht për këtë, në këtë nen mund të bashkërenditen dispozitat e nenit 119 të Kushtetutës, të cilat garantojnë mbrojtjen e konsumatorit, nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik nga ana e Republikës së Kosovës, si dhe sigurimin e pronës publike dhe private.

Neni 11 [Valuta]

- (1) Në Republikën e Kosovës si mjet i vlefshëm pagese përdoret një valutë e vetme.**
- (2) Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës është i pavarur dhe quhet Banka Qendrore e Republikës së Kosovës**

Neni 11

1. Ky nen parasheh përdorimin e një monedhe të vetme në tërë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe pavarësinë e autoritetit të bankës qendrore në këtë territor.

Neni 11.1

1. Kosova ka përdorur markën gjermane si monedhë zyrtare prej vitit 1999. Nga 28 shkurti 2002, marka gjermane u zëvendësua me euron si valutë zyrtare dhe e vetme.

Neni 11.2

1. Në sistemin kushtetues të Kosovës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka statusin e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës. Ligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (miratuar nga Kuvendi më 05.06.2008, i shpallur me Dekretin e Presidentit, nr. DL-028-2008, të 15/06/2008) përcakton statusin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Sipas këtij Ligji, Banka Qendrore e Kosovës (BQK), është pasardhëse e Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosovës dhe e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës. Kjo është një subjekt i pavarur juridik me cilësi të plota të juridik sipas normave të zbatueshme juridike (neni 1). Kjo Bankë, me seli në Prishtinë dhe e cila nuk ka degët e veta, bashkëpunon me Kuvendin dhe Qeverinë dhe me organet e tyre përkatëse në arritjen e qëllimeve të veta, rregullisht me kohë dhe objektivisht informon publikun, Kuvendin dhe Qeverinë për analizat e veta makro-ekonomike dhe zhvillimet financiare të tregut dhe në lidhje me të dhënat përkatëse statistikore. Guvernatori i Bankës Qendrore të

Kosovës, së paku një herë në vit, i paraqet Kuvendit i Kosovës një raport gjithëpërfshirës mbi gjendjen e sektorit financiar në Kosovë (neni 9, paragrafi 2).

2. Sa i përket Guvernatorit, i cili udhëheq Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, duhet theksuar se Banka ka një bord të drejtorëve që përbëhet nga pesë anëtarë dhe përbëhet nga Guvernatori dhe katër zëvendësit e tij. Këtu është shumë interesante mënyra e zgjedhjes së Guvernatorit, i cili do t'i raportojë Kuvendit, dhe do t'i përgjigjet për punën e vet. Sipas nenit 18, paragrafi 2 (a), Bordi së pari nominon kandidatë për guvernator dhe të njëjtit i rendit në bazë të kualifikimeve të tyre dhe të performancës në intervistë dhe shpjegon arsyen për renditjen e tillë. Pastaj Bordi dorëzon listën e nominimeve në Kuvend për miratim (neni 18 paragrafi 2 (b)), dhe pas miratimit nga ana e Kuvendit, këto propozime i përcillen Presidentit të Republikës së Kosovës për emërim (neni 84 pika 27), pasi që ai emëron edhe anëtarët e tjerë të Bordit Drejtues të Bankës. Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të 26 marsit 2007, emërimi i Guvernatorit sipas nenit 18 paragrafi 1 të këtij ligji do të bëhet vetëm pas miratimit nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar.
3. Guvernatori, ne përputhje me Nenin 29 paragrafi 1 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, është përgjegjës për zbatimin e politikave të miratuara nga Bordi, si dhe për të menaxhuar administratën, planifikimin dhe ekzekutimin e strategjive për të arritur objektivat kryesore të Bankës Qendrore të Kosovës. Guvernatori është përgjegjës ndaj Bordit drejtues për ekzekutimin e vendimeve të saj dhe për menaxhimin dhe kontrollin në fushën e administrimit dhe të funksionimit të Bankës Qendrore të Kosovës. Gjithashtu, Banka ka edhe Inspektorin e Përgjithshëm, që është i caktuar nga Guvernatori me miratimin e Bordit drejtues. Inspektori i Përgjithshëm duhet të jetë një person i cili i plotëson kualifikimet e kërkuara për të shërbyer si anëtar i Bordit drejtues.
4. Mund të thuhet se dispozitat e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, nuk janë të plota. Kushtetuta nuk jep përgjigje për pyetjen, se si manifestohet dhe se si është pasqyruar pavarësia e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, në rrethanat në të cilat ajo është përgjegjëse ndaj Bordit të Drejtorëve, dhe të paktën një herë në vit, i dorëzon Kuvendit një raport gjithëpërfshirës për situatën në sektorin financiar në Kosovë. Gjithashtu, kur është fjala për kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës (neni 65 i Kushtetutës), me asnjë fjalë të vetme, nuk përmenden marrëdhëniet ndërmjet Kuvendit dhe Guvernatori, përkatësisht Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Neni 12 [Pushteti Lokal]

- (1) **Njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës janë komunat.**

(2) Organizimi dhe kompetencat e njërive të vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj.

Neni 12

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton qeverinë lokale në dispozitat e saj themelore (neni 12), kurse të drejtën e qytetarëve për vetëqeverisje lokale dhe format e ushtrimit të kësaj të drejte, më përparësisht e rregullojnë dispozitat në Kapitullin X, të cilat janë të lidhura me organizimin e vetëqeverisjes lokale dhe territoriale (neni 123-124). Të drejtën për vetëqeverisje lokale, Kushtetuta e përcakton si e drejtë burimore e qytetarëve dhe formë e kufizuar dhe e pushtetit qeveritar. Kufijtë e ushtrimit të këtyre të drejtave të qytetarëve, përcaktojnë parimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë. E drejta për vetëqeverisje lokale, sipas Kushtetutës, "garantohet dhe rregullohet me ligj" (neni 123, paragrafi 1), dmth. Ligji rregullon organizimin dhe juridiksionin e qeverive lokale, ndërsa: "vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese, të cilët janë zgjedhur me votime të përgjithshme, të barabarta, të lira, të drejtpërdrejta dhe të fshehta" (neni 123, paragrafi 2).
2. Kur është fjala për vetëqeverisjen lokale në Republikën e Kosovës, duhet të theksohet që aktivitetet e vetëqeverisjes lokale bazohen në Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, si dhe në respektimin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Duhet gjithashtu të theksohet se vetëqeverisja lokale e Kosovës bazohet në "parimin e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike" (neni 123, paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

Neni 12.1

1. Ajo që është veçanërisht e rëndësishme për komentin dhe analizën tonë, është fakti që njëria themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është Komuna, e cila gëzon një shkallë të lartë të pavarësisë, inkurajon dhe siguron pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse të organeve të organeve komunale. Komuna përbëhet nga bashkësia e qytetarëve të një territori të caktuar, të përcaktuar me ligj dhe që është e autorizuar të merret me të gjitha çështjet që nuk janë të rezervuar shprehimisht për pushtetin qendror. Kushtetuta, edhe në këtë rast, ia lë ligjit kompetencat e krijimit të komunave, vendosjen e kufijve, vendosjen e autoritetit, organizimin dhe funksionimin e komunave. Kur është fjala për kompetencat e komunës, duhet të theksohet se ajo ka tre lloje të kompetencave, dhe atë: kompetencat vetanake (burimore), kompetencat e zgjeruara dhe kompetencat e deleguara. Natyrisht, e gjithë kjo është bërë në përputhje me ligjin, por duhet theksuar se pushteti shtetëror që ia delegon përgjegjësitë e caktuara Komunës, mbulon koston e zbatimit të përgjegjësisë të deleguara, dhe, natyrisht, kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin të detyrave të deleguara.

2. Në mënyrë që Komuna të ushtrojë kompetencat e veta me sukses (si ato burimore edhe ato të zgjeruara dhe të deleguara), ato mund të realizohen me bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkufitar, por natyrisht ne pajtim me ligjin. Për funksionim të suksesshëm komunave u është mundësuar që të vendosin, përcaktojnë, mbledhin dhe shpenzojnë burimet e tyre por edhe të marrin fonde nga pushteti qendror. Natyrisht, e gjithë kjo mund të kryhet në përputhje me ligjin si dhe duke respektuar Kushtetutën dhe ligjet e tjera relevante, dhe duke zbatuar vendimet gjyqësore. Kur është fjala për përzierjen e pushtetit qendror në fushën e kompetencave administrative për shqyrtimit e ligjeve komunale, duhet theksuar se ky autorizim kufizohet vetëm në vlerësimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin.

Neni 12.2

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, siç e kemi theksuar tashmë, garanton pushtetin lokal në nenin 12, duke përcaktuar se komuna është njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale (paragrafi 1). Në paragrafin e ardhshëm të këtij neni, Kushtetuta i referohet për rregullimin ligjor të pushtetit lokal, dispozitën që "Organizimi dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj" (paragrafi 2). Prandaj është nxjerrë edhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale (i miratuar nga Kuvendi më 20.02.2008 dhe është shpallur me Dekretin e Presidentit, nr. DL-008-2008 të datës 15.06.2008.) me të cilin e përcakton "bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës" (neni 1 i Ligjit). Efekti i këtij ligji qëndron në faktin se ai kryesisht përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat e tyre dhe parimet e përgjithshme të financave komunale, organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brendakomunale dhe marrëveshjet e bashkëpunimit ndër-komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.
2. Vetëqeverisja lokale, sipas këtij Ligji, do të thotë e drejta dhe mundësia e pushteteve lokale për të rregulluar dhe menaxhuar pjesën thelbësore të punëve publike brenda juridiksionit të vet, në interes të popullatës lokale. Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues i komunës, i cili përbëhet nga të gjithë këshilltarët e saj të zgjedhur, ndërsa kryetari i komunës është organi më i lartë ekzekutiv i komunës që zgjidhet në zgjedhje të drejtpërdrejta. Kur është fjala për pushtetin lokal, duhet theksuar se vlen parimi i subsidiaritetit, dmth. se punët publike bëhen në interes të qytetarëve të tyre sa më shumë të jetë e mundur, dhe atë nga niveli më i ulët i udhëheqjes që është në gjendje të ofrojë shërbime efikase. Siç e kemi theksuar në fillim të komenteve të këtij neni, komuna ka tri lloje kompetencash, si në vijim:
 - 1) **kompetencat vetanake** - kompetencat që i janë dhënë Komunës në bazë të Kushtetutës ose ligjit dhe për të cilat komuna është plotësisht përgjegjëse për të përmbushur nevojat lokale në përputhje me ligjin (zhvillimi ekonomik lokal, planifikimi urban, shfrytëzimi i tokës dhe zhvillimi, mbrojtja e mjedisit jetësor

në nivel lokal, ofrimi i shërbimeve lokale komunale, kujdesi shëndetësor parësor etj, - neni 17i Ligjit);

- 2) **kompetencat e deleguara** - Kompetencat e pushtetit qendror dhe të institucioneve të tjera qendrore, puna e të cilëve është transferuar përkohësisht tek komunat, sipas Ligjit, (mbajtja e shënimeve kadastrale dhe librave amë, regjistrimi i votuesve, regjistrimin e biznesit, regjistrimin dhe licencimin e biznesit, si dhe shpërndarja e pagesave në drejtim të mirëqenies sociale dhe të tjera - neni 18 i Ligjit);
 - 3) **kompetencat e zgjeruara komunale** - kompetencë që i është bartur një komune ose një numër të caktuar komunash në bazë të ligjit (kujdesi dytësor shëndetësor, shkollimin e lartë, kultura dhe të ngjashme- neni 20-23 i Ligjit).
3. Komunat janë persona juridikë dhe kanë emërtimet dhe kufijtë e tyre, të cilat janë të parapara me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave. Qytetar i komunës është çdo person i cili është qytetar i përhershëm i Republikës së Kosovës dhe i cili jeton në komunën në fjalë. Neni 9 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale përcakton se përdorimi i gjuhëve në komunë rregullohet me Ligjin për përdorimin e gjuhëve, i cili parasheh që Kuvendi i Komunës është përgjegjëse për miratimin e rregullores së detajuar për përdorimin e gjuhëve brenda territorit të saj (neni 9, paragrafi 2 i Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale).
 4. Bashkëpunimi mes komunave në Republikën e Kosovës është mundësuar në atë mënyrë që komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë dhe të krijojnë partneritete me komunat tjera në Republikën e Kosovës, brenda kompetencave të tyre dhe me qëllim që të kryejnë detyrat e interesit të përbashkët, në përputhje me Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale dhe me ligjin përkatës (neni 28 i Ligjit). Veprimtaritë e partneritetit financohen nga buxheti i komunave që janë anëtarë të këtyre partneriteteve. Gjithashtu, komunat mund të realizojnë edhe bashkëpunim ndërkuftar, dmth. kanë të drejtë të hyjnë në marrëveshje me autoritetet e huaja të vetëqeverisjes lokale në fushën e kompetencave komunale vetanake dhe të zgjeruara (neni 30, paragrafi 1 i Ligjit), si dhe në kuadër të kompetencave të tyre vetanake, bashkëpunojnë me komunat dhe institucionet duke përfshirë agjencitë qeveritare të Republikës së Serbisë (paragrafi 2). Komuna kanë të drejtë asociimi në mënyrë që të mbrojnë dhe të promovojnë interesat e përbashkëta, kështu ato mund të formojnë dhe marrin pjesë në asociacionet që funksionojnë në përputhje me Ligjin (neni 31), ndërsa disa komuna mund të anëtarësohen asociacioneve përfaqësuese të pushtetit vendor në Republikën e Kosovës (neni 32, paragrafi 1).
 5. Ajo që është shumë e rëndësishme për punën komunës është funksionimi i saj, pasi kjo mund të shkaktojë shpërbërjen kuvendit komunal jofunksionues. Gjegjësish, në qoftë se kuvendi komunal dështon në kryerjen e funksionit të detyrueshëm sipas standardeve të përcaktuara me Ligj, apo nëse bëhet jofunksionale (dhe kështu, rrezikon ushtrimin e të drejtave themelore të qytetarëve), Ministria e Pushtetit Lokal, i raporton komunës për dështim dhe kërkon që të ndërmerren masa të duhura për të siguruar kryerjen e qetë të funksionit komunal (neni 50, paragrafi 1). Kjo Ministri njofton Qeverinë e Republikës për mosfunksionimin e komunës, dhe

Qeveria e Kosovës mund ta shpërndajë kuvendin e komunës jofunksionuese (neni 50 paragrafi 2).

Neni 13 [Kryeqyteti]

- (1) Kryeqyteti i Republikës së Kosovës është Prishtina.**
- (2) Statusi dhe organizimi i kryeqytetit rregullohet me ligj.**

Neni 13

1. Ky nen përmban një dispozitë për kryeqytetin e Republikës. Kjo do të thotë se, me Kushtetutë, përcaktohet kryeqyteti, ndërsa normat e posaçme ligjore të dedikuara për kryeqytetin më tutje rregullojnë statusin i tij.

Neni 13.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se Prishtina është kryeqyteti i Republikës së Kosovës (neni 13 paragrafi 1i Kushtetutës).

Neni 13.2

1. Për kryeqytetin nxirret ligji i posaçëm i cili rregullon më tej pozicionin dhe kompetencat. Kështu, qyteti i Prishtinës, si qyteti kryesor i Republikës së Kosovës do të rregullohet me ligjin e posaçëm për qytetin e Prishtinës, kurse Ligji për Vetëqeverisjen Lokale zbatohet për kryeqytetin Prishtinën, përveç nëse nuk parashikohet ndryshe me ndonjë ligj të ardhshëm për qytetin e Prishtinës. Në tetor të vitit 2010, në Kuvendin e Kosovës është realizuar një debat i gjerë në lidhje me rekomandimin e Komisionit Funkcional në lidhje me projektligjin për qytetin e Prishtinës, me të cilin ishte propozuar që i njëjti t'i kthehet Qeverisë për përmirësim, ndërsa në mars të vitit 2011, në nivelin më të lartë politik të Republikës së Kosovës, është thënë se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do të jetë përfaqësuesi kryesor i iniciativës për miratimin sa më të shpejtë të ligjit për qytetin e Prishtinës.

Neni 14 [Shtetësia]

Fitimi dhe humbja e së drejtës së shtetësisë së Republikës së Kosovës rregullohet me ligj.

Neni 14

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut e vitit 1948 proklamon të drejtën e çdo personi për një shtetësi, ndalon privimin arbitrar nga shtetësia dhe mohimin e të drejtës për të ndryshuar shtetësinë. Në këtë drejtim, Protokollin nr. 4 i Konventës

Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, i miratuar në vitin 1963, ndalon dëbimin individual ose kolektive të nënshtetasve, si dhe privimin e të drejtave të personave për të hyrë në luftë në territorin e Shtetit në të cilin janë shtetas.

2. Edhe pse shtetësia është një nga të drejtat më të rëndësishme statusore të individit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk garanton në mënyrë eksplicite këtë të drejtë, por e lë ligjin për të rregulluar mënyrën e fitimit dhe humbjes së shtetësisë (neni 14 i Kushtetutës). Megjithatë, fitimit dhe humbjes së drejtës së shtetësisë së Republikës së Kosovës, ndonëse është një çështje tepër e rëndësishme dhe e ndjeshme, i kushton vetëm një fjali, duke mos rregulluar, në të njëjtën kohë, edhe disa çështje që lidhen me shtetësinë, ndërsa për mbrojtjen e qytetarëve të saj dhe interesave të tyre jashtë vendit, Kushtetuta flet në nenin në vijim (neni 15), por, me një fjali të vetme.

Rreth konceptit të "shtetësisë" më shumë kemi folur në komentimin dhe analizën e nenit 1 paragrafi 2, i cili thekson se Republika e Kosovës është shtet i shtetasve të saj. Prandaj, nuk duhet të përsëritet ajo që është thënë më herët, sepse qëllimi ynë kryesor në komentimin e nenit 14 të Kushtetutës, është për të treguar mënyrat e fitimit dhe humbjes së të drejtave të shtetësisë.

3. Megjithatë, këtu është shumë e rëndësishme të theksohet se koncepti "shtetësi" duhet të dallohet nga koncepti "kombësi", sepse "kombësi" nënkupton përkatësinë e një individi ndaj një kombi të caktuar. Në fakt, çdo komb ka bashkëkombësit e vet, të cilët nuk është e thënë që të gjithë të kenë të njëjtën shtetësi, dhe, prandaj, kombësia është koncept etnik. Përkundrazi, shtetësia nënkupton marrëdhënien juridike ndërmjet individit dhe shtetit (vetëm se shteti ka shtetasit e vet, të cilët nuk duhet që të jenë të gjithë të të njëjtës kombësi). Rëndësia e shtetësisë (dhe kombësisë) është e madhe për cdo njeri, sepse në këtë mënyrë i konfirmohet përkatësia e identitetit, por ajo i jep edhe të drejtën për mbrojtje nga shteti, si dhe një numër të të drejtave të tjera civile dhe politike⁷⁴. Duke folur për shtetësinë, në përgjithësi, duhet theksuar se ekzistojnë tri parime themelore për fitimin e saj, si në vijim:

- 1) parimi i lidhjes së gjakut (prejardhja);
- 2) parimi i territorit (lindjes);
- 3) parimi i vendbanimit.

4. Të drejtën për shtetësi e garanton Deklarata Universale e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (Neni 15), i cili proklamon të drejtën e çdo personi për një shtetësi⁷⁵

⁷⁴ Shih më shumë për këtë në: Janoski, Thomas, (1998) *Citizenship and Civil Society: A Framework of Rights and Obligations in Liberal, Traditional, and Social Democratic Regimes*, Cambridge University Press: Cambridge; Gershon Shafir, (1998), *The Citizenship Debates: A Reader*, University of Minnesota Press: Minnesota; dhe Maas, Willem, (2013) *Multilevel Citizenship: Democracy, Citizenship, and Constitutionalism*, University of Pennsylvania Press: Philadelphia,

⁷⁵ Përveç kësaj, ekziston mundësia e mbajtjes së shtetësisë së dyfishtë (në raste të veçanta dhe më shumë shtetësive, që është e rrallë). Për këtë shih më gjerësisht: Čok, V., (1993), "Dvojno

dhe ndalon çdo privim arbitrar nga shtetësia, si dhe mohimit e të drejtës për shtetësisë⁷⁶. Në përputhje me këtë, neni 4 i Ligjit për Shtetësinë e Kosovës, parasheh mbrojtjen e shtetësisë, duke përcaktuar se "qytetarit të Kosovës nuk mund t'i privohet shtetësia e Kosovës, përveç në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara me këtë Ligj". Megjithatë, bie në sy se me dispozitat e lartpërmendura kushtetuese nuk është përcaktuar që shprehimisht ndalohet dëbimi i qytetarëve të saj, edhe pse kjo është një praktikë e zakonshme në kushtetshmërinë krahasuese.⁷⁷

5. Kur është fjala për Republikën e Kosovës, duhet të theksohet se Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke bazuar në Kushtetutën e vet, me qëllim që të vendosë rregullat juridike për shtetësinë, ka miratuar Ligjin për Shtetësinë e Kosovës. Ky ligj u miratua nga Kuvendi i Kosovës, më 20.02.2008, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit, nr. DL-002-2008, më 15.06.2008.
6. Me dispozitat e këtij Ligji janë përcaktuar mënyrat e fitimit, humbjes, si dhe çështje të tjera që lidhen me shtetësinë e Republikës së Kosovës. "Shtetësia" nënkupton një marrëdhënie të ngushtë juridike midis shtetit të Kosovës dhe një person, nga të cilat dalin të drejtat dhe detyrimet reciproke. Shtetas i Republikës mund të jetë një shtetas i një ose më shumë shteteve tjera.
7. Fitimi apo mbajtjen e një shtetësie tjetër nuk shkakton humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës. Duke e krahasuar me tri mënyra e përgjithshme pararendëse për marrjen e shtetësisë, tregojmë mundësinë e marrjes së shtetësisë së Republikës së Kosovës, të parashikuar me nenin 5 të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës, dhe atë me:
 - 1) me lindje;
 - 2) me adoptim;
 - 3) me natyralizim ("natyralizimi" nënkupton fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës në bazë të kërkesës së personit të huaj që nuk është shtetas i Kosovës);
 - 4) në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare;Gjithashtu, me Ligjin për shtetësinë e Kosovës (neni 16) parashihen edhe mënyrat e humbjes së shtetësisë së Republikës së Kosovës, dhe atë:
 - 1) me lirim nga shtetësia;
 - 2) me privim të shtetësisë;
 - 3) në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

državljanstvo u uporednom i međunarodnom pravu“, *Jugoslavenska Revija za Medjunarodno Pravo*, nr. 3, fq. 259-280.

⁷⁶ Qëllimi i përgjithshëm i dokumenteve ndërkombëtare është garantimi i të drejtës për një shtetësi, që të shmangët mundësia që disa persona të jenë bipatridi ose apatridi (persona me dy shtetësi ose pa shtetësi).

⁷⁷ Shih për praktikën e në të drejtën krahasuese dhe doktrinën, në: Wouters, Kees, (2009), 'International Legal Standards for the Protection from Refoulement', Intersentia: UK and US; Meyer, Michel, (2012), 'Qu'est-ce que le refoulement?.' [Kindle Edition] L'Herne: Paris.

8. Disa të drejta Kushtetuta shprehimisht ua garanton qytetarëve, si për shembull, të drejtën zgjedhore, e cila është e garantuar me nenin 45 paragrafi 1, ku parashihet se "çdo shtetas i Republikës së Kosovës, që ka arritur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor".
9. Gjithashtu, në kapitullin XIV të Kushtetutës (Dispozitat kalimtare), në nenin 155 paragrafi 1, përcaktohet se të gjithë banorët e ligjshëm të Kosovës në ditën e miratimit të kësaj Kushtetute, gëzojnë të drejtën e shtetësisë të Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, Republika e Kosovës njih të drejtën e fitimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh vendin e tyre aktual të banimit dhe shtetësisë që ata kanë, të gjithë qytetarëve të ish- Republikës Federative të Jugosllavisë, të cilët kishin vendbanim të përhershëm në Kosovë më 1 janar 1998, si dhe pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë (paragrafi 2).

Neni 15 [Shtetasit jashtë Vendit]

Republika e Kosovës mbron interesat e shtetasve të saj jashtë vendit, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 15

1. Në dispozitat themelore (Kapitulli I), Kushtetuta përcakton qëndrimin aktiv të Republikës së Kosovës ndaj atyre shtetasve të saj të cilët nuk jetojnë në këtë territor, por që (përherë ose përkohësisht) jetojnë në një vend tjetër. Megjithatë, Kushtetuta në lidhje me mbrojtjen e shtetasve të Kosovës jashtë shtetit nuk thotë asgjë më tepër por, mbrojtjen konkrete ia lë ligjit. Duke analizuar dispozitat e Ligjit për Shtetësinë e Kosovës mund të shihet se vetëm neni 4 rregullon mbrojtjen e shtetësisë, duke përcaktuar se "shtetasit të Kosovës nuk mund t'i hiqet shtetësia e Kosovës, përveç në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara me këtë ligj." Për mbrojtjen e interesave të shtetasve të Kosovës që jetojnë jashtë shtetit, Ligji, megjithatë, nuk thotë asgjë.
2. Kur në fillim të komenteve të këtij neni kemi theksuar faktin se ka një qëndrim aktiv të shtetit ndaj qytetarëve të saj që jetojnë jashtë vendit, duhet të përmendet se kjo marrëdhënie është reflektuar dhe realizuar, kryesisht në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të tyre. Ne konsiderojmë se ka qenë e nevojshme që me nenin e përmendur të parashihet edhe dispozita që Republika e Kosovës të zhvillojë dhe përmirësojë marrëdhëniet e shtetasve të saj që jetojnë jashtë vendit me shtetin amë, dhe atë përmes një sërë aktiviteteve dhe ngjarjesh, siç është shpesh rasti në praktikën krahasuese kushtetuese të vendeve tjera.
3. Është shumë e rëndësishme që çdo kushtetutë, si akti më i lartë dhe më i përgjithshëm i shtetit, në dispozitat themelore rregullon çështjen e shtetësisë, veçanërisht mbrojtjen e shtetasve të saj jashtë vendit. Megjithatë, meqë kushtetuta

është njëkohësisht edhe akti më abstrakt, vetëm përgjithësisht, në një fjali, garanton mbrojtjen e interesave të shtetasve të saj jashtë vendit, ashtu siç parashihet me ligj. Ai ligj mbart emërtime të ndryshme, por në fakt, gjithmonë flet për organizimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të përfaqësive diplomatike dhe konsullore. Pra, kjo ministri e secilit vend, nëpërmjet përfaqësive të saj, mbron të drejtat dhe interesat e shtetit të vet dhe të shtetasve të saj jashtë vendit. Përfaqësitë janë diplomatike dhe konsullore. Edhe njëra edhe tjetra kanë detyrë që të mbrojnë shtetasit e vet jashtë vendit. Ku qëndron kjo mbrojtje, zakonisht nuk rregullohet me ligj. Çdo shtet lidh me vendet e tjera konventa të ndryshme (në këtë drejtim, më të rëndësishmet janë konventat konsullore). Kur ka tashmë konventa të tilla, autoritetet diplomatike&konsullore duhet të jenë të kujdesshme për të respektuar të drejtat dhe privilegjet e shtetasve të tyre, pra të shtetasve të shtetit që ata përfaqësojnë, të pranuar nga ato konventa. Me konventa të tilla më së shpeshti pranohen, përmes të ashtuquajturës klauzolë e privilegjit më të madh, të gjitha privilegjet të cilat u njihen qytetarëve të vendeve të tjera në aspektin e hyrjes, veprimtarisë, vendbanimit, mjeshtrisë, industrisë, tregtisë, lundrimit, ushtrimit të profesionit, lirisë punës së kompanive ekonomike që janë me seli në territorin e njëres prej palëve kontraktuese, dhe, së fundi, lirisë së fitimit të të mirave të luajtshme dhe të paluajtshme. Jashtë këtyre konventave dhe në vendet ku konventat nuk janë lidhur, mund t'i shkaktohen shqetësime një shtetasi të një shteti të caktuar, do të thotë që ndaj tij mund të ndërmerren veprimet të paligjshme dhe të ngjashme. Në të gjitha këto raste, përfaqësitë diplomatike dhe konsullore duhet të sigurojnë mbrojtje të shtetasve të vet.

4. Duke pasur gjithë këtë në mendje, do të analizojmë dispozitat e Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Diplomatik të Republikës së Kosovës (miratuar nga Kuvendi më 13 mars 2008, dhe i shpallur me dekreten e Presidentit nr. DL-010-2008, më 15 qershor 2008). Ky Ligj rregullon Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, si dhe përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre (neni 1). Ministria e Punëve të Jashtme dhe Shërbimi Diplomatik i Republikës së Kosovës, janë pjesë e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ajo (Ministria) formulon dhe zbaton politikën e jashtme të Republikës së Kosovës. Si e tillë, Ministria është e angazhuar në veprimtaritë e mëposhtme:
 - 1) zhvillon dhe bashkërendon politikat ndaj shteteve të tjera ndërsa në punët e jashtme, shpreh dhe mbron interesat e Kosovës në raport me vendet e tjera dhe organizatat ndërkombëtare,
 - 2) përfaqëson Kosovën dhe institucionet e saj shtetërore në vendet e jashtme dhe në organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare,
 - 3) ofron ndihmë konsullore shtetasve të Kosovës në vendet e tjera ashtu siç parashihet me akte nënligjore të Ministrisë si dhe mbron të drejtat e kosovarëve me banim të përkohshëm ose të përhershëm në vendet e tjera,
 - 4) rregullisht i raporton Presidentit të Republikës së Kosovës, si dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës,
 - 5) Kryen detyra tjera të domosdoshme.

Neni 16 [Epërsia e Kushtetutës]

- (1) Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë.**
- (2) Pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta.**
- (3) Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare.**
- (4) Secili person dhe organ në Republikën e Kosovës u nënshtrohet dispozitave të Kushtetutës.**

Neni 16

1. Kur është fjala për analizën e nenit 16, i cili flet për epërsinë e Kushtetutës, konsiderojmë se është një nga dispozitat më të rëndësishme sepse tregon pozitën dhe rolin e Kushtetutës në piramidën e përgjithshme të organizimit sociale, politike, ekonomike dhe kulturore të pushtetit në Kosovë.
2. Kjo është për shkak se Kushtetuta është akti më i lartë juridik i përgjithshëm i çdo vendi, ligji themelor i vendit, që institucionalizon ekzistencën dhe funksionimin e pushtetit politik, që rregullon marrëdhëniet themelore socioekonomike dhe politike, siguron një sferë të caktuar të të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe paraqet një mjet të kufizimit të bartësve të pushtetit politik.
3. Ky është një akt solemn, normativ, që ka forcë juridike të ligjit, si e tillë, është simboli i parë i pavarësisë së vendit. Për të parashikuar dhe për qartësi, më vonë me nenet ndryshme, do të rregullohet në mënyrë të veçantë hierarkinë vendore dhe ndërkombëtare të akteve të përgjithshme juridike dhe hierarkinë e akteve ligjore kombëtare.

Neni 16.1

1. Kur rregullon hierarkinë e akteve juridike, Kushtetuta përcakton se të gjitha ato duhet të jenë në pajtueshmëri me të (neni 16 paragrafi 1 i Kushtetutës). Kur rregullon kompetencën e Gjykatës Kushtetuese, Kushtetuta përcakton se kjo Gjykatë është “autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën“ dhe se kjo Gjykatë vendosë, jo vetëm për pajtueshmërinë e akteve juridike ligjore, pra të ligjit me Kushtetutën, por edhe të dekretit të Presidentit dhe Kryeministrit, rregulloreve të Qeverisë, si dhe statutit të komunave me këtë Kushtetutë.

Neni 16.2

1. Në përputhje me parimin e unitetit të rendit juridik (Kushtetuta mbështetet në parimin themelor, sipas të cilit rendi juridik i Republikës së Kosovës është unik, dhe rregullon hierarkinë e rregulloreve ndërkombëtare dhe dispozitave të përgjithshme të së drejtës së brendshme/kombëtare), Kushtetuta rregullon statusin e rregulloreve të ndryshme juridike në sistemin kushtetues (neni 16, paragrafi 1).

Me dispozitën vijuese të këtij neni, të përfshirë në paragrafin 2, theksohet kushtetutshmëria e pushtetit, pra pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta. Kjo do të thotë se aktet individuale dhe veprimet e organeve shtetërore, organizata që u janë ngarkuar kompetencat publike dhe organet e njësive të vetëqeverisjes lokale, duhet të bazohen në Kushtetutë (dhe ligj). Pushteti, më i vjetër, qeverisës, ekziston qysh kur ekziston shteti. Pushteti qeverisës nxjerr aktet individuale dhe të përgjithshme, me qëllim të zbatimit në vepër aktet e pushtetit legjislativ, derisa pushteti gjyqësor zgjidh kontestet në të gjitha nivelet.

Neni 16.3

1. Më tutje Kushtetuta, në paragrafin 3 të këtij neni parashikon që Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare. Kjo është një dispozitë shumë e rëndësishme, e cila ka të bëjë me marrëdhëniet midis së drejtës së brendshme dhe të drejtës ndërkombëtare përkatësisht marrëdhëniet në mes marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare dhe parimeve të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare, në njërën anë dhe ligjeve të Republikës së Kosovës, në anën tjetër.
2. Megjithatë, duke pasur parasysh për këto çështje shumë të rëndësishme dhe të ndjeshme, flitet në nenet 17-20 të Kushtetutës, dhe mbi të gjitha, në nenin 19, i cili do të jetë objekt i një analize të veçantë dhe të detajuar të komentimit tonë, me këtë rast, në mënyrë që të shmanget përsëritja e panevojshme, ne nuk do të ndalemi më shumë në sqarimin e kësaj dispozite.

Neni 16.4

1. Së fundi, në paragrafin 4 të këtij neni, Kushtetuta përcakton një detyrim të përgjithshëm që çdo person dhe organ i Republikës së Kosovës duhet të respektojë dispozitat e Kushtetutës, si akti më i lartë i përgjithshëm juridik në vend. Ky është një detyrim kushtetues i çdo personi fizik ose juridik, i cili në këtë mënyrë tregon gatishmërinë për të mbrojtur parimet themelore të sundimit të së drejtës, i cili është supozimi themelor i çdo kushtetute dhe është i bazuar mbi të drejtat e patjetërsueshme të njeriut, por gjithashtu edhe në detyrimet e tyre. Në një mënyrë, mund të thuhet se sundimi i së drejtës realizohet me garantimin kushtetues të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, ndarjen e pushteteve, sundimin e pavarur gjyqësor dhe, ajo që është më e rëndësishme, sepse me të drejtat vijnë edhe detyrimet, çdo person duhet të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.

Neni 17 [Marrëveshjet Ndërkombëtare]

- (1) Republika e Kosovës lidh marrëveshje ndërkombëtare dhe anëtarësohet në organizata ndërkombëtare.**
- (2) Republika e Kosovës merr pjesë në bashkëpunim ndërkombëtar për promovimin dhe mbrojtjen e paqes, sigurisë dhe të drejtave të njeriut.**

Neni 17

1. Me analizën e nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës fillojmë komentimin e një grupi shumë të rëndësishëm të neneve (nenet 17-20 të Kushtetutës), në lidhje me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politikën e jashtme të Republikës së Kosovës, e cila është e bazuar në parimet përgjithësisht të pranuar dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare.
2. Pra, marrëveshjet ndërkombëtare të cilat ratifikohen nga Republika e Kosovës, d.m.th. nga organi legjislativ i saj (Kuvendi i Republikës së Kosovës - neni 65 paragrafi 4), janë pjesë përbërëse e rendit të brendshëm juridik, sepse pas publikimit në Gazetën Zyrtare, bëhen pjesë përbërëse e sistemit juridik të Republikës së Kosovës (neni 19 paragrafi 1). Përveç marrëveshjeve që ratifikohen nga Kuvendi, ka edhe marrëveshje që ratifikohen nga Presidenti i Republikës. Këto janë të gjitha marrëveshjet përveç atyre që janë të numëruara në nenin 18.1

Neni 17.1

1. Neni 17 i Kushtetutës, i cili është objekt i këtij komenti, i kushtohet problematikës së përgjithshme të marrëveshjeve ndërkombëtare, duke pasur parasysh se teksti kushtetues në paragrafin 1 përcakton se Republika e Kosovës ka të drejtë të lidh marrëveshje ndërkombëtare dhe të anëtarësohet në organizata ndërkombëtare. Marrëveshjet ndërkombëtare paraqesin akte juridike, domethënë prodhojnë pajtueshmërinë e vullnetit të dy ose më shumë subjekteve të së drejtës ndërkombëtare, të shprehura përmes autoriteteve kompetente, në mënyrë që të krijojnë të drejta dhe detyrime reciproke. Organizatë ndërkombëtare (ose ndërshtetërore) është një organizatë fushëveprimi i së cilës mbulon disa shtete. Ka dy lloje themelore të këtyre organizatave, siç janë: 1) organizata ndërkombëtare ndërshtetërore, anëtarët e të cilave janë shtetet sovrane dhe 2) organizata ndërkombëtare jo-qeveritare, që formalisht janë organizata private (termi "organizatë ndërkombëtare", kryesisht i referohet organizatave ndërshtetërore).
2. Organizata ndërkombëtare ka disa elementë përbërëse - shtetet anëtare (shtetet, organizatat tjera ndërkombëtare ose territorit jo vetëqeverisës), marrëveshja ndërkombëtare (që më shpesh referuara si statut, por mund të bartin edhe emërtimin kartë, kushtetutë), organet e përhershme, fushëveprimi, statusi special (person juridik në të drejtën ndërkombëtare dhe kombëtare/vendore). Duke folur në mënyrë formale-juridike, organizatat ndërkombëtare themelohen në bazë të marrëveshjeve, që i japin plotfuqishmëri. Organizatat ndërkombëtare të themeluara në këtë mënyrë i nënshtrohen të drejtës ndërkombëtare dhe mund të hyjnë në marrëveshje dhe konteste me njëra-tjetrën ose me shtetet e veçanta. Në këtë mënyrë, dallojmë organizatat ndërkombëtare nga grupet e tjera ndërshtetërore transnacionale, si për shembull të G8 dhe G77, të cilat nuk janë të themeluara nga marrëveshjet ndërkombëtare.

3. Në anën tjetër, duhet gjetur dallimin në mes të organizatave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare; edhe pse organizatat ndërkombëtare themelohen në bazë të marrëveshjeve, disa marrëveshje (për shembull, Marrëveshja e Amerikës së Veriut për Tregti të Lirë - NAFTA, është një organizatë ndërkombëtare, pasi që nuk ka administratën e vet, por mbështetet ekskluzivisht në administrimin e shteteve anëtare të marrëveshjes).
4. Duke pasur parasysh statusin ligjor dhe administrativ, organizatat ndërkombëtare mund të klasifikohen në dy kategori, pra: 1) për nga anëtarësimi, 2) për nga funksioni. Organizatat ndërkombëtare mund t'i dallojnë në bazë të shteteve anëtare dhe nëse është anëtarësimi i lirë ose i kufizuar. Anëtarësimi në disa organizata ndërkombëtare (organizatat globale) është i hapur për të gjitha vendet e botës (për shembull, në këtë kategori klasifikohen Kombet e Bashkuara, agjencitë e saj të veçanta dhe Organizata Botërore e Tregtisë). Gjithashtu, dallojmë edhe organizatat ndërkombëtare me anëtarësi të kufizuar, dhe shembulli më i shpeshtë i këtyre organizatave janë organizatat rajonale (p.sh. Bashkimi Evropian apo Unioni Afrikan). Së fundi, ka edhe organizata të themeluara në bazë të kriterëve tjerë, si për shembull: Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OBEZH), Bashkimi Latin, Lëvizja e të Painkuadruarve, Liga Arabe, dhe të tjera të ngjashme.

Neni 17.2

1. Republika e Kosovës, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, ka të drejtë për bashkëpunim ndërkombëtar me synim mbrojtjen e paqes, sigurisë dhe të drejtave të njeriut. Sot është veçanërisht i rëndësishëm bashkëpunimi ndërkombëtar në kushtet e ekonomisë së globalizuar. Pasojat makroekonomike të çrregullimeve të konsiderueshme në funksionimin e tregjeve financiare në botë, reflektojnë mbi gjendjen e ruajtjes së paqes botërore dhe sigurisë globale.
2. Natyra transnacionale dhe asimetrike e sfidave bashkëkohore, rreziqet dhe kërcënimet ndaj sigurisë kanë ndikuar në faktin se siguria është e pandashme, dhe është gjithnjë e më e qartë se asnjë vend nuk është në gjendje që në mënyrë të pavarur të zgjidhë problemet komplekse të ruajtjes dhe forcimit të sigurisë kombëtare. Prandaj, siguria në kushtet moderne shihet gjithnjë e më shumë në nivel global, dhe siguria kombëtare është e lidhur gjithnjë e më shumë me sigurinë në mjedisin e afërt dhe të largët. Prandaj, përgjigjja për një numër të çrregullimeve në botë, dhe kërcënimeve asimetrike ndaj paqes dhe sigurisë, shihet në integrimin e sistemit të sigurisë kombëtare, forcimin e forumeve multilaterale të sigurisë dhe sistemin kolektiv të sigurisë ndërkombëtare, si faktorë kyç në sigurimin e paqes, stabilitetit dhe zhvillimit demokratik të vendeve të botës moderne.
3. Proceset demokratike dhe orientimi evropian i politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, forcojnë pozitën e saj ndërkombëtare dhe ndikojnë pozitivisht në krijimin dhe përmirësimin e politikave të bashkëpunimit dhe për të forcuar masat e besueshmërisë në rajon. Megjithatë, Republika e Kosovës, ende përballlet me sfida të rëndësishme, rreziqe dhe kërcënime të cilat rrezikojnë sigurinë e saj. Përkundër

progresit të konsiderueshëm në ndërtimin e institucioneve demokratike dhe kulturës politike e marrëdhënieve demokratike në Kosovë, ky proces nuk ka shkuar siç pritej, prandaj pritet që problemet e sigurisë në këtë fushë të zgjidhen sa më shpejt të jetë e mundur, për shkak se kanë përmasa rajonale. Për këtë arsye pritet që me zgjidhjen e tyre, kjo hapësirë do të shndërrohet në një burim stabiliteti, e jo paqëndrueshmërisë së stabilitetit në rajon.⁷⁸

4. Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut paraqet një vlerë civilizuese, bazuar në sigurinë kombëtare dhe një matës të karakterit demokratik të shoqërisë dhe shtetit. Politika në këtë fushë është e bazuar në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës dhe të traktateve të tjera të ratifikuara ndërkombëtare. Respektimi i detyrimeve të pranuar në fushën e të drejtave njerëzore dhe të pakicave dhe përmirësimi i kornizës juridike, paraqesin aspekt të rëndësishëm të përmirësimit të sigurisë kombëtare.
5. Republika e Kosovës garanton në territorin e vet të gjitha të drejtat individuale dhe ligjore, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore, të parapara me Kushtetutë (neni 21 par. 2) dhe përcakton se të gjithë kanë për detyrë që të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të të tjerëve (neni 21 par. 3). Gjithashtu, ajo mbështet dhe mbron interesat e shtetasve të saj jashtë vendit, siç parashikohet me ligj, bashkë me detyrimin për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në vendet e tjera, duke përmirësuar marrëdhëniet me ato vende, dhe në pajtim me dokumentet përkatëse të së drejtës ndërkombëtare. Duke u nisur nga rëndësia e tolerancës ndëretnike dhe dialogut ndërkulturor⁷⁹, Republika e Kosovës është duke marrë masa të ndryshme për të promovuar respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin midis të gjithë personave që jetojnë në territorin e saj, pavarësisht identitetit të tyre etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar. Republika e Kosovës është e vendosur që të zhvillojë bashkëpunimin me përfaqësuesit e pakicave, si dhe vendet e tyre të origjinës, në mënyrë që të përmirësojnë pozitën e tyre dhe të drejtat e tyre. Kështu është normative, domethënë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse.

⁷⁸ Analizë më e gjerë e sigurisë dhe bashkëpunimit në Evropë është dhënë në: Smith, E. Michael (2003), *Europe's Foreign and Security Policy: The Institutionalization of Cooperation* Cambridge University Press; dhe Cross, Sharyl, Kentera, Savo, Vukadinovic, Radovan dhe R. Craig Nation (2013). (eds.), *Shaping South East Europe's Security Community for the Twenty-First Century: Trust, Partnership, Integration*. New Security Challenges, Palgrave Macmillan: United Kingdom

⁷⁹ Për tolerancën ndëretnike dhe dialogun, shih më shumë në: Naimark, M. Norman, (2002) *Fires of Hatred: Ethnic Cleansing in Twentieth-Century Europe*, Harvard University Press: Harvard; dhe Brown, Wendy (2006), *Regulating Aversion: Tolerance in the Age of Identity and Empire* Princeton University Press: Princeton, New Jersey.

Neni 18 [Ratifikimi i Marrëveshjeve Ndërkombëtare]

- (1) Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare për këto çështje:
 1. territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake;
 2. të drejtat dhe liritë themelore;
 3. anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizata ndërkombëtare;
 4. marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës.
- (2) Marrëveshjet ndërkombëtare me përjashtim të atyre në pikën 1, ratifikohen pas nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
- (3) Presidenti i Republikës së Kosovës ose Kryeministri njoftojnë Kuvendin sa herë që të nënshkruhet një marrëveshje ndërkombëtare.
- (4) Amendamenti ose tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare do të kenë të njëjtën procedurë të vendim marrjes sikur ajo e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare.
- (5) Parimet dhe procedurat për ratifikimin dhe kontestimin e marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohen me ligj.

Neni 18

1. **Kuorumi** paraqet, sipas ligjit, numrin e paraparë të anëtarëve të një organizate, prania e të cilëve është e nevojshme në seancë, në mënyrë që të kryhen detyrat. Në parlament, kuorumi paraqet numrin e nevojshme të anëtarëve (deputetëve) për një zgjidhje të plotfuqishme. Kur është fjala për Kuvendin e Republikës së Kosovës, atëherë duhet të thuhet se ky parlament republikan *arrin kuorumin atëherë kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e deputetë të Kuvendit* (duke marrë parasysh se Kuvendi ka gjithsej 120 deputetë, kuorumi përfshin 61 deputetë për të qenë i plotfuqishëm)
2. Nocionet **shumica absolute** dhe **relative** nuk janë ekskluzivisht të lidhura me zgjedhjet dhe sistemin politik dhe nuk duhet të përzihen me nocionin shumicë e kualifikuar, që do të thotë shumica e kualifikuar për të marrë ndonjë vendim, sipas ligjit, rregullores, zakonit dhe të ngjashme. Për disa vendime të Kuvendit është e nevojshme shumica e thjeshtë (shumica e deputetëve të cilët në atë moment sigurojnë kuorumin për punë), e për disa të tjera (vendime më të rëndësishme) është e nevojshme shumica e kualifikuar, e cila mund të jetë p.sh. **absolute** (shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve, në këtë rast prej 120 deputetëve, p.sh për zgjedhjen Qeverisë, e cila konsiderohet e zgjedhur, nëse për zgjedhjen e saj ka votuar shumica e numrit të përgjithshëm të deputetëve të Kuvendit të Kosovës -neni 95 paragrafi 3 i Kushtetutës) ose p.sh. **dy të tretat** (në këtë rast, zgjedhja e presidentit, që bëhet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve - neni 86 paragrafi 4)⁸⁰ ose ndonjë tjetër. Për ndryshimin e Kushtetutës, shumica e

⁸⁰ Këtu megjithatë, duhet theksuar se me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është paraparë edhe zgjidhja në rast se në dy votimet e para, asnjë kandidat nuk fiton shumicën e 2/3 të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Atëherë organizohet votimi i tretë, në të cilin votohet për dy

kualifikuar është dy të tretat e deputetëve, pra çdo ndryshim kërkon miratimin nga 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit (neni 144 paragrafi 2), siç janë marrëveshjet ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me çështjet e përmendura në këtë nen 18 paragrafi 1 ratifikojnë gjithashtu, me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.⁸¹ Sistemi i shumicës **relative** nënkupton që përfaqësues i zgjedhësve në trupën përkatëse zgjedhore zgjidhet kandidati që merr më shumë vota krahasuar me kandidatët tjerë.

Neni 18.1

1. Duke pasur parasysh domethënien e çështjeve për të cilat votohet në Kuvend, është e paraparë edhe shumica e duhur që nevojitet për votimin e tyre, siç është për ratifikim. Kështu p.sh. për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me çështjet territoriale, paqe, çështje politike dhe ushtarake, është e nevojshme vota e dy të tretave (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit (neni 18 paragrafi 1 pika 1). Kjo është për shkak se, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si edhe të gjitha kushtetutat e tjera, garantojnë integritetin territorial në të cilin jetojnë qytetarët e saj, dhe për shkak se territori paraqet një nga tri kushtet konstitutive të secilit shtet, krahas popullatës dhe qeverisë. Për shkak të rëndësisë së ruajtjes së paqes, aleancave me vendet e tjera, çështjeve politike dhe ushtarake, me dispozitat e këtij paragrafi parashikohet gjithashtu domosdoshmëria e dy të tretave të votave, siç është për ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me këto çështje.
2. Duke pasur parasysh se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të njeriut (neni 18, paragrafi 1, pika 2), në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, janë "të pandashme, të patjetërsueshme e të pakontestueshme" dhe se ato janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës, gjithashtu edhe për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, janë të nevojshme 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në fakt, me këto të drejta dhe liri përcaktohet, statusi juridik i individit ndaj qeverisë dhe, për këtë përfaqësojnë kufirin që pushteti shtetëror nuk guxon ta kalojë, nëse është e organizuar në parime demokratike.
3. Rëndësia e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut është vendimtare për të siguruar demokracinë, sepse nuk do të ketë demokraci, nëse qytetarëve nuk u është siguruar vëllimi i përshtatshëm, sikurse edhe respektimi i të drejtave të njeriut. Këto të drejta, sikurse edhe Kushtetuta, përfaqësojnë mburojën nga pushteti absolut dhe i papërgjegjshëm dhe një nga treguesit më të rëndësishëm të parimeve

kandidatë me numrin më të madh të votave në rundin e dytë dhe, për President të Republikës së Kosovës konsiderohet i zgjedhur ai kandidat që ka fituar shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm (neni 86 paragrafi 5). Gjithashtu, Kushtetuta parasheh edhe mundësinë se nëse as me votimin e tretë, të kandidatëve të propozuar nuk zgjidhet Presidenti i Republikës, atëherë Kuvendi shpërndahet dhe shpallen zgjedhjet e reja (neni 86.6)

⁸¹ Në Unionin Evropian, për disa vendime shumica e kualifikuar përmban 3/5.

të kushtetutshmërisë. Si të tilla, të drejtat dhe liritë e njeriut, janë faktor që përcaktojnë pushtetin politik dhe vlerën e një kushtetute.⁸²

4. Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare, secilit shtet, duke përfshirë Republikën e Kosovës, u ofron disa mundësi për bashkëpunim në nivel ndërkombëtar dhe për të lidhur marrëveshje relevante ndërkombëtare. Duke marrë parasysh se me anëtarësimin në organizata të caktuara ndërkombëtare, për shtetin nënkupton do të thotë fitimi i të drejtave të caktuara, por në të njëjtën kohë dhe marrja e angazhimeve të rëndësishme, kjo vlen edhe për ratifikimin e marrëveshjes lidhur me pranimin e Republikës së Kosovës në organizata të caktuara ndërkombëtare dhe fitimi i statusit si anëtare e tyre (neni 18, paragrafi 1, pika 3), kërkon shumicën e kualifikuar, siç është rasti në paragrafët e mësipërm.
5. Së fundi, shumica e dy të tretave të të gjithë deputetëve të Kuvendit janë të nevojshme edhe për marrjen e përgjegjësisë ndaj detyrimeve financiare të Republikës së Kosovës. Në fakt, kjo është kompetencë mjaft e logjikshme e Parlamentit, e cila ishte më parë e vetmja dhe ekskluzive, sidomos në historinë e largët, që d.m.th. kur u paraqitën kërkesat e para për formimin e parlamentit (kuvendit), si organ përfaqësues.
6. Megjithëse, sipas ndarjes organike të pushteteve, parlamenti është trupi që miraton ligjet (trupi legjislativ), origjina e tij gjendet në kërkesën e fisnikërisë që edhe ata të marrin pjesë gjatë përcaktimit të tatimeve, e jo sunduesit e tyre të vendosin në mënyrë arbitrare tatimet. Prandaj, parlamenti u krijua nga arsyeja e kufizimit të të drejtave fiskale të monarkut dhe këtu qëndron rrënja e idesë së përfaqësimit, sepse fisnikëria e atëhershme lansoi sloganin "nuk ka tatim pa përfaqësim të përbashkët" (no taxation without representation).
7. Kjo do të thotë që kuvendet klasore, si forma origjinale e përfaqësimit, nuk janë krijuar për të kryer një funksion legjislativ, por, funksioni i tyre primar ishte financiar (e më pas edhe gjyqësor).⁸³ Prandaj, numri më i madh i parlamenteve, duke filluar nga shekulli i X, kur është themeluar trupi i parë përfaqësues, e deri më sot, ka marrë me kushtetutë juridiksionin e një natyre financiare, d.m.th. kontrolli i kreut të shtetit nga huamarrja e mundshme dhe nga marrja e mundshme e obligimeve të caktuara financiare. Prandaj, edhe me dispozitën e nenit 18 paragrafi 1 pika 4, të Kushtetutës, është paraparë që për shkak të rëndësisë së kësaj çështjeje, është i nevojshëm ratifikimi me dy të tretat i marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat përcaktojnë marrjen përsipër të detyrimeve të caktuara financiare nga ana e Republikës së Kosovës.

⁸² Jowell, J., (2004), "The Rule of Law Today", në J. Jowell, D. Oliver (eds.), *The Changing Constitution*. Oxford University Press: Oxford; fq. 5-25.

⁸³ Këtu duhet përmendur kuriozitetin historik, që parlamenti më i vjetër në botë, është ai që ekziston në Islandë, pandërprerë që nga viti 930 (gati plot 11 shekuj). Edhe ky parlament nuk është aq i rëndësishëm për shkak të formimit të trupit ligjvënës, aq sa është për marrjen e kompetencave të caktuara financiare të monarkut dhe me këtë edhe zbutjen e absolutizmit të tij.

Neni 18.2

1. Ashtu siç theksuam, për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare lidhur me çështjet e lartpërmendura, të parashikuara me nenin 18 paragrafi 1 të Kushtetutës, nevojiten dy të tretat e shumicës të kualifikuar të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Megjithatë, ky nuk është rasti edhe me marrëveshjet ndërkombëtare, që ratifikohen me nënshkrimin e Presidentit të Republikës së Kosovës (neni 18, paragrafi 2). Gjegjesisht, në përputhje me nenin 84 paragrafi 7, Presidenti nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë.

Neni 18.3

1. Në rast të ratifikimit përmes nënshkrimit, si të ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkuara nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Presidenti ose Kryeministri janë të obliguar që personalisht të informojnë Kuvendin për çfarëdo marrëveshje të tillë ndërkombëtare të nënshkuar (neni 18 paragrafi 3).

Neni 18.4

1. Çfarë është e rëndësishme të theksohet këtu është fakti se, për shkak të rrethanave të ndryshuara mund të vijë deri te ndryshime të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, apo madje edhe deri te tërheqja e Republikës së Kosovës nga marrëveshjet. Në raste të tilla, është shumë e rëndësishme se si bëhet ky ndryshim përkatësisht kjo tërheqje. Për të shmangur disa dilema dhe paqartësi në këto situata, Kushtetuta parashikon procedurë të njëjtë sikur për rastet kur bëhet ratifikimi i traktateve ndërkombëtare (neni 18 paragrafi 4).

Neni 18.5

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ia lë ligjit rregullimin e parimeve dhe procedurave të ratifikimit dhe ndërprerjen e marrëveshjeve ndërkombëtare (neni 18 paragrafi 5).

Neni 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare]

- (1) **Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ato zbatohen në mënyrë të drejt-përdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.**
- (2) **Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.**

Neni 19

1. Me nenin paraprak, nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, parashikohet ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e Kuvendit, si përfaqësuese e popullit, detyrimet e Presidentit dhe të Kryeministrit në lidhje me informimin e Kuvendit të Republikës për çdo marrëveshje të nënshkruar ndërkombëtare (të drejtën për të nënshkruar këto marrëveshje në përputhje me Kushtetutën e ka vetëm Presidenti, jo Kryeministri), procedura për ndryshimin e këtyre marrëveshjeve apo tërheqjen nga ato, si dhe rregullimi ligjor (Kushtetuta ia lë ligjit që me dispozitat e tij të rregullojë parimet dhe procedurat e ratifikimit dhe ndërprerjes së marrëveshjeve ndërkombëtare).

Neni 19.1

1. Megjithatë, neni 19, i cili është objekt i analizës sonë, parasheh një dispozitë shumë të rëndësishme, me të cilën përcaktohet se çdo marrëveshje ndërkombëtare, e cila është ratifikuar nga Republika e Kosovës (kjo mund të bëhet nga Kuvendi dhe Presidenti i Republikës së Kosovës) bëhet pjesë përbërëse e sistemit të brendshëm juridik, d.m.th. pjesë e rendit juridik (paragrafi 1). Kushti që këto marrëveshje të bëhen pjesë përbërëse e rendit juridik të Republikës së Kosovës, është që ato të publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Për këtë arsye, këto marrëveshje, statusin e të cilave Kushtetuta e rregullon me nenin 19 paragrafin 1, nuk i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe bëhen pjesë përbërëse e rendit juridik. Ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, d.m.th. drejtpërdrejtë, që do të thotë, për shembull, se një vendim i gjykatës mund të bazohet në rregullat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Pavarësisht nga dispozitat e përcaktuara në këtë paragraf, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nuk zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, vetëm në ato raste kur kjo është e pamundur, dhe kur për zbatimin e atyre marrëveshjeve kërkohet të nxirret ligj i ri.⁸⁴

⁸⁴ Shih rastin KO95-13 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Në aktgjykimin e rastit KO 95-13 (*Parashtrues i Kërkesës Visar Ymeri dhe 11 deputetët tjerë të Kuvendit të Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 04/L-199, për ratifikimin e Marrëveshjes së Parë për parimet të cilat rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Serbisë, si dhe planit për zbatimin e kësaj marrëveshjeje*) të 9 shtatorit 2013, Gjykata Kushtetuese qartazi ka shpjeguar se sistemi kushtetuese i Kosovës i takon vendeve të sistemit kontinental ku marrëveshjet ndërkombëtare janë sipas fuqisë juridike dhe janë mbi ligjin dhe nën Kushtetutën. Tjetra, me këtë Aktgjykim është thënë që ligjet për ratifikim nuk kanë vlerë normative dhe zbatohen drejtpërdrejtë nga ana e gjykatave dhe organeve tjera vetëm në qoftë se janë vetpërmbaruese. Nëse nuk janë, atëherë duhet një ligj i ri për zbatimin e tyre. Ky ligj për zbatimin e tyre është ndryshe nga ligji për ratifikim sepse ka vlerë normative. Ndryshimi i këtij ligji për zbatimin mund të bëhet vetëm më rrugë të njëjtë me të cilën edhe është lidhur marrëveshja kryesore i cili zbatohet e jo përmes procedurave të rregullta ligjore. Kjo është për arsye se në Kosovë marrëveshjet ndërkombëtare që janë bërë pjesë përbërëse e rendit kushtetues të Kosovës dhe të cilët janë publikuar kanë më shumë fuqi juridike nga ligjet e rregullta.

Neni 19.2

1. Është e rëndësishme në këtë pikë për të përcaktuar marrëdhëniet midis të drejtës së brendshme dhe të drejtës ndërkombëtare. E drejta ndërkombëtare paraqet një rend të veçantë normativ, që rregullon marrëdhënie e caktuara shoqërore dhe proceset në bashkësinë ndërkombëtare, dhe është e sanksionuar nga ana e shtetit dhe organizatave ndërkombëtare. Si e tillë, ajo është rezultat i një evolucioni të gjatë, nëpër të cilin ka kaluar bashkësia ndërkombëtare.
2. Përderisa e drejta e brendshme është e vendosur vertikalisht dhe bazohet në hierarkinë e pushtetit (individit është i detyruar që t'i bindet ligjit), rendi ndërkombëtar është vendosur horizontalisht⁸⁵ dhe nuk shërben si një mjet për shtypje kundrejt ligjit vendor, por si një mjet për koordinimin dhe kontrollin e marrëdhënieve të caktuara shoqërore dhe proceseve në komunitetin ndërkombëtar, në mënyrë që të mundësojë funksionimin e ekonomisë globale dhe për të siguruar paqen në botë.
Për këtë arsye rendi ndërkombëtar bazohet në barazinë e shteteve sovraane (e jo në hierarkinë e pushtetit), prandaj në bashkësinë ndërkombëtare nuk ka as organ suprem legjislativ, e as gjyqësor, siç është rasti me rendet ligjore vendore.
3. Versionin kontinental sipas të cilit ekziston primati i ligjit ndërkombëtar në raport me atë vendor (kjo teori u shfaq në fund të Luftës së Parë Botërore, dhe sot e kësaj dite mbetet shumë i përhapur), e pranon edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Konkretisht, neni 19 paragrafi 2 i kësaj Kushtetute, përcakton se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe parimet e detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare, kanë përparësi mbi ligjet e Republikës së Kosovës.
4. Kjo do të thotë se rregullat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara bëhen pjesë e rendit juridik, se ato janë mbi ligjin vendor, dmth. mbi ligjin e Republikës së Kosovës, të cilat i përkasin ligjit vendor kombëtar dhe, si të tilla, këto rregulla (parime) dhe marrëveshje ndërkombëtare nuk i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë. E njëjta gjë vlen edhe për parimet e detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare të cilat kanë statusin e njëjtë në sistemin juridik të Republikës së Kosovës ashtu si dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara (janë pjesë e rendit të brendshëm juridik dhe zbatohen drejtpërdrejt) dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese.

Neni 20 [Bartja e Sovranitetit]

- (1) Republika e Kosovës, në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, për çështje të caktuara mund të kalojë kompetenca shtetërore organizatave ndërkombëtare.**

⁸⁵ Friedrich, C., (1950), *Constitutional Government and Democracy: Theory and Practice in Europe and America*, Ginn and Co., Boston, fq. 151.

- (2) Nëse një marrëveshje anëtarësimi e ratifikuar nga Republika e Kosovës për pjesëmarrje në një organizatë ndërkombëtare në mënyrë eksplicite kërkon zbatim të drejtpërdrejtë të normave të kësaj organizate, ligji me të cilin ratifikohet marrëveshja e anëtarësisë miratohet me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit dhe ato norma kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.

Neni 20

1. Rreth sovranitetit është folur në fillim të Kushtetutës dhe atë në nenin 2 të Kapitullit I ("Dispozitat Themelore"). Paragrafi 2 i nenit të theksuar përfshin dispozitën sipas të cilës sovraniteti i Republikës së Kosovës është i **pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm** dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me këtë Kushtetutë. Megjithatë, në botën e marrëdhënieve ndërkombëtare jo vetëm tani por edhe në të kaluarën, shtetet kanë qenë të detyruara që të hyjnë në kontakt me shtetet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare që të punojë për të realizuar interesat e veta kombëtare të të gjitha llojeve. Ky është qëllimi i këtij neni i cili flet rreth transferimit të sovranitetit në baza vullnetare dhe në mënyrë demokratike. Në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, Republika e Kosovës në bazë të marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, ua bartë organizatave ndërkombëtare kompetencat shtetërore për disa çështje të caktuara. Problemi është se as në Kushtetutë dhe as në tekstet relevante juridike nuk është përcaktuar saktësisht se cilat janë ato "çështje të caktuara" për të cilat mund të barten kompetencat e shtetit tek disa organizata ndërkombëtare.
2. Në çdo rast, kjo është çështje kontekstuale që mund të zgjidhet në varësi të rrethanave. Një shembull i "çështjeve të caktuara", ku mund të konstatohet bartja e të drejtave sovrane të Kosovës tek subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare do të ishte pjesëmarrja në operacione paqeruajtëse apo pjesëmarrje tjetër e Kosovës në shoqatat e mbrojtjes, anëtarësimi në Bashkimin Evropian, etj. Kjo nuk duhet të kuptohet se ka si pasojë bartjen e sovranitetit. Në fakt, këtu bëhet fjalë për bartjen e të drejtave sovrane të Kosovës si një shtet i pavarur dhe sovran tek subjektet e tjera të së drejtës ndërkombëtare dhe vetë fakti që kjo dispozitë e autorizon autoritetet e Kosovës për të bartur disa të drejta sovrane është një shenjë se Kosova është shtet sovran dhe i pavarur.

Neni 20.1

1. Do të analizojnë Ligjin për Marrëveshje Ndërkombëtare i cili përcakton procedurën për negociatave, nënshkrimin, ratifikimin, vendosjen e rezervave dhe dhënien e deklaratave, ndryshimin dhe plotësimin, anulimin, si dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, pavarësisht se cili institucion ose zyrtar kanë lidhur ose nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare në fjalë, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ajo që është shumë e rëndësishme të përmendet është se ekziston një përputhshmëri e legjislacionit të brendshëm me normat dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare, dhe kështu, nga autori i këtij ligji,

gjatë përpilimit të tij, është marrë parasysh edhe përputhshmëria e tij me normat përgjithësisht të pranuar dhe parimet ndërkombëtare ligji që rregullojnë ekzekutimin dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare.

2. Kur flasim për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, është e rëndësishme të përmendet, se kush janë propozuesit e autorizuar, dmth. kush ka të drejtën e iniciativës për lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe ndërkombëtare të Republikës së Kosovës. Këta janë Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme, derisa ministritë dhe agjencitë qeveritare kanë të drejtë të iniciojnë lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në çështjet brenda juridiksionit të tyre. Gjithashtu, iniciativën për lidhjen e marrëveshjeve të dypalëshe ose shumëpalëshe ndërkombëtare, mund t'a iniciojnë edhe organet kompetente të Republikës së Kosovës ose organet e vendeve të huaja. Përveç të drejtës për iniciativë për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, kemi nevojë të dimë se kush ka kompetenca për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare. Sipas nenit 7 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëveshje Ndërkombëtare, Presidenti, Kryeministri dhe Ministri i Jashtëm kanë të drejtë që pa kurrfarë autorizimi të posaçëm, të kryejë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, përderisa shefi i misionit diplomatik të Republikës së Kosovës ose përfaqësuesit e autorizuar të Republikës së Kosovës në ndonjë konferencë ndërkombëtare, në ndonjë organizatë ndërkombëtare ose në njërin nga organet e tij, janë të autorizuar që të negociojë për lidhjen e ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare (neni 7, paragrafi 2 i Ligjit). Personat e tjerë mund të angazhohen në veprime që kanë të bëjnë me lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, vetëm me kusht nëse kanë autorizimin, i cili u është dhënë atyre sipas ligjit të zbatueshëm dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara me këtë Ligj.
3. Gjithashtu, kur është fjala për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit ndër-institucional, Ministritë në Qeveri dhe agjencitë shtetërore mund t'i lidhin, secila brenda juridiksionit të vet marrëveshjet apo memorandumet me vendet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare, vetëm në qoftë se kontratat e tilla nuk përmbajnë klauzola detyruese juridike nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në qoftë se nuk janë në konflikt me ligjet dhe aktet tjera juridike të Republikës së Kosovës, si dhe me obligimet ndërkombëtare (neni 13 i Ligjit).
4. Zbatimin e marrëveshjeve të lidhura ndërkombëtare e siguron Qeveria e Republikës së Kosovës, me atë që një marrëveshje ndërkombëtare mund të ndryshohet ose të plotësohet në bazë të normave të së drejtës ndërkombëtare dhe në pajtim me procedurat e përcaktuara me këtë Ligj për përmbylljen e marrëveshjeve ndërkombëtare. Gjithashtu parashikohet edhe mundësia e anulimit të marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës ose pezullimin i efektit të saj, por vetëm sipas dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare, normave të së drejtës ndërkombëtare dhe procedurave përcaktuara me këtë Ligj (neni 19, paragrafi 1). Dispozitat e këtij Ligji për Ndryshimin apo Plotësimin si dhe pezullimin dhe anulimin e marrë-

vëshjeve ndërkombëtare të parashikuara me këtë Ligj, në fakt janë të njëjta si në Konventën e Vjenës për të Drejtën e Kontratës të vitit 1969 (ka hyrë në fuqi në vitin 1980).

Marrëveshjet e përmbyllura ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, publikohen në Gazetën Zyrtare, kur të jenë dërguar nga zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës, përkatësisht nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Neni 20.2

1. Në fund të komentit të nenit 20 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nuk mund të mos theksojmë faktin e mënyrave të ndryshme të ratifikimit (vërtetimit) të marrëveshjeve ndërkombëtare. Konkretisht, neni 11 i Ligjit të përmendur për marrëveshjet ndërkombëtare, parashikon ratifikim (vërtetim) përmes dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës e Kosovës për marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me: 1) territorin, 2) paqen, 3) aleancat, 4) çështjet politike dhe ushtarake; 5) të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, 6) anëtarësimin e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare, dhe 7) marrjen e detyrimeve financiare të Republikës së Kosovës.
2. Në vijim sa pamë më lartë, me paragrafin 2 të nenit 20 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës parashikohet miratimi me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit i ligjit me të cilin ratifikohet (vërtetohet) marrëveshja për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në ndonjë organizatë ndërkombëtare, në rast se kjo marrëveshje përcakton zbatimin e drejtpërdrejtë të normave të detyrueshme të asaj organizate. Marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, të cilat nuk janë të lidhura me çështjet e lartpërmendura, vërtetohen me nënshkrimin e Presidentit të Republikës së Kosovës.
Ajo që është shumë e rëndësishme për analizën tonë dhe në çfarë duhet në veçanti të kemi vëmendjen është fakti se normat e organizatës ndërkombëtare, anëtare e së cilës bëhet Republika e Kosovës duke lidhur marrëveshje përkatëse ndërkombëtare, marrin përparësi mbi ligjet e Republikës së Kosovës.
3. Kjo do të thotë se këto norma janë pjesë e rendit të brendshëm juridik (bëhen kështu me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nga ana e institucioneve relevante politike të Republikës së Kosovës) dhe nuk i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë së tyre, sepse marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara (të vërtetuara) të Republikës së Kosovës, të cilat kanë hyrë në fuqi, marrin karakter detyrues për Republikën e Kosovës. Prandaj, në qoftë se një marrëveshje ndërkombëtare e Republikës së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi, vendos standarde ndryshe nga ato të përcaktuara me ligj si dhe me aktet e tjera juridike të Republikës së Kosovës të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e lidhjes së kësaj marrëveshje ndërkombëtare atëherë mbizotërojnë me fuqi juridike dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.

Kapitulli II: Të Drejtat dhe Liritë Themelore

Shqyrtime hyrëse

1. Ende konsiderohet se një nga detyrat kryesore të kushtetutës është vendosja e bazave të pozitës juridike të individëve, të cilat me ligjet e zakonshme do të duhej elaboruar, konkretizuar dhe garantuar më tutje, pa i cenuar ato në asnjë rast. Që në kushtetutat e para evropiane hasen dispozita të mbi të drejtat njerëzore dhe liritë themelore, të cilat janë marrë nga deklarata paksa më të vjetra kushtuar të drejtave të njeriut dhe qytetarëve. Para së gjithash, këto janë deklaratat e disa shteteve të Amerikës Veriore dhe të Francës së fundshekullit XVIII, të cilave iu është dhënë rëndësi e madhe, pasi që ato shënojnë transformimin themelor të llojit të qeverisjes, i cili tani e tutje nuk do të duhej të ushtrohej sipas llojit të mëhershëm, pra sipas llojit të sundimit absolutist.
2. Roli i atyre dispozitave ka konsistuar në mbrojtjen e të mirave të caktuar juridike dhe konkretisht jo vetëm nga pushteti administrativ (ekzekutiv), por edhe ai legjislativ. Me kalimin e kohës këto dispozita u bënë traditë, kështu që ato më pastaj janë futur në krejt kushtetutat e mëvonshme dhe në ato më të rejtat te kohëve të fundit.⁸⁶ Kushtetuta të ndryshme e kanë shënuar këtë pjesë me emërtime të ndryshme, si për shembull: "të drejtat kushtetuese të qytetarëve", "të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të pakicave", "të drejtat themelore dhe obligimet e qytetarëve", e ngjashëm me këto. Kjo shtesë lidhur me obligimet ka pasur rolin që të theksojë, posaçërisht në vendet e socializmit real, se mund të jetohet në kohën ku "secili individ duhet ta kuptojë se është pjesëtar i shoqërisë dhe se përballë shoqërisë ka jo vetëm të drejta por edhe obligime". Për këtë arsye në fund të kësaj pjese është futur një nen i cili me shprehjen më të përgjithësuar normon obligimin e qytetarëve (t'i binden ligjit, t'u shërbejnë interesave të komunitetit, mbrojtja e atdheut, kryerja e detyrave shtetërore dhe ngjashëm).⁸⁷
3. Në kushtetutat tjera një nen i tillë nuk është lejuar, ashtu që në këtë pjesë nuk përmenden kurrfarë obligimesh të qytetarëve. Obligimet përmenden në një pjesë të veçantë, por jo në atë pjesë që paraqet të drejtat e individëve, thjesht të drejtat individuale.⁸⁸ Ato të drejta, para së gjithash, kanë qenë pjesërisht civile, pjesërisht

⁸⁶ Krahaso: Hunt, Lynn (2008), *'Inventing Human Rights: A History'*, W. W. Norton & Company: New York and London, Kapitulli 3 ("They Have Set a Great Example. Declaring Rights") dhe Kapitulli 4 ("There Will Be No End Of It. The Consequences of Declaring") fq. 113-175; Donnelly, Jack (2013), *'Universal Human Rights in Theory and Practice'*, Cornell University Press: USA, Kapitulli 5 ("A Brief History of Human Rights"), fq. 75-92.

⁸⁷ Lidhur me obligimet më të rëndësishme të qytetarëve, shih më gjerësisht: Stupar, M., (1996), *'Teorija opolitičkim dužnostima'* Savremena Administracija: Beograd; dhe Paine, Th., (2001), (ed. by Mark Philip), *'Rights of Man, Common Sense and Other Political Writtings'* Oxford University Press: Oxford

⁸⁸ Gewirth, A., (1978), 'Osнова i sadržaj ljudskih prava', *Dometi*, nr. 4, fq. 133-148.

politike. Civile janë ato të drejta që mbrojnë dhe sigurojnë personalitetin privat të individit, ndërsa politike janë ato që i sigurojnë pjesëmarrjen në jetën publike. Të drejtat civile nuk janë të kufizuara vetëm për shtetasit, ndërsa ato politike janë të kufizuara.

4. Të drejtat e njeriut,⁸⁹ në bazë të kriterëve të ndryshme, mund të klasifikohen në grupe shumë të ndryshme. Kështu për shembull dallojmë:
- 1) **të drejtat e statusit negativ, të drejtat e statusit pozitiv dhe të drejtat e statusit aktiv** (sipas kriterit të raportit të ndërsjellë në mes të individit, pra qytetarit dhe shtetit).
 - të drejtat e statusit negativ janë të drejtat e qytetarit të cilat shteti nuk mund t'i prekë, pra qytetarët gëzojnë lirinë nga intervenimi i shtetit në sferën e tyre juridike. Prandaj këto të drejta ende quhen të drejtat e lirisë,
 - të drejtat e statusit pozitiv, përkundrazi, u japin qytetarëve të drejtën që nga shteti të kërkojnë veprime ose mosveprime të caktuar dhe shteti është i obliguar që të veprojë aktivisht në të favor të qytetarëve,
 - të drejtat e statusit aktiv janë ato të drejta në të cilat qytetarët marrin pjesë aktivisht në kryerjen e punëve publike.
 - 2) **të drejtat e njeriut, të drejtat e qytetarit dhe të drejtat e shtetasit** (duke marrë parasysh atë se a i takojnë secilit njeri si qenie njerëzore, qytetarit si pjesëtar të bashkësisë politike apo vetëm shtetasit të një shteti të caktuar).
 - 3) **të drejtat personale, politike, sociale, ekonomike dhe kulturore** (sipas objektit, respektivisht sferës së personalitetit të njeriut që e mbrojnë).
 - 4) **të drejtat natyrale dhe civile** (varësisht nga ajo se a ekzistojnë si të pavarura nga shteti apo vetëm në kornizat e bashkësisë politike).
 - 5) **të drejtat e gjeneratës së parë, të dytë dhe të tretë** (varësisht nga koha e paraqitjes së tyre, respektivisht nga koha në të cilën garantohen me kushtetutë).
 - të drejtat e gjeneratës së parë janë për nga aspekti kohor të drejtat më të vjetra dhe përfshijnë të drejtat personale dhe politike,
 - të drejtat e gjeneratës së dytë vijnë pas të drejtave të gjeneratës së parë dhe përfshijnë të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore,
 - të drejtat e gjeneratës së tretë⁹⁰ (për këto të drejta ende përdoren terme siç janë “të drejtat e popullit”, “të drejtat kolektive” dhe “të drejtat e solidaritetit” dhe ngjashëm), janë të drejta përmbajtja e të cilave është komplekse dhe bartësit e të cilave, pak a shumë, janë kolektivitete të caktuara. Për këtë arsye ata përfshijnë një sërë të drejtash dhe nuk mund të reduktohen në një të drejtë (për shembull, e drejta e paqes, e drejta për

⁸⁹ Lidhur me dokumentet themelore që janë dedikuar të drejtave të njeriut, shih më gjerësisht: Brownlie, I., (1981), *Basic Documents on Human Rights*, 2nd edition, Oxford University Press: Oxford; dhe Cassese, A. (2009), (ed.), *UN Law - Fundamental Rights - Two Topics in International Law*, Springer: New York

⁹⁰ Lidhur me të drejtat e gjeneratës së tretë shih më gjerësisht: Vodinelić-Rakić, V., (1989), "Prava treće generacije", *Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu*, nr. 5-6, (Supplement), fq. 789-814.

zhvillim,⁹¹ e drejta për një mjedis të shëndetshëm jetësor, e drejta për komunikim dhe ngjashëm), kështu që bartës i këtyre të drejtave është e tërë bashkësia e shtetasve, pra të gjithë qytetarët e një shteti.⁹²

- 6) **të drejtat individuale dhe të drejtat kolektive** (sipas subjektit që i takojnë)
 - të drejtat individuale i takojnë secilit individ,
 - të drejtat kolektive i takojnë kolektiviteteteve të ngushta dhe të gjera.
- 7) **të drejta ligjore dhe etike** (varësisht nga ajo se a janë të rregulluara nga e drejta apo jo)
- 8) **të drejtat kushtetuese, pra themelore dhe të drejtat ligjore** (varësisht nga ajo se a mbrohen me kushtetutë apo me ligj).

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

- (1) Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.**
- (2) Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.**
- (3) Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.**
- (4) Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.**

Neni 21

1. Për të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me kushtetutë, është me rëndësi që ato të zbatohen drejtpërdrejtë dhe kjo duhet të jetë e përcaktuar si parim nismëtar i garantimit të të drejtave të njeriut. Kushtetuta e Republikës së Kosovës këtë nuk e përcakton në parimet e përgjithshme (neni 21.), por në nenin tjetër 22 tregohet për zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare dhe, madje, për epërsinë e tyre në rast të konfliktit ndaj të gjitha dispozitave ligjore dhe akteve tjera të institucioneve publike. Zbatimi i drejtpërdrejtë i dispozitave kushtetuese për të drejtat e njeriut parashihet më së shpeshti në praktikën kushtetuese krahasimtare, sepse ajo nënkupton që ligji nuk është ndërmjetës i domosdoshëm në mes të normës kushtetuese dhe zbatimit të saj praktik. Kështu që Gjykata dhe çdo organ tjetër që zbaton të drejtën mund që drejtpërdrejtë të thirret në normën kushtetuese dhe, rrjedhimisht, mund të zbatojë drejtpërdrejt rregullën kushtetuese në rastin konkret.

⁹¹ Lidhur më këtë drejtë është nxjerrë Deklaratë e veçantë, shih: Gajinov, M., (1988), "Deklaracija o pravu na razvoj", *Jugoslovenska Revija za Medjunarodno Pravo*, nr. 2, fq. 235-250.

⁹² Lidhur me këtë shih më gjerësisht: Bard A. Andreassen and Marks, P. Stephen (2007), (eds.), 'Development As a Human Right: Legal, Political, and Economic Dimensions', Harvard Series on Health and Human Rights, FXB Center for Health and Human Rights: Harvard.

2. Duke marrë parasysh që Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare si bazë e interpretimit të dispozitave për të drejtat dhe liritë themelore, do të duhej të ishin dy burime:
 - 1) standardet e aplikueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
 - 2) praktika e institucioneve ndërkombëtare që mbikëqyrin zbatimin e të drejtave të njeriut.
3. Qëllimi i garancive kushtetuese për të drejtat dhe liritë themelore është mbrojtja e dinjitetit të njeriut, lirisë dhe barazisë. Këto janë vlera themelore që karakterizojnë një shoqëri të drejtë, të hapur dhe demokratike dhe një bashkësi politike e cila mbështetet në sundimin e së drejtës. Në një bashkësi të tillë dinjiteti i personalitetit të njeriut është i pacenueshëm dhe për këtë arsye të gjithë janë të obliguar që ta respektojnë dhe ta mbrojnë.⁹³ Kësisoj, çdo Kushtetutë ashtu sikurse edhe Kushtetuta e Kosovës që është objekt i komentit tonë, krahas normave reale përmban edhe norma të karakterit programor. Kur është fjala për Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kësaj problematike i është dedikuar Kapitulli II që mban emërtimin "TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE". Ky është kapitulli më i vëllimshëm dhe përmban gjithsej 42 nene.⁹⁴ Ai i është dedikuar lirive, të drejtave dhe obligimeve të njeriut dhe të qytetarit, mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, barazisë para ligjit dhe zbatimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare. Një vend i tillë në sistematikë dhe një vëllim i tillë i rregullimit kushtetues të atyre raporteve shoqërore korrespondojnë me konceptin e përgjithshëm të Kushtetutës si mjet për mbrojtjen e njeriut dhe i kufizimit të pushtetit shtetëror. Ajo është në përputhje edhe me atë dispozitën themelore,⁹⁵ që përcakton se Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të parapara me Kushtetutë (neni 21 paragrafi 2) dhe se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë të pandashme, patjetërsueshme dhe të pacenueshme dhe se janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës (neni 21 paragrafi 1).

Neni 21.1

1. Termet që flasin për pandashmërinë, patjetërsueshmërinë dhe pacenueshmërinë përdoren në shumë vende në Kushtetutë. Kësisoj, dispozita kushtetuese nga neni 2 paragrafi 2 që i dedikohet sovranitetit të shtetit të Kosovës përcakton që ky sovranitet (dhe integritet) është i "pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm". Kur bëhet fjalë për pandashmërinë e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, atëherë duhet thënë se ato janë të lidhura me personalitetin e bartësve të tyre, pra secilit person individualisht dhe se atyre askush nuk mund t'ua kontestojë ato të drejta.

⁹³ Lidhur me këtë qasje liberale, shih më gjerësisht: Rawls, John (2005), *Political Liberalism*, Columbia University Press: New York.

⁹⁴ Nenet 21-62 të Kushtetutës.

⁹⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 21.

2. Në të vërtetë, këto të drejta dhe liri janë të bazuara para së gjithash në të drejtën natyrale të secilit njeri që fitohet me lindjes e tij/saj dhe e cila është e përhershme dhe e pacenueshme, porse ajo gjithashtu bazohet edhe në një numër të madh marrëveshjesh ndërkombëtare, deklaratash, konventash dhe instrumentesh, dhe rrjedhimisht garantohen me këtë Kushtetutë. Atë vend të veçantë e zënë Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore,⁹⁶ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe akte të tjera ndërkombëtare.
3. Dispozita e po këtij paragrafi që përcakton se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore janë të patjetërsueshme do të thotë se këto të drejta dhe liri nuk mund të barten tek tjetri, pra personat që posedojnë këto të drejta (të cilëve ato u janë garantuar) nuk mund të tjetërsojnë të njëjtat në favor të personave tjerë. Pacenueshmëria e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore nënkupton që asnjë organ shtetëror, organizatë politike, grup, madje asnjë individ, nuk mund të cenojë, pra nuk mund të rrezikojë apo shkelë gëzimin paqësor të këtyre të drejtave dhe lirive nga ana e atyre personave të cilëve ato u janë garantuar shprehimisht me Kushtetutë.

Neni 21.2

1. Ajo që është shumë me rëndësi për realizimin e sundimit të së drejtës dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, është çështja nëse një shtet me Kushtetutën e vet garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore dhe nëse parashikon sistem të mbrojtjes së atyre të drejtave dhe lirive të garantuara. Kjo është me rëndësi pasi që për çdo shtet demokratik është e një rëndësie vendimtare si krijimi ashtu edhe realizimi i të drejtave. Pikërisht për këtë arsye, Republika e Kosovës me dispozitën kushtetuese të paraparë në nenin 21 paragrafi 2, parashikon mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të parapara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo do të thotë se secili ka të drejtë për mbrojtje gjyqësore nëse i është cenuar ose shkelur ndonjë e drejtë e njeriut ose liri themelore e garantuar me Kushtetutë si dhe e drejta për mënjanimin e pasojave që

⁹⁶ Konventa është nënshkruar në Romë, më 4 nëntor 1950, ndërsa ka hyrë në fuqi pas ratifikimit nga 8 vende evropiane (më 3 shtator 1953). Me kalimin e kohës Konventa është plotësuar me 13 protokolle. Rrethi i vendeve që e kanë ratifikuar Konventën është zgjeruar shpejt, ndërsa shtytje e veçantë ka qenë pranimi i një numri të madh të lirive dhe të drejtave të reja të njeriut pas vitit 1990.

Lidhur me interpretimin doktriner të kësaj Konvente, shih më gjerësisht: Van Dijk, F., Van Hoof, F. Van Rijn, A. and Zwaak, Leo, (2006), *Theory and Practice of the European Convention on Human Rights*. Fourth Edition' Intersentia: Antwerp - Oxford,; Janis, W. Richard, Mark Kay, S. and Bradley, W. Anthony (2008), *European Human Rights Law: Texts and Materials*(Oxford University Press: USA,; C A White, Robin and Ovey, Clare (2010), *The European Convention on Human Rights*(Oxford University Press: USA,; dhe Mowbray, Alastair (2012), *Cases and Materials and Commentary on the European Convention on Human Rights*, Oxford University Press: USA.

kanë rezultuar nga shkelja. Pikërisht për shkak të rëndësisë që ka për statusin e të drejtave të njeriut në sistemin kushtetues dhe juridik mbrojtja e tyre, në mesin e parimeve të përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore (neni 21 paragrafi 2) renditen edhe garantitë kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.

2. Kushtetuta kryesisht garanton mbrojtjen para gjykatës si formën më të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në të drejtën e brendshme. Secilit i garantohet e drejta për një gjykatë të pavarur, të paanshme dhe të themeluar me ligj, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31), e drejta për mbrojtje të barabartë para gjykatave, organeve tjera shtetërore dhe bartësve të autoritetit publik (neni 31 paragrafi 1), e drejta për shqyrtim publik, të paanshëm dhe të drejtë të vendimit për të drejtat dhe obligimet ose për çfarëdo ndjekje penale që është iniciuar ndaj tij brenda afatit të arsyeshëm, nga ana e një gjykate të pavarur, të paanshme dhe të themeluar me ligj (neni 31 paragrafi 2), e drejta për mjet juridik (neni 32), e drejta e personit për të mos u gjykuar dy herë për veprën e njëjtë penale (neni 34). Bashkë me garantimin e të drejtave të caktuara. Kushtetuta shprehimisht urdhëron edhe mbrojtjen e tyre, duke përcaktuar që secili ka të drejtë për mbrojtje gjyqësore në rast të shkeljes ose cenimit të ndonjë të drejte që garantohet me këtë Kushtetutë si dhe të drejtën për masa efikase juridike nëse konstatohet se ajo e drejtë është shkelur (neni 54). Natyrisht, përmbajtja e të drejtës për mbrojtje të të drejtave të njeriut përfshin jo vetëm të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës por edhe të drejtën për mënjanimin e pasojave që janë paraqitur me shkeljen e të drejtave.
3. Krahas mbrojtjes gjyqësore, në mënyrë të veçantë garantohet mbrojtja e drejtpërdrejtë e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore pranë Gjykatës Kushtetuese (neni 113 paragrafi 7). Në të vërtetë, sipas dispozitës kushtetuese në fjalë, individët mund të iniciojnë procedurë, nëse të drejtat dhe liritë e tyre që ua garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës janë shkelur nga ana e autoriteteve publike, por vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet tjera juridike të parapara me ligj. Konsiderojmë se në këtë mënyrë janë parashikuar mbrojtjet e duhura të domosdoshme të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të secilit person që jeton dhe punon në territorin e Republikës së Kosovës.⁹⁷

⁹⁷ Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese ka pasur lëndë që kanë pasur të bëjnë me shtetas të huaj që punojnë dhe jetojnë në Kosovës dhe që kanë kërkuar mbrojtje pranë kësaj Gjykate. Shih lëndët: 1. Aktvendim për Papranueshmëri në rastin KI121/10. (*Parashtrues: Sitaram Chaulagai, Krishna Bandur Chamlagai, Chandra Kala Chauhan dhe Hom Bahadur Battarai. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë GJL. nr. 1258/2010, 1259/2010, 1260/2010, 1261/2010, të 22 nëntorit 2010*); dhe 2. Aktvendim për Papranueshmëri në rastin KI 147/11. (*Parashtrues: Maria Strugari. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, GJL. nr. 1288/2011 të 28 tetorit 2011*).

Neni 21.3

1. Garancitë kushtetuese për të drejtat e njeriut i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, lirisë dhe barazisë, sepse ato janë vlera themelore që karakterizojnë një shoqëri të drejtë, të hapur dhe demokratike dhe një bashkësi politike e cila mbështetet në sundimin e së drejtës. Në një bashkësi të tillë dinjiteti i personalitetit të njeriut është i pacenueshëm dhe për këtë arsye të gjitha janë të obliguar ta respektojnë, dhe rrjedhimisht edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës shprehimisht e përcakton se të gjithë janë të obliguar të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të të tjerëve (neni 21 paragrafi 3).

Neni 21.4

1. Në fund, duhet thënë se të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuara me Kushtetutë nuk vlejnë vetëm për personat fizikë,⁹⁸ por edhe për personat juridike,⁹⁹ për aq sa janë të zbatueshme (neni 21 paragrafi 4).

Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

(1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;

⁹⁸ Person fizik është shprehje që në të drejtën shënjon qenien njerëzore, individuale dhe të pavarur. Në shkencën juridike, personi fizik është qenie njerëzore e vetëdijshme që i nënshtrohet ligjeve fizike, për dallim nga personi juridik. Pra, njerëzit bëhen subjekt fizik me vetë lindjen e tyre dhe mbesin të tillë deri në vdekje e tyre. Atributet themelore të personave fizikë janë: a) emri personal; b) vendbanimi dhe vendqëndrimi; c) shtetësia.

⁹⁹ Person juridik është krijesë juridike, person fizik virtual i cili ka të drejtë dhe obligim ligjor, siç janë mundësia ligjore për të bërë kontrata, të padisë dhe të paditet e ngjashëm. Është person (ose trup) më së shpeshti në formën e një organizate, korporate (ndërmarrje) ose qeverie, që përbëhet prej disa personave fizikë, e të cilët ligji për arsye praktike i trajton si një person. Atributet e personave juridikë janë: a) emri; b) selia; c) shtetësia (përcaktohet sipas asaj se në cilin vend gjendet selia e personit juridik.

Në praktikën e Gjykatës ka pasur raste kur personat juridikë kanë kërkuar mbrojtje në Gjykatë. Shih lëndët: 1. Aktvendim për Papranueshmërinë në rastin KI19/10, (*Parashtruesi i kërkesës: Sh.P.K. "Syri", Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës SCA-09-0041 të 9 shkurtit 2010*); 2. Aktvendim për Papranueshmëri në rastin KI 99/10(*Parashtruesi i kërkesës H.C. "Emin Duraku" SH.A., Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit për privatizimin valës 45-A dhe 46 të Agjencisë Kosovare për Privatizim të 7 shtatorit 2010, respektivisht 4 tetorit 2010*); 3. Aktvendim për Papranueshmëri në rastin KI43/12, (*Parashtruesi i kërkesës SH. A "JATEX", Vlerësim kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme P.P.A.nr.3/ 2008 të 3 majit 2011*); dhe 4. Aktvendim për Papranueshmëri në rastin KI 61/09, (*Parashtruesi i kërkesës "Adler Com" Sh.p.k. nga Gjakova, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit të Kryetarit të Komunës së Gjakovës të 22 janarit 2008*).

- (2) **Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;**
- (3) **Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;**
- (4) **Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;**
- (5) **Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;**
- (6) **Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;**
- (7) **Konventa për të Drejtat e Fëmijës;**
- (8) **Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizo-re, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.**

Neni 22

1. Me këtë Kushtetutë garantohen të drejtat e njeriut dhe të pakicave të parashikuara me rregullat botërisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, të konfirmuara me marrëveshje ndërkombëtare dhe ligje. Të drejtat dhe liritë e njeriut të cilat janë vërtetuar me marrëveshje dhe instrumentet përkatëse ndërkombëtare janë të garantuar me këtë Kushtetutë dhe zbatohen drejtpërdrejt në territorin e Republikës së Kosovës¹⁰⁰. Ajo çfarë është shumë me rëndësi është fakti se të këto të drejta dhe liri kanë epërsi në rast të konfliktit ndaj të gjitha dispozitave ligjore dhe akteve tjera të institucioneve publike. Në këto marrëveshje dhe instrumente ndërko-mbëtare hyjnë:
 - ***Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*** (e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara (A/RES/217, 10 dhjetor 1948. në Pallatin Shajo në Paris), me të cilën është paraqitur këndvështrimi i përgjithshëm i organizatës përkitazi me çështjet e të drejtave që u garantohen njerëzve. Elenor Ruzvelt kishte thënë se Deklarata do të mund të ishte "*Magna karta për tërë njerëzimin* ")¹⁰¹;
 - ***Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe protokollet e saj*** (miratuar në Romë më 4 nëntor 1950 dhe hyrë në fuqi më 3 shtator 1953. Nënshkrueset e para të Konventës ishin: Belgjika, Danimarka, Franca, Gjermania, Irlanda, Italia, Islanda, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Turqia dhe Britania e Madhe. Pranimi i obligimeve nga Konventa do të thotë jo vetëm respektim i të drejtave dhe lirive, por edhe pranimi i juridiksionit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg të Francës që është themeluar me Konventën Evropiane. Gjykata për të drejtat e njeriut vepron pas shterjes së mjeteve juridike në shtetet anëtare);
 - ***Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj*** (kjo është një instrument ndërkombëtar për të drejtat e njeriut me karakter legjislativ. Me dispozitat e tij janë parashikuar të drejtat individuale dhe

¹⁰⁰ Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare është paraparë me nenin 22 të Kushtetutës.

¹⁰¹ Beasley, H. Maurine (2010), '*Eleanor Roosevelt: Transformative First Lady*' University Press of Kansas: USA, fq. 214, 220-221.

kolektive, masat e caktuara për mbikëqyrje të respektimit të tyre dhe Komisioni i themeluar për të drejtat e njeriut që përpiqet që shtete nënshkruese t'i përmbahen obligimeve të marra. Konventa është miratuar dhe hapur për nënshkrim dhe ratifikim ose aderim, me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 2200 A(XXI) të 16 dhjetorit 1966, ndërsa ka hyrë në fuqi më 23 mars 1976 kur 35 shtetet sa kërkoheshin i deponuan instrumentet e tyre për ratifikim ose aderim. Bashkë me Konventën janë miratuar edhe dy protokolle: Protokollin opcional i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike që ka hyrë në fuqi më 23 mars 1976 dhe Protokollin i Dytë Opcional i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike që ka hyrë në fuqi më 11 korrik 1991)¹⁰²;

- **Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare** (Marrëveshja e parë regjionale ndërkombëtare gjithëpërfshirëse dhe instrumenti i parë ndërkombëtar juridikisht i obligueshëm që i është kushtuar në tërësi mbrojtjes së pakicave kombëtare. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës e ka miratuar Konventën Kornizë në vitin 1994 e cila ka hyrë në fuqi më 1 shkurt 1998);
- **Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor** (është miratuar dhe hapur për nënshkrim dhe ratifikim nga ana e Asamblesë së Përgjithshme me Rezolutën 2106 A (XX) të 21 dhjetorit 1965. Ka hyrë në fuqi më 4 janar 1969);
- **Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, e njohur si Konventa CEDAW** (e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 18 dhjetor 1979, si një prej dokumenteve kyçe për zvogëlimin e pabarazisë gjinore);
- **Konventa për të Drejtat e Fëmijës** (e miratuar më 20 nëntor 1989 në Asamblesë të Përgjithshme të OKB-së dhe hyrë në fuqi në vitin 1990 pasi që u nënshkrua nga 20 shtetet e para. Konventa përmban 54 nene, që përcaktojnë katër grupe të të drejtave: 1) e drejta për mbijetesë, 2) e drejta për zhvillim, 3) e drejta e mbrojtjes 4) e drejta e pjesëmarrjes);
- **Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese** (e miratuar në vitin 1984, ndërsa ka hyrë në fuqi në vitin 1987. Përveç dispozitave për ndalimin e torturës, në instrumentet kryesore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ekzistojnë edhe marrëveshje të veçanta që kanë të bëjnë me torturën dhe veprimet ose dënimet mizore, jonjerëzore ose poshtëruese. Më e rëndësishmja prej tyre është Konventa në fjalë. Mbrojtja e integritetit fizik dhe psikik është e drejtë absolute që duhet të përcillet me ndalime precize).

Kjo është padyshim vlera e këtij dokumenti, por edhe kjo përfundimisht duhet vlerësuar në kuadër të tërësisë së tekstit kushtetues, e për më tepër në bazë të praktikës shoqërore. Nëse nuk bëhet kështu, atëherë zvogëlohet dukshëm mundësia që të vlerësohet sistemi i vërtetë kushtetues.

¹⁰² Për analizë më të detajuar shih: Bantekas, Ilias dhe Oette, Lutz (2013), 'International Human Rights Law and Practice' Cambridge University Press: Cambridge, Kapitulli 8 ("Civil and Political Rights").

Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut]

Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Neni 23

1. Për shkak të rëndësisë që ka edhe vetë deklarata kushtetuese e të drejtave të njeriut fillon me dinjitetin e njeriut ashtu që të shprehë qëndrimin parimor që të gjithë njerëzit duhet të kenë respektim të barabartë. Gjithashtu, arsye për këtë është edhe fakti që shteti ekziston për hir të njeriut, dhe jo njeriu për hir të shtetit, kështu që, dinjiteti i njeriut përjashton mundësinë dhe praktikën që njeriu të bëhet objekt i zakonshëm, qoftë i veprimeve të shtetit qoftë i veprimeve të personave privatë. Për këtë arsye garantimi i dinjitetit të njeriut është pikë fillestare ideale e të gjithat të drejtave tjera të njeriut, para së gjithash, të drejtës për jetën, pacenueshmëri dhe integritetin e njeriut, lirisë së personalitetit, lirisë së të menduarit dhe të drejtave tjera themelore. Respektimi i dinjitetit të njeriut është barriera e parë me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut.
2. Duke marrë parasysh një rëndësi të tillë të dinjitetit të njeriut, numri më i madh i kushtetutave bashkëkohore demokratike e shpallin atë si të pacenueshëm (të cilin nuk mund ta kontestojë askush), duke kërkuar nga të gjithë të tjerët që ta respektojnë dhe ta mbrojnë. Rrjedhimisht, dinjiteti i njeriut e përcjell secilin që të zhvillojë lirshëm personalitetin e vet në kuptimin trupor, shpirtëror dhe moral.
3. Si një prej vlerave themelore mbi të cilën mbështetet sistemi kushtetues, Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton që dinjiteti i njeriut është i pakontestueshëm (i pacenueshëm) dhe se paraqet, si i tillë, bazën e të gjitha të drejtave të tjera të njeriut dhe lirive themelore, kështu që shmangia nga e drejta e dinjitetit të njeriut nuk lejohet në asnjë rrethanë madje as gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Kjo është parashikuar shprehimisht në nenin 23 të Kushtetutës.¹⁰³

Neni 24 [Barazia para Ligjit]

- (1) **Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.**
- (2) **Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a**

¹⁰³ Përveç kësaj të drejte, në të drejtat absolutisht të mbrojtura hyjnë edhe: Barazia para Ligjit (Neni 24), E drejta për jetën (Neni 25), Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, jonjerëzor dhe poshtërues (Neni 27.), Ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar (Neni 28.), E drejta e Lirisë dhe Sigurisë (Neni 29.), E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm (Neni 31.), Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale (Neni 33.), E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër (Neni 34.), E Drejta e Martesës dhe e Familjes (Neni 37.), Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë (Neni 38.).

shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

- (3) Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.**

Neni 24

1. Ky nen garanton barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit dhe përcakton të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë gjyqësore pa asnjë dallim mes tyre. Në të vërtetë, kuptimi i këtij neni është ndalimi kushtetues i diskriminimit, si parakusht themelor i sigurimit të respektimit të të gjitha të drejtave tjera të njeriut që i garanton Kushtetuta dhe realizimit të tyre në kushte të barabarta.

Neni 24.1

1. Në mesin e dispozitave më të rëndësishme të Kushtetutës së Republikës së Kosovës për të drejtat dhe liritë themelore gjendet edhe norma për barazinë para ligjit (neni 24 paragrafi 1).¹⁰⁴

Neni 24.2

1. Kushtetuta shprehimisht e ndalon çfarëdo forme të diskriminimit duke mos përmendur format konkrete të diskriminimit direkt (drejtpërdrejtë) dhe indirekt (tërthortë), porse shprehimisht ndalon diskriminimin mbi bazën e cilësdo veti personale të individit (racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal). Krahas dispozitës së përgjithshme për barazinë para ligjit, të drejtës për mbrojtje të barabartë ligjore dhe ndalim të diskriminimit (neni 24 paragrafi 1), Kushtetuta

¹⁰⁴ Shih lëndët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KI39-09 dhe KI04-12.

Në rastin e parë, në mesin e shumë rasteve që shqyrtohen dhe vendosen në Gjykatë, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se nuk ekziston shkelja e barazisë vetëm për shkak se pala është e pakënaqur me vendimin e gjykatave të rregullta. Më hollësisht shih: Aktgjykimin e 3 nëntorit 2011 në rastin nr. KI 39/09 (*Parashtruesi i kërkesës Avni Kumnova. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 142/07, të 27 majit 2009*). Në rastin e dytë, megjithatë, në aktgjykimin lidhur me rastin KI 04/12 të 20 korrikut 2012, Gjykata gjeti shkelje të parimit të barazisë për shkak se gjykatat e rregullta nuk kishin përmbuar në tërësi vendimet e të ashtëquajuarit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës që është instancë kuazigjyqësore për zgjidhjen e ankesave në rastet nga marrëdhënia e punës të punësuarve në Shërbimin Civil. Gjykatat e rregullta i kishin përmbuar vetëm vendimet lidhur me kompensimin në të holla por jo edhe pjesën që kishte të bënte me kthimin në marrëdhënien e punës. Më detajisht shih: Aktgjykimin në rastin KI 04/12. (*Parashtruesi i kërkesës Esat Kelmendi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 647/2011 të 30 nëntorit 2011*).

përmban edhe një dispozitë të veçantë që siguron barazinë e gjinive si një vlerë të domosdoshme për zhvillimin e shoqërisë demokratike dhe mundësisë së barabartë të pjesëmarrjes së grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës shoqërore (neni 7 paragrafi 2). Kjo do të thotë që Kushtetuta përcakton obligimin e shtetit që në fushën e barazisë së gjinive të udhëheqë politika të mundësive të barabarta. Gjithashtu, Kushtetuta përcakton edhe një dispozita të veçantë që ndalon çdo formë të diskriminimit të bazuar në përkatësinë e komuniteti, pra grupit të caktuar nacional apo etnik, gjuhësor ose religjioz, që është tradicionalisht i pranishëm në territorin e Kosovës (neni 57 paragrafi 2).¹⁰⁵

Neni 24.3

1. Lidhur me sigurimin e barazisë para ligjit, e rrjedhimisht lidhur me ndalimin e diskriminimit mbi çfarëdo baze, duhet thënë se neni 24 paragrafi 3 përmban dispozita kushtetuese qëllimi i të cilave është të eliminojnë ose të ndryshojnë rrethanat që pengojnë arrijten e barazisë së personave ose grupeve të personave, të cilët faktikisht gjenden në pozicion të pabarabartë në raport me qytetarët e tjerë. Në të vërtetë, sipas këtyre dispozitave, parimi i lartpërmendur nuk është arsye për ndalimin e zbatimit dhe nxjerrjen e masave të përkohshme, nëse masat e tilla janë të domosdoshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve ose të grupeve, të cilët në krahasim me të tjerët me rastin e gëzimit të atyre të drejtave nuk janë të barabartë. Shteti në atë rast ndërmerr këto masa të veçanta (të përkohshme) dhe ky është obligimi i tij kushtetues, por masat e tilla mund të zbatohen vetëm deri në realizimin e qëllimit për të cilin edhe janë vendosur. Masat e tilla të përkohshme në të vërtetë paraqesin instrument me të cilin shteti zhvillon edhe politikën e mundësive të barabarta, zbut ose eliminon pabarazinë faktike. Rrjedhimisht, sipas kësaj dispozite kushtetuese shprehimore, këto masa të përkohshme që ndërmerren me qëllim të eliminimit të pabarazisë faktike, nuk konsiderohen diskriminim dhe shkelje e parimit të barazisë para ligjit. Prandaj, kjo është ajo që ato masa (të përkohshme, si masa të veçanta) vënë në pozicion më të favorshëm personat ose grupe të personave që gjenden në pozicion faktikisht të pabarabartë me të tjerët. Pikërisht për këtë, një dispozitë e tillë (neni 24 paragrafi 3 i Kushtetutës) për karakterin jodiskriminues të masave të përkohshme është i domosdoshëm në mënyrë që ato të mos vlerësohen si jo-kushtetuese. Natyrisht, ashtu siç e theksuam, masat e tilla të përkohshme kanë veprim të kufizuar kohor dhe zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato. Kushtetuta nuk ka ndonjë dispozitë lidhur me kohëzgjatjen e masave të tilla.

¹⁰⁵ Për shembull, në *rastin gjuhësor belg* (1968), Gjykata konkludoi se e drejta e arsimimit, në bazë të nenit 2 të Protokollit 1 vërtetë është e siguruar për të gjithë fëmijët në Belgjikë, refuzimi i mundësisë që fëmijët që flasin frëngjisht të shkojnë në shkollë në gjuhën frënge në periferi të Brukselit, vetëm në bazë të vendbanimit të prindërve, ndërsa një kufizim i tillë nuk ka ekzistuar për fëmijët që flasin gjuhën flamave, ka paraqitur formë të ndaluar të diskriminimit.

Neni 25 [E Drejta për Jetën]

- (1) Secili individ gëzon të drejtën për jetën.
- (2) Dënimi me vdekje është i ndaluar.

Neni 25

1. E drejta e njeriut për respektimin e jetës së tij gjendet mu në qendër të sistemit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kështu që e drejta për jetën, pra pacenueshmëria e jetës, është e drejtë absolute e njeriut që pranohet në të gjitha kushtetutat.¹⁰⁶ Ajo më së shpeshti gjendet në fillim të pjesës për të drejtat e njeriut dhe të drejtat civile, siç është rasti edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 25 paragrafi 1).¹⁰⁷ Kjo e drejtë është e garantuar edhe me dokumentet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, ku për shembull, në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (miratuar më 16 dhjetor 1966, dhe hyrë në fuqi më 23 mars 1976), është emërtuar si "e drejtë e lindur e secilës qenie njerëzore për jetën".¹⁰⁸
2. Këtu është shumë me rëndësi të theksohet se e drejta në fjalë mund të jetë absolute ose jo, pra mund të ketë karakter absolut në disa vende. Kjo do të thotë që e drejta për pacenueshmërinë e jetës është absolute vetëm në ato shtete në të cilat me Kushtetutë është e ndaluar shqiptimi i dënimit me vdekje, gjë të cilën e parasheh edhe neni 25 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në të vërtetë, në vende të caktuara lejohet dënimi me vdekje, madje sot është një tendencë e dukshme që në botë po rritet numri i shteteve që shprehimisht e ndalojnë dënimin me vdekje ose që dënimet e shqiptuara me vdekje nuk i ekzekutojnë. Kësisoj edhe në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ndalohet dënimi me vdekje ose shtetet obligohen që nuk do të ekzekutojnë më dënimet me vdekje dhe se do të ndërmarrin masa që këtë dënim ta heqin nga ligji. Konventa Evropiane e vitit 1950, për shembull, thotë se " E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i privohet jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjykate pas dënimit për një krim për të cilin dënimi është parashikuar me ligj ".

¹⁰⁶ Nowak, M., (1996), "Pravo na život", *Pravni život*, nr. 9, fq. 3-26.

¹⁰⁷ Shih lëndën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KI41-12.

Në aktgjykimin lidhur më këtë rast të 26 shkurtit 2013, Gjykata ka gjetur se ka shkelje të së drejtës për jetën në rastet kur organi gjyqësor ose organet tjera të shtetit nuk ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme qytetarëve kur këtë e kërkon situata, siç ka qenë ky rast kur një person femër është vrarë nga ana e ish-bashkëshortit të saj, me gjithë faktin që vazhdimisht ka kërkuar mbrojtje nga gjykata për shkak të dhunës së ushtruar ndaj saj në mënyrë të pandërprerë. Shih më detajisht: Aktgjykim në rastin KI 41/12. (*Parashtrues të kërkesës Gezim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komonale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës*).

¹⁰⁸ Disa Kushtetuta nuk e përmendin shprehimisht këtë të drejtë, por e presupozojnë qoftë duke garantuar pacenueshmërinë e integritetit trupor, qoftë me mbrojtjen e pakusht të jetës, pra ndalimin absolut të dënimit me vdekje.

3. Megjihatë, me Protokollin nr. 6. të kësaj Konvente, Këshilli i Evropës në vitin 1983 i obligoi shtetet nënshkruese që ta heqin dënimin me vdekje për të gjitha veprat penale, përveç atyre që janë kryer gjatë luftës ose gjatë rrezikut të afërt nga lufta, ndërsa me protokollin nr. 13 nga viti 2002 është hequr dënimi me vdekje, pa asnjë kufizim ose shmangie gjatë luftës ose rrezikut të afërt nga lufta.
4. Gjithashtu, këtu duhet përmendur edhe Protokollin e dytë fakultativ të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1989. Më këtë Konventë shtetet nënshkruese janë obliguar që më nuk do të ekzekutojnë dënimet me vdekje dhe që do të ndërmarrin masa që këtë sanksion ta heqin nga ligjet e tyre, ashtu që pala kontraktuese mund të mbajë të drejtën që të shqiptojë dënimin me vdekje, por vetëm për veprat më të rënda penale të natyrës ushtarake, që janë kryer gjatë gjendjes së luftës.
5. Në bazë të asaj që u tha më lart, shihet se pacenueshmëria e jetës mbron të drejtën e çdo njeriu për jetën, nga lindja e tij e gjer në vdekje. Kohëve të fundit, lidhur me të drejtën e pacenueshmërisë së jetës janë ngritur një numër çështjesh kontestuese, kryesisht për shkak të ekzistimit të mundësive të reja biomjekësore. Këtu, vëmendjen më të madhe të publikut e nxit aborti, pra ndërprerja e dhunshme e shtatzënisë përmes viktimizimit të frytit, ashtu që nga shumëkush kjo quhet fëmijëvrasje. Pastaj, këtu hyn edhe eutanazia, pra vrasja nga mëshira ose privimi i jetës së qenies njerëzore me vetë kërkesën e tij/saj, shkyçje e aparatit për mbajtje në jetë të personave që janë në komë, klonimi i qenieve të gjalla, transplantimi i organeve të caktuara të njeriut etj.¹⁰⁹

Neni 25.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se secili person ka të drejtën për jetë, me të cilën garantohet pacenueshmëria e jetës së njeriut (neni 25 paragrafi 1). Duke pranuar standardet e cekura evropiane për të drejtat e njeriut Kushtetuta përcakton që në sistemin e dënimeve në këtë Republikë nuk ekziston dënimi me vdekje. Konsiderojmë që me dispozita kushtetuese në fjalë, e lidhur me garantimin e të drejtës për jetën, do të duhej të ishte parashikuar ndalimi i klonimit të qenies njerëzore, ndalim ky të cilin sot e hasim gjithnjë e më shumë në tekstet kushtetuese të shumë vendeve. Gjithashtu në kuptimin e gjerë, në lidhje të ngushtë me pacenueshmërinë e cekur të jetës gjenden edhe dispozitat kushtetuese që garantojnë të drejtën e integritetit personal që përfshin të drejtën për të marrë vendim për të lindur fëmijë, në bazë të rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj (Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 26 pika 1).

¹⁰⁹ Shih vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1995.), ose (*Ergi kundër Turqisë* (1998.) dhe *Yaşa kundër Turqisë* (1998.))

Neni 25.2

1. E drejta për jetën, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i takon grupit të të drejtave të mbrojtura absolute (neni 25 paragrafi 2), pasi që dënimi me vdekje është i ndaluar. Si e tillë, kjo e drejtë nuk mund të kufizohet në asnjë mënyrë madje as gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Shmangia nga kjo e drejtë e garantuar me nenin 25 nuk lejohet në asnjë rrethanë (Neni 56 paragrafi 2 i Kushtetutës).

Neni 26 [E Drejta e Integritetit Personal]

Secili person gëzon të drejtën e respektimit të integritetit fizik dhe psikik të tij/saj, që përfshin:

- (1) të drejtën që të marrë vendime lidhur me reprodukimin, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj;
- (2) të drejtën që të ketë kontroll mbi trupin e saj/tij në pajtim me ligjin;
- (3) të drejtën që të mos i nënshtrohet trajtimit mjekësor kundër vullnetit të tij/saj në pajtim me ligjin;
- (4) të drejtën që të mos marrë pjesë në eksperimente mjekësore ose shkencore, pa pëlqimin paraprak të saj/tij.

Neni 26

1. E drejta për integritet personal, pra e drejta për respektim dhe pacenueshmëri të integritetit të çdo personi hyn në mesin e të drejtave personale më të rëndësishme. Prandaj, të gjitha kushtetutat bashkëkohore moderne e garantojnë këtë të drejtë, por duhet theksuar se mbrojtja e këtij integriteti nuk shteret vetëm në mbrojtjen e shëndetit. Ç'është e vërteta, edhe kërkesat tjera, përveç nëse nuk janë krejtësisht të parëndësishme, hynë në këtë koncept, siç janë për shembull, dhënia e drogës, ndëshkimi trupor, intervenimet kirurgjike për "zbukurim", marrja e organeve etj. Tek e drejta për integritet personal sikurse edhe tek e drejta për jetën, për shtetin nuk ekziston vetëm obligimi për lehtësim por ekziston edhe obligimi pozitiv për ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e pacenueshmërisë së integritetit të njeriut, veçanërisht nëse ky integritet cenohet nga objektet e rrezikshme ose nga ndotja e ujit dhe ajrit.
2. Ajo çfarë duhet bërë me dije kur bëhet fjalë për të drejtën për integritet personal dhe pacenueshmëri e integritetit të njeriut është fakti se kjo e drejtë duhet të përcillet me dispozita precize kushtetuese. Kushtetuta e Republikës së Kosovës posaçërisht garanton respektimin e personalitetit dhe dinjitetit të njeriut në procedurat penale dhe në çfarëdo procedure tjetër, në rast të privimit, respektivisht kufizimit të lirisë sikurse dhe gjatë ekzekutimit të dënimit. Përveç kësaj, Kushtetuta merr dispozitën e Konventës Evropiane, sipas së cilës " Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës" (neni 27 i Kushtetutës), si dhe nuk "i nënshtrohet trajtimit mjekësor..." (neni 26 paragrafi 3), "eksperimenteve mjekësore dhe shkencore " (neni 26 pika 4) pa dhënien e pëlqimit të tij/saj.

3. E drejta për integritet personal, që krijon obligim për respektimin dhe pacenueshmërinë e integritetit fizik dhe psikik të secilit person, Kushtetuta e garanton me normë të përgjithshme, ndërsa e konkretizon në disa dispozita të veçanta kushtetuese. Përmbajtjen që ka norma e përgjithshme kushtetuese për respektimin e integritetit fizik dhe psikik të secilit person dhe pacenueshmërisë së tyre, e përkufizon dispozita për të drejtën për marrjen e vendimit për të lindur fëmijë, në bazë të rregullave dhe procedurave të përcaktuara me ligj (neni 26 paragrafi 1), si dhe dispozita për të drejtën e kontrollit e trupit të secilit person, në pajtim me ligjin (neni 26 paragrafi 2). Gjithashtu, këtu hyjnë edhe dispozitat për ndalimin e torturës, trajtimit mizor, jonjerëzor dhe poshtëruës (neni 27), dhe posaçërisht e drejta për mosnënshtrim eksperimenteve mjekësore dhe shkencore, pa dhënien e pëlqimit të individit. Respektimin dhe pacenueshmërinë e integritetit fizik dhe psikik e përkufizon në aspektin përmbajtjesor ndalimi i mbajtjes në skllavëri ose në pozitë të ngjashme me skllavërinë (neni 28 paragrafi 1), ndalimi i punës së detyruar (neni 28 paragrafi 2), si dhe ndalimi i tregtisë me qenie njerëzore (neni 28 paragrafi 3).
4. Disa të drejta që i takojnë këtij grupi e kanë statusin e të drejtave të mbrojtura absolute. Atë që duhet përmendur këtu është fakti se Kushtetuta i përcakton si të drejta absolute, ndalimin e torturës, trajtimit mizor, jonjerëzor dhe poshtëruës (neni 27) dhe ndalimin e skllavërisë dhe punës së detyruar (neni 28), që do të thotë se shmangia nga këto të drejta nuk lejohet në asnjë rrethanë, madje as pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme (neni 56). Megjithatë, Kushtetuta këtë nuk e ka paraparë edhe për të drejtën për integritet personal (neni 26), gjë që konsiderojmë se doemos duhet bërë dhe se kjo e drejtë doemos është dashur të gjendet në grupin e të drejtave dhe lirive themelore nga të cilat nuk lejohet shmangia as edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

Neni 27 [Ndalimi i Torturës, Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruës]

Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës.

Neni 27

1. Kushtetuta në nenin 27 e pranon dispozitën e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut nga viti 1948, që proklamon se askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit ose ndëshkimit mizor, jonjerëzor ose poshtëruës (neni 5). Edhe marrëveshje ndërkombëtare dhe dokumente tjera për të drejtat e njeriut parashikojnë këto ndalime, përfshirë ndalimin e punës së detyruar. Lidhur më këtë, në kuadër të Kombeve të Bashkuara është nxjerrë Konventë e veçantë kundër torturës dhe dënimeve e trajtimeve tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (1984) dhe është themeluar organ special për përcjelljen dhe zbatimin e saj - Komiteti kundër torturës (neni 17). Në këtë materie është nxjerrë edhe Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe dënimeve ose trajtimeve jonjerëzore

dhe poshtëruese (1987.), lidhur me të cilën në vitin 1989 është themeluar Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës që ka zhvilluar një numër standardesh që kanë për qëllim mbrojtjen e të burgosurve nga tortura dhe trajtimeve ose ndëshkimet tjera jonjerëzore dhe poshtëruese, përfshirë mbylljen në qeli izolimi, disiplinë, kontakte me botën e jashtme, si dhe procedura ankimore dhe të inspektimit. Me qëllim të vendosjes së trajtimit human Këshilli i Evropës ka nxjerrë Rregulloren Evropiane për Burgjet (1987).

2. Shtetet duhet të ndërmarrin masa të qëndrueshme, vendimtare dhe efikase që të mund të parandalohen dhe eliminohen të gjitha rastet e torturës dhe trajtimeve ose dënimeve tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese. Shtetet, gjithashtu duhet të sigurojnë që kryesit e trajtimeve të tilla të sillen para drejtësisë. Konventa kundër torturës dhe trajtimeve ose dënimeve tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese është miratuar në vitin 1984, por deri më sot rreth 50 vende nga e tërë bota, ende nuk janë anëtare të kësaj konvente derisa gati gjysma e rreth 150 vendeve anëtare ende nuk bërë palë nënshkruese të plota.¹¹⁰

Neni 28 [Ndalimi i Skllavërisë dhe i Punës së Detyruar]

- (1) Askush nuk mund të mbahet në skllavëri ose në pozitë të ngjashme me skllavërinë.
- (2) Askush nuk mund të shtrëngohet për të kryer punë të detyruar. Punë e detyruar nuk konsiderohet puna ose shërbimi i përcaktuar me ligj për personat e dënuar me vendim të formës së prerë gjatë vuajtjes së dënimit ose në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme, të shpallur sipas rregullave të përcaktuara me këtë Kushtetutë.
- (3) Trafikimi i qenieve njerëzore është i ndaluar.

Neni 28

1. Numër i konsiderueshëm i Konventave multilaterale ka të bëjë me ndalimin e skllavërisë dhe institucionit e praktikës së ngjashme me skllavërinë, si dhe ndalimin e tregtisë me njerëz. Janë këto konventa të lidhura mu në fillim të shekullit XX dhe pas Luftës së Parë Botërore, kur është zhvilluar një rregullativë intensive ndërkombëtare me qëllim heqjen dhe ndalimin e institucionit të skllavërisë që e dehumanizon dhe poshtëron njeriun në mënyrë brutale duke e privuar nga çdo e drejtë dhe liri e njeriut. Nga aspekti i sotëm, ato Konventa edhe pse pjesërisht të tejkaluara, ato kanë rol të rëndësishëm juridik dhe politik, ndërsa në përmbledhjen e marrëveshjeve në Kombet e Bashkuara ato trajtohen njëjtë sikurse edhe Konventat tjera.

¹¹⁰ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka bërë dallim në mes të tri koncepteve thelbësore në nenin 3 në kuptim të shkallës së mizorisë së një veprimi ose ndëshkimi konkret në *çështjen Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1978.).

2. Në aspektin e ndalimit të skllavërisë janë arritur rezultat të konsiderueshme brenda shteteve të caktuara, ashtu që pas këtyre përparimeve pozitive është nxjerrë numër i madh i marrëveshjeve ndërkombëtare duke marrë parasysh se skllavëria ka qenë çështja e parë e të drejtave të njeriut që ka zgjuar vëmendjen e opinionit ndërkombëtar. Kësisoj, në mesin e marrëveshjeve më të rëndësishme ndërkombëtare për ndalimin e skllavërisë radhiten: 1) Deklaratë për eliminimin e përgjithshëm të tregtisë me njerëz (1815.); 2) Marrëveshja ndërkombëtare për zhdukjen e tregtisë me njerëz (1904.); 3) Konventa për zhdukjen e tregtisë (1910.); 4) Konventa për zhdukjen e tregtisë me gra dhe fëmijë (1921.); 5) Konventa për skllavërinë (1926); 6) Konventa për zhdukjen e tregtisë me gra të rritura (1933.); 7) Konventa për zhdukjen e tregtisë me qenie njerëzore dhe eksploatimin e prostitucionit të personave tjerë (1949); 8) Konventa për eliminimin e skllavërisë, tregtisë me njerëz dhe institucioneve e praktikave të ngjashme me skllavërinë (1956).
3. Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1998 ka formuar një komitet *ad hoc* dhe e ka autorizuar që të hartojë një draft Konventë kundër kriminalitetit të organizuar ndërkombëtar dhe instrumente juridike shtesë. Ky Komitet e ka hartuar këtë draft si dhe tri protokolle plotësuese, në mesin të cilave edhe Protokollin për parandalimin, zhdukjen dhe dënimin e tregtisë me njerëz, sidomos me femra dhe fëmijë. Teksti i Konventës dhe dy Protokollin (për tregtinë me njerëz dhe kontrabandë e migrantëve), janë miratuar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 15 nëntor 2000, ndërsa Protokollin i tretë është miratuar më 31 maj 2001.
4. Mes garancive kushtetuese për të drejtat dhe liritë themelore që mbrojnë integritetin fizik të personalitetit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton edhe disa ndalime, domethënia e të cilave është mbrojtja e integritetit fizik dhe dinjitetit të personalitetit. Kësisoj, krahas dispozitës shprehimore, sipas së cilës askush nuk duhet të mbahet në skllavëri ose në pozitë të ngjashme me skllavërinë (neni 28 paragrafi 1), Kushtetuta e ndalon punën e detyruar (neni 28 paragrafi 2), si dhe çdo formë të tregtisë me njerëz (neni 28 paragrafi 3).¹¹¹

Neni 28.1

1. Para se të fillojmë komentimin për paragrafin 1 të këtij neni, do të tregojmë se çka nënkuptohet me skllavëri. Në të vërtetë, skllavëria është status shoqëror ose juridik i individit (skllavit), të cilit i janë marrë të drejtat e njeriut dhe ai gjendet në pronësi të personit ose bashkësisë tjetër. Skllavi bëhet i tillë me të lindur, me blerje ose kapje dhe mbahet në gjendje/status të tillë kundër vullnetit të tij, për përfitim material, financiar, seksual ose përfitim tjetër nga ana e atij në pronësinë e të cilit

¹¹¹ Deri në fund të vitit 2003. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vetëm në një çështje ka konkluduar se bëhet fjalë për shkelje të ndalimit të punës së detyruar ose të obligueshme dhe atë në lidhje me ndalimin e diskriminimit, kur autoritetet kishin kërkuar që të gjithë personat meshkuj duhet të punojnë në skuadrën e zjarrfikësve ose duhet të paguajnë dënimin me gjobë (*Karlheinz Schmidt kundër Gjermanisë* 1994.)).

gjendet. Shikuar historikisht, skllavërit janë shfrytëzuar me së shpeshti si fuqi punëtore pa pagesë e cila nuk ka të drejtë të refuzojë, ta lë ose të marrë diçka në këmbim për punën e tillë. Fakt është se skllavëria fatkeqësisht ka qenë pjesë përbërëse e kulturave të ndryshme gjatë historisë porse në dyqind vitet e fundit konsiderohet e papranueshme dhe johumane.¹¹² Në kuptimin juridik, skllavëria është e kundërligjshme dhe e palejueshme në pothuajse të gjitha shoqëritë e sotme, ndërsa shtetet në cilat është e lejuar me ligj vështirë se mund të gjenden. Mirëpo, këtu duhet pasur shumë kujdes dhe theksuar se Shoqata për Luftën Kundër Skllavërisë pohon se "edhe pse nuk ekziston më asnjë shtet që e pranon skllavërinë apo që pranon pretendimet e ndonjë personi për pronësinë mbi personin tjetër, heqja e skllavërisë nuk do të thotë ajo nuk ekziston më ". Në të vërtetë, janë me miliona njerëz anembanë botës që jetojnë dhe punojnë (në veçanti fëmijë) në kushte të ngjashme me skllavërinë.

2. Duke marrë parasysh se në të gjitha shtetet bashkëkohore demokratike shprehimisht me Kushtetutë dhe me rregulla përkatëse ligjore ndalohet skllavëria dhe pozita e ngjashme me skllavërinë, njashtu edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 28, përcakton që " askush nuk duhet të mbahet në skllavëri ose në pozitë të ngjashme me skllavërinë".

Neni 28.2

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës me dispozitën e paragrafit 2 të këtij neni përcakton se askush nuk duhet të detyrohet të kryejë punë të detyruar, gjë që është në pajtim me Deklaratat, Konventat dhe qëndrimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës të cilat punën e detyruar e përkufizojnë si " çdo punë apo shërbim që është i kërkuar nga ndonjë person nën kërcënim të çfarëdo ndëshkimi dhe për të cilën personi i tillë nuk është ofruar vullnetarisht". Përfundimisht nga kjo punë janë punët në ushtrimet ushtarake, punët e të dënuarve, punët gjatë gjendjes së jashtëzakonshme dhe vuajtja e dënimit përmes punës në të mirë të shoqërisë. Konform kësaj mënyre të të kuptuarit nga ana e Organizatës Ndërkombëtare të Punës të përjashtimeve të lartpërmendura edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës shprehimisht përcakton rastet që nuk konsiderohen punë e detyruar dhe që prandaj nuk i nënshtrohen ndalesës kushtetuese për punën e detyruar. Përveç asaj që u përmend më lart, Konventa Evropiane me shprehjen "punë e detyruar dhe e obligueshme" nuk e konsideron as punën ose shërbimin që është pjesë përbërëse e obligimeve të zakonshme qytetare. Kështu që, sipas paragrafit 2 të nenit 28 të

¹¹² Deri te heqja e skllavërisë në botë ka ardhur gjatë shekujve të kaluar dhe duhet theksuar se në botë Japonia është e para që e ka hequr skllavërinë në vitin 1588. Në pjesët tjera të botës, kjo heqje është bërë mjaft ngadalë, ashtu që në Mbretërinë e Bashkuar, si vend amë, skllavëria është hequr në vitin 1807, ndërsa në tërë mbretërinë në vitin 1834. Ky proces ka filluar edhe në SHBA në vitin 1791, ndërsa ka përfunduar vetëm në vitin 1865., në Brazil në vitin 1888, si vend i fundit nga Amerika Veriore dhe Jugore. Është interesant të përmendet se disa vende këtë proces e kanë përmbyllur tek në gjysmën e dytë të shekullit XX, siç janë Arabia Saudite (1962. godine) dhe Mauritania në vitin 1981, madje disa raporte flasin se disa skllavëria ende ekziston në këtë vend në forma të caktuar.

Kushtetutës, punë e detyruar nuk konsiderohet: 1) puna ose shërbimi që është përcaktuar me ligj për personat që janë dënuar me vendim të formës së prerë; 2) puna ose shërbimi për personat që gjenden në vuajtje të dënimit me privim të lirisë; 3) puna ose shërbimi në rast të gjendjes së jashtëzakonshme, me kusht që një gjendje e tillë të jetë shpallur në bazë të rregullave të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 28.3

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës me dispozitën e paragrafit 3 të nenit 28 shprehimisht e ndalon tregtinë me njerëz. Mirëpo, këtu duhet theksuar se tregtia me njerëz nuk është e njëjtë me kontrabandën me njerëz. Në të vërtetë, duke marrë parasysh se shumica e viktimave të kësaj tregtie janë gratë dhe fëmijët, që detyrohen në prostitucion (tregtia me njerëz shpesh quhet "trafikim"(trafikim) ose "seks trafikim" (seks trafikim)), viktimat e tregtisë në fjalë nuk janë të lira, por janë të robëruara (ato nuk janë pajtuar me atë, porse janë mashtruar me premtime të rrejshme ose janë detyruar dashur ose padashur). Ky nuk është rasti me kontrabandën me njerëz, ku kontrabanduesi me kompensim në të holla e çon dikë në një shtet të caktuar por nga ai moment, kur ai person të jetë kontrabanduar, ai bëhet i lirë (personi pranon që të kontrabandohet me kompensim të caktuar në të holla). Numrat e saktë të tregtisë me njerëz nuk dihen, por është vlerësim i qeverisë amerikane që kufijtë ndërkombëtarë i kalojnë deri në 900.000 në vit, por duhet bërë me dije faktin se në këtë numër nuk hyjnë ato viktimat me të cilat bëhet tregti përbrenda një vendi.
2. Sipas Kodit Penal të Kosovës (të nxjerrë më 06.07.2003 dhe shpallur në "Gazetën Zyrtare" të Kosovës, nr. 2003/25 - të ndryshuar me 2004/19), shprehja "skllavërim" shënon ushtrimin e një kompetence ose i të gjitha kompetencave që lidhen me të drejtën e pronësisë mbi një person, duke përfshirë ushtrimin e një kompetence të tillë në trafikimin e njerëzve, veçanërisht të grave dhe të fëmijëve. Duke marrë parasysh se tek tregtia me njerëz vjen deri te skllavërimi i viktimave pa dëshirën e tyre, kjo vepër penale është kategorizuar si krim kundër njerëzimit (neni 117 paragrafi 2 pika 3 Kodit Penal të Kosovës). Sipas dispozitave të nenit 139 paragrafi 8 të Kodit të njëjtë, shprehja "trafikim me njerëz" shënon rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit. Neni në fjalë shprehimisht e përcakton që rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i fëmijës me qëllim të shfrytëzimit konsiderohet "trafikim me njerëz", madje edhe nëse kjo nuk përfshin asnjërin nga mjetet e detyruara të parashtruara në fjalinë pararendëse.
3. Duke marrë parasysh që trafikimi me njerëz parqet vepër të rëndë penale, me Kodin Penal të Kosovës (neni 139 paragrafët 1-7) janë paraparë dënime të rrepta

me burgim për këtë veprë kundër njerëzimit, konkretisht prej 2 deri në 12 vjet. Mirëpo, nëse kjo veprë penale është kryer ndaj personit më të ri se 18 vjet, kryesi do të dënohet me burgim prej 3 deri në 15 vjet. Gjithashtu, është paraparë dënimi edhe për organizatorin e grupit të personave për kryerjen e kësaj veprë penale (dënimi me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej 7 deri në 20 vjet). Në rast se një person nga pakujdesia mundëson kryerjen e trafikimit me njerëz, dënohet me burgim prej 6 muajve deri në 5 vjet, që do të thotë se për dënimin e tij nuk nevojitet dashja, por mjafton edhe pakujdesia.

Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë]

- (1) Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë. Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim:
 1. pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale;
 2. për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një veprë tjetër penale dhe vetëm për një periudhë të shkurtër kohore para gjykimit në mënyrën e përcaktuar me ligj;
 3. për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm;
 4. për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë;
 5. për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim.
- (2) Çdokush që privohet nga liria, duhet të vihet në dijeni menjëherë, për arsyet e privimit, në gjuhën që ajo/ai e kupton. Njoftimi me shkrim mbi arsyet e privimit duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Çdokush që privohet nga liria pa urdhër të gjykatës, brenda dyzet e tetë (48) orësh duhet të dërgohet përpara gjyqtarit, i cili vendos për paraburgimin ose lirimin e tij/saj, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga momenti kur personi i privuar është sjellë para gjykatës. Çdokush që arrestohet, ka të drejtën që të nxirret në gjykim brenda një periudhe të arsyeshme, ose të lirohet në pritje të gjykimit, me përjashtim kur gjyqtari konstaton se personi përbën rrezik për komunitetin ose ka rrezik për ikjen e saj/tij para gjykimit.
- (3) Çdokush që privohet nga liria, duhet të njoftohet menjëherë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe se ka të drejtë për mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj dhe ka të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë personin sipas zgjedhjes së vet.
- (4) Çdokush që i hiqet liria me arrest ose ndalim, gëzon të drejtën që të përdorë mjete juridike për të sfiduar ligjshmërinë e arrestit ose të ndalimit. Rasti do të vendoset nga gjykata brenda një afati sa më të shkurtër

dhe nëse arresti ose ndalimi është i paligjshëm, do të urdhërohet lirimi i personit.

- (5) Çdokush që është ndaluar ose arrestuar në kundërshtim me dispozitat e këtij neni, gëzon të drejtën e kompensimit në mënyrën e parashikuar me ligj.**
- (6) Personi që vuan dënimin, ka të drejtë të ankohet për kushtet e privimit nga liria, në mënyrën e përcaktuar me ligj.**

Neni 29

1. Mbrojtja dhe garantimi i lirisë personale në demokracitë individualiste-liberale, vihet zakonisht si një nga të drejtat e para kushtetuese të qytetarëve. Në fakt, kjo nuk është ndonjë e drejtë por thjesht një gjendje. Pushteti shtetëror duhet sa më pak të kufizojë lirinë natyrore të individëve dhe ajo mund të ndërhyjë vetëm atëherë kur është e nevojshme që të mbrohet liria tjetër e dikujt. Një parim i tillë i vënë në mënyrë të përgjithshme mu në fillim të nenit 29 të Kushtetutës, në pikën e dytë është paksa më mirë i precizuar dhe i konkretizuar. Në të vërtetë, pika e dytë përmban postulatën *habeas corpus*, të cilin që në vitin 1679 qytetarët anglezë arritën ta sigurojnë nga sundimtari i kohës. Sipas këtij parimi, asnjë qytetar nuk ka mundur të privohet nga liria pa bazë ligjore dhe pa u paraqitur në gjykatë (prandaj edhe shprehja *habeas corpus*, që do të thotë se i dyshuari duhet personalisht t'i paraqitet gjykatës, t'i nënshtrohet së njëjtës dhe aty të provojë të arsyetohet).
2. E drejta e lirisë dhe e sigurisë paraqet korpusin e të drejtave të njeriut, që është i mbrojtur me të gjitha dokumentet e përgjithshme për të drejtat e njeriut. Kësisoj, neni 5 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka të bëjë me mbrojtjen e lirisë fizike, e veçanërisht lirisë nga arrestimi ose ndalimi arbitrar, duke siguruar garancitë për disa të drejta themelore procedurale, si për shembull:
 - 1) e drejta për t'u informuar menjëherë për arsyet e arrestimit;
 - 2) e drejta për ta nxjerrë atë person para gjykatës pa vonesa;
 - 3) e drejta për të ushtruar ankesë dhe për procedurë pa vonesë lidhur me të njëjtën.
3. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut parashikon që të gjitha qeniet njerëzore lindin të lira dhe të barabarta në dinjitet dhe të drejta (neni 1), që secilit i takojnë të gjitha të drejtat dhe liritë e proklamuar me këtë Deklaratë, pa marrë parasysh dallimet në aspektin racor, të ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit, mendimit politik ose mendimit tjetër, përkatësisë nacionale ose shoqërore, pronës, lindjes ose rrethanave tjera (neni 2), që secili ka të drejtë për jetën, lirinë dhe sigurinë e personalitetit (neni 3), dhe se të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë dallim në mbrojtje të barabartë nga ligji (neni 7).
4. Me të drejtën për lirinë personale nënkuptohet liria fizike e personalitetit, me të cilën secilit i garantohet mundësia e lëvizjes trupore në hapësirë të gjerë dhe sipas zgjedhjes së lirë. Natyrisht, liria personale nuk është e pakufizuar pasi që ajo nuk përfshin të drejtën për të hyrë në vende të huaja, si dhe qasja në vende të cilat në

interes të publikut nuk janë të qasshme ose janë të mbrojtura si sferë private e njerëzve tjerë. Këto liri garantohen me Kushtetutë por për to ekzistojnë edhe kufizime në aspektin që kjo garanci nuk shtrihet në lirinë e përgjithshme të veprimit ose lirinë e vullnetit të individëve.

5. Liria e vërtetë është e rëndësishë kruciale për jetën normale të njeriut dhe ai mund të jetë vërtetë i lirë, përveç nëse nuk duhet të jetojë në frikë nga arrestimi arbitrar. Rrjedhimisht në raport me pushtetin shtetëror, e posaçërisht në raport me organet policore dhe gjyqësore, liria personale është barazuar me sigurinë. Siguria, qysh në deklaratat franceze ka pasur rangun e të drejtës natyrale të njeriut dhe se atëherë por edhe tani është kuptuar si ndalesë organeve që arbitrarisht t'ia marrin ose kufizojnë lirinë njeriut. Pa garanci të shumëfishta për lirinë personale është i paparamendueshëm katalogu kushtetues i të drejtave të njeriut. Korpusi i këtyre garancive është përfshirë edhe në dokumentet ndërkombëtare, para së gjithash në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Politike dhe Civile, Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe dokumente tjera.
6. Në tërë nënin 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, askund nuk përmendet as shtetasi as qytetari i Republikës së Kosovës. Aty nuk flitet në "formë negative për askënd", që do të thotë "për secilin", pra, për çdo person, pa marrë parasysh nëse ai është shtetas ose jo (kuptohet, ky mund të jetë vetëm person fizik sepse personi juridik nuk privohet nga liria). Prandaj, mbrojtja e lirisë personale vlen për çdo person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës.¹¹³

Neni 29.1

1. Duke pranuar qëndrimet e Konventës Evropiane, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nënin 29 paragrafi 1 i garanton secilit person të drejtën e lirisë dhe sigurisë (lirinë personale), duke cekur se askush nuk mund të privohet nga liria, përveç në rastet e përcaktuara me ligj, si dhe në bazë të vendimit të formës së prerë nga gjykata kompetente, që do thotë se kjo e drejtë nuk është absolute dhe se e drejta e lirisë mund të kufizohet në rastet e lartpërmendura, ku hyjnë:
 - 1) aktgjykimi i formës së prerë për dënimin me burgim për shkak të veprës së penale;
 - 2) dyshimi i arsyeshëm se personi ka kryer veprën penale, por vetëm kur një privim i tillë nga liria është i domosdoshëm për parandalimin e kryerjes së veprës penale dhe duhet të jetë në kohëzgjatje sa më të shkurtë;
 - 3) mbikëqyrje edukative personit të mitur ose sjellja e tij para organit kompetent;
 - 4) mbikëqyrje shëndetësore e personit i cili për shkak të sëmundjes është i rrezikshëm për shoqërinë;
 - 5) hyrja ilegale në Republikën e Kosovës;
 - 6) urdhri i ligjshëm për largim ose ekstradim.

¹¹³ Shih lëndën *Aerts kundër Belgjikës* (1998), Gjykata Evropiane ka gjetur shkelje të nenit 5 (1) kur parashtruesin e kërkesës e kishin mbajtur shtatë muaj, aq sa kishte zgjatur privimi i tij nga liria, në krahun psikiatrik të burgut të zakonshëm, dhe jo në qendrën për mbrojtje sociale ashtu siç kishte përcaktuar komisioni kompetent për shëndet mendor.

2. Prandaj, edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës është garantuar liria personale dhe pamundësuar çfarëdo sulmi ndaj saj, por çdo gjë brenda kufijve të ligjit, që do të thotë se për veprimin e ligjvënësit Kushtetuta këtu nuk vë asnjë pengesë. Vetëm pushtetit ekzekutiv (qeverisë dhe gjyqësor) i është ndaluar që ta privojë dikë nga liria, nëse këtë nuk e ka paraparë ligji paraprakisht. Kontestuese këtu është nëse privimi nga liria është kryer nga ana organeve policore, gjyqësore ose nga cilido organ tjetër. Për më tepër, edhe vendosja e detyruar në spitale (shpirtërore, infektuese, shërimi nga droga etj.) do të ishte në kundërshtim me këtë rregull nëse është kryer pa bazë ligjore.
3. Kjo është një nga të drejtat themelore dhe përcakton një numër të garancive të veçanta, qëllimi i të cilave është ta mbrojnë këtë të drejtë. Garancitë e veçanta kanë të bëjnë me përcaktimin eksplicit të kushteve në të cilat mund të kufizohet liria personale e individit. Këtu gjithashtu hyjnë edhe rregullimi i procedurës së privimit nga liria, përcaktimi i organit që është kompetent për të vendosur lidhur me privimin nga liria dhe në fund, garantimi i të drejtave të caktuara me të cilat mund të shërbehet individit në procedurë para organeve shtetërore, kur i është kufizuar liria e tij personale.

Neni 29.2

1. Prandaj, garancitë më të rëndësishme kushtetuese të lirisë personale përfshijnë rregullimin ligjor të arsyeve për privimin nga liria dhe të procedurës së privimit nga liria (neni 29 paragrafi 1). Mirëpo, për nevoja të mëtejme të komentit tonë lidhur me këtë nen, është shumë rëndësi garantimi i të drejtave të veçanta që i ka personi në momentin e privimit nga liria (neni 29 paragrafi 2, 3. i 4.). Gjithashtu, në pjesën e mëtejme të komentit do të bëhet fjalë edhe për referimin në të drejtat që gëzojnë personat që janë viktimat të arrestimit ose ndalimit (neni 29 paragrafi 5) dhe personat që janë në vuajtje të dënimit (neni 29 paragrafi 6).
2. Në mesin e të drejtave të veçanta që gëzon individit në momentin e privimit nga liria janë:
 - 1) e drejta për procedim urgjent ("të menjëhershëm", siç e thotë Kushtetuta);
 - 2) e drejta për t'u njoftuar për arsyet e arrestimit, pra privimit nga liria ("sa më shpejt që është e mundshme", siç e thotë Kushtetuta);
 - 3) e drejta për t'u njoftuar për natyrën dhe arsyet e akuzës me të cilën ngarkohet;
 - 4) e drejta që arsyet e arrestimit dhe akuza që i ngarkohet t'i komunikohen në gjuhën e tij amtare ose në gjuhën që e kupton;
 - 5) e drejta që për privimin nga liria të njoftojë personin të cilin e zgjedh vetë;
 - 6) e drejta për t'u njoftuar për të drejtat e tij/saj;
 - 7) e drejta për të ushtruar ankesë në gjykatë për shkak të privimit nga liria (për t'u vlerësuar ligjshmëria e arrestimit ose ndalimit);
 - 8) obligimi i gjykatës që të vendos lidhur me ankesën me procedurë urgjente ("brenda një afati sa më të shkurtër", siç e thotë Kushtetuta).

3. Mënyra se si janë rregulluar disa nga garancitë lidhur me privimin nga liria, paraqet rast për të ngritur disa çështje. Para së gjithash, e drejta për përdorimin e gjuhës në procedurë pranë organeve të pushtetit shtetëror, posaçërisht në procedurën e privimit nga liria dhe në procedurë gjyqësore, është më rendësi për mbrojtjen e lirisë personale. Kjo çështje është veçanërisht e ndjeshme në një mjedis ku jetojnë banorë të grupit të njëjtë nacional ose etnik, gjuhësor ose fetar, që është tradicionalisht i pranishëm në territorin e Kosovës (bashkësisë). Në një mjedis të tillë Kushtetuta ua garanton pakicave kombëtare dhe grupeve tjera që të shfrytëzojnë gjuhën e vet amtare ose gjuhën të cilën e kuptojnë, shkrimin, në kushte dhe në mënyrën e rregulluar me Kushtetutë dhe me ligje (neni 59 i Kushtetutës).¹¹⁴
4. Lidhur me garancitë që kanë të bëjnë me lirinë personale, Kushtetuta e përmend vetëm gjuhën (gjuhën amtare ose gjuhën të cilën e kupton individi), mirëpo në nenin 30 paragrafi 4 thotë se çdokush që është akuzuar për veprë penale, e gëzon si një prej të drejtave minimale, të drejtën të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, nëse nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi. Mirëpo, Kushtetuta nuk e garanton të drejtën për përkthyes, as të drejtën për interpreto, në rastet kur personi i privuar është i verbër, i shurdhër ose memec. Për shkak të tërë kësaj, çështja është nëse e drejta e personit të privuar nga liria përfshijnë edhe ato të drejta të cilat Kushtetuta në këtë kontekst nuk i përmend në mënyrë specifike (neni 31 paragrafi 2) ose përmbajtja e të drejtave të personit të privuar nga liria për përdorimin e gjuhës, për nga substanca dhe cilësia, më e ngushtë se të drejtat përkatëse në procedurë gjyqësore. Kushtetuta e rregullon edhe veprimin ndaj personit të privuar nga liria dhe përcakton obligimin për respektimin e dinjitetit të personalitetit, shprehimisht e ndalon ushtrimin e çdo lloji të dhunës ndaj personit të privuar nga liria, si dhe detyrimi për dhënie të dëshmisë.
5. Kjo do të thotë se ndaj personit të privuar nga liria duhet vepruar në mënyrë njerëzore dhe duke respektuar dinjitetin e personalitetit të tij, pasi që privimi nga liria është akt, pra veprim faktik i kufizimit të lirisë personale, si një prej lirive më të rëndësishme individuale. Kjo është arsye që Kushtetuta mjaft hollësisht dhe me vëmendje të veçantë e rregullon raportin e organeve të pushtetit shtetëror me rastin ndërmarrjes së aktiviteteve që kufizojnë lirinë personale, si dhe veprimin e tyre ndaj personit të privuar nga liria. Dispozita kushtetuese sipas së cilës ndaj personit të privuar nga liria duhet vepruar në mënyrë njerëzore dhe duke respektuar dinjitetin e personalitetit të tij, paraqet vetëm konkretizimin e parimit kushtetues të pacenueshmërisë së dinjitetit të personalitetit të njeriut (neni 23 i Kushtetutës) dhe konkretisht në një moment shumë delikat, kur liria personale e individit i nënshtrohet kufizimit. Të gjitha këto rregulla për veprimin me personat e privuar nga liria, si dhe ndalesa e veprimeve të caktuara ndaj atij personi, i takojnë grupit të të drejtave të mbrojtura absolute. Shmangia nga këto të drejta nuk është e lejueshme në asnjë rrethanë, që do të thotë se gëzimi i këtyre të drejtave nuk mund të kufizohet madje as gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

¹¹⁴ Krahaso: May, Stephen (2011), *‘Language and Minority Rights: Ethnicity, Nationalism and the Politics of Language’*, 2 edition, Routledge: New York, NY,.

Neni 29.3

1. Nga sa u tha më lart, duhet thënë se personit të privuar nga liria i dhurohet vëmendje e madhe, para së gjithash, me dispozitë kushtetuese që ai person duhet të njoftohet pa vonesë se ka të drejtë të mos japë asnjë deklaratë dhe ka të drejtë në mbrojtës sipas zgjedhjes së tij/saj si dhe të drejtë që pa vonesë të informojë për këtë atë person (neni 29 paragrafi 3 i Kushtetutës).

Neni 29.4

1. Duke marrë parasysh se privimi nga liria me arrestimin ose ndalimin, është masë e përkohshme dhe se ajo duhet të zgjasë sa më shkurt, personi i privuar nga liria ka të drejtë për ndihmë juridike për vlerësim të ligjshmërisë së arrestimit, pra ndalimit dhe gjykata është e obliguar që vendimin ta marrë brenda afatit sa më të shkurtër (neni 29 paragrafi 4). Ajo që është shumë me rëndësi është që nëse privimi nga liria është i paligjshëm,¹¹⁵ gjykata është e obliguar që menjëherë të urdhërojë lirimin, ndërsa personi që është viktimë e arrestimit ose ndalimit të tillë, ka të drejtë për kompensim dhe dëmshpërblim.

Neni 29.5

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën për rehabilitim dhe kompensim të dëmit për shkak të privimit të paligjshëm nga liria, por konsiderojmë se kësaj çështjeje është dashur t'i kushtohet shumë më shumë vëmendje, duke marrë parasysh rëndësinë e saj dhe cenimin e shpeshtë të të drejtave themelore të njeriut. Gjithashtu, me Kushtetutë është dashur të parashikohet edhe e drejta e secilit person për rehabilitim dhe dëmshpërblim (kompensim), jo vetëm për shkak të privimit të paligjshëm nga liria, por edhe për shkak të dënimit të gabuar. Për këtë arsye kjo problematikë ka merituar vëmendje të posaçme, pra e drejta për rehabilitim dhe dëmshpërblim është dashur të jetë në një nen të veçantë, me të cilin, krahas të drejtës për rehabilitim, si dhe të drejtës për dëmshpërblim, Kushtetuta ka paraparë autorizimin e ligjvënësit që të krijojë edhe të drejta tjera, të cilat në rastet në fjalë u takojnë këtyre personave. Ligjvënësit, në atë rast do t'i delegohej e drejta që të përcaktojë kushtet në të cilat i dëmtuari do të kishte të drejtë që kompensimin për dëmin ta kërkojë drejtpërdrejt nga personi që ka e ka shkaktuar dëmin ose nga organi, institucioni shtetëror që kryen kompetenca publike, organit të komunës ose të qytetit për shkak të punës së tyre të paligjshme ose jo të drejtë. Ai do të mund ta rregullonte në kufijtë e përcaktuar me Kushtetutë. Këtu para së gjithash e kemi fjalën për garancinë kushtetuese parimore për të drejtën e secilit, të cilit i është shkelur e drejta, që të kërkojë eliminimin e pasojave që janë shkaktuar me shkeljen e të drejtës (neni 54 i Kushtetutës). Ky nen përcakton që secili ka të drejtë në mbrojtje gjyqësore në rast të shkeljes ose cenimit

¹¹⁵ Lidhur me privimin e paligjshëm nga liria shih më gjerësisht: Lazin, Đ., (1996), “Zabrana samovoljnog lišenja slobode“, *Pravni život*, nr. 9, fq. 393-411. dhe Lazin, Đ., (1995), “Pravo na sudsku kontrolu lišenja slobode“, *Pravni život*, nr. 9, fq. 421-435.

të ndonjë të drejte që është e garantuar me Kushtetutë, si dhe të drejtë për mjete efektive juridike nëse vërtetohet se është shkelur e drejta.

2. Protokollin nr. 7 i Konventës Evropiane garanton pikërisht kompensimin për dënimin e gabuar. Kjo e drejtë i njihet personit që ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për veprë penale nëse më vonë është shfuqizuar dënimi i tij ose i njëjti është falur. Kusht është që ndonjë fakt i ri ose i zbuluar rishtas në mënyrë të pakontestueshme tregon se fjala ka qenë për gabim gjyqësor. Personi që ka përjetuar dënimin, si pasojë e gjyqimit të tillë, do të marrë kompensim në pajtim me ligjin ose praktikën e shtetit përkatës.

Neni 29.6

1. Me paragrafin e fundit të nenit 29 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është paraparë që personi që vuan dënimin ka të drejtë të ankohet në kushtet e arrestit. Ky person mund të shfrytëzojë të drejtën në fjalë për ankesë në pajtim me rregullat ligjore në fuqi. Gjithashtu, çdo person që është privuar nga liria me anë të arrestimit ose ndalimit, ka të drejtë të iniciojë procedurë me të cilën kërkohet nga gjykata që të vendosë shpejt për ligjshmërinë e mbajtjes së tij/saj dhe në rast të ndalimit të paligjshëm të urdhërojë lirimimin e tij/saj.
2. Në rastin kur ndonjë person është dënuar, arrestuar ose mbajtur në paraburgim gjyqësor në mënyrë të paligjshme para shqyrtimit kryesor, ka të drejtë në rehabilitim të plotë, kompensim të drejtë nga mjetet buxhetore dhe të drejta tjera të përcaktuara me ligj.

Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit]

Çdokush që akuzohet për veprë penale, gëzon të drejtat minimale në vijim:

- (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;
- (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit;
- (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;
- (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi;
- (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas;
- (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

Neni 30

1. E drejta për mbrojtjen e të drejtave hyn në kategorinë e *të drejtave justiciale*, të drejta që mund të realizohen në rrugë gjyqësore, por ky është njëkohësisht një

aspekt i veçantë i parimit të barazisë. Me Kushtetutë (neni 31 paragrafi 1) garantohet mbrojtja e barabartë e të drejtave para gjykatave, organeve të tjera dhe bartësve të kompetencave publike. Pjesë përbërëse e kësaj të drejte për mbrojtje të barabartë juridike është e drejta për mjet efektiv juridik. Prandaj Kushtetuta secilit ia njuh të drejtën për ankesë ose mjet tjetër juridik kundër vendimit me të cilin vendoset për të drejtën e tij, obligimin ose interesin e bazuar në ligj (neni 32).

2. I akuzuari ndaj të cilit është iniciuar procedura penale për një vepër të caktuar penale gëzon të drejta të caktuara minimale që konsistojnë para së gjithash në faktin që askush nuk mund të dënohet deri sa të mos dëgjohet nga një gjykatë kompetente dhe deri sa të mos i mundësohet mënyra e ligjshme të paraqesë mbrojtjen e vet.
3. Kushtetuta në veçanti parasheh që i akuzuari duhet të njoftohet “menjëherë”, por nuk e precizon brenda çfarë afati ai ka të drejtë të njoftohet për veprën, aktakuzën dhe provat. Këtu duhet theksuar se përcaktimi kushtetues që i akuzuari duhet të njoftohet menjëherë “për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij/saj” është mjaft precize dhe e përdorur drejt. Kjo për shkak se në Kushtetuta të caktuara ekziston dispozita që i akuzuari duhet të njoftohet “për arsyet e veprës që i ngarkohet”, gjë që nuk është precize. Në të vërtetë, arsyet pse e ka kryer veprën, më së miri i di pikërisht i akuzuari prandaj nuk duhet të njoftohet në mënyrë të veçantë . Atë duhet njoftuar për arsyet e akuzës që i ngarkohet (krahaso nenin 6 paragrafin 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore).
4. Ajo që është shumë me rëndësi për mbrojtjen adekuate të të akuzuarit është fakti që ai gëzon të drejtën kushtetuese që të ketë mjaft kohë dhe mjete për përgatitjen e mbrojtjes (neni 30 pika 3), që tregon se i akuzuari ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmë juridike nga anëtar i Odës së Avokatëve sipas zgjedhjes së tij. Mirëpo, nëse i akuzuari nuk merr avokat me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së tij, në raste kur mbrojtja është e obligueshme, të akuzuarit i caktohet mbrojtësi i pavarur me përvojë të duhur dhe kompetencë sipas natyrës së veprës penale. Në rastin kur i akuzuari nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar ndihmën juridike, për çka nuk mund të angazhojë avokat mbrojtës, me kërkesë të tij/saj do t’i caktohet avokati mbrojtës me përvojë të duhur dhe kompetencë sipas natyrës së veprës penale dhe i njëjti do të paguhet nga mjetet buxhetore. Natyrisht, me rëndësi është të përmendet se cilido person i privuar nga liria ka të drejtë në shërbime të avokatit mbrojtës, dhe atë që nga vetë momenti i arrestimit, e më tutje.
5. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 30 pika 4 e garanton të drejtën e secilit që është i akuzuar për vepër penale që mund të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi nëse nuk e flet ose nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi (krahaso nenin 6 paragrafi 3 nën “e” të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore). Këtë Kushtetuta e ka përcaktuar në mënyrën më abstrakte me vetëm një fjali ndërsa ajo elaborohet më tej me dispozita ligjore.

6. Si të drejtë shumë të rëndësishme që e ka i akuzuari është mundësia që vetë të zgjedhë avokatin e tij mbrojtës dhe se mund të refuzojë dhënien e deklaratës, pra të mos merret në pyetje, nëse nuk i sigurohet avokati mbrojtës (neni 30 pika 5). Për këtë arsye është e domosdoshme të respektohet e drejta e të akuzuarit që të komunikojë lirisht me avokatin e tij mbrojtës, që para dhënies së deklaratës me rastin e dëgjimit/marrjes në pyetje të konsultohet me avokatin e tij mbrojtës, se ka të drejtë në bisedë ndaras me të për konsultime të nevojshme dhe përgatitje të mbrojtjes. Natyrisht, për shërbime të avokatit, ai e ka për obligim që avokatit t'ia paguajë shumën e duhur, por nëse i akuzuari nuk ka mjete të mjaftueshme për shkak të gjendjes së tij materiale dhe nuk mund të paguajë për ndihmën e dhënë nga avokati mbrojtës, i njëjti do t'i caktohet atij sipas detyrës zyrtare dhe do t'i ofrojë ndihmë juridike pa pagesë, ndërsa shpenzimet për shërbimet të avokatit do të mbulohen nga mjetet buxhetore.
7. Në fund, me pikën 6 të nenit në fjalë të Kushtetutës, është paraparë edhe një e drejtë e rëndësishme që e ka i akuzuari, e ajo është fakti që atë nuk guxon ta detyrojë askush të dëshmojë kundër vetes dhe ta pranojë fajin. Kjo do të thotë se i akuzuari nuk është i obliguar që të deklarohet për rastin e tij/saj, dhe as të përgjigjet në çfarëdo pyetje, dhe nëse ai/ajo deklarohet lidhur me rastin e vet, ai/ajo nuk është i obliguar ta inkriminojë veten ose të afërmit e tij, dhe as të pranojë fajësinë. Kjo më tej nënkupton ndalimin dhe dënimin për detyrimin e pranimit ose çfarëdo deklarate tjetër nga i akuzuari ose nga cilido pjesëmarrës tjetër në procedurë përmes torturës, dhunës, kërcënimit ose nën ndikimin e medikamenteve, ose në çfarëdo mënyre tjetër të ngjashme.
8. Nga sa u tha mund të konkludohet që askush nuk mund të dënohet, deri sa të mos merret në pyetje nga ana e organit (gjykatës) kompetente dhe deri sa të mos i sigurohet mbrojtja adekuate e paraparë me ligjin përkatës. Pikërisht ky parim më së shpeshti zbatohet me anë të ligjeve përkatëse për procedurat penale, ashtu që madje një kapitull ose pjesë e tërë i ligjeve të tilla i kushtohet marrjes në pyetje të të akuzuarit.
9. I akuzuari dhe prokurori në procedurë penale kanë status të palëve të barabarta. Prokurori duhet të paraqesë faktet mbi të cilat e bazon aktakuzën dhe duhet të ofrojë prova për faktet e tilla, ndërsa i akuzuari ka të drejtë dhe mund të japë deklaratë për të gjitha faktet dhe provat që e inkriminojnë dhe të paraqesë të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij. Ai/ajo ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të aktakuzës ose të kërkojë që të njëjtit të merren në pyetje, si të drejtën për praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes, në kushte të njëjta që vlejné edhe për dëshmitarët e aktakuzës.
10. Çështje që shtrohet lidhur me përmbajtjen e këtij neni ka të bëjë me të drejtat e garantuara me këtë Kushtetutë. Pasi që shprehimisht nuk janë futur në mesin e të drejtave të mbrojtura absolute (neni 56 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës), këto të drejta i nënshtrohen shmangies gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, ndërsa të drejtat e parapara me nenin 29 të Kushtetutës (E drejta për liri dhe

siguri) dhe nenin 31 të Kushtetutës (E drejta për gjykim të drejtë dhe paanshëm) nuk i nënshtrohen shmangies në asnjë rrethanë. Është fakt se me nenin 30 janë paraparë të drejtat themelore të të akuzuarit që garantojnë parakushtet elementare për një gjykim ferr dhe të paanshëm. Është e paqartë se përse në Kushtetutë janë përcaktuar regjime të ndryshme për të drejtat që përbëjnë substancën e të drejtës për gjykim të drejtë (krahaso nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore).¹¹⁶

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- (1) Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
- (2) Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
- (3) Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
- (4) Çdokush i akuzuar për veprë penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
- (5) Çdokush i akuzuar për veprë penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.
- (6) Ndihma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.
- (7) Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

Neni 31

1. Një garanci shumë e rëndësishme kushtetuese që mbron lirinë individuale të individëve ka të bëjë me të drejtën për gjykim të drejtë. Kjo e drejtë përfshin disa garanci dhe të drejta të veçanta kushtetuese qëllimi i të cilave është që individit t'i garantohet një gjykim ferr, korrekt dhe të paanshëm. Edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore nga viti 1950 (neni 6), parashikon që secili, me rastin e përcaktimit të të drejtave dhe obligimeve civile

¹¹⁶ Gjykata Evropiane ka konstatuar shkelje të nenit 5 (shih për shembull, *Laumont kundër Francës* (2001), *Baranowski kundër Polonisë* (2000), *Quinn kundër Francës* (1995.), *Labita kundër Italisë* (2000.)

ose me rastin e akuzës penale ndaj tij/saj, ka të drejtë për shqyrtim të drejtë dhe publik, brenda afatit të arsyeshëm, para një gjykate të pavarur dhe të paanshme, të themeluar me ligj. Ajo që është shumë me rëndësi, duhet thënë se me këtë Konventë është paraparë shqiptimi publik i aktgjykimit, por që mediet dhe publiku mund të përjashtohen, në tërësi ose pjesërisht, nga gjykimi në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

2. Garancitë procedurale me të cilat garantohet gjykim i drejtë janë posaçërisht të rëndësishme në procedurën e shqiptimit të sanksioneve penale,¹¹⁷ dhe në mesin e tyre veçohen:
 - 1) e drejta për gjykatë të ligjshme;
 - 2) e drejta për mbrojtje;
 - 3) prezumimi i pafajësisë;
 - 4) e drejta për ankesë.
3. Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashikon të drejtën për gjykim të drejtë, esenca e së cilës qëndron tek ajo që secilit i garantohet mbrojtja e barabartë e të drejtave në procedurë pranë gjykatave.¹¹⁸ Ajo e zgjeron listën e këtyre garan-

¹¹⁷ Shih më gjerësisht: Packer, L. Herbert (1968), *The Limits of the Criminal Sanction* 1st edition Stanford University Press; Sanford, California, pjesa e dytë që ka të bëjë me procesin penal në aspektin krahasimtar; dhe Dammer, R. Harry, Albanese, S. Jay (2010), *Comparative Criminal Justice Systems* 4 edition, Cengage Learning: Belmont, USA, Kapitulli 6 (“Criminal Procedure”) dhe 8 (“After Conviction: The Sentencing Process”).

¹¹⁸ Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave në gjykata, e drejta më e rëndësishme është ajo për mjet efektiv juridik dhe e drejta për gjykim të drejtë. Lidhur me këtë çështje, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka pasur disa vendime. Shih për shembull: Aktgjykim në rastin KI 55/11 të 16 korrikut 2012 (*Parashtruesi i kërkesës Fatmir Pireci. Vlerësim i kushtetutshmërisë i Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010*). Në këtë rast, Gjykata ka gjetur se ka shkelje të së drejtës për mjet efektiv juridik pasi që parashtruesit të kërkesës nuk i është mundësuar që ta përmbarojë vendimin e formës së prerë në favor të tij, pasi që gjykatat e rregullta kishin refuzuar të përmbarojnë vendimet e formës së prerë me arsyetimin se ato mund të përmbarojnë vetëm kërkesat monetare të të ashtuquajturit Këshill i Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Të njëjtën shkelje Gjykata Kushtetuese e ka gjetur edhe në këto raste: Aktgjykim në rastin nr. KI 50/12 i 16 korrikut 2012. (*Parashtruesi i kërkesës Agush Lloluni. Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërbarimit të vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 153/2011 të 4 tetorit 2011 dhe Vendimit nr. 02 (207) 2010 të 4 tetorit 2010, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nga ana e Komunës së Junikut*); Aktgjykim në rastin nr. KI 80/12 i 5 korrikut 2013. (*Parashtruesi i kërkesës Sali Pepshi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërbarimit të aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 164/2011, të 5 korrikut 2011*); Aktgjykim në rastin nr. KI 112/12 të 5 korrikut 2013. (*Parashtruesi i kërkesës Adem Meta. Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. Nr. 61/12, të 13 shkurtit 2012*); Aktgjykim në rastin Nr. KI 129/11 të 17 korrikut 2012. (*Parashtruesi i kërkesës Viktor Marku. Vlerësim i kushtetutshmërisë lidhur me mospërbarimin e aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. Dr. 158/2011 të 5 korrikut 2011 dhe vendimit nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur*

cive dhe të drejtave për secilin individ me qëllim të sigurimit të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, ashtu që në mesin e tyre hyjnë:

- a) **Mbrojtja e barabartë e të drejtave para gjykatës, si dhe para organeve, organizatave tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike** (neni 31 paragrafi 1). Kjo e drejtë është shumë e rëndësishme, sepse mundëson barazinë e të gjithë personave para ligjit, gëzimin e të drejtave dhe lirive të parapara me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, me Kushtetutë dhe me ligje përkatëse, pa diskriminim mbi çfarëdo baze.¹¹⁹
- b) **E drejta për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj** (neni 31 paragrafi 2). Pavarësia dhe paanshmëria e gjykatës përkufizohet me dispozitat kushtetuese për statusin e pushtetit gjyqësor (neni 102 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës), statusin e gjyqtarëve (neni 102 paragrafi 4, neni 104-107.) dhe vendimet gjyqësore (neni 102 paragrafi 5), që janë të garantuara, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me ligj. Në dispozitat për gjykatat, Kushtetuta e përsërit dhe përkufizon që ligji e rregullon themelimin, organizimin, kompetencën, rregullimin dhe përbërjen e gjykatave, pra “të Gjykatës Supreme dhe gjykatave tjera” (neni 103 paragrafi 1) dhe shprehimisht e ndalon themelimin e gjykatave të jashtëzakonshme, duke përcaktuar që gjykatat speciale mund të themelohen me ligj, atëherë kur kjo është e paarsyeshme (neni 103 paragrafi 7). E drejta për procedurë gjyqësore publike (shqyrtimi publik dhe vendimmarrja), është e paraparë me nenin 31 paragrafi 2 dhe 3 i Kushtetutës (Kushtetuta përmban disa rregulla për parimin e publicitetit në procedurë para gjykatës).¹²⁰

Mbikëqyrës të Kosovës nga ana e Komunës së Klinës); dhe, në fund, Aktgjykimi në rastin nr. KI 47/12 të 16 korrikut 2012 (*Parashtruesi i kërkesës Islam Thaçi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 188/2009, të 7 dhjetorit 2011*).

Në Aktgjykimin lidhur me rastin nr. KI 41/12 të 26 shkurtit 2013, Gjykata ka gjetur shkelje të së drejtës për mjet efektiv juridik që ka rezultuar me shkelje të së drejtës për jetën për shkak të neglizhencës së gjykatave dhe organeve tjera shtetërore për të mbrojtur në mënyrë efektive viktimën e vrasjes, pra një grua të ndarë të cilën e kishte vrarë ish-bashkëshorti i saj. (*Parashtrues të kërkesës Gëzim dhe Makfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës*).

Në rastin e Aktvendimit nr. KI 113/11 të 9 korrikut 2012, Gjykata nuk ka gjetur shkelje të Kushtetutës, të drejtës për mjet efektiv juridik pasi që Gjykata Kushtetuese duhet të respektojë në tërësi të gjeturat faktike dhe juridike të gjykatave të rregullta (parimi i subsidiaritetit). (*Parashtruesi i kërkesës "DELOITIE KOSOVA" SHPK. Vlerësim i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës KRJA nr. 3/2010 të 4 majit 2011*).

¹¹⁹ Qasja në gjykatë duhet të jetë substanciale, dhe jo vetëm formale. Çdo kufizim i qasjes në gjykatë ose organi të pavarur gjyqësor, duhet të ketë qëllim legjitim, ndërsa mjetet që përdoren duhet të jenë në proporcion me atë qëllim (*Tinnelly & Sons Ltd. dhe të tjerë dhe McElduffitë tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1998.)).

¹²⁰ Kur ligji e dikton përbërjen e gjykatës, mosrespektimi i kushteve të përcaktuara me ligj çon tek konstatimi i shkeljes së kërkesave për një gjykatë të themeluar me ligj (*Posokhov kundër Rusisë* (2003) dhe *Lavents kundër Letonisë* (2002.)).

E drejta për gjykim të drejtë brenda afatit të arsyeshëm (neni 31 paragrafi 2) është garanci kushtetuese parimore. Ajo paraqet bazën dhe kornizën për zgjidhjet ligjore përkitazi me procedurat gjyqësore (posaçërisht, kohëzgjatjen e procedurës para gjykatës), që siguron efikasitetin e mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe lirive. Konsiderojmë se, krahas kësaj norme parimore, Kushtetuta do të duhej të rregullonte edhe të drejtën e veçantë të personit që gjykohet për vepër penale (procedura penale), që i njëjti të gjykohet pa vonesa. Standardet që e operacionalizojnë dispozitën parimore përkitazi me gjykimin e drejtë brenda afatit të arsyeshëm dhe që përkufizojnë konkretisht kuptimin e termit "afati i arsyeshëm" në fusha të ndryshme përcaktohen me ligje.

c) ***E drejta për gjykim publik*** (neni 31 paragrafi 3). Duke respektuar dispozitën e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore për përjashtimin e medieve dhe publikut në rastet kur gjykata, për shkak të arsyeve të veçanta, konsideron se kjo është e domosdoshme në interes të drejtësisë, Kushtetuta e pranon këtë mundësi si përjashtim. Mirëpo, mënyra se si janë të rregulluara çështjet e publicitetit mund të jetë shkas për vështirësi në zbatimin praktik. Kështu, duhet konstatuar që në Kushtetutë nuk ka norma shprehimore për shqiptimin (komunikimin) e vendimit, përveç nëse me termin "shqyrtim publik i vendimeve lidhur me të drejtat dhe detyrimet" do të nënkuptonte edhe komunikimin e vendimit (Konventa Evropiane në nenin 6 paragrafi 1 shprehimisht e përcakton që dënimi duhet të shqiptohet publikisht). Parimi i publicitetit i nënshtrohet kufizimeve të caktuara të cilat i përcakton Kushtetuta (neni 31 paragrafi 3) dhe këto kufizime kanë të bëjnë "procedurën para gjykatës" (e tërë procedura ose një pjesë e procedurës). Arsyet që mund të kenë bazë që publiku të përjashtohet janë cekur në vetë tekstin kushtetues (neni 31 paragrafi 3) dhe kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesit të të miturve, ruajtjen e privatësisë së pjesëmarrësve në procedurë, mbrojtjen e interesave të sigurisë kombëtare si dhe ruajtjen e rendit publik dhe moralit. Natyrisht, kjo mundësi e përjashtimit të publikut për arsyet të dhëna taksativisht është e arsyetuar, por mund (kjo përmendje taksative) të jetë burim i problemeve në praktikë, sepse nuk lejon mundësitë që gjykata, duke vlerësuar të gjitha rrethanat e rastit, të përjashtojë publikun për arsyet që Kushtetuta nuk i përmend shprehimisht. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, siç e kemi përmendur tashmë lejon që publiku të përjashtohet edhe në rastin "kur, sipas mendimit të gjykatës, ai do dëmtonte interesat e drejtësisë" (neni 6 paragrafi 1).¹²¹

d) ***E drejta për të kërkuar paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet dhe e drejta për t'u bërë pyetje personave të pranishëm*** (neni 31 paragrafi 4). Për mbrojtjen e të akuzuarit dhe sqarimin e shumë fakteve të ndërlydhura me veprën penale që i ngarkohet të akuzuarit, është shumë me rëndësi prania e dëshmitarëve, të cilët me dëshminë e tyre dhe ofrimin e provave të caktuara, mund t'i ndihmojnë gjykatës në nxjerrjen e një vendimi të drejtë dhe të bazuar në ligj.

¹²¹ Procedura që është e hapur vetëm për palët në të dhe përfaqësuesit e tyre nuk plotëson kriteret sipas kësaj dispozite të Konventës (*Kadubec kundër Sllovakisë* (1998) dhe *Malhous kundër Republikës Çeke* (2001).

Dëshmia e dëshmitarit paraqet një nga mjetet provuese më të vjetra dhe mjaft shpesh të përdorura, për shkak se një numër shumë i vogël i veprave penale është kryer pa praninë e personit të tretë, ndërsa është edhe më i vogël numri i të akuzuarve për të cilët ndonjë person nuk mund të paraqesë të dhëna nga jeta e tyre. Natyrisht, këtu duhet pasur parasysh faktin se dëshmia e dëshmitarit, si mjet provues, mund të jetë mjaft e pasigurt, pasi që burimi i informacionit është njeriu si qenie e vetëdijshme. Dëshmitari është person për të cilin besohet se do të mund të japë informata për veprën penale dhe kryesin si dhe për rrethanat tjera të rëndësishme. Më saktësisht, ky është person që me anë të shqisave të tij drejtpërdrejt ka vërejtur fakte të caktuara, të cilat janë në lidhje me veprën e kryer penale ose me kryesin ose për ta ka mësuar tërthorazi dhe të cilët, me ftesë të gjykatës penale, jep dëshmi lidhur me to. Prandaj, në mënyrë që një person të ketë cilësinë e dëshmitarit në procedurë penale, është e nevojshme, që së pari, të ketë vërejtur drejtpërdrejt faktet ose të ketë mësuar për to tërthorazi dhe organi i procedurës penale ta ketë ftuar për të dhënë dëshmi. Në procedurë penale si dëshmitar mund të paraqitet çdo person, pa marrë parasysh moshën ose të metat të caktuara fizike dhe psikike, vetëm nëse është i aftë të vërej faktet lidhur me çështjen penale dhe t'i riprodhojë të njëjtat.

Këtu duhet treguar faktin se teoria dhe praktika e njohin nocionin e dëshmitarit ekspert. Ky është një person që dëshmon në gjykatë, dëshmia e të cilit bazohet në njohjen profesionale të temës për të cilën bëhet fjalë dhe që u mundëson vendimmarrësve që të vlerësojnë më mirë provat, situatën ose dënimin adekuat (për shembull, punëtorët socialë ftohen të gjykatë si dëshmitarë profesionalë në kontestet që kanë të bëjnë me kujdestarinë e fëmijëve, mospërfilljen dhe keqtrajtimin e fëmijëve, shkurorëzime, kujdesin për personat me nevoja të veçanta etj.).

Gjithashtu, një faktor shumë i rëndësishëm, shpesh edhe vendimtar në procedura të tilla, është eksperti gjyqësor, si person profesional që plotëson kushtet formale dhe substanciale se mund të merret me këtë lloj të punës. Eksperti me të gjeturat e tij profesionale dhe me mendimin e tij nga ndonjë fushë për të cilën është profesionist (makineri, mjekësi, ekonomi, financa, ndërtimtari dhe fusha të tjera të ndryshme), në masë të madhe i ndihmon gjykatës që të përcaktohet e vërteta, respektivisht të përcaktojë konkretizimin e caktuar të fakteve, pas së cilës hapet ose mbyllet shqyrtimi. Nga cilësia dhe gjithëpërfshirja e të gjeturave dhe mendimit të ekspertit gjyqësor, varet edhe rezultati i procesit gjyqësor ose jashtëgjyqësor. Në procesin e përcaktimit të së vërtetës materiale gjykata gjithnjë e më shumë mbështetet në të gjeturat dhe mendimet e profesionistëve nga fusha me të cilën kanë të bëjnë kontestet gjyqësore.

Të akuzuarit nuk duhet t'i mohohet e drejta për të zgjedhur vetë ekspertizën për të cilën konsideron se është në favor të tij. Gjykata nuk duhet të refuzojë kërkesën e të akuzuarit për të propozuar kryerjen e super-ekspertizës nëse ai/ajo konsideron se është në favor të tij/saj. Nëse mohohet kjo e drejtë, atëherë kjo paraqet cenim të së drejtës për gjykim të drejtë.¹²²

¹²² Në aktgjykimin e 24 janarit 2013, në rastin nr. KI78/12 (*Parashtruesi i kërkesës Bajrush Xhemajli: Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 70/2012, të 22 qershorit 2012*), Gjykata ka konstatuar shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë

- e) **Supozimi (prezumimi) i pafajësisë** (neni 31 paragrafi 5). Prezumimi i pafajësisë është njëra nga garancitë më të rëndësishme të sigurisë juridike në të drejtën penale dhe pjesë e pandashme e gjykimit të drejtë. Sipas këtij prezumimi, çdokush konsiderohet i pafajshëm për veprën penale, deri sa të mos vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Esenca e prezumimit qëndron në atë se prokurorit i imponohet barra e të provuarit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit. Ky kuptim qartazi del nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, që urdhëron që çdokush që akuzohet për vepër penale të konsiderohet i pafajshëm deri sa të mos provohet fajësia e tij/saj në bazë të ligjit. Një dispozitë të tillë e përmban edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 31 paragrafi 5. Kjo do të thotë se prezumimi i pafajësisë e mbron të akuzuarin nga obligimi që të provojë pafajësinë e tij në gjykatë.¹²³
- f) **E drejta për ndihmë juridike pa pagesë** (neni 31 paragrafi 6). E drejta për ndihmë juridike garantohej si një nga të drejtat individuale. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 29 paragrafi 4) përcakton që personi i cili është privuar nga liria ka të drejtë për ndihmë juridike, në mënyrë që të vlerësohet ligjshmëria e arrestimit ose ndalimit. Me qëllim të mundësimit të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kjo Kushtetutë në nenin 31 paragrafi 6 përcakton edhe të drejtën për ndihmë juridike pa pagesë të gjithë personave të cilët për këtë nuk kanë mjete të mjaftueshme, që do të thotë se forma në të cilën garantohej kjo e drejtë është e përgjithshme. Në fakt, rrethi i subjekteve që mund të shfrytëzojnë të drejtën në fjalë është vënë më së gjeri, sepse Kushtetuta përdor një formë të përgjithshme dhe neutrale ("të gjithë personave që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare"). Kjo është një nga të drejtat që garanton Kushtetuta në mënyrë që të krijohen mundësitë e barabarta për shfrytëzimin dhe mbrojtjen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe akte ndërkombëtare. Këto janë obligimet e shtetit që bazohen në parimin e drejtësisë sociale, që ndalon çdo formë të diskriminimit, duke marrë parasysh gjendjen materiale dhe përkatësinë shoqërore dhe që ndërmerr masa të veçanta me qëllim të aritjes së barazisë së plotë të personit ose grupit të personave të cilët gjenden në pozitë substancialisht të pabarabartë (neni 24 paragrafi 1).¹²⁴ Kjo normë është e përgjithshme, jo vetëm në raport me subjektet e të drejtës, por edhe në raport me format e ndihmës juridike. Dispozita kushtetuese nuk e përmend shprehimisht se cilat janë ato forma, kështu që merret me mend se ajo

dhe të paanshëm pasi që parashtruesit nuk i është e drejta për paraqitje të provave sipas bindjes së tij përgjatë tërë procedurës së vërtetimit të fakteve. Gjykatat e rregullta nuk kanë dhënë mundësi parashtruesit të kërkesës që të propozojë dhe të paraqesë fakte që shkojnë në favor të tij, dhe rrjedhimisht kishin bërë shkelje kushtetuese të së drejtës së lartpërmendur.

¹²³ Parimi kryesor i kësaj të drejtë është që personi që akuzohet penalisht ka të drejtë në privilegjet e parimit *in dubio pro reo*. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka shqyrtuar lëndët në të cilat bëhet fjalë për tri aspekte të kësaj të drejte. Në kuptim të aspektit të parë, që barrën e të provuarit të fajësisë e bart aktakuza, Gjykata ka konstatuar shkelje vetëm në disa lëndë. Shih aktgjykimin *Telfner kundër Austrisë* (2001)

¹²⁴ Në parim, nëse një person privohet nga liria, interesat e drejtësisë e kërkojnë që i njëjti të ketë avokat mbrojtës (*Quaranta kundër Zvicrës* (1991.), *Benham kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1996.) dhe *Perks e të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1999.)).

përfshin të gjitha format e ndihmës juridike. Siç duket, Kushtetuta nuk ia ka besuar ligjit që të përkufizojë dhe rregullojë më konkretisht kushtet e realizimit të së drejtës për ndihmë juridike pa pagesë (dhe as të drejtën për ndihmë juridike në përgjithësi). Ligji mund të rregullojë mënyrën e realizimit të një të drejtë të caktuar, vetëm nëse është autorizuar për diçka të tillë shprehimisht me Kushtetutë dhe nëse kjo është e domosdoshme për realizimin e një të drejtë të caktuar, për shkak të natyrës së saj. Kornizat dhe kufijtë e autorizimit të ligjvënësit mund t'i precizojë vetëm dispozita kushtetuese, kështu që ligji në asnjë rast nuk guxon të ndikojë në substancën e të drejtës së garantuar. Ligji nuk mund të rregullojë përmbajtjen e të drejtës, por vetëm mënyrën e realizimit të saj.

Në veçanti rregullohet e drejta për ndihmë juridike pa pagesë (neni 31 paragrafi 6), si formë specifike e ndihmës juridike (neni 29 paragrafi 4). Për shfrytëzuesin e të drejtës, ndihma juridike është pa pagesë, ndërsa shteti është i obliguar të sigurojë mjete financiare për realizimin e kësaj të drejte, si dhe kornizën juridike për organizmin e ndihmës juridike pa pagesë, ashtu që kjo masë e veçantë të mundësojë barazinë e të gjithëve para Kushtetutës dhe ligjit, pa diskriminim (neni 24 paragrafi 1). Ndihmën juridike pa pagesë, megjithatë, nuk duhet barazuar me të drejtën e të akuzuarit për avokat mbrojtës pa pagesë në procedurë penale. Me të drejtën për avokat mbrojtës garantohet e drejta e të akuzuarit për mbrojtje dhe ajo i takon grupit të të drejtave kushtetuese themelore. Ajo është radhitur në mesin e të drejtave të veçanta të të akuzuarit dhe shprehimisht është e ndërlidhur me "interesin e drejtësisë", që urdhëron që të akuzuarit, që nuk mund të bartë shpenzimet për avokat mbrojtës, t'i caktohet avokati mbrojtës profesional, angazhimin e të cilit e financon shteti. I akuzuari mund të shfrytëzojë këtë të drejtë në pajtim me ligjin. Kur bëhet fjalë për ndihmën juridike, duhet thënë se atë e ofron avokatura si shërbim i mëvetësishëm dhe i pavarur dhe shërbim i ndihmës juridike që themelohet në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

- g) Respektimi i rregullave dhe procedurave të veçanta për të miturit* (neni 31 paragrafi 7). Kur bëhet fjalë për të miturit, procedurat gjyqësore që zhvillohen ndaj tyre kanë karakteristika të veçanta dhe kërkojnë procedura specifike. Për shkak të mbrojtjes të interesave të personave të mitur, moralit dhe vlerave tjera, shumë herë në procedura të tilla përjashtohen mediet dhe publiku.

Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 32

1. Parimi i dyshkallësisë së gjykimit është element i domosdoshëm i gjykimit të drejtë. Për shkak të ashpërsisë së sanksioneve penale, e drejta për mjet juridik, ka

rëndësi të veçantë në shqyrtimin e aktgjykimeve penale të shkallës së parë. Prandaj, Kushtetuta ia garanton secilit të drejtën e ankesës apo ndonjë mjet tjetër juridik kundër vendimit më të cilin vendoset për të drejtën, obligimin apo interesin e tij të bazuar në ligj. Prandaj, pjesë përbërëse e të drejtës së mbrojtjes juridike është pikërisht *e drejta e mjetit efikas juridik*, të cilin e njih Konventa Evropiane (neni 13). Protokollin nr. 7 me Konventën Evropiane garanton të drejtën e ankesës për çështjet penale, kështu që çdokush që me vendim gjykate është dënuar për vepër penale, ka të drejtë që gjykimin apo dënimin e tij ta rishqyrtojë gjykata më e lartë. Realizimi i kësaj të drejte, duke përfshirë edhe bazat për shfrytëzimin e saj, rregullohet me ligj. E drejta e mjetit juridik, do të thotë e drejta e ankesës, mund të përjashtohet vetëm kur bëhet fjalë për vepra më pak të rëndësishme (me vlerë më të vogël) apo kur në shkallën e parë, personin e ka gjykuar gjykata më e lartë apo kur personi është gjykuar në bazë të ankesës kundër aktgjykimit përkatës.¹²⁵

Neni 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]

- (1) Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.**
- (2) Dënimi i shqiptuar për një vepër penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës.**
- (3) Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.**
- (4) Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.**

Neni 33

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton shumë parime të veçanta, qëllimi i të cilave është që të sigurojnë siguri juridike në fushën e ndjeshme të së drejtës penale. Veçanërisht janë të rëndësishme disa nga këto parime.

Neni 33.1

1. E para, Kushtetuta proklamon parimin e legalitetit të veprave dhe të dënimeve, do të thotë të sanksioneve (neni 33. paragrafi 1.), duke ndaluar, pos kësaj, veprimin retroaktiv të ligjit penal dhe të dispozitave të tjera ndëshkimore. Sipas parimit të legaliteti, *nullum crimen nulla poena sine lege*, nuk ka vepër të dënueshme, as

¹²⁵ Shteti nuk mund ta kufizojë apo eliminojë rishqyrtimin gjyqësor të kontesteve që bëjnë hyjnë në kuadër të nenit 6.(1) (*Glod kundër Rumanisë* (2003.) (ligjshmëria e vendimeve që i ka marrë organi juridik) dhe *Popovici dhe Dimitrescu kundër Rumanisë* (2003.) (nacionalizimi i pasurisë)), apo në raport me kategoritë e caktuara të njerëzve (*Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1975.) (të burgosurit).

dënim pa ligj. Kjo do të thotë se askush nuk mund të shpallet fajtor për veprën e cila, para se të jetë kryer me ligj, apo dispozitë tjetër të bazuar në ligj, nuk ka qenë e parashikuar si vepër e dënueshme dhe as nuk mund t'i shqiptohet dënimi, i cili për atë vepër nuk ka qenë i parashikuar. Prapaveprimi i ligjit penal është përjashtuar, sepse dënimi përcaktohet sipas dispozitës që ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer vepra, përveç rasteve, kur dispozita e mëvonshme është më e volitshme për kryerësin e veprës penale (neni 33. paragrafi 4.).

2. Duke ndaluar prapaveprimin, Konventa Evropiane, po ashtu, lejon dënimin vetëm në bazë të ligjit, duke përcaktuar që askush nuk mund të konsiderohet fajtor për veprën e kryer penale me veprimin apo joveprimin i cili, në kohën kur është kryer, nuk ka paraqitur vepër penale sipas së drejtës vendore apo ndërkombëtare (neni 7. paragrafi 1.). Parimi i legalitetit nuk mund të zbatohet vetëm për ato vepra, të cilat në periudhën kur janë kryer, në bazë të së drejtës ndërkombëtare, janë konsideruar si gjenocid, krim lufte apo krim kundër njerëzimit.
3. Derisa Kushtetuta nuk e jep definicionin e ligjit në kuptimin material, do të thotë nuk e përcakton se çka do të përmbajë në tërësi ligji, (ashtu që ligji mund të përfshijë dhe rregullojë çdo materie, që e konsideron të rëndësishme), megjithatë në Kushtetutë ekzistojnë vende të veçanta dhe të tilla, që quhen “*rezervate ligjore*”, do të thotë të rezervuara vetëm për ligjin. Pra, ekzistojnë materie të cilat hartuesi i Kushtetutës i ka konsideruar veçanërisht të rëndësishme dhe rregullimin e të cilave ia ka lënë ekskluzivisht ligjdhënësit. Një nga këto materie është edhe dënimi. Kështu, edhe sipas fjalës së urtë latine të theksuar më sipër, *nullum crimen nulla poena sine lege*, nuk mund të ketë dënim pa ligj, do të thotë nuk mund të shqiptohet dënimi, nëse nuk është parashikuar dhe rregulluar me ligj. Këtë parim e përmban edhe dispozita e mësipërme që “dënimi mund të vendoset vetëm me ligj”. Kjo vlen për të gjitha llojet e dënimeve: për dënimet kryesore dhe plotësuese, për dënime të privimit nga liria, si dhe për dënime me të holla, (dënime të privimit nga pasuria) për dënime disiplinore e të tjera.
4. Nëse ky parim do të respektohej në mënyrë të rreptë, atëherë asnjë dënim nuk do të mund të rregullohej me dispozitë, do të thotë me akt nënligjor, sepse materia ekskluzivisht është rezervuar për ligjdhënësin. Prandaj, ai nuk mund ta bartë atë mbi dikë tjetër, në këtë rast mbi pushtetin administrativ. Çdo dënim, madje edhe më të voglin do të duhej ta sanksiononte vetë ligji dhe t’i inkriminonte veprimet me të cilat do të lidhej ai dënim. Ndërkaq, nuk janë të rralla rastet kur dënimet rregullohen me dispozita, dhe rastet më të shpeshta janë ato që kanë të bëjnë me të ashtuquajturat dekrete policore, por ka edhe dispozita që parashikojnë veprat penale dhe i përcaktojnë dënimet. Teorikisht lejohen dënimet e përcaktuara me dispozitë, nëse ligji, që autorizon nxjerrjen e dispozitës e ka përcaktuar llojin dhe maksimumin e dënimit dhe në pikat kryesore së paku ka përcaktuar veprat që inkriminohen.¹²⁶

¹²⁶ Gjykata Evropiane konsideron se kur ndryshohen elementet e veprës penale, ndryshimet e tilla nuk mund të zbatohen në mënyrë retroaktive në dëm të personit të akuzuar për atë vepër penale konkrete. Në lëndën *Veeber kundër Estonisë* (2003.), ligji penal pozitiv në fuqi në

Neni 33.2

1. Me qëllim të sigurimit të sigurisë juridike në të drejtën penale dhe të respektimit të parimeve të legalitetit, Kushtetuta në nenin 33. paragrafi 2. përcakton që dënimi që është shqiptuar për ndonjë veprë penale, nuk mund të jetë më i ashpër, sesa që ka qenë e përcaktuar me ligj në kohën kur është kryer vepra. Kjo do të thotë që dënimet përcaktohen sipas dispozitës që ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer vepra e inkriminuar, me përjashtim kur dispozita e mëvonshme është më e volitshme për kryerësin. Veprat penale dhe sanksionet penale përcaktohen me ligj.¹²⁷

Neni 33.3

1. Ajo që është shumë e rëndësishme për sigurimin e sigurisë juridike të çdo individi në fushën shumë të rëndësishme të së drejtës penale, është garancia kushtetuese (neni 33. paragrafi 3.) që lartësia e dënimit nuk duhet të jetë në disproporcion me veprën penale, që do të thotë se duhet të ekzistojë proporcionaliteti në procedurat penale. Kjo është çështje jashtëzakonisht e rëndësishme dhe mjaft e ndjeshme, e cila me rastin e matjes së lartësisë së dënimit kërkon nga personi përgjegjës profesionalizëm të lartë, dije, përvojë dhe guxim. Të gjitha këto veti të këtij personi janë të domosdoshme, në mënyrë që me dënimin përkatës të arrihet qëllimi i dëshiruar. Shpeshherë, pos të gjitha cilësive të përmendura, të domosdoshme për matjen më adekuate të dënimit, më i rëndësishmi është guximi, sepse është e nevojshme që personi i tillë t'i shqyrtojë dhe t'i marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në lartësinë e dënimit, si rrethanat lehtësuese, ashtu edhe ato rënduese, që të hyjë në psikikën e kryerësit të veprës penale, t'i shqyrtojë rrethanat dhe shkaqet e kryerjes së veprës penale, ta njohë sjelljen e kryerësit deri në kryerjen e veprës së inkriminuar e të ngjashme dhe tërë kjo me qëllim të shqiptimit të dënimit të tillë (në pikëpamje të llojit, lartësisë etj.), që do ta arrinte më së shpejti qëllimin e vet. Kjo nuk është aspak punë e lehtë, por për këtë arsye në procedurat penale duhet të angazhohen njerëzit më të mirë, më profesionistë, më me përvojë dhe më të guximshëm, në mënyrë që për veprën përkatëse të shqiptohet edhe dënimi përkatës, ndërsa të evitohet disproporcioni.

Neni 33.4

1. Më në fund, ndalimi i retroaktivitetit, do të thotë prapaveprimin, paraqet parimin e fundit të cilin Kushtetuta e ka parashikuar si mjet të sigurimit të sigurisë juridike të qytetarëve në procedurën penale. Kjo do të thotë se, sipas kësaj dispozite kushtetuese (neni 33. paragrafi 4.), dënimet përcaktohen në bazë të ligjit i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer vepra. Kjo dispozitë e ndalon zbatimin

kohën kur kinse është kryer ajo veprë ka kërkuar që duhet të ekzistojë dënimi paraprak administrativ për veprë të ngjashme si parakusht për aktgjykimin penal.

¹²⁷ Gjykata ka konkluduar se bëhet fjalë shkeljen e kësaj dispozite, kur personave të gjykuar për vepra penale u janë shqiptuar dënime më të rënda, se sa që janë parashikuar në kohën e kryerjes së atyre veprave (*Ecer dhe Zeyrek kundër Turqisë* (2001.)).

retroaktiv të dispozitave penale-juridike dhe materiale. Kjo do të thotë se ligji i ri nuk do të zbatohet, vetëm nëse është më i ashpër se ligji i mëparshëm. Në fushën e së drejtës penale vlen rregulla: *In dubio mitius, in dubio pro reo* (kur dyshohet vepron në dobi të të pandehurit). Ky parim ka gjetur shprehje në ligjin penal të numrit më të madh të vendeve dhe nënkupton: “nëse pas kryerjes së veprës penale është ndryshuar ligji penal, atëherë zbatohet ligji më i butë”. Kjo nuk është në kundërshtim me dispozitën paraprake të Kushtetutës. Sepse, nëse ligji i mëparshëm nuk e ka parashikuar fare ndonjë vepër inkriminuese, do të vlejë ai ligj i vjetër që nuk e njeh një lloj të tillë të veprave penale, do të thotë, do të vlejë si më i butë. Edhe kjo dispozitë e Kushtetutës vlen për çdokënd e jo vetëm për shtetasit, sepse me këtë mbrohen personat privatë, si të tillë, mbrohen ndaj pushtetit gjyqësor.

2. Të gjitha këto të drejta të garantuara me nenin 33. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilat e mundësojnë parimin e legalitetit dhe të proporcionalitetit në procedurat penale, kanë status të të drejtave të mbrojtura absolute dhe nuk i nënshtrohen devijimit me asnjë kusht, e që do të thotë as gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme (neni 56. paragrafi 2.).

Neni 34 [E Drejta për të mos u Gjykuar dy herë për të njëjtën Vepër]

Askush nuk mund të gjykohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale.

Neni 34

1. ushtetuta e njeh parimin se askush nuk mund të dënohet dy herë për të njëjtën vepër penale. Këtu mund të zbatohet rregulla e njohur *ne bis in idem* (jo dy herë për të njëjtën çështje), esenca e së cilës ka të bëjë me atë që askush nuk mund të ndiqet, as të dënohet për veprën penale, për të cilën është liruar apo gjykuar me aktgjykim të formës së prerë, apo për të cilën aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë, apo për të cilën është ndërprerë procedura me vendim të formës së prerë. Ky nen është mjaft i shkurtër dhe, si i tillë, ofron mjaft hapësirë për dilema, sepse në mënyrë të përpiktë dhe precize (siç është zakon në kushtetutat e tjera), nuk i përmend rastet me të cilat ka të bëjë kjo ndalesë. Po ashtu, në tekstin kushtetues nuk ka kurrfarë dispozite për atë se këtë problematikë më për së afërmi do ta rregullojë ligji, i cili në mënyrë precize do t'i theksojë rastet e ndalimit të ndjekjes dhe të dënimit për të njëjtën çështje. Këtu duhet theksuar edhe fakti se me Protokollin nr.7. me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, të miratuar në vitin 1984 (neni 4. paragrafi 2.), është parashikuar që shtetet nuk mund të shmangen nga garancia për të mos u gjykuar apo dënuar për të njëjtën çështje, as në rrethana të jashtëzakonshme. Kështu, sipas këtij Protokollit, askush nuk mund të gjykohet përsëri, as nuk mund të dënohet përsëri në procedurën penale në kompetencë të të njëjtit shtet, për veprën për të cilën është liruar apo gjykuar me vendim të formës së prerë, në pajtim me ligjin dhe procedurën penale të atij shteti. Ndalesa *ne bis in idem* nuk e ndalon hapjen e

sërishme të procedurës, nëse ekzistojnë prova për fakte të reja apo të pazbuluara, apo nëse në procedurën paraprake ka pasur shkelje të theksuara, të cilat kanë mundur të ndikojnë në ecurinë e saj.

2. Kushtetuta e ndalon ndjekjen dhe dënimin për të njëjtën çështje dhe këtë ndalesë e parashikon në mënyrë të përgjithshme. Kjo është e përgjithshme dhe vlen për të gjithë, sepse neni 34. e rregullon këtë që në fillim, me fjalën “askush”. Ai nuk thekson në mënyrë precize se cilat janë ato raste në të cilat Kushtetuta e përcakton të drejtën e secilit person që të mos gjykohet dy herë për të njëjtën vepër penale, por kjo situatë zgjidhet me dispozitat e ligjit penal, ashtu që në mënyrë precize rregullohen rastet kur ndalohet ndjekja dhe dënimi për të njëjtën çështje, do të thotë gjykimi i të njëjtit person dy herë për të njëjtën vepër penale. Me përcaktimin që vendimi gjyqësor nuk mund të ndryshohet në dëm të të pandehurit në procedurën e përdorimit të mjetit të jashtëzakonshëm juridik, Kushtetuta e ka pranuar parimin e ndalesës *reformatio in peius*.
3. E drejta e garantuar me nenin 34. të Kushtetutës e ka statusin e të drejtës absolute të mbrojtur dhe nuk i nënshtrohet shmangies me asnjë kusht, që do të thotë as gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme (neni 56. paragrafi 2.).

Neni 35 [Liria e Lëvizjes]

- (1) Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.
- (2) Secili person ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.
- (3) Shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t’u ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës.
- (4) Shtetasit e Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohen nga Kosova kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe.
- (5) E drejta e të huajve për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe për t’u vendosur në vend, rregullohet me ligj.

Neni 35

1. Liria e lëvizjes (dhe e vendosjes), si një nga të drejtat themelore të çdo njeriu, është proklamuar në nenin 13 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe në nenin 12 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Me këto dokumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, secilit që legalisht gjendet në territorin e një shteti i garantohet e drejta e lirisë së lëvizjes dhe e zgjedhjes së vendbanimit në kufijtë e atij shteti. Secili ka të drejtë ta braktisë secilin shtet, duke

përfshirë edhe shtetin e vet dhe askush nuk mundet që në mënyrë arbitrare ta privojë nga e drejta për tu kthyer, përkatësisht për të hyrë në vendin e vet. Kjo do të thotë se liria e lëvizjes dhe e vendosjes përjashton çdo ekzistim të pasaportave të brendshme, pa të cilat nuk guxon të braktiset vendi i banimit apo marrja e lejeve të veçanta për vendosje në qytete, veçanërisht në kryeqytete.

2. Liria e lëvizjes ndërkombëtare do të thotë se çdokush është i lirë që ta braktisë cilindo vend, duke përfshirë edhe vendin e vet dhe që në të të kthehet me dëshirë.¹²⁸ Kështu, Protokollin nr.4. me Konventën Evropiane, parashikon që secili që në mënyrë të ligjshme gjendet në territorin e një shteti, duhet ta gëzojë lirinë e lëvizjes dhe lirinë e zgjedhjes së vendbanimit. Pos kësaj, secili duhet të jetë i lirë dhe ta braktisë cilindo vend, duke përfshirë edhe vendin e vet. Ndërkaq, duhet theksuar se këto liri u nënshtrohen kufizimeve të caktuara ligjore, të cilat janë të nevojshme në shoqërinë demokratike, me qëllim të sigurisë nacionale dhe publike, mbrojtjes së rendit publik, pengimit të kriminalitetit, mbrojtjes së shëndetit apo moralit, apo mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të të tjerëve.¹²⁹
3. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut për lirinë e lëvizjes lidhet me ndalimin e ndjekjes së shtetasve të vet dhe ndalimin e ndjekjes grupore të të huajve. Kështu, Protokollin nr. 7. me Konventën Evropiane, i nxjerrë në vitin 1984, garanton mbrojtjen në procedurën e ndjekjes së të huajve, ashtu që i huaji, i cili në mënyrë të ligjshme qëndron në territorin e një shteti, nuk mund të dëbohet nga ai shtet, përveç në bazë të vendimit të marrë në pajtim me ligjin. Natyrisht, i huaji në çdo rast e ka të drejtën e paraqitjes së shkaqeve me të cilat e konteston dëbimin dhe të drejtën që rasti i tij të rishqyrtohet. Ndërkaq, ai nuk mund të dëbohet para se t'i ketë shfrytëzuar të drejtat e përmendura, nëse dëbimi është i domosdoshëm dhe në interes të rendit publik apo që mbështetet në arsyet e sigurisë kombëtare. Lidhur me këtë është edhe e drejta e azilit, e cila i garantohet çdokujt, si mbrojtje nga ndjekja, por përjashtohet atëherë kur kemi të bëjmë me rastin e ndjekjes për vepër penale të natyrës jopolitike apo të procedurave dhe veprimeve kundër qëllimeve dhe parimeve të Kombeve të Bashkuara.

¹²⁸ Shih lëndët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KI62/10 dhe KI35/09.

Në rastin e aktvendimit për mospranueshmëri nr. KI62/10, të datës 18 mars 2011, Gjykata Kushtetuese ka vendosur, ndër të tjera, edhe për të drejtën e lirisë së lëvizjes. Edhe pse rasti ka qenë i papranueshëm për shqyrtim, sepse ka qenë qartazi i pabazuar, gjykata me këtë aktvendim ia ka bërë me dije palës se e drejta e lëvizjes është një e drejtë që nuk mund të abuzohet për arritjen e qëllimeve të tjera dytësore (në rastin konkret, për arritjen e përparësive materiale në emër të së drejtës së lëvizjes së lirë). Paraqitës ka qenë Azem Ademi kundër Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Kosovës.

Edhe në rastin KI35/09 të datës 14 dhjetor 2010, Gjykata ka vlerësuar se rasti është i papranueshëm për shqyrtim për arsye se pala, Halit Bahtiri, nuk ka arritur që në mënyrë konkrete të provojë se cilat të drejta i janë shkelur nga ana e Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Podujevës, edhe pse ai në mënyrë të theksuar përmend të drejtën e lëvizjes së lirë.

¹²⁹ Më shumë për rrethanat dhe kushtet në të cilat mund të ketë kufizim, të shihet në: Kisigiro, Xhon. Innocent (2011), 'Human Rights Law In International And National Context: Challenges, Violations, Derogation, and Enforcement', LAP LAMBERT Academic Publishing: Germany

Neni 35.1

1. Liria e lëvizjes dhe zgjedhja e vendbanimit në Republikën e Kosovës janë të garantuara me Kushtetutë dhe këtë të drejtë e gëzojnë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt, të cilët janë banues të saj të ligjshëm (neni 35. paragrafi 1.). Kjo do të thotë se çdokush që në mënyrë të ligjshme gjendet në territorin e shtetit, lirisht mund të lëvizë dhe të vendoset, por edhe ta braktisë vendin dhe të kthehet në të. Natyrisht, të gjitha këto të drejta mund të jenë të kufizuara, por vetëm në rastet e parashikuara me ligj.

Neni 35.2

1. Kur është fjala për të drejtën e çdo personi për ta braktisur territorin e Republikës së Kosovës (neni 35. paragrafi 2.), atëherë duhet thënë se kufizimet e kësaj të drejte mund të rregullohen me ligj, dhe kjo e drejtë mund të kufizohet në këto raste:
 - 1) nëse kufizimet e përmendura janë të domosdoshme për sigurimin e procedurës ligjore;
 - 2) nëse kufizimet e të drejtës së braktisjes së vendit janë të domosdoshme për zbatimin e vendimit gjyqësor;
 - 3) nëse ndalesa e braktisjes së vendit është e domosdoshme për plotësimin e obligimit të mbrojtjes së tij.
2. Prandaj, Kushtetuta e lejon kufizimin e së drejtës së braktisjes së vendit dhe çon në ligjin që rregullon kufizimin e së drejtës së lëvizjes dhe të vendosjes. Ligdhënësi, me këtë rast, ka qenë i lidhur me rregullën e përgjithshme kushtetuese, e cila e definon përmbajtjen, cilësinë dhe vëllimin e autorizimeve ligjore në materien e të drejtave të njeriut (neni 21. paragrafi 1 dhe 2. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës) dhe kufijtë në të cilët Kushtetuta e lejon kufizimin e të drejtave dhe të lirive themelore (neni 55.). Kushtetuta drejtpërsëdrejti i përcakton shkaqet të cilat mund të jenë bazë e kufizimit të lirisë së lëvizjes dhe të vendosjes.¹³⁰ Në këtë mënyrë, Kushtetuta në nenin 56 thekson se shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë, mund të ndodhë vetëm pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe mund të zgjasë vetëm për aq sa është e domosdoshme në rrethanat e caktuara (paragrafi 1.).
3. Në paragrafin 2. të të njëjtit nen, në mënyrë takstative janë theksuar rastet kur shmangia nga këto të drejta nuk është e lejuar në asnjë rast, madje as gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme. Ndërkaq, me paragrafin 2. të nenit 34. në mënyrë precize janë parashikuar rastet e kufizimeve, por vetëm të braktisjes së vendit. Këto shkaqe i kemi përmendur që në fillim të këtij pasusi dhe nuk ka nevojë t'i përsërisim.

¹³⁰ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka përcaktuar shkeljen e kësaj dispozite në rastet kur shteti imponon një varg kufizimesh të së drejtës së lëvizjes, duke përfshirë edhe obligimin e paraqitjes së rregullt dhe të shpeshtë në polici (*Raimondo kundër Italisë (1994.)*), apo obligimin për braktisjen e vendqëndrimit gjatë procedurës së bankrotimit, kur veprimet e tilla kanë zgjatur me vjet (*Luordo kundër Italisë (2003.)*) (më shumë se 14 vjet) dhe *Battoro kundër Italisë (2003.)* (dymbëdhjetë vjet e gjashtë muaj).

Neni 35.3

1. iria e lëvizjes (dhe e vendosjes) është një nga ato liri të cilat të huajt i gëzojnë me regjim të veçantë, për dallim nga shtetasit. Kështu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në paragrafin 3. të nenit 35. parashikon që shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t'u mohohet e drejta e hyrjes në vend.

Neni 35.4

1. Me paragrafin 4. të nenit 35. Kushtetuta përcakton që shtetasit e Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohen kundër vullnetit të tyre, përveç kur me ligj është parashikuar ndryshe, apo me marrëveshje ndërkombëtare.¹³¹ Ndërkaq, kur është fjala për të huajt, atëherë Kushtetuta parashikon zgjidhje të ndryshme.

Neni 35.5

1. Në fund, neni i përmendur në paragrafin 5. përcakton që e drejta e hyrjes së të huajve në Republikën e Kosovës dhe e qëndrimit të tyre rregullohet me ligj. Ligjit për të Huajt (i miratuar në Kuvend, më 16.12.2008, ndërsa i shpallur me Dekretin e Kryetarit, nr. DL-069-2008, më 30.12.2008) në nenin 4. paragrafi 1. e rregullon të drejtën e hyrjes së të huajve dhe përcakton se i huaji mund të hyjë në Republikën e Kosovës dhe të qëndrojë në territorin e saj me dokument të rregullt udhëtimi, në të cilin është evidencuar viza apo leja e qëndrimit, nëse me dispozitat e këtij Ligji apo me marrëveshje ndërkombëtare nuk është parashikuar ndryshe. Po ashtu, të huajve që nuk kanë dokument të vlefshëm udhëtimi u lejohet hyrja në Republikën e Kosovës, nëse Republika e Kosovës është e obliguar t'i pranojë në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare (paragrafi 2.).
2. Liria e lëvizjes është rregulluar me nenin 6. të këtij Ligji, ashtu që paragrafi 1. i këtij neni përcakton që çdo person që qëndron legalisht në Republikën e Kosovës e ka të drejtën e lirisë së lëvizjes dhe të zgjedhjes së vendit të qëndrimit në tërë territorin e Kosovës, ndërsa paragrafi 2. e përcakton kufizimin e lëvizjes së të huajve brenda Republikës së Kosovës, por deri në masën e cila është e domosdoshme për një shoqëri demokratike. Ky paragraf, po ashtu përcakton kushtet e kufizimit të lëvizjes së të huajve, në të cilat bëjnë pjesë:
 - 1) mbrojtja e interesave vitale për sigurinë kombëtare;
 - 2) pengimi i kërcënimeve serioze dhe të drejtpërdrejta për rendin dhe qetësinë publike;
 - 3) pengimi i kërcënimeve serioze dhe të drejtpërdrejta kriminale;

¹³¹ Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në dy raste, ka konstatuar se ekstradimi i shtetasve të Kosovës është në pajtim të plotë me Kushtetutën kur ky bëhet në bazë të zbatimit të obligimeve ndërkombëtare të Kosovës, që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare. Shih më shumë: Vendimi për heqjen e kërkesës nga lista (*Rafet Hoxha kundër Vendimit nr. PN. nr. 168/05 të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 24 mars 2010*); dhe Aktvendimi për moslejueshmëri i datës 20 maj 2010: lënda K122/09 (*Dedë Gecaj kundër vendimit nr. PKL-KZZ 76/08 i Gjykatës Supreme të Kosovës, nga data 6 prill 2009*).

- 4) pengimi i kërcënimeve serioze dhe urgjente për shëndetin dhe moralin publik;
 - 5) Pengimi i kërcënimeve serioze dhe të drejtpërdrejta për të drejtat dhe liritë e të tjerëve.
3. Siç mund të shihet, Kushtetuta, të drejtën e hyrjes së të huajve në Republikën e Kosovës dhe të qëndrimit në të, në tërësi ia ka lënë ligjit, i cili në mënyrë mjaft të detajuar e rregullon këtë çështje të ndjeshme. Kështu, neni 29. i Ligjit për të Huajt e rregullon ndalesën e hyrjes dhe të rihyrjes në Republikën e Kosovës. Pra, paragrafi 1. i këtij neni i thekson një për një shkaqet për të cilat të huajt nuk i lejohet hyrja, si:
- 1) nëse nuk posedon dokumente të vlefshme udhëtimi, në të cilat është evidencuar viza apo leja e qëndrimit;
 - 2) nëse nuk posedon mjete të mjaftueshme për jetesë gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Kosovës dhe për udhëtim në vendin tjetër i cili është i gatshëm ta pranojë¹³²;
 - 3) nëse është në transit dhe nuk i plotëson kushtet për hyrje në vendin e tretë;
 - 4) nëse kundër tij është në fuqi urdhëri për dëbim me ndalesën e hyrjes së sërishme;
 - 5) nëse nuk e posedon vërtetimin për evakuim, ndërsa vjen nga rajoni ku ekziston epidemia e sëmundjeve ngjitëse;
 - 6) nëse paraqet rrezik për rregullimin juridik, sigurinë kombëtare apo për shëndetin publik;
 - 7) nëse ekziston dyshimi i bazuar se qëndrimi i tij mund të lidhet me kryerjen e veprave penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, në bazë të dyshimit të arsyeshëm;
 - 8) nëse në evidencën e organit kompetent është i regjistruar si kryes i veprave penale.
4. Llojet e qëndrimit të të huajt në Republikën e Kosovës janë përcaktuar me nenin 33. të Ligjit për të Huajt, sipas dispozitave të të cilit të huajt mund t'i lejohet qëndrimi:
- 1) deri në 90 ditë;¹³³
 - 2) në bazë të qëndrimit të përkohshëm;
 - 3) në bazë të qëndrimit të përhershëm.
- Ndërkaq, i huaji mund të ndalet në kufi, do të thotë mund t'i mohohet e drejta e hyrjes në Republikën e Kosovës për shkak të sigurisë publike dhe të sigurisë që të largohet nga territori shtetëror (neni 60. paragrafi 1.). Në atë rast, ai mund të mbahet në lokalet e organit kompetent, por më së shumti deri në 12 orë. Po ashtu, në kufi mund të ndalohen në Qendrën e Pranimi për të Huajt të organit kompetent¹³⁴ edhe të huajt identiteti i të cilëve nuk mund të konstatohet dhe/apo

¹³² Qeveria e Republikës së Kosovës e përcakton shumën e mjeteve që janë të nevojshme për jetesë në pajtim me nenin 1. pika 2. e këtij neni.

¹³³ Qëndrimi deri në 90 ditë, do të thotë se i huaji mund të qëndrojë në Republikën e Kosovës pa vizë, me vizë, apo me leje të kalimit të kufirit, nëse me këtë Ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare nuk është parashikuar ndryshe.

¹³⁴ I huaji, i cili për shkaqe shëndetësore, apo për nevoja ose arsye të tjera të veçanta nuk mund të vendoset në Qendër, mund të vendoset në një vend tjetër të standardit përkatës (paragrafi 3.).

nuk kanë vizë të vlefshme, leje qëndrimi apo nuk mund të dëbohen në pajtim me urdhrin për dëbim (paragrafi 2.).

5. Hyrja e të huajve është rregulluar me nenin 32. të Ligjit të përmendur, i cili përcakton se të huajt mund të shkojnë lirisht nga Republika e Kosovës (paragrafi 1.). Ndërkaq, kjo e drejtë nuk është absolute, sepse dalja nga Republika e Kosovës nuk i lejohet të huajit,¹³⁵ nëse:
- 1) paraqiten dokumente të pavlefshme të udhëtimit, dokumente udhëtimi të ndonjë personi tjetër apo çfarëdo dokumentesh tjera të pavlefshme;
 - 2) nuk i plotëson kushtet e hyrjes në shtetin tjetër;
 - 3) përpiqet ta shmangë ndjekjen për vepra penale;
 - 4) nëse organi kompetent, në pajtim me ligjin, konstaton se paraqet kërcënim për rregullimin kushtetues, sigurinë kombëtare apo shëndetin publik.
- Kur të gjitha shkaqet e numëruara pushojnë së ekzistuari, të huajit i lejohet shkuarja nga Republika e Kosovës.
6. Në fund, duhet thënë se me këtë Ligj është parashikuar edhe një Institut, shumë i rëndësishëm, kur bëhet fjalë për të huajt që qëndrojnë në territorin e Kosovës. Ky është dëbimi që është rregulluar me nenin 58, sipas të cilit i huaji mund të dëbohet me apo pa ndalesë të hyrjes së sërishme, me urdhër të gjykatës kompetente, kur ai nuk i nënshtrohet urdhrin për largim¹³⁶ që e ka marrë organi kompetent në pajtim me nenin 55. paragrafi 1. Organi kompetent duhet të veprojë sipas aktvendimit të gjykatës kompetente për dëbim të të huajit i cili qëndron ilegalisht në Republikën e Kosovës (paragrafi 2.). I huaji që largohet në pajtim me marrëveshjen ndërkombëtare, largohet në të njëjtën mënyrë si i huaj të cilit i është shqiptuar urdhëresa për dëbim (paragrafi 3.). Ndërkaq, duhet theksuar se ekzistojnë edhe shmangie nga dispozitat e këtij neni të Ligjit, në rastet kur nuk lejohet depërtimi apo kthimi i të huajit në çfarëdo mënyre deri te kufijtë e territoreve, ku jeta apo liria e të huajit rrezikohet në bazë të shkaqeve fetare, përkatësisë etnike, përkatësisë së grupit të veçantë shoqëror apo për shkak të mendimit politik. Natyrisht, këtu është me rëndësi të theksohet fakti që këto favore, megjithatë, nuk mund t'i kërkojnë të huajt për të cilët ekziston dyshimi i bazuar se paraqesin kërcënim serioz për sigurinë e shtetit, në të cilin me vendim të formës së prerë janë dënuar për vepra veçanërisht të rënda penale dhe paraqesin rrezik të përhershëm për bashkësinë e atij vendi. Po ashtu, në pajtim me këtë, duhet thënë se nuk lejohet dëbimi apo kthimi në çfarëdo mënyrë në shtetin tjetër, i personit për të cilin ekzistojnë baza të arsyeshme për dyshim se i ekspozohet rrezikut të nënshtimit të torturës dhe/apo trajtimit jonjerëzor dhe degradues.

¹³⁵ Kur të huajit i refuzohet e drejta e daljes nga Republika e Kosovës për arsye të parashikuara me ligj, organi kompetent i lëshon të huajit aktvendim me shkrim. I huaji ka të drejtë ankese kundër këtij aktvendimi në gjykatën që është kompetente për atë rajon. Gjykata merr vendim lidhur me atë çështje në afat prej 72 orësh nga koha e paraqitjes së ankesës dhe është e autorizuar që ta anulojë aktvendimin dhe që të urdhërojë që i huaji mund ta lëshojë vendin lirisht.

¹³⁶ Nëse konstatohet se i huaji qëndron ilegalisht në Republikën e Kosovës, organi kompetent e urdhëron që ta braktisë shtetin për një kohë të caktuar (neni 55. paragrafi 1.)

7. Siç mund të konkludohet nga kjo që u tha, liria e lëvizjes e garantuar me nenin 35, nuk është e drejtë absolute, që do të thotë se kjo e drejtë e mbrojtur me Kushtetutë mund të realizohet në kushte të caktuara Këtu, para së gjithash, mendohet për kufizimin e lirisë së lëvizjes në rast të gjendjes së jashtëzakonshme, (duke pasur parasysh se neni 35. i Kushtetutës nuk gjendet në grupin e neneve të cilat numërohen një për një në neni 56. paragrafi 2.), si dhe në rastet e tjera të parashikuara me ligj.

Neni 36 [E Drejta e Privatësisë]

- (1) Çdokush gëzon të drejtën që t'i respektohet jeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.
- (2) Kontrollat e cilësdo banese ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratojë veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.
- (3) Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.
- (4) Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigjimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligj.

Neni 36

1. E drejta e privatësisë përfshin në vete disa të drejta të tjera, në pikëpamje të të cilave Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (neni 12.) dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 17.) parashikojnë: “Askush nuk bën t’i ekspozohet ndërhyrjes arbitrare dhe të paligjshme në jetën private, familje, banesë apo letërkëmbim dhe as sulmeve të kundërligjshme në nderin dhe reputacionin dhe ka të drejtë në mbrojtje ligjore nga ndërhyrja dhe sulmi i tillë”. Këto të drejta janë të mbrojtura edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (neni 8.), e cila garanton të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare, të shtëpisë dhe të letërkëmbimit. Kjo konventë, pra, garanton pacenueshmërinë e banesës në kuadër të të drejtave të përgjithshme të respektimit të jetës private dhe familjare. Pushteti publik nuk mund të ndërhyjë në realizimin e kësaj të drejte. Në raste të jashtëzakonshme, pushteti publik mund t’i cenojë këto të

drejta, vetëm atëherë kur kjo bëhet në pajtim me ligjin, në mënyrë të domosdoshme në interes të sigurisë kombëtare, të sigurisë publike apo të mirëqenies ekonomike të vendit, si dhe me qëllim të pengimit të trazirave dhe të kriminalitetit, të mbrojtjes së shëndetit apo të moralit, apo me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të të tjerëve.

2. Për shkak të rrezikimit të jetës private, me zhvillimin e teknologjisë kompjuterike dhe të përpunimit automatik të të dhënave, kur pushteti publik mund t'i keqpërdorë të dhënat e kompjuterizuara që i kanë për qytetarët, në kuadër të Këshillit të Evropës është miratuar Konventa Evropiane "Për mbrojtjen e personave lidhur me përpunimin automatik të të dhënave personale" (1981.). Është themeluar edhe një Komitet i veçantë këshillëdhënës dhe konsultativ, i cili ka për detyrë të ofrojë ndihmë në implementimin e Konventës. Lidhur me këtë, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka dhënë disa rekomandime me qëllim të mbrojtjes së privatësisë së të dhënave të përpunuara në mënyrë automatike, ndër të cilat janë:
 - 1) të dhënat e natyrës mjekësore (1981.);
 - 2) të dhënat për dosjet policore (1987.);
 - 3) të dhënat për punësimin (1989.);
 - 4) mbrojtja e të dhënave personale në fushën e telekomunikimeve, veçanërisht të shërbimeve telefonike (1995) etj.

Në shumë raste për këtë kategori të të drejtave të njeriut ka vendosur edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

3. Pacenueshmëria e banesës, si një nga të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit, mbron intimitetin e jetës private dhe familjare, qetësinë shtëpiake dhe vendqëndrimin e çdo njeriu. Prandaj, pacenueshmëria e banesës është e lidhur ngushtë me pacenueshmërinë e individit, lirinë dhe sigurinë e njeriut. Si e tillë, e drejta e pacenueshmërisë së banesës bën pjesë në korpusin tradicional të të drejtave negative, ndërsa për nga shtrirja e saj, banesa është e pacenueshme, jo vetëm për organet e pushtetit publik por edhe për të gjithë personat e tretë, të cilët nuk janë shfrytëzues të saj. Kufizimet e kësaj të drejte janë të lejueshme vetëm në rastet dhe në kushtet që janë në pajtim me parimet e rregullimit të lirë demokratik.¹³⁷

¹³⁷ Shih lëndët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KI98/10 dhe KI48/10.

Në këtë rast gjykata ka marrë aktvendim për papranueshmëri, sepse kërkesa është paraqitur nga ana e personit të paautorizuar. Pala e paautorizuar, si bazë të kërkesës së saj e ka theksuar të drejtën e privatësisë. Krahaso: Aktvendimi për papranueshmëri në rastin KI98/10, i datës 4 prill 2012 (*Paraqitësi i kërkesës: Ombudspersoni i Kosovës. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve 01 nr. 06/837, i datës 16 prill 2009 dhe Npi-01/132, i datës 30 prill 2009*).

Në aktvendimin për palejueshmëri për shkak të ratioe temporis, mungesës së kompetencës së Gjykatës, është theksuar nga ana e palës edhe e shkelja e së drejtës së privatësisë, përveç shkeljeve të tjera të garantuara me Kushtetutë. Ndërkaq, pasi që Gjykata nuk ka pasur kompetencë racione temporis, nuk ka qenë e mundur të përcaktohet saktësisht se cili do të ishte qëndrimi i gjykatës në rastin konkret. Shih: Aktvendimi për palejueshmëri në rastin KI48/10, i datës 1 dhjetor 2011 (*Paraqitësi i kërkesës, Naser Rexhepi. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të Gjykatës Ekonomike të Qarkut VI. C. nr. 54/2003, nga data 15 prill 2003 dhe vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. nr. 39/2003, nga data 19 qershor 2003 dhe Rev.E.nr.11/2003, nga data 18 maj 2004*).

Neni 36.1

1. Duke i marrë aktvendimet nga deklaratat dhe konventat më të rëndësishme ndërkombëtare, para së gjithash, nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ia garanton secilit të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, pacenueshmërinë e banesës dhe fshehtësinë e letrave, telefonit dhe mjeteve të tjera të komunikimit (neni 36. paragrafi 1.). Të gjitha këto të drejta janë jashtëzakonisht të rëndësishme për sigurimin e privatësisë së çdo njeriu. Ndërkaq, është fakt se shpeshherë ato të drejta nuk respektohen dhe cenohen, edhe pse ato janë të patjetërsueshme, të garantuara me aktet e përgjithshme më të larta juridike të së drejtës së brendshme dhe me dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare. Kjo, siç kemi theksuar më sipër, veçanërisht ka të bëjë me mjetet e komunikimit (letrat, telefonia mobile dhe fikse, posta elektronike e të tjera),¹³⁸ të cilat sot, për shkak të zhvillimit të lartë të teknologjisë, mund të jenë lëndë e kontrollit dhe rrezikimit të privatësisë jo vetëm nga pushteti publik, por edhe nga organizatat e caktuara komerciale, madje edhe nga individët.

2. Duke proklamuar pacenueshmërinë e banesës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka dashur t'i mbrojtë dy të mira:

- 1) shfrytëzimin e lirë dhe të papengueshëm të banesës;
- 2) qetësinë e shtëpisë (neni 36. paragrafi 1).

Kjo mbrojtje vlen për çdokënd: edhe për organet e pushtetit, edhe për individët. Shfrytëzimi i papenguar i banesës do të mund të cenohej me çdo lloj rekuizicioni.¹³⁹ 3. Duke pasur parasysh se Kushtetuta nuk përcakton kurrfarë kufizimi në këtë pikëpamje, del se rekuizicioni i banesës nuk është i mundur në pikëpamje juridike dhe aio as me ligj nuk guxon të themelohet. E drejta e pronësisë mund të kufizohet, por e drejta e shfrytëzimit të banesës nuk mund të kufizohet. Ndërkaq, siç do të shohim më vonë, kjo e drejtë nuk është absolute dhe nga kjo mund të ketë shmangie në rast të gjendjes së jashtëzakonshme, kështu që shtrohet pyetja se çka nënkupton kjo shmangie. Kështu, për shembull, më parë, në disa ligje të caktuara, ka pasur dispozita që në raste të caktuara kanë lejuar, në kushte të caktuara, rekuizicionin e pjesëve të banesës, (për shembull, që të mund të përdoren për nevojat e ushtrisë, lokalet private të cilat nuk janë të domosdoshme për banim të kryefamiljarit dhe të anëtarëve të familjes së tij). Ky obligim i dhënies së lokaleve private është i pakushtëzuar, kur ushtria është në gjendje mobile dhe në gjendje lufte. Në gjendje të rregullt, kjo është e veçantë dhe parashikohet vetëm

¹³⁸ Në lëndën *Molone kundër Mbretërisë së Bashkuar (1984.)*, paraqitësit janë ankuar se me përcjellje të fshehtë gjatë hetimit penal, është cenuar e drejta e tyre e privatësisë dhe e letërkëmbimit, (në këtë kontekst nënkupton të gjitha format e komunikimit privat).

¹³⁹ Rekuizicion (lat. *requisitio*)-kërkesë, lutje; në drejtësi-kërkesa që një pushtet ia dërgon tjetrit me qëllim të ndihmës dhe të bashkëpunimit për ndonjë çështje; regjistrimi apo marrja e gjërave për nevoja shtetërore apo ushtarake, veçanërisht gjatë kohës së luftës, të cilat nuk paguhen me të holla të gatshme, por merren me vërtetim.

për raste të jashtëzakonshme (vetëm për “vendosje e përkohshme” dhe vetëm atëherë kur nuk ka ndërtesa të mjaftueshme shtetërore).

Neni 36.2

1. E drejta e pacenueshmërisë së banesës është një formë e garantimit të privatësisë. Kjo pacenueshmëri është garantuar me dispozitën e përgjithshme të Kushtetutës, ndërsa përmbajtja e të drejtës së pacenueshmërisë të banesës përfshin ndalesën e hyrjes në banesë të huaj si dhe ndalesën e bastisjes së banesës kundër dëshirës së mbajtësit të banesës. Kjo rregull e përgjithshme ka të bëjë jo vetëm me banesën, por edhe me çdo hapësirë tjetër. Nga dispozitat e mëtejme të nenit 36 të Kushtetutës shihet se me pacenueshmëri të banesës, ai nen ka për qëllim mbrojtjen, në rend të parë, të qetësisë shtëpiake nga shkeljet e pushtetit (paragrafi 2.). Kjo mund të konkludohet nga dispozita e cila përcakton se kontrollimi i cilësdo banesë apo hapësirave të tjera private, i domosdoshëm për zhvillimin e hetimit lidhur me krimin, mund të zbatohet vetëm deri në një masë të domosdoshme dhe vetëm në bazë të vendimit gjyqësor, pas shpjegimit të shkaqeve të domosdoshmërisë së një kontrolli të tillë.¹⁴⁰ Kundër urdhrin të tillë, do të thotë të vendimit gjyqësor, mund të ushtrohet ankesë, por kjo nuk e pengon kryerjen e bastisjes. Nga kjo nuk ka asnjë dobi, përveçse do të mund të dënohej organi i cili e ka dhënë urdhrin pa arsye të nevojshme. Në bastisje detyrimisht duhet të marrin pjesë “dy qytetarë të ftuar”, apo siç thuhet shpesh, “dy dëshmitarë të ndershëm”. Por, gjithnjë ftohet që në bastisje të jetë i pranishëm pronari i banesës, i autorizuari i tij, anëtarët e familjes apo fqinjët. Bastisja duhet të bëhet ditën, ndërsa vetëm kur kjo është më se e domosdoshme, bastisja mund të bëhet edhe natën. Ajo që është me rëndësi të theksohet është se bastisja e banesës dhe e personave duhet të bëhet në mënyrën më të denjë, duke mos çrregulluar qetësinë shtëpiake dhe duke evituar çdo nxitje të kureshtjes së mjedisit. Pas bastisjes së bërë hartohet procesverbali, të cilin e nënshkruajnë të gjithë personat e pranishëm, kurse pronarit të banesës i jepet vërtetimi për ecurinë e bastisjes dhe kur i merret ndonjë gjë, i dorëzohet edhe regjistri i gjërave të marra.
2. Kushtetuta, ndërkaq, e lejon mundësinë që e drejta e pacenueshmërisë së banesës të kufizohet sipas kushteve dhe procedurës që e parashikon Kushtetuta. Ekzistojnë dy raste në të cilat Kushtetuta e lejon kufizimin e kësaj të drejte:
 - 1) i pari, siç theksuam në pasusin paraprak, me vendim dhe me urdhëresë me shkrim të gjykatës;
 - 2) i dyti, kur kufizimi është i lejueshëm dhe kur nuk ka urdhëresë me shkrim të gjykatës për hyrje në banesë dhe për bastisje të banesës (gjykata është e obliguar që t’i lejojë veprimet e këtilla në mënyrë retroaktive).

¹⁴⁰ Gjykata Evropiane e ka përcaktuar shkeljen e nenit 8 të Konventës, kur shtëpitë e paraqitësve kanë qenë lëndë e bastisjes sipas urdhrin të formuluar në mënyrë shumë të gjerë e që nuk u është dhënë asnjë informacion shtesë për shkaqet e bastisjes dhe kur kundër tyre nuk është iniciuar kurrfarë hetimi penal (*Ernesti dhe të tjerët kundër Belgjikës* (2003.).

3. Këtu është e domosdoshme që të analizohen nga afër rastet e përmendura dhe të shpjegohet hyrja në banesë të huaj dhe bastisja e saj kundër dëshirës së mbajtësit të banesës. Rastin e parë, në bazë të vendimit gjyqësor e kemi shpjeguar dhe ai nuk ka qenë kontestues. Atëherë mbajtësi i banesës, me dy dëshmitarë të moshës madhore, mund të jetë i pranishëm në bastisjen e banesës, vetë apo nëpërmjet përfaqësuesit të tij. Bastisja e banesës në bazë të urdhërësës gjyqësore është e mundshme edhe pa praninë e mbajtësit të banesës apo të të autorizuarit të tij, por me kusht që në bastisje të jenë të pranishëm dy dëshmitarë të moshës madhore. Ndërkaq, problemi mund të paraqitet në rastin e dytë, kur e drejta e huaj e pacenueshmërisë së banesës shkelet pa vendim gjyqësor dhe pa urdhër për bastisje. Kjo shmangie nga rregulla e pasjes dhe e paraqitjes së vendimit dhe urdhërësës së tillë nga ana e atij që e bën bastisjen, mund të bëhet (dhe kjo është e lejueshme sipas nenit 36. paragrafi 2.), në këto raste:
 - 1) nëse është e domosdoshme për privimin ligjor nga liria të kryerësit të veprës penale;
 - 2) nëse është e domosdoshme mbledhja e provave, të cilat mund të humbin;
 - 3) në rast të evitimit të rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe pronën në mënyrën e parashikuar me ligj.
4. Këtu do të flasim më shumë për shmangien e lejuar nga rregulla e pasjes së vendimit gjyqësor, do të thotë kur mund të bëhet bastisja e banesës së huaj për shkak të privimit të ligjshëm nga liria të kryerësit të veprës penale, pa pasur “urdhërësë të arsyetuar me shkrim”. Ndërkaq, edhe këtu është mjaft me rëndësi që, para së gjithash, mbajtësit të banesës t’i shpjegohen shkaqet e domosdoshmërisë së një kontrolli të tillë, qëllimi i të cilit është gjetja e të dyshuarit apo gjetja e gjërave që do të mund të ishin me rëndësi për hetimin. Vetëm për këtë qëllim dhe nëse ka gjasa për sukses, mund të bëhet bastisja. Sipas rregullës, bastisjes duhet t’i paraprijë marrja në pyetje e mbajtësit të banesës dhe ftesa që vullnetarisht ta dorëzojë personin apo gjënë e kërkuar dhe vetëm pastaj, në rast të mossuksesit, pason hyrja në banesë, kontrollimi dhe bastisja e saj.

Neni 36.3

1. E drejta e pacenueshmërisë së fshehtësisë së letrave, po ashtu, është një nga të drejtat themelore personale të njeriut dhe të qytetarit. Edhe kjo e drejtë hyn në suazat e gjëra të të drejtave të pacenueshmërisë së jetës personale dhe familjare, përkatësisht të së drejtës së përgjithshme të lirisë personale. Detyrimin për përmbajtje nga shkelja e kësaj të drejte, siç është hapja e letrave private dhe njohja me përmbajtjes së tyre, e kanë jo vetëm pushteti publik, por edhe të gjithë personat e tjerë të tretë. Përfundim bën vetëm përfaqësuesi ligjor dhe personat e autorizuar nga ai. Me fshehtësi të letrës janë të mbrojtura edhe të gjitha mjetet e tjera të komunikimeve në largësi, siç është telegrami, biseda telefonike, telefonia mobile, posta elektronike e të tjera. Këtë të drejtë e njeh edhe Konventa Evropiane, por me rezervimin e tërheqjes, e cila zbatohet për të drejtën e përgjithshme të respektimit të jetës private dhe familjare.

2. Fshehtësinë e letrave, të bisedave telefonike dhe të mjeteve të tjera të komunikimit, si të drejtë të paqjetërsueshme Kushtetuta e Republikës së Kosovës e garanton me normë të përgjithshme (paragrafi 3.). Kushtetuta e rregullon edhe mundësinë e kufizimit të fshehtësisë së letrave, të bisedave telefonike dhe të mjeteve të tjera të komunikimit, sipas kushteve dhe shkaqeve që i parashikon shprehimisht. Kufizimi, përkatësisht mohimi i kësaj të drejte është i mundur vetëm në bazë të vendimit gjyqësor dhe përkohësisht. Gjykata kompetente mund të marrë vendim për mohimin e së drejtës së fshehtësisë së letrave, të bisedave telefonike dhe të mjeteve të tjera të komunikimit, vetëm nëse ekzistojnë shkaqe të cilat janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë, si:

- 1) nëse është e domosdoshme për zhvillimin e procedurës penale;
- 2) nëse mohimi i përmendur është i domosdoshëm për mbrojtjen e vendit, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

Siç shihet, vendimi për kufizimin e fshehtësisë së letrave, përkatësisht vendimi për mohimin e fshehtësisë së letrave, të bisedave telefonike dhe të mjeteve të tjera të komunikimit, ka veprim të kufizuar kohor, do të thotë ka karakter të përkohshëm dhe duhet të zgjasë sa më pak, përkatësisht vetëm aq sa është e domosdoshme për zhvillimin e procedurës penale apo për mbrojtje të vendit. Ndërkaq, Kushtetuta nuk e precizon veprimin kohor të vendimit dhe as nuk e përcakton zgjatjen maksimale të vendimit.

3. Kushtetuta i referohet ligjit i cili e rregullon më nga afër procedurën e kufizimit të kësaj të drejte (paragrafi 3.), në suaza dhe sipas vëllimit në të cilin Kushtetuta e lejon rregullativën ligjdhënëse në fushën e të drejtave të njeriut (neni 22. dhe neni 55.). Mund të thuhet se në këtë nen si dhe në disa nene të tjera, hasim në probleme të caktuara terminologjike, siç janë: “shmangie” dhe “mohim” nga të drejtat e caktuara, ndërsa në nenin 55 dhe 56 e hasim termin “kufizim” të të drejtave dhe lirive themelore. Me termin “shmangie” në Kushtetutë nënkuptohet regjimi i të drejtave të njeriut gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme (neni 56. paragrafi 1.), ndërsa me termin “kufizim” nënkuptohet regjimi i të drejtave individuale lidhur me të cilat Kushtetuta i parashikon përjashtimet nga garantimi i përgjithshëm kushtetues i të drejtave (neni 35. paragrafi 2., neni 55. paragrafi 1., neni 38. paragrafi 4., neni 40. paragrafi 2.). Termi “mohim” nënkupton vetëm përjashtimin e përkohshëm dhe në bazë të vendimit gjyqësor të të drejtave të caktuara kushtetuese dhe kjo nëse është e domosdoshme për zhvillimin e procedurës penale apo për mbrojtje të vendit.¹⁴¹

¹⁴¹ Shumicën e lëndëve me të cilat inicohet çështja e të drejtave të respektimit të letërkëmbimit e kanë paraqitur të burgosurit. Gjykata konsideron se e drejta e letërkëmbimit të pacensuar me avokatin apo organin gjyqësor është e pacenueshme, si mjet kryesor me anë të të cilit ndonjë person mund të kërkojë lirim nga fajësia (*Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar (1975.)*, *Campbell kundër Mbretërisë së Bashkuar (1992.)*, *Domenichini kundër Italisë (1996.)* dhe *Calogero Diana kundër Italisë (1996.)*).

Neni 36.4

1. Paragrafi i fundit i këtij neni i kushtohet mbrojtjes së të dhënave personale, përkatësisht të dhënave për personin. Kjo e drejtë paraqet një nga të drejtat e reja të mbrojtjes së privatësisë së individit, të cilat Kushtetuta i garanton në me dispozitën parimore (paragrafi 4.). Për përmbajtjen e garancisë mund të gjykohet në mënyrë indirekte në bazë të dispozitave kushtetuese, të cilat e rregullojnë ndalesën apo i referohen rregullimit ligjor të çështjeve të caktuara. Po ashtu, Kushtetuta përcakton se vetëm me ligj mund të rregullohet grumbullimi, mbajtja, qasja, përmirësimi dhe shfrytëzimi i të dhënave për personin (paragrafi 4.). Çështjet që i rregullon ligji një për një janë numëruar dhe, shikuar me rreptësi, kjo nuk lë mundësi që ligji të rregullojë edhe çështje të tjera. Ndërkaq, me rastin e vënies në dukje të materies që e rregullon ligji, Kushtetuta e ka mënjanuar një çështje të rëndësishme. Kështu, për shkak të rëndësisë së mbrojtjes së privatësisë, ajo do të mund të rregullohej me ligj, e kjo është mbrojtja e të dhënave për personin. Referimi ndaj dispozitave parimore kushtetuese, të cilat i rregullojnë kufijtë dhe suazat e veprimtarisë ligjdhënëse në fushën e të drejtave të njeriut (neni 21 dhe neni 22).
2. Përveç garancisë së përgjithshme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, sipas së cilës çdokush ka të drejtën e mbrojtjes nëse i është shkelur apo mohuar ndonjë e drejtë apo liri themelore, Kushtetuta, veçanërisht me nenin 54, e garanton mbrojtjen gjyqësore të së drejtës, sipas së cilës çdokujt veçmas ia garanton të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes apo të mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë. Po ashtu, me dispozitat e këtij neni i garantohet çdokujt e drejta e masave efikase juridike, nëse konstatohet se e drejta është shkelur. Kushtetuta nuk e përmend shprehimisht ndalesën që të dhënat personale të shfrytëzohen për qëllime të tjera, përveç për qëllime për të cilat janë mbledhur, kjo nënkuptohet. Nga kjo rregull themelore janë parashikuar përjashtime për shkak të nevojave që kërkon zhvillimi i procedurës penale dhe mbrojtja e sigurisë së vendit.
3. Për shkak të rëndësisë së kësaj problematike, që ka të bëjë me mbrojtjen e të dhënave personale, është nxjerrë Ligji i veçantë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (i miratuar në Kuvend, më 29.04.2010 dhe është shpallur me Dekretin e Kryetarit të Republikës së Kosovës nr. DL-020-2010, më 13.05.2010). Kushtetuta e Republikës së Kosovës vetëm me një dispozitë të përgjithshme e përcakton të drejtën e secilit njeri, (pra, edhe shtetas edhe të huaj) për mbrojtjen e të dhënave personale. Ndërkaq, përpunimin konkret të kësaj dispozite kushtetuese, Kushtetuta ia beson ligjit, me të cilin më për së afërmi rregullohet mbledhja, mbajtja, qasja, përmirësimi dhe shfrytëzimi i të dhënave të tilla për personin. Vet termi “të dhëna personale” nënkupton çdo informacion lidhur me personin e identifikuar apo të paidentifikuar (subjekt i të dhënave); personi i identifikuar është person që mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, veçanërisht në bazë të numrit identifikues apo të një a më shumë faktorëve, veçanërisht për identitetin e tij apo të saj fizik, psikologjik, mental, ekonomik, kulturor apo shoqëror (neni 2. paragrafi 1. pika 1.).

4. Subjektet e të dhënave gëzojnë mbrojtjen ligjore, kështu që ata që mësojnë se të drejtat e tyre të garantuara janë shkelur, mund të kërkojnë mbrojtje ligjore për atë kohë deri sa zgjat shkelja e tillë (neni 26. paragrafi 1.). Poashtu, me ligjin e përmendur është përcaktuar edhe mbrojtja institucionale e të dhënave personale, me formimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 29.), e cila është e pavarur në punën e saj dhe është e obliguar ta bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të mbrojtjes së të dhënave. Anëtarët e saj veprojnë në mënyrë të pavarur dhe për punën e tyre i përgjigjen Kuvendit të Kosovës.

Neni 37 [E Drejta e Martesës dhe Familjes]

- (1) Në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin.
- (2) Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohen me ligj dhe bazohen në barazinë e bashkëshortëve.
- (3) Familja gëzon mbrojtje të veçantë të shtetit, në mënyrën e rregulluar me ligj.

Neni 37

1. Numri më i madh i kushtetutave martesën nuk e konsiderojnë as si fshehtësi, as si të shenjtë, por si një institucion të dobishëm shoqëror, të cilin e mbrojnë veçanërisht. Familja lind nga martesa, po ashtu, edhe fëmijët. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, përcakton të drejtën e lidhjes martesore me dispozitën që meshkujt dhe femrat e moshës së caktuar kanë të drejtë të martohen dhe të themelojnë familje në pajtim me ligjet e brendshme, të cilat e përcaktojnë realizimin e kësaj të drejte.¹⁴²

Neni 37.1

1. irinë e vendosjes për lidhje të martesës e përcaktojnë dy dispozita të paragrafit 1. të nenit 37. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.¹⁴³ Njëra dispozitë, në mënyrë të përgjithshme (“çdokush ka të drejtë”), i definojnë subjektet që e gëzojnë këtë të

¹⁴² Gjykata Evropiane ka shqyrtuar një numër relativisht të vogël të lëndëve në të cilat objekt ankese ka qenë shkelja e të drejtave të lidhjes martesore dhe të themelimit të familjes. (*Xhonsón dhe të tjerët kundër Irlandës (1986.)*).

¹⁴³ Shih lëndën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KI63/09. Në këtë rast gjykata nuk ka gjetur shkelje të së drejtës martesore dhe të të drejtave të tjera familjare. Pra, paraqitësi i kërkesës është ankuar, përveç tjerash, se pushteti suedez ia ka shkelur të drejtën martesore dhe familjare për shkaqe raciste. Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me vendime të pushtetit publik në një shtet të tretë, Gjykata ka gjetur se lënda është e palejueshme *ratione materiae*. Krahaso: Aktvendimi për palejueshmëri i datës 17 gusht 2011 me rastin nr.KI63/09 (*Paraqitësi Bajram Santuri. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Komonale në Prizren C. nr. 368/2000, nga data 8 maj 2013, aktgjykimet e Gjykatës Supreme në Prizren Rev. 46/2005 C. nr. 99/07, nga data 28 dhjetor 2006, si dhe vendimi i gjykatave në Suedi nr. 8329/06 dhe 9095/07 i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*).

drejtë. Dispozita e dytë precizon se subjekte e të drejtës së lidhjes së martesës janë bashkëshortët, të cilët në bazë të zgjedhjes së lirë të tyre (të shprehjes së lirë të pranimit) lidhin martesën. Këtu duhet të theksojmë se zgjidhja kushtetuese është kundërtë. Kështu, e njëjta çështje, pra subjektet të cilave Kushtetuta ua garanton lirinë e vendosjes për lidhje të martesës, janë përcaktuar në mënyra të ndryshme, prandaj në praktikë kjo mund të shkaktojë probleme. Për çka është fjala? Rregulla e përgjithshme kushtetuese, me të cilën fillon paragrafi 1, ia lejon mundësinë secilit që të lidhë martesë dhe ia garanton lirinë e vendosjes për lidhje të martesës. Ndërkaq, në tekstin vijues të këtij paragrafi shkruan se martesë lidhet në bazë të “zgjedhjes së lirë të bashkëshortëve”. Përveç lirisë së vendosjes për liri të martesës, Kushtetuta garanton edhe të drejtën e themelimit të familjes në pajtim me ligjin.

Neni 37.2

1. Për shkak të rëndësisë që ka martesë dhe raportet në martesë dhe familje, Kushtetuta parashikon që ato të rregullohen me ligj. Kështu, paragrafi 2. neni 37. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës i referohet rregullimit ligjor të lidhjes dhe të zgjedhjes së martesës, kështu që këtë problematikë në mënyrë mjaft të hollësishme e rregullon Ligji i përmendur i Kosovës për Familjen, sipas të cilit meshkujt dhe femrat, pas asnjë kufizim në pikëpamje të racës, nacionalitetit apo fesë, kanë të drejtën e lidhjes së martesës dhe të krijimit të familjes dhe janë të barabartë në lidhjen e martesës, gjatë kohës së zgjatjes së martesës dhe me rastin e zgjedhjes së martesës.
2. Në Republikën e Kosovës është e lejuar martesë civile. Kushtetuta nuk e parashikon në mënyrë eksplicite që martesë të lidhet para organit shtetëror, por Ligji i Kosovës për Familjen, përcakton që personat që kanë qëllim të lidhin martesë duhet t’i paraqesin kërkesë për lidhje të martesës ofiqarit të Kuvendit të Komunës (neni 25. paragrafi 1.), që do të thotë se martesë lidhet para organit shtetëror. Sipas Ligjit të përmendur, martesë është bashkësi e regjistruar ligjore ndërmjet dy personave të gjinive të kundërta, nëpërmjet së cilës ata lirisht vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes.
3. Ajo që është me rëndësi për analizën e këtij neni, është fakti se martesë bazohet në barazinë e bashkëshortëve (paragrafi 2.). Këtë dispozitë më tutje e përpunon Ligji i Kosovës për Familjen, i cili thekson se në martesë, në të gjitha raportet personale dhe pasurore, bashkëshortët janë të barabartë (neni 42. paragrafi 1.). Prandaj, parimi i barazisë së bashkëshortëve garantohet jo vetëm në rastin e lidhjes së martesës, por edhe gjatë kohës së zgjatjes së martesës, si dhe me rastin e zgjedhjes së martesës.
4. Kushtetuta në tekstin e saj nuk thekson se bashkësia jashtëmartesore është e barabartë me martesën. Ndërkaq, këtë çështje e rregullon Ligji i përmendur, i cili në nenin 39. paragrafi 2. përcakton që bashkësia faktike (bashkësia jashtëmartesore) është e barabartë me statusin martesor, nga aspekti i të drejtave dhe

obligimeve të përkujdesjes, të përkrahjes reciproke financiare dhe të të drejtave pasurore. Bashkësia faktike (bashkësia jashtëmartesore) paraqet raportin faktik ndërmjet mashkullit dhe femrës që jetojnë në çift, në jetesë të përbashkët që ka karakter të stabilitetit dhe të vazhdimësisë (neni 39. paragrafi 1.).⁵ Është fakt se kushtetutat bashkëkohore përpiqen t'ia mundësojnë shtetit që ai dispozitat për martesën dhe familjen t'i nxjerrë vetë, që ai t'i vendosë rregullat për atë se çka konsiderohet martesë, për kushtet e lidhjes së martesës, për pengesat martesore, për të drejtat dhe obligimet e bashkëshortëve, për prishjen e martesës, për pasojat e prishjes së martesës, për mbrojtjen e familjes, edukimin e fëmijëve e të tjera. Rregullimin më të përafërt të këtyre raporteve, kushtetutat ua lënë ligjeve përkatëse, ndërsa organet dhe institucionet e tjera mund të marrin pjesë në tërë këtë, natyrisht, vetëm nëse normat shtetërore i autorizojnë lidhur me këtë.

Neni 37.3

1. Duke pasur parasysh tërë këtë, përkatësisht se si ka qenë situata gjatë historisë dhe si është gjendja në praktikën kushtetuese krahasuese, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në paragrafin 3 të nenit 37, në mënyrë të përpiktë përcakton që familja gëzon mbrojtje të veçantë shtetërore sipas mënyrës së parashikuar me ligj. Konkretizimin e kësaj dispozite Kushtetuta ia lë Ligjit të Kosovës për Familjen, i cili detajisht merret me rregullimin e kësaj materie jashtëzakonisht të rëndësishme dhe të ndjeshme dhe i cili, prandaj, i kushton shumë më tepër hapësirë mbrojtjes së familjes.
2. Sa i përket barazisë ndërmjet mashkullit dhe femrës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹⁴⁴ nuk ka ndonjë dispozitë parimore të karakterit të tillë, por në nenin 14 ndalon çdo dallim të bazuar në dallim të gjinive, ndërsa parimi i barazisë së bashkëshortëve në pikëpamje të të drejtave dhe të përgjegjësive të tyre në martesë i është shtuar Konventës nëpërmjet dispozitës së Protokollit nr. 1. Në kuadër të Këshillit të Evropës janë miratuar shumë dokumente me qëllim të krijimit sa më të plotë dhe më të gjerë të barazisë së gjinive. Karta Evropiane Sociale, e reviduar më 1996, siguron një varg të drejtash për femra, si nëna dhe punëtore.

Neni 38 [Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë]

- (1) Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, është e garantuar.
- (2) Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë ngërthen të drejtën për të pranuar dhe për të manifestuar fenë, të drejtën për të shfaqur bindjet personale dhe të drejtën për të pranuar ose refuzuar për të qenë anëtarë i një bashkësie ose grupi fetar.

¹⁴⁴ Krahaso: Frowein, J., Peukert, W., (1985), 'Europäische Menschenrechtskonvention: EMRK - Kommentar', Kehl am Rhein/Strassbourg/Arlington

- (3) **Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohet, në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, që të marrë pjesë në praktikimin e fesë si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij/saj.**
- (4) **Liria e manifestimit të fesë, e besimit dhe e ndërgjegjes mund të kufizohet me ligj, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë dhe rendit publik, të shëndetit, ose të të drejtave të personave të tjerë.**

Neni 38

1. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut çdo njeriu ia garanton të drejtën e mendimit, të ndërgjegjes dhe të besimit fetar (neni 9.). Kjo e drejtë e përfshin lirinë e ndërrimit të fesë apo të besimit dhe lirinë e njeriut që, vetë apo së bashku me të tjerët, publikisht apo privatisht, ta manifestojë fenë e vet apo besimin nëpërmjet lutjes, predikimit, zakoneve apo ceremonive. Natyrisht, edhe liria e manifestimit të fesë apo bindjes, si edhe një varg të drejtash të tjera, mund t'u nënshtrohet kufizimeve të caktuara, por ato mund të jenë vetëm ato kufizime, që janë parashikuar me ligj dhe që janë të domosdoshme në shoqërinë demokratike, në interes të sigurisë publike, me qëllim të mbrojtjes së rendit publik, të shëndetit apo të moralit, apo të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Prandaj, Konventa Evropiane është garantuese e secilit për lirinë e mendimit, të ndërgjegjes dhe të besimit.¹⁴⁵
2. Në kushtetutat e demokracive kushtetuese detyrimisht garantohet e drejta e qytetarëve për shprehje të lirë të besimeve të tyre fetare apo të shprehin bindjet e tyre ateiste apo që fare të mos deklarohen për raportin e tyre ndaj fesë. E vështruar në kuptimin negativ, liria e shprehjes së besimit përjashton çdo obligim të qytetarëve që ta pranojnë religjionin e caktuar dhe pranimin e dogmës së tij. Liria e besimit fetar është në kundërshtim me obligimin e njeriut që të pranojë “dogmat e religjionit zyrtar”.
3. Shikuar gjatë historisë, obligimi fetar një kohë të gjatë ka qenë i përcjellë me dënime të vrazhda, torturë fizike dhe likuidime të tmerrshme. Periudha e tolerancës fetare në Evropë fillon me reformën, kur gradualisht fitohet e drejta e njeriut që lirisht ta zgjedhë dhe ta ndërrojë qëndrimin ndaj religjionit, kështu që sot, në shumicën e shteteve, me kushtetutë është përcaktuar liria e shprehjes së besimit. Rasti i këtillë, madje, është edhe në të ashtuquajturat shtete konfesionale, përkatësisht në shtetet në të cilat shprehja e besimit ka status të privilegjuar, kur shteti, megjithatë, ua njeh qytetarëve të drejtën formale që t'i përkasin apo të mos i përkasin religjionit shtetëror.

¹⁴⁵ Gjatë disa viteve të kaluara, Gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 9 në situatat kur shteti ka intervenuar në organizimin e punëve të brendshme të grupeve fetare. Në lëndët *Serif kundër Greqisë (1999)* dhe *Agga kundër Greqisë (nr. 2.) (2002.)*, për shembull, paraqitësit janë gjykuar për veprë penale “uzurpim i funksionit të zyrtarit fetar të fesë së pranuar dhe të mbajtjes publike të rrobës së tillë të zyrtarit fetar”. Në ato lëndë, paraqitësit në bashkësitë e tyre kanë qenë të zgjedhur për Myfti. Ndërkaq, Qeveria në të njëjtin funksion ka emëruar persona të tjerë.

4. Liria e shprehjes së besimit nënkupton që çdo qytetar lirisht mund t'i përkasë cilësdo fe, që besimin e tij mund ta përshtatë sipas mësimëve të cilësdo fe, jo vetëm të pranuar, por edhe të papranuar. Liria e ndërgjegjes nënkupton që qytetari nuk është i lidhur me mësimet e cilësdo fe në çështjet themelore të shikimit të botës. Ai mund të mos e pranojë cilëndo pikëpamje për dukuritë në kozmos, por që të ketë pikëpamje të vet personale. Praktikisht, kjo do të thotë se ai mund të mos i përkas asnjë feje, sepse ateizmi është juridikisht i mundshëm. Numri më i madh i shkrimtarëve me lirinë e shprehjes së besimit dhe të ndërgjegjes nënkupton lirinë e shprehjes së pikëpamjes fetare shprehjes së qëndrimit të tij për çështjet fetare. Posa të kuptohet në këtë mënyrë liria e shprehjes së besimit, atëherë në mënyrë plotësisht logjike vjen dispozita vijuese që “gëzimi i të drejtave civile dhe politike është i pavarur nga shprehja fetare”. Sikur kjo të mos ishte kështu, nuk do të mund të flitej as për barazi të qytetarëve. Kështu, të privilegjuarit apo mospërfillja e pjesëtarëve të një feje do të shkaktonte pabarazi të qytetarëve për shkak të besimeve të ndryshme apo të shikimit të botës. Prandaj, dallimi në religjion, besimi fetar apo shprehja e besimit fetar nuk bën të jetë pengesë për asnjë pjesëtar të shoqërisë në shfrytëzimin e të drejtave civile dhe politike, e veçanërisht për pranim në shërbimet publike, tituj dhe nderime apo për kryerje të profesioneve të ndryshme.
5. Natyrisht, duke pasur parasysh se shprehja fetare nuk mund t'i japë të drejtë pushtetit shtetëror për trajtim të pabarabartë të qytetarëve, po ashtu as qytetari nuk mund t'i japë të drejtë vetes që të vihet në një situatë më të volitshme vetëm sepse i takon ndonjë feje tjetër.¹⁴⁶ Për këtë arsye numri më i madh i kushtetutave, në mënyrë plotësisht konsistente, parashikon që askush nuk mund të lirohet nga obligimet e tij shtetërore, duke iu referuar besimit të tij fetar apo rregullave të fesë së vet. E drejta e shprehjes së lirë fetare nuk shkon deri atje që mësimet fetare të vihen mbi dispozitat ligjore pozitive. Në atë rast nuk do të mund të arrihej barazia para ligjit. Liria e shprehjes së besimit nënkupton lirinë e plotë të shprehjes së besimit fetar, por nuk nënkupton formimin e pozitës së individit në shoqëri sipas rregullave fetare, e në kundërshtim me dispozitat shtetërore. Veprimet e jashtme të besimtarëve, po ashtu, mund të kryhen sipas mësimëve fetare, nëse ata nuk janë në konflikt me ligjet pozitive. Nëse ligjet urdhërojnë një sjellje, ndërsa feja një tjetër, qytetari duhet tu nënshtrohet urdhërësave të shtetit.¹⁴⁷

¹⁴⁶ Shih lëndën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KI36/11. Në pikat 69-78 gjykata detajisht ka elaboruar që të drejtat fetare nuk mund të jenë bazë për rrëzimin e themeleve sekulare të shtetit dhe të shoqërisë në Republikën e Kosovës. Krahaso: Aktvendimi për palejueshmëri i datës 30 shtator 2011 në rastin nr. KI36/11 (*Paraqitëse e kërkesës, Arjeta Halimi. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të aktgjykimit nr. 24/09, nga data 17 nëntor 2009 i Gjykatës së Qarkut në Gjiilan për kinse shkëljen e të drejtave të njeriut të paraqitësit të kërkesës*).

¹⁴⁷ Për shembull, dispozitat fetare thonë “mos vrit”, ndërsa rregullat luftarake mësojnë se si të vritet armiku më lehtë. Këto rregulla të luftës, dhe jo dispozitat fetare, i obligojnë qytetarët.

Neni 38.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 38. paragrafi 1. garanton lirinë e shprehjes së besimit, të bindjes dhe të ndërgjegjes, si një nga liritë më të rëndësishme shpirtërore. Kjo do të thotë se askush nuk është i obliguar që të deklarohej për bindjet e veta fetare apo të tjera. Në këtë mënyrë mbrohet e drejta e individit që në mënyrë të lirë ta zgjedhë bindjen e vet, përkatësisht pikëpamjen e vet ndaj botës. Kjo e drejtë është e garantuar edhe me Ligjin për Liritë Fetare në Kosovë (zbatohet së bashku me Rregulloren e UNMIK-ut për shpalljen e tij nr. 2006/48, të datës 24.08.2006), i cili përcakton që çdo person e ka të drejtën e mendimit, besimit dhe të fesë. Kjo e drejtë përfshin të drejtën e zgjedhjes së individit që të ketë fe apo jo, përkatësisht që të jetë besimtar apo ateist, që ta mbajë apo ndërrojë fenë e vet, qoftë si person apo në bashkësi me të tjetër, publikisht apo privatisht (neni 1. paragrafi 1.).

Neni 38.2

1. Kushtetuta nuk e parashikon veçanërisht përmbajtjen e garancive që përfshijnë liritë e ndërgjegjes dhe të besimit. Republika e Kosovës është shpallur si shtet laik, gjë që në mënyrë të theksuar thuhet në nenin 8 të Kushtetutës, ndërsa dispozita e nenit 39 në mënyrë edhe më të detajuar precizon që bashkësitë fetare janë të ndara nga shteti, sepse sipas paragrafit 1, Republika e Kosovës siguron dhe mbron autonominë e të gjitha bashkësive fetare brenda territorit të saj, ndërsa bashkësitë fetare janë të lira që në mënyrë të pavarur ta rregullojnë organizimin e tyre të brendshëm. Nga konteksti i përgjithshëm i paragrafit 2 mund të përmenden disa garanci kushtetuese, të cilat në masën më të madhe kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes së besimit dhe me të drejtat lidhur me këtë, ndër të cilat janë:
 - 1) e drejta e pranimit të fesë së vet;
 - 2) e drejta e manifestimit të fesë së vet;
 - 3) e drejta e manifestimit të bindjeve personale;
 - 4) e drejta e pranimit apo mospranimit të anëtarësisë në ndonjë bashkësi fetare apo grup.
2. Siç mund të shihet, liria e ndërgjegjes dhe besimit përmendet në të katër paragrafët e nenit 38, prandaj ajo meriton që për të, të thuhet diçka. Në të vërtetë, e drejta e ndërgjegjes është një formë më e ngushte e lirisë së përcaktimit të njeriut, lirisë së shpirtit dhe nënkupton të drejtën e njeriut për integritet të brendshëm moral. Njeriu është i lirë t'i manifestojë ndjenjat e veta, qëndrimet dhe pikëpamjet pa marrë parasysh autoritetet shpirtërore, ideologjike, të cilat në këtë mënyrë i kundërshton (së pari institucioni fetar, pastaj edhe shteti). Njerëzit janë të lirë vetëm nëse mund të veprojnë sipas ndërgjegjes së tyre, në pajtim me bindjet e veta.
3. Ndërgjegjja është kategori e lirisë shpirtërore dhe si e tillë nënkupton ekzistimin e vetëdijes për atë që, në pikëpamje morale, është një sjellje, jo vetëm e drejtë, por edhe obliguese. Esencës së lirisë së ndërgjegjes dhe të besimit i përgjigjet edhe e drejta e njeriut që në mënyrë të pavarur ta zgjedhë "pikëpamjen për botën" në

cilëndo sferë të jetës (jo vetëm religjioze dhe politike). Liria e ndërgjegjes dhe e bindjes më parë ka qenë e lidhur, para së gjithash, me religjionin, ndërsa sot nënkupton, në rend të parë, mohimin e ideologjisë zyrtare shtetërore, (e cila, në masë të madhe, e ka marrë rolin e mëparshëm të fesë).¹⁴⁸ Prandaj, kushtetutat bashkëkohore gjithnjë e më shumë kanë kujdes për atë që njeriu shpesh vjen në kundërshtim me ndërgjegjen e vet, prandaj konfliktin ndërmjet bindjes dhe obligimit zyrtar, ata e zgjidhin me pranimin (në rastin konkret) e kundërshtimit të ndërgjegjes, për shembull, refuzimi i shërbimit ushtarak me armë, refuzimi i mjekut për ndërprerje të shtatzënisë e të tjera.¹⁴⁹

Neni 38.3

1. Kushtetuta, me një formulim të përgjithshëm, e garanton lirinë e shprehjes së besimit, të bindjes dhe të ndërgjegjes, të drejtën për të mbetur pranë qëndrimeve apo shprehjes së besimit të vet apo që këto të ndërrohen sipas zgjedhjes personale. Kështu, paragrafi 3. i nenit 38. përcakton që askush nuk mund të detyrohet dhe as nuk mund t'i ndalohet që në kundërshtim me bindjet e veta, të marrë pjesë në manifestimin e fesë dhe propagandimin publik të fesë dhe të bindjes së vet. Kjo do të thotë se askush nuk mundet që, në kundërshtim me vullnetin dhe bindjen e vet, në çfarëdo mënyre të detyrohet që ta manifestojë fenë dhe bindjen e vet. Po ashtu, në asnjë mënyrë individit nuk mund t'i ndalohet që, nëse ai këtë e dëshiron, ta manifestojë dhe publikisht ta propagandojë bindjen dhe besimin e vet fetar. Me kushtetutë është e mbrojtur si shprehja private, ashtu edhe shprehja publike e bindjeve fetare.
2. Liria e shprehjes fetare i përket, ekskluzivisht, raportit të individit dhe të bashkësisë fetare ndaj shtetit dhe garancia e kësaj lirie nënkupton që ajo nuk mund të rrezikohet apo nënçmohet nga askush. Pikërisht për këtë shteti është i obliguar që ta mbrojë lirinë e shprehjes fetare nga sulmet e personave të tretë. Prandaj, si e drejtë njerëzore, e drejta e shprehjes fetare është e garantuar si ajo pozitive, ashtu edhe negative. Secili është i lirë që ta manifestojë fenë e vet, përkatësisht askush nuk është i obliguar që të deklarohet për bindjet e veta fetare dhe të tjera. Duke i konkretizuar dispozitat kushtetuese që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes së besimit, të bindjeve dhe të ndërgjegjes, Ligji për Liritë Fetare në Kosovë e siguron mbrojtjen nga diskriminimi me dispozitën që askush nuk mund të jetë i diskriminuar apo i privilegjuar në çfarëdo mënyre, në bazë të bindjes fetare, përkatësisë apo mospërkatësisë së ndonjë bashkësie fetare (neni 2. paragrafi 1.). Poashtu, si pjesë përbërëse e kësaj mbrojtjeje, Ligji i përmendur parashikon që

¹⁴⁸ Krijuesit e ideologjive të tilla shtetërore kanë pasur pretendime të qarta që ato të jenë gjithëpërfshirëse, prandaj ideologjitë e këtylla shtetërore, me të drejtë, quhen “sekulare, përkatësisht religjione laike” (për shembull, një nga to ka qenë ideologjia komuniste e ish-shteteve socialiste). Ndërkaq, qëndrimi i sotëm i shtetit liberal distancohet nga ky pretendim dhe e pranon pluralizmin e ideve për qasje kësaj çështjeje, përkatësisht në çështjet sekulare/laike.

¹⁴⁹ Zink, H., (1962), ‘*Modern Governments*’, D. Van Nostrand Company Inc.: New York; Strong, C.F., (1963), ‘*Modern Political Constitutions*’ Putnam: London dhe Wheare, K.C., (1966) ‘*Modern Constitutions*’, Oxford University Press: USA.

askush nuk duhet të pengohet apo të obligohet që të marrë pjesë në ceremonitë fetare apo forma të tjera të manifestimit të besimit religjioz (neni 2. paragrafi 2.).

3. Liria fetare e tejkalon lirinë e ndërgjegjes dhe përfshijnë përmbajtje të tilla rregullative, që nuk kanë për qëllim që të tjerëve t'u kumtohet bindja personale fetare. Ajo përfshin edhe veprimet të cilat, sipas pikëpamjes së bashkësisë së caktuar fetare, u takojnë obligimeve të besimtarëve të vet. Duke u nisur nga kjo, Kushtetuta ia garanton secilit lirinë që fenë apo bindjen e vet ta manifestojë nëpërmjet shprehjes fetare, kryerjes së ceremonive fetare, ndjekjes së shërbimit apo mësimit fetar.

Neni 38.4

1. Këtu është mjaft me rëndësi që, me rastin e analizës së këtij neni, kujdes i caktuar t'i kushtohet kufizimit të lirisë së përmendur. Pra, paragrafi 4. i nenet të përmendur përcakton që liria e shprehjes fetare, e bindjes dhe e ndërgjegjes, përkatësisht liria e shprehjes së fesë dhe e bindjeve personale, mund të kufizohet me ligj. Theksi vihet në manifestimin e lirisë së bindjes dhe të shprehjes fetare, por Kushtetuta nuk e precizon në hollësi se si manifestohet kjo shprehje, (për shembull, a është ky manifestim publik i fesë dhe bindjes apo është fjala për të gjitha format e manifestimit fetar dhe të bindjes?). Shkaqet që lejojnë kufizimin dhe kushtet në të cilat ky kufizim është i lejuar, i parashikon Kushtetuta.
2. Kufizimet e manifestimit të lirisë fetare dhe të bindjes, janë të lejueshme vetëm nëse kjo është e domosdoshme me qëllim të mbrojtjes së:
 - 1) sigurisë;
 - 2) rendit publik;
 - 3) shëndetit;
 - 4) të drejtave të të tjerëve.
3. Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në këtë Kushtetutë, mund të parashikohet vetëm me ligj (neni 55. paragrafi 1. i Kushtetutës) dhe ky për vëllimin me të cilin Kushtetuta e lejon rregullimin ligjor dhe kufizimin e të drejtave të njeriut (neni 55. paragrafi 2.). Liria e manifestimit të fesë apo besimit personal mund t'u nënshtrohet vetëm atyre kufizimeve, të cilat janë parashikuar me ligj dhe që janë të domosdoshme për shoqërinë demokratike, në interes të sigurisë, për mbrojtje të rregullimit publik, të shëndetit dhe të moralit dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të të tjerëve (neni 1. paragrafi 3. i Ligjit për Liritë Fetare në Kosovë). 4. Prandaj, kjo mundësi e kufizimit të lirisë së shprehjes fetare, bindjeve dhe ndërgjegjes, është parashikuar jo vetëm me Kushtetutë, por edhe me ligj. Për këtë arsye, këtu parashtrohet një pyetje e arsyeshme lidhur me mënyrën me të cilën Kushtetuta e rregullon kufizimin e kësaj lirie kushtetuese. Në të vërtetë, liria e shprehjes fetare, e bindjes dhe e ndërgjegjes bën pjesë në kuadër të të drejtave absolute të mbrojtura dhe kjo është e përjashtuar nga regjimi i shmangies në gjendje të jashtëzakonshme (neni 56. paragrafi 2.), por tash mbetet i paqartë raporti ndërmjet dispozitës kushtetuese, e cila e ndalon shprehimisht shmangien

nga neni 38, përkatësisht nga liria e shprehjes fetare, e besimit dhe ndërgjegjes (këtë ndalesë absolute e garanton neni 56. paragrafi 2.) dhe, nga ana tjetër, po ashtu, dispozita e përmendur kushtetuese (neni 38. paragrafi 4.), që lejon kufizimin e kësaj lirie në rrethana të rregullta për shkaqet e përmendura në Kushtetutë. Për këtë arsye shtrohet pyetja se a është e mundur që në rrethana të rregullta të kufizohen liritë nga të cilat nuk lejohet shmangia as në gjendje të jashtëzakonshme.

Neni 39 [Konfesionet Fetare]

- (1) Republika e Kosovës siguron dhe mbron autonominë fetare dhe monumentet fetare brenda territorit të saj.**
- (2) Konfesionet fetare janë të lira që të rregullojnë pavarësisht organizimin e vet të brendshëm, veprimtaritë fetare, si dhe ritet fetare.**
- (3) Konfesionet fetare kanë të drejtë të themelojnë shkolla fetare dhe institucione bamirëse në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligj.**

Neni 39

1. Ky nen e parashikon sigurimin dhe mbrojtjen e autonomisë së të gjitha bashkësive dhe monumenteve fetare në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Poashtu, kujdes i veçantë i kushtohet rregullimit të pavarur të organizimit të brendshëm të bashkësive fetare, të cilat janë të lira t'i kryejnë veprimtaritë e tyre fetare dhe ritualet fetare përkatëse. Që të mund t'i realizojnë të gjitha këto të drejta të tyre, bashkësive fetare me dispozita kushtetuese u garantohet edhe e drejta që lirisht të themelojnë shkolla fetare dhe organizata humanitare, natyrisht, krahas respektimit dhe në pajtim me dispozitat që përmban kjo Kushtetutë, si dhe në pajtim me normat përkatëse ligjore.

Neni 39.1

1. Lidhur me lirinë e shprehjes fetare, Kushtetuta i rregullon edhe çështjet më të rëndësishme lidhur me statusin e bashkësive fetare, duke theksuar se Republika e Kosovës e siguron dhe mbron autonominë e të gjitha bashkësive fetare, të përmendoreve të tyre, të simboleve dhe të të gjitha shenjave lidhur me ruajtjen e identitetit të tyre (neni 39. paragrafi 1.). Lidhur me parimin e laicitetit të shtetit dhe duke u nisur nga ai, Kushtetuta parashikon që bashkësitë fetare janë të lira që në mënyrë të pavarur ta rregullojnë organizimin e tyre të brendshëm, veprimtarinë fetare dhe ritualet fetare (neni 39. paragrafi 2.), duke theksuar më parë dispozitat për autonominë e këtyre bashkësive fetare.
2. Ajo që është me rëndësi të theksohet këtu është përpunimi i mëtejshëm i dispozitave kushtetuese nëpërmjet ligjeve. Këtu, para së gjithash mendojmë për Ligjin për Liritë Fetare në Kosovë, i cili në nenin 3. e përcakton barazinë fetare, me dispozitën që të gjithë personat, pavarësisht nga besimi i tyre, bindja apo përkatësia cilësdo bashkësi fetare, janë të barabartë para ligjit dhe i kanë të njëjtat të drejta në

jetën e tyre civile, politike, ekonomike, sociale dhe shoqërore. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë e kanë të drejtën e mbrojtjes para ligjit.

3. Ligji i përmendur për liritë fetare e përcakton neutralitetin fetar, duke theksuar se në Kosovë nuk ekziston asnjë fe zyrtare (neni 5. paragrafi 1.), që do të thotë se nuk ka bazë për formim të religjionit shtetëror. Ndarjen e kishës nga shteti e thekson paragrafi 2. i nenit të përmendur, i cili parashikon që bashkësitë fetare janë të ndara nga organet publike dhe që të gjitha organet publike duhet të kenë kujdes për tolerancë dhe respektim reciprok ndërmjet bashkësive fetare (neni 5. paragrafi 3.). Për pozitën e bashkësive fetare në Kosovë, me rëndësi të veçantë është dispozita që ato i gëzojnë të gjitha të drejtat e garantuara me këtë Ligj. Prandaj, organet publike duhet të kenë dialog të hapur, të rregullt dhe transparent me shoqatat fetare dhe bashkësitë fetare lidhur me çështjet me interes të përbashkët.

Neni 39.2

1. Liria e bashkimit fetar është garantuar me Kushtetutë dhe kjo theksohet në dispozitën e nenin 39 paragrafi 2, e cila bashkësive fetare ua jep lirinë që në mënyrë të pavarur ta rregullojnë organizimin e tyre të brendshëm, lirinë fetare dhe ritualet fetare. Këtë garanci kushtetuese e rregullon më tutje Ligji i përmendur (neni 6. paragrafi 1.), duke theksuar faktin se ndalohet formimi i shoqatës fetare, e cila, sipas emrit apo statutit, sugjeron se është lidhur apo njohur lirisht nga ana e një bashkësie fetare, por nuk e ka pëlqimin e saj.¹⁵⁰

Neni 39.3

1. Kushtetuta ua garanton bashkësive fetare edhe të drejtën e themelimit të shkollave fetare dhe të organizatave humanitare, natyrisht, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin (neni 39. paragrafi 3.). Në këtë vështrim, është e rëndësishme dispozita e nenit 7 e Ligjit për Liritë Fetare në Kosovë, e cila e garanton vetëpërcaktimin dhe vetërregullimin e bashkësive fetare. Sipas këtij ligji, bashkësitë fetare janë të lira që ta përcaktojnë identitetin e tyre fetar, ta rregullojnë dhe zhvillojnë organizimin e tyre të brendshëm dhe lirisht mund të themelojnë dhe të komunikojnë me persona dhe bashkësi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe të formojnë shoqata me bashkësitë dhe grupet e tjera fetare në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në pajtim me dispozitat pozitive ligjore. Prandaj, pushteti shtetëror i pranon bashkësitë fetare dhe ekzistimin e tyre dhe me këto dispozita ligjore ua mundëson funksionimin e papenguar, si dhe i përcakton bazat e rregullimit të tyre të jashtëm, organizimin e tyre. Njësoj si pranimin, shteti edhe këtë funksion e kryen nëpërmjet ligjit. Shteti ua lejon bashkësive fetare që në mënyrë të pavarur t'i rregullojnë punët e tyre të brendshme dhe t'i qeverisin ndihmat dhe fondacionet e tyre, por të gjitha në kuadër të ligjit.

¹⁵⁰ Gjykata konsideron se kisha apo organi tjetër fetar, si i tillë, në emër të pasuesve të vet do të gëzojë të drejtat që ia garanton neni 9. i Konventës. (*Cha'are Shalom Ve Tsedek kundër Francës* (2000.) dhe *Kisha Mitropolitane e Besarabisë dhe të tjerët kundër Moldavisë* (2001.)).

Neni 40 [Liria e Shprehjes]

- (1) Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush.
- (2) Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.

Neni 40

1. Në klasifikimin material të të drejtave të njeriut në të drejta personale, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore,¹⁵¹ të drejtat personale janë edhe liri personale, të cilat në mënyrën më të domosdoshme janë të lidhura me dinjitetin e njeriut, integritetin trupor dhe moral të personalitetit dhe me privatësinë e tij. Ndërkaq, një grup mjaft i rëndësishëm i të drejtave, i cili është i rëndësishëm për zhvillimin dhe respektimin e personalitetit të secilit njeri, janë të drejtat dhe liritë politike. Këto të drejta dhe liri i përfshijnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, të cilat ua mundësojnë qytetarëve pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike dhe ndikimin në edukimin e vullnetit shtetëror. Për këtë arsye kjo kategori e të drejtave themelore të njeriut quhet edhe *e drejtë e pjesëmarrjes apo e drejtë e participimit politik*. Pikërisht, së bashku me të drejtat personale, të drejtat politike janë fitore e demokracisë liberale, por afirmim të plotë e fitojnë vetëm pas krijimit të shtetit demokratik kushtetues në shekullin XX. Në fakt,, këtyre të drejtave shumë gjatë nuk u është njohur karakteri i të drejtave themelore “të vërteta” të njeriut, prandaj edhe sot, në mjaft kushtetuta të shteteve evropiane, ato gjenden jashtë katalogut të të drejtave njerëzore (më së shpeshti në pjesën e kushtetutës për sistemin zgjedhor dhe parlamentin).
2. Të drejtat politike, në kuptim të ngushtë, përfshijnë të drejtën e zgjedhjes,¹⁵² të drejtën e votimit në referendum, të drejtën e themelimit të partive politike, të drejtën e peticionit, të drejtën e kritikës së organeve shtetërore dhe të drejtën e qasjes në shërbimet publike. Të drejtat politike, në kuptim të gjerë, përfshijnë edhe të drejtat të cilat krijojnë parakushte dhe predispozita të domosdoshme për realizimin e të drejtave “të vërteta” politike, për shembull, liria e fjalës dhe e paraqitjes publike, liria e shtypit dhe liria e formave të shprehjes publike, liria e zgjedhjes dhe e tubimit tjetër të qetë etj.
3. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, si një nga të drejtat më të rëndësishme të njeriut, thekson të drejtën e lirisë së

¹⁵¹ Për rëndësinë e të drejtave kulturore më gjerësisht të shihet: Kartag-Odri, A., “Kulturna prava kao ljudska prava“, *Pravni život*, nr. 12, 1996, fq.1065-1075.

¹⁵² Krahaso: Lijphart, Arend (1995), ‘*Electoral Systems and Party Systems: A Study of Twenty-Seven Democracies*’, 1945-1990 Oxford University Press: Oxford,.

shprehjes,¹⁵³ si e drejtë e përgjithshme që i takon çdo njeriu (neni 10. paragrafi 1.).¹⁵⁴ Kjo e drejtë e përfshin lirinë e pasjes së mendimit personal, marrjes dhe dhënies së informatave dhe të ideve pa ndërhyrje të pushtetit publik dhe pa marrë parasysh kufijtë. Natyrisht, shfrytëzimi i këtyre të drejtave tërheq pas vetes edhe disa obligime dhe përgjegjësi të caktuara, prandaj kjo mund t'u nënshtrohet formaliteteve të caktuara, kushteve dhe kufizimeve, madje edhe dënimeve, të parashikuara me ligj dhe të domosdoshme në shoqërinë demokratike.

4. Këto kufizime dhe shmangiet e tjera të përmendura nga e drejta e lirisë së shprehjes, mund të lindin për shkaqe të caktuara, në të cilat bëjnë pjesë:
 - 1) interesi i sigurisë kombëtare, integritetit territorial apo sigurisë publike;
 - 2) pengimi i çrregullimeve apo kriminalitetit;
 - 3) mbrojtja e shëndetit apo moralit;
 - 4) pengimi i zbulimit të informatave të marra në besim;
 - 5) mbrojtja e reputacionit apo e të drejtave të tjerëve;
 - 6) mbrojtja e autoritetit dhe e paanësisë së gjyqësisë.
5. shtë e drejtë e njeriut që lirisht të mendojë dhe që publikisht t'i shprehë mendimet, qëndrimet dhe bindjet e veta. Ai mund të mendojë çfarë të dëshirojë dhe nuk duhet të dënohet apo të shqetësohet për shkak të përmbajtjes së mendimeve të tij (edhe përkundër asaj që ato mendime janë të papranueshme për të tjerët). Në pikëpamje politike-juridike, kërkesa minimale e lirisë së mendimit është që askush nuk duhet të detyrohet që t'i zbulojë mendimet dhe bindjet e veta. Në këtë vend mund ta përdorim lirinë e mendimit dhe lirinë e besimit fetar (për të cilën kemi shkruar drejtpërsëdrejti para këtij teksti, duke analizuar nenin 38 të Kushtetutës). Pra, liria e mendimit, sipas kësaj përmbajtjeje, është dukshëm më e gjerë se liria e shprehjes së besimit, ndërsa sipas veprimit të saj absolut, sepse nuk mund të kufizohet me asnjë kusht (liria e shprehjes fetare, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është liri absolute, nga e cila nuk lejohet shmangia as në gjendje të jashtëzakonshme). Liria e mendimit juridikisht mund të kufizohet vetëm kur bëhet fjalë për manifestim të mendimit, që do të thotë, kur është fjala për shprehje publike të mendimit të vet, e jo për mendimin.
6. Këtu duhet bërë dallimi ndërmjet lirisë së mendimit (kryesisht ka të bëjë me sferën shpirtërore, fetare dhe filozofike) dhe lirisë së të menduarit (më shume ka të bëjë me marrje të qëndrimit për çështje të përgjithshme të shoqërisë dhe politikës). Si edhe ideja, mendimi është proces i brendshëm psikik, por manifestohet në sjelljen dhe veprimin njerëzor. Nëse manifestohet si qëndrim i kundërt politik, atëherë në

¹⁵³ Čok, V., (1995), "Pravo na slobodu izražavanja, javno informisanje i govori mržnje", *Pravni život*, nr. 9, str. 521-536.

¹⁵⁴ Gjykata Evropiane i kushton rëndësi të madhe të drejtës së shprehjes ndërmjet anëtarëve të zgjedhur të organeve ligjdhënëse, duke konsideruar se duhet t'u jepet mbrojtje e gjerë, që të mund të shprehen lidhur me atë që është me interes për votuesit e tyre dhe për opinionin në tërësi. Në këtë vështrim, gjykata ka konkluduar se bëhet fjalë për shkelje të nenit 10 në rastin në të cilin anëtari i parlamentit është gjykuar për fyerje të qeverisë (Castels kundër Spanjës (1992.)).

sistemet totalitare në mënyrë të vrazhdë dënohen dhe ndiqen njerëzit që kanë mendime politike të ndryshme. Prandaj, liria e mendimit dhe e të menduarit kanë kuptim vetëm nëse mund të manifestohen lirshëm në forma të ndryshme të shprehjes publike, të cilat veçanërisht garantohen me dispozita kushtetuese. Nga mënyra e lejitimit të lirisë së shprehjes, del se ajo i garantohet çdokujt ashtu që ka karakter të së drejtës njerëzore. Kjo e drejtë përfshin mundësinë që me anë të të folurit, të shkruarit, me fotografi dhe në mënyrë tjetër, të kërkohen, pranohen dhe përhapen informatat dhe idetë.

Neni 40.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës i garanton të drejtat politike në të njëjtën mënyrë, në të cilën këtë e bëjnë shumica e shteteve evropiane. Në të në mënyrë të veçantë theksohet e drejta e grumbullimit publik dhe bashkimi politik dhe veprimi, që do të thotë e drejta e themelimit të partive politike. Të gjitha të drejtat politike janë të garantuara në pjesën e Kushtetutës për të drejtat dhe liritë themelore (Kapitulli II). Një nga të drejtat më të rëndësishme politike, që është parakusht i realizimit të të gjitha të tjerave, është liria e shprehjes, e garantuar me nenin 40 të Kushtetutës. Pra, liria e të folurit e përfshin të drejtën e shprehjes, komunikimit dhe të marrjes së informatave, të mendimeve dhe të porosive të tjera pa asnjë pengesë. Siç e kemi parë, liria e mendimit duhet dalluar nga liria e të menduarit, e cila, më së shpeshti, garantohet me lirinë e shprehjes. Neni i përmendur 40 në emërtimin e vet nuk përmban lirinë e theksuar të mendimit, por nga teksti kushtetues (paragrafi 1) mund të shihet se Kushtetuta e garanton edhe këtë të drejtë themelore të njeriut, si pjesë përbërëse e lirisë së shprehjes. Në kushtetutshmërinë krahasuese, liria e mendimit garantohet, më së shpeshti, krahas lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë, ndërsa liria e mendimit garantohet krahas lirisë së shprehjes, por edhe si liri e veçantë.
2. Duke përcaktuar më për së afërmi dispozitën kushtetuese për lirinë e shprehjes Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (zbatohet së bashku me Rregulloren e UNMIK-ut për shpalljen e tij nr. 2006/51, të datës 20.10.2006), përcakton që secili person e ka të drejtën e lirisë së shprehjes (neni 3. paragrafi 1.). Kjo e drejtë e përfshin lirinë e marrjes, kërkimit dhe ofrimit të informatave dhe ideve në gjuhën sipas zgjedhjes personale, pa pengesa. Zbatimi i kësaj lirie mund t'u nënshtrohet kufizimeve, të cilat janë në pajtim me marrëveshjet obliguese ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Neni 40.2

1. Nga arsyet e lartpërmendura, kufizimit i nënshtrohet vetëm liria e shprehjes (por jo edhe liria fetare, e bindjes dhe e ndërgjegjes, e cila në vete përfshin lirinë e mendimit). Pra, Kushtetuta e lejon kufizimin ligjor të kësaj lirie (neni 40. paragrafi 2.), të cilën ligji mund ta parashohë në kufijtë dhe vëllimin të cilin e lejon Kushtetuta në parimet e përgjithshme (neni 21.). Shkaqet që mund të jenë bazë e kufizimit të lirisë së shprehjes, i përcakton kushtetuta në mënyrë taksative. Do të

thotë, ky kufizim është i mundshëm, vetëm nëse kjo është e domosdoshme për pengimin e nxitjes dhe të provokimit të dhunës dhe të armiqësisë në bazë të urrejtjes racore, nacionale, etnike apo fetare. Në kushtetutshmërinë krahasuese, kufizimi i lirisë së shprehjes ndërmerret edhe për shkaqe të tjera,¹⁵⁵ siç janë, p.sh.:

- 1) mbrojtja e të drejtave dhe reputacionit të të tjerëve;
 - 2) ruajtja e autoritetit dhe e paanësisë së gjyqit;
 - 3) mbrojtja e shëndetit publik;
 - 4) mbrojtja e moralit të shoqërisë demokratike;
 - 5) mbrojtja e sigurisë kombëtare etj.
2. Edhe pse Kushtetuta e Republikës së Kosovës si shkaqe që mund të jenë bazë për kufizimin e lirisë së shprehjes, nuk i ka theksuar të gjitha shkaqet që hasen në kushtetutshmërinë krahasuese, është e sigurt se në rastin e paraqitjes së tyre, duhet të vijë deri te kufizimi i lirisë së shprehjes. Sigurisht që këtë çështje do ta definojë më për së afërmi ndonjë nga ligjet e ardhshme që do të nxirren lidhur me këtë materie.
- Lidhur me shkaqet e kufizimit të lirisë së shprehjes, më shumë në komentet përkatëse me nenet 35, 36, 38, 39, 42, 43 dhe 44.

Neni 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike]

- (1) Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.**
- (2) Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.**

Neni 41

1. Me këtë nen përcaktohet një e drejtë, relativisht e re, por mjaft e rëndësishme, e cila ia mundëson çdo personi që të ketë qasje në të gjitha dokumentet publike, që gjenden në posedim të organeve publike dhe shtetërore. Kjo do të thotë se këto dokumente janë transparente, përkatësisht publike dhe që qytetarët e kanë të drejtën e qasjes në to, duke përjashtuar ato dokumente, shikimi i të cilave për qytetarët është i kufizuar me ligj. Ky kufizim i shikimit të dokumenteve publike mund të bëhet vetëm për mbrojtje të privatësisë, ruajtje të sekretit afarist apo të informatave sekrete.

Neni 41.1

1. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 41. paragrafi 1.) në mënyrë të veçantë është garantuar e drejta e secilit person për qasje në dokumentet publike,

¹⁵⁵ Për këtë, të shihet më gjerësisht: Wolf-Philips, L., “Komparativni ustavi“, në: Bačić, A. (1992) (ed.), *Ustavna diktatura: Hrestomatija ustavnopravne i politicke znanosti* (Knjizevni krug: Split, fq. 125.

me ĉka, në të vërtetë, garantohet e drejta e përgjithshme për informim. Në të vërtetë, ĉdokush ka të drejtë për informim të vërtetë, të plotë dhe me kohë për ĉështjet me rëndësi publike. Mjetet e informimit publik janë të obliguara që këtë të drejtë ta respektojnë. Lidhur me këtë të drejtë është edhe e drejta e qasjes në informatat me rëndësi publike, që do të thotë se Kushtetuta ia garanton secilit të drejtën në qasje në të dhënat e përfshira në dokumentet publike, të cilat janë në posedim të organeve dhe organizatave publike dhe shtetërore, e të cilave u janë besuar autorizimet publike. Këtë të drejtë të qasjes ĉdo qytetar mund ta realizojë në pajtim me ligjin.

2. Si e drejtë e veçantë, e lidhur me lirinë e medieeve, (që do të komentohet detajisht në nenin vijues 42. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës), Kushtetuta e garanton të drejtën e informimit, si të drejtë të përgjithshme që e gëzon secili individ. Mirëpo, në tekstin kushtetues është lënë anash sanksionimi i dënimit për shkelje të kësaj të drejte kushtetuese, përkatësisht detyrimi kushtetues që të tjerët ta respektojnë, qoftë me parashikim të sanksioneve në vetë Kushtetutën apo duke iu referuar rregullimit ligjor të sanksioneve dhe të dënimeve. Pra, mënyra sipas së cilës është rregulluar kjo ĉështje në Kushtetutë është pikërisht shkak që të parashtrohet dhe të shqyrtohet ĉështja, ku do të shqyrtoheshin konsekuencat eventuale të mosrespektimit të obligimit kushtetues nga ana e mjeteve të informimit publik, institucioneve publike, organeve publike dhe shtetërore dhe personave të tjerë. Ćfarë do të ishin mundësitë e qytetarëve që, duke iu referuar patjetërsueshmërisë, mosndarjes dhe moskontestimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, që përbëjnë bazën e rregullimit juridik të Republikës së Kosovës (neni 21. paragrafi 1.), pastaj, duke iu referuar obligimit kushtetues që të gjithë t'i respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të të tjerëve (neni 21. paragrafi 3.), të kërkojnë sanksionim për shkelje të kësaj të drejte (neni 24. paragrafi 1.), sepse të gjithë para ligjit janë të barabartë dhe secili ka të drejtën për mbrojtje të njëjtë ligjore pa diskriminim. Po ashtu, duke pasur parasysh se Republika e Kosovës i mbron dhe i garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara me këtë Kushtetutë (neni 21. paragrafi 2.), qytetarët, eventualisht, do të mund të kërkonin kompensim të dëmit për shkak të shkeljes së kësaj të drejte. Zgjidhjet jo të plota kushtetuese i lënë këto ĉështje të hapura për praktikën, e cila do të jetë e detyruar që t'u përgjigjet këtyre konkretisht.
3. E drejta e qasjes në dokumentet publike paraqet të drejtën e qytetarit për të ditur se ĉka dhe si punojnë organet e pushtetit. Kjo e drejtë është e drejtë themelore njerëzore, siç është e drejta e zgjedhjes, e drejta e bashkimit apo e drejta e privatësisë. Njëkohësisht, e drejta e qasjes në dokumentet publike ia mundëson qytetarit që t'i dijë të gjitha informatat publike të domosdoshme për realizimin e të drejtës së tij kushtetuese për t'u informuar. Kjo e drejtë është bazë për realizimin cilësor dhe efikas të të drejtave dhe lirive të tjera të njeriut: liria e mendimit, liria e informimit, liria e zgjedhjes.
4. Me shfrytëzimin e të drejtës së qasjes në dokumentet dhe informatat publike që i posedojnë organet e pushtetit, bëhet kontrolli i punës së tyre. Kjo e drejtë është

mjet i fort në duart e çdo qytetari për kontrollin e punës së organeve të shtetit ndërmjet dy cikleve zgjedhore. Bartësit e pushtetit, si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë lokal, dhe të gjithë ata që financohen nga mjetet publike, më nuk mund ta kalojnë pa u shqetësuar mandatin e tyre zgjedhor. Puna e tyre i nënshtrohet verifikimit të përditshëm. Me përjashtime, krejt ajo që bëjnë i nënshtrohet verifikimit nga ana e qytetarëve. Ky, pa dyshim, është kusht i realizimit të qeverisjes së mirë, sepse shumë shembuj të sjelljes së keqe të zyrtarëve - plogështia, jopreciziteti, joefikasiteti, arroganca, korruptimi, me zbatimin konsekuent të kësaj të drejte, gradualisht do të evitohen dhe do t'ia lëshojnë vendin precizitetit, efikasitetit, mirësjelljes, përgjegjësisë, që duhet të rezultojë me realizimin e parimit të punës së mirë të administratës, por edhe të të gjitha organeve të pushtetit: legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore.

5. Prandaj, kushtetutbërësi ka gjetur zgjidhje në garancitë kushtetuese dhe në avancimin e rregullativës ligjore. E drejta e qasjes së lirë në dokumentet publike, prandaj, është radhitur në korpusin e të drejtave të njeriut në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si e drejtë e veçantë e njeriut, që kjo Kushtetutë duhet ta garantojë. Republika e Kosovës kështu e ndjek praktikën e kushtetutave moderne të miratuara gjatë dy dekenieve të fundit në mbarë botën, e veçanërisht në vendet e tranzicionit. Vetëm në këtë mënyrë qytetarët e saj do të jenë të bindur që bartësit e pushtetit shtetëror participimin e qytetarëve në punët publike do ta konsiderojnë vepër të standardeve, të praktikave dhe procedurave demokratike, ndërsa që publiciteti dhe përgjegjësia në punë e bartësve të autorizimeve publike janë parime që në asnjë mënyrë nuk vihen në dyshim.
6. Lidhur me këtë të drejtë kushtetuese, është miratuar Ligji për Qasje në Dokumentet Publike (i miratuar në Kuvend, më 07.10.2010, ndërsa i shpallur me Dekretin e Kryetarit të Republikës së Kosovës nr. DL-063-2010 më 01.11.2010). Nga pikëpamja e unitetit të sistemit juridik, ky Ligj duhet të shikohet si ligj themelor që e fut në sistemin juridik regjimin e përgjithshëm të sjelljes së organeve të pushtetit me informatat në posedim të tyre dhe vënies në shikim dhe dispozicion qytetarëve kur këtë e kërkojnë. Duke respektuar parimin e unitetit të sistemit juridik është e papranueshme që me ligje të veçanta të degradohet apo ngushtohet vëllimi i lirisë së qasjes në informata të garantuara me Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike. Nëse kjo do të ndodhte, do të shkeleshin standardet ndërkombëtare, të cilat e obligojnë Republikën e Kosovës.
7. Miratimi i Ligjit të përmendur është mjaft me rëndësi për respektimin e së drejtës kushtetuese të qytetarëve për qasje në dokumentet publike. Ndërkaq, është e domosdoshme që edhe më tutje të bëhet harmonizimi edhe i atyre zgjidhjeve në ligjet e tjera, të cilat shmangen nga regjimi i përgjithshëm i qasjes në informatat dhe dokumentet publike, që gjenden në posedim të organeve publike shtetërore. Është e domosdoshme që të bëhet harmonizimi i sistemit juridik dhe nxjerrja e ligjeve të kompletuara, para së gjithash e Ligjit për Qasje në Dokumentet Sekrete. Ndërkaq, mungesa e një ligji të tillë dhe rregullimi i kësaj materije, mjaft të ndjeshme me akte ligjore dhe nënligjore, mund të jetë bazë për keqpërdorim të së

drejtës së qasjes së lirë në informata dhe dokumente publike. Ngushtimi i së drejtës së qasjes në informata në lëmin e dokumenteve sekrete, mund të pengohet vetëm me miratimin e një ligji të veçantë për veprim me to. Me atë ligj do të rregullohej:

- 1) procedura unike e vënies së shenjës “sekret” në informatat e caktuara dhe në dokumentet publike;
- 2) definimi i nocionit të sekretit shtetëror, ushtarak dhe zyrtar;
- 3) përcaktimi i klasifikimit të ri të sekreteve;
- 4) përcaktimi i kushteve në të cilat një informacion apo dokument publik mund të vihet nën njërin nga shenjat e sekretit;
- 5) formimi i organit të veçantë që do të kujdesej për mbrojtjen e sekreteve;
- 6) përcaktimi i përgjegjësisë së operatorit të sekreteve;
- 7) përcaktimi i obligimit të zbatimit të testit të interesit publik, pa marrë parasysh formën e dokumentit, para përcaktimit të shenjës së sekretit.

Neni 41.2

1. Për shkak të rëndësisë që kanë informatat dhe dokumentet publike, që janë në posedim të organeve publike dhe shtetërore, këto dokumente janë publike dhe të arritshme për të gjithë. Ndërkaq, kjo e drejtë kushtetuese që i përket çdo personi, nuk është absolute, sepse nga qasja përjashtohen ato dokumente, për të cilat është kufizuar shikimi me ligj, për shkak të privatësisë, sekretit afarist apo informatave që janë klasifikuar si konfidenciale (neni 41. paragrafi 2. i Kushtetutës).
2. Realizimi më i përafërt i kësaj të drejte është rregulluar me Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike. Pra, ky Ligj ia garanton çdo personi fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, pas paraqitjes së kërkesës, të drejtën e qasjes në dokumentet që mbajnë, hartojnë apo pranojnë institucionet publike (neni 1.). Po ashtu, neni 2. i këtij Ligji e përcakton fushëveprimin e tij, ashtu që përcakton që ai zbatohet për të gjitha dokumentet që i mbajnë, hartojnë apo pranojnë institucionet publike (paragrafi 1.) dhe e rregullon të drejtën e qasjes në dokumentet publike me dispozitën që secili kërkues i dokumentit, ka të drejtën e qasjes në dokumentet e institucioneve publike, duke iu përmbajtur parimeve, kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara me ligj (neni 4. paragrafi 1.). Të gjitha këto dokumente janë të hapura për opinionin në bazë të kërkesës së drejtpërdrejtë, në bazë të kërkesës së paraqitur me shkrim apo në formë elektronike, përveç informatave të kufizuara me ligj (neni 4. paragrafi 2.).
3. Kjo do të thotë se përjashtimi i të drejtës së qasjes në dokumentet publike mund të zbatohet, vetëm me qëllim të:
 - 1) mbrojtjes së sigurisë kombëtare dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare;
 - 2) mbrojtjes së sigurisë publike;
 - 3) mbrojtjes së hetimit të ndjekjes së kryerësve të veprave penale;
 - 4) hetimit disiplinor;
 - 5) inspektimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes nga ana e institucioneve publike;
 - 6) mbrojtjes së privatësisë së interesave të tjera legjitime private;

- 7) mbrojtjes së interesave komerciale dhe të interesave të tjera ekonomike dhe në situata të tjera të arsyeshme (neni 12. paragrafi 1.).
4. Institucioni publik i cili e refuzon kërkesën për qasje në dokument në tërësi apo pjesërisht duhet t'i përmend shkaqet e refuzimit (neni 13. paragrafi 2.). Kërkuesi ka të drejtë që pas paraqitjes së kërkesës të marrë vendimin e arsyetuar nga institucioni publik lidhur me refuzimin e kërkesës.
5. Po ashtu, është e domosdoshme, që sa më parë, të miratohet Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave për Personin, sepse Ligji ekzistues për Qasje në Dokumentet Zyrtare dhe Ligji i ardhshëm për Mbrojtjen e të Dhënave për Personin reflektojnë raportin ndërmjet informatave publike dhe private. Informatat private, përkatësisht të dhënat për personalitetin janë ato që kanë të bëjnë me individin dhe që përmbajnë elemente të privatësisë së tij/saj në të cilat askush nuk ka të drejtën e qasjes, pa pëlqimin e personit me të cilin kanë të bëjnë apo të autorizimit ligjor. Përkundër kësaj, informatat publike të dokumenteve që i posedojnë organet publike dhe shtetërore janë publike dhe kanë të bëjnë me punën e organeve të pushtetit publik, për të cilën të gjithë individët kanë interes të arsyeshëm që të dinë. Këto dy tekste ligjore kanë të bëjnë shumëfish me njëri-tjetrin.

Neni 42 [Liria e Medieve]

- (1) **Garantohet liria dhe pluralizmi i medieve.**
- (2) **Censura është e ndaluar. Askush nuk mund të pengojë shpërndarjen e informacionit ose të ideve nëpërmjet medieve, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare.**
- (3) **Çdokush ka të drejtë të korrigojë informacionin e pavërtetë, jo të plotë ose të pasaktë të publikuar, nëse cenon të drejtat ose interesat e saj/tij, në pajtim me ligjin.**

Neni 42

1. Në çdo kushtetutë detyrimisht është e garantuar liria e qytetarëve që t'i shprehin dhe t'i shpallin mendimet e tyre politike dhe mendimet e tjera nëpërmjet shtypit apo mjeteve të tjera të informimit publik, si dhe të drejtën e botimit të gazetave dhe të publikimeve të tjera.¹⁵⁶ Liria e shtypit, si një nga mënyrat e mundshme të shprehjes së mendimit publik, paraqet një nga të drejtat njerëzore më të vlefshme, pa të cilën nuk mund të mendohet rregullimi politik demokratik. Pra, liria e shtypit, në të njëjtën kohë, është edhe e drejtë civile dhe politike e njeriut, sepse e pranon dhe e vërteton të drejtën e njeriut nga pushteti shtetëror, por edhe të drejtën që me

¹⁵⁶ Čok, V., (1995), "Pravo na slobodu izražavanja, javno informisanje i govor mržnje", *Pravni život*, nr. 9, fq. 521-536.

mendimin e shprehur lirisht të ndikohet në ushtrimin e punëve publike.¹⁵⁷ Prandaj, kjo liri është në lidhje të ngushtë me liritë tjera personale, para së gjithash, me lirinë e mendimit, të bindjes, të ndërgjegjes, të fesë, lirinë e zgjedhjes dhe të grumbullimeve të tjera publike, lirinë e krijimit shkencor dhe artistik dhe liritë e të drejtat e tjera që i shërbejnë procesit të edukimit të mendimit dhe të manifestimit publik të personalitetit njerëzor.

2. Liria e medieve, e shikuar në vështrim negativ, do të thotë se ndaj shtypit¹⁵⁸ dhe të gjitha formave të tjera të shprehjes publike të mendimit është e ndaluar censura, si dhe masat e tjera preventive të pushtetit administrativ. Masat ndëshkuese të pushtetit gjyqësor lejohen vetëm në rastet kur kjo liri, haptazi keqpërdoret. Çfarë do të thotë kjo konkretisht? Kjo do të thotë se e drejta e botimit, daljes, shitjes dhe shpërndarjes së letrave, gazetave, publikimeve e të tjera, nuk varet nga lejimi paraprak i pushtetit administrativ, por për arsye se shpallet publikisht ekziston përgjegjësia para pushtetit gjyqësor. Prandaj, sot, liria e shtypit (diku, ende vetëm në mënyrë deklarative) njihet në të gjitha kushtetutat bashkëkohore dhe në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
3. Kështu, sipas Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut të vitit 1950, çdokush e ka të drejtën e shprehjes, ashtu që kjo e drejtë e përfshin edhe lirinë e të pasurit të mendimit personal, të pranimit dhe të dhënies së informatave dhe të ideve, pa ndërhyrje të pushtetit publik dhe pa marrë parasysh kufijtë (neni 10.)¹⁵⁹ Natyrisht, si çdo e drejtë tjetër themelore e garantuar me kushtetutë, edhe liria e medias i ka kufijtë e vet të brendshëm, të vënë në vet tekstin kushtetues apo në legjislacionin e përgjithshëm.¹⁶⁰ Prandaj, edhe Konventa

¹⁵⁷ Në kohë të fundit gjykata përcakton parimin që shteti mund të ketë obligim që gazetarët dhe botuesit t'i mbrojë nga frikësimi, maltretimi dhe dhuna. Në lëndën: *Ozgur Gundem kundër Turqisë* (2000.), p.sh. Gjykata e ka konstatuar shkeljen e nenit 10., sepse qeveria nuk u ka ofruar ndihmë gazetave që kanë qenë cak i sulmeve terroriste.

¹⁵⁸ Një nga arritjet më të rëndësishme të mendimit liberal juridik-politik është pikërisht liria e shtypit. Meritat për këtë u takojnë, para së gjithash, përfaqësuesve anglezë të së drejtës racionale natyrore, siç janë: Xhon Lok, Xhon Stjuart Mil dhe veçanërisht Xhon Milton. Ky i fundit, me të drejtë e ka marrë emrin "babai i shtypit të lirë", që me Deklaratën franceze për të drejtat e njeriut dhe të qytetarit të vitit 1789 dhe me Amendamentin e parë të Kushtetutës së SHBA-ve të vitit 1791, fiton rangun e së drejtës së njeriut të garantuar në Kushtetutë (të dy këto dokumente e përcaktojnë lirinë e shtypit, si një nga të drejtat më të çmuara të njeriut, ndërsa amendamenti i përmendur, ndër të tjera, e ndalon edhe nxjerrjen e ligjit i cili e kufizon lirinë e fjalës dhe të shtypit.

¹⁵⁹ Më këtë, natyrisht, shtetet nuk pengohen që të kërkojnë leje për punën e ndërmarrjeve televizive, të radiove apo të ndërmarrjeve filmike.

¹⁶⁰ Paraqitësit e parashtrës në lëndët *information severein Lentia dhe të tjerët kundër Austrisë* (1993.) dhe *Radio ABC kundër Austrisë* (1997.) e kanë kontestuar atë që qeveria ua ka refuzuar licencën, dhe në këtë mënyrë, në esencë, e kanë kontestuar monopolin e vazhdueshëm të korporatës së RTV të Austrisë. Gjykata në të dy rastet e ka konstatuar shkeljen e nenit 10, duke theksuar se monopoli shtetëror në emetimin e radios dhe televizionit imponon kufizime të mëdha në pluralizmin e shprehjes, prandaj mund të arsyetohet vetëm nëse ekziston ndonjë nevojë urgjente shoqërore.

e përmendur Evropiane parashikon disa baza të lejueshme për kufizim të lirisë së medias ku bëjnë pjesë:

- 1) mbrojtja e interesit të sigurisë kombëtare, e integritetit territorial dhe sigurisë publike;
 - 2) pengimi i trazirave dhe kriminalitetit;
 - 3) mbrojtja e shëndetit apo moralit;
 - 4) mbrojtja e reputacionit apo të drejtave të tjerëve;
 - 5) pengimi i zbulimit të informatave të pranuar në konfidencë;
 - 6) ruajtja e autoritetit dhe e paanësisë së gjyqësorit.
4. Këtu duhet theksuar se me shtyp nuk nënkuptohen vetëm gazetat dhe gjërat e shtypura, por edhe fotografitë, vizatimet apo gjërat e tjera, të punuara në mënyrë mekanike apo kimike për shumëzim, që i dedikohen opinionit. Këto janë “mjete të përshtatshme” në kuptim të nenit të mësipërm të Kushtetutës. Por, ai flet edhe për shprehjen e mendimit nëpërmjet “fjalës së gjallë”. Kjo do të thotë me ligjërim të rëndomtë (me gojë, kokë më kokë) në një rreth të kufizuar të njerëzve (sepse për grumbullimin dhe bashkimin, do të thotë për mbledhje dhe marrëveshje flitet në nenet vijuese të Kushtetutës-neni 43. dhe neni 44.). Mirëpo, para së gjithash kjo mund të ketë të bëjë me shprehjen e mendimit nëpërmjet radios dhe televizionit, sepse ky nen i Kushtetutës nuk i ka parasysh shprehjet individuale të mendimit në një rreth të ngushtë,¹⁶¹ por shprehjen e mendimit që shumëzohet dhe i dërgohet një numri të pakufizuar të personave.¹⁶²

Neni 42.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 42. paragrafi 1.) përmban garancinë institucionale të lirisë dhe pluralizmit të medias. Kjo do të thotë se çdokush është i lirë që pa leje, në mënyrën e parashikuar me ligj, të themelojë gazeta dhe mjete të tjera të informimit publik. Në pajtim me ligjin, është parashikuar, po ashtu, themelimi i stacioneve televizive dhe të radios. Me emërtimin e institutit me të cilin rregullohet neni përkatës “Liria e medias”, Kushtetuta garanton mjaft të drejta të veçanta që kanë të bëjnë me liritë e medias, e parashikon ndalesën e censurës, i përcakton kufizimet të cilave u nënshtrohen liritë e medias dhe shkaqet që janë bazë për kufizim.

¹⁶¹ Shih lëndën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, KO63/12: Vendimi për heqjen e lëndës nga lista më 10 dhjetor 2012 në rastin KO63/12. (*Kërkesa e Alma Lamës dhe 10 deputetëve të Kuvendit të Kosovës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 37,38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 04/L-82*).

¹⁶² Për të drejtën e informimit të shihet më gjerësisht: Čok, V., (1978) “Neki preduslovi za ostvarivanje prava na obaveštenost“, në: Zvonimir Separevic (ed.), *Odgovornost u informativnoj djelatnosti* (Centar za strucno usavrsavanje i suradnju s udruženim radom Pravnog Fakulteta: Zagreb, fq. 171-179).

Neni 42.2

1. Në kontest të garantimit institucional të lirisë së shtypit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ndalon shprehimisht censurën, duke theksuar së askush nuk mund ta ndalojë përhapjen e informatave apo ideve nëpërmjet medias (neni 42. paragrafi 2.). Kjo do të thotë se Kushtetuta nuk konstaton vetëm në mënyrë të përgjithshme se nuk ka censurë, por e ndalon atë shprehimisht, por nuk e parashikon dënimin e saj. Konsiderojmë se kjo Kushtetutë ka shkuar një hap më tej në krahasim me kushtetutat e tjera, të cilat në tekstin e vet e kanë vetëm dispozitën deklarative dhe parimore që “nuk ka censurë”, sepse e parashikon shprehimisht ndalimin e censurës. Ndërkaq, nuk është parashikuar dënimi i censurës as në Kushtetutë dhe as nuk është lënë që kjo çështje të rregullohet me ligji. Pengimi i përhapjes së informatave dhe ideve nëpërmjet medieve, është i mundur vetëm kur kjo është e domosdoshme për pengimin e nxitjes dhe të provokimit të dhunës dhe të armiqësisë në bazë të urrejtjes racore, nacionale, etnike apo fetare.
2. Analiza e kujdesshme e shkaqeve që paraqesin bazë për kufizimin e lirisë së medias, tregon se disa shkaqe të rëndësishme janë anashkaluar plotësisht, siç janë, p.sh.:
 - 1) rrezikimi i të drejtave njerëzore apo të pakicave;
 - 2) prishja e rendit publik dhe moralit;
 - 3) diskriminimi në të gjitha bazat e tjera, pos asaj racore, nacionale dhe fetare;
 - 4) rrezikimi i sigurisë së Republikës së Kosovës;
 - 5) thirrja për rrënim të dhunshëm të rendit të përcaktuar me Kushtetutë;
 - 6) shkelja e integritetit territorial të Republikës së Kosovës;
 - 7) propagandimi i luftës e të tjera.
3. Anashkalim të paarsyeshëm të shkaqeve të rëndësishme të kufizimit të lirive të medias mund të hasim edhe nën nenin 40., i cili, po ashtu, si shkak për kufizim të lirisë së shprehjes, thekson vetëm pengimin e nxitjes dhe të provokimit të dhunës dhe të armiqësisë, në bazë të urrejtjes racore, nacionale, etnike apo fetare. Do të thotë, në të dy rastet janë parashikuar shkaqe plotësisht të njëjta për kufizimin e lirive të përmendura.

Për shkaqet e kufizimit të lirisë së përhapjes së informatave dhe të ideve nëpërmjet medias, të shihet më shumë në komentet përkatëse të neneve 35, 36, 38, 39, 43 dhe 44.

Neni 42.3

1. Kushtetuta e garanton të drejtën e përmirësimit nëse e drejta apo interesi i dikujt është mohuar nëpërmjet dhënies së informacionit të pasaktë, jo të plotë dhe të pavërtetë (neni 42. paragrafi 3.). Ky përmirësim i është mundësuar çdo personi dhe këtë mund ta realizojë në pajtim me ligjin. Ndërkaq, konsiderojmë se, përveç të drejtës së përmirësimit, Kushtetuta parimisht është dashur që ta garantojë edhe të drejtën për t’iu përgjigjur informacionit të dhënë në mjetet e informimit publik. Këto dy të drejta, Kushtetuta do të duhej t’i garantonte vetëm parimisht dhe t’ia

linde ligjit për ta rregulluar më për së afërmi mënyrën e realizimit të tyre në kufijtë dhe vëllimin të cilin Kushtetuta e definon në mënyrë parimore (kjo është bërë vetëm për të drejtën e korrigjimit të informacionit të pavërtetë, të paplotë dhe të pasaktë, që është dhënë.

2. Në fund, konsiderojmë se Kushtetuta është dashur që t'ua garantojë shprehimisht edhe disa të drejta të tjera personave e drejta apo interesi i të cilëve është shkelur apo është mohuar, për shkak të dhënies së informacionit të pavërtetë, të paplotë apo të pasaktë, siç janë, për shembull:
 - 1) e drejta e kompensimit të dëmit;
 - 2) evitimi i pasojës së shkeljes së të drejtës e të tjera.
3. Lidhur me këtë situatë mund të zbatohet vetëm garancia e përgjithshme kushtetuese e së drejtës së mbrojtjes gjyqësore (neni 54. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës). në rast të shkeljes apo të mohimit të ndonjë të drejtë, që është e garantuar me këtë Kushtetutë, si dhe e drejta për masë efikase juridike, nëse konstatohet se e drejta është cenuar.

Neni 43 [Liria e Tubimit]

Liria e tubimit paqësor është e garantuar. Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to. Këto të drejta mund të kufizohen me ligj, nëse është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve.

Neni 43

1. Është e drejtë e qytetarëve që të grumbullohen në mënyrë të qetë dhe pa armë dhe të mbajnë mbledhje, manifestime, demonstrata, mitingje dhe tubime të ngjashme, në vende të hapura apo të mbyllura. Qëllimi i mbledhjes apo grumbullimit tjetër mund të jetë shprehja e mendimit politik apo të mendimit tjetër, të kritikuarit e pushtetit publik, protesta publike, informimi, ekspozimi dhe shfaqja e veprave artistike, garat sportive etj. Liria e tubimit apo manifestimi publik është tubim kolektiv që ka për qëllim shprehjen e qëndrimit apo të mendimit kolektiv. Natyrisht, këto grumbullime dhe forma të tjera të tubimit publik mund të kenë karakter politik dhe jopolitik. Për tubim të qetë në vende publike, zakonisht nuk nevojitet leje paraprake e pushtetit publik, ndërsa në disa shtete nuk nevojitet as paraqitja paraprake e tubimit. Vetëm kur kjo është e domosdoshme në interes të sigurisë nacionale apo publike, të mbrojtjes së shëndetit apo të moralit, përkatësisht të të drejtave dhe të lirive të të tjerëve, liria e grumbullimit dhe e mbledhjes mund të kufizohet. Kështu, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, duke e garantuar lirinë e grumbullimit të qetë dhe lirinë e bashkimit me të tjerët, ia garanton të drejtën secilit që të

formojë sindikatë dhe të anëtarësohet në të me qëllim të mbrojtjes së interesave të veta.¹⁶³

2. Për realizimin e këtyre të drejtave, Konventa nuk paraqet kurrfarë kufizimesh, përveç atyre që janë parashikuar me ligj dhe që janë të domosdoshme në shoqërinë demokratike. Këto kufizime mund të vendosen vetëm:
 - 1) nëse është në interes të sigurisë nacionale apo të sigurisë publike;
 - 2) me qëllim të pengimit të trazirave dhe të kriminalitetit;
 - 3) me qëllim të mbrojtjes së shëndetit apo të moralit;
 - 4) me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve.
3. Natyrisht, përveç këtyre lirive, duhet theksuar edhe fakti se është i palejueshëm detyrimi i kujtdoqoftë që t'i takojë ndonjë bashkimi (neni 20. i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe neni 21-22. i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike). Liria e grumbullimit nënkupton takimet e njerëzve dhe këmbimin e ideve e të mendimeve në suaza më të gjera dhe joformale, sesa që është kuptimi i fjalës “bashkim”, në ç’mënyrë mundësohet zhvillimi dhe përparimi i shoqërisë demokratike dhe i institucioneve të saj. Këto të drejta i garantojnë edhe dokumentet e tjera të përgjithshme për të drejtat e njeriut, siç është Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (neni 5. dhe neni 11.).
4. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 43.) liria e tubimit është garantuar në mënyrë të përgjithshme, ashtu që me aktin më të lartë juridik është përcaktuar që çdo person ka të drejtë të organizojë tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtë që të marrë pjesë në to. Ndërkaq, konsiderojmë se Kushtetuta është dashur ta bëjë dallimin e dy situatave, si:
 - 1) tubimi në vend të mbyllur;
 - 2) tubimi në vend të hapur.Natyrisht, për secilën nga këto dy forma të tubimit do të duhej të parashihej një regjim i veçantë, ashtu që qytetarët do të mund të mblidheshin në vende të mbyllura, pa obligim që këtë t’ia paraqesin organit kompetent dhe pa leje të veçantë paraprake. Përkundër kësaj, tubimi i qytetarëve në vend të hapur (mbledhjet, demonstratat dhe tubimet e tjera), do të duhej nënshtuar paraqitjes përkatëse, do të thotë organizatorët e tubimeve të tilla, do të ishin të obliguar që tubimet t’ia paraqesin organit kompetent. Kjo për arsye se tubimi në vende të hapura është shumë më i rrezikshëm për rendin dhe qetësinë publike dhe se është e nevojshme që në raste të tilla organi kompetent të sigurojë mbikëqyrje përkatëse. Kushtetuta do të duhej t’ia linte ligjit që më për së afërmi ta rregullonte mënyrën e realizimit të kësaj të drejtë, në kufijtë dhe vëllimin e parashikuar në Kushtetutë.
5. Edhe pse e tërë kjo nuk është përcaktuar me Kushtetutë, megjithatë Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka nxjerrë Ligjin për Tubimet Publike (të miratuar në Kuvend, më 04.12.2008, ndërsa është shpallur me vendimin e Kuvendit, nr. 03-V-

¹⁶³ Edhe pse konsiderohet se neni 11. në raste të tilla *lex specialis*, Gjykata e merr parasysh nenin 10. kur e komenton lirinë e tubimit dhe të bashkimit sipas nenit 11. (*Ezelin kundër Francës (1991.) dhe Partia Socialiste dhe të tjerët kundër Turqisë (1998.)*).

101, më 26.03.2009). Me këtë Ligj është përcaktuar e drejta e tubimit publik, liria e fjalimit në tubime publike, liria e protestës dhe manifestimit publik, koha e organizimit, detyrimet dhe përgjegjësitë e organizatorit (neni 1.). Po ashtu, ligji i përmendur jep definicione përkatëse të nocioneve të caktuara të përdorura në tekstin e Kushtetutës. Kështu, me nocionin e grumbullimit nënkuptohen grumbullimet e organizuara nga grupet, entitetet, organizatat joqeveritare, subjektet politike e të tjera, në të cilat “festohet, jepen shfaqje apo shprehet pakënaqësi lidhur me çështje të ndryshme”. Me protestë nënkuptohet kundërvënia e vendosur për ndonjë padrejtësi apo vepër të paligjshme, shprehja e vendosur e mospajtit lidhur me diçka, ndërsa demonstrata nënkupton manifestimin e masës popullore në rrugë dhe sheshe me qëllim të shprehjes së hapur të një kërkesë politike, ekonomike apo shoqërore, që të kundërshtohet diçka (neni 2.).

6. Pra, sipas nenit 7. të Ligjit për Tubimet Publike, tubimet që mund të mbahen pa paralajmërim janë ato që zhvillohen në vende të mbyllura apo hapësira të parashikuara për qëllime të caktuara siç janë: mbledhjet, tribunat, tavolinat e rrumbullakëta të partive dhe të lidhjeve të regjistruara politike (paragrafi 1.). Pos kësaj, nuk nevojitet paralajmërim për ato tubime publike që duhet të mbahen në: stadione, salla të filmit, teatro, etj. dhe për të cilat nuk nevojiten masa shtesë të sigurisë (paragrafi 2.). Tubimet publike, pra, mund të mbahen në çdo vend të përshtatshëm, por nga kjo rregull përjashtohen vendet, si:
 - 1) në afërsi të spitaleve dhe në vende që do të mund t’i pengonin automjetet e ndihmës së shpejtë apo ku do të prishej qetësia e personave të hospitalizuar;
 - 2) në afërsi të çerdheve dhe të shkollave fillore gjatë kohës së mësimt;
 - 3) në parqet natyrore, kombëtare dhe të mbrojtura, përveç kur tubimi ka për qëllim mbrojtjen e natyrës dhe të mjedisit;
 - 4) në afërsi të përmendoreve dhe të objekteve me vlera të mëdha historike dhe kulturore, përveç me qëllim të mbrojtjes së tyre nga dëmtimet e mundshme;
 - 5) në udhëkryqe dhe rrugë magjistrale në mënyrë që të mos pengohet lëvizja e automjeteve;
 - 6) në vendet në të cilat, duke pasur parasysh kohën, numri i pjesëmarrësve dhe qëllimi i tubimit do të mund të shqetësonte seriozisht një numër të madh të qytetarëve.
7. Ligji i përmendur për tubimet publike e përcakton edhe të drejtën e mbajtjes së tubimit publik, si dhe llojet e tubimeve publike. Kështu, çdo qytetar i Republikës së Kosovës, pa asnjë dallim gjinor, racor, gjuhësor, fetar, kombëtar, ekonomik, arsimor, social apo politik, ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në tubimet publike, sipas rregullave të përcaktuara me këtë Ligj (neni 3. paragrafi 1.). Tubimet publike nënkuptojnë të gjitha tubimet e qeta, siç janë:
 - 1) manifestimet;
 - 2) marshet;
 - 3) protestat;
 - 4) festat publike;
 - 5) komemoracionet e qeta;

- 6) manifestimet dhe shfaqjet e natyrës së ngjashme, në të cilat pjesëmarrësit, në mënyrë të lirë dhe të qetë, i shprehin pikëpamjet e tyre për çështjet të cilat iu interesojnë;
 - 7) demonstratat;
 - 8) shfaqjet kulturore, humanitare, sportive, fetare dhe kulturore-argëtuese (neni 3. paragrafi 2 dhe 3.).
8. Sipas nenit 6. të Ligjit të përmendur, Policia e Kosovës në vendin që do të organizohet tubimi publik, duhet të lajmërohet për organizimin e tubimit të qetë publik, llojin e tij dhe kohën e tubimit. Ky njoftim për tubimin publik duhet të paraqitet më së voni 72 orë më parë, ndërsa Policia e Kosovës është e obliguar që ta njoftojë organizatorin për lejen apo ndalesën e tubimit publik më së voni 48 orë para tubimit të caktuar. Nëse në afatin e parashikuar nuk jepet vendimi për ndalesë, tubimi konsiderohet i lejueshëm.
9. Liria e tubimit mund të kufizohet me ligj dhe kjo është paraqitur në nenin 43 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Shkaqet për këtë kufizim janë mbrojtja e këtyre vlerave:
- 1) rendi publik;
 - 2) shëndeti;
 - 3) siguria nacionale;
 - 4) të drejtat e të tjerëve.
 - 5) Pra, kufizimi mund të parashikohet vetëm me ligj, në pajtim kuadrin e përgjithshëm kushtetues të kompetencës ligjdhënëse në fushën e të drejtave të njeriut (neni 21. i Kushtetutës). Me Ligjin për Tubimet Publike (neni 4.) përcaktohen, po ashtu, kufizimet dhe shkaqet e ndërprerjes së tubimeve publike, kur mbajtja e tyre e rrezikon rendin dhe qetësinë publike në pikëpamje të së drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe të shëndetit e të moralit publik (paragrafi 1.). Kështu, e drejta e pjesëmarrjes dhe mbajtja e fjalimit të tubimit publike do të ndalohet kur tubimet publike shfrytëzohet për nxitje dhe thirrje në dhunë dhe urrejtje ndëretnike apo fetare apo për çfarëdo nxitje tjetër të ndaluar me këtë Ligj (paragrafi 2.).
- Policia e Kosovës mund ta ndalojë tubimin e qetë publik, nëse vlerëson:
- 1) se njoftimi për tubimin publik nuk ka qenë me kohë;
 - 2) nëse për tubim është parashikuar vendi i cili me këtë Ligj është i ndaluar;
 - 3) se qëllimet e tubimit nxisin apo thërrasin në urrejtje dhe dhunë ndëretnike, fetare, racore, politike;
 - 4) se ekziston dyshimi i bazuar që tubimi do të mund të shfrytëzohej për dhunë (neni 8. paragrafi 1.).
- Ndër shkaqet e kufizimit të lirisë së tubimit mbledhjes dhe të tubimit publik, mungon theksimi i veçantë:
- 1) mbrojtja e të drejtave të fëmijëve;
 - 2) mbrojtja e jetës dhe e pasurisë;
 - 3) nxitja dhe shkaktimi i urrejtjes fetare, nacionale apo racore apo i çfarëdo forme tjetër të diskriminimit, mos durimit e të tjera, (që Kushtetuta i përmend si

shkaqe për kufizimin e disa të drejtave të tjera, si, për shembull, lirinë e medias, lirinë e bashkimit e të tjera).

Të krahasohen komentet e shkaqeve të kufizimit të të drejtave dhe lirive nga nenet 35, 36, 38, 39, 42 dhe 44 të cilët tregojnë se dallohen vlerat, të cilat Kushtetuta i mbron veçanërisht (shkaqet e kufizimit të të drejtave paraqesin rrezikim të atyre vlerave), si dhe për këtë dallim shpeshherë nuk ka bazë. Lidhur me kufizimin e mundshëm të lirisë së tubimit, është e dukshme se në Kushtetutë nuk ka një dispozitë që do të përcaktonte shprehimisht se në kompetencë të kujt është vendosja për ndalesën e tubimit, në çfarë forme kumtohet ndalesa (me shkrim apo me gojë), a është ndalesa e përhershme apo e përkohshme etj. Duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një liri të rëndësishme politike të qytetarit, këto çështje do të duhej rregulluar me Kushtetutë, siç ndodh edhe në rastet e tjera, (për shembull, te fshehtësia e letrave, pacenueshmëria e banesës, liria personale e të tjera).

Neni 44 [Liria e Asociimit]

- (1) Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.**
- (2) Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve.**
- (3) Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirive dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente.**

Neni 44

1. Esenca e lirisë së bashkimit është e shprehur me të drejtën e qytetarëve për themelimin të partive politike dhe të shoqatave e organizatave të tjera politike. Diku nga liria e përgjithshme e bashkimit del liria e bashkimit politik, e cila në kushtetuta të caktuara përcaktohet si e drejtë subjektive e qytetarëve, ndërsa në disa tekste të tjera kushtetuese në mënyrë institucionale garantohet pozita kushtetuese-juridike e partive politike. Dallimi ndërmjet lirisë së përgjithshme të bashkimit dhe lirisë së bashkimit politik, qëndron në atë se liria e përgjithshme pranohet pa përjashtim, do të thotë për secilin njeri, ndërsa liria e bashkimit politik u njihet vetëm qytetarëve, do të thotë shtetasve dhe hyn në korpusin e të drejtave civile.
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ia garanton secilit lirinë e bashkimit me të tjerët, duke përfshirë edhe të drejtën e themelimit të sindikatës dhe të anëtarësimit në të me qëllim të mbrojtjes së

interesave të veta (neni 11.).¹⁶⁴ Prandaj, e pandashme nga liria e bashkimit është edhe liria e themelimit të sindikatës dhe të bashkimit, përkatësisht të mosbashkimit sindikal. Në nenin 5 të Kartës Sociale Evropiane (të reviduar më 1996, është parashikuar e drejta e punëtorëve dhe e punëdhënësve për të formuar organizata lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e interesave të veta ekonomike dhe shoqërore e po ashtu edhe e drejta për negociata kolektive (neni 6.), që nënkupton që sindikatave duhet mundësuar që të hyjnë në negociata kolektive që t'i mbajnë tubimet e tyre dhe që t'u mundësohet qasja tek punëtorët. Punëtorët dhe përfaqësuesit e tyre, të angazhuar në negociata kolektive apo/dhe ata që janë të anëtarësuar në sindikatë, nuk duhet që për këtë arsye të kenë pasoja të dëmshme në formë të largimit nga puna. Disa nga konventat të organizatave ndërkombëtare të punës i mbrojnë këto të drejta, si për shembull, Konventa nr. 87 për Liritë Sindikale dhe Mbrojtjen e të Drejtave Sindikale e vitit 1948, Konventa nr. 89, e cila ka të bëjë me zbatimin e parimit të së drejtës së organizimit dhe të negociatave kolektive e vitit 1949 dhe Konventa nr. 135 për mbrojtjen dhe lehtësitë që u ofrohen përfaqësuesve të punëtorëve në ndërmarrje, e vitit 1971.

3. Liria e bashkimit nuk përfundon vetëm në bashkimin sindikal, por nënkupton edhe të gjitha llojet e tjera të asociacioneve mbi baza të ndryshme dhe për interesa të ndryshme, të cilave për funksionimin normal të të cilave është i domosdoshëm ekzistimi i këtyre të drejtave dhe lirive. Në këto asociacione të tjera bëjnë pjesë: organizatat joqeveritare, shoqatat e pakicave kombëtare, shoqatat fetare, shoqatat profesionale e të tjera. Kufizimet e parashikuara me ligj të këtyre të drejtave duhet të jenë të domosdoshme në shoqërinë demokratike për katër arsye themelore:
- 1) mbrojtja e interesit të sigurisë nacionale apo të sigurisë publike;
 - 2) pengimi i trazirave apo kriminalitetit;
 - 3) mbrojtja e shëndetit apo moralit;
 - 4) mbrojtja e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve. Me këtë, natyrisht nuk pengohet kufizimi ligjor i realizimit të këtyre të drejtave të pjesëtarëve të forcave të armatosura, të policisë dhe administratës shtetërore.

Neni 44.1

1. Lirinë e bashkimit Kushtetuta e Republikës së Kosovës e garanton me dispozitë të përgjithshme. Përbajtja e lirisë së bashkimit nuk është përcaktuar më për së afërmi me dispozitën kushtetuese, por nga paragrafi 1. i nenit 44. të Kushtetutës, mund të përfundohet se kjo liri e përfshin edhe të drejtën e themelimit të organizatave pa marrje të lejes, që individit të jetë apo të mos jetë anëtar i ndonjë

¹⁶⁴ Kriteri i “vullnetarizmit” është theksuar veçanërisht në këto rast, e të cilat merren me qasjen “negative” në të drejtat nga neni 11., me fjalë të tjera, me të drejtën që të mos hyhet në shoqata apo sindikata. Gjykata e ka shqyrtuar këtë çështje në aktgjykimin në lëndën *Young, James dhe Webster kundër Mbretërisë së Bashkuar (1981.)*, në të cilin paraqitësit kanë pohuar se marrëveshja që e kanë nënshkruar Hekurudhat Britanike dhe disa sindikata të punëtorëve të hekurudhës, me të cilën punësimi kushtëzohet me anëtarësim në një nga ato sindikata, ka paraqitur shkelje të lirisë së bashkimit sipas nenit 11.

organizate, pra që të mos bashkohet (që të mbetet jashtë çfarëdo forme të bashkimit), si dhe të marrë pjesë në aktivitetet e ndonjë organizate.¹⁶⁵

2. Konsiderojmë se një parim, në kuadër të parimeve themelore të Kushtetutës, do të duhej të merrej vetëm me partitë politike, rregullimin e themelimit të tyre, njohjen e rolit të partive politike në formimin demokratik të vullnetit politik të qytetarëve, mënyrën e realizimit të pushtetit dhe eventualisht kufizimin e veprimit të partive politike, nëse ajo është e drejtuar në rrënimin me dhunë të rendit kushtetues, cenimin e të drejtave të garantuara të njeriut dhe të drejtave të pakicave apo nxitje të urrejtjes racore, nacionale apo fetare. Konsiderojmë, thjesht, se është dashur të përfshihet liria e bashkimit politik, e cila, si e drejtë subjektive e qytetarëve, e përfshin të drejtën e themelimit të partive politike dhe të shoqatave dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitetet e tyre politike e të tjera. Kjo, para së gjithash, për shkak se partitë politike janë të domosdoshme për formën e sotme të funksionimit të çdo shteti demokratik, shprehjen e vullnetit të qytetarëve dhe organizimin e zgjedhjeve demokratike, pas të cilave bëhet marrja e pushtetit në shtet. Pikërisht nëpërmjet partive politike dhe shoqatave, qytetarët marrin pjesë në realizimin e pushtetit politik dhe formimin e vullnetit politik.
3. Prandaj, në pajtim me parimin e demokracisë qytetare, në parimet themelore të Kushtetutës do të duhej garantuar shprehimisht pluralizmi politik dhe të njihej roli që në demokracitë qytetare e kanë partitë politike, si aktorë kryesorë të proceseve politike (identifikimi, profilizimi dhe artikulimi i vullnetit politik të qytetarëve dhe të përfaqësimit të tyre politik). Liria e themelimit të partive politike duhet të garantohet me ligj të veçantë, edhe pse rregullën parimore për lirinë e bashkimit, e cila e përfshin edhe të drejtën e themelimit të organizatave pa refuzim të lejes, e operacionalizojnë dispozitat kushtetuese në nenin 44. paragrafi 1. Rregulla parimore për themelimin e lirë të partive politike duhet të garantohet me Ligjin për Partitë Politike dhe të parashikohet se çka është e nevojshme për themelimin e partisë (statuti, programi, numri i caktuar i nënshkrimeve të qytetarëve të cilët e përkrahin formimin e partisë), në bazë të të cilave organi kompetent e regjistron partinë në regjistrin e partive politike.
4. Ndërkaq, as në Kushtetutë dhe as në ligjin përkatës, kësaj çështjeje nuk i kushtohet kujdes përkatës. Kushtetuta, më së shpeshti, në mënyrën më abstrakte, më të përgjithshme dhe parimore e rregullon një çështje të caktuar, ndërsa pastaj e orienton në tekstin përkatës ligjor apo nënligjor, me qëllim të konkretizimit të dispozitës së caktuar kushtetuese. Ndërkaq, këtu nuk kemi të bëjmë me këtë rast, prandaj konsiderojmë që sa më parë duhet miratuar Ligji për Partitë Politike apo

¹⁶⁵ Shih lëndën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KO97/12. Në paragrafët 115-137 të Aktgjykimit, Gjykata e ka elaboruar shkëlqen e të drejtës së bashkimit të lirë, së bashku me të drejtat e tjera pronësore. Të shihet: Aktgjykimi i datës 12 prill 2013 në rastin nr. KO97/12. (*Paraqitësi Ombudspersoni i Kosovës, vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 90,95 (1.6), 110,111 dhe 16 i Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Jobankare, nr.04/L-093, nga data 12 prill 2012*).

Ligji për Bashkimet Politike e të tjera, që kjo materie, jashtëzakonisht e ndjeshme dhe e rëndësishme, të mos mbetet e parregulluar. Gjëja e vetme që në këtë moment mund të shërbejë si ndonjë ndihmë në komentimin e lirisë së bashkimit, është Ligji për Lirinë e Bashkimit në Organizata Joqeveritare (i miratuar në Kuvend, me 12.02.2009 dhe i shpallur me Dekretin e Kryetarit nr. DL-002-2009, 06.03.2009).

5. Qëllimet dhe fushëveprimtaria e këtij Ligji janë përcaktuar në nenin 1. dhe në dispozitën që ai e rregullon themelimin, regjistrimin, udhëheqjen e brendshme, veprimtarinë, shlyerjen nga regjistri dhe ndërprerjen e punës së personave juridik të organizuar si organizata joqeveritare në Kosovë (paragrafi 1.). Çdo person në Kosovë gëzon të drejta të barabarta për bashkim dhe themelim të organizatave joqeveritare. Po ashtu, asnjë person nuk mund të obligohet për t'u bashkuar kundër vullnetit të tij, as të jetë i diskriminuar në çfarëdo mënyre, për shkak të vendimit të tij për t'u bashkuar apo mos u bashkuar (neni 3.). Ndërkaq, ajo që është e rëndësishme të theksohet, është fakti se ky ligj nuk vlen për partitë politike, sindikatat dhe organizatat sindikale, e as për qendrat fetare apo për faltoret dhe fushat e tjera që rregullohen me ligj të veçantë (paragrafi 2.).
6. Liria e bashkimit politik të qytetarëve është e datës së re në hapësirat e shteteve të ish-Jugosllavisë, kështu që me kushtetutat e vendeve të përmendura për herë të parë garantohet kjo liri, vetëm pas viteve njëzet të shekullit të kaluar. Sot, pluralizmi politik është dukuri plotësisht normale, e garantuar me Kushtetutë në të gjitha këto vende, gjë që, në realitet, përkatësisht në jetën reale është edhe në Republikën e Kosovës, por në Kushtetutë kjo nuk është garantuar me dispozitë të caktuar.

Neni 44.2

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e garanton të drejtën e themelimit të sindikatës dhe të organizimit me qëllim të mbrojtjes së interesave (neni 44. paragrafi 2.). Në të gjitha kushtetutat e reja patjetër garantohet e drejta e punëtorëve dhe e personave të tjerë të punësuar që lirisht të formojnë bashkime sindikale. Liria sindikale përfshin të drejtën për qasje në sindikatë pa diskriminim dhe që në të, të vepohet lirisht.
2. Pikërisht, duke u nisur nga funksioni i mbrojtjes së interesave profesionale dhe ekonomike, liria e bashkimit sindikal, zakonisht, përfshihet në të drejtat ekonomike të të punësuarve,¹⁶⁶ por, sipas natyrës së vet, njëkohësisht është edhe një formë e lirisë qytetare për t'u bashkuar, do të thotë e drejtë liberale e qytetarëve të punësuar. Siç kemi theksuar, liritë sindikale janë të pranuar edhe me dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, siç janë: Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Karta Sociale Evropiane dhe Konventa nr. 87 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Të gjitha këto dokumente ndërkombëtare i

¹⁶⁶ Türk, D., (1989), "Neka aktuelna pitanja ostvarivanja ekonomskih, socijalnih i kulturnih prava čoveka u svetlu rasprava u organima UN", *Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu*, nr. 5-6.,(Supplement), fq.691-696.

obligojnë shtetet anëtare që t'ia sigurojnë të drejtën çdo personi që me të tjerët të formojë sindikata dhe të hyjë në sindikatë sipas zgjedhjes së tij, si dhe të drejtën e këtyre asociacioneve që të formojnë organizata ndërkombëtare sindikale apo që të anëtarësohen në to. Sindikatat janë të lira në ushtrimin e veprimtarisë së tyre pa asnjë kufizim, pos atyre që janë përcaktuar:

- 1) në interes të mbrojtjes së sigurisë kombëtare apo të rendit publik;
- 2) në interes të mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të personave të tjerë.

Kufizimi i kësaj të drejte mund të zbatohet sipas dispozitës së Kushtetutës së Republikës të Kosovës (neni 44. paragrafi 2., “në bazë të ligjit për kategoritë e caktuara të të punësuarve”.

Neni 44.3

1. Në fund, Kushtetuta i përcakton edhe shkaqet (neni 44. paragrafi 3.) që mund të jenë bazë për ndalimin e veprimit të organizatës apo aktivitetit. Si shkak për ndalim theksohet aktiviteti i tyre, që është i orientuar në:
 - 1) rrënimin e rendit kushtetues;
 - 2) shkeljen e të drejtave dhe lirive të njeriut;
 - 3) nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike apo fetare.
2. Lidhur me shkaqet e përmendura në Kushtetutë për ndalimin e punës së organizatës apo të aktivitetit, shtrohen disa pyetje të arsyeshme. E para, është e paqartë pse ndër shkaqet e ndalimit të punës mungon theksimi, për shembull, i rrezikimit të sigurisë së Republikës, formimi i bashkimeve të fshehta dhe paraushtarake dhe shkaqet e tjera, të cilat Kushtetuta i përmend si shkaqe të kufizimit të lirive dhe të të drejtave të tjera, (për shembull, neni 38. paragrafi 4; neni 40 paragrafi 2; neni 42 paragrafi 2; neni 43)? Pse në mënyrë taksative janë përmendur vetëm katër veçori personale (nacionaliteti, raca, feja, përkatësia etnike), të cilat mbrohen në këtë mënyrë, ndërsa anashkalohen të gjitha të tjerat, po ashtu njësoj të rëndësishme, të cilat Kushtetuta i thekson lidhur me ndalesën e diskriminimit (neni 24. paragrafi 2.).¹⁶⁷
3. Vendosija për ndalimin e punës së organizatës apo të aktiviteteve që kanë për qëllim veprimet e përmendura kundërligjore, sipas paragrafit 3. të nenit 44. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i është besuar “gjykatës kompetente” e cila mund ta bëjë këtë me “vendim”. Konsiderojmë se këtu ka qenë e domosdoshme që të theksohet saktësisht se cila është kjo gjykatë, (me shikimin e kushtetutshmërisë krahasuese, mund të shihet lehtë se kjo më së shpeshti është Gjykata Kushtetuese) që të rregullohet juridiksioni i saj, veçanërisht kur është fjala për përmbajtjen e saj, cilësinë dhe vëllimin. Po ashtu, nuk është theksuar se me cilin vendim bëhet ndalesa e organizatës apo e aktivitetit të tillë.

¹⁶⁷ Për shkaqet e kufizimit, krahaso komentet me nenet 35, 38, 39, 40, 42 dhe 43.

Neni 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes]

- (1) Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.
- (2) Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
- (3) Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

Neni 45

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut në nenin 21. parashikon:

- 1) të drejtën dhe nevojën e zhvillimit të zgjedhjeve të kohëpaskohshme dhe të lira, nëpërmjet së drejtës së përgjithshme dhe unike të votimit, me votim të fshehtë apo me procedurë përkatëse, me të cilën sigurohet liria e votimit;
- 2) të drejtën e secilit që të marrë pjesë në qeverisjen e punëve publike të vendit të vet, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në mënyrë të lirë;
- 3) të drejtën e secilit që mbi bazë të barabartë të hyjë në shërbim publik në vendin e vet. Të njëjtën gjë e përcakton edhe Pakti Ndërkombëtar për Partitë Civile dhe Politike (neni 25.).

1. Me Protokollin nr.1 me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, shtetet kontraktuese kanë marrë obligim që në intervale të përshtatshme kohore të mbajnë zgjedhje të lira nëpërmjet votimit të fshehtë, me kushte që sigurojnë shprehje të lirë të mendimit të popullit gjatë zgjedhjes së organeve ligdhënëse (neni 3.). Kjo për arsye se e drejta e zgjedhjeve të lira ka rëndësi parësore për mbrojtjen dhe avancimin e demokracisë pluraliste. Në fakt, pa zgjedhje të lira, nuk mund të ketë demokraci. Po ashtu, mbajtja e zgjedhjeve të lira është parakusht për hyrje të ndonjë shteti në Këshillin e Evropës, Asambleja Parlamentare dhe forumet e tjera të të cilit janë të përfshira në përcjelljen e zgjedhjeve në nivel kombëtar dhe lokal. Konsiderohet se në shoqërinë e sotme, shfrytëzimi vetëm i së drejtës së votimit nuk është vetëm i mjaftueshëm, por është e domosdoshme që qytetarët t'i marrin përgjegjësitë e veta në jetën e bashkësisë dhe të marrin pjesë në funksionimin e institucioneve demokratike. Prandaj, Këshilli i Evropës, për ta nxitur pjesëmarrjen demokratike nëpërmjet aksionit “Të drejtat e njeriut” dhe “Programi i demokracisë reale”, ka iniciuar shumë aktivitete dhe projekte.
2. *E drejta e përgjithshme e zgjedhjes* nuk do të thotë se ajo i përket çdo qytetari pa dallim. Mund të vendosen edhe kushtet e caktuara për arritjen e saj, por kushtet duhet të jenë të tilla, që çdo shtresë e shtetasve, pjesëtar i çdo shtrese shoqërore, të mund t'i plotësojë. Sot zbatohet parimi i ashtuquajtur i *së drejtës së përgjithshme të votimit*, sepse gjatë evolucionit të saj, e drejta e zgjedhjes, me kohë e ka fituar karakterin e të drejtës së përgjithshme.¹⁶⁸ Ndërkaq, pavarësisht nga baza e vet

¹⁶⁸ Në lëndën *Matthews kundër Mbretërisë së Bashkuar (1999.)*, Gjykata ka konstatuar shkeljen

demokratike, politike-juridike, e drejta e zgjedhjes një kohë të gjatë ka qenë e rezervuar për një numër të vogël të popullsisë, me rregullim të theksuar të censuseve të ndryshme apo mbi baza të tjera diskriminuese.¹⁶⁹

3. Përkundër së drejtës së përgjithshme, ekziston *e drejta e kufizuar e zgjedhjes*, e cila u njihet vetëm atyre qytetarëve, të cilët e kanë arritur një census të caktuar-qoftë pronësor (lartësia e caktuar e tatimit, që do të thotë se sa më e lartë të jetë ajo, aq më e kufizuar është e drejta), qoftë intelektual (shkollimi) apo, së paku, të diturit e shkrimit dhe leximit. *E drejta e barabartë zgjedhore* do të thotë që vota e çdo zgjedhësi, parimisht, duhet të vlejë njësoj. E kundërta e kësaj është *votimi plural*, do të thotë kur ndonjë zgjedhës i merr dy apo tri vota, ndërsa tjetri vetëm një, si dhe e ashtuquajtura *zgjedhje kuriale*, do të thotë kur grupi apo “kuria” prej, për shembull, 1000 pronarë të mëdhenj, zgjedhin aq deputetë, sa edhe masa e qytetarëve të varfër prej, të themi, 1.000.000 zgjedhësish (nëse secili prej tyre do të kishte vetëm nga një votë, do të dilte që vota e pronarit të madh, sipas fuqisë së saj, është 1000 herë më e fortë nga vota e pjesëtarit të shtresës së ulët).
4. Barazia e plotë e së drejtës së zgjedhjes nuk mund të arrihet askund, por ajo më për së afërmi arrihet në sistemin e ashtuquajtur të përfaqësimit proporcional. *Zgjedhje të drejtpërdrejta* janë ato zgjedhje, kur secili zgjedhës e jep votën e vet për kandidatin e caktuar për deputet, e jo për të besuarit, të cilët pastaj do t’i zgjidhnin deputetët (për shembull, në çdo 100 zgjedhës apo në çdo komunë zgjidhet çdo i besuar). Zgjedhësi ka rëndësi më të madhe kur drejtpërsëdrejti e jep votën e vet. Ai personalisht e zgjedh kandidatin më të përshtatshëm dhe nuk mund të mashtrohet nga ana e të besuarit.

e nenit 3. të Protokollit nr.1 kur një qytetar i Gjibraltarit ka provuar që të regjistrohet si votues në zgjedhjet për Parlamentin Evropian, por kjo nuk i është lejuar në bazë të asaj që Akti i Unionit Evropian e kufizon të drejtën e votimit për Parlamentin Evropian vetëm në Mbretërinë e Bashkuar. Duke konkluduar se bëhet fjalë për shkelje, Gjykata ka thënë se Parlamenti Evropian paraqet një organ të rëndësishëm ligjdhënës të Unionit Evropian, dispozitat e të cilit ndikojnë në popullsinë e Xhibraltarit në të njëjtën mënyrë siç e bëjnë këtë ligjet e tjera në rendin juridik të vendit.

¹⁶⁹ Më i rëndësishmi ndër këto censuse ka qenë *censusi pasuror*, prandaj të drejtën e votimit e kanë pasur vetëm qytetarët që kanë paguar një shumë të caktuar të tatimit apo që kanë qenë pronarë të të mirave të paluajtshme. Po ashtu, ka ekzistuar edhe *censusi i gjinisë*, i cili i ka përjashtuar femrat nga e drejta e votimit (për herë të parë femrave u është njohur e drejta e votimit në Suedi më 1876, në njësinë federale amerikane Vajoming, më 1869. Pas luftës së dytë botërore, femrave u është njohur çdokund e drejta e zgjedhjes, përveç në Zvicër, ku kjo e drejtë është njohur vetëm në vitin 1971. *Censusi i vendqëndrimit apo domicilit* ka kërkuar nga zgjedhësit që për një kohë të caktuar para zgjedhjes të jenë banorë të shtetit, përkatësisht të njësisë zgjedhore ku duhet të votohet. Kështu, nga zgjedhja është përjashtuar një numër i madh i punëtorëve-migrantëve. *Censusi arsimor* e ka kushtëzuar fitimin e të drejtës së zgjedhjes me arritjen e caktuar të një shkalle të arsimit, me marrjen e titullit, thirrjes, diplomës së caktuar e të ngjashme. Një nga kufizimet e zbatuara më rrallë të së drejtës së zgjedhjes, ka qenë e bazuar në diskriminimin e hapur racor, për shembull, politika e Aparteidit në Republikën Jugafrikane, ndaj tërë popullsisë zezake.

5. Besimi i dhënë njëherë deputetëve të popullit nuk mund të revokohet më. Pasi që ai *de facto* mund të humbet, pasi që ai besim nuk është kurrë i përhershëm, kohë pas kohe duhet të ripërtërihet. Çdo regjimi demokratik do t'i konvenonte përsëritja sa më e shpeshtë e zgjedhjeve apo, siç thuhet në zhargonin politik, të bërit sa më shpesh “apel popullit”. Së paku një herë në vit do të duhej përtërirë trupi parlamentar. Ndërkaq, kjo nuk mund të zbatohet, sepse organizimi dhe realizimi i zgjedhjes kushton shumë, gjatë kohës së kryerjes së zgjedhjeve “makineria parlamentare” nuk funksionon, vendi është në gjendje të tensionuar dhe në luftë politike. Këto, nga ana tjetër, janë shkaqet që imponojnë zgjedhje më të rralla. Kështu, në disa shtete të caktuara zgjedhjet mbahen në intervale prej 3-7 vjet ndërsa në hapësirat e vendeve të ish-Jugosllavisë është miratuar, sipas shumicës zgjidhja më e pranueshme, që të ekzistojë periudha mandatore prej 4 vjetësh. Në këtë periudhë parlamenti (kuvendi) nuk përtërihet pjesërisht por plotësisht: posa të kalojnë 4 vjet nga dita e zgjedhjeve, të gjithë deputetët e humbin mandatin dhe duhet të mbahen zgjedhjet e përgjithshme për të gjitha vendet e deputetëve. Deputetët e vjetër mund të kandidohen përsëri dhe, nëse zgjedhën, e fitojnë mandatin e ri katërvjeçar.
6. Intervali katërvjeçar nga zgjedhjet në zgjedhje, quhet periudhë kuvendare apo legjislativë. Konsiderohet se ky është interval i mjaftueshëm kohor që kuvendi ta kryejë detyrën e parashtruar legjislativë, sado që ajo të jetë e madhe dhe e gjerë. Mandati mund të ndërpritet edhe më herët, në rastet që i parashikon ligji zgjedhor, edhe pse, më së shpeshti për këtë flet edhe vetë Kushtetuta. Duhet dalluar ndërprerja (humbja) kolektive, përkatësisht e përgjithshme dhe e veçantë e mandatit. Humbja e parakohshme kolektive e mandatit ndodh për shkak të shpërndarjes së parlamentit (kuvendit). Zgjedhjet që bëhen atëherë, po ashtu, janë zgjedhje të përgjithshme, por për dallim nga zgjedhjet që bëhen pas periudhës së plotë legjislativë (të ashtuquajturat zgjedhje të lira), këto janë zgjedhje të jashtëzakonshme. Nëse kuvendi që del nga zgjedhjet e jashtëzakonshme mbetet në funksion gjatë tërë periudhës katërvjeçare, atëherë zgjedhjet pasuese do të jenë përsëri të rregullta. Humbja individuale e mandatit ndodh për shkaqe të ndryshme, të cilat, më së shpeshti, lidhen me personalitetin e vetë deputetit dhe këto shkaqe, kushtetutat e caktuara i parashikojnë në mënyra të ndryshme, kështu që këtu nuk do t'i theksojmë në mënyrë të veçantë.
7. E drejta e zgjedhjes është e drejtë e garantuar kushtetuese e qytetarëve për t'i zgjedhur përfaqësuesit dhe për të qenë të zgjedhur në organet përfaqësuese të shtetit, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe të autonomisë territoriale (nëse ekziston), si dhe e drejta për të zgjedhur dhe për të qenë të zgjedhur për kryetar të shtetit, guvernator të njësisë federale, kryebashkiak apo në funksione të tjera punëdrejtuese publike. Si një nga të drejtat më të rëndësishme politike, përkatësisht të drejtat subjektive publike, e drejta e zgjedhjes është një mënyrë e pjesëmarrjes së tërthortë të qytetarëve në jetën politike të shtetit. Në shumicën e shteteve, e drejta e zgjedhjes apo e drejta e votës konsiderohet e drejtë personale, do të thotë autorizim juridik të cilin qytetarët mundën, por nuk janë të obliguar ta shfrytëzojnë. Vetëm në një numër më të vogël të shteteve votimi është shpallur si

obligim qytetar, për shembull, në Belgjikë, Greqi, Austri, Itali etj. Në shtetet e tilla, ku është i kushtëzuar ky detyrim, shkelja e detyrimit të votimit apo abstenimi zgjedhor, më së shpeshti, përcillet me sanksionim në formë të dënimit me të holla.

8. Në të gjitha shtetet, kusht për ta pasur të drejtën e zgjedhjes është shtetësia.¹⁷⁰ Kushtetutat e disa vendeve evropiane ua njohin të drejtën e zgjedhjeve të huajve për zgjedhjen e organeve përfaqësuese lokale (siç është rasti në Suedi, Spanjë, Holandë dhe në shtete të tjera). Në shtetet anëtarë të Unionit Evropian, e drejta e zgjedhjes u njihet të gjithë qytetarëve të Unionit për zgjedhjen e anëtarëve kombëtar të Parlamentit Evropian dhe për zgjedhjet komunale. Kur është fjala për të drejtën për të zgjedhur, pra për të drejtën zgjedhore, duhet thënë se ajo paraqitet në dy forma themelore, që janë:
- 1) e drejta aktive zgjedhore (e drejta për të zgjedhur);
 - 2) e drejta pasive zgjedhore (e drejta për të qenë i zgjedhur).

Neni 45.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, kështu, e garanton të drejtën e zgjedhjes, sipas kushteve të cilat i ka përcaktuar vet, drejtpërsëdrejti. Pra, çdo qytetari të Republikës së Kosovës i garantohet e drejta aktive dhe pasive e zgjedhjes, do të thotë e drejta për të zgjedhur dhe për të qenë i zgjedhur.¹⁷¹ Kjo e drejtë fitohet pas arritjes së moshës së pjekurisë prej 18 vjetësh, madje edhe nëse personi e ka arritur moshën e pjekurisë pikërisht në ditën e zgjedhjeve, me kusht që kjo e drejtë të mos jetë e kufizuar me vendim gjyqësor.¹⁷² Pra, Kushtetuta më për së afërmi i rregullon vetëm këto dy forma të së drejtës së zgjedhjes dhe thekson se kushtet për arritjen e këtyre dy të drejtave të përmendura janë të njëjta (neni 45. paragrafi 1.).

¹⁷⁰ Krahaso: Qok, V., (1996), “Shtetësia në sistemin e lirive dhe të të drejtave të njeriut”, jeta juridike, nr. 9, faqe 493-507; Belamy, Richard, (2008) ‘citizenship: A very short introduction’ Oxford University Press: Oxford, kapitulli 4 (“Rights and the “Right to Have Rights”)” fq. 78-96; dhe kapitulli 5 (“Participation and Democracy”) fq. 97-123

¹⁷¹ Shih lëndët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KI 22/11 dhe KI 32/10. Në paragrafët 16-25, Gjykata e ka elaboruar çështjen e të drejtave zgjedhore në rastin konkret, edhe pse fjala ka qenë për një rast të palejueshëm për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike. Krahaso: Aktvendimi për moslejueshmëri i datës 19 maj 2011 në rastin nr. KI22/11. (*Paraqitës Bojana Deniq. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së panelit zgjedhor për ankesa dhe parashtrës, A. nr. 263/2010, datë 12 nëntor 2010*)

¹⁷² Kushtet për ta pasur të drejtën pasive zgjedhore, zakonisht janë më restriktive se ato për të drejtën aktive të votimit.

Aftësia e deputetit më së shpeshti është më e ngushtë se aftësia zgjedhore, veçanërisht për shkak të dallimit në censusin e moshës, ndërsa arsytimi kërkohet në kërkesën e pjekurisë më të madhe politike që duhet ta kenë anëtarët e organeve përfaqësuese veçanërisht në dhomën e lartë të parlamentit. Kështu, kufiri i moshës për anëtarët e parlamentit sillet nga 18 vjet në Portugali dhe Holandë, 19 në Austri, 21 në Federatën Ruse, 23 në Francë, e deri në 25 vjet në Itali, Gjermani dhe Greqi. Për kryetar të republikës, kufiri i moshës është edhe më i lartë dhe sillet nga 35 vjet në Austri, Portugali dhe në Federatën Ruse, 40 në SHBA, Gjermani dhe Greqi, e deri në 50 vjet në Itali.

2. Natyrisht, përveç së drejtës aktive dhe pasive zgjedhore, e drejta e zgjedhjes dhe pjesëmarrja e garantuar me Kushtetutë, përfshin edhe disa të drejta të tjera, të cilat qytetarët i realizojnë në zgjedhje, si, për shembull:
 - 1) të drejtën e qytetarëve për t'i kandiduar deputetët;
 - 2) të drejtën e qytetarëve për t'i shfrytëzuar instrumentet juridike për mbrojtjen e të drejtës së zgjedhjes para organeve kompetente për mbrojtjen e kësaj të drejte;
 - 3) të drejtën e qytetarëve që objektivisht të jenë të informuar për programet zgjedhore të kandidatëve për deputetë e të tjera.
3. Këtu duhet theksuar se e drejta zgjedhore pasive u nënshtrohet kufizimeve kushtetuese, të cilat kanë të bëjnë me mospërputhshmëri parlamentare. Pra, Kushtetuta parimisht, e ndalon konfliktin e interesit, ndërsa veçanërisht e rregullon mospërputhshmërinë parlamentare (neni 72.). Do të thotë, deputeti popullor sipas kësaj dispozite kushtetuese, nuk mundet që, njëkohësisht:
 - 1) të punojë në administratën shtetërore apo në ndonjë ndërmarrje tjetër publike;
 - 2) të kryejë ndonjë funksion tjetër ekzekutiv.
4. Po ashtu, ky inkompatibilitet, do të thotë mospërputhshmëri, është parashikuar edhe me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (të miratuar në Kuvend, më 05.06.2008, të shpallur me Dekretin e Kryetarit nr. DL-027-2008, më 15.06.2008), i cili përcakton se personi që është anëtar i ndonjë organi tjetër të zgjedhur ligjdhënës, nuk mund të fitojë vend në Kuvendin e Kosovës. Pos kësaj, deputeti i Kuvendit, i cili është bërë anëtar i ndonjë organi tjetër të zgjedhur ligjdhënës, pasi që e ka fituar vendin e deputetit në Kuvend, duhet ta ndërpresë mandatin e vet në Kuvend (neni 29. paragrafi 5.).
5. Nëpunësi publik që kandidohet për deputet të Kuvendit është i obliguar që të marrë pushim nga dita e fillimit të fushatës zgjedhore (neni 29. paragrafi 6.). Konsiderojmë së ky konflikt interesi, pra mospërputhshmëria e kryerjes së funksionit të deputetit me funksionet e tjera, do të duhej të përpunohej edhe më shumë dhe në mënyrë më të detajuar. Para së gjithash, është dashur të parashikohet se a mundet deputeti, si përfaqësues i pushtetit ligjdhënës, të jetë anëtar i qeverisë, do të thotë përfaqësues i pushtetit ekzekutiv, a mund të jetë Kryetar i Republikës, si dhe a mund të jetë gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës Supreme apo i ndonjë gjykate tjetër të rregullt, prokuror apo zëvendës i tij, pra a mund të jetë përfaqësues i pushtetit gjyqësor. Këto janë pyetje shumë të rëndësishme të cilat duhet të parashihen detajisht në Kushtetutë apo në ligjin përkatës, sepse për sigurimin e demokracisë është e domosdoshme që pushteti të organizohet dhe të realizohet sipas parimit të ndarjes së pushtetit në ligjdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, e jo sipas parimit të unitetit apo të përzierjes së pushtetit.
6. Edhe Kushtetuta, edhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i japin rëndësi të gjerë përmbajtjes së të drejtës zgjedhore. Kjo e drejtë është definuar si e drejtë zgjedhore e qytetarëve. Ligji i përmendur i përcakton parimet themelore, të cilave duhet t'i nënshtrohet zbatimi dhe administrimi i

zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe ligjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet (neni 2.). Kështu, zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës duhet të organizohen në bazë të votimit të lirë, universal, të njëjtë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë, në pajtim me këtë ligj dhe me rregullat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Po ashtu, votuesit kanë të drejtë të barabartë të votimit dhe kanë të drejtë që të japin numër të barabartë të votave në të njëjtat zgjedhje, ndërsa çdo qytetar i Kosovës ka të drejtë të votojë dhe të zgjedh pa asnjë diskriminim në bazë të racës, përkatësisë etnike, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, bindjes fetare apo politike, arsimit apo të ngjashme, në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Parimet e përmendura, në të vërtetë, paraqesin vetëm konkretizim dhe sqarim të mëtejme të dispozitës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të përfshirë në paragrafin 2, sipas së cilës votimi është personal, i barabartë, i lirë dhe i fshehtë.

Neni 45.2

1. Dispozita kushtetuese se votimi është personal, do të thotë se kjo e drejtë kushtetuese nuk mund të bartet mbi tjetrin, se askush nuk mund të votojë në emër të huaj, por që çdokush duhet të paraqitet personalisht në vendin përkatës të zgjedhjeve dhe ta shfrytëzojë të drejtën e tij të zgjedhjes. Nëse nuk e bën këtë, do të thotë se e shfrytëzon abstenimin zgjedhor, por për këtë nuk do të sanksionohet nga ana e shtetit, siç është parashikuar në disa shtete evropiane (dënim me të holla për mosdalje në zgjedhje). Sa i përket përcaktimit të parimit të së drejtës së barabartë të votimit, të dispozitës kushtetuese se votimi është i barabartë (neni 45. paragrafi 2.), duhet thënë se nga parimi i barazisë juridike dhe i doktrinës së sovranitetit popullor, del se e drejta e zgjedhjes duhet të jetë e njëjtë për të gjithë qytetarët. Në të vërtetë, e drejta e njëjtë në zgjedhje, si dhe e drejta e përgjithshme në zgjedhje, gradualisht ka ardhur pas fitores së ideve liberale-demokratike në shumë shtete, e veçanërisht parimet e barazisë së të gjithë njerëzve, përkatësisht qytetarëve. Barazia e votimit, pra barazia e të drejtës së votimit, do të thotë se të gjitha votat e zgjedhësve duhet të kenë vlerë të njëjtë nominale sipas rregullës që në një palë zgjedhje, një zgjedhës e ka vetëm një votë.
2. Mosbarazia e të drejtës zgjedhore do të thotë që zgjedhësit nuk kanë numër të njëjtë të votave, por që zgjedhësit e caktuar e kanë vetëm një votë, ndërsa të tjerët i kanë nga dy apo më shumë vota.¹⁷³
3. E drejta për të zgjedhur, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është *e lirë*, gjë që Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës e përpunon më

¹⁷³ Këtu është zbatuar i ashtuquajhuri *votim plural*, ndërsa baza për të fituar vota plotësuese ka qenë pronësia mbi paluajtshmëritë, arsimit universitar, fitimi i rentës së caktuar e të tjera. Nga sistemi i të drejtës pluraliste të votës, është dalluar sistemi i votimit të shumëfishtë apo të shumëzuar, i ashtuquajhuri *votimi i shumëzuar* (në këtë sistem formalisht e kanë pasur nga një votë në të njëjtat zgjedhje, por zgjedhësit e caktuar kanë mundur të votojnë në më shumë vende, do të thotë në më shumë njësi zgjedhore, nëse në to kanë pasur paluajtshmëri të parashikuara me ligj). Forma e tretë e së drejtës së pabarabartë zgjedhore ka qenë *votimi familjar*, sipas të cilit udhëheqësi i familjes ka pasur aq vota sa ka pasur anëtarë të moshës së rritur të familjes së tij.

tutje. Pra, liria dhe privatësia e dhënies së votës është e garantuar dhe askush nuk ka të drejtë t'ia mohojë të drejtën e votës ndonjë qytetari, as ta detyrojë në çfarëdo mënyre që ta konsiderojë përgjegjës për votën e dhënë apo të përgjigjet për atë se nuk e ka dhënë votën (neni 2.). Po ashtu, të gjitha subjektet politike kanë të drejtë për fushatë të lirë dhe të barabartë dhe propagandë zgjedhore nëpërmjet medieeve, me mbajtjen e fushatave politike, shpalljen dhe përhapjen e materialit zgjedhor. Subjektet politike kanë të drejtë për mundësi të barabarta të shfrytëzimit të radios dhe të televizionit, të mjeteve publike dhe formave të tjera të përkrahjes. Së fundi, kur është fjala për të drejtën zgjedhore, duhet thënë se Kushtetuta parashikon se votimi është i fshehtë, që është kusht mjaft i rëndësishëm për sigurimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Pra, fshehtësia e votimit u është garantuar qytetarëve në vendin e votimit dhe është e mbrojtur me ligj, kështu që askush nuk mund të përcaktojë se kush për kë ka votuar, qytetari nuk mund të thirret në përgjegjësi për shkak të shprehjes së lirë të vullnetit. Është mjaft e rëndësishme që të theksohet kjo, sepse votimi i lirë dhe i fshehtë është bazë e rëndësishme e sigurimit të demokracisë në çdo shtet.

4. Pra, Kushtetuta i rregullon karakteristikat e përgjithshme të zgjedhjeve të lira, demokratike dhe të drejta:

- 1) zgjedhjet i karakterizon drejtpërdrejtshmëria, qytetarët i zgjedhin përfaqësuesit e vet personalisht, pra drejtpërsëdrejti, të drejtën e tyre zgjedhore nuk mund ta bartin mbi tjetrin dhe nuk mund ta autorizojnë askënd tjetër që të votojë në emër të tyre;
- 2) e drejta zgjedhore është e përgjithshme - e gëzojnë të gjithë shtetasit në kushte të barabarta;
- 3) e drejta zgjedhore është e barabartë - vota e çdo zgjedhësi individual ka vlerë të barabartë (barazia politike - parimi “një njeri-një votë”);
- 4) votimi është i fshehtë - e siguron lirinë e zgjedhjes.

Këtu nuk mund ta përfundojmë komentin e nenit të përmendur e të mos e përmendim faktin se personave të caktuar u mohohet e drejta e zgjedhjes, do të thotë mundësia për të votuar. Kështu, për shembull, gjatë historisë, ka pasur raste që me Kushtetutë të parashihen shkaqet e humbjes së përkohshme të së drejtës së zgjedhjes, për shembull, për personat:

- 1) që janë dënuar me dënim me burg;
- 2) që janë dënuar për humbje të të drejtave të nderit për tërë kohën deri sa ai dënim zgjat;
- 3) të cilët janë në falimentim;
- 4) të cilët janë nën përkujdesje;
- 5) të cilët me aktgjykim e kanë humbur të drejtën për të zgjedhur në zgjedhje për shkak të fajeve zgjedhore.

Edhe sot, në disa shtete, madje shumë të zhvilluara, është në fuqi sistemi zgjedhor i cili kategorive të caktuara të personave ua ndalon të drejtën e votimit, pra ua mohon të drejtën e zgjedhjes. Madje, si shkaqe për kufizim të kësaj të drejte parashikohet invaliditeti fizik, e të mos flasim për burgun, dënimin me burg, dënimin shumëvjeçar me burg, humbjen e të drejtave civile e të tjera. Ligji për

zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës parashikon se personi nuk mund të votojë:

- 1) nëse është duke e vuajtur dënimin që e ka caktuar Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë;
 - 2) nëse është nën hetim të Tribunalit dhe nuk e ka respektuar urdhrin për paraqitje në Tribunal;
 - 3) nëse është shpallur mendërisht i sëmurë me vendim të formës së prerë të Gjykatës.
5. Edhe pse të gjitha liritë dhe të drejtat individuale të garantuara me Kushtetutë, gëzojnë të drejtën e cila përfshin mbrojtjen gjyqësore, si formë parësore e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, mbrojtjes kushtetuese-gjyqësore si formë e mbrojtjes së drejtpërdrejtë kushtetuese të të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë, si dhe e drejta para institucioneve ndërkombëtare. Çdo kushtetutë duhet që veçmas të përcaktojë se e drejta e zgjedhjes dhe pjesëmarrja gëzon mbrojtjen juridike dhe se mënyrën e realizimit të së drejtës për mbrojtje juridike të kësaj të drejte, duhet ta rregullojë ligji, në kufijtë dhe vëllimin që parimisht e definojnë Kushtetuta. Ndërkaq, Kushtetuta e Republikës së Kosovës këtë nuk e përcakton shprehimisht, përveç që me një nen të përgjithshëm e siguron mbrojtjen ligjore të së drejtës, duke parashikuar që çdokush ka të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes apo të mohimit të ndonjë të drejte që i është garantuar me këtë Kushtetutë, si dhe të drejtën për masa efikase juridike, nëse konstatohet se e drejta është shkelur.
6. Të drejtën e zgjedhjes në të gjitha shtetet e ka niveli i së drejtës themelore të qytetarëve dhe, si e tillë, gëzon mbrojtjen më të gjerë juridike. Më së shpeshti kjo është mbrojtja juridike në kompetencë të gjykatave të rregullta, ndërsa në disa shtete, e drejta zgjedhore e ka edhe mbrojtjen nga ana e gjykatave kushtetuese. Gjykata Kushtetuese e Kosovës e parashikon mbrojtjen gjyqësore të së drejtës (neni 54.) me dispozitën që secili ka të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes apo të mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë. Po ashtu, me këtë dispozitë garantohet edhe e drejta për masë efikase juridike, nëse konstatohet se e drejta e caktuar është shkelur. Kjo do të thotë se kjo mbrojtje gjyqësore ka të bëjë edhe me të drejtën e zgjedhjes dhe të pjesëmarrjes, të garantuar me nenin 45. të Kushtetutës.
7. Duke pasur parasysh rëndësinë e të drejtës së zgjedhjes, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës e ka parashikuar formimin e Komisionit Zgjedhor për Lutje dhe Ankesa, si dhe të organit të përhershëm e të pavarur, të autorizuar për shqyrtimin e ankesave dhe të lutjeve që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. Kryetari i Gjykatës Supreme i emëron anëtarët e këtij Komisioni nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe të gjykatave të qarkut, mandati i të cilëve është 4 vjet, me mundësi të rizgjedhjes. Personi fizik apo juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë rrezikuar me çfarëdo vendimi të Komisionit Qendror Zgjedhor, mund t'i paraqesë ankesë kundër atij vendimi Komisionit Zgjedhor për Lutje dhe Ankesa, i cili mund ta pranojë atë ankesë, nëse konstaton

se vendimi i ankimuar ka qenë joadekuat, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat. Komisioni Zgjedhor, nëse e pranon ankesën lidhur me vendimin e Komisionit Qendror Zgjedhor, munde ta urdhërojë atë që:

- 1) përsëri ta shqyrtojë vendimin e vet;
- 2) të ndër marrë masa për evitimin e pasojave.

8. Përveç dispozitave të përgjithshme për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (neni 21. paragrafi 1. dhe neni 54.) dhe të dispozitave të veçanta për kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut (neni 113. paragrafi 7.) dhe për të vendosur për shkeljet eventuale të Kushtetutës gjatë zgjedhjes së Kuvendit (neni 113. paragrafi 5.), shtrohet pyetja se a është e nevojshme një dispozitë e veçantë për “mbrojtjen juridike” të së drejtës zgjedhore në përgjithësi, do të thotë “e drejta e zgjedhjes dhe e pjesëmarrjes”, siç e thekson këtë Kushtetuta në tekst apo ekzistimi i saj mund të jetë vetëm pretekst që në zbatimin e dispozitave kushtetuese të bëhen supozime për vendosjen edhe të ndonjë forme të mbrojtjes, vetëm të kësaj të drejte të veçantë (për shembull, mbrojtja nga ana e organit për zbatimin e zgjedhjeve). Në të vërtetë, këtu kemi të bëjmë me këtë formën e dytë të mbrojtjes gjyqësore të kësaj të drejte, në kuptimin që Kushtetuta në këtë paragraf të nenin 45 paraqet prezumime për vendosjen e disa shkallëve dhe të formave të mbrojtjes së kësaj të drejte, e cila më vonë rregullohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë. Në vështrim të këtij Ligji, shkalla e parë dhe forma e mbrojtjes së kësaj të drejte është mbrojtja administrative brenda Komisionit Qendror Zgjedhor (neni 64 lidhur me nenin 98); e dyta është kinse mbrojtja gjyqësore (105;118-119), ndërsa e treta është mbrojtja e plotë gjyqësore në Gjykatën Supreme të Kosovës (neni 118.4). Instanca e fundit e mbrojtjes është në Gjykatën Kushtetuese sepse, siç thotë Ligji në nenin 106. paragrafi 1, zgjedhjet nuk mund të certifikohen derisa ekziston procedura ankimore në Gjykatën Kushtetuese lidhur me mbrojtjen e të drejtave zgjedhore.¹⁷⁴

Neni 45.3

1. Për shkak të tërë kësaj që u tha, konsiderojmë që, në vend të “e drejta e zgjedhjes” (që nuk thotë në zgjedhje të kujt, pra të cilit organ), do të duhej të ishte “e drejta e zgjedhjeve të lira” apo “e drejta zgjedhore”, apo duhet të përdoret një shprehje tjetër, më e përshtatshme. Po ashtu, në emërtimin e këtij neni, pranë “të drejtës së zgjedhjes” është “edhe pjesëmarrja”. Nuk shihet se ku qëndron kjo pjesëmarrje, përveçse në paragrafin 3 gjendet dispozita për përkrahjen e mundësisë për pjesëmarrje të të gjithë personave në aktivitetet publike. Kur është fjala për “e drejta e pjesëmarrjes”, Kushtetuta përcakton që institucionet shtetërore e përkrahin mundësinë e pjesëmarrjes së të gjithë personave në aktivitetet publike dhe të drejtën e secilit që në mënyrë demokratike të ndikojë në vendimet e organeve publike. Kjo mund të arrihet vetëm nëpërmjet zgjedhjeve të lira, shumëpartiake dhe të fshehta, për çka do të flitet më vonë.

¹⁷⁴ Krahaso: Paragrafët 20-36 të Aktvendimit për papranueshmëri të datës 22 mars 2010 në rastin KI73/09. (*Paraqitësi i kërkesës Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor*).

Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

- (1) E drejta e pronës është e garantuar.
- (2) Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
- (3) Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
- (4) Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.
- (5) Prona intelektuale mbrohet me ligj.

Neni 46

1. Çdokush ka të drejtë të ketë pasuri, vetëm apo në bashkësi me të tjerët dhe askush nuk bën që në mënyrë arbitrare të privohet nga pasuria e vet.¹⁷⁵ Këto dispozita për mbrojtjen e pronësisë i përmban Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (neni 17.) dhe kjo nënkupton jo vetëm lirinë e fitimit dhe të posedimit të pasurisë, por ia përjashton edhe të drejtën kujtdoqoftë që tjetrit në mënyrë arbitrare t’ia marrë pasurinë. Natyrisht, këtu duhet pasur parasysh se ekziston konfiskimi i pasurisë në emër të interesit publik, nëpërmjet shpronësimit, që nuk është në kundërshtim me parimet e përmendura, (me kusht që të jetë e zbatuar në mënyrë restriktive dhe detyrimisht e shoqëruar me kompensim të drejtë të tregut). Lidhur me këtë, në vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore është shtruar çështja e restitucionit të pasurisë (denacionalizimit), që të ashtuquajturat “vende në tranzicion” e zgjidhin me legjislacion të brendshëm, në pajtim me parimet e përgjithshme të mbrojtjes dhe ruajtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në atë fushë.¹⁷⁶

¹⁷⁵ Gjykata ka shqyrtuar mjaft lëndë në të cilat është dashur të përkufizohet natyra e “pasurisë” sipas nenit 1 të Protokollit nr.1. Sipas interpretimit me një logjikë të shëndoshë të termit, duke përfshirë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, Gjykata konsideron se termi “pasuri” ka të bëjë me të gjitha “të drejtat e dhëna” të cilat individi mund t’i përcaktojë, duke përfshirë edhe gjërat private juridike siç është e drejta e lidhjes së kontratave për blerje të banesës (*Melacher e të tjerët kundër Austrisë (1989.)*) apo aksionet ose kërkesat në të holla në bazë të kontratës apo të pagesës së dëmit. (*Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë (1994.)*). Përfshin edhe të drejtat e fituara nëpërmjet fondit pensional dhe të sistemit të mbrojtjes sociale (*Vasilopoulou kundër Greqisë (2002.)*), “prijta ilegale” se pasuria do të mund të ndërtohej në pajtim me planin urbanistik ligjor të regjistruar (*Pine Valley Development Ltd. e të tjerët kundër Irlandës (1981.)*), kërkesa ligjore e vlerës materiale (*S.A. Dangeville kundër Francës (2002.)*), lejet e dhëna lidhur me aktivitetin e firmës (*Tre traktorere Aktiebolog kundër Suedisë (1989.)*), vullnetin e mirë të krijuar nëpërmjet marrëdhënieve profesionale (*Van Marle dhe të tjerët kundër Hollandës (1986.)*) dhe kërkesat për kompensim për pasurinë e shpronësuar (në tekstin vijues).

¹⁷⁶ Çështja e restitucionit të pasurisë së nacionalizuar nga ana e regjimeve të kaluara komuniste ka qenë një nga çështjet më të ndjeshme në këto vende, krahas çështjeve të ashtuquajtura të

2. Këtu duhet thënë diçka për termin e përmendur më sipër “*eksproprijim*” apo, siç thuhet edhe, *shpronësim*. Në të vërtetë, shpronësimi është marrje me dhunë e pronësisë mbi ndonjë gjë dhe kjo është e lejueshme vetëm nëse ligji e parashikon shprehimisht këtë. Kjo mund të ndërmerret vetëm për interes të përgjithshëm dhe vetëm me kompensim të drejtë (të duhur), që mund të përbëhet nga ndërrimi i pronës së të njëjtit lloj apo të ngritjes së të njëjtës ndërtesë apo, më së shpeshti në të holla. Kompensimit i paraprin vlerësimi i profesionistëve të degës përkatëse, d.m.th. të ekspertit dhe atë e paguan komuna, qyteti, shteti apo subjekti tjetër, për nevojën e të cilit merret ndonjë e mirë nga pasuria e ndokujt. Kushtetutat, më së shpeshti, nuk përcaktohen se në dobi të kujt bëhet shpronësimi, por e përmendin vetëm një anë të kësaj çështjeje. Ndërkaq, duhet theksuar se shpronësimi nuk është qëllim në vetvete, sepse nuk mjafton që vetëm të merret ndonjë gjë nga pasuria e ndokujt, por duhet të bartet në pronësi të personit tjetër. Kjo do të thotë se shpronësimi, si konfiskim i dhunshëm i pronës nga personat privatë për interes të përgjithshëm, veçanërisht toka, fabrika dhe të gjitha mjetet e tjera të prodhimit, nënkupton apropracionin do të thotë përvetësimin e pronës së marrë.¹⁷⁷
3. Prandaj, Kushtetuta parimisht e lejon çdo eksproprijim të pronës private, nëse ajo është vetëm “në interes të përgjithshëm”. Padyshim eksproprijimi bëhet në dobi të shërbimit publik, për nevoja të administratës publike, në interes të përgjithshëm. Por, po ashtu në interes të përgjithshëm është edhe shpronësimi i bërë për plotësimin e së “drejtës sociale” dhe atë më së shpeshti hasim në periudha të caktuara pasrevolucionare dhe të pasluftës. Këtu bëjnë pjesë, të ashtuquajturat reforma agrare, me të cilat në mënyrë të dhunshme merren pronat nga persona të caktuar (shumica të pasur) që t’u ndahet të tjerëve (të varfërve, të interesuarve, kolonistëve, vullnetarëve etj.). Këtu, shpronësuesi nuk është njëkohësisht edhe aproprues (përfitues). Edhe për pronat e tilla është parashikuar kompensimi, të cilin pjesërisht e paguajnë pronarët e rinj, pjesërisht shteti.
4. Këtu do të flasim edhe për dallimin që ekziston ndërmjet *shpronësimit dhe rekuizicionit*. Fjala shpronësim zakonisht përdoret për shpronësimin e paluajtshmërisë, ndërsa rekuizicion quhet marrja e dhunshme e gjërave të luajtshme. Rekuizicioni, më së shpeshti bëhet në rast lufte dhe ky për nevoja të ushtrisë, por vende-vende edhe për nevoja të popullsisë civile. Po ashtu, duhet theksuar se mund të flitet edhe për rekuizicion të banesave. Ky është rasti kur bëhet kufizimi apo e drejta e pronës

lustracionit. Të gjitha zgjidhjet ligjore në këto vende kanë pasur kujdes për specifikat kombëtare, kështu që diferencat kanë qenë të dukshme nga njëri në vendin e tjetri. Ndërkaq, Gjykata në Strasburg disa herë ua ka bërë me dije të gjitha këtyre vendeve që restitucioni i pasurisë së nacionalizuar duhet t’i respektojë standardet e sundimit të ligjit dhe jo të jetë arbitrare apo i motivuar në mënyrë hakmarrëse. Të shihet për një analizë të jashtëzakonshme e të thellë të sistemit të restitucionit në të gjitha ish- vendet komuniste të Evropës, në Csongor Kuti, *Post-communist Restitution and the Rule of Law* (CEU Press: Budapest, 2009).

¹⁷⁷ Apropracioni është proces i fitimit të pronësisë private në objektet e pasurisë shoqërore. Mund të zbatohet në shumë mënyra, siç janë: a) apropracioni ligjor, pra ndarja e tokës në bazë të ligjit ashtu siç është ndarë toka me dispozitat e reformës agrare në pronësi private të bujqve; 2) apropracioni administrativ, do të thotë fitimi i pronës private në objektet e pasurisë publike në bazë të lejes administrative, (leja për gjueti, për peshkim); 3) arondimi; 4) komasacioni.

apo e drejta e përdorimit, përkatësisht e shfrytëzimit të banesës (rasti i parë, nëse banuesi është njëkohësisht edhe pronar i shtëpisë, ndërsa i dyti nëse ai është qiraxhi). Kjo është një masë sociale që nuk synon marrjen e pasurisë, por më së shumti kufizimin e saj.

5. Më në fund, rregullimi i pasurisë përfshin garancinë institucionale të pacenueshmërisë së pasurisë, autorizimet e ligjdhënësit për kufizimin e saj, duke përfshirë shpronësimin dhe nacionalizimin, si dhe të drejtën e kompensimit, në rastin kur pronari mbetet pa pasurinë e vet. Në numrin më të madh të kushtetutave, pasurisë i është kushtuar funksioni social. Pasuria obligon, kështu që përdorimi i saj duhet t'i shërbejë të mirës së bashkësisë, ashtu që, parimisht, lejohet shtetëzimi, do të thotë kalimi i të mirave nga regjimi i pronës private në regjimin juridik të pronës publike. Marrja e pasurisë nga pronari është e mundshme vetëm nëpërmjet ligjit apo në bazë të ligjit, i cili e rregullon llojin dhe vëllimin e kompensimit të dëmit, ndërsa kompensimi i pronarit, siç e kemi parë, duhet të jetë i vlerësuar realisht nga ana e personave përkatës, i drejtë, adekuat dhe sipas masës së tregut.
6. E drejta e pronës dhe mbrojtja e saj është me rëndësi të jashtëzakonshme për çdo individ, e veçanërisht për mundësinë e shfrytëzimit të lirive dhe të të drejtave të tjera të garantuara me Kushtetutë. Kështu neni 1 i Protokollit nr.1 me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut përcakton që çdo person fizik dhe juridik e ka të drejtën e shfrytëzimit të papenguar të pasurisë së vet dhe që askush nuk mund të privohet nga pasuria e vet, përveç në interesin publik dhe në kushtet e parashikuara me ligj dhe mbi parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.¹⁷⁸ Natyrisht, duhet theksuar se të gjitha këto dispozita të përmendura më sipër, në asnjë mënyrë nuk ndikojnë në të drejtën e shtetit që t'i zbatojë ligjet që i konsideron të nevojshme për ta rregulluar shfrytëzimin e pasurisë në pajtim me interesin e përgjithshëm apo që të sigurojë pagesën e tatimit dhe të taksave të tjera e gjobave.
7. Si e drejtë e pacenueshme e njeriut dhe garanci e institutit, e drejta e pronës gjendet në pjesën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku gjenden të drejtat dhe liritë themelore. Neni përkatës i Kushtetutës është emërtuar me “Mbrojtja e pronës”, edhe pse konsiderojmë se shumë më i përshtatshëm do të ishte emërtimi “E drejta e pronës”, sepse që në paragrafin 1 të këtij neni thuhet se “garantohet e drejta e pronës”. Kjo sepse përmbajtja e këtij neni nuk i përgjigjet në tërësi përmbajtjes së materies që e rregullon dispozita e këtij neni, sepse ai më shumë ka të bëjë me të drejtën e pronës, sesa me mbrojtjen e saj.¹⁷⁹ Garantohet shfrytëzimi i qetë i pronës

¹⁷⁸ Sipas Konventës, prona nuk ekziston derisa mbi të të mos mund të vendoset kërkesa. Me fjalë të tjera, e drejta e pronës nuk e përfshin të drejtën e fitimit të pronës. Prandaj, në lëndën *Marckx kundër Belgjikës (1979)* (e cila është shqyrtuar edhe në vështrim të neneve 8 dhe 14). Gjykata ka konsideruar se nëna, vajzës të së cilës i është mohuar e drejta e pronës, është viktimë e shkeljes të së drejtës sipas nenit 1 të Protokollit nr.1, por jo edhe vajza, sepse me këtë nen nuk është mbrojtur fitimi i pritshëm i pronës.

¹⁷⁹ Shih lëndët Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës: KEK I, KEK II, KEK III, KEK IV, KEK V, përkatësisht KO 97-12, KI 104-10, KI 72-12, KI 93-11, KI 151-11, KI 87-11, KI

dhe i të drejtave të tjera pronësore të fituara në bazë të ligjit, por që kjo e drejtë e pronës mund të merret apo të kufizohet, por më shumë për këtë do të bëhet fjalë në komentin që vijon lidhur me paragrafin 3 të këtij neni, kështu që këtu nuk do të zgjatemi për shkak të përsëritjes së panevojshme.

Neni 46.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në mënyrë të përgjithshme e garanton të drejtën e pronës (neni 46. paragrafi 1.) dhe të gjitha të drejtat e tjera pronësore, si dhe mbrojtjen e tyre. Ndërkaq, kusht për shfrytëzimin e këtyre të drejtave është që të gjitha këto të jenë fituar në bazë të ligjit.

Neni 46.2

1. Për shkak të kushtit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni (që të gjitha të drejtat pronësore duhet të jenë fituar në bazë të ligjit), Kushtetuta parashikon edhe atë që shfrytëzimi i pronës të rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik (neni 46. paragrafi 2.). Interesi publik (anglisht, public interest) është interes shtetëror apo i përgjithshëm. Këto janë nocione që, zakonisht, shfrytëzohen në debate politike për politikën ekonomike, kur dëshirohet të theksohen dobritë apo përparësitë e bashkësisë, si tërësi, për dallim nga interesat private apo personale. Kushtetuta nuk i përpunon më për së afërmi subjektet të cilave u garantohen këto të drejta. Norma është formuluar në mënyrë neutrale - “garantohet” dhe njësoj ka të bëjë si me personat fizikë, si subjekt i këtyre të drejtave, ashtu edhe me ata juridikë. Duke pasur parasysh se norma është sistematizuar në Kapitullin II, që u është kushtuar të drejtave dhe lirive themelore, forma neutrale në të cilën është kumtuar, mundëson që të interpretohet drejt si një nga të drejtat individuale të qytetarëve, por që, me këtë rast, veprimi i normës nuk reduktohen domosdoshmërisht vetëm në këto subjekte, por i përfshin edhe subjektet e tjera të të drejtave pronësore dhe pasurore.
2. Në garantimin institucional të së drejtës pronësore, Kushtetuta në Kapitullin IX, që emërtohet “Marrëdhëniet ekonomike”, përcakton që të gjitha llojet e pasurisë rregullohen me ligj (neni 121. paragrafi 1.). Po ashtu, sipas këtij neni, personat e huaj fizikë dhe organizatat e huaja mund ta fitojnë të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, por vetëm në pajtim me kushtet e përcaktuara me ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare. Në këtë mënyrë përcaktohen të drejtat pronësore të të huajve. Subjekte të të drejtave pronësore këtu janë edhe personat fizikë, edhe personat juridikë, do të thotë organizatat. Meqë është fjala jo vetëm për të drejtat individuale edhe të personave të parë edhe të personave të dytë, këto të drejta garantohen në kontekst të marrëdhënieve ekonomike.¹⁸⁰

70-11, KI 116-10, KI 113-11, KI 90-11, KI 114-11, KI 161-11, KI 26-10, KI 17-11, KI 52-09, KI 12-11, KI 96-10, KI 11-10 dhe KI 77-10.

¹⁸⁰ Krahaso: Moderne, F., (1996), “Osnovne slobode i prava stranaca”, *Pravni život*, br. 12, fq. 945-962.

3. Kushtetuta, pra, ua garanton pronën personave të huaj fizikë dhe juridikë mbi pasurinë e paluajtshme, por të njëjtave subjekte, po ashtu, ua mundëson që në bazë të ligjit, në kushte të caktuara, të mund ta fitojnë edhe të drejtën e koncesionit, si dhe të drejtat e tjera të shfrytëzimit dhe/apo të eksploatimit të resurseve që gjenden në pronësi të shtetit, (duke përfshirë këtu edhe pasuritë natyrore dhe infrastrukturën në pronësi shtetërore). Përmbajtja e të drejtave të koncesionit dhe të të drejtave të tjera të përmendura garantohet në suazat që i parashikon ligji, për të cilat Kushtetuta shprehimisht udhëzon në (nenin 121. paragrafi 3.). Kur është fjala për shfrytëzimin e burimeve dhe të pasurive natyrore, qytetarët e Republikës së Kosovës, po ashtu në pajtim me kushtet e përcaktuara me ligj, mund të disponojnë burime dhe pasuri natyrore të Republikës së Kosovës. Kushtetuta edhe këtu ia lë ligjit ta përcaktojë regjimin juridik të mënyrës së shfrytëzimit të burimeve dhe të pasurive natyrore, por në mënyrë të ndryshme, duke parashikuar që kjo nuk mund të bëhet, nëse në këtë mënyrë do të shkeleshin obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim ekonomik.
4. Natyrisht, Kushtetuta nuk i trajton në të njëjtën mënyrë të gjitha pasuritë natyrore, prandaj, në pajtim me këtë, nuk i mbron në të njëjtën mënyrë, përkatësisht, nuk ua ofron të njëjtën shkallë të mbrojtjes. Kështu, për shembull, ato pasuri natyrore të cilat me ligj janë përcaktuar që janë me rëndësi të veçantë për Republikën e Kosovës (uji, hapësira ajrore, pasuritë minerare, toka, pyjet, bota bimore dhe shtazore, paluajtshmëritë dhe të mirat e tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike), kanë mbrojtje të veçantë. Kjo mbrojtje e veçantë garantohet në pajtim me ligjin. Në fund, Kushtetuta udhëzon edhe në rregullimin ligjor të mënyrës në të cilën pronarët me të drejtë banesore dhe pronarët në përgjithësi mund t'i shfrytëzojnë të mirat me interes për Republikën e Kosovës, si dhe kompensimin për kufizimet të cilave u nënshtrohet.

Neni 46.3

1. Ajo që është mjaft e rëndësishme për çdo individ, është dispozita e përgjithshme e Kushtetutës që askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga pasuria personale (neni 46. paragrafi 3.) Kjo do të thotë se një personi nuk mund t'i merret pasuria në mënyrë arbitrare dhe pa bazë përkatëse juridike, por vetëm në mënyrë të bazuar dhe të parashikuar me norma të së drejtës ekzistuese. Ndërkaq, në të njëjtin paragraf Kushtetuta e parashikon edhe mundësinë e kufizimit të këtyre të drejtave dhe kushtet në të cilat lejohet kufizimi. Kushtetuta i parashikon këto kushte si dhe formën e kufizimit të së drejtës së pronës. Për dallim nga kushtetutat e tjera, kjo Kushtetutë nuk i parashikon dy forma të kufizimit të së drejtës pasurore (një, kur e drejta kufizohet, ndërsa i dyti që e përfshin mundësinë e marrjes së të drejtës), por vetëm mundësinë e shpronësimit të pasurisë, pra këtë formën e dytë (marrjen e së drejtës). Në paragrafin 3 të nenit që është objekt i këtij komenti, Kushtetuta i parashikon kushtet në të cilat marrja e së drejtës së pasurisë (shpronësimi) është e lejueshme:
 - 1) baza e parë e shpronësimit është përshtatja e saj me ligjin;

- 2) baza e dytë është domosdoshmëria apo mënyra adekuate e formës së përmendur të kufizimit të së drejtës së pasurisë;
- 3) baza e tretë është arritja e qëllimeve publike apo përkrahja e interesit të përgjithshëm;
- 4) kufizimi i të drejtës së pasurisë, domethënë shpronësimi, lejohet vetëm me kusht që kjo t'u bëhet me kompensim të drejtë personit apo personave pasuria e të cilëve konfiskohet.

Kushtetuta e parashikon shprehimisht që ky kompensim duhet të jetë i drejtpërdrejtë dhe kompensim adekuat, që do të thotë se nuk mund të jetë më i ulët se vlera e tregut.

2. Kushtetuta nuk e përcakton më për së afërmi se çka konsiderohet interes publik, por i obligon organet që vendosin për kufizimin apo konfiskimin e pasurisë që të udhëhiqen vetëm na ato interesa publike që janë përcaktuar në bazë të ligjit (paragrafi 2 dhe paragrafi 3 i nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës). Edhe pse kjo paraqet një formë të mbrojtjes së të drejtës së pronës nga arbitrariteti eventual me rastin e vendosjes për kufizim apo për konfiskim, duhet theksuar se kjo mbrojtje nuk është kushtetuese, por ligjore. Fakti se Kushtetuta nuk përcakton se cilat interesa publike mund të jenë bazë e kufizimit apo e marrjes së të drejtës së pronës, por këtë çështje e rregullon ligji, e ndryshon edhe cilësinë e mbrojtjes së të drejtës së pronës. Kushtetuta, si akti juridik më i lartë, më i përgjithshëm, më i rëndësishëm, më abstrakt dhe më parimor ndryshohet më vështirë, prandaj mbrojtja që ajo e siguron është më e besueshme nga mbrojtja ligjore, sepse ligji, si akt më i ulët juridik, ndryshohet më lehtë.

Neni 46.4

1. Duke pasur parasysh se kufizimi i së drejtës së pronës është i mundshëm vetëm nëpërmjet shpronësimit, mbrojtjes së pronës edhe me këtë institut jashtëzakonisht të rëndësishëm, i është kushtuar kujdes i veçantë. Kështu, me paragrafin 4 është parashikuar që për kontestet që i shkakton ndonjë veprim, përkatësisht ndonjë aktivitet i pushtetit publik apo i vetë shtetit e që konsiderohen shpronësim, vendos gjykata kompetente. Kjo do të thotë se pasurisë i është kushtuar një shkallë e lartë e mbrojtjes gjyqësore, ndërsa lidhur me shpronësimin është miratuar ligji përkatës (Ligji për Shpronësimin e Pasurisë së Luajtshme, miratuar në Kuvend më 26 mars 2009, dhe i shpallur me Dekretin e Kryetarit të Republikës së Kosovës, nr. DL-011-2009, më 23 prill 2009).
2. Që në fillim të këtij Ligji (neni 1.) është përcaktuar qëllimi i nxjerrjes së tij me dispozitën se me të parashikohen:
 - 1) rregullat dhe kushtet në bazë të të cilave Qeveria apo komunat e caktuara mund ta bëjnë shpronësimin e pasurisë apo të të drejtave të tjera në pasurinë e paluajtshme të personit të caktuar;
 - 2) rregullat dhe kushtet në bazë të të cilave Qeveria mund ta autorizojë marrjen e përkohshme dhe shfrytëzimin e pasurisë së paluajtshme;
 - 3) veprimet për shpronësimin apo kufizim të pronësisë;

- 4) rregullat dhe veprimet për përcaktimin e kompensimit për shpronësim apo kufizim të pronësisë;
 - 5) dispozitat e tjera në të cilat rregullohen çështjet e tjera dytësore e që kanë të bëjnë me shpronësimin apo kufizimin e pronës.
3. Objekt shpronësimi, në kuadër të fushëveprimit të këtij ligji, mund të jetë prona private apo të drejtat e tjera private mbi pasurinë e paluajtshme, (përveç të drejtave mbi pasurinë e paluajtshme, të cilat bëjnë pjesë në pasurinë, për të cilën është parashikuar shprehimisht që nuk do të jetë objekt shpronësimi).
4. Duke pasur parasysh që vet Kushtetuta udhëzon për konkretizim të mëtejshëm ligjor të dispozitave të caktuara kushtetuese, (i tillë është rasti edhe me shpronësimin e pasurisë, që mund të bëhet vetëm nëse është në pajtim me ligjin), Ligji i përmendur për Shpronësimin e Pasurisë së Paluajtshme parashikon që organi kompetent mund ta bëjë shpronësimin vetëm nëse janë plotësuar të gjitha këto kushte:
- 1) kur shpronësimi ka të bëjë drejtpërsëdrejti me plotësimin e qëllimit të ligjshëm publik në kuadër të kompetencës së vet;
 - 2) kur qëllimi i ligjshëm publik nuk mund të arrihet praktikisht pa realizimin e shpronësimi;
 - 3) kur dobia publike që del nga shpronësimi do të dominojë mbi pasojat negative që do të shkaktohet në rast të shpronësimi;
 - 4) kur zgjedhja e pasurisë që do të shpronësohet nuk është bërë me qëllim të realizimit të çfarëdo qëllimi diskriminues;
 - 5) kur organi për shpronësim i ka plotësuar të gjitha dispozitat e zbatueshme të këtij Ligji (neni 4.).
5. Siç kemi thënë më sipër, është mjaft e rëndësishme që gjatë realizimit të shpronësimi të jetë përcaktuar kompensimi përkatës, sipas vlerës së tregut të pasurisë së paluajtshme e cila merret. Këtu një rol mjaft të rëndësishëm e ka Ministria e Ekonomisë dhe Financave, e cila, në kuadër të Drejtorisë/Departamentit për Tatim mbi Pronën, e cakton Zyrën për Vlerësimin e Pasurisë së Paluajtshme, që është objekt i shpronësimi (neni 21. paragrafi 1.). Kjo Zyre mund të angazhojë ekspertë të tjerë dhe të formojë komisione për verifikim dhe ndihmë gjatë përcaktimit të vlerës së pasurisë, e cila do të shpronësohet (neni 21. paragrafi 2.). Gjatë këtij vlerësimi, Zyra do ta bëjë vlerësimin e pasurisë së paluajtshme në pajtim me aktin ekzistues nënligjor dhe do ta marrë parasysh, nëse kjo është e mundur, vlerësimin më të ri të pasurisë nga ana e komunës, ku gjendet pasuria, në bazë të obligimeve të veta në pajtim me nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2003-29 “Për tatimin në pasurinë e paluajtshme në Kosovë”.

Neni 46.5

1. Për shkak të rrezikut të përhershëm nga shkatërrimi apo humbja e të mirave materiale, gjatë historisë së civilizimit njerëzor janë zhvilluar mënyra të shumta të mbrojtjes me metoda përkatëse të fshehjes, mbylljes, mbikëqyrjes dhe ruajtjes si dhe sistemi përkatës i mbrojtjes juridike të pronësisë materiale. Prodhimet e

mendjes njerëzore paraqesin të mira materiale, vlera e të cilave qëndron në shumëzimin, përdorimin dhe paraqitjen e tyre para njerëzve të tjerë, prandaj nuk është e mundur të mbrohen me anë të fshehjes, mbylljes apo me masa të tjera të mbrojtjes fizike. Në mënyrë që të mbrohej ky lloj i të mirave dhe që në këtë mënyrë të nxitej kreativiteti njerëzor që kontribuon për zhvillimin e përgjithshëm shoqëror, është zhvilluar sistemi përkatës i mbrojtjes juridike të pronës intelektuale, i cili e përbën të drejtën intelektuale. Përdorimi i paautorizuar apo shumëzimi i gjërave të pronësisë intelektuale paraqet shkelje të kësaj të drejte intelektuale. Për këtë arsye e drejta e pronarit (autorit, krijuesit) për ta disponuar, përdorur dhe për të pasur dobi, mbrohet me mjete dhe institucione të sistemit juridik.

2. *Nocioni e drejta intelektuale*, përfshin të drejtën autoriale dhe të drejtat e ngjashme, si dhe të drejtat e pronësisë industriale. *E drejta autoriale* është e drejtë ekskluzive e autorëve mbi disponibilitetin e veprave të tyre letrare, shkencore apo artistike, si dhe veprave nga fushat e tjera të krijimtarisë. *Të drejtat e ngjashme* kanë të bëjnë me të drejtat dhe sistemin e mbrojtjes juridike të shprehjes artistike, si dhe me mbrojtjen e investimeve organizative, afariste dhe financiare në shfaqjen, prodhimin, shpërndarjen dhe radiodifuzionin e veprave autoriale. Këto të drejta të ngjashme përfshijnë:
 - 1) të drejtat e artistëve interpretues mbi shfaqjet e tyre;
 - 2) të drejtat e prodhuesve të fonogrameve mbi fonogramet e tyre;
 - 3) të drejtat e producentëve filmikë (prodhuesve të videogrameve) mbi videogramet e tyre;
 - 4) të drejtat e organizatave radiodifuzive mbi emetimet e tyre;
 - 5) të drejtat e botuesve mbi botimet e tyre;
 - 6) të drejtat e prodhuesve të bazave të të dhënave mbi bazat e tyre të të dhënave.
3. *Pronësia industriale* përfshin të drejtat me të cilat prodhuesit i mbrojnë nga konkurrentët interesat e tyre afariste, pozitën në treg dhe mjetet e investuara në hulumtim, zhvillim dhe promovim. Kjo përfshin patentat, vulat (shenjat mbrojtëse), dizajnin industrial, shenjat e prejardhjes gjeografike dhe shenjat e autenticitetit e të tjera.
4. Për shkak të rëndësisë së vet, prona intelektuale gëzon mbrojtje të veçantë. Pra, realizimi kreativ apo artistik i ndonjë ideje, e cila është prodhim i intelektit njerëzor, i takon krijuesit të saj, prandaj, në kushte të caktuara, paraqet pronë të tij intelektuale. Edhe pse e paprekshme në kuptimin fizik, prona intelektuale i ka të gjitha karakteristikat e pasurisë, prandaj, ajo mund të blihet, të shitet, të licencohet, të ndërrohet, të falet, të trashëgohet, sikurse edhe e tërë pasuria tjetër. Në pikëpamje afariste, prona intelektuale paraqet pasuri jomateriale, eksploatimi i suksesshëm i së cilës mund të jetë bazë e dobishme e afarizmit. Kështu, disa aspekte të caktuara apo cilësi të ndonjë prodhimi, mund të mbrohen nëpërmjet një apo më shumë formave të pronës intelektuale, që plotësohen reciprokisht. Me patentë mbrohet zgjidhja e re e ndonjë problemi teknik, me dizajn industrial mbrohet forma e jashtme e re apo pamja e prodhimit, ndërsa me vulë mbrohet

ndonjë shenjë që shërben për dallim nga prodhimet e ngjashme apo shërbimet në treg.

5. Për tërë këtë që u tha, e drejta intelektuale e përfshin sistemin e instrumenteve juridike me të cilat rregullohet mënyra e arritjes së pronësisë intelektuale dhe mënyra e mbrojtjes nga shfrytëzimi i saj i paautorizuar. Kjo e drejtë, sipas nenit 46. paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mbrohet me ligj. Kushtetuta vetëm parimisht e garanton mbrojtjen e së drejtës intelektuale, ndërsa konkretizimi i mëtejshëm i kësaj dispozite i është lënë ligjit përkatës.
6. Në fund të komentit të këtij neni, duhet theksuar se problemi në praktikë mund të lindë për shkak të terminologjisë. Pra, në Kushtetutë shfrytëzohen termet kuptimi i të cilave nuk është identik: “mbrojtja e pasurisë (rubrum), e drejta e pasurisë” (paragrafi 1.), “shfrytëzimi i pasurisë” (paragrafi 2.), “pasuria personale” (paragrafi 3.), “e drejta intelektuale” (paragrafi 5.), prandaj mund të shtrohet pyetja se a është fjala për të drejta të njëjta apo të ndryshme.
7. Siç mund të shihet, e drejta e pronës, edhe pse është garantuar shprehimisht me vetë Kushtetutën, në kapitullin që u kushtohet të drejtave dhe lirive themelore, nuk është e drejtë absolute, që do të thotë se mund të kufizohet shfrytëzimi i kësaj të drejte nëpërmjet shpronësimit, por vetëm sipas mënyrës së parashikuar me ligj dhe për arsye që i parashikon vetë Kushtetuta

Neni 47 [E Drejta për Arsimin]

- (1) Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohet me ligj dhe financohet nga fondet publike.**
- (2) Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.**

Neni 47

1. E drejta e arsimit, shkollimi fillor falas, qasja në institucionet arsimore e të gjithëve sipas aftësive, liria e zgjedhjes së llojit të shkollimit, paraqesin bazat themelore, të cilat i proklamon Deklarata Universale (neni 26.). Shtetet nënshkruese të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, janë obliguar që t’i njohin këto të drejta që i përcakton Pakti në nenin 13 dhe në nenin 14. E drejta e arsimit është përfshirë edhe në nenin 2 të Protokollit nr.2 me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, që parashikon që askujt nuk mund t’i mohohet e drejta e arsimit, por që shteti duhet ta respektojë të drejtën e prindërve për të siguruar arsim të tillë, që është në pajtim me bindjet e tyre fetare dhe filozofike. Kështu, Karta e Reviduar Sociale Evropiane, i obligon shtetet që t’ua sigurojnë fëmijëve dhe personave të rinj arsimin e lirë fillor dhe të mesëm dhe që ta nxisin vijimin e rregullt të mësimin (neni 17.).

2. Këshilli i Evropës në fushën e arsimit ka analizuar shumë çështje: mësimin e tolerancës dhe të mirëkuptimit reciprok, historinë pa urrejtje, pra pengimin e keqpërdorimit të historisë për qëllime të antagonizmave nacionalë, mësimin për vlerat demokratike e të tjera, prandaj lidhur me këtë ka miratuar shumë dokumente. Kështu, me Rezolutën e Komitetit të Ministrave nr.41 të vitit 1978, është shprehur qëndrimi se gjatë tërë shkollimit të tyre, të gjithë të rinjtë duhet të mësojnë për të drejtat e njeriut, si pjesë përbërëse të përgatitjes së tyre për jetesë në demokracinë pluraliste. U është rekomanduar qeverive që në planet dhe programet mësimore në të gjitha nivelet, deri te arsimit universitar, t'i fusin lëndët e mësimin për të drejtat e njeriut. Në botë tanimë shfrytëzohet shprehja “e drejta e të drejtave të njeriut” (Human Rights Law), që tregon se të drejtat e njeriut gjithnjë e më shumë konsiderohen si disiplinë e veçantë dhe e pavarur, në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, e cila duhet të studiohet në mënyrë të veçantë dhe të pavarur.
3. Është e evidente se e drejta e arsimit është një nga të drejtat më të rëndësishme kulturore të qytetarëve e garantuar me kushtetutë, sepse realizimi i kësaj të drejte e mundëson arritjen e arsimit dhe të përsosjes personale të njeriut, duke filluar nga arsimit fillor, e deri tek arsimit më i lartë. Ajo që është më me rëndësi të theksohet është se e drejta e arsimit, si e tillë, paraqet një parakusht të rëndësishëm për t'i gëzuar të drejtat e tjera të njeriut (civile, politike, sociale, ekonomike, kulturore). Kjo, prandaj, kontribuon jo vetëm në zhvillimin e plotë të personalitetit, por edhe në përparimin e gjendjes së përgjithshme kulturore në shoqëri, prandaj, siç kemi thënë, është pranuar me dokumente të shumta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.
4. Realizimi i plotë i së drejtës së arsimit nënkupton obligimin e shtetit për ndërmarrjen e masave që do të mundësojnë që çdokush të arsimohet dhe të përsoset sipas mundësive dhe prirjeve të tij. Në rend të parë, kjo e drejtë nënkupton që të fitohet arsimit në mënyrën që është e arritshme për të gjithë dhe që arsimit fillor është i obligueshëm, falas dhe i arritshëm për të gjithë.¹⁸¹ Nga ana tjetër, shteti është i obliguar që, me rastin e organizimit dhe të rregullimit të mësimin dhe të proceseve të tjera arsimore, të përmbahet nga të gjitha aktivitetet në të cilat mund të bëhet indoktrinimi i qytetarëve veçanërisht i fëmijëve.¹⁸²

Neni 47.1

1. Të drejtën e arsimit Kushtetuta e garanton si të drejtë të përgjithshme të njeriut që e gëzon çdo person (neni 47. paragrafi 1.). Me Kushtetutë nuk është parashikuar regjimi i të drejtave të lidhura me nivelet e caktuara të arsimit. Në Kushtetutë nuk thuhet shprehimisht se cili arsim është i obligueshëm, a është ky vetëm arsimi fillor apo edhe arsimi i mesëm, e as se cili arsim është falas. Në numrin më të madh të rasteve, me kushtetutë parashikohet se arsimi i mesëm është i obligueshëm dhe që

¹⁸¹ Në lëndën *Kjeldsen, Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës* (1976), Gjykata e ka theksuar rëndësinë e rolit që luan arsimi në shoqërinë demokratike.

¹⁸² Ky indoktrinim mund të bëhet me privilegjin e religjionit të caktuar, të pikëpamjes morale apo filozofike e të ngjashme në programet mësimore.

është në pajtim me statusin e këtyllë të arsimit fillor dhe është falas. Kjo presupozon se shteti e merr përsipër në tërësi financimin e këtij niveli të arsimit. Arsimi i mesëm, më së shpeshti, nuk është i obligueshëm, por është praktikë në kushtetutshmërinë krahasuese që shteti edhe për këtë nivel të arsimit ta garantojë shkollimin falas, gjë që parashikohet me një dispozitë të caktuar kushtetuese.

2. Duke pasur parasysh se kushtetuta është akti më i përgjithshëm juridik në shtet, ashtu edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës vetëm parimisht e përcakton se arsimi i obligueshëm është i rregulluar me ligj dhe që do të financohet nga mjetet publike (neni 47. paragrafi 1. i Kushtetutës). Për shpjegim dhe konkretizim më të përafërt të kësaj dispozite, Kushtetuta udhëzon në dispozitat ligjore, të cilat janë mjaft konkrete dhe të detajuara. Pra, kjo e drejtë jashtëzakonisht e rëndësishme e çdo personi, e cila paraqet bazë për të gëzuar të gjitha të drejtat e tjera dhe themel të zhvillimit të çdo shoqërie demokratike, është rregulluar me Ligjin për Arsimin Fillor dhe të Mesëm (të miratuar në Kuvend, më 25 korrik 2002 dhe të shpallur nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, me Rregulloren nr. 2002/19 të datës 31 tetor 2002). Ligji i përmendur ka të bëjë me:
 - 1) arsimin publik dhe privat parashkollor;
 - 2) arsimin fillor;
 - 3) arsimi i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë në shkolla (neni 2. paragrafi 1.). Për dallim nga arsimi fillor, vijimi i arsimit parashkollor është vullnetar, ndërsa komuna mund ta kufizojë regjistrimin për shkaqe ekonomike (neni 2. paragrafi 3.).

3. Rolin esencial në sigurimin dhe zbatimin e së drejtës së arsimit e ka Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Detyra themelore e saj, e përcaktuar me dispozitat e këtij Ligji, është që ta promovojë arsimin e njerëzve në Kosovë dhe që të japë në dispozicion programe adekuate dhe efikase për shkolla fillore e të mesme, që të jenë të arritshme për të gjithë. Me garantimin e së drejtës së përgjithshme të njeriut për arsim fillor falas, që e gëzon çdo person, (paragrafi 1.), Kushtetuta e përcakton edhe obligimin e shtetit dhe të të gjitha pushteteve publike që asnjë fëmijë nuk mund t'i mohohet e drejta e arsimit, gjë që me dispozitat e veta shprehimisht e parashikon Ligji për Arsimin Fillor dhe të mesëm (neni 3. paragrafi 2.). Me rastin e avancimit të kësaj të drejte, duhet të zbatohen këto parime:
 - 1) arsimi në shkollat e financuara publike të shkallës së parë, të dytë dhe të tretë është falas;
 - 2) mjetet mësimore (për shembull, librat) në shkollat e shkallës së parë jepen falas, ndërsa për shkollën e dytë dhe të tretë i jep Qeveria nëse ka mjete financiare;
 - 3) çdo fëmijë ka të drejtë ta mësojë gjuhën e vet amtare në shkollën fillore dhe të mesme, nëse plotësohen kushtet e parashikuara nga ministria kompetente.

Neni 47.2

1. Kushtetuta, po ashtu, i garanton çdo personi mundësi të barabarta të shkollimit në bazë të nevojave dhe të aftësive individuale të atij personi, që do të thotë që në realizimin e së drejtës së arsimit nuk lejohet të ketë kurrfarë diskriminimi (neni 47. paragrafi 2.). Këtë dispozitë kushtetuese e përmban dhe e përpunon më tutje Ligji, i cili e parashikon që në zbatimin e të drejtave dhe obligimeve të veta, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe komunat duhet ta respektojnë të drejtën e prindërve, duke ua mundësuar arsimin dhe mësimin në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 3. paragrafi 3.). Kjo pastaj nënkupton se qasja dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë, duhet të mundësohen pa diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, mbi çfarëdo baze reale apo të supozuar, siç janë: gjinia, raca, orientimi seksual, gjendja martesore, ngjyra e lëkurës, gjuha, feja, mendimi politik apo mendimi tjetër, prejardhja nacionale, etnike apo sociale, përkatësia ndaj bashkësisë nacionale, statusi pasuror, prejardhja apo ndonjë status tjetër i nxënësit apo i familjes së tij (neni 5. paragrafi 1.).
2. Për nivelin e arsimit të lartë, Kushtetuta nuk përmban kurrfarë dispozitash apo garancish, por këtë e lë për ligjet përkatëse, kështu që këtu nuk do të merremi me komentimin e këtyre ligjeve. Do të theksojmë vetëm se cilat janë këto ligje, të cilat e rregullojnë themelimin e shkollave të larta dhe superiore dhe të universiteteve në territorin e Republikës së Kosovës. Këtu, para së gjithash, bëjnë pjesë:
 - 1) Ligji për Shkollimin Superior (i miratuar në Kuvend, më 25 korrik 2002, dhe i shpallur nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të bashkuara me Rregulloren nr. 2003/14, të datës 12 maj 2003);
 - 2) Ligji për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve (i miratuar në Kuvend, më 22 korrik 2005 dhe i shpallur nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të bashkuara, me Rregulloren nr. 2005/43, të datës 07 shtator 2005);
 - 3) Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (i miratuar në Kuvend, më 23 shkurt 2006 dhe i shpallur nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të bashkuara, me Rregulloren nr. 2006/24, të datës 25 prill 2006) e të tjerë.

Neni 48 [Liria e Artit dhe e Shkencës]

- (1) Liria e krijimtarisë artistike dhe shkencore është e garantuar.**
- (2) Liria akademike është e garantuar.**

Neni 48

1. Liria e shkencës dhe e artit, si e drejtë themelore e njeriut, e garantuar me dokumente ndërkombëtare, si dhe me legjislacionin kombëtar, e vërteton dhe materializon lirinë e përgjithshme të mendimit dhe të shprehjes së njeriut. Në disa

kushtetuta, liria shkencore dhe artistike është e garantuar në mënyrë institucionale, me formulën se shkencë dhe arti janë të lira. Diku krahas kësaj lirie garantohet edhe liria e mësimit dhe liria e katedrës. Kufijtë e lirisë së krijimtarisë shkencore dhe artistike janë të barabarta me kufijtë që i janë vënë lirisë së mendimit. Kështu, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut parashikon që çdokush ka të drejtë që lirisht të marrë pjesë në jetën kulturore të bashkësisë, që të kënaqet me artin dhe të marrë pjesë në përparimin shkencor dhe në të mirat që dalin nga kjo (neni 27. paragrafi 1.). Po ashtu, çdokush e ka të drejtën e mbrojtjes së interesave morale dhe materiale që dalin nga çdo vepër shkencore, letrare apo artistike, krijues i së cilës është ai (neni 27. paragrafi 2.). Prandaj, lirinë e krijimtarisë shkencore dhe artistike e garanton kushtetuta e çdo vendi demokratik, ndërsa këto garanci përfshijnë:

- 1) lirinë e krijimtarisë;
- 2) garancinë e të drejtave materiale dhe morale të krijuesit.

Neni 48.1

1. Liria e krijimtarisë shkencore dhe artistike është formë specifike e manifestimit të lirisë së mendimit (neni 48. paragrafi 1. i Kushtetutës) në fusha të veçanta të veprimtarisë njerëzore, siç është shkencë, arti dhe kultura. Ndërkaq, këto liri të krijimtarisë shkencore dhe artistike nuk e kanë të njëjtin vëllim të garancive kushtetuese si liria e mendimit. Kjo, ndër të tjera, shprehet edhe në anashkalimin e këtyre lirive nga lista e lirive nga të cilat është e mundur shmangia gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme. Prandaj, këto liri nuk i takojnë grupit të të drejtave të mbrojtura absolute. Ndërkaq, kur flitet për këtë parim të garantimit të krijimtarisë shkencore dhe artistike, duhet thënë se ai është absolut, sepse nuk thuhet, si zakonisht, “në kufi të ligjit”. Kjo do të thotë se as ligjet nuk do të guxonin, në asnjë mënyrë, ta kufizojnë zhvillimin e lirë të shkencës dhe të artit, por problemi është në atë se nuk është dhënë definimi juridik i shkencës dhe i artit (nëse kjo do të ishte fare e mundshme që të jepej ky definicion). I është lënë pushtetit shtetëror që veç ta vlerësojë se a është një veprimtari shkencore, përkatësisht artistike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në formë institucionale e garanton krijimtarinë shkencore dhe artistike. Kjo liri e shkencës dhe e artit, sipas veprimit të vet juridik, konsiderohet edhe e drejtë personale (neni 48. paragrafi 1.).
2. Me lirinë e krijimtarisë shkencore dhe artistike është ngushtë e lidhur edhe garancia e veçantë kushtetuese e lirisë akademike, do të thotë e autonomisë së universiteteve, institucioneve të shkollimit të lartë shkencor, që është me rëndësi të veçantë për çdo punë artistike dhe krijuese të arsimitarëve universitarë. Nëse shkencë është e lirë, e lirë është edhe çdo punë në universitet, në rend të parë mësimi. Në të vërtetë, këtë dispozitë në mënyrë edhe më precize e parashikojnë ligjet për universitetet, të cilat më së shpeshti përcaktojnë se mësimi universitar është i lirë, se arsimitarët janë plotësisht të lirë në punën e tyre shkencore dhe që askush, për shkak të paraqitjeve të tyre shkencore, nuk mund t’i thërrasë në përgjegjësi. Kjo dispozitë është aq më e rëndësishme, pasi që nga kjo shihet se çka nënkupton ligdhënësi me lirinë shkencore. Kjo nuk është vetëm punë shkencore,

por edhe paraqitje e rezultateve shkencore. Dhe kjo është e lirë, që do të thotë se nuk guxon të pengohet dhe të dënohet. Kuptohet se ekspozimet duhet që vërtet të jenë shkencore, sepse nëse bëhen në vetë universitetin, ekziston supozimi juridik se ato janë shkencore. Jashtë universitetit kjo edhe mund të kontestohet. Veçanërisht do të mund të kontestohet nëse një profesor do të ndërhynte në fushat e tjera të punës, për të cilat nuk ka marrë autorizim special për punën shkencore, autorizim që jepet me zgjedhje dhe vërtetim të zgjedhjes. Por, publikimi i ligjëratave të veta të rregullta universitare, po ashtu është i lirë, siç është e lirë edhe mbajtja e ligjëratave. Pushteti do të mund ta pengonte shpërndarjen e tyre në masa, por ligjërimin e tyre studentëve në ndërtesën e universitetit nuk do të guxonte ta pengonte, nëse dëshiron që ta respektojë parimin e lirisë së shkencës dhe të lirisë së “paraqitjeve shkencore”. Në numrin më të madh të legjislaturave bashkëkohore, para së gjithash në ligjet për universitetin, thuhet se askush nuk mund t’i thërrasë profesorët e universitetit në përgjegjësi për shkak të paraqitjeve të tyre shkencore. Do të thotë, asnjë pushtet në vend nuk mund ta bëjë këtë.

Neni 48.2

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, po ashtu, e garanton lirinë akademike (neni 48. paragrafi 2.), me çka ofrohet garancia institucionale e autonomisë së universitetit. Në këtë mënyrë, Kushtetuta e garanton autonominë, jo vetëm të universitetit, por edhe të institucioneve shkencore të shkollimit superior. Kjo ua mundëson universiteteve, institucioneve shkencore të shkollimit superior që në mënyrë të pavarur të vendosin për rendin dhe punën, në pajtim me ligjin, i cili në mënyrë më të përafërt e rregullon mënyrën e realizimit të këtyre të drejtave, në kufijtë e parashikuar me Kushtetutë.

Neni 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

- (1) **E drejta e punës garantohet.**
- (2) **Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.**

Neni 49

1. Të drejtën e punës¹⁸³ dhe, lidhur me këtë, të drejtën e zgjedhjes së lirë të punësimit dhe të ushtrimit të profesionit, e proklamon Deklarata Universale. Kjo Deklaratë, po ashtu, e garanton të drejtën për kushte të ndershme dhe të kënaqshme të punës, të drejtën për mbrojtje nga papunësia, të drejtën për pagesë të barabartë për punë të barabartë, të drejtën për kompensim të ndershëm dhe të kënaqshëm, i cili punëtorit dhe familjes së tij i siguron ekzistencë dinjitoze të njeriut, të drejtën për kohë të kufizuar të punës, të drejtën për pushim dhe argëtim, si dhe të drejtën për pushim të kohëpaskohshëm me pagesë (neni 23-24). Këto të drejta në mënyrë më të detajuar i përpunon Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe

¹⁸³ Për këtë të shihet më gjerësisht: Arsenov, S., (1987), “Pravo na rad, zaposlenost i nezaposlenost u suvremenoj teoriji i praksi“. *Socijalna politika*, nr. 6, fq. 49-54.

Kulturore i vitit 1996, në pjesën e tretë të vet (neni 6-7). Po ashtu, Karta Sociale Evropiane¹⁸⁴ në mënyrë mjaft precize dhe gjithëpërfshirëse e përcakton pozitën juridike të punëtorëve dhe të grupimeve të tjera sociale, duke u nisur nga ajo se përmirësimi i standardit të jetesës së popullsisë dhe të begatisë shoqërore, janë parakusht themelor për kultivimin dhe realizimin e mëtejshëm të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut.

2. E drejta e punës është një nga të drejtat më të rëndësishme ekonomike-sociale të njeriut dhe parim themelor i legjislacionit të punës.¹⁸⁵ Realizimi i plotë i kësaj të drejte është i rëndësishëm për çdo individ, sepse me këtë sigurohet siguria ekonomike dhe sociale, ekzistenca dinjitoze për njeriun. Kjo e drejtë është relativisht e re dhe konstitucionalizmi i saj i vërtetë arrihet vetëm me miratimin e Kushtetutës së Vajmarit, më 1919, edhe pse elementet e para të së drejtës së punës kanë qenë të inkorporuar që në Kushtetutën e Montaniare të vitit 1793. Njohja e kësaj të drejte dhe inkorporimi i saj në tekstet kushtetuese të shteteve të caktuara, si dhe në dokumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut ndodh, veçanërisht, pas Luftës së Dytë Botërore.¹⁸⁶ Në ato dokumente ndërkombëtare hyjnë, para së gjithash: Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore i vitit 1966, Karta Sociale Evropiane e vitit 1961, Karta e Përbashkët për të Drejtat Themelore Sociale të Punëtorëve e vitit 1989 etj.
3. E drejta e punës është me rëndësi të jashtëzakonshme për çdo individ dhe, si e tillë, paraqet parakusht dhe garanci të lirisë, të realizimit të zhvillimit të personalitetit. Ndërkaq, këtu duhet theksuar se e drejta e punës nuk do të thotë se çdo person ka të drejtë që t'i sigurohet punësimi, por mundësia për secilin që të sigurojë mjete për jetesë me punën e cila është zgjedhur dhe pranuar lirisht. Prandaj, nëse e analizojmë natyrën juridike të së drejtës së punës, do të vijmë në konkludimin se ajo gjendet diku midis parimit programor, do të thotë detyrimit kushtetues të shtetit për të udhëhequr politikë të punësisë së plotë dhe për të siguruar punësim për çdo qytetar të aftë për punë, nga njëra anë, dhe së drejtës subjektive për punësim, do të thotë të kërkesës së mbrojtur gjyqësore për punësim, nga ana tjetër. Natyrisht, edhe pse kjo e drejtë nuk ia mundëson çdo individ që nga shteti, nëpërmjet gjykatës, të kërkojë vend pune, nga kjo drejtpërsëdrejti dalin autorizime të caktuara subjektive, p.sh., e drejta për kushte të barabarta gjatë punësimit, liria e zgjedhjes së punës dhe profesionit, pra ndalimi i robërisë dhe i punës së detyrueshme, e drejta e fitimit

¹⁸⁴ Karta Sociale Evropiane është miratuar dhe është hapur për nënshkrim në Torino, më 1961. Ajo, pas Konventës për të Drejtat e Njeriut të Vitit 1950, është dokumenti i dytë më i rëndësishëm i Këshillit të Evropës. Karta Sociale Evropiane i garanton nëntëmbëdhjetë të drejta themelore, ndërsa edhe katër të drejta dalin nga Protokollin plotësues i vitit 1998. Në konferencën ndërkombëtare në Torino, të mbajtur më 1991 me rastin e 30-vjetorit të miratimit të Kartës Evropiane, është vendosur që Karta të rinovohet në atë mënyrë që në të të futen të drejtat e përfshira në protokollin e miratuar më parë, si dhe të drejtat e reja. Karta është reviduar në Strasburg, më 1996 dhe tash përmban tridhjetë të drejta themelore.

¹⁸⁵ Paravina, D., (1979), "Načelo prava na rad", *Pravni život*, br. 12, str. 23-40.

¹⁸⁶ Për zhvillimin prej pas Luftës së Dytë Botërore, të shihet studimi mjaft i hollësishëm: Mellwain, C.H., (1969), *Constitutionalism and the Changing World*, Cambridge University Press: Cambridge.

përkatës, e drejta e sigurimit material gjatë kohës së papunësisë kundër dëshirës së vet, e drejta e ndihmës pa pagesë gjatë kërkimit të punës, e drejta për aftësim dhe trajnim etj.

4. Garancia kushtetuese për punë bëhet shprehimisht, por gjithnjë në pajtim me ligjin, kështu që përmbajtja e saj nuk përcaktohet më detajisht. Garancia e tillë bëhet në mënyrën më të përgjithshme dhe më parimore, ndërsa konkretizimin e këtyre dispozitave kushtetuese akti më i përgjithshëm juridik në shtet ia lë ligjit përkatës. Duke u nisur nga ajo se çdokush ka të drejtë për zgjedhje të lirë të punës, numri më i madh i kushtetutave të sotme bashkëkohore të gjithëve u garantojnë qasje në të gjitha vendet e punës me kushte të barabarta. Kjo garanci, deri diku, edhe mund të respektohet dhe të sigurohet gjatë punësimit. Ndërkaq, e drejta e sigurimit të vendit të punës, do të thotë punësimi i përhershëm, si element kyç i së drejtës për punë në kushtet e ekonomisë private, edhe më parë edhe sot ka shtrirje të kufizuar. Pra, pronarët e ndërmarrjeve private janë të lirë gjatë pranimit dhe largimit të fuqisë punëtore, kështu që kufizimet në pikëpamje të largimit më së shpeshti reduktohen në dëmshpërbllim në rast të mosrespektimit të afatit të përjashtimit, largimit të kategorive të mbrojtura të punëtorëve, të punëtorëve të vjetër etj.¹⁸⁷
5. Natyrisht, lidhur me të drejtën për punë, përkatësisht marrëdhënien e punës, ekziston një numër gjithnjë e më i madh i kushtetutave që garantojnë që çdokush ka të drejtën e respektimit të personalitetit të vet në punë, kushte të sigurta dhe të shëndetshme në punë, mbrojtje të nevojshme në punë, kohë të kufizuar të punës, pushim ditor dhe javor, pushim të paguar vjetor, kompensim të drejtë për punë dhe mbrojtje juridike në rast të pushimit të marrëdhënies së punës. Këto të drejta janë të patjetërsueshme dhe askush nuk mund t'i shmangë. Duke pasur parasysh se sot, duke filluar nga Kushtetuta e Vajmarit, ekziston një numër gjithnjë e më i madh i teksteve kushtetuese që parashikojnë mbrojtjen sociale dhe shëndetësore dhe garantojnë një numër gjithnjë e më të madh të të drejtave sociale, në rast të pengesës së përkohshme për punë, të punësuarve u garantohet e drejta për kompensim të të ardhurave si dhe e drejta për kompensim në rast të papunësisë së përkohshme. Femrave, të rinjve dhe invalidëve u kushtohet kujdes i veçantë dhe u sigurohet mbrojtja në punë dhe kushte të veçanta të punës në pajtim me ligjin.
6. Kur flasim për të drejtën e punës dhe për ushtrimin e lirë të profesionit, duhet thënë se pjesë përbërëse e kësaj dispozite është një maksimum individualiste-liberale:

¹⁸⁷ Të shihet lënda e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës: Aktvendimi për moslejueshmëri i datës 13 maj 2010 në rastin nr.KI37/09. (*Paraqitësi X kundër Vendimit të Senatit të Universitetit në Prishtinë, më 29.09.2009*); Aktvendimi për moslejueshmëri i datës 16 dhjetor 2011 në rastin KI02/11. (*Paraqitës Esat Kurtaliqu. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, C. Or. 409/06, nga data 7 shkurt 2008*); Aktvendimi për moslejueshmëri i datës 8 shkurt 2011, në rastin nr. KI100/IO. (*Paraqitës Eduard Thaqi, i njohur njëkohësisht si Sokol Thaqi. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Policisë së Kosovës nr. 3985 SHPK-2002, datë 22 tetor 2002*); dhe, së fundi, Aktgjykimi i datës 15 prill 2013 në rastin nr. KO131/12. (*Paraqitës Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 18,19,41 dhe 60 të Ligjit për Shëndetësinë, nr.04/L-125, i miratuar nga Kuvendi, më 13 dhjetor 2012*).

“Liria e punës dhe e kontraktimit në marrëdhëniet ekonomike”. Edhe marrëdhëniet e punës, siç e dimë, janë marrëdhënie ekonomike. Kjo do të thotë se edhe për to ekziston, parimisht, liria e kontraktimit (në kushtet të punës). Këtu është me rëndësi të theksohet se shteti nuk duhet të ketë kompetenca në pikëpamje të lirisë së punës dhe të kontraktimit, domethënë të zgjedhjes së lirë të profesionit dhe të vendit të punës. Ndërkaq, shteti mundet, vetëm në raste të jashtëzakonshme, në interes të tërësisë, por në bazë të ligjit, të fitojë të drejtën dhe obligimin që të ndërhyjë në marrëdhëniet ekonomike të qytetarëve, në frymën e së drejtës dhe të shmangies së kundërshtive shoqërore. Kjo do të thotë se parimi i përmendur i zgjedhjes së lirë të profesionit dhe të vendit të punës, pra të lirisë së punës dhe të kontraktimit, mund të anashkalohet, por vetëm kur këtë e kërkon interesi i shumicës. Në vend të ekonomisë së lirë, mund të urdhërohet ekonomia e planifikuar, në vend të kontraktimit të lirë të vendeve të punës, nëpërmjet legjislacionit mund të parashihen kushtet, të cilat nuk do të mund të ndryshoheshin me marrëveshje të palëve.¹⁸⁸

7. E drejta e zgjedhjes së lirë të profesionit dhe vendit të punës, tash për tash, në numrin më të madh të vendeve dhe të veprimtarive ekonomike, vazhdon të respektohet. Po ashtu, në bujqësi liria e punës, është gati absolute: askush nuk e urdhëron bujkun se çfarë kulture do të kultivojë dhe punojë. Në veprimtaritë e tjera ekonomike ekzistojnë kufizime të caktuara, do të thotë dallohen veprimtaritë të cilat parimisht janë plotësisht të lira (për zhvillimin e tyre nevojitet një autorizim i thjeshtë) dhe ato që mund të ushtrohen vetëm me leje të pushtetit administrativ. Natyrisht, duhet theksuar se liria e punës nuk do të thotë se secili mund të punojë çfarë të dëshirojë. Pra, liria e punës do të thotë vetëm që askush nuk duhet të pengohet që të punojë atë që për të është e dobishme, nëse ka ofruar garanci se mund të punojë më sukses. Intervenimi i ligjdhënësit është shumë më i nevojshëm në marrëdhëniet ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve, sesa në marrëdhëniet ekonomike të afaristëve të pavarur. Pra, njohja e lirisë së plotë të punës ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve, do të nënkuptonte që punëtorët t'i lihen eksploatimit nga ana e punëdhënësve, veçanërisht në kohën e sotme, ku numri i atyre që e ofrojnë fuqinë e vet punëtore është pakrahasimisht më i madh se numri i atyre që e kërkojnë atë. Veçanërisht në vendet në tranzicion, brenda ditës disa qindra punëtorë mbesin pa punë, prandaj llogaritur në shkallë mujore apo vjetore, mund të kuptohet se çfarë është raporti i ofertës dhe kërkesës së fuqisë punëtore dhe çka do të mund të ndodhte nëse ligjdhënësi nuk do të ndërhynte në marrëdhëniet ndërmjet punëtorëve dhe punëdhënësve.
8. Liria e punës, pra zgjedhja e lirë e profesionit dhe e vendit të punës, është pjesë e jetës personale deri në atë masë sa që pa të është i paimagjinueshëm zhvillimi i personalitetit. Në shumë kushtetuta, ajo është barazuar me lirinë e zgjedhjes së

¹⁸⁸ Kjo situatë është e mundshme dhe masa të tilla, më së shpeshti, ndërmerren në periudha pasrevolucionare dhe të pasluftës, kur është e domosdoshme që shteti sa më parë të nxirret nga kriza e përgjithshme. Atëherë nuk është në fuqi mënyra e ekonomisë së tregut e, por ekonomia e caktuar me marrëveshje apo ekonomia e planifikuar, e bazuar në qeverisjen dhe centralizmin burokratik.

punës apo të profesionit, ndërsa në disa të tjera mjaftohet me ndalimin e punës së detyrueshme. Për dallim nga liria e ndërmarrësisë, liria e punës nuk e përmban vetëm parimin objektiv, por njëkohësisht e garanton edhe të drejtën subjektive për zgjedhje dhe ushtrim të lirë të profesionit. Nocioni i profesionit apo titullit është më i gjerë se nocioni i ndërmarrësisë dhe nënkupton çdo veprimtari që është bazë e jetës së individit, pavarësisht se a është fjala për veprimtari të pavarur apo jo të pavarur, profesion “të lirë” apo atë që është i lidhur me shtetin dhe shërbimet publike.

Neni 49.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës shprehimisht parashikon se garantohej e drejta e punës dhe këtë e përcakton në mënyrën më të shkurtër dhe më të përgjithshme të mundshme. Kushtetuta nuk udhëzon shprehimisht në ligjin përkatës për konkretizim të mëtejme të kësaj dispozite, por që të konstatojmë se cilat janë këto të drejta individuale të lidhura me punën, duhet të mbështetemi në zgjidhjet që i ka dhënë Ligji për Punën (i miratuar në Kuvend, më 02 nëntor 2010, dhe i shpallur me Dekretin e Kryetarit të Republikës së Kosovës nr. DL-007-2010, më 18 nëntor 2010), qëllimi i të cilit është që t’i rregullojë të drejtat dhe obligimet nga marrëdhënia e punës. Dispozitat e këtij Ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës, si dhe për shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi që punojnë te punëdhënësit në territorin e Republikës së Kosovës. Ndërkaq, këto dispozita nuk përmenden të marrëdhënia e punës në kuadër të misioneve ndërkombëtare të shteteve të huaja dhe të forcave ndërkombëtare ushtarake të stacionuara në Republikën e Kosovës (neni 2.).
2. Atë që Ligji veçanërisht e thekson, duke konkretizuar dispozitën kushtetuese me të cilën garantohej e drejta e punës (neni 49. paragrafi 1.), është ndalimi e diskriminimit në punësim. Pra, Ligji parashikon se diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion (neni 5. paragrafi 1.), por që, në mënyrë të veçantë parashikohet ndalimi i diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të personave me aftësi të kufizuar me rastin e punësimit, të avancimit në vendin e punës dhe të ngritjes profesionale, nëse për atë vend pune është i aftë ta kryej punën në mënyrë adekuate (paragrafi 2.). Ndërkaq, duhet theksuar se nuk konsiderohet diskriminim çdo dallim, përjashtim apo dhënie përparësie, lidhur me ndonjë vend të caktuar të punës, në bazë të kriterëve që kërkohen dhe përcaktohen për atë vend pune (paragrafi 3.).¹⁸⁹
3. Mbrojtja e përgjithshme e të punësuarve në punë është e parashikuar me Ligjin për Punën (neni 42.) dhe me Ligjin për Sigurinë në Punë, Mbrojtjen e Shëndetit të të Punësuarve dhe Mbrojtjen e Mjedisit të Punës. Përveç kësaj mbrojtjeje, i punësuari që vlerëson se punëdhënësi ia ka shkelur të drejtën e punës, mund t’i bëjë kërkesë punëdhënësit apo organit të caktuar të punëdhënësit, nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të tij të shkelura. Punëdhënësi është i obliguar që të vendosë për

¹⁸⁹ Punëdhënësi është i obliguar që gjatë punësimit të punëtorëve, për të njëjtin vend punë t’i caktojë kriteret dhe mundësitë e barabarta si për femra, ashtu edhe për meshkuj.

kërkesën e të punësuarit në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës, ndërsa vendimi i punëdhënësit duhet t'i dërgohet të punësuarit në formë të shkruar në afat prej 8 ditësh (neni 78). Natyrisht, mbrojtja e të drejtave të të punësuarit nuk mbaron me kaq, sepse çdo i punësuar, i cili nuk është i kënaqur me vendimin e punëdhënësit (kur konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij) apo që nuk merr përgjigje në afatin ligjor, mund ta nisë kontestin e punës në gjykatën kompetente (neni 79.).

4. Për realizimin e të drejtës së punës të garantuar me Kushtetutë dhe ushtrimin të profesionit, kontribuon liria e organizimit sindikal, e cila të punësuarve dhe punëdhënësve u garanton bashkim dhe veprim, pa ndërhyrje të organizatave të tjera apo të organeve publike (neni 88. paragrafi 1.). Të drejtat, liritë dhe organizimi i sindikatës në Republikën e Kosovës rregullohen me ligj të veçantë (neni 88. paragrafi 2.), i cili e mundëson organizimin e grevave, me qëllim të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të të punësuarve.¹⁹⁰

Neni 49.2

1. Lidhur me këtë që u tha më sipër, duhet thënë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton që çdo person ka të drejtë që lirisht ta zgjedhë profesionin dhe vendin e punës së tij (neni 49. paragrafi 2.), që do të thotë se secilit i garantohet liria e punës. Pjesë përbërëse e garancisë së të drejtës së punës dhe të lirisë së punës, është edhe ndalimi i punës së detyrueshme dhe të dhunshme. Nuk konsiderohet punë e detyrueshme puna apo shërbimi i përcaktuar me Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës, për personat e gjykuar me vendim të formës së prerë, gjatë vuajtjes së dënimit, apo në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në bazë të nenit 131 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 6. i Ligjit).

Neni 50 [Të Drejtat e Fëmijës]

- (1) Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.
- (2) Fëmijët e lindur jashtë martesë, kanë të drejta të barabarta me të lindurit në martesë.
- (3) Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.
- (4) Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.

¹⁹⁰ E drejta e të punësuarve për ndërprerje të punës është rregulluar me shumë akte dhe për këtë ekziston një numër i madh i punimeve. Diçka më gjerë për këtë të drejtë, të shihet në: Toroman, M.M., (1993), "Zakonsko regulisanje prava na štrajk", *Anali Pravnog Fakulteta u Beogradu*, br. 3-4, fq. 243-258.

(5) Secili fëmijë gëzon të drejtën për raporte të rregullta personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me prindërit e vet, me përjashtim kur institucioni kompetent përcakton se një gjë e tillë është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës.

Neni 50

1. Sot, në të gjitha vendet, bëhen përpjekje për garanci sa më të plota dhe sigurim juridik të të drejtave të fëmijës. Përpjekjet në këtë drejtim kanë çuar në verifikimin dhe kodifikimin e të drejtave të fëmijës në planin e të drejtave ndërkombëtare të njeriut. Në konstituimin e korpusit të të drejtave të më të rinjve më së shumti ka ndikuar miratimi dhe ratifikimi i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, në të cilën janë përcaktuar të drejtat e përgjithshme, universale të fëmijës.¹⁹¹
2. Për këtë arsye, Kombet e Bashkuara janë të bindura që familjes, si njësi themelore e shoqërisë dhe e mjedisit natyror për zhvillim dhe begati të të gjithë anëtarëve të saj, e veçanërisht fëmijëve duhet t'u ofrohet mbrojtja dhe ndihma e domosdoshme, në Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut, është proklamuar se fëmijëve në fëmijëri u takon kujdesi dhe ndihma e veçantë. Duke konsideruar se fëmija duhet të përgatitet plotësisht për të jetuar i pavarur në shoqëri dhe që të jetë i edukuar në frymën e idealeve të proklamuar në Kartën e Kombeve të Bashkuara, e veçanërisht në frymën e paqes, dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit, në këtë Konventë janë marrë dhe janë përpunuar edhe më tutje dispozitat e dokumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare, që u kushtohen të drejtave të fëmijës. Këtu, para së gjithash e kemi fjalën për Deklaratën e Gjenevës për të Drejtat e Fëmijës (1924), Deklaratën për të Drejtat e Fëmijës (të miratuar nga ana e Kombeve të Bashkuara më 1959), Deklaratën e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut (miratuar dhe e proklamuar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1948), Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (të miratuar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 16 dhjetor 1966, veçanërisht nenet 23 dhe 24),¹⁹² Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (të miratuar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 16 dhjetor 1966, veçanërisht neni 10), si dhe statutet dhe instrumentet përkatëse të agjencive të specializuara të organizatave ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e fëmijëve.
3. eklarata për të Drejtat e Fëmijës, të cilën e ka miratuar Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1959, ka parashikuar se “fëmijës, duke pasur parasysh papjekurinë e tij fizike dhe mentale, i nevojitet mbrojtje dhe kujdes i veçantë, duke përfshirë edhe mbrojtjen përkatëse juridike si para, ashtu edhe pas

¹⁹¹ Krahaso lëndën e Gjykatës Kushtetutëse të Republikës së Kosovës, në: Aktvendimi për moslejueshmëri i datës 6 nëntor 2012, në rastin nr. KI36/12. (*Paraqitës, Bajram Luta. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Ac. nr. 116/211, nga data 17 janar 2012*).

¹⁹² Krahaso: Nowak, M., (1989), ‘*UNO-Pakt ueber buergerliche und politische Rechte und Fakultativprotokoll: CCPR-Kommentar*’, (Engel Verlag, Kehl am Rhein-Strasbourg)

lindjes). Duke i pasur parasysh dispozitat e Deklaratës për Parimet Sociale dhe Juridike, që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe mirëqenien fëmijëve, me vështrim të veçantë në përkujdesjen kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në adoptim, Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Standarde Minimale për Drejtësinë për të Mitur (të ashtuquajturat Rregullat e Pekingut) dhe Deklaratën për Mbrojtjen e Grave dhe të Fëmijëve në Rast të Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe të Konfliktit të Armatosur dhe duke pranuar faktin se në të gjitha vendet e botës ka fëmijë që jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe që për fëmijët e tillë është i domosdoshëm kujdesi i veçantë, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989 e ka miratuar Konventën për të Drejtat e Fëmijës.

4. Sipas kësaj Konvente, fëmijë është çdo qenie njerëzore që nuk i ka mbushur 18 vjet jetese, nëse, sipas ligjit që zbatohet për fëmijën, mosha e pjekurisë nuk arrihet më parë (neni 1.). Sipas Ligjit për Familjen në Republikën e Kosovës, është parashikuar mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësitë e të dy prindërve për rritjen dhe arsimin e fëmijëve të tyre, me ç'rast si fëmijë nënkuptohet personi nën moshën 18 vjeçare. Po ashtu, me Konventën e Përmendur, çdo fëmijë i njihet e drejta e jetesës me vetë lindjen, prandaj në masën më të madhe të mundshme duhet t'i sigurohet jetesa dhe zhvillimi (neni 6.). Ajo që është mjaft e rëndësishme për çdo fëmijë, është obligimi që të regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe që prej momentit të lindjes ta ketë të drejtën e emrit, të drejtën e fitimit të shtetësisë dhe, për aq sa është e mundur, të drejtën që ta dijë se cilët janë prindërit e tij dhe të drejtën për përkujdesjen e tyre (neni 7. paragrafi 1.). Prandaj, të gjitha palët kontraktuese janë obliguar ta respektojnë të drejtën e fëmijës për ruajtje të identitetit, duke përfshirë shtetësinë, emrin dhe marrëdhëniet familjare në pajtim me ligjin, pa asnjë ndërhyrje ligjore.¹⁹³
5. Dispozitat e Konventës së KB për të drejtat e fëmijës, të cilat e paraqesin bazën e paragrafit 3 të nenit 50 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, garantojnë që asnjë fëmijë nuk do t'i nënshtrohet ndërhyrjes arbitrare apo ndërhyrjes së paligjshme në privatësinë e tij, në familje, shtëpi apo letërkëmbim, as sulmeve të paligjshme në nderin dhe prestigjin e tij (neni 16. paragrafi 1. i Konventës). Por për ta siguruar mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha format e dhunës fizike apo mendore, lëndimi apo keqtrajtimi, injorimi apo sjellja e pakujdesshme, maltretimi apo eksploatimi, duke përfshirë edhe keqtrajtimin seksual, palët kontraktuese janë obliguar që të ndërmarrin masa përkatëse ligjore, administrative, sociale dhe arsimore. Prandaj, palët kontraktuese ia kanë njohur të drejtën çdo fëmijë që të jetë i mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe kryerja e çfarëdo pune, e cila do të mund të ishte e rrezikshme apo do ta pengonte shkollimin e fëmijës, apo do të ishte e dëmshme për shëndetin e fëmijës apo për zhvillimin, fizik, shpirtëror, moral apo shoqëror të fëmijës (neni 19.). Veçanërisht është e rëndësishme marrja përsipër e obligimit të palëve kontraktuese për t'i mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe të keqtrajtimit seksual, si dhe të shitjes dhe të tregimit të fëmijëve me çfarëdo qëllimi apo në çfarëdo forme (neni 34-35).

¹⁹³ Krahaso: Čok, V., (1987), "Državljanstvo deteta u pravu savremenih država", *Strani pravni život*, Seria D, fq. 73-85.

Neni 50.1

1. Kësaj tendence i bashkëngjitet edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në të cilën veçanërisht sistematizohen të drejtat e njeriut. Kjo Kushtetutë, parimisht, ua njeh fëmijëve të gjitha të drejtat njerëzore, që janë të domosdoshme për mirëqenien e tyre (neni 50. paragrafi 1.). Konventa për të Drejtat e Fëmijës (e miratuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989), parashikon që palët kontraktuese t'ia njohin të drejtën çdo fëmije për standard jetësor, që i përgjigjet zhvillimit fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe social të fëmijës (neni 27. paragrafi 1.). Duke e marrë këtë dispozitë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës me normë të përgjithshme ua garanton fëmijëve të gëzuarit e të drejtave të njeriut, nëse kjo është e përshtatshme për moshën e tyre dhe pjekurinë shpirtërore. Tërësia e të drejtave dhe e obligimeve të prindërve për t'u kujdesur për individualitetin, të drejtat dhe interesat e këtij fëmije të mitur, përcaktohet me nocionin e së drejtës prindërore ose përgjegjësisë prindërore.
2. Sipas Ligjit për Familjen,¹⁹⁴ (i miratuar në Kuvend, më 20 janar 2006 dhe i shpallur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/7, më 16 shkurt 2006) prindërit kanë të drejtë dhe obligim që t'i mbajnë, edukojnë dhe arsimojnë fëmijët e vet. Në fitimin dhe realizimin e së drejtës prindërore, prindërit janë plotësisht të barabartë.

Neni 50.2

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 50 paragrafi 2, e merr normën e gjithëpranueshme për barazinë e fëmijëve martesorë dhe jashtëmartesorë, pra fëmijët jashtëmartesorë i kanë të njëjtat të drejta që kanë fëmijët e lindur në martesë. Kjo do të thotë se me Kushtetutë është eliminuar dallimi i të drejtave ndërmjet fëmijëve varësisht nga lindja e tyre, përkatësisht se a kanë lindur në martesë apo jashtë martesës. Të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtja e tyre rregullohen me ligj. Pra, sipas dispozitave të Ligjit për Familjen, fëmijët e prindërve që kanë qenë të martuar në kohën e lindjes së tyre, i kanë të njëjtat të drejta dhe obligime, sikurse edhe fëmijët prindërit e të cilëve nuk kanë qenë të martuar në kohën e lindjes së tyre (neni 3. paragrafi 4.).

Neni 50.3

1. Përveç garantimit të të drejtave të veçanta subjektive, Kushtetuta ia garanton çdo fëmije të drejtën që të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi (neni 50. paragrafi 3. i Kushtetutës). Kjo do të thotë se me aktin më të lartë të përgjithshëm juridik urdhërohet që fëmijët të jenë të mbrojtur nga abuzimi psikik, fizik, ekonomik dhe nga çdo lloj shfrytëzimi dhe abuzimi tjetër. Kjo urdhëresë i është drejtuar jo vetëm ligjdhënësit, por edhe pushtetit publik në përgjithësi. Kjo e

¹⁹⁴ Ky Ligj e rregullon raportin e të fejuarve, martesën, raportet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, adoptimin dhe përkujdesjen, mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdesje prindërore, marrëdhëniet familjare pronësore dhe procedurën e veçantë gjyqësore në kontestet e marrëdhënieve familjare.

drejtë në tekstet e mëparshme kushtetuese nuk është paraqitur aq shpesh, sepse çdo hartues i Kushtetutës e ka të vështirë ta imagjinojë fare se mund të ndodhë shkelja e të drejtave të fëmijës. Ndërkaq, duke pasur parasysh se në deceniet e fundit situata në këtë pikëpamje është krejt tjetër, numri më i madh i kushtetutave bashkëkohore në tekstet e tyre përfshijnë edhe dispozitat që parashikojnë mbrojtjen e fëmijës dhe garantimin e të drejtës që ai të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, keqtrajtimit dhe eksploatimit.

Neni 50.4

1. Pikërisht për shkak të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve Kushtetuta parashikon që të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të ndërmarra nga ana e institucioneve shtetërore, publike apo private, duhet të jenë në interesin më të mirë të vetë fëmijës. Prandaj, është parashikuar edhe mbrojtja e veçantë e këtyre të drejtave, para së gjithash mbrojtja sociale, si dhe format specifike të kësaj mbrojtjeje. Pra, fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe ata me çrregullime të konstatuara shpirtërore dhe trupore, si dhe prindërit që nuk janë të aftë për të krijuar kushte të domosdoshme për jetesë për vete dhe fëmijët e tyre, kanë përkrahje të veçantë financiare dhe shoqërore (neni 5. i Ligjit). Fëmijëve pa përkujdesje prindërore u sigurohet mbrojtje e veçantë nëpërmjet formave të mbrojtjes, siç është përkujdesja, vendosja prindërore, vendosja rezidente dhe adoptimi. Gjatë zbatimit të këtij Ligji, personat juridikë dhe fizikë që ofrojnë ndihmë profesionale, përkatësisht që i zgjidhin kontestet ndërmjet anëtarëve të familjes, janë të obliguar që të bashkëpunojnë.
2. Po ashtu, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe të ndërmarrjes së të gjitha veprimeve që kanë të bëjnë me interesin më të mirë të vetë fëmijës, janë parashikuar parime të caktuara të mbrojtjes. Kështu, neni 125 i Ligjit të përmendur parashikon që çdo fëmijë gëzon të drejtë të pakontestueshme për jetë, që fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindërit (fëmijët që nuk jetojnë së bashku me të dy prindërit, kanë të drejtë që rregullisht të takohen me ta), që fëmijët e gëzojnë të drejtën e mbrojtjes nga shfrytëzimi ekonomik, eksploatimi i punës së fëmijëve, nga kontrabandimi i njerëzve dhe shfrytëzimi seksual, si dhe nga kryerja e çfarëdo pune që është e dëmshme apo e rrezikshme për arsimin dhe shëndetin e tyre.

Neni 50.5

1. Në paragrafin e fundit të këtij neni të Kushtetutës (paragrafi 5.), është parashikuar që çdo fëmijë e gëzon të drejtën për kontakte të rregullta personale dhe të drejtpërdrejta me të dy prindërit. Duke u lidhur me këtë dispozitë kushtetuese, edhe Ligji i përmendur për Familjen e parashikon familjen si qelizë themelore të shoqërisë, pra si bashkësi jetësore të prindërve dhe të fëmijëve të tyre dhe të afërmeve të tjerë (neni 2. paragrafi 1.). Prandaj, Ligji për Familjen e kupton si të natyrshme bërthamën themelore të shoqërisë dhe e garanton të gëzuarit e të drejtës për mbrojtje të veçantë. E drejta e përmendur e fëmijës për kontakte të rregullta personale dhe të drejtpërdrejta me prindërit, mund të jetë e kufizuar, përkatësisht e

mohuar, nëse ndonjë institucion kompetent konsideron se kjo është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës. Kjo do të thotë se në marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, para së gjithash, të kihet parasysh mirëqenia dhe interesi i më të rinjve. Në këtë vështrim, Ligji për Familjen veçanërisht thekson që të gjithë personat gëzojnë trajtim të barabartë të të drejtave dhe obligimeve ligjore, mbrojtje nga diskriminimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë mbi çfarëdo baze.

2. Kur është fjala për marrëdhëniet e prindërve e të fëmijëve, duhet thënë se e drejta e prindit është e drejtë ekskluzivisht personale e prindit dhe që obligimet e prindërve janë reciproke në raport me të drejtat e fëmijës, por të drejtave të prindërve nuk u përgjigjen obligimet juridike të fëmijës. Sipas rregullës, e drejta prindërore nuk mund t'u kalohet personave të tjerë dhe prindërit nuk mund të heqin dorë nga e drejta prindërore. Kushtetuta dhe Ligji përkatës për Familjen lejojnë që me vendim gjyqësor, në pajtim me ligjin, të kufizohet apo të merret e drejta prindërore. Të drejta të caktuara apo të gjitha të drejtat, mund t'i merren njërit apo të dy prindërve, apo t'u kufizohen vetëm me vendim të gjykatës, nëse kjo është në interesin më të mirë të fëmijës.
3. Prandaj, ajo që mund të konkludohet nga kjo që u tha, të drejtat e fëmijës, si dhe mbrojtjen e tyre, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i rregullon më hollësisht Ligji përkatës për Familjen, në suazat që i parashikon vetë Kushtetuta. Që në fillim të komentit të këtij neni e kemi theksuar rëndësinë e jashtëzakonshme të konstitucionalizmit të të drejtave të fëmijës në dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare dhe domosdoshmërinë e mbrojtjes së tyre. Prandaj, të drejtat e fëmijës në numrin më të madh të kushtetutave bashkëkohore janë absolutisht të mbrojtura, çka do të thotë se shmangia nga këto të drejta nuk lejohet me asnjë kusht, pra as gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme apo gjatë luftës. Ndërkaq, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të drejtat e fëmijës të parashikuara dhe të garantuara me nenin 50 nuk bëjnë pjesë në grupin e të drejtave absolute, të cilat janë parashikuar me nenin 56 paragrafi 2 të Kushtetutës (sipas dispozitave të këtij neni, nuk lejohet shmangia, në asnjë rrethanë, vetëm nga të drejtat dhe liritë themelore, të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38 të Kushtetutës). Se a është bërë kjo qëllimisht apo rastësisht dhe se a do të rregullohet ky lëshim, ndoshta në ndonjë periudhë të ardhshme nëpërmjet amendamentimit, mbetet të shihet.

Neni 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale]

- (1) Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.**
- (2) Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.**

Neni 51

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut shpall se secili, si anëtar i shoqërisë, ka të drejtë për sigurim social, të drejtën për atë standard jetësor i cili atij dhe

familjes së tij i siguron shëndet dhe mirëqenie, (duke përfshirë ushqimin, veshjen, banesën, përkujdesjen mjekësore dhe nevojat e shërbimit social), si dhe të drejtën e sigurimit në rast të papunësisë, sëmundjes, paaftësisimit, pleqërisë dhe në raste të tjera të humbjes së mjeteve të jetesës, për shkak të rrethanave që nuk varen nga vullneti i tij (neni 22 dhe neni 25). Përkujdesje të veçantë dhe ndihmë gëzojnë nënat dhe fëmijët, ndërsa të gjitha këto të drejta i garanton dhe i përpunon në mënyrë normative Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (neni 9-12).

2. Po ashtu, Karta Sociale Evropiane i përcakton të drejtat themelore sociale,¹⁹⁵ në cilat bëjnë pjesë:
 - 1) e drejta për mbrojtje shëndetësore;
 - 2) e drejta për sigurim social;
 - 3) e drejta për ndihmë sociale dhe shëndetësore dhe shërbime të shërbimit për punë sociale.
3. E drejta e mbrojtjes sociale nënkupton që çdokujt t'i ofrohet ndihma dhe përkujdesja shëndetësore, që shteti t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e shëndetit dhe mjekim e veçanërisht që, në masën më të madhe të mundshme, të pengohen sëmundjet dhe lëndimet epidemiologjike, endemike e të tjera (neni 11 dhe neni 13 i Kartës). Në kohë të fundit, kujdes i madh i kushtohet çështjes së bioetikës, me ç'rast insistohet për rregullimin juridik të inxhinieringut gjenetik dhe të përdorimit të embrionit dhe fetusit në mjekësi edhe për kërkimet shkencore.¹⁹⁶ Karta Sociale Evropiane e vitit 1996 i obligon shtetet kontraktuese që të përcaktojnë dhe të mbajnë një sistem adekuat të arritshëm të sigurisë sociale. Standardet e mbrojtjes sociale evropiane janë përfshirë në Kodin Evropian të Sigurisë Sociale me Protokollin e miratuar së bashku me të, më 1964. Kodi i përmendur është reviduar në vitin 1990, me qëllim të modernizimit dhe të ngritjes së shkallës së mbrojtjes sociale në nivel më të lartë. Për këtë qëllim edhe neni 13 i Kartës Sociale Evropiane, duke përcaktuar të drejtën e ndihmës sociale dhe mjekësore dhe të shërbimeve sociale, i obligon shtetet që të sigurojnë që çdo person që nuk ka mjete adekuate dhe që është i paaftë për t'i siguruar ato mjete me përpjekje të veta, të marrë ndihmën adekuate, ndërsa në rast të sëmundjes ndihmën që është e domosdoshme për gjendjen e tij.
4. Për arsyet e përmendura, qytetarët dhe familjet të cilat kanë nevojë të domosdoshme për ndihmën shoqërore, për t'i përballuar vështirësitë sociale dhe jetësore dhe për të krijuar kushte për përmbushjen e nevojave themelore jetësore, kanë të drejtën e mbrojtjes sociale. Ofrimi i kësaj mbrojtjeje bazohet në parimet e së

¹⁹⁵ Për këtë, të shihet më gjerësisht: Türk, D., (1989), "Neka aktuelna pitanja ostvarivanja ekonomskih, socijalnih i kulturnih prava čoveka u svetlu rasprava u organima UN", *Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu*, nr. 5-6., (Supplement), fq. 691-696..

¹⁹⁶ Kjo, në kuadër të Këshillit të Evropës ka rezultuar me miratimin e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Dinjitetit të Qenies Njerëzore, nga aspekti i biologjisë dhe mjekësisë së aplikuar nga viti 1997, si dhe me Protokollin plotësues të vitit 1998. Nën mbrojtjen e UNESCO-s është miratuar Deklarata e Përgjithshme për Genomin Njerëzor, më 1997.

drejtës sociale, të humanizmit dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor. Të drejtat e të punësuarve dhe të familjeve të tyre për sigurim social rregullohen me ligj, ndërsa të drejtat dhe liritë sociale përfshijnë një varg autorizimesh kushtetuese-juridike dhe të garancive institucionale të individit ndaj shtetit, të cilëve në pikëpamje materiale dhe morale u mundësohet një jetesë dinjitoze për njeriun. Prandaj, të drejtat sociale, më së shpeshti, janë të formuluar në formë të obligimeve dhe të detyrave të shtetit për sigurimin e statusit social të njeriut në shoqëri,¹⁹⁷ do të thotë të integritetit social të personalitetit dhe të përmbushjes, së paku minimale, të nevojave jetësore. Këtu individit nuk mbrohet nga pushteti shtetëror, por e kundërta, pushteti shtetëror e mbron individin, ndërsa shkalla e kësaj mbrojtjeje dhe vëllimi i të drejtave sociale drejtpërsëdrejti varen nga fuqia ekonomike e shtetit.

5. Kur është fjala për të drejtat sociale, duhet thënë se ato e mbrojnë individin dhe familjen e tij nga rreziku i caktuar, të padrejtat, pasiguria e të ngjashme. Prandaj, shteti këtu ka rol aktiv dhe nga shteti mund të kërkohen aktivitete të caktuara pozitive dhe veprime përkatëse me qëllim të tejkalimit të situatës së krijuar. Natyrisht, duhet të theksojmë së ideja e të drejtave sociale nuk vjen nga një e kaluar e largët dhe se ajo është e datës më të re, pra ka lindur më vonë se të drejtat civile dhe politike. Kjo do të thotë se garantimi kushtetues i të drejtave sociale ka ardhur vetëm pas Luftës së Parë Botërore, pra me Kushtetutën e Vajmarit të vitit 1919; (në të vërtetë, disa të drejta sociale janë paralajmëruar qysh në kushtetutat e revolucionit francez, para së gjithash në Kushtetutën e Montanjarit të vitit 1793, në të cilën mund të gjenden elementet e së drejtës së punës dhe të drejtat arsimore).
6. Konsitucionalizimi i të drejtave sociale ka ndodhur pas Luftës së Dytë Botërore, por jo në numër aq të madh të shteteve evropiane. Kjo është bërë, në masë të caktuar, në preambulën e Kushtetutës së Francës të vitit 1946, pastaj në Kushtetutën e Italisë të vitit 1948 e veçanërisht në Kushtetutën e Greqisë të vitit 1975, në Kushtetutën e Portugalisë të vitit 1976, në Kushtetutën e Suedisë të vitit 1976, në Kushtetutën e Spanjës të vitit 1978, në Kushtetutën e Holandës të vitit 1983 dhe në kushtetutat e tjera. Në përcaktimin dhe konstitucionalizmin kushtetues të të drejtave sociale, veçanërisht ka ndikuar miratimi i Kartës Sociale Evropiane të vitit 1961 dhe sidomos i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të vitit 1966.
7. E drejta kushtetuese pozitive e Republikës së Kosovës përmban, përveç tjerash, dy të drejta sociale të qytetarëve dhe garanci institucionale të natyrës sociale, siç janë:
 - 1) e drejta e mbrojtjes shëndetësore, do të thotë mbrojtja dhe e drejta e sigurimit shëndetësor (neni 51. paragrafi 1.);
 - 2) e drejta e mbrojtjes sociale, do të thotë mbrojtja dhe e drejta e sigurimit social (neni 51. paragrafi 2.).

¹⁹⁷ Të drejtat sociale, para së gjithash bazohen në parimet e barazisë dhe të solidaritetit njerëzor dhe shteti është i obliguar që tu përmbahet këtyre parimeve.

8. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton vetëm faktin se mbrojtja dhe e drejta e sigurimit social janë rregulluar me ligj dhe në këtë mënyrë i referohet mbrojtjes ligjore të kësaj të drejte. Natyrisht, Kushtetuta ka mundur që në një mënyrë të përgjithshme, gjenerale, t'ia garantojë secilit të drejtën e mbrojtjes nga të gjitha sëmundjet psikike dhe fizike. Ndërkaq, duke pasur parasysh se këtë ia ka lënë ligjit, do t'i theksojmë karakteristikat themelore të Ligjit për Shëndetësinë dhe të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Mbrojtjen Shëndetësore.

Neni 51.1

1. E drejta e mbrojtjes shëndetësore hyn në grupin e të drejtave sociale-ekonomike, të cilat Kushtetuta e Republikës së Kosovës i garanton me dispozitën e nenit 51 paragrafi 1. Kjo e drejtë, në të vërtetë, e paraqet të drejtën e mbrojtjes së shëndetit psikik dhe fizik të çdo individit, por Kushtetuta nuk e rregullon në mënyrë detaje këtë të drejtë, por i referohet rregullimit të saj ligjor. Kushtetuta madje as nuk jep definicion të gjerë të rrethit të subjekteve që mund ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, (me shprehjen që “secili ka të drejtë”). Kushtetuta, po ashtu, nuk e ka përcaktuar as përmbajtjen e të drejtave të mbrojtjes shëndetësore, por shprehimisht i është referuar ligjit që ta definojë këtë (paragrafi 1.) në kufijtë që vetë i parashikon (neni 21. i Kushtetutës). E drejta e mbrojtjes shëndetësore, prandaj e ka statusin e së drejtës ligjore. Për këtë flet, parimisht, dispozita kushtetuese e cila e garanton këtë të drejtë, si dhe rregullimin ligjor të të gjitha çështjeve të rëndësishme të lidhura me realizimin e saj. Ligji e rregullon mbrojtjen shëndetësore, sigurimin shëndetësor dhe themelimin e fondeve shëndetësore.
2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, po ashtu, e përmban dispozitën parimore kushtetuese, e cila e garanton të drejtën e mbrojtjes sociale. E drejta e kësaj mbrojtjeje, pra e drejta e sigurimit social në rast të papunësisë, sëmundjes, aftësisë së kufizuar dhe të pleqërisë, e ka statusin e të drejtës ligjore. Për këtë flet dispozita parimore kushtetuese, e cila e garanton këtë të drejtë, si dhe referimi në rregullimin ligjor të të gjitha çështjeve të rëndësishme që lidhen me realizimin e saj. Në të vërtetë, nuk është përcaktuar lista e të drejtave të të punësuarve në bazë të sigurimit social, por është e sigurt që në të duhet të gjenden të drejtat e sigurimit shëndetësor dhe të drejtat e tjera në rast të sëmundjes, të drejtat në rast të shtatzënësisë, të lindjes, të zvogëlimit apo të humbjes së aftësisë së punës, të papunësisë dhe të pleqërisë, ndërsa për anëtarët e familjes, e drejta e mbrojtjes shëndetësore, e drejta e pensionit familjar si dhe të drejtat e tjera në bazë të sigurimit social. Të punësuarve, veçanërisht nëpërmjet ligjit, u garantohet e drejta e kompensimit të të ardhurave në rast të pengimit të përkohshëm për punë si dhe e drejta e kompensimit gjatë kohës së papunësisë së përkohshme. Mbrojtje e veçantë u ofrohet invalidëve, veteranëve të luftës dhe viktimave të luftës.
3. Prandaj, të drejtat sociale-ekonomike përfshijnë të drejta të shumta dhe, sipas përmbajtjes dhe natyrës, të drejta të ndryshme. Numri më i madh i këtyre të drejtave nuk realizohet në bazë të vetë kushtetutës, por përmbajtjen e tyre, subjektet dhe kushtet në të cilat fitohen, i rregullon ligji. Prandaj, këto të drejta quhen të drejta ligjore dhe dallohen nga të drejtat kushtetuese (themelore),

përmbajtjen e të cilave dhe subjekteve të cilave u takojnë, i përcakton kushtetuta. Në pajtim me parimin e së drejtës sociale dhe me parimet e humanizmit dhe të respektimit të personalitetit të njeriut, në të cilat mbështetet sistemi i mbrojtjes sociale, Kushtetuta e garanton të drejtën e mbrojtjes sociale (neni 51. paragrafi 2.). Sipas nenit 1 të **Ligjit për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë** (të miratuar në Kuvend, më 11 korrik 2003 dhe të shpallur nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, më 18 gusht 2003) është parashikuar mënyra e dhënies së ndihmës sociale, me qëllim të mbrojtjes dhe të përkujdesjes së familjeve të rrezikuara sociale. Subjekte të kësaj të drejte janë qytetarët dhe familjet e tyre, me kusht që ndihma shoqërore për to të jetë e domosdoshme, në mënyrë që t'i përballojnë vështirësitë sociale jetësore në të cilat gjenden dhe që ta përmbushin minimumin e nevojave të tyre themelore jetësore.

4. Skema e ndihmës sociale, e përcaktuar me Ligjin e përmendur, u ofron ndihmë në të holla familjeve në pajtim me kriteret që i parashikon vetë Ligji dhe me mjete të cilat me buxhetin e Kosovës janë parashikuar për këtë destinim. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale i ka caktuar qendrat për punë sociale si dhe organet përkatëse për administrimin e skemës së ndihmës sociale. Natyrisht, Ministria mund të caktojë edhe organe të tjera të administrimit të skemës dhe të nxjerrë dispozita ligjore për administrim të drejtpërdrejtë të saj. Kriteret jofinanciare dhe financiare për fitimin e së drejtës së ndihmës sociale janë përcaktuar me nenet 4 dhe 5 të Ligjit të përmendur. Duhet theksuar se Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, në raste të caktuara dhe të jashtëzakonshme, mund të shmanget nga ligji dhe të marrë vendim për përmbushjen e nevojave momentale, ad hoc dhe të jashtëzakonshme, të cilat, fare, nuk janë parashikuar me dispozitat ekzistuese të ligjit. Nevojë e jashtëzakonshme konsiderohet nevoja momentale, e njëhershme dhe e veçantë, por jo e përhershme (neni 12. paragrafi 1.).
5. Skemën e ndihmës sociale, të parashikuar me Ligjin e përmendur, e administron Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e cila së bashku me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, në pajtim me Ligjin për Administrimin e Financave Publike dhe të Kontabilitetit, e përcakton buxhetin vjetor të Skemës së Ndhmës Sociale (neni 13. paragrafi 2.). Është mjaft e rëndësishme në tërë këtë procedurë që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe organet përkatëse të sigurojnë fshehtësi të informatave personale, pra që të mos ia zbulojnë të dhënat e mbledhura të shfrytëzuesve të Skemës së Ndhmës Sociale, cilësdo organizatë apo organ, përveç kur kjo ka për qëllim zbulimin e mashtrimit apo të korrupsionit (neni 14.).
6. Sipas **Ligjit nr. 24/L-125 për Shëndetësinë** (të miratuar në Kuvend, më 13 dhjetor 2012), qëllimi i të cilit është vënia e bazave juridike për rregullimin, përparimin dhe përmirësimin e ofrimit të mbrojtjes shëndetësore për qytetarët e Kosovës, qytetari definohet si person që e posedon shtetësinë e dhënë nga ana e pushtetit kompetent të Republikës së Kosovës, që vlen për territorin e Kosovës apo personi i kualifikuar si refugjat,¹⁹⁸ në pajtim me rregulloren përkatëse. Ky ligj ka

¹⁹⁸ Jankuloski, Z., (1991), "Status izbeglica u međunarodnom pravu", *Forum - Čovek i pravo*, nr. 2, fq. 28-38

për qëllim sigurimin e bazës ligjore për ruajtjen dhe përparimin e shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës, nëpërmjet promovimit të shëndetit dhe të aktiviteteve preventive, të drejtuara në ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe cilësore të mbrojtjes shëndetësore (neni 1.).

Neni 51.2

1. Pra, siç e kemi parë, Kushtetuta nuk e garanton shprehimisht të drejtën e mbrojtjes sociale, por vetëm thekson se sigurimi themelor social rregullohet me ligj. Kushtetuta, po ashtu, nuk e përcakton as kush janë subjektet e kësaj të drejte, por nga paragrafi 2 i nenit 51 të Kushtetutës mund të konkludohet në mënyrë të tërthortë që mbrojtjen sociale mund ta gëzojnë dhe këtë të drejtë ta shfrytëzojnë personat gjatë kohës së papunësisë, në rast të sëmundjes, te paaftësia e kufizuar dhe në kohë të pleqërisë.¹⁹⁹
2. Mënyra në të cilën në Kushtetutë është parashikuar kjo garanci (“Sigurimi themelor social që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, paaftësinë e kufizuar dhe pleqërinë, rregullohet me ligj”), e lë të hapur çështjen se a i garanton këto të drejta fare Kushtetuta apo vetëm e autorizon ligjdhënësin që t’i rregullojë këto të drejta, duke e vënë bazën kushtetuese për rregullativën ligjore?! Lidhur me të gjitha të drejtat që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale, të cilën e rregullon neni 51. paragrafi 2. i Kushtetutës, mungon përcaktimi i obligimeve të shtetit, lidhur me sigurimin e kushteve për realizimin e tyre.

¹⁹⁹ Krahaso lëndët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në: *Aktvendimi për moslejueshmëri i datës 26 janar 2010 në rastin KI10/09. Abdullah Beqiri kundër Ministrisë së Punës dhe të Mbrojtjes Sociale të Republikës së Kosovës; Vendimi për heqje nga lista, nga data 24 mars 2010 i rastit KI12/09. Paraqitës i kërkesës Mehdi Krasniqi kundër Ministrisë së Punës dhe të Mbrojtjes Sociale të Republikës së Kosovës; Aktvendimi për mospranueshmëri i datës 17 qershor 2010 në rastin nr. KI13/09. Paraqitës i kërkesës Sevdail Avdyli. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 533/2006, nga data 11 shtator 2006 dhe i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 533/2006, nga data 2 dhjetor 2006; Aktvendimi për moslejueshmëri i datës 13 qershor 2011 në rastin nr. KI124/10. Paraqitëse Shkurte Krasniqi. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 771/2010, nga data 27 tetor 2010; Aktgjykimi për mospranueshmëri, nga data 3 nëntor 2011 në rastin nr. KI38/11. Paraqitës Bejta Vitia. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit të Drejtoratit të Administratës Pensionale në kuadër të Ministrisë së Punës dhe të Mbrojtjes Sociale të Republikës së Kosovës nr. 5022876, nga data 1 dhjetor 2008; dhe Aktvendimi për moslejueshmëri i datës 21 maj 2012 në rastin nr. KI18/12. Paraqitëse Remzie Arifi. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës A. nr. 1285/2011, nga data 30 dhjetor 2011.*

Neni 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor]

- (1) **Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.**
- (2) **Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.**
- (3) **Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.**

Neni 52

1. Presumimi i të drejtës për shëndet fizik dhe psikik është e drejtë e njeriut për mjedis të shëndetshëm jetësor. Kushtetuta i pranon të drejtat e reja ekologjike, në atë mënyrë që ia garanton secilit të drejtën për mjedis të shëndetshëm jetësor dhe për njoftim me kohë dhe të plotë për gjendjen e tij. Ndërkaq, kësaj të drejte i përgjigjet edhe obligimi i çdo personi që të ketë kujdes për natyrën dhe mbrojtjen e diversitetit biologjik. Ky është obligim i përgjithshëm njerëzor, sepse ka të bëjë me çdo njeri. Po ashtu, me këtë nen është përcaktuar edhe obligimi i institucioneve të pushtetit publik që të angazhohen me qëllim të garantimit të mundësive për çdo person që të mund të ndikojë në vendimet që merren për mbrojtje të mjedisit jetësor.

Neni 52.1

1. Secili, veçanërisht Republika e Kosovës, Qeveria e saj dhe komunat, është përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Po ashtu, secili është i obliguar ta mbrojë dhe përmirësojë mjedisin jetësor, gjë që Kushtetuta e Republikës së Kosovës e parashikon shprehimisht me dispozitën që “natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare janë obligim i çdo njeriu” (neni 52. paragrafi 1.).²⁰⁰ Natyra (po ashtu, e njohur me emërtimet: bota materiale, universumi material, bota natyrore dhe universumi natyror) është emërtim për gjithë materien dhe energjinë, veçanërisht në format e tyre esenciale. Natyra i përmban të gjitha kafshët, bimët dhe mineralet; të gjitha resurset dhe ngjarjet natyrore, sjelljen e qenieve të gjalla si dhe proceset që lidhen me gjërat jo të gjalla - mënyrën me të cilën gjërat ndryshohen.
2. Biodiversiteti (llojlojshmëria biologjike) nënkupton llojlojshmërinë e organizmave të gjalla, të cilat jetojnë në tokë, ujë dhe ajër, si dhe llojlojshmërinë brenda llojeve të ndryshme, ndërmjet llojeve dhe ekosistemit. Kjo nuk është vetëm llojlojshmëri e përgjithshme e formave dhe dukurive të botës bimore dhe shtazore, por edhe llojlojshmëri e funksioneve të organizmave të gjalla. Mjedisi jetësor apo rrethina e njeriut paraqesin tërë atë që na rrethon, përkatësisht tërë atë me çka në mënyrë direkte apo indirekte lidhet aktiviteti jetësor dhe prodhues i njeriut. Mjedisi natyror paraqet një nocion të afërt me ç'rast këtu nuk nënkupton që të jenë të pranishme aktivitetet e njeriut dhe as që njeriu duhet të ketë ndikime të drejtpër-

²⁰⁰ Shih lëndën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KI 56/09

drejta. Trashëgimia kombëtare paraqet tërë atë që një komb e ka trashëguar nga gjeneratat paraprake në kuptimin kulturor, historik, shkencor, gjeografik dhe në çdo kuptim tjetër.

Neni 52.2

1. Përgjegjësinë për mjedisin jetësor Kushtetuta njëkohësisht e definojnë edhe si obligim të të gjithëve për ruajtjen dhe përmirësimin e natyrës dhe të biodiversitetit, të mjedisit jetësor dhe të trashëgimisë kombëtare (paragrafi 1.). Garancia kushtetuese është parimore, ndërsa e plotëson edhe një dispozitë, e cila i rregullon detyrimet dhe obligimet lidhur me ruajtjen, mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor (paragrafi 2.).
2. Përgjegjësinë për mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe për ruajtjen e natyrës, të biodiversitetit dhe të trashëgimisë kombëtare, Kushtetuta e rregullon me dispozitë të përgjithshme, e cila ka të bëjë me të gjitha subjektet (“obligim i çdo personi”). Veçanërisht përcaktohet përgjegjësia e institucioneve të pushtetit publik, për të cilat parashikohet obligimi që të angazhohet me qëllim të sigurimit dhe të garantimit të mundësive të ndikimit të çdo personi në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin në të cilin punojnë dhe jetojnë (paragrafi 2.). Përgjegjësia për mbrojtjen e mjedisit jetësor është mbështetur në kompetencën të cilën në këtë fushë e ka Republika e Kosovës.
3. Duke pasur parasysh se Kushtetuta vetëm parimisht e rregullon përgjegjësinë për mjedisin jetësor dhe nuk i hyn më thellë kësaj problematike, konkretizimin e dispozitave kushtetuese mund ta gjejmë në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor (të miratuar në Kuvend, më 26 shkurt 2009 dhe të shpallur me Dekretin e Kryetarit të Republikës së Kosovës nr. DL-007-2009, më 19 mars 2009). Me këtë Ligj harmonizohet zhvillimi ekonomik dhe përkujdesja sociale në pajtim me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit jetësor sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.²⁰¹
4. Qëllimi i këtij Ligji është që ta promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm jetësor për popullin e Kosovës, nëpërmjet pranimit gradual të standardeve për mjedisin jetësor të Unionit Evropian, shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe kufizimin e emetimit të ndotësve të mjedisit jetësor, pengimin e dëmtimit dhe rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar jetësor, përmirësimin e kushteve të mjedisit jetësor, që lidhen me cilësinë e jetesës dhe të mbrojtjes së shëndetit të njerëzve; bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e mjedisit jetësor; harmonizimin e ligjeve, të akteve nënligjore, të procedurave të institucioneve të Kosovës me legjisllacionin e Unionit Evropian etj. (neni 2.).

²⁰¹ Zhvillimi i qëndrueshëm është një raport harmonik i ekologjisë dhe i ekonomisë, në mënyrë që pasuria natyrore e planetit tonë të ruhet edhe për gjeneratat e ardhshme. Mund të thuhet se zhvillimi i qëndrueshëm paraqet një orientim të përgjithshëm, pra përpjekjen për krijimin e një bote më të mirë duke i balancuar faktorët socialë, ekonomikë dhe faktorët e mbrojtjes së mjedisit jetësor.

5. Zbatimi i dispozitave të këtij Ligji është detyrues për të gjitha institucionet qendrore dhe lokale, personat juridikë dhe fizikë vendorë e të huaj, të cilët kryejnë veprimtari në territorin e Kosovës. Organet përgjegjëse për administrimin e mjedisit jetësor janë:

- 1) Qeveria e Republikës së Kosovës;
- 2) Ministri kompetent që gjendet në krye të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe të Planifikimit Hapësinor;
- 3) komunat.

Në vetë procesin e mbrojtjes së mjedisit jetësor, personat përgjegjës duhet të sillen në pajtim me parimet themelore të përcaktuara me ligj, ku bëjnë pjesë:

- 1) parimi i integritetit të mbrojtjes së mjedisit jetësor;
- 2) parimi i harmonizimit gradual me standardet e Unionit Evropian;
- 3) parimi i preventivës dhe i parandalimit;
- 4) parimi “ndotësi paguan”,²⁰²
- 5) parimi “shfrytëzuesi paguan”,²⁰³
- 6) parimi i përgjegjësisë subsidiare,²⁰⁴
- 7) parimi i masave stimuluese;
- 8) parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë;
- 9) parimi i kontrollit të publikut në informatat për mjedisin jetësor (neni 6.).

Me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor janë parashikuar edhe instrumentet për mbrojtjen e tij, kështu që mjedisi jetësor rregullohet me:

- 1) infrastrukturë ligjore;
- 2) dokumente për mbrojtjen e mjedisit jetësor;
- 3) instrumente ekonomike;
- 4) dokumente për vlerësim të ndikimit në mjedisin jetësor;
- 5) instrumente për monitorim të mjedisit jetësor;
- 6) menaxhim të mbrojtjes së mjedisit jetësor nga personat juridik apo fizik (neni 7.).

6. Për ruajtjen e mjedisit jetësor dhe mbrojtjen e tij është shumë i rëndësishëm ekzistimi i strategjisë përkatëse. Kështu, Strategjinë për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe për zhvillim të qëndrueshëm e hartojnë, për shkak të rëndësisë së saj, institucionet më të larta politike në Republikë. Pra, me propozim të Qeverisë, këtë strategji, e cila i përfshin qëllimet për mbrojtje të mjedisit jetësor të Kosovës, e miraton Kuvendi i Kosovës për periudhën kohore prej 10 vjetësh, me mundësi të rishqyrtimit në çdo dy vjet. Strategjinë e përmendur e harton Ministria kompetente e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor në bashkëpunim me ministritë e tjera përkatëse dhe me institucionet relevante shkencore të Kosovës. Në hartimin e kësaj Strategjie, në mënyrë përkatëse, merr pjesë edhe opinioni, si dhe palët e

²⁰² Ndotësi e paguan kompensimin për ndotje të mjedisit jetësor kur me aktivitetet e veta shkakton ngarkesë për mjedisin jetësor, me prodhimin, shfrytëzimin apo vënien në qarkullim të lëndës së parë, të gjysmëfabrikateve apo të prodhimeve që përmbajnë materie të dëmshme për mjedisin.

²⁰³ Çdokush që i shfrytëzon resurset natyrore, është i obliguar që ta paguajë çmimin real për shfrytëzimin e tyre dhe rikultivimin e hapësirës pas përfundimit të aktivitetit të shfrytëzimit.

²⁰⁴ Në rastin kur përgjegjësia për ndotje nuk mund të përcaktohet, atëherë institucionet shtetërore i bartin shpenzimet për rehabilitim dhe zvogëlim të ndotjes së mjedisit.

interesuara. Për shkak të rëndësisë së mbrojtjes së mjedisit jetësor, Ministria kompetente i raporton Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës një herë në vit për realizimin e Strategjisë për mbrojtjen e mjedisit jetësor, ndërsa Planin e Kosovës për ruajtjen e mjedisit jetësor, me propozim të së njëjtës Ministri, e harton Qeveria për periudhë prej 5 vjetësh, të cilin e miraton Kuvendi. Plani i përmendur miratohet në afat prej 18 muajsh pas miratimit të Strategjisë.

7. Duke pasur parasysh tërë atë që e kemi thënë deri tash për rëndësinë e mjedisit jetësor dhe mbrojtjen e tij, në çdo shoqëri është me rëndësi të sigurohet edhe monitorimi përkatës. Kështu, Ministria, në kuadër të kompetencave të veta të përcaktuara me ligj, e siguron kontrollin e përhershëm dhe përcjelljen e gjendjes së mjedisit jetësor (neni 50. paragrafi 1.), ndërsa çdo palë e interesuar ka të drejtë që në çdo kohë, t'i shohë regjistrin dhe evidencat e Ministrisë, të cilat përmbajnë informata dhe të dhëna për gjendjen e mjedisit jetësor (neni 50. paragrafi 8.). Me qëllim të sigurimit të këtij monitorimi, Ministria e organizon dhe udhëheq Sistemin informativ të mjedisit jetësor (neni 52.), dhe është e obliguar që çdo personi të interesuar, organi apo organizate t'i sigurojë qasje në informatat e kërkuara dhe që rregullisht, me kohë, në mënyrë të plotë dhe objektive, ta informojë opinionin për gjendjen e mjedisit jetësor, përkatësisht për dukuritë e përcjella gjatë monitorimit. Po ashtu, me qëllim të monitorimit të cilësisë dhe të veçorive të mjedisit jetësor, Ministria e themelon Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor të Kosovës, struktura organizative e të cilit dhe përgjegjësitë e tjera rregullohen me akt nënligjor.

Neni 52.3

1. Kur është fjala për paragrafin 3. të nenit 52 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që thotë se “ndikimi në mjedisin jetësor do të merret parasysh nga ana e institucioneve publike gjatë procesit të marrjes së vendimeve”, shtrohet pyetja se për cilin ndikim është fjala dhe kush e ushtron atë ndikim. Prandaj konsiderojmë se ky paragraf nuk është mjaft i qartë, kështu që nuk do të ishte në rregull për t'u thelluar në analiza të mëtejme dhe komentim të dispozitës që është përfshirë në këtë paragraf.
2. Mënyra në të cilën Kushtetuta i rregullon obligimet e pushtetit publik është shkas që të shtrohet pyetja se cili është ky pushtet publik të cilit Kushtetuta ia vë në kompetencë obligimin e përmendur dhe pse nga ky kontekst janë përjashtuar bashkësitë lokale (qytetet dhe komunat), kur ndër kompetencat e tyre gjendet edhe kujdesi për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Edhe pse dispozitat kushtetuese janë parimore, Kushtetuta shprehimisht i referohet ligjit i cili do ta rregullonte më hollësisht mënyrën e realizimit të këtyre të drejtave dhe këtyre obligimeve. Në këtë rast, mund të zbatohet dispozita e përgjithshme kushtetuese, sipas së cilës, ligji mund ta rregullojë mënyrën e realizimit të ndonjë të drejte në kufijtë që i definon Kushtetuta, me kusht që kjo të jetë e domosdoshme për realizimin e saj.

Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 53

1. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, siç e kemi thënë edhe më sipër, paraqet instrumentin themelor dhe më të vjetër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, që realizohet në sistemin e Këshillit të Evropës.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës interpretohen në mënyrën me të cilën avancohen vlerat e shoqërisë së hapur dhe të lirë demokratike, në pajtim me garancitë ekzistuese ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të pakicave dhe praktikën e organeve ndërkombëtare, të cilat e mbikëqyrin zbatimin e tyre. Duke pasur parasysh se gjykatat kushtetuese të numrit më të madh të vendeve evropiane, nëpërmjet zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kushtetuese për të drejtat e njeriut, në pajtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e kanë pranuar interpretimin e dispozitave për të drejtat e njeriut në pajtim me vendimet gjyqësore të kësaj Gjykate, prandaj edhe neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës e kërkon këtë me dispozitën e vet të përmendur. Kjo për arsye se konsiderohet se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, si dhe organet e tjera që do t'i interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutën, do t'i përkrahim vendimet e përmendura. Me arsye pritet që në këtë mënyrë Republika e Kosovës do t'i afrohet një doktrine të të drejtave të njeriut, çfarë e kërkon zbatimi dhe interpretimi i dispozitave kushtetuese për të drejtat e njeriut, që do ta hapë rrugën e globalizimit të të drejtave kushtetuese të Kosovës dhe do të kontribuojë për mbrojtjen më të mirë të të drejtave të individëve në Republikë, gjë që është më e rëndësishmja nga të gjitha të tjerat.
3. Vetë dispozita e nenit të përmendur lidhet me parimet e përgjithshme të parashikuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të cilat theksojnë se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut e përbëjnë bazën e rendit juridik të Republikës së Kosovës, se këto të drejta vlejné për të gjithë personat dhe që të gjithë janë të obliguar që t'i respektojnë ato (neni 21.), si dhe dispozitën e cila e parashikon zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe të instrumenteve ndërkombëtare (neni 22.). Prandaj, Kushtetuta e garanton zbatimin e drejtpërdrejtë të të drejtave të njeriut, sipas mënyrës në të cilën janë garantuar me rregulla të gjithëpranueshme të së drejtës ndërkombëtare, të vërtetuara me marrëveshje dhe ligje ndërkombëtare. Ajo përcaktohet për zgjidhjet se, të drejtat dhe liritë e njeriut, të cilat janë parashikuar një për një me marrëveshjet dhe instrumentet e përmendura ndërkombëtare, të garantuara me të, në mënyrë të drejtpërdrejtë do të zbatohen në territorin e Republikës së Kosovës dhe do të kenë epërsi në rast të konfliktit ndaj të

gjitha dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Kjo do të thotë se këtu u jepet përparësi marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare, pra marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, por njëkohësisht garantohet që dispozitat për të drejtat dhe liritë themelore, të interpretohen në dobi të përparimit të vlerave të shoqërisë demokratike.

4. Po ashtu, pasi që standardet dhe praktika ndërkombëtare e institucioneve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (Komiteti i KB për të Drejtat e Njeriut apo Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut) janë obliguese për interpretimin e dispozitave kushtetuese për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, zbatimi i drejtë i këtyre dispozitave në interpretimin e së drejtës, do të mund t'i përmirësonte disa parregullsi të caktuara dhe paqartësi gjuhësore. Po ashtu, zbatimi i drejtë i dispozitave për të drejtat dhe liritë themelore dhe interpretimi në pajtim me të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, do të duhej të kontribuonin në harmonizimin e legjislacionit të Republikës së Kosovës me legjislacionin e Unionit Evropian.
5. Pranimi i Konventës nuk ka të bëjë vetëm me një deklaratë formale të pranimit të formulimeve dhe të përmbajtjes së tekstit të Konventës, por kjo do të thotë edhe pranim i asaj që vendimin definitiv për shkeljen e të drejtave të njeriut, pra edhe interpretimin e kuptimit të dispozitave, e jep Komisioni dhe Gjykata për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Në interpretimet e tilla, praktika e Gjykatës dhe e Komisionit për të Drejtat e Njeriut paraqet burim të begatshëm të interpretimeve të ndryshme. Pra, Gjykata në praktikë e ka përcaktuar edhe përmbajtjen e shumë standardeve dhe kriterëve juridike, siç janë, për shembull, kriteri i “domosdoshmërisë në shoqërinë demokratike”, “derogimi në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme” etj. Roli i praktikës gjyqësore, në këtë pikëpamje, nuk i përgjigjet shembullit klasik të së drejtës kontinentale evropiane, por në pjesën më të madhe traditës dhe metodave të sistemeve që bazohen në precedentë. Me praktikën dhe interpretimet e Gjykatës shtrirja e dispozitave është zgjeruar dukshëm.
6. Duhet përkujtuar së këtu kemi të bëjmë me dokumentin juridik për të cilin ekzistojnë procedura të caktuara të zbatimit të dhunshëm, të kompensimit të palëve të dëmtuara dhe vullneti politik e pajtimi i shteteve që e kanë pranuar Konventën. Po ashtu, ekziston edhe obligimi që shtetet nënshkruese ta harmonizojnë të drejtën vendore me Konventën, e veçanërisht edhe obligimi që t'i sigurohet secilit individ që t'i gëzojë të drejtat dhe liritë e garantuara me Konventë. Shprehja “secilit” do të thotë se realizimi i këtyre të drejtave nuk ka të bëjë vetëm me qytetarët, as nuk kushtëzohet me vendbanim apo vendqëndrim, por tekstualisht ka të bëjë me të gjithë personat nën juridiksion të një shteti.
7. Secili shtet, me nënshkrimin e Konventës, e pranon edhe obligimin që t'i njohë vendimet e Gjykatës dhe që t'ia garantojë “secilit nën juridiksionin e vet”, të drejtën për të kërkuar mbrojtje. Krijimi i një sistemi të tillë, në masë të madhe është pasojë e mendimit kritik për efikasitetin dhe efektivitetin e së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht të kuptimit se po krijohet sistemi në të cilin

mbikëqyrja dhe gjykimi përfundimtar për të drejtat e njeriut u është lënë institucioneve transnacionale, mbi të cilat kontraktualisht bartet veprimtaria, e cila më parë ka qenë pjesë e sovranitetit kombëtar.

8. Kompetenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut shtrihet në të gjitha lëndët në pikëpamje të interpretimit dhe të zbatimit të Konventës dhe të protokolleve plotësuese. Gjykata vendos në bazë të kërkesave të palëve, edhe nëse është fjala për konteste ndërshtetërore në të cilat nënshkrueset e Konventës i drejtohen Gjykatës apo edhe nëse është fjala për kërkesa individuale. Kërkesë individuale mund të parashtrojë cilido person fizik, organizatë joqeveritare apo shoqatë e individëve. E drejta për padi individuale është element thelbësor i sistemit të mbrojtjes “mbinacionale” të të drejtave të njeriut, ndërsa shtetet, jo vetëm që janë palë e paditur, por, me pranimin e Konventës, pra me pranimin e kompetencave, marrin obligim që “në asnjë mënyrë të mos e pengojnë realizimin efektiv të kësaj të drejte”. Kushtet e lejueshmërisë, do të thotë mundësia që kjo Gjykatë të jetë kompetente, janë përcaktuar me nenin 35 të Protokollit II me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut. Sipas këtij neni, Gjykata mund ta shqyrtojë lëndën vetëm pasi që të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike vendore dhe në interval kohor prej 6 muajsh nga dita e marrjes së vendimit definitiv, si dhe nëse për të njëjtën lëndë nuk vendos apo është vendosur në ndonjë organ tjetër ndërkombëtar (*ne bis in idem*).
9. Edhe pse këtu zbatohet parimi i ndalimit të prapaveprimit, domethënë zbatimi prapaveprues i traktateve ndërkombëtare, Gjykata ka marrë qëndrim që, megjithatë, ta pranojë shqyrtimin e këtyre kërkesëpadive, kur është fjala për shkelje të vazhdueshme të ndonjë të drejte të mbrojtur me Konventë, pasojat e së cilës vazhdojnë edhe pas hyrjes në fuqi të Konventës, edhe pse akti i shkeljes ka ndodhur para atij momenti. Gjykata vendos për të gjitha rastet në suaza të kompetencave të veta, me shumicë votash. Secili gjyqtar, që ka qenë në Bord, Këshill apo në Këshillin e Lartë të Gjykatës, është i autorizuar që për vendimin ta veçojë mendimin e vet. Vendimi definitiv i obligon shtetet që janë përfshirë në padi, ndërsa mbikëqyrja e realizimit të vendimit i është besuar Këshillit të Ministrave.

Neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Neni 54

1. Për shkak të rëndësisë që ka për statusin e të drejtave të njeriut në sistemin kushtetues dhe juridik e mbrojtja e tyre, ndërmjet dispozitave të përgjithshme për

të drejtat e njeriut janë vendosur edhe garancitë kushtetuese të së drejtës për mbrojtje të të drejtave njerëzore. Kushtetuta i përcakton dy forma të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si: mbrojtjen në të drejtën e brendshme dhe mbrojtjen juridike-ndërkombëtare (mbrojtjen para institucioneve ndërkombëtare).

2. Kushtetuta në mënyrë primare e garanton mbrojtjen në Gjykatë, si formën më të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në të drejtën e brendshme. Të drejtën e mbrojtjes në gjykatë e ka çdokush, të cilit i është shkelur apo mohuar e drejta e garantuar me Kushtetutë. Kështu, edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, përcakton që çdokush ka të drejtë për mbrojtje gjyqësore në rast të shkeljes apo të mohimit të ndonjë të drejte, që është e garantuar me vetë Kushtetutën.²⁰⁵ Pos kësaj, neni 54 i kësaj Kushtetute e përmban dispozitën e cila ia garanton çdo individ edhe të drejtën për masa efikase juridike, nëse konstatohet se e drejta i është shkelur. Nga kjo del se secilit i është garantuar e drejta për gjykim të pavarur, të paanshëm dhe të bazuar në ligj, që do të thotë se në këtë mënyrë është garantuar e drejta për gjykim të drejtë (neni 31 i Kushtetutës) dhe e drejta për mbrojtje të barabartë në gjykata, në organet e tjera shtetërore, bartësit e autorizimeve publike dhe organet e njësisve të vetëqeverisjes lokale (neni 24. paragrafi 1. dhe neni 32. i Kushtetutës).
3. Mbrojtjen e të drejtave të njeriut në gjykatë e plotëson edhe kontrolli gjyqësor i administratës (kontrolli i kushtetutshmërisë dhe i ligjshmërisë së akteve të caktuara të organeve të administratës), me të cilat vendoset për të drejtën e ndokujt, obligimin apo interesin e bazuar në ligj. Krahas garantimit të të drejtave të caktuara (për shembull, të drejtës së zgjedhjes, të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtës fetare, të bindjes dhe të ndërgjegjes e të tjera), Kushtetuta shprehimisht e parashikon mbrojtjen e tyre, do të thotë pamundësinë e kufizimit, madje edhe në rast të gjendjes së jashtëzakonshme. Ajo që është mjaft e

²⁰⁵ Shih lëndët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në: *Aktgjykimi i datës 3 mars 2011 në rastin nr. KI32/10. Paraqitës i kërkesës Fahrudin Mexhedoviq. Zëvendës i kryesuesit për Bashkësi në Kuvendin e Komunës së Pejës. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Kuvendit të Komunës së Pejës për emërimin e zëvendësit të komunës për bashkësi, nga data 15 shkurt 2010; Aktgjykimi i datës 17 korrik 2012 në rastin nr. KI129/11. Paraqitës i kërkesës Viktor Marku nga Prishtina. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktgjykimi të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 158/2011, nga data 5 korrik 2011 dhe i vendimit nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga ana e Komunës së Klinës; Aktgjykimi i datës 16 korrik 2012 në rastin nr. KI47/12. Paraqitës i kërkesës Islam Thaqi. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 188/2009, nga data 7 dhjetor 2011; Aktgjykimi i datës 16 korrik 2012 në rastin, nr. KI50/12. Paraqitës i kërkesës Agush Lloluni. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. nr. 153/2011, nga data 4 tetor 2011 dhe i vendimit nr. 02/207/2010, nga data 4 tetor 2010, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga ana e Komunës së Junikut; Aktgjykimi i datës 26 shkurt 2013 në rastin KI41/12. Paraqitës Gëzim dhe Maqfire Kastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe Aktgjykimi i datës 5 korrik 2013 në rastin nr. KI112/12. Paraqitës i kërkesës Adem Meta. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë Ac. nr. 61/12, nga data 13 shkurt 2012.*

rëndësishme për mbrojtjen ligjore të të drejtave, është fakti që përmbajtja e të drejtave për mbrojtje në rast të shkeljes apo të mohimit të ndonjë të drejte, nuk e përfshin vetëm të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, por edhe të drejtën për mënjanimin e pasojave që janë shkaktuar me shkeljen e të drejtës së caktuar, do të thotë, e drejta për masa efikase juridike, nëse konstatohet se e drejta është shkelur (neni 54. i Kushtetutës). Përveç mbrojtjes gjyqësore, veçanërisht garantohet mbrojtja e drejtpërdrejtë e të drejtave të njeriut në Gjykatën Kushtetuese (neni 113. i Kushtetutës). Mbrojtja e drejtpërdrejtë kushtetuese-gjyqësore e të drejtave të njeriut, mbështetet në parimin e zbatimit të drejtpërdrejtë të të drejtave të garantuara kushtetuese, ndërsa realizohet si formë subsidiare e mbrojtjes, në kushtet e përcaktuara me Kushtetutë.

4. Mekanizmi i mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut përfshin një varg parimesh juridike, garanci institucionale dhe instrumente e procedura të tjera juridike, në të cilat mbrohen liritë dhe të drejtat themelore të qytetarëve nga shkeljet e mundshme, rrezikimi, keqpërdorimi, mohimi dhe kufizimet e pabazuara. Nëse kthehemi në historinë e lindjes së të drejtave themelore të njeriut, atëherë mund të konkludojmë se qëllimi dhe kuptimi i lirisë së njeriut janë kërkuar dhe gjetur në kufizimin e pushtetit shtetëror dhe mbrojtjen nga veprimi arbitrar i aparatit drejtues të shtetit. Prandaj shtrohet pyetja se çka është më e rëndësishme në çdo shtet për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut. Përgjigja në këtë pyetje është e thjeshtë: kjo është mënyra e realizimit të tyre, dhe procedura e mbrojtjes së tyre kushtetuese-juridike. Kjo mbrojtje e të drejtave dhe e lirive themelore duhet të jetë efikase, sepse ajo do të duhej ta vërtetonte nivelin e lartë të të drejtave të garantuara me kushtetutë dhe superioritetin juridik të tyre në krahasim me të drejtën e thjeshtë ligjore. Prandaj, mbrojtja juridike është “gur provues” për numrin më të madh të të drejtave themelore të njeriut, veçanërisht të atyre të drejtave me të cilat, në të njëjtën kohë, kufizohen autorizimet e pushtetit publik, përkatësisht të shtetit.
5. Është parim që të drejtat dhe liritë themelore të realizohen drejtë për së drejti. Do të thotë, parimi i zbatimit të drejtpërdrejtë të normave për të drejtat e njeriut shtrihet edhe në burimet e tyre ndërkombëtare, prandaj me Kushtetutë garantohen dhe, si të tilla, zbatohen drejtë për së drejti të drejtat dhe liritë themelore, të njohura me rregulla të gjithëpranueshme të së drejtës ndërkombëtare, të përcaktuara me marrëveshje dhe ligje.²⁰⁶ Me ligj mund të parashikohet mënyra e realizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, vetëm nëse kjo është parashikuar me kushtetutë shprehimisht apo nëse kjo është e domosdoshme për realizimin e ndonjë të drejte. Për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut si dhe për realizimin e parimit të shtetit juridik, me rëndësinë më të madhe është garancia e mbrojtjes gjyqësore të lirive dhe të të drejtave, të pranuar dhe të garantuara me kushtetutë. Pra, nuk ka mbrojtje efikase të të drejtave (që është me rëndësi esenciale për çdo individ), as realizim të parimeve të shtetit juridik, pa gjykatë të pavarur dhe të paanshme. Prandaj, çdo kushtetutë duhet t'ia garantojë çdo individ të drejtën për

²⁰⁶ Nga kjo del se Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut drejtpërsëdrejti zbatohet në Republikën e Kosovës, me vëllim të pazvogëluar.

mbrojtje gjyqësore, nëse i nevojitet apo i është mohuar ndonjë e drejtë njerëzore apo liri themelore, si dhe të drejtën për evitimin e pasojave të cilat janë shkaktuar nga shkelja.

6. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave, përveç mbrojtjes klasike penale-juridike dhe civile-juridike, përfshin garancinë e zhvillimit të kontestit administrativ dhe procedurën e vendosjes lidhur me ankesat kushtetuese të qytetarëve. Në procedurën e zgjidhjes së *kontesteve administrative*, gjykata kompetente vendos për ligjshmërinë e akteve definitive administrative,²⁰⁷ me të cilat vendoset për të drejtën, obligimin apo interesin e qytetarëve të bazuar në ligj. Kontestet administrative, sipas rregullës, i zgjidhin gjykatat administrative.²⁰⁸ Në procedurën lidhur me ankesat kushtetuese, parimisht vendoset për kushtetutshmërinë e të gjitha akteve dhe veprimeve individuale, me të cilat cenohen të drejtat themelore kushtetuese të qytetarëve. Për ankesat kushtetuese vendos Gjykata Kushtetuese.
7. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave të njeriut është formë themelore e mbrojtjes juridike të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe të qytetarit, të garantuara me Kushtetutë. Gjykatat e mbrojnë të drejtën në përgjithësi dhe rendin juridik në tërësi. Me atë që mundësojnë realizimin e të drejtës objektive dhe funksionimin e rendit juridik, gjykatat drejtpërsëdrejti i mbrojnë të drejtat subjektive të individëve, të drejtat dhe liritë e garantuara të njeriut dhe të qytetarit. Çfarë mund të vërehet këtu? Para së gjithash, karakteri dualist i gjykatave, sepse gjykatat njëkohësisht janë edhe organe të pushtetit shtetëror (do të thotë, pjesë e aparatit të saj detyrues), edhe mbrojtës të të drejtave dhe lirive të njeriut e të qytetarit.
8. Kur flasim për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të njeriut, atëherë duhet t'i përmendim edhe llojet kryesore të kësaj mbrojtjeje. Pra, ajo përfshin:
 - 1) mbrojtjen nga shkeljet dhe rrezikimet e bëra nga ana e shtetit dhe të organeve të tjera publike;
 - 2) mbrojtjen nga shkeljet e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, të shkaktuara me veprime të kundërligjshme dhe me akte të personave të tjerë (të personave fizikë dhe juridikë);
 - 3) kur i mbron të gjitha dimensionet e pozicionit subjektiv juridik në raport me pushtetin publik, mbrojtja gjyqësore përfshin jo vetëm mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, por edhe të drejtat e përcaktuara me ligj dhe interesat legjitime të individit.
 - 4) kur i mbron të gjitha dimensionet e pozitës subjektiv juridik në raport me pushtetin publik, mbrojtja gjyqësore përfshin jo vetëm mbrojtjen e të drejtave

²⁰⁷ Përveç kontestit administrativ, në të cilin vendoset për ligjshmërinë e akteve definitive administrative, rëndësi jashtëzakonisht të madhe ka edhe procedura administrative, në të cilën vendoset për mbrojtjen e të drejtave të personalitetit. Për këtë, të shihet më gjerësisht: Kavran, D., (1979) "Kadrovske evidencije i zaštita prava ličnosti u upravnom postupku", *Pravni život*, nr. 12, fq. 3-22.

²⁰⁸ Ky nuk është rast në Republikën e Kosovës, sepse për të gjitha kontestet administrative është kompetente Gjykata Themelore në Prishtinë.

themelore të njeriut, por edhe të drejtat e përcaktuara me ligj dhe interesat legjitime të individit.

9. Me këtë nen Kushtetuta i mbron qytetarët nga arbitrariteti i pushtetit administrativ dhe nga veprimet e tij të paligjshme. Me vetë vendosjen e kësaj mbrojtjeje, qytetarët në masë të caktuar janë të siguruar nga aktet e paligjshme të administratës. Aktet e tilla do t'i eliminojë gjykata dhe pushteti administrativ do të jetë i obliguar, nëse është e nevojshme, që të nxjerrë akt të ri në pajtim me ligjin. Gjyqësia administrative është një nga krijimet e kohës më të re, veçanërisht në ish-vendet jugosllave. Po ashtu, në kohën kur janë miratuar deklaratat e para për të drejtat e njeriut dhe të qytetarit, ende nuk mendohej për gjyqësi administrative. Deri tek paraqitja e gjyqësisë administrative dhe të gjykatave të tjera të specializuara, mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të qytetarëve e kanë ofruar gjykatat në procedura gjyqësore tradicionale (procedura penale dhe civile gjyqësore). Sot, në një numër të madh shtetesh, përveç gjykatave të përgjithshme ekzistojnë edhe gjykata të ndryshme të veçanta, varësisht nga lloji i kontestit që e zgjidhin, përkatësisht nga të drejtat subjektive që i mbrojnë.²⁰⁹
10. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave sot, në pjesën më të madhe realizohet si kompetencë e pushtetit të pavarur gjyqësor, sepse pa pushtetin e gjykimit, shteti juridik nuk mund të paramendohet.²¹⁰ Pra, gjykatat i mbrojnë liritë dhe të drejtat e qytetarëve, të drejtat e përcaktuara me ligj dhe interesat subjektive juridike dhe e sigurojnë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. Pikërisht për këtë (për të qenë objektiv dhe neutral), pushteti gjyqësor duhet të jetë i pavarur nga funksionet e tjera të pushtetit shtetëror. Kështu është edhe sipas Ligjit për Gjykatat të Republikës së Kosovës (të miratuar në Kuvend, më 22 korrik 2010 dhe të shpallur me Dekretin e Kryetarit të Republikës së Kosovës nr. DL-047-2010, më 09 gusht 2010), objekt i të cilit është rregullimi i organizimit, funksionimit dhe kompetencës së gjykatave në Republikën e Kosovës (nenin 1).
11. Që në fillim të këtij Ligji është parashikuar pavarësia dhe paanësia e gjykatave. Kështu, edhe vetë gjykata e garanton këtë pavarësi, me dispozitën që gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm gjatë ushtrimit të detyrave të tyre (neni 102. paragrafi 4.), ndërsa me Ligjin për Gjykatat (neni 3. paragrafi 2.), po ashtu, është parashikuar që gjyqtarët, gjatë kryerjes së funksioneve të veta dhe marrjes së vendimeve, janë të pavarur dhe të paanshëm, si dhe në asnjë mënyrë nuk bien nën ndikimin e cilitdo person fizik apo juridik, duke i përfshirë edhe organet shtetërore. Gjykatat e themeluara me këtë Ligj gjykojnë në pajtim me Kushtetutën dhe

²⁰⁹ Karakter të gjykatave të veçanta kanë: 1) gjykatat tregtare apo ekonomike; 2) administrative; 3) të punës; 4) gjykatat e sigurimit social; 5) doganore; 6) tatimore; 7) gjykatat e të miturve; 8) gjykatat ushtarake e të tjera. Ndër to, rëndësi të veçantë kanë gjykatat administrative, të cilat zgjidhin konteste administrative, njëkohësisht, i mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore publike të qytetarëve nga shkeljet e bëra në akte administrative.

²¹⁰ Basta-Posavec, L., (1993), 'Pravna država i konstitucionalna demokratija', *Anali Pravnog Fakultetat u Beogradu*, nr. 1-2, fq. 26-31.

ligjin²¹¹ (paragrafi 1.) Duke pasur parasysh se Republika e Kosovës është shoqëri multietnike, neni 5 paragrafi 1 parashikon që përbërja e administratës gjyqësore duhet ta shprehë këtë llojllojshmëri etnike,²¹² në pajtim me vetë Kushtetutën, si dhe me parimet e njohura ndërkombëtare për barazinë gjinore.

12. Ajo që është mjaft karakteristike për gjyqësinë e Republikës së Kosovës është struktura organizative e sistemit gjyqësor, të cilën e përbëjnë: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Degët formohen në territorin e Gjykatës Themelore, ndërsa brenda Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore mund të themelohen njësi dhe seksione, me qëllim të funksionimit më efikas të gjykatës së caktuar.
13. Kompetenca lëndore e gjykatave themelore është caktuar në atë mënyrë që Ligji përmendur parashikon se ato janë kompetente që në shkallë të parë të gjykojnë për të gjitha lëndët, përveç nëse me ligj është parashikuar ndryshe. Gjykatat themelore janë kompetente edhe për ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare, si dhe për vendosje lidhur me pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja. Duhet theksuar se nuk ekzistojnë as gjykata administrative, as ekonomike (tregtare), por kontestet administrative dhe ekonomike janë në kompetencë ekskluzive të Gjykatës Themelore në Prishtinë (neni 11).
14. Në raport me gjykatat themelore, është themeluar edhe Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, me kompetencë vendore në tërë territorin e Republikës së Kosovës, ndërsa selia e saj është në Prishtinë. Përbërja e Gjykatës së Apelit, po ashtu, e shpreh llojllojshmërinë etnike të Republikës së Kosovës në pajtim me parimet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. Në pajtim me dispozitat relevante të Propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e me qëllim të sigurimit të pjesëmarrjes së bashkësive në gjyqësi, është parashikuar që 15% nga numri i përgjithshëm i vendeve në Gjykatën e Apelit (por, kurrësi më pak se 10 vende), janë të garantuara për gjyqtarët nga bashkësitë që nuk janë shumicë në Kosovë (neni 17).
15. Kompetencat e Gjykatës së Apelit janë parashikuar me nenin 18 të Ligjit, e cila, sipas dispozitave të tij, mund:
 - 1) t'i shqyrtojë të gjitha ankesat e paraqitura kundër vendimeve të gjykatave themelore;
 - 2) të vendosë, si gjykatë e shkallës së tretë (dytë), për ankesa të lejueshme me ligj dhe për konflikt të juridiksionit ndërmjet gjykatave themelore;
 - 3) ta zgjidhë konfliktin e kompetencave ndërmjet gjykatave themelore;
 - 4) t'i zgjidh rastet e tjera të parashikuara me ligj.

²¹¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 102, paragrafi 3.

²¹² Përbërja e gjyqësisë duhet ta shprehë përbërjen etnike të kompetencën vendore të secilës gjykatë.

16. Në fund, organi më i lartë i pushtetit gjyqësor në Kosovë është Gjykata Supreme, (Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 103 paragrafi 2), që ka kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, ndërsa organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i saj (si edhe i gjykatave të tjera), rregullohet me ligj. Kjo Gjykatë e përfshin Kolegjin e ankesave të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e së cilës njëkohësisht janë edhe gjyqtarë të Gjykatës Supreme. Po ashtu, si edhe te Gjykata e Apelit, përbërja e Gjykatës Supreme, sipas ligjit, duhet ta shprehë përbërjen etnike të Republikës së Kosovës. Kjo do të thotë se së paku 15% e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, (por kurrsesi më pak se 3 gjyqtarë), duhet të jenë nga bashkësitë që nuk janë shumicë në Kosovë, (neni 103. paragrafi 3. i Kushtetutës). Selia e Gjykatës Supreme është në Prishtinë (neni 21.), ndërsa në krye të saj është kryetari, i cili mund të kryejë edhe detyra të tjera të parashikuara me ligj (neni 103. i Kushtetutës).
17. Kompetenca e Gjykatës Supreme është caktuar me nenin 22 të Ligjit për Gjykatat, kështu që kjo gjykatë:
- 1) vendos për kërkesën për shfrytëzim të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, kundër vendimeve të plotfuqishme të gjykatave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është parashikuar me ligj;
 - 2) vendos për revizionin kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së dytë;
 - 3) i përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet juridike lidhur me çështjet që janë të rëndësishme për zbatimin e ligjit nga ana e gjykatave në territorin e Kosovës;
 - 4) i zgjidh lëndët e Agjencisë Kosovare të Pronës;
 - 5) i zgjidh lëndët e Agjencionit Kosovar të Privatizimit apo të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit;
 - 6) çështjet e tjera të parashikuara me ligj.
18. Duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë, rëndësinë dhe rrezikun e mundshëm në ushtrimin e funksionit gjyqësor, gjyqtarët mund të kërkojnë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës masa të veçanta të mbrojtjes për vete dhe familjet e tyre, kur rreziku për jetën e tyre apo jetën e anëtarëve të familjeve të tyre del si rezultat i ushtrimit të funksionit me përgjegjësi që kryejnë. Përveç kësaj, gjyqtarët dhe gjyqtarët porotë kanë imunitet (neni 31 i Ligjit për Gjykatat) nga ndjekja penale, paditë civile apo largimi nga funksioni, për shkak të vendimit të marrë, votimit, mendimit të shprehur apo të ndonjë veprimi tjetër, që është në pajtim me detyrimet dhe përgjegjësitë e tij, gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarit (neni 117. paragrafi 1. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës). Natyrisht, kjo mospërgjegjësi e gjyqtarëve, përkatësisht imuniteti i tyre, nuk mund të zbatohet në rast të shkeljes së qëllimshme të ligjit, prandaj, nëse konstatohet një sjellje e tillë e gjyqtarit apo e gjyqtarit porotë, ata mund të shkarkohen nga funksioni.
19. Mbrojtja kushtetuese-gjyqësore e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut është formë e specializuar e mbrojtjes së tyre në shumicën e numrit të shteteve evropiane, duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës. Ajo realizohet nëpërmjet gjykatave kushtetuese, të cilat kanë karakter të institucioneve të veçanta gjyqësore-

politike dhe gjinden jashtë sistemit të rregullt gjyqësor. Detyrë kryesore e funksionit kushtetues-gjyqësor është garantimi dhe ruajtja e superioritetit të Kushtetutës, kështu që gjyqësia kushtetuese ekziston, logjikisht, vetëm në regjimin e një kushtetutshmërie të fortë. Mbrojtja kushtetuese-gjyqësore e të drejtave të njeriut realizohet si mbrojtje e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, ndërsa kompetenca themelore e kësaj mbrojtjeje është kontrolli normativ, para së gjithash, vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjeve dhe zgjidhja e kontesteve të tjera abstrakte kushtetuese. Këtu bëhet fjalë për konfliktin e dy normave, nga të cilat njëra është patjetër normë kushtetuese, ndërsa tjetra është normë e ligjit apo normë e ndonjë dispozite tjetër.

20. Nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se norma e ndonjë ligji apo dispozite tjetër është në kundërshtim me normën kushtetuese, ajo e deklaron pavlefshmërinë e saj, ndërsa masë për përcaktimin e pavlefshmërisë janë pikërisht normat kushtetuese.²¹³ Është e qartë se kontrolli normativ ka rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave themelore, në të gjitha ato raste kur ndodh shkelja e tyre me veprimin e akteve të përgjithshme kundërkushtetuese, të ligjeve dhe të dispozitave të tjera jokushtetuese. Intervenimi kushtetues-gjyqësor, siç e kemi theksuar, ka karakter të mbrojtjes së tërthortë, por me kontrollin normativ realizohen, pos mbrojtjes së të drejtave themelore, edhe qëllime të tjera. Si pushtet i mëvetësishëm dhe i pavarur gjyqësor, që gjendet jashtë gjyqësisë së rregullt, Gjykata Kushtetuese, pjesërisht tërthorazi, pra me vlerësim abstrakt të kushtetutshmërisë, dhe pjesërisht edhe drejtpërsëdrejti, duke vendosur lidhur me ankesat kushtetuese, i mbron të drejtat dhe liritë e qytetarëve.
21. Në fund të komentit të Ligjit të përmendur për Gjykatat, duhet theksuar se ai do të zbatohet në faza të caktuara, së pari në fazën e planifikimit, nga 1 janari 2011 deri më 31 dhjetor 2011, pastaj edhe në fazën e zbatimit, nga 1 janari 2012 deri më 31 dhjetor 2012.
22. Çështja që mund të shtrohet në praktikë lidhur me dispozitën kushtetuese të nenit 54, që ka qenë objekt i këtij komenti, ka të bëjë me përmbajtjen, cilësinë dhe vëllimin e të drejtave të njeriut, në të cilat shtrihen garancitë kushtetuese lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në nenin e përmendur Kushtetuta e Republikës së Kosovës kufizohet vetëm në mbrojtjen e “të drejtave të garantuara me Kushtetutë”, pra “në rast të shkeljes apo të mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë”. Prandaj shtrohet pyetja se a kanë të bëjnë garancitë e mbrojtjes edhe me ato të drejta të cilat Kushtetuta nuk i garanton shprehimisht, por i garantojnë traktatet e vërtetuara ndërkombëtare apo janë të garantuara me ligje (të drejtat ligjore) dhe a bëhet kjo vetëm me prezumimin se Kushtetuta u referohet atyre apo pavarësisht nga kjo.

²¹³ Në praktikën e gjykatave kushtetuese, këto, më së shpeshti janë, normat e kushtetutës me të cilat garantohen të drejtat dhe liritë e njeriut.

Neni 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

- (1) Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.**
- (2) Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.**
- (3) Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.**
- (4) Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.**
- (5) Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrsesi esencën e së drejtës së garantuar.**

Neni 55

1. Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore mund të kufizohen me ligj, vetëm nëse kjo lejohet me Kushtetutë, por Kushtetuta, në numrin më të madh të rasteve, këtë kufizim ia lë ligjit. Këto të drejta dhe liri mund të kufizohen vetëm me qëllime të cilat i lejon vetë Kushtetuta dhe në masën që është e domosdoshme që qëllimi kushtetues i kufizimit të përmbushet në një shoqëri të hapur dhe demokratike. Ajo që është veçanërisht e rëndësishme të theksohet është fakti se kufizimet e tilla nuk bën të prekin esencën e së drejtës së garantuar, ndërsa me këtë rast, të gjitha organet shtetërore, veçanërisht gjykatat, janë të obliguara që të kenë kujdes për esencën e të drejtave apo lirive që kufizohen. Po ashtu, këto organe janë të obliguara që të kenë kujdes edhe për rëndësinë e qëllimit të kufizimit, natyrën dhe masën e kufizimit, raportin e kufizimit me qëllimin e kufizimit dhe veçanërisht, për atë se a ekziston mënyra që qëllimi i kufizimit të arrihet me kufizim më të vogël të të drejtave.
2. Siç kemi theksuar në pasusin paraprak (që në fillim të komentit të këtij neni), me ligj mund të parashikohet mënyra e kufizimit të të drejtave dhe të lirive të njeriut, vetëm nëse kjo me kushtetutë është parashikuar shprehimisht, apo nëse kjo është e domosdoshme për realizimin e të drejtës së caktuar, për shkak të natyrës së saj. Për të drejtat dhe liritë e caktuara kushtetuta mund t'i parashikojë të vetmet kushte të lejuara, në të cilat ato mund të kufizohen dhe, në atë rast, kemi të bëjmë me kufij specialë dhe të veçantë të të drejtave të njeriut.²¹⁴ Ndalimi kushtetues që të drejtat

²¹⁴ Kështu, për shembull, liria e lëvizjes dhe e vendosjes mund të kufizohet me ligj, vetëm nëse kjo është e domosdoshme me qëllim të zhvillimit të procedurës penale, pengimit dhe përhapjes së sëmundjeve ngjitëse, mbrojtjes së shtetit e të tjera.

dhe liritë e caktuara të shfrytëzohen për qëllime të caktuara, po ashtu, paraqet kufizimin e tyre të lejueshëm.²¹⁵

Neni 55.1

1. Për të qenë efektive, shumica e të drejtave themelore të garantuara me kushtetutën e një shteti, kërkon formësim të mëtejshëm juridik të fushave jetësore, me të cilat kanë të bëjnë. Kjo veçanërisht vlen për të drejtat themelore, të cilat janë formuluar në formën e parimeve programore apo të urdhëresave kushtetuese. Formimi juridik i të drejtave themelore do të thotë përcaktimi i përmbajtjes konkrete dhe i shtrirjes së të drejtave të caktuara themelore dhe më së shpeshti, nënkupton kufizimin e tyre. Në rend të parë, kjo është detyrë e ligjdhënësit, prandaj edhe neni 55. paragrafi 1. i Kushtetutës së Republikës Kosovës përcakton se të drejtat dhe liritë themelore, të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj. Natyrisht, kjo mund të bëhet vetëm me kusht që këto kufizime t'i lejojë vetë Kushtetuta. Gjatë kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore, të gjitha organet shtetërore, veçanërisht gjykatat, janë të obliguara që të kenë kujdes për esencën e së drejtës që kufizohet, rëndësinë e qëllimit të kufizimit, natyrën dhe masën e kufizimit, raportin e kufizimit me qëllimin e kufizimit si dhe për atë se a ekziston ndonjë mënyrë që ky qëllim të arrihet me një shkallë më të vogël të kufizimit të së drejtës.

Neni 52.5

1. Prandaj, duke u lidhur me paragrafin paraparak të nenit të përmendur 55, paragrafi 2 përcakton se të drejtat dhe liritë themelore, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, mund të kufizohen vetëm deri në ato masa që janë të pashmangshme, në mënyrë që të përmbushet qëllimi për të cilin është lejuar kufizimi i atyre të drejtave dhe lirive, përkatësisht, në mënyrë që të arrihet qëllimi i kufizimit. Parimet që e përkufizojnë përmbajtjen, bazën, suazat dhe vëllimin e kufizimit të të drejtave të njeriut i përcakton Kushtetuta, ndërsa rëndësia e këtyre parimeve ka të bëjë me atë që ato e vendosin kufirin, të cilin pushteti nuk guxon ta kalojë, kur gjendet në situatë për të vendosur kufizimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Ato, prandaj, paraqesin udhërrëfyes për veprimin e organeve të pushtetit në situata të tilla. Kështu, për shembull, disa parime dhe kritere themelore e karakterizojnë kufizimin e të drejtave dhe të lirive themelore të parashikuara me nenin 55:
 - 1) Të drejtat dhe liritë themelore duhet të jenë të garantuara me Kushtetutë (paragrafi 1);
 - 2) Kufizimi i të drejtave dhe lirive të përmendura mund të bëhet vetëm me ligj (paragrafi 1);
 - 3) Kufizimi është i mundshëm vetëm në rastin kur këtë e lejon Kushtetuta;

²¹⁵ Për shembull, Kushtetuta mund ta ndalojë veprimin e bashkimeve politike, sindikale e të tjerave, veprimtaria e të cilave është e orientuar në rrënimin e dhunshëm të rendit kushtetues, shkeljen e të drejtave të garantuara njerëzore apo të drejtave të pakicave, nxitjen e urrejtjes racore, nacionale apo fetare e të tjera.

- 4) Të drejtat dhe liritë mund të kufizohen vetëm deri në masën që është e pashmangshme për arritjen e qëllimit (paragrafi 2);
 - 5) Kufizimi është i mundshëm vetëm nëse është parashikuar për qëllimet për të cilat Kushtetuta e lejon kufizimin (paragrafi 3);
 - 6) Kufizimi duhet të reduktohet në minimumin, i cili e përmbush qëllimin për të cilin Kushtetuta e lejon mundësinë e kufizimit të së drejtës (paragrafi 2);
 - 7) Me Kushtetutë është parashikuar ndalimi i kontestimit të esencës së të drejtave të garantuara (paragrafi 5).
2. Prandaj, kur vendosin për kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, organet e pushtetit janë të lidhura me rregullat kushtetuese, të cilat i definojnë përmbajtjen dhe suazat e veprimit të tyre. Ato, para së gjithash, janë të obliguara që të kujdesen për:
- 1) Esencën e të drejtave të garantuara që kufizohen dhe ajo nuk guxon të jetë kontestuese (paragrafi 5);
 - 2) Rëndësinë e qëllimit për të cilin kufizohet liria apo e drejta (paragrafi 4);
 - 3) Masën e kufizimit dhe natyrën e saj (paragrafi 2);
 - 4) Raportin ndërmjet kufizimit dhe qëllimit për të cilin është parashikuar kufizimi (paragrafi 4);
 - 5) Mundësinë ekzistuese që qëllimi i kufizimit të së drejtës apo lirisë së njeriut të arrihet edhe me një shkallë më të ulët të kufizimit të së drejtës (paragrafi 4).

Neni 55.3

1. Duke e komentuar nenin 55, do ta theksojmë faktin se paragrafi 3 i këtij neni i lejon kufizimet e të drejtave dhe të lirive themelore, vetëm për ato qëllime për të cilat janë caktuar. Në asnjë rast nuk mund të zbatohen këto kufizime për qëllime të tjera. Këtë garanci e parashikon edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, duke i parashikuar kufijtë e shfrytëzimit të kufizimit të të drejtave (neni 18.). Kufizimet e të drejtave dhe të lirive të përmendura, të cilat lejohen me këtë Konventë, nuk mund të zbatohen për asnjë qëllim tjetër, përveç për ato qëllime për të cilat janë parashikuar.
2. Kur është fjala për intervenimin legjislativ në të drejtat themelore, atëherë duhet thënë se në teorinë juridike ky intervenim paraqitet si formësim i të drejtave themelore apo si kufizim i tyre. Problemi i formësimit është veçanërisht i shprehur te të drejtat sociale, ndërsa te të drejtat liberale, më së shpeshti, shtrohet pyetja e kufizimit të tyre. Është e pakontestueshme që të drejtat themelore nuk mund jenë të pakufizuara, prandaj rendi i jetës së përbashkët duhet ta kufizojë lirinë e individit, në mënyrë që të mos rrezikohet liria e të tjerëve.
3. Prandaj në bashkësinë shtetërore, çdo e drejtë themelore individuale paraqitet si madhësi e kufizuar, kështu që, parimisht, të drejtat themelore nuk mund të jenë absolute. Duke pasur parasysh se të drejtat themelore janë të garantuara me Kushtetutë, del se kufijtë e tyre duhet të kenë bazë në vetë Kushtetutën.

Neni 55.4

1. Është shumë interesante dispozita e paragrafit 4 të nenit 55, sipas së cilës të gjitha institucionet e pushtetit publik, veçanërisht gjykatat, në rast të kufizimit të të drejtave dhe të lirive të njeriut, janë të obliguara që t'i përkushtohen esencës së të drejtës e cila kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës së kufizimit dhe raportit të kufizimit me qëllimin që dëshirohet të arrihet. Po ashtu, dispozita e këtij neni parashikon se institucionet e përmendura të pushtetit publik janë të obliguara që edhe t'i shqyrtojnë mundësitë e realizimit të atij qëllimi me kufizime sa më të buta. Pra, Kushtetuta parashikon obligime të veçanta për veprimin e organeve shtetërore, kur vendosin për kufizimin e të drejtave dhe i apostrofon gjykatat si organe të pushtetit, të cilat drejtpërsëdrejti edhe në rastin konkret vendosin për kufizimin e të drejtave. Këto garanci kushtetuese janë veçanërisht të rëndësishme, sepse ato e mbrojnë hapësirën e lirisë individuale dhe i përcaktojnë kufirin dhe kriteret për veprimin e organeve të pushtetit në fushën e të drejtave të njeriut.

Neni 55.5

1. Dispozita e parashikuar me paragrafin 5 të nenit 55 të Kushtetutës përcakton që kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, në asnjë mënyrë nuk guxon ta kontestojë esencën (thelbin, përmbajtjen esenciale) të të drejtave të garantuara. Pra, rregulla e cila kërkon që e drejta themelore në asnjë rast nuk guxon të preket në përmbajtjen e saj esenciale, gjendet në vargun e kushtetutave të cilat e kanë marrë formulën e njohur të Kushtetutës së Gjermanisë. Ndërkaq, duhet theksuar fakti se është vështirë të përcaktohet se kur është shkelur *përmbajtja esenciale* e së drejtës themelore dhe me cilat prezumime ligji që e kufizon të drejtën themelore, nuk e prek esencën e saj absolute. Ajo që është e sigurt në këtë kuadër është fakti se garantimi i përmbajtjes esenciale duhet të përfshijë çështjen e proporcionalitetit të kufizimit të të drejtave themelore.²¹⁶
2. Format kushtetuese të kufizimit të së drejtës kushtetuese mund të jenë të ndryshme. Në shumë raste, Kushtetuta i vë kufijtë e të drejtave themelore, duke parashikuar mundësinë e kufizimit të tyre (me ligj apo në bazë të ligjit), sepse kufizimi i mëvetësishëm i të drejtave themelore nga ana e pushtetit ekzekutiv apo gjyqësor do të ishte i palejueshëm. Rezervat ligjore mund ta autorizojnë kufizimin e të drejtave themelore vetëm me ligj të kualifikuar, qoftë kur kufizimi bën të ndërmerret vetëm me supozime të caktuara, qoftë vetëm për një qëllim të caktuar (për shembull, në interes të sigurisë nacionale, të zhvillimit të procedurës penale, të mbrojtjes së shëndetit etj). Natyrisht, gjatë vendosjes së kufijve për të drejtat

²¹⁶ Këtu është me rëndësi të theksohet se në teorinë juridike dallohen disa lloje të kufizime të të drejtave dhe të lirive themelore, pra disa kufij, prandaj, kështu, më së shpeshti përmenden kufijtë realë apo personalë, si dhe kufijtë sistematikë immanentë. Kufijtë realë ekzistojnë nëse në kushtetutë dikush e ka themeluar të drejtën e kufizuar apo, megjithatë, është rezervuar për ligjin, ndërsa ata personalë kanë të bëjnë me raportet speciale, të veçanta të pushtetit. Kufijtë sistematikë dalin nga raportet reciproke të të drejtave të caktuara themelore, ndërsa kufijtë immanentë dalin nga të mirat e mbrojtura juridike.

themelore, duhet pasur kujdes që të vendoset një raport optimal ndërmjet të drejtave themelore dhe të mirave të tjera juridike. Kjo për arsye se kufizimi i të drejtës themelore duhet të jetë i përshtatshëm që t'i mbrojë të mirat e tjera juridike, por nuk bën të shkojë më tej se ajo që është domosdoshme. Ai duhet të jetë proporcional që t'i përgjigjet rëndësisë së të drejtës themelore, që do të thotë se edhe kufizimet e të drejtës themelore duhet t'i kenë kufijtë e tyre.

3. Prandaj, nga kjo që e thamë, mund të konkludohet se për caktimin përmbajtjesor dhe kufizimin e të drejtave themelore, janë të nevojshme rregullat e caktuara formale dhe materiale, me të cilat ligdhënësi është i lidhur. E para, kufizimet e të drejtave themelore duhet të jenë *të përgjithshme*, sepse, parimisht, miratimi i palejueshëm i ligjeve individuale, të cilat i kufizojnë të drejtat themelore për personat e caktuar me emër apo për një grup me numër paraprakisht të caktuar personash. Pra, parimi i gjeneralitetit përjashton mundësinë që kufizimet të ndërmerren vetëm për pikëpamje politike, religjioze, kulturore dhe të ngjashme. Po ashtu, është rregull që duhet *emërtuar* e drejta themelore që kufizohet, duke iu referuar dispozitës kushtetuese. Kjo rregull duhet ta obligojë ligdhënësin që, para miratimit të ligjit, të vlerësojë seriozisht se a është kufizimi i domosdoshëm dhe, nëse është, atëherë cila e drejtë themelore duhet kufizuar.

Neni 56 [Të Drejtat dhe Liritë Themelore gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme]

- (1) **Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore që mbrohen me Kushtetutë, mund të bëhet vetëm pas shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme sipas kësaj Kushtetute dhe vetëm deri në masën sa është e domosdoshme nën rrethanat e dhëna.**
- (2) **Shmangia nga të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 23, 24, 25, 27, 28, 29, 31, 33, 34, 37 dhe 38, të Kushtetutës nuk është e lejuar në kurrfarë rrethanash.**

Neni 56

1. Duke pasur parasysh se fusha të cilën e rregullon neni 56. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës është mjaft e ndjeshme, komentimin e këtij neni do ta fillojmë me dispozitat e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Pra, ky nen e rregullon shmangien nga këto të drejta në rrethanat e jashtëzakonshme, përkatësisht në kohë lufte apo rreziku tjetër publik që i kanoset mbijetesës së kombit. Vetëm në atë situatë pala e lartë kontraktuese mund të ndërmarrë masa që shmangen nga obligimet e saj sipas kësaj Konvente (dhe atë në masën më të domosdoshme, që e kërkon urgjenca e situatës), por me kusht që masat e tilla të jenë me pajtim me obligimet e saj të tjera sipas së drejtës ndërkombëtare.
2. Suspendimi apo heqja e përkohshme e të drejtave themelore në rrethana të jashtëzakonshme, pra në rrethana të shtrëngesës shtetërore, parashikohet në shumicën e

kushtetutave. Dispozitat për suspendim të këtyre të drejtave, më së shpeshti gjenden në pjesën për të drejtat themelore apo në pjesën e kushtetutës në të cilën lejohet mundësia e aplikimit të gjendjes së jashtëzakonshme në shtet.²¹⁷ Shumica e shteteve evropiane niset nga vlefshmëria e pazvogëluar e të drejtave themelore edhe në rast të nevojës shtetërore, pra në gjendje të jashtëzakonshme, në gjendje të rrezikut të drejtpërdrejt të luftës, të rrethimit apo të gjendjes së luftës duke lejuar vetëm ndalimin e tyre të pjesshëm. Me këtë rast, përmenden me emër të drejtat themelore, të cilat as në ato raste nuk mund të suspendohen apo numërohen në mënyrë taksative të drejtat themelore, realizimi i të cilave ndërpritet përkohësisht, (qoftë në tërë territorin, qoftë në një pjesë të tij).²¹⁸

3. Ndërkaq, përveç suspendimit të përgjithshëm, duhet theksuar se ekziston edhe i ashtuquajhuri suspendim individual i të drejtave themelore. Pra, disa kushtetuta, siç janë, për shembull, Kushtetuta e Gjermanisë, Kushtetuta e Spanjës etj., e lejojnë të ashtuquajturin suspendim individual, si sanksion për shfrytëzimin abuzues të të drejtave themelore për rrezikim serioz të rendit të lirë demokratik. Suspendimit të tillë individual, më së shpeshti i nënshtrohet liria e shtypit, liria e mësimit, liria e tubimit, liria e bashkimit, sekreti i letrave, e drejta e azilit etj. Natyrisht, ekziston mundësia e keqpërdorimit të këtij instituti, prandaj në këtë kuptim, në mënyrë që kjo të pengohet, (para së gjithash, për kundërshtarët politikë), Gjykata Kushtetuese vendos për humbjen dhe masën e humbjes së të drejtave themelore të individit.
4. Në lidhje të drejtpërdrejtë me problemin e kufizimit të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, është edhe vlefshmëria e tyre në rrethana të jashtëzakonshme, pra në gjendje të rrezikut shtetëror. Shumica e kushtetutave evropiane e përcakton shprehimisht vlefshmërinë e përgjithshme të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në rrethana të jashtëzakonshme, por, në këtë rast, numërohen një për një të drejtat themelore, realizimi i të cilave, në asnjë rast dhe në kurrfarë kushtesh, nuk guxon të suspendohet apo përmenden të drejtat të cilat mund të ndërpritën apo të kufizohen përkohësisht.

Neni 56.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban dispozita për shmangien nga të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë, të cilat, në bazë të vetë Kushtetutës, mund t'i kufizojë vetëm pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme

²¹⁷ Të shihet më për së afërmi për këtë çështje: Oren Gross Finnouala i Ni Aolain, (2006), 'Law in Times of Crisis: Emergency Powers in Theory and Practice', Cambridge University Press: Cambridge, veçanërisht kapitulli 1 ("Models of Accomodation") dhe 5 ("International Human Rights and Emergencies").

²¹⁸ Në raste të tilla, përveç disa të drejtave politike, siç është liria e shtypit, liria e tubimit, e bashkimit politik, e tubimit në vende publike, liria e mendimit dhe e informimit etj., suspendohen edhe disa të drejta personale, siç janë kufijtë e lirisë së personalitetit, kufijtë e lëvizjes dhe të vendosjes, të moscenimit të banesës, të fshehtësisë së letrave etj. Në raste të tilla mund të suspendohen edhe disa të drejta sociale-ekonomike, siç është e drejta e grevës, liria sindikale e të tjera, por edhe që disa liri të transformohen në obligime të qytetarit, ashtu siç mundet që liria e punës të transformohet në obligim të punës.

dhe vetëm për aq sa është e domosdoshme në rrethana të caktuara (neni 56. paragrafi 1).²¹⁹ Regjimi i shmangies nga këto të drejta dhe liri paraqet një nga çështjet më delikate në rrethanat që karakterizohen si gjendje e jashtëzakonshme.²²⁰ Në të vërtetë, gjatë kohës së një gjendjeje të tillë, ndodh çrregullimi i kompetencave në dobi të pushtetit ekzekutiv, pra të ekzekutivit, dhe shmangia nga regjimi i të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Kjo flet në favor të konstatimit se në rrethana të këtilla, nën goditje të veçantë gjenden dy parime jashtëzakonisht të rëndësishme, si:

- 1) parimi i pushtetit të kufizuar në formën e ndarjes së pushtetit;
 - 2) parimi i mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, garantuese e të cilave është vetë Kushtetuta.
2. Pikërisht për këtë arsye ekziston përpjekja e hartuesit të Kushtetutës që, duke i pasur parasysh standardet e konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në vetë Kushtetutën t'i vendosë kufijtë për rregullimin e shmangies nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Kështu, edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban parime të caktuara kushtetuese, të cilat i vendosin kufijtë e veprimit gjatë vendosjes për masat e shmangies nga të drejtat dhe liritë e përmendura:
- 1) në pajtim me parimet e përgjithshme kushtetuese që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut (neni 56. paragrafi 1), Kushtetuta shprehimisht e rregullon shmangien nga këto të drejta dhe liri, pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme;
 - 2) parimi i proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet me kufizimin e së drejtës, po ashtu, është zbatuar, prandaj Kushtetuta e lejon shmangien vetëm për aq sa është domosdoshme në rrethana të caktuara (neni 56. paragrafi 1). Kjo do të thotë se vlefshmëria e masave të shmangies nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut është e kufizuar në kohë, sepse këto masa pushojnë me heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme.
3. Konsiderojmë se këtu është dashur të përmendet shprehimisht edhe parimi i mosdiskriminimit, pra me Kushtetutë është dashur të parashikohet që masat e shmangies nga të drejtat dhe liritë themelore, nuk duhet të çojnë në dallime në bazë racës, gjinisë gjuhës, fesë, përkatësisë nacionale apo të prejardhjes shoqërore. Pra, mungon rregulla parimore e cila e ndalon “çdo formë të diskriminimit”, por që do të mundësonte që gjatë interpretimit të kësaj dispozite kushtetuese të përfshihen

²¹⁹ Në lëndën *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1978.), Komisioni në mënyrë eksplicite e ka shqyrtuar zbatimin e parimit të proporcionalitetit inherent në nenin 15. Ka konkluduar se qeveria nuk mund t'i referohet ekzistimit të situatës së jashtëzakonshme vetëm për të arsyetuar çfarëdo mase që ka vendosur ta zbatojë, por duhet ta përcaktojë lidhjen konkrete ndërmjet masës dhe situatës që duhet të kontrollohet.

²²⁰ Gjendja e jashtëzakonshme është një situatë e veçantë në të cilën mund të gjendet një viktimë dhe, në rrethana të tilla, mund të zbatohet kufizimi, përkatësisht suspendimi i të drejtave të caktuara të njeriut. Për këtë të shihet më gjerësisht: Dicey, A., (1992) “Opsadno stanje“, në: Bačić, A. (ed.), *Ustav i ustavna diktatura*, Knjizevni krug: Split; Fridrich, C.J. (1992), “Ustavna diktatura i vojna vlada“, në: Bačić, A. (ed.), *Ustav i ustavna diktatura*, Knjizevni krug: Split; Po ashtu, të shihet: Agamben, (2005), ‘*State of Exception*’, University Of Chicago Press; Chicago.

edhe format e tjera të diskriminimit.²²¹ Në të vërtetë, paragrafi vijues i këtij neni (paragrafi 2) flet për atë se nga cilat të drejta dhe liri themelore të garantuara me Kushtetutë, nuk lejohet shmangia me asnjë kusht, duke i përmendur në mënyrë taksative këto të drejta dhe liri absolute. (Për këtë do të flitet në komentin që vijon). Kështu, në këtë paragraf është përmendur neni 24. i Kushtetues (“barazia para ligjit”) i cili, në të vërtetë, paraqet ndalimin e diskriminimit mbi çfarëdo baze.

Neni 56.2

1. Me paragrafin 2 të nenit 56. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës janë numëruar në mënyrë taksative nenet që i garantojnë të drejtat dhe liritë themelore nga të cilat nuk lejohet shmangia me asnjë kusht, madje as gjatë kohës së zgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme. Ky është një varg i të drejtave themelore, të cilat janë të lidhura në mënyrën më të drejtpërdrejtë me personalitetin njerëzor dhe në ato të drejta bëjnë pjesë:
 - Dinjiteti i njeriut (neni 23.);
 - Barazia para ligjit, do të thotë ndalimi i diskriminimit (neni 24);
 - E drejta për jetesë, do të thotë ndalimi i dënimit me vdekje (neni 25);
 - Ndalimi i mundimit, sjelljes së vrazhdë jo njerëzore dhe nënçmuese (neni 27);
 - Ndalimi i robërisë dhe i punës së detyrueshme (neni 28);
 - E drejta e lirisë edhe e sigurisë, do të thotë ndalimi i privimit të lirisë, përveç në rastet e parashikuara me ligj në bazë të vendimit të gjykatës kompetente (neni 29);
 - E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (neni 31);
 - Parimi i legalitetit dhe i proporcionalitetit në procedurat penale (neni 33);
 - E drejta e personit që të mos gjykohet dy herë për të njëjtën vepër penale (neni 34);
 - E drejta e lidhjes së martesës dhe e themelimit të familjes (neni 37);
 - E drejta e religjionit, besimit dhe ndërgjegjes (neni 38).
2. Me këtë rast, të gjitha këto të drejta dhe liri, të cilat Kushtetuta, në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, i përmend taksativisht, janë përjashtuar nga regjimi i shmangies. Kjo do të thotë se këto janë *të drejtat e mbrojtura absolute*, sepse vetë Kushtetuta i ndalon shmangiet nga këto të drejta në çfarëdo rasti dhe në çfarëdo rrethanash.

²²¹ Peleš, A., (1973), “Pravo na peticiju u Međunarodnoj konvenciji o uklanjanju svih oblika rasne diskriminacije“, *Jugoslovenska Revija Medjunarodno Pravo*, nr. 1-3, fq.113-136.

Kapitulli III: Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre

Shqyrtime hyrëse

1. Në shtetet që i karakterizon përbërja multietnike e popullsisë, pjesëtarëve të pakicave kombëtare, pra të bashkësive pakicë, u garantohen shumë të drejta që të jenë të barabartë me popullsinë shumicë.²²² Kategoria e të drejtave të këtyre pjesëtarëve përfshin të drejtat e veçanta të garantuara me kushtetutë dhe me dokumente ndërkombëtare të pjesëtarëve të të gjitha bashkësive, me qëllim të ruajtjes së identitetit të tyre kombëtar.²²³ Në dokumentet ndërkombëtare dhe në të drejtën e brendshme kushtetuese të shteteve, këto të drejta, në masën më të madhe, janë të mbrojtura si të drejta individuale, pra si të drejta të individëve që u takojnë bashkësive kombëtare pakicë. Kjo për arsye se, si të drejta kolektive, janë shpërdoruar nga ana e Gjermanisë naziste (rasti i Sudetit dhe fati i Çekosllovakisë para Luftës së Dytë Botërore).
2. Kur është fjala për planin ndërkombëtar,²²⁴ këto të drejta janë garantuar me dokumentet më të rëndësishme ndërkombëtare, si: me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Pjesëtarëve të Pakicave Kombëtare apo Etnike, Fetare dhe Gjuhësore të vitit 1992,²²⁵ me Konventën Kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare të Këshillit të Evropës nga viti 1995, Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor,²²⁶ rekomandimet nga Londra për pjesëmarrje të pakicave kombëtare në procesin zgjedhor²²⁷ dhe në dokumentet e tjera ndërkombëtare-

²²² Dobrković, N., (1992), “Južni Tiroi - model za rešavanje položaja i statusa nacionalnih manjina?”, *Međunarodni problemi*, nr. 3-4, fq. 272-286.

²²³ Kështu, për shembull, me Dokumentin e Kopenhagës për pjesëtarët e pakicave kombëtare garantohet e drejta për “pjesëmarrje të plotë në punët shtetërore, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në punët që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe promovimin e identitetit të atyre pakicave” (paragrafi 35.).

²²⁴ Të shihet: Türk, D., (1976), “Osvrt na međunarodno-pravno regulisanje zaštite manjine u Ujedinjenim nacijama”, *Jugoslovesnka Revija za Međunarodno Pravo*, br. 1-2.

²²⁵ Kjo deklaratë e garanton “të drejtën për pjesëmarrje në vendosje në nivel kombëtar dhe atje ku është e mundshme, në nivel rajonal, që ka të bëjë me pakicat të cilave u takojnë apo rajonin në të cilin jetojnë” (neni 2. paragrafi 3.).

²²⁶ Me këtë Konventë, si dhe me dokumente të tjera të ngjashme, vendet anëtare obligohen që do të ndalojnë dhe eliminojnë çdo lloj të diskriminimit të pakicave kombëtare. Ndalimi i këtij diskriminimi veçanërisht ka të bëjë me realizimin e “të drejtave politike, veçanërisht të së drejtës për pjesëmarrje në zgjedhje, votim dhe përkrahje të zgjedhjeve... për pjesëmarrje në qeveri dhe në udhëheqjen e punëve publike në të gjitha nivelet, si dhe për qasje të barabartë në shërbimet shtetërore” (neni 5. pika b e Konventës).

²²⁷ Me këto rekomandime definohen standardet dhe masat që kontribuojnë për realizimin më efektiv të të drejtave të pjesëtarëve të pakicave kombëtare për pjesëmarrje në udhëheqjen e punëve shtetërore.

juridike, me të cilat përcaktohen standardet ndërkombëtare të të drejtave të veçanta të pjesëtarëve të pakicave kombëtare.²²⁸

3. Me dokumentet e përmendura ndërkombëtare janë përcaktuar të drejtat e përgjithshme politike, por edhe janë precizuar të drejtat e veçanta të pjesëtarëve të pakicave kombëtare. Në këto të drejta politike, të garantuara me dokumentet e përmendura bëjnë pjesë, për shembull, e drejta e votimit, e drejta e zgjedhjeve të rregullta dhe ferr, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike, liria e bashkimit, liria e grumbullimit, liria e votimit të fshehtë dhe të drejtat e tjera, ndërsa në të drejtat e veçanta të pakicave bën pjesë, për shembull, liria e themelimit të partive politike, të bazuara në identitetet e përbashkëta (rekomandimi nr. 8). Kjo e drejtë e veçantë e pakicave është përfshirë në të drejtën e përgjithshme të lirisë së bashkimit. Veçanërisht janë të rëndësishme dispozitat që kanë të bëjnë me sistemin zgjedhor dhe efektet e tij për përfaqësimin e pjesëtarëve të pakicave kombëtare në Parlament (rekomandimi nr. 9). Të gjitha këto standarde janë të përgjithshme, por zbatimi i tyre varet nga rrethanat në çdo vend të caktuar, prandaj, ato zbatohen në pajtim me rrethanat konkrete të secilit vend, i cili me dispozitat e veta, para së gjithash me aktet e përgjithshme, pra me kushtetutë apo ligje, e rregullon më për së afërmi përmbajtjen e tyre.
4. anë të shumë faktorët që ndikojnë në realizimin e të drejtave të pjesëtarëve të bashkësive pakicë për të marrë pjesë në udhëheqjen e punëve shtetërore. Këtu, para së gjithash, mendojmë për faktorët objektivë, në të cilët bëjnë pjesë: 1) numri i pjesëtarëve të çdo bashkësie pakicë; 2) numri i bashkësive pakicë, që jeton në shtetin e caktuar; 3) shtrirja apo përqendrimi i këtyre bashkësive në hapësirën e caktuar dhe faktorë të tjerë. Në mënyrë që bashkësitë pakicë të mund t'i realizojnë të drejtat dhe liritë themelore që u garantohen me Kushtetutë dhe me akte të tjera të përgjithshme juridike, është e domosdoshme që t'i kenë përfaqësuesit e vet, do të thotë të jenë të përfaqësuara në parlament. Po ashtu, mundësia e shfrytëzimit efektiv të të drejtave të pjesëtarëve të këtyre bashkësive, në masë të madhe, varet edhe nga kuadri institucional në të cilin realizohen këto të drejta, ndërsa atë kuadër e definojnë dispozitat që e rregullojnë sistemin zgjedhor.
5. Të drejtat që u garantohen pjesëtarëve të bashkësive pakicë dhe bashkësive kombëtare, në rend të parë realizohen në sferën kulturore, kështu që Kushtetuta pjesëtarëve të këtyre bashkësive dhe pakicave u garanton të drejta plotësuese, do të thotë ato të drejta që nuk i gëzojnë pjesëtarët e popullsisë shumicë. Këto të drejta paraqiten edhe si të drejta individuale (realizohen individualisht), edhe si të drejta kolektive (në bashkësi me të tjerët). Siç kemi theksuar, korniza juridike dhe baza e të drejtave të pjesëtarëve të bashkësive pakicë dhe të pakicave kombëtare paraqesin, para së gjithash, Kushtetuta, si dhe ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, që do të thotë jo vetëm e drejta e brendshme, por edhe e drejta ndërkombëtare. Të drejtat kolektive të pakicave nënkuptojnë që pjesëtarët e këtyre pakicave, drej-

²²⁸ Analiza e rëndësishme krahasuese e së drejtës ndërkombëtare dhe të drejtat e pakicave është dhënë në: Thornberry, P., (1992), *International Law and Rights of Minorities*, Oxford University Press: Oxford

tpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, marrin pjesë në procesin e vendosjes apo vendosin vetë për çështje të caktuara lidhur me kulturën e tyre, arsimin, informimin, përdorimin zyrtar të gjuhës së tyre, të shkrimit e të tjera. Ajo që është mjaft e rëndësishme dhe që gjatë viteve të fundit ndodh në mjaft shtete në tranzicion, të cilat janë me përbërje multietnike, pjesëtarëve të këtyre pakicave u ofrohet mundësia që t'i zgjedhin këshillat e veta kombëtare.

6. Veçanërisht duhet theksuar se nuk është aspak e lehtë që të identifkohet korniza institucionale dhe normative, e cila e mundëson përfaqësimin e pjesëtarëve të bashkësive pakicë dhe të pakicave kombëtare në parlament. Kjo, para së gjithash, ndodh për shkak se shumë faktorë, në bashkëveprim reciprok dhe në rrethana të ndryshme konkrete, ndikojnë në zgjidhjen e kësaj çështjeje, prandaj, në të njëjtin shtet, ndonjë rregull apo masë e caktuar mund të ketë edhe efekte diametralisht të kundërta në përfaqësimin e pjesëtarëve të pakicave në parlament. Pra, është mjaft me rëndësi se a është pranuar sistemi proporcional apo i shumicës në ndarjen e mandateve. Kështu, bashkësitë pakicë dhe pakicat kombëtare, të cilat janë të përqendruara në një rajon të caktuar të shtetit, me zbatimin e sistemit proporcional zgjedhor, do të jenë në pozitë më të mirë, nëse trupi zgjedhor është i ndarë në disa njësi zgjedhore. Ndërkaq, një zgjidhje e këtillë nuk u përgjigjet pjesëtarëve të këtyre pakicave, të cilët janë të shpërndarë në një rajon të gjerë, për arsye se gjatë ndarjes së trupit zgjedhor në disa njësi zgjedhore, këto pakica mund të mbesin pa përfaqësues në parlament. Këto pakica do të kishin shanse shumë më të mëdha për përfaqësim të tyre në organin përfaqësues, nëse në shtet do të ekzistonte vetëm një njësi zgjedhore (gjë që shpesh edhe ndodh në praktikë). Kjo është kështu, sepse, në atë rast, nuk do të ndodhte shpërndarja e trupit të tyre zgjedhor nëpër shumë njësi zgjedhore, prandaj, për këtë arsye, është mjaft me rëndësi të zgjidhen rregullat të cilat i definojnë suazat optimale për realizimin e të drejtave të pjesëtarëve të këtyre pakicave për përfaqësim të tyre, pra për përfaqësim në parlament, si organi më i lartë përfaqësues. Natyrisht, kjo nuk është aspak punë e lehtë, sepse është gati e pamundshme të parashikohet se si do të veprojnë ndonjë sistem zgjedhor, si dhe çfarë do të jenë efektet e tij në çdo rast konkret, për shkak të ndërlikueshmërisë së faktorëve, të cilët, në këtë rast, duhet të merren parasysh, sepse ndikojnë në pozitën e pjesëtarëve të këtyre pakicave. Ndodh shpeshherë që efektet, në raport me pozitën e pjesëtarëve të pakicave, në një shtet të njëjtë të jenë diametralisht të ndryshme dhe plotësisht të kundërta.
7. Për pjesëtarët e bashkësive pakicë dhe të pakicave kombëtare dhe për përfaqësimin e tyre në parlament, rëndësinë më të madhe e ka garantimi i organizimit të tyre politik, sepse në atë rast, janë më të mëdha mundësitë për përfaqësim të interesave të pakicave në organin përfaqësues. Nëse i hidhet një shikim periudhës së deritashme historike, praktika krahasuese kushtetuese nuk do të mund të lavdërohej për arritje të mëdha në këtë sferë. Ndërkaq, sot situata është dukshëm më ndryshe, kështu që përvojat krahasuese tregojnë rregullsi të caktuara, prandaj mund të identifkohen disa elemente me karakter të përgjithshëm, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kontribuojnë për realizimin e së drejtës aq të rëndësishme të pjesëtarëve të pakicave dhe të bashkësive të tyre në parlament.

Rëndësi të veçantë ka garantimi i së drejtës së bashkësive pakicë dhe pakicave kombëtare që të themelojnë parti, në ç'mënyrë do të lehtësohej dukshëm kandidimi për vende përfaqësuese në parlament që, natyrisht, nuk do të çojë në përfaqësim politik automatik të tyre në këtë organ edhe me marrjen e numrit të caktuar të mandateve. Kjo e drejtë për organizim politik të pjesëtarëve të këtyre pakicave është vetëm kusht i nevojshëm (i domosdoshëm), por jo edhe i mjaftueshëm për përfaqësim të tyre në organin përfaqësues, sepse realizimi i kësaj të drejte varet nga shumë faktorë.

8. Para së gjithash, siç kemi theksuar, një nga faktorët themelorë, nga të cilët varet realizimi i së drejtës së caktuar për përfaqësim të përfaqësuesve të bashkësive pakicë dhe të pakicave kombëtare në parlament, është sistemi zgjedhor, sepse ai ndikon në përfaqësimin e tyre. Kështu, nëse zbatohet **sistemi zgjedhor proporcional**, bashkësitë dhe pakicat e përmendura kanë më shumë gjasa për realizimin e kësaj të drejte, nëse përfaqësuesit e tyre janë të shtrirë në një rajon të gjerë dhe nuk janë të përqendruar në një hapësirë të caktuar. Për dallim nga kjo, për përfaqësuesit e këtyre pakicave është më i përshtatshëm sistemi zgjedhor i shumicës në rastin kur bashkësitë pakicë dhe pakicat kombëtare janë të përqendruara në një rajon, veçanërisht nëse në atë hapësirë e përbëjnë shumicën e popullsisë. Atëherë zbatimimi i **sistemit zgjedhor mazhoritar** ua mundëson që, si pakica, t'i kenë deputetët e vet në parlament.²²⁹
9. Sot në shumicën e vendeve evropiane është pranuar sistemi i përfaqësimit proporcional, pra sistemi zgjedhor proporcional, para së gjithash, sepse ai mundëson që në parlament të jenë të përfaqësuara më shumë parti politike dhe u konvenon partive të vogla politike, e në këtë mënyrë edhe përfaqësimit të bashkësive pakicë dhe pakicave kombëtare. Pra, duke pasur parasysh se e mundëson edhe përfaqësimin e pakicës, sistemi i përfaqësimit proporcional e nxit themelimin e një numri të madh të partive politike. Ajo që është me rëndësi të theksohet këtu është që ky sistem nuk i çon partitë politike në koalicion, sepse edhe pa lidhje partiake ua mundëson përfaqësimin në organin përfaqësues, e mundëson ekzistimin dhe forcimin e partive radikale, rigjide dhe ekstreme. Duke pasur parasysh se nuk kontribuon për formimin e koalicioneve stabile, ai nuk kontribuon as për stabilitetin e qeverive, gjë që në sistemin parlamentar të pushtetit sjell kriza të qeverisë, që mund të çojnë në shpërndarjen e parlamentit dhe në këtë mënyrë në krizë të tërë pushtetit të sistemit parlamentar. Ndryshe nga kjo, sistemi mazhoritar i çon palët që marrin pjesë në zgjedhje në koalicione.

²²⁹ Këtu është shumë me rëndësi, si shembull, të përmenden të ashtuquajturat Rekomandimet nga Lunda, të cilat pikërisht e theksojnë ndikimin e sistemit zgjedhor në përfaqësimin e pjesëtarëve të bashkësive pakicë në organin përfaqësues. Pra, sipas rekomandimit nr.9, “atje ku pakicat kombëtare janë të përqendruara territorialisht, nga një anëtar nga qarku mund të sigurojë përfaqësim të mjaftueshëm të pakicave”, ndërsa “sistemi i përfaqësimit proporcional, ku një pjesë e partisë politike në votën nacionale shprehet nëpërmjet përqindjes së deputetit, mund të ndihmojnë të përfaqësimi i pakicave kombëtare”. Krahaso: The OSCE High Commissioner on National Minorities (HCNM), *The Lund Recommendations on the Effective Participation of National Minorities in Public Life* (1 September 1999).

10. Ndërkaq, në teorinë politike dhe në të drejtën krahasuese kushtetuese, ende nuk ka përfunduar debati për përparësitë dhe të metat e sistemit mazhoritar dhe sistemit të përfaqësimit proporcional, gjë që natyrisht, nuk është e mundur pa shikim të rrethanave konkrete shoqërore të shtetit përkatës. Prandaj, edhe nuk mund të thuhet *a priori* se njëri nga këto dy sisteme të ndarjes së mandateve është më demokratik në krahasim me tjetrin, e veçanërisht jo që njëri nga ata është jodemokratik. Ne në rastin konkret na intereson se cili nga këto dy sisteme është më i përshtatshëm dhe më i mirë për përfaqësimin politik të bashkësive pakicë dhe të pakicave kombëtare në parlament, si organ përfaqësues. Për zgjedhësin mesatar më i afërt është sistemi mazhoritar, sesa sistemi i përfaqësimit proporcional, sepse zgjedhësit e kanë më lehtë ta kuptojnë; ai e siguron lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet kandidatit dhe zgjedhësit; zgjedhësit e njohin mirë kandidatin për deputet, gjë që ofron mundësi që vendet e deputetit t'i fitojnë kandidatët më të mirë, më të aftë, më të njohur, (si parim i ndarjes së mandateve, vendimtare është cilësia e kandidatëve për deputetë, e jo programi apo personaliteti i liderit të partisë politike), shpreh liri më të madhe të zgjedhësit gjatë zgjedhjeve dhe pavarësi të deputetit gjatë punës në parlament. Por, përkundër të gjitha këtyre përparësive dhe veçorive pozitive të sistemit shumicë, teoria dhe praktika politike kanë gjetur edhe shumë të meta të këtij sistemi, ndër të cilat më të rëndësishmet janë: mundësia që një parti të fitojë një numër më të madh të deputetëve, sesa që, në përpjesëtim me fuqinë e saj, do t'i takonin dhe që është edhe më e papërshtatshme, ky sistem i ndarjes së mandateve e pamundëson përfaqësimin e kategorive të tëra të zgjedhësve, prandaj, për këtë arsye, është jodemokratik? dhe jo i drejtë. Kjo veçanërisht ka të bëjë me përfaqësimin e bashkësive pakicë dhe të pakicave kombëtare.
11. Pos kësaj, për sistemin shumicë është karakteristikë se nga jeta politike i eliminon partitë e vogla dhe të mesme, ndërsa u përshtatet parive të mëdha politike. Ai nuk e respekton në masë të mjaftueshme pluralizmin politik dhe partiak në shoqëri, i nxit partitë për koalicion zgjedhor dhe çon kah sistemi dypartiak. Pikërisht në thumb të kritikës së këtij sistemi mazhoritar është gjendur edhe sistemi i përfaqësimit proporcional, pra sistemi proporcional, i cili i përmirëson padrejtësitë dhe të metat e këtij të parit (sistemit mazhoritar), me zbatimin e të cilit një parti mund të fitojë një numër më të madh të deputetëve, sesa që kjo, në proporcion me fuqinë e saj numerike, do t'i takonin. Sistemi i përfaqësimit proporcional zbatohet në njësitë më të mëdha zgjedhore, në të cilat zgjidhet një numër më i madh i deputetëve, prandaj, në vend të votimit për një kandidat, në këtë sistem votohet për listat partiake (sistemi i listave). Mandatet e deputetëve pastaj ndahen në mes të listave të kandidatëve, proporcionalisht me votat e fituara. Këtë dallim në mes të sistemit mazhoritar dhe të sistemit proporcional e theksojnë para së gjithash që të shihen përparësitë dhe mangësitë e njërit apo të sistemit tjetër.
12. Për komentimin e Kapitullit III, që i është kushtuar të drejtave të bashkësive dhe përfaqësuesve të tyre, përkatësisht për mundësimin e pjesëtarëve të bashkësive pakicë dhe të pakicave kombëtare për t'u përfaqësuar në parlament, si organ përfaqësues, me rëndësi vendimtare është sistemi i ndarjes së mandateve. Pra, pikërisht sistemi proporcional, do të thotë sistemi i përfaqësimit proporcional, e

mundëson përfaqësimin e pakicës, sepse ai i pengon partitë e mëdha që t'i asfiksojnë të voglat. Ky sistem, vetvetiu, paraqet një lloj të sistemit demokratik, në atë vështrim që e mundëson pjesëmarrjen e të gjitha pjesëve të trupit zgjedhor në qeverisjen e shtetit. Sistemi i përfaqësimit proporcional jep rezultate të tilla në ndarjen e mandateve, në të cilat shprehet, si vullneti i shumicës, ashtu edhe vullneti i pakicës, (gjë që nuk është rasti te sistemi mazhoritar). Natyrisht, ky sistem nuk duhet të idealizohet, sepse me gjithë përparësitë e shumta, që kanë bërë që ai sot, në numrin më të madh të vendeve, të jetë në zbatim, ka edhe të meta të shumta për të cilat kanë tërhequr vërejtjen teoricienët dhe konstitucionalistët më të njohur.²³⁰ Ndërkaq, për përfaqësuesit e bashkësive pakicë dhe pakicat kombëtare më i përshtatshëm (më i pranueshëm) është sistemi i përfaqësimit proporcional, prandaj, për këtë arsye, ai është pranuar në shumicën e vendeve evropiane. Pra, sistemi proporcional mundëson që në parlament të përfaqësohen më shumë parti politike dhe si i tillë, u përshtatet partive më të vogla politike, prandaj për këtë arsye, parimisht, është më i përshtatshëm edhe për përfaqësimin e bashkësive pakicë dhe të pakicave kombëtare. Natyrisht, gjatë analizës së efekteve të tij reale, duhet të merren parasysh shumë faktorë, që mund të jenë vendimtarë, faktorë nxitës apo limitues për arritjen e përfaqësimit të pakicave në parlament. Për këtë arsye, është e domosdoshme që ta hedhim një vështrim të shkurtër mbi këta faktorë më të rëndësishëm.

13. Së pari, do ta përmendim *faktorin që ka të bëjë me zgjedhjen e formulës për llogaritjen e raportit ndërmjet votave të fituara dhe mandateve që i kanë takuar listës së kandidatëve*. Këtë e theksojmë që në fillim, sepse formula zgjedhore drejtpërsëdrejti ndikon në proporcionalitetin e rezultatit të zgjedhjeve, kështu, për shembull, gjatë ndarjes së mandateve, *formula e mesatares më të madhe* u jep përparësi të caktuar partive më të mëdha politike, *formula e mbetjes më të madhe të votave* u jep përparësi partive më të vogla politike, ndërsa disa formula zgjedhore e zvogëlojnë proporcionalitetin.
14. Së dyti, një faktor mjaft i rëndësishëm, i cili sot gjithnjë e më tepër zbatohet në shumicën e sistemeve kushtetuese bashkëkohore, (me qëllim që t'u mundësohet pakicave të jenë të përfaqësuara në parlament), është *përqindja minimale e votave*

²³⁰ Kështu, për shembull, shumica e gjykojnë shumë rreptë këtë sistem, duke theksuar se ai nuk është as në frymën e demokracisë përfaqësuese, as të regjimit parlamentar, se dobia e tij ende nuk është vërtetuar në masë të mjaftueshme në praktikë, se ky sistem i favorizon partitë, e jo individin (gjë që mundëson që në mbështetje të listës partiake, të zgjidhet kandidati që nuk është mjaft i njohur, pa autoritet dhe pa prestigj, prandaj ky sistem i përfaqëson partitë politike e jo qytetarët, prandaj zgjedhësve “u imponohet ai që ata nuk e duan” etj. Pse për këtë sistem thuhet se ai është shprehje, por edhe shkak i burokratizimit të partive politike dhe i krijimit të oligarkisë partiake, se ky është “sistem i ndërtuar për partitë, në të cilat mbështetet, e i cili, në vend të sovranitetit të së drejtës së përgjithshme të votës, e ngrë sovranitetin e partisë...”. Në sistemin e përfaqësimit profesional, kandidati para zgjedhjes nuk ka nevojë që drejtpërsëdrejti t'u paraqitet zgjedhësve, sepse për të këtë e bën partia. Në të vërtetë, këtu zgjedhësit e zgjedhin drejtpërsëdrejti partinë politike, ndërsa kjo pastaj i zgjedh deputetët (për këtë arsye, për këtë sistem thuhet se është një formë e zgjedhjeve të tërthorta), prandaj, është e arsyeshme vërejtja se sistemi i përfaqësimit proporcional e pamundëson zgjedhjen e kandidatëve të pavarur.

(pragu zgjedhor, pengesa zgjedhore, censusi zgjedhor etj), që duhet ta fitojë lista e kandidatëve, për ta fituar të drejtën për pjesëmarrje në ndarjen e mandateve. Të gjitha partitë që kanë marrë pjesë në zgjedhje e që nuk e kanë arritur përqindjen e nevojshme të votave, do të përjashtohen nga ndarja e mandateve të deputetëve, kështu që do të mbesin parti jashtëparlamentare. Ky prag zgjedhor (census zgjedhor), mund të jetë i natyrshëm apo artificial, (kur ligji e përcakton numrin më të vogël të nevojshëm të votave, të shprehur në përqindje, për fitimin e së drejtës së mandatit të deputetit), ndërsa efekti i tij për përfaqësim të bashkësive pakicë dhe të pakicave kombëtare në parlament është i shumëfishtë. Ndërkaq, për nevojat e këtij punimi, e theksojmë ndikimin e dyfishtë të censusit zgjedhor i cili parashikohet për pakicat: së pari, ai varet nga ajo se cili census, domethënë, cili prag zgjedhor ekziston në sistemin zgjedhor, (i natyrshëm apo ligjor) dhe e dyta, a llogaritet ai census në nivel të tërë shtetit apo vetëm në nivel të njësisë zgjedhore.

15. Parashtrohet pyetja se cili census zgjedhor, si zgjidhje për sigurimin e përfaqësimit të pakicave në parlament, është më i volitshëm. Përgjigjja e kësaj pyetjeje është e thjeshtë, sepse është e qartë se pragu i natyrshëm zgjedhor (censusi) paraqet zgjidhje më të përshtatshme se sa ai ligjor, duke pasur parasysh se nuk vë kushte plotësuese për hyrje në parlament. Parimisht, ky prag zgjedhor i natyrshëm (censusi) më shumë u përgjigjet partive më të vogla politike, prandaj për këtë arsye edhe partive të pakicave kombëtare, të cilat gjenden në këtë rreth të partive politike.²³¹ Përkundër kësaj, censusi ligjor zgjedhor e vështirëson mundësinë e përfaqësimit të tyre në organin përfaqësues, sepse e rrit përqindjen minimale të votave, që është e nevojshme për hyrje në parlament. Kështu, lista e kandidatëve, e cila me zbatimin e së drejtës së natyrshme zgjedhore do të fitonte mandate të caktuara në parlament, me zbatimin e censusit zgjedhor ligjor, do të mund të përjashtohet nga kjo ndarje, për arsye se nuk e ka marrë përqindjen minimale të votave të parashikuar me ligj, që është e nevojshme për pjesëmarrje në ndarje të mandateve. Me parashikimin e pragut zgjedhor ligjor, veçanërisht janë të goditura partitë më të vogla politike, ndërsa pikërisht ndër to janë edhe partitë e pakicave kombëtare.
16. Tash duhet t'i kthehemi faktit që e përmendëm në pasusin e parafundit, që mund të jetë me rëndësi të madhe për përfaqësim të pakicave në parlament, ndërsa ka të bëjë me rrethanat se a është përcaktuar censusi zgjedhor në nivel të tërë shtetit, (kur tërë shteti është një njësi zgjedhore), apo vetëm në nivel të njësisë zgjedhore, (kur trupi zgjedhor është ndarë në disa njësi zgjedhore). Shtrohet pyetja se cili variant është më i volitshëm për bashkësitë pakicë dhe pakicat kombëtare? Përgjigjja e kësaj pyetjeje qëndron në atë se gjasat që përfaqësuesit e tyre të marrin vende të caktuara në parlament janë më të mëdha, nëse trupi zgjedhor është i ndarë në më shumë njësi zgjedhore, ndërsa censusi zgjedhor formohet në nivel të vet atyre njësisë. Natyrisht, duhet theksuar edhe fakti që efekti i zgjidhjes së këtyre

²³¹ Këtu duhet theksuar se listat e pakicave dhe listat e partive politike të pakicave do të jenë në pozitë më të pavoritshme në krahasim me listat e shumicës dhe listat e partive më të mëdha politike, sepse kriteri për fitimin e së drejtës së mandatit të deputetit është i njëjtë për të gjitha listat e kandidatëve.

nuk është i qartë dhe që zgjidhja e këtillë nuk u përgjigjet njësoj të gjitha partive të pakicave, gjë që veçanërisht ka të bëjë me pakicat, përfaqësuesit e të cilave jetojnë në grupe më të vogla, “të shpërndarë” në tërë territorin e shtetit. Pra, për këtë arsye mund të ndodhë që bashkësitë pakicë dhe pakicat kombëtare në asnjë njësi zgjedhore të mos e realizojnë numrin minimal të votave të nevojshme për fitimin e mandateve të deputetëve, ndërsa po të ishte situata e kundërt, do të thotë po të ekzistonte vetëm një njësi zgjedhore, ata të drejtën e tyre të përfaqësimit në parlament do ta realizonin dhe do të fitonin numër përkatës të vendeve të deputetëve.

17. Ndërkaq, duhet thënë se, edhe pse censusi zgjedhor ka efekte të ndryshme, pragu i caktuar natyrshëm, në nivel të njësisë zgjedhore, jep gjasa më të mëdha për fitimin e numrit të caktuar të mandateve të deputetëve në parlament dhe në këtë mënyrë, përfaqësim të pakicave në organin përfaqësues. Pikërisht për këtë arsye, në të drejtën krahasuese kushtetuese hasim shumë masa me karakter afirmativ, që mund të çojnë në zgjidhje më të volitshme (optimale) për përfaqësuesit e bashkësive pakicë dhe të pakicave kombëtare. Kështu, për shembull, në disa shtete, censusi ligjor zgjedhor parashikohet në nivel prej 5%, ndërsa për pakicat kjo përqindje zbritet, për shembull, në 2% apo 3% të votave të fituara. Në disa sisteme zgjedhore ky prag nuk zbatohet fare për listat e pakicave (Gjermania, Polonia dhe shtetet e tjera) ndërsa në disa sisteme rezervohet vendi plotësues për përfaqësuesit e pakicave, listat e kandidatëve të të cilave nuk e kanë kaluar praguin zgjedhor (Rumania). Duke pasur parasysh se edhe Republika e Kosovës është shoqëri multietnike, e cila përbëhet nga shqiptarët dhe bashkësitë e tjera (neni 3. paragrafi 1. i Kushtetutës), me dispozitat kushtetuese është caktuar struktura e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kështu që, nga gjithsej 120 deputetë, në kuadër të kësaj ndarjeje, 20 vende janë garantuar për përfaqësuesit e bashkësive, që nuk janë shumicë në Kosovës (neni 64. paragrafi 1 dhe 2 i Kushtetutës), ku bëjnë pjesë: serbët, romët, ashkalinjtë, egjiptianët, boshnjakët, turqit dhe goranët. Në kuadër të këtyre 20 vendeve të garantuara, me pikat 1 dhe 2 të paragrafit 2 të nenin 64 të Kushtetutës, atyre u është caktuar në mënyrë të saktë ndarja e mandateve, kështu që nëse në zgjedhjet e përgjithshme nuk fitojnë numër të nevojshëm të votave, atyre u garantohet numri i caktuar i vendeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës.
18. Si faktor i tretë, i cili mund të ketë efekte shumë të rëndësishme për arritjen e përfaqësimit të bashkësive pakicë dhe të pakicave kombëtare në parlament, vihen në dukje ***njësitë zgjedhore***, para së gjithash, madhësia e tyre, numri dhe veçanërisht vendosja e kufijve të këtyre njësive zgjedhore. Pra, formimi i njësive zgjedhore ka veprim të dyfishtë për mundësinë e fitimit të mandateve të deputetëve dhe të përfaqësimit të tyre në parlament. E para, kjo pasqyrohet në efektet e sistemit të përfaqësimit proporcional dhe e dyta, në vendosjen e kufijve të njësive zgjedhore, por në atë mënyrë që ata kufij të jenë në funksion të lehtësimit të përfaqësimit të barabartë të pakicave.²³² Këtu mund të ndodhë edhe e ashtuquajtura pabarazi e fshehtë (faktike) e së drejtës së zgjedhjes, pra, kur njësitë zgjedhore me

²³² Rekomandimet nga Lundi, nr.10.

numër të ndryshëm të zgjedhësve zgjedhin numër të barabartë të përfaqësuesve apo kur njësitë zgjedhore me numër të njëjtë të zgjedhësve zgjedhin numër të ndryshëm të përfaqësuesve. Këtu ekziston pabarazi evidente e përfaqësimit. Forma më subtile e pabarazisë është përshtatja e njësive zgjedhore, që ka për qëllim favorizimin e tendencave të caktuara politike, nacionale apo racore (gjeometria zgjedhore në SHBA, e quajtur “gjerimandering”). Kështu, me favorizimin e tendencave të caktuara dhe me zbatimin e gjeometrisë zgjedhore, mund të realizohet qëllimi i shumicës përfaqësuese që nga parlamenti të përjashtohen plotësisht përfaqësuesit e partive të caktuara politike, të pakicave kombëtare, të racës, religjionit, profesionit etj.

19. Prandaj, nga analiza e deritashme e sistemit mazhoritar dhe sistemit proporcional mund të konkludohet që edhe njëri, edhe sistemi tjetër, i kanë përparësitë e veta e, po ashtu, edhe mangësitë, si: në pikëpamje të përfaqësimit të pakicave, të partive politike, të rajoneve etj. Për nevoja të komentimit tonë, më i rëndësishmi është shqyrtimi i ndikimit të zbatimit të këtyre sistemeve në përfaqësimin e pakicave, pra të bashkësive pakicë dhe të pjesëtarëve të pakicave kombëtare, duke pasur parasysh se sot në Evropë, madje edhe në tërë botën, është shumë i vogël numri i shteteve njënacionale, por në numrin më të madh të vendeve hasim shtete multietnike, kështu që është mjaft e rëndësishme që me sistemet kushtetuese të atyre vendeve t’u mundësohet përfaqësim adekuat dhe sa më i mirë i këtyre pakicave në parlamentet kombëtare. Kjo për arsye se pikërisht përfaqësuesit e tyre më së miri mund t’i përfaqësojnë bashkëkombësit e vet në forumet përfaqësuese të vendeve në të cilat jetojnë, që t’i shprehin problemet e tyre aktuale dhe që për zgjidhjen e tyre ta japin një kontribut më të madh, sepse edhe ata vetë drejtpërsëdrejti janë të interesuar për sukses në parlament. Nga krahasimi i sistemit të përfaqësimit proporcional me sistemin mazhoritar, mund të nxirret konkluzioni më i shkurtër që sistemi i përfaqësimit proporcional i përgjigjet më shumë idealit të drejtësisë, ndërsa sistemi mazhoritar ofron më shumë komoditet për formimin e shumicës parlamentare.
20. Siç theksuam më sipër, përparësia më e madhe e sistemit të përfaqësimit proporcional është se ky sistem e vlerëson njësoj çdo votë të zgjedhësve dhe në mënyrë të besueshme e shpreh vullnetin trupit zgjedhor. Duke pasur parasysh se u ofron mundësi të barabarta të gjitha partive që t’i kenë përfaqësuesit në parlament, ai e mundëson përfaqësimin e pakicës, sepse pengon që partitë e mëdha t’i asfiksojnë të voglat, ndërsa përfaqësuesi i zgjedhur sipas këtij sistemi e ka më shumë parasysh interesin e përgjithshëm të shtetit dhe të popullit. Prandaj, në ndarjen e mandateve, ky sistem jep rezultat të tillë që shprehet si vullneti i shumicës, ashtu edhe vullneti i pakicës, gjë që ndërkaq nuk është rasti me sistemin mazhoritar, i cili zbatohet në dy variante, si sistem i shumicës relative dhe si sistem i shumicës absolute. Ndërkaq, në të dy këto variante të sistemit mazhoritar shprehet vetëm vullneti i shumicës, ndërsa përfaqësuesi i zgjedhur sipas këtij sistemi (në njësi të vogël zgjedhore), është i lidhur me njësinë zgjedhore, kështu që më shumë u jep përparësi interesave të ngushta, sesa interesave të përgjithshme.

21. Por, edhe pse nga kjo që u tha mund të konkludohet se sistemi i përfaqësimit proporcional është më demokratik në krahasim me sistemin mazhoritar, shumë teoricienë politik liberalë i theksojnë dobësitë e tij të shumta, para së gjithash, komplikimin teknik, pakuptueshmërinë për zgjedhësit, si dhe faktin se, gjatë historisë, zbatimi i këtij sistemi ka qenë një nga shkaqet themelore të krizës së parlamentarizmit.²³³ Për këtë arsye, në kohë të re, po bëhet kompromis ndërmjet këtyre dy sistemeve të ndarjes së mandateve dhe kështu po krijohet sistemi i përzier, si kombinim i sistemit mazhoritar dhe i sistemit proporcional. Ky sistem i përzier quhet votim i dyfishtë dhe me decenie zbatohet në Republikën Federale të Gjermanisë. Pra, Gjermania, nga pikëpamja e zgjedhjeve për Dhomën e Ulët të Parlamentit ndahet në njësi të vogla zgjedhore, (në këto njësi përfaqësuesit zgjidhen me shumicë relative) dhe në njësi të mëdha zgjedhore (në to përfaqësuesit zgjidhen me sistemin e përfaqësimit proporcional, në bazë të koeficientit zgjedhor). Kur përfundon votimi, gjysma e përfaqësuesve në Dhomën e Ulët zgjidhet në pajtim me rezultatet e zgjedhjeve në njësitë e vogla zgjedhore (ndarja bëhet me zbatimin e sistemit mazhoritar relativ), ndërsa gjysma tjetër e mandateve përfaqësuese ndahet ndërmjet partive politike (ndarja bëhet me zbatimin e sistemit të përfaqësimit proporcional duke zbatuar metodën e koeficientit zgjedhor). Natyrisht, është mjaft me rëndësi të theksohet se edhe këtu parashikohet një census i caktuar, pra kufiri i poshtëm i numrit të votave të cilin partia duhet ta fitojë, në mënyrë që kandidatët e saj të mund të bëhen përfaqësues. Pra, që një parti politike, e cila merr pjesë në zgjedhje në RF të Gjermanisë, të fitojë të drejtën për të marrë pjesë në ndarjen e mandateve, ajo duhet që, nga numri i përgjithshëm i votave të dhëna në zgjedhje në tërë vendin, të fitojë së paku 5% sipas sistemit proporcional të përfaqësimit, përkatësisht duhet të realizojë së paku tri mandate sipas sistemit mazhoritar relativ në njësitë e vogla zgjedhore.²³⁴
22. Pikërisht për shkak të inkonsequencave të përmendura, përkatësisht të mangësive të njërës dhe të sistemit tjetër (edhe përkundër përparësive të tyre të shumta), në proporcionalitetin e mundshëm ndërmjet numrit të votave të fituara dhe numrit të mandateve që u ka takuar listave të kandidatëve, një rol thelbësor dhe ndikim vendimtar ka formimi i njësive zgjedhore. Pra, pikërisht vendosja e kufijve të njësive zgjedhore paraqet faktorin esencial, i cili ndikon në mundësinë e përfaqësimit të njësive pakicë dhe të pakicave kombëtare në parlament. Ndërkaq, duhet theksuar se nuk është aspak e thjeshtë që të përcaktohet veprimi i këtij faktori, duke pasur parasysh se në masë të konsiderueshme kjo varet nga rrethanat se a janë të “shpërndarë” pjesëtarët e këtyre bashkësive, të këtyre pakicave, në një rajon të gjerë apo janë të përqendruar në një hapësirë të caktuar. Nëse kemi të

²³³ Zbatimi i këtij sistemi ka qenë, madje, edhe shkak i drejtpërdrejtë i thyerjes së demokracisë politike në Gjermaninë e Vajmarit. Pra, pikërisht Hitleri, me zbatimin e sistemit të përfaqësimit proporcional ka ardhur në pushtet. Për këtë të shihet më gjerësisht: Zeh, W., (1987), ‘Parlamentarismus: historische Wurzeln, moderne Entfaltung’, R. v. Decker & C.F. Müller: Heidelberg.

²³⁴ Për shkak të përparësive në krahasim me zbatimin ekskluziv të sistemit të përfaqësimit proporcional apo të sistemit mazhoritar, sistemi i përzier zgjedhor është zbatuar edhe në zgjedhjet për Dumën Shtetërore, në zgjedhjet shumëpartiake në Federatën Ruse, më 1993.

bëjmë me situatën e dytë, pra nëse ekziston përqendrimi i pjesëtarëve të këtyre bashkësive pakicë në një hapësirë të caktuar, atëherë për ta është më e volitshme ndarja në njësi zgjedhore, kufijtë e së cilës caktohen në atë mënyrë që të mos e shpërndajnë trupin zgjedhor nëpër disa njësi. Por, kjo ndarje nuk u konvenon bashkësive të përmendura dhe pakicave, nëse pjesëtarët e tyre janë të “shpërndarë”, do të thotë nëse ekziston një dispersion i tyre në një rajon më të gjerë (atyre më nuk u konvenon formimi i njësive të mëdha zgjedhore, territori i të cilave përfshin një hapësirë më të gjerë). Në këtë rast, trupi i tyre zgjedhor mbetet jo unik, pra i pandashëm në mes të disa njësive zgjedhore, prandaj në këtë mënyrë, rriten gjasat e tyre për mandate deputeti.

23. Në bazë të kësaj që u tha më sipër, mund të konkludohet se caktimi i kujdesshëm i kufijve të njësive zgjedhore, që nuk çon në shpërndarje të trupit zgjedhor, ofron mundësi më të mëdha për përfaqësim të bashkësive pakicë dhe të pakicave kombëtare në parlament. Natyrisht, këtu nuk duhet harruar as mundësia e parashikimit të masave të caktuara të karakterit afirmativ, (gjë që është e njohur në të drejtën krahasuese kushtetuese), kur, për shembull, formohen njësitë e veçanta zgjedhore për bashkësitë pakicë dhe pakicat kombëtare. Në atë rast, për përfaqësuesit e këtyre bashkësive dhe të pakicave rezervohet një numër i caktuar i vendeve të deputetëve në parlament (Rusia, Rumania, Sllovenia, Kroacia, Kosova e të tjera). Zgjedhësve u ofrohet mundësia që ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre zgjedhore dhe ata mund të votojnë si për të gjithë kandidatët, ashtu edhe për listat e pakicës.
24. Kur është fjala për bashkësitë dhe për përcaktimin e tyre më të përafërt, duhet theksuar se në tre kapitujt e parë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (kapitulli I, II dhe III), mund të gjenden dispozita të shumta, që u janë kushtuar bashkësive. Pra, nëse kapitulli i parë i Kushtetutës u është kushtuar dispozitave themelore, disa nga ato dispozita janë mjaft të rëndësishme edhe për banorët të cilët i takojnë të njëjtit grup nacional apo etnik, gjuhësor apo fetar, që tradicionalisht është i pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (bashkësive). Kështu, për shembull, Kushtetuta thekson se Republika e Kosovës është shoqëri multietnike (neni 3. paragrafi 1.) dhe që paraqet një shtet sekular (neni 8.), se gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë gjuhë zyrtare në Kosovë (neni 5. paragrafi 1.), ndërsa gjuha boshnjake, rome dhe turke, janë gjuhë zyrtare në nivel komunal (neni 5. paragrafi 2.). Kapitulli II u është kushtuar të drejtave dhe lirive themelore, por në kuadër të këtij kapitulli, hasim në shumë dispozita kushtetuese që garantojnë një shtrirje gjithëpërfshirëse të të drejtave dhe të lirive të individit, siç është barazia para ligjit dhe mosdiskriminimi (neni 24. paragrafi 1.). Pra, sipas paragrafit 2 të të njëjtit nen, “askush nuk guxon të diskriminohet në bazë të statusit, racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës..., lidhjes me ndonjë bashkësi... apo të ndonjë statusi tjetër personal”. Ky kapitull, po ashtu, thekson se marrëveshjet kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatohen në Kosovë, gjë që është veçanërisht e rëndësishme për pjesëtarët e bashkësive pakicë, duke pasur parasysh se këto janë aktet më të rëndësishme me karakter ndërkombëtar (neni 22.). Ky nen e garanton zbatimin e drejtpërdrejtë të

marrëveshjeve dhe të instrumenteve ndërkombëtare në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe ato kanë epërsi, në rast mosmarrëveshjeje, mbi të gjitha dispozitat ligjore dhe aktet e tjera të institucioneve publike.

25. Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Pjesëtarëve të Pakicave Nacionale apo Etnike, Fetare apo Gjuhësore, paraqet një dokument me rëndësi esenciale për të drejtat e pakicave, si dhe standardet e tjera të rëndësishme rajonale dhe ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të pakicave, që përmbajnë obligime dhe udhëzime në planin e mbrojtjes së të drejtave të pakicave. Për këtë arsye, është mjaft i rëndësishëm inkorporimi i tyre në kornizën kushtetuese dhe ligjdhënëse, gjë që është rasti edhe me Kushtetutën ekzistuese të Republikës së Kosovës tashmë të miratuar në vitin 2008. Por, nuk mjafton vetëm ekzistimi i tyre, por është shumë më i rëndësishëm sigurimi i zbatimit të plotë dhe efikas i këtyre standardeve, krahas administrimit adekuat dhe të mbikëqyrjes përkatëse.
26. Republika e Kosovës ofron shumë sfida, por edhe mundësi për përmbushjen e të drejtave dhe premtimeve të garantuara të njeriut në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Me qëllim të përmbushjes së këtyre premtimeve, është e nevojshme që me forcat e përbashkëta t'i qasemi zbatimit të përvojave të arritura gjatë decenieve të fundit. Po ashtu, Kosova paraqet edhe një test dhe sfidë për sistemin ndërkombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht të të drejtave të pakicave, sepse respektimi i të drejtave të pakicave i avancohet kushtet për stabilitet politik dhe shoqëror dhe për paqe jo vetëm në hapësirën e Kosovës, por edhe në tërë rajonin. Për dallim nga sistemi i segregacionit dhe i ndarjes, të drejtat e pakicave bazohen në parimin e integritetit shoqëror, i cili nënkupton të drejtën e çdo personi për përdorim të gjuhës amtare, ruajtje të identitetit kulturor dhe fetar, por edhe të përkatësisë ndaj identitetit kombëtar të bashkësisë së gjerë.
27. Kategoria e të drejtave të pjesëtarëve të pakicave në territorin e Republikës së Kosovës, i përfshin të drejtat e veçanta të garantuara me Kushtetutën dhe dokumentet ndërkombëtare të pjesëtarëve të bashkësive pakicë, me qëllim të ruajtjes së identitetit të tyre kombëtar. Në planin ndërkombëtar, këto të drejta janë garantuar me Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966, Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Pjesëtarëve të Pakicave Kombëtare apo Etnike, Fetare apo Gjuhësore të vitit 1992, me Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës të vitit 1995 dhe me dokumentet e tjera ndërkombëtare-juridike. Për këtë arsye, të gjitha këto akte janë instrumente relevante ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Kështu, me nenin 27 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është parashikuar që në shtetet në të cilat ka pakica etnike, fetare dhe gjuhësore, pjesëtarëve të këtyre pakicave nuk guxon t'u mohohet e drejta që, në bashkësi me pjesëtarët e tjerë të grupit të tyre, ta kultivojnë kulturën e tyre, ta predikojnë dhe shprehin fenë e tyre apo ta shfrytëzojnë gjuhën e vet. Po ashtu, Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Pakicave Nacionale apo Etnike, Fetare apo Gjuhësore (neni 2.) parashikon që pjesëtarët e pakicave kanë të drejtë për pjesëmarrje efektive në jetën kulturore, fetare, shoqërore, ekonomike dhe publike,

ndërsa agjencitë e specializuara të KB dhe organizatat e tjera në sistemin e KB janë të obliguara që, në kuadër të këtyre kompetencave, t'i kontribuojnë realizimit të plotë të të drejtave dhe të parimeve të përcaktuara me këtë Deklaratë (neni 9.). Edhe me Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është përcaktuar që të gjithë pjesëtarët e pakicave kombëtare kanë të drejtë që lirisht të përcaktohen se a dëshirojnë apo jo që të jenë të trajtuar si pakicë, pa asnjë pasojë për një përcaktim të tillë (neni 3.), ndërsa nënshkruesit janë të obliguar që të ndërmarrin masa adekuate të mbrojtjes së personave nga kërcënimet apo diskriminimi i mundshëm, armiqësia apo dhuna në bazë të përkatësisë së tyre etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare (neni 6.).

28. Në mbrojtjen e të drejtave të pakicave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, rol të madh kanë Kombet e Bashkuara, të cilat i sigurojnë të drejtat e pakicave në planin ndërkombëtar, ndërsa instrumentet më të rëndësishme të KB-së kanë të bëjnë pikërisht me mbrojtjen e këtyre të drejtave. Kuvendi i Përgjithshëm i KB-së, më 1992, e ka miratuar Deklaratën për të Drejtat e Pjesëtareve të Pakicave Nacionale apo Etnike, Fetare apo Gjuhësore, me të cilën janë vendosur të drejtat e gjithëpranueshme të të gjitha pakicave, ndërsa neni 9 i kësaj Deklarate thotë: “Agjencitë e specializuara dhe organizatat e tjera të sistemit të KB e kanë për obligim që, në kuadër të kompetencave të tyre, të kontribuojnë për realizimin e plotë të parimeve të definuar me këtë Deklaratë”.
29. Me qëllim të zbatimit të dispozitave ligjore në jetë dhe të mbrojtjes së të drejtave të bashkësive pakicë dhe të pjesëtarëve të tyre në territorin e Kosovës, është parashikuar themelimi i shumë institucioneve, në të cilat bëjnë pjesë:
- a) **Ministria për Komunitete dhe Kthim** - e themeluar në vitin 2005, si ministria më e rëndësishme për mbrojtjen dhe avancimin e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre. Në kompetencën e saj bëjnë pjesë: 1) miratimi i dispozitave përkatëse dhe zbatimi i tyre, me qëllim të avancimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të bashkësisë dhe të pjesëtarëve të saj; 2) krijimi i kushteve për kthimin e personave të shpërngulur; 3) ndërtimi i mirëbesimit, dialogut dhe pajtimit ndërmjet bashkësive dhe zbatimi i këtyre aktiviteteve e të tjera.
 - b) **Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal**, e themeluar në vitin 2004, është përgjegjëse për çështjet që kanë të bëjnë me efikasitetin e vetëqeverisjes lokale dhe me përmbushjen e nevojave të të gjitha bashkësive si dhe sigurimin e qasjes së barabartë ndaj shërbimeve që i ofron. Në kuadër të kësaj Ministrie funksionojnë: Zyra e Sekretarit të Përhershëm; Zyra për Informim; Drejtoria Juridike; Drejtoria për Vetëqeverisje Lokale; Drejtoria për Reformë dhe Integrim Evropian; Drejtoria për Administrim dhe Përkrahje dhe Drejtoria për Furnizim. Për nevoja të komentimit tonë, rëndësi të veçantë ka Drejtoria për Vetëqeverisje Lokale, kështu që, në këtë vend, do të ndalemi vetëm në analizën e obligimeve dhe përgjegjësisë të saj, ku bëjnë pjesë: 1) mbledhja e të dhënave komunale dhe analiza e tyre; 2) mbikëqyrja e qasjes së opinionit në shërbimet komunale, të cilat i kontrollojnë pushteti qendror; 3) mbikëqyrja e respektimit të të drejtave të bashkësive gjatë ofrimit të shërbimeve komunale;

- 4) mbikëqyrja e përfaqësimit të punës dhe ofrimi i mundësive të barabarta në të gjitha komunitatet; 5) mbikëqyrja e përdorimit të gjuhëve zyrtare në komuna e të tjera.
- c) **Njësitë për të Drejtat e Njeriut në Ministri** zyrtarisht janë formuar në vitin 2007, me qëllim të mbikëqyrjes së harmonizimit të politikës dhe të aktiviteteve të çdo ministrie dhe të legjislacionit përkatës me standardet e të drejtave të njeriut. Çdo njësi për të drejtat e njeriut në ministri në përbërjen e vet duhet ta ketë specialistin për të drejtat e bashkësive, i cili duhet ta përcjellë ndikimin e politikës që e zbatojnë ministratë përkatëse, realizimin e ligjeve dhe të aktiviteteve që kanë të bëjnë me bashkësitë. Këto njësi, në kuptim të ngushtë, duhet të fokusohen në çështjet e harmonizimit të brendshëm, siç është shkalla e punësimit të pjesëtarëve të bashkësive në çdo ministri.
- d) **Zyra Këshilluese për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Çështje Gjinore** ekziston që nga viti 2002, ndërsa në funksionet e saj më të rëndësishme hyjnë: 1) mbikëqyrja dhe këshillimi i ministrive në lëmin e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, të mundësive të barabarta dhe të çështjes së gjinive;²³⁵ 2) zhvillimi i rregullave dhe dhënia e kaheve në fushat e caktuara etj. Kjo Zyra është përgjegjëse për revizionin e ligjeve, rregullave, procedurave dhe praktikës, me qëllim të harmonizimit me standardet e zbatueshme të të drejtave të njeriut, si dhe për dhënien e rekomandimeve përkatëse Kryeministrit dhe ministrive relevante. Edhe pse kjo Zyra nuk është institucion që u kushtohet ekskluzivisht interesave të bashkësive, ajo ka kompetencën që të “konsultohet me pjesëtarët e bashkësive dhe të zhvillojë organe konsultative të nevojshme për sigurimin e qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut, mundësive të barabarta dhe të çështjeve të gjinive”. Në kompetencë të kësaj Zyre, po ashtu, bëjnë pjesë: 1) mbrojtja dhe avancimi i të drejtave të njeriut në tërësi, me theks të veçantë në të drejtat e grave, fëmijëve dhe të personave me nevojë të veçanta; 2) ndikimi të zyrtarët që t’i respektojnë standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; 3) lufta kundër korrupsionit; 4) hartimi i strategjisë gjithëpërfshirëse dhe integruese për zgjidhjen e të gjitha aspekteve të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe të drejtat e bashkësive; 5) formulimi i hapave konkret dhe i masave programore për zbatimin e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, veçanërisht të drejtave të bashkësive.
- e) **Zyra për Çështje të Komuniteteve** është një organ mjaft i rëndësishëm për realizimin e të drejtave të bashkësive dhe të pjesëtarëve të tyre, ndërsa një organ i ngjashëm ka ekzistuar në vitin 2002, i cili, ndërkaq, nuk e ka realizuar rolin e vet dhe nuk ka kontribuar për mbrojtjen e të drejtave të bashkësive. Për këtë arsye pritet që Zyra për Çështje të Bashkësive ta përmirësojë mungesën e koordinimit në qasjen e Qeverisë ndaj mbrojtjes së bashkësive dhe që ta zgjidh këtë problem nëpërmjet mbikëqyrjes së të gjitha aktiviteteve në nivelin qendror, lidhur me bashkësitë, për t’u siguruar që Qeveria ka një sistem gjithëpërfshirës dhe efikas të mbrojtjes së bashkësive. Prandaj, në kompetencat më të rëndësishme të kësaj zyre, bëjnë pjesë: 1) këshillimi i kryetarit të

²³⁵ Krahaso: Čok, V., (1985), “Evolucija shvatanja o pravima žena kao pravima čoveka - od osnivanja Ujedinjenih nacija do danas“, *Jugoslovenska Revija za Medjunarodno Pravo*, nr. 1-2, fq. 242-262.

Qeverisë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me bashkësitë; 2) koordinimi i aktiviteteve lidhur me këto çështje; 3) koordinimi i aktiviteteve të të gjitha institucioneve kompetente lidhur me zgjidhjen efikase të problemeve të bashkësive në tërë Kosovën; 4) zbatimimi i rregullave për çështjet që kanë të bëjnë me bashkësitë; 5) zgjidhja e nevojave praktike të bashkësive e të tjera.

- f) **Koordinatori për të Drejtat e Njeriut**, i themeluar nga ana e Kryeministrit të Kosovës në vitin 2007, si një organ i rëndësishëm punues i Qeverisë, kompetencat kryesore të të cilit janë: 1) koordinimi i punës së njësisë për të drejtat e njeriut në ministri, me qëllim të avancimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë; 2) koordinimi i aktiviteteve lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut e të tjera. Duhet theksuar se vetë vëllimi i veprimtarisë së koordinatorit për të Drejtat e Njeriut është i definuar mjaft gjerësisht, sepse ekziston tendenca që të drejtat e bashkësive të trajtohen si pjesë e të drejtave të njeriut. Po ashtu, nuk përmenden shprehimisht të drejtat e bashkësive dhe të pjesëtarëve të tyre në mandatin e koordinatorit dhe as çështjet me rëndësi për ta. Ndërkaq, duke pasur parasysh se të drejtat e bashkësive janë komponentë e të drejtave të njeriut, ato konsiderohen pjesë kushtetuese e mandatit të Koordinatorit.
- g) **Ombudspersoni (Avokati i Popullit)**.- Institucioni i Ombudspersonit është formuar në vitin 2000, si organ i pavarur, i cili ka mandatin që të shqyrtojë çdo shkelje eventuale të të drejtave të njeriut apo abuzim të pushtetit nga ana e institucioneve publike në Kosovë. Edhe pse është formuar në kuadër të UNMIK-ut, roli dhe kompetenca e Ombudspersonit janë reformuar në Kushtetutën e Kosovës. Pra, mundësia e sërishme për mbrojtjen e të drejtave të pakicave është dhënë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të vitit 2008 (neni 132.), që e ka themeluar institucionin e Ombudspersonit, roli më i rëndësishëm i të cilit është që të mbikëqyrë dhe të mbrojë të drejtat dhe liritë e individit nga veprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve publike. Ai është i pavarur në zbatimin e kompetencave të veta, ashtu që të gjitha organet e tjera, të cilat e ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës, nuk mund të ndikojnë në punën e tij, por janë të obliguara që t'u përgjigjen kërkesave të tij dhe t'i dërgojnë të gjitha dokumentet dhe informatat e kërkuara. Për punën e tij, ai i paraqet raport vjetor Kuvendit të Republikës së Kosovës, por ka të drejtë të japë rekomandime dhe të propozojë masa, atëherë kur vëren shkelje të të drejtave dhe të lirive nga ana e organeve shtetërore,²³⁶ si dhe të fillojë procedurën në Gjykatën Kushtetuese (neni 135. paragrafi 4. i Kushtetutës), lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me: a) harmonizimi i ligjeve, dekretëve të Kryetarit dhe të Kryeministrit dhe rregulloreve të Qeverisë me Kushtetutën; b) harmonizimi i statuteve të komunave me Kushtetutën (neni 113. paragrafi 2. pika 1 dhe 2. e Kushtetutës). Në kuadër të Ombudspersonit janë formuar tri ekipe, që duhet të fokusohen në problemet speciale të grupeve të rrezikuara të njerëzve, siç janë: Ekipi për të Drejtat e Njeriut, Njësia për Barazi Gjinore dhe Ekipi për Mosdiskriminim. Brenda Ombudspersonit, problemet e bashkësive janë përfshirë në punën e këtij të fundit, kështu që deri tash janë paraqitur disa parashtrësia për diskriminimin në Kosovë.

²³⁶ Degan, V.Đ., (1989), "Pojam i sadržaj "naročito teških kršenja" prava čovjeka", *Zbornik Pravnog fakulteta u Zagrebu*, nr. 5-6,(Supplement), fq. 755-772.

- h) Komisioni Parlamentar për të Drejtat dhe Interesat e Bashkësive** është Komision i përhershëm i Kuvendit të Kosovës, si institucion më i lartë ligjdhënës i Republikës së Kosovës. Pozita e këtij Komisioni brenda Kuvendit është parashikuar me Kushtetutë (neni 77 dhe 78), duke konfirmuar rolin e tij jashtëzakonisht të rëndësishëm në procesin ligjdhënës, (duhet theksuar fakti se edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit, shfrytëzohet emërtimi Komision, ndërsa në disa artikuj, komentime dhe sajte zyrtare të disa institucioneve kosovare përdoret emërtimi Këshill). Sipas nenit 78 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të vitit 2008, ky Komision paraqet një nga dy institucionet, të cilat ekskluzivisht u janë përkushtuar bashkësive (përveç Këshillit Konsultativ për Bashkësitë, të parashikuar me nenin 60 të Kushtetutës). Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Bashkësive është i përbërë nga një e treta (1/3) e pjesëtarëve të caktuar në vendet e rezervuara për bashkësinë e serbëve të Kosovës, një e treta (1/3) e pjesëtarëve të caktuar në vendet e rezervuara për pjesëtarët e bashkësive të tjera pakicë dhe një e treta (1/3) pjesëtarë të bashkësisë shumicë, që është e përfaqësuar në Kuvend.
- i) Në fund, duhet thënë se ekziston edhe Këshilli Konsultativ për Komunitetet,** por këtu nuk do të zgjatemi më shumë në analizën e pozitës, rolit dhe të rëndësisë së tij për realizimin e të drejtave të bashkësive dhe të pjesëtarëve të tyre, duke pasur parasysh së për këtë Këshill do të flitet shumë më tepër me rastin e komentimit të nenit 60 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që në tërësi i kushtohet këtij Këshilli.
- 30.** Kushtetuta e Republikës së Kosovës pjesëtarëve të pakicave u garanton të drejta shtesë, përveç të drejtave që u takojnë të gjithë qytetarëve. Këto të drejta paraqiten pjesërisht si individuale (realizohen individualisht) dhe pjesërisht si të drejta kolektive (realizohen në bashkësi me të tjerët). Të drejtat kolektive të pakicave nënkuptojnë që pjesëtarët e pakicave kombëtare, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të zgjedhur, marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes apo vendosin vetë për çështje të caktuara lidhur me kulturën, arsimin, informimin dhe përdorimin zyrtar të gjuhës e të shkrimit të tyre. Pjesëtarëve të pakicave u janë siguruar dhe garantuar të drejta të veçanta, qëllimi i të cilave është ruajtja e identitetit të tyre. Kështu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës parashikon që banorët që i takojnë të njëjtit grup nacional apo etnik, gjuhësor apo fetar, që tradicionalisht është i pranishëm në territorin e Kosovës (bashkësitë), gëzojnë të drejta të veçanta kushtetuese, pos të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në kapitullin II të kësaj Kushtetute.
- 31.** Për komentin tonë është veçanërisht i rëndësishëm Kapitulli III i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që u është kushtuar ekskluzivisht të drejtave të bashkësive dhe pjesëtarëve të tyre. Në këtë kapitull u ofrohet mbrojtje shtesë pjesëtarëve të bashkësive pakicë, në raport me të drejtat dhe liritë themelore, të paraqitura në Kapitullin II. Kështu, Kapitulli III e vë në dukje përgjegjësinë e bashkësive dhe pjesëtarëve të tyre dhe përgjegjësinë e shtetit që t'i mbrojë, promovojë dhe avancojë ato të drejta. Ai, po ashtu, e parashikon formimin e Këshillit Konsultativ

për Bashkësitë, i cili funksionon nën mbikëqyrje të Kryetarit të Republikës së Kosovës dhe në të cilin janë të përfaqësuara të gjitha bashkësitë. Roli më i rëndësishëm i këtij Këshilli është sigurimi i bashkëpunimit ndërmjet pjesëtarëve të bashkësive dhe të Qeverisë. Në fund, Kapitulli III ua garanton pjesëtarëve të bashkësive përfaqësimin e barabartë në institucionet publike dhe cakton dispozita të veçanta të destinuara për komunat në të cilat bashkësitë përbëjnë më së paku dhjetë për qind të popullsisë. Në këto komuna bashkësitë do të përfaqësohen me nënkryetarin e Kuvendit, të ngarkuar për bashkësitë, funksioni kryesor i të cilit është përmbushja e interesave dhe zgjidhja e problemeve të bashkësive pakicë.

32. Duke pasur parasysh tërë këtë, për pakicat në Kosovë, Kushtetuta në fuqi e vitit 2008 është shpresë e madhe për realizimin e të drejtave të tyre, duke pasur parasysh se ajo në Kapitullin III (neni 57-62), që emërtohet “Të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre”, pjesëtarëve të pakicave u ka garantuar të drejta të caktuara, të cilat kanë të bëjnë me *ndalimin e diskriminimit, lirinë e shprehjes së përkatësisë nacionale, barazinë në kryerjen e punëve publike, ndalimin e asimilimit të dhunshëm, të drejtat për ruajtjen e veçantive, të drejtat për bashkim dhe bashkëpunim me bashkëkombësit, zhvillimin e frymës së tolerancës e të tjera*. Ndërkaq, problemi është te realizimi i këtyre të drejtave nga ana e atyre, të cilëve këto të drejta u janë garantuar me Kushtetutë. Siç kemi thënë, me qëllim të përfaqësimit në organin më të lartë përfaqësues, Kuvendi i Kosovës ka një sistem të komplikuar të përfaqësimit të pakicave, sikur të jetë zbatuar, në masë të caktuar, sistemi që vlen në Bosnje dhe Hercegovinë, i bazuar në numrin e garantuar të vendeve për grupin e caktuar pakicë. Në këtë mënyrë, për serbët në Kuvend janë garantuar 10 vende dhe 10 vende për pakicat e tjera, të radhitura sipas madhësisë relative të komuniteteve (romët, ashkalinjtë, egjiptianët i kanë fituar 4 vende, boshnjakët 3, turqit 2 dhe goranët 1).

Neni 57 [Parimet e Përgjithshme]

- (1) Banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), gëzojnë të drejta të veçanta, të përcaktuara me këtë Kushtetutë, krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përcaktuara në Kapitullin II të kësaj Kushtetute.
- (2) Çdo pjesëtar i komunitetit do të ketë të drejtën që të zgjedhë lirisht nëse do të trajtohet ose të mos trajtohet si pjesëtar i komunitetit dhe nga kjo zgjedhje ose nga ushtrimi i të drejtave që ndërlidhen me këtë zgjedhje, nuk do të rezultojë asnjë diskriminim.
- (3) Pjesëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtë që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin dhe atributet e tyre si komunitet.
- (4) Ushtrimi i këtyre të drejtave do të bartë me vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me ligjin e Republikës së Kosovës, dhe nuk i cenon të drejtat e të tjerëve.

1. Ky nen i përcakton parimet e përgjithshme, që kanë të bëjnë me garantimin e të drejtave të veçanta të banorëve të cilët i takojnë të njëjtit grup kombëtar apo etnik, gjuhësor apo fetar dhe i cili tradicionalisht është i pranishëm në territorin e Kosovës. Këto janë komunitetet të cilat, përveç lirive themelore dhe të drejtave të njeriut e të qytetarit (të përcaktuar me kapitull të veçantë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës), gëzojnë edhe të drejta të caktuara të veçanta, të cilat ua garanton vetë Kushtetuta. Në këtë kuptim, me dispozitat kushtetuese është parashikuar ndalimi i çfarëdo diskriminimi, nëse pjesëtari i komunitetit, do të thotë i grupit nacional, etnik, gjuhësor apo fetar, sipas zgjedhjes së vet të lirë, vendos që me të të veprohet apo të mos veprohet, si me pjesëtarin e komunitetit kombëtar.
2. Me qëllim të ruajtjes së veçantive të veta, pjesëtarëve të komuniteteve u garantohej e drejta që lirisht ta shprehin, ta kultivojnë dhe ta zhvillojnë identitetin e vet, si dhe t'i shprehin veçoritë e komunitetit së vet. Natyrisht, shfrytëzimi i çdo të drejte tërheq pas vetes edhe obligime të caktuara, kështu që personi i cili i shfrytëzon të drejtat e përmendura më sipër, është i obliguar dhe përgjegjës që këtë ta bëjë në pajtim me ligjet përkatëse. Po ashtu, shfrytëzimi i këtyre të drejtave nuk guxon t'i rrezikojë apo mohojë të drejtat e personave të tjerë në territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 57.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në pjesën më të madhe bazohet në “Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës” (Plani i Ahtisarit) dhe paraqet bazë të kornizës së gjerë ligjdhënëse, që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Sipas kësaj Kushtetute (neni 57. paragrafi 1.), me komunitet nënkuptohen “banorët që i takojnë të njëjtit grup nacional apo etnik, gjuhësor apo fetar, i cili tradicionalisht është i pranishëm në territorin e Kosovës”.²³⁷ Në shikim të parë, mund të konkludohet se ky përcaktim i nocionit të komunitetit është mjaft i gjerë, sepse i përfshin të gjitha grupet etnike dhe nuk bën dallim ndërmjet grupeve të cilat përbëjnë shumicë apo pakicë numerike. Prandaj, Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe të Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (i miratuar në Kuvend, më 13.03.2008, ndërsa i shpallur me Dekretin e Kryetarit nr. DL-013-2008, më 15 qershor 2008), jep definicion të ngushtë, sipas të cilit komunitetet paraqesin “grupe nacionale, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare, të cilat tradicionalisht janë të pranishme në Republikën e Kosovës dhe që nuk janë shumicë” në këto grupe bëjnë pjesë: serbët, turqit, boshnjakët, romët, ashkalinjtë, egjiptianët, goranët dhe komunitetet e tjera (neni 1. paragrafi 4. i Ligjit). Ky është definicioni i ngushtë, që zbatohet vetëm për grupet që janë pakicë, ndërsa komuniteti shqiptarë, si komunitet shumicë, është e përjashtuar nga ky definicion.

²³⁷ Krahaso paragrafët 17 dhe 21-23. *Aktvendim për palejueshmëri nga 15.2010 në rastin nr. KI18/09. Paraqitës i kërkesës, Reshat Karanxha kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës.*

2. Të drejtat më të rëndësishme të komuniteteve në Kosovë janë e drejta për jetë të lirë, përdorim të gjuhës amtare, kultivim të kulturës e të fesë, prandaj në shumë raste pjesëtarët e tyre nuk dëshirojnë që të trajtohen si pakica, por në përdorim shumë më të shpeshtë është nocioni “komunitet”, siç është definuar me të drejtat e tyre edhe në kuadër të Kushtetutës (neni 3 dhe nenet 57-62). Mirëpo, nocioni “pakicë” është objektiv dhe ka të bëjë me grupin identiteti etnik, gjuhësor apo fetar i të cilit është në pakicë në territorin e caktuar, gjë që paraqet qasje të veçantë adekuate, kur është fjala për Kosovën. Pra, nocionet “pakicë” dhe “të drejtat e pakicave” janë të domosdoshme kur grupet e caktuara etnike, fetare apo racore nuk kanë pushtet, pra atëherë kur janë në pozitë të pakicës numerike në kontekstin e realizimit të pushtetit.
3. Me Kushtetutën ekzistuese të Republikës së Kosovës të vitit 2008 (neni 64. paragrafi 2. pika 1.), nga gjithsej 120 deputetë, të zgjedhur me votim të fshehtë, në bazë të listave zgjedhore, 20 vende në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë garantuar për pjesëtarët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Nga ky numër partitë, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin serb, kanë aq në Kuvend, sa kanë fituar në zgjedhje, por më së paku 10 vendet e garantuara, nëse numri i vendeve të fituara është më i vogël se 10.
4. **Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët** paraqesin grupin e dytë pakicë të banorëve, të cilëve duhet t'u mundësohet që t'i gëzojnë të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Që të sigurohet përfaqësimi i këtyre pakicave në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me dispozitat e Kushtetutës (neni 64. paragrafi 2. pika 2.), është përcaktuar se partitë, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët kanë deklaruar se i përfaqësojnë komunitetet e tjera në Kuvend, kanë po aq vende, sa kanë fituar në zgjedhje, por me numër minimal të vendeve të garantuara, si: komuniteti i romëve një vend, komuniteti i ashkalinjve një vend, komuniteti i egjiptianëve një vend dhe një vend shtesë i është garantuar njëerës nga tri komunitetet e përmendura paraprake, e cila e fiton numrin më të madh të votave në zgjedhje.
5. **Boshnjakët** paraqesin popullsinë, së cilës i është pranuar identiteti nacional në RSF të Jugosllavisë, gjatë regjistrimit të popullsisë, më 1961, në kuadër të kategorisë “mysliman në kuptimin etnik”, ndërsa gjatë luftës në Bosnje dhe Hercegovinë, më 1990, për këtë grup është marrë termi “boshnjak”, ndërsa gjuha boshnjake është promovuar si gjuhë e pavarur ndaj gjuhës serbe dhe kroate, (edhe pse në mes të këtyre tri gjuhëve ekzistojnë dallime të vogla). Emërtimi boshnjak në masë të madhe është pranuar nga myslimanët në Kosovë, pas vitit 1999. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës, nga 120 vende deputetësh, siç kemi thënë më sipër, 20 vende janë rezervuar për përfaqësuesit e komuniteteve të cilat nuk janë shumicë në Kosovë. Nga kjo partitë, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët kanë deklaruar se i përfaqësojnë komunitetet e tjera në Kuvend, e kanë numrin e përgjithshëm të vendeve të cilat i kanë fituar në zgjedhje, por ashtu që numri minimal i vendeve të garantuara për komunitetin e boshnjakëve është tri (3) vende.

6. **Turqit** - një nga problemet e tyre themelore ka qenë njohja e identitetit dhe ruajtja e gjuhës amtare. Me qëllim të ruajtjes së interesave të tyre në këtë hapësirë, ata në bazë të zgjedhjeve të mbajtura, e kanë numrin e përgjithshëm të vendeve të cilat i fitojnë, por që u është garantuar numri minimal prej 2 vendesh të deputetit.
7. **Goranët** janë popull i veçantë me religjion islam që jetojnë në trekufirin e Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës. Për t'u penguar shpërngulja e mëtejme e goranëve nga trojet e tyre shekullore dhe për t'u siguruar mbrojtja e të drejtave të tyre, ruajtja e identitetit dhe e gjuhës, në Kuvendin e Republikës së Kosovës kanë aq vende, sa kanë fituar në zgjedhje, por u është garantuar një (1) vend deputeti.

Neni 57.2

1. Sipas paragrafit 2 të nenit 57 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, çdo pjesëtar ka të drejtë që lirisht të zgjedhë që me të të veprohet apo të mos veprohet si me pjesëtarin e komunitetit së caktuar, ndërsa për shkak të asaj zgjedhjeje dhe për shkak të shfrytëzimit të të drejtave që lidhen me atë zgjedhje, nuk guxon t'i nënshtrohet asnjë diskriminimi. Në kushte të njëjta, si edhe për qytetarët e tjerë, pjesëtarëve të pakicave kombëtare u garantohet barazia para ligjit dhe mbrojtja e barabartë ligjore, kështu që është i ndaluar çfarëdo diskriminimi për shkak të përkatësisë komunitetit pakicë. Pra, duke pasur parasysh se Republika e Kosovës është shoqëri multietnike, e cila përbëhet nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera, me Kushtetutë është parashikuar se kjo Republikë duhet të qeveriset në mënyrë demokratike, duke respektuar pushtetin e së drejtës, nëpërmjet institucioneve ligjdhënëse, ekzekutive dhe gjyqësore. Prandaj, zbatimi i pushtetit publik bazohet në parimin e barazisë së të gjithë qytetarëve para ligjit dhe respektimin e të drejtave të njohura ndërkombëtare dhe të lirive themelore, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre (neni 3. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës). Edhe me nenin 24 të Kushtetutës, është parashikuar se para ligjit janë të gjithë të barabartë dhe që çdokush ka të drejtën e mbrojtjes ligjore pa diskriminim. Pra, edhe pse dispozita e përgjithshme kushtetuese për ndalimin e diskriminimit e përfshin edhe ndalimin e diskriminimit në pikëpamje të përkatësisë nacionale (neni 24 i Kushtetutës), për shkak të rëndësisë që e ka për statusin kushtetues të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, Kushtetuta e përsërit ndalimin e diskriminimit edhe ndër të drejtat e veçanta të këtyre komuniteteve (neni 57 i Kushtetutës).

Neni 57.3

1. Me paragrafin 3 të nenit 57 të Kushtetutës, pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në mënyrë të veçantë u është garantuar e drejta e ruajtjes së veçantive dhe në këtë të drejtë kolektive, së pari, është përfshirë e drejta për shprehje të lirë, kultivim dhe zhvillim të identitetit dhe të veçorive të komunitetit së vet. Kjo e drejtë pastaj në mënyrë shumë detaje është shtjelluar në nenin 59 (emërtimi i tij është “të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre”), sipas dispozitave të të cilit pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, individualisht apo në kuadër të komunitetit, ta

shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e vet dhe t'i ruajnë elementet esenciale të identitetit të tyre, përkatësisht besimin fetar, gjuhën, traditën dhe kulturën, të fitojnë arsim publik në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, sipas zgjedhjes së tyre në të gjitha nivelet, si dhe të fitojnë arsim parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre, në masën që është parashikuar me ligj.

Neni 57.4

1. Në fund, me paragrafin 4 të këtij neni është parashikuar se pjesëtarët e komuniteteve pakicë nuk e kanë vetëm mundësinë që t'i gëzojnë të drejtat e përmendura më sipër, por kanë edhe detyrime dhe përgjegjësi të caktuara. Këto detyrime dhe përgjegjësi të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, kanë të bëjnë me veprimin e tyre në pajtim me dispozitat ligjore pozitive të Republikës së Kosovës dhe ky veprim i tyre dhe as të gëzuarit e të drejtave të garantuara me Kushtetutë, nuk guxon të jetë në dëm të personave të tjerë, pra nuk guxon të shkaktojë mohimin e të drejtave dhe të lirive të huaja.

Neni 58 [Përgjegjësitë e Shtetit]

- (1) **Republika e Kosovës siguron kushtet e duhura, të cilat u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre. Qeveria do të përkrahë veçanërisht nismat kulturore të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, përfshirë këtu edhe nëpërmjet ndihmës financiare.**
- (2) **Republika e Kosovës do të promovoj frymën e tolerancës, dialogut dhe do të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe do të respektoj standardet e përcaktuara me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave.**
- (3) **Republika e Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat të cilët mund t'u nënshtrohen kërcënimeve ose veprimeve diskriminuese, armiqësisë a dhunës, si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar.**
- (4) **Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuate për të promovuar një barazi të plotë dhe efektive ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore. Masat e tilla nuk do të konsiderohen të jenë vepër e diskriminimit.**
- (5) **Republika e Kosovës do të promovoj ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës. Republika e Kosovës do të ketë detyrë të posaçme për të siguruar mbrojtjen efektive të tërësisë së objekteve dhe monumenteve të rëndësishme kulturore dhe fetare për komunitetet.**
- (6) **Republika e Kosovës ndërmerr veprime efektive kundër të gjithë atyre që pengojnë gëzimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve. Republika**

e Kosovës do të përmbahet nga politikat ose praktikat që kanë për qëllim asimilimin, kundër vullnetit të tyre, të personave që u përkasin komuniteteve, dhe do t'i mbrojtë ata persona nga çfarëdo veprimi që ka për qëllim një asimilim të tillë.

- (7) Republika e Kosovës siguron, në baza jodiskriminuese, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të specifikuar me këtë Kushtetutë.**

Neni 58

1. Me këtë nen përcaktohet përgjegjësia e Republikës së Kosovës dhe obligimi i saj që të sigurojë kushte përkatëse, që janë të nevojshme për t'ua mundësuar komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që ta ruajnë identitetin e vet. Në këtë, rol të veçantë ka Qeveria, e cila, përveç përkrahjes së nismave kulturore të komuniteteve të përmendura dhe të pjesëtarëve të tyre, duhet t'u mundësojë edhe ndihmë të caktuar financiare. Po ashtu, në dispozitat kushtetuese theksohet veçanërisht avancimi i frymës së tolerancës dhe të dialogut reciprok, si dhe të vlerave të reja, të cilat në kohë të fundit garantohet nga ana e një numri të madh të kushtetutave, konventave, deklaratave dhe dokumenteve të tjera të rëndësishme. Zhvillimi i tolerancës dhe kultivimi i dialogut për tejkalimin e konflikteve, është parashikuar edhe me dokumentet më të rëndësishme evropiane, të cilat i kushtohen mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare, të grupeve etnike, të gjuhëve rajonale etj.
2. Në rast se pjesëtarët e komuniteteve në territorin e Republikës së Kosovës u nënshtrohen kërcënimeve të caktuara apo çfarëdo forme të diskriminimit për shkak të identitetit të tyre kombëtar, etnik, gjuhësor, fetar apo kulturor, shteti është i detyruar që të ndërmarrë masa të domosdoshme, për t'u ofruar mbrojtje përkatëse pjesëtarëve të këtyre komuniteteve. Po ashtu, shteti është i detyruar që, në rast të nevojës, të marrë masa adekuate për sigurimin e barazisë reale dhe të plotë në mes të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës shoqërore, dhe të sigurojë mbrojtje efikase të përmendoreve të kulturës materiale dhe shpirtërore, që janë me rëndësi për komunitetet në territorin e Republikës së Kosovës. Në këtë vështrim, Kushtetuta e përcakton si obligim të veçantë të shtetit që, pa kurrfarë diskriminimi, t'ua mundësojë të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre shfrytëzimin e të drejtave të tyre, të cilat janë përmendur në aktin e përgjithshëm më të lartë juridik.

Neni 58.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 58 e parashikon përgjegjësinë e shtetit për realizimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre. Pra, për komunitetet pakicë dhe pjesëtarët e tyre, përveç krijimit të të drejtave, po aq i rëndësishëm është edhe realizimi i të drejtave, sepse në të kundërtën të drejtat e garantuara me Kushtetutë të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, do të mbesin vetëm fjalë boshe në letër. Pikërisht për këtë arsye me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është parashikuar obligimi i Republikës së Kosovës për të siguruar kushte përkatëse, që do t'ua mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që ta

ruajnë, mbrojnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre, ndërsa Qeveria është obliguar që veçanërisht t'i përkrahë nismat kulturore të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë edhe ndihmën financiare (paragrafi 1.).²³⁸

2. Obligim i veçantë kushtetues i Republikës së Kosovës është edhe ndërmarrja e të gjitha masave të domosdoshme për mbrojtjen e personave që mund t'u nënshtrohen kërcënimeve apo veprimeve diskriminuese, armiqësisë apo dhunës për shkak të identitetit të tyre nacional, etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar. Për këtë qëllim, është obligim i shtetit që t'i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për avancimin e barazisë së plotë dhe reale në mes të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore. Duke pasur parasysh se edhe vetë Kushtetuta e cek faktin se Republika e Kosovës është shoqëri multietnike, e cila përbëhet nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera dhe që të gjithë janë të barabartë para ligjit, është mjaft e rëndësishme, me qëllim të respektimit real të dispozitave kushtetuese dhe të përpjekjeve reale për ruajtjen e veçantive të komuniteteve pakicë, promovimi i ruajtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës. Prandaj, Republika e Kosovës ka obligim të veçantë që ta sigurojë mbrojtjen e lokaliteteve dhe të përmendoreve me rëndësi kulturore dhe fetare për komunitet.

Neni 58.2

1. Sipas paragrafit 2 të nenit 58 të Kushtetutës, Republika e Kosovës është e obliguar që ta avancojë frymën e tolerancës, dialogut dhe t'i ofrojë përkrahje pajtimit ndërmjet komuniteteve. Po ashtu, me qëllim të realizimit të obligimit të tij, shteti është përgjegjës edhe për respektimin e standardeve të caktuara me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale dhe të Pakicave. Për këtë arsye, për pozitën e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Republikën e Kosovës, me rëndësi të madhe janë dispozitat programore të Kushtetutës, në të cilat është i përfshirë mandati i shtetit që në fushën e arsimit, kulturës dhe informimit ta zhvillojë frymën e tolerancës dhe të dialogut ndërkulturor. Duke proklamuar frymën e tolerancës me qëllim themelor të marrëdhënieve të shumicës dhe të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, Kushtetuta tregon se për të pozita e pakicave është jo vetëm e drejtë, por edhe çështje morale. Në të njëjtin drejtim është orientuar edhe obligimi i shtetit që të ndërmarrë masa për avancimin e respektit reciprok, mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit në mes të gjithë njerëzve që jetojnë në territorin e saj, pa marrë parasysh identitetin e tyre etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar.
2. Republika e Kosovës, në këtë kuptim, në fushën e arsimit, kulturës, informimit, si dhe në fushat e tjera, do ta nxisë frymën e tolerancës dhe të dialogut ndërkulturor dhe do të ndërmarrë masa efektive për avancimin e respektimit reciprok, të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në mes të gjithë njerëzve që jetojnë në territorin e

²³⁸ Shih paragrafët 26-56 të *Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 18 mars në rastin KO01/09. Paraqitës i kërkesës Qemajl Kurtishi kundër Kuvendit të Komunës së Prizrenit.*

saj, pa marrë parasysh identitetin e tyre etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar. Pra, konteksti i dëshiruar për ruajtje të identitetit nacional, nënkupton që në rend të parë, në këto fusha të zhvillohet toleranca, respektimi reciprok dhe bashkëpunimi i të gjithë qytetarëve. Kjo dispozitë deklaruese e Kushtetutës e obligon shtetin dhe e shpreh gatishmërinë e tij që ta nxis njohjen dhe respektimin e vlerave demokratike të rëndësishme për ruajtjen e identitetit nacional të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në territorin e Republikës së Kosovës. Kushtetuta nuk i rregullon më për së afërmi obligimet e shtetit, as në kontekst të kësaj dispozite nuk i referohet rregullativës ligjore, e cila do t'i operacionalizonte obligimet e shtetit, por dispozitat parimore, të cilat i parashikon Kushtetuta (neni 21 dhe 22), e mundësojnë rregullimin më të përafërt ligjor të të drejtave të njeriut dhe mund të jenë bazë për rregullativen ligjore në këtë fushë.

Neni 58.3

1. Për mbrojtjen e të drejtave të pakicave të cilat jetojnë në territorin e Republikës së Kosovës, me rëndësi vendimtare është garantimi kushtetues i këtyre të drejtave të natyrshme dhe të patjetërsueshme. Ajo që është më e rëndësishme, duke pasur parasysh raportin e legjislacionit ndërkombëtar dhe kombëtar në sistemet kushtetuese bashkëkohore, e veçanërisht në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës, është fakti se me dispozitën e nenit 22 të Kushtetutës, garantohet zbatimi i drejtpërdrejtë i dokumenteve ndërkombëtare. Pra, me këtë nen shprehimisht përcaktohet që të drejtat dhe liritë e njeriut, që janë përcaktuar me marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare,²³⁹ janë të garantuara me këtë Kushtetutë dhe drejtpërsëdrejti zbatohen në territorin e Republikës së Kosovës dhe kanë epërsi, në rast të konfliktit, mbi të gjitha dispozitat ligjore dhe aktet e tjera të institucioneve publike. Për këtë arsye, Republika e Kosovës është e obliguar që t'i ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për t'i mbrojtur personat që mund t'u nënshtrohen kërcënimeve apo veprimeve diskriminuese, armiqësisë apo dhunës për shkak të identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor apo fetar (neni 58. paragrafi 3.)

Neni 58.4

1. Për ta përmbushur detyrimin e vet kushtetues dhe për ta treguar vendosmërinë se vërtet dëshiron që t'i mbrojë të drejtat e pakicave në territorin e Republikës së Kosovës, shteti duhet të ndërmarrë masa efikase kundër të gjithë atyre që i minojnë të drejtat e pjesëtarëve të komuniteteve, që të përmbahet nga politika dhe praktika, që ka për qëllim asimilimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe është i

²³⁹ Në këto dokumente ndërkombëtare bëjnë pjesë: 1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; 2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e saj; 3) Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollin e tij; 4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; 5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; 6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Normave të Diskriminimit e njohur si Konventa CEDAW; 7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; 8) Konventa kundër mundimit dhe veprimeve apo dënimeve të tjera të vrazhda, jonjerëzore dhe nënçmuese.

obliguar që t'i mbrojtë ata persona nga çdo veprim që ka qëllim të tillë. Për këtë arsye, në pajtim me Kushtetutën ekzistuese, Republika e Kosovës duhet të sigurojë, në bazë të mosdiskriminimit, që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre, të mund t'i shfrytëzojnë të drejtat e veta, të cilat janë përmendur në këtë akt më të lartë juridik të shtetit, i cili i obligon të gjithë në mënyrë të barabartë. Për këtë qëllim, Republika e Kosovës, sipas nevojës, do të miratojë masa adekuatë që mund të jenë të domosdoshme për avancimin e barazisë së plotë dhe reale në mes të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore. Ndërmarrja e masave të këtilla nuk do të konsiderohet si akt diskriminimi (neni 58. paragrafi 4.).

Neni 58.5

1. Duke pasur parasysh se me Kushtetutën ekzistuese të Republikës së Kosovës, numri më i madh i të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë është përcaktuar shprehimisht, është e domosdoshme që të mundësohet zbatimi i këtyre të drejtave të pakicave në praktikë dhe të sigurohet **kontrolli i zbatimit të tyre**. Nëse dominon urrejta etnike, të gjitha përpjekjet e deritashme në Kosovë do të jenë të kota. Prandaj, është e domosdoshme që të gjendet një zgjidhje adekuatë, e cila në tërësi do ta sigurojë mbrojtjen e plotë të të drejtave të të gjithë qytetarëve të Kosovës, e veçanërisht mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve pakicë, me qëllim të sigurimit të sigurisë së pjesëtarëve të tyre. Për këtë arsye, Republika e Kosovës, si shtet, me Kushtetutë është obliguar që ta promovojë dhe ta avancojë ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse të trashëgimisë së Kosovës. Republika e Kosovës do të ketë detyrim të veçantë që të sigurojë mbrojtje efikase të lokaliteteve dhe të përmendoreve me rëndësi kulturore dhe fetare për komunitetet (neni 58. paragrafi 5.).

Neni 58.6

1. Për tërë këtë që u tha, është e domosdoshme që në të ardhmen të sigurohet mbrojtja e të drejtave të komuniteteve dhe e pjesëtarëve të tyre në tërë territorin e Kosovës, sipas dispozitave të Kushtetutës, e cila e ka përcaktuar përgjegjësinë e shtetit për mbrojtje plotësuese dhe të veçantë të komuniteteve pakicë. Kjo do të thotë se, në këto hapësira, duhet të sigurohet zhvillimi i politikës së qëllimeve afatgjata nëpërmjet pranisë së pushtetit transparent dhe përgjegjës dhe të mbrojtjes reale të të drejtave të njeriut. Pra, në asnjë rast, nuk guxon të vijë deri te marginalizimi i të drejtave të njeriut, por duhet të sigurohet respektimi i pushtetit të së drejtës, si dhe përkthimi me kohë i ligjeve të miratuara në gjuhët e pakicave. Po ashtu, është e nevojshme që të forcohet puna e shoqërisë civile dhe të realizohet një angazhim më i madh i saj. Republika e Kosovës, në këtë kuptim, do të jetë e obliguar që të ndërmarrë masa efikase kundër të gjithë atyre, të cilët e minojnë të gëzuarit e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve. Republika e Kosovës do të përmbahet nga politikat dhe praktikrat që kanë për qëllim asimilimin e personave, të cilët u takojnë komuniteteve, kundër vullnetit të tyre dhe është e obliguar që t'i mbrojtë ata nga çdo veprim që ka për qëllim asimilimin e tillë (neni 58. paragrafi 6.).

1. Në fund të komentimit të këtij neni, duhet thënë se rrethanat, të cilat ekzistojnë momentalisht në Kosovë, kërkojnë vendosje të raporteve harmonike dhe të bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme etnike, pra sigurim të mbrojtjes së plotë të të gjitha të drejtave të tyre, e veçanërisht të drejtave të pakicave. Respektimi i të drejtave të pakicave ka për qëllim krijimin e një shoqërie në të cilën çdokush do të mundet që lirisht të flasë në gjuhën e tij amtare, t'i realizojë bindjet fetare dhe ta kultivojë kulturën pa asnjë pasojë. Kjo nënkupton krijimin e shoqërive të integruara, pa ndarje të vrazhda në bazë të përkatësisë etnike apo religjioze. Më e keqja nga të gjitha ndoshta janë pikërisht ndarjet, të cilat kanë si pasojë krijimin e territoreve njënacionale. Gati pa përjashtim, të drejtat e komuniteteve pakicë të cilat jetojnë brenda territoreve të tilla janë të kufizuara.
2. Shikuar në afat të gjatë, stabiliteti i një shoqërie bazohet në integrimin dhe respektimin e dallimeve. Sistemi i këtillë kërkon masa efektive për zgjidhjen e diskriminimit dhe sigurimin e qasjes në shërbimet publike dhe në punësim të të gjitha grupeve shoqërore në bazë të barabartë. Për këtë arsye, Kushtetuta e ka përcaktuar obligimin dhe përgjegjësinë e Kosovës që në bazë të mosdiskriminimit të sigurojë që të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund t'i shfrytëzojnë të drejtat e tyre, të cilat janë cekur në Kushtetutë (neni 58. paragrafi 7.). Prandaj, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ndalon çdo asimilim të dhunshëm të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe parashikon që me ligj të rregullohet mbrojtja e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë nga çdo veprim i orientuar në asimilimin e tyre të dhunshëm. Po ashtu, veçanërisht ndalohet ndërmarrja e masave të cilat do të shkaktonin ndryshim artificial të përbërjes nacionale të popullsisë në territoret ku pjesëtarët e komuniteteve pakicë jetojnë tradicionalisht dhe në numër të konsiderueshëm.
3. Për këtë qëllim Republika e Kosovës është e obliguar që ta promovojë ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve dhe ka obligim të veçantë që të sigurojë mbrojtje efikase të lokaliteteve dhe të përmendoreve me rëndësi kulturore dhe fetare për komunitetet, duke pasur parasysh se në këto hapësira ekzistojnë mbi 1.000 përmendore të kulturës materiale, të cilat dëshmojnë për jetesën shumëshekullore të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, (për fat të keq shumë nga këto përmendore, në mënyrë të përhershme apo pjesërisht janë shkatërruar). Për këtë arsye, Republika e Kosovës duhet të ndërmarrë masa efektive kundër të gjithë atyre që e minojnë të gëzuarit e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve dhe që të përmbahet nga politika dhe praktika, që ka për qëllim asimilimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe është e obliguar që ata persona t'i mbrojë nga çdo veprim që ka qëllim të tillë. Ajo që është mjaft e rëndësishme, është fakti se me vetë dispozitat kushtetuese është parashikuar që Republika e Kosovës, në bazë jodiskriminuese, do të sigurojë se të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre të mund t'i sigurojnë të drejtat e veta të përmendura në Kushtetutë.

Neni 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre]

- (1) Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që, në mënyrë individuale ose si komunitet:
- (2) të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre;
- (3) të marrin arsimim publik në të gjitha nivelet, në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, sipas zgjidhjes së tyre;
- (4) të marrin arsimim publik parafillor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre, deri në masën e përcaktuar me ligj, ku pragu për themelimin e paraleleve a shkollave të veçanta për këtë qëllim, do të jetë më i ulët sesa ai që përcaktohet rëndom për institucionet arsimore;
- (5) të themelojnë dhe të menaxhojnë institucionet private të arsimit dhe trajnimit, për të cilat mund të jepet ndihma financiare publike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
- (6) të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre lirisht në jetën private dhe publike;
- (7) të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në marrëdhëniet e tyre me autoritetet komunale ose me zyrat lokale të autoriteteve qendrore në fushat në të cilat ata përfaqësojnë një pjesë të mjaftueshme të popullatës, në pajtim me ligjin. Shpenzimet e bëra për interpretuesit ose përkthyesit, do të mbulohen nga autoritetet kompetente;
- (8) të përdorin dhe të shfaqin simbolet e komunitetit, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
- (9) të regjistrojnë emrat personal në formën e tyre origjinale dhe në shkrimin e gjuhës së tyre, si dhe emrat e tyre t'i kthejnë në formën origjinale, nëse u janë ndryshuar me dhunë;
- (10) të kenë emërtime lokale, emërtime të rrugëve dhe tregues të tjerë topografikë, që pasqyrojnë dhe janë të ndjeshëm ndaj karakterit shumetnik dhe shumëgjuhësor të zonës përkatëse;
- (11) të kenë qasje të garantuar dhe përfaqësim të veçantë në mediet transmetuese publike si dhe programet në gjuhën e tyre, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;
- (12) të krijojnë dhe të përdorin mediet e tyre vetjake, përfshirë këtu ofrimin e informacioneve në gjuhën e tyre, ndër të tjera, përmes gazetave ditore e shërbimeve kabllore, dhe përdorimin e një numri të rezervuar të frekuencave për mediet elektronike, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Republika e Kosovës do të marrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e një plani ndërkombëtar të frekuencave, për t'i mundësuar komunitetit Serb në Kosovë qasje në një kanal televiziv të pavarur, të licencuar në gjuhën Serbe, në mbarë Republikën e Kosovës;
- (13) të gëzojnë kontakte të papenguara ndërmjet tyre përbrenda Republikës së Kosovës, dhe të themelojnë e të mbajnë kontakte të lira dhe paqësore me personat në cilindo shtet, sidomos me ata që kanë të përbashkët identitetin etnik, kulturor, gjuhësor a fetar, ose trashëgiminë e përbashkët kulturore, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare;

- (14) të gëzojnë kontakte të papenguara me dhe të marrin pjesë, pa diskriminim, në aktivitetet e organizatave joqeveritare lokale, rajonale dhe ndërkombëtare;**
- (15) të themelojnë shoqata të kulturës, artit, shkencës dhe arsimit, si dhe shoqata të studiuesve e shoqata të tjera për shprehjen, avancimin dhe zhvillimin e identitetit të tyre.**

Neni 59

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin e vet 59 flet për të drejtat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, duke u përpjekur që në tërësi t'i përfshijë të drejtat e shumta të pakicave dhe të komuniteteve pakicë, që jetojnë në territorin e Kosovës, në mënyrë që me aktin më të lartë të përgjithshëm të garantohet e drejta për ruajtjen e veçantive të tyre. Do të thotë, pjesëtarëve të këtyre pakicave u garantohet e drejta për: shprehje, ruajtje, kultivim, zhvillim dhe shprehje të haptë të veçantive nacionale, etnike, kulturore dhe fetare; e drejta në përdorimit të simboleve të veta në vende publike; e drejta e shfrytëzimit të gjuhës dhe të shkrimit të vet; e drejta që në mjediset ku përbëjnë popullsi të konsiderueshme, organet shtetërore, organizatat të cilave u janë besuar autorizimet publike dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale të zhvillojnë procedura edhe në gjuhën e tyre; e drejta e shkollimit në gjuhën e vet; e formimit e institucioneve arsimore private; që në gjuhën e vet ta përdorin emrin dhe mbiemrin; që në mjediset ku përbëjnë popullsi të konsiderueshme, emërtimet tradicionale lokale, emrat e rrugëve, të vendbanimeve dhe shenjat topografike të jenë të shkruara edhe në gjuhën e tyre; të drejtën për informim të plotë me kohë dhe të paanshëm në gjuhën e tyre, duke përfshirë edhe të drejtën për shprehjen, marrjen, dërgimin dhe këmbimin e informatave dhe të ideve; të drejtën e themelimit të mjeteve vetjake të informimit publik, në pajtim me ligjin. Në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet përkatëse, mund të themelohen të drejtat shtesë të pjesëtarëve të pakicave kombëtare.
2. E drejta e ruajtjes së veçantive (neni 59), përfshin një varg të drejtash qëllimi i të cilave është që të sigurojnë garanci për ruajtjen e identitetit kombëtar të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në territorin e Kosovës. Kushtetuta takstativisht i përmend të drejtat që kontribuojnë për ruajtjen e veçantive të pjesëtarëve të këtyre pakicave. Kështu, pjesëtarëve të komuniteteve pakicë u garantohet e drejta, individuale apo në kuadër të komunitetit, që ta shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e vet dhe t'i ruajnë elementet themelore të identitetit të vet, përkatësisht religjionin, gjuhën, traditën dhe kulturën (pika 1), si dhe që të fitojnë arsim publik në një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, sipas zgjedhjes së vet në të gjitha nivelet (pika 2).
3. Me qëllim të realizimit të së drejtës së vet të garantuar me Kushtetutë, për ruajtjen e veçantive, pjesëtarëve të komuniteteve pakicë u garantohet marrja e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e vet, në masën që është parashikuar me ligj (pika 3). E drejtë mjaft e rëndësishme e komuniteteve dhe e pjesëtarëve të tyre, pa të cilën nuk ka ruajtje të veçantive të tyre, është mundësia e garantuar me Kushtetutë që lirisht mund ta përdorin gjuhën e tyre, si privatisht, po ashtu edhe

publikisht (pika 5), si dhe që ta përdorin gjuhën dhe shkrimin e vet në raportet me pushtetin komunal apo me zyrat lokale të pushtetit në fushat në të cilat kanë pjesëmarrje të mjaftueshme të popullsisë, në pajtim me ligjin (pika 6). Shpenzimet e shërbimeve të interpretimit apo të përkthimit, i bartin organet kompetente.

4. Veçanërisht është me rëndësi e drejta e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë që emrat personal t'i shkruajnë në formën burimore me shkrim në gjuhën e tyre, që t'i kthejnë emrat burimorë të cilët janë ndryshuar me detyrim (pika 8) dhe t'i përdorin emërtimet lokale, emërtimet e rrugëve dhe të shenjave topografike, të cilat e përmbajnë dhe marrin parasysh karakterin multietnik dhe multigjuhësor të rajonit të caktuar (pika 9). Në kuadër të të drejtave për ruajtjen e veçantive, komuniteteve pakicë u është garantuar e drejta për informim të plotë, me kohë dhe të paanshëm në gjuhën e tyre, u është garantuar qasja dhe përfaqësimi i veçantë në mediet publike (pika 11), si dhe redaktimi i programeve në gjuhën e tyre, në pajtim me dispozitat e caktuara ligjore dhe me standardet ndërkombëtare (pika 10). Këtu, gjithsesi vend mjaft të rëndësishëm zë mundësia e themelimit dhe e shfrytëzimit të medieve të veta, duke përfshirë ofrimin e informatave në gjuhën e vet, ndër të tjera nëpërmjet gazetave ditore dhe shërbimeve kabllore dhe shfrytëzimin e numrit të rezervuar të frekuencave për mediet elektronike dhe e tërë kjo në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare (pika 11). Që t'u mundësohet realizimi i shfrytëzimit të këtyre të drejtave komuniteteve pakicë, Republika e Kosovës është obliguar me Kushtetutë që t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e planit ndërkombëtar të frekuencave, i cili ua mundëson serbëve të Kosovës qasjen në kanalën e licencuar të pavarur në gjuhën serbe në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
5. Të gjitha të drejtat e përmendura në dy pasuset paraprake, kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës dhe përvetësimin e arsimit publik të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, që jetojnë në territorin e Republikës së Kosovës. Mirëpo, për realizimin e të drejtave të ruajtjes së veçantive, është mjaft e rëndësishme të theksohet se, në pajtim me dispozitat ligjore pozitive dhe me standardet e miratuara ndërkombëtare, shteti mund t'u lejojë ndihmë financiare komuniteteve pakicë për themelimin dhe qeverisjen e institucioneve të veta private arsimore për mësim (pika 4). Po ashtu, komuniteteve pakicë dhe pjesëtarëve të tyre me Kushtetutë u është garantuar e drejta që t'i përdorin dhe t'i paraqesin simbolet e komunitetit (pika 7), si dhe që të vendosin kontakte të papengueshme reciproke në Republikën e Kosovës dhe të mbajnë kontakte të lira me personat nga cilido shtet. Pra, duke u nisur nga parimet e ruajtjes së veçantive dhe të identitetit personal, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, veçanërisht e thekson të drejtën e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë për bashkim dhe bashkëpunim me bashkëkombësit e tyre në shtete të tjera, prandaj, për këtë arsye, u garantohet që të mund të formojnë shoqata arsimore dhe kulturore, të cilat i financojnë vullnetarisht.
6. Kështu, me dispozitat kushtetuese, pjesëtarëve të komuniteteve pakicë u garantohet e drejta e kontakteve të papengueshme reciproke në Republikën e Kosovës dhe vendosja e mbajtja e bashkëpunimit të lirë dhe të qetë me personat nga cilido shtet,

e veçanërisht me ata me të cilët kanë identitet të përbashkët etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar apo trashëgimi të përbashkët kulturore, në pajtim me ligjin dhe standardet ndërkombëtare (pika 12). Atyre, po ashtu, u garantohet shfrytëzimi i kontakteve të papengueshme me organizatat joqeveritare lokale, rajonale dhe ndërkombëtare dhe pjesëmarrja pa diskriminim në aktivitetet e tyre (pika 13), kurse për t'i realizuar më lehtë të gjitha këto të drejta, komuniteteve pakicë dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, me Kushtetutë u është garantuar edhe formimi i shoqatave të tyre për kulturë, art, shkencë dhe arsim, si dhe i shoqatave shkollore dhe shoqatave të tjera për shprehjen, kultivimin dhe zhvillimin e identitetit të vet (pika 14).

Neni 60 [Këshilli Konsultativ për Komunitete]

- (1) Një Këshill Konsultativ për Komunitete vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, në të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet.**
- (2) Këshilli Konsultativ për Komunitete përbëhet, përveç të tjerësh, nga përfaqësues të asociacioneve të komuniteteve.**
- (3) Mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete përfshin:**
 - 1. ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës;**
 - 2. mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse;**
 - 3. çdo përgjegjësi a funksion tjetër, në pajtim me ligjin.**

Neni 60

1. Ky nen e përcakton se për funksionimin e Këshillit Konsultativ të Komuniteteve, në të cilin duhet të përfaqësohen të gjitha komunitetet, është kompetent Kryetari i Republikës së Kosovës, domethënë funksionimi i këtij Këshilli bëhet nën përkujdesjen e këtij institucioni më të lartë politik të shtetit. Me dispozitat kushtetuese, po ashtu, është parashikuar edhe që në përbërjen e Këshillit Konsultativ të Komuniteteve hyjnë përfaqësuesit e shoqatave të komuniteteve, të cilat tradicionalisht ekzistojnë në territorin e Republikës së Kosovës. Siç do të flasim dhe shpjegojmë hollësisht kur do të bëhet fjalë për nenin 83 dhe 84 të Kushtetutës i cili e rregullon rolin, pozitën dhe kompetencat e Kryetarit në sistemin kushtetues të Kosovës, arsyeja kryesore që Këshilli Konsultativ i Komuniteteve është në kompetencë të Kryetarit është ajo që Kryetari është personifikim i unitetit kushtetues-juridik i popullit dhe qytetarëve të Kosovës pa marrë parasysh përkatësinë fetare, nacionale gjuhësore etj.
2. Shefi i shtetit në demokracitë kushtetuese duhet t'i përfaqësojë të gjithë qytetarët e Kosovës. Fakti se ky organ qëndron nën mbikëqyrjen e Shefit të Shtetit i shërben

këtij qëllimi, pra ia mundëson shefit të shtetit të Kosovës që në mënyrë simbolike ta personifikojë unitetin kushtetues juridik të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Në fund, vetë Kushtetuta i përcakton edhe kompetencat më të rëndësishme të këtij Këshilli, që kanë të bëjnë me sigurimin e mekanizmave për këmbimin e rregullt të mendimeve në mes të komuniteteve dhe të Qeverisë së Kosovës, ofrimin e mundësive komuniteteve që t'i japin mendimin dhe komentet e veta për nisma të caktuara (para së gjithash, ligdhënese dhe politike) të Qeverisë, mundësimin që qëndrimet dhe propozimet e tyre të bëhen pjesë e projekteve dhe programeve përkatëse etj.

Neni 60.1

1. Për realizimin e të drejtave të komuniteteve pakicë dhe të pjesëtarëve të tyre, që jetjnë në territorin e Kosovës, është shumë i rëndësishëm ekzistimi i institucioneve përkatëse, prandaj në këtë mënyrë, në nenin 60 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është parashikuar formimi i Këshillit Konsultativ të Komuniteteve, i cili funksionon nën përkujdesjen e Kryetarit të Republikës së Kosovës (paragrafi 1).

Neni 60.2

1. Ky Këshill është strukturuar në mënyrë të tillë që në të përfaqësohen komunitetet, me qëllim të realizimit të lirive dhe të të drejtave të pjesëtarëve të tyre (neni 60. paragrafi 2.), si dhe përmirësimin e pjesëmarrjes dhe të konsultimeve të komuniteteve. Me përkrahjen e Qendrës Evropiane për Çështje të Pakicave, Këshilli Konsultativ i ka definuar qëllimet strategjike dhe operative, i ka zhvilluar rregullat e procedurës dhe ka formuar grupe punuese për formim dhe njohje ligjore të komuniteteve. Ky Këshill merret me fusha specifike të interesit të komuniteteve, kurse në nivelin qendror, ai mund ta sigurojë mundësinë për pjesëmarrje të përmirësuar të komuniteteve në jetën publike. Po ashtu, Këshilli Konsultativ duhet ta sigurojë përfaqësimin e komuniteteve pakicë, funksionimin e rregullt, transparencën dhe informimin publik lidhur me aktivitetet e tyre. Për këtë qëllim, është e domosdoshme që të sigurohet harmonizimi dhe koordinimi i aktiviteteve të komuniteteve, ndarja e qartë e përgjegjësisve dhe vendosja transparente.

Neni 60.3

1. Kur është fjala për mandatin e Këshillit Konsultativ të Komuniteteve dhe detyrat e tij më të rëndësishme, duhet theksuar se ai duhet të sigurojë, së pari, mekanizma përkatës për këmbim të rregullt të mendimeve ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (neni 60. paragrafi 3. pika 1.). Roli i këtij Këshilli është veçanërisht i rëndësishëm në ofrimin e mundësisë komuniteteve që në fazë të hershme, do të thotë në fazën fillestare t'i japin komentet e veta për nisma ligdhënese dhe politike, të cilat mund t'i pranojë Qeveria, të japin propozime për nisma të tilla dhe të kërkojnë që qëndrimet e tyre të hyjnë në projekte dhe programe relevante (neni 60. paragrafi 3. pika 2.). Natyrisht, nuk duhet theksuar në mënyrë të veçantë fakti se mandati i këtij Këshilli i përfshin edhe

të gjitha përgjegjësitë dhe funksionet e tjera, në pajtim me ligjin (neni 60. paragrafi 3. pika 2.).

Neni 61 [Përfaqësimi në Punësim në Institucionet Publike]

Komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë për përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë këtu veçanërisht në shërbimin policor në zonat e banuara me komunitetin përkatës, duke respektuar në të njëjtën kohë rregullat që kanë të bëjnë me kompetencën dhe integritetin e qeverisjes së administratës publike.

Neni 61

1. Me qëllim të realizimit të të drejtave të komuniteteve pakicë, pjesëtarët e tyre, në të njëjtat kushte si dhe qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës, kanë të drejtë të marrin pjesë në administrimin e punëve publike dhe të caktohen në funksione publike. Prandaj, me rastin e punësimit në organet shtetërore, shërbimet dhe njësitë publike të vetëqeverisjes lokale, merret parasysh përbërja nacionale e popullsisë dhe e përfaqësimit përkatës të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë. Kështu, sipas dispozitave të nenit 61 të Kushtetutës, komunitetet dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë me rastin e punësimit në organet publike dhe në ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, veçanërisht në shërbimin policor në viset ku jeton komuniteti i caktuar, duke respektuar rregullat në pikëpamje të aftësive dhe të integritetit që zbatohen në administratën publike. Më Kushtetutë, po ashtu, janë përcaktuar dispozitat speciale me të cilat sigurohet përfaqësimi i komuniteteve në institucionet publike. Për disa institucione, siç është shërbimi i institucionit të sigurisë, është e nevojshme një natyrë e theksuar multietnike e Republikës së Kosovës, kurse për shumë institucione të tjera, nevojat minimale për përfaqësim të komuniteteve janë përmendur në mënyrë të veçantë.

Neni 62 [Përfaqësimi në Organet e Pushtetit Lokal]

- (1) Në komunat në të cilat së paku dhjetë për qind (10%) të banorëve u përkasin komuniteteve, të cilat në ato komuna nuk janë shumicë, posti i zëvendëskryetarit për komunitete të kuvendit të komunës do të rezervohet për një përfaqësues nga radhët e këtyre komuniteteve.
- (2) Postin e zëvendëskryetarit do ta mbajë kandidati që i përket popullatës që nuk është shumicë, që ka marrë shumicën e votave në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje për kuvendin e komunës.
- (3) Zëvendëskryetari për komunitetet, do të promovojë dialog ndërmjet komuniteteve dhe shërben si pikë formale e kontaktit për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve që nuk janë shumicë në takimet e kuvendit të komunës dhe në punët e saj. Zëvendëskryetari gjithashtu

është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave që parashtrihen nga komunitetet ose pjesëtarët e tyre, nëse aktet a vendimet e kuvendit të komunës shkelin të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë. Zëvendëskryetari këto çështje i'a referon kuvendit të komunës, për rishqyrtimin e aktit a të vendimit të marrë.

- (4) Në rast se kuvendi i komunës vendos që të mos rishqyrtojë aktin a vendimin e vet, ose nëse zëvendëskryetari vlerëson se, edhe pas rishqyrtimit rezultati përbën shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, ai/ajo mund të parashtrijë çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, e cila mund të vendosë nëse do të pranojë ta shqyrtojë rastin përkatës.**
- (5) Në këto komuna përfaqësimi në organin ekzekutiv për komunitetet që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës është i garantuar.**

Neni 62

1. Ky nen e përcakton rregullën që vendi i nënkryetarit është i rezervuar për komunitetet në ato komuna, në të cilat më së paku 10% të banorëve janë nga radhët e komuniteteve pakicë, në mënyrë që këto komunitet, të cilat në ato komuna nuk përbëjnë shumicë, të kenë përfaqësim përkatës në organet publike dhe lokale. Natyrisht, këtë vend të nënkryetarit e fiton ai kandidat i cili ka marrë më së shumti vota në zgjedhjet për kuvendin e komunës. Roli i nënkryetarit të tillë është mjaft i rëndësishëm për komunitetet, duke pasur parasysh se ai është kompetent për avancimin e dialogut ndërmjet tyre dhe paraqet personin zyrtar që është i autorizuar për zgjidhjen e problemeve të shumta dhe të interesave të komuniteteve (dhe të pjesëtarëve të tyre), të cilat nuk e përbëjnë shumicën. Ai këtë rol të tij e ushtron në mbledhje të kuvendit të komunës dhe në punën e tij të përditshme, ndërsa është përgjegjës edhe për rishqyrtimin e parashtrësive të komuniteteve apo të pjesëtarëve të tyre në rastet kur me akte apo vendime të uvendit të komunës shkelen të drejtat e tyre, të cilat janë të garantuara me Kushtetutë. Roli i tij nuk përfundon këtu, duke pasur parasysh se ai e ka mundësinë që drejtpërsëdrejti t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, nëse kuvendi i komunës nuk e rishqyrton aktin apo vendimin e tij, apo nëse vetë nënkryetari vlerëson se të drejtat e garantuara me Kushtetutë të komuniteteve apo të pjesëtarëve të tyre do të shkelen edhe pas rishqyrtimit.

Neni 62.1

1. Që përfaqësuesit e komuniteteve pakicë të mund t'i realizojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë, është e domosdoshme që t'u sigurohet përfaqësimi përkatës në organet lokale publike. Kështu, në komunat ku më së paku (10%) të banorëve u takojnë komuniteteve pakicë, të cilat në atë komunë nuk përbëjnë shumicën, vendi i nënkryetarit është i rezervuar për një përfaqësues të komunitetit (neni 62. paragrafi 1 i Kushtetutës).

Neni 62.2

1. Ky vend i nënkryetarit, i cili është i rezervuar për një përfaqësues nga radhët e komunitetit pakicë, e cila nuk e përbën shumicën, i takon atij që ka marrë më së shumti vota në listën e hapur të kandidatëve në zgjedhjet për kuvendin e komunës (neni 62. paragrafi 2. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

Neni 62.3

1. Detyra më e rëndësishme e nënkryetarit për komunitete është balancimi i dialogut në mes të komuniteteve dhe zgjidhja e problemeve të komuniteteve të tyre (neni 63. paragrafi 3.). Në vendosjen dhe avancimin e marrëdhënieve të mira në mes të komuniteteve, roli i nënkryetarit të komuniteteve është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse pikërisht ai, sipas detyrës dhe funksionit zyrtar që e ushtron, është personi zyrtar që duhet të merret ekskluzivisht me zgjidhjen e problemeve të komuniteteve pakicë dhe mbrojtjen e interesave të tyre. Mundësinë për zgjidhjen e këtyre problemeve dhe mbrojtjen e interesave të komuniteteve të përmendura, nënkryetari i komuniteteve e ka në mbledhjet e kuvendit të komunës. Po ashtu, ai mundet që këtë funksion të tij ta realizojë edhe në punën e rregullt në kuvendin e komunës jashtë mbledhjeve të tij, si dhe në punën e tij, që ushtrohet pavarësisht nga mbajtja e mbledhjeve zyrtare të kuvendit.
2. Duke pasur parasysh se komunitetet janë pakicë, pjesëtarët e tyre shpeshherë i drejtohen kuvendit të komunës me mjaft parashtrës, kështu që nënkryetari i komuniteteve është përgjegjës për rishqyrtimin e këtyre parashtrësive, nëse me akte apo vendime të caktuara të kuvendit të komunës shkelen të drejtat e garantuara me Kushtetutë të komuniteteve pakicë dhe të pjesëtarëve të tyre. Prandaj, roli i nënkryetarit në këtë procedurë është mjaft i rëndësishëm, sepse ai ka mundësi, në saj të funksionit në të cilin gjendet, që kuvendit të komunës t'ia dërgojë çështjet e tilla kontestuese, për rishqyrtim dhe miratim të zgjidhjeve përkatëse, të cilat do t'i përmbushin nevojat dhe interesat e komuniteteve pakicë dhe të pjesëtarëve të tyre.

Neni 62.4

1. Ndërkaq, mund të ndodhë që kuvendi i komunës të vendos të mos e rishqyrtojë aktin e vet apo ndonjë vendim të vetin të marrë më përpara. Po ashtu, mund të ndodhë që nënkryetari për komunitet të konsiderojë se rezultati, pas rishqyrtimit të aktit apo të vendimit të caktuar nga ana e kuvendit të komunës, edhe më tutje paraqet shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë të komuniteteve pakicë dhe të pjesëtarëve të tyre. Në raste të tilla, nënkryetari i komuniteteve mund të paraqesë kërkesë për zgjidhje të atyre çështjeve kontestuese drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kjo Gjykatë mund të marrë vendim se a do ta pranojë lëndën e tillë për rishqyrtim.

2. Deri më tash Gjykata ka pasur rast ta shqyrtojë një rast mjaft të rëndësishëm i cili është iniciuar në bazë të paragrafit 4. të nenit 62. Në publik është i njohur si “rasti i Stemës së Qytetit të Prizrenit”.²⁴⁰ Në këtë rast nënkryetari i komuniteteve i qytetit të Prizrenit ka iniciuar kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtij vendimi të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, me të cilin është miratuar neni 7. i Statutit të Komunës së Prizrenit dhe i cili ka parashikuar që stema e këtij qyteti të jetë vetëm në gjuhën shqipe, që si shenjë ta ketë Shtëpinë e Lidhjes së Prizrenit të vitit “1978”, do të thotë vitin kur është mbajtur Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Kjo kërkesë ka pasur të bëjë me atë, siç është cekur nga ana e nënkryetarit, Qemajl Kurtishi, që stema, si e tillë, e ka përfaqësuar vetëm komunitetin shqiptare shumicë, përkundër kundërshtimit nga të gjitha komunitetet joshqiptare me rastin e miratimit të Statutit, më 11 shtator 2008. Me atë akt Kuvendi i Komunës e ka shkelur dispozitën kushtetuese për barazi të të gjitha komuniteteve, prandaj është dashur që Kuvendi i Komunës ta harmonizojë nenin 7 të Statutit të me Kushtetutën e Kosovës, gjë që më vonë edhe është bërë.
3. Edhe një formë nëpërmjet së cilës Kushtetuta i mbron të drejtat dhe interesat e komuniteteve është nëpërmjet sistemit të decentralizimit, nëpërmjet të cilit komuniteteve u është garantuar autonomi e gjerë në nivel lokal, veçanërisht në viset ku komunitetet e përbëjnë shumicën e popullsisë. Në Kosovë termi “decentralizim” shfrytëzohet në dy mënyra të ndryshme. E para, ai në kuptim të gjerë ka të bëjë me bartje të autorizimeve ekzekutive nga organet qendrore në organet komunale të pushtetit. E dyta, termi po ashtu ka të bëjë me procesin e definimit të kufijve territoriale të atyre komunave. Ekzistojnë dy pjesë esenciale të ligdhënies me të cilat administrohet decentralizimi në Kosovë: e para, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, me të cilin krijohet baza ligjore për vetëqeverisje të qëndrueshme lokale në nivel komunal; e dyta, Ligji për Kufijtë Administrativë Komunalë, që rregullon organizimin territorial të vetëqeverisjes lokale dhe i cakton kufijtë territorial të komunave.
4. Republika e Kosovës ka dispozita ligjore ekstensive lidhur me çështjen e mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve. Një nga ligjet më të rëndësishme për këtë çështje është Ligji për Avancimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Komuniteteve dhe të Anëtarëve të tyre në Kosovë. Ndërkaq, përkundër dispozitave të avancuara ligjore, komunitetet pakicë në Kosovë edhe më tutje ballafaqohen me probleme serioze, nga të cilat shumica është e lidhur ngushtë me mungesën e qasjes së mjaftueshme në shërbimet publike dhe mundësitë për punë. Institucionet politike dhe publike të Kosovës kanë mandat për ta siguruar përfaqësimin e komuniteteve pakicë. Prandaj, ekziston edhe nevoja e madhe që mekanizmat ekzistues të zbatohen dhe të gjenden mënyra shtesë për realizimin e përfshirjes më të madhe të komuniteteve.
5. Derisa anëtarët e komunitetit pakicë në nivel komunal janë tepër të përfaqësuar në pozicionet që i kushtohen kthimit dhe komuniteteve, ata janë pak të përfaqësuar në

²⁴⁰ Shih veçanërisht paragrafët 26-56 të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 18 mars 2010, në rastin KO01/09. Paraqitës i kërkesës, Qemajl Kurtishi kundër Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

të gjithë sektorët e tjerë. Gratë nga komunitetet pakicë janë shumë pak të pranishme në shërbimin civil, veçanërisht në pozita të larta. Qasja në administratë për anëtarët e komuniteteve pakicë është përmirësuar, pjesërisht për shkak të avancimit dhe të përmirësimit të situatës së sigurisë, si dhe për shkak të presionit në administratën komunale.

Neni 62.5

1. Ajo që është mjaft e rëndësishme të theksohet, por që është zbatuar edhe te formimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës, është fakti se komuniteteve, të cilat nuk përbëjnë shumicë në Republikën e Kosovës, u garantohet përfaqësimi në organet ekzekutive të komunave (neni 62. paragrafi 5.). Kjo zgjidhje shumë shpesh haset në praktikën e kushtetutshmërisë krahasimore të vendeve të tjera, të cilat kanë karakter multietnik dhe multigjuhësor.

Kapitulli IV: Kuvendi i Republikës së Kosovës

Shqyrtime hyrëse

1. Sipas ndarjes organike të pushtetit, Kuvendi (Parlamenti) është organ që miraton ligje (organ ligjdhënës). Emërtimi i institucionit vjen nga fjala latine *parlare - për të folur*, prandaj, nga kjo, sipas përmbajtjes themelore të punës së vet, Parlamenti në të vërtetë është “një diskutim i organizuar”, vend dhe institucion ku zhvillohet biseda. Ajo që është me rëndësi të thuhet, është se ky është një bashkim i mbledhur sipas një rendi të caktuar dhe në mënyrë të organizuar (dhe jo i pakontrolluar dhe i rastësishëm), ku flitet dhe bisedohet.
2. Prejardhjen e Kuvendit (Parlamentit)²⁴¹ e hasim, para shumë shekujsh, në kërkesën e fisnikëve që edhe ata të marrin pjesë në caktimin e tatimit, prandaj në këtë mënyrë Kuvendi është krijuar për arsye të kufizimit të të drejtave fiskale të monarkëve. Pikërisht këtu qëndron rrënja e idesë së përfaqësimit, si formë fillestare e së cilës kanë qenë kuvendet e kategorizuara, funksioni themelor i të cilave ka qenë financiar. Më vonë, këto kuvende e kanë marrë edhe funksionin e gjykatës, ndërsa në fund edhe funksionin më të rëndësishëm-ligjdhënës.²⁴² Kjo ide për herë të parë është formësuar në pikëpamje të Kushtetutës në Kushtetutën e SHBA-ve të vitit 1787, ndërsa më vonë në Deklaratën e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit të vitit 1789 dhe në Kushtetutën e Francës të vitit 1791. Sot legjislacioni konsiderohet më i rëndësishmi, si veçori ekskluzive në kompetencë të Kuvendit, edhe pse Kuvendi nuk e ushtron *tërë* pushtetin legjislativ në vend, as është kompetencë e tij *vetëm* pushteti legjislativ në vend. Prandaj më e sakta do të ishte që të thuhet se Kuvendi jep vetëm fjalën e fundit për ligjin dhe që pushteti ligjdhënës i Kuvendit e ka kufirin e vet të epërm e të poshtëm -kufiri i epërm është tërhequr në dobi të Kushtetutës, ndërsa kufiri i poshtëm në dobi të dekretit. Pushteti ligjdhënës i Kuvendit (Parlamentit), do të thotë se ai është organ i shtetit, i cili i miraton dispozitat burimore dhe në mënyrë origjinare i rregullon marrëdhëniet shoqërore.

²⁴¹ Institucioni i parë në procesin e konstituimit të parlamentarizmit është vet Parlamenti, i cili krijohet me zgjerimin e Këshillit mbretëror me përfaqësuesit e kategorive të lira dhe me stabilizimin e funksionit përfaqësues në Këshillin (shoqëror) e zgjeruar të mbretit, i cili më vonë bëhet organ shoqëror përfaqësues i përgjithshëm.

²⁴² Më shumë si kurreshtje historike, sesa për rolin që e ka luajtur në formimin e Parlamentit si organ ligjdhënës, përmendet fakti se Parlamenti më i vjetër në botë, është ai që ekziston në Islandë, pandërprerë që nga viti 930. Fillimi i Parlamentit në Angli ka qenë Këshilli i madh (*magnum concilium*), i cili është shndërruar në Parlament model (Model Parliament), i mbledhur më 1295. Në Francë kuvendet e kategorizuara kanë qenë të shpërbëra më 1614, në mënyrë që Luigji XVI përsëri t'i mbledh vetëm pas 175 vjetësh, më 1789, kur ka shpërthyer Revolucioni i njohur Francez. Teoria për Parlamentin si organ ligjdhënës ka lindur në shekullin XVIII, ndërsa krijues i saj ka qenë Monteskje (vepra e tij e njohur “fryma e ligjit” e vitit 1748). Vetëm atëherë Parlamenti, në vend të funksionit ekskluziv financiar dhe gjyqësor, e ka marrë edhe ushtrimin e funksionit ligjdhënës.

3. Në nocionin e këtij pushtetit përfshihet edhe pushteti kushtetues, i cili, në shumicën e shteteve, në tërësi apo pjesërisht është në kompetencë të Parlamentit. Kjo është kështu për shkak se Kushtetuta, në kuptimin material, nuk është asgjë tjetër pos ligj themelor i vendit,²⁴³ ndërsa sa është funksioni ligjdhënës dominues në kompetencat e Kuvendit (Parlamentit), më së miri shihet me atë që në disa shtete emërtimi për këtë institucion, në tërësi apo për një nga dhomat e tij, është organ ligjdhënës.²⁴⁴ Kështu, Parlamenti gjatë kalimit të kohës, ngadalë por në mënyrë të sigurt, “e ka fituar” të drejtën që të miratojë ligje në të gjitha fushat.
4. Ndërkaq, ajo që është karakteristikë për sistemet kushtetuese bashkëkohore, është fakti se roli i Parlamentit dobësohet në jetën kushtetuese të vendit dhe kjo shprehet në ngushtimin e (diku, gati në zhdukje) funksionit ligjdhënës të Parlamentit.²⁴⁵ Kësaj veçanërisht i kontribuon forcimi i rolit të ekzekutivit dhe kontaktet gjithnjë e më të drejtpërdrejta që vendosen ndërmjet pushtetit dhe qytetarëve, por ideja se Kuvendi është institucion që i realizon të drejtat e njeriut, ende nuk është vënë në pikëpyetje, prandaj ai edhe sot është institucion pa të cilin nuk mund të paramendohet shoqëria demokratike. Kuvendi është organi më i kualifikuar për zhvillimin e debatit për qëndrimet dhe aktet e pushtetit, sepse në të bashkohen kërkesat e grupeve më të ndryshme shoqërore në vend. Kështu, funksionit ligjdhënës të Kuvendit i takon *funkzioni i saj i miratimit të buxhetit dhe të llogarisë përfundimtare* (buxheti është ligj specifik financiar, i cili edhe miratohet si “ligji për buxhetin”), si dhe *ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare*, të cilat i lidhin qeveritë apo shefat e shteteve (Kuvendi këtë e bën në formë të ligjit).
5. Kuvendit (Parlamentit), si përfaqësues popullor, i takojnë edhe disa kompetenca të cilat, si edhe funksioni ligjdhënës, janë të lidhura ngushtë me sovranitetin. *Këto kompetenca kanë të bëjnë me vendosjen për luftën dhe paqen dhe shpalljen e referendumit*. Në shtetet me sistem parlamentar apo kuvendar të pushtetit, këtij institucioni i takon edhe një funksion i rëndësishëm - *kontrolli i punës së pushtetit ekzekutiv*, para së gjithash i punës së qeverisë (në sistemet e tilla të pushtetit, Parlamenti “e formon dhe e heq Qeverinë, e zgjedh dhe e shkarkon”).²⁴⁶ Funksionin e kontrollit politik të punës së Qeverisë, disa autorë bashkëkohorë e shohin si funksion të Parlamentit, që ka të bëjë me përgatitjen eventuale të ndërrimit të ekipit qeveritar aktual. Po ashtu, gjithkund në botë, kuvendet kanë

²⁴³ Kjo është plotësisht e vërtetë, sepse edhe vetë Kushtetuta është një lloj ligji, por më i larti, më i rëndësishmi, më i forti, ligji themelor i një vendi. Kështu që diku quhet, për shembull, në Gjermani “Ligji Themelor” (*Grundgesetz*).

²⁴⁴ Kështu, në Kushtetutën e Francës së vitit 1793, organi përfaqësues njëdhomësh është quajtur organi ligjdhënës, por edhe sot në shumë institucione të botës Parlamenti definohet nëpërmjet funksionit ligjdhënës, si pushtet ligjdhënës.

²⁴⁵ Më shumë për këtë krahaso: Bradshaw, K., and Pring, D., (1972), ‘*Parliament and Congress*’, Quartet Books: London.

²⁴⁶ Si institut i kontrollit parlamentar, më së shpeshti përmendet pyetja e deputetit, e cila, së pari është paraqitur në Angli dhe kuptimi i së cilës veçanërisht është rritur në parlamentarizmin anglez gjatë shekullit XIX. Pastaj, këtu hyn edhe interpelanca, e paraqitur në Francë, me vendimin Konstituante të vitit 1791. Po ashtu, nga mjetet për fillimin e përgjegjësisë politike të Qeverisë, si mjet klasik i parlamentarizmit është propozimi për votim të mosbesimit të qeverisë.

edhe *funkcion zgjedhor* të rëndësishëm, i cili varet nga sistemi i pranuar me Kushtetutë të pushtetit, në atë vështrim, që ai më gjen shprehje në sistemin parlamentar dhe kuvendar, sesa në sistemin presidencial.²⁴⁷

6. Në fund, në një numër të shteteve, Kuvendi është edhe organ kuazi-gjyqësor, i cili ushtron *autorizime kuazi-gjyqësore* (fjala është për autorizimet që ky institucion t'i gjykojë bartësit e pushtetit ekzekutiv-kryetarin e Republikës dhe anëtarët e Qeverisë). Përveç funksionit të Kuvendit (Parlamentit), për pozitën kushtetuese të këtij institucioni, me rëndësi të veçantë është edhe struktura e tij, e cila varet nga ajo se a kuptohet trupi zgjedhor si një bashkim i zgjedhësve me të drejtat e barabarta (i qytetarëve, si bartës me të drejtë të barabartë të votimit) apo si bashkim i qytetarëve të ndryshëm ndërmjet vete (varësisht nga përkatësia njësive të ndryshme territoriale, shtresave shoqërore, profesioneve etj.). Prandaj janë të mundshme dy zgjidhje: e para, që Parlamenti të jetë organ njëdhomësh (i përbërë nga një dhomë) dhe e dyta, që Parlamenti të jetë organ dydhomësh, (i përbërë nga dy dhoma). Është rregull që Parlamenti të jetë i përbërë nga një dhomë, ndërsa shumë të rralla janë rastet e parlamenteve me më shumë dhoma, ndoshta në historinë e afërt apo të largët ka pasur shembuj të njohur të organeve të tilla përfaqësuese. Sot ky është rast mjaft i rrallë, sepse konsiderohet se Parlamenti njëdhomësh është më shumë në harmoni me parimin e sovranitetit popullor. Përfaqësimi njëdhomësh del nga teoria për popullin sovran, dëshira e të cilit është një dhe e pandashme. Do të thotë, sovraniteti popullor nuk duron asnjë ndarje, sepse edhe populli është një, prandaj, përfaqësimi i tij duhet të jetë një.²⁴⁸ Kur është fjala për Kuvendin e Republikës së Kosovës, do ta theksojmë faktin se këtij Kuvendi i është kushtuar kapitulli IV, i cili në vete i ka 20 nene, ndërsa secili nen e ka institutin e vet.

Neni 63 [Parimet e Përgjithshme]

Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli.

Neni 63

1. Pozicionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës në sistemin juridik e përcakton dispozita kushtetuese, sipas së cilës ai është organi më i lartë përfaqësues dhe institucioni më i lartë ligjdhënës i Republikës së Kosovës (neni 63). Si institucioni i

²⁴⁷ Kjo është për arsye se në sistemin parlamentar dhe kuvendar të Parlamentit, kryesisht, zgjidhen bartësit e pushtetit ekzekutiv (shefi i shtetit, qeveria etj.), ndërsa në sistemin presidencial ekziston ndarja e rreptë e pushtetit, prandaj në këtë mënyrë bie mundësia që bartësin e pushtetit ekzekutiv ta zgjedhë Parlamenti.

²⁴⁸ Dy dhoma janë justifikuar që nga koha e Revolucionit Francez. Sipas kësaj pikëpamjeje, një dhomë është imagjinatë, ndërsa e dyta arsye. Dhoma e dytë shpeshherë krahasohet me mbrojtje apo fre, qëllimi i së cilës është që ta ndalojë vërsuljen popullore, që gjen shprehje në dhomën që është zgjedhur drejtpërsëdrejti nga ana e qytetarëve.

cili drejtpërsëdrejti e shpreh sovranitetin e qytetarëve (neni 2. paragrafi 1.). Ai e ka në duart e veta pushtetin e krijimit të Kushtetutës dhe të ligjeve (neni 65. pika 1.), sepse ai është organ i pushtetit, i cili e shpreh sovranitetin e popullit dhe i cili është i zgjedhur drejtpërsëdrejti nga ana e popullit në zgjedhjet e drejtpërdrejta, me votim të fshehtë (neni 63. dhe neni 66.). Në kuadër të Kuvendit të Kosovës, sipas dispozitës së veçantë të Kushtetutës, sigurohet përfaqësimi i barabartë i gjinive (neni 7. paragrafi 2. dhe neni 71. paragrafi 2.), si dhe përfaqësimi përkatës i komuniteteve dhe i pjesëtarëve të tyre (neni 64. paragrafi 2.). Si i tillë, Kuvendi e përfaqëson popullin e Republikës së Kosovës. Anëtarët e Kuvendit të Republikës së Kosovës quhen kuvendarë, por deputetët e Kuvendit (në disa parlamente quhen deputetë popullorë, sepse i zgjedh populli).

2. Pra, deputetët janë persona të cilët populli i ka *dërguar (deleguar)* që, në vend të tij dhe në emër të tij, t'i kryejnë punët shtetërore. Do të thotë, pasi që nuk është e mundur që tërë populli të mblidhet në një vend dhe të vendosë për punët shtetërore, është e nevojshme që të caktohen personat që do ta kenë besimin e popullit dhe që me autoritet do të mund ta përfaqësojnë dhe ta paraqesin. Në shtetet e sotme të tipit demokratik thuhet se populli qeveris, se ai është burim dhe bartës i të gjitha pushteteve, por në rend të parë i pushtetit ligjdhënës, si pushteti më i lartë. Mirëpo, populli nuk mund të qeveris drejtpërsëdrejti, por tërthorazi, sepse shteti i sotëm, i madh për nga vëllimi (territori, popullsia etj.), mund ta organizojë vetëm demokracinë e tërthortë apo përfaqësuese.²⁴⁹ Populli *i dërgon dhe i autorizon* personat e *besueshëm* që në vend të tij të marrin pjesë në miratimin e akteve më të larta shtetërore, që ta *përfaqësojnë dhe paraqesin* në funksionet publike (prandaj shpeshherë përdoren shprehjet si sinonime-deputeti popullor, avokati popullor, përfaqësuesi popullor, i besuari popullor).
3. Pasi që populli nuk mund të marrë pjesë vet në drejtimin e vendit, atëherë duhet të jetë i sigurt që personat që e përfaqësojnë e kanë, me të vërtetë, besimin e tij të sinqertë. Ky është një parim i cili është miratuar çdo kund. Por, si të realizohet? Besimi tregohet me zgjedhje të veçantë. Personat që konsiderojnë se e kanë merituar besimin e popullit, e kërkojnë atë nga populli, kurse ky kërkim i besimit bëhet nëpërmjet kandidimit, ndërsa vetë besimi, megjithatë, tregohet me zgjedhjen. Që ky besim të mos jetë i dyshimtë, zgjedhjet duhen organizuar në atë mënyrë që ato, realisht, ta tregojnë rezultatin më të saktë dhe vullnetin real të popullit. Zgjedhjet, para së gjithash, duhet të jenë të lira, e pastaj edhe që e drejta e zgjedhjes të jetë e përgjithshme, e barabartë e drejtpërdrejtë dhe e fshehtë.

²⁴⁹ Për këtë të shihet më gjerësisht: Hirst, P., (1990), 'Representative Democracy and its Limits', Cambridge University Press: Cambridge.

Neni 64 [Struktura e Kuvendit]

- (1) Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin.
- (2) Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovës, si vijon:
 1. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);
 2. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti Rom një (1) vend; komuniteti Ashkali një (1) vend; komuniteti Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali, ose Egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti Boshnjak tri (3) vende, komuniteti Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

Neni 64

1. Siç kemi theksuar në pjesën hyrëse të komentimit kushtuar Kapitullit IV, sipas strukturës së vet, pavarësisht nga sistemi i pushtetit, Kuvendi mund të jetë organ përfaqësues njëdhomësh (monokameral) apo dydhomësh (bikameral). Në rastin e parë, Parlamenti është unik, ndërsa në të dytin përfaqësimi popullor është i ndarë në dy pjesë te veçanta, të cilat mund të kenë, (por më së shpeshti nuk kanë) kompetencë të barabartë. Sigurisht, Kuvendi mund t'i ketë edhe më shumë se dy dhoma. Kështu, më parë kanë ekzistuar edhe kuvende me 3, 4 madje edhe me 5 dhoma, por sot, në numrin më të madh të vendeve, kuvendet janë me një apo dy dhoma, por që Kuvendi me një dhomë është rregull (dhe, prandaj rast shumë i shpeshtë), ndërsa Kuvendi me dy dhoma është përjashtim (dhe, prandaj, rast shumë më i rrallë).
2. Pra, siç kemi parë, në pjesën e teorisë konsiderohet se vetëm Parlamenti njëdhomësh është në harmoni me parimin e sovranitetit popullor, ndërsa pikënisja për këtë është mosndarja e vullnetit të popullit sovran, e cila mund të jetë vetëm një. Kjo do të thotë se populli nuk mundet që njëkohësisht të përfaqësohet dy herë në mënyra të ndryshme - drejtpërsëdrejti dhe tërthorazi, prandaj ekzistimi i dy dhomave, për këtë arsye do të nënkuptonte kundërvënie ndaj sovranitetit unik dhe

të pandashëm të popullit. Në favor të strukturës parlamentare njëdhomëshe, përmenden edhe arsyet e zbatimit praktik, para së gjithash, vendimi efikas për shkak të procedurës më të thjeshtë dhe relativisht më të shpejtë ligjore. Aq më tepër, vetëm dyfishohet ushtrimi i detyrave shtetërore, rritet dukshëm numri i nëpunësve, e në këtë mënyrë edhe shpenzimi i panevojshëm i mjeteve shtetërore. Me ekzistimin e dhomës së dytë, pa nevojë, vetëm ngadalësohet puna ligjdhënëse (edhe pse ajo, në atë rast, është më cilësore, para së gjithash, sepse nga dhoma e dytë pritet që t'i përmirësojë gabimet e dhomës së parë).

3. Kur është fjala për numrin e deputetëve, do të thotë të anëtarëve të Kuvendit si organ përfaqësues, dallimet midis shteteve janë jashtëzakonisht të mëdha. Numri i parlamentarëve varet, para së gjithash, nga numri i banorëve të shtetit, por ndonjëherë edhe arsyet e tjera mund të jenë vendimtare. Ky numër mund të jetë edhe i pandryshueshëm, pra i përcaktuar me Kushtetutë (i ashtuquajtur *numerus clausus*), por mund të jetë edhe i pacaktuar, kur në numrin e caktuar të zgjedhësve ndahet një mandat parlamentar. Është logjike se Parlamenti i shteteve me popullsi të madhe ka edhe numër më të madh të deputetëve, sesa Parlamenti i shteteve me numër të vogël të banorëve. Po ashtu, është rregull që edhe dhoma e parë të ketë numër më të madh të anëtarëve nga dhoma e dytë, megjithëse edhe këtu ka përjashtime.²⁵⁰ Përveç numrit të qytetarëve, përkatësisht të zgjedhësve, në numrin e anëtarëve të Parlamentit ndikojnë edhe arsye të tjera, para së gjithash, tradita demokratike, gjendja ekonomike e shtetit, kushtet gjeografike, situata politike në vend, struktura etnike, llojllojshmëria gjuhësore, komunitetet religjioze, struktura partiake, niveli kulturor, si dhe mundësitë optimale të Parlamentit për marrje të vendimeve.
4. Duke pasur parasysh tërë këtë, hartuesit e Kushtetutës gjatë shkrimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kanë konsideruar se Kuvendi i Repub likës së Kosovës duhet të jetë njëdhomësh, kështu që ai i ka 120 deputetë. Zgjedhja e tyre bazohet në parimet e drejtpërdrejtshmërisë së zgjedhjeve dhe në fshehtësinë e votimit (neni 64. paragrafi 1.) ndërsa zgjedhjet për deputetë të Kuvendit i rregullon Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (i miratuar në Kuvend, më 05 qershor 2008, ndërsa i shpallur me Dekretin e Kryetarit nr. DL-027-2008, më 15 qershor 2008). Qëllimi i miratimit të këtij ligji është rregullimi i: 1) sistemit zgjedhor për zgjedhje të Kuvendit të Republikës së Kosovës; 2) financimi dhe mbajtja e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës; 3) njohja dhe mbrojtja e së drejtës së votimit dhe e kushteve të votimit; 4) mbajtja dhe sigurimi i rregullsisë së listave zgjedhore; 5) rigjenerimi i partive politike dhe certifikimi i subjekteve politike e të tjera. Ajo që është karakteristikë për Kuvendin e Republikës së Kosovës, është se vendet e deputetëve (mandatet) janë të ndara ndërmjet të gjitha partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur sipas numrit proporcional të votave të vlefshme, të marra në zgjedhjet për Kuvend.

²⁵⁰ Sipas Kushtetutës së Holandës së vitit 1983, Dhoma e Parë e Parlamentit i ka gjithsej 75 anëtarë, ndërsa e dyta 150 anëtarë, por ky shtet, në të vërtetë nuk është përjashtim i vërtetë, sepse në të, si Dhomë e Dytë është emërtuar ajo dhomë, që në shtetet e tjera quhet Dhomë e Parë.

5. Kur është fjala për numrin e anëtarëve të Kuvendit (Parlamentit), duhet thënë se në këtë organ përfaqësues nuk mund të përfaqësohen të gjitha grupet dhe komunitetet, por sigurisht shteti më i vogël social dhe homogjen do të ketë parlament më të vogël në krahasim me shtetin më të madh social homogjen. Kështu, për shembull, dhomën e parë më të vogël e ka Lihtenshtajni me 15 anëtarë, ndërsa më i madhi Kongresi Kombëtar Kinez me 2978 anëtarë. Senatin më të vogël e ka Bahami - gjithsej 16 anëtarë, ndërsa dhomën e dytë më të madhe, Dhomën e Lordëve e ka Britania e madhe-1183 anëtarë. Dhoma përfaqësuese e Kongresit Amerikan (dhoma e parë, dhoma e ulët) i ka 435 anëtarë ndërsa Senati (dhoma e dytë, dhoma e ulët) i ka 107 anëtarë, Bundestagu gjerman²⁵¹ i ka 656 anëtarë ndërsa Bundersrati 69, ndërsa Nationalrat në Austri i ka 183, kurse Bundersrati 64 anëtarë, Duma ruse 450 kurse Këshilli i Federatës 178 deputetë. Ekzistojnë parlamente që nuk kanë numër të caktuar të anëtarëve.
6. Në disa shtete numri i parlamentarëve ndryshon në çdo legjislacion, përkatësisht pas së cilave zgjedhjet e përgjithshme kështu që me Kushtetutë përcaktohet se mandati i deputetit do të fitohet me numrin e caktuar të zgjedhësve apo numrin e caktuar të votave. Në disa kushtetuta i lihet ligjit që ta caktojë numrin e deputetëve, por Kushtetuta e përcakton numrin maksimal dhe minimal të deputetëve. Kështu, sipas Kushtetutës së Spanjës, Kongresi i Deputetëve, si dhomë e parë i ka së paku 300 e më së shumti 400 anëtarë. Kushtetuta e Greqisë, po ashtu, ia lë ligjit caktimin e numrit të deputetëve i cili, ndërkaq nuk mund të jetë më i vogël se 200, as më i madh se 300 deputetë.

Neni 64.1

1. Siç kemi theksuar në fillimin të komentimit të këtij neni, Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka 120 deputetë, që do të thotë se numri i përfaqësuesve popullorë në Parlament është fiks, i caktuar që më parë dhe kjo është rregulluar me dispozitën kushtetuese të nenit 64. paragrafi 1. Ndërkaq, në kuadër të ndarjes së vendeve të deputetëve në Kuvend, në mes të partive, koalicioneve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, njëzet (20) vende janë garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve, të cilat nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 64.2

1. Në kuadër të kësaj, me përcaktim kushtetues, të numrit prej 20 vendesh të deputetëve, të rezervuara për përfaqësuesit e komuniteteve pakicë në Kosovë, është bërë ndarja përkatëse (neni 64. paragrafi 2. pika 1.). Kështu, partitë e përmendura, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur, që janë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin serb e kanë numrin e përgjithshëm të vendeve në Kuvend që e kanë marrë në zgjedhje të hapura. Ndërkaq, nëse numri i vendeve të fituara është më pak se 10, atëherë ata i kanë më së paku 10 vende të garantuara. Kjo vlen po ashtu edhe për pjesëmarrësit e përmendur të zgjedhjeve, të cilët janë

²⁵¹ Të shihet më shumë për këtë në: Schick, R and Zeh, W., (1999), 'The German Bundestag - Functions and Procedures', Neue Darmstadter Verlagstalt, Rheinbreitbach: Berlin.

deklaruar se i përfaqësojnë komunitetet e tjera në Kuvend. Pra, edhe ata do ta kenë numrin e përgjithshëm të vendeve që i kanë fituar në zgjedhjet e hapura, por nëse numri i votave të fituara të çdo komuniteti është më i vogël se numri i vendeve të garantuara, atëherë ata do ta kenë numrin minimal të vendeve të garantuara, sipas radhitjes së caktuar me vetë Kushtetutën. Kështu komunitetet e romëve, ashkalinjëve, egjiptianëve, do të kenë nga një (1) vend, por që një (1) vend shtesë do t'i ndahet atij komuniteti që do të marrë më së shumti vota, ndërsa komunitetit të goranëve, po ashtu, do t'i ndahet një (1) vend. Pesë (5) vendet e mbetura në Kuvend do të ndahen në mes të komunitetit të boshnjakëve-tri (3) dhe komunitetit të turqve-dy (2).

2. Siç mund të konkludohet nga kjo që u tha, dispozitat e përmendura kushtetuese kanë për qëllim që, duke e njohur situatën demografike në Kosovë dhe strukturën e popullsisë që jeton në këtë territor, do t'u mundësojnë të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, pjesëmarrje proporcionale në popullatën e përgjithshme, të marrjes së vendeve të deputetëve në Kuvend, sipas rezultateve të fituara në zgjedhje. Ndërkaq, për shkak të pjesëmarrjes së tyre jo aq të madhe në trupin zgjedhor, të mos themi, në disa raste edhe të ndikimit të papërfillshëm në zgjedhje dhe në rezultatet e zgjedhjeve, me dispozita kushtetuese është garantuar pjesëmarrja e përfaqësuesve të këtyre komuniteteve në jetën parlamentare të Kosovës, duke ua mundësuar së paku një apo më shumë vende të deputetëve në Kuvend. Kjo është bërë për arsye që përfaqësuesit e këtyre komuniteteve, jo shumë të mëdha, të mund t'i përfaqësojnë interesat e bashkëkombësve të tyre, do të thotë të komuniteteve, sepse ata mund ta bëjnë këtë më së miri në Parlamentin republikan, duke pasur parasysh se shumë më mirë e njohin problematikën e komunitetit, pjesëtarë të së cilës janë edhe ata vetë.

Neni 65 [Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

- (1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme;
- (2) vendos të ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë;
- (3) shpall referendum, në pajtim me ligjin;
- (4) ratifikon traktatet ndërkombëtare;
- (5) miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës;
- (6) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit;
- (7) zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (8) zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin ndaj saj;
- (9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit;

- (10) zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë;**
- (11) propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese;**
- (12) mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë;**
- (13) jep pëlqimin për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme;**
- (14) vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.**

Neni 65

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës është institucion qendror përfaqësues i sistemit kushtetues të Kosovës. Si përfaqësues kolektiv i vullnetit të popullit, ai në sistemin parlamentar të qeverisjes duhet të konsiderohet, ndërsa edhe më shumë të konfirmohet praktikisht, si strumbullar i pushtetit dhe i vendosjes politike. Në sistemin delegates-kuvendar të pushtetit, ai nominalisht ka pasur më shumë funksione, por, faktikisht, roli i tij ka qenë i reduktuar vetëm në konfirmimin e thjeshtë të vendimeve, të marra që më parë, të partisë komuniste. Kuptimi i vërtetë i përfaqësimit popullor, ndërkaq është konstituimi i procesit të lirë politik të bazuar në subjektivitetin e barabartë politik, barazinë politike dhe juridike të qytetarëve dhe në garën e barabartë politike të partive politike.
2. Nëpërmjet iniciativës së përfaqësimit popullor do të duhej të shprehej legjitimiteti, kontrolli vendimtar i funksionit të komunitetit, i cili në këtë mënyrë fiton karakteristikat e komunitetit demokratik, të hapur dhe të lirë. Me rolin real dhe jo vetëm nominal të Kuvendit, vendoset vazhdimësia mbipersonale e pushtetit, vendosja racionale dhe demokratike, kufizimi kohor dhe funksional i pushtetit, por edhe kontrolli efektiv i përgjegjësisë së bartësve të pushtetit publik. Prandaj përfaqësimi popullor është forma më e rëndësishme e realizimit të sovranitetit të qytetarëve.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës i ushtron të gjitha funksionet të cilat, tradicionalisht, konsiderohen “e drejtë bashkëkohore e Parlamentit”. Disa prej tyre, për shembull, funksionin kushtetues, ai nuk e realizon në masë të plotë. Në ushtrimin e funksioneve të veta ai, megjithatë, duhet të mbetet në suazat që ia ka vënë Kushtetuta, duke ia përcaktuar kompetencat. Prandaj, regjimi i pushtetit kushtetues kërkon që institucioni qendror përfaqësues të jetë i lidhur me aktin më të lartë të përgjithshëm të shtetit (Kushtetutën), përkatësisht që të jetë i lidhur me parimet e kushtetutshmërisë. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, parimi i ndarjes së pushtetit, pushteti i së drejtës, si dhe parimet e tjera kushtetuese të Kushtetutës, për Kuvendin e Republikës së Kosovës paraqesin kufij të veçantë, të cilin ai nuk bën ta kalojë. Kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve që i ka miratuar Kuvendi e ushtron Gjykata Kushtetuese.
4. Grupi i parë dhe më i rëndësishëm të cilin, në kuadër të kompetencave të veta e ushtron Kuvendi i Republikës së Kosovës, është kompetenca e tij normative, sepse, ai, si organ qendror përfaqësues dhe si organi më i lartë ligjdhënës, e krijon të drejtën. Ai është bartës i pushtetit kushtetues dhe ligjor dhe në këtë cilësi, e ushtron

funkcionin e vet kushtetues, në atë mënyrë që vendos për ndryshimin e Kushtetutës. Pra, për ndryshimin e Kushtetutës është e nevojshme shumica prej dy të tretave (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, duke përfshirë edhe dy të tretat (2/3) e të gjithë delegatëve, të cilët i kanë marrë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë (neni 64. paragrafi 2. pika 1 dhe 2).

5. Funkzioni i dytë mjaft i rëndësishëm i Kuvendit është ai ligdhënës, sepse ky institucion është bartës i pushtetit ligjor, që, në kuptim të caktuar, kufizohet me të drejtën e vetos pezulluese, të cilën e disponon Kryetari i Republikës (neni 84. pika 6.).
6. Pra, ai ka të drejtë që t'i kthejë në rishqyrtim ligjet që i konsideron të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës apo të një a më shumë komuniteteve dhe këtë të drejtë të kthimit të ligjeve mund ta shfrytëzojë vetëm njëherë. Kështu, sipas nenit 65. paragrafi 1. Kuvendi i Republikës së Kosovës i miraton ligjet, por përveç tyre, ai miraton edhe akte të tjera juridike. Funkcionin ligdhënës Kuvendi e realizon në mënyrë të pavarur. Ligjet me interes vital, siç janë ligjet me të cilat ndryshohen kufijtë e komunave, ligjet për përdorimin e gjuhëve, ligjet për zgjedhjet lokale, ligjet për përdorimin e simboleve e të tjera, nuk mund të jenë lënë e vendimit në referendum. E drejta e shpalljes së referendumit republikan për çështjet nga kompetenca e Republikës është kompetencë e Kuvendit (neni 65. pika 3.).
7. Rezolutat, deklaratat dhe rekomandimet, sipas rregullit, nuk kanë karakter normativ, ndërsa vendimet dhe konkluzionet kanë karakter të akteve juridike. Në cilësi të organit qendror ligjdhënës, përkatësisht të bartësit të funksionit ligjdhënës, ky Kuvend, po ashtu, shpall referendum më pajtim me ligjin (neni 65. pika 3.), i ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare (neni 65. pika 4.), të cilat pastaj bëhen pjesë përbërëse e rendit të brendshëm juridik (neni 19. paragrafi 1.), e miraton buxhetin e Republikës së Kosovës (neni 65. pika 5.), e vërteton dekretin e kryetarit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme (neni 65. pika 13.). Përgjatë nga rregulla që vetëm Kuvendi miraton akte me fuqi ligjore është autorizimi kushtetues i Kryetarit të Republikës që të marrë vendim për shpallje të gjendjes së jashtëzakonshme në bashkëpunim me Kryeministrin, si dhe të nxjerrë dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë. Se kemi të bëjmë me akte me të cilat degradohen ligjet ekzistuese, vërteton urdhëresa kushtetuese që këto akte t'i paraqiten për konfirmim Kuvendit, pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme (neni 65. pika 13.). Kur është fjala për aktet të cilat Kryetari i Republikës i miraton gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme, nuk ekziston urdhëresë e theksuar kushtetuese se edhe ato i nënshtrohen konfirmimit të mëvonshëm të Kuvendit. Sa u përket akteve të Qeverisë, Kushtetuta absolutisht e ka përjashtuar mundësinë që ato të marrin fuqi ligjore, kështu që gjithnjë paraqiten si akte të realizimit të ligjeve, e jo të realizimit të Kushtetutës.
8. Duke përcaktuar se ligjet i miraton Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kushtetuta nuk e cakton nocionin e ligjit, duke pasur parasysh përmbajtjen e tij, por i ka parasysh karakteristikat e tij formale. Në të nuk gjendet urdhëresa që ligjet duhet të

jenë të përgjithshme, që do të thotë se ato mund të miratohen për rastin apo personin konkret (i ashtuquajtur i ligj individual).

9. Ndër kompetencat e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë edhe zgjedhjet dhe shkarkimet. Sipas Kushtetutës ekzistuese, funksioni zgjedhor i Kuvendit i përfshin jo vetëm bartësit e pushtetit ekzekutiv, por edhe bartësit e pushtetit gjyqësor. Një pjesë e këtyre kompetencave lidhet me zgjedhjen e organeve të tjera të pushtetit në nivel të Republikës, ndërsa një pjesë me zgjedhjet brenda Kuvendit. Kështu, ky Kuvend:
- 1) e zgjedh dhe e shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit;
 - 2) e zgjedh dhe mund ta shkarkojë Kryetarin e Republikës së Kosovës, në harmoni me Kushtetutën;
 - 3) e zgjedh Qeverinë dhe mund ta votojë mosbesimin e saj;
 - 4) i zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës në harmoni me Kushtetutën.
10. Në kuadër të kompetencave zgjedhore të cilat miratohen në vetë Kuvendin, Kushtetuta e rregullon vetëm zgjedhjen e Kryetarit dhe të nënkryetarëve të Kuvendit. Rregullorja e punës së Kuvendit, e shpallur më 29.04.2010, e rregullon zgjedhjen e funksionarëve të tjerë në Kuvend, para së gjithash Ombudspersonin, Sekretarin e Kuvendit, përfaqësuesin dhe anëtarët e organeve punuese. Kur është fjala për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, duhet theksuar fakti dhe një situatë shumë interesante, që, në këtë vështrim, Kuvendi ka funksion propozues, sepse i propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese (neni 65. paragrafi 11.), ndërsa Kryetari i Republikës i emëron gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese me propozim të Kuvendit.
11. Kuvendi i Republikës së Kosovës, po ashtu, e bën edhe kontrollin (mbikëqyrjen) e punës së Qeverisë, institucioneve të tjera publike dhe të organeve e të funksionarëve të tjerë, që i përgjigjen në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin (neni 65. pika 9) dhe në bazë të të cilëve ata i paraqesin raport Kuvendit. Pos kësaj, Kuvendi e mbikëqyr edhe politikën e jashtme të sigurisë (neni 65. pika 12.). Kryetari i Republikës politikisht i përgjigjet Kuvendit, sepse ai e zgjedh me votim të fshehtë (neni 86. paragrafi 1.) me shumicë prej dy të tretash (2/3) të të gjithë deputetëve (neni 86. paragrafi 4.). Kryetari i Republikës së Kosovës, mund të shkarkohet me vendim të Kuvendit, atëherë kur është dënuar për ndonjë vepër penale apo kur nuk është në gjendje ta ushtrojë detyrën e këtij funksioni, për shkak të paaftësisë apo të sëmundjes së rëndë, si dhe në rastin kur Gjykata Kushtetuese konsideron se Kryetari ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës. Prandaj, Kuvendi mund të nis procedurën për shkarkim të tij. E drejta e inicimit të shkarkimit të Kryetarit të Republikës, megjithatë nënkupton se Kuvendi e vlerëson kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e veprimit të tij. Procedura e shkarkimit të Kryetarit iniciohet nëpërmjet një të tretës (1/3) së deputetëve të Kuvendit, të cilët e nënshkruajnë petitionin me shpjegimin e shkaqeve të shkarkimit të tij. Nëse peticioni e thekson paaftësinë apo sëmundjen e rëndë, Kuvendi do ta kërkojë mendimin e mjekut për gjendjen e Kryetarit, por nëse peticioni e përmend shkeljen e Kushtetutës, ai duhet

menjëherë t'i paraqitet Gjykatës Kushtetuese, e cila merr vendim në afat prej 7 ditësh nga pranimi i peticionit. Në rast se konstatohet se shkaqet e përmendura në peticion janë të sakta, Kuvendi mund ta shkarkojë kryetarin me dy të tretat (2/3) e deputetëve të vet.

Neni 66 [Zgjedhja dhe Mandati]

- (1) Kuvendi i Kosovës zgjidhet me mandat katërvjeçar, duke filluar nga dita e seancës konstituive, që mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.**
- (2) Zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit, kurse në raste të shpërndarjes së Kuvendit, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërndarjes.**
- (3) Presidenti i Republikës së Kosovës e thërret seancën e parë të Kuvendit. Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës nuk është në gjendje të thërrasë seancën e parë, Kuvendi mblidhet pa pjesëmarrjen e Presidentit.**
- (4) Mandati i Kuvendit të Kosovës mund të vazhdohet vetëm në raste të Gjendjes së Jashtëzakonshme për masa emergjente të mbrojtjes ose në rast të rrezikut ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike të Republikës së Kosovës, dhe vetëm për atë që zgjat Gjendja e Jashtëzakonshme, siç është përcaktuar me këtë Kushtetutë.**
- (5) Kushtet, zonat dhe procedurat zgjedhore, rregullohen me ligj.**

Neni 66

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës rregullon vetëm çështjet themelore dhe më të rëndësishme në lidhje me zgjedhjen e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës (për shembull, e drejta aktive dhe pasive e zgjedhjes, e cila fitohet me moshën 18-vjeçare - neni 45, paragrafi 1, si dhe neni 71, paragrafi 1, numri i deputetëve, i cili është 120 - neni 64, paragrafi 1, shpallja e zgjedhjeve, që është kompetencë e Presidentit të Republikës - neni 84, pika 3, koha në të cilën duhen mbajtur zgjedhjet, p.sh., zgjedhjet e rregullta më së voni 30 ditë para përfundimit të mandatit të Kuvendit, ndërsa në rast të shpërndarjes së Kuvendit, jo më vonë se 45 ditë nga shpërndarja - neni 66, paragrafi 2, kohëzgjatja e mandatit, që është 4 vjet - neni 66, paragrafi 1, natyra e mandatit të deputetit, si mos përputhja e funksionit të deputetit me vendin e punës në administratën shtetërore ose ndonjë ndërmarrje tjetër publike - paragrafi 72). Zgjedhja e deputetëve rregullohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve për Kuvend merret nga Presidenti i Republikës (neni 84, pika 3, e Kushtetutës).
2. Sipas Ligjit në fjalë, pas konsultimeve me partitë politike, Presidenti i Republikës së Kosovës shpall datën e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës (neni 4, paragrafi 1 i Ligjit), me kushtin që këto zgjedhje gjithmonë të mbahen të dielën, çdo katër vjet. Zgjedhjet nuk mund të mbahen më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë para

përfundimit të mandatit, e assesi më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit (neni 4, paragrafi 2 i Ligjit). Në bazë të autorizimeve kushtetuese të Presidentit të Republikës, dekreti i tij (saj), i cili shpall datën e zgjedhjeve, publikohet më së hershmi gjashtë (6), e më së voni katër (4) muaj para ditës së zgjedhjeve, me kusht që ky dekret të përmbajë edhe datën e mbajtjes së zgjedhjeve. Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve duhet të botohet në "Gazetën Zyrtare të Kosovës".

Neni 66.1

1. Kuvendi i Kosovës zgjidhet për një mandat prej katër (4) vitesh, duke filluar nga dita e seancës konstituive, e cila duhet mbajtur më së voni tridhjetë (30) ditë nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve (neni 66, paragrafi 1 i Kushtetutës). Mandati i rregullt i Parlamentit përfundon me përfundimin e periudhës së zgjedhjeve. Para përfundimit të rregullt, mandati i Parlamentit mund të ndërpritet me shpërndarjen e tij nga pushteti ekzekutiv. E drejta kushtetuese krahasimtare dhe praktika parlamentare ofrojnë situata të ndryshme të cilat mund të çojnë tek shpërndarja e Parlamentit.
2. Një prej rasteve të shpeshta është pamundësia për të krijuar Qeverinë në afat të arsyeshëm, që është reflektim i një strukture qenësisht heterogjene politike të Parlamentit, të cilën do të duhej ta tejkalonin zgjedhjet e reja. Shpërndarja mund të ketë edhe arsyeën e ndërprerjes së bashkëpunimit mes Parlamentit dhe Qeverisë, mocionet e shpeshta të mosbesimit ndaj Qeverisë e të tjera të ngjashme. Gjithashtu, arsyeja për shpërndarjen e Kuvendit mund të jetë edhe bllokimi në vendimmarrjen parlamentare për shkak të obstrukcioneve të opozitës parlamentare e të tjera. Nuk përjashtohet as mundësia që Qeveria, e cila gëzon besimin e Parlamentit, të vendosë shpërndarjen e tij, ashtu që pas zgjedhjeve të reja të sigurojë mbështetje të një shumice më të qëndrueshme parlamentare.
3. Duhet bërë dallimi mes ndërprerjes (humbjes) *kolektive*, apo të *përgjithshme* dhe asaj *individuale*, të mandatit. Humbja e parakohshme kolektive e mandateve ndodh me shpërndarjen e Kuvendit. Zgjedhjet që bëhen atëherë janë të përgjithshme, por për dallim nga zgjedhjet që bëhen pas një mandati të plotë legjislativ, pra pas përfundimit të periudhës së plotë të legjislaturës (apo *zgjedhjeve të rregullta*), këto janë *zgjedhje të jashtëzakonshme*. Nëse Kuvendi, i cili del nga zgjedhjet e jashtëzakonshme, mbetet në funksion për gjithë periudhën katërvjeçare, zgjedhjet e ardhme do të jenë prapë të rregullta. Humbja individuale e mandatit ndodh në rastet kur, për shembull, deputeti humb të drejtën e zgjedhjes, nëse tërhiqet me vullnet nga mandati (falënderohet për mandatin e dhënë apo jep dorëheqje nga funksioni i deputetit), nëse dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, gjë që e bën atë të paafitë të kryejë funksionin e deputetit etj. Pas përfundimit të një mandati individual, vjen në vendin e deputetit zëvendësi(ja) e tij, kurse nëse nuk ka zëvendës, shpallen zgjedhje plotësuese. Këto zgjedhje janë të veçanta, e jo të përgjithshme, sepse zgjidhet vetëm një deputet apo disa sish, por jo më shumë sesa që ka ulëse të lira. Përveç këtij lloji të zgjedhjeve, paraqiten edhe

zgjedhjet e përsëritura, si dhe të veçanta. Zgjedhjet e përsëritura bëhen në një zonë zgjedhore ose vetëm në një vendvotim, nëse nuk kanë arritur të bëhen zgjedhjet në ditën e caktuar.

Neni 66.2

1. Sipas nenit 66, paragrafi 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit, ndërsa në rast të shpërndarjes së Kuvendit, jo më vonë se dyzetepesë (45) ditë nga shpërndarja. Pas shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës, Presidenti shpall zgjedhjet e jashtëzakonshme, më së voni dhjetë (10) ditë nga dita e shpërndarjes së Kuvendit. Zgjedhjet e jashtëzakonshme nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) e as më vonë se dyzetepesë (45) ditë nga dita e shpërndarjes së Kuvendit. Zgjedhjet e jashtëzakonshme rregullohen me ligje e rregulla të zgjedhjeve të përgjithshme, me kushtin që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mund të ndërrojë kornizat kohore, varësisht nga nevojat si dhe në pajtim me rrethanat (neni 4, paragrafi 5 i Ligjit).

Neni 66.3

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton që Kuvendi i Republikës së Kosovës konstituohet në seancën e parë (konstituive), e cila mbahet pas zgjedhjeve. Këtë seancë e thërret Presidenti i Republikës së Kosovës, kurse në rast të pamundësisë që Presidenti të thërrasë seancën e parë, Kuvendi takohet pa praninë e tij (saj) (neni 66, paragrafi 3). Siç është theksuar tashmë, mandati i Kuvendit zgjat 4 vjet, si dhe llogaritet nga dita e seancës konstituive (kjo seancë duhet mbajtur në afat prej 30 ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve). Në seancën konstituive, konfirmohen (verifikohen) mandatet e deputetëve.

Neni 66.4

1. Megjithatë, ky mandat i parashikuar me Kushtetutë mund të zgjatet vetëm në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, e cila është e domosdoshme për të marrë masa urgjente për mbrojtje nga agresioni, apo rreziku ndaj rendit kushtetues ose sigurinë publike të Republikës së Kosovës. Për përputhshmërinë e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme me masat që ndërmerren gjatë saj me Kushtetutën, me kërkesë të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë, vendos Gjykata Kushtetuese (neni 113, paragrafi 3, pika 3). Natyrisht, kjo zgjatje e mandatit mund të zgjasë vetëm për atë sa zgjat edhe gjendja e jashtëzakonshme (neni 66, paragrafi 4).

Neni 66.5

1. Me dispozitën e fundit të paragrafit 5 të nenit 66, Kushtetuta përcakton që rregullimi i kushteve, zonave zgjedhore dhe procedura e zgjedhjeve bëhet me ligj.

Sa i përket kushteve të zgjedhjeve, me dispozitat e Ligjit për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës është përcaktuar votimi brenda dhe jashtë Kosovës. Saktësisht, secili person që ka mbushur 18 vjet ka të drejtë të votojë në Kosovë, në ditën e zgjedhjeve, si dhe në zonën ku është i regjistruar, me kusht që emri i tij/saj të jetë në Regjistrin Qendror të Shtetasve, apo të jetë i regjistruar si shtetas i Kosovës, në ditën e përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kurse personi me të drejtë vote, që përkohësisht gjendet jashtë vendit ose është zhvendosur nga Kosova, ka të drejtë vote në pajtim me rregullat dhe afatet e përcaktuara me këtë ligj.

2. Ajo që është karakteristike për zonat zgjedhore është që asnjë vendvotim brenda njësisë zgjedhore nuk tejkalon 750 votues, kurse përjashtimi nga ky rregull mund të lejohet vetëm nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (neni 82, paragrafi 1). Përveç kësaj, secili vendvotim duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme për të siguruar rrjedhë të rregullt të votimit, fshehtësinë e votës, vëzhgim të lirë dhe kontroll të kutive me fletëvotime, si dhe qasje të papenguar të vëzhguesve. Me rëndësi të veçantë është që të ofrohet siguria e vendvotimit, pra rrjedha e qetë dhe votimi i sigurt brenda secilit vendvotim, ashtu që, në rastet e prishjeve serioze të rendit brenda apo në afërsi të vendvotimit, mund të kërkohet edhe ndihma e përkohshme e policisë.
3. Kushtet dhe procedurat e zgjedhjeve janë të përcaktuara me dispozitat e ligjit të përmendur, mbi të gjitha, e drejta për të votuar dhe fshehtësia e votës. Në fakt, me nenin 89, paragrafi 1 të këtij ligji, parashikohet që personi që ka të drejtë vote mund të shfrytëzojë këtë të drejtë, nëse është i regjistruar në Kosovë ose ka arritur të aplikojë për zgjedhje edhe jashtë Kosovës. Me rëndësi të veçantë është dispozita që askush nuk mund ta ndalojë e as të provojë ta ndalojë votuesin në shfrytëzimin e të drejtës së tij të votimit, si dhe nuk mund t'i lejohet dikujt të votojë në emër të një votuesi tjetër.²⁵² Fshtësia e votës është tejet e rëndësishme në këtë proces zgjedhor, ashtu që secili votues duhet të shënojë në fletëvotimin e tij, prapa kabinës së votimit, si dhe në atë rast, të jetë plotësisht i vetëm.²⁵³ Gjithashtu, votimi për më shumë se një herë në një palë zgjedhje paraqet vepër penale, të dënueshme në pajtim me Kodin Penal të Kosovës, kurse procedurat për zgjedhje të rregullta i përcakton Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (neni 91, paragrafi 1), i cili përcakton edhe rregullat, në pajtim me të cilat duhet ndërmarrë edhe procedura të numërimit të votave.
4. Për të garuar në zgjedhje, subjekti politik duhet të certifikohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas aplikimit të dorëzuar me kohë (neni 15, paragrafi 1 i

²⁵² Në këtë dispozitë ligjore, ekziston edhe një përjashtim, i përcaktuar me nenin 89, paragrafi 5, e cila thekson që votuesi që ka aftësi të kufizuara deri në masën që nuk mund të shkruajë apo të hedhë fletëvotimin, apo është analfabet, mund të ndihmohet nga një person tjetër që zgjidhet nga votuesi, nëse kërkohet një ndihmë e tillë. Personi i tillë mund t'i ndihmojë vetëm një votuesi, si dhe nuk mund të jetë anëtar i këshillit zgjedhor e as vëzhgues i akredituar.

²⁵³ Përjashtimi nga ky rregull ndodh vetëm kur votuesit i duhet ndihma e personit të dytë, siç përcaktohet me nenin 89, paragrafi 5.

Ligjit). Partia e regjistruar politike, e cila ka dorëzuar aplikimin e plotë, certifikohet, kurse ato parti politike që nuk e dëshirojnë këtë, janë të obliguara të informojnë Zyrën që nuk duan të marrin pjesë në zgjedhje. Sipas nenit 110, paragrafi 3 i Ligjit, secili subjekt i certifikuar politik paraqitet me “listë të hapur”.

5. Kosova konsiderohet një zonë e vetme zgjedhore, me shumë kandidatë. Subjektet politike dorëzojnë listën e kandidatëve në pajtim me procedurën e përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe rregullat e vëna nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në pajtim me parimet e barazisë mes grave e burrave (neni 7, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës), kjo Kushtetutë siguron parimin e barazisë së përfaqësimit të femrave e meshkujve. Në fakt, secila listë e kandidatëve duhet të përbëhet prej më së paku 30% të gjinisë së kundërt (neni 110, paragrafi 2 i Ligjit).

Neni 67 [Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarëve]

- (1) Kuvendi i Kosovës nga radhët e veta zgjedh Kryetarin dhe pesë (5) nënkryetarë.
- (2) Kryetari i Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar dhe zgjedhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
- (3) Tre (3) nënkryetarët të propozuar nga tri grupet më të mëdha parlamentare, zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.
- (4) Dy (2) nënkryetarë përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend dhe ata zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve. Njëri nënkryetar do të jetë nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet të rezervuara ose të garantuara të komunitetit Serb, dhe tjetri nënkryetar nga radhët e deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara nga komunitetet tjera që nuk janë shumicë.
- (5) Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen me votën e shumicës prej dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të deputetëve.
- (6) Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës të Kuvendit.
- (7) Kryetari i Kuvendit:
 1. përfaqëson Kuvendin;
 2. përcakton rendin e ditës, thërret dhe kryeson seancat;
 3. nënshkruan aktet e miratuara nga Kuvendi;
 4. ushtron edhe funksione të tjera, në bazë të kësaj Kushtetute dhe Rregullore së Punës të Kuvendit.
- (8) Në rast mungese ose pamundësie për të ushtruar funksionin, Kryetarin e Kuvendit e zëvendëson njëri nga nënkryetarët.

1. Secili kuvend (parlament) ka të drejtë të organizojë punën e tij dhe të zgjedhë udhëheqësit e vet, organet dhe trupat punues ndihmës. Organizimi i brendshëm i Kuvendit përcaktohet me Rregulloren e punës, edhe pse në disa shtete, më shumë kanë rëndësi rregullat e natyrës së pashkruar.
2. Kur bëhet fjalë për të drejtën e Kuvendit për vetorganizim, paraqiten disa grupe pyetjesh, përgjigjet ndaj të cilave përcaktojnë edhe funksionimin e Kuvendit dhe jetës së tij në përgjithësi. E para ka të bëjë me statusin dhe autorizimet e atyre njerëzve të cilët udhëheqin me vetë rrjedhën e procesit parlamentar si dhe përfaqësojnë Parlamentin në marrëdhënie me organet tjera shtetërore, pra *zyrtarët parlamentarë*. Grupi i dytë i pyetjeve ka të bëjë me seancat dhe mbledhjet e Parlamentit, pra me organizimin kohor i punës parlamentare. Fusha e tretë e organizimit të brendshëm të Kuvendit ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e trupave ndihmës, këshillave e komisioneve parlamentare, të cilat do të duhej të lehtësonin dhe shpejtonin procesin e vendimmarrjes në Kuvend. Kjo fushë e fundit e çështjeve të organizimit të Parlamentit del nga anëtarësia politike e këtij organi përfaqësues në grupe parlamentare, të cilat në fakt, kanë ndikim qenësor në punën e Parlamentit, por edhe tek deputetët të cilët u përkasin atyre grupeve.
3. Siç kemi përmendur tashmë, grupi i parë i këtyre pyetjeve ka të bëjë me liderët parlamentarë, të cilët janë zyrtarë të lartë të Parlamentit, të zgjedhur mes radhëve të deputetëve në seancë plenare të Parlamentit, ose në ndonjë nga mbledhjet e tjera. Këta udhëheqës parlamentarë janë Kryetari i Kuvendit, zëvendësi apo zëvendësit e tij (saj) (nënkryetari apo nënkryetarët), kryetarët e këshillave e komisioneve parlamentare, sekretari e të tjerë. Zgjedhja e këtyre zyrtarëve është e domosdoshme, më së pari për shkak se Parlamenti (Kuvendi) është organ kolegjal, me numër të madh të anëtarëve, detyrave që Parlamenti ka, si dhe marrëdhënieve që vendos me organe të tjera shtetërore. Pasi që procedura parlamentare është mjaft e ndërlikuar, për marrje vendimesh ka nevojë për diskutime, të cilat mund të zgjasin me ditë të tëra. Për këtë, është e nevojshme të ekzistojnë persona që do të udhëheqin këto procedura si në seancën plenare të Parlamentit, ashtu edhe në seancat e organeve punuese dhe ndihmëse të Parlamentit.
4. Funkionarët parlamentarë zgjidhen nga radhët e deputetëve, por zgjedhja e tyre varet nga përkatësia e grupit parlamentar, gjegjësisht klubit të deputetëve. Është e natyrshme që kryetari i Parlamentit ose i dhomës së Parlamentit (nëse Parlamenti ka dy ose më shumë dhoma), të vijë në këtë funksion si kandidat i shumicës parlamentare, edhe pse një numër i caktuar nënkryetarësh apo kryetarësh të këshillave mund të zgjidhen edhe nga pakicat parlamentare, në proporcion me fuqinë e tyre përfaqësuese. Funkionarët parlamentarë janë zyrtarë të lartë në Parlament, ndërsa atë funksion e fitojnë duke qenë në pozitën e deputetit, si dhe në ato funksione ata zgjedhën në seanca plenare parlamentare, apo të dhomave të tij. Domosdoshmëria e funksionarëve të tillë në secilin parlament (apo kuvend) del nga natyra e organit përfaqësues, si organ kolegjal, i cili ka disa dhjetëra, ose edhe

qindra anëtarë. Pasi që vendimet e Parlamentit merren në seanca, është e domosdoshme të ekzistojë një person përgjegjës për thirrjen e seancave, kryesimin e seancave, udhëheqjen e seancave, vendosjen e rendit në seanca, e të ngjashme. Funkionarët e tillë janë kryetari i Parlamentit dhe kryetarët e dhomave, nënkryetarët e tyre, kryetarët e komisioneve parlamentare etj.

5. Funkionari më i rëndësishëm parlamentar është gjithsesi Kryetari i Kuvendit, përkatësisht kryetarët e dhomave të Kuvendit. Kryetari i Kuvendit zakonisht është kryesuesi i seancave parlamentare, por ekziston edhe lloji i kryetarëve me autorizime të pavarura, të cilët kanë edhe kompetenca si organ i veçantë. Kryetari më origjinal dhe më i njohur i Parlamentit, apo dhomave të Parlamentit, është *spikeri (speaker)* i Dhomës së Ulët (House of Commons) në Britani, i cili ka shërbyer si shembull për formësimin e postit të kryetarit të Parlamentit në shumë shtete. Ky funksionar formalisht paraqitet si shërbyes i Dhomës së Ulët, por në fakt është funksionari kryesor i dhomës parlamentare, pozita e të cilit (spikerit, si shërbyes i Dhomës së Ulët) është vendosur që prej vitit 1642.²⁵⁴ Që prej gjysmës së shekullit XIX, ai është personalitet jopartiak dhe duhet të jetë politikisht neutral, (edhe pse më parë duhet të zgjidhet si deputet) dhe kështu, menjëherë pasi të zgjidhet në atë pozitë të lartë, ai duhet të japë dorëheqje nga anëtarësia në parti, e cila e ka kandiduar në zgjedhje.

Neni 67.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 67, paragrafin 1, përcakton që Kuvendi i Kosovës, nga radhët e veta, zgjedh Kryetarin dhe 5 nënkryetarë. Ata i ndihmojnë Kryetarit në kryerjen e punëve në fushëveprimin e tij. Nënkryetarët zgjidhen me të njëjtën procedurë me të cilën zgjidhet edhe Kryetari i Kuvendit, si dhe për këtë, në të njëjtën mënyrë edhe shkarkohen, pra me shumicën e dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të deputetëve.
2. Zgjedhja e Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit është rregulluar me nenin 12 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pra, në seancën konstituive, Kuvendi zgjedh këta udhëheqës nga radhët e veta, të cilët krijojnë Kryesinë e Kuvendit. Këtu duhet theksuar që as Kushtetuta e Republikës së Kosovës, as Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës nuk përmbajnë ndonjë dispozitë të qartë mbi atë se kush e thërret seancën e parë konstituive pas zgjedhjeve të përgjithshme të kryera, e as kush e kryeson seancën e Kuvendit deri në zgjedhjen e Kryetarit dhe nënkryetarëve. Sipas praktikës parlamentare të disa shteteve, ky mund të jetë, kur bëhet fjalë për thirrjen e seancës së parë, apo asaj konstituive, Kryetari i Kuvendit në përbërjen e kaluar, kurse kur bëhet fjalë për

²⁵⁴ Në fakt, atëherë Çarls ka hyrë në parlament për të arrestuar 5 anëtarë të tij, si dhe pyeti spikerin se ku gjenden deputetët, kurse ai u përgjigj: “Nëse më lejon Madhëria Juaj, unë nuk kam sy për të parë, e as gjuhë për të folur, përveç nëse kjo Dhomë, shërbyes i së cilës jam, më urdhëron ta bëj këtë”. Kjo do të thotë që ky funksionar parlamentar do të mund t’i përkushtohet plotësisht Parlamentit si dhe t’i shërbejë atij, si dhe nuk mund të ketë kurrfarë interesi që do të ishte mbi Parlamentin.

kryesimin, deri në zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit, mund të jetë deputeti më i moshuar, i ndihmuar nga dy deputetët më të rinj - që të gjithë nga përbërja e re e Kuvendit. Deputetët marrin të drejtat dhe detyrimet në Kuvendin e Republikës së Kosovës në ditën e vërtetimit të mandatit të tyre, kurse në ditën e verifikimit të mandatit të tyre, si deputetë të rinj, përfundon mandati i deputetëve të mëparshëm, . Konfirmimi i mandatit të deputetit bëhet në bazë të verifikimit të zgjedhjeve dhe raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zgjedhjet e mbajtura.

3. Kryetari i Kuvendit zgjidhet me shumicë të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Kuorumi (numri i domosdoshëm i deputetëve për vendimmarrje të plotfuqishme të Kuvendit) si dhe votimi në seancat e Kuvendit rregullohen me nenin 51 të Rregullores. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit, që do të thotë që duhet që në seancë të jenë të pranishëm së paku 61 deputetë. Vendimet nga seancat e Kuvendit janë të vlefshme, nëse për kohën e marrjes së vendimeve, në sallë janë të pranishëm më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të deputetëve, kurse ligjet, vendimet dhe aktet tjera të Kuvendit konsiderohen të miratuara, përderisa për ta votojnë shumica e deputetëve të pranishëm. Përrjashtim bëhet kur me Kushtetutë të Republikës së Kosovës përcaktohet ndryshe. Prania e deputetëve në seancë verifikohet me sistemin elektronik të votimit, me ngritje dore apo me thirrje të emrave. Natyra e verifikimit të pranisë së deputetëve vendoset nga kryesuesi i seancës. Votimi bëhet në mënyrën vijuese: a) votimi publik, me ngritje të dorës “për”, “kundër” ose “abstenim”; b) votimi i fshehtë; c) votimi i regjistruar, i cili përfshin votimin elektronik; d) votimi me thirrjen individuale të secilit deputet.

Neni 67.2

1. Dispozitat e paragrafit 2 të nenit 67 të Kushtetutës përcaktojnë që kryesuesi i seancës konstituive kërkon nga grupi më i madh parlamentar që të propozojë kandidatin për Kryetar të Kuvendit. Pra, kur kandidati për Kryetar të Kuvendit propozohet nga grupi më i madh parlamentar në Kuvend, fillohet me zgjedhjen e tij. Ai zgjidhet nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Neni 67.3

1. Sipas dispozitave të paragrafit 3 të nenit të lartpërmendur të Kushtetutës, kryesuesi i seancës konstituive kërkon nga tri grupet parlamentare të propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit. Këta tre nënkryetarë zgjidhen me shumicë të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Kryesuesi i seancës konstituive shpall rezultatet e votimit për zgjedhje të Kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit. Pastaj, e thërret Kryetarin e ri të porsazgjedhur të Kuvendit që të zërë vendin e tij (neni 12, paragrafi 6 i Rregullores).

Neni 67.4

1. Dispozitat kushtetuese të paragrafit 4 të nenit 67 të Kushtetutës përcaktojnë që dy nënkryetarë të Kuvendit përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kuvend. Në përputhje me këtë dispozitë, kryesuesi i seancës konstituive kërkon nga deputetët që mbajnë ulëset e garantuara për komunitetin serb dhe ata që mbajnë ulëset e garantuara për komunitetet tjera që nuk janë shumicë, të propozojnë nga një kandidat për nënkryetar të Kuvendit. Edhe këta nënkryetarë, si në rastin e kryetarit dhe tre nënkryetarëve, propozohen nga tri grupet më të mëdha parlamentare dhe zgjidhen me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Neni 67.5

1. Siç është thënë më herët, me rastin e komentimit të këtij neni, Kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit shkarkohen në të njëjtën mënyrë, sepse ashtu edhe zgjidhen në ato pozita, por këtu është me rëndësi të përmendim që për zgjedhjen dhe shkarkimin e tyre nuk parashikohet e njëjta shumicë (neni 67, paragrafi 5). Pra, ndërsa për zgjedhjen e Kryetarit dhe të pesë nënkryetarëve nevojitet shumica e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, për shkarkimin e tyre parashikohet shumica me dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit!?

Neni 67.6

1. E drejta parlamentare e shumë vendeve nuk parasheh institucionin e llojit të kryesisë së Parlamentit ose konferencës së kryetarëve. Tek ato nuk ekziston ndonjë organ i institucionalizuar parlamentar në të cilin do të përfaqësoheshin kryetarët e grupeve parlamentare, edhe pse në praktikë kryetari i Kuvendit konsultohet me ta për çështjet e veçanta të punës së Parlamentit. Megjithatë, kjo nuk ndodh edhe në të drejtën parlamentare të Republikës së Kosovës, sepse me Kushtetutë parashikohet që kryetari dhe nënkryetarët përbëjnë Kryesinë e Kuvendit (neni 67, paragrafi 6). Në përputhje me kornizën kushtetuese, Kryesia takohet çdo javë, kur edhe Kuvendi mban seancë, për shqyrtimin dhe përgatitjen e rendit të ditës së Kuvendit për seancën e javës së ardhme, si dhe rendin e ditës për dy javët në vijim. Kryesia siguron që secili propozim përmbajtjesor që përkrahet nga gjashtë apo më shumë deputetë të Kuvendit të futet në rendin e ditës së seancës plenare të Kuvendit, brenda tri javëve të punës prej ditës kur është dhënë përkrahja. Kryesia merr vendime me konsensus. Në rast të mungesës së pajtimit, Kryesia vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, përveç në raste të caktuara.
2. Këtu është karakteristike të përmendet që ka ndodhur ndërrimi i përbërjes së Kryesisë. Në fakt, Kryesia e Kuvendit, deri në mandatin e legjislaturës së tretë, është përbërë nga nëntë anëtarë, prej të cilëve: a) dy anëtarë nga partia ose koalicioni që ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhje për Kuvend; b) dy anëtarë nga partia apo koalicioni i dytë, sipas numrit më të madh të votave; c) një anëtar nga partia ose koalicioni i tretë, sipas numrit më të madh të votave; d) një anëtar nga partia apo koalicioni i katërt sipas numrit më të madh të votave; e) një

anëtar nga partia apo koalicioni i pestë, sipas numrit më të madh të votave; f) një anëtar nga partitë që janë deklaruar të përfaqësojnë bashkësinë serbe në Kosovë, si dhe g) një anëtar nga partitë që janë deklaruar të përfaqësojnë bashkësitë tjera (përveç atyre shqiptare dhe serbe). Pas përfundimit të mandatit të tretë, Kryesia e legjislaturës së katërt është zgjedhur në muajin shkurt të vitit 2011, në bazë të nenit 67 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 12 të Rregullores së Punës, ashtu që tash ka gjashtë anëtarë, të përbërë nga Kryetari i Kuvendit dhe pesë nënkryetarë. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit, në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës.

3. Për përbërjen e Kryesisë dhe organeve të tjera punuese të Kuvendit, respektohet përbërja gjinore e Kuvendit, kurse mandati i Kryetarit dhe anëtarëve të Kryesisë është në përputhje me mandatin e Kuvendit. Kuvendi lë punën një ditë para fillimit të fushatës parazgjedhore, por gjatë fushatës zgjedhore, Kryesia vazhdon punën e saj, me qëllim të ruajtjes së vazhdimësisë së punës së Kuvendit. Me Rregulloren e Punës së Kuvendit (neni 15), janë përcaktuar detyrat e Kryesisë, e cila në fillim të mandatit të saj të zgjedhjeve, në marrëveshje me grupet parlamentare, propozon edhe numrin edhe strukturën e komisioneve kuvendore, për të cilët pastaj vendos Kuvendi. Gjithashtu, gjatë mandatit, në marrëveshje me grupet parlamentare, mund t'i propozojë Kuvendit formimin e komisioneve të reja funksionale. Përveç kësaj, Kryesia përgatit programin e punës së Kuvendit, shqyrton dhe përgatit rendin e ditës për seancën e ardhshme të Kuvendit, shqyrton propozimet e Qeverisë dhe i integron ato në programin e punës së Kuvendit, zgjedh Sekretarin e Kuvendit (në bazë të konkursit), i cili i raporton drejtpërdrejt Kryesisë, miraton Projektbuxhetin e Kuvendit, si dhe vendos për mjetet financiare, që janë të nevojshme për punën dhe funksionimin e Kuvendit, deputetët e tij, administratën, anëtarët e Kryesisë dhe anëtarët e grupeve parlamentare.

Neni 67.7

1. Pozita kushtetuese, detyrat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Kuvendit janë përcaktuar me nenin 67, paragrafi 7. Pra, sipas këtij neni, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës: a) përfaqëson Kuvendin; b) propozon rendin e ditës për seancat e Kuvendit; c) thërret dhe kryeson seancat; d) nënshkruan aktet e miratuara nga Kuvendi; e) kujdeset për rendin në Kuvend si dhe kryen funksione të tjera, sipas Kushtetutës dhe Rregullores së Punës së Kuvendit.
2. Kryetari bën interpretimin përfundimtar të Rregullores së Punës gjatë seancës plenare. Gjithashtu, Kryetari i Kuvendit kryen funksionin e Presidentit të Republikës së Kosovës, nëse ai nuk është në gjendje përkohësisht të kryejë detyrat kushtetuese. Në fakt, mungesa e përkohshme e Presidentit dhe paaftësia për të kryer detyrat e veta janë të rregulluara me nenin 90 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ashtu që ai mundet vullnetarisht t'i kalojë obligimet e veta të Kryetarit i Kuvendit, (i cili pastaj është ushtrues detyre i Presidentit të Republikës së Kosovës - paragrafi 1). Megjithatë, nëse nuk ekziston bartja e vullnetshme e kompetencave,

Kuvendi i Republikës së Kosovës mundet, me shumicën prej dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit, pas konsultimit me komisionin mjekësor, të marrë vendim që Presidenti, përkohësisht, nuk mund të kryejë detyrat e veta (jo më gjatë se gjashtë muaj), dhe që atë detyrë do ta ushtrojë Kryetari i Kuvendit (paragrafi 2).

Neni 67.8

1. Ushtrimi i detyrës së Kryetarit të Kuvendit është i përcaktuar edhe me Kushtetutë, edhe me Rregullore të Punës, ashtu që në udhëheqjen dhe kryesimin e seancave të Kuvendit, Kryetari ndihmohet nga njëri prej anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit, sipas renditjes së caktuar nga Kryesia. Në rast të mungesës së tij, apo me kërkesë të tij, Kryetari i Kuvendit zëvendësohet nga njëri prej anëtarëve të Kryesisë, përkatësisht njëri nga nënkryetarët (neni 67, paragrafi 8 i Kushtetutës). Në rastet kur Kryetari mungon, përcaktohet me autorizim të veçantë se cili anëtar i Kryesisë apo nënkryetar, do ta ushtrojë funksionin e Kryetarit, ndërsa në rast të pamundësisë për të ushtruar detyrën e Kryetarit të Kuvendit, ai zëvendësohet nga anëtari i Kryesisë së Kuvendit nga e njëjta parti.

Neni 68 [Seancat]

- (1) **Mbledhjet e Kuvendit të Kosovës janë publike.**
- (2) **Mbledhjet e Kuvendit të Kosovës mund të jenë të mbyllura me kërkesën e Presidentit të Republikës së Kosovës, të Kryeministrit ose të një të tretës (1/3) së deputetëve, në rastet e përcaktuara me Rregulloren e Punës të Kuvendit. Vendimi miratohet në mënyrë të hapur e transparente dhe kërkon votën e dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë.**

Neni 68

1. Kuvendi gjithmonë zgjidhet për një periudhë të caktuar kohore, më së shpeshti për katër ose pesë vjet, ndërsa ajo periudhë, brenda së cilës përbërja e Kuvendit ka mandatin, quhet legjislaturë apo periudhë zgjedhore. Ajo periudhë fillon me përfundimin e periudhës së mandatit të strukturës së kaluar parlamentare dhe rregullisht përfundon me konstituimin e Parlamentit të zgjedhur. Për këtë arsye flitet shpesh për legjislaturën e parë, të dytë, të tretë e kështu me radhë. Natyrisht, këtu duhet përmendur që para përfundimit të periudhës së rregullt mandatore, legjislatura mund të përfundojë para përfundimit të periudhës së mandatuar, mund të ndërpritet me shpërndarjen e Parlamentit, kurse të drejtën e shpërndarjes së Kuvendit e kanë organet e tjera kushtetuese, si bartësit e ekzekutivit - Qeveria apo shefi i shtetit, përkatësisht Qeveria dhe shefi i shtetit së bashku. Kjo e drejtë e ekzekutivit ndaj legjislativit është shumë karakteristike dhe konsiderohet një lloj e drejte simetrike ndaj të drejtës së Kuvendit që të votojë mosbesimin e Qeverisë.

2. Përveç kësaj, kur bëhet fjalë për mandatin e Kuvendit, duhet thënë që ekzistojnë edhe shtete në të cilat organi përfaqësues mund të marrë vendim për shkurtimin e mandatit të tij, pra për vetëshpërndarje. Megjithatë, në vende të tilla ekziston mundësia e manipulimit dhe destabilizimit të Parlamentit dhe, për këtë arsye, një vendim i tillë do të duhej paraprirë nga një votim i «kualifikuar» i deputetëve për vetëshpërndarjen e Kuvendit, anëtarë të të cilit janë. Kjo është zakonisht shumica me dy të tretat, edhe pse në vende tjera, në një formë të ligjit të zakonshëm, para përfundimit të legjislaturës së rregullt, mund të merret vendimi për vetëshpërndarje (për shembull, Dhoma Nacionale në Austri). Kushtetuta e ish-Republikës Federale të Jugosllavisë, më saktë Amendamenti i parë i kësaj Kushtetute, parashihte mundësinë e vetëshpërndarjes së Kuvendit Federativ, në bazë të vendimit për ndërprerjen e mandatit të deputetëve federativë, para përfundimit të afatit të mandatit për të cilin janë zgjedhur. Për këtë vendim, ka qenë e nevojshme të votojnë 2/3 e deputetëve në të dy dhomat e Kuvendit.
3. Gjithashtu, mandati kuvendor mund të ndërpritet para periudhës së legjislaturës me fuqi kushtetuese (*ex constitutione*). Në të drejtën krahasimtare kushtetuese ekzistojnë raste të ndryshme kur mund të ndodhë një situatë e tillë, kurse si arsye të mundshme, e më të shpeshta, përmenden:
 - 1) nëse në një afat prej disa muajsh (p.sh. 90 ditë) nga fillimi i procedurës nuk zgjidhet Qeveria;
 - 2) nëse në një afat të caktuar, (i cili mund të jetë gjithashtu disa muajsh), nuk dorëzohet buxheti;
 - 3) nëse gjatë kohës së zbatimit të përkohshëm të ndonjë ligji, (gjë që ndodh kur në një parlament me dy dhoma, dhomat nuk kanë miratuar ligjin me të njëjtin tekst, kurse procedura e përafrimit nuk ka pasur sukses), nuk miratohet ai ligj në të dyja dhomat, në pajtim me Kushtetutën, brenda një afati të caktuar paraprakisht (për shembull, afati prej një viti);
 - 4) nëse zgjedhësit nuk e revokojnë Presidentin e Republikës, edhe pas inicimit të procedurës për revokimin e tij nga Kuvendi;
 - 5) nëse Kuvendi nuk zgjedh Qeverinë në afatin e caktuar (p.sh. 60 ditë) nga dita kur presidenti i republikës propozon kandidatin për kryetar të Qeverisë.
4. Kur flasim për kohëzgjatjen e legjislaturës, pra periudhën brenda së cilës Kuvendi ushtron mandatin e vet dhe mbledhjet kuvendore, pra periudhën në të cilën takohet dhe merr vendime, duhet bërë dallimi si në vijim. Në fakt, kohëzgjatja e legjislaturës është e përcaktuar me Kushtetutë apo ligj, si dhe përputhet me kohëzgjatjen e mandatit të deputetëve, kurse Kuvendi, si institucion autonom politik, vetëpërcakton kohëzgjatjen e seancave të tij. Së këndejmi, mund të krijohen situata të ndryshme dhe kështu, në vende të ndryshme, Kuvendi është në seancë të vazhdueshme, gjë që më së shpeshti ka ndodhur në shtetet socialiste. Në vendet tjera, Kuvendi është në seancë pune kur thirret nga shefi i shtetit, e kjo zakonisht ndodh në monarki. Megjithatë, në numrin më të madh të shteteve, edhe fillimi, edhe përfundimi i seancës së punës përcaktohen me Kushtetutë (në disa vende përcaktohet vetëm fillimi). Më së shpeshti ndodh që seanca e rregullt e punës të mbahet dy herë në vit (e para në pranverë, e dyta seanca vjeshtore), kurse

seancat e jashtëzakonshme të Kuvendit mbahen për shkak të ndonjë nevoje veçanërisht urgjente (për shembull, në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme). Sesioni parlamentar i punës paraqet kohën prej së cilës Parlamenti mblidhet e deri në ditën kur mbyll punimet e veta, kurse shtyrja e sesionit të Kuvendit paraqet ndërprerje të punës që ndodh gjatë një sesioni pune. Mbledhjet e rregullta të Kuvendit janë të lidhura me një ditë të caktuar të muajit, kurse të jashtëzakonshme janë ato që propozohen nga propozuesi i autorizuar në kohën mes sesioneve të rregullta dhe mbahen në atë kohë. Kështu, për shembull, sipas disa kushtetutave, sesioni i parë i rregullt fillon në ditën e parë të punës të shkurtit apo marsit, kurse i dyti ditën e parë të punës në shtator apo tetor, kurse mbledhjet e jashtëzakonshme mbahen me kërkesë të më së paku një të tretës së deputetëve në një dhomë (nëse Parlamenti përbëhet nga dy dhoma) apo numrit të përgjithshëm të deputetëve, si dhe me kërkesë të Qeverisë, me rend të ditës paraprakisht të përcaktuar. Zakonisht parashikohet që sesioni i rregullt të mos zgjasë më shumë se 90 ditë.

5. Siç e kemi theksuar në paragrafin paraprak, periudha gjatë së cilës Parlamenti ushtron mandatin e vet, pra legjislatura, përputhet me mandatin e deputetëve, por kjo periudhë dallon në vende të ndryshme. Kështu, legjislaturat mund të jenë nga dy vjet, siç është për shembull rasti me mandatin e anëtarëve të Dhomës së Përfaqësuesve në SHBA, e deri në pesë vjet, siç është për shembull rasti me anëtarët e Dhomës së Ulët në Angli. E njëjta legjislaturë me kohëzgjatje pesëvjeçare vlen edhe për anëtarët e Kuvendit Kombëtar Francez. Të dy mandatet kanë sigurisht përparësi dhe mangësi. Kështu, nëse mandati është më i shkurtër, kjo gjë ka vetinë e mirë që bëhen zgjedhje më të shpeshta, gjë që mundëson ndërrimin e shpeshtë të anëtarëve të Parlamentit, pra rotacionin e tyre. Nëse mandati është më i gjatë, ai mundëson punën e papenguar të parlamentarëve, si dhe realizim më të mirë të programit për të cilin kanë fituar mandatin, por edhe mundësi më të madhe për realizimin e premtimeve të dhëna në fushatën zgjedhore.
6. Natyrisht, mandati i Kuvendit mund edhe të zgjatet, por vetëm në raste të jashtëzakonshme të përcaktuara me Kushtetutë. Këto janë gjendjet e luftës apo të jashtëzakonshme (të ashtuquajtura nevoja shtetërore), kurse mandati i anëtarëve të Parlamentit në këto situata zgjatet, por vetëm për aq sa ekzistojnë ato rrethana të jashtëzakonshme. Duhet theksuar që kohëzgjatja e mandatit të Parlamentit (legjislatura) nuk mund të jetë as tejet e shkurtër, por as tejet e gjatë. Argumentet për mandat më të shkurtër ndërlidhen me ofrimin e mundësive për qytetarët që të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në periudha më të shpeshta, kurse argumentet për mandate më të gjata parlamentare lidhen me nevojën që anëtarët e Parlamentit t'i kushtohen plotësisht punës së tyre, pa ngarkesa e as fushata politike para votuesve, për përgatitje për zgjedhje të reja, gjë që është praktikë në rastin e mandatit të shkurtër. Në anën tjetër, mandati i Parlamentit nuk do të mund të ishte as tejet i shkurtër, për shkak se në rast të tillë, anëtarët e tij nuk do të arrinin të bënin asgjë të qëndrueshme apo të dobishme për shtetin e popullin. Nëse mandati i Parlamentit është tejet i gjatë, humbet lidhja e afërt mes popullit dhe përfaqësuesve të tij.

Kështu, për të shmangur mangësitë e periudhave tejet të shkurtra apo tejet të gjata parlamentare, më së shpeshti merret zgjidhja e ndërmjetme.

7. Megjithatë, duke pasur parasysh që Kuvendi është organi më i rëndësishëm përfaqësues, me kompetenca të shumta, të cilat janë të rëndësishme më të madhe për funksionimin e një shteti, është e domosdoshme të sigurohet vazhdimësia e punës së tij (nëse ndodh shpërndarja e parakohshme e Kuvendit, menjëherë shpallen zgjedhjet dhe bëhet konstituimi i strukturës së re). Për këtë arsye, zgjedhjet për legjislaturën e re mbahen gjithmonë para përfundimit të periudhës zgjedhore të Kuvendit ekzistues. Kështu, për shembull, nëse ndodh shpërndarja e Dhomës së Ulët të Parlamentit Gjerman, Bundestag, Ligji Themelor i Republikës Federale Gjermane (*Grundgesetz*) përcakton që zgjedhjet mbahen në afat prej 60 ditësh, kurse sipas të njëjtës Kushtetutë, Parlamenti i sapozgjedhur takohet, më së voni 30 ditë pas zgjedhjeve. Nëse ndodh shpërndarja e dhomave kuvendore në Itali, zgjedhjet për deputetë të rinj bëhen brenda një afati prej 70 ditësh nga shpërndarja e dhomave paraprake, kurse seanca e parë e Parlamentit mbahet më së voni 20 ditë nga dita e zgjedhjeve.
8. Gjithashtu, duhet theksuar që në disa shtete, për dallim nga rindërtimi i plotë i Kuvendit (për të cilën u fol më herët), ekziston edhe rindërtimi i pjesshëm, kurse kjo vlen zakonisht për dhomën e dytë. Pra, ky është rasti kur mandati i anëtarëve të dhomës së dytë (të lartë) është më i gjatë, si në Senatin Amerikan apo Francez, ku mandati i deputetëve është gjashtë, përkatësisht nëntë vjet. Për të mos lejuar përqendrimin e pushtetit ligjvënës në duart e deputetëve, parashikohet rotacioni i tyre, kështu që çdo vit, përkatësisht çdo tri vjet, bëhen zgjedhje për një të tretën (1/3) e senatorëve.
9. Mbajtja e seancave është tejet e rëndësishme për secilin kuvend, sepse në atë mënyrë ai ushtron pjesën më të madhe të detyrave në kuadër të sesionit kuvendor, përkatësisht legjislaturës. Rregullorja e Punës së Kuvendit përcakton se kush mund të thërrasë seancën kuvendore, konfirmimin e rendit të ditës, kohën e fillimit dhe përfundimit të saj, kuorumin e domosdoshëm për punë dhe vendimmarrje, shtyrje dhe ndërprerje të seancës, thirrjet për seancë, renditjen e diskutimeve gjatë saj, pjesëmarrësit në seancë dhe renditjen e folësve, kryesimin e seancës dhe ruajtjen e rendit, mënyrën e votimit e kështu me radhë.
10. Seancën e Kuvendit e thërret Kryetari i tij, e këtë ai mund ta bëjë me iniciativë të vet apo me iniciativë të Qeverisë, ose të një numri të caktuar të deputetëve. Në fillim të seancës përcaktohet rendi i ditës, por para kësaj duhet vërtetuar nëse ekzistojnë kushtet e seancës për diskutim dhe vendimmarrje të plotfuqishme (numri minimal i deputetëve ashtu që Kuvendit të punojë dhe të marrë vendime pa pengesa). Ky kuorum i punës mund të përcaktohet në mënyra të ndryshme, por më së shpeshti është gjysma e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Ky numër diku mund të zvogëlohet edhe deri në një të tretën, me qëllim të pamundësimin të pengimit të punës së Kuvendit. Natyrisht, duhet theksuar që në rastin e dallimeve

mes kuorumit për vendimmarrje dhe kuorumit për diskutim, i pari është gjithmonë më i madh se gjysma e numrit të përgjithshëm të deputetëve.

11. Kuvendi efektivisht punon në seancat e tij, por çështja themelore në çdo seancë është çështja e rendit të saj të ditës. Deputetët nuk mund të flasin për gjithçka në seanca parlamentare e as të gjithë të flasin njëkohësisht. Për këtë arsye, duhet përcaktuar saktë renditja e temave për të cilat do të diskutohet në seancë, por edhe renditja e fjalës së deputetëve të caktuar. Në sistemet në të cilat ndarja e pushtetit realizohet në formë të izolimit të pushtetit, pra ndarja e prerë (e fortë, rigjide) e pushtetit, siç ndodh në sistemet presidenciale, vetë Parlamenti vendos për rendin e ditës. Ky funksion zakonisht i besohet joformalisht organit që përbëhet nga Kryetari i Parlamentit, kryetarët e këshillave dhe komisioneve parlamentare, si dhe përfaqësuesit e të gjitha partive parlamentare. Në sistemet në të cilat ndarja e pushtetit është fleksibile (elastike), si në sisteme parlamentare, e drejta për të marrë pjesë në përcaktimin e rendit të ditës i jepet edhe Qeverisë, gjithsesi me ndikim të kufizuar në atë caktim, gjë që përfundimisht është në interes të autonomisë së Parlamentit. Në ditën e sotme, zgjidhjet në këtë drejtim janë të ndryshme, por ajo që është e dukshme është ndikimi përditë e më i madh i qeverive në caktimin e rendit të ditës së Parlamentit.
12. Vendimet për pikat e veçanta të rendit të ditës merren me votim në seancat parlamentare, të cilat mund të jenë publike dhe të mbyllura. Nëse votimi është publik, atëherë votohet me ngritje dore, ose në rastin e votimit elektronik, me shtypjen e pullës që gjendet në bankën e deputetit. Në rast se votimi është i fshehtë, atëherë votohet me anë të fletëvotimeve, të cilat pas votimit, hidhen në kutinë e votimit. Megjithatë, pa marrë parasysh teknikën e votimit, çështja themelore tek vendimi me votë është se kur merret ai vendim, përkatësisht me çfarë shumice duhen votuar vendimet. Kur nuk ekziston ndonjë përcaktim tjetër për këtë, zakonisht mjafton shumica e kuorumit, pra shumica e votave nga kuorumi i pranishëm. Por, për vendimet mbi çështje të caktuara, Kushtetuta mund të kërkojë të ashtuquajturën shumicë të kualifikuar (për çështje si, p.sh. votimi i mosbesimit të Qeverisë, votimi i ndryshimeve kushtetuese, etj.). Në këtë rast, bëhet fjalë për shumicën absolute të anëtarëve të Parlamentit, pra për shumicën që nuk llogaritet me kuorumin e të pranishmëve, por me numrin e anëtarëve të Parlamentit të përcaktuar me Kushtetutë. Për këtë arsye, kjo nuk është më **shumicë kuorumi**, por **shumicë kushtetuese**, e ajo përbën gjysmën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Parlamentit plus një. Gjithashtu, mund të kërkohet edhe shumica e dy të tretave (2/3), shumica e tri të pestave (3/5) e të tjera, nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Parlamentit.

Neni 68.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ia ka kushtuar nenin 68 një temë të vetme, që ka të bëjë me seancat e Kuvendit të Republikës së Kosovës - publicitetit të punës së tij. Paragrafi 1 i këtij neni përcakton që mbledhjet e Kuvendit të Republikës së Kosovës janë publike. Ajo që vlen të theksohet për punën, si të kuvendeve të tjera,

por edhe të Kuvendit të Republikës së Kosovës, është fakti që ekzistojnë dy forma të punës parlamentare, si: 1) ajo plenare (seanca); 2) në komisione parlamentare, apo këshilla (në seancat e tyre). Për punën e komisioneve parlamentare do të flitet në pjesën ku komentohen nenet 77 dhe 78 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilët i kushtohen themelimit, kompetencave dhe procesit të punës së tyre.

2. Seancat plenare të Kuvendit janë publike, përveç në rastet kur Kuvendi vendos ndryshe. Seancat, në pajtim me vendimin e Kryesisë së Kuvendit, transmetohen në media, por edhe regjistrohen në mënyrë elektronike. Secili diskutim regjistrohet në gjuhën në të cilën është bërë. Në procesverbal shënohen pikat e rendit të ditës, diskutimet e përmbledhura si dhe vendimet që merren nga Kuvendi (neni 43, paragrafi 1, Rregullorja e Punës së Kuvendit Republikës së Kosovës). Transkriptet e seancave, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni të Rregullores ruhen në arkivin e Kuvendit, publikohen në faqen elektronike të Kuvendit, u dërgohen deputetëve dhe vihen në dispozicion të publikut, në pajtim me ligjin (neni 43, paragrafi 2 i Rregullores së Punës).

Neni 68.2

1. Megjithatë, ky publicitet i përcaktuar dhe i garantuar me Kushtetutë i seancave të Kuvendit të Republikës së Kosovës mund të anashkalohet në raste të caktuara, ashtu që seancat e caktuara të mbyllen për publikun. Kjo mund të ndodhë vetëm në rastet e përcaktuara me Rregulloren e Punës së Kuvendit, si dhe me kërkesë të Presidentit të Republikës së Kosovës, kryeministrit ose një të tretës (1/3) së deputetëve. Vendimi për përjashtimin e publikut merret në mënyrë transparente dhe të hapur dhe kërkon shumicën e dy të tretave (2/3) të deputetëve të pranishëm (neni 68, paragrafi 2).

Neni 69 [Orari i Seancave dhe Kuorumi]

- (1) **Kuvendi i Kosovës punimet vjetore i zhvillon në dy sesione.**
- (2) **Sesioni pranveror fillon të hënën e tretë të muajit janar, kurse sesioni vjeshtor fillon të hënën e dytë të muajit shtator.**
- (3) **Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit.**
- (4) **Kuvendi i Kosovës mblidhet në seancë të jashtëzakonshme me kërkesë të Presidentit të Republikës, të Kryeministrit ose të një të tretës (1/3) të deputetëve.**

Neni 69

1. Kohëzgjatja e periudhës brenda së cilës Kuvendi ushtron mandatin e tij, pra legjislatura, përcaktohet, sipas rregullit, me Kushtetutë. Për këtë, kjo kohëzgjatje nuk është sipas vullnetit të Kuvendit. Megjithatë, kjo nuk ndodh edhe me sesionet

e Kuvendit, sepse në parim, Kuvendi përcakton sesionet e veta, të cilat paraqesin periudhën gjatë së cilës Parlamenti takohet apo punon (përmes organeve të punës, ose seanca plenare). Në disa shtete, Parlamenti është në sesion të përhershëm, kurse në të tjerat është në sesion kur thirret, zakonisht nga shefi i shtetit, i cili këtë e bën kur përmbushen kushtet e caktuara, ose në diskrecion të vet. Në një numër të caktuar shtetesh, fillimi dhe fundi i sesionit (ose vetëm fillimi i sesionit) përcaktohen në vetë Kushtetutën e në raste të tilla, shprehet autonomia e pushtetit ligjvënës (legjislativ) kundrejt pushtetit ekzekutiv, krejt kjo në përputhje me parimin e ndarjes së pushtetit.

2. Sesionet e Kuvendit mund të jenë të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Sesionet e rregullta lidhen me një ditë të përcaktuar saktë të muajit, kurse ato të jashtëzakonshme janë ato që propozuesi i autorizuar i propozon në kohën mes dy sesioneve të rregullta dhe që mbahen në atë kohë. Zakonisht, ekzistojnë dy sesione të rregullta, njëri pranveror e tjetri vjeshtor. Në praktikën parlamentare kushtetuese gjenden zgjidhje të ndryshme në këtë drejtim, ashtu që sesioni i rregullt pranveror mund të fillojë, për shembull, në ditën e parë të punës së muajit shkurt, ditën e parë të punës së marsit, e të tjera, kurse sesioni vjeshtor mund të fillojë, për shembull, në ditën e parë të punës në shtator, ditën e parë të punës në tetor, e kështu me radhë. Edhe në rast të gjendjes së jashtëzakonshme, ekzistojnë zgjidhje të ndryshme në lidhje me propozuesit e autorizuar që mund ta kërkojnë atë, por më së shpeshti në këtë cilësi mund të paraqiten, për shembull, më së paku një e treta (1/3) e numrit të përgjithshëm të deputetëve, Qeveria (me rend të ditës të para-përcaktuar), shefi i shtetit, e në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, Kuvendi takohet pa thirrje.
3. Secila kushtetutë zakonisht përcakton kuorumin, apo numrin e anëtarëve të Parlamentit, ose të dhomave të tij, i cili duhet të jetë i pranishëm ashtu që Kuvendi apo dhoma e tij të mund të vendosë në mënyrë të plotë. Ky emërtim vjen nga fjala latine *quorum* (i cili prapë është fragment i fjalisë "*quorum contione agitor*", pra ata, prania e të cilëve është e nevojshme). Po të mos kishte një dispozitë të tillë, në secilin vendim të Kuvendit do të duhej të ishin të gjithë pjesëtarët e Parlamentit, përkatësisht këshillave të tij, të cilët së bashku përbëjnë një «organ». Për këtë arsye, për t'u konsideruar si organ përkundër numrit më të vogël të anëtarëve në raste të caktuara, është e domosdoshme që kjo të përcaktohet me të njëjtën normë që organizon organin, pra do të thotë që kjo dispozitë duhet të gjendet në të njëjtën Kushtetutë. Natyrisht, kuorumi mund të përcaktohet në mënyra të ndryshme, ashtu që duke marrë parasysh autonominë e garantuar të Kuvendit, ky numër i anëtarëve është i domosdoshëm për vendimmarrje të vlefshme, diku i caktuar në një të tretën e anëtarëve, diku tjetër gjysma plus një, e diku tjetër një e katërta e anëtarëve të Kuvendit, apo dhomave të tij.
4. Kur kërkohet prania e një të tretës së anëtarëve, mendohet më së paku një e treta, kështu që, nëse numri i përgjithshëm i deputetëve të një Parlamenti është 120, atëherë kuorumi është 40 e më tepër. Nëse numri i përgjithshëm nuk plotpjesëtohet me tre, atij i shtohen, e jo i hiqen, aq njësi sa ka nevojë për t'u plotpjesëtuar me tre.

Kështu, për shembull, nëse Kuvendi ka 305 deputetë, kuorumi për vendosje të plotfuqishme është 102, sepse numri prej 101 deputetësh nuk do të arrinte një të tretën. Pjesëtimi bëhet përmes numrit *legal, e jo real* të deputetëve në kuvend, apo në dhomat e tij. Në rastin konkret, kuorumi do të ishte 102, edhe nëse 100 deputetë do të abstenonin vazhdimisht dhe të mos bënin betimin (atëherë numri real i deputetëve do të ishte 205). Kështu, për Kuvendin është e lehtë të përcaktohet numri, pasi që numri legal i deputetëve gjithmonë mund të vërtetohet.

5. Për kuorumin flitet më hollësisht në Rregulloren e punës së Kuvendit, si dhe në rregulloret e punës së dhomave të Parlamentit (nëse Kuvendi nuk ka vetëm një dhomë). Kur bëhet fjalë për votimin, duhet thënë që dallojmë, më së shpeshti, votimin publik (ngritjen e dorës për «për», «kundër» apo «abstenim») dhe atë të fshehtë. Gjithashtu, në kohët më të reja përdoret edhe votimi i regjistruar (që përfshin votimin elektronik), si dhe votimin me thirrjen individuale të deputetëve. Votimi publik mund të paraqitet në dy forma: të ulur dhe në këmbë (për shembull, «kush është për të ulët, kush është kundër të ngrihet në këmbë»), si dhe me emër, apo thirrjen e emrit të deputetit, ashtu që ai të ngrihet dhe të deklarojë me zë nëse është për apo kundër propozimit. Votimi publik është rregull, kurse ai i fshehtë është përjashtimi. Kuorumi është gjithsesi i nevojshëm gjatë vendimit, apo në rast të votimit, por nëse kuptohet më ngushtë, as diskutimet në parlament nuk do të mund të bëheshin pa kuorum. 6. Çështjen e kuoromit mund ta ngrejë kryetari i Kuvendit, kryetari i dhomës së Kuvendit, apo anëtarët e dhomës së Kuvendit (të ndihmuar nga një numër i caktuar i deputetëve). Kryetari i Kuvendit apo ai i dhomës së Kuvendit shtron çështjen e kuoromit, nëse dyshon që ekziston numri i mjaftueshëm i deputetëve në Kuvend, apo në dhomë, e pas kësaj mund të kërkojë «thirrjen» apo «numërimin», kurse anëtarët e dhomës mund të kërkojnë përcaktimin e kuoromit para votimit. Rregullorja e punës mund të përcaktojë edhe obligimin e deputetit që të mos largohet nga salla, nëse iniciohet çështja e kuoromit, e mund të miratohet edhe rregulli si vijon: «Nëse edhe largohen, konsiderohet që janë të pranishëm dhe kanë votuar kundër». Ky rregull ka për qëllim luftimin e obstrukcioneve, pra pengimin e rendit parlamentar, kurse disa teoricienë dyshojnë nëse rregulli i tillë është në përputhje me Kushtetutën.

Neni 69.1

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë një viti kalendarik kryen punët e tij në dy sesione të rregullta, dhe atë: sesioni pranveror dhe atë vjeshtor (neni 69, paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës). Kjo renditje e seancave gjithashtu është përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës - neni 37, paragrafi 1).

Neni 69.2

1. Kushtetuta saktëson edhe kohën në të cilën bëhen sesionet e rregullta të Kuvendit, duke përcaktuar kështu që sesioni i parë i rregullt (pranveror) fillon të hënën e tretë në janar, kurse sesioni i dytë (vjeshtor) i rregullt fillon të hënën e dytë në shtator

(neni 69, paragrafi 2 i Kushtetutës). Në pajtim me nenin 37, paragrafi 3, të Rregullores së Punës, Kryetari i Kuvendit informon deputetët për datat e fillimit dhe përfundimit të sesionit të punës së Kuvendit. Rendi në seancat e Kuvendit janë të parashikuara me nenin 39 të Rregullores së Punës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton që organi më i lartë përfaqësues i Kosovës të zhvillojë punën e tij në seanca plenare dhe në komisione (paragrafi 1).

2. Kuvendi zhvillon punën në bazë të kalendarit që propozohet nga Kryesia, në konsultim me Qeverinë, me kryetarët e grupeve parlamentare dhe kryetarët e komisioneve të Kuvendit. Kalendar miratohet nga ana e Kuvendit, kurse Kryesia e Kuvendit përcakton datën dhe vendos për rendin e ditës të seancës së Kuvendit. Seancat plenare të Kuvendit zakonisht mbahen dy herë në muaj, kurse java plenare zakonisht fillon të enjten. Kryesia, në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare, mund të dalë edhe nga ky rend dite, kur e konsideron të nevojshme.

Neni 69.3

1. Në vërejtjet e përgjithshme për nenin 69, i cili është objekt i komenteve tona, kemi folur për kuorumin, si numër i domosdoshëm i deputetëve për vendimmarrje të plotë të Kuvendit. Kur bëhet fjalë për Kuvendin e Republikës së Kosovës, duhet thënë që ai arrin kuorumin kur të pranishëm janë më shumë se gjysma e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Duke konsideruar që ky Kuvend ka 120 deputetë, kuorumi është 61 (neni 69, paragrafi 3 i Kushtetutës).

Neni 69.4

1. Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit të Republikës së Kosovës është forma e dytë e punës së tij. Kuvendi mund të thirret në seancë të jashtëzakonshme vetëm kur përmbushen kushtet e caktuara, të cilat i përcakton vetë Kushtetuta (neni 69, paragrafi 4). Sipas nenit 38 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryesia mund të thërrasë seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit për të shqyrtuar një apo më shumë çështje urgjente. Këtu është tejet me rëndësi të theksohet se kush janë propozuesit e autorizuar për thirrjen e një seance të tillë të Kuvendit. Pra, seancën e jashtëzakonshme mund ta thërrasin: a) Presidenti i Republikës së Kosovës; b) Kryetari i Qeverisë së Republikës së Kosovës (Kryeministri), c) një apo më shumë grupe parlamentare, të cilët përfaqësojnë jo më shumë se një të tretën e deputetëve, gjegjësisht dyzet (40) deputetë të Kuvendit. Kërkesa e tillë për thirrjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet të përmbajë çështjen(t) të cilat duhen shqyrtuar, si dhe arsyetimin se pse ato konsiderohen urgjente dhe të rëndësishme. Kjo do të thotë që seanca e jashtëzakonshme e organit më të lartë përfaqësues të Kosovës mund të thirret vetëm nëse plotësohen dy kushte: njëri, që ka të bëjë me subjektet, të cilët mund të kërkojnë seancën e jashtëzakonshme, kurse i dyti ka të bëjë me përmbajtjen e punës. Rendi i ditës i seancave të jashtëzakonshme duhet përcaktuar paraprakisht dhe nuk mund të ndërrohet në seancë.

Neni 70 [Mandati i Deputetëve]

- (1) Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues.**
- (2) Mandati i deputetit të Kuvendit të Kosovës fillon ditën e certifikimit të rezultatit të zgjedhjes.**
- (3) Mandati i deputetit mbaron ose bëhet i pavlefshëm, nëse:**
 - 1. nuk bën betimin;**
 - 2. jep dorëheqjen;**
 - 3. emërohet anëtar i Qeverisë së Kosovës;**
 - 4. përfundon mandati i Kuvendit;**
 - 5. mungon gjashtë (6) muaj rresht në seancat e Kuvendit. Në raste të veçanta, Kuvendi i Kosovës mund të vendosë ndryshe;**
 - 6. dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale me një ose më shumë vjet burgim;**
 - 7. ajo/ai vdes.**
- (4) Vendet e liruara të deputetëve në Kuvend, plotësohen menjëherë, në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligjin.**

Neni 70

1. Kuvendi është organ përfaqësues, i përbërë nga deputetët, që janë përfaqësues të popullit. Kështu, secili kuvend (parlament) është organ përfaqësues dhe bartës i funksionit më të rëndësishëm të pushtetit shtetëror - kushtetues dhe ligjvënës, por nuk është bartës i sovranitetit e as është mbi Kushtetutën. Në fakt, në demokraci, bartësi i sovranitetit është populli, kurse Parlamenti dhe organet e tjera të pushtetit, i nënshtrohet Kushtetutës, si dhe duhet të punojë brenda kornizave të caktuara me Kushtetutë.²⁵⁵ Kështu, e drejta është më e fuqishme se Parlamenti, i cili në fakt është hartuesi i saj formal, kurse kjo arrihet ashtu që Parlamenti udhëhiqet sipas Kushtetutës. E vetmja mbrojtje nga fuqia e tepërt e Parlamentit është vetë Kushtetuta, kurse ekzekutivi dhe gjyqësori i nënshtrohen ligjit.
2. Kuptimi i kushtetutshmërisë, përveç tjerash, qëndron edhe në faktin që asnjë organ shtetëror nuk mund të rregullojë vetveten, me vullnetin e tij vetjak, por që të gjitha organet shtetërore të rregullohen me vullnetin autoritativ të tjetrit. Për këtë, kushtetutat rregullojnë hollësisht vetëm organizimin dhe punën e pushtetit ligjvënës (Kuvendit), kurse të njëjtat çështje në lidhje me ekzekutivin dhe gjyqësorin rregullohen vetëm në parime, duke i lënë ligjeve që të parashikojnë detajet. Këtu, kur flasim për Kuvendin, qëndron kuptimi i nënshtërimit të pushtetit ndaj të drejtës objektive dhe kufizimit të pushtetit vetanak. Prej të gjithë organeve shtetërore, pushteti kushtetues është sovran, i lirë dhe i panënshtuar ndaj të drejtës. Në ushtrimin e kompetencave të tij, Kuvendi është i obliguar t'u përmbahet ligjeve të përparshme që i ka miratuar deri në kohën kur i ndryshon sipas

²⁵⁵ Për më shumë, krahaso: R. C. Van Caengem, (1995), *An Historical Introduction to Western Constitutional Law* Cambridge University Press: Cambridge, sidomos Kapitulli 8 (“The Bourgeois Nation State”) dhe Kapitulli 9 (“The Liberal Model Transformed or rejected”).

procedurës së parashikuar, (këtu zbatohet parimi i njohur i të drejtës romake, *dura lex, sed lex* - e drejta është e rëndë, por është ligj).²⁵⁶

3. Kuvendi, si organi më i rëndësishëm përfaqësues, përfaqëson gurthemelin e regjimit politik, të cilin me kohë e ka themeluar borgjezia fitimtare dhe së këndejmi, përfaqëson simbolin e rendit të ri që ajo ka krijuar, por njëkohësisht, edhe rendin e larguar feudal. Kuvendi është krijuar për t'iu kundërvënë pushtetit të pakufizuar të monarkut absolut, ashtu që, për aq sa është e mundur, të ndalohej pushteti i tij absolut. Megjithatë, duhet theksuar këtu një fenomen e tendence karakteristike. Deri diku rreth Luftës së Parë Botërore, Parlamenti është konsideruar si institucioni qendror përfaqësues, por sot qendra e përfaqësimit, ngadalë por sigurt, bartet nga legjislativi tek ekzekutivi. Ekziston prirja që qendër të bëhet organi i pushtetit ekzekutiv, sidomos aty ku për bazë ka partinë shumicë në parlament.
4. Kur flasim për mandatin e deputetëve (anëtarëve) të Kuvendit, duhet thënë që marrëdhënia mes përfaqësuesve të popullit dhe zgjedhësve është një prej çështjeve më themelore në teorinë e përfaqësimit dhe, në këtë marrëdhënie, deputetët nuk i nënshtrohen kurrfarë mandati të detyrueshëm. Në fakt, ekzistojnë dykuptimësi të skajshme. Sipas të parës, përfaqësuesit janë të pavarur nga votuesit, kurse sipas të dytës, ata janë llogaridhënës para votuesve të vet. Kuptimi i parë është pjesë përbërëse e *teorisë së mandatit të lirë apo përfaqësues* si dhe kuptimit të së drejtës së votimit si funksion, kurse e dyta është shprehje e *teorisë së mandatit të lidhur apo imperativ* dhe të drejtës së zgjedhjes, si e drejtë individuale e qytetarit. Kështu, sipas teorisë së parë, përfaqësuesit e votuesve fitojnë me zgjedhje pushtetin nga i gjithë populli, e jo nga votuesit e njësisë së tyre zgjedhore. Në momentin e votimit, roli i zgjedhësit shteron, dhe kështu, pas atij momenti, përfaqësuesi i zgjedhur është i lirë deri në skadimin e mandatit të tij përfaqësues. Kështu, revokimi i përfaqësuesit nga ana e votuesit nuk vjen në konsiderim, sepse i pengon funksionimit të sistemit përfaqësues, por edhe nuk është në pajtim me të. Sipas teorisë së dytë, zgjedhësit nuk bartin pushtetin suprem me zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre, por janë vetë titullarë të sovranitetit. Kështu, në çfarëdo kohe, ata mund ta revokojnë apo tërheqin përfaqësuesin e tyre, i cili nuk i përmbahet programit zgjedhor apo nuk është i kënaqshëm në kryerjen e punëve të tij. Këtu, lidhja mes votuesve dhe përfaqësuesve të tyre nuk ndërpritet me aktin e zgjedhjes.
5. Kështu, kur flasim për tërheqjen e përfaqësuesit, duhet thënë që ky institut lidhet me mandatin imperativ, kurse e drejta për mandat të lirë përjashton revokimin. Në fakt, instituti i tërheqjes bazohet tek parimi që deputeti përfaqëson qytetarët që e kanë zgjedhur, kështu që ata kanë të drejtë të zgjedhin deputetët e tyre, por edhe të vlerësojnë aktivitetin e tyre dhe të shprehin pakënaqësinë me punën e tyre. Pra, ata kanë të drejtë, sipas procedurës së përcaktuar me kushtetutë dhe ligj, të ndërrojnë

²⁵⁶ Për raportin ndërmjet kuvendit dhe demokracisë, shih më gjerësisht: Congleton, D. Roger (2010), *'Perfecting Parliament: Constitutional Reform, Liberalism and the Rise of Western Democracy'* Cambridge University Press: Cambridge.

përfaqësuesit e zgjedhur, të cilët veprojnë jashtë kuadrit të mandatit imperativ. Revokimi në sisteme parlamentare përdoret tejet rrallë, sepse është në kundërshtim me parimin e mandatit të lirë, kurse kërcënimi i revokimit do të ishte instrument i presionit mbi deputetin, i cili pastaj do të ishte i detyruar të përfaqësonte vetëm interesat e ngushta të votuesve që e kanë zgjedhur atë.

6. *Mandati imperativ (i lidhur)* përfaqëson lidhjen juridike të përfaqësuesit me vullnetin e zgjedhësve të tij dhe ai është aplikuar së pari në shoqëritë feudale, në të cilat kanë ekzistuar të ashtuquajturit kuvende të klasave (kastave). Ky mandat, shumë më vonë, është aplikuar edhe në BRSS si dhe në vendet e demokracisë popullore, të cilat rregullimin e tyre kushtetues e bazonin në modelin sovjetik kushtetues.²⁵⁷ Mandati imperativ karakterizohet nga tri shenja thelbësore, që janë: 1) zgjedhësit kanë të drejtë t'i japin udhëzime përfaqësuesve të tyre; 2) përfaqësuesit kanë për obligim t'i raportojnë zgjedhësve të tyre për punën e vet; 3) zgjedhësit mund të revokojnë përfaqësuesit e tyre edhe para përfundimit të afatit për të cilin janë zgjedhur.
7. *Mandati i lirë (përfaqësues)* ka lindur pas atij imperativ, dhe shumë më vonë (gjatë shekujve XIX dhe XX), në vendet në të cilat është vendosur sistemi shumëpartiak parlamentar. Sipas teorisë që përkrahte mandatin e lirë, përfaqësuesit në organin përfaqësues nuk përfaqësojnë zgjedhësit e caktuar (ata përmes zgjedhjeve i vendosin në funksionin e tyre), por kombin të pandarë. Funkcioni i përfaqësuesit përcaktohet me kushtetutë dhe ligje, kurse ushtrimi i tij nuk varet nga vullneti i zgjedhësit. Edhe pse në kohët e reja, me paraqitjen e partive politike, deputetët lidhen me programin politik të partisë së tyre dhe humbin lirinë (i nënshtrohen disiplinës partiake dhe bëhen të dëgjueshëm të liderit), ende mbetet veçori e rëndësishme e mandatit të lirë që mes zgjedhësve dhe përfaqësuesve të mos ekzistojë lidhja juridike, por ajo politike.²⁵⁸
8. Pas zgjedhjeve parlamentare (kuvendore), të rregullta apo të parakohshme, bëhet konstituimi i Parlamentit të ri. Për t'u konstituuar, duhen bërë verifikimet e mandateve të deputetëve, dhe Kuvendi të organizojë zgjedhjen e funksionarëve të tij, të cilët do të udhëheqin punën e tij. Seancën e parë, konstituive, të Kuvendit, pas zgjedhjeve të përgjithshme të kryera, sipas rregullit, e thërret kryetari i Kuvendit i legjislaturës së kaluar, në ditën e parë, pas dorëzimit të raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zgjedhjet e kryera (sigurisht, zgjidhjet në këtë drejtim mund të jenë të ndryshme). Më së shpeshti, seanca kryesohet (deri në zgjedhjen e kryetarit) nga deputeti më i vjetër në moshë, i ndihmuar edhe nga një apo më shumë deputetë më të rinj më moshë (përpjekje për të bashkuar rininë dhe përvojën), si dhe një person ekspert që punon profesionalisht në kuvend - sekretari i Kuvendit.

²⁵⁷ Në këto vende bën pjesë edhe Jugosllavia e Dytë (Komuniste) (1945-1992).

²⁵⁸ Prej kësaj, përfaqësuesit janë plotësisht të pavarur nga votuesit, votojnë dhe flasin sipas vullnetit të tyre, e jo sipas vullnetit të zgjedhësve.

9. Në seancën e parë konfirmohen mandatet e deputetëve, zgjidhen kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit dhe anëtarët e organeve të tij të punës, si dhe emërohet sekretari. Kushtetuta e secilit shtet saktësisht përcakton afatin deri në të cilin duhen mbajtur zgjedhjet për përfaqësuesit e popullit. Menjëherë pas zgjedhjeve të kryera për kuvend, apo për dhomat e tij (nëse ka), këshillat e votimit të secilës njësi zgjedhore i dorëzojnë autorizimet tek përfaqësuesit e zgjedhur të popullit, në një formular të caktuar, të cilin më së shpeshti, e mandaton ministri i punëve të brendshme. Ky *autorizim* apo *mandat* (sipas të cilit edhe vetë shërbimi, apo funksioni, quhet mandat) vlen për kohësisht. Ai i nënshtrohet kontrollit në kuptimin e rregullsisë dhe vlefshmërisë së aktit, rezultat i të cilit është (akti zgjedhor). Vlerësimi dhe vërtetimi i vlefshmërisë (Kushtetuta mund ta përcaktojë si rregullsi) së mandateve quhet verifikim apo konfirmim i mandateve (autorizimeve). Në teori, ka mosmarrëveshje mbi faktin nëse verifikimi i mandateve është akt i pushtetit gjyqësor apo ligjvënës. Nëse akti është i pushtetit gjyqësor, i duhet lënë gjykatave (sidomos Gjykatës Kushtetuese, nëse ekziston). Numri i madh i kushtetutave merr si qëndrim që konfirmimi i mandatit të anëtarëve të Kuvendit është kusht paraprak, por i domosdoshëm, për punën e pushtetit ligjvënës, pra që është akt themelor i konstituimit të organit ligjvënës. Verifikimi i mandateve mbetet punë parlamentare (e Kuvendit), por dhomat (nëse ka dy e më shumë) nuk e bëjnë këtë së bashku, por secila dhomë për anëtarët e vet, ndaras.
10. Ditën e verifikimit të mandateve të deputetëve të rinj (anëtarëve të Kuvendit), si përfaqësues të popullit, ndërpritet funksioni i deputetëve mandati i të cilëve ka përfunduar. Kuvendi vetëvendos për konfirmimin e *mandateve të deputetëve*, me të cilën gjë përfundimisht vendos për ligjshmërinë e zgjedhjeve, kurse deputetët marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet në ditën e vërtetimit të mandateve të tyre. Ky vërtetim bëhet në bazë të verifikimit të zgjedhjeve dhe raportit të komisionit qendror zgjedhor për zgjedhjet e kryera, si dhe duhet përfunduar në një afat të caktuar (për shembull, mund të jetë afat 30-ditor nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve). Në seancë konstituive, Kuvendi zgjedh komisionin (më së shpeshti me tre anëtarë), i cili i dorëzon Kuvendin një raport mbi atë nëse të dhënat nga verifikimi i zgjedhjeve të secilit deputet përputhen me të dhënat e raportit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si dhe nëse vërtetimet janë lëshuar nga organet e autorizuar. Në bazë të këtij raporti, personi që kryeson seancën konstituive të Kuvendit konstaton që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dorëzuar raportin për zgjedhjet e kryera, si dhe mbi atë se cilat konfirmime për zgjedhje janë në përputhje me atë raport. Në këtë mënyrë *konfirmohet (verifikohet) mandati* i atyre deputetëve, kurse Kuvendi mund të fillojë punë kur të jetë konfirmuar mandati i më shumë se gjysmës së deputetëve. Në vazhden e procedurës së konstituimit, Kuvendi zgjedh udhëheqësit dhe anëtarët e grupeve punuese.
11. Dispozitat e hollësishme mbi procedurën e verifikimit të mandateve të deputetëve gjenden në Ligjin për zgjedhjet dhe Rregulloren e punës së Kuvendit. Kuvendi i sapozgjedhur shqyrton vlefshmërinë e mandateve të anëtarëve të tij. Vetëm verifikohen mandatet e deputetëve të zgjedhur, kurse aktet e emërimit të tyre thjesht lexohen në Kuvend dhe merren në dijeni. Është fakt që tek emërimi i

deputetëve nuk mund të ketë parregullsi objektive (siç është për shembull parregullsia e veprimeve në zgjedhje), por mund të ketë mangësi subjektive të personit të emëruar (për shembull të mos plotësojë kushtet për deputet).

Neni 70.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin e saj 70, paragrafi 1, përcakton që deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen ndonjë mandati imperativ. Në fakt, demokracia, në kuptimin e saj burimor, paraqet pushtet të popullit, kurse mendimi politik modern ka shprehur atë ide themelore të demokracisë me parimin e sovranitetit të popullit ndaj secilës qeveri, organizatë apo cilitdo interes grupor. Për t'i mundësuar popullit të qeverisë drejtpërdrejt, në organizata vendore dhe punuese, si dhe tërthorazi përmes përfaqësuesve të zgjedhur në institucionet politike të të gjithë shoqërisë, duhet hequr çdo monopol pushteti. Kjo do të thotë që sistemi politik duhet ndërtuar në atë mënyrë që asnjë parti politike të mos mund t'ia nënshtrojë shtetin interesave të saj partiake. Ekzistenca e opozitës politike, në këtë kuptim, është gjendje normale e bashkësisë së lirë politike, që në anën tjetër do të thotë që asnjë organizatë politike apo grup shoqëror nuk mund të ketë pushtet monopolist mbi institucionet kulturore dhe mjetet e komunikimit në masë.²⁵⁹
2. Nga sa u parashtrua del që demokracia është e domosdoshme, jo vetëm në politikë, por edhe në fushat e ekonomisë dhe kulturës, në format indirekte («përfaqësuese») dhe direkte («pjesëmarrëse»). Demokracia përfaqësuese është fryt i padiskutueshëm i civilizimit bashkëkohor, që do të thotë zgjedhje dhe ndryshueshmëri e pushtetit shtetëror. Përfaqësuesit e popullit në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilët mbajnë përgjegjësi për marrjen e vendimeve kyçe politike, zgjidhen përmes zgjedhjeve të lira, të fshehta dhe direkte. Ata janë përgjegjës para zgjedhësve të tyre dhe mund të përjashtohen kur keqpërdorin pushtetin ose e përdorin për interesa vetjakë të caktuar. Përgjegjësia e tillë është e sanksionuar me Kodin e Mirësjelljes së Deputetit të Kuvendit (Shtojca nr. 3), i cili është pjesë përbërëse e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës.
3. Në fakt, deputetët janë të obliguar t'i përmbahen ligjit dhe që në çdo rast të veprojnë në përputhje me besimin e popullit që u është dhënë, duke pasur veçanërisht vëmendje ndaj parimeve vijuese: vetëpërmbajtja, integriteti moral, objektiviteti, përgjegjshmëria, respekti dhe shkathtësitë udhëheqëse. Deputetët marrin vendime që janë vetëm në interesin publik dhe nuk mund të marrin vendime për përfitime financiare apo materiale për vete, familjen apo miqtë e tyre. Deputetët duhet të kenë moral në ushtrimin e funksioneve të veta dhe, së këndejmi, nuk mund të kenë kurrfarë obligimi financiar ndaj individëve apo organizatave, të cilat mund të ndikojnë në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare. Objektiviteti dhe përgjegjshmëria janë parime që duhen zbatuar dhe respektuar nga deputetët në

²⁵⁹ Për rëndësinë e demokracisë për ekzistencën e një shoqërie, kushtet për sigurimin e saj, si dhe format e saj, shih më shumë: David Held, (2006), *Models of Democracy*, Stanford University Press: Stanford;

ushtrimin e funksioneve të veta, që janë tejet të rëndësishme për shtetin dhe qytetarët që përfaqësojnë. Kështu, deputetët duhet të marrin vendime në mënyrë objektive, pra vetëm në bazë të meritave dhe interesit publik dhe në mënyrë të përgjegjshme, pra të mbajnë përgjegjësi për vendimet e veta. Nga deputeti gjithashtu kërkohet që, në ushtrimin e funksionit të tij të përfaqësuesit të popullit, të jetë i ndershëm, ashtu që të shpjegojë drejtpërdrejt dhe të paraqesë secilin interes të tij privat, i cili mund të ketë rëndësi për detyrat e tij publike, ndërsa përmes udhëheqjes dhe shembujve konkretë, deputetët duhet të sigurojnë përkrahjen e këtyre parimeve.

4. Për të penguar përqendrimin e tepërt të pushtetit, ai ndahet në shtyllat ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore. Për të siguruar pavarësinë e plotë të pushtetit gjyqësor, gjyqtarët zgjidhen me mandate më të gjata dhe të përhershme, kurse ndërhyrja në punën e tyre trajtohet si vepër penale. Për të pasur zgjedhje politike vërtetë të lira, është e domosdoshme mundësia e paraqitjes së një numri më të madh të kandidatëve. Kjo përfshin edhe bashkimin e lirë të qytetarëve në parti politike, lëvizje, lidhje e organizata të ndryshme politike të formave të ndryshme, lirinë e shtypit, grumbullimit publik dhe fjalës. Përfaqësuesi politik i popullit është ai që në zgjedhje legjitime ka mbështetjen e shumicës. Rëndësia e kësaj çështjeje dëshmohet edhe nga fakti që nuk mund të ketë demokraci të qëndrueshme nëse nuk vlerësohet ajo që zgjedh populli, sepse demokracia kërkon që të respektohet zëri i popullit.
5. Në fakt, Kushtetuta e Republikës së Kosovës që në fillim përcakton se sovraniteti i Kosovës rrjedh nga shtetasit e saj, se u përket atyre dhe se zbatohet në pajtim me Kushtetutën, përmes përfaqësuesve të zgjedhur. Ajo që në disa vende, në aktin më të lartë të përgjithshëm të Republikës së Kosovës, është theksuar shumë është fakti që ky akt ndërtohet mbi respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njohura ndërkombëtarisht, dhe që të drejtat e liritë e njeriut janë garantuar me marrëveshjet dhe instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare, të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, theksohet që këto të drejta dhe liri të njeriut drejtpërdrejt zbatohen në territorin e Republikës së Kosovës dhe që mbizotërojnë, në rast konflikti, mbi çdo dispozitë dhe akt tjetër ligjor të institucioneve publike. Prej këtyre mund të konkludohet që ligjvënësi mundohet të theksojë synimin e Republikës së Kosovës që organizimin e pushtetit të saj ta themelojë mbi përkatësinë ndaj parimeve dhe vlerave evropiane. Vlerat evropiane karakterizohen mu nga mandati i lirë (përfaqësues) e jo ai i lidhur (imperativ) i deputetit,²⁶⁰ sepse mandati i lirë është një prej parimeve të pakontestueshme të përfaqësimit parlamentar, i cili në Bashkimin Evropian konsiderohet standard i demokracisë dhe të drejtës parlamentare.
6. Ligjvënësi, pra, me përcaktimin që deputetët të mos i nënshtrohen asnjë mandati imperativ (të lidhur), nuk e ka vënë në dyshim mandatin e lirë në kolizion në

²⁶⁰ Megjithatë, ndodh që në vende të caktuara mandati i lirë të vihet nën kontrollin e rreptë të partive, pra liderëve partiakë dhe me këtë, në vetë praktikën kushtetuese, ky parim “evropian” kthehet në fosil të së drejtës kushtetuese.

parimin e proklamuar kushtetues, sipas të cilit sovraniteti vjen nga populli, i përket atij dhe zbatohet përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirisht. Liria e deputetëve në mandatin e lirë paraqet në fakt pavarësinë e deputetit nga cilido vullnet, përveç atij të qytetarit. Natyrisht, këtu duhet thënë që mandati i lirë nuk i jep „lirinë“ deputetit të zgjedhë mënyrën në të cilën do ta ushtrojë mandatin. Thjesht, deputeti fiton mandatin për të përfaqësuar qytetarët, për të realizuar qëllimet personale politike. Raporti i mandatit si marrëdhënie qytetar-përfaqësues, nuk nënkupton të drejtën e deputetit që me vullnetin e tij të ndryshojë karakterin e atij raporti. Kështu, ligjvënësi, me vetë formulimin e dispozitës kushtetuese që “deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati imperativ”, e ka bërë shtetasin bartës të sovranitetit dhe i ka privuar partitë nga ai, që do të thotë se asnjë organ shtetëror, organizatë politike, grup apo individ (pra as deputeti) nuk mund të përvetësojë sovranitetin nga populli, e as të marrë pushtetin jashtë vullnetit të shprehur të popullit, aq më pak t’ia bartë atë partisë, qoftë ajo me listën e të cilës është zgjedhur, apo ndonjë tjetër.

7. Kjo do të thotë që partitë politike nuk mund të ushtrojnë pushtetin drejtpërdrejtë e as ta nënshtrojnë për vete, sepse përfaqësimi parlamentar bazohet mbi faktin që qytetarët i japin mandatin deputetit, kurse deputetët marrin vendime në organin ligjvënës, të cilat pastaj obligojnë të gjithë qytetarët dhe bashkësinë politike. Po të vepronte në anën tjetër, pra që të proklamonte mandatin e lidhur (imperativ), hartuesit e kushtetutës do të ofronin mundësi që partitë, të cilat përndryshe dominojnë në jetën politike, të uzurpojnë sovranitetin, të marrin përsipër rolin e zgjedhësve dhe kështu t’ia nënshtrojnë pushtetin vetes së tyre, atëherë dispozita kushtetuese për sovranitetin e shtetasit do të ishte më shumë dekor kushtetues, sesa parim themelor i përcaktuar me nenin 2, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
8. Mandati i lirë, e jo ai imperativ, është parakushti themelor për kryerje të papenguar të funksionit të deputetit, i cili përforcohet edhe me standarde e dokumente ndërkombëtare (për shembull, Pakti për të drejtat civile dhe politike, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore, Dokumenti i KEMPK-së). Statusi i deputetit si përfaqësues i qytetarëve dhe anëtarit të Kuvendit, si organ ligjvënës, bazohet mbi mandatin e lirë, sepse deputetët nuk lidhen me udhëzimet e zgjedhësve të tyre, por vendosin lirshëm dhe në bazë të besimit të tyre. Vlera e mandatit të lirë shprehet më së miri në kuptimin e mbrojtjes së të drejtave më të rëndësishme të deputetit, pra me lirinë e fjalës dhe lirinë e vendosjes në Kuvend. Deputeti përfaqëson të gjithë qytetarët e jo vetëm votuesit që kanë votuar për të.²⁶¹ Së këndejmi, deputeti ka të drejtë të ushtrojë pa pengesa

²⁶¹ Për dallim nga mandati i lirë, mandati imperativ ekziston në rastet kur deputetët janë të obliguar që në rastet e vendimmarrjes, të veprojnë sipas udhëzimeve të atyre që i kanë zgjedhur, sepse përndryshe kërcënohen nga revokimi. Për këtë, shumë kushtetuta garantojnë mandat të lirë, kurse të tjera shprehimisht theksojnë pavlefshmërinë e mandatit imperativ. Për shembull, neni 27 i Kushtetutës së Francës parasheh që “çdo mandat imperativ është i pavlefshëm”, kurse neni 96 i Kushtetutës së Norvegjisë parasheh që “deputetët (e Dhomës së Ulët) nuk janë të lidhur për mandat, si dhe votojnë pa udhëzime”. Gjithashtu, neni 38 i Ligjit Themelor të Gjermanisë (*Grundgesetz*) përcakton që “deputetët e Bundestagut janë përfaqësues të të gjithë

mandatin e tij, gjë që i mundëson atij realizimin e të drejtave të deputetit dhe përbushjen e obligimeve të tij, por edhe e mbron atë nga kufizimi dhe tërheqja vetjake dhe e paligjshme e mandatit.

9. Mandati i lirë është parashikuar me Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit (miratuar në Kuvend më 04 qershor 2010, si dhe shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës, nr. DL-029-2010, me datë 05 korrik 2010). Ky ligj thekson që deputeti është i dërguar i qytetarëve dhe se për kohën e mandatit të tij, ai i nënshtrohet vetëm ndërgjegjes së tij (neni 3, paragrafi 1). Gjithashtu, dispozitat e këtij ligji parashikojnë që deputeti të kryejë detyrat e tij në pajtim me dispozitat kushtetuese, ligjin dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit (neni 3, paragrafi 2). Deputetit i duhet garantuar shprehja e lirë e mendimit në diskutimet në kuvend (përfaqësia popullore) dhe liria në vendimmarrje dhe votim, gjë që është në pajtim edhe me garancinë e shprehur kushtetuese të imunitetit material. Imuniteti material, apo imuniteti i papërgjegjësive, mbron deputetin nga dhënia e përgjegjësive penale apo një përgjegjësie tjetër në lidhje me mendimin që ka dhënë apo votën që ka hedhur në lidhje me vendimmarrjen, kur ato janë të lidhura me ushtrimin e funksionit të deputetit. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e thekson këtë shprehimisht me dispozitën e paragrafit 1 të nenit 75, i cili i dedikohet imunitetit të deputetit, ku thuhet që "Deputetët e Kuvendit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet e tyre brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit".

Neni 70.2

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në paragrafin 2 të nenit 70 përcakton që mandati i deputetit të Kuvendit fillon në ditën e konfirmimit të rezultateve zyrtare të zgjedhjeve. Periudha për ankesa dhe konfirmim përfshin periudhën pas shpalljes së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës, gjatë së cilës votuesit mund të parashtrajnë ankesa, në pajtim me procedurat e përcaktuara me rregullat e komisionit qendror zgjedhor, për çfarëdo parregullsie apo lëshimi që gjendet në listën e votuesve. Komisioni qendror zgjedhor vepron ndaj koalicionit si ndaj një subjekti individual politik, prej ditës së certifikimit të koalicionit, e deri tek vërtetimi i rezultateve zgjedhore. Partia politike nuk mund të tërhiqet nga koalicioni kur është e certifikuar si e tillë, deri në vërtetim të rezultateve të zgjedhjeve (Ligji për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 18, paragrafi 2). Vëzhguesit e akredituar²⁶² kanë të drejtë të mbikëqyrin përgatitjen dhe realizimin e zgjedhjeve

popullit. Ata nuk zbatojnë urdhrat dhe udhëzimet, si dhe i nënshtrohen vetëm ndërgjegjes së tyre." Dispozita të ngjashme për mandatin e lirë, apo ndalimin e mandatit imperativ, ofrohen edhe në kushtetutat e Zvicrës, Danimarkës, Spanjës, Italisë dhe të tjera.

²⁶² Vëzhgues i akredituar mund të jetë përfaqësuesi i subjektit të certifikuar politik, organizatave joqeveritare, qeveritare dhe ndërqeveritare, organizatave të specializuara dhe të angazhuara në mbrojtje të të drejtave të njeriut, vendeve të huaja, ose medieve që kanë parashtruar kërkesë për të vëzhguar zgjedhjet, si dhe që kanë marrë leje nga komisioni qendror zgjedhor, në pajtim me rregullat e Ligjit për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe rregullat e Komisionit Qendror Zgjedhor.

pa kurrfarë pengese, shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve dhe verifikimin e kandidatëve që kanë fituar.

2. Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtat më të rëndësishme statutores të deputetit, brenda të cilave dy grupe kanë rëndësi të veçantë. Këto janë të drejtat e ndërlidhura me mandatin e deputetit dhe të drejtat për mbrojtjen e imunitetit të deputetit. Mandati i deputetit zgjat 4 vjet, që do të thotë se Kuvendi zgjidhet për një mandat katërvjeçar. Ai fillon që prej seancës konstituive (e cila mbahet në afatin prej 30 ditësh nga dita e shpalljes së rezultateve zyrtare të zgjedhjeve). Mandati i deputetëve të strukturës aktuale të Kuvendit të Republikës së Kosovës përfundon me verifikimin e deputetëve të zgjedhur dhe mund të zgjatet vetëm në rast të gjendjes së jashtëzakonshme, për marrjen e masave urgjente për mbrojtje nga agresioni apo rreziku ndaj rendit kushtetues apo sigurisë publike të Republikës së Kosovës, si dhe vetëm për aq kohë sa zgjat gjendja e jashtëzakonshme (neni 66, paragrafi 4, Kushtetuta e Republikës së Kosovës).
3. Rregullorja e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës përcakton që përgatitjet për seancën konstituive të legjislaturës në Kuvend janë përgjegjësi e kryetarit të legjislaturës së kaluar (neni 8, paragrafi 1). Kryetari dhe kryesia, jo më pak se pesë ditë para mbajtjes së seancës konstituive të legjislaturës së re të Kuvendit, thirrin një seancë të përbashkët me kryetarët e partive që kanë fituar ulëset në Kuvend, për të përgatitur propozim-rendin e ditës për seancën konstituive të legjislaturës së Kuvendit, për caktimin e vendeve të deputetëve, përkatësisht forcave politike në sallë, në përpjesëtim me fuqinë politike që ato kanë, sipas numrit të deputetëve të secilës forcë politike. Rendi i ditës i seancës konstituive duhet të përmbajë formimin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikim të Kuorumit, Mandateve, zgjedhjen e Kryetarit dhe pesë (5) nënkryetarëve të Kuvendit (neni 8, paragrafi 4 i Rregullores së Punës). Punën e seancës konstituive të legjislaturës së Kuvendit, deri në zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarit të Kuvendit, e udhëheq deputeti më i moshuar, i ndihmuar nga deputeti më i ri në moshë, ndërsa nëse këta deputetë mungojnë në seancën konstituive të legjislaturës ose refuzojnë kryesimin, në këtë rast angazhohen deputetët që, sipas moshës, vijnë menjëherë pas tyre. Pas hapjes së seancës dhe paraqitjes së rendit të ditës, kryesuesi i seancës konstituive të legjislaturës kërkon nga partitë politike të përfaqësuara në Kuvend që të caktojnë nga një përfaqësues në Komisionin e përkohshëm për verifikim të kuorumit dhe mandateve (neni 9, paragrafi 3, Rregullorja e Punës). Ky komision i përkohshëm shqyrton dokumentacionin përkatës të zgjedhjeve dhe i dorëzon Kuvendit raportin për mandatet e vlefshme të deputetëve të Kuvendit dhe verifikon kuorumin në seancën konstituive të Kuvendit.
4. Shtojca nr. 4 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës përcakton të drejtat e deputetit, ashtu që në momentin e verifikimit të mandatit të deputetit, ai deputet gëzon të gjitha të drejtat që duhet t'i ketë si deputet, pra edhe të drejtat shtesë, me qëllim të sigurimit të kushteve për ushtrim të suksesshëm të funksionit që ka, në pajtim me ligjin. Këto të drejta përfshijnë: a) të drejtën e kompensimit material me të ardhura mujore; b) të drejtën për kompensim shtesë në

të ardhura; c) të drejtën për heqje të shpenzimeve të qëndrimit dhe udhëtimit të deputetit brenda dhe jashtë vendit në detyrë zyrtare; d) të drejtën e shfrytëzimit të shërbimeve të Kuvendit; e) të drejtën e informimit; f) të drejtën e posedimit të dokumentacionit identifikues të deputetit.

5. Veçanërisht duhet theksuar e drejta e deputetit që të gëzojë i papenguar mandatin e tij të deputetit, e drejtë kjo që mbrohet me përcaktimin e shprehur të bazave në të cilat ky mandat ndërpritet, por edhe me rregullimin e procedurës sipas të cilës vendoset edhe ndërprerja e tij. Këto çështje janë tejet të rëndësishme për statusin e deputetit dhe autonominë e vetë Parlamentit dhe për këtë arsye, garantimi i tyre është i parashikuar edhe me aktet përkatëse. Për shembull, pika 7.9 e Konventës së Kopenhagës obligon shtetet nënshkruese që të sigurojnë kushtet që "kandidatët që fitojnë numrin e nevojshëm të votave... të marrin detyrën me kohë dhe t'u mundësohet të qëndrojnë në atë detyrë deri në skadimin e mandatit ose deri në ndërprerjen e tij në mënyra të tjera të përcaktuara me ligj". Mu për këtë rëndësi që kanë për sigurimin e mandatit të lirë, arsyet për ndërprerjen e tij rregullohen në vetë Kushtetutë (Suedi, Austri, Norvegji, Irlandë, Hungari, Bullgari, etj.) - shpërndarja e Parlamentit, dorëheqja e deputetëve, heqja dorë nga mandati, vdekja, dënimi me heqje lirie për vepër penale, humbja e të drejtës së zgjedhjes e të tjera.²⁶³ Kështu, vëmendje e veçantë i kushtohet edhe vendosjes mbi arsyet për ndërprerjen e mandatit (Gjermani, Austri, Suedi, Hungari, etj.). Në Austri vendos Gjykata Kushtetuese, në Suedi organe speciale, në Hungari Parlamenti me propozim të deputetëve ose gjykata. Natyrisht, për të gjitha këto është e përligjur procedura e veçantë, sipas së cilës vërtetohet lindja e arsyeve për ndërprerje të mandatit.
6. Në fund të prezantimit tonë mbi atë se cilat janë arsyet e mundshme për ndërprerjen e mandatit të deputetit në legjislatura krahasuese si dhe praktikat krahasuese kushtetuese, duhet nënvizuar një fakt tejet interesant. Si arsye për ndërprerjen e mandatit të deputetit nuk përmendet dalja nga anëtarësia në parti politike, në listën e së cilës ai është kandiduar si deputet, pa marrë parasysh nëse kjo dalje ka ndodhur me vullnetin e zgjedhësve ose me përjashtimin e deputetit nga partia politike. Gjithashtu, as kalimi i deputetit nga një parti politike në tjetrën nuk parashikohet si bazë për humbjen e mandatit të deputetit, por përkundrazi, përcaktohet shprehimisht, në demokraci të caktuara parlamentare (për shembull, Gjermania, Austria e të tjera) që ndërprerja e anëtarësisë në parti politike (për shkak të braktisjes së partisë, kalimit në parti tjetër politike, ose përjashtimit nga partia politike) nuk është arsye për të cilën deputeti mund të humbë mandatin.²⁶⁴

²⁶³ Në disa sisteme kushtetuese, përveç arsyeve të dhëna, mandati parlamentar mund të ndërpritet edhe në baza të tjera, si për shembull, ndalimi i partisë politike nga gjykata kushtetuese (në Gjermani), refuzimi nga deputetit që të bëjë betimin dhe mungesa e gjatë e paarsyetuar në seancat parlamentare (në Austri), fajësia për blerjen e votave, shitjen e votave, apo votimin në më shumë se një vendvotim (në Norvegji). Megjithatë, duhet theksuar që arsyet e dhëna për ndërprerjen e mandatit të deputetit nuk janë tipike, si dhe gjenden rrallë në praktikën parlamentare.

²⁶⁴ Sigurisht, përjashtim nga kjo bën, siç kemi theksuar më parë, ndalimi i veprimtarisë së partisë politike nga ana e Gjykatës Kushtetuese në Gjermani.

Kjo bëhet së pari që në këtë mënyrë të mbrohet mandati i lirë dhe për t'u definuar qartë raporti i deputetit me partinë politike që e ka kandiduar në listën e saj. Në fakt, mes partisë dhe kandidatit nuk ekziston ndonjë relacion juridik, por vetëm ai politik, kurse kjo është tejet e rëndësishme për sistemet zgjedhore proporcionale në të cilat marrja e statusit të deputetit varet nga emërimi në listën e kandidatëve të një partie politike të caktuar (për këtë arsye, shpesh, pa bazë, thuhet që mandatet e deputetëve janë në dorën e partisë politike, sepse zgjedhja e deputetëve bëhet nga votuesit, nga votat e të cilëve, përfundimisht, varet edhe zgjedhja e tyre, pra përjashtimi nga partia ose kalimi nga një parti në tjetrën nuk mund të jetë arsye për humbjen e mandatit të deputetit, apo ndërprerjes së statusit të deputetit).

7. Prandaj, gjatë afatit të mandatit përfaqësues mund të paraqiten rrethana të cilat shkaktojnë ndërprerjen e mandatit përfaqësues, ndërsa këto raste, si baza dhe shkaqe të ndërprerjes së mandatit përfaqësues, përcaktohen me Kushtetutë dhe ligj. Këto arsye mund të ndahen në disa grupe, zakonisht mund të dallohen katër grupe të tilla. Një numër shkaqesh të tilla lidhet me kushtet për fitimin e të drejtës së zgjedhjes, pra me humbjen e ndonjërit prej atyre kushteve, ndërpritet edhe komoditeti që është fituar me anë të së drejtës së zgjedhjes (për shembull, humbja e shtetësisë, heqja e lirisë së punës me vendim të prerë gjyqësor, pushimi i banimit të deputetit në territorin e shtetit në Parlamentin e të cilit është zgjedhur si deputet, etj.). Grupi i dytë i arsyeve për ndërprerjen e mandatit përfaqësues ka të bëjë me vendimet juridike ose politike që ndikojnë në statusin e deputetit, si përfaqësues i popullit (për shembull, shpërndarja e Kuvendit në të cilin është deputet, dënimi i deputetit me vendim gjyqësor të formës së prerë, burgosja pa kusht me kohëzgjatje të caktuar - shpesh 6 muaj, marrja përsipër e punëve apo funksioneve të cilat, sipas ligjit përkatës të zgjedhjeve, nuk përputhen me funksionin e deputetit etj.). Grupi i tretë i arsyeve është ngushtësisht i natyrës personale (për shembull, dorëheqja dhe vdekja e deputetit). Grupi i katërt i arsyeve ka të bëjë me përkatësinë e përfaqësuesve në partitë politike dhe është pasojë e zbatimit të sistemit të përfaqësimit proporcional tek ndarja e mandateve përfaqësuese (për shembull, nëse nuk ka lidhje mes përfaqësuesit dhe partisë politike, me anë të listës zgjedhore të së cilës deputeti ka fituar mandatin përfaqësues në zgjedhjet parlamentare, pastaj nëse gjatë mandatit partia politike pushon së ekzistuari dhe nëse ndodh ndalimi i veprimtarisë së partisë politike, përkatësisht koalicionit të regjistruar nga lista e të cilit është zgjedhur deputeti, përkatësisht, nëse ajo parti apo koalicion shlyhet nga regjistri i organizatave politike).

Neni 70.3

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh që mandati i deputetit skadon ose shpallet i pavlefshëm për disa arsye (neni 70, paragrafi 3). Kështu, si arsye e parë e ndërprerjes së statusit të deputetit të Kuvendit jepet mosdhënia e betimit. Pra, pas verifikimit të mandatit, deputetët japin betimin, teksti i të cilit është: "Unë, deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryejë detyrën time dhe do ta përfaqësojë me dinjitet popullin, do të punojë në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen

dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane". Tekstin e betimit e lexon kryesuesi i seancës. Deputetët bëjnë betimin duke thënë në fund të deklaratës fjalën "Betoheh!". Secili deputet nënshkruan tekstin e betimit. Deputeti që nuk është i pranishëm në seancën konstituive, kur bëhet betimi, e bën betimin në seancën e parë të radhës (neni 10 i Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës).

2. Arsyeja e dytë për ndërprerjen e statusit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjegjësisht humbjen e mandatit të deputetit, është dhënia e dorëheqjes nga vetë përfaqësuesi i zgjedhur i qytetarëve. Deputeti ka të drejtë të japë dorëheqje, sepse funksionin përfaqësues në Parlamentin republikan ai e ushtron në bazë të vullnetit të lirë. Për këtë flet edhe fakti që për vlefshmëri të kandidaturës duhet dorëzuar një deklaratë me shkrim e kandidatit për pranim të kandidaturës. Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit (neni 4) parasheh që, me rastin e kandidimit për mandat përfaqësues, askujt nuk mund t'i ndalohej që të kandidojë apo të ushtrojë funksionin e deputetit, përveç në rastet e parashikuara me ligj. Gjithashtu, duke marrë parasysh që mandati i deputetit është i lirë, ai ka të drejtë të heqë dorë nga pozita e tij. Dorëheqja është akt personal dhe paraqet njërin prej shkaqeve për ndërprerjen e mandatit të deputetit.²⁶⁵
3. Nga analiza e legjislativave krahasuese të vendeve të caktuara (si, për shembull, Austria, Gjermania, Franca, Suedia, etj.), mund të vërehet që këto vende i rregullojnë me kujdes arsyet e përligjura për ndërprerjen e mandatit (dorëheqjen). Legjislativat e këtyre vendeve parashikojnë procedurë të veçantë të dorëheqjes, siç janë për shembull forma e shkruar, dorëzimi i dorëheqjes para Kryesisë së Parlamentit, pëlqimi i Parlamentit etj. Me rëndësi të veçantë është të theksohet që rregulloret e punës së parlamenteve të këtyre vendeve shprehimisht përcaktojnë që dorëheqjet, sidomos ato që nënshkruhen paraprakisht ose i dorëzohen partisë politike, nuk prodhojnë efekt juridik. Dorëheqjet e tilla konsiderohen ligjërisht nul. Megjithatë, në rastin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Ligjit për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit dhe akteve tjera, kjo arsye për ndërprerjen e mandatit nuk është rregulluar në mënyrën si është bërë në vendet e tjera të zhvilluara, me traditë afatgjatë parlamentare. Konsiderojmë që kjo çështje ka merituar më shumë vëmendje në aktet e përmendura të Republikës së Kosovës.
4. Një arsye tjetër për humbjen e mandatit përfaqësues në Kuvendin e Republikës së Kosovës është paraparë me nenin 70, paragrafi 3, pika 3, e cila është emërimi si anëtar i Qeverisë së Kosovës. Në fakt, edhe vetë Kushtetuta në nenin e saj 72

²⁶⁵ Edhe pse dorëheqja është akt personal i deputetit, disa sisteme kushtetuese, si në Suedi, kërkojnë që Parlamenti të pranojë dorëheqjen e deputetit. Kështu, neni 7, paragrafi 1 i Kreut 4 të Instrumentit të Qeverisjes së Suedisë parasheh që "deputeti nuk mund të japë dorëheqje pa pëlqimin e Riksdagut".

parashikon papajtueshmërinë e funksioneve me dispozitën që " Deputeti i Kuvendit të Kosovës nuk mund të mbajë ndonjë post ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike dhe as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër ekzekutiv". Papajtueshmëria me funksionet ekzekutive theksohet edhe në Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit (neni 6, paragrafi 1), i cili përcakton që deputeti nuk mund të jetë njëkohësisht kryeministër, zëvendëskryeministër, ministër apo zëvendësministër. I njëjti nen i Ligjit në paragrafin e dytë parasheh që në rast të emërimit të ndonjë deputeti në njërin prej funksioneve të përmendura, mandati i deputetit ndërpritet në ditën e emërimit të tij/saj.

5. Skadimi i mandatit të Kuvendit të Republikës së Kosovës është arsyeja e radhës për ndërprerjen e mandatit të deputetit (neni 70, paragrafi 3, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës). Në fakt, Kushtetuta përcakton që Kuvendi zgjidhet për një mandat katërvjeçar dhe ai fillon të rrjedhë nga seanca konstituive, e cila mbahet në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga shpallja e rezultateve zyrtare të zgjedhjeve. Ky mandat i Kuvendit mund të zgjatet vetëm në rastet e parashikuara me nenin 66, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për të cilin kemi folur më herët. Kështu, me përfundimin e mandatit katërvjeçar të Kuvendit, skadon edhe mandati i deputetëve që janë anëtarë të tij.
6. Arsyeja e radhës, për shkak të së cilës deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës mund të humbë mandatin, është përcaktuar me nenin 70, paragrafi 3, pika 5, e cila mund të ndodhë në rast të mungesës së paarsyetuar të deputetit për gjashtë (6) muaj në vazhdimësi në mbledhjet e Kuvendit, edhe pse Kuvendi i Kosovës mundet, në raste të veçanta, të vendosë ndryshe. Pra, duke marrë parasysh që këtu bëhet fjalë për mandat të lirë, siç e kemi theksuar më herët, zgjedhësit nuk kanë të drejtë ta revokojnë deputetin, pra nuk kanë të drejtë të tërheqin një deputet të zgjedhur. Gjithashtu, në praktikën parlamentare kushtetuese është marrë qëndrimi që as Kuvendi nuk ka të drejtë t'ia marrë mandatin deputetit. Mes ndëshkimeve disiplinore gjithsesi ekziston edhe dënimi i përjashtimit, por deputeti mund të përjashtohet vetëm përkohësisht, por jo edhe përfundimisht. Ekzistojnë edhe mendime të autorëve të caktuar - konstitucionalistë, që "as ai deputet që nuk shkon kurrë në seancat e Kuvendit, nuk do të mund të përjashtohet përgjithmonë". Megjithatë, siç e kemi theksuar tashmë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh mundësinë e humbjes së mandatit, nëse deputeti mungon pa arsye gjatë periudhës së përmendur prej 6 muajsh në vazhdimësi.
7. Obligimet ligjore të deputetit rrjedhin nga anëtarësia e tij në parlament. Pra, Parlamenti është organ pushteti apo institucion i themeluar me Kushtetutë, përgjegjësitë dhe mënyra e punës e të cilit janë të përcaktuara me dispozita ligjore (Kushtetutë, ligje e rregullore pune). Së këndejmi, deputeti, si anëtar i këtij trupi kolegjal, edhe vetë duhet të veprojë në bazë të të drejtave dhe brenda kufijve të së drejtës, duke qenë kështu i obliguar t'u përmbahet dispozitave të përmendura juridike, (Kushtetutës, ligjeve dhe rregulloreve të punës). Shkelja e këtyre rregullave është e sanksionuar me ligj, ashtu që deputeti i nënshtrohet përgjegjësisë juridike dhe sanksioneve përkatëse, nëse i shkel ato rregulla të përcaktuara. Kjo

përgjegjësi për shkeljen e detyrimeve të tij juridike është disiplinore, dhe për këtë vendos vetë Parlamenti, anëtar i të cilit është deputeti (masa disiplinore mund të vendoset vetëm nga Parlamenti, nga asnjë organ tjetër pushteti). Vetëm në raste të jashtëzakonshme, sanksioni mund të jetë edhe ndërprerje e mandatit të deputetit.

8. Këtu duhet theksuar që obligimi për pjesëmarrje në seancat e Parlamentit është obligim juridik i deputetit, gjë që është tejet e rëndësishme për punën e Parlamentit, pra është parakusht për funksionimin e tij normal. Kështu, nëse deputetët nuk respektojnë këtë obligime, Parlamenti do të bllokohej dhe nuk do të mund ta ushtronte funksionin e tij, sepse për të pasur punë me efekt të plotë dhe vendimmarrje të Parlamentit, është i nevojshëm kuorumi përkatës, pra prania e numrit të caktuar të deputetëve. Obligimi i deputetit për prani në seanca ka të bëjë edhe me praninë në seancat plenare të Parlamentit, edhe me praninë në trupat punues të Parlamentit, anëtarë të të cilëve janë. Puna e këtyre trupave është gjithashtu tejet e rëndësishme për funksionimin e Parlamentit, sepse përgatisin seancat e tij, mundësojnë dhe lehtësojnë përmbushjen e obligimeve të tij. Nëse ndodh cenimi i këtyre obligimeve, Parlamenti vendos sanksionet përkatëse, prej të cilave më i shpeshti është humbja e kompensimit të deputetit, kurse në disa sisteme parlamentare, shkelja afatgjate e këtij obligimi mund të jetë edhe humbja e mandatit të deputetit. Kështu, për shembull, nëse deputeti mungon pa arsye në seancat e Dhomës Kombëtare të Austrisë, vetëm për një periudhë prej së paku 30 ditësh, sanksioni për mospërmbushje të obligimit juridik të deputetit është humbja e mandatit të deputetit.
9. Gjithashtu, duhet theksuar që nëse deputeti është i penguar të marrë pjesë në seancën e Parlamentit apo një trupi punues ku është anëtar, ai është i obliguar të njoftojë kryetarin e Parlamentit, përkatësisht kryetarin e trupit punues, për arsyet e mungesës së tij. Ai është i obliguar të bëjë këtë para mbajtjes së seancës. Të gjitha këto dhe rregullat e tjera të rendit parlamentar përcaktohen me Rregulloren e punës së Kuvendit, kurse respektimi i tyre nga deputetët paraqet një parakusht të domosdoshëm për punë të papenguar të Parlamentit. Këto janë detyrime juridike të deputetit, si anëtar i Parlamentit, kështu që shkelja e tyre sanksionohet me masa disiplinore. Nëse anëtarët e Parlamentit nuk respektojnë rregullat e rendit parlamentar, kryetari i Parlamentit ose Parlamenti vetë mund të marrin ndaj këtyre masa disiplinore përkatëse, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme. Në fakt, një deputet i tillë mund të thirret të punojë sipas rendit dhe të respektojë rregullat e punës parlamentare, mund të marrë vërejtje ose t'i merret fjala. Përfundimisht, deputeti i tillë mund të largohet nga seanca e Parlamentit apo trupit punues, për periudha afatshkurtra ose më afatgjate.
10. Me Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit përcaktohen edhe obligimet parlamentare të deputetit, por edhe sanksionet për mosrespektimin e tij. Kështu, me nenin 40 të këtij Ligji, parashikohet që deputeti është i obliguar të marrë pjesë në seancat plenare dhe seancat e trupave ndihmës të Kuvendit,²⁶⁶ anëtar i të cilëve

²⁶⁶ Organet ndihmëse të Kuvendit janë të gjitha organet e përhershme apo *ad hoc* që formohen me vendim të Kuvendit

është (paragrafi 1). Deputeti i cili nuk mund të marrë pjesë në seancat e Kuvendit apo seancat e trupave ndihmës të Kuvendit në të cilët është anëtar, për këtë duhet ta informojë Kryetarin e Kuvendit ose kryetarin/zëvendëskryetarin e atij organi ndihmës me kohë, duke paraqitur gjithashtu edhe arsyet për mungesën e tij (paragrafi 3). Gjithashtu, deputeti nuk mund të refuzojë anëtarësinë apo pjesëmarrjen në punën e trupave ndihmës të Kuvendit pa një arsyetim të pranueshëm e objektiv (neni 42).

11. Mospërmbushja e obligimeve të deputetit është përcaktuar me nenin 41 të Ligjit, ashtu që nëse deputeti nuk merr pjesë në punën e seancës plenare ose trupave ndihmës të Kuvendit, në të cilët është anëtar, paga bazë dhe kompensimet e tjera zvogëlohen (paragrafi 1).²⁶⁷ Këtu duhet shtuar edhe një dispozitë tejet interesante të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës (neni 25, paragrafi 1e), me të cilën rregullohet mungesa e vazhdueshme gjashtëmuajore, pra mungesa e një deputeti në të gjitha seancat e Kuvendit. Pra, nëse ai deputet nuk ofron fakte bindëse në lidhje me mungesën e tij/saj te Kryetari i Kuvendit, Kryetari kërkon rekomandimin e Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës. Pas rekomandimit të Komisionit, Kryetari i propozon Kuvendit pushimin e funksionit të deputetit, kurse Kuvendi vendos për këtë propozim në seancën vijuese të tij.
12. Deputeti, si anëtar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, humb mandatin e tij përfaqësues për një shkak tejet të rëndësishëm, i cili është dënimi i dhënë me vendim të prerë të gjykatës për vepër penale që dënohet me burg prej një apo më shumë vitesh (neni 70, paragrafi 3, pika 6). Duhet përmendur që kjo çështje rregullohet ndryshe në vende të caktuara, ashtu që në disa sisteme kushtetuese parashikohet humbja e mandatit të deputetit edhe për shkak të dënimit me afat më të shkurtër kohor. Më së shpeshti ky është dënimi pa kusht me burg me më së paku gjashtë muaj, edhe pse kjo bazë dallon nga vendi në vend.
13. Si arsye e fundit për ndërprerje të statusit të deputetit, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 70, paragrafi 3, pika 7, e përcakton vdekjen e deputetit. Këtë fakt juridik e përcaktojnë të gjitha kushtetutat si shkak i ndërprerjes së mandatit të deputetit. Në fakt, normat juridike përcaktojnë faktet në bazë të të cilave krijohen, ndryshohen (barten) dhe pushojnë të drejtat subjektive të qytetarëve. Këto fakte quhen fakte juridike. Sipas këtyre, faktet juridike janë fakte të jetës për të cilat lidhen krijimi, ndryshimi apo pushimi i të drejtave civile subjektive.²⁶⁸ Të drejtat subjektive nuk lindin me ekzistencën e një fakti juridik, por e zakonshme është që për lindjen e tyre kërkohet ekzistenca e një grupi faktesh juridike, të cilat mund të lindin ose në të njëjtën kohë, ose kohë pas kohe. Përjashtimisht, një fakt juridik mund të çojë tek paraqitja e pasojave juridike, të cilat, për shembull, janë lindja apo vdekja, të cilat çojnë te krijimi apo pushimi i subjektivitetit.

²⁶⁷ Nga ky spektër përjashtohen rastet kur deputeti zyrtarisht mungon në kuadër të funksionit të tij parlamentar.

²⁶⁸ Faktet juridike dallohen nga normat juridike (e drejta objektive), sepse në bazë të normave juridike lind e drejta subjektive, kurse norma juridike e lidh lindjen, ndryshimin apo pushimin e të drejtave me faktet juridike.

14. Faktet juridike mund të ndahen sipas indikatorëve të ndryshëm, kurse në teorinë juridike nuk ekziston ndonjë vështrim unik mbi ndarjen e tyre. Kështu, faktet mund të ndahen në të brendshme dhe të jashtme. Faktet e brendshme lindin në mendjen e njeriut (dhe në jetën e tij të brendshme), kurse ato të jashtme lindin në botën e jashtme. Një prej ndarjeve të pakontestueshme, njëkohësisht edhe më e rëndësishmja, të fakteve juridike, është ndarja në ngjarje natyrore dhe veprime njerëzore. Ngjarjet natyrore lindin me veprimin e forcave të natyrës apo në mënyra të tjera, pa vullnetin e njeriut ose jo vetëm me vullnetin e tij. Ngjarjet natyrore mund të prodhojnë efekte të ndryshme; kështu, me lindjen e njeriut fitohet subjektiviteti juridik, kurse mes fëmijës dhe prindit krijohet marrëdhënia prindërore. Me vdekjen e tij, njeriut i humb subjektiviteti dhe pushojnë kapacitetet e tij juridike, të deliktit dhe ato të punës, pushon martesja, hapet trashëgimia etj. Kështu, ndërpritet edhe statusi i deputetit, të cilin ai e ka fituar gjatë jetës së tij.

Neni 70.4

1. Me paragrafin e fundit të këtij neni, i cili është objekt i komenteve tona (neni 70, paragrafi 4, Kushtetuta e Republikës së Kosovës), parashikohet që vendet e lira të deputetit të Kuvendit të plotësohen menjëherë, në pajtim me këtë Kushtetutën dhe ligjin. Në fakt, pushimi i mandatit të deputetit për të cilin është zgjedhur tërheq pas vetes edhe faktin e përbërjes jo të plotë të Parlamentit. Vendet e liruar të përfaqësuesve të qytetarëve në Parlament duhen plotësuar me përfaqësues të rinj, kurse ky plotësim mund të bëhet me veprime të ndryshme, varësisht nga fakti nëse janë mbajtur zgjedhjet apo jo, apo nëse mandatet përfaqësuese janë ndarë sipas sistemit mazhoritar apo atij proporcional. Kështu, për shembull, nëse përfaqësuesi që është zgjedhur me sistem mazhoritar, i pushohet mandati para skadimit të afatit për të cilin është zgjedhur, atëherë shpallen **zgjedhje plotësuese** sipas sistemit mazhoritar. Këto zgjedhje bëhen në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar edhe për zgjedhje të rregullta. Megjithatë, nëse është rasti i përfaqësuesit që është zgjedhur me sistem proporcional zgjedhor, atëherë mandati i përket propozuesit, nga lista e të cilit është zgjedhur deputeti të cilit i ka pushuar mandati dhe ai mandati pastaj i ndahet kandidatit në listën zgjedhore (zakonisht thuhet “kandidati i radhës në listën zgjedhore”), për të cilin propozuesi nuk ka fituar mandatin. Nëse në listën zgjedhore prej së cilës deputeti është zgjedhur nuk ka kandidat, për të cilin propozuesi nuk ka fituar mandatin, atëherë mandati i përket propozuesit që ka koeficientin më të madh të radhës, për të cilin nuk ka fituar mandatin. Mandati i deputetit të ri zgjat deri në përfundimin e mandatit të deputetit të cilit i është ndërprerë mandati. Nga kandidati për deputet të ri sigurohet pëlqimi me shkrim i tij për pranimin e atij mandati.
2. Shpallja e zgjedhjeve plotësuese, përkatësisht ndarja e mandatit të deputetit të ri, në rast të pushimit të mandatit të deputetit para kohës për të cilën është zgjedhur, duhet dalluar nga **zgjedhjet e parakohshme**. Këto zgjedhje shpallen në rast të shpërndarjes së Kuvendit, ndërprerjes së mandatit të Kuvendit para kohe dhe në rast të marrjes së vendimit të vetë Kuvendit për ndërprerjen e mandatit të deputetëve, (nëse ekziston një mundësi e tillë e parashikuar me Kushtetutë për vetëshpërndarjen e Kuvendit, pra

vendimin e vetë Kuvendit për shkurtimin e mandatit të deputetëve para skadimit të kohës për të cilën janë zgjedhur). Zgjedhjet e parakohshme në këto raste shpallen nga Presidenti i Republikës, kurse mbahen në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me ligjin zgjedhor për mbajtjen e zgjedhjeve.

3. Procedura e zëvendësimit të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës është paraparë me nenin 112 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës. Në fakt, duke pasur parasysh që me nenin 70, paragrafi 1, është paraparë që deputetët e Kuvendit, si përfaqësues të popullit, nuk i nënshtrohen mandatit imperativ (të lidhur), por vetëm atij të lirë, vendet e ndara në pajtim me këtë Ligj janë ulëse personale që mbahen nga kandidati e jo subjekti politik. Mandati i deputetit nuk mund të ndryshohet apo ndërpritet para përfundimit të afatit për të cilin është zgjedhur, përveç nëse ekzistojnë shkaqet e paraparë me nenin 70, paragrafi 3, pikat 1-7. Deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilit i pushon mandati për shkak të arsyeve të përmendura, duhet zëvendësuar në mënyrën vijuese: a) me kandidatin e kualifikuar të radhës, të së njëjtës gjini, që ka fituar numrin më të madh të votave në listën e kandidatëve të subjektit politik, në emër të të cilit kandidati është paraqitur në zgjedhjet e fundit; b) nëse nuk ka kandidat tjetër të kualifikuar të të njëjtës gjini në listën e kandidatëve, kandidatin e kualifikuar të radhës të gjinisë së kundërt; c) nëse nuk ka kandidatë të tjerë të kualifikuar në listën e kandidatëve, kandidatin e kualifikuar të radhës nga lista e kandidatëve të subjektit politik i cili ka pasur mbetjen më të madhe të përqindjes së votave sipas formulës së dhënë në nenin 111, paragrafi 4, të këtij Ligji²⁶⁹ në zgjedhjet e kaluara të të njëjtit lloj; dhe d) nëse deputeti është kandidat i pavarur, kandidatin e kualifikuar të radhës nga lista e kandidatëve të subjektit politik që ka pasur përqindjen më të madhe të votave tjera, sipas formulës së dhënë në nenin 111, paragrafi 4, të këtij Ligji (neni 112, paragrafi 2, Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës). Pasi që ulësja e deputetit lihet e lirë, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës dërgon kërkesën me shkrim te Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me qëllim të plotësimit të vendit të lirë të deputetit. Kjo kërkesë duhet të përmbajë edhe shpjegimin për atë se si vendi ka mbetur i lirë. Pas pranimit të kërkesës, Kryetari i Kuvendit, nëse shpjegimi i dhënë është i kënaqshëm, kërkon nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të propozojë emrin e personit që do të plotësojë vendin e lirë në Kuvend. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i obliguar që brenda afatit prej pesë (5) ditësh nga pranimi i kërkesës t'i ofrojë Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës emrin e kandidatit të kualifikuar në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme.

²⁶⁹ Të gjitha votat që ka fituar kandidati, emri i të cilit gjendet në listën e hapur të subjektit politik, numërohen një nga një. Vota e dhënë për partinë politike konsiderohet votë e fituar për kandidatin e parë në listën e kandidatëve të partisë politike. Riorganizimi i listës në renditje me rënie bëhet në pajtim me numrin e votave që ka fituar secili kandidat.

Neni 71 [Kualifikimet dhe Barazia Gjimore]

- (1) Secili shtetas i Republikës së Kosovës i cili është tetëmbëdhjetë (18) vjeç ose më i madh dhe përmbush kriteret ligjore, mund të jetë kandidat për deputet.
- (2) Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektoj parimet e barazisë gjimore të cilat janë të pranuar në pajtim me parimet ndërkombëtare.

Neni 71

1. Bartësi i pushtetit sovran është elektorati, por meqenëse këtë pushtet nuk mund ta ushtrojë drejtpërdrejt, ai zgjedh përfaqësuesit e vet që formojnë organin përfaqësues - Parlamentin (Kuvendin). Ky organ përfaqësues, në vend të zgjedhësve, gjegjësisht ***në emrin dhe interesin e tyre***, ushtron pushtetin shtetëror në intervalin e caktuar kohor. Varësisht nga organizimi i pushtetit në shtet, domethënë nga ajo se cili parim i organizimit të pushtetit është pranuar, përfaqësuesit e popullit fitojnë kompetenca të ndryshme. Kështu, sipas teorisë së ndarjes së pushtetit, Parlamenti (Kuvendi) ushtron funksionin më të rëndësishëm, atë ligjvënës, kurse sipas teorisë së unitetit të pushtetit, këtij organi i jepen edhe disa funksione të tjera shtetërore.
2. Elektoratin e përbëjnë shtetasit që kanë ***zotësinë e zgjedhjes*** apo të drejtën e garantuar me kushtetutë e ligj që të zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Megjithatë, përveç kësaj zotësie, duhet dalluar edhe ***zotësia e përfaqësimit (e deputetit)***, d.m.th. zotësia për t'u zgjedhur nga ana e votuesve dhe që ata votues të përfaqësohen në Parlament. Të drejtën e zgjedhjes e përbëjnë këto dy zotësi apo kapacitete. Si e tillë, e drejta zgjedhore përbën bazën e formimit të organit përfaqësues, e me këtë edhe pjesëmarrjen e qytetarëve në veprimtarinë shtetërore. Pa ta, nuk ka demokraci dhe pushtet të popullit dhe prandaj thuhet që ata krijojnë atë që quhet “gurthemel”.
3. Kur flitet për të drejtën zgjedhore, pyetja kryesore që bëhet në lidhje me të është se kush është bartësi ose kush ka të drejtë aktive zgjedhore (të drejtën e pjesëmarrjes në formimin e elektoratit) dhe të drejtë pasive zgjedhore (të drejtën që me zgjedhjen e të tjerëve të bëhet anëtar i organit përfaqësues). Kriteri themelor për përgjigjen ndaj kësaj pyetjeje është grupi i njerëzve, të cilëve u lejohej gëzimi i kësaj të drejte, kështu që dallohen dy lloje kryesore të së drejtës zgjedhore: e drejta e përgjithshme dhe ajo e kufizuar.
4. ***E drejta e përgjithshme zgjedhore*** nuk do të thotë që bartës të saj janë të gjithë qytetarët, por vetëm që nuk ekziston ndonjë diskriminim në baza sociale apo politike dhe në këtë kuptim ajo e drejtë u ndalohet individëve vetëm për arsye që lidhen me personalitetin e tyre. Për të gëzuar të drejtën e përgjithshme zgjedhore kërkohen disa kualifikime, të cilat tek e drejta e përgjithshme e votës përfshijnë disa kushte, të cilat janë: shtetësia, mosha madhore dhe posedimi i subjektivitetit juridik, pra aftësia personale që me veprimet e veta të krijojnë të drejta dhe obligime (zotësia për ushtrim të pavarur veprimesh).

5. ***E drejta e kufizuar zgjedhore*** ekziston kur nga gëzimi i saj përjashtohen kategori të tëra të qytetarëve, të cilët përndryshe plotësojnë kushtin e nevojshëm për të drejtën e përgjithshme zgjedhore apo posedojnë subjektivitetin juridik. Përjashtimi i tillë, apo përjashtimi nga gëzimi i të drejtës zgjedhore, mund të shkaktohet për arsye të ndryshme, gjithmonë duke lidhur të drejtën zgjedhore me posedimin e disa kualifikimeve shtesë, kështu që të gjithë qytetarët që nuk kanë kualifikime të tilla janë të përjashtuar nga gëzimi i kësaj të drejte. Kjo për shembull mund të jetë pragu i pronës apo pagesa e tatimeve në masë të caktuar, pragu sipas prejardhjes dhe ngjyrës së lëkurës, sipas gjinisë, pragu i arsimimit, regjistrimi i moshës, etj. Kështu, ka raste që i gjithë profesioni përjashtohet nga gëzimi i të drejtës zgjedhore (aktive dhe pasive ose vetëm të drejtës pasive zgjedhore), ku më së shpeshti bëjnë pjesë: shërbyesit, zyrtarët, apo nëpunësit shtetërorë, ushtarakët, të burgosurit, e të tjerët.
6. Kufizimet e tilla të së drejtës zgjedhore janë pjesë të së kaluarës dhe janë përjashtime, kurse në gati të gjitha shtetet e botës, e drejta zgjedhore është e përgjithshme, në kuptimin që gëzohet nga të gjithë shtetasit e moshës madhore që kanë subjektivitet dhe nuk janë të privuar nga gëzimi i të drejtës me vendim të gjykatës për vepër penale. Në shumicën e shteteve bashkëkohore, moshë madhore arrihet me 18 apo 21 vjet e kjo njëkohësisht paraqet fitim të së drejtës zgjedhore në ato shtete. Megjithatë, në disa shtete, vitet e moshës që kërkohen për të drejtën pasive zgjedhore nuk janë të barabarta me moshën që kërkohet për të drejtën aktive zgjedhore (për gëzim të së drejtës pasive zgjedhore kërkohet një prag më i lartë i moshës). Kjo nuk është në pajtim me zgjedhjet shumëpartiake demokratike, kështu që konsiderohet që zgjidhja qëndron në barazimin e kushteve për arritjen e të dyja formave të së drejtës zgjedhore.
7. Kur flitet për kufizimin e të drejtës zgjedhore, këtu gjejmë rast të themi që, siç kemi theksuar në paragrafin e kaluar, më herët kategori të tëra të njerëzve janë përjashtuar nga gëzimi i kësaj të drejte. Kështu për shembull, grave me shekuj u është privuar kjo e drejtë. Në disa shtete, ky kufizim ka pushuar në fillim të shekullit njëzetë, mes dy luftërave botërore, pas Luftës së Dytë Botërore, në fund të shekullit XX, ose edhe së voni, edhe pse ende ekzistojnë disa vende në të cilat gratë nuk gëzojnë të drejtën aktive dhe pasive zgjedhore ose njërën prej tyre. Gjithashtu më herët, e edhe sot, edhe pse shumë rrallë, ka pasur dispozita të cilat përcaktonin që pjesëtarët e ushtrisë “nuk mund të ushtrojnë të drejtën zgjedhore”. Në fakt, e drejta zgjedhore nuk u merret, por vetëm nuk mund ta ushtrojnë. Ata e kanë këtë të drejtë, por siç thuhet në teori, ajo pushon apo pezullohet, kurse si pjesëtarë të ushtrisë zakonisht numërohen oficerët aktivë, nën-oficerët (sigurisht aktivë), ushtarët në shërbim ushtarak, si dhe ata që janë të mobilizuar. Arsyet për kufizimin e të drejtës zgjedhore janë të shumta, por më së shpeshti si arsye themelore është dhënë përpjekja që ushtria të mos përzihet në jetën politike të shtetit dhe që pushteti ushtarak të mos keqpërdorë eventualisht të drejtën e tij të thirrjes në ushtrime, manovra e aktivitete tjera ushtarake, sepse kështu e drejta zgjedhore do të kufizohej në praktikë. Natyrisht, këto forma të shkeljes së të drejtave themelore të njeriut (në rastin konkret, të drejtës politike për zgjedhje dhe pjesëmarrje) sot janë tejet të rralla, si dhe janë përjashtime në të drejtën kushtetuese krahasuese.

8. Në fund të këtij prezantimi për kufizimin e të drejtës zgjedhore nuk mund të harrojmë pa përmendur faktin që më herët, ka ndodhur shumë shpesh, e sot është dukuri në vende të caktuara të botës, që kategori të caktuara të shtetasve, përkohësisht apo përherë, humbin të drejtën e zgjedhjes. Në këto kategori më së shpeshti përfshihen: 1) personat që janë dënuar me burgim me afat të caktuar kohor (për shembull, më gjatë se një vit); 2) personat që janë dënuar për humbje të nderit (për aq kohë sa zgjat dënimi); 3) personat që janë në procedurë bankrotimi; 4) personat nën kujdestari; 5) personat që me aktgjykim kanë humbur të drejtën e zgjedhjes për shkak të veprave në zgjedhje. Edhe pse e drejta e zgjedhjes në teori konsiderohet si funksion, si detyrim publik, kushtetutat dhe ligjet e vendeve të caktuara edhe sot e trajtojnë si të drejtë të veçantë, humbja e të cilës duhet kuptuar si ndëshkim i veçantë. Rastet e tilla të humbjes së të drejtës zgjedhore paraprihen nga një akt i institucionit gjyqësor, i cili shpall humbjen e të drejtës ose bazën mbi të cilën është humbur e drejta.
9. Pushteti ekzekutiv nuk është në gjendje që vetë të shpallë humbjen e një të drejte zgjedhore, bile as përkohësisht. Aty ku ekziston një sanksion i tillë (edhe pse shumë rrallë ndeshet në praktikën parlamentare kushtetuese), më së shpeshti kjo është e përkohshme, që do të thotë se zgjat për një kohë, por edhe duhet ditur se për sa kohë zgjat. Për lloje të caktuara, kjo përcaktohet me Kushtetutë e ligje, kurse në disa raste afati i humbjes së të drejtës zgjedhore duhet përcaktuar me interpretim. Nëse disa persona humbin të drejtën zgjedhore, qoftë ajo edhe e përkohshme, ata shlyhen nga listat e zgjedhjeve, kurse kur rifitojnë të drejtën, ata duhen regjistruar prapë në listat zgjedhore.
10. Megjithatë, për të pasur të drejtë zgjedhore të përcaktuar në mënyrë demokratike, nuk mjafton që ajo të jetë vetëm e përgjithshme, por duhet që të jetë e barabartë (që të gëzohet dhe ushtrohet sipas parimit “një njeri, një votë”). ***E drejta e barabartë zgjedhore*** do të thotë që secili votues ka vetëm një votë në një palë zgjedhje dhe që vota e secilit votues ka vlerë të barabartë, pra ka ndikim të barabartë në formimin e organit përfaqësues. ***E drejta e pabarabartë zgjedhore*** ekziston në rastin kur disa kategori të caktuara të shtetasve kanë numër më të madh të votave sesa shtetasit e tjerë. Kjo pabarazi e të drejtës zgjedhore mund të jetë e dyfishtë, si: *shprehimore (e hapur, e pafshehur) dhe e mbuluar (faktike)*. Kur flasim për llojin e parë të të drejtës së pabarabartë zgjedhore, duhet thënë që dallohen tri forma të pabarazisë: 1) votimi plural - disa kategori të zgjedhësve, të formuara në baza të gjendjes pronësore apo shkallës arsimore, kanë pasur dy apo më shumë vota, kurse votuesit tjerë kanë pasur vetëm një votë; 2) votimi i shumëfishtë (shumëzuar) - të gjithë votuesit kanë formalisht një votë, por kategoritë e caktuara të votuesve mund të votojnë në disa njësi zgjedhore në të njëjtat zgjedhje; 3) votimi familjar - kreu i familjes ka numër më të madh të votave, në proporcion me madhësinë e familjes. Megjithatë, edhe këto janë relikte të së kaluarës, kështu që votimet e përmendura (e drejta e pabarabartë zgjedhore) nuk aplikohen më. I pari është aplikuar në Belgjikë në periudhën 1893-1919, kurse i dyti në Britaninë e Madhe deri në vitin 1948.²⁷⁰

²⁷⁰ Mbi shfrytëzimin e të drejtës zgjedhore dhe procedurat e votimit, shih më shumë: Dummet, M., (1984), ‘*Voting Procedures*’, Oxford University Press: Oxford.

11. Në fund, duhet thënë që në teori dhe praktikë dallohet edhe pabarazia e ashtuquajtur e fshehtë (faktike) e të drejtës zgjedhore, ndërsa quhet kështu për shkak se tek ajo arrihet tërthorazi, edhe pse, në kuptimin juridik, të gjithë votuesit kanë të drejta zgjedhore të barabarta. Tek ajo arrihet në rastet kur njësitë zgjedhore me numra të ndryshëm të votuesve zgjedhin numër të njëjtë të përfaqësuesve, ose kur njësitë zgjedhore me të njëjtin numër të votuesve zgjedhin numra të ndryshëm të përfaqësuesve. Në raste të tilla ndodh pabarazia e përfaqësimit, apo vendoset pabarazia në dobi të njërive të caktuara zgjedhore. Një formë më subtile e pabarazisë së të drejtës zgjedhore, sesa kjo është edhe “përshtatja” e njërive zgjedhore, gjë që ka për qëllim favorizimin e tendencave të caktuara politike, apo preferencave të caktuara politike të zgjedhësve. Këtu flitet për gjeometrinë zgjedhore, e cila në SHBA quhet “gjerimandering” (Gerrymandering), ndërsa këtë titull e ka marrë sipas ish-gubernatorit të shtetit Masaçusets (emri i tij ka qenë Gerry), i cili kishte formuar njësitë zgjedhore sipas masave politike (për të siguruar ndikim joproporcional në rezultatet zgjedhore për partinë e tij) dhe të cilat kishin pamje mjaft të çuditshme, ngjashëm me salamandrën. Kështu, me kombinimin e emrave Gerry dhe Mander, është fituar emri "Gerrymander".

Neni 71.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin e saj 71, paragrafi 1, parasheh kualifikimet e duhura, apo kushtet që një person duhet të plotësojë për të arritur të jetë kandidat për deputet. Duke marrë parasysh që me Kushtetutë parashikohet e drejta e përgjithshme zgjedhore, e jo e kufizuar, si dhe që ekziston e drejta e barabartë zgjedhore, e jo ajo e pabarabartë (në asnjë formë) për kandidim për funksionin e deputetit, duhet plotësuar kushtet në vijim: 1) shtetësia - vetëm shtetasit e Republikës së Kosovës mund të kandidohen për deputet; 2) mosha madhore - vetëm personi që ka 18 apo më shumë vjet mund të jetë kandidat për deputet; 3) subjektiviteti - për kandidaturë, është i domosdoshëm posedimi i aftësisë që me veprimet personale të krijohen të drejta e obligime - pra aftësia për të ndërmarrë veprime vetjake. Kjo do të thotë që për arritjen e të ashtuquajturit *kualifikim deputeti* duhen disa kushte të caktuara, sepse ky kualifikim paraqet një grup kushtesh që individi duhet të përmbushë për të qenë kandidat. Këtu qëndrojnë edhe kushtet e fitimit të së drejtës pasive zgjedhore, e së këndejmi, deputet mund të jetë vetëm personi që përmbush këto kushte. Natyrisht, këtu duhet theksuar që secili qytetar ka të drejtë subjektive që të kërkojë mundësi të barabarta për fitimin e të drejtës për kandidim, si dhe garanci për kushte të barabarta, në të cilat kandidati i emëruar hyn në garën zgjedhore, e cila ofron mundësi të barabarta për zgjedhjen e tij.
2. Në të drejtën ndërkombëtare, ka konventa të shumta (si për shembull Traktati për të drejtat civile dhe politike), kurse në të drejtën vendore ekzistojnë kushtetuta dhe ligjet, të cilat garantojnë të drejtën pasive zgjedhore, si një prej formave të realizimit të së drejtës themelore të qytetarit që “pa diskriminim dhe pa kufizime të paarsyeshme të marrë pjesë në punët publike, qoftë drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirish”.

3. Vetë nocioni “kandidat” ka të bëjë me kandidatin për deputet të Kuvendit të Kosovës, i cili kandidohet në emër të partisë politike ose iniciativës qytetare, kurse termi “kandidat i pavarur” do të thotë kandidati për deputet të Kuvendit të Kosovës, i cili nuk i përket asnjë partie politike apo initiative qytetare, si dhe nuk merr pjesë në asnjë listë të subjekteve politike. Partitë politike kanë rol kryesor në mbajtjen e zgjedhjeve dhe plotësimin e ulëseve përfaqësuese në parlament. Kjo rrethanë është veçanërisht e rëndësishme për sistemet shumëpartiake, në të cilat kandidimi për zgjedhje është bërë monopol i partive politike, sepse individët apo grupet e qytetarëve, si bartës të kandidaturës, nuk kanë mundësi për arritje të suksesit. Për këtë rol të madh të partive politike flet shumë qartë Moris Diverzhe, i cili konstaton që “para se zgjedhësit të votojnë deputetin, ai zgjidhet nga partia”. Kjo do të thotë që votuesit në fakt vetëm e përforcojnë atë zgjedhje. “Kjo është qartë e dukshme në sisteme monopartiake” - vazhdon më tutje Diverzhe, “i cili nuk iu lejon zgjedhje votuesve”.
4. Në sistemin shumëpartiak është e njëjta gjë, por më pak e dukshme. Fakt është që votuesi mund të zgjedhë mes disa kandidatëve, por paraprakisht secili prej tyre është emëruar nga partia”. Partia politike është organizatë e personave që janë bashkuar me vullnetin e tyre në bazë të ideve, interesave apo qëndrimeve të përbashkëta, me qëllim të ndikimit në zgjedhjen e kandidatëve të tyre, kurse subjekti politik nënkupton partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare apo kandidatët politikë. Kur flitet për kandidatin e pavarur, duhet thënë që ai mund të certifikohet për kandidim në zgjedhje, me kushtin që të jetë i përshtatshëm si kandidat, në bazë të nenit 73 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenit 29 të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe vetëm nëse është regjistruar si zgjedhës. Kandidati i pavarur nuk mund të kërkojë certifikim për parti politike, koalicion apo iniciativë qytetare në të njëjtat palë zgjedhje. Ajo që vlen të thuhet për kandidatët që nuk bëjnë pjesë në grupin e kandidatëve të pavarur, sepse kandidohen nga partia politike, është fakti që këta kandidatë, pasi që e dinë që kandidaturën e kanë fituar në saje të partisë, kur zgjidhen si përfaqësues, ndjejnë më shumë obligim ndaj asaj partie, sesa ndaj votuesve.
5. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në kapitullin II, që i kushtohet të drejtave dhe lirive themelore, proklamon parimin e të drejtës së përgjithshme zgjedhore me dispozitën që thotë thekson se çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor (neni 45, paragrafi 1 - të drejtat e zgjedhjes dhe pjesëmarrjes). Kështu, ligjvënësi ka vendosur që me Kushtetutë t’i vendosë kushtet për realizimin e asaj të drejte, apo kushtet e zgjedhjes. Nëse Kushtetuta do t’ia linte ligjeve këtë të drejtë plotësisht, do të mund të vinte tek situata që ligji të vendosë kushte të tjera, ose t’i ashpërsojë ato, ashtu që prej të drejtës së përgjithshme të krijohej e drejta e kufizuar zgjedhore. Kushtetuta ka vendosur dy kushte themelore të zgjedhjes, që janë: shtetësia dhe mosha tetëmbëdhjetëvjeçare. Ligji zgjedhor, apo Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nuk përsërit këto kushte, pra

ato nuk mund të gjenden në tekstin ligjor, përveç që neni 29, paragrafi 1 i këtij Ligji qartë e thekson që secili person, emri i të cilit paraqitet në listën zgjedhore, duhet certifikuar si kandidat për deputet, përveç në rastet e përcaktuara shprehimisht me pikat e këtij paragrafi, prej a) deri në s).

6. Në paragrafin 1 të nenit 71 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili është lënda e komenteve tona, shtetësia, si kusht për zgjedhje, nuk kualifikohet më afërsisht, por Kushtetuta e njeh të drejtë e zgjedhjes për secilin person që është shtetas i Republikës së Kosovës. Në fakt, nuk ka aspak nevojë që të klasifikohet apo përcaktohet më hollësisht shtetësia. E drejta e zgjedhjes, si e drejtë eminente e votuesit, i përket të gjithë qytetarëve pa dallim. Shtetësia nënkupton një lidhje shumë të ngushtë ligjore mes shtetit të Kosovës dhe një personi, prej së cilës lindin të drejta e obligime të dyanshme. Marrja apo mbajtja e shtetësisë së dytë nuk shkakton humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës. Këtu do të përmendim mundësinë e marrjes së shtetësisë së Republikës së Kosovës, të përcaktuar me nenin 5 të Ligjit për shtetësinë e Kosovës, si në vijim: 1) me lindje; 2) me birësim; 3) natyralizim ("natyralizimi" nënkupton fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës në bazë të kërkesës së një personi që nuk është shtetas i Kosovës); 4) në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare. Gjithashtu, Ligji i shtetësisë së Kosovës (neni 16) përcakton edhe mënyrat e humbjes së shtetësisë së Republikës së Kosovës, si në vijim: 1) lirimi nga shtetësia; 2) marrja e të drejtës së shtetësisë; 3) në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare.
7. Zgjedhja e deputetëve bëhet sipas rregullave të përgjithshme por edhe atyre të veçanta. Në rastin e parë, pra rregullat e përgjithshme, përfshihet përfaqësimi i qytetarëve në parlament, por përbërja e Parlamentit ndikohet edhe nga rasti i dytë, apo rregullat e veçanta të cilat quhen *masa të veprimt afirmativ*. Në fakt, në praktikën parlamentare deri tash është treguar që mund të ndodhë diskriminimi në baza gjinore, nëse përbërja e Parlamentit zgjidhet vetëm sipas rregullave të përgjithshme. Është fakt edhe në ditën e sotme që në shumë vende, e sidomos në të kaluarën, ka pasur përfaqësim shumë më të ulët të gruas në parlament, në krahasim me meshkujt.²⁷¹ Më herët, grave iu është privuar e drejta e zgjedhjes, kurse sot, edhe pse kushtetutat garantojnë këtë të drejtë politike pa diskriminim në bazë gjinore, përçindja më e madhe e elektoratit femëror efektivisht shfrytëzon vetëm të drejtën aktive, e jo atë pasive të zgjedhjes. Ky problem nuk është individual, por i përgjithshëm, apo global, si dhe për këtë, nuk mund të zgjidhet pjesërisht (lokalisht), por në mënyrë të përgjithshme, apo në plan ndërkombëtar. Dokumente të shumta ndërkombëtare (deklarata, konventa, traktate e të tjera) vendosin standarde të ndryshme që duhet të kontribuojnë në barazinë e përfaqësimit të gruas dhe burrit në parlament. Ndër aktet më të rëndësishme të cilat merren me këtë problematikë veçanërisht të rëndësishme është edhe Konventa për të drejtat politike të gruas e vitit 1952, Deklarata për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të gruas e

²⁷¹ Për më shumë, shih: Mertus, A. Julie and Flowers, Nancy (2008), '*Local Action/Global Change: A Handbook on Women's Rights*', Paradigm Publishers: Boulder, Colorado; Wollstonecraft, Mary (2013), '*A Vindication of the Rights of Woman*', Flipside Publishing: Philippines.

vitit 1967, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave nga viti 1979, Deklarata për barazinë mes grave dhe burrave e vitit 1988, Deklarata e Këshillit të Evropës për barazinë e grave dhe burrave e vitit 1997, Deklarata Universale për Demokracinë e vitit 1997, si dhe akte të tjera.²⁷²

8. Duke marrë parasysh që sot në një numër të madh vendesh, vëmendje e veçantë i kushtohet të drejtës ndërkombëtare, që politika e jashtme e shumë vendeve bazohet tek parimet e njohura gjerësisht dhe rregullat e të drejtës ndërkombëtare, që parimet dhe rregullat e njohura të së drejtës ndërkombëtare paraqesin kornizën e përcaktuar me kushtetutë, si dhe bazën mbi të cilën ndërtohet politika e jashtme e atyre vendeve, përbërja e Parlamentit ndikohet edhe nga këto standarde të përmendura, të cilat përligjen nga kushtetutat e këtyre vendeve. Në fakt, kushtetutat e këtyre vendeve përcaktojnë mundësinë e marrjes së masave të veprimit afirmativ, mu për të hequr çdo lloj diskriminimi (drejtpërdrejt apo tërthorazi) dhe për të realizuar barazinë gjinore. Këtë zbatim të drejtpërdrejtë të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare e përcakton me dispozitat e saj edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, duke theksuar që të drejtat dhe liritë e njeriut, që janë të përcaktuara me marrëveshjet dhe instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare,²⁷³ të garantuara me këtë Kushtetutë, si dhe që ato zbatohen drejtpërdrejt në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës si dhe që mbizotërojnë, në rast konflikti, mbi të gjitha dispozitat ligjore dhe aktet tjera të institucioneve publike (neni 22.).
9. Kur bëhet fjalë për sigurimin e barazisë së grave dhe burrave në konsolidimin e elektoratit dhe zhdukjes së diskriminimit, qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, duhet thënë që me ligjet përkatëse për zgjedhje rregullohen më saktësisht përmbajtja e këtyre masave të veprimit afirmativ. Këto masa mund të jenë të natyrave të ndryshme, që varet nga llojet e sistemit zgjedhor që zbatohet, pra nëse zbatohet sistemi mazhoritar apo ai proporcional zgjedhor. Nëse është tipi i parë i sistemit zgjedhor, i cili zbatohet në njësi zgjedhore me një mandat, edhe përkundër ndërmarrjes së masave të shumta të veprimit afirmativ në dobi të grave, prapë është më e vështirë arritja e përfaqësimit të barabartë të gjinive në strukturën e Parlamentit. Në fakt, në sistemet proporcionale zgjedhore në njësi zgjedhore me më shumë mandate arrihet më lehtë ky përfaqësim i barabartë, kaq i kërkuar në kohët e fundit, i gjinive në parlament. Kur flitet për këto sisteme zgjedhore, duhet thënë që kandidimi bëhet në lista dhe që bëhet zgjedhja e më shumë mandateve, apo një numri më të madh të deputetëve në një listë të vetme zgjedhore, pra

²⁷² Për këtë është shkruar mjaft gjerësisht tek: Michalska, A., (1980), "Primjena međunarodnih paktova o pravima čovjeka", *Zbornik radova Pravnog fakulteta u Splitu*, Vol. 17, fq. 157-170; Samuel Issacharkopp, Karlan, S. Pamela and Pildes, H. Richard (2007), 'The Law of Democracy. Legal Structure of the Political Process', Foundation Press: New York, NY

²⁷³ Në këto marrëveshje dhe instrumente bëjnë pjesë: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut, si dhe protokollet e saj, Konventa Ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, si dhe protokollet e saj, Kornizë-Konventa e Këshillit Evropian për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, si dhe të tjera.

ndërmarrja e masave të përmendura (veprimet afirmativ) siguron eliminimin e diskriminimit të gjinive në përbërje të Parlamentit.

10. Megjithatë, kur flitet për këto masa, duhet thënë që padyshim më efikasja është ajo që përcakton *kuota për gjininë më pak të përfaqësuar në listën e kandidatëve*. Kështu për shembull, më së shpeshti përcaktohet që në secilën listë kandidatësh duhet të jenë të emëruar më së paku 30% të kandidatëve nga gjinia më pak e përfaqësuar. Kjo përcaktohet me ligj dhe, së këndejmi, paraqet kusht ligjor për vlefshmërinë e listës. Natyrisht, përveç kuotave të përcaktuara në lista, si dhe votimit teknik, përcaktohen edhe masa të tjera afirmative, si për shembull, mjetet materiale të veçanta që i ndahen partisë politike për fushatën zgjedhore të kandidatëve të gjinisë më pak të përfaqësuar (që zakonisht është femërore), lirimi nga pagesa e depozitës për candidate që garojnë si të pavarura, etj. Praktika ka treguar që ndërmarrja e këtyre masave jep rezultate të mira, si dhe sot, ka përditë e më shumë gra në parlament.

Neni 71.2

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 71, paragrafi 2, flet për barazinë gjinore të anëtarëve të organit më të lartë përfaqësues, me dispozitën që «përbërja e Kuvendit të Kosovës duhet të respektojë barazinë gjinore, që është në pajtim me parimet e pranura ndërkombëtare". Ligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës përcakton kushtet për barazinë gjinore, duke theksuar që të gjitha listat e kandidatëve të subjekteve politike duhet të përbëhen nga së paku 30% meshkuj dhe së paku 30% femra, me nga një kandidat të secilës gjini, që është i përfshirë së paku një herë në çdo grup prej tre kandidatësh, duke filluar nga kandidati i parë në listë (neni 27, paragrafi 1). Ky paragraf nuk përfshin listat që përbëhen nga një apo dy kandidatë (neni 27, paragrafi 2).
2. Grupi joformal i grave deputete të Kuvendit të Kosovës, në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, kishin organizuar në shtator të vitit 2010 një tryezë të rumbullakët dedikuar implementimit të ligjit që ka të bëjë me barazinë gjinore, dorëzimit të amendamenteve për Ligjin për zgjedhje dhe forcimit të pozitës së gruas në shoqëri. Përvojat më të mira në SHBA dhe në botë tregojnë që pjesëmarrja e gruas në jetën parlamentare dhe në veprimtaritë tjera ofron përfitime të mëdha në punën e Parlamentit. Kontributi i grave ndjehet edhe në luftën ndaj dukurive negative, siç janë dhuna në familje, korrupsioni, e të ngjashme. Kështu, ai kontribut vërehet edhe në tejkalimin e ndarjeve politike dhe ndarjeve tjera, si dhe në tejkalimin e konflikteve në drejtim të arritjes së kompromiseve. Gjithkund në botë, gratë përballen me pengesa të ndryshme, por ato duhet të jenë të vendosura në tejkalimin e tyre dhe në ofrimin e mbështetjes për njëra-tjetrën, sidomos në fushatat parazgjedhore dhe në garën e zgjedhjeve. Vetëm me vullnet të hekurt dhe organizim të mirë, gratë amerikane kanë hyrë në Kongres dhe këto me pjesëmarrje prej 1% para 25 vitesh, përqindje kjo që sot është 17%. Edhe gratë deputete, apo anëtarët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, kanë arritur rezultate të konsiderueshme, gjë që i trimëron për suksese të mëtuqeshme dhe i obligojnë ato

të jenë të njëzëshme për forcimin e rolit të gruas në jetën parlamentare dhe në çdo segment tjetër të shoqërisë. Në fakt, pozita e gruas kosovare në vendimmarrje, por edhe në përgjithësi në shoqëri, është në përmirësim e sipër. Kështu, sot, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, gratë kanë pjesëmarrje të garantuar prej 30%, në Qeverinë e Republikës së Kosovës janë të përfaqësuara me 14%, deri sa në institucionet komunale kjo pjesëmarrje është 34%. Megjithatë, gratë në Kosovë duhet të bëjnë përpjekje që pozita e tyre të mos varet nga kuotat e përligjura zgjedhore, por që të sigurojnë vetë ulësen në Kuvend, Qeveri, biznes e fusha të tjera, ku me zërin dhe kontributin e tyre të marrin pjesë në çdo fushë të jetës institucionale dhe shoqërore.

Neni 72 [Papajtueshmëria]

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nuk mund të mbajë ndonjë post ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike, dhe as të ushtrojë ndonjë funksion tjetër ekzekutiv, sikurse është përcaktuar me ligj.

Neni 72

1. Për punë të papenguar të Parlamentit, është tejet me rëndësi që anëtarët e tij, përkatësisht deputetët, të jenë plotësisht të pavarur në kryerjen e funksioneve të tyre dhe në qëllimin e sigurimit të kësaj pavarësie, me Kushtetutë, si akti i përgjithshëm juridik më i lartë, përcaktohet që mandati i deputetit është i mbrojtur me imunitet (për të cilin do flasim pak më vonë). Megjithatë, për të siguruar pavarësinë e plotë të deputetëve dhe ushtrimin e paanshëm të funksionit të tyre, është e domosdoshme që mandati i deputetit t'iu nënshtrohet disa kufizimeve të caktuara. Këto kufizime kanë të bëjnë me ushtrimin e disa aktiviteteve publike apo private të deputetit, sepse aktivitete të caktuara jashtëparlamentare mund të ndikojnë në masë të konsiderueshme në pavarësinë e deputetit. Gjithashtu, me rëndësi të veçantë është që me pamundësimin e ushtrimit të aktiviteteve të caktuara nga deputetit jashtë Parlamenti, apo me përcaktimin ligjor të mospërputhshmërisë parlamentare, të ndalohen keqpërdorimet e mundshme në ushtrimin e funksionit të deputetit. Këtu bëhet fjalë për atë që deputetëve t'iu ndalohet ushtrimi i njëkohshëm i mandatit parlamentar me funksionet apo pozitat që kanë mbajtur para zgjedhjeve, ose të cilët i kanë marrë pas zgjedhjeve parlamentare dhe fitimit të mandatit të deputetit.
2. Mospërputhshmëria parlamentare, apo mospërputhja e funksioneve do të thotë ndalim i grumbullimit të mandatit me shërbime e aktivitete të caktuara dhe kufizim të mundësisë së grumbullimit të tyre në duart e një deputeti. Kështu, kjo mospërputhje parlamentare obligon, apo më mirë të themi, detyron deputetin që të zgjedhë mes mandatit të fituar parlamentar dhe funksionit që nuk është në përputhje me këtë mandat (ky vendim nuk ndikohet fare nga fakti nëse ai funksion është fituar para apo pas zgjedhjeve). Kështu, mospërputhshmëria parlamentare nuk mund të jetë pengesë për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare (për këtë do të

bëhet fjalë në komentet për nenin vijues 73 të Kushtetutës, i cili flet për pamundësinë e kandidimit), por kjo është pengesë për ushtrim të mëtutjeshëm të mandatit, sepse qëllimi themelor i mospërputhjes është mbrojtja e pavarësisë së deputetit e jo mbrojtja e zgjedhësve. Ajo që është karakteristike për mospërputhshmërinë, (e cila përmendet edhe në Kushtetutën e Republikës së Kosovës në nenin e saj 72), është fakti që deputeti i zgjedhur duhet të vendosë për njërin nga këto dy opsione: ose të mbajë mandatin e fituar parlamentar, ose funksionin që nuk përputhet me atë mandat (nëse zgjedh këtë të dytën, mandati i tij parlamentar shuhet).

3. Kur flasim për mospërputhshmërinë e funksioneve, apo jokompatibilitetin parlamentar, duhet thënë që ajo zbatohet në ato sisteme kushtetuese të cilët organizimin e autoritetit të tyre²⁷⁴ e mbështesin tek parimet e ndarjes së pushtetit.²⁷⁵ Si element i pashmangshëm i shtetit të së drejtës, sundimit të ligjit dhe konstitucionalizmit,²⁷⁶ ky parim është njëri prej kushteve që garanton respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.²⁷⁷ Në këto sisteme, të cilat e zbatojnë këtë parim,²⁷⁸ çështja kryesore është raporti mes pushtetit ligjvënës dhe atij ekzekutiv, pra marrëdhënia mes legjislativit dhe ekzekutivit. Duke marrë parasysh që të dyja janë funksione politike, kurse pushteti gjyqësor është funksion profesional, grumbullimi i këtyre funksioneve është paraprakisht i pamundësuar, sepse pushteti gjyqësor duhet të jetë plotësisht i pavarur nga pushteti ligjvënës dhe ekzekutiv (në ushtrimin e funksioneve të tij, marrjen e vendimeve e të ngjashme, përveç në rastin e zgjedhjeve). Në të kundërtën, ky parim i ndarjes së pushtetit do të deformatohej plotësisht dhe do të humbte kuptimin. Megjithatë, në sistemin parlamentar është shumë i rëndësishëm raporti mes Qeverisë dhe Parlamentit,²⁷⁹ apo funksioneve të fituara dhe të kontrolluara nga Qeveria dhe funksionit parlamentar. Pra, duke marrë parasysh që Qeveria dhe anëtarët e saj zgjidhen nga Parlamenti, i cili edhe

²⁷⁴ Në organizimin e autoritetit apo pushtetit, duhet dalluar organizimi horizontal dhe vertikal i pushtetit. I pari mund të definohet si pozitiv e përcaktuar me Kushtetutë si dhe raport mes organeve shtetërore, të cilët ushtrojnë funksione të caktuara shtetërore (ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore) në nivel horizontal. Ndarja vertikale e pushtetit paraqet ndarje të punëve të pushtetit shtetëror mes organeve qendrore të pushtetit, organeve të krahinave autonome dhe organeve të vetëqeverisjes lokale.

²⁷⁵ Parimi i ndarjes së pushtetit është tashmë rregull, si dhe zbatohet në vendet demokratike të botës, kurse parimi i njësimimit (akumulimit) të pushtetit, si parim mbi të cilin bëhet organizimi i pushtetit në vende të caktuara, është vetëm përjashtim nga rregulli.

²⁷⁶ Për një analizë të shkëlqyeshme të evoluimit historik të këtyre tri instituteve, që nga koha e Mesjetës deri më sot, shih më tepër në: Vile, M.C.J., (1967), *'Constitutionalism and the Separation of Powers'*, Oxford University Press: Oxford, dhe Fridrih, K., (1996), *'Konstitucionalizam' ograničavanje i kontrola vlasti*, CID: Podgorica.

²⁷⁷ Anson, W. R., (1907), *'The Law and Custom of the Constitution'*, The Clarendon Press: Oxford, fq. 85.

²⁷⁸ Ky parim paraqet një instrument demokratik të veprimit kundër koncentrimin të pushtetit, si dhe sipas tij, ndarja e pushtetit është parim i organizimit të shtetit modern kushtetues. Në fakt, parimi i ndarjes së pushtetit ka vlerë të pakontestueshme demokratike, sepse me pamundësimin e koncentrimin të pushtetit, ndarja e pushtetit vendos sundimin e ligjit.

²⁷⁹ Andrews, W.G., (1963), *'Constitutions and Constitutionalism'*, Van Nostrand: Princeton, New Jersey, fq.161-165.

kontrollon punën e tyre, që i përgjigjet Parlamentit për punën e saj, si dhe prej Parlamentit mund të ushtrohet edhe mosbesimi i Qeverisë. Është plotësisht normale që deputetët të kritikojnë, të kërkojnë raporte dhe të kontrollojnë Qeverinë. Kështu, është e domosdoshme që këto dy funksione të jenë të ndara, që të mos ndodhë që deputetët të kontrollojnë vetveten dhe t'i japin vetes votën.

4. Përveç kësaj, arsye e mospërputhshmërisë është mbrojtja e parlamentarëve nga presioni që vjen nga ana e ekzekutivit dhe sigurimi i stabilitetit të Qeverisë, edhe pse arsyeja më e natyrshme për vendosjen e saj është vështirësia, pra mund të thuhet lirisht që është edhe fizikisht e pamundur që deputeti të ushtrojë dy apo më shumë funksione njëkohësisht. Siç kemi theksuar më lart, funksioni i Parlamentit, sidomos në regjime parlamentare, është zgjedhja, kontrollimi, vëzhgimi dhe kritika e punës dhe aktiviteteve të Qeverisë. Megjithatë, anëtarët e Parlamentit nuk mund të kenë atë liri të kritikës së Qeverisë, nëse ai njëkohësisht i përket edhe administratës shtetërore, sepse statusi i tyre në administratën shtetërore varet mu nga Qeveria. Po të ishte kështu, me rastin e votimit të këtyre deputetëve për Qeverinë, do të kishte gjithmonë dyshime që ata kanë dhënë votën ose nga frika ose nga interesi.
5. Mu për këtë, edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës shprehimisht përcakton që deputeti i Republikës së Kosovës nuk mund të punojë në administratën shtetërore apo në ndonjë ndërmarrje tjetër publike, pasi që zgjedhja, mbikëqyrja e punëve, kontrolli i akteve, sigurimi i mjeteve financiare, si dhe humbja e besimit bëhet nga Qeveria, si bartësja më e rëndësishme e funksionit ekzekutiv, përveç Presidentit të Republikës. Gjithashtu, deputeti i Kuvendit të Kosovës nuk mund të ushtrojë funksione të tjera ekzekutive, ashtu siç edhe përcaktohet me ligj, sepse kjo do të ishte në kundërshtim me dispozitat e nenit 4, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila përcakton që Kosova është Republikë Demokratike, e ndërtuar mbi parimin e ndarjes së pushtetit. Nëse kjo gjë nuk do të respektohej, do të vinte shkatërrimi i thelbit të këtij parimi, i cili sot është rregull i organizimit të pushtetit të shteteve bashkëkohore demokratike.

Neni 73 [Pamundësia e Kandidimit]

- (1) **Nuk mund të kandidohen dhe as të zgjidhen deputetë të Kuvendit, pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre:**
 1. **gjqytarët dhe prokurorët;**
 2. **pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës;**
 3. **pjesëtarët e Policisë së Kosovës;**
 4. **pjesëtarët e Doganave të Kosovës;**
 5. **pjesëtarët e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;**
 6. **udhëheqësit e agjencive të pavarura;**
 7. **përfaqësuesit diplomatikë;**
 8. **kryetarët dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.**

- (2) Nuk mund të kandidohen për deputetë personat e privuar nga zotësia juridike për të vepruar, me vendim përfundimtar të gjykatës.
- (3) Kryetarët dhe zyrtarët e tjerë, të cilët mbajnë përgjegjësi ekzekutive në nivel komune, nuk mund të zgjidhen si deputetë të Kuvendit pa hequr dorë paraprakisht nga detyra e tyre.

Neni 73

1. Në nenin paraprak, folëm për papajtueshmërinë e funksioneve (pamundësinë e grumbullimit) të mandatit parlamentar me pozitë që deputeti ka marrë para zgjedhjeve, ose ka fituar pas zgjedhjes në funksionin e përmendur. Këtu është e rëndësishme të thuhet që kjo papajtueshmëri nuk mund të jetë pengesë për pjesëmarrje në zgjedhjet parlamentare, por është pengesë për ushtrimin e mëtutjeshëm të mandatit. Kështu, në teori bëhet dallimi (siç theksohet shpesh) mes **papajtueshmërisë** dhe **pamundësisë për zgjedhje**, dhe ky dallim është tejte i qartë. Në fakt, pamundësia e kandidimit është pengesë ligjore që ekziston para zgjedhjeve dhe e bën atë zgjedhje të pamundur. Pasojat e kësaj do t'i shpjegojmë në rastin e ardhshëm. Nëse themi që kandidati për deputet është personi që nuk është i përshtatshëm për zgjedhje, si dhe nëse ai person ka marrë shumicën e nevojshme të votave, konsiderohet që zgjedhja e tij është e pavlefshme, si dhe së këndejmi, ajo zgjedhje duhet anuluar, si dhe personi i tillë nuk mund të hyjë në parlament. Me papajtueshmërinë situata është ndryshe. Pra, nëse ai person fiton shumicën e nevojshme të votave, pra nëse zgjidhet, ai person hyn në parlament dhe zgjedhja e tij do të vërtetohet, por pasojat e papajtueshmërisë janë si në vijim: ai person nuk mund të mbajë pozitën e cila është e papajtueshme me mandatin e tij.
2. Siç kemi theksuar gjatë komentimit të nenit të mëhershëm 72 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pamundësia e kandidimit ka për qëllim të mbrojtë zgjedhësit. Ky parim i pamundësisë mbron zgjedhësit nga presionet e kandidatëve për pozitë pushteti si dhe siguron garë të drejtë, korrekte dhe të barabartë të zgjedhjeve, kështu që, për të garuar në zgjedhje, këta persona më së pari duhet të lëshojnë funksionet e deriatëhershme publike. Ajo që është me rëndësi të theksohet është që pamundësia e kandidimit ka karakter absolut, si dhe mund të paraqitet edhe para edhe pas zgjedhjeve. Nëse paraqitet para zgjedhjeve, ajo paraqet pengesë të patejkalueshme për kandidim (ndalon zgjedhjen e personit në funksion deputeti), kurse nëse paraqitet pas zgjedhjeve, ajo paraqet bazë për humbjen e mandatit të deputetit (çon në shpallje të pavlefshme të zgjedhjeve, apo humbjen e mandatit parlamentar, pa marrë parasysh vullnetin e deputetit të zgjedhur). Në rastin e parë, pengesat për kandidim i përkasin të drejtës zgjedhore, kurse në rastin e dytë, këto pengesa kanë rëndësi për të drejtën parlamentare.
3. Pamundësia e kandidimit, pra, paraqet kushtëzime dhe shpall papajtueshmërinë e shërbimit të deputetit dhe shërbimin e bartësit të funksioneve të caktuara të pushtetit. Kjo papajtueshmëri është e natyrës që paraprakisht pamundëson përputhjen e atyre shërbimeve. Jo vetëm që bartësit e atyre funksioneve nuk mund të jenë deputetë, por as nuk mund të kandidohen. Kështu, zyrtarët e tillë, apo

bartësit e funksioneve të caktuara, nëse duan të kandidojnë, duhet që kapacitetin e tyre zyrtar, apo kapacitetin e bartësit të funksionit të pushtetit ta «likuidojnë» që para paraqitjes së kandidaturës. Kjo do të thotë që nuk mund të vërtetohet asnjë listë kandidatësh në të cilën personi i tillë figuron si kandidat, e kjo është lehtë të konstatohet, sepse secilit kandidat i duhet shënuar profesioni dhe nuk do të duhej konfirmuar lista në të cilën është shënuar një profesion i tillë «i kontestueshëm» i kandidatit. Nëse në çfarëdo rasti, një listë e tillë kandidatësh do të vërtetohet megjithatë, apo nëse profesioni do të shkruhej rrejtshëm, mandatet e deputetëve të zgjedhur në këtë mënyrë do të duhej anuluar me aktin e verifikimit.

4. Kushtetutat që i përmbahen parimit të ndarjes së pushtetit (siç është edhe rasti me Kushtetutën e Republikës së Kosovës), ndalojnë bashkimin e funksionit gjyqësor, përkatësisht organit administrativ me funksionet e organit ligjvënës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka mundur të kërkojë nga funksionarët e zgjedhur që «t'ia thonë lamtumirën» shërbimit gjyqësor apo administrativ dhe, në këtë mënyrë, të mos lejohet grumbullimi i funksioneve të ndryshme. Por, ajo ka ndaluar edhe vetë kandidimin e këtyre zyrtarëve, duke u frikësuar (me të drejtë) nga presioni i mundshëm i tyre mbi zgjedhësit me rastin e zgjedhjeve. Kështu pamundësohet hyrja e zyrtarëve, apo bartësve të funksioneve në pushtetin publik, të shprehur me kushtetutë, në parlament. Kjo bëhet gjithsesi ashtu që parimi i ndarjes së pushtetit të zbatohet në mënyrë të rreptë dhe me qëllim të mbrojtjes së interesave të përgjithshëm. Në këtë mënyrë, këtyre personave i ndalohet kandidimi, si dhe me këtë, iu merret e drejta pasive e zgjedhjes, por ata, në anën tjetër, gëzojnë të drejtën aktive të zgjedhjes së plotë, përveç, natyrisht, përfaqësuesve diplomatikë, të cilët nuk mund të kenë të drejtë «të zgjedhin apo të zgjidhen», të garantuar me nenin 45, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke theksuar që me këtë paragraf përcaktohet që secili shtetas i Republikës së Kosovës që ka mbushur 18 vjet, ka të drejtë të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur, përveç nëse kjo e drejtë kufizohet me vendim gjykate (kurse përfaqësuesit diplomatikë nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, pra nuk kanë të drejtë as pasive e as aktive të zgjedhjes).
5. Ky institut i pamundësisë së kandidimit pra kufizon mundësinë e shfrytëzimit efektiv të të drejtës për kandidim. Në fakt, në anën e kandidatit nuk guxojnë të ekzistojnë supozime të përcaktuara me kushtetutë e ligj, për arritjen dhe realizimin e funksionit të deputetit. Siç e kemi theksuar, ky institut i papajtueshmërisë parlamentare bazohet tek parimi i ndarjes së pushtetit, i cili nuk lejon që disa veprimtari profesionale (si për shembull: gjyqtarët, prokurorët publikë, ushtarët profesionistë, pjesëtarët e policisë profesionale, ombudsmani apo avokati i popullit, e të tjerët), bartësit e funksioneve publike dhe politike (për shembull, ministrat, zyrtarët e lartë të administratës shtetërore, anëtarët e kuvendeve - rajonale apo lokale) të bëhen njëkohësisht me mandatin e parlamentarit. Këto vende pune, apo veprimtari profesionale apo pozita publike, të cilat janë të papajtueshme me funksionin parlamentar, renditen në kushtetutë, ose lihen për t'u rregulluar me ligj, kurse Kushtetuta e jep vetëm normën parimore (të përgjithshme, abstrakte), duke theksuar papajtueshmërinë e funksionit të deputetit me veprimtaritë tjera profesionale apo funksionet publike.

1. Në lidhje me zgjidhjet kushtetuese që kanë të bëjnë me rregullimin e konfliktit të interesave dhe papajtueshmërinë e funksionit të deputetit me pozitat dhe punët tjera, theksojmë këtu faktin që me nenin 73, paragrafi 1, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është përcaktuar që prej kandidimit për funksion deputeti përjashtohen edhe gjyqtarët dhe prokurorët,²⁸⁰ pra këta persona nuk mund të kandidohen, e as të zgjidhen si deputetë të Republikës së Kosovës, pa dhënë dorëheqje (kjo vlen edhe për personat tjerë të renditur shprehimisht në nenin 73, paragrafi 1, pikat 2-8, dhe personat e përmendur në paragrafin e dytë të të njëjtit nen, të cilët nuk mund të kandidohen për deputetë nëse janë të privuar nga zotësia juridike dhe personat e përcaktuar me paragrafin 3 të këtij neni, të cilët nuk mund të zgjidhen si deputetë, nëse gjenden në funksionin e kryetarëve të komunave ose zyrtarëve të tjerë në nivel komunal, që ushtrojnë funksion ekzekutiv, deri në dorëheqjen e tyre). Kushtetuta nuk përcakton shprehimisht që pozita e zyrtarit në organet e drejtësisë është e papajtueshme me funksionin e deputetit dhe me mundësinë e kandidimit për këtë funksion dhe as për atë të zëvendësit të prokurorit, por nga norma parimore, e përgjithshme, sipas së cilës gjyqtarët dhe prokurorët e kanë të ndaluar të kandidojnë, mund të përfundohet që kjo ndalesë vlen edhe për zyrtarët e përmendur, pra edhe për zëvendësit e tyre. Në fakt, gjyqtarët dhe prokurorët (si dhe zyrtarët në organet e drejtësisë dhe zëvendës-prokurorët) janë bartës të funksioneve të drejtësisë, pra përfaqësues të pushtetit gjyqësor, kështu që ndërhyrja (grumbullimi, akumulimi, bashkimi, përafrimi) i funksioneve të deputetit dhe gjyqësore *apriori* është e përjashtuar.
2. Përveç këtyre, me paragrafin 1, pika 2, të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pamundësia e kandidimit për funksion deputeti parashikohet edhe për pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (neni 126 i Kushtetutës), të cilët

²⁸⁰ Këtu është me interes të theksohet fakti që neni 29, paragrafi 1 i Ligjit për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës zgjeron spektrin e personave për të cilët vlen pamundësia e kandidimit, e përcaktuar me nenin 73, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në fakt, sipas dispozitës së përmendur të këtij Ligji, pamundësia e kandidimit përcaktohet duke u përligjur që secili person, emri i të cilit paraqitet në listën zgjedhore, është i aftë të certifikohet si kandidat, përveç nëse ky person është: a) gjykatës apo prokuror në Kosovë ose gjetkë; b) pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës; c) pjesëtar i Policisë së Kosovës; d) pjesëtar i Shërbimit Doganor të Kosovës; e) pjesëtar i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë; f) kryesues i një agjencie të pavarur; g) përfaqësues diplomatik; h) kryesues apo anëtar i Komisionit Qendror Zgjedhor; i) pjesëtar i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa; j) anëtar i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve; k) pjesëtar i forcave të armatosura të ndonjë shteti; l) pjesëtar i ndonjë force policore apo të një trupi të ngjashëm; m) duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë; n) nën akuzë nga Tribunali dhe ka dështuar të veprojë në përputhje me urdhrin për t'u paraqitur para Tribunalit; o) me anë të vendimit të gjykatës, përfshirë edhe vendimin e KZAP-it i është hequr e drejta për të qenë kandidat; p) me anë të vendimit të gjykatës, i është hequr e drejta për të qenë kandidat; q) shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit; r) ka dështuar të paguajë gjobën e vënë nga KZAP-i apo KQZ-ja; ose s) ka dështuar t'i përmbahet ndonjë urdhri të KZAP-it.

përfaqësojnë forcat e sigurisë kombëtare të Republikës së Kosovës dhe mbrojnë qytetarët dhe komunitetet e Kosovës, në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj. Komandanti Suprem i këtyre forcave është Presidenti i Republikës së Kosovës, sepse ato forca gjithmonë i nënshtrohen kontrollit të autoriteteve civile, të zgjedhura në mënyrë demokratike. Kuvendi i Republikës së Kosovës, presidenti, kryeministri dhe ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës përbëjnë zinxhirin e mbikëqyrjes civile mbi këto forca, në pajtim me Kushtetutën, Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe aktet tjera relevante ligjore. Qeveria e Republikës së Kosovës ka të drejtë dhe obligim që të ushtrojë kontrollin transparent, demokratik dhe civil mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë profesionale, që promovon diversitetin etnik të banorëve të Republikës së Kosovës, kurse trupat e veta i plotëson me rekrutimin e shtetasve të Republikës së Kosovës. Komandantin e kësaj Force e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës, me rekomandim të Qeverisë, kurse organizimi i saj i brendshëm rregullohet me Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës (miratuar në Kuvend më 13 mars 2008, shpallur me Dekretin e Presidentit nr. DL-012-2008, të datës 15 qershor 2008). Si instrument i sigurisë, këto forca kanë për mision ofrimin e mbështetjes për Qeverinë e Republikës së Kosovës, janë të armatosura lehtë, si dhe nuk kanë armë të rënda, si tanket, artileria e rëndë, apo kapacitetet ofensive ajrore. Me ligjin përkatës, është përcaktuar paanësia politike, integriteti dhe standardet e sjelljes së Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila nuk mund të përdoret për qëllime politike apo aktivitete të partive politike. Së këndejmi, pjesëtarët e kësaj Force nuk mund të jenë anëtarë të partive politike, as nuk mund të shprehin haptas përkrahjen për asnjë parti, nuk mund të kandidohen e as të zgjidhen si deputetë, por kjo nuk ndikon në të drejtën e secilit pjesëtar të Forcës që të votojë. Gjithashtu, pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës duhet të respektojnë kodin e mirësjelljes që nxirret nga Ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës.
4. Gjithashtu, me nenin 73, paragrafi 1, pika 3, është përcaktuar pamundësia e kandidimit, e edhe zgjedhjes si deputet, në rastin e pjesëtarëve të Policisë së Republikës së Kosovës, e cila është përgjegjëse për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike në gjithë territorin e Republikës, dhe si shërbim profesional, është i obliguar të respektojë larminë e popullsisë së Republikës së Kosovës. Kryeministri, në konsultim me Qeverinë dhe në pajtim me ligjin, emëron Drejtorin e Policisë së Republikës së Kosovës, kurse organizimi i saj i brendshëm rregullohet me Ligjin për Policinë (miratuar në Kuvend më 20.02.2008, dhe shpallur me Dekretin e Presidentit nr. DL-003-2008, të datës 15 qershor 2008).
5. Gjithashtu, neni 59 i këtij Ligji përcakton që oficerët policorë gëzojnë të njëjtat të drejta civile e politike si qytetarët e tjerë, duke iu nënshtuar vetëm kufizimeve të përcaktuara me këtë Ligj, të cilat janë të domosdoshme për ushtrimin efektiv të autorizimeve dhe obligimeve të tyre policore në detyrë në një shoqëri demokratike. Gjithashtu, ata gëzojnë të njëjtat të drejta sociale e ekonomike, si shërbyesit e tjerë

publikë, por nuk kanë të drejtë të hyjnë në grevë (kanë të drejtë vetëm të shprehin pakënaqësitë e tyre, me anë të demonstratave që organizohen dhe udhëhiqen nga organet përfaqësuese). Për komentin tonë, janë shumë të rëndësishme dispozitat e nenit 62 të Ligjit të përmendur, të cilat rregullojnë konfliktin e interesave, duke theksuar që oficeri policor nuk mund të marrë një vend pune apo obligim e as të marrë pjesë në asnjë funksion apo veprimtari që çon në konflikt interesash me detyrat zyrtare policore. Pra, vendet e punës dhe veprimtaritë që shkaktojnë këtë konflikt janë: a) emërimi apo zgjedhja në detyrë publike apo pozitë tjetër qeveritare; b) pjesëmarrja në fushata elektorale për zgjedhje në detyrë publike (sidomos në funksionin e deputetit); c) punësimi apo pjesëmarrja në çfarëdo aktiviteti biznesi për kompensim, përveç me leje të dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm; d) pjesëmarrja aktive në cilëndo parti politike; ndjekja e udhëzimeve nga cilado parti politike në kryerjen e detyrave policore; paraqitja me uniformë policore në çfarëdo tubimi politik, përveç kur është në detyrë zyrtare policore (anëtarësimi i thjeshtë në një parti politike nuk është konflikt i interesave); dhe e) dhënia e deklaratave publike apo komenteve lidhur me punën e Policisë, përveç në raste kur lejohet nga eprori me autorizim të duhur.

6. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 73, paragrafi 1, pika 4, përcakton që për deputetë as nuk mund të kandidohen e as të zgjidhen as pjesëtarët e Shërbimit Doganor të Kosovës. Ky shërbim është themeluar me ambicien që, si shërbimet e tjera doganore në Ballkanin Perëndimor, të vendosë standardet evropiane si prioritet, në dobi të shoqërisë dhe popullit të saj. Në botën që ndryshon shpejt, ku tregtia globale fiton rëndësi të madhe, është më e rëndësishme që Shërbimi Doganor i Kosovës të bëjë dy gjëra: 1) të mundësojë tregtinë e ligjshme, e cila i ndihmon ndërtimit të ekonomisë së fortë; 2) të sigurojë zbatim efikas të ligjit, me të cilin luftohet dhe zbulohet tregtia e paligjshme. Me luftë kundër tregtisë së paligjshme, në bashkëpunim me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit, gjithashtu ndihmohet lufta kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, si dhe mbrojtja e të drejtave të pronës intelektuale.
7. Kriteret që duhet t'i plotësojë secili kandidat që konkurren për punësim në Shërbimin Doganor të Kosovës, përveç kriterëve të përgjithshme, përcaktohen në bazë të kriterëve të veçanta në konkurset për vende të punës. Gjatë intervistës, kandidatët duhet të demonstrojnë aftësi për punë në Shërbimin Doganor. Kodi i Doganës dhe Akcizave në Kosovë (miratuar në Kuvend më 10 nëntor 2008, shpallur me Dekretin e Presidentit nr. DL-054-2008, të datës 10 nëntor 2008), përcakton autorizimet për kryerjen e detyrave doganore dhe detyrave të tjera të dhëna (neni 9), kurse me nenin 4, pika 3 të të njëjtit Kod, parashikohet që Dogana do të thotë Shërbimi Doganor i Kosovës, i cili është i obliguar, mes tjerash, edhe me zbatimin e legjisllacionit doganor. Në fakt, Shërbimi Doganor është i vetmi institucion në Kosovë që mund të kryejë punët doganore, kurse të gjitha pagesat dhe tatimet doganore për import dhe eksport që grumbullohen nga ky Shërbim derdhen në Buxhetin e Kosovës. Shërbimi Doganor i Kosovës ka subjektivitet juridik, kurse pjesëtarët e tij nuk kanë të drejtë pasive të zgjedhjes, si një prej të drejtave themelore të njeriut, të cilat janë pjesë e grupit të të drejtave politike.

Pamundësia e kandidimit dhe zgjedhjes si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, e përcaktuar për pjesëtarët e Shërbimit Doganor të Kosovës, është shprehur qartë në vetë Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

8. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në të njëjtin nen 73, paragrafi 1, pika 5, përcakton pamundësinë e kandidimit për funksionin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, por edhe pamundësinë e zgjedhjes në këtë funksion edhe për pjesëtarët e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Shërbimi Informativ i Kosovës ka pushuar së funksionuari në mes të qershorit 2008, kurse në vend të tij është formuar Agjencia Kosovare e Inteligjencës. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Formimin e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës më 21 maj 2008, shpallur me Dekretin e Presidentit nr. DL-020-2008, të datës 15 qershor 2008. Kjo Agjenci është themeluar për të mbledhur, analizuar dhe përcjellë të dhëna zbulimi në mënyrë energjike dhe të përgjegjshme, si agjenci e sigurisë dhe punëve të inteligjencës në Kosovë. Puna e saj rregullohet me Ligjin e përmendur, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me ligjet e tjera përkatëse pozitive. Agjencia Kosovare e Inteligjencës mbledh të dhëna që kanë të bëjnë me kërcënimet ndaj sigurisë së Kosovës, mes të cilave konsiderohen rrezikimi i integritetit territorial, integritetit të institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetit ekonomik dhe zhvillimit, si dhe kërcënimet e sigurisë globale në dëm të Kosovës. Me ligj përcaktohen kushtet e veçanta për personelin e Agjencisë, përveç kushteve të përgjithshme për punësim.
9. Neni 17 i Ligjit të lartpërmendur përcakton rastet e sjelljeve të palejueshme të personelit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, ashtu që pjesëtarët e kësaj Agjencie nuk mund të jenë anëtarë të partive politike e as të marrin udhëzime nga partitë politike, organizatat apo lëvizjet apo personat jashtë Agjencisë. Gjithashtu, ata nuk mund të ndërmarrin aktivitete për kompensim material, apo detyra publike e profesionale të cilat nuk janë në përputhje me veprimtarinë e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, por janë të detyruar të kërkojnë pëlqimin e Drejtorit të Agjencisë, para se të hyjnë në çfarëdo organizate apo grupi. Në të kundërtën, mund të krijohen kushtet për suspendim apo shkarkim të punëtorit të Agjencisë. Të punësuarit në Agjenci nuk kanë të drejtë të bëjnë ndërprerje kolektive apo çfarëdo pengese tjetër kolektive në punë e as të japin deklarata për publik apo të komentojnë në ndonjë mënyrë punën e Agjencisë (ofrimin e informatave për të dhënat për persona të paautorizuar, dokumente, kontakte, qëllime, njohuri apo personel të Agjencisë).
10. Grupi tjetër i personave të cilët nuk mund të kandidohen, e as të zgjidhen për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri sa të mos japin dorëheqje nga funksioni i vet, janë udhëheqësit e agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës, të cilat përfaqësojnë institucione, të cilat i ka themeluar Kuvendi në bazë të ligjeve relevante, të cilat e rregullojnë themelimin, funksionimin dhe autorizimet e këtyre agjencive. Ajo që është me rëndësi të thuhet për pozitën e tyre, është se këto agjenci i kryejnë funksionet e veta pavarësisht nga të gjitha organet e tjera apo nga pushteti i Republikës së Kosovës, se e kanë buxhetin e vet (të cilin e administrojnë pavarësisht në pajtim me ligjin), ndërsa çdo organ apo institucion që e zbaton

pushtetin legjitim në Republikën e Kosovës, është i obliguar që të bashkëpunojë dhe tu përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë zbatimit të autorizimeve të tyre ligjore, në pajtim me ligjin (neni 142. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës).

11. Agjencitë e pavarura në Kosovë janë kategori kushtetuese dhe pjesë e sistemit institucional dhe demokratik. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të autorizimeve kushtetuese dhe ligjore, ka themeluar, deri tash, një numër të konsideruar të këtyre agjencive dhe ka siguruar një kornizë ligjore bashkëkohore për funksionimin e tyre. Themelimi, funksionimi, kompetencat dhe raportet reciproke në mes të Kuvendit dhe agjencive të pavarura janë të rregulluara me ligj. Ato janë të mbrojtura me ligj gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, pa ndikim apo ndërhyrje të politikës, të organeve shtetërore apo të çfarëdo autoriteti, janë të pavarura në pikëpamje financiare (e kanë vet në dispozicion fondin buxhetor, por natyrisht, në bazë të planifikimit buxhetor), por megjithatë janë të obliguara që të japin llogari për shpenzimin e të hollave. Ato u nënshtrohen ligjeve, siç është ligji për administrimin e financave dhe përgjegjësive publike (i miratuar në Kuvend, më 13 mars 2008, ndërsa i shpallur me Dekretin e Kryetarit nr. DL-014-2008, më 15 qershor 2008) apo ligji për furnizimet publike në Republikën e Kosovës (i miratuar në Kuvend, më 30 shtator 2010, kurse i shpallur me Dekretin e Kryetarit të Republikës së Kosovës nr. DL-057-2010 (më 25 tetor 2010), si edhe çdo agjenci tjetër buxhetore. Po ashtu, ato duhet të mbikëqyren, ndërsa mbikëqyrja e këtyre institucioneve është detyrë dhe obligimin i Kuvendit të Kosovës, i cili e përcjell zbatimin e ligjeve dhe i shqyrton raportet e tyre të obligueshme.
12. Agjencitë e pavarura, në bazë të obligimeve ligjore, e njoftojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës për punën e vet, ndërsa raportet e tyre së pari shqyrtohen nga ana e komisioneve të Kuvendit, gjithnjë duke e respektuar autonominë e vendosjes që e kanë. Kuvendi u jep rekomandime këtyre agjencive me qëllim të përmirësimit të administrimit të procesit të vendosjes, por ka kujdes që, me këtë rast, të mos e rrezikojë pavarësinë e tyre të vendosjes. Kuvendi i Republikës së Kosovës angazhohet për funksionim ligjor dhe forcim institucional të agjencive të pavarura dhe mbrojtjen e pavarësisë së tyre, sepse përveç rolit praktik të këtyre agjencive, ato ndikojnë në gjendjen e demokracisë në Republikën e Kosovës dhe afrimin e standardeve evropiane. Vendimet e këtyre agjencive janë ekzekutive dhe respektohen në kuptim të zbatimit të tyre. Kushtetuta nuk e përmend në mënyrë të theksuar regjistrin e agjencive të pavarura, ndërsa as numri i saktë i agjencive të përmendura në mënyrë taksative nuk mund të gjendet në ndonjë dokument tjetër. Prandaj, në këtë vend do të përmendim vetëm disa nga më të rëndësishmet, udhëheqësit e të cilave, pa dhënë dorëheqje nga ai funksion, nuk mund të kandidohen, as të zgjidhen deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në ato agjenci bëjnë pjesë, për shembull: Agjencia Kosovare e Pronës, Agjencia kundër Korrupsionit, Agjencia Kosovare e Informimit, Agjencia e Privatizimit, Agjencia Kosovare e Forensikës, Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Rrezatimit dhe për Siguri Nukleare.

13. Përfaqësuesit diplomatik janë kategoria tjetër për të cilët është paraparë pamundësia e kandidimit dhe e zgjedhjes në funksionin e përfaqësuesit popullor, përkatësisht të deputetit republikan (neni 73. paragrafi 1. pika 7. e Kushtetutës së Republikës së Kosovës). Pra, ndërlikueshmëria dhe dinamizmi i marrëdhënieve ndërkombëtare gjithnjë i ka përcjell edhe nevojat e rregullimit përkatës të marrëdhënieve ndërkombëtare me norma të së drejtës ndërkombëtare. Në funksionet (detyrat) më të rëndësishme të diplomacisë bëjnë pjesë: përfaqësimi i shtetit, mbrojtja e interesave të tij, mbrojtja e interesave të shtetasve të saj, negociatat, mbledhja e të dhënave dhe raportimi, përparimi i marrëdhënieve ndërmjet shteteve në të gjitha fushat e të tjera, ndërsa si forma kryesore të diplomacisë i dallojnë: bilaterale, multilaterale, ushtarake, ekonomike, kulturore publike e të tjera. Me marrëdhënie diplomatike nënkuptohen marrëdhëniet zyrtare ndërmjet shteteve, veçanërisht marrëdhëniet që përfshijnë vendosjen reciproke të përfaqësive diplomatike, përkatësisht akreditimin reciprok të shefave të përfaqësive diplomatike. Ndërkaq, për të ardhur deri te vendosja e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet shteteve të caktuara, është e domosdoshme që paraprakisht, të vijë deri te njohja reciproke, që paraqet një akt politik me rrjedhoja të rëndësishme juridike.
14. Me përfaqësi diplomatike (mision diplomatik) nënkuptohet përfaqësimi i përhershëm i një subjekti ndërkombëtar (i shtetit dërgues), që te subjekti tjetër ndërkombëtar (shteti pranues) kryen punë diplomatike. Përfaqësuesit diplomatik janë persona të cilët në bazë të autorizimit të marrë e paraqesin dhe e përfaqësojnë shtetin e vet në shtetin tjetër. Këtu, para së gjithash, i dallojmë shefat e përfaqësive diplomatike, ku bëjnë pjesë: ambasadorët, ndihmësit e tyre, përfaqësuesit fetar dhe ministrat e akredituar te shefat e shteteve të huaja, drejtuesit e punëve të akredituar te ministri i punëve të jashtme e të tjera. Shefat e përfaqësive diplomatike, të akredituar në të njëjtin vend, e përbëjnë të ashtuquajturin kor diplomatik (*frëngj. Corps Diplomatique*), të cilin e udhëheq doajeni (*frëngj. doyen*), do të thotë ai shef i përfaqësisë diplomatike në shtetin përkatës, i cili sipas rangut është më i vjetri. Doajeni paraqitet para pranuesit shtetëror në emër të korit diplomatik në rastet me karakter ceremonial por edhe i mbron interesat e korit diplomatik, si tërësi. Anëtarë të personelit diplomatik të përfaqësisë diplomatike quhen edhe: i ngarkuari i përhershëm me punë, i ngarkuari i përkohshëm me punë, ministri fuqiplotë, ministri këshilltar, këshilltari, sekretari i parë, i dytë dhe i tretë si dhe atasheu.
15. Në grupin e dytë të personave, të paraparë me nenin 73. paragrafi 1. pika 8, të cilët nuk mund as të kandidohen, as të zgjidhen deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë kryetarët dhe anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhor. Sipas nenit 139. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, komisioni Qendror i zgjedhjeve, i përbërë prej 11 anëtarësh, është organ i përhershëm dhe i pavarur, i cili përgatitë, monitoron, administron dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve dhe të referendimit dhe publikon rezultatet e tyre, në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Në përputhje me nenin 61. paragrafi 8. i këtij Ligji, anëtar i Komisionit Qendror Zgjedhor nuk mund të jetë personi, i cili është: a) deputet i Kuvendit të Kosovës;

b) këshilltar i kuvendit komunal në Kosovë; c) kandidat për funksion publik në Kosovë; d) deputet i kuvendit të zgjedhur publikisht jashtë Kosovës; e) ushtrues i disa funksioneve publike apo partiake; f) anëtar i Komisionit Publik Zgjedhor në Kosovë ose jashtë Kosovës; g) pjesëtar i korpusit mbrojtës të Kosovës; h) pjesëtar i policisë dhe i shërbimeve të ngjashme; i) person që nuk mund të votojë në Kosovë; j) person që vuan dënimin e shqiptuar nga ana e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë apo që është nën hetim të Tribunalit dhe nuk është paraqitur para tij; k) anëtar i organizatës joqeveritare e cila i monitoron zgjedhjet; l) person i dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë të gjykatës; m) pjesëtar i organit informativ apo të sigurisë në Kosovë apo bë botën e jashtme, gjatë 5 vjetëve të fundit; n) nëse është përjashtuar nga funksioni publik për shkelje të ligjit. Mirëpo, ajo që është edhe më e rëndësishme dhe që është esenca e komentimit të pikës së përmendur 8. paragrafi 1. neni 73. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është fakti se pjesëtarët dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet ti respektojnë pamundësitë e kandidimit, të cilat paraqesin esencën e nenit të përmendur 73 i cili është lëndë e komentit tonë. Kjo do të thotë se personat e përmendur, deri sa i ushtrojnë funksionet e veta në këtë Komision nuk mund as të kandidohen, as të zgjidhen deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nëse para kësaj nuk japin dorëheqje.

Neni 73.2

1. Pamundësia e kandidimit është paraparë edhe me paragrafin dy të nenit 73. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili parasheh që për deputet nuk mund të kandidohen as personat të cilët janë privuar nga aftësia afariste me vendim definitiv të gjykatës. Çështja e privimit të aftësisë afariste paraqet hap të rëndësishëm në realizimin e të drejtave të njeriut, sepse ky privim nënkupton humbjen e të gjitha të drejtave civile dhe politike dhe në përgjithësi, shkelje serioze e të drejtave themelore të njeriut. Lidhur me këtë dhe me qëllim të pengimit të çdo lloj diskriminimi të personave invalidë, është miratuar Konventa për të Drejtat e Personave me Invaliditet (e miratuar në seancën e Kuvendit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, më 13 dhjetor 2006 në Nju-Jork). Për të hyrë në fuqi Konventa, është e domosdoshme që ta ratifikojnë 20 shtete, ndërsa deri më sot e kanë nënshkruar 119 shtete, ndërsa 12 e kanë ratifikuar. Shtetet që e kanë ratifikuar Konventën për të Drejtat e Personave me Invaliditet, në këtë mënyrë kanë marrë obligim ndërkombëtar të përputhjes së legjislacionit të tyre kombëtar, si dhe obligim të reformës së avancimit të të drejtave të personave me invaliditet. Kështu, në këto vende, njëkohësisht, janë krijuar kushtet për fillimin e dialogut dhe të debatit për këtë çështje, mjaft të rëndësishme, duke pasur parasysh parimet e proklamuar me Kartën e Kombeve të Bashkuara, e cila e njuh dinjitetin e lindur dhe të drejtat e barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë anëtarëve të bashkësisë njerëzore, si bazën e lirisë, të të drejtës dhe të paqes në botë. Po ashtu, Kombet e Bashkuara me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe me paktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, kanë proklamuar dhe vërtetuar se çdokush e ka të drejtën e pasjes së të drejtave dhe lirive themelore të proklamuar me aktet e përmendura, pa asnjë dallim.

2. Qëllimi i kësaj Konvente është që ta promovojë, mbroj dhe sigurojë pasjen e plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, për të gjithë personat me invaliditet dhe ta promovojë respektimin e dinjitetit të tyre të lindur. Në personat me invaliditet përfshihen personat të cilët kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale, dëgjimore, të cilat në bashkëveprim me pengesa të ndryshme mund ta vështirësojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të këtyre personave në shoqëri në bazë të barazisë me të tjerët.
3. Aftësia e veprimit ka rëndësi të madhe në jetën e çdo personi. Mundësia për ta zgjedhur vendin ku jetojnë, personin me të cilin jetojnë, fakultetin në të cilin studiojnë, palën për të cilën votojnë, a do të martohemi apo jo, a do të kemi fëmijë apo jo, me çfarë pune do të merremi-shumica e njerëzve pa invaliditet kurrë nuk e shqyrtojnë, e aq më pak të mendojnë për atë se dikujt gjërat e tilla të thjeshta dhe të zakonshme u mohohen, ndërsa nga ana tjetër, shumica e personave me invaliditet ballafaqohen me këto dhe probleme të ngjashme. Për ta komentuar dispozitën e paragrafit të përmendur 2. të nenit 73. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është me dobi të dihet se në drejtësi ekzistojnë dy lloje të aftësisë të cilat dallohen-aftësia juridike dhe aftësia afariste.
4. **Aftësia juridike** është më e gjerë dhe e nënkupton aftësinë që një person të jetë bartës i të drejtave dhe obligimeve. Kjo aftësi fitohet me lindjen, ndërsa shuhet me vdekjen dhe nuk ekziston mënyrë në të cilën do të mund të kufizohet apo të merrej. Në periudhat e më parme të zhvillimit të shoqërisë (p.sh. në Romën e vjetër) kjo nuk ka qenë kështu sepse aftësia juridike ka qenë privilegj i grupeve të caktuara të njerëzve, por në legjislacionin bashkëkohor të gjithë kanë aftësi të përgjithshme dhe të plotë juridike, pavarësisht nga gjinia, mosha, përkatësia nacionale, racore apo fetare, gjendja shoqërore apo invaliditeti. Ndërkaq, kjo nuk është kurrfarë gjendje e natyrshme e gjërave, por është rezultat i përparimit dhe i shkallës së zhvillimit të shoqërisë.
5. **Aftësia e veprimit** nënkupton aftësinë e vendosjes së pavarur për të drejtat dhe obligimet, përkatësisht aftësinë e një personi që me deklaram personal të vullnetit të marrë të drejtat e caktuara, të pranojë obligime të caktuara, të hyjë në marrëdhënie të ndryshme juridike e të tjera. Kjo aftësi, sipas rregullit, fitohet me arritjen e moshës së pjekurisë. Në praktikë, aftësia juridike do të thotë që personi mund të posedojë ndonjë paluejtshmëri edhe para moshës 18 vjeçare (për shembull, fëmija mund ta trashëgojë prindin i cili ka vdekur, por fëmija nuk ka mundësi që të bëjë çfarëdo qoftë me atë paluejtshmëri, deri sa ti mbushë 18 vjet dhe të bëhet i moshës madhore dhe, vetëm nga ai moment fitohet aftësia për të vepruar, që do të thotë se personi mund të vendos në mënyrë të pavarur se çfarë do të bëjë me paluejtshmërinë që e ka-mund ta shfrytëzojë, ta shes, ta falë apo ta jap me qira).
6. Kjo është pasojë e supozimit ligjor se çdo person që merr ndonjë vendim (p.sh. shitja e shtëpisë) dhe që ndërmerr ndonjë veprim që ka fuqi juridike obliguese (p.sh. nënshkrimi i kontratave) duhet të jetë në gjendje përkatëse mendore, si dhe

që duhet të posedojë aftësi për ti kuptuar vendimet që i merr, që ti shqyrtojë të gjitha mundësitë dhe ti shohë pasojat e vendimeve të veta, e po ashtu edhe që të ketë mundësi të komunikimit të vendimit të vet. Në shumicën e vendeve vlen supozimi se të gjitha këto aftësi arrihen me moshën e pjekurisë.

7. Legjislacioni në fuqi i Kosovës i parasheh edhe disa përjashtime nga ky rregull. Personi i moshës madhore mund të privohet plotësisht nga aftësia e veprimit nëse ka pengesa mendore apo intelektuale për shkak të të cilave është “i paaftë për gjykim normal” dhe nuk është në gjendje që të përkujdeset për mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të veta. Pos kësaj, është paraparë edhe privimi i pjesshëm i aftësisë së veprimit në rast se personi madhor ka pengesa të shëndetit mendor apo pengesa intelektuale dhe me veprimet e veta drejtpërsëdrejti i rrezikon të drejtat dhe interesat e veta apo të drejtat dhe interesat e personave të tjerë. Paaftësia e personit të moshës madhore që ta kuptojë rëndësinë e veprimeve të veta nuk është një nga kushtet për privim të pjesshëm nga aftësia e veprimit. Personat e privuar nga aftësia afariste, vihen nën mbikëqyrje-për çka do të bëhet fjalë më vonë në tekst. Është me rëndësi të theksohet se privimi i pjesshëm nga aftësia e veprimit është mjaft i rrallë në Kosove, edhe pse ligji e parasheh, ndërsa është rregull që personat të privohen plotësisht nga aftësia afariste, që është në kundërshtim me zgjidhjet ligjore moderne në botë.
8. Një nga mënyrat e të privuarit nga aftësia afariste, përkatësisht, e pengimit të fitimit të aftësisë afariste është edhe vazhdimi i së drejtës prindërore. E drejta prindërore mund të vazhdohet edhe pas arritjes së moshës madhore të fëmijës nëse fëmija për shkak të sëmundjes apo të pengesave në zhvillimin psikiko-fizik është i paaftë që vet të kujdeset për veten dhe për mbrojtjen e të drejtave përkatësisht të interesave të tij apo që me veprimet e veta i rrezikon të drejtat dhe interesat e veta.
9. Këtu është edhe më me rëndësi të theksohet një jologjikshmëri, pra, Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh se me Kushtetutë dhe ligj të gjithë janë të barabartë dhe që çdokush ka të drejtë në mbrojtje të barabartë ligjore, pa diskriminim (neni 24. paragrafi 1.). Po ashtu, Kushtetuta ia garanton secilit aftësinë juridike, ndërsa me moshën e pjekurisë fitohet aftësia e vendosjes së pavarur për të drejtat dhe obligimet. Në pikëpamje të kufizimit të të drejtave dhe të lirive themelore, kushtetutat më së shpeshti garantojnë që të drejtat njerëzore dhe të pakicave, të cilat ato i garantojnë, me ligj mund të kufizohen, nëse këtë kufizim e lejojnë vet ata, për qëllime për të cilat e lejojnë, në masën e domosdoshme që qëllimi kushtetues i kufizimit të përmbushet në shoqërinë demokratike dhe pa cenimin e esencës së të drejtës së garantuar. Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është paraparë që të drejtat dhe liritë themelore të cilat ajo i garanton, mund të kufizohen vetëm me ligj, dhe atë vetëm deri në atë masë, që është e paevitueshme, në mënyrë që të arrihet qëllimi për të cilin është lejuar kufizimi. Po ashtu, si edhe shumica e kushtetutave të shoqërive të hapura dhe demokratike, edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh që kufizimet e të drejtave dhe të lirive themelore të garantuara, nuk mund të zbatohen për qëllime të tjera, përveç të atyre për të cilat janë caktuar. Ndërkaq, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës

(nuk është paraparë as lejuar) çfarëdo kufizimi i aftësisë afariste, përkatësisht i aftësisë së vendosjes së pavarur për të drejtat dhe obligimet. Nga kjo del pyetja logjike-cila është baza e privimit nga aftësia afariste e personave madhorë në Republikën e Kosovës?

10. Vendimi me të cilin dikujt i merret aftësia afariste ka pasoja afatgjata praktike, juridike, shoqërore dhe psikike. Personi të cilit i është marrë aftësia afariste sillet në pozitë të ngjashme, e cila në Romën e vjetër është quajtur “vdekje civile”. Ai më nuk mund të marrë vendime në emër të vet, por dikush tjetër do të vendosë për të, në bazë të supozimit se kujdestari e di se çka është në interesin më të mirë të atij personi. Personat e privuar nga aftësia afariste i humbin të drejtat politike, duke përfshirë edhe të drejtën e votimit, ndërsa e humbin edhe të aftësinë ligjore. Po ashtu, ata nuk mund të punësohen, do të thotë e humbin të drejtën e punës. Në rast të privimit të pjesshëm nga aftësia afariste, mund të lidhin kontratë për punë me pëlqimin e kujdestarit dhe lejen e organit kujdestar. Personat e privuar nga aftësia afariste e humbin shumicën e të drejtave pronësore, përveç kur janë në pyetje gjërat me vlerë të vogël, nuk kanë të drejtë martesë, të krijimit të familjes dhe të drejtë të zgjedhjes së vendbanimit, janë të privuar nga e drejta në anëtarësimin në shoqata dhe parti politike. Personat të cilët plotësisht apo pjesërisht janë privuar nga aftësia afariste nuk mundën madje as të jenë vullnetar, nuk kanë të drejtë të hartimit të testamentit, ndërsa mund të vendosen përjetësisht në ente të mbrojtjes sociale pa pëlqim dhe pa mundësi ankese. Nga ana tjetër, këta persona nuk janë të pranueshëm në shoqëri, shumë shpesh i nënshtrohen një shkalle të lartë të stigmatizimit, do të thotë të vulosjes (vëmendjes publike).
11. Zgjidhjet e këtilla ligjore të cilat ekzistojnë në disa vende të caktuara relativisht janë tejkaluar dhe nuk përputhen me kornizat dhe standardet juridike ndërkombëtare, prandaj, është e domosdoshme që të bëhen ndryshime të të gjitha dispozitave të tilla juridike pozitive, me qëllim të përmirësimit të pozitës së personave me invaliditet dhe të cilësisë së jetës së tyre. Duke pasur parasysh se edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin e përmendur 73. paragrafi 2. e parasheh pamundësinë e kandidimit për deputet të personave të cilët me vendim definitiv gjyqësor, janë privuar nga aftësia afariste, është e domosdoshme që kësaj çështjeje ti kushtohet kujdes shumë më i madh dhe të harmonizohen dispozitat ligjore kushtetuese me aktet ndërkombëtare në fuqi. Është me rëndësi të veçantë që të bëhet kjo dhe të plotësohet zbrazëtia e përmendur juridike e cila ekziston në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke pasur parasysh se kjo Kushtetutë, nga njëra anë, e garanton barazinë e të gjithëve para ligjit, kurse nga ana tjetër, personave të privuar nga aftësia afariste (me vendim definitiv të gjykatës), ua cakton ndalimin e kandidimit dhe të zgjedhjes në funksion të deputetit, edhe pse as ai dhe as dispozitat përkatëse pozitive ligjore, nuk i parashohin bazat e privimit të kësaj aftësie të personave madhorë.

Neni 73.3

1. Në fund, me paragrafin e fundit (paragrafi 3), të nenit që është lëndë e komentimit tonë (neni 73. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës) është paraparë pamundësia e zgjedhjes për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si për kryetarët e komunave, po ashtu edhe për zyrtarët e tjerë në nivelin komunal, të cilët kanë funksione ekzekutive (ata mund të zgjidhen anëtarë të organit më të lartë përfaqësues në Republikë, do të thotë të parlamentit republikan, vetëm nëse japin dorëheqje). Pra, secili funksionar, shikuar në përgjithësi, pra duke mos u lidhur me asnjë sistem kushtetues është i detyruar që funksionin publik ta ushtrojë në atë mënyrë që të mos shkaktojë grumbullimin e funksioneve të caktuara, të cilat janë të papajtueshme, si dhe që interesi publik të mos i nënshtrohet interesit privat dhe as të mos nxitet në mes tyre konflikt eventual. Ky konflikt i interesit publik dhe privat ekziston kur funksionari ka interes privat, i cili ndikon apo mund të ndikojë në ushtrimin e funksionit të tij publik.
2. Funksion publik konsiderohet funksioni të cilin e ushtron (funksionari) në bazë të zgjedhjes, caktimit apo emërimit në organet shtetërore (republikane apo krahinore, nëse ato ekzistojnë), në organet e qytetit, të komunës dhe në organet e ndërmarrjeve publike, themelues i të cilave është shteti, republika, krahina, qyteti, komuna e të tjera.²⁸¹ Për zbatimin e ligjit përkatës, i cili e rregullon materien e konfliktit të interesit, më së shpeshti zgjidhet një bord, agjenci, komision apo ndonjë organ tjetër, kompetent për të vendosur për konfliktin e interesit. Organi i tillë është i mëvetësishëm dhe i pavarur, ndërsa mjetet për punën e tij, më së shpeshti, sigurohen nga mjetet buxhetore. Funksionari është i obligueshëm që t'u nënshtrohet dispozitave, të cilat i rregullojnë të drejtat dhe obligimet e tij, që të krijojë dhe të ruajë besimin e qytetarëve në ushtrimin e ndërgjegjshëm dhe me përgjegjësi të funksionit publik. Funksionari nuk lejohet të jetë në kurrfarë marrëdhënieje të vartësisë ndaj personave që do të mund të ndikonin në paanësinë e tij në kryerjen e funksionit publik, as që funksionin publik ta shfrytëzojë për arritjen e çfarëdo dobie apo lehtësie për vete a për personin e lidhur.²⁸²

Neni 73.3

1. Në fund, me paragrafin e fundit (paragrafi 3), të nenit që është lëndë e komentimit tonë (neni 73. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës) është paraparë pamundësia

²⁸¹ Në shumicën e sistemeve kushtetuese, konflikti i interesit gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarëve për kundërvajtje, të prokurorëve publikë dhe të zëvendësprokurorëve publikë rregullohet me ligje të veçanta. Me ligje të veçanta, po ashtu, rregullohet edhe konflikti i interesit të funksionarëve të emëruar në organet e institucioneve dhe të organizatave të tjera, themelues i të cilave është shteti, republika, krahina, qyteti apo komuna.

²⁸² Persona të lidhur, në numrin më të madh të legjislacioneve, konsiderohen: bashkëshorti a partneri jashtëmartesor i funksionarit, i afërmi për nga gjaku i funksionarit në linjë juridike, në linjë anësore përfundimisht me shkallën e dytë të afërsisë, adoptuesi dhe i adoptuari, i afërmi i vjehërrve, përfundimisht me shkallën e parë të afërsisë dhe çdo person tjetër juridik apo fizik, i cili, në baza dhe rrethana të tjera, mund të konsiderohet me arsye si i lidhur nëpërmjet interesit me funksionarin.

e zgjedhjes për deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si për kryetarët e komunave, po ashtu edhe për zyrtarët tjerë në nivelin komunal, të cilët kanë funksione ekzekutive (ata mund të zgjidhen anëtarë të organit më të lartë përfaqësues në Republikë, do të thotë të parlamentit republikan, vetëm nëse japin dorëheqje). Pra, secili funksionar, shikuar në përgjithësi, pra duke mos u lidhur me asnjë sistem kushtetues është i detyruar që funksionin publik ta ushtrojë ashtu që të mos vijë deri te grumbullimi i funksioneve të caktuara të cilat janë të papajtueshme, si dhe që interesi publik të mos i nënshtrohet interesit privat dhe as që në mes tyre të mos nxitet konflikti eventual. Ky konflikt i interesit publik dhe privat ekziston kur funksionari ka interes privat, i cili ndikon apo mund të ndikojë në ushtrimin e funksionit të tij publik.

2. Funksion publik konsiderohet funksioni të cilin (funksionari), e ushtron në bazë të zgjedhjes, caktimit apo emërimit në organet shtetërore (republikane apo krahinore, nëse ato ekzistojnë), organet e qytetit, të komunës dhe në organet e ndërmarrjeve publike themelues i të cilave është shteti, republika, krahina, qyteti, komuna e të tjera.²⁸³ Për zbatimin e ligjit përkatës, i cili e rregullon materien e konfliktit të interesit, më së shpeshti zgjidhet një bord, agjenci, komision apo ndonjë organ tjetër, kompetent për të vendosur për konfliktin e interesit. Organi i tillë është i mëvetësishëm dhe i pavarur, ndërsa mjetet për punën e tij, më së shpeshti, sigurohen nga mjetet buxhetore. Funksionari është i obligueshëm që t'u nënshtrohet dispozitave, të cilat i rregullojnë të drejtat dhe obligimet e tij, që ta krijojë dhe ruaj besimin e qytetarëve në ushtrimin e ndërgjegjshëm dhe me përgjegjësi të funksionit publik. Funksionari nuk guxon të jetë në kurrfarë marrëdhënie të vartësisë ndaj personave që do të mund të ndikojnë në paanësinë e tij në kryerjen e funksionit publik, as që funksionin publik ta shfrytëzojë për arritjen e çfarëdo dobie apo lehtësie për vete apo për personin lidhës.²⁸⁴
3. Ajo që është me rëndësi të theksohet këtu, është se funksionari i zgjedhur mund të pranojë funksion tjetër publik vetëm me pajtim të organit i cili e ka zgjedhur, caktuar apo emëruar në funksionin publik, nëse kjo nuk është në kundërshtim me ndalesat që burojnë nga ligji në fuqi për pengimin e konfliktit të interesit apo të ndonjë ligji tjetër. Në shumicën e sistemeve kushtetuese, funksionari mund të merret me veprimtari shkencore, arsimore dhe kulturore dhe të fitojë të hyra nga të drejtat autoriale, të drejtat e patentimeve të pronës intelektuale. Bordi kompetent i agjencisë, komisionit apo ndonjë organ tjetër i cili vendos për konfliktin e interesit,

²⁸³ Në shumicën e sistemeve kushtetuese, konflikti i interesit gjatë ushtrimit të funksionit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarëve për kundërvajtje, të prokurorëve publik dhe të zëvendës prokurorëve publikë rregullohet me ligje të veçanta. Me ligje të veçanta, po ashtu, rregullohet edhe konflikti i interesit të funksionarëve të emëruar në organet e institucioneve dhe të organizatave të tjera, themelues i të cilave është shteti, republika, krahina, qyteti apo komuna.

²⁸⁴ Persona të lidhur, në numrin më të madh të legjislacioneve, konsiderohen: bashkëshorti apo partneri jashtëmartesor i funksionarit, i afërmi për nga gjaku i funksionarit në linjë juridike, linjë anësore përfundimisht me shkallën e dytë të afërsisë, adoptuesi dhe i adoptuari, i afërmi i vjehërrve, përfundimisht me shkallën e parë të afërsisë dhe çdo person tjetër juridik apo fizik i cili, në baza dhe rrethana të tjera, me arsye mund të konsiderohet si i lidhur nëpërmjet interesit me funksionarin.

harton udhëzime, formularë dhe jep mendime të nevojshme për zbatimin e ligjit përkatës, e mban regjistrin e pasurisë së funksionarëve, vendos për çështjen se a ka shkaktuar veprimi apo mosveprimi i funksionarëve shkelje të ligjit dhe nëse po, shqipton masa dhe kryen punë të tjera nga kompetenca e vet. Të gjithë funksionarët janë të obliguar që organit të tillë, pas kërkesës së tij, menjëherë t'ia dërgojnë të dhënat dhe informatat e nevojshme.

4. Kur është fjala për Republikën e Kosovës, duhet thënë se këtë materie e rregullon Ligji për Pengimin e Konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike (i miratuar në Kuvend, më 2 nëntor 2007, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/32, më 14 qershor 2008). Sipas nenit 7 të këtij Ligji, konflikti i interesit është gjendje e mospajtimit në mes të detyrës publike dhe të interesit privat të një funksionari (zyrtari), kur gjatë ushtrimit të funksionit të vet ai ka interesa private (personale) të cilat, drejtpërsëdrejti apo tërthorazi, ndikojnë apo mund të ndikojnë në ushtrimin e rregullt të funksionit publik. Për këtë arsye funksionari (zyrtari) është i kufizuar në ushtrimin e veprimtarive të tjera, në atë kuptim që gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik nuk mund të ushtrojë funksion tjetër, përveç nëse e merr pëlqimin e institucionit i cili e ka zgjedhur apo emëruar dhe nëse ai funksion nuk është në kundërshtim me dispozitat e ligjit të përmendur për Pengimin e Konfliktit të interesit, gjatë ushtrimit të funksioneve publike apo të ndonjë ligji tjetër.
5. Me nenin 13 të këtij Ligji, është paraparë ushtrimi i veprimtarive të tjera nga ana e funksionarëve (zyrtarëve të zgjedhur), të cilët në nivel komunal kanë funksione të caktuara ekzekutive. Pra, ata, si përfaqësues të partisë së tyre politike në të mund të ushtrojnë ndikime të caktuara (nëse me ligj të veçantë nuk është paraparë ndryshe), kurse gjatë ushtrimit të funksioneve publike mund të ushtrojnë punë nga fusha e shkencës, sportit, arsimit dhe e veprimtarive humanitare dhe të fitojnë të ardhura në bazë të së drejtës autoriale, të patentës e të ngjashme. Pos kësaj, këta funksionarë (zyrtarë), si bartës të funksioneve ekzekutive në nivel komunal, nuk janë të privuar nga anëtarësimi në organizatat joqeveritare, duke pasur parasysh se mund të jenë anëtarë të organeve drejtuese të organizatave joqeveritare në lëmin e punës humanitare, kulturore, sportive etj, por pa të drejtë në çfarëdo fitimi të të ardhurave, përveç kompensimit të shpenzimeve të arsyeshme të udhëtimit dhe të shpenzimeve tjera (neni 14). Ajo që është mjaft e rëndësishme të theksohet gjatë komentimit të paragrafit të fundit të nenit që është lëndë e analizës sonë (paragrafi 3 i nenit 73 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës), është fakti se vet Ligji për Pengimin e Konfliktit të Interesit gjatë kryerjes së funksioneve publike në Republikën e Kosovës, parasheh detyrime të caktuara të funksionarëve (zyrtarëve) lidhur me pengimin e konfliktit të interesit (neni 15 i Ligjit). Do të thotë, me vet aktin e zgjedhjes apo të emërimit, funksionari (zyrtari) është i detyruar që të pengojë çdo lloj të konfliktit të interesit. Po ashtu, çdo epror (apo institucion udhëheqës) duhet t'i ndër marrë të gjitha masat e nevojshme lidhur me pengimin dhe zgjidhjen e rasteve eventuale të konfliktit të interesit. Në rastin kur eprori i institucionit të caktuar apo vet institucioni nuk janë të sigurt për faktin e ekzistimit të konfliktit të interesit, kanë të drejtë dhe detyrim që t'i drejtohen Agjencisë për Shqyrtimin e Konfliktit të Interesit, e cila merr aktvendim për secilin rast të veçantë.

6. Ligji i përmendur për Pengimin e Konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike në Republikën e Kosovës, si një nga qëllimet themelore, e ka luftën kundër korrupsionit, sepse ushtrimi i njëkohshëm i disa funksioneve publike, duke përfshirë edhe funksionet e deputetëve popullorë dhe të kryebashkiakëve, përkatësisht të kryetarëve të komunave, si dhe të të gjithë zyrtarëve të tjerë, të cilët janë bartës të funksioneve ekzekutive, është konflikt interesi. Prandaj, ushtrimi i njëkohshëm i tyre nga ana e një personi nuk është i mundshëm, kështu që këta persona, nëse do të zgjidhen në funksion të deputetit (Kushtetuta nuk ua ndalon kandidimin, por vetëm thotë se nuk mund të zgjidhen për deputetë, nëse nuk japin dorëheqje nga ushtrimi i funksionit të deriatëhershëm në komunë) dhe duhet të përcaktohen. Kjo do të thotë zgjedhja e tyre që t'i mbajnë mandatet e deputetit apo, megjithatë, të mbesin në kolltukët e kryetarëve në mjediset e veta, përkatësisht që edhe më tutje të mbesin bartës të funksioneve ekzekutive si zyrtar në nivel komunal.

Neni 74 [Ushtrimi i Funksionit]

Deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me këtë Kushtetutë, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit.

Neni 74

1. Termi deputet në shoqërinë demokratike e nënkupton personin i cili e përfaqëson popullsinë e tërësishme të një rajoni, të cilin e zgjedhin qytetarët e atij rajoni. Ata e zgjedhin si të autorizuar të tyre, që të debatojë në emër të tyre me deputetët e tjerë për udhëheqjen e shoqërisë dhe të shtetit. Funksioni i deputetit fitohet në votim të përgjithshëm, ndërsa detyrë e deputetit, si bartës i këtij funksioni, jashtëzakonisht të rëndësishëm, është që seriozisht t'i shqyrtojë të gjitha çështjet e parashtuara dhe të gjitha zgjidhjet e propozuara. Kur zgjidhja e ofruar është në pajtim me bindjen e tij, ai duhet të votojë për të, por nëse, nga ana tjetër, bindja e tij është e tjetër, ai duhet të votojë kundër. Nëse i pranon urdhrat e të tjerëve, ai e tradhton autorizimin e vet. Deputetët po ashtu janë të detyruar, që ta respektojnë dinjitetin e shtetit dhe të deputetit, që njëri tjetrit t'i drejtohen me mirësjellje dhe respekt, pa përdorimin e shprehjeve fyese apo paraqitjen e fakteve dhe të vlerësimeve nga jeta private e deputetit dhe e personave të tjerë.
2. Prandaj, përveç të drejtave të deputetëve, të cilat janë të garantuara me Kushtetutë, me ligj dhe me rregulloren e punës së kuvendit, me ligjin dhe rregulloren e punës së parlamentit përcaktohen edhe detyrimet përkatëse të këtyre përfaqësuesve të popullit. Siç shihet, detyrimet e deputetëve ndryshojnë nga të drejtat e tyre, para së gjithash, sipas akteve me të cilat përcaktohen. Detyrimet e deputetëve dalin nga natyra e mandatit të deputetit, të lidhjes së tij me zgjedhësit, të lidhjes me partinë politike e cila e ka kandiduar dhe të lidhjes me deputetët e tjerë në parlament, si organ kolektiv anëtar i të cilit është deputeti. Kështu, sipas cilësive të tyre, i

dallojmë dy lloje të detyrimeve të deputetëve: 1) morale; 2) juridike. Shkelja e grupit të parë të detyrimeve (obligimeve etike) sjell deri te sanksionet në formë të përgjegjësisë politike të deputetëve, ndërsa shkelja e grupit të dytë të obligimeve (obligimeve juridike), mund të sjellë deri te sanksionet e caktuara në formë të kufizimit të të drejtave të caktuara të deputetit, në të cilat bën pjesë edhe ndërprerja e mandatit.

3. Kur është fjala për grupin e parë do të thotë për detyrimet morale të deputetit, duhet theksuar se ato manifestohen në raport me deputetin ndaj zgjedhësve, në bazë të votave të të cilëve ai deputet është zgjedhur në funksionin e përmendur dhe në raport ndaj partisë politike e cila e ka kandiduar për funksionin e deputetit popullor në parlament. Pra, si reprezentues i qytetarëve, ai i përfaqëson të gjithë qytetarët, e jo vetëm ata që ia kanë dhënë besimin e vet dhe kanë votuar për të. Prandaj ai duhet t'i përfaqësojë interesat e të gjithë qytetarëve, gjë që qartazi paraqet obligimin e tij më të rëndësishëm, por në pikëpamje morale, sepse ky nuk është edhe obligim i tij juridik. Kjo do të thotë se deputeti, si përfaqësues i popullit në parlament, nuk mund të thirret në përgjegjësi, as nuk mund të shkarkohet nëse nuk e përmbush këtë detyrim të vetin, sepse raporti në mes të përfaqësuesit dhe të zgjedhësve nuk mbështetet në mandatin e lidhur (imperativ), por në mandatin e lirë (përfaqësues). Sikur të ekzistonte mundësia e tillë (thirrja e deputetit në përgjegjësi, shkarkimi për shkak të mospërmbushjes së detyrimit, detyrimi për përmbushjen e obligimit të përmendur e të tjera), atëherë kjo do të ishte në kundërshtim me parimin e mandatit të lirë, të cilit i jepet përparësi në krahasim me, po ashtu, parimin njësoj të rëndësishëm të parlamentarizmit-parimin e reprezentimit. Duke pasur parasysh se ky është obligim moral i deputetit, përgjegjësia e tij për mospërfaqësim të interesit të zgjedhësve është vetëm politike dhe realizohet në zgjedhjet vijuese në formë të sanksionit politik, i cili do të thotë humbje e besimit të zgjedhësve dhe mohimi i tyre i dhënies së votave deputetit të tillë, i cili nuk e ka përmbushur këtë detyrim moral.²⁸⁵
4. Për dallim nga kjo, në sistemet në të cilat ekziston mandati imperativ, deputeti nuk i përmbush interesat e të gjithë qytetarëve (nuk i reprezenton të gjithë qytetarët), por i reprezenton vetëm ata zgjedhës që kanë votuar për të. Prandaj, ai ka obligim që t'i përfaqësojë vetëm interesat e zgjedhësve të cilët e kanë zgjedhur dhe ky është obligim i tij juridik, i cili sanksionohet me ndërprerje të mandatit të deputetit,

²⁸⁵ Si anëtar i partisë politike e cila e ka kandiduar në zgjedhje për funksionin e deputetit, përfaqësuesi i tillë i popullit i cili e ka marrë besimin dhe është bërë anëtar i parlamentit, ka, po ashtu, obligim moral. Ky obligim ka të bëjë me përfaqësimin e programit politik të partisë anëtar i së cilës është por shkelja e tyre nuk u nënshtrohet sanksioneve juridike (edhe pse deri tash ka pas përpjekje të shumta që kjo lidhje e deputetit në partinë politike të rregullohet edhe juridikisht, si dhe që të sanksionohet juridikisht shkelja e obligimit të deputetit që në parlament ta përfaqësojë programin politik të partisë e cila e ka kandiduar dhe në listën zgjedhore të së cilës e ka marrë mandatin e deputetit). Dhe kjo është pasojë e garantimit të theksuar kushtetues të mandatit të lirë të deputetit dhe të parashikimit kushtetues të anulimit të mandatit të lidhur, do të thotë imperativ të deputetit.

nëse shkarkimin e deputetit e kërkojnë zgjedhësit e tij, të cilët ia kanë dhënë atë mandat në zgjedhje.²⁸⁶

5. Duke pasur parasysh këtë që u tha, neni 74. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës e përcakton që deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë obligim që ta ushtrojnë funksionin e tyre në interesin më të mirë të Republikës së Kosovës. Po ashtu, ky nen përcakton që ushtrimi i këtij funksioni të deputetit duhet të zhvillohet në përputhje, para së gjithash me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pastaj edhe me ligjet përkatëse dhe me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, sepse të gjitha këto akte të përgjithshme juridike, pa marrë parasysh fuqinë e vet juridike, i përcaktojnë të drejtat, por edhe obligimet e deputetëve, si anëtar të parlamentit republikan, që ta ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrën më të mirë që mundën dhe në interes të Republikës në Kuvendin e së cilës i përfaqësojnë të gjithë qytetarët e shtetit, shtetas të të cilit janë. Për këtë i obligon vet betimi që ata e japin pas verifikimit të mandatit në Kuvend, që në mënyrë të ndershme dhe të sinqertë do t'i kryejnë obligimet e veta dhe që me dinjitet do t'i përfaqësojnë të gjithë qytetarët, pra tërë popullin dhe që do të punojnë në interes të Republikës së Kosovës dhe të të gjithë qytetarëve të saj. Po ashtu, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës në detyrimin e ushtrimit të funksionit të tyre në interesin më të mirë të shtetit të tyre, i obligon edhe betimi që në punën e tyre, si përfaqësues të popullit në parlament, do të angazhohen për mbrojtjen dhe respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Republikës së Kosovës, si dhe për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane.²⁸⁷

Neni 75 [Imuniteti]

- (1) Deputetët e Kuvendit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet e tyre brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit. Imuniteti nuk pengon ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit.
- (2) Deputeti i Kuvendit nuk mund të arrestohet dhe as ndalohet përderisa është duke kryer detyrat e tij/saj si deputet i Kuvendit, pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit.

²⁸⁶ Për ekzistimin e demokracisë, në çdo shtet, me rëndësi vendimtare është respektimi i së drejtës zgjedhore të çdo qytetari dhe sigurimi i mbrojtjes së kësaj të drejte, në rast të shkeljes së saj. Për raportin e demokracisë dhe të së drejtës së përmendur politike, të shihet më gjerësisht: Kasapović, M., Šiber, I, Zakošek, N., (1998), *'Birači i demokratija'*, Alinea: Zagreb.

²⁸⁷ Krahaso paragrafët 61-82 të *Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 8 dhjetor 2011 në rastin nr. KO119/10. Paraqitës i kërkesës Ombudspersoni i Republikës së Kosovës. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 14. paragrafi 1.6, të nenit 22, nenit 24, nenit 25 dhe nenit 27 të Ligjit për të Drejtat dhe Obligimet e Deputetëve, nr. 03/1111. nga data 4 qershor 2010.*

1. Organizmi i brendshëm i parlamentit përfshin disa fusha që përbëhen nga institucionet e veçanta të parapara me kushtetutë dhe me norma të tjera (juridike apo zakonore). Këtu, para së gjithash, mendojmë në lëmin që ka të bëjë me pozitën e parlamentarëve (përfaqësuesve të popullit), e cila duhet ta sigurojë pavarësinë e tyre në raport me presionet e jashtme, nga njëra anë dhe pavarësinë dhe institucionet e parlamentarëve, nga ana tjetër. Instituti i cili i shërben qëllimit të parë është imuniteti parlamentar,²⁸⁸ ndërsa qëllimit të dytë inkompatibiliteti kombëtar.
2. Kur flasim për imunitetin parlamentar, duhet thënë se ai nënkupton pacenueshmërinë e deputetit si anëtar i parlamentit dhe që baza e këtij imuniteti gjendet në parimin e sovranitetit popullor (deputeti është përfaqësues popullor, do të thotë shprehje e sovranitetit popullor, prandaj, ashtu si edhe vet ai sovranitet edhe ai është i pacenueshëm) dhe në parimin e ndarjes së pushtetit (meqë pushtetin legjislativ e ushtron parlamenti i cili përbëhet nga deputetët, ky parim e përfshin pavarësinë dhe pacenueshmërinë e deputetit në raport me pushtetin ekzekutiv dhe gjyqësor.
3. I dallojmë dy forma themelore të imunitetit të deputetit, si: **imuniteti i mospërgjegjshmërisë** (vepron automatikisht dhe e mbron deputetin kur ai e ushtron funksionin parlamentar) dhe **imuniteti i pacenueshmërisë** (vepron vetëm nëse deputeti thirret në të dhe e mbron deputetin kur ai nuk e ushtron funksionin parlamentar). Lirinë e plotë të ushtrimit të funksionit parlamentar e mundëson vetëm ekzistimi i njëkohshëm i të dyja këtyre imuniteteve.
4. **Imuniteti i mospërgjegjësisë** e mbron deputetin për diskutimin, mendimin e shprehur dhe dhënien e votës në parlament, që do të thotë se me të mbulohen aktet e parlamentarit që janë kryer gjatë ushtrimit të funksionit të tij. Për këtë arsye, për të thuhet se ai është esencjal, do të thotë imunitet material, i cili e mbron deputetin nga thirrja në përgjegjësi penale apo çfarëdo përgjegjësie tjetër, për mendimin e paraqitur në parlament apo për votim në rastin e ushtrimit të funksionit të deputetit. Ndërkaq, deputeti për diskutimet dhe mendimet e veta të paraqitura jashtë parlamentit është përgjegjës si çdo qytetar tjetër.²⁸⁹ Esenca e këtij imuniteti ka të bëjë me sigurimin e lirisë së debatit në parlament, që e paraqet një organ në të cilin deri te zgjidhja e interesave të përgjithshme shtetërore, më së shpeshti vihet nëpërmjet një konflikti të organizuar, shpeshherë, me kuptime dhe mendime të kundërta personale. Ajo që është me rëndësi të theksohet, është se ai mendim, si

²⁸⁸ Me qëllim të sigurimit të pavarësisë së parlamentarëve në raport me presionet e jashtme, zbatohet edhe instituti i kompensimit parlamentar, por për të nuk do të flasim këtu, duke pasur parasysh se lëndë e komentimit tonë është vetëm imuniteti parlamentar.

²⁸⁹ Gjykata ka konkluduar se nuk është e pranueshme që një anëtar i parlamentit t'i ikë akuzës për shpifje në lëndën në të cilën ka ndodhur kontesti jashtë kontekstit politik, ndërsa imuniteti ka dalë nga vendimi të cilin e ka miratuar vet parlamenti dhe kur nuk ka pasur mjetet e tjera në dispozicion që do të mund të shfrytëzoheshin për përmirësimin e dëmit të shkaktuar me shpifjen e supozuar (*Cardava kundër Italisë (nr. 1 dhe 2) (2003)*).

dhe votimi për një çështje të caktuar, është shprehur gjatë ushtrimit të mandatit të deputetit dhe se është bërë në vet parlamentin (është e parëndësishme për ekzistimin e këtij imuniteti, se a zhvillohet puna e parlamentit në ndërtesën e parlamentit apo në ndonjë vend tjetër, por është me rëndësi se mendimi dhe votimi ka të bëjë me lëndët që janë në kompetencë të parlamentit.

5. Prandaj, parlamentari është i mbrojtur për diskutimet e veta, deklaratat, mendimet e dhëna e të tjera, pavarësisht nga përmbajtja e tyre dhe shkalla e rrezikut shoqëror, por siç kemi theksuar, vetëm nëse deputeti, si deputet popullor dhe anëtar i parlamentit, i ka shprehur brenda të njëjtit parlament, përkatësisht në organet e tij dhe madje vetëm gjatë kohës së mbajtjes së mbledhjes. Para dhe pas mbledhjes, si dhe gjatë kohës së pauzës, deklaratat e parlamentarëve nuk janë të mbrojtura nga imuniteti i mospërgjegjësisë.²⁹⁰ Ajo që, në këtë vend, është e rëndësishme të theksohet është edhe ajo se kjo mospërgjegjësi është absolute, duke pasur parasysh se ajo vlen deri sa zgjat mandati i parlamentarit, si edhe pas kalimit të mandatit, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet liria e plotë e shprehjes. Në të kundërtën, do të thotë sikur deputeti të mos ishte përherë, pra përjetësisht i papërgjegjësi dhe sikur të ekzistonte të thirrurit e mëvonshëm në përgjegjësi, ai nuk do të gëzonte liri të plotë të shprehjes dhe kjo sigurisht do ta shkatërronte tërë institucionin e këtij imuniteti. Se sa është i rëndësishëm ky imunitet, mund të shihet edhe nga fakti se ai është privilegj me karakter publik-juridik, që i është dhënë çdo parlamentari, si bartës i funksionit publik-juridik dhe jo si personalitet privat. Kjo do të thotë se kjo përgjegjësi i garantohet parlamentarit, jo për mbrojtje të interesit të tij personal, por për mbrojtje të interesit dhe të pavarësisë së vet parlamentit (para së gjithash, nga veprimi arbitrar i administratës dhe i gjyqësisë), prandaj, për këtë arsye, parlamentarit nuk mund t'i mohohet ky privilegj).²⁹¹
6. **Imuniteti i paprekshmërisë**, për dallim prej imunitetit të papërgjegjësisë vlen edhe për veprat e kryera jashtë ushtrimit të funksioneve parlamentare, dhe me të mbrohet e gjithë veprimtaria jashtëparlamentare e deputetëve. Pasi që ky imunitet pengon zbatimin e ligjit të përgjithshëm për përfaqësuesit e popullit, për të mund të thuhet se ai është, në fakt, imunitet procedural, sepse pa pëlqimin e parlamentit, deputetit si anëtar i tij, nuk mund të privohet nga liria dhe as nuk mund të ndiqet penalisht. Siç është qëllimi i imunitetit të papërgjegjësisë sigurimi i lirisë së shprehjes (elementi më i rëndësishëm i përmbajtjes së këtij imunitetit është liria e

²⁹⁰ Ndërkaq, duhet theksuar se ekzistojnë edhe kushtetuta të tilla të cilat, në një mënyrë, në shkallë të caktuar (më të lartë apo më të ulët), e kufizojnë lirinë e shprehjes së parlamentarit. Kështu, p.sh., sipas Ligjit Themelor të Gjermanisë (*Grundgesetz*) të vitit 1949, mbrojtja për votimin dhe mendimin e parlamentarëve gjatë punës parlamentare (këtë mbrojtje e siguron imuniteti i mospërgjegjësisë) deri diku është ngushtuar. Pra, kjo mbrojtje nuk vlen për të ashtuquajturat “ofendime të paturpshme”, që është paraparë me nenin 46 të këtij Ligji, i cili, në të vërtetë, është akti më i lartë i përgjithshëm i Republikës Federale të Gjermanisë, do të thotë i Kushtetutës.

²⁹¹ Për të drejtat e karakterit publik-juridik ka shkruar Georg Jellinek në fund të shekullit XIX. Shih më shumë: Jellinek, G., (1892), ‘*System der subjektiven öffentlichen Rechte*’, Mohr: Freiburg.

fjalës), qëllimi i imunitetit të paprekshmërisë është garantimi i lirisë nga arresti. Prandaj, ai mund të hiqet vetëm me vendim të parlamentit.

7. Këtu duhet gjithashtu të theksohet se imuniteti i paprekshmërisë vlen vetëm për iniciimin e procedurës penale (për dallim prej imunitetit të papërgjegjësisë), dhe kështu, me këtë lloj të imunitetit nuk janë të përfshirë anëtarët e parlamentit nëse është fjala për përgjegjësitet civile-juridike, administrative dhe disiplinore. Ajo që duhet të theksohet këtu është krahasimi i këtyre dy imuniteteve për nga vëllimi dhe ndikimi. Kështu, kur është fjala për vëllim, duhet thënë se imuniteti i paprekshmërisë është më i gjerë se imuniteti i papërgjegjësisë, meqenëse potencialisht përfshin një numër shumë më të madh të veprave penale,²⁹² por është i dobët për nga efekti, pasi që, në të vërtetë, paraqet vetëm shtyrje të ndjekjes penale²⁹³ dhe e mbron parlamentaritetin vetëm gjatë kohës së mandatit parlamentar (pas skadimit të këtij mandati, anëtar i parlamentit është përgjegjës penalisht). Ai, pra, paraqet vetëm një pengesë procedurale për ngritjen e procedurës penale, përderisa përfaqësuesi i popullit, si anëtar i parlamentit, gëzon imunitet. Në këtë mënyrë mbrojtja, e cila ofrohet me imunitetin e paprekshmërisë është vetëm e përkohshme,²⁹⁴ dhe jo absolute (siç është rasti me imunitetin e papërgjegjësisë), që do të thotë se në qoftë se parlamenti e refuzon kërkesën për ngritjen e procedurës penale kundër anëtarit të tij, me këtë nuk pushon përgjithmonë e drejta e ndjekjes. Sidoqoftë, duhet thënë se kjo paprekshmëri, sipas rregullit, e dobëson përgjegjësinë penale të anëtarit të parlamentit, sepse padyshim nuk është efekti i njëjtë i ngritjes së procedurës penale menjëherë pas kryerjes së veprës penale dhe iniciimi i së njëjtës procedurë pas kalimit të kohës prej dy deri katër vjet.²⁹⁵ Sigurisht që imuniteti i paprekshmërisë nuk vlen nëse anëtar i parlamentit është kapur gjatë kryerjes së veprës penale (i ashtuquajtur i delikt në flagrancë), dhe pastaj rregullisht përjashtohet nga mbrojtja e këtij

²⁹² Imuniteti i papërgjegjësisë vlen vetëm për veprat penale të cilat janë kryer me të folur, gjegjësisht me një deklaratë të dhënë ose mendim të shprehur (votim), dhe jo për veprat penale, të cilat janë kryer me një veprim, gjegjësisht aktivitet.

²⁹³ Imuniteti i paprekshmërisë paraqet shtyrje në kohë të ndjekjes penale të parlamentaritetit, përderisa të deklarohet parlamenti, dhe më së largu përderisa zgjat mandati i parlamentit.

²⁹⁴ Në disa vende imuniteti i paprekshmërisë zgjat vetëm gjatë kohës së seancës së parlamentit, dhe jo si në shumicën e vendeve, gjatë mandatit parlamentar (kjo do të thotë se në këto vende edhe pse jo në numër aq të madh, imuniteti i paprekshmërisë është edhe më i kufizuar, që është më pak në pajtueshmëri me idenë e paprekshmërisë).

²⁹⁵ Edhe pse të rralla, më mirë të thuhet zgjidhje kushtetuese të vetme (të jashtëzakonshme), duhet cekur se ka shtete, të cilat garantojnë imunitet të paprekshmërisë, i cili padyshim ofron mundësinë për përjashtimin e plotë të përgjegjësisë penale të anëtarit të parlamentit (kjo, qartë paraqet largim nga parimi i barazisë së qytetarëve para ligjit). Kështu sipas Kushtetutës së Republike Çeke, e vitit 1992, "deputeti ose senatori nuk mund t'i nënshtrohet procedurës penale pa lejen e dhomës, anëtar i së cilës është, ndërsa nëse dhoma përkatëse refuzon ta jep pëlqimin, ajo procedurë penale bëhet e pamundshme përgjithmonë" (neni 27), përderisa Kushtetuta e Republikës Sllovaqe e vitit 1992, gjithashtu parasheh, "deputetët nuk mund të ndiqen as penalisht dhe as në mënyrë disiplinore, dhe as të privohen nga liria pa pajtimin e Këshillit kombëtar të Republikës Sllovaqe, dhe në rast se Këshilli kombëtar refuzon të japë pëlqimin, procedura pezullohet përgjithmonë" (neni 78).

imuniteti,²⁹⁶ sepse në një rast të tillë, largimi nga parimi i barazisë së të gjithë qytetarëve para ligjit, do të ishte shumë i madh.

8. Në fund të këtij prezantimi mbi imunitetin parlamentar përpara se të komentojmë nenin 75 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, esenca e të cilit titullohet "imuniteti", do të theksojmë se paprekshmëria është në lidhje të ngushtë me papërgjegjësinë dhe, vetëm të dy këto imunitete së bashku e mundësojnë lirinë e plotë të ushtrimit të funksioneve parlamentare. Baza e imunitetit të papërgjegjësive gjendet në parimin e sovranitetit popullor, sipas të cilit bartës i sovranitetit është populli, dhe e realizon atë përmes përfaqësuesve ose drejtpërdrejt, derisa baza e imunitetit të paprekshmërisë gjendet në parimin e ndarjes së pushtetit dhe përbajtja kryesore e këtij imuniteti konsiston në ndalimin e arrestimit të deputetëve jashtë parlamentit, para se parlamenti, deputeti i të cilit është vetë, ta aprovojë.
9. Sidoqoftë, duhet thënë se ekzistojnë vendet, të cilat nuk e njohin imunitetin e paprekshmërisë, ndërsa si shembuj më të njohur për këtë mund të përmenden Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të Britanisë së Madhe. Në fakt, Kongresi në SHBA (parlamenti amerikan) ka pushtet të gjerë disiplinor mbi anëtarët e tij (siç është rasti edhe me Parlamentin e Britanisë), ashtu që mundet t'i privojë nga liria dhe mund t'u marrë mandatin me shumicën e dy të tretave në dhomën përkatëse të parlamentit (Dhoma Përfaqësuese ose Senati). Kjo do të thotë se ligji i SHBA-së nuk e njeht imunitetin e paprekshmërisë, derisa imuniteti i papërgjegjësive vlen vetëm për jashtë. Kur është fjala për Britaninë e Madhe, situata është plotësisht e njëjtë (Parlamenti britanik nuk mundet t'ua merr mandatet deputetëve), ashtu që deputetët, si anëtarë të parlamentit, janë përgjegjës për veprat penale para gjykatave të rregullta, si të gjithë qytetarët tjerë. Sipas kësaj, ata mund të privohen nga liria, të gjykohen dhe të dënohen, pa asnjë leje paraprake të Parlamentit britanik, gjegjësisht dhomave, anëtarë të të cilave janë.

Neni 75.1

1. Me analizën e dispozitës së nenit 75 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mund të themi se të dy imunitetet e lartpërmendura, si pjesë përbërëse e imunitetit të parlamentarëve, janë të garantuara me aktin më të lartë të përgjithshëm të Republikës së Kosovës, gjegjësisht Kushtetutën. Në të vërtetë, paragrafi 1 i nenit të lartpërmendur u garanton deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës imunitet të papërgjegjësive, përderisa paragrafi 2 i nenit të njëjtë u garanton përfaqësuesve të popullit imunitet të paprekshmërisë. Kjo do të thotë se paragrafi i parë i këtij neni i mbron deputetët nga çdo lloj i ndjekjes penale, të gjitha llojeve të padive civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet e parlamentit (fjalim i mbajtur, mendim i shprehur, vota e dhënë dhe të ngjashme), gjatë ushtrimit të

²⁹⁶ Ky kufizim në disa kushtetuta është edhe më i dukshëm, kështu që, Ligji Themelor i Gjermanisë i vitit 1949, parasheh që ky imunitet i paprekshmërisë, jo vetëm që nuk vlen kur anëtari i parlamentit është kapur gjatë kryerjes së veprës, por edhe të nesërmen. Gjithashtu ekzistojnë kushtetuta, sipas të cilave ky imunitet vlen vetëm për vepra të caktuara të parlamentarëve, për shembull për fyerje, shpifje ose krime.

funksionit të deputetit. Nga kjo rezulton se me këtë imunitet parlamentar nuk janë mbrojtur deputetët e Kuvendit të Republikës nga ndjekja penale për veprimet e bëra jashtë ushtrimit të funksioneve të tyre të deputetit.²⁹⁷

2. E drejta për imunitet e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, lind me ditën e zgjedhjes, respektivisht verifikimit të mandateve të tyre. Ky nen, i cili është subjekt i komentit tonë (neni 75) krijon **imunitet** (të papërgjegjesisë dhe të paprekshmërisë) të anëtarëve të përfaqësimit popullor. Vetë fjala imunitet rrjedh nga fjala latine *immunis* (spastruar nga ngarkesa, liruar, shkarkuar). *Imuniteti i papërgjegjesisë* ose siç quhet ndryshe *imuniteti material*, i mbron të drejtat më të rëndësishme të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës të cilat kanë të bëjnë me statusin e tyre në parlament- liria e fjalës dhe liria e votimit. Kjo është e drejta e tyre individuale, të cilën ata mund ta disponojnë lirisht, ashtu që ata nuk mund të përgjigjen për fjalimin në parlament apo për votën e dhënë gjatë vendimmarrjes. Nëse kjo e drejtë nuk do t'u garantohej atyre, atëherë nuk do të ekzistonin kushtet në të cilat ata do të mund ta ushtronin funksionin e tyre parlamentar. Meqenëse efekti i këtij imuniteti material është absolut, gjegjësisht e përjashton përgjegjësinë e deputetit edhe pas pushimit të mandatit (për mendimin e paraqitur në debatin parlamentar dhe për votën e dhënë gjatë nxjerrjes së vendimit parlamentar), ky imunitet quhet edhe papërgjegjësi parlamentare (neni 75 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës).
3. Ky lloj mandati u garantohej deputetëve edhe me nenin 22 të Rregullores së punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në fakt, sipas dispozitave të këtij neni, deputeti gëzon imunitet, në pajtim me Kushtetutën, për deklarimet gojore ose të shkruara, si dhe për veprimet e tjera, të kryera në cilësinë e deputetit të Kuvendit, ndërsa ky imunitet, si edhe *imuniteti procedural* ose *imuniteti i paprekshmërisë* fillon në ditën e verifikimit të mandatit dhe mbaron me përfundimin e mandatit të tij. Por, përjashtimisht nga paragrafi 4 i këtij neni, Kuvendi mund t'ia heqë imunitetin deputetit para mbarimit të mandatit. Kërkesën për heqjen e imunitetit të deputetit e bën organi kompetent për ndjekje penale, ndërsa vendimin për heqjen e imunitetit të deputetit e merr Kuvendi, në përputhje me rekomandimet e Komisionit për Mandat, Imunitet dhe Rregullore.

Neni 75.2

1. Duke e analizuar më tutje nenin 75 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili i është dedikuar imunitetit të deputetit të Kuvendit, në fillim të komentimit të

²⁹⁷ *Krahaso paragrafët 51-135 Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, 20 shtator 2011, në rastin Nr. K098/11. Parashtruesi i kërkesës Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në këtë rast, Gjykata konstatoi se kishte vetëm imunitet funksional, gjegjësisht vetëm për vepra dhe akte të ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë, ministra të qeverisë dhe Kryeministrit, dhe si president i shtetit, dhe jo për veprat dhe aktet që janë marrë jashtë sferës së përgjegjësive me qëllim të ushtrimit të atyre kompetencave nga ana e zyrtarëve të shtetit të Kosovës.*

paragrafit 2 të këtij neni, do të tregojmë se dispozita e këtij paragrafi i dedikohet të ashtuquajturit *imunitet procedural*, përkatësisht *imunitetit të paprekshmërisë*. Në të vërtetë, sipas dispozitës së paragrafit të përmendur, deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk mund të arrestohet dhe as ndalohet përderisa është duke kryer detyrat e tij/saj si deputet i Kuvendit, pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit, anëtar i të cilit është. Garantimi i këtij imuniteti posaçërisht mbron lirinë individuale të deputetit dhe paraqet të drejtën e tij individuale, ashtu që nëse deputeti dëshiron ta shfrytëzojë, ai duhet të thirret në këtë imunitet. Duhet të theksohet se, edhe pse imuniteti procedural është e drejtë personale e deputetit, përveç atij, në imunitet mund të thirret edhe parlamenti, anëtar i së cilit është ai, ndërsa vendimin për imunitetin personal e merr parlamenti. Kjo kërkohet nga parimi i parë i ndarjes së pushtetit, sipas të cilit statusi i deputetit në parlament duhet veçanërisht të mbrohet, e që kjo posaçërisht lidhet me ndikimin e ekzekutivit dhe gjyqësorit. Kështu, nëse me aktet e pushteteve të lartpërmendura (ekzekutivit ose gjyqësorit) është kërcënuar liria personale e deputetit të Republikës së Kosovës, do të kërcënohej edhe vet ushtrimi i funksionit të deputetit, të cilin deputeti, si përfaqësues i popullit e ushtron gjatë kohëzgjatjes së mandatit parlamentar. Ky imunitet e siguron mbrojtjen e lirisë personale të deputetit, jo vetëm lidhur me aktivitetin e tij të ndërmarrë në parlament, por edhe aktivitetet, të cilat nuk janë drejtpërdrejt të lidhura me punën e tij në parlament.

2. *Imuniteti procedural* (imuniteti i paprekshmërisë) i garantuar për deputetët të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e përjashton mundësinë e arrestimit të tyre, ndjekjes penale, gjyqimit dhe ndërmarrjes së masave tjera kundër lirisë personale të deputetëve.²⁹⁸ Por, efekti i këtij imuniteti është relativ (dhe jo absolut, siç është rasti me imunitetin material, përkatësisht imunitetin e papërgjegjësisë) dhe ai mund të hiqet, sipas kushteve të përcaktuara me Kushtetutë. Kështu, për shembull, nëse deputeti është kapur në kryerjen e veprës penale për të cilën parashihet dënim me burgim prej 5 e më shumë vite, ai mund të privohet nga liria, me kusht që Parlamenti të informohet menjëherë për këtë, i cili në atë rast, vendos për imunitetin e deputetit. Kundër atij deputeti mund të ndiqet procedurë gjyqësore, nëse Parlamenti vendos për heqjen e mbrojtjes nga imuniteti dhe kështu të mundësojë udhëheqjen e procedurës. Mbrojtja që ofron imuniteti procedural, siç e kemi cekur më lart, ka efekt vetëm gjatë kohës sa zgjat mandati i deputetit dhe me përfundimin e tij, pushon edhe efekti i këtij imuniteti, ashtu që kundër deputetit, mandati i të cilit ka përfunduar, mund të iniciohet ndjekje penale ose të udhëhiqet procedurë gjyqësore.
3. Rregullorja e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, ashtu si Kushtetuta, në nenin 22 përcakton se deputeti gëzon imunitet ndaj masave të ndalimit, të arrestit, të ndjekjes penale, përderisa Kuvendi nuk merr vendim për heqjen e imunitetit të tij. Masa e ndalesës ose e arrestit gjithashtu mund të merret ndaj deputetit edhe pa

²⁹⁸ Disa kushtetuta, siç është për shembull, rasti me Kushtetutën e Italisë, shprehimisht përjashtojnë kontrollin personal të deputetit, pastaj kontrollimin e banesës së tij, si dhe shkeljen e fshehtësisë së letrave (dhe formave të tjera të komunikimit).

heqjen paraprake të imunitetit nga Kuvendi, në rastin kur deputeti kryen veprë të rëndë penale, që është e dënueshme me pesë (5) e më shumë vjet burgim. Me nenin 24 të kësaj Rregulloreje, parashihet procedura e cila ndërmerret në rastet kur deputeti ndalohet ose arrestohet. Në fakt, në rastin kur një deputet është ndaluar ose arrestuar, pa heqjen e imunitetit, organi kompetent i ndjekjes e informon menjëherë Kryetarin e Kuvendit, i cili pas kësaj e thërret Komisionin për Mandate, Imunitete dhe Rregullore dhe ia dërgon njoftimin me dokumentet e tjera përcjellëse të organit kompetent të ndjekjes. Kryetari është i autorizuar të kërkon nga Komisioni shqyrtim urgjent të çështjes, i cili brenda dy ditëve pas njoftimit nga Kryetari i Kuvendit, e shqyrton rastin e deputetit të ndaluar ose të arrestuar. Komisioni i fton për t'i dëgjuar organin kompetent të ndjekjes dhe deputetin e ndaluar ose të arrestuar. Kryetari i Kuvendit e thërret mbledhjen brenda dy ditësh pas paraqitjes së raportit nga Komisioni, në të cilën Kuvendi vendos me votim të fshehtë për heqjen ose mos-heqjen e imunitetit të deputetit. Në rastet kur deputetit nuk i hiqet imuniteti në Kuvend, lirohet nga ndalimi ose nga arresti.

4. Sipas kësaj, dispozita e paragrafit 2 të nenit të lartpërmendur, i cili është subjekt i komentimit tonë (neni 75 i Kushtetutës), ka të bëjë me ato veprime, të cilat deputetët i ndërmarrin jashtë funksionit të tyre dhe kur i kryejnë ato, ata nuk paraqiten si deputetë, por si qytetarë të thjeshtë. Prandaj, nëse ato veprime janë kundërligjore, ata do të përgjigjen si të gjithë personat, të cilët kishin për t'i kryer ato veprime. Për ndjekjen e tyre duhet plotësuar një kusht dhe ai është që Kuvendi i Republikës së Kosovës jep autorizim për inicim të procedurës. Ky privilegj nuk i njihet përfaqësuesve të popullit në mënyrë që ata të lirohen nga përgjegjësia, por vetëm që të mbrohen nga "akuzat tendencioze". Sipas frymës së dispozitave të lartpërmendura, përkatësisht të asaj që u tha më lart në lidhje me imunitetin procedural (imuniteti i paprekshmërisë), Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk duhet të mohojë autorizimin të ngrihet procedura penale ndaj deputetit, për të cilin është i bindur se akuzat është e bazuar dhe nuk është tendencioze. Për këtë qëllim, Kuvendi ka të drejtë të njihet më për së afërmi me lëndën (përmes Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore), mund të kërkojë sqarim nga gjykatat, dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm, aktet e caktuara dhe të ngjashme.

Neni 76 [Rregullorja e Punës]

Rregullat e Punës së Kuvendit miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit.

Neni 76

1. Kur është fjala për organizimin e brendshëm të parlamentit, duhet thënë se rregullorja e parlamentit është akti më i rëndësishëm ligjor, me të cilin ai rregullohet. Ky është një dokument specifik i përgjithshëm ligjor, i cili përveç organizimit të brendshëm të Parlamentit, rregullon të drejtat e anëtarëve, rendin e

ditës dhe procedurat parlamentare. Parlamenti rregullon organizimin e vet të brendshëm në mënyrë të pavarur dhe procedurat, sipas të cilave zhvillohet puna e tij. Në parlamentet me dy ose më shumë dhoma, çdo dhomë miraton rregulloren e saj. Me organizimin e brendshëm të Parlamentit nënkuptojmë një numër të fushave që lidhen me institucione të veçanta.

2. **Fusha e parë** ka të bëjë me pozitën e *parlamentarëve* (rregullat me të cilat përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e të gjithë pjesëmarrësve të procedurës parlamentare, para së gjithash, deputetëve dhe propozuesve të ligjeve të cilat parlamenti duhet t'i miratojë). **Fusha e dytë** përfshin *lëndën e mbledhjeve dhe të seancave parlamentare* (procedura e diskutimit dhe miratimit të vendimeve ligjore dhe politike, procedura kushtetuese dhe legjislativë, ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, miratimi i buxhetit dhe llogarive përfundimtare, procedura e miratimit dhe akteve të rëndësishme të parlamentit, siç janë rezolutat, deklaratat, rekomandimet, përfundimet, etj, rregullimi i detajuar i seancave të parlamentit dhe puna në seancat e tij, duke filluar me thirrjen e mbledhjeve, diskutimit dhe votimit, deri në përfundimin e seancave, dhe të gjitha çështjet tjera të procedurave parlamentare, të cilat përfshijnë rregullimin e marrëdhënieve midis parlamentit dhe organeve tjera shtetërore- për shembull, emërimi dhe shkarkimi i qeverisë, procesi i zgjedhjes së Kryetarit të Republikës, gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, procedura e interpelancës, etj.). Në fund, **fusha e tretë** ka të bëjë me trupat parlamentare të punës dhe zyrtarët parlamentarë të punës (të brendshëm, organizatat e punës dhe politike, caktimi i trupave të punës së dhe mënyra e zgjedhjes së tyre, trupat e brendshme të punës, këshillat dhe komisionet, trupat teknike të Parlamentit, të tilla si shërbimet, sekretariati, zyra, etj.).
3. Ky organizim i brendshëm, si dhe mënyra e punës së parlamentit rregullohen jo vetëm me Rregulloren e Parlamentit, por edhe me Kushtetutë dhe me Ligjin për Parlamentin, me ç'rast Kushtetuta rregullon çështjet më të rëndësishme nga kjo fushë (këtu hyjnë për shembull çështjet si struktura e Parlamentit, pra numri i dhomave të tij, numri i deputetëve, periudhat gjatë së cilave mbahen sesionet e rregullta të Parlamentit, kushtet e nevojshme për t'u thirrur seanca e Parlamentit, statusi dhe zgjedhja e Kryetarit të Parlamentit, kuorumi, pra shumica e parlamentarëve që nevojitet për punë të vlefshme të Parlamentit, pastaj shumica e deputetëve që nevojitet për miratimin e ligjeve etj.). Duke marrë parasysh se Kushtetuta e çdo vendi është akti juridik më i përgjithshëm, më abstrakt dhe më parimor, ligji për Parlamentin dhe në veçanti rregullorja e punës së tij i konkretizon këto çështje edhe më tej dhe i rregullon në tërësi.
4. Mirëpo, duhet theksuar se çdo legjislaturë parlamentare ka të drejtë që, gjatë periudhës së mandatit të saj për të cilën janë zgjedhur deputetët, pra gjatë periudhës së legjislaturës së vet, të caktojë rregulla sipas të cilave do të veprojë. Kjo do të thotë se Parlamenti ka të drejtë të rregullojë organizimin e vet të brendshëm dhe mënyrën se si do të punojë, para së gjithash përmes rregullores parlamentare e cila paraqet aktin e përgjithshëm juridik më të rëndësishëm dhe specifik që përmban rregullat e lartpërmendura për organizimin e brendshëm të

parlamentit, si dhe për të drejtat e deputetëve, procedurat parlamentare, rendin shtëpiak etj. Natyrisht, interpretimi i rregullave të rregullores duhet të mbështetet edhe në traditën dhe praktikën parlamentare që është krijuar gjatë zhvillimit historik dhe politik. Pikërisht për shkak të rëndësisë që ka Rregullorja për punën e Parlamentit, disa vende me Kushtetutat e tyre shprehimisht parashikojnë se është e nevojshme të sigurohet shumica e kualifikuar e deputetëve në Parlament që do të votonte për miratimin e Rregullores. Kjo duhet përmendur në mënyrë eksplicite në Kushtetutë dhe në mesin e vendeve të tilla hyjnë, për shembull: Italia, Austria, Sllovenia etj. Në disa vende tjera, me Kushtetutë parashikohet që për miratimin e Rregullores nevojitet shumica absolute, ndërsa në disa madje edhe shumica prej dy të tretave të deputetëve. Natyrisht, nëse bëhet fjalë për parlamentet me dy ose më shumë dhoma, atëherë secila dhomë nxjerrë në mënyrë të pavarur rregulloren e vet.²⁹⁹

5. Kur bëhet fjalë për çështjen se a duhet të jetë parlamenti i përbërë nga një dhomë ose dy dhoma, pra nga disa dhoma, në teorinë kushtetuese³⁰⁰ nuk ka pajtueshmëri, ashtu që mendimet janë mjaft të ndara, ndërsa përfaqësuesit e njërit mendim ose tjetrit gjithmonë theksojnë argumente të caktuara në mbështetje të pohimeve të veta. Kësisoj, për ekzistimin e parlamentit të përbërë nga një dhomë angazhohen përkrahësit e parimit të sovranitetit të popullit, të cilët theksojnë që qytetarët me zgjedhjen e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të tyre marrin pjesë në legjislativ, pra në pushtetin ligjvënës dhe se vetëm një parlament i tillë mund të sigurojë parimin demokratik të sovranitetit të popullit. Mirëpo, përfaqësuesit e mendimit që parlamenti nuk duhet të jetë i përbërë nga një dhomë, por nga dy ose më shumë dhoma, konsiderojnë se një strukturë e tillë e parlamentit nuk paraqet asnjë pengesë për realizimin e parimit të sovranitetit të popullit, për të cilin këmbëngulnin ata që mendojnë ndryshe. Ata e arsyetojnë këtë me faktin se deputetët e dhomës së ulët (dhomës së parë), pra dhomës së qytetarëve, gjithmonë zgjidhen nga qytetarët, ndërsa përparësinë e parlamentit me shumë dhoma ata e shohin, para së gjithash, tek ajo që në këtë mënyrë sigurohet një realizim më i përgjegjshëm i detyrave legjislative, korrigjimi eventual i gabimeve të cilat gjatë punës së vet do të mund t'i bënte dhoma e ulët (për dhomën e ulët zakonisht thuhet se ajo përfaqëson "imagjinatën", ndërsa dhoma e lartë "arsyen"), se një strukturë e tillë mundëson që në parlament, si një përfaqësi e popullit, të përfaqësohen interesat jo vetëm të qytetarëve, pra votuesve por edhe interesat e subjekteve tjera, siç janë për shembull, njësitë federale. Prandaj, Parlamenti në federata gjithmonë i ka dy dhoma, prej të cilave njëra është e qytetarëve (përfaqëson zgjedhësit), ndërsa tjetra dhomë e njësitë federale (përfaqëson njësitë federale). Natyrisht, duhet të theksojmë se një strukturë e tillë dydhomëshe e parlamenteve nuk është

²⁹⁹ Nëse analizojmë praktikën kushtetuese krahasuese, do të vërejmë se dominojnë parlamentet me dy dhoma. Kësisoj, në mesin e shteteve evropiane mund të përmendim vetëm disa sisteme kushtetuese që parashikojnë parlamente me një dhomë dhe këtu hyjnë: Suedia, Finlanda, Danimarka, Luksemburgu, Greqia, Hungaria, Portugalia, Sllovakia, Bullgaria, Serbia, Kroacia si dhe Republika e Kosovës.

³⁰⁰ Shih më hollësisht për këtë në analizën shteruese të: Marshall, G., (1971), 'Constitutional Theory', Clarendon Press: Oxford.

karakteristikë vetëm për shtetet federale, por edhe për një numër të madh të shteteve unitare porse arsyet për vendosjen e sistemit me dy dhoma në ato vende janë të ndryshme (në federata këto arsye për vendosjen e dhomës së dytë janë të njëjta).

6. Në fund të këtij prezantimi për rregulloren e parlamentit, natyrën e saj dhe rëndësinë në përgjithësi, duhet bërë me dije faktin se ai është një akt jashtëzakonisht i rëndësishëm i parlamentit dhe për këtë arsye me të drejtë ekziston presupozimi se vetëm një rregullore cilësore mund të mundësojë punë cilësore të Parlamentit. Në të vërtetë, nga rregullorja varet në masë të madhe nëse Parlamenti do të kryejë rregullisht dhe me kohë detyrat e përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj, pra nëse ajo si akt i përgjithshëm juridik do të mund të pamundësojë obstrukcionin nga ana e deputetëve dhe grupeve të deputetëve të opozitës (natyrisht, me atë rast pritet që rregullorja parlamentare në asnjë rast të mos kufizojë të drejtat e tyre themelore). Gjithashtu, edhe pse është e pakontestueshme rëndësia e rregullores së Parlamentit në mesin e teoricienëve juridikë, megjithatë në teorinë juridike nuk ekziston pikëpamje e njësuar për natyrën e saj juridike dhe efektin e saj juridik, përkatësisht detyrueshmërinë e saj. Kësisoj, ekziston mendimi se rregullorja e Parlamentit është akt ekskluzivisht i brendshëm statutar, pra akt i brendshëm i dhomave të Parlamentit, prandaj ajo duke qenë “e drejtë e brendshme” është e obligueshme vetëm për Parlamentin i cili e ka nxjerrë (por jo edhe për qytetarët dhe organet tjera shtetërore). Për dallim nga ky mendim, rregullorja kuptohet si akt i cili ka efekt edhe jashtë Parlamentit (ndërsa kjo do të thotë edhe ndaj qytetarëve dhe organeve tjera) dhe ky mendim është më afër së vërtetës, duke marrë parasysh se rregullorja e Parlamentit përmban një sërë rregullash të cilat (drejtpërdrejt ose tërthorazi) kanë të bëjnë edhe me organe tjera shtetërore - para së gjithash, me Qeverinë dhe Presidentin e Republikës, posaçërisht nëse parlamenti e zgjedh edhe shefin e shtetit, e jo vetëm Qeverinë.
7. Rregullorja e punës e Kuvendit të Republikës së Kosovës miratohet me votat e dy të tretave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Pikërisht për shkak të mënyrës së tillë të miratimit të Rregullores, e shohim se sa është rëndësia e saj për punën dhe funksionimin e Parlamentit, pasi që aktet më të rëndësishme, marrëveshjet dhe institucionet politike miratohen, respektivisht zgjidhen dhe shkarkohen me shumicën e kualifikuar prej dy të tretave (2/3) të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Kështu për shembull marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me çështjet më të rëndësishme (territorin, paqen, aleancat, çështjet politike dhe ushtarake, të drejtat dhe liritë themelore, anëtarësimi i Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare, marrja e përgjegjësive ndaj obligimeve financiare nga ana e Republikës së Kosovës) ratifikohen me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit (neni 18 paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës). Gjithashtu, sipas nenit 65 pika 2 e Kushtetutës, Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të votave të dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve e ndryshon Kushtetutën, duke përfshirë edhe dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Në fund, zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës

(neni 86 paragrafi 4) dhe shkarkimi i tij/saj (neni 91 paragrafi 3), si dhe i Kryetarit dhe Nënkyetarit të Kuvendit (neni 67 paragrafi 5), bëhet me shumicën e votave të dy të tretave (2/3) të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

8. Rregullorja e punës e Kuvendit të Republikës së Kosovës përcakton organizimin dhe funksionimin e Kuvendit, organeve dhe trupave punuese të tij, si dhe të drejtat dhe obligimet e deputetëve, ndërsa çështjet që kanë të bëjnë me punën e Kuvendit e të cilat nuk janë rregulluar me këtë Rregullore, rregullohen me vendim ose me ndonjë akt tjetër të Kuvendit në përputhje me këtë Rregullore dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në çështjet më të rëndësishme që rregullohen me Rregulloren e punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës hyjnë:

- Kompetencat e Kuvendit (neni 6);
- Mbledhja konstituive e legjislaturës së Kuvendit (neni 7);
- Zgjedhja e Kryetarit dhe e nënkryetarëve të Kuvendit (neni 12);
- Zgjedhja, mandati, detyrat dhe mbledhjet e Kryesisë (neni 13-16);
- Kryesimi i mbledhjeve të Kuvendit (neni 19);
- Të drejtat dhe detyrat e deputetit të Kuvendit (neni 21);
- Imuniteti dhe procedura e heqjes së imunitetit të deputetit të Kuvendit (neni 22-23);
- Humbja e statusit të deputetit të Kuvendit (neni 25);
- Zgjedhja dhe shkarkimi i Presidentit të Republikës së Kosovës (neni 27-28);
- Zgjedhja e Kryeministrit dhe Qeverisë (neni 29);
- Mocioni i mosbesimit për Kryeministrin (neni 30);
- Mocioni i votëbesimit i Kryeministrit për Qeverinë (neni 31);
- Propozimi i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe ngritja e një çështjeje para Gjykatës Kushtetuese (neni 32-33);
- Zgjedhja dhe shkarkimi i Avokatit të Popullit (neni 36);
- Zhvillimi i mbledhjeve plenare të Kuvendit (neni 37-38);
- Puna në Kuvend (neni 39-52);
- Procedura ligjvënëse (neni 53-61);
- Komisionet e Kuvendit (neni 62-73);
- Bashkëpunimi ndërparlamentar (neni 74-75);
- Çështjet e integritetit evropian (neni 76-77);
- Përdorimi i gjuhëve në Kuvend (neni 78-79);
- Administrata e Kuvendit (neni 80);
- Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores së Kuvendit (neni 81-82);
- Shpërndarja e Kuvendit (neni 83).

Duke pasur parasysh që Rregullorja e punës e Kuvendit të Republikës së Kosovës rregullon organizimin e brendshëm dhe mënyrën e punës së Kuvendit, në tekstin e mëtejshëm të komentit tonë do të tregojmë faktin se ky organizim i brendshëm përfshin tri fusha të rëndësishme.

9. **Fusha e parë** ka të bëjë me pozitën e deputetit, si anëtar i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Deputeti i Kuvendit është përfaqësues i popullit, nuk i nënshtrohet asnjë obligimi tjetër dhe vepron sipas bindjes dhe ndërgjegjes së vet. Deputeti përveç të drejtës për të iniciuar projektligje, rezoluta, të parashtrijë pyetje

anëtarëve të Qeverisë, të votojë për vendimet e propozuara të Kuvendit, ai/ajo ka të drejtë të marrë pjesë në diskutime, në kushte të barabarta me deputetët tjerë të Kuvendit. Deputeti në pajtim me këtë Rregullore, mund të marrë pjesë në mbledhjet e komisioneve, në të cilat nuk është anëtar, por pa të drejtë vote. Me qëllim që ta kryejë në mënyrë të rregullt funksionin e tij, ai ka të drejtë të ketë qasje në të dhëna, në materiale dhe dokumente zyrtare, që janë të domosdoshme për ushtrimin e funksionit të tij, të jetë i informuar ose të kërkojë sqarime për çështjet që kanë të bëjnë me ushtrimin e funksionit të tij e çështje të tjera. Posaçërisht duhet theksuar se secili deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës gëzon imunitet në pajtim me Kushtetutën, për deklaratat gojore ose me shkrim dhe veprimet tjera, të kryera në cilësinë e deputetit të Kuvendit, në raport me masat e ndalimit, privimit nga liria, ndjekjes penale, deri sa Kuvendi të mos marrë vendim për heqjen e imunitetit të tij. Mirëpo, në mënyrë që një deputet të gëzojë të gjitha këto të drejta, ai duhet të respektojë detyrat e tij si dhe Kodin e Mirësjelljes, i cili është dhënë në shtojcën nr. 3 të Rregullores së punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës. E tërë kjo është e rregulluar me Rregulloren e punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës në dispozitat e neneve 21-26.

10. **Fusha e dytë** të cilën e përfshin organizimi i brendshëm i Parlamentit ka të bëjë me materien e sesioneve dhe seancave të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Këtu para së gjithash e kemi fjalën për procesin e debatit dhe marrjes së vendimeve juridike dhe politike, pastaj thirrja e seancës konstituive, kryesimi me seancat e Kuvendit, procedurën ligjvënëse, paraqitjen e propozimeve për projektligje nga ana e propozuesve të autorizuar, në mesin e të cilëve hyjnë Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushëveprimi i tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, Komisionet parlamentare, grupet parlamentare dhe më së paku 6 deputetë, 10.000 votues, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjithashtu, me Rregullore janë parashikuar edhe kushtet për paraqitjen e projektligjeve, pra është përcaktuar hollësisht se çfarë duhet të përmbajë projektligji që paraqitet në Kuvend, si dhe e tëra procedura ligjvënëse, duke përfshirë edhe paraqitjen e ndryshimeve në projektligj, nënshkrimi dhe shpallja e ligjeve të miratuara përfundimisht. Një çështje e rëndësishme e veçantë e rregulluar me Rregullore është ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare të cilin Kuvendi i Republikës së Kosovës e kryen në mbështetje të nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
11. Me Rregullore, në kuadër të kësaj fushe, është rregulluar hollësisht raporti i parlamentit të Republikës me organet tjera shtetërore. Këtu para së gjithash e kemi fjalën tek zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës, të cilin e zgjedh Kuvendi me votim të fshehtë, me votat e shumicës së dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, si dhe tek shkarkimi i tij, që kryhet në të njëjtën mënyrë, pra me shumicën e kualifikuar të lartpërmendur. Gjithashtu, Rregullorja përmban dispozita për zgjedhjen e Kryeministrit (Presidenti i Republikës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër) dhe tërë Qeverisë së Republikës së Kosovës (kandidati i emëruar për Kryeministër në afat prej 15 ditësh i paraqet Kuvendit përbërjen e Qeverisë dhe programin e Qeverisë për miratim), ndërsa ajo zgjidhet nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Çështje

tjetër nga kjo fushë ka të bëjë me propozimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilin e paraqet Kuvendi në bazë të nenit 114 dhe 152 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, si dhe me ngritjen e çështjeve para Gjykatës Kushtetuese nga ana e Kuvendit dhe deputetëve, gjë që është e përcaktuar me nenin 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

12. Krahas këtyre kompetencave për zgjedhje dhe raportit me organet tjera shtetërore, çështje me shumë rëndësi nga kjo fushë, e të cilën e përfshin organizimi i brendshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ka të bëjë me mbledhjet e Kuvendit, sesionet e tij (të rregullta - pranverore dhe vjeshtore dhe të jashtëzakonshme - për shqyrtimin e ndonjë çështjeje urgjente), përcaktimi i rendit të ditës, zhvillimi i punës së Kuvendit (në mbledhje plenare dhe në komisione), mbajtja e rendit në seancat e Kuvendit, përcaktimi i kalendarit të cilin e miraton Kuvendi (me propozim të Kryesisë, në konsultim me Qeverinë, me kryetarët e grupeve parlamentare dhe me kryetarët e komisioneve të Kuvendit). Çështje shumë me rëndësi nga kjo fushë është parashtrimi i kërkesës për interpelancë (propozues të autorizuar janë një grup parlamentar ose më së paku 6 deputetë për shqyrtimin e një çështjeje të caktuar që ka të bëjë me punën e Qeverisë ose të një ministrie të caktuar) si dhe parashtrimi i pyetjeve të deputetëve drejtuar Qeverisë për përgjigje me gojë ose me shkrim, si dhe paraqitja e propozimeve procedurale. Me Rregullore janë paraparë kuorumi (Kuvendi ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit) dhe votimi në seancat e Kuvendit (vendimet nga seancat janë të vlefshme nëse gjatë marrjes së tyre në sallë kanë qenë të pranishëm më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit, ndërsa ato konsiderohen të miratuara nëse për to voton shumica e deputetëve të pranishëm). Në fund, Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës rregullon edhe bashkëpunimin me parlamentet e vendeve tjera, shqyrtimin e raporteve të Qeverisë për procesin e integritetit evropian si dhe përdorimin e gjuhëve në Kuvend si dhe gjuhën e dokumentacionit, pra hartimit të të gjitha dokumenteve zyrtare të Kuvendit. Çështjet e lartpërmendura, që hyjnë në materien e sesioneve dhe seancave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, janë rregulluar me nenet 7, 19, 27-29, 32-33, 37-61, 74-79.

13. *Fusha e tretë* të cilën e përfshin organizimi i brendshëm i parlamentit ka të bëjë me trupat punuese të parlamentit dhe me funksionarët punues të parlamentit. Kësisoj, neni 12 i Rregullores e rregullon zgjedhjen e Kryetarit dhe Nënkyetarëve të Kuvendit të cilët përbëjnë Kryesinë nëntë-anëtarëshe të Kuvendit, mbledhjet e së cilës i thërret dhe me të njëjtat, kryeson Kryetari i Kuvendit. Rol shumë të rëndësishëm në punën e çdo parlamenti kanë trupat punuese të brendshme, pra komitetet dhe komisionet, prandaj edhe Rregullorja e rregullon mënyrën e zgjedhjes, punës, llojet (të përhershme dhe funksionale) dhe funksionet e komisioneve të shumta që ekzistojnë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, emërimin e kryetarit dhe nënkryetarit të komisioneve, mbajtja e mbledhjeve të komisioneve. Fushëveprimi dhe përgjegjësi të komisioneve parlamentare, për shkak të rëndësisë së tyre, u është dedikuar edhe Shtojca nr. 2. e Rregullores si shtojcë e veçantë. Në fund, duhet thënë se me nenin 80 të Rregullores është

rregulluar puna e administratës së Kuvendit e cila ofron mbështetje profesionale, administrative dhe teknike për nevojat e Kuvendit, Kryesisë, komisioneve, grupeve parlamentare dhe deputetëve të Kuvendit.

Neni 77 [Komisionet]

- (1) Kuvendi i Kosovës emëron komisione të përhershme, komisione funksionale dhe komisione ad hoc, që pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit.**
- (2) Kuvendi, me kërkesën e një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve të tij, cakton komisione për një çështje të veçantë, duke përfshirë edhe çështje hetimore.**
- (3) Së paku një zëvendëskryesues i secilit komision parlamentar, do të jetë nga radhët e komunitetit tjetër nga ai i kryesuesit.**
- (4) Pushtetet dhe procedurat e komisioneve përkufizohen me Rregulloren e Punës të Kuvendit.**

Neni 77

1. Siç e kemi cekur në nenin e mëparshëm 76 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili i ishte kushtuar analizës së Rregullores së punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, grupi i tretë i çështjeve nga fusha e organizimit të brendshëm të Kuvendit përfshin trupat punues parlamentarë dhe zyrtarët parlamentarë. Pikërisht këto çështje janë të lidhura më së ngushti me organizimin e brendshëm të parlamenteve, kurse kushtetutat, si rregull, përmbajnë lidhur me to vetëm dispozitat më parimore, duke ia lënë Rregullores së punës të Parlamentit që në bazë të parimit të vetorganizimit të Parlamentit, t'i rregullojë më tej ato çështje. Puna e Parlamentit zhvillohet në dy forma: në plenum, gjegjësisht në seanca parlamentare dhe në mbledhje të këshillave dhe të komisioneve.
2. Komisionet parlamentare janë trupa punues ndihmës të Parlamentit, të cilat e ndihmojnë Parlamentin në punë dhe kontribuojnë në efikasitetin saj, pasi që në to shqyrtohen çështje dhe përgatiten propozime për marrjen e vendimeve në seancat parlamentare, gjegjësisht në plenum. Kjo bëhet në mënyrë që Parlamenti të mund të punojë në mënyrë më efikase, ndërsa ndonjëherë, për shkak të vëllimit të punëve, me të cilat merret Kuvendi dhe ngadalësisë së procedurës parlamentare, komisioneve parlamentare mund t'u besohet vendimmarrja për çështjet të cilat janë në kompetencë të Parlamentit. Në ato raste, komisioni parlamentar, nga organi përgjegjës për punën përgatitore të Parlamentit, bëhet organ me autorizime qeverisëse,³⁰¹ edhe pse kjo paraqet një përjashtim. Është rregull që komisionet, si trupa të punës, të përgatisin punën plenare të Parlamentit, derisa organet e Parlamentit e udhëheqin punën e tyre. Përbërja, roli dhe funksioni i tyre në

³⁰¹ Në historinë parlamentare për herë të parë një sistem i tillë i komisioneve (këshillave) me kompetenca qeverisëse ishte zbatuar në periudhën e sundimit të Konventës, gjatë kohës së Revolucionit francez.

procesin parlamentar rregullohen në mënyrë të detajuar me Rregulloren e punës së Parlamentit.

3. Në komisionet parlamentare shqyrtohen të gjitha çështjet dhe propozimet, të cilat do të zgjidhen përfundimisht në seancën e Parlamentit. Siç theksuam në paragrafin paraprak, vetëm në raste të caktuara, gjegjësisht në raste të jashtëzakonshme, në lidhje me disa çështje, komisionet mund të marrin vendime përfundimtare, d.m.th. mund të jenë të autorizuar për votimin e ligjeve.³⁰² Në fushën e legjislacionit, komisionet parlamentare i shqyrtojnë propozimet e paraqitura dhe përmes raportuesit të komisionit, i japin mendimin Parlamentit për projektligjin dhe amendamentet e paraqitura. Përbërja e këtyre komisioneve, siç dihet, është rezultat ose, thënë më mirë, shprehje e raportit aktual të forcave politike në Kuvend. Duke pasur parasysh këtë, komisioni pakicë ka të drejtë t'ia paraqesë plenumit të Parlamentit mendimin e vet mbi propozimet e paraqitura. Përveç këtij roli të komisioneve në fushën e legjislacionit, ato kanë një funksion të rëndësishëm në drejtim të fushës së ekzekutivit, i cili manifestohet si një kontroll i veçantë i punës së organeve të pushtetit ekzekutiv (para së gjithash të qeverisë). Në të vërtetë, komisionet parlamentare zakonisht formohen si trupa punues të specializuara për fusha të caktuara, të cilat përputhen me fushat e departamenteve ministrore, duke lehtësuar kështu kontrollin parlamentar mbi ministrinë e caktuara, si dhe mbi qeverinë, si tërësi.
4. Kur është fjala për komisionet parlamentare, duhet cekur se ka klasifikime të ndryshme, sipas kritereve të ndryshme. Megjithatë, më së shpeshti pranohet ndarja e komisioneve në të përhershme dhe të përkohshme (diku quhen të herëpashershme), të specializuara ose me fushëveprim të përgjithshëm. Komisionet e përhershme veprojnë deri me skadimin e legjislaturës (ato punojnë vazhdimisht gjatë seancave parlamentare dhe formohen për fusha të caktuara nga sfera e kompetencave standarde të Kuvendit, siç janë, për shembull, çështjet kushtetuese, financiare, politika e jashtme, siguria, ekonomia, shëndetësia, arsimi, mbrojtja e mjedisit jetësor dhe të tjera), përderisa ato të përkohshme deri në një datë të caktuar apo me përfundimin e detyrës, e cila u është besuar (formohen me vendim të Parlamentit në rast se për këtë paraqitet nevoja, ashtu që, kur ta përfundojnë punën e herëpashershme, ato pushojnë së punuari).³⁰³ Kështu, për shembull,

³⁰² Ky rast parashihet, për shembull me Kushtetutën e Italisë, e cila lejon që me Rregulloren e punës së Kuvendit të Italisë të rregullohen rastet dhe mënyra e votimit të projekteve ligjore nga ana e komisionit, si dhe komisioneve të përhershme, të cilat janë të përbëra në atë mënyrë që në të përfaqësohen grupet parlamentare në mënyrë proporcionale.

³⁰³ Një lloj të posaçëm të trupave të përkohshëm të Parlamentit paraqesin komisionet hetuese, si organe që formohen me qëllim të kryerjes së hetimit parlamentar, si dhe komisionet e përziera për zgjidhjen e konflikteve mes dhomave të Parlamentit. Komisioni hetues formohet me vendimin e Parlamentit, me detyrë që të shqyrtojë një çështje, të cilën Parlamenti e konsideron të rëndësishme për vendimin të cilin duhet ta merr. Me vendimin e formimit të komisionit hetues përcaktohet përbërja e tij, fushëveprimi i punës, çështja që ka nevojë të studiohet dhe duhet të specifikohet afati brenda të cilit duhet të kryhet një punë e caktuar. Kur të përfundohet puna, komisioni hetues do të hartojë raportin e tij dhe do t'ia paraqesë Parlamentit për miratim, dhe pas kësaj do të pushojë puna e tij.

komisioni, i cili kryen një hetim parlamentar, formohet për të mbledhur fakte dhe të dhëna në lidhje me një çështje të rëndësishme të interesit publik ose për një çështje që lidhet me punën pushtetit ekzekutiv (p.sh., kreu i shtetit, Qeveria, etj).

5. Hetimi parlamentar i besohet një organi të posaçëm punues (komisionit), të cilin e formon Parlamenti nga deputetët, por në atë mënyrë që në përbërjen e tij sigurohet përfaqësimi proporcional i partive parlamentare. Ekzistojnë edhe komisione të përziera për zgjidhjen e konflikteve të dhomave të Parlamentit dhe ato formohen kur ndodh një situatë në të cilën Parlamenti nuk mund ta kalojë një ligj për shkak të mosmarrëveshjes në mes të dhomave (kjo ndodh kur ligji aprovohet me kompetenca të barabarta në mes të dy dhomave, ashtu që për miratimin e tij është i nevojshëm pëlqimi i tyre). Në qoftë se pëlqimi i dhomave mungon (apo dhomat e votojnë ligjin me tekste të ndryshme), Parlamenti formon një komision të përzier të përbërë nga një numër i barabartë deputetësh nga çdo dhomë, me detyrën e vetme për të gjetur një zgjidhje të pranueshme për anëtarët e të dyja dhomave të Parlamentit. Kur komisioni përfundon punën, ai i paraqet Parlamentit propozimin e tij për zgjidhjen e çështjes së kontestuar.
6. Komisionet e specializuara formohen për fusha të caktuara të administrimit shtetëror, por në disa shtete komisionet mund të kenë fushëveprim të përgjithshëm, që do të thotë se i mbulojnë të gjitha fushat e administratës publike (kësi shembujsh ka më pak, por atje ku ekziston, çdo komision mund të shqyrtojë të gjitha çështjet, për të cilat vendos Parlamenti).³⁰⁴ Është një rregull që anëtarë të komisionit mund të jenë vetëm deputetët, por ka edhe raste kur mund të jenë edhe persona që nuk i takojnë Parlamentit. Por, ajo që është me rëndësi të përmendet, është që, në çdo rast, përbërja e komisionit duhet t'i përgjigjet përbërjes politike të Kuvendit, që do të thotë se në të janë të përfaqësuara grupet e deputetëve, në përprjesëtim me fuqinë e tyre. Nga kjo mund të thuhet se komisioni, sipas përbërjes së tij, paraqet një "mini-parlament", të llojit të vet, përmes të cilit grupet e deputetëve, duke i caktuar anëtarët e tyre, udhëheqin me aftësitë e tyre për punë profesionale në komisionin përkatës (si dhe dëshirën e tyre të shprehur për të qenë anëtarë të komisionit të caktuar, në të cilin, sipas mendimit të tyre personal, do të mund të japin rezultatet më të mira dhe kontributin më të madh në punën e Parlamentit dhe të njëjtën kohë, duke përfaqësuar grupin e vet parlamentar në mënyrën më të mirë të mundshme).
7. Sipas kësaj, punës më të mirë kualitative të Parlamentit i kontribuon njohja e fushës për të cilën është formuar organi i punës, sepse, siç theksuam më lart, me rastin e zgjedhjes së deputetëve në organe punuese, kujdeset që në përbërjen e tyre të zgjidhen deputetët, të cilët e njohin atë fushë më së miri. Përveç kësaj, në punën e organeve punuese parlamentare (komisione), mund të marrin pjesë ekspertë të lëmenjve përkatës, gjë që mund të kontribuojë në kualitetin e punës së Parlamentit.

³⁰⁴ 1) Kështu, për shembull, e drejta parlamentare franceze i dallon tri kategori të komisioneve parlamentare: 1) të përhershme, 2) të veçanta dhe 3) hetuese. Të gjitha këto komisione kanë kompetenca të ndryshme, por parimi për të gjitha komisionet është përfaqësimi proporcional i grupeve parlamentare.

Ekspertët, të cilët marrin pjesë në punën e këtyre organeve, kanë të drejtë të marrin pjesë në diskutim, por nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrje. Nga kjo del se komisioneve, si organe të punës, u përket një vend i rëndësishëm në miratimin e ligjeve, posaçërisht në pjesën e procedurës legjislative, para seancës plenare të Parlamentit. Në to shqyrtohet propozimi i ligjit dhe amendamentet që paraqiten në propozimin e ligjit, mbahet diskutimi për projektligj, diskutohen zgjidhjet e propozuara dhe amendamentet e paraqitura në propozimin e ligjit etj.

8. Parlamenti në seancat e veta plenare i zgjedh anëtarët e komisionit për periudhën prej një mandati, për të cilën ai është zgjedhur. Kryetari i komisionit përkatës, më së shpeshti, është vetëm kryesues në të dhe pa kompetenca të veçanta të veta. Atë e zgjedhë ose vetë komisioni, ose e emëron Parlamenti, gjegjësisht dhoma përkatëse, ndërsa në lidhje me qëndrimet dhe mendimet e komisionit, plenumi nuk e lajmëron kryesuesin e atij komisioni, por një raportues i posaçëm, nga radhët e anëtarëve të komisionit. Përgjegjësia kryesore e këtij raportuesi është që në seancat e Parlamentit të shpjegojë dhe të mbrojë qëndrimin dhe mendimin e komisionit. Një situatë e veçantë është kur kemi të bëjmë me Parlamentin dydhomësh, ku çdo dhomë ka rrejetin e vet të komisioneve. Ndërmjet këtyre komisioneve ekziston një paralelizëm i plotë, por përveç komisioneve të dhomave, ekzistojnë komisione të përbashkëta të Parlamentit (për Parlamentin si një tërësi), të cilat më së shpeshti janë bërë sipas parimit të paritetit, gjegjësisht përfaqësimit të barabartë të të dy dhomave. Kështu, për shembull, komisionet e përhershme të Parlamentit në Itali, janë të përbëra në atë mënyrë që grupet parlamentare janë të përfaqësuara në mënyrë proporcionale.³⁰⁵

Neni 77.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 77, paragrafi 1 përcakton se Kuvendi i Kosovës emëron *komisione të përhershme, funksionale, dhe komisione ad-hoc*, që pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit, gjegjësisht raportin e forcave politike, dhe kjo do të thotë se, si në Kuvend, ashtu edhe në komisionet e tij, janë të përfaqësuara partitë politike, gjegjësisht grupet e deputetëve në përpjesëtim me fuqinë dhe ndikimin e tyre, të fituar në zgjedhjet e përgjithshme për këtë organ përfaqësues. Të njëjtën dispozitë e përmban edhe neni 69 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës. Fushëveprimi i punës dhe përgjegjësitë e komisioneve përcaktohen në Shtojcën nr. 2, e cila është një pjesë integrale e kësaj Rregulloreje. Kryetari i Kuvendit mund të emërojë si anëtarë të komisioneve edhe deputetë, pavarësisht nga grupi parlamentar të cilit i përkasin, por pa të drejtë vote. Kryesia e Kuvendit e propozon numrin e anëtarëve të çdo komisioni, por deputeti i Kuvendit, në parim, mund të jetë anëtar vetëm i një komisioni. Kuvendi i Republikës së Kosovës përcakton numrin e komisioneve të përhershme dhe funksionale.

³⁰⁵ Neni 72. paragrafi 2. i Kushtetutës së Italisë

2. Në **komisione të përhershme** bëjnë pjesë:
 1. Komisioni për Buxhet dhe Financa - i shqyrton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me buxhetin dhe financat në Kosovë;
 2. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve - i shqyrton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve;
 3. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi - shqyrton bazën ligjore dhe kushtetuese për nxjerrjen e çdo ligji të Kuvendit të Kosovës;
 4. Komisioni për Integritet Evropian - e shqyrton dhe monitoron procesin e harmonizimit të çdo ligji të miratuar në Kuvend me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

3. Si **komisione funksionale** në Rregullore përmenden më tej:
 1. Komisioni për Punë të Jashtme -ndërton bashkëpunimin me parlamente të vendeve dhe promovon anëtarësimin e Kuvendit në organizatat parlamentare rajonale dhe ndërkombëtare;
 2. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport -shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në Kosovë, pastaj të gjitha çështjet e zhvillimit dhe promovimit të kulturës dhe të sportit në Kosovë, si dhe çështje të statusit të të rinjve në shoqëri;
 3. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion - shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me ekonomi, industri, trafik rrugor, ujqor dhe ajror në Kosovë dhe të gjitha çështjet e telekomunikacionit, shërbimeve postare, internetit, frekuencave të transmetimit televiziv dhe të radios dhe me çështje të tjera të telekomunikacionit;
 4. Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor - shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor;
 5. Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale - shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale;
 6. Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media - shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me funksionimin e shërbimit civil, administratën lokale dhe media;
 7. Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri - shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë e brendshme.
 8. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione - shqyrton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, monitorimin dhe zbatimin e parimit të barazisë të gjinisë, legjislacionit dhe peticioneve të paraqitura nga një apo më shumë qytetarë;
 9. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike - mbikëqyr ligjshmërinë e shpenzimit të parave publike mbi bazën e raporteve vjetore dhe periodike, të cilat i shikon dhe ia nënshtron një rishikimi;
 10. Komisioni për Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës - Forca shqyrton strategjitë, ligjet dhe dokumentet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe i përgatitë ato për debat në Kuvend, shqyrton planin e vazhdueshëm dhjetë-vjeçar për Forcën e Sigurisë së Kosovës para se të paraqitet në Kuvend për miratim dhe heton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë

- me organizimin, financimin, personelin dhe pajisjen e Forcave të Sigurisë së Kosovës;
11. Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë - mbikëqyr ligjshmërinë e punës së kësaj Agjencie, shqyrton dhe miraton buxhetin e Agjencisë, shqyrton raportet e Drejtorit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, i raporton Inspektorit të Përgjithshëm e kështu me radhë;
 12. Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit - shqyrton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Rregullores së Kuvendit, për mandate dhe imunitete.
4. Në përputhje me dispozitat e nenit 71 të Rregullores së punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, mund të formohet edhe **komisioni ad-hoc**, që ka autorizime të komisionit funksional (dhe këtë komision e formon vetë Kuvendi, në vendimin për themelimin e të cilit duhet të përfshihet përbërja e komisionit, e cila duhet të jetë në përputhje me nenin 63 të kësaj Rregulloreje). Komisioni ad-hoc (Komisioni Hetues Parlamentar dhe komisionet e tjera) është një komision i përkohshëm, i cili merret me shqyrtimin e çështjeve të veçanta. Kur Kuvendi e identifikon një çështje të një rëndësie të veçantë, e autorizon komisionin ad-hoc për të thirrur secilin prej autoriteteve të Kosovës, që e shoh të arsyeshme, për të dëshmuar para komisionit. Kuvendi përcakton: procedurën, kohëzgjatjen e funksionimit të komisionit, si dhe shpenzimet e mundshme të punëve të tij. Hetimi parlamentar rregullohet me akte të veçanta të procedurës, të miratuara nga Kuvendi me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve të pranishëm. Kur Kuvendi e shoh të arsyeshme, mund të formojë edhe komisione të tjera ad-hoc për kryerjen e detyrave brenda kompetencave të tij.
5. Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës rregullon në detaje emërimin e zyrtarëve të komisioneve të përmendura, gjegjësisht kryetarin dhe nënkryetarin e komisionit (neni 63), thirrjen dhe punën e mbledhjeve të komisionit, raportet e tyre dhe të ngjashme. Kryesia e Kuvendit mund të kërkojë nga secili grup parlamentar, që është i përfaqësuar në Kuvend, që të propozojnë kandidatët e tyre për këto vende, si dhe anëtarë të komisionit. Megjithatë, me dispozitat e këtij neni posaçërisht theksohet fakti se, për shkak të shmangies së konfliktit të interesit, anëtari i Kryesisë nuk mund të jetë kryetar i komisionit parlamentar, që një deputet nuk mund të jetë kryetar në më shumë se një komision, si dhe se ministri ose zëvendës ministri nuk mund të jetë anëtar i komisionit të kuvendit. Kjo mospërputhje (papajtueshmëri) e kryerjes së njëkohshme të këtyre detyrave është parashikuar, në dy rastet e para, në mënyrë që në kuadër të pushtetit legjislativ, domethënë në kuadër të Kuvendit, si titullari më i rëndësishëm i funksionit legjislativ brenda këtij pushteti, të mos ndodhë akumulimi i funksioneve në duart e një personi, përkatësisht të një anëtari të kryesisë ose një deputeti. Në rastin e tretë, papajtueshmëria është projektuar për shkak të respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve, në mënyrë që të evitohet situata që përfaqësuesi i pushtetit ekzekutiv të jetë njëkohësisht edhe anëtar i një komisioni parlamentar, i cili është pjesë përbërëse e Kuvendit, si organ legjislativ.

6. Duke marrë parasysh se partia politike, si organizatë politike, është një formë e organizimit politik të njerëzve dhe se ajo përfshin njerëzit me të njëjtën ideologji politike me qëllimin kryesor të fitimit të plotë apo të pjesshëm të pushtetit shtetëror me mjete demokratike, të bazuar në zgjedhje, është normale që me hyrjen e përfaqësuesve të partive të caktuara në Parlament (zgjedhjes së tyre për deputetë), këto parti të përfshihen në jetën parlamentare. Në fakt, qëllimi i bashkimit në parti politike është edhe fitimi dhe ushtrimi i pushtetit në mënyrë ligjore dhe demokratike, gjegjësisht me pjesëmarrje në zgjedhje dhe duke marrë shumicën e votave të elektoratit. Njerëzit bashkohen në parti politike, kryesisht për shkak se ata kanë një ideologji të përbashkët, pikëpamje të njëjta për botën, por edhe interesa të përbashkëta, të cilat dëshirojnë t'i arrijnë përmes një organizimi të fortë, në mënyrë që të ndikojnë në vendimmarrje në lidhje me drejtimin politik të zhvillimit të vendit.³⁰⁶ Prandaj grupet parlamentare e shfrytëzojnë të drejtën e tyre që të propozojnë kryetarë të komisioneve, në pajtim me marrëveshjen e arritur në Kryesi, të cilat, në pajtim me marrëveshjen e arritur për ndarjen e funksioneve, kujdeset për proporcionalitetin e forcave të grupeve parlamentare, gjegjësisht ndikimin e tyre në Kuvend, i cili rrjedh nga një numër i fituar i vendeve të deputetëve dhe votave të fituara në zgjedhje.
7. Për shkak të rëndësisë së jashtëzakonshme të komisioneve për punën e Kuvendit, ato takohen më së paku dy herë në muaj dhe mbledhjet e këtyre komisioneve, në parim janë të hapura, përveç në rastet e planifikuara paraprakisht dhe rastet e përmendura shprehimisht. Për përmirësimin e kualitetit të punës së tij, komisioni mund të angazhojë këshilltarë (ekspertë), si dhe të ftojë përfaqësues të institucioneve dhe shoqërisë civile që të marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve, që të paraqesin fakte dhe dokumente të rëndësishme. Me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës, komisioni mund të mbajë seanca të përbashkëta me komisionet tjera, me ç'rast një komision i ofron informata ose dokumente komisioneve të tjera, nëse ato e kërkojnë këtë nga ai. Kur është e nevojshme, me

³⁰⁶ Pikërisht për këtë, elementi më i rëndësishëm përbërës (dëshira për të marrë pjesë në funksionimin e institucioneve politike dhe për të fituar pushtetin, për të mundësuar epërsi të ideve dhe interesave të anëtarëve të saj), partitë politike ndryshojnë nga institucione të ngjashme që ekzistojnë në sistemin e demokracisë përfaqësuese. Kështu, partitë politike ndryshojnë nga grupet e interesit me atë se ato kanë një ideologji politike, dhe se objektivi i tyre është ta fitojnë dhe ta ushtrojnë pushtetin shtetëror, ndërsa grupet e interesit, në vend të ideologjisë politike kanë interesa konkrete financiare apo ideologjike, por qëllimi i tyre nuk është fitimi dhe ushtrimi i pushtetit shtetëror. Një situatë e ngjashme ekziston me lëvizjet politike, nga të cilat partitë ndryshojnë për nga ideologjia unike politike, sepse lëvizjet politike synojnë mbrojtjen e interesave shumë të gjera dhe relativisht të pacaktuara popullore, të cilat nuk mund të përfshihen nga ndonjë ideologji e posaçme në kuptimin e vërtetë të fjalës. Dhe, së fundi, ka një dallim edhe me grupet e armatosura, si organizata që gjithashtu kanë për qëllim ta fitojnë dhe ta ushtrojnë pushtetin shtetëror, por me rrënimin e institucioneve ekzistuese të pushtetit, pa respektuar rendin e themeluar publik në vend dhe pa respektuar mënyrën e fitimit të pushtetit të përcaktuar me rendin publik. Kjo do të thotë se këto grupe tentojnë të fitojnë dhe ushtrojnë pushtet shtetëror në mënyrë jodemokratike, me mospjesëmarrje në zgjedhje dhe pa fituar shumicën në zgjedhje. Dhe kjo është pikërisht e kundërta e asaj që është karakteristikë kryesore dhe që paraqet element konstitutiv të partive politike.

qëllim të marrjes së informatave të caktuara në lidhje me çështjet, shqyrtimi i të cilave është në zhvillim e sipër, komisioni mund të organizojë një shqyrtim publik me ekspertë të organizatave publike, përfaqësues të grupeve të interesit dhe persona të tjerë. Komisioni harton raport me shkrim për Kuvendin, i cili duhet të përmbajë rekomandime me arsyetime përkatëse.

Neni 77.2

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në paragrafin 2 të këtij neni përcakton se Kuvendi me kërkesën e një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve të tij, cakton komisione për një çështje të veçantë, duke përfshirë edhe procedurën hetimore. Meqenëse komisioni i tillë nuk është i përhershëm, ai pushon së funksionuari kur e përfundon punën e tij, gjegjësisht kur e zgjidh çështjen për të cilën edhe është formuar.

Neni 77.3

1. Sipas paragrafit 3 neni 77 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, më së paku një zëvendëskryetar i çdo komisioni parlamentar, duhet të jetë i një komuniteti tjetër në raport me komunitetin të cilit i përket kryetari. Dispozitë të ngjashme përmban edhe neni 69 i Rregullores së punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës në paragrafin 8, sipas të cilit të gjitha komisionet duhet të kenë nga dy zëvendëskryetarë - zëvendëskryetarin e parë dhe zëvendëskryetarin e dytë, të cilët i takojnë grupeve të ndryshme parlamentare dhe së paku një nga zëvendëskryetarët duhet të jetë nga një komunitet tjetër prej atij të kryetarit. Kryesia i propozon Kuvendit emërimin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të komisioneve, në pajtim me dispozitat e nenit 63 të Rregullores, duke u përkujdesur për përfaqësimin dhe ndikimin e grupeve parlamentare në Kuvend (përfashtim praqet Komisioni për të drejta dhe interesa të komuniteteve). Kjo parashihet për shkak të faktit se Republika e Kosovës është një mjedis multi-etnik, ashtu që anëtarët e komuniteteve kanë të drejtë që lirshëm të shprehin, të kultivojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre dhe karakteristikat e komunitetit të tyre. Në këtë drejtim, Kushtetuta e Republikës së Kosovës përkujdeset që në të gjitha institucionet politike të Republikës së Kosovës, pra edhe në komisionet e Kuvendit, të jenë të përfaqësuar përfaqësuesit e komuniteteve përkatëse, të cilat jetojnë në territorin e Kosovës.

Neni 77.4

1. Paragrafi i fundit i këtij neni të Kushtetutës (Neni 77 paragrafi 4) parashikon që kompetencat dhe procedurat e komisionit rregullohen me Rregulloren të punës së Kuvendit. Duke pasur parasysh rëndësinë e Rregullores për funksionim dhe punë të Kuvendit, si organ më i rëndësishëm përfaqësues i Republikës së Kosovës dhe rolin e madh të komisioneve në përgatitjen, lehtësimin dhe sigurimin e funksionimit të qetë dhe efikas të Kuvendit, këtyre çështjeve u kemi kushtuar një pjesë të konsiderueshme të komentit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Për të gjitha këto arsye dhe veçanërisht për shkak të faktit se komisionet e

lartpërmendura shpesh kanë detyra specifike, secila prej këtyre komisioneve, për t'i kryer këto detyrat, mund të formojë nënkomisione për anëtarët e saj (formimi i një nënkomisioni duhet të mbështetet nga dy të tretat e anëtarëve të komisionit), me kusht që për formimin e këtyre nënkomisioneve dhe listës së anëtarëve të tyre, duhet informuar Kryesia e Kuvendit. Për çështjet e interesit të përbashkët, dy ose më shumë komisione mund të formojnë një nënkomision të përbashkët që duhet të miratohet më vonë në Kryesi. Anëtarët e nënkomisioneve e caktojnë grupin parlamentar, por këtu, si në të gjitha organet e tjera të Kuvendit të Republikës së Kosovës, aplikohet parimi i proporcionalitetit, gjegjësisht merret parasysh raporti i fuqisë së grupit parlamentar. Nënkomisioni kryen aktivitete që janë kompetencë e komisionit dhe bazuar në kompetencat e dhëna nga komisioni raporton për punë në komisionin kompetent.

Neni 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve]

- (1) Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve është komision i përhershëm i Kuvendit. Ky komision përbëhet nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb, nga një e treta (1/3) e anëtarëve që përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë, dhe një e treta (1/3) e anëtarëve nga komuniteti shumicë, të përfaqësuar në Kuvend.**
- (2) Me kërkesën e cilitdo anëtar të Kryesisë së Kuvendit, çdo ligj i propozuar do të dorëzohet në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të tij, do të vendosë nëse do të bëjë rekomandime në lidhje me ligjin e propozuar brenda dy javësh.**
- (3) Për të siguruar që të drejtat dhe interesat e komuniteteve janë adresuar si duhet, Komisioni mund t'i bëjë rekomandime komisionit tjetër përkatës ose Kuvendit.**
- (4) Komisioni, me nismën e vet, mund të propozojë ligje dhe masa të tilla të tjera brenda përgjegjësive të Kuvendit, të cilat i konsideron se janë të duhura për të adresuar interesat e komuniteteve. Anëtarët e Komisionit mund të japin mendime individuale.**
- (5) Një çështje mund t'i referohet komisionit për mendim këshillimor nga Kryesia e Kuvendit, një komisioni tjetër, ose një grupi të përbërë nga të paktën dhjetë (10) deputetë të Kuvendit.**

Neni 78

1. Për të siguruar dhe mbrojtur të drejtat edhe interesat e komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, Kushtetuta parashikon themelimin e Komisionit të Përhershëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Detyra më e rëndësishme e këtij Komisioni është që të respektojë të drejtat e komuniteteve dhe ruajtjen e multiethnicitetit,

kështu që roli i tij është shumë i rëndësishëm në ruajtjen dhe garantimin e të drejtave dhe interesave të pjesëtarëve të komuniteteve në territorin e Republikës së Kosovës. Në këtë aspekt, parashihet gjithashtu mundësia për të propozuar ligje dhe akte të tjera nga ana e Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, me kusht që këto akte të jenë brenda juridiksionit të Kuvendit të Republikës.

Neni 78.1

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës emëron anëtarët e Komisionit në bazë të propozimit të Kryesisë së Kuvendit. Megjithatë, një përjashtim nga ky rregull, bën Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve (neni 78, paragrafi 1 i Kushtetutës), përbërja e të cilit, për shkak të veçantisë së Komisionit dhe rëndësisë së tij për ruajtjen e multietnicitetit dhe respektimit të të drejtave dhe interesave të komuniteteve në Kosovë, është i rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky Komision i takon grupit të komisioneve të përhershme të Kuvendit dhe ka një përbërje shumë të veçantë, duke pasur parasysh se ai përbëhet nga 1/3 e deputetëve, të cilët përfaqësojnë grupin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilët mbajnë ulëse të rezervuara apo të garantuara për komunitetin serb. Një të tretën e tjetër të këtij Komisioni e përbëjnë deputetët nga komuniteti shumicë, që është i përfaqësuar në Kuvend.
2. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij Komisioni, i cila projektohet përmes vetë përbërjes së tij me Shtojcën nr. 2, e cila përbën një pjesë të Rregullores së punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, parashihet juridiksioni, i cili përfshin një numër të madh të punëve, detyrave dhe kompetencave. Kështu, Komisioni, brenda fushëveprimit dhe përgjegjësisë së tij, shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me të drejtat dhe interesat e komunitetit, kështu që fushëveprimi i punës së këtij Komisioni përfshin:
 - Shqyrtimin e projektligjit në aspektin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve;
 - Vendimmarrjen me shumicën e votave të anëtarëve të tij në lidhje me projektligjin me qëllim të adresimit të duhur dhe të përshtatshëm të të drejtave dhe interesave të komuniteteve;
 - Propozimin e projektligjeve dhe masave të tjera të ngjashme brenda suazave të përgjegjësisë së Kuvendit, kurdo që konsiderohet e nevojshme për të trajtuar problemet e komuniteteve;
 - Dorëzimin e amendamenteve në projektligj (vendimi për dorëzimin e amendamenteve merret me shumicën e votave të anëtarëve të Komisionit);
 - Dhënien e mendimit këshillëdhënës, me kërkesë të Kryesisë së Kuvendit;
 - Shqyrtimin e projektbuxhetit dhe rishikimin e buxhetit të ministrisë së sektorit përkatës;
 - Propozimin Komisionit për Buxhet dhe Financa për shqyrtim dhe miratim të projektbuxhetit në Kuvend, duke përfshirë amendamentet;
 - Monitorimin e zbatimit të ligjit nga fushëveprimi i tij i punës;
 - Shqyrtimin e çështjeve të tjera, të përcaktuara me Rregulloren, të cilat me një vendim të veçantë të Kuvendit, barten në këtë Komision.

3. Në kryerjen e funksioneve të tij, Komisioni bashkëpunon me Ministrinë e sektorit përkatës dhe të gjitha ministritë e tjera, disa prej të cilave mund të kërkojnë të dhëna të veçanta, duke përfshirë edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave ose personave tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni. Rregullorja e punës së Kuvendit (neni 63, paragrafi 6), parashikon që për funksionin e kryetarit të Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, propozimi shkon nga grupi parlamentar i një komuniteti tjetër, përveç komunitetit të shumicës.

Neni 78.2

1. Neni 78 i përmendur i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në paragrafin 2 parashikon mundësinë që çdo anëtar i Kryesisë së Kuvendit³⁰⁷ të paraqesë kërkesë që çdo ligji i propozuar (propozuesit e autorizuar janë Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe të paktën 10.000 qytetarë) t'i paraqitet Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Kjo është paraparë, për shkak se në këtë mënyrë mundësohet mbrojtja e drejtave dhe interesave të qytetarëve që u përkasin komuniteteve të ndryshme.³⁰⁸ Për shkak të rëndësisë së procesit legjislativ, veçanërisht nevojës për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e pjesëtarëve të një komuniteti të caktuar, Komisioni është i obliguar që me procedurë urgjente, por jo më vonë se 2 javë, me shumicë votash të anëtarëve të tij, të nxjerrë një vendim mbi atë nëse do të bëjë rekomandime lidhur me kërkesën e propozuar.

Neni 78.3

1. Në mënyrë që t'i kushtohet vëmendje e veçantë mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme dhe kjo është arsyeja e themelimit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve (neni 78 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës), për të siguruar mbrojtje adekuate të këtyre të drejtave dhe interesave, Komisioni mund të bëjë rekomandimet e duhura për komisionet e tjera kompetente ose për vetë Kuvendin (paragrafi 3). Kjo është e nevojshme për një shqyrtim sa më të plotë të çdo ligji të propozuar, duke pasur parasysh ndjeshmërinë e problemit që ato i rregullojnë dhe rëndësinë e ruajtjes së marrëdhënieve të mira që ekzistojnë mes komuniteteve në Kosovë. Ruajtjes së këtyre marrëdhënieve i kontribuon mbrojtja adekuate e të drejtave dhe interesave të të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve, të cilët kanë të drejtë lirisht të shprehin, të

³⁰⁷ Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës ka gjithsej 9 anëtarë dhe përbëhet nga: a) dy anëtarë nga partia ose koalicioni që ka fituar shumicën e votave në zgjedhjet për Kuvend, b) Dy anëtarë të partisë tjetër ose koalicionit me numrin më të madh të votave, c) një anëtar nga një parti ose koalicion i tretë, sipas numrit më të madh të votave, d) një anëtar i partisë ose koalicionit të katërt, sipas numrit më të madh të votave e) një anëtar nga partia ose koalicioni i pestë, sipas numrit më të madh të votave, f) një anëtar nga partitë që kanë deklaruar se e përfaqësojnë komunitetin serb në Kosovë dhe g) një anëtar nga partitë që janë deklaruar se i përfaqësojnë komunitetet e tjera, përveç komunitetit shqiptar dhe atij serb.

³⁰⁸ Komuniteti paraqet grupin e njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Kosovës.

kultivojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre dhe karakteristikat e komuniteteve të tyre. Prandaj, përdorimi i këtyre të drejtave i krijon detyrime Kuvendit të Republikës së Kosovës, në veçanti Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve për të vepruar në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, me qëllim të shmangies së çfarëdo diskriminimi dhe për të penguar mohimin e të drejtave të personave të tjerë.

Neni 78.4

1. Duke pasur parasysh këto që u thanë më sipër, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka një numër të autorizimeve të caktuara, siç janë, për shembull, shqyrtimi i projektligjit në aspektin e të drejtave dhe interesave të komunitetit, propozimi i projektligjit dhe masave të tjera të ngjashme; paraqitja e amendamenteve ndaj projektligjit, dhënia e mendimit këshillëdhënës dhe të ngjashme. Megjithatë, paragrafi 4, i cili është objekt i komenteve tona (neni 78 i Kushtetutës), parasheh që Komisioni mundet, jo vetëm me kërkesë të Kuvendit apo Kryesisë, të japë disa mendime dhe propozime të caktuara, por mundet edhe vullnetarisht të propozojë miratimin e disa ligjeve dhe akteve të tjera, miratimi i cilave është përgjegjësi e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve mund ta bëjë këtë me iniciativën e vet, nëse konsideron se miratimi i këtyre ligjeve dhe akteve nën kompetencën e Kuvendit, është i domosdoshëm për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Në lidhje me këtë, me paragrafin e përmendur, parashihet që anëtarët e Komisionit mundën që individualisht t'i paraqesin mendimet e tyre.

Neni 78.5

1. Së fundi, me paragrafin 5 të nenit të cekur, parashihet edhe një tjetër mundësi për të marrë mendimet e nevojshme ose këshillat në procedurën e miratimit të ligjit, si dhe të akteve tjera të ngjashme, që lidhen me të drejtat dhe interesat e pjesëtarëve të komuniteteve të caktuara. Në fakt, duke pasur parasysh se me paragrafin 2 të këtij neni parashihet se çdo anëtar i Kryesisë Kuvendit mund të paraqesë kërkesë që çdo ligj i propozuar t'i drejtohet Komisionit për të drejtat dhe interesat e komuniteteve, Kryesia e Kuvendit mundet me qëllim të marrjes së qëndrimit të duhur dhe vendimin e duhur, të kërkojë mendimin apo këshillën e ndonjë komisioni tjetër ose të një grupi të deputetëve të Republikës së Kosovës, që ka të paktën 10 përfaqësues të popullit.

Neni 79 [Nisma Legjislative]

Nismën për të propozuar ligje, mund ta marrë Presidenti i Republikës së Kosovës nga fushëveprimtaria e saj/tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, ose më së paku dhjetëmjë qytetarë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.

Neni 79

1. Procedurat legjislative iniciohen nëpërmjet ***nismës legjislative dhe dorëzimit të propozimit të ligjit***. E drejta e nismës legjislative dhe e drejta për të propozuar ligje shpesh identifikohen, edhe pse bëhet fjalë për dy terme të ndryshme, si nga aspekti i përmbajtjes, ashtu edhe për nga efekti. Në fakt, këto dy të drejta dallojnë sipas subjekteve që kanë legjitimitet aktiv, gjegjësisht autorizim për të paraqitur një nismë legjislative dhe autorizim që të propozojnë miratimin e një ligji të caktuar; pastaj ato dallojnë edhe për nga përmbajtja e të drejtave të përmendura, veprimi me nismë, respektivisht me propozim, efekti juridik dhe pasojat e shfrytëzimit të këtyre të drejtave, si dhe për nga forma në të cilën këto të drejta shprehen. Për shembull, nëse shikohen subjektet që kanë legjitimitet aktiv, mund të thuhet se e drejta e nismës legjislative (atë të drejtë e ka çdo qytetar dhe çdo person juridik) është më e gjerë se sa e drejta të propozojë ligje (këtë e ka vetëm një grup i përcaktuar qartë i subjekteve). Gjithashtu, sipas përmbajtjes së të drejtave të përmendura, nisma legjislative është e gjerë (ajo paraqet një formë të ushtrimit të së drejtës kushtetuese të qytetarëve që t'ju drejtohen autoriteteve me peticione, kërkesa, propozime dhe të ngjashme) në lidhje me propozimin e ligjit (kjo vlen vetëm për ligjet dhe jo për propozime të tjera drejtuar Parlamentit). Të drejtat e mësipërme dallohen për nga procedura, ashtu që nisma e drejtuar parlamentit shqyrtohet në procedurën paraprake në organin amë të punës, përderisa propozimi për miratim të ligjit nuk shqyrtohet në procedurën paraprake. Së fundi, edhe efekti i këtyre të drejtave është i ndryshëm, sepse me paraqitjen e nismës nuk fillon procesi legjislativ, derisa me paraqitjen e propozimit procesi legjislativ fillon të rrjedhë.
2. rocesi legjislativ dhe aprovimi i ligjit paraqet funksionin më të rëndësishëm të çdo Parlamenti. Si faza të zakonshme të procesit legjislativ, gjithkund më së shpeshti veçohen nisma legjislative, shqyrtimi dhe vendimmarrja për propozimin e ligjit nga organi i Kuvendit (Parlamenti), konfirmimi i tij ose kthimi eventual në Kuvend për rishqyrtim, pastaj shpallja (promulgimi) dhe, së fundi, publikimi i ligjit. Zakonisht, me dispozita kushtetuese parashikohet ndalimi i fuqisë prapavepruese të ligjeve dhe akteve të tjera të përgjithshme, gjegjësisht ndalohet efekti i tyre prapaveprues, pasi që prapaveprimi është përjashtim, sepse ai krijon pasiguri juridike për qytetarët. Në raste të veçanta, vetëm dispozita të caktuara të ligjit mund të kenë efekt prapaveprues, nëse kjo kërkohet nga interesi i përgjithshëm, i përcaktuar me miratimin e vetë ligjit (dispozita e Kodit Penal mund të ketë efekt prapaveprues, në qoftë se ajo është më e butë për kryerësin e veprës). Konfirmimi (i sanksioneve) të ligjit, ushtrimi i vetos pezulluese, gjegjësisht kthimi i ligjit në

parlament për rishqyrtim, si dhe shpallja e ligjit, janë përgjegjësi e kreut të shtetit në procesin legjislativ.

3. Detyra kryesore e përfaqësimit popullor është **miratimi i ligjeve**, por sipas një procedure të përcaktuar, me agjendë paraprakisht të definuar. Praktika ka treguar kudo në botë se organi që miraton ligje, së pari paraqet një **propozim të ligjit** (thuhet edhe projektligj, draft-ligj, bazë ligjore etj.). Në të vërtetë, ky është teksti i plotë i ligjit, ashtu si ata e imagjinojnë, dhe se si do të donin të zgjidhet nga ata që e propozojnë. Përfaqësimi popullor mund të bëjë disa ndryshime të caktuara në propozim, mund të heqë disa pjesë, gjegjësisht disa nene, mund të shtojë diçka që është e përshtatshme, të bëjë një renditje të ndryshme të dispozitave ligjore dhe të ngjashme. Por, sa të punohet në bazë të një projektligji (me kusht që ai projekt të mos hidhet në veprim plotësisht, qysh në fillim), gjithmonë diçka mbetet nga ai. Ai që ka të drejtë të paraqesë projektligjet, padyshim që ndikon në tekstin e ligjit. Ai është bashkëpunëtor në miratimin e ligjit, në të vërtetë i mëparshëm, por prapë se prapë me ndikim.
4. Autoriteti që ka të drejtë të paraqesë propozime të ligjeve, thuhet se ka **iniciativën legjislative** (nga fjala initium-fillim), nga ai fillon procesi legjislativ, kështu që me vetë tekstin e Kushtetutës përcaktohet se kush janë propozuesit e autorizuar të ligjit, gjegjësisht cilat autoritetet kanë nismën legjislative. Ajo u njihet organeve ekzekutive dhe legjislative (ligjvënëse), por jo të gjithëve, por vetëm organeve të përcaktuara qartë. Nga organet ekzekutive, nisma legjislative, më së shpeshti, i takon kreut të shtetit dhe qeverisë, si tërësi (në disa sisteme kushtetuese edhe ministrave veç e veç, por në bazë të kompetencave të veçanta të kreut të shtetit, e cila jepet me dekret, me propozim të atij ministri, i cili do të paraqesë një projektligj në procedurë të mëtejshme legjislative). Nga organi legjislativ, nismën legjislative e kanë Kuvendi si tërësi, grupi i deputetëve (numri i saktë i paraparë i përfaqësuesve të popullit) ose çdo deputet i popullit individualisht. Këtu ka zgjidhje të ndryshme, kështu që në praktikën kushtetuese ka pasur shembuj (ka edhe sot), që të drejtën e nismës legjislative mund ta ketë çdo anëtar individualisht, që mund të çojë në një situatë ku organet legjislative modifikohen nga projektligjet.
5. Duhet të dihet paraprakisht që projektligji ka të paktën pak mundësi suksesi, që të hyjë në këtë proces. Për projektet e qeverisë, kjo supozohet, sepse prapa qeverisë, zakonisht, qëndron shumica e përfaqësuesve të popullit. Projektet e deputetëve kanë gjasa të depërtojnë, nëse ndihmohen nga një pjesë e madhe e kolegëve deputetë. Në të vërtetë, nisma legjislative në raste të tilla rrjedh vërtet nga një anëtar i përfaqësimit popullor dhe ideja e ligjit lind më së pari tek ai. Ai vetë (ose me ndihmën e dikujt) e përpilon tekstin e projektligjit, por që ai projekt të hyjë në procedurë, është e nevojshme të mbështetet nga përkrahja e një numri të deputetëve. Në të njëjtën mënyrë, siç është i nevojshëm për projektligjin e ministrit (në sistemet ku kjo parashihet), autorizimi i kreut të shtetit, për projektin e deputetëve nevojitet mbështetja e një numri të madh të deputetëve të tjerë. Kjo mbështetje është e nevojshme për paraqitjen e një projektligji, por jo për amendamente (propozime për ndryshime dhe plotësime gjatë procesit legjislativ).

6. Në praktikë, shumë rrallë gjejnë shprehje propozimet legjislative të anëtarëve të Kuvendit dhe të vetë Kuvendit. Në fakt, në sistemet parlamentare, Qeveria dhe Parlamenti bashkëpunojnë dhe, si organe të tilla, nuk mund të punojnë njëri pa tjetrin. Parlamenti ia lë qeverisë përgatitjen e projekteve legjislative, ndërsa projektet e anëtarëve të organeve legjislative, zakonisht mund të bëhen ligje, vetëm nëse Qeveria pajtohet me to. Përndryshe, rrallë ndonjë qeveri pranon që projektligjin ta hartojë dhe ta propozojë dikush tjetër, jashtë saj.³⁰⁹ Procedura e miratimit të ligjit (shqyrtimi, paraqitja e amendamenteve, etj.) i lihet rregullimit me anë të Rregullores.
7. Nisma legjislative paraqet fazën e parë të procesit legjislativ dhe, prandaj, nga aty fillon procedura formale e hartimit dhe miratimit të ligjit. Si e tillë, ajo paraqet autorizimin e një subjekti të caktuar, të paraqesë në Parlament një propozim për miratimin apo ndryshimin e ligjit ekzistues. Nisma legjislative mund të paraqitet si një projektligj, gjegjësisht në formën e plotë, të redaktuar të tekstit të ligjit. Gjithashtu, ajo mund të ketë një formë pak a shumë të përpunuar të grupit të ideve rreth ligjit. Përfundimisht, kjo nismë mund të jetë thjesht kërkesë që të miratohet një ligj për një fushë të caktuar. Siç kemi përmendur më lart, bartësi i nismës legjislative është pushteti ekzekutiv dhe ai dominon shumë më tepër, se sa kreu i shtetit. Në praktikë, gjithkund dominon nisma qeveritare, pasi që projektligjet, më së shpeshti përgatiten në vetë ministritë dhe, si propozime të qeverisë, dorëzohen në Parlament. Sigurisht, kjo nismë për miratim të ligjit, mund të vijë edhe nga vetë Parlamenti, gjegjësisht nga anëtarët e tij (iniciativa parlamentare apo e deputetëve) dhe ajo mund të jetë individuale ose kolektive. E para ndodh kur propozuesi i ligjit mund të jetë një deputet individual, kurse tjetra kur të drejtën e propozimit e ka një grup i deputetëve, gjegjësisht një numër minimal i deputetëve ose një grup parlamentar. Në disa sisteme kushtetuese, këtë nismë parlamentare legjislative mund ta kenë këshillat parlamentare, gjegjësisht komisionet, ndërsa në bikameralizmin federal (kuvendi i përbërë nga dy dhoma), të drejtën e nismës legjislative mund ta ketë dhoma e dytë.³¹⁰
8. Kur një projektligj i caktuar vjen në Kuvend, vendimit për ligjin nga ana e organit legjislativ, i paraprin diskutimi për projektligjin e dorëzuar dhe ky diskutim, më së shpeshti bëhet në këshillat përkatës parlamentar, gjegjësisht në komisione, pastaj në plenum të Parlamentit (si në parim, ashtu edhe nen për nen), që më në fund do të votohet ligji në tërësi. Ajo çka e kemi thënë me rastin e komentimit të nenit 77 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me komisionet dhe rëndësinë e

³⁰⁹ Shih më shumë në: Morison, H., (1954), 'Government and Parliament. A Survey From Inside', Oxford University Press:London; Morgenstern, Scott and Nacif, Benito (2002) (eds.), 'Legislative Politics in Latin America. Cambridge Studies in Comparative Politics', Cambridge University Press: Cambridge; dhe John M. Carey, (2008), 'Legislative Voting and Accountability. Cambridge Studies in Comparative Politics', Cambridge University Press: Cambridge.

³¹⁰ Shembull për këtë është Bundesrat (dhoma e lartë) në Gjermani, e cila projektligjet e veta nuk ia referon Bundestagut (dhoma e ultë), por ia dorëzon qeverisë federale, dhe kjo vërteton atë që u tha më lart se shumë shpesh varet nga Qeveria se a do të miratohet një ligj i caktuar nga një nismë parlamentare legjislative.

tyre për punë dhe funksionim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mund të vlejë edhe për shumicën e sistemeve të tjera parlamentare bashkëkohore. Në fakt, rëndësia e organeve punuese parlamentare (këshillave dhe komisioneve) është shumë e madhe në procedurën legjislativë, për shkak se përgatitja, diskutimi dhe përpunimi i projektligjit, së pari, bëhen në ato organe, me ç'rast vëllimi i autorizimeve të tyre mund të jetë shumë i ndryshëm - nga dhënia e mendimit për pranim ose refuzim të propozimit, deri te ndryshimi i propozimit, madje në disa shtete edhe deri te ndalimi që propozimi i ligjit të vijë në plenum të Parlamentit.³¹¹ Këshilli, gjegjësisht komisioni parlamentar, harton raport për projektligjin dhe atë ia dorëzon Parlamentit, me çka përfundon faza e parë e procedurës legjislativë. Çështje me rëndësi të përmendet është që duke marrë parasysh faktin se organet punuese parlamentare, para së gjithash, këshilli përkatës, përfaqëson një lloj "mini parlamenti" (gjegjësisht një pamje të zvogëluar të Parlamentit në plenum), përderisa propozimi i ligjit e fiton mbështetjen e këshillit, ai sigurisht që do të miratohet më vonë në plenumin e Parlamentit. Kjo ndodh për shkak se këshilli, duke marrë parasysh përbërjen e tij, ka rëndësi të madhe politike.

9. Kushtetuta e Republikës së Kosovës rregullon çështjet themelore të procedurës legjislativë. Kështu, në dispozitat e veta ajo parasheh subjektet të cilat kanë të drejtën e nismës legjislativë (neni 79.), shumicën e votave të nevojshme për aprovimin (hartimin) e një ligji (neni 80 paragrafi 1.), shpalljen e ligjit (neni 80 paragrafi 2), veton pezulluese të Kryetarit të Republikës (neni 80 paragrafi 3), shpalljen e ligjit (neni 80 paragrafi 5) dhe hyrjen në fuqi të ligjit (neni 80 paragrafi 6). Sipas dispozitave të Kushtetutës, të drejtën e nismës legjislativë e kanë Kryetari i Republikës së Kosovës, Qeveria, deputetët e Kuvendit dhe qytetarët. Megjithatë, në mënyrë që propozimi i ligjit, të cilin e paraqesin qytetarët, të jetë i vlefshëm, Kushtetuta parashikon që të plotësohet edhe një kusht. Pra, qytetarët nuk e realizojnë këtë të drejtë si të drejtë individuale, por si të drejtë kolektive, ashtu që propozimi i tyre i ligjit është i vlefshëm vetëm nëse mbështetet nga nënshkrimet e më së paku 10.000 qytetarëve, në mënyrën e paraparë me ligj (neni 79).³¹² Përkundër të drejtës së garantuar me Kushtetutë për propozim të ligjeve, vërehet se aktiviteti i Kuvendit në përgatitjen dhe përpunimin e ligjit është vetëm simbolik.
10. Dispozitat kushtetuese mbi nismën për propozimin e legjislacionit i shtjellon më tej Rregullorja e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës (nenet 53-55). Kështu, sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, propozimi për projektligj mund të dorëzohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nga fushë-veprimtaria e tij/saj e punës, Qeveria, deputetët e Kuvendit, komisioni parlamentar, grupi parlamentar dhe së paku gjashtë (6) deputetë, 10.000 qytetarë, në pajtim me ligjin. Këtu mund

³¹¹ Vetëm në disa raste të jashtëzakonshme, në disa vende, siç është rasti me Italinë, komisioni parlamentar ka më shumë kompetenca, të cilat konsistojnë në atë që ai mund të miratojë disa projektligje.

³¹² Në disa sisteme kushtetuese, propozues i autorizuar mund të jenë persona të tjerë, si, për shembull, Avokati i Popullit, Banka Kombëtare dhe të ngjashme. Ata mund të propozojnë ligje vetëm në fushat që janë në kuadër të juridiksionit të tyre, kështu që ata kanë të ashtuquajturën të drejtë të kufizuar për të propozuar ligje.

të shihet se nuk ka dallime ndërmjet të drejtës për nismë legislative dhe të drejtës për të propozuar ligje. Gjithashtu, në qoftë se krahasohen dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 79) dhe të Rregullores së punës (neni 53, paragrafi 1), të cilat flasin për propozuesit e autorizuar, mund të vërehet ndryshimi, për shkak se sipas Kushtetutës, nisma për propozimin e ligjit mund të merret nga Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria, deputetët dhe qytetarët, ndërsa sipas Rregullores, këtë të drejtë e ka edhe komisioni parlamentar, grupi parlamentar dhe së paku gjashtë (6) deputetë. Me sa duket, këtu ka pasur një mosmarrëveshje në përcaktimin e propozuesve të autorizuar, e cila krijon paqartësi dhe konfuzion.

11. Me dispozitat e nenit 53, paragrafi 2 të Rregullores parashihet se projektligji i propozuar nga Presidenti i Republikës, deputetët, komisionet parlamentare, grupet parlamentare, qytetarët, i dorëzohet Qeverisë për mendim, nëpërmjet Kryesisë së Kuvendit. Qeveria duhet të paraqesë me shkrim, mendimin e vet, brenda një muaji nga marrja e projektligjit. Pas kalimit të këtij afati, projektligji i dërgohet Kuvendit për shqyrtim. Me nenin 54 të Rregullores, janë dhënë kushte të caktuara për dorëzimin e projektligjit dhe, kështu, çdo plan duhet të përfshijë: objektivat që synohen të arrihen, një arsyetim të dispozitave të ligjeve, implikimet buxhetore të vitit të parë dhe të viteve të mëvonshme, deklaratat e përafritimit dhe harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe të ngjashme. Çdo projektligj që paraqitet në Kuvend duhet të bëhet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, në letër dhe në formë elektronike dhe Kryesia e Kuvendit, në seancën e saj të radhës, përcakton komisionin funksional (raportues) për të shqyrtuar projektligjin.

Neni 80 [Miratimi i Ligjeve]

- (1) **Ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me këtë Kushtetutë.**
- (2) **Ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi ta ketë nënshkruar brenda tetë (8) ditësh pasi të ketë marrë ligjin.**
- (3) **Nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin në Kuvend, ai/ajo duhet të theksojë arsyet e kthimit të ligjit. Presidenti i Republikës së Kosovës të drejtën e kthimit të një ligji në Kuvend, mund ta ushtrojë vetëm një herë.**
- (4) **Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, vendos për miratimin e ligjit të rikthyer nga Presidenti i Republikës, dhe ligji përkatës konsiderohet i shpallur.**
- (5) **Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda tetë (8) ditësh pas marrjes së ligjit, nuk merr asnjë vendim për shpalljen ose kthimin e tij, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare.**
- (6) **Ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nëse, me vetë këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe.**

1. Që të bëhet një projektligj ligj, duhet të miratohet nga Kuvendi (si organ përfaqësues), në qoftë se është njëdhomësh, gjegjësisht duhet të miratohet nga të dyja dhomat, në qoftë se Parlamenti është dydhomësh. Përveç kësaj, asnjë nga dhomat nuk ka prioritet, në qoftë se dhoma tjetër miraton ligj në barazi të plotë me dhomën e parë. Megjithatë, kjo nuk ndodh në rast se fuqitë legislative të dhomës së dytë janë të diferencuara, gjegjësisht të shkurtuara, siç është rasti, për shembull, me Bundesratin gjerman, i cili në disa ligje mundet vetëm të vërë një veto pezulluese, në procedurën e miratimit të ligjeve të tjera në përgjithësi dhe nuk merr pjesë në miratim, ndërsa te disa ligje, pëlqimi i tij është i nevojshëm. Seanca plenare, ku bëhet diskutimi për projektligjin, dhe rrjedha e kësaj seance, në mënyrë të detajuar rregullohet me Rregulloren e Kuvendit. Sigurisht, parlamentet ndryshojnë sipas mënyrës së diskutimit, por prapë se prapë është ende e mundur të identifikohen disa prej karakteristikave të tyre të përbashkëta.
2. Debati mbi projektligjin zakonisht fillon me paraqitjen e raportit të organeve punuese parlamentare (këshilli, gjegjësisht komisioni) lidhur me propozimin e ligjit, si dhe paraqitjen e ministrit përgjegjës, i cili i paraqet dhe i mbron qëndrimet e Qeverisë në lidhje me propozimin e ligjit. Ky është diskutim i përgjithshëm apo shqyrtim në parim, në të cilën mund të marrin pjesë si deputetët (të gjithë), ashtu edhe përfaqësuesit e Qeverisë dhe të këshillave përkatës. Aty diskutohen qëllimet e miratimit të ligjeve, parimet e përgjithshme, koncepti i ligjit dhe çështje të tjera që janë të një rëndësie vendimtare. Kryetari i Kuvendit e udhëheq diskutimin, duke marrë parasysh agjendën e seancës, si dhe përfaqësimin e barabartë të deputetëve që janë PËR dhe KUNDËR propozimit të ligjit. Ajo që është e rëndësishme të theksohet për debatin në parim është se këtu deputetët përfaqësojnë pikëpamjet e grupeve të tyre parlamentare, ndërsa pas këtij diskutimi, nëse me votim pranohet propozimi i ligjit në parim, fillon diskutimi nen për nen. Për këtë diskutim është karakteristike që mund të shqyrtohet çdo nen i ligjit të propozuar, si dhe amendamentet që parashtrihen për anëtarët individualë.
3. Është interesante të theksohet praktika e disa vendeve, sistemet kushtetuese të të cilave parashohin të ashtuquajturin "lexim të shumëfishtë", gjegjësisht shqyrtimin e propozimit të ligjit. Në fakt, në terminologjinë parlamentare është adoptuar ky emërtim, pasi që sistemi parlamentar zakonisht njihet dy "lexime", edhe pse ka shtete në të cilat parashihen tri "lexime", si, për shembull, në Gjermani. Kjo është diçka që nuk haset aq shpesh në praktikën parlamentare dhe shkurtimisht ne do të shpjegojmë thelbin e këtyre shqyrtimeve të shumëfishta të propozimit të ligjit. *Leximi i parë* ka për qëllim diskutimin ku në parim shqyrtohet propozimi i ligjit, objektivi i tij dhe, në përgjithësi, kuptimi i miratimit të ligjit, pastaj teksti i propozimit i dorëzohet këshillit kompetent të Kuvendit, ndërsa rekomandimet që i bën ky këshill me rastin e propozimit të dorëzuar të ligjit, paraqesin bazë për leximin vijues (të dytë). *Leximi i dytë* paraqet, në fakt, diskutimin kryesor për propozimin e ligjit dhe amendamentet të cilat janë miratuar në këshill, gjegjësisht të cilat eventualisht janë paraqitur në vetë seancën e Kuvendit. Në atë lexim

diskutohet dhe votohet për çdo dispozitë të ligjit dhe për propozimet për ndryshime. *Leximi i tretë* paraqet diskutimin e fundit për çështjet në parim dhe propozimet, kurse pas këtij diskutimi kalohet në votimin përfundimtar.³¹³

4. Kur flasim për seancat plenare, është e nevojshme të pasqyrohet mundësia e paraqitjes së amendamenteve, të cilat mund t'i ushtrojnë, para së gjithash, deputetët, duke marrë parasysh se ata kanë të drejtën e nismës legislative, si dhe të drejtën e fjalës në Parlament. Këtë të drejtë për paraqitjen e amendamenteve e ka edhe Qeveria. Amendamentet zakonisht dorëzohen me shkrim dhe aty mund të kërkohej ndryshimi i ndonjë neni, i një apo më shumë fjalive në nen, shtimi i paragrafëve të ri në nen të ligjit si dhe heqja e një apo më shumë neneve të ligjit. I kushtohet kujdes radhës së paraqitjes së amendamenteve, për shkak se në atë mënyrë diskutohet për to dhe kjo, para miratimit të tekstit të cilit i referohen. Amendamentet, të cilat paraqiten në propozim të ligjit, gjithnjë i drejtohen propozuesit të ligjit, në mënyrë që ai të mund t'i shpjegojë ata. Vetë procedura e vendosjes në lidhje me amendamentet e dorëzuara, në thelb, nuk dallon shumë nga procedura, e cila parashihet për vendimmarrje në lidhje me propozimin e ligjit. Në fakt, diskutimi për amendamentet e paraqitura mbahet në të njëjtën kohë me diskutimin për propozimin e ligjit. Në lidhje me amendamentet gjithashtu diskutohet si në organet punuese parlamentare, ashtu edhe në sesionin plenar të Kuvendit.
5. Një fazë tjetër shumë e rëndësishme në procedurën legislative është vendosja me votim e deputetëve në lidhje me propozimin e ligjit, i cili, sipas rregullit, është *i hapur* dhe me ngritje të dorës ose me anë shfrytëzimit të pajisjeve teknike. Nga kjo rregull, është i mundshëm një përjashtim, kur me Kushtetutë ose me Rregulloren e Parlamentit parashihet votim i *fshehtë* (ose kur Parlamenti e pranon kërkesën e deputetëve që ligji të aprovohet me votim të fshehtë, për shkaqe të caktuara). Më në fund, për propozimin e ligjit mund të votohet edhe me *thirrjen me emër të deputetëve* (gjithashtu, nëse Parlamenti e pranon kërkesën e deputetëve, që të votohet propozimi i ligjit në atë mënyrë, me thirrjen me emër).
6. Shtrohet pyetja se kur ligji miratohet dhe cila shumicë është e nevojshme për miratimin e tij? Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje mund të jepet me një fjali të vetme - ligji i propozuar është i miratuar vetëm me kusht që për miratimin e tij të ketë votuar shumica e deputetëve, e cila është e përcaktuar me Kushtetutë dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit. Pikërisht për shkak se parashihet një numër i ndryshëm i deputetëve për miratimin e ligjit, është thelbësore që, para votimit për të, të përcaktohet nëse ka kuorum, gjegjësisht numër të nevojshëm të anëtarëve për një vendim të vlefshëm. Kjo nevojitet sepse mund të ndodhë që, për shkak të arsyeve të

³¹³ Disa ligje, p.sh. ato për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare bëjnë përjashtim nga ky rregull dhe nuk i nënshtrohen më shumë se një diskutimi. Shih paragrafët 85-87 në *Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, datë 2 shtator 2013, në rastin KO95/13. Parashtruesit: Visar Ymeri dhe 11 anëtarë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit, nr. 04/L-199, për ratifikimin e traktatit të parë ndërkombëtar mbi parimet që rregullojnë procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë dhe Planin e Zbatimit të Marrëveshjes.*

caktuara, (të arsyeshme ose të paarsyeshme, por zakonisht për shkak të pengesave nga ana e opozitës), numri i deputetëve në fillim të seancës dhe gjatë votimit të mos jetë i njëjtë, sepse ndërkohë disa deputetë mund ta braktisin seancën. Kuorumi paraqet numrin minimal të deputetëve që duhet të jetë i pranishëm në seancën parlamentare, në mënyrë që vendimet që ai i merr të jenë vlefshme. Këtë numër të nevojshëm të deputetëve për punë të vlefshme të Parlamentit (kuorum), më së shpeshti e bën shumica mbi gjysmën e numrit të përgjithshëm të deputetëve. Megjithatë, edhe pse ky është një rregull i përgjithshëm, ka përjashtime, ashtu që në disa sisteme kushtetuese për vendimmarrje të vlefshme të Parlamentit, gjegjësisht për ekzistimin e kuorumit, nevojitet prania e vetëm një të tretës së numrit të përgjithshëm të deputetëve. Për këtë arsye, është jashtëzakonisht me rëndësi që të kihet kujdes për praninë e deputetëve, ashtu që kuorumi verifikohet shumë herë gjatë seancës në këtë mënyrë: në fillim të seancës plenare, menjëherë para votimit të propozimit të ligjit, ndërsa mund të verifikohet edhe gjatë vetë procesit të votimit të propozimit të ligjit (nëse këtë e kërkon dikush nga deputetët).

7. Pasi që në pjesën e mëparshme të komentit të këtij neni e kemi vënë në dukje faktin se procedura legjislative mund të zhvillohet në një apo disa faza, ashtu edhe deputetët mund të deklarohen në lidhje me propozimin e ligjit disa herë. Në fakt, anëtarët e Parlamentit votojnë së pari për propozimin e ligjit në parim dhe në këtë mënyrë sqarohen nëse do ta pranojnë projektligjin në parim dhe pastaj të votojnë nen për nen, d.m.th. vendosin për zgjidhje të veçanta nga propozimi dorëzuar i ligjit. Sigurisht, ata votojnë nen për nen, vetëm nëse ndaj zgjidhjeve specifike ligjore dorëzohet amendamente.³¹⁴ Së fundi, anëtarët votojnë për projektligjin në tërësi dhe pastaj deklarohen nëse e pranojnë projektligjin në tërësi.
8. Mënyra e mësipërme e votimit është parashikuar për një trup përfaqësues njëdhomësh (Parlamenti). Megjithatë, në rastin e një trupi përfaqësues dydhomësh ose disadhomësh, projektligji votohet në të dyja dhomat (natyrisht, nëse miratimi i ligjit është në fushëveprimin e barabartë të dhomave), dhe ligji miratohet vetëm nëse merr shumicën e nevojshme në të dyja dhomat e Parlamentit. Anasjelltas, nëse vendimi për miratimin e një ligji i takon autoritetit të pavarur të një dhome, për te votojnë vetëm deputetët e asaj dhome. Sa i përket shumicës së votave të deputetëve të nevojshme për miratimin e ligjeve, shumica e parlamenteve parashikojnë *shumicën e thjeshtë* (më shumë se gjysma e numrit të anëtarëve të pranishëm, me kusht që në një seancë parlamentare të marrin pjesë shumica e të gjithë deputetëve)³¹⁵ ose *shumica absolute* (më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të deputetëve). Shumica absolute paraqet një formë më të rreptë të shumicës, në raport me shumicën relative, por edhe nga ky rregull i përgjithshëm ka disa përjashtime të caktuara, kur për miratimin e disa ligjeve më të rëndësishme

³¹⁴ Kjo do të thotë se votohet nen për nen, vetëm kur pjesëmarrësit në procedurën legjislative sugjerojnë disa zgjidhje të ndryshme nga ato të përfshira në vet projektligjin.

³¹⁵ Siç është cekur në pjesën e mëparshme të këtij komenti, ekzistojnë sisteme kushtetuese të cilat parashohin që në një seancë parlamentare në të cilën miratohet projektligji, duhet të jenë të pranishëm të paktën një e treta e të gjithë deputetëve dhe ligji miratohet, nëse për atë votojnë shumica e deputetëve të pranishëm. Ky është rasti, për shembull, në Austri, Çeki dhe në disa vende të tjera.

(siç janë ligjet themelore, gjegjësisht kushtetutat, ligjet kushtetuese, ligjet organike, etj.), është e nevojshme e ashtuquajtura *shumicë e kualifikuar*. Kjo shumicë e kualifikuar më së shpeshti përcaktohet në vetë Kushtetutën dhe mund të jetë e ndryshme, për shembull, dy të tretat (2/3), katër të pestat (4/5), etj. Përfundimisht, duhet thënë se në disa raste, votimi për projektligjin në parlament nuk është i mjaftueshëm për miratimin e tij, kështu që kërkohet votimi (vendimi) i votuesve në referendumin legjislativ ose votimi (konfirmimi) në parlamentet e njësisve federale (nëse është fjala për shtete të përbëra).

9. Akti i fundit i procedurës legjislative është shpallja e ligjit që është e rëndësishme për atë se kur propozimi i ligjit miratohet në trupin përfaqësues, ai fiton fuqinë ligjore dhe bëhet ligj. Organi kompetent, me aktin e shpalljes së ligjit, e konstaton vullnetin e trupit përfaqësues dhe vërteton se është miratuar ligji, se është bërë ligj dhe është i detyrueshëm për të gjithë dhe për gjithkënd. Natyrisht, kjo shpallje nuk është karakteristike për të gjitha aktet, por akti për shpallje merret vetëm kur bëhet fjalë për aktet ligjore më të rëndësishme, siç janë Kushtetuta dhe ligjet. Me këtë rast duhet të theksohet se institucioni i shpalljes së ligjit, si pjesë përbërëse e procedurës legjislative, e ka origjinën nga *sanksionet legjislative* dhe është ngushtë i lidhur me të, si dhe *me kundërnëshkrim "caunter-signature") dhe me veton legjislative*. Sanksioni legjislativ ka paraqitur të drejtën e sovranit, gjegjësisht monarkut për të vënë nënshkrimin e tij në ligjin që është shpallur në parlament, me çka pushteti legjislativ i Parlamentit ishte i ndarë me sovranin, për shkak se ligji merrte fuqinë juridike vetëm pasi një ligj i votuar nga Parlamenti nënshkruhej nga ai. Në këtë mënyrë, sunduesi me nënshkrimin e tij e kishte sanksionuar një ligj të tillë, që nënkuptonte një lloj ndarjeje të pushtetit legjislativ, derisa sanksioni ligjvënës e kishte efektin e vetos absolute. Kjo e drejtë e qeverisjes u transformua më vonë, ashtu që nga vetoja legjislative u krijuan tri institucione të rëndësishme dhe ato janë: shpallja e ligjit, kundërnëshkrimi dhe vetoja legjislative pezulluese.
10. Pra, akti i shpalljes së ligjit, gjegjësisht dekreti lëshohet nga organi i lartë i qeverisjes shtetërore dhe ky është, sipas rregullit, kreu i shtetit, por ai këtë të drejtë mund ta realizojë në mënyrë të pavarur, ose me nënshkrimin e dytë, gjegjësisht me nënshkrim të kryetarit të trupit ligjvënës (këtu kemi raste me regjime parlamentare, siç është rasti në Hungari). Ky akt i shpalljes së ligjit nxirret në formën e nënaktit ligjor, ku ceket emri i ligjit, autoriteti që e ka miratuar ligjin, seanca e Parlamentit dhe data kur është mbajtur seanca, në të cilën Parlamenti e ka miratuar ligjin.³¹⁶ Nëse është fjala për shtete federale, në të cilat për miratimin e ligjeve të veçanta federale nevojitet pëlqimi i njësisve federale, në aktin e shpalljes së ligjit, duhet të konstatohet, nëse pëlqimi i atyre njësisve, si anëtare të federatës, arrihet me miratimin e ligjit. Me aktin, me të cilin shpallet ligjit (dekreti), do të konstatohet fakti se ligji është marrë në referendumin legjislativ, nëse është e nevojshme. Më në fund, ky akt përmban edhe datën e miratimit, si dhe nënshkrimin e kreut të shtetit.³¹⁷

³¹⁶ Nëse Parlamenti është dydhomësh, në aktin e shpalljes së këtij ligji duhet të cekën dhomat që kanë miratuar ligjin dhe datën e seancave të dhomave në të cilat u miratua ligji.

³¹⁷ Në qoftë se me sisteme të veçanta kushtetuese parashihet edhe instituti i kundërnëshkrimit, akti nënshkruhet nga Kryeministri apo ministri dhe në qoftë se për shpalljen e ligjit kërkohet

11. Ajo çka duhet të theksohet këtu është fakti se këtë dekret, gjegjësisht aktin për shpalljen e ligjit, sipas rregullit, kreu i shtetit e nxjerr në afat të shkurtër, ndërsa në ato sisteme kushtetuese në të cilat kreu i shteti disponon të drejtën e vetos pezulluese, mund ta shfrytëzojë këtë të drejtë pikërisht në këtë afat. Pra, në rast se ai refuzon ta nënshkruajë dekretin, ligji i kthehet Kuvendit për vendim të sërishëm dhe nëse ai e miraton të njëjtin ligj me shumicë votash, kreu i shtetit e miraton aktin për shpalljen e ligjit. Këtu duhet të vihet në dukje se kjo veto legjislative, në fakt, është zhvilluar nga e drejta e sanksionit legjislativ dhe se kreu i shtetit, mundet, duke e zhvilluar këtë të drejtë, ta hedhë në tërësi ligjin i cili është miratuar në Kuvend. Atëherë flasim për ekzistimin e *vetos absolute*, sepse në atë rast kreu i shtetit mund të refuzojë ta nënshkruajë projektligjin, i cili është votuar në Kuvend gjegjësisht atë ligj. Në këtë mënyrë, ai pamundëson që ai ligj të hyjë në fuqi, edhe pse i votuar në Kuvend. Megjithatë, vetoja absolute legjislative është karakteristike për ato sisteme kushtetuese në të cilat është i ndarë pushteti legjislativ ndërmjet parlamentit dhe kreut të shtetit, ashtu që kushtetutshmëria bashkëkohore nuk e njeh këtë lloj të vetos, meqenëse pushteti legjislativ i është besuar Kuvendit në tërësi, si organit më të lartë përfaqësues. Për këtë arsye thuhet se edhe ky institut dhe sanksioni legjislativ (nga i cili është zhvilluar ai) paraqesin relikte, gjegjësisht mbetje të së kaluarës dhe se edhe ato i takojnë historisë së kushtetutshmërisë. Për sistemet kushtetuese bashkëkohore është karakteristike se ato e njohin *veton legjislative pezulluese*,³¹⁸ e cila paraqet të drejtën e kreut të shtetit që ligjin i cili është votuar në Kuvend ta kthejë në rishqyrtim.³¹⁹

edhe nënshkrimi i Kryetarit të Kuvendit, atëherë ai, krahas nënshkrimit të kreut të shtetit, duhet të përmbajë edhe nënshkrimin e Kryetarit të Kuvendit. Kundërnënshkrimin në aktet e kreut të shtetit e vënë ministri i parë ose ministri i sektorit (ose që të dy), ndërsa ligjet e rëndësishme i nënshkruajnë edhe të gjithë anëtarët e Qeverisë, e cila i përgjigjet Parlamentit. Kuptimi kundërnënshkrimit është marrja e përgjegjësisë për këto akte, dhe transferimin e saj në Qeveri, e cila i përgjigjet Parlamentit. Një shembull i kësaj mund të përmendet neni 89 i Kushtetutës së Italisë, i cili parashikon se "çdo akt i Presidentit nuk është i vlefshëm, nëse nuk është i bashkë-nënshkruar nga ministrat, të cilët e propozojnë të mbahen përgjegjës".

³¹⁸ Shembuj për këtë janë të shumtë, por këtu mund të ceket neni 10 i Kushtetutës franceze, sipas të cilit "Presidenti i Republikës shpall ligjet brenda 15 ditëve nga koha kur Qeverisë i është dorëzuar ligji i miratuar përfundimisht. Para skadimit të kësaj periudhe, ai mund t'i kërkojë Parlamentit të votojë përsëri për ligjin ose për disa nene të tij".

³¹⁹ Vetoja absolute ka efekt më të fortë se vetoja pezulluese, pasi që kreu i shtetit (i cili paraqet veto pezulluese) nuk mund të ndalojë miratimin e ligjit, por vetëm mund të vonojë zbatimin e tij, pasi që ka të drejtë të kërkojë rishqyrtim nga Kuvendi të ligjit tashmë të votuar, për arsye të cilat ai duhet t'i specifikojë shprehimisht. Me rastin e vendosjes së sërishme, Kuvendi duhet të marrë parasysh këto arsye, por për miratimin e ligjit duhet të ketë shumicë të kualifikuar, që rezulton që në sistemet dypartiake parlamentare, kjo veto pezulluese legjislative (shpesh) mund të veprojë si një veto absolute. Kjo është për shkak se shumica e kualifikuar për rimiratimin e ligjit në Kuvend është e vështirë të arrihet për shkak se në Kuvend njëra nga partitë politike e ka një shumicë parlamentare. Shih paragrafët 35-77 të *Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës së 20 shtatorit 2012 në rastin nr. KO 57/12 Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e saj Atifete Jahjaga, për kontestimin e votimit për miratimin e Ligjit nr. 04/1-084 "Për pensionet e anëtarëve të forcave të sigurisë," i cili me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës i është kthyer për shqyrtim Kuvendit të Kosovës.*

12. Kur është fjala për miratimin e ligjit, është e nevojshme të thuhet diçka edhe për shpalljen e ligjit, hyrjen e tij në fuqi, si dhe ndalimin e efektit prapaveprues të ligjit. Pra, siç e kemi cekur më lart, fazat e rëndësishme të procedurës legjislative janë miratimi i ligjit në Kuvend dhe shpallja e atij ligji me dekret të kreut të shtetit. Megjithatë, në mënyrë që ai ligj të hyjë në fuqi, duhet që edhe të shpallet, gjegjësisht t'i bëhet i qartë opinionit të gjerë, në mënyrën e saktë paraprakisht të parashikuar në ligj, se ligji me të vërtetë është miratuar. Kjo është e nevojshme sepse subjektet, me të cilat ka të bëjë ligji, duhet të jenë të njoftuara për zgjidhjet e miratuara ligjore, në mënyrë që të mund të harmonizojnë sjelljet e tyre me to. Meqenëse vlejnë rregullat e vjetra të së drejtës romake *ignorantia iuris nocet* (mosnjohja e të drejtave dëmton, mosnjohja e ligjeve nuk të shpëton nga dënimi), respektivisht *ignorantia iuris non excusat* (mosnjohja e ligjit nuk arsyeton), është e nevojshme që ligji, i miratuar në Kuvend, t'i komunikohet publikut.³²⁰
13. Së fundi, është e nevojshme të plotësohet edhe një kusht në mënyrë që ligji, i miratuar në Parlament, i shpallur me dekret të kreut të shtetit dhe i publikuar (për ta njoftuar opinionin në lidhje me përmbajtjen e tij) në gazetën zyrtare të caktuar, të hyjë në fuqi është e nevojshme që nga momenti i publikimit të ligjit e deri në hyrjen e tij në fuqi të kalojë një kohë e caktuar, e cila quhet *vacatio legis*, pritja e ligjit). Sigurisht, kjo kohë ndryshon prej një sistemi kushtetues te tjetri, si dhe nga një ligj te tjetri ligj brenda sistemit të njëjtë kushtetues, (kjo varet nga vetë ligji ose nga përmbajtja e lëndës të cilën e rregullon).³²¹ Gjithashtu, ekziston mundësia që ligji të hyjë në fuqi edhe para skadimit të afatit të përgjithshëm të pritjes së ligjit, por ky është një rast i rrallë dhe zbatohet vetëm në raste të jashtëzakonshme, gjegjësisht në mënyrë kufizuese, nëse janë plotësuar arsyet posaçërisht të justifikueshme, por data e hyrjes në fuqi duhet shprehimisht të parashihet në vetë ligjin. Është e kuptueshme që ligji mundet, në raste të tilla, të hyjë në fuqi më së shpejti të njëjtën ditë kur është publikuar.³²²
14. Një nga vetitë kryesore të ligjit (kjo ka të bëjë edhe me Kushtetutën, pasi që ajo paraqet ligjin themelor të çdo vendi), është që ligji miratohet për të ardhmen dhe pritet që ai të qëndrojë sa më gjatë. Për këtë arsye edhe thuhet se Kushtetuta është akt programor - deklarativ. Pra, edhe pse në esencë ai është tekst pozitiv-ligjor, me të cilin sanksionohet rregullimi i tanishëm kushtetues, për arsye se nga ai pritet që

³²⁰ Sot, në saje të teknologjisë së zhvilluar dhe një numri të madh të medieve, shumë më lehtë se përpara, kur ligjet shkruheshin në panele të caktuara (të bëra nga guri, druri ose metalike), të cilat ekspozoheshin në sheshe dhe vende të tjera publike, në mënyrë që, qytetarët të njiheshin me përmbajtjen e ligjit. Sot është shumë më lehtë, pasi që nga publikimi i ligjit bëhet përmes fletoreve zyrtare të trupave përfaqësues, pastaj në formë elektronike në internet, në media, shtyp dhe botime të veçanta etj.

³²¹ Kur është fjala për gjatësinë e këtij afati, duhet të ceket se, zakonisht, me Kushtetutë përcaktohet afati i përgjithshëm i pritjes, i cili mund të jetë 7, 8, 14, 15, 30 ditë etj., kurse në disa sisteme kushtetuese lihet mundësia që ligji të hyjë në fuqi para skadimit të afatit të përgjithshëm të pritjes ose pas skadimit të tij

³²² Këtu duhet të përmendet rasti i ligjit kushtetues, i cili gjithmonë miratohet në të njëjtën kohë me Kushtetutën (nëse miratohet një, dy ose më shumë ditë më vonë se sa Kushtetuta, kjo është një shkelje e Kushtetutës). Ky ligj miratohet për zbatimin e Kushtetutës dhe për këtë arsye, hyn në fuqi kur edhe Kushtetuta hyn në fuqi.

të vlejë një kohë të gjatë në të ardhmen, shpesh mbi mundësitë reale të shoqërisë së dhënë, në këtë aspekt, krahas si normë e vlefshme, ai është edhe një kushtetutë dhe program për të ardhmen. Si çdo program, edhe programi në Kushtetutë përbën një grup kërkesash të caktuara, për respektimin e të cilave synohet e ardhmja. Situata e njëjtë është edhe me ligjin, edhe pse ai nuk është si kushtetuta, si akt më i përgjithshëm ligjor dhe më parimor, me fuqinë më të madhe ligjore, por gjendet nën kushtetutë dhe duhet të jetë në pajtueshmëri me të dhe shërben për konkretizimin e dispozitave kushtetuese abstrakte (të përgjithshme).

15. Ligjet veprojnë prej ditës kur hyjnë në fuqi, prandaj në pajtim me këtë, në Kushtetutë parashihet shprehimisht ndalimi retroaktiv (prapaveprues) i efektit të ligjit, pasi që një zbatim i tillë i tij do të rezultonte me pasiguri ligjore të qytetarëve. Ky është një rregull i përgjithshëm, por duhet të theksohet se ka përjashtime të caktuara prej tij, të cilat zbatohen vetëm në mënyrë restriktive. Një nga përjashtimet më të shpeshta, i cili është i njohur në shumicën e sistemeve kushtetuese, ka të bëjë me të drejtën penale dhe konsiston që ligjet të cilat rregullojnë këtë fushë mund të kenë efekt prapaveprues, në kushte të caktuara. Pra, shumica e sistemeve kushtetuese parashohin mundësinë që ndaj kryesit të veprës penale të zbatohet një ligj më i butë, gjegjësisht nëse ligji i cili është miratuar pas kryerjes së veprës penale është më i butë për kryesin e veprës penale, ndaj tij do të zbatohet retroaktivisht ky ligj, që është miratuar më vonë (përcaktohen veprat e dënueshme dhe shpallen dënimet për to sipas ligjit i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës, përveç nëse ligji i ri është më i butë për kryesin).

Neni 80.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 80, i cili ka të bëjë me miratimin e ligjit, parasheh që ligjet, vendimet dhe aktet e tjera miratohen nga ana e Kuvendit me shumicë votash të deputetëve të pranishëm (paragrafi 1). Por, nga ky rregull ka përjashtime, në rastet kur kjo Kushtetutë parasheh ndryshe, gjegjësisht kur për miratim, ndryshim dhe plotësim ose për shfuqizim të ligjeve të caktuara nevojitet shumica e votave jo vetëm e deputetëve të pranishëm, por edhe shumica e votave të deputetëve të Kuvendit, të cilët kanë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësim të komuniteteve, të cilat nuk përbëjnë shumicën. Kjo parashihet nëse kemi të bëjmë me ligjet me interes vital (neni 81 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës). Përveç kësaj, me këtë Kushtetutë parashihet shprehimisht që, në disa raste, nevojiten shumica e dy të tretave, gjegjësisht shumica e kualifikuar dhe jo vetëm të deputetëve të pranishëm, por 2/3 e numrit të përgjithshëm të deputetëve të Kuvendit (për shembull zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës - neni 86, paragrafi 4; çdo ndryshim i Kushtetutës - neni 144, paragrafi 2; ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare - neni 18 paragrafi 1).
2. Sidoqoftë, për t'u miratuar ligji, duhet të ndiqet një procedurë e komplikuar legislative, e cila, për shumëçka, dallohet nga procedura legislative, e cila parashihet në sistemet kushtetuese të vendeve të tjera. Kështu, me Rregulloren e punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës (neni 40), së pari, parashihet shqyrtimi i

projektligjeve në Kuvend, sipas radhës së përcaktuar. Pra, në fillim propozuesi i ligjit ua paraqet deputetëve të Kuvendit projektligjin dhe pastaj kryetari ose raportuesi i komisionit funksional paraqet raportin për propozimin e bërë të ligjit. Pas kësaj fjalën e kanë kryetarët e komisioneve të përhershme dhe kryesuesit e grupeve parlamentare. Në rastet kur Qeveria nuk është propozuese e projektligjit, Kuvendi mund të kërkojë deklaram nga Qeveria. Pastaj deputetët tjerë diskutojnë për projektligjin, sipas radhës së përcaktuar nga kryetari i Kuvendit dhe, pas diskutimit të bërë, propozuesi i projektligjit ka të drejtë ta marrë fjalën dhe t'u përgjigjet pyetjeve të mundshme të deputetëve. Në fund, kryetari i Kuvendit e mbyll diskutimin dhe kërkon nga deputetët të deklarohen në lidhje me projektligjin.

3. Në komentimin e mëtejshëm të dispozitave të paragrafit 1 të nenit 80 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, do të shpjegojmë ecurinë e procedurës legjislative, e cila paraqitet në paragrafin paraprak. Pra, karakteristikë për këtë procedurë legjislative është ajo se këtu dallojmë "leximin" e parë, të dytë dhe të tretë".³²³ Leximi i parë (shqyrtimi) i projektligjit nuk mund të bëhet para kalimit të dy javëve të punës dhe as më vonë se katër javë të punës, prej ditës së dorëzimit të tij. Para leximit të parë në seancën plenare, komisioni funksional (raportues), i ngarkuar nga Kryesia e Kuvendit, e shqyrton projektligjin në parim dhe i paraqet Kuvendit raport me rekomandim dhe arsyetim për miratimin ose mosmiratimin në parim të projektligjit. Ky lexim i parë i projektligjit nënkupton diskutimin dhe votimin në parim. Siç kemi theksuar më lart, ai fillon me paraqitjen e projektligjit nga propozuesi i projektligjit, vazhdon me paraqitjen e komisionit funksional, paraqitjen e përfaqësuesve të grupeve parlamentare dhe të deputetëve. Para vënies në votim të projektligjit në parim, propozuesi mund ta tërheqë atë (gjatë shqyrtimit në Kuvend). Nëse projektligji i propozuar aprovohet në parim (me rastin e leximit të parë), Kuvendi e ngarkon për shqyrtim të mëtejshëm të projektligjit Komisionin funksional (si raportues) dhe komisionet e përhershme (Shtojca 2 e Rregullores). Në rast se projektligji i rregullon çështjet nga fushëveprimi i punës së dy komisioneve funksionale, Kuvendi e ngarkon njërin nga ata si komision raportues.
4. Në projektligj, amendamentet mund t'i paraqesë çdo deputet, grup parlamentar, komision parlamentar dhe Qeveria, në afat prej dy javësh të punës prej miratimit në parim të projektligjit dhe amendamentet i drejtohen komisionit funksional, i cili ia paraqet Kuvendit raportin me rekomandime për projektligjin në afat prej dy muajsh, prej shqyrtimit të parë. Në raste të posaçme, ky komision mund të kërkojë nga Kuvendi afat shtesë, deri një muaj, nga paraqitja e raportit. Komisionet e përhershme duhet t'i dorëzojnë raporte komisionit funksional, në afat prej dhjetë ditësh të punës nga dita e pranimit të amendamentit nga ky Komision, si raportues, i cili, pas përfundimit të shqyrtimit, i dorëzon raport me rekomandime Kuvendit. Në raport është përfshirë edhe mendimi i komisioneve të përhershme si dhe deklarimi në lidhje me amendamentet e propozuara nga ana e deputetëve, mandej të vetë Komisionit funksional, grupit parlamentar ose Qeverisë.

³²³ Diku shprehja "lexim" përkthehet si "shqyrtim".

5. Me Rregullore të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës (neni 58) parashihet leximi i dytë (shqyrtimi) i projektligjit, i cili fillon me paraqitjen e raportit të Komisionit funksional, në lidhje me të cilin, të drejtë në diskutim kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfaqësuesit e Qeverisë dhe deputetët. Ky lexim vazhdon me shqyrtimin dhe votimin e amendamenteve të propozuara nga komisionet funksionale (raportuese), si dhe të amendamenteve të propozuara nga komisionet e përhershme, grupet parlamentare, deputetët dhe vetë Qeveria. Amendamentet shqyrtohen dhe votohen një nga një, sipas radhitjes së paraqitur, me tekst të projektligjit. Kur janë të propozuara dy amendamente për të njëjtin nen të projektligjit, që e përjashtojnë njëri-tjetrin, amendamenti i cili merr numrin më të madh të votave, konsiderohet i miratuar.
6. Përfundimisht, me nenin 59 të Rregullores është rregulluar leximi (shqyrtimi) i tretë i projektligjit i cili bëhet kur në leximin e dytë projektligji nuk fiton numrin e nevojshëm të votave për miratim. Leximi i tretë bëhet me kërkesë të propozuesit ose Komisionit funksional, për të cilin vendos Kuvendi. Por, duhet të theksohet se amendamentet që janë shqyrtuar dhe që janë refuzuar në shqyrtimin e dytë ose që janë të ngjashme me amendamentet në shqyrtimin e dytë, nuk mund të propozohen për shqyrtimin e tretë. Procedura e shqyrtimit të amendamenteve plotësuese dhe procedura e shqyrtimit të projektligjit të ndryshuar në leximin e tretë, duhet të jenë në pajtim me nenin 58 të kësaj Rregulloreje.

Neni 80.2

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 80.2, parasheh se ligji i miratuar nga Kuvendi nënshkruhet nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe shpallet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pasi ta ketë nënshkruar brenda tetë (8) ditësh nga marrja e ligjit. Sipas Kushtetutës, (për dallim prej disa sistemeve të tjera kushtetuese), Kryetari i Republikës së Kosovës ka të drejtë të propozojë ligje në pajtim me pozitën në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës. Ai ka të drejta të caktuara në procedurën legjislative dhe është pjesëmarrës në aktivitetin legjislativ, i cili i përgjigjet formës së sistemit parlamentar, në të cilin kreu i shtetit përfaqëson unitet shtetëror, gjegjësisht përfaqëson pushtetin suprem të shtetit dhe unitetin e popullit të Republikës së Kosovës (neni 83) dhe nuk ka kompetenca përfaqësuese. Pra, në aktivitetin legjislativ, kryetari i Republikës merr pjesë në procedurën e cila pason pas miratimit të ligjit. Ai nxjerr dekretin për shpalljen e ligjit në afatin e përcaktuar me Kushtetutë (neni 80, paragrafi 2). Ligji i nënshkruar nga Kryetari i Kuvendit, i dorëzohet Kryetarit të Republikës së Kosovës për shpallje. Dekreti për shpalljen e ligjit është akt i natyrës deklarative dhe aty ceken emrat e ligjeve, autoriteti që i ka miratuar, seanca në të cilën janë miratuar dhe data kur është mbajtur kjo seancë. Fakti se në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës nuk ka kundërnënshkrim dhe të drejtë të vetos legjislative, flasin në favor të konkluzionit se të drejtat e kryetarit të Republikës në procedurën legjislative nuk janë vetëm të natyrës protokollare.

1. Ndër të drejtat më të rëndësishme të Kryetarit të Republikës së Kosovës është vetoja pezulluese, e cila paraqet instrumentin përmes të cilit kryetari i Republikës ka mundësi që drejtpërdrejt të ndikojë në aktivitetin legjislativ dhe të marrë pjesë në ushtrimin e pushtetit legjislativ.³²⁴ Ligji të cilin e ka miratuar Kuvendi i Republikës së Kosovës shpallet nga Kryetari i Republikës në formë të aktit nënligjor, gjegjësisht dekretit për shpalljen e ligjit dhe ai është i obliguar ta bëjë këtë brenda afatit prej tetë (8) ditësh prej ditës së pranimit të tij (neni 80, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës).
2. Para shpalljes së ligjit, Kryetari i Republikës mund të shfrytëzojë të drejtën e vetos pezulluese (neni 80, paragrafi 3). Pra, nëse ia kthen ligjin e votuar Kuvendit, ai duhet t'i përmendë arsyet për kthimin e tij dhe këtë të drejtë mund ta shfrytëzojë vetëm një herë. Kjo do të thotë se kryetari ia kthen ligjin Kuvendit, i cili e ka miratuar, me kërkesën që të vendoset prapë për këtë ligj, por, siç kemi theksuar, është obligim i tij (i përcaktuar me Kushtetutë) që me shkrim t'i përmend arsyet dhe të arsyetojë pse kërkon nga Kuvendi që të vendosë sërish për ligjin (paragrafi 3). Me Rregullore të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës (neni 61) është rregulluar më në detaje nënshkrimi dhe shpallja e ligjit. Kështu, me dispozitat e këtij neni parashihet që, nëse Presidenti i Republikës e kthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryesia e Kuvendit ia dërgon menjëherë komisionit funksional raportues për shqyrtim. Ky komision i shqyrton vetëm çështjet që i përmban kërkesa e Presidentit dhe brenda dy javë pune, nga data e pranimit të tij, ia paraqet Kuvendit raportin me rekomandime.

³²⁴ Këtu nuk mund të mos cekim zgjidhjen e Kushtetutës së SHBA të 1787, e cila është doajene e kushtetutave të botës, meqenëse ka vendosur para më shumë se dy shekujve institute të caktuara të cilat zbatohen edhe sot në një numër të madh sistemesh kushtetuese. Kështu, duke qenë se Kongresi, si trup ligjvënës, ka autorizime të caktuara ndaj Presidentit, ndër të cilat më e njohura është "Vetoja e Kongresit", e cila i mundëson Kongresit të bllokojë disa kompetenca të Presidentit, Presidenti, nga ana e tij, i ka disa mjete të caktuara ndikimi ndaj bartësit të pushtetit legjislativ. Një ndër autorizimet më të njohura të Presidentit të SHBA-së, është e drejta e tij e vetos pezulluese në ligje të Parlamentit (Kongresit). Në fakt, në SHBA, Kongresi çdo ligj të cilin e ka miratuar, ia dorëzon për pëlqim dhe nënshkrim Kryetarit të SHBA dhe, nëse ai pajtohet, e nënshkruan atë. Nëse kjo nuk ndodh, Presidenti nuk do ta nënshkruajë ligjin e miratuar në Kongres, por do t'ia kthejë Kongresit në afat prej 10 ditësh nga dita e paraqitjes për nënshkrim. Në mënyrë që projektligji, i cili është miratuar dhe të cilit Presidenti nuk ia ka dhënë pëlqimin të bëhet ligj, pavarësisht nga qëndrimi i Presidentit, nevojitet që Kongresi prapë ta votojë, por këtë herë me shumicën e dy të tretave në dy dhomat. Nëse Presidenti i SHBA brenda afatit prej 10 ditësh nuk e jep as pëlqimin dhe as nuk e vë veton në ligjin e miratuar në Kongres, ai projektligj automatikisht bëhet ligj edhe pa nënshkrimin e Presidentit, pas skadimit të afatit prej 10 ditësh, prej ditës kur i është dorëzuar Presidentit (dhe sigurisht me kusht që Kongresi të presë, pasi që, nëse në ndërkohë Kongresi e ka përfunduar punën e tij, vendimin me të cilin kryetari nuk pajtohet, praktikisht e "fut në xhep"- në praktikë ky lloj i vetos, e ka efektin e vetos absolute, e njohur me emrin "vetoja e xhepit").

Neni 80.4

1. Konsiderojmë se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në paragrafin 4, neni 80, është pa hollësi, për shkak se nga dispozitat e këtij paragrafi, si dhe nga i tërë neni, nuk mund të arrihet në përfundim nëse Kuvendi i Republikës së Kosovës është i obliguar ta votojë ligjin, të cilin Kryetari i Republikës së Kosovës e ka kthyer në Kuvend për rivendosi. Pra, Kushtetuta në asnjë dispozitë të tekstit të saj nuk kërkon nga Kuvendi që ta votojë përsëri këtë ligj dhe as nuk parasheh shprehimisht që Kuvendi të vendosë nëse do ta votojë përsëri ligjin. Nga vetë teksti i paragrafit 4 mund të arrihet në përfundim se Kuvendi me shumicë votash të deputetëve të tij, gjegjësisht të numrit të përgjithshëm të deputetëve të trupit përfaqësues (shumica absolute) vendos për ligjin të cilin Kryetari i Republikës ia ka kthyer Kuvendit. Nëse ligji e merr shumicën e nevojshme, gjegjësisht nëse Kuvendi me shumicë absolute të votave i miraton rekomandimet e komisionit funksional në lidhje me vërejtjen e Kryetarit të Republikës, ligji konsiderohet si i miratuar, ndërsa Kryetari është i obliguar që ta shpallë atë. Në të kundërtën, nëse Kuvendi nuk i miraton rekomandimet e Komisionit funksional në lidhje me vërejtjen e kryetarit, gjegjësisht nëse nuk sigurohet shumica e nevojshme, ligji mbetet i njëjtë siç ka qenë i miratuar nga Kuvendi dhe konsiderohet si i miratuar.

Neni 80.5

1. Por, nëse Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda afatit të paraparë me Kushtetutë (8 ditë pas marrjes së ligjit), nuk e shpall ligjin ose nuk ia kthen Kuvendit, ligji konsiderohet i shpallur, pa nënshkrimin e saj/tij dhe publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (neni 80, paragrafi 5). Në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës publikohen, përveç ligjeve të miratuara nga Kuvendi dhe të shpallura nga Kryetari i Republikës (më parë nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara), gjithashtu edhe rezolutat e miratuara në Kuvendin e Kosovës, rregullat dhe aktet e tjera normative të Qeverisë së Kosovës dhe të ministrive, si dhe marrëveshjet e karakterit ndërkombëtar. Gazeta Zyrtare publikohet në gjuhën shqipe, serbe, angleze, turke dhe boshnjake. Në rast të mospërputhjes së versioneve në gjuhë të ndryshme, mbizotëron gjuha origjinale në të cilin është shkruar dokumenti.

Neni 80.6

1. Me paragrafin e fundit të këtij neni, i cili është temë e këtij komenti (neni 80, paragrafi 2) parashihet që ligji të hyjë në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare. Në raste të jashtëzakonshme, për shkak të arsyeve jashtëzakonisht të justifikuar, gjegjësisht në rastet kur me vetë ligjin përcaktohet ndryshe, hyrja në fuqi e ligjit të miratuar dhe të shpallur, mund të bëhet edhe më herët. Koha e cila duhet të kalojë prej publikimit deri te hyrja në fuqi, e ashtuquajtur *vacatio legis* (pritja e ligjit) është 15 ditë.³²⁵

³²⁵ Sipas rregullit, në shumicën e sistemeve kushtetuese, kjo periudhë është 8 ditë.

Neni 81 [Legjislacioni me Interes Vital]

- (1) Për miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve në vijim, kërkohet vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe të shumicës së deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garan-tuara për përfaqësuesit e Komuniteteve që nuk janë shumicë:
1. ligjet të cilat ndryshojnë kufijtë e komunave, themelojnë ose shuajnë komuna, përkufizojnë shtrirjen e pushteteve të komunave dhe pjesëmarrjen e tyre në marrëdhëniet ndërkomunale dhe tejkufitare;
 2. ligjet të cilat zbatojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara me Kushtetutë;
 3. ligjet për përdorimin e gjuhëve;
 4. ligjet për zgjedhjet lokale;
 5. ligjet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore;
 6. ligjet për liritë fetare ose për marrëveshjet me komunitetet fetare;
 7. ligjet për arsimin;
 8. ligjet për përdorimin e simboleve, përfshirë simbolet e komuniteteve dhe për festat publike.
- (2) Asnjëri nga ligjet me interes vital, nuk mund t'i nënshtrohet referendumi.

Neni 81

1. Me këtë nen parashikohet situata kur kemi të bëjmë me miratimin, ndryshimin ose shfuqizimin e ligjeve me interes vital. Atëherë, për shkak të rëndësisë së tyre, kërkohet një shumicë e veçantë, gjegjësisht vota e shumicës së deputetëve të Kuvendit, si dhe e shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë. Këto ligje me interes, gjegjësisht me rëndësi vitale, shprehimisht numërohen në nenin 81 dhe do të analizohen në veçanti në komentimin e këtij neni. Këtu është e rëndësishme se me dispozitat kushtetuese parashihet edhe pamundësia e nënshtimit të referendumi të çfarëdo ligji me interes vital.

Neni 81.1

1. Krahas llojeve të ndryshme të mbrojtjes, Kushtetuta parasheh edhe mbrojtjen e komuniteteve në procesin legjislativ, ashtu që, krahas garantimit të përfaqësimit të komuniteteve në institucionet publike, i mbron edhe të drejtat e pakicave në procesin e lartpërmendur. Ligjet e caktuara, ku bëjnë pjesë: 1) ligji për kufijtë administrativë të komunave; 2) Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës; (3) Ligji për Përdorimin e Gjuhëve; (4) Ligji për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës; (5) Ligji për Trashëgiminë Kulturore; (6) Ligji për Lirinë Fetare në Kosovë; (7) Ligji për Arsimin Fillor dhe të Mesëm; (8) Ligji për Arsimin e Lartë; (9) Ligji për Aftësim dhe Trajnim profesional; (10) Ligji për Arsim në Komunat e Republikës

së Kosovës; (11) Ligji për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës dhe (12) Ligji për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës, konsiderohen si ligje me interes vital. Kjo do të thotë se miratimi, shfuqizimi, ndryshimi ose plotësimi i këtyre ligjeve kërkon një procedurë më të komplikuar, e cila ndryshon nga miratimi i të ashtuquajturve *ligjeve të 'zakonshme'* (miratohen nga Kuvendi me shumicë të votave të deputetëve të pranishëm, ose në rastet kur me Kushtetutë kërkohet ndryshe - neni 80 paragrafi 1), por edhe nga miratimi dhe ndryshimi i *Kushtetutës*, si ligj themelor më i rëndësishëm (neni 144, paragrafi 2) si dhe ratifikimi i *marrëveshjeve ndërkombëtare*, që kanë të bëjnë me çështjet e përmendura në nenin 18, paragrafi 1.

2. Pra, ndryshimi dhe miratimi i Kushtetutës bëhet vetëm në bazë të dy të tretave (2/3) votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, duke i përfshirë 2/3 e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara për përfaqësues të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë (neni 65 pika 2). Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me çështjet e përmendura në nenin 18 paragrafin 1 të Kushtetutës (territori, paqja, lidhja, çështjet politike dhe ushtarake, të drejtat dhe liritë themelore, anëtarësinë e Republikës së Kosovës në organizatat ndërkombëtare, marrjen e përgjegjësisë për detyrimet financiare nga Republika e Kosovës, gjegjësisht ngarkimi i shtetit), bëhet, për dallim prej Kushtetutës, me dy të tretat (2/3) të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Miratimi, shfuqizimi, ndryshimi ose plotësimi i *ligjeve me interes vital* bëhet me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm të Kuvendit dhe shumicën e votave të deputetëve të pranishëm të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë (neni 81, paragrafi 1).
3. Kur është fjala për interesat vitale kombëtare, duhet të ceket se ato dallohen prej një sistemi kushtetues në tjetrin. Megjithatë, më së shpeshti në këto interesa bëjnë pjesë: 1) realizimi i të drejtave, si të popujve konstituiiv, ashtu edhe të komuniteteve pakicë (pakicave kombëtare), që të jenë të përfaqësuar në mënyrë adekuate në organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor; 2) ruajtja e veçantive dhe identitetit të popujve konstituiiv dhe komuniteteve pakicë (pakicave kombëtare); 3) pjesëmarrja e duhur në miratimin dhe ndryshimin e kushtetutës; 4) pjesëmarrja në ushtrimin e pushtetit publik dhe formimin e organeve të saj; 5) pjesëmarrja e duhur në procesin e marrjes së vendimeve, 6) arsimi, religjioni, gjuha, kultivimi i kulturës, respektimi i traditës dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore; 7) organizimi territorial dhe vetëqeverisja lokale; 8) sistemi i informimit publik; 9) barazia në udhëheqjen e çështjeve publike; 10) barazia para ligjit; 11) zhvillimi i frymës së tolerancës dhe çështje të tjera të cilat do të mund të trajtoheshin si çështje me interes vital kombëtar, në pajtim me kërkesat e disa sistemeve kushtetuese individuale.
4. Të gjitha këto dispozita si më sipër, të cilat normojnë mbrojtjen e interesave vitale nacionale, kanë për qëllim që, nga njëra anë, të konstitujnë dhe të mbrojnë institucionet dhe praktikat e një shteti multikulturor dhe multietnik,³²⁶ dhe, nga ana

³²⁶ Shih më tepër për këtë në: Kymlicka, W., (1995), '*Multicultural Citizenship*', Clarendon Press: Oxford.

tjetër, t'i konsolidojnë këto struktura, duke ruajtur pluralizmin kulturor të shoqërisë. Megjithatë, në këtë pikë, me të drejtë shtrohet pyetja se sa kjo u përgjigjet standardeve evropiane të pluralizmit. Për atë që është e mundur që praktika evropiane e pluralizmit të sistematizohet, ne mund të themi se ka dy drejtime: njëri është tradicional, i cili është në shumicën e vendeve kushtetuese nacionale dhe i cili, duke u mbështetur në parimin e ndarjes klasike të shtetit dhe të shoqërisë, ndërton shoqërinë bazuar në një konkurrencë të pavarur dhe të lirë të fuqive shoqërore, tjetri është i ri, në vartësi të pluralizmit të brendshëm kulturor, që ka për qëllim të mbrojë pakicat kulturore, fetare, gjuhësore dhe sociale.³²⁷

Neni 81.2

1. Me paragrafin 2 të nenit 81, që është temë e komentit tonë, parashihet një dispozitë shumë e rëndësishme, e cila përcakton se asnjë ligj me interes vital (për të cilët tanimë është folur), nuk mund të jetë objekt i referendumit. Pra, duke marrë parasysh se referendumi është institucion, me ndihmën e të cilit elektorati, përmes votimit të drejtpërdrejtë, shpreh pikëpamjen ose vullnetin e vet, në raport me masat, të cilat një qeveri tjetër tanimë i ka ndërmarrë ose ka për qëllim t'i ndërmarrë, ky paragraf tregon rëndësinë të cilën Kushtetuta e Republikës së Kosovës ua jep ligjeve me interes vital. Prandaj, ato nuk mund të jenë subjekt i deklaramit të drejtpërdrejtë të qytetarëve për dy alternativat e ofruara ("PËR" dhe "KUNDËR").

Neni 82 [Shpërndarja e Kuvendit]

(1) Kuvendi shpërndahet në këto raste:

1. nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria;
2. nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve, shpërndarja bëhet me dekret të Presidentit të Republikës së Kosovës;
3. nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjes, nuk zgjidhet Presidenti i Republikës së Kosovës.

(2) Kuvendi mund të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas votimit të suksesshëm të mosbesimit të Qeverisë.

³²⁷ Shih më shumë, në: Smootha, Sammy and Hanf, Theodor, (1992) "The Diverse Modes of Conflict-Regulation in Deeply Divided Societies". *International Journal of Comparative Sociology* (Publisher: BRILL), Volume 33, Numbers 1-2, fq. 26-47 (22); Easterly, Russell William, (2000), 'Can Institutions Resolve Ethnic Conflict?.', The World Bank Research Development Group Macroeconomics and Growth: Washington, November; dhe Reynolds, Andrew (2002), 'The Architecture of Democracy: Constitutional Design, Conflict Management and Democracy' Oxford University Press: Oxford.

1. Mandati i rregullt i Kuvendit përfundon me përfundimin e mandatit të vet, gjegjësisht të periudhës për të cilën janë zgjedhur deputetët si anëtarë të trupit përfaqësues. Megjithatë, para përfundimit të rregullt të kësaj periudhe, mandati i Kuvendit mund të përfundojë me shpërndarjen e tij nga pushteti ekzekutiv. E drejta kushtetues krahasuese dhe praktika parlamentare parashikojnë situata të ndryshme që mund të çojnë në shpërndarjen e Kuvendit dhe një nga arsyet më të shpeshta është pamundësia e formimit të qeverisë brenda një kohe të arsyeshme (kjo pamundësi, në shumicën e rasteve, është shprehje e një strukture politike jashtëzakonisht heterogjene të Parlamentit dhe në situata të tilla zgjidhja kërkohet në zgjedhjet e reja). Një shembull të tillë të shpërndarjes për arsyet e dhëna japin Polonia, Kroacia dhe vende të tjera, kur në afatin e paraparë kushtetues, pas zgjedhjeve dhe konstituimit të Kuvendit të ri, nuk arrihet zgjedhja e Qeverisë ose votimi i buxhetit. Përveç kësaj, arsyeja për shpërndarjen e Kuvendit mund të jetë ndërprerja e bashkëpunimit ndërmjet tij dhe Qeverisë, mocioni i njëpasnjëshëm i mosbesimit të Qeverisë brenda një kohe të shkurtër (Rusia, Hungaria, Sllovenia, etj.), refuzimi i shpeshtë i propozimeve të Qeverisë, mungesa e kuorumit në mbledhjet e Kuvendit në një periudhë të caktuar kohore (Sllovakia, Republika Çeke, etj.).
2. Sigurisht, si një arsye shumë e rëndësishme përmendet bllokada e punës së Parlamentit, që mund të ndodhë për shkak të pamundësisë së vendimmarrjes, të cilën e shkakton pengimi i opozitës në parlament. Së fundi, edhe Qeveria vetë, e cila gëzon besimin e Kuvendit, mund të propozojë shpërndarjen e vet, në mënyrë që, pas zgjedhjeve të reja, t'i mundësojë vetes përkrahje më të qëndrueshme nga shumica në Parlament. Ka edhe raste të përtëritjes së pjesshme të përbërjes së dhomave të Parlamentit, por si rregull, vetëm kur kemi të bëjmë me dhomën e dytë, të lartë (për shembull, në Shtetet e Bashkuara zgjidhen çdo dy vjet, 1/3 e Senatit, mandati i të cilit përndryshe është 6 vjet).
3. Shpesh shtrohet pyetja se përse ndodh pushimi i hershëm i mandatit të Parlamentit (në ato raste kjo ndodh kundër vullnetit të Parlamentit), për të cilin është zgjedhur dhe çfarë është natyra e shpërndarjes së këtij trupi përfaqësues. Përgjigja e kësaj pyetjeje gjendet në shpjegimin se kjo shpërndarje paraqet një lloj sanksioni për vetë Parlamentin, i cili është në pamundësi për t'i kryer detyrat e veta, për arsyet që i kemi përmendur në paragrafin paraprak. Nëse ndodh shpërndarja, Parlamenti pushon punën e tij dhe, për të fituar një përbërje të re parlamentare, duhet të shpallen zgjedhjet menjëherë pas kësaj shpërndarjeje. Zgjedhjet për Kuvendin e ri (zgjedhjet e parakohshme) duhet të mbahen brenda afateve të përcaktuara me Kushtetutë dhe ai zakonisht është më i shkurtër se afati për zgjedhjet e rregullta.
4. Sigurisht që është shumë e rëndësishme të mbrohet Parlamenti nga keqpërdorimet e mundshme të shfrytëzimit të mundësive për shpërndarjen e tij, posaçërisht nëse Parlamenti nuk ka një shumicë të qëndrueshme parlamentare. Kështu, në disa sisteme kushtetuese individuale (të cilat, megjithatë nuk janë aq të shumta), siç janë Gjermania, Austria, Spanja dhe në disa vende tjera, ekziston e ashtuquajtura

vetë konstruktive e mosbesimit ndaj Qeverisë, me të cilën mbrohet stabiliteti i Parlamentit, duke hequr një nga arsyet e shpërndarjes së tij. Në fakt, kjo votë mosbesimi ndaj Qeverisë nuk është arsye për shpërndarjen e Parlamentit (kuvendit) dhe në disa sisteme kushtetuese, stabiliteti parlamentar mbrohet edhe me kufizim, sipas të cilit Parlamenti (për të njëjtën arsye), mund të shpërndahet vetëm një herë gjatë mandatit.³²⁸

5. Megjithatë, këtu duhet të theksojmë faktin se shpërndarja e Kuvendit (Parlamentit), mund të ndodhë në dy raste, përkatësisht: 1) në rrethana të caktuara, të cilat janë të përcaktuara me aktin më të lartë juridik të përgjithshëm, gjegjësisht me Kushtetutë (në bazë të Kushtetutës, *ex constitutionem*); 2) mbi bazën e vendimeve të marra nga vetë Kuvendi (e ashtuquajtura vetëshpërndarje). Sigurisht, duhet të theksohet se kur kemi të bëjmë me Parlamentin dydhomësh, është e zakonshme që të shpërndahet vetëm Dhoma e Ulët (dhoma e qytetarëve). Megjithatë, në praktikën kushtetuese krahasuese mund të gjenden shembuj kur ndodh shpërndarja e dy dhomave të Kuvendit, siç është rasti në Holandë, Belgjikë, Poloni, etj. Vetëshpërndarja e Kuvendit paraqet një formë të veçantë, të cilën e gjejmë në një numër të vogël sistemesh kushtetuese, të tilla si Austria,³²⁹ Polonia, Hungaria, Bullgaria, Kroacia e të tjera.³³⁰ Në një rast të tillë, Kuvendi shpërndahet sipas zgjedhjes së vet, me shumicë të kualifikuar të deputetëve.
6. Në kushtetuta shpesh përmenden situata kur nuk ekziston mundësia e shpërndarjes së Kuvendit, pa marrë parasysh se për çfarë arsyes bëhet fjalë e të cilat janë shkas për këtë shpërndarje. Për këtë arsye, në tekstin kushtetues saktësisht përmenden rrethanat në të cilat organi përfaqësues nuk mund të shpërndahet në asnjë rast, edhe në qoftë se paraqitet ndonjëra nga arsye për këtë. Pra, Kuvendi nuk mund të shpërbëhet gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, gjatë kohës së regjencës të monarkitë dhe periudhës së caktuar kohore pas konstituimit para skadimit të mandatit për të cilin ishte zgjedhur (kjo periudhë, zakonisht, zgjat prej 3 ose 6 muaj).³³¹ Këto arsye që ndalojnë shpërndarjen e Kuvendit janë më të shpeshta në

³²⁸ Ky rast parashihet me Kushtetutën austriake, në nenin 29 të saj, paragrafi 1, sipas të cilit kryetari mund ta shpërndajë Këshillin Kombëtar, por vetëm një herë për të njëjtën arsye

³²⁹ Në bazë të nenit 29 paragrafi 1 Kushtetutës së Austrisë, Këshilli Kombëtar mundet, para skadimit të afatit të mandatit, të vendosë për shpërndarjen e tij, duke e miratuar ligjin përkatës.

³³⁰ Kushtetuta e mëparshme e Republikës Federative të Jugosllavisë e prillit 1992, vetëm disa muaj pas miratimit të saj, në shtator të të njëjtët vit, e miratoi një amendament për një lloj vetëshpërndarjeje të Kuvendit Federativ, me të cilin Kushtetuta, prej Kushtetutës kodifikuese u bë Kushtetutë jo-kodifikuese. Ky është rasti i miratimit të një vendimi të Kuvendit për kohë të shkurtër të mandatit të saj siç është paraparë me Kushtetutë (Amendamenti I i Kushtetutës së Republikës Federative të Jugosllavisë e vitit 1992).

³³¹ Ka shumë shembuj për këtë, por po e përmendim Kushtetutën e Francës, sipas së cilës, Kuvendi Nacional nuk mund të shpërndahet gjatë kohës së ushtrimit të kompetencave të jashtëzakonshme (neni 16. para 5.) dhe Kushtetutën e Belgjikës, sipas së cilës "kur mbreti vdes, dhomat takohen pa ftesë, më së largu dhjetë ditë pas vdekjes. Nëse dhomat ishin të shpërndara para kësaj... dhomat e vjetra i marrin funksionet deri në takimin e dhomave, të cilat do të vijnë në vendin e tyre" (neni 79. para 1.). Gjithashtu është një zgjidhje karakteristike Kushtetutës së Hungarisë, sipas së cilës Parlamenti gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ose në rast të situatës

kushtetutshmërinë krahasuese, por përveç tyre, në sisteme të ndryshme kushtetuese hasen edhe rrethana të tjera, për shembull, në Rusi, ku Kuvendi nuk mund të shpërndahet gjatë procesit të ndërrimit të Kryetarit të Republikës.

7. Megjithatë, në qoftë se paraqiten disa nga arsyet e parapara me Kushtetutë për shpërndarjen e Kuvendit, vendimin për shpërndarje e merr kreu i shtetit, ndërsa propozimin për të nxjerrë një vendim të tillë e paraqet Qeveria, me kusht që propozimi të justifikohet mirë. Një vendim të tillë kreu i shtetit mund ta marrë, ose në mënyrë të pavarur, ose në konsultim dhe bashkëpunim me subjektet e tjera, gjegjësisht bartësit e jetës politike të shtetit.³³²

Neni 82.1

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e rregullon mandatin e deputetëve (neni 70), kohëzgjatja e mandateve (neni 66, paragrafi 1), dhe shpërndarjen e Kuvendit (neni 82). Kuvendi i Kosovës zgjidhet për një mandat katërvjeçar nga data e seancës konstituive, që mbahet brenda 30 ditëve nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve.
2. Sidoqoftë, mandati i deputetëve mund të jetë edhe më i shkurtër, nëse Kuvendi shpërndahet para mandatit, për të cilin është zgjedhur. Mënyra e parë e shpërndarjes së Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas Kushtetutës (neni 82 paragraf 1 pika 1), është kur ai shpërndahet *ex constitutionem*, nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e caktimit të mandatarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nuk mund të formohet Qeveria. Presidenti e shpërndan Kuvendin me dekret dhe është i obliguar ta nxjerrë një dekret të tillë në të gjitha rastet e parapara me Kushtetutë, ndërsa sipas nenit 84 pika 3, Presidenti shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e parë të tij. Në rast të shpërndarjes së Kuvendit sipas Kushtetutës, gjegjësisht *ex constitutionem*, zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare, si rregull, duhet të përfundojnë në një kohë më të shkurtër se periudha në të cilën mbahen zgjedhjet e rregullta. Megjithatë, ky nuk është rasti sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilës zgjedhjet e rregullta për Kuvend mbahen më së voni tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit, kurse në rastet e shpërndarjes së Kuvendit, jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërndarjes (neni 66, paragrafi 2).

emergjente, nuk mund të vendosë për shpërndarjen e vet dhe askush nuk mund ta shpërndajë (neni 28. para 1.). Kjo Kushtetutë përmban edhe dispozitën, sipas së cilës kryetari i Republikës gjatë kohës së luftës, rrezikut të luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, nuk mund ta thërrasë Parlamentin, i cili ishte shpërndarë para kësaj (neni 28. para 3.). Edhe Kushtetuta e Spanjës e ndalon shpërndarjen e Kuvendit, nëse është në procedurë propozimi për mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë.

³³² Kështu, për shembull, Kushtetuta e Hungarisë parasheh që Kryetari i Republikës duhet, para shpërndarjes së Parlamentit, të kërkojë mendimin e Kryeministrit, kryetarit të Parlamentit dhe kryesuesve të grupeve të deputetëve, të cilët i kanë përfaqësuesit e tyre në parlament (neni 28. paragrafi 5.).

3. Një tjetër mënyrë e shpërndarjes së Kuvendit është ajo në bazë të dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës (neni 84, paragrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës), të cilin ai e nxjerr nëse për shpërndarjen e Kuvendit votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve (neni 82, paragrafi 1, pika 2 i Kushtetutës). Kjo do të thotë se ky është një lloj i vetëshpërndarjes së Kuvendit, por me të ashtuquajturën shumicë të "kualifikuar", gjegjësisht me dy të tretat e të gjithë deputetëve të trupit përfaqësues.
4. Arsyeja e tretë, shumë karakteristike, për shpërndarjen e Kuvendit paraqitet nëse brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e fillimit të procedurës së zgjedhjeve, nuk zgjidhet Presidenti i Republikës së Kosovës (neni 82, paragrafi 1, pika 3 e Kushtetutës). Me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës (neni 27), është rregulluar në detaje zgjedhja e Presidentit. Në të vërtetë, Presidentin e Republikës së Kosovës e zgjedh Kuvendi me votim të fshehtë, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të tij. Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve të Kuvendit, por, nëse asnjë kandidat nuk e merr këtë shumicë të votave në dy votimet e para, zhvillohet votimi i tretë mes dy kandidatëve, të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave në votimin e dytë. Kandidati që e merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve në votimin e tretë, zgjidhet President i Republikës së Kosovës.³³³ Nëse edhe në votimin e tretë asnjëri nga kandidatët nuk zgjidhet President i Republikës, Kuvendi shpërndahet, ndërsa zgjedhjet e reja për Kuvend mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditëve nga dita e shpërndarjes së Kuvendit.

Neni 82.2

1. Në paragrafin paraprak, 1 të nenit 82 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përmenden tri situata, kur domosdo ndodh shpërndarja e Kuvendit dhe këto raste përfshihen në pikat 1, 2 dhe 3. Megjithatë, paragrafi 2 i këtij neni është shumë karakteristik, sepse Kuvendi i Republikës së Kosovës mundet (por jo domosdoshmërisht) të shpërndahet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, nëse ndodh votimi i mosbesimit ndaj Qeverisë. Siç dihet, Kuvendi është bartës i pushtetit legjislativ, kurse Presidenti i Republikës dhe Qeveria janë bartës të pushtetit ekzekutiv (ekzekutivi bicefal). Meqenëse zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës rregullohet me nenin 86 të Kushtetutës, sipas dispozitave, të këtij neni, atë e zgjedh Kuvendi me votim të fshehtë (paragrafi 1) dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.

³³³ Ky është një sistem i ngjashëm zgjedhor, që aplikohet edhe për zgjedhjen e deputetëve të Kuvendit me sistemin e shumicës. Në fakt, si mund të ndodhë që asnjë kandidat nuk merr një shumicë absolute (sipas të cilit zgjedhjet i fiton një kandidat, i cili ka marrë një votë më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të votave), në të cilin rast votohet përsëri. Në votimin e dytë, do të zgjidhet kandidati i cili fiton një shumicë relative. Megjithatë, në raundin e dytë mund të aplikohet i ashtuquajturimi sistem "balotazh i pastër" (ballottage), përkatësisht lista e ngushtë, sipas të cilit në atë raund bëhet zgjedhja në mesin e dy kandidatëve të cilët në raundin e parë kanë fituar shumicën e votave, në mënyrë që njëri prej tyre pashmangshëm merr shumicën absolute të votave.

(paragrafi 2), me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Gjithashtu, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka një rol të rëndësishëm zgjedhor në aspektin e formimit të Qeverisë, gjegjësisht zgjedh Qeverinë dhe mund të shprehë mosbesimin ndaj saj (neni 65, pika 8), pasi që atij i besohet kontrolli, gjegjësisht funksioni mbikëqyrës ndaj punës së Qeverisë dhe institucioneve të tjera publike. Marrëdhënia mes Presidentit dhe Qeverisë, si bartës të pushtetit ekzekutiv, është mjaft e afërt, sepse President i Republikës e cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën në Kuvend (neni 84, pika 14 e Kushtetutës).

2. Mirëpo, në pajtim me dispozitat e nenit 30 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, me propozimin e një të tretës (1/3), respektivisht 40 deputetëve të Kuvendit, mund të jepet mocioni i mosbesimit për Kryeministrin. Ky propozim, i nënshkruar nga një numër i caktuar i deputetëve, pranohet, kur për të voton shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit, që do të thotë gjysma plus një, respektivisht 61 deputetë. Mocioni i mosbesimit vihet në rend dite jo më vonë se pesë (5) ditë e jo më herët se dy (2) ditë, nga dita e parashtrimit të tij. Në qoftë se mocioni për mosbesim ndaj Qeverisë nuk merr shumicën e nevojshme, mund të paraqitet një mocion i ri, vetëm pas 90 ditëve.
3. Përveç, deputetëve të Kuvendit të Republikës, vetë Kryeministri mund ta kërkojë votëbesimin për Qeverinë (neni 31 i Rregullores). Siç pamë në paragrafin paraprak, mocionin për mosbesim për Qeverinë (që është plotësisht e zakonshme), e paraqet një numër i caktuar i deputetëve në Kuvend, ndërsa në mënyrë që Qeveria të humbë besimin e Kuvendit, nevojitet që atë propozim ta miratojë shumica e njëjtë e deputetëve, e cila nevojitet edhe për zgjedhjen e Qeverisë (shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit - neni 95 paragrafi 3 i Kushtetutës). Megjithatë, mund të ndodhë që edhe vetë Qeveria, në rastin e Republikës së Kosovës, kreu i Qeverisë, mund të shtrojë çështjen e mosbesimit në Kuvend. Kjo bëhet në mënyrë që Qeveria, në atë mënyrë, të bëjë presion mbi Kuvendin, por nëse nuk e fiton numrin e nevojshëm të votave, si rastet paraprake, e humb besimin e Kuvendit. Humbja e besimit të Kuvendit Republikan, e obligon Qeverinë të ofrojë dorëheqje. Presidenti i Republikës së Kosovës, në pajtim me dispozitat e nenit 82 paragrafi 2, mund ta shpërndajë Kuvendin në këtë rast, gjegjësisht, nëse me shumicën e duhur të deputetëve, votohet mocioni për mosbesim ndaj Qeverisë. Në atë rast, ai thërret zgjedhjet për Kuvendin e ri, brenda 45 ditëve nga dita e shpërndarjes së tij dhe thërret mbledhjen e parë të Kuvendit të sapozgjedhur.

Kapitulli V: Presidenti i Republikës së Kosovës

Hyrje e Përgjithshme

1. Megjithëse një republikë me tipare tipike parlamentare, regjimi kushtetues i Kosovës e ka vënë në një pozicion shumë të rëndësishëm postin e presidentit të republikës. Duke ndjekur traditat logjike të republikave parlamentare, presidenti i republikës në Kosovë shpreh kategorinë më shumë ceremoniale se sa ekzekutive të shtetit, që është rrjedhje normale e dizajnit të tij kushtetues. Presidenti i republikës, në përgjithësi, kryen dy funksione bazike: një, kryen detyrën më shumë ceremoniale të kreut të shtetit, dhe dy, është i veshur me një numër të kompetencave ekzekutive, të cilat, varësisht nga modeli kushtetues, e variojnë përcaktimin e republikës nga një tip tipik presidencial deri në një të pastër parlamentar. Në rolin e tij si kreu i shtetit, presidenti i republikës kryen funksione kryesisht formale, në të cilat parimisht vihet në rolin e konfirmuesit ceremonial të vendimeve të organeve tjera të shtetit. Si kreu i shtetit, presidenti i republikës luan një rol neutral përballë jetës politike, dhe në parim nuk ndërhyr në çështje të natyrës partiake.
2. Nën këtë supozim, presidenti i republikës, në rolin e kreut të shtetit, konfirmon vendime nën konceptin e një pozicioni mbi palët dhe thjeshtë për interesat e përgjithshme të shtetit. Në funksionin e tij ekzekutiv, presidenti i republikës vishet me të drejtën e shfrytëzimit diskrecional të kompetencës, duke vendosur mbi baza të qëndrimit individual për mënyrën e materializimit të vendimeve në atë fushë. Në funksionin e tij ekzekutiv, presidenti i republikës vepron më shumë si një aktor politik se sa si një figurë e gjerë përfaqësuese dhe ceremoniale e shtetit.³³⁴ Të dy

³³⁴ Debati mbi natyrën dhe pozitën e presidentit të republikës ka filluar nga Karl Shmit (Carl Schmitt) me shkrimin e tij të njohur “Ruajtësi i Kushtetutës” dhe ka vazhduar nga Hans Kelzen (Hans Kelsen), i cili në përgjigjen e tij ndaj këtij shkrimi, të titulluar si “Kush duhet të jetë ruajtësi i Kushtetutës?”, ka hedhur poshtë në tërësi konceptin shmitian mbi natyrën dhe pozitën e shefit të shtetit. Cila, pra, është esenca e këtij debati në mes të këtyre dy autorëve të njohur? Para se të fillojmë këtë shtjellim, në fillim duhet të konstatojmë se konceptet themelore të këtij debati dhe vetë përmbajtja e tyre paraqesin vetë themelet aktuale të natyrës dhe pozitës së presidentit të republikës. Më një fjalë, debati Shmit-Kelzen nuk duhet shikuar si një debat teoriko-historik por si një debat aktual teoriko-praktik, rëndësia e të cilit mbetet krejt e pandryshuar nga koha kur ka lindur.

Siç dihet nga historia e teorisë kushtetuese, debati Shmit - Kelsen është bërë për çështjen se kush është, apo kush duhet të jetë, garant i kushtetutës. Gjatë atij debati fillestar, është hedhur dritë edhe për rolin dhe për rëndësinë e shefit të shtetit (kryesisht) në demokracitë parlamentare me rregullim (kryesisht) republikan. Një pjesë e madhe e atij debati kishte të bënte me shefin e shtetit, si përfaqësues i unitetit të popullit, dhe me mospajtimin konceptual përkitazi me atë nëse ky unitet është sociologjiko-politik, apo nëse ka natyrë ekskluzivisht juridiko-kushtetuese. Të parën pikëpamje e ndërtoi dhe e mbështeti deri në fund Karl Shmit, kurse të dytën - Hans Kelsen.

Koncepti i shefit të shtetit, si përfaqësues i unitetit sociologjiko-politik, të Karl Shmit, është

funksionet e presidentit, megjithatë, varen shumë nga përcaktimi specifik kushtetues, sepse secili regjim kushtetues vendos mbi specifikat e kompetencave që bart një president i caktuar. Vështruar në aspektin e modelit kushtetues të presidentit të republikës, variacioni në kompetencat e tij dhe në modelin e zgjedhjes së tij/saj është përcaktor i tipit të presidentit të republikës.

3. Në teori, ekzistojnë tre modele themelore sistemit qeverisës në kuptim të pozicionit kushtetues të presidentit të republikës: një, modeli parlamentar i qeverisjes, ku roli i presidentit të republikës është pothuajse formal dhe me shumë pak karakteristika ekzekutive; dy, modeli i sistemit gjysmëpresidencial, ku presidenti i republikës përveç funksionit formal të shefit të shtetit bart me vete edhe shumë kompetenca ekzekutive, që e vendosin atë në pozitën e një mbikëqyrësi real të qeverisë, dhe tre, modeli i sistemit presidencial, ku presidenti i republikës është bartës i vetëm i pushtetit ekzekutiv dhe njëkohësisht kryen funksionin e shefit të shtetit, dhe ku mbikëqyrja parlamentare ndaj degës ekzekutive pothuajse praktikisht nuk ekziston.
4. Shikuar në perspektivën historike, institucioni i presidentit të republikës ka lindur në kontekst të revolucionit amerikan në fund shekullin XVIII, si një kundërshtim ndaj monarkisë në Britaninë e Madhe. Në pozicionin fillestar, funksioni i presidentit të republikës ishte refleksion i afërt, ose i modeluar afërsisht, me listën e kompetencave ekzekutive që barte kurora mbretërore në Britaninë e Madhe. Në këtë stad të zhvillimit, presidenti i republikës mëtonte të shprehte versionin mbretëror të pushtetit por me bazë popullore. Duke qenë se revolucioni republikan në SHBA ndjekej nga ideja e ndërtimit të një pushteti me bazë popullore, edhe versioni bazik amerikan i presidentit të republikës legjitimohej me kauzën republikane, pra të zgjedhjes së tij/saj nga ana e popullit në mënyrë të drejtpërdrejtë. Me zhvillimin e mëtejshëm të republikanizmit, modeli i shtetit

mjaft i strukturuar dhe përfundon në personin e Fyhrerit, i cili gjendet në krye të piramidës shtetërore si mishërim i unitetit të tillë. Te Hans Kelsen, po ashtu, koncepti është mjaft i strukturuar, por, në një mënyrë e në një kah tjetër, krejt të kundërt, me atë të K. Shmit. Shefi i shtetit, te H. Kelsen, del si mishërim i unitetit juridiko-kushtetues të popullit, kurse, në krye të piramidës shtetërore, gjendet norma bazë (“*grundnorm*”), të cilën shefi i shtetit duhet ta vëjë në jetë krahas me institucionet tjera kushtetuese. Derisa teoria e parë është në esencë diktatoriale, e dyta paraqet të kundërtën e saj. Cf. më shumë në hollësi për këtë debat në: Smit, Karl “Cuvar Ustava”. Në Samardzic, Slobodan (ed.), (2001) ‘Norma i Odluka. Karl Smit i njegovi kriticari’, Beograd, Filip Visnjic, fq. 211-253, në fq. 211-238. Titulli i origjinalit: Schmitt, Carl, (1929) ‘Der huter der verfassung’. Archiv des öffentlichen rechts, Neue Folge 16 Band J.C.B. Mohr (Paul Siebeck), Tubingen 1929; Smit, Karl, (2003) ‘Tri vrste pravnonaucnog misljenja’, Biblioteka Parerga, Beograd, fq. 34-42; 46-54, titulli në origjinal: Schmitt, Carl, (1934) ‘Über die drei Arten des rechtswissenschaftlichen Denkens’, Hamburg, Hanseatische Verlagsanstalt; Kelsen, Hans, ‘Ko treba da bude cuvar Ustava’, në Samardzic, Slobodan (ed.), Norma i Olduka, fq. 256-297, në fq. 265, titulli në original: Kelsen, Hans, (1931) ‘Wer soll der huter der verfassung sein?’, Dr. Walther Rothschild, Berlin-Grunewald.

Me kalimin e kohës, teoria e dytë e Hans Kelzen-it u bë vetë thelbi i asaj që tashmë njihet si teoria dhe praktika për demokracinë kushtetuese. Thënë më saktë, teoria e dytë, për dallim nga e para, e cila vuri themelet e arsytimit irracional të diktaturës naziste, shërbeu si subtrakt i teorisë dhe i praktikës së konstitucionalizmit modern që mori hov pas Luftës së Dytë Botërore.

republikan - pra, me një president në krye të shtetit - gjen përhapje të gjerë në shekullin XIX dhe XX.³³⁵ Koncepti evropian mbi presidentin e republikës diferencohet mjaftueshëm nga modeli amerikan, duke promovuar një shtet republikan me një president, pushteti ekzekutiv i të cilit është i ndarë me një qeveri të zgjedhur nga parlamenti. Në këtë aspekt, pozita e presidentit të republikës gjen “zbutje” të pushtetit të saj në shtetet evropiane, duke e ideuar një president republike me shije evropiane.³³⁶

5. Dëshmitë komparative sugjerojnë që numri i republikave parlamentare dhe i presidentëve të zgjedhur nga ana e parlamenteve ka gjetur rritje të vazhdueshme nga viti 1900 deri në vitin 2000.³³⁷ Shikuar nga aspekti i qeverisjes komuniste/post-komuniste, dominimi presidencial - pra i një presidenti me kompetenca të fuqishme ekzekutive - ka qenë gjithnjë i rrezikshëm për demokracinë. Vendet e a.q. të Botës së tretë, gjatë Luftës së Ftohët, kryesisht ato në Amerikën Latine, si dhe ish vendet komuniste pas rënies së komunizmit kanë treguar një tendencë të theksuar kah presidencializmi. Kjo tendencë, e kthyer në praktikë në disa vende gjatë viteve të para pas mbarimit të Luftës së Ftohët, u cilësua nga doktrina si “mega persidencializëm” për arsye se krerët e shtetit krijojnë parlamente kukulla, liliput, kontrollonin gjyqësinë dhe përdornin instrumentet e forcës (ushtrinë dhe policinë) për të përjetësuar sundimin e tyre absolut.³³⁸ Për këtë arsye, në teori me shumë të drejtë është sugjeruar që sistemet

³³⁵ Për lindjen dhe zhvillimin e e sistemit presidencial amerikan dhe krahasimin e tij me sistemet evropiane, Cf. më shumë në Bederman, David J (2008) ‘The Classical Foundations of the American Constitution’, Cambridge: Cambridge University Press; Martin van Geldren and Quentin (eds.) (2002) ‘*Republicanism. A Shared European Heritage*: Vol. I and II’, Cambridge: Cambridge University Press.

³³⁶ Shih p.sh: Dann, P (2003) ‘European Parliament and Executive Federalism: Approaching a Parliament in a Semi-Parliamentary Democracy’. *European Law Journal*. Vol. 9, p. 549-574.

³³⁷ Neto, A., Octavio and Strøm, Kaare (2006) ‘Breaking the Parliamentary Chain of Delegation: Presidents and Non-partisan Cabinet Members in European Democracies’. *British Journal of Political Science*. Vol. 36, p. 621-2.

³³⁸ Për Amerikën Latine dhe parlamentet e tyre sa për sy e faqe ose liliput, si dhe për kultivimin e sistemeve hiperpresidenciale, Cf. më shumë në Darke, W. Paul, (2009) ‘Between Tyranny and Anarchy: A History of Democracy in Latin America, 1800-2006’. Stanford: Stanford University Press, p. 34-39. Për vendet ish komuniste, Cf. më shumë në Sajo, Andras (1999) ‘Limiting Government: An Introduction to Constitutionalism’. Budapest, CEU Press, fq. 179-180; Gonenc, Levent (2002) ‘Prospects for Constitutionalism in Post-Communist Countries’. The Hague: Kluwer Law International, p. 280-318; Massias, Jean - Pierre (2008) ‘Droit constitutionnel des Etats d’ Europe de l’ Est’. Paris: Press Universitaire de France, p. 13-140 & 421-563.

Për një analizë të shkëlqyer komparative të Evropës ish-komuniste dhe të Amerikës Latine, si dhe të rëndësisë së madhe që ka sistemi presidencial në Amerikën Latine, krahasuar me Evropën ish-komuniste, Cf. Juan J. Linz, Alfred Stepan and Richard Gunther, ‘Democratic Transition and Consolidation in Southern Europe, with Reflections on Latin America and Eastern Europe’, në ‘The Politics of Democratic Consolidation. Southern Europe in Comparative Perspective’ Gunther, Richard, Diamandouros, P. Nikoforos, and Hans-Jurgen Puhle (eds.) (1995). Baltimore and London: The John Hopkins University Press, fq. 77-123; Bunce Valerie, ‘Comparing East and South’, në ‘Democracy After Communism’, Diamon, Larry and Plattner, F. Marc (eds.)

parlamentare janë shumë më të shëndetshme për demokracinë se sa ato presidenciale, dhe kjo për dy arsye themelore: një, sistemet presidenciale janë shumë të ngurta, dhe i japin shumë siguri dhe autoritet kushtetues presidentit të republikës, dhe dy, sistemet presidenciale e mbjellin idenë që fituesi i merr të gjitha, duke i zvogëluar shanset për një jetë shumë-partiake dhe jo-monopolistike.

6. M. Steven Fish, në teorinë e tij të famshme mbi superpresidencializmin, arsyen kryesore të pengesës për demokratizim në shtetet post-komuniste e lidh me pushtetin e fuqishëm të presidentëve. Sipas Fish-it, të gjitha vendet post-komuniste që kishin ngelur mbrapa sa i përket demokratizimit e kishin një të përbashkët: super-presidencializmin. Në këtë kuptim, pozita dhe funksioni i presidentit të republikës duhet shikuar nën hijen e mundësisë së monopolizimit të pushtetit dhe rrezikimit të demokracisë. Një argument i bazuar në dëshmi nga praktika, sa i përket kësaj çështjeje, është që kontrolli parlamentar i qeverisë dhe mungesa e një super-presidenti në republikat post-komuniste janë faktorët që i shërbejnë shëndetit demokratik të shtetit. Prandaj, sqarimi i modelit të presidentit të shtetit, në kuptimin e dëshmimeve krahasuese, duhet bërë nën hijen e kërkesave që procesi i demokratizimit vë përpara shteteve post-komuniste.³³⁹ Kosova nuk është përjashtim nga kjo. Argumenti i njëjtë vlen edhe në lidhje me qëndrueshmërinë dhe karakterin më reprezentativ të demokracive parlamentare përballë atyre presidenciale.³⁴⁰ Argumenti bazik në lidhje me këtë është se koncentrimi i kompetencave legjislative në presidentin e republikës mund të rezultojë si shumë e dëmshme për stabilitetin e sistemit politik.³⁴¹
7. Në republikat parlamentare, në rastet kur presidenti zgjidhet nga ana e parlamentit, ose të tillat me dominim parlamentar, presidenti i republikës nuk është institucioni që qeveris i vetëm me shtetin: janë partitë politike ato që kontrollojnë dhe e disejnojnë jetën politike.³⁴² Në këtë kuptim, presidenti i republikës është më shumë

(2002). Baltimore and London: The John Hopkins University Press, fq. 18-32. Ky autor, në faqet 28-29 të këtij shkrimi, mendon se debati aktual, që ekziston përkitazi me atë se cili sistem i qeverisjes duhet të ketë përparësi në Evropën postkomuniste, duhet të zgjidhet në favor të sistemit presidencial, sepse, sipas tij, ai sistem ofron më shumë efektivitet dhe mundësi praktike për zgjidhjen e problemeve të ish-vendeve komuniste.

³³⁹ Shih p.sh: Linz, Juan J (Juan José), (1990) 'The Perils of Presidentialism'. *Journal of Democracy*. Vol. 1, No. 1, (Winter), p. 51-69; Krahaso me: Lee, B. W., Gross, D. A. and Kim, J.-S (1992) 'A Presidential or Parliamentary System: The South Korean Debate'. *Pacific Focus*. Vol. 7, p. 117-139; Shih gjithashtu: Linz J., Juan 'Presidential or Parliamentary Democracy: Does It Make a Difference,' në 'The Failure of Presidential Democracy', Linz, J., Juan and Valenzuela, Arturo (eds.) (1994). Baltimore, MD: Johns Hopkins University Press, pp. 48-62.

³⁴⁰ Shih p.sh: Lijphart, Arend (1999) 'Patterns of Democracy: Government Forms and Performance in Thirty-Six Countries'. New Haven: Yale University Press; & Linz, J., Juan (1990) 'The Perils of Presidentialism.' *Journal of Democracy*, Vol. 1, No. 1, pp. 51-69.

³⁴¹ Shih: Shugart, Matthew Soberg and Carey, M., John (1992) 'Presidents and Assemblies: Constitutional Design and Electoral Dynamics'. New York: Cambridge University Press.

³⁴² Herman, Valentine and Pope, John (1973) 'Minority Governments in Western Democracies'. *British Journal of Political Science*. Vol. 3, No. 2, p. 191-212. Në të njëjtën linjë, Sartori shkon më tej duke argumentuar që aftësia e sistemit parlamentar apo/dhe presidencial për të

instrument i partisë nga vjen, se sa një lider i pavarur që e dimensionon jetën politike sipas theksit të tij personal.³⁴³ I njëjti konstatim mund të jetë edhe për rastin e një presidenti me kompetenca të gjëra siç është ai amerikan.³⁴⁴ Roli dhe funksioni i presidentit të republikës nuk duhet shikuar thjeshtë nga lista e kompetencave kushtetuese por edhe nga perspektiva e fuqisë politike (mbështetjes partiake) që ai/ajo ka në jetën politike.³⁴⁵

8. Natyrisht, përveç listës apo gjerësisë së kompetencave që ka një president republike, i rëndësishëm në vetvete është edhe modeli i zgjedhjes së presidentit. Jo vetëm që modeli i zgjedhjes së presidentit është përcaktues i fuqisë së tij politike dhe legjitimitetit politik por është edhe përcaktor i tërë hapësirës mbi të cilën mund të manovrojë një president republike. Modelet kushtetuese ku presidentët zgjidhen nga populli, i ofrojnë presidentit mundësinë që të thirret në legjitimitetin popullor për të ushtruar kompetencat e tij kushtetuese, pavarësisht kundërshtimeve që mund të vijnë nga parlamenti. E kundërta ndodh me presidentët që zgjidhen nga parlamenti, meqë këta janë të prirur t'i qëndrojnë prapa argumentit që vullneti i parlamentit nuk mund të anashkalohe në mënyrë radikale për shkak të legjitimitetit të tij popullor. Edhe në kontekst të një presidenti të zgjedhur nga parlamenti, është e rëndësishme të kihet parasysh që mënyra parlamentare e zgjedhjes ndryshon nga ato modele ku presidenti zgjidhet me shumicë të thjeshtë të votave, pra është një instrument i mazhorancës parlamentare, deri tek modelet ku presidenti zgjidhet me shumicë të kualifikuar të votave, dhe ku supozohet që ai/ajo të jetë një institucion mbipartiak dhe konsensual.
9. Modeli i zgjedhjes së presidentit të republikës është përcaktor edhe për funksionet kushtetuese që ai/ajo mund/duhet t'i ushtrojë. Një president që zgjidhet sipas një modeli ku dominon kontrolli një-partiak, p.sh. me anë të një shumice absolute në parlament (pra, është nën kontrollin e mazhorancës parlamentare), nuk mund të

funksionuar kryesisht varet nga disiplina e partive politike dhe mundësia që këto parti të sigurojnë një mazhorancë qeverisëse. Shih për më tepër, Sartori në Lorch, Maristella (1994) 'Italian Parliamentary Democracy: Discussion'. *Political Science Quarterly*. Vol. 109, No. 3, 'Conference Issue: Presidential and Parliamentary Democracies: Which Work Best?', p. 461-479; Strøm, K (2000) 'Delegation and Accountability in Parliamentary Democracies'. *European Journal of Political Research*. Vol. 37, p. 261-289.

³⁴³ Në këtë drejtim shprehet edhe tendenca e vazhdueshme e demokracive Evropiane që të rrisin rolin e qeverisë dhe mbrojtjen e saj nga shkarkimi nëpërmjet shpërndarjes së parlamentit. Shih për më tepër, Bracher, D., Karl (1964) 'Problems of Parliamentary Democracy in Europe'. *Daedalus*. Vol. 93, No. 1, A New Europe?, p. 179-198.

³⁴⁴ Rose in Rose, Richard (1977) 'The President: A Chief but Not an Executive'. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 7, No. 1, p. 8.

³⁴⁵ Shih Baum, R., Jeeyang (2007) 'Presidents Have Problems Too: The Logic of Intra-branch Delegation in East Asian Democracies'. *British Journal of Political Science*. Vol. 37, p. 659-684, dhe, Neto, A., Octavio and Strøm, Kaare (2006) 'Breaking the Parliamentary Chain of Delegation: Presidents and Non-partisan Cabinet Members in European Democracies'. *British Journal of Political Science*. Vol. 36, pp. 619-643' Shih gjithashtu: Elgie, Robert 'The Politics of Semi-presidentialism', in 'Semi-presidentialism in Europe', Robert Elgie (ed.) (1999). Oxford: Oxford University Press, p. 1-21.

vishet me kompetenca që kërkojnë integritet neutral nga bartësi i tyre. Por, një president i zgjedhur nga një shumicë e kualifikuar në parlament apo edhe i zgjedhur drejtpërdrejtë nga populli përmes një modeli elektoral kredibil natyrisht që mund të bartë kompetenca që kërkojnë integritet në ushtrimin e tyre.³⁴⁶ Si parim, kompetencat në fushën gjyqësore, prokuroriale dhe në garantimin e funksionimit kushtetues të shtetit mund të bartet me integritet vetëm nga një president republike zgjedhja e të cilit nuk lë hapësirë për kontroll një-partiak apo jo-konsensual. Në këtë kontekst, shumica e regjimeve kushtetuese në botë e modelojnë zgjedhjen e presidentit në proporcion me funksionet e tij/saj, duke tentuar kështu që të ruaj integritetin, meritën dhe objektivitetin në ushtrimin e kompetencave të ndjeshme, sikur ato në fushën e emërimeve gjyqësore dhe prokuroriale, apo edhe në garantimin e rishikimit të ligjeve sipas standardeve kushtetuese në procesin e dekretimit.³⁴⁷

10. Çështja e fundit të kuptim të pozitës kushtetuese të presidentit të republikës lidhet me pozicionin e presidentit të republikës në “peisazhin” e ndarjes së pushteteve. Meqë kushtetutat e vendeve demokratike zbatojnë një model të pushtetit të ndarë, pyetja themelore është se ku pozicionohet presidenti në terrenin e tri degëve të pushtetit. Fillimisht, sikur nuk është rasti me regjimin kushtetues të Shteteve të Bashkuara, presidenti në republikat parlamentare ka shumë pak kompetenca ekzekutive përveç rolit të tij si kreu i shtetit. Në këtë kontekst, presidenti i shtetit, për aq kohë sa ushtron detyrën e kreu të shtetit, është i pozicionuar mbi të tri pushtetet, megjithëse kompetencat e tij si kreu i shtetit janë shumë formale dhe nuk lënë hapësirë për diskrecion personal mbi zbatimin ose jo të tyre. Në anën tjetër, për aq kohë sa presidenti i shtetit kryen detyra ekzekutive, ai/ajo është pjesë e pushtetit ekzekutiv, duke e ndarë këtë të fundit me qeverinë, varësisht nga modeli kushtetues i ndarjes së pushtetit. Në këtë imazh, pozicioni i presidentit të republikës përballë tri degëve të pushtetit varet qenësisht nga masa e kompetencave ekzekutive që ai/ajo ka. Është e rëndësishme të ceket që literatura sugjeron që modelet kushtetuese të cilat ndajnë kompetencat në mes të presidentit, legjislativit dhe qeverisë në mënyrë më të prerë ofrojnë më shumë mundësi për votuesit që të drejtojnë përgjegjësinë e tyre përballë presidentit në mënyrë më të saktë.³⁴⁸

³⁴⁶ Raporti në mes të zgjedhjes së presidentit dhe rolit të tij në Republikë, për më tepër, është i rëndësishme edhe në përcaktimin e rolit të tij kundrejt përfaqësimit të Republikës dhe jetës politike. Mbi këtë bazë, nuk është i parëndësishëm fakti që Presidenti francez, duke marrë parasysh modelin e zgjedhjes së tij, kualifikohet si shef i shtetit dhe lider i Francës, dhe si i tillë është i detyruar të qëndrojë mbi jetën e përditshme politike. Shih, Heper, Metin and Çinar, Menderes (1996) ‘Parliamentary Government with a Strong President: The Post-1989 Turkish Experience’. *Political Science Quarterly*. Vol. 111, No. 3, p. 483-503.

³⁴⁷ Duhet theksuar se gjerësia e mbështetjes së Presidentit nga një zgjedhje e drejtpërdrejtë elektorale dhe/apo nga partitë politike në një sistem që kërkon shumicë të kualifikuar përcakton autoritetin e Presidentit dhe funksionet që ai/ajo ka. Shih, Baum, R., Jeeyang (2007) ‘Presidents Have Problems Too: The Logic of Intra-branch Delegation in East Asian Democracies’. *British Journal of Political Science*. Vol. 37, p. 659-684.

³⁴⁸ Samuels J., David and Shugart Soberg Matthew (2003) ‘Presidentialism, Elections and Representation’. *Journal of Theoretical Politics*. Vol. 15, No. 1, p. 33-60.

11. Dhënia e kompetencave individuale një presidenti të republikës, dhe ikja nga ndërtimi i mekanizmave kushtetues të bashkë vendosjes, sugjerohej në mënyrë që të ofrohet një rritje e përgjegjësisë presidenciale ndaj elektoratit dhe rrjedhimisht një sukses më i madh në zbatimin e parimit të ndarjes së pushtetit. Kjo, megjithatë, nuk do të thotë se ndërtimi i mekanizmave kushtetues të bashkë vendosjes ulë përgjegjësinë elektorale të presidentit dhe që, për pasojë, reflektohet keq në zbatimin e parimit të ndarjes së pushtetit. Kjo vërehet në veçanti në rastin e Kosovës ku presidenti, siç do të shihet, qëndron mbi tre pushtetet jo vetëm kur kryen funksionin formal të kreut të shtetit por edhe kur vepron në kuadër të mekanizmave kushtetues të bashkë vendosjes (krahas dhe së bashku) me qeverinë dhe mekanizmat tjerë kushtetues (si p.sh. me Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial etj.). Në të njëjtën kohë, kjo bashkë vendosje në asnjë mënyrë nuk nënkupton, siç mund të mendohet nga disa, se Kosova ka sistem gjysëmepresidencial. Nuk ka asnjë dyshim se Kosova paraqet një republikë të qartë parlamentare dhe çdo dukje si më sipër për rolin dhe pozitën e presidentit të Kosovës është e rrejshme dhe e gabuar deri në fund.

Neni 83 [Statusi i Presidentit]

Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës.

Neni 83

1. Neni 83 është përcaktori kushtetues i funksionit bazik të presidentit të republikës. Ky nen përcakton që presidenti i republikës është kreu i shtetit dhe që përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës. Janë dy koncepte kushtetuese që duhen komentuar me këtë rast: një, koncepti i presidentit të republikës si kreu i shtetit, dhe dy, koncepti i presidenti si përfaqësues i unitetit të popullit.
2. Përcaktimi i vënë me nenin 83 që presidenti i republikës është kreu i shtetit ilustron funksionin logjik të presidentit të republikës, duke ndjekur një linjë normale të pozitës së çdo presidenti në botë. Qenia kreu i shtetit, megjithatë, në kuptim të nenit 83 dhe praktikave ndërkombëtare, duhet shikuar me shumë kujdes. Në rend të parë, koncepti i presidentit si kreu i shtetit duhet, në pajtim me praktikat ndërkombëtare të të shikuarit të kësaj çështjeje, të komentohet më shumë si një përcaktim formal se sa si autoritet substancial.³⁴⁹ Koncepti i kreut të shtetit, prandaj, është më shumë një kategori kushtetuese formale që i takon presidentit të republikës, por që nuk nënkupton që presidenti i republikës vishet me karakteristika qeverisëse. Përcaktimi i nenit 83 sipas të cilit presidenti i republikës është kreu i shtetit nënkupton më shumë një autoritet ceremonial, formal, të cilin e

³⁴⁹ Përcaktimi që presidenti është kreu i shtetit tregon që ky i fundit natyrshëm udhëheqë (kryeson) por nuk qeverisë. Shih, Neto, A., Octavio dhe Strøm, Kaare (2006) 'Breaking the Parliamentary Chain of Delegation: Presidents and Non-Partisan Cabinet Members in European Democracies'. *British Journal of Political Science*. Vol. 36, p. 619-643.

ka presidenti i republikës, se sa një autoritet qeverisës. I vënë në këtë kontekst, neni 83 ilustron pozitën formale të presidentit të republikës si kreu i shtetit dhe jo kompetencat/autoritetin e tij substancial. Në rend të dytë, si kreu i shtetit, presidenti i republikës logjikshëm vishet me autoritetin që të përfaqësojë shtetin në nivelet më të larta të komunikimit të brendshëm dhe ndërkombëtar thjeshtë si një detyrë ceremoniale pa diskrecion vendimmarrjeje. Shikuar në këtë perspektivë, në pozitën e kreu të shtetit, presidenti i republikës vepron në përputhje me autoritetin kushtetues të institucioneve tjera shtetërore, dhe vulos vendimet e tyre thjeshtë në aspektin ceremonial/formal, nëse nuk është përcaktuar ndryshe në listën konkrete të kompetencave të tij/saj.

3. Funkzioni i kreu të shtetit, prandaj, duhet shikuar në përputhje me tërë sistemin kushtetues dhe kompetencat që i janë veshur institucioneve tjera shtetërore, përderisa ky funksion kushtetues i presidentit të republikës ka më shumë theks ceremonial (formal) se sa autoritet substancial. Dy këto aspekte, pra i presidentit si kreu i shtetit dhe si përfaqësues i unitetit të popullit, kanë qenë objekt shqyrtimi dhe vendosjeje në një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, në Aktgjykimin për rastet KO.29/12 dhe KO.48/12, i datës 20 korrik 2012 (Nr. ref. AGJ 284/12). Me këtë Aktgjykim Gjykata ka kryer detyrën e kontrollit abstrakt preventiv të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese të propozuara nga Kuvendi i Kosovës më datat 23 mars dhe 4 maj 2012 respektivisht.³⁵⁰ Në këtë Aktgjykim, Gjykata ka dhënë verdiktin e saj më gjithëpërfshirës sa i përket rolit dhe pozitës së shefit të shtetit kosovar. Si i tillë, Aktgjykimi prek esencën e debatit Shmit-Kelsen duke lëvizur në pikëpamje praktike në vijat e stërholluara të konstitucionalizmit modern të rrahur nga Hans Kelsen dhe të tjerët pas tij. Nga Gjykata u kërkua që të konstitucionalizojë termet e një marrëveshjeje të nënshkruar në mes të forcave politike kosovare më 6 prill 2011, marrëveshje e cila thoshte se shefi kosovar i shtetit duhej të shkonte në shtëpi, pra të shkarkohej, brenda (apo pas) gjashtë (6) muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të amendamentit dhjetë (X) të propozuar. Ky amendament, së bashku me mbi gjashtëdhjetë përqind (60%) të amendamenteve tjera, njëmbëdhjetë (XI) gjithsejtë, u deklarua si në kundërshtim më Kushtetutën e

³⁵⁰ Kontrolli preventiv, si në rastin e Kosovës, është i rrallë dhe ekziston vetëm në disa vende, siç janë Azerbajxhani, Kirgizia, Moldavia, Turqia dhe Ukraina. Kontrolli i tillë abstrakt preventiv mbi amendamentet kushtetuese e vendos Gjykatën Kushtetuese jo thjeshtë në pozicion të një legjislatori negativ, por edhe të një kushtetutbërësi negativ, meqë amendamentet e tilla kushtetuese i nënshtrohen kontrollit kushtetues sa i përket të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me kushtetutë. Në këtë perspektivë, ky kontroll i tipit preventiv vetëm se e fuqizon edhe më tutje karakterin e ngurtë të kushtetutës së Kosovës, duke mundësuar që gjyqësia kushtetuese të ketë funksion themelor në qeverisjen e shtetit. Cf. analizën komparative të Komisionit të Venedikut: Report on Constitutional Amendment, No. 469/2008, adopted by the Venice Commission at its Plenary Session, CDL-AD (2010) 001, Starsbourg, 19 January 2010 Venice, 11-12 December 2009. Në internet mund të gjendet në: www.venice.coe.int, me këtë shenjë: CDL-AD (2010) 001. Për aspektet teorike të kontrollit preventiv të amendamenteve kushtetuese, Cf. Gozler, Kemal (2008) 'Judicial review of Constitutional Amendmenets. A Comparative Study'. Bursa: EKIN PRESS; Jacobsohn, Jeffrey Gary, (2006) 'An unconstitutional constitution? A comparative perspective'. *International Journal of Counstitutional Law*. Vol. 4, No. 3, p. 460-487.

Kosovës. Jo-kushtetushmëria e këtij amendamenti dilte jo vetëm nga cenimi i kapitullit II të Kushtetutës (“Të Drejtat dhe liritë themelore”), por edhe dispozitat, parimet dhe vlerat tjera kushtetuese mbi të cilat rri rendi kushtetues juridik kosovar, siç janë parimi i barazisë para ligjit, i sundimit të ligjit dhe i sigurisë juridike, si dhe i mosdiskriminimit. Esenca e këtij verdikti sa i përket rolit dhe rëndësisë së shefit të shtetit në përgjithësi, duke përfshirë këtu sistemin kosovar kushtetues, do të shtjellohet në vijim përgjatë vijave të verdiktit të Gjykatës në rastin e sipërcekur.

4. Në kryerjen e detyrës së tij/saj si kreu i shtetit, presidenti i republikës, sipas nenit 83, duhet të veprojë në linjë me të mirën publike të tërë shtetit dhe jashtë çdo linje të ngushtë partiake apo personale. Funkzioni i kreut të shtetit, prandaj, është funksion që kërkon integritet neutral dhe përmbajtje meritore, meqë materializimi i vendimeve në kuadër të këtij funksioni duhet të përfaqësoj të mirën publike/shtetërore para interesave elektorale/partiake.
5. Në këtë kontekst, në kryerjen e funksionit të kreut të shtetit, sipas këtij neni, presidenti i republikës duhet përmbajtur këtyre katër parimeve: a) shprehjes së neutralitetit: në kryerjen e detyrës së tij si kreu i shtetit, presidenti i republikës nuk lejohet që të marrë veprime që lejojnë hapësirë për anim partiak, politik apo personal; b) kredibilitetit shtetëror: në kryerjen e këtij funksioni, presidenti i republikës përfaqëson shtetin dhe jo interesin e tij/saj personal apo partiak, prandaj publiku duhet të jetë i bindur arsyeshëm që veprimet në kuadër të këtij funksioni janë thjeshtë në përputhje me interesat e gjëra shtetërore, si në kuadrin e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm; c) objektivitetit: në kryerjen e këtij funksioni, presidenti i republikës duhet të gjykoj objektivisht nga pritjet e publikut të gjerë sa i përket përfaqësimit të interesit shtetëror, dhe të veprojë në mënyrë të tillë që pritjet e publikut për veprimet e kryera në kuadrin e këtij funksioni të mos lënë dyshim për anime personale të presidentit të republikës³⁵¹; dhe, d) kufizimi i këtij funksioni në aspekte formale: përcaktimi i vënë në nenin 83 për presidentin e republikës si kreu i shtetit duhet interpretuar në mënyrë të ngushtë, duke përjashtuar çdo hapsirë që kjo të nënkuptojë një autoritet substancial të qeverisjes në dobi të presidentit të republikës.

³⁵¹ Kjo vlen edhe për ushtruesin e detyrës së presidentit, i cili po ashtu duhet t'i ushtroj kompetencat e presidentit në mënyrë të njëjtë sikur presidenti i republikës. Se kjo është kështu mund të vërehet nga argumentet e dhëna nga njohësit e çështjeve kushtetuese që iu drejtuar Dr. Jakup Krasniqi për sjelljet e tij në kohën sa ka qenë duke ushtruar detyrën e presidentit të republikës (shtator 2010-prill 2011) për shkak se kishte refuzuar emërimin e disa gjyqtarëve dhe kishte dhënë falje e ndarë dekorata të cilat në publik u patën parë si sjellje arbitrare dhe jo objektive. Cf. Kuvendi i Republikës së Kosovës. Lajmet e fundit: Reagim i Kabinetit të Kryetarit të Kuvendit, 20 shkurt 2012, e hënë, ueb-faqja e Kuvendit të Kosovës: <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,128,4462> (shikuar më 24 nëntor 2012); “Eliminuan nga lista Driton Muharremin”, gazeta e përditshme “Kosova sot”, 27 janar 2012, e premtë, version elektronik vetëm (http://www.kosova-sot.info/politike/kosove/_eliminuan-nga-lista-driton-muharremin). Këtu, në këtë shkrim, analizohet raporti kritik i Misionit të OSBE-së në Kosovë, i cili flet për parregullsitë në emërimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të Kosovës nga u.d. i Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, si dhe për rastet e faljeve të dhëna e dhuratave të ndara.

6. Në kryerjen e këtij funksioni, presidenti i republikës është i kufizuar me kompetencat e institucioneve tjera, dhe natyrshëm, materializimi i këtij funksioni, siç është e pritshme nga këndi i standardeve ndërkombëtare, nuk mund të ngërthej në vete ‘pushtim’ të kompetencave substanciale të institucioneve tjera të vëna me këtë kushtetutë.
7. Në kuptim të nenin 83, presidenti i republikës përcaktohet edhe si përfaqësues i unitetit të popullit të Republikës së Kosovës. Ky koncept i vënë në nenin 83 duhet vështruar me shumë kujdes, meqë përfaqëson një nga parimet më të rëndësishme të tërë kushtetutës, në kontekst të së cilës duhet shpjeguar tërë dizajni institucional i shtetit dhe raporti në mes institucioneve. Në dimenzionimin e presidentit të republikës si përfaqësues i unitetit të popullit, rol të rëndësishëm kanë luajtur aktgjykimi *Rrustemi et al v. Presidenti i Republikës*³⁵² i datës 28 shtator 2010 dhe ai mbi “Shefin e Shtetit” që u diskutua më sipër.³⁵³ Megjithatë, përpara se ta komentojmë gjerësisht këtë koncept kushtetues, është e rëndësishme të kihen parasysh tre supozime që i prodhon interpretimi i këtij koncepti. Një, çështja e interpretimit të konceptit të presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit reflekton, por edhe kushtëzohet, nga modeli i zgjedhjes së tij. Dy, interpretimi i konceptit në fjalë përcakton pozicionin politik të presidentit të republikës përballë skenës politike, dhe, tre, interpretimi i konceptit në fjalë përcakton funksionin e presidentit të republikës përballë ushtrimit të kompetencave tjera konkrete të dhëna me kushtetutë.
8. Më konkretisht, koncepti i presidentit të republikës si përfaqësues i unitetit të popullit, nën linjën e rastit *Rrustemi et al v. Presidenti i Republikës*,³⁵⁴ dhe “Shefi i Shtetit” duhet interpretuar si një parim kushtetues me relevancë për tërë sistemin kushtetues kosovar. Në vijim të kësaj, ky koncept ka të paktën katër cilësi të cilat i vishen shpjegimit të tij. Një, në kuptim të nenit 83, përfaqësimi i unitetit të popullit gjen shtrirje shumë më të gjerë se sa thjeshtë në kuptimin formal. Në aspektin e multietnicitetit, si parim bazik i proklamuar me kushtetutë, koncepti i një presidenti që përfaqëson unitetin e popullit duhet shpjeguar në kontekst të demokracisë konsociacionale (“consociational”)³⁵⁵.

³⁵² Aktgjykim: Rasti nr. KI 47/10, ‘Naim Rrustemi dhe 31 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës’, datë 28 shtator 2010, Nr. ref.: AGJ 43/10.

³⁵³ Aktgjykim: Rastet K.O.29/12 dhe K.O. 48/12, ‘Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars dhe 4 maj 2012, datë 20 korrik 2012’, Nr. ref.: AGJ 284/12.

³⁵⁴ Krahaso me: O'Regan, K (2012) ‘Text Matters: Some Reflections on the Forging of a New Constitutional Jurisprudence in South Africa’. *The Modern Law Review*. Vol. 75, p. 1-32.

³⁵⁵ Ky term më së pari është përdorur dhe shtjelluar nga Arend Lijphart në një libër të tij të botuar më 1968. Në këtë libër dhe më pastaj në shkrimet tjera, Lijphart ka theksuar se ka një tip të demokracisë në botën perëndimore i cili nuk është as britaniko-evropian e as amerikan. Ky lloj i demokracisë ekziston, sipas tij, në vendet skandinave dhe në vendet e ulëta. Këtë tipologji ai e ka bazuar duke u mbështetur në kulturën politike dhe strukturën sociale në njërin anë dhe në stabilitetin politik në anën tjetër. Kombinimi i këtyre faktorëve prodhon, sipas tij, një sistem demokratik të qëndrueshëm që akomodon strukturat problematike sociale kundrejt kulturës së

9. Detyrimi që lind nga neni 83 është që presidenti i republikës të jetë përfaqësues jo thjesht i unitetit të shumicës por përfaqësues i unitetit të tërë popullit, duke marrë parasysh edhe vullnetin e komuniteteve pakicë. Në këtë aspekt, përfaqësimi i unitetit të popullit në kuptim të këtij neni duhet të përmbush kushtet e një uniteti popullor multi-etnik jo thjeshtë në kuptimin subjektiv, por edhe në kuptimin objektiv. Prandaj, nuk mjafton që presidenti të jetë një përfaqësues i unitetit të popullit në aspektin e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, por edhe të shihet objektivisht si i tillë nga të gjitha komunitetet etnike. Kjo nënkupton që përfaqësimi i unitetit të popullit nga ana e presidentit të republikës të jetë një funksion mbi-etnik, që i shërben konceptit të shtetit neutral ndaj etnisë.³⁵⁶ Dy, në kuptim të nenit në fjalë, përfaqësimi i unitetit të popullit duhet shikuar edhe në kontekst të një konsensusi të gjerë partiak e politik mbi rolin e presidentit dhe kryerjen e funksionit të tij.
10. Shikuar nga këndi i *Rrustemi et al v. Presidenti i Republikës*, funksioni i presidentit të republikës si përfaqësues i unitetit të popullit ka tre kuptime: a) që presidenti i republikës të mos jetë pjesë aktive e ndonjë partie politike, apo që të mos mbaj çfarëdo posti që mund t'i paragjykojë animin e tij partiak/politik. Kjo nënkupton që përderisa është në detyrën e tij kushtetuese, presidenti i republikës nuk mundet të mbajë apo të ushtrojë çfarëdo detyre partiake, pavarësisht nëse ajo bëhet në mënyre formale apo substanciale. Në kuptim të rastit në fjalë, presidenti i republikës nuk lejohet qoftë edhe ceremonialisht apo formalisht të mbaj çfarëdo titulli apo pozite partiake, dhe që fakti më i vogël, qoftë edhe formal, që racionalisht e lidh presidentin me mbajtjen apo ushtrimin e një detyre partiake shkel përcaktimin e vënë në nenin 83 që ai/ajo të përfaqësoj unitetin e popullit. b) që presidenti i republikës të mos jetë pjesë qoftë edhe pasive e ndonjë strukture, rryme apo lëvizjeje me karakter partiak.

dhënë politike më qëllim të garantimit të një stabiliteti politik. Demokracia konsociacionale ka gjetur shprehje në vendet e ndryshme të botës, në veçanti pas mbarimit të Luftës së Ftohtë. Cf. Arend Lijphart, (1969) 'Consociational Democracy'. *World Politics*. Vol. 21, No. 2, p. 207-225; Samuel Issacharoff, Pamela S. Karlan and Richard H. Plides (eds.) (2007) 'The Law of Democracy: Legal Structure of the Political Process'. New York, NY: Foundation Press, p. 1202-1207.

³⁵⁶ Ky segment është elaboruar me elokuencë nga Gjykata në rastin e sipërcekur mbi "Shefin e Shtetit" ku është vendosur në mënyrë abstrakte dhe preventive mbi kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese të propozuara. Me këtë rast Gjykata ka theksuar se nuk është vetëm Kapitulli II i Kushtetutës si standard referimi por edhe Kapitulli III ("Të Drejtat e Komuniteteve dhe Prestarëve të tyre") si dhe tërë fryma e Kushtetutës. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata ka vlerësuar edhe rolin dhe pozitën e shefit kosovar të shtetit i cili, sipas Gjykatës, ka detyrim kushtetues të përfaqësoj unitetin juridik-kushtetues të popullit, jo unitetin sociologjiko-politik të popullit. Me këtë qasje, Gjykata ka përqafuar doktrinën gjermane mbi kushtetutën si një tërësi organike e cila përmban norma, parime dhe vlera të cilat vetëm si një tërësi mund të japin kuptimin dhe thelbin e konstitucionalizmit modern. Cf. Kommers, P. Donald, (1991) 'German Constitutionalism: A Prolegomenon'. *Emory Law Journal*, Vol. 40, No. 1, p. 837-873; Donald P. Kommers (1997) 'The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany. Second Edition'. Durham and London: Duke University Press, p. 3-60; Shih gjithashtu: Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë, në rastin BVerfGE 7, 198 - Lüth (Bundesverfassungsgericht), Urteil, e datës 15. Janar 1958, në të cilën jepet kjo logjikë e definimit të konceptit kushtetues sipas parametrevë të mësipërm.

11. Në kuptim të nenit 83, presidenti i republikës, për atë kohë sa është i detyruar të përfaqësojë unitetin e popullit, nuk lejohet që t'i përkasë as pasivisht një partie politike. Kjo nënkupton që presidenti i republikës nuk lejohet që të shihet nga të tjerët në një pozicion pasiv kur atij/asaj i adresohen anime partiake, apo kur atij/asaj, nga një pritje e arsyeshme, publiku e gjen pasiv përballë animeve që interpretohet si të atribuara ndaj një partie politike apo një grupimi politik. Kjo nënkupton që njerëzit e lidhur për një grupim/parti të caktuar politike nuk mund të shfrytëzojnë animin pasiv të presidentit si një rrugë për të shfrytëzuar autoritetin e tij për nevoja të ndërhyrjes në pushtetin publik; c) nën dritën e rastit *Rrustemi et al v. Presidenti i Republikës*, presidenti i republikës, në mënyrë që të ushtrojë detyrën e një përfaqësuesi të unitetit të popullit, duhet që të mos jetë thjeshtë vetëm në pikëpamje subjektive i paanshëm ndaj cilësdo parti politike, por edhe që të shihet ashtu në anën e jashtme.³⁵⁷ Pra, përfaqësimi i unitetit të popullit duhet të reflektohet edhe objektivisht nga ana e presidentit të republikës, në kuptimin që ushtrimi i funksionit të tij duhet të jetë, pritshëm, i shikuar nga ana e publikut si i paanshëm ndaj cilësdo rrymë politike. Ana objektive e paanshmërisë partiake të presidentit të republikës, megjithatë, duhet interpretuar nga këndi i pritjes së arsyeshme, që nënkupton që dyshimi në animin e tij/saj partiak nuk është i mjaftueshëm që publiku ta paragjykojë shkeljen e parimit të përfaqësimit të unitetit të popullit: prandaj, arsyeja mbi animin e tij/saj duhet të jetë e faktuar. *Tre*, koncepti i përfaqësimit të unitetit të popullit nga ana e presidentit të republikës duhet diskutuar edhe në kontekst të paraardhësit apo prapavijës politike të presidentit. Për të qenë objektivisht i pranuar nga publiku si një autoritet i paanshëm ndaj skenës apo rrymave politike, në mënyrë që të përfaqësojë unitetin e popullit, pyetja është nëse presidenti i republikës duhet që të mos ketë qenë pjesë aktive apo pasive e ndonjë partie politike përpara se të vihej në detyrën e presidentit? Megjithëse kjo është një pyetje shumë e ngushtë, është logjikisht e pritshme që koncepti i presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit të gjej zbatim prej momentit kur presidenti merr detyrën e tij. Dhe, në fund, *katër*, koncepti i përfaqësimit të unitetit të popullit lind detyrën që presidenti i republikës të jetë kundërbalancues popullor ndaj politikave publike që nxjerr qeveria dhe parlamenti. Në këtë rol, presidenti i republikës është i detyruar që të shpreh qëndrimin unifikues popullor përballë politikave publike të institucioneve tjera, duke i kundërbalancuar ato me një qëndrim unifikues popullor. Megjithëse roli i presidentit është relativisht formal, është e pritshme që koncepti që ai/ajo është përfaqësues i unitetit të popullit të shfrytëzohet vetëm në rastet e politikave publike shumë të rëndësishme ku objektivisht publiku i gjerë pret që presidenti i republikës të reagojë duke kundërshtuar apo përkrahur një linjë të caktuar politikash publike me referim tek përfaqësimi i unitetit të popullit.

³⁵⁷ Presidenti Fatmir Sejdiu gjatë tërë kohës sa ka qenë në detyrë ka mbajtur dy pozitat, atë të shefit të shtetit dhe të shefit të partisë, Lidhjes Demokratike (LDK). Për këtë arsye Gjykata në verdiktin e saj pat gjetur se ai po bënte shkelje serioze kushtetuese. Cf Paragrafet 65-70. Aktgjykim: Rasti Nr. KI 47/10. 'Naim Rrustemi dhe 31 deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës', datë 28 shtator 2010, Nr. ref.: AGJ 43/10.

12. Prandaj, në përgjithësi, koncepti i funksionit të presidentit si përfaqësues i unitetit të popullit duhet të përbëjë parimin themelor që përcakton funksionin e presidenti të republikës, parim i cili duhet të ushtrohet nga ana e presidentit të republikës aktivisht dhe objektivisht si i tillë nga publiku i gjerë. Në këtë rol, megjithatë, presidenti i republikës duhet të jetë një figurë mbipartiake dhe mbietnike, të përfaqësoj dhe avancoj interesin e përgjithshëm popullor dhe shtetëror. Të gjitha kompetencat tjera që bart presidenti i republikës, prandaj, duhet shikuar nën dritën e këtij parimi, meqë presidenti i republikës, në ushtrimin e detyrave tjera të tij, nuk mund të dal jashtë obligimit që rrjedh nga ky parim.

Neni 84 [Kompetencat e Presidentit]

Presidenti i Republikës së Kosovës:

- (1) përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë;
- (2) garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë;
- (3) shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e parë të tij;
- (4) nxjerr dekrete në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (5) shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- (6) ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Të drejtën e rikthimit të një ligji mund ta shfrytëzojë vetëm një herë;
- (7) nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me këtë Kushtetutë;
- (8) propozon amendamente për këtë Kushtetutë;
- (9) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
- (10) udhëheq politikën e jashtme të vendit;
- (11) pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës;
- (12) është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës;
- (13) udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete;
- (14) cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit;
- (15) emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- (16) emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Republikës së Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- (17) emëron dhe shkarkon Kryeprokurorin e Shtetit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokuroial të Kosovës;
- (18) emëron dhe shkarkon prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozimin të Këshillit Prokuroial të Kosovës;
- (19) emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit;
- (20) emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit;

- (21) së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;
- (22) vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin;
- (23) mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së Jashtëzakonshme;
- (24) vendos për formimin e misioneve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin;
- (25) emëron dhe shkarkon shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë;
- (26) emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- (27) emëron Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i cili shërben edhe si Drejtor Menaxhues dhe emëron anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës;
- (28) jep medalje, mirënjohje dhe çmime, në pajtim me ligjin;
- (29) shpall falje individuale, në pajtim me ligjin;
- (30) së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushëveprimtarinë e tij/saj.

Neni 84

1. Neni 84 përcakton kompetencat specifike të presidentit të republikës,³⁵⁸ megjithëse disa prej tyre janë përcaktuar edhe nëpër disa nene tjera të Kushtetutës, por edhe mund të rrjedhin nga të dy parimet e përgjithshme të nenit 83. Të shohim më në detaje secilën kompetencë të presidentit të republikës, të dhënë me nenin 84.

Neni 84.1

1. Ky paragraf përcakton që presidenti i republikës përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë.³⁵⁹ Mbetet për t'u testuar në praktikë domethënia specifike e kësaj kompetence, sidomos sa i përket përfaqësimit të brendshëm. Në kuptimin e përgjithshëm, ky paragraf i jep presidentit të republikës funksionin e përfaqësimit të jashtëm të shtetit, duke nënkuptuar që presidenti i republikës është përfaqësuesi më i lartë i shtetit në botën e jashtme.

³⁵⁸ Si shembull interpretues, Gjykata Kushtetuese e Ukrainës në vendimin e saj, Nr. 3-rp/2008 theksoi se kompetencat e Presidentit janë të përcaktuara taksativisht me Kushtetutë. Kjo e bën të pamundur të miratohet ndonjë ligj që mund të shtojë të drejta apo detyrime shtesë për Presidentin. Shih Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës, Nr. 3-rp/2008, i datës 01.04.2008. Mbetet për interpretim nëse Neni 84 i kushtetutës duhet shikuar si *ndalues* për kompetenca shtesë për presidentin me anë të ligjeve të Kuvendit.

³⁵⁹ Duhet theksuar se kompetencat në fushën e brendshme dhe të politikës së jashtme dallojnë si në bazë të origjinës ashtu edhe në bazë të natyrës së tyre. Shih, Sutherland në Fisher, Louis (1988) 'Foreign Policy Powers of the President and Congress'. *Annals of the American Academy of Political and Social Science*. Vol. 499, Congress and the Presidency: Invitation to Struggle, p. 148-159.

2. Duhet thënë, megjithatë, që koncepti i përfaqësimit të shtetit në botën e jashtme është thjeshtë një kompetencë formale, pa substancë diskrecioni në vendimmarrje, në paraqitje të qëndrimeve të cilat presidenti duhet t'i përfaqësoj apo edhe në negociim të marrëdhënieve të shtetit me shtetet e huaja. Përfaqësimi jashtë dhe brenda shtetit, si një kompetencë e presidentit të republikës, nuk duhet të nënkuptohet si një kompetencë për të krijuar pozicion të cilin Kosova duhet ta mbajë në marrëdhënien e saj me botën e jashtme. Këtu, roli i presidenti të republikës është më shumë formal. Kjo, pra, nënkupton që ai/ajo materializon qëndrimin/vendimin mbi substancën e një marrëdhënieje të jashtme thjeshtë në nivel të përfaqësimit të shtetit.

Neni 84.2

1. Ky paragraf e vesh presidentin e republikës me kompetencën e garantimit të funksionimit kushtetues të institucioneve të përcaktuara me kushtetutë. Koncepti i “garantimit” të funksionimit kushtetues, megjithatë, është shumë diskutabil në kontekst të mekanizmeve që e mundësojnë këtë. Fillimisht, kjo kompetencë, në një interpretim tekstual, është shumë substancial në kuptim të veprimeve që mund të ushtrojë presidenti i republikës. Duhet thënë, megjithatë, që presidenti i republikës nuk është gardiani më i lartë i kushtetutës por as gardiani më kredibil për mbrojtjen e kushtetutës, meqë ky është një funksion që kushtetuta ia ka veshur Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, në kuptim të këtij paragrafi, kushtetuta i jep kompetencën presidentit të republikës për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve në kuadër të materializimit të kompetencave presidenciale. Në këtë aspekt, ky paragraf nuk mëton të jep ndonjë kompetencë shtesë për presidentin e republikës, por vetëm të vendos detyrimin që presidenti i republikës ka për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve në kuadër të kompetencave të tij specifike. Ky paragraf, megjithatë, e lë të hapur mundësinë e nënkuptimit të kësaj kompetence si të veçuar, duke nënkuptuar që presidenti i republikës shndërrohet në një mbrojtës të jetës institucionale kushtetuese dhe, për pasojë, ai/ajo mund të marrë për vete prerogativa në bazë të përcaktimit të tij/saj si garantues i funksionimit kushtetues të institucioneve të sistemit. Me një fjalë, kjo mund të keqkuptohet ashtu që presidenti i republikës të mund të mbjell praktika të kontrollit të institucioneve tjera shtetërore në bazë të ‘detyrimit’ të tij formal për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve kushtetuese. Kjo, sigurisht, nuk është kështu sepse ky paragraf e vesh presidentin e republikës me rolin e një kundërbalancuesi të vetëm kushtetues të institucioneve tjera shtetërore, gjë që nënkupton se materializimi i këtij funksioni nga ana e presidenti të republikës nuk mund të prek në kufijtë e pavarësisë së institucioneve/pushteteve të ndara.
2. Në fund, është e rëndësishme të ceket që ky paragraf nuk mund të paragjykohet që të ‘imitojë’ rolin e gjykatës kushtetuese, meqë institucioni i presidentit të republikës nuk është mekanizëm me garancione standardesh që të mund të ushtrojë rolin e një gardiani gjyqësor të kushtetutës. Në këtë kuptim, presidenti paraqitet si garantues i funksionimit të institucioneve kushtetuese, jo i vetë Kushtetutës në kuadrin e sistemit të tërësishëm të ndarjes së pushteteve. Ky fakt është vënë në pah

në Aktgjykimin e Gjykatës për “Shefin e Shtetit” ku është theksuar, *inter alia*, se funksioni i garantuesit të funksionimit të institucioneve kushtetuese e bën presidentin pikën kyçe në realizmin e doktrinës së ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre (paragrafët 257-258).

Neni 84.3

1. Ky paragraf përcakton rolin formal që ka presidenti i republikës për të shpallur zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Duhet thënë që kjo është një kompetencë formale e presidentit të republikës, dhe që kjo kompetencë ushtrohet nga ai/ajo në bazë të funksionit të tij/saj ceremonial si kreu i shtetit. Në ushtrimin e kësaj kompetence, presidenti i republikës nuk gëzon diskrecion vendosjeje, meqë vendimi për të shpallur zgjedhjet është i paralidhur me disa kushte të tjera. Në këtë aspekt, kjo kompetencë nuk ka asnjë ngjashmëri (dhe nuk duhet kuptuar) me të drejtën e presidentit për të shpërndarë parlamentin. Shpërndarja e parlamentit, prandaj, nuk është kompetencë (e drejtë) e presidentit të republikës, dhe nuk jepet as në mënyrë implicite me këtë paragraf kushtetues.
2. Për të materializuar shpalljen e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, presidenti i republikës është i paralidhur për katër kushte alternative: a) që Kuvendi të ketë kaluar një mocion mosbesimi ndaj qeverisë së Kosovës; b) që Kuvendi të ketë vendosur, sipas përcaktimit kushtetues, shpërndarjen e tij; c) që Kuvendi të ketë dështuar në zgjedhjen e presidentit të republikës, dhe që shpërndarja e Kuvendit të ketë ndodhur *ipso iure*; dhe c) që të ketë përfunduar mandati i rregullt kushtetues i Kuvendit, që nënkupton lindjen e detyrimit për shpalljen e zgjedhjeve të reja.
3. Sikundër vërehet, kompetenca e presidentit të republikës për të shpallur zgjedhjet e Kuvendit është e lidhur për rrethanat e caktuara që duhet të paraqiten: presidenti i republikës nuk ka diskrecion në shpalljen e zgjedhjeve sipas dëshirës së tij/saj sepse ajo çështje është një rrjedhje logjike e një procesi kushtetues ku hallka e fundit, pra presidenti i republikës, duhet që ta bëjë vetëm shpalljen formale për mbajtjen e tyre. Përveç shpalljes së zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, presidenti i republikës ka kompetencë të thërras mbledhjen e parë të tij. Edhe kjo është një kompetencë ceremoniale, të cilën presidenti e ushtron në formën e një detyrimi që të thërras mbledhjen e parë të Kuvendit pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga ana e institucioneve përgjegjëse. Edhe kjo kompetencë ushtrohet nga ana e presidentit të republikës në kuadër të funksionit të tij ceremonial si kreu i shtetit dhe nuk nënkupton që presidenti të vendos mbi këtë çështje sipas dëshirës së tij/saj. Shkurt, as në ushtrimin e kësaj kompetence, presidenti nuk disponon me diskrecion.

Neni 84.4

1. Ky paragraf përcakton kompetencën e presidentit të republikës për të nxjerr dekrete për materializimin e funksionit të tij kushtetues. Kjo kompetencë e presidentit të republikës duhet shikuar në kontekst të materializimit të kompetencave të veçanta

të presidentit gjë që nënkupton se presidenti i republikës e materializon funksionin e tij kushtetues përmes nxjerrjes së dekretëve. Dekretet, në kuptim të këtij paragrafi, janë akte juridike individuale që e zbatojnë një kompetencë të caktuar të presidentit duke e aplikuar normën e përgjithshme mbi një rast individual (case). Prandaj, materializimi i funksioneve të presidentit të republikës, në kuptim të nenit 84, bëhet duke lëshuar dekrete, procedurë e cila e zbaton mbi një rast individual një kompetencë abstrakte të presidentit të republikës.

Neni 84.5 & 84.6

1. Këto dy paragrafe nuk bëjnë pjesë në kuadër të të ashtuquajturës kompetencë legislative të presidentit të republikës nga neni 79 i Kushtetutës. Këto dy paragrafë e veshin presidentin e republikës me disa garancione kushtetuese të cilat mundësojnë kundërbalancimin e thjeshtë të pushtetit legjislativ. Të dy këto paragrafe, prandaj, përbëjnë dy kompetenca të ndara të presidentit të republikës të cilat luajnë rol të njejtë.
2. Sa i përket kompetencës së shpalljes së ligjeve të miratuara në Kuvend, kjo është një kompetencë formale e presidentit të republikës të cilën e ushtron në kuptim të funksionit të tij kushtetues si kreu i shtetit. Prandaj, shpallja e ligjeve nga ana e presidentit të republikës - si një kompetencë kushtetuese - është thjeshtë e natyrës formale, dhe nuk nënkupton që presidenti i republikës mund të refuzojë të shpall një ligj nëse ai është miratuar dhe e ka kaluar fazën e kontrollit presidencial. Kjo do të thotë se ligji mund të “bëhet” i tillë vetëm pasi që të jetë shpallur nga ana e presidentit të republikës.³⁶⁰ Presidenti, megjithatë, të drejtën për kontroll kushtetues të një ligji e ushtron sipas paragrafit 6. Nëse presidenti i republikës nuk e ka ushtruar të drejtën e kthimit të ligjit sipas paragrafit 6, ose nëse rikthimi i një ligji nga ana e presidentit të republikës është rrëzuar me një votim të sërishëm në Kuvend, atëherë presidenti është i detyruar ta shpall ligjin e tillë. Këtu, presidenti i republikës nuk gëzon fare diskrecion, dhe thjeshtë e materializon një detyrim ceremonial të funksionit të tij si kreu i shtetit. Në këtë relacion, Gjykata Kushtetuese e Polonisë ka vendosur që presidenti i republikës nuk gëzon kompetencë ta nënshkruajë asnjë ligj i cili është vlerësuar nga Tribunali Kushtetues të jetë në kundërshtim me Kushtetutën.³⁶¹ Në kuptim të kësaj praktike, nëse një ligj i caktuar është vlerësuar në ndonjë formë si kundërkushtetues nga ana e Gjykatës Kushtetuese, kompetenca e presidentit të republikës nga ky nen i kushtetutës nuk mund të shfrytëzohet për të nënshkruar një ligj të tillë.
3. Sa i përket paragrafit 6, presidenti i republikës gëzon kompetencën për të rikthyer një ligj të caktuar në Kuvend nëse ligji i tillë, sipas vlerësimit të presidentit, është

³⁶⁰ Si shembull krahasues, Tribunali Kushtetues i Polonisë në rastin K 37/05 theksoi se publikimi i një ligji është parakusht për hyrjen në fuqi të tij. Rrjedhimisht, një akt normativ nuk paraqet burim të së drejtës së obligueshme brenda kuptimit të dispozitave kushtetuese derisa të shpallet ashtu siç parashihet me dispozitat kushtetuese. Shih Vendimin e Tribunalit Kushtetues të Polonisë K-37/05 i datës 25.10.2005.

³⁶¹ Vendim i Tribunalit Kushtetues të Polonisë W 1/95 i datës 05.09.1995.

në kundërshtim me “interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj”. Kjo kompetencë është një e drejtë vetoje suspensive e presidentit të republikës, megjithëse është një veto e tipit të një sistemi qeverisës të pastër parlamentar. Kompetenca e presidentit të republikës për ta kthyer një ligj të caktuar për rishqyrtim në Kuvendin e Kosovës duhet të ketë plotësuar këto kushte:

- a) që ligji të jetë miratuar në procedurë finale në Kuvendin e Kosovës, dhe të jetë nënshkruar nga ana e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, sipas procedurës së ligjdhënies. Kjo nënkupton që një akt juridik i miratuar nga ana e Kuvendit, me përmbajtje të një ligji, nuk mund t’i procedohet presidentit të republikës për shpallje përpara se t’i ketë kaluar procedurat e miratimit final (p.sh. leximin e tretë);
 - b) në vlerësimin e ligjit, presidenti i republikës është i kufizuar në kontrollin e ligjit vetëm në dy aspekte: 1) nëse ligji është në përputhje me interesat legjitime të Kosovës, që është një koncept që i lejon presidentit të republikës një diskrecion të gjerë vendosjeje dhe vlerësimi, dhe 2) nëse ligji është në përputhje me interesat e një apo më shumë komuniteteve etnike në Kosovë. Prandaj, presidenti i republikës mund ta kthejë ligjin në rishqyrtim thjeshtë dhe vetëm mbi këto dy baza; dhe
 - c) kjo e drejtë e presidentit të republikës mund të shfrytëzohet vetëm një herë.
4. Kompetenca për të rikthyer në shqyrtim një ligj në Kuvendin e Kosovës, prandaj, është një kompetencë ku presidenti i republikës ka diskrecion të plotë për të vlerësuar shfrytëzimin e saj. Në materializimin e kësaj kompetence, megjithatë, presidenti i republikës gëzon jo thjeshtë të drejtën e kontrollit të procedurës së ndjekur por edhe substancës së vet ligjit. Nëse shikohen bazat mbi të cilat mund të shfrytëzohet kjo kompetencë e presidentit, është lehtësisht e kuptueshme që presidenti i republikës duhet të veprojë në pozicionin e tij si përfaqësues i unitetit të popullit, jo thjeshtë në aspektin politik por edhe atë etnik. Kontekstualizimi i kësaj kompetence nga ana e presidentit jo thjeshtë që duhet të plotësojë kushtet që e bëjnë vendimin e tij të shihet në publik në linjë me parimet e nenit 83, por edhe që pasojat nga vendimi i tillë të kenë qëllim arritjen e një objektivi që qëndron në linjë me parimet e tilla. Kjo kompetencë, megjithatë, siç është vendosur në një rast edhe nga Gjykata Kushtetuese e Bjellorusisë, nuk nënkupton që kjo t’i jap presidentit të republikës të drejtën e shfuqizimit, ndryshimit apo pezullimit të ligjeve që janë në fuqi.³⁶² Në anën tjetër, sipas Gjykatës Kushtetuese të Afrikës së Jugut, kjo kompetencë assesi nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që të nënkuptoj që Kuvendi ka të drejtë t’i bartë presidentit të republikës kompetencën për nxjerrjen e ligjeve, gjë që mbetet absolutisht e ndaluar.³⁶³
5. Kompetenca për të rikthyer në shqyrtim një ligj në Kuvendin e Kosovës, në kuptimin e interpretimit sistemor, është lehtësisht e kalueshme nga ana e mazhorancës në Kuvend, meqë rivotimi i ligjit në fjalë duhet të bëhet me pragun e njëjtë të votave i cili është kërkuar për miratimin e tij të parë. Me një fjalë, nëse

³⁶² Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bjellorusisë, Nr. J-18/95 i datës 27.10.1995.

³⁶³ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Jug-Afrikane, Nr. CCT 27/95 i datës 22.09.1995.

votimi i dytë nuk i mbledh votat e shumicës së krejt deputetëve, atëherë del se Kuvendi ka votuar sërish për versionin e vet dhe jo për veton e presidentit të republikës. Megjithatë, nëse presidenti i republikës vjen nga një parti që është pjesë e mazhorancës qeverisëse, apo nëse kontrollon një numër deputetësh që i përkasin mazhorancës, atëherë e drejta e tij për rikthim në shqyrtim të një ligji mund të kthehet në një kundërbalancim dhe bllokim total të ligjit në fjalë në votimin e dytë, duke bërë që ky model vetoje të ketë kosto të lartë kontrolluese ndaj veprimtarisë legislative të Kuvendit.³⁶⁴ Nga kjo del se fuqia e kësaj të drejte të presidentit të republikës varet shumë nga numri i deputeteve që presidenti mund t'i kontrolloj brenda mazhorancës që ka votuar për ligjin në raundin e parë.³⁶⁵

Neni 84.7

1. Ky paragraf i jep presidentit të republikës kompetencën për të nënshkruar traktatet ndërkombëtare, në pajtim me këtë kushtetutë. Fillimisht, duhet shpjeguar që kushtetuta parasheh dy lloje të traktateve ndërkombëtare: a) traktate ndërkombëtare që duhen ratifikuar në Kuvend,³⁶⁶ përpara se të nënshkruhet nga ana e presidentit të republikës; dhe b) traktate ndërkombëtare që hyjnë në fuqi vetëm më nënshkrimin e presidentit të republikës³⁶⁷. Në rastin e traktateve të para, kompetenca për të bërë marrëveshje ndërkombëtare, dhe për të negociuar

³⁶⁴ Krahasoje me argumentin për modelin francez: Suleiman, N. Ezra, 'Presidentialism and Political Stability in France' in Linz, J. Juan, and Valenzuela, Arturo (eds.) (1994) *The Failure of Presidential Democracy*, Vol. 1'. Baltimore-Maryland and London: The Johns Hopkins University Press.

³⁶⁵ Deri më sot, Gjykata ka pasur rastin të deklarohet vetëm një herë për këtë të drejtë të presidentit. Në rastin Nr. K057/12, të datës 20 shtator 2012, shefi i shtetit kosovar kërkonte nga Gjykata që të tregonte nëse ka pasur shkelje të të drejtës së saj të vetos nga neni 80.4 i Kushtetutës, me rastin e miratimit të Ligjit Nr. 04/1-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në këtë rast Gjykata vendosi se presidenti i republikës, duke kthyer ligjin në Kuvend për rivotim, kishte gabuar kur kishte bërë amendamente në ligj sepse kjo nuk është e drejtë e presidentit që përfshihet më këtë paragraf që diskutohet këtu. Siç u tha më sipër, presidenti i republikës ka iniciativën legislative sipas nenit 79 të Kushtetutës. Ai/ajo mund ta shfrytëzoj këtë të drejtë për të propozuar ligje tërësisht të reja, në kuadër të realizimit të kompetencave të veta si shef i shtetit. Në rastin në fjalë, presidenti i Kosovës, zonja, Atifete Jahjaga, kishte bërë jo iniciativë legislative por kishte kthyer për rivotim Ligjin si më sipër, së bashkë me disa amendamente dhe ishte rrëzuar në këtë kërkesë të sajën nga Kuvendi meqë vetoja e presidentit nuk kishte marrë shumicën e votave të të gjithë deputetëve, siç kërkohen në paragrafin 4 të nenit 80 të Kushtetutës. Cf. Aktgjykim, Nr. K057/12, Kërkesa e Presidentes së Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së Saj, Atifete Jahjaga, me të cilën konteston votimin për miratimin e Ligjit Nr. 04/1-084 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, datë 20 shtator 2012, Nr. ref.: AGJ297/12, paragrafët 62-77.

³⁶⁶ Cf. nenet 18.1 dhe 65.4 të Kushtetutës. Vlen të theksohet këtu se procedura e ratifikimit në Kuvend mund ta nxjerr jashtë presidentin nga kontrollimi i substancës së marrëveshjeve të negociuara me shtetet tjera. Shih një model të ikjes nga kjo procedurë e vështirë të cilën e shfrytëzon presidenti amerikan, në Krutz, G. S. and Peake, J. S (2006) 'The Changing Nature of Presidential Policy Making on International Agreements'. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 36, p. 391-409.

³⁶⁷ Cf. Neni 18.2 i Kushtetutës.

substancën e tyre, i takon Kuvendit dhe ekzekutivit, pra është një kompetencë e ndarë. Në rastin e traktateve të dyta, kompetenca për të bërë marrëveshje ndërkombëtare dhe për të negociuar substancën e tyre i takon plotësisht presidenti të republikës. Duhet thënë që, ky paragraf, i jep presidentit të republikës diskrecion vlerësimi nëse dëshiron ta nënshkruaj apo jo një marrëveshje të caktuar ndërkombëtare, përveç atyre nga neni 18.1 i Kushtetutës, pavarësisht nëse ajo është ratifikuar në Kuvend paraprakisht. Presidenti i republikës, megjithatë, mund t'ia bartë autorizimin për negociimin e marrëveshjeve ndërkombëtare qeverisë apo institucioneve tjera, por që një marrëveshje ndërkombëtare ku Kosova është palë nuk bëhet me fuqi juridike përpara se të jetë nënshkruar nga ana e presidentit të republikës.

2. E drejta për të nënshkruar traktatet ndërkombëtare në emër të Kosovës, prandaj, e vesh presidentin e republikës me një autoritet shumë të fuqishëm të politikës së jashtme.³⁶⁸ Për më tepër, negociimi i çfarëdo marrëveshje ndërkombëtare, përveç atyre nga neni 18.1 i Kushtetutës, mund të bëhet vetëm nën autorizimin e dhënë nga ana e presidentit të republikës.³⁶⁹ Në të kundërtën, negociimi i substancës së një marrëveshjeje ndërkombëtare pa autorizimin paraprak të dhënë nga ana e presidentit të republikës, përveç atyre nga neni 18.1 i Kushtetutës, duhet shikuar si në kundërshtim me këtë paragraf. Duhet thënë që në kuptim të këtij paragrafi, traktatet ndërkombëtare janë aktet juridike ndërkombëtare në kuptim të Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve. Marrëveshjet ndërkombëtare të pashkruara, pra marrëveshjet ndërkombëtare verbale, nuk hyjnë në kuadër të kuptimit të këtij paragrafi,³⁷⁰ sepse natyra parlamentare e sistemit kosovar të qeverisjes, për dallim nga rastet e sistemit presidencial, nuk lejon një mundësi të tillë.

Neni 84.8

1. Ky paragraf i jep të drejtën presidentit të republikës për të propozuar amendamente kushtetuese, të cilat pastaj hyjnë në procedurën e miratimit sipas përcaktimit të vet kushtetutës. Statusi i iniciuesit të procesit të amendamentimit të kushtetutës, në kuptim të presidentit të republikës, është një e drejtë që e bën presidentin aktor në amendamentimin e kushtetutës. Logjika prapa kësaj të drejte lidhet me mundësinë që presidenti i republikës të ketë hapësirën e duhur për të materializuar konceptin e përfaqësimit të unitetit të popullit duke propozuar amendamente kushtetuese që kanë qëllim një objektiv të tillë. Shikuar në ndërlidhmëri me Nenin 83, ky paragraf e

³⁶⁸ Shih p.sh. në rastin amerikan: Reter, R. F (1982) 'President Theodore Roosevelt and the Senate's "Advice and Consent" to *Treaties*'. *Historian*. Vol. 44, p. 483-504.

³⁶⁹ Shih p.sh. rastin amerikan sa i përket kompetencës reale për negociimin e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe konceptin e tillë: Fisher, L (2008) 'The Law *Treaty* Negotiation: A Presidential Monopoly?'. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 38, p. 144-158.

³⁷⁰ Presidentët amerikan e shfrytëzojnë praktikën e nënshkrimit të marrëveshjeve ekzekutive me shtetet në botë, për t'i ikur procedurës së rëndë të ratifikimit të traktateve nga ana e senatit. Shih p.sh: Martin, L. L (2005) 'The President and International Commitments: Treaties as Signaling Devices'. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 35, p. 440-465. Shih gjithashtu: Krutz, G. S. and Peake, J. S (2006) 'The Changing Nature of Presidential Policy Making on International Agreements'. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 36, p. 391-409.

detyron presidentin e republikës që shfrytëzimin e kësaj të drejte ta bëjë në kuptim të funksionit të tij/saj si përfaqësues i unitetit të popullit, dhe i substancializimit të qëllimeve nga ky funksion. Një shembull shumë i mirë ekziston në kuptim të precedentit gjyqësor sllovak, ku Gjykata Kushtetuese vendosi që njëra nga katër pyetjet në referendum, e vendosur me vendim të Presidentit, nuk është në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe me ligjin në fuqi, pasi që me Kushtetutë nuk ka asnjë dispozitë që lejon ndonjë autoritet t'i bashkangjesë një propozim të një amendamenti kushtetues si një pyetje në referendum, ashtu siç bëri Presidenti sllovak.³⁷¹ Shikuar në këtë kontekst, neni 84.8 i Kushtetutës nuk duhet lexuar si mjet për presidentin e republikës që të vendos në referendum një propozim të tij për amendamente kushtetuese. Në ushtrimin e të drejtës për amendamente kushtetuese, presidenti i republikës në kuptim të këtij neni duhet të jetë i liruar nga ndikimi i çfarëdo vendimmarrjeje të jashtme, dhe duhet të veproj individualisht dhe i pavarur.

Neni 84.9

1. Ky paragraf i vesh të drejtën presidentit të republikës për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Shikuar në aspektin e përgjithshëm, pozita e palës së legjitimuar për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese i jep hapësirë presidentit të republikës për të materializuar në një mënyrë apo tjetër kompetencën e tij si “garantues” i funksionimit kushtetues të institucioneve kushtetuese. Dy janë çështje të rëndësishme: a) çfarë lloj pyetjesh mund të referoj presidenti i republikës në kuptim të këtij neni?; dhe b) çfarë është efekti juridik i pyetjes që bën presidenti i republikës?
2. Sa i përket pyetjes së parë, në kuptim të këtij paragrafi, nocioni “çështje kushtetuese” mund të kuptohet në dy kuptime, të ngushtë dhe të gjerë. Në kuptim të gjerë, termi “çështje kushtetuese” i referohet çdo parashtrese që presidenti i republikës mund të dërgoj në Gjykatën Kushtetuese. Në kuptim të ngushtë, parashtresa që mund ta dërgoj presidenti mund dhe duhet konsideruar vetëm në kuptim të atyre çështjeve brenda juridiksionit të rregullt të Gjykatës Kushtetuese të përcaktuar nga neni 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetutës.. Kjo do të thotë se pyetjet që mund t'i dërgoj në Gjykatën Kushtetuese presidenti i republikës duhen parë në kontekst të plotësimi të kushteve që lidhen me juridiksionin e vet Gjykatës të përcaktuar me Kushtetutë. Prandaj, nocioni “çështje kushtetuese” nuk i referohet çfarëdo lloj pyetjeje, por një parashtrese që e vë në lëvizje cilindo juridiksion të cilin e ka Gjykata Kushtetuese sipas Kushtetutës. Në praktikën e deritanishme të Gjykatës, megjithatë, nuk ka gjetur zbatim kuptimi i ngushtë por ai i gjerë i termit “çështje kushtetuese”. Ky përfundim rrjedh nga analizimi i disa rasteve të cilat janë ngritur pranë Gjykatës Kushtetuese, njëri prej të cilëve janë ngritur nga qeveria duke u mbështetur në formulimin tërësisht të njëjtë të nenit 93.10 të Kushtetutës ku thuhet se qeveria, *inter alia*, “mund të referoj çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese”.³⁷²

³⁷¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, Nr. II.US 31/97, i datës 21.5.1997.

³⁷² Rasti i parë kërkesës për sqarim të cilin nga Gjykata Kushtetuese e kërkonte qeveria, në bazë të nenit 93.10 të Kushtetutës i referohej një kërkesë për sqarim të bërë nga Qeveria, sërish në bazë të nenit 93.10 të Kushtetutës, me të cilin kërkohet nga Gjykata që të bënte të qartë për

3. Në rastin e parë, Presidenti i Republikës kërkoi që Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 84.9 i cili përcakton se presidenti mund të referoj çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese, sqaronte për nevojat e tij se cili institucion ishte përgjegjës për të vlerësuar efektshmërinë dhe validitetin e dorëheqjes dhe për të konstatuar

Qeverinë nëse duhen proceduar në Kuvend me zgjedhjen e shefit të shtetit nëse parapraakisht dihet që nuk do të ketë në sallë mbi tetëdhjetë (80) deputetë, kurse në rastin e dytë nga Gjykata u kërkua një interpretim abstrakt, tekstual, i dispozitave të neneve përkatëse të Kushtetutës që flasin për imunitetin dhe privilegjet e funksionarëve të lartë të Shtetit të Kosovës. Më një fjalë, këtu Qeveria kishte kërkuar që Gjykata të sqaronte caqet dhe vëllimin e imunitetit dhe privilegjeve të funksionarëve të lartë shtetëror të Kosovës.

Derisa në rastin e parë Gjykata kishte refuzuar shqyrtimin meritore të rastit sepse bazohej në një gjendje hipotetike që pritej të ndodhte në të ardhmen, pra votimi i shefit kosovar të shtetit pas vendimit të Gjykatës që shpallte antikushtetues vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e z. Behxhet Pacolli për President të Kosovës më 22 shkurt 2011, në rastin e dytë Gjykata shqyrtoi meritat e rastit. Ato merita të rastit të dytë kishin të bënin jo me një gjendje faktike por më një interpretim abstrakt dhe hipotetik të neneve përkatëse të Kushtetutës që flasin për imunitetin dhe privilegjet e funksionarëve të lartë shtetëror të Kosovës. Me një fjalë, Gjykata nuk vlerësoi kushtetutshmërinë e një norme ligjore të përmbajtur në një draft-ligj, as të një norme kushtetuese të përmbajtur në një draft-amendament kushtetues, por bëri interpretim abstrakt dhe tërësisht hipotetik të caqeve dhe vëllimit të imunitetit dhe privilegjeve të funksionarëve të lartë shtetëror. Sikundër mund të vërehet, në këto dy raste dhe në rastet e ngritura nga Presidenti dhe ushtruesi i detyrës së Presidentit Gjykata ka bërë një interpretim ekstensiv të juridiksionit të vet nga nenet 113, paragrafët 2 dhe 3 të Kushtetues, duke pranuar si palë të autorizuar Qeverinë dhe Presidentit për ngritje të “çdo çështje kushtetuese” pranë Gjykatës. Kjo efektivisht do të thotë se cilësia e të qenurit president dhe qeveri përcaktojnë se çka është “çështje kushtetuese”, jo juridiksioni i Gjykatës sipas nenit 113, paragrafët 2 dhe 3. Cilësimi që Presidenti dhe Qeveria ia bëjnë një çështje e përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese tani e tutje. Këtu kemi të bëjmë me vendime interpretuese, të cilat njihen në mënyrë shprehimore në disa vende, si p.sh. në Itali dhe deri vonë në Bullgari, por ka raste kur vetë gjykatat, si në rastin e Kosovës, kanë bërë interpretim ekstensiv të dispozitave kushtetuese për t’i krijuar vetes një juridiksion shtesë. Për rastin e Italisë dhe të Bullgarisë, Cf. Herman Schwartz, (2000) ‘The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe’. Chicago: The University of Chicago Press, p. 164-193; Rolla, Giancarlo and Groppi, Tania ‘Between Politics and the Law: The Development of Constitutional Review in Italy’, në Wojciech Sadurski (ed.) (2010) ‘Constitutional Justice East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in A Comparative Perspective’. The Hague Kluwer Law International, p. 143-159; Për rastin e krijimit të këtij juridiksioni përmes interpretimit ekstensiv të dispozitave kushtetuese, Cf. Brewer-Carias, R., Allan (2011) ‘Constitutional Courts as Positive Legislators. A Comparative Law Study’. Cambridge: Cambridge University Press, Kapitulli 5 ‘Constitutional Courts as Legislators on Matters of Judicial Review’, fq.173-188. Në këtë kapitull, autori jep një analizë komparative të rasteve të gjykatave të cilat krijojnë rregulla materiale dhe procedurale në dobi të zgjerimit të juridiksionit të tyre vetanë. Për aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të diskutuar këtu: Cf. Sqarim i Aktgjykimit në Rastin Nr. KO 29/11 ‘Sabri Hamiti dhe deputetë të tjerë’. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, të 22 shkurtit 2011, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, ‘Sqarimet e kërkuara për Vendimin e shumicës, të 30 marsit 2011’, datë: me 1 prill 2011, Nr. ref.: SQ 111/11. Paragrafët 14-19; dhe Aktgjykim në Rastin Nr. K098/11, ‘Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës’, datë 20 shtator 2011, Nr. ref.: AGJ138/11, paragrafët 4, dhe 51-135.

përfundimin eventual të mandatit të kryetarit të një komune në bazë të një komunikate drejtuar qytetarëve, paqartësia e së cilës ia bënte të pamundur Presidentit veprimin e mëtejshëm në përputhje me parimin kushtetues për zgjedhje të lira dhe të barabarta³⁷³. Rasti tjetër u paraqit nga ushtruesi i detyrës së Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, po ashtu në bazë të nenit 84.9, i cili kërkonte që Gjykata Kushtetuese t'i jepte një sqarim nëse ushtruesit të detyrës së Presidentit i ndalohej mbajtja dhe ushtrimi i postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë demokratike të Kosovës (PDK).³⁷⁴

4. Sa i përket pyetjes së dytë për sa më sipër, efekti juridik i parashtrësës që mund ta dërgojë presidenti i republikës është i njëjtë me efektin juridik të çdo pale tjetër të autorizuar. Në këtë aspekt, pyetjet që mund t'i parashtrojë Gjykatës Kushtetuese presidenti i republikës nuk kanë efekt juridik tjetër, pos të asaj të një pale të autorizuar që mund të vejë në lëvizje juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.
5. Është e rëndësishme, gjithashtu, të kihet parasysh që kjo kompetencë e presidentit të republikës duhet kuptuar në kuptim të ngritjes së çështjeve në Gjykatën Kushtetuese të cilat ai/ajo i has gjatë ushtrimit të kompetencave të garantuara me Kushtetutë e me qëllim të realizimit të rolit primar të Presidentit të Republikës si përfaqësues i unitetit juridik-kushtetues të popullit të Kosovës dhe si garantues i funksionimit normal të institucioneve të sistemit kushtetues kosovar.

Neni 84.10

1. Ky nen përcakton që presidenti i republikës udhëheq politikën e jashtme të shtetit. Koncepti “udhëheq” mbetet pika më kontestuese e tërë autoritetit të presidentit të republikës. Dy janë kontestet kryesore: a) nëse koncepti “udhëheq” i përcaktuar me këtë nen të kushtetutës njëkohësisht e përcakton presidentin si shefin e politikës së jashtme, i cili e udhëheq i vetëm politikën e jashtme të shtetit, pa asnjë bashkëvendimarrës? dhe, b) nëse në kuptim të këtij paragrafi ka ndonjë dallim në mes të konceptit “udhëheq” dhe “qeveris”?³⁷⁵ Për ta shtruar këtë çështje në nivel më të ulët, duhet sqaruar që kushtetuta njëkohësisht lejon mekanizma të tjerë

³⁷³ Aktgjykim. Rasti Nr. K.O. 80/10, ‘Kërkesa e Presidentit të Republikës së Kosovës, Shkëlqesisë së tij, Dr. Fatmir Sejdiu, për sqarim të kompetencave në rastin e kryetarit të Rahovecit, z. Qazim Qeska’, datë 7 tetor 2010, Ref. nr. AGJ: 46/10, paragrafi 10.

³⁷⁴ Aktgjykim. Rasti Nr. K.O. 97/10, ‘Kërkesa e parashtruar nga Ushtruesi i Detyrës së Presidentit, Dr. Jakup Krasniqi, lidhur me mbajtjen e postit të Ushtruesit të Detyrës së Presidentit dhe njëkohësisht të postit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK)’ datë 22 dhjetor 2010, Ref. Nr. AGJ 78/10.

³⁷⁵ Në këtë kuadër, një vendim i Gjykatës Supreme të SHBA-së, ndër të tjera, përcakton parimin që presidenti mund të veproj dhe të merr përsipër detyrime në emër të SHBA-së në kuadër të politikës së jashtme pa autorizimin e Kongresit, për aq kohë dhe duke u kujdesur që veprimi i tij nuk është në kundërshtim me ndonjë akt të Kongresit. Shih për më shumë: Fisher, Louis (1988) ‘Foreign Policy Powers of the President and Congress’. *Annals of the American Academy of Political and Social Science*. Vol. 499, Congress and the Presidency: Invitation to Struggle, p. 148-159.

qeverisës të cilët bartin kompetencën e të marrit me punët e jashtme të shtetit, siç është Qeveria.

2. Për ta shpjeguar në mënyrë krahasuese, koncepti i famoz francez që “presidenti udhëheq ndërsa kryeministri qeveris” (“il regne et ne gouverne pas”) duhet të jetë pika zbërthuese e këtij paragrafi, koncept i elaboruar nga Benjamin Konstant (Benjamin Constant) për herë të parë.
3. Sado që ky koncept është elaboruar në një kontest tjetër, përkatësisht në kontekstin e monarkive kushtetuese të shekullit 19-të, më pastaj është pasuruar nga debati Shmit-Kelsen dhe praktikat kushtetuese të pas vitit 1945 e deri më sot. Koncepti “udhëheq”, prandaj, duhet marruar si kompetencë jo substanciale e vënë me këtë paragraf, pra si një atribut formal i autoritetit të presidentit. Në këtë aspekt, meqë ky paragraf e shënon në mënyrë shumë të qartë se “udhëheqja” e politikës së jashtme të shtetit është kompetencë e presidentit të shtetit, kjo nuk do të thotë se ajo nuk ndahet e as nuk konkurrohet nga ana e Qeverisë. Kjo nënkupton se presidenti i republikës është udhëheqësi i vetëm i politikës së jashtme, por në sensin formal (jo substancial) sepse në këtë autoritet ai/ajo kufizohet dhe kushtëzohet nga Qeveria dhe Kuvendi si organe respektivisht menaxhuese (Qeveria) dhe mbikëqyrëse (Kuvendi) të politikës së jashtme në një sistem parlamentar. Për ta shpjeguar më mirë këtë kompetencë kushtetuese, është e rëndësishme që të bëhet një dallim në mes të rolit të presidentit të republikës dhe qeverisë sa i përket politikës së jashtme. Në kuptim të këtij paragrafi, duhet kuptuar që rolin “udhëheqës” të politikës së jashtme e bart presidenti i republikës, përderisa qeverisjen (menaxhimin) e politikës së jashtme e bën qeveria e shtetit.
4. Në aspektin teknik, kjo ndarje në mes të rolit udhëheqës të politikës së jashtme, që është kompetencë e presidentit të republikës dhe rolit qeverisës/menaxhues të politikës së jashtme, që është kompetencë e Qeverisë, konsiston në këto dallime: a) udhëheqja e politikës së jashtme nënkupton të drejtën për të përcaktuar objektivat dhe linjat e drejtimit të politikës së jashtme, kurse qeverisja e politikës së jashtme nënkupton menaxhimin e mekanizmave për të arritur objektivat e përcaktuara; b) udhëheqja e politikës së jashtme nënkupton të drejtën e përfaqësimit më të lartë të shtetit në botën e jashtme, ndërsa qeverisja e saj nënkupton menaxhimin e instrumenteve në përfaqësimin e nivelit të dytë të Kosovës në botën e jashtme. Prandaj, koncepti i udhëheqjes së politikës së jashtme e vendos presidentin e republikës në pozicion të përcaktorit të linjave/ drejtimeve dhe objektivave të politikës së jashtme të shtetit, përderisa Qeveria (përkatësisht, organi i saj administrativ, Ministria e Jashtme) e bën materializimin e linjave të përcaktuara nga ana e presidentit. Në përgjithësi, ky paragraf e vendos një hierarki në kontekst të politikës së jashtme sa i përket institucionit të presidentit të republikës dhe qeverisë: është qartësisht e pranueshme që presidenti i republikës është autoriteti më i lartë i përcaktimit të politikës së jashtme të kuptim të linjave, përderisa qeveria i nënshtrohet këtyre objektivave dhe zbaton politika qeverisëse për t'i adresuar ato në praktikë.

5. Siç është vendosur nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, në ushtrimin e detyrave të tij për të kërkuar raporte nga Qeveria apo ministra të caktuar, siç mund të jetë rasti kushtetues i kërimit të përgjegjësive për zbatimin e politikës së jashtme, Presidenti nuk duhet të imponojë as procedura se si të përgatitet raporti e as afat kohor për dorëzimin e raportit të tillë.³⁷⁶ Një qëndrim i tillë i Gjykatës Kushtetuese ka për qëllim që të ruaj balancën në mes pushteteve, dhe njëkohësisht që të mos ndërtojë linja të kontrollit ndaj qeverisë që dalin jashtë kuptimit të kësaj norme.
6. Duhet thënë gjithashtu që, në vijim të përcaktimit të vijave të trasha të politikës së jashtme, Presidenti ndihmohet dhe ndikohet nga Kuvendi i cili gjatë ushtrimit të funksionit të tij mbikëqyrës, sipas nenit 65.12, të Kushtetutës mund t'i bëjë të qarta kahet e politikës së jashtme që kanë të bëjnë me çështjet kyçe nga neni 18.1 i Kushtetutës.

Neni 84.11

1. Ky paragraf përcakton kompetencën e presidentit për të pranuar letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituara në Republikën e Kosovës. Kjo kompetencë e presidentit të republikës është detyrë tipike e kreut të shtetit, e cila ka kryesisht funksion ceremonial. Në kuptim të pranimit të letrave kredenciale të diplomatëve të huaj, presidenti i republikës materializon detyrën e tij si përfaqësuesi më i lartë i shtetit në botën e jashtme. Përveç rëndësisë formale, për dallim nga paragrafi paraprak, ky paragraf nuk ka ndonjë rëndësi substanciale për autoritetin e presidentit të republikës.

Neni 84.12

1. Ky paragraf përcakton kompetencën e presidentit të republikës si Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë së Kosovës. Në kuptimin real, ky paragraf e bën presidentin e republikës shef të forcave të armatosura të shtetit si në kohë lufte ashtu edhe në kohë paqeje. Qenia Komandant Suprem, megjithatë, edhe në kuptim të këtij paragrafi, nuk nënkupton që presidenti i republikës është politik-bërësi dhe udhëheqësi i politikës ushtarake të shtetit. Prandaj, ky paragraf duhet lexuar thjeshtë në kuptimin teknik, si një kompetencë e presidentit të republikës për të komanduar - jo për të përcaktuar politikën publike të ushtrisë - Forcat e Sigurisë së Republikës. Në materializimin e kësaj të drejte, presidenti i republikës më shumë vepron si një autoritet formal - në kuptim të kreut të shtetit - se sa si një komandant praktik dhe real i forcave në fjalë.

Neni 84.13

1. Ky paragraf përcakton kompetencën e presidentit të republikës për të udhëhequr Këshillin Konsultativ për Komunitete, një organ kushtetues me mision mbrojtjen e interesit të komuniteteve. Si i tillë, duhet të kuptohet në lidhje të ngushtë me nenin

³⁷⁶ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, No. I. US 7/96 i datës 11.07.1996.

60 të Kushtetutës (“Këshilli Konsultativ për Komunitete”). Duke shpjeguar në mënyrë më të detajuar, koncepti i “udhëheqjes” me Këshillin Konsultativ për Komunitete, në kuptim të këtij paragrafi, nënkupton që Këshilli është një organ i presidentit të republikës dhe jo një trup kolegjal. Prandaj, presidenti i republikës udhëheq me Këshillin në fjalë, dhe e qeveris atë, edhe pse të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve supozohet se janë të përfaqësuar në procesin e vendimmarrjes në të. Pozita e udhëheqësit të Këshillit, dhe në përgjithësi pozicioni i Këshillit pranë presidentit të republikës, i jep ngjyrë përfaqësimi të unitetit të popullit në kuptim të interesave të komuniteteve të Kosovës. Në këtë mënyrë, kjo kompetencë e presidentit të republikës qëndron në përputhje me konceptin e multi-etnicitetit, barazisë para ligjit, mosdiskriminimit dhe parimeve e vlerave tjera të proklamuar dhe të mbrojtura nga Kushtetuta e Kosovës.

Neni 84.14

1. Ky paragraf e vesh presidentin e republikës me autoritetin për të caktuar mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose koalicionit të partive që përbëjnë mazhorancën në Kuvend. Shikuar në aspektin krahasues, kjo është një kompetencë tipike e presidentit të republikës në kuptim të funksionit të tij si kreu i shtetit. Dy gjëra janë të rëndësishme në këtë aspekt: a) nëse presidenti i republikës ka të drejtën që të kthej një kandidaturë për kryeministër, edhe nëse propozohet si i tillë nga partia/koalicioni i partive që kanë fituar shumicën në Kuvend?, dhe b) nëse presidenti i republikës gëzon të drejtën që të caktojë mandatarin e Qeverisë pa marrë propozimin e partisë/koalicionit që ka fituar shumicën e vendeve në Kuvend? Materializimi i kompetencës së presidentit për mandatimin e kandidatit për kryeministër, në kuptim të këtij paragrafi, nënkupton që presidenti i republikës është i lidhur dhe nuk ka diskrecion në vendosjen e kësaj çështjeje. Në rend të parë, kjo nënkupton se presidenti i republikës këtë kompetencë e ushtron thjeshtë në aspektin formal, si kreu i shtetit ashtu që ky paragraf nuk duhet nënkuptuar sikur i jep presidentit të republikës të drejtë ekzekutive për të gjykuar nëse kandidati i propozuar nga partia/koalicioni që ka fituar shumicën është i përshtatshëm. Së dyti, kjo do të thotë se presidenti i republikës këtë kompetencë e ushtron duke ndjekur pas propozimin e dhënë nga partia/koalicioni që ka fituar shumicën e votave në parlament, dhe që presidenti i republikës nuk gëzon të drejtën të mos e pranoj/refuzoj kandidatin e propozuar. Në fund, presidentit të republikës, në kuptim të këtij paragrafi, i ndalohet që të caktojë një mandatar pa e marrë propozimin nga pala e autorizuar.³⁷⁷ Në përgjithësi, prandaj, kompetenca e presidentit të republikës për të caktuar mandatarin e qeverisë është një detyrë ceremoniale, që nuk nënkupton të drejtën e tij për të refuzuar apo kërkuar ndryshimin e kandidatit që propozon partia/koalicioni fitues.

³⁷⁷ Në këtë kuptim, duhet argumentuar që caktimi i mandatarit për kryeministër është çështje e partisë/koalicionit politik dhe, në këtë linjë, presidenti është vetëm një zëdhënës i vendimit që marrin partitë politike. Shih për më shumë, Calise, Mauro (1994) ‘The Italian Particracy: Beyond President and Parliament’. *Political Science Quarterly*. Vol. 109, No. 3, Conference Issue: Presidential and Parliamentary Democracies: Which Work Best?, p. 441- 460.

1. Këta dy paragrafë përbëjnë të ashtuquajturat kompetenca gjyqësore të presidentit të republikës.³⁷⁸ Sipas përcaktimit të këtyre dy paragrafëve, presidenti i republikës emëron dhe shkarkon Kryetarin dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës sipas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Çështja e nocionit “emërim”, sipas përcaktimit të këtij paragrafi, duhet shikuar me shumë kujdes. Fillimisht, është e rëndësishme të ceket se, siç është shpjeguar edhe në kapitullin mbi standardet ndërkombëtare të emërimit, promovimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve, pavarësia e gjyqësorit kërkon integritet dhe kredibilitet në procesin e zgjedhjes, promovimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve. Kjo nënkupton se është vështirë e pranueshme që koncepti “emërim” dhe “shkarkim” siç përcaktohet me këta dy paragrafë, të nënkuptojë një kompetencë të pavarur të presidentit të republikës. Në këtë aspekt, komentimi logjik i këtyre dy koncepteve kushtetuese, të ndërlidhura me funksionin kushtetues të Këshillit Gjyqësor të Kosovës si sigurues/garantues i meritës së profesionit të gjyqtarëve, nënkupton që kompetenca e presidentit për “emërim” dhe “shkarkim” duhet të komentohet thjeshtë në aspektin ceremonial.
2. Prandaj, emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve, presidenti i republikës e bën duke mbështetur propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe duke ndjekur ngurtësisht propozimet e tij. Në kuptim të këtyre paragrafëve, presidenti i republikës nuk mund të kontrollojë meritën e “propozimeve” që vijnë nga Këshilli Gjyqësor sipas këtyre paragrafëve, gjë që nënkupton se ai/ajo nuk mund të ushtroj kontroll substancial mbi propozimet e Këshillit. Presidenti është thjeshtë i “detyruar” që t’i konfirmoj propozimet e tilla. E vetmja hapësirë që mund të shfrytëzohet nga ana e presidentit sa i përket propozimeve të Këshillit është kontrolli i rregullsisë së tyre procedurale: pra, nëse ato propozime janë nxjerrur në procedurën e paraparë. Nëse procedura e dhënies së propozimeve konstatohet të jetë në rregull, presidenti i republikës është i “detyruar” që t’i konfirmoj propozimet e Këshillit në formë të “emërimeve” apo “shkarkimeve”.
3. Në të kundërtën, sikur këto dy koncepte të këtyre dy paragrafëve të nënkuptonin të drejtën e presidentit për të ushtruar kontroll substancial ndaj propozimeve të Këshillit, pra që presidenti t’i gjykonte meritat e propozimeve të tilla, atëherë kjo do të ishte ndërhyrje e drejtpërdrejtë në pavarësinë e gjyqësorit dhe në vet rolin e Këshillit si garantues i vetëm i pavarësisë së gjyqësorit në kuptim të meritës së kryerjes së funksionit nga ana e gjyqtarëve. Prandaj, në përgjithësi, shikuar edhe në përputhje me dispozitat kushtetuese mbi Këshillin, gjyqësorin dhe standardet ndërkombëtare mbi emërimet, shkarkimet dhe promovimin, këta dy paragrafë i

³⁷⁸ Një shembull se si kompetencat gjyqësore në asnjë mënyrë nuk mund të nënkuptohet si të tilla që t’i lejojnë presidentit kryerjen e çfarëdo funksioni gjyqësor, është vendimi i Gjykatës Supreme të Meksikos e cila ka vendosur që urdhrat për bastisje të lëshuara nga autoritetet administrative janë kundërkushtetues. Sipas Kushtetutës, dhe bazuar në parimin e paprekshmërisë së shtëpive të qytetarëve, vetëm organet gjyqësore kanë kompetencë të lëshojnë urdhër për bastisje. Vendim i Gjykatës Supreme të Meksikos, Nr. 198 i datës 28.5.2003.

japin detyrimin presidentit që thjeshtë të “konfirmoj”, pra që të mos ketë të drejtë të refuzoj, propozimet e Këshillit, përveç nëse presidenti arsyeton që propozimet e tilla të Këshillit kanë shkelur procedurat e parapara sipas kushtetutës dhe ligjit. Duhet thënë këtu që kjo kompetencë e presidentit të republikës, siç është vendosur edhe nga Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut,³⁷⁹ nuk mund të shfrytëzohet për të zgjatur apo shkurtuar mandatin e të emëruarit gjyqësor të presidentit të republikës, sepse një formë e tillë e shtrirjes së kësaj kompetence është absolutisht kundërkushtetuese.

Neni 84.17 & 84.18

1. Këta dy paragrafë përcaktojnë kompetencën e presidentit të republikës për të emëruar dhe shkarkuar³⁸⁰ Kryeprokurorin dhe prokurorët e Shtetit të Republikës së Kosovës mbi bazën e propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. I tërë argumenti dhe logjika e shfrytëzuar në komentimin e dy paragrafëve paraparak gjen shprehje edhe në këta dy paragrafë. Prandaj, nuk është i nevojshëm komentimi shtesë. Përjashtim bën çështja e ushtruesit të detyrës së presidentit të republikës dhe kompetencat e tij/saj në rastet kur ky post aktivizohet.
2. Në praktikë ka pasur raste kur ushtruesi i detyrës së presidentit të republikës nuk ka respektuar këtë detyrim kushtetues të definuar si më sipër. Në kohën prej shtatorit 2010 deri në prill të vitit 2011 pozita e shefit të shtetit kosovar është mbajtur nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, si ushtrues detyre i presidentit të republikës në pritje të zgjedhjes së presidentit të ri. Në këtë interval kohor, ushtruesi i detyrës së presidentit të republikës bëri disa emërimet të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës. Në vijim të këtyre emërimeve, në të njëjtën kohë ai ka mohuar emërimin e disa gjyqtarëve pa dhënë asnjë arsye, qoftë procedurale apo materiale. Kjo rrethanë ka shërbyer si shkas për hartuesit e njëmbëdhjetë (XI) amendamenteve kushtetuese, njëri prej të cilëve, amendamenti VII, kufizonte të drejtat e ushtruesit të detyrës së presidentit të ardhshëm për të emëruar dhe shkarkuar gjyqtarë dhe prokurorë në të ardhmen kur të krijohej një situatë e tillë. Këtë pjesë të amendamentit shtatë (VII), Gjykata e shpalli jokushtetues, sepse, “drejtësia nuk mund të administrohet nëse gjyqtarët dhe prokurorët nuk janë në detyrë”. Kjo nënkupton se kjo e drejtë nuk mund të kufizohet në asnjë kohë se në çdo moment duhet të ketë gjyqtar e prokuror që kryejnë detyrat e tyre kushtetuese të administrimit të drejtësisë në Kosovë.³⁸¹

³⁷⁹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Jug-Afrikane, Nr. CCT 53/11, 54/11, 62/11, i datës 29.07.2011.

³⁸⁰ Si shembull, Gjykata Kushtetuese e Rusisë ka vendosur që Gjykata Kushtetuese e Federatës Ruse në vendimin e saj të datës 1 dhjetor 1999 vendosi që Këshilli Federal (dhoma e lartë e parlamentit) nuk ka juridiksion për të lëshuar dekret për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm nga funksionet e tij, gjatë periudhës hetuese për veprën penale të ngritur kundër tij. Sipas Kushtetutës, dhe në mungesë të ndonjë norme tjetër legislative, dekretet e tilla janë pjesë e detyrave të Presidentit. Shih: Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Federatës Ruse, i datës 1.12.1999.

³⁸¹ Cf. Paragrafët 162-167 nga Aktgjykimi në rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12, ‘Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23

1. Ky paragraf përcakton kompetencën e presidentit të republikës për të emëruar gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, sipas propozimit të Kuvendit.³⁸² Fillimisht, ky paragraf e vesh presidentin e republikës me kompetencën e emërimit të gjyqtarëve kushtetues. Katër janë pyetjet që duhen shpjeguar: a) nëse presidenti i republikës është i lirë të emërojë gjyqtarët kushtetues edhe pa propozimin e Kuvendit?; b) nëse presidenti i republikës mund të refuzojë një kandidat të propozuar nga ana e Kuvendit?; ³⁸³ c) mbi çfarë baze presidenti i republikës mund të refuzojë emërimin e gjyqtarëve të propozuar nga Kuvendi?; dhe d) a nënkupton koncepti “emërim” në kuptim të këtij paragrafi, edhe kompetencën e presidentit të republikës për shkarkimin e gjyqtarëve kushtetues?
2. Fillimisht, koncepti “emërim” i shfrytëzuar nga ky paragraf ka natyrë krejtësisht tjetër krahasuar me kompetencën e presidentit për emërimin e gjyqtarëve të rregullt (të pushtetit gjyqësor). Në rend të parë, argumenti qëndron në faktin që koncepti “emërim” sipas këtij paragrafi është shumëfish më i fuqishëm se sa kompetenca për “emërim” sipas paragrafit 15 & 16. Kjo sepse propozimi në rastin e paragrafit 15 & 16 vinte nga një organ i pavarur që ishte i veshur me detyrën e garantimit të profesionalizmit të gjyqtarëve të rregullt, prandaj edhe kompetenca e presidentit të republikës për “emërim” sipas atyre paragrafëve nuk nënkuptonte të drejtën e presidentit për të refuzuar kandidaturat e Këshillit Gjyqësor në kuptim të meritës (substancës) së kandidatëve. Në kuptim të këtij paragrafi, koncepti “emërim” duhet të nënkuptoj edhe të drejtën e presidentit për të kontrolluar meritën profesionale/karrierën e kandidatëve, meqë, në këtë rast, propozimi vjen nga Kuvendi, e jo nga një trup i pavarur që garanton profesionalizmin dhe pavarësinë e një institucioni.³⁸⁴ Në këtë kontekst, koncepti “emërim” sipas këtij paragrafi nënkupton të drejtën e presidentit për të kontrolluar jo vetëm procedurën por edhe substancën/meritën e propozimeve të Kuvendit.³⁸⁵ Prandaj, në kuptim të këtij paragrafi, presidenti i republikës mund të

mars 2012 dhe 4 maj 2012’, datë 20 korrik 2012, Ref.: AGJ 284/12.

³⁸² Krahaso logjikën e raportit në mes të presidentit dhe Kuvendit me rastin e zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve të gjykatave të larta, në Shugart, Matthew Soberg and Carey M., John (1992) ‘Presidents and Assemblies. Constitutional Design and Electoral Dynamics’. Cambridge: Cambridge University Press; Stepan, Alfred and Cindy Skach (1993) ‘Constitutional Frameworks and Democratic Consolidation. Parliamentarism versus Presidentialism.’ *World Politics*. Vol.46, p. 1-22. Shih gjithashtu të njëjtën logjikë në sistemet e pastra presidenciale: Petersen, M., (1993) ‘Legislating Together: The White House and Capitol Hill from Eisenhower to Reagan’. Cambridge, MA: Harvard University Press; Shih, gjithashtu: Shartel, Burke (1930) ‘Federal Judges: Appointment, Supervision, and Removal: Some Possibilities under the Constitution’. *Michigan Law Review*. Vol. 28, No. 5, p. 485-529.

³⁸³ Shih një kritikë mbi modelin amerikan të marrëdhënies së presidentit me Kongresin sa i përket emërimit të gjyqtarëve federal: McMahan, K. J (2007) ‘Presidents, Political Regimes, and Contentious Supreme Court Nominations: A Historical Institutional Model’. *Law and Social Inquiry*, Vol. 32, p. 919-954.

³⁸⁴ Krahaso këtë argument me: Silverstein, M., (1994) ‘Judicious Choices: The New Politics of Supreme Court Confirmations’. New York: W.W. Norton and Company.

³⁸⁵ Duhet pasur parasysh që nga kjo kompetencë mund të lind debat publik që, megjithatë, e

refuzojë kandidatët e propozuar nga Kuvendi për arsye të meritës apo karrierës së propozimeve. Prandaj, koncepti “emërim”, në kuptim të këtij paragrafi, është shumë më i gjerë dhe nënkupton kompetencën e presidentit për të qenë bashkëvendimarrës i barabartë me Kuvendin në emërimin e gjyqtarëve kushtetues. Sa i përket pyetjes tjetër, presidenti i republikës, megjithatë, emërimin mund ta materializojë vetëm në bazë të propozimit të Kuvendit, në asnjë mënyrë pa pasur mbështetje në të.

Koncepti “emërim”, në anën tjetër, në kuptim të këtij paragrafi, nuk nënkupton kompetencën e presidentit për të shkarkuar gjyqtarë kushtetues, meqë shkarkimi i gjyqtarëve kushtetues bëhet përmes një procedure të përcaktuar me nenin 118.³⁸⁶

Neni 84.20

1. Ky paragraf përcakton kompetencën e presidentit të republikës për të emëruar Komandantin e Forcave të Sigurisë së Kosovës, në bazë të rekomandimit të kryeministrit. Kjo është një kompetencë e ndarë e presidentit të republikës me kryeministrin,³⁸⁷ që nënkupton që presidenti i republikës mund të emëroj një kandidat për pozitën e Komandantit të FSK-së vetëm në bazë të rekomandimit të kryeministrit. Prandaj, vendimi i presidentit për emërim të një kandidati duhet të jetë detyrimisht i lidhur me një propozim të kryeministrit, në të kundërtën, procedura e emërimit do të konsiderohej në kundërshtim me këtë paragraf.

Neni 84.21

1. Ky paragraf përcakton kompetencën e përbashkët që presidenti dhe kryeministri kanë për të emëruar Drejtorin, Zëvendësdrejtorin, dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI). Ky paragraf përcakton një kompetencë të ndarë në mes të presidentit dhe kryeministrit, sipas logjikës së një procedure bashkëvendimarrëse. Bashkëvendosja në mes të presidentit të republikës dhe kryeministrit në lidhje me emërimin e shefave të AKI-së shpreh edhe logjikën

drejton procesin në kahje të pikshikimit politik. E tillë është eksperiencia e shtetit amerikan sa i përket konfirmimit të nominimeve për gjyqësor në Senat. Shih: Monaghan, Paul, Henry (1988) ‘The Confirmation Process: Law or Politics’. *Harvard Law Review*. Vol 101, No. 6, p. 1202-1212. Në të gjitha vendet perëndimore, me përjashtim të Greqisë, parlamentet janë të involvuar në nominimet (propozimet) e kandidatëve. Në rastet kur caktimi i gjyqtarëve ndahet në mes të disa organeve qendrore (gjyqësori, parlamenti dhe shefi i shtetit) atëherë nuk shtrohet fare çështja e vlerësimit të meritave të kandidatëve sepse ata bëhet gjyqtarë në momentin e caktimit të tyre nga organi qendror caktues. Nga kjo shihet se problemi i vlerësimit të meritave të kandidatëve del vetëm në rastet kur nominimet (propozimet) dalin nga votimi në Kuvend të cilat më pastaj kërkojnë emërim (dekretim) nga shefi i shtetit. Cf. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), (1994) ‘Models of Constitutional Jurisdiction’. Strasbourg: Council of Europe Press, p. 40-45.

³⁸⁶ Krahaso me modelin amerikan të “shkarkimit për shkak të moskryerjes së detyrës në mënyrë të duhur”. Shih: Shane, Peter M., (1993) ‘Who May Discipline or Remove Federal Judges a Constitutional Analysis’. *University of Pennsylvania Law Review*. Vol. 142, No. 1, p. 209-242.

³⁸⁷ Shih një argument mbi këtë binom vendosës në kuptim të standardeve të demokracisë: Elgie, Robert (1998) “The Classification of Democratic Regime Types: Conceptual Ambiguity and Contestable Assumptions”. *European Journal of Political Research*. Vol. 33, No. 2, p. 219-238.

që AKI qëndron mbi një substrat politik të cilin e përbën konsensusi politik i presidentit të republikës dhe kryeministrit. Ky model konsensusi, në anën tjetër, arsyetohet me kërkesën që bartësit e AKI-së të jenë figura integriteti i të cilëve është kontrolluar nga një konsensus i presidentit të republikës dhe kryeministrit. Si procedurë, kjo paraqet një lloj garancioni për kredibilitetin konsensual (pra, jopolitik) që duhet të kenë bartësit e AKI-së.

Neni 84.22

1. Ky paragraf përcakton kompetencën e presidentit të republikës për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, sipas konsultimit me kryeministrin.³⁸⁸ Kjo është një kompetencë tipike e kreut të shtetit, i cili vepron sipas logjikës së mbrojtjes së interesit të përgjithshëm.³⁸⁹ Dy pika kontestuese duhen sqaruar në lidhje me këtë paragraf: a) nëse presidenti i republikës mund ta shpall gjendjen e jashtëzakonshme edhe pa konsultim me kryeministrin; dhe b) nëse presidenti i republikës mund të refuzoj konsultën e kryeministrit sa i përket vendimit për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme. Sa i përket pikës së parë, është absolutisht e qartë që presidenti i republikës është i detyruar të konsultojë kryeministrin sa i përket vendimit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Megjithatë, ky paragraf, sa i përket lidhjes në mes të vendimit të presidentit dhe kërkesës për “konsultim” me kryeministrin, i referohet konceptit “konsultim” me kryeministrin thjeshtë në aspektin e këshillimit dhe jo detyrimit për “udhëzim” nga ana e kryeministrit. Në këtë kontekst, detyrimi për të konsultuar kryeministrin nënkupton detyrën e presidentit për t’u këshilluar nga kryeministri sa i përket shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, kurse, presidenti i republikës nuk është i lidhur me të dhe vendos për shpalljen apo jo pavarësisht “këshillës” së kryeministrit. Kjo do të thotë se vendimi për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme është individual, dhe presidenti i republikës nuk është i detyruar të ndjek këshillën e kryeministrit sa i përket kësaj çështjeje. Megjithatë, duhet thënë këtu se në materializimin e kompetencës për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme, presidenti i republikës është i lidhur me kushtet specifike të përcaktuara me Kushtetutë, në bazë të cilave mund të bëhet shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme. Prandaj, presidenti i republikës, në materializimin e kompetencës që buron nga ky paragraf, është i detyruar të bëjë vlerësimin e përmbushjes së kushteve të përcaktuara me Kushtetutë.³⁹⁰

³⁸⁸ Bartja e kompetencës për shpallje të gjendjes së jashtëzakonshme nga ana e presidentit të republikës është një dukuri normale kushtetuese në kuptimin krahasues. Shih më shumë për këtë në Ferejohn, John and Pasquino, Pasquale (2004) ‘The Law of Exception: A Typology of Emergency Powers’. *International Journal of Constitutional Law*. Vol. 2, No. 2, p. 210-239.

³⁸⁹ Krahaso me presidentët tjerë në Evropë: Lucky, Christian (1993) ‘Tables of Presidential Power’. *East European Constitutional Review*. Vol. 2, No. 4 and Vol. 3, No. 1, p. 81-94.

³⁹⁰ Studiuësit janë të mendimit se përjashtimi i zbatimit të ligjit gjatë gjendjes së emergjencës është shumë jashtë konceptit kushtetues mbi gjendjen e jashtëzakonshme. Shih: Pffifner, J. P (2011) ‘Federalist No. 70: Is the President Too Powerful?’. *Public Administration Review*. Vol.71, No. s1, p. s112-s117; Krahaso me: Adler, D. G (2012) ‘The Law: The Framers and Executive Prerogative: A Constitutional and Historical Rebuke’. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 42, No. 2, p. 376-389.

Neni 84.23

1. Ky paragraf përcakton që presidenti i republikës mund të thërras mbledhje të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, dhe i kryeson ato në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme. Në kuptim të këtij paragrafi, presidenti i republikës ka të drejtë të thërras mbledhjet e Këshillit të Sigurisë në çdo kohë, sipas diskrecionit të tij, dhe që Këshilli në fjalë është i obliguar t'i bindet detyrimit për t'u mbledhur. Megjithatë, kjo kompetencë nuk nënkupton që presidenti i republikës mund të qeveris me Këshillin, meqë ky i fundit është një organ kolegjal. Kryesimi i Këshillit, në anën tjetër, në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme bëhet nga ana e presidentit të republikës, si një logjikë që ndjek parimin që presidenti i republikës është kreu i shtetit.

Neni 84.24

1. Ky paragraf përcakton kompetencën e presidentit të republikës për formimin e misioneve diplomatike e konsullore të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me kryeministrin. Koncepti “konsultim” i shënuar në këtë paragraf nënkupton detyrimin e presidentit për të marrë qëndrimin e kryeministrit sa i përket vendosjes në këtë fushë. Megjithatë, presidenti i republikës ka detyrimin që vetëm të këshillohet me kryeministrin, por që nuk është i detyruar që të përfill konsultën e tij. Kompetenca për vendosjen në lidhje me formimin e misioneve diplomatike e konsullore të shtetit jashtë vendit shkon në përputhje me kompetencën e përgjithshme të presidentit të republikës si udhëheqës i politikës së jashtme të shtetit, të përcaktuar me nenin 84.10.

Neni 84.25

1. Ky paragraf përcakton kompetencën e presidentit të republikës për të emëruar dhe shkarkuar shefat e misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë. Kompetenca për emërim dhe shkarkim, prandaj, është e ndarë në mes të presidentit të republikës dhe qeverisë. Në materializimin e kësaj kompetence, presidenti i republikës është i detyruar që të veproj në bazë të propozimit të qeverisë për kandidatët për emërim apo shkarkim. Presidenti i republikës mund që të refuzoj propozimet e qeverisë, mirëpo ai/ajo nuk mund të bëjë emërim apo shkarkimet pa qenë të bazuara në një propozim të qeverisë. Emërimi dhe shkarkimi i shefave të misioneve diplomatike të shtetit, si kompetencë e ndarë në mes të presidentit dhe qeverisë, vendos një lloj balance në kuptim të figurave që bartin këto misione, me nënkuptimin që konsensusi që duhet të ekzistoj në mes të këtyre dy institucioneve prodhon një balancim të vendimit për emërim dhe shkarkim.

Neni 84.26

1. Ky paragraf përcakton kompetencën e presidentit të republikës për të emëruar Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kjo kompetencë e ndërton një urë

përfaqësimi të një kandidati të emëruar nga ana e presidentit të republikës në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duke pasur parasysh që materializimi i kësaj kompetence nga ana e presidentit të republikës duhet që të bazohet në konceptin e një vendimi neutral që shkon në përputhje me funksionin e tij, si përfaqësues i unitetit të popullit.

Neni 84.27

1. Ky paragraf përcakton kompetencën e presidentit të republikës për të emëruar Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Kjo kompetencë është individuale, dhe i takon vetëm presidentit të republikës. Kjo do të thotë se presidenti i republikës është i vetmi autoritet që ka kompetencën për të emëruar Guvernatorin e BQK-së. Logjika e funksionit të BQK-së, si një institucion i pavarur, kërkon që materializimi i kësaj kompetence nga ana e presidentit të republikës të bëhet në përputhje me funksionin e tij si përfaqësues i unitetit të popullit, duke plotësuar kushtet e renditura në komentimin e nenit 83.

Neni 84.28, 84.29 & 84.30

1. Këta tre paragrafë përcaktojnë tri kompetenca tipike ceremoniale që i takojnë kreut të shtetit.³⁹¹ Neni 84.28 përcakton kompetencën e presidentit të republikës për të dhënë medalje, mirënjohje dhe çmime në pajtim me ligjin e nxjerrur nga Kuvendi.³⁹² Neni 84.29 përcakton të drejtën e presidentit për falje të të dënuarve, sipas përcaktimit të ligjit përkatës. Në kuptim të kësaj, shembulli i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, ku përmes vendimit të saj ka vendosur që e drejta për të shpallur faljen apo amnistinë është ekskluzive kompetencë e Presidentit të Republikës, dhe se kjo e drejtë nuk mund të transferohet në asnjë autoritet tjetër shtetëror,³⁹³ është interpretimi që mund të aplikohet edhe në rastin e Neni 84.28.³⁹⁴ Në ushtrimin e kësaj kompetence, si parim, Gjykata Kushtetuese e Republikës Jug-Afrikane, në vendimin CCT 54/09, theksoi se Presidenti duhet ta ushtrojë të drejtën e tij për t'i falur të burgosurit në atë mënyrë që të jetë i lidhur racionalisht me objektivat që synohen të arrihen me falje.³⁹⁵ Kjo është një logjikë

³⁹¹ Krahaso me presidentët tjerë në Evropë: Lucky, Christian (1993) 'Tables of Presidential Power'. *East European Constitutional Review*. Vol. 2, No. 4 and Vol. 3, No. 1, p. 81-94.

³⁹² Duke tentuar që t'ia ruaj ekskluzivitetin e kësaj kompetence presidenciale, Gjykata Kushtetuese e Lituaniës ka vendosur që Rregullorja që i siguron Presidiumit të Këshillit Suprem të Republikës së Lituaniës kompetenca sa i përket dhënies së shpërblimeve, është në kundërshtim me dispozitat kushtetuese që përcaktojnë se shpërblimet shtetërore jepen nga Presidenti i Republikës. Shih: Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituaniës, Nr. 7/08, i datës 07.09.2010.

³⁹³ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, Nr. PL. US 8/97, i datës 24.06.1998.

³⁹⁴ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Republikës Jug-Afrikane në vendimin, Nr. CCT 42/09 theksoi se Presidenti në ushtrimin e kompetencave kushtetuese për faljen e të burgosurve mund të kërkojë asistencë nga Kabineti qeveritar apo ministritë përkatëse, por përgjegjësia në ushtrimin e kësaj kompetence mbetet vetëm e Presidentit (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Jug-Afrikane, Nr. CCT 42/09 i datës 30.9.2009).

³⁹⁵ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Jug-Afrikane, Nr. CCT 54/09, i datës 23.2.2010.

interpretuese edhe për nenin 84.29. Ndërsa, neni 84.30 përcakton detyrimin e presidentit të republikës për t'iu drejtuar Kuvendit të Kosovës një herë në vit sa i përket fushëveprimtarisë së tij/saj. Detyrimi për t'iu drejtuar me një fjalim vjetor Kuvendit, megjithatë, në kuptim të këtij neni, nuk duhet nënkuptuar si detyrim i presidentit për t'i raportuar apo për t'i dhënë përgjegjësi Kuvendit për punën e tij. Kjo sepse presidenti i republikës nuk bart përgjegjësi politike përballë Kuvendit, dhe është absolutisht i pavarur nga Kuvendi në kryerjen e funksioneve të tij. Kjo nënkupton se fjalimi vjetor në Kuvend i presidentit të republikës sipas këtij paragrafi ka thjeshtë një karakter informues.

Neni 85 [Kualifikimi për Zgjedhjen e Presidentit]

President i Republikës së Kosovës mund të zgjedhet çdo shtetas i Republikës së Kosovës, i cili e ka mbushur moshën tridhjetë e pesë (35) vjeçare.

Neni 85

1. Ky nen përcakton kushtet që duhet të plotësojë një kandidat që të mund të zgjidhet president i republikës. Sipas këtij neni, janë dy kushte themelore që duhen plotësuar: a) që kandidati për president të jetë bartës i shtetësisë së Republikës së Kosovës në momentin e kandidimit, dhe b) që kandidati të ketë mbushur 35 vjeç në ditën kur bën betimin si president i republikës. Sa i përket kushtit të shtetësisë, është logjikisht e pritshme që kandidati të jetë shtetas i shtetit ku kandidon që të ushtrojë detyrën e presidentit të republikës. Në kuptim të këtij neni, nuk jepen kushte shtesë, të tilla që mund të kërkonin që kandidati të ketë jetuar për një kohë të caktuar si shtetas në shtetin ku kandidon. Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë, në kuptim të interpretimit të një dispozite të ngjashme, ka vendosur që qytetari i lindur bullgar që kandidon për President të Republikës së Bullgarisë në kuptim të Kushtetutës mund të jetë vetëm ai person që e ka fituar shtetësinë bullgare për nga origjina apo vendi i lindjes në datën e lindjes sipas ligjit përkatës bullgar në fuqi.³⁹⁶ Një kusht i tillë gjendet i vendosur edhe në kuptim të Nenit 85 të Kushtetutës së Kosovës.
2. Sa i përket kushtit të moshës, moshja 35-vjeçare përmbush një detyrim bazik që presidenti i republikës të ketë një maturi themelore në kuptim të moshës.³⁹⁷ Ky paragraf, prandaj, vendos dy kushte shumë themelore, duke promovuar një sistem shumë të hapur mbi konkurruesit. Thënë kjo, mungesa e kushteve shtesë, të tilla çfarë kanë shumë kushtetuta në botë, e bën procesin e kandidimit për president republike të krijoj hapësirë për konkurrim të hapur.

³⁹⁶ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë, Nr. 12/96, i datës 23.7.1996.

³⁹⁷ P.sh, siç tregon një studim, në Shtetet e Bashkuara publiku i jep më shumë rëndësi personalitetit se sa partisë nga e cila vjen kandidati për president. Rol shumë të rëndësishëm në këtë aspekt ka edhe integriteti i kandidatit në kuptim të maturisë së tij. Shih: Miller, H., Arthur Wattenberg, P., Martin and Malanchuk, Oksana (1986) 'Schematic Assessments of Presidential Candidates'. *The American Political Science Review*. Vol. 80, No. 2, p. 521-540.

3. Në Aktgjykimin e saj mbi amendamentet kushtetuese, Gjykata është marrë edhe me çështjen e kushteve për president të republikës të cilat segmente të caktuara të politikës kosovare synonin t'i vendosin. Ndër to ka qenë edhe: a) të qenit banor i përhershëm i Republikës së Kosovës për pesë (5) vjet me radhë; dhe b) propozimet për postin e presidentit të Kosovës mund të vijnë vetëm nga subjektet politike parlamentare që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit. Lidhur me rastin e parë, Gjykata diskutoi dhe vendosi në paragrafët 114-120. Me këtë rast, Gjykata theksoi ndër të tjera se në “në shikim të parë mund të duket e arsyeshme të kufizohet mbajtësi i postit me këtë kriter të banimit për të siguruar që Presidenti është i lidhur ngushtë me popullin dhe shtetin para se të hyjë në postin më të lartë politik në vend”. Mirëpo, vazhdon më tej Gjykata, ky formulim cenon të drejtat njerëzore që kanë të bëjnë me barazinë e të gjithëve para ligjit dhe mosdiskriminimit. Sa i përket rastit të dytë, Gjykata ka vendosur dhe diskutuar për paragrafët 131-140, duke gjetur se kushti i tillë është diskriminues ndaj partive tjera që pritet të marrin pjesë në garë zgjedhore në mënyrë ligjore.³⁹⁸

Neni 86 [Zgjedhja e Presidentit]

- (1) Presidenti i Republikës së Kosovës zgjedhet nga Kuvendi, me votim të fshehtë.**
- (2) Zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit të Presidentit aktual.**
- (3) Secili shtetas i Republikës së Kosovës mund të nominohet si kandidat për President të Republikës së Kosovës, nëse ajo/ai siguron nënshkrimet e të paktën tridhjetë (30) deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Deputetët e Kuvendit mund të nënshkruajnë vetëm për një candidate për President të Republikës së Kosovës.**
- (4) Zgjedhja e Presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.**
- (5) Nëse asnjëri kandidat nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes të dy kandidatëve të cilët kanë marrë numrin më të lartë të votave në votimin e dytë dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjedhet President i Republikës së Kosovës.**
- (6) Nëse në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjidhet President i Republikës së Kosovës, shpërndahet Kuvendi dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) ditësh.**

Neni 86

1. Ky nen rregullon çështjen e zgjedhjes së presidentit të republikës. Si e tillë ka qenë një ndër çështjet më kontroverse në diskursin politik dhe kushtetues kosovar dhe

³⁹⁸ Aktgjykimi në rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12, ‘Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012’, datë 20 korrik 2012, Ref.: AGJ 284/12.

objekt i njerit prej aktgjytimeve me me rendesi te Gjykatës Kushtetuese te Kosovës.³⁹⁹ Në fakt, komentimet tona me poshte në teresi ndjekin vijat e interpretimit të dhënë nga Gjykata në këtë aktgjykim.

2. Sipas paragrafit të parë, votimi duhet të jetë i fshehtë, kurse sipas të dytit presidenti i ri duhet të zgjidhet tridhjetë ditë para se të skadojë mandati i presidentit në detyrë. I nominuari për president mund të jetë çdo shtetas i Kosovës, pa marrë parasysh nëse ka dhe një shtetësi tjetër, me kusht që të sigurojë nënshkrimet e tridhjetë (30) deputetëve. Kjo nënkupton se në një Kuvend prej 120 deputetëve më së shumti katër kandidatë mund të hyjnë në garë për deputet. Ky paragraf e jep kuptimin e dy tjerëve në vijim që flasin për fitimin e dy të tretave (2/3) të votave të të gjithë deputetëve si kusht për t'u zgjedhur president, si dhe për organizmin e votimit të tretë nëse në dy votimet e para asnjëri prej kandidatëve nuk fiton dy të tretat (2/3) e votave të kërkuara. Në votimin e tretë, president zgjidhet ai/ajo që merr votat e shumicës absolute, d.m.th. gjashtëdhjetë (60) votat e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Nëse as në votimin e tretë asnjëri nga kandidatët nuk fiton shumicën absolute të votave, atëherë Kuvendi shpërndahet dhe shkohet në zgjedhje të reja brenda dyzetë e pesë (45) ditëve.
3. Nga kjo që u tha, del se për t'u zgjedhur president duhet të plotësohen këto kushte: një, që votimi duhet të jetë me votim të fshehtë; dy, që të ketë më shumë se një kandidat në të gjitha votimet deri në arritjen e dy të tretave (2/3), përkatësisht deri në fitimin e shumicës absolute të votave në Kuvend; tre, që nuk mund të ketë më shumë se katër kandidatë në garë për president; dhe, së fundit, katër, që me rastin e fillimit të votimit për president të republikës në sallë duhet të jenë prezent numri që kërkohet për t'u bërë president në votimin e parë, pra dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Mosplotësimi i këtyre kushteve e bën zgjedhjen e presidentit të pavlefshme. Këtë e ka konstatuar Gjykata në aktgjykimin e sipërcekur, mirëpo pavlefshmërinë e deklaruar Gjykata nuk e ka bërë me efekt prapaveprues.⁴⁰⁰ Po ta kishte bërë një gjë të tillë, atëherë do të ishin prodhuar dy pasoja: e para, çdo veprim i ndërmarr nga presidenti Behxhet Pacolli do të ishte konsideruar si jo i vlefshëm (p.sh. emërimi i ambasadorëve, pranimin i letrave kredenciale, emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, etj.); e dyta, vendi do të kishte shkuar në zgjedhje brenda dyzetë e pesë (45) ditëve.

³⁹⁹ Aktgjykimi në rastin K. O. 29/11, 'Sabri Hamiti dhe deputetët e tjerë: Vlerësimi kushtetues i vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, i 22 shkurtit 2011, përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës' më 30 mars 2011, Ref.: AGJ.: 107/11.

⁴⁰⁰ Cf. Sqarim i Aktgjykimit në Rastin Nr. KO 29/11, 'Sabri Hamiti dhe deputetët të tjerë. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 04-V-04, të 22 shkurtit 2011, lidhur me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës-Sqarimet e kërkuara për Vendimin e shumicës, të 30 marsit 2011, datë 1 prill 2011, Nr. ref.: SQ 111/11, paragrafi 15.

Neni 87 [Mandati dhe Betimi]

- (1) **Presidenti i Republikës së Kosovës fillon mandatin pasi të ketë dhënë betimin para Kuvendit të Kosovës. Teksti i betimit rregullohet me ligjin.**
- (2) **Mandati i Presidentit është pesë (5) vjet.**
- (3) **Pas përfundimit të mandatit të parë, Presidenti mund të rizgjedhet vetëm edhe një herë.**

Neni 87.1 & 87.2

1. Neni 87 e rregullon çështjen e fillimit të mandatit të presidentit të republikës, kohëzgjatjen e tij dhe hapësirën për rizgjedhje. Ky nen përcakton që mandati i presidentit të republikës fillon në momentin e dhënies së betimit në Kuvendin e Kosovës. Pra, në kuptim të këtij paragrafi, presidenti i Republikës e fillon detyrën e tij me dhënien e betimit në Kuvendin e Kosovës. Në kuptim të kësaj, Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë pati vendosur që efekti juridik i zgjedhjes së Presidentit është *nul* nëse personi i zgjedhur për President dështon të bëjë betimin siç është paraparë me Kushtetutë.⁴⁰¹ Një interpretim i tillë mund të bëhet edhe në kuptim të nenit 87 të Kushtetutës.
2. Sa i përket çështjes së kohëzgjatjes së mandatit, ky nen përcakton që kohëzgjatja e mandatit të presidentit të republikës është 5 vite. Shikuar nga kjo perspektivë, mandati i presidentit të republikës është më i gjatë se mandati kushtetues i qeverisë dhe parlamentit. Në këtë kontekst, kjo lejon që një lëvizje të mos ketë përputhje në mes të kohës së zgjedhjes së presidentit të republikës dhe kohës së zgjedhjes së Kuvendit dhe qeverisë, duke nënkuptuar që, parimisht, duhen ndërtuar marrëveshje të veçanta politike për zgjedhjen e presidentit dhe të kuvendit. Në këtë aspekt, mandati pesë (5) vjeçar i mundëson presidentit të republikës që të ketë kohëzgjatje mbi të paktën dy legjislatura dhe qeveri, duke mundësuar që presidenti i republikës të luajë rolin e tij kundërbalancues në mënyrë më efektive. Duhet thënë që, fakti që ky paragraf i jep presidentit të republikës mandat pesë (5) vjeçar, përderisa Kuvendi dhe qeveria kanë mandat kushtetues katër (4) vjeçar, e rrënjos idenë që mandati i presidentit të republikës është i ndarë nga mandati i kuvendit. Pra, edhe nëse ka një procedurë ku presidenti i republikës zgjidhet nga ana e Kuvendit, shpërndarja e Kuvendi para kohe nuk interferon në kohëzgjatjen e mandatit të presidentit të republikës.
3. Këtë interpretim kësisoj, pak a shumë, e ka mbrojtur Gjykata në Aktgjykimin e saj mbi amendamentet kushtetuese. Më këtë rast Gjykata ka theksuar se mandati pesë (5) vjeçar i presidentit nuk mund të ndërpritet para kohe përmes teknikës juridike të amendamentimit kushtetues. Kjo rrugë e eliminimit të presidentit të republikës bie ndesh me parimin e sigurisë juridike dhe, mbi të gjitha, cenon postulatën themelore mbi rolin dhe rëndësinë e presidentit si përfaqësues i unitetit juridiko-kushtetues të popullit dhe si garantues i funksionimit normal të institucioneve të sistemit.⁴⁰²

⁴⁰¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë, Nr. II.US 65/97 i datës 10.12.1997.

⁴⁰² Cf. Paragrafët 255-271. Aktgjykimi në rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12, 'Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23

4. U mor vesh, kjo nuk do të thotë se nuk ekziston një mënyrë kushtetuese për ta ndryshuar mandatin e kreut të shtetit. Në aspektin komparativ, ka pasur raste kur kjo ka ndodhur, pra kur është ndryshuar mandati i shefit të shtetit, ashtu sikundër që ka kushtetuta që e sanksionojnë një gjë të tillë. Rasti i parë ka ndodhur në Francë, në vitin 2000. Atë vit, francezët ndryshuan me amendament kushtetues mandatin e presidentit të atëhershëm francez nga 7 (shtatë) në 5 (pesë) vjet. Por, ky amendament hyri në fuqi dhe u zbatua vetëm për sa i përkiste presidentit tjetër që vinte, jo atij aktual. Kjo do të thotë se nuk u lejua apriori që amendamenti i ri, që ndryshoi mandatin e presidentit aktual francez, të kishte efekt retroaktiv si në rastin kosovar.⁴⁰³ Nga kushtetutat që parashohin një gjë të tillë, vlen të theksohet Kushtetuta e Koresë së Jugut, e cila përcakton procedurat që duhet ndjekur në rastet kur ndryshohet mandati i kreut të shtetit, duke e bërë të qartë se ato ndryshime mund të vlejnjë vetëm për shefin e ardhëm të shtetit.⁴⁰⁴ Është e qartë, pra, se gjyqësia kushtetuese, në asnjë rast, nuk mbron *ad hominem* askënd, por vetëm parimet dhe dispozitat kushtetuese që paraqesin esencën e konstitucionalizmit bashkëkohor.
5. Ky nen gjithashtu përcakton që një person mund të ushtroj vetëm dy mandate postin e presidentit të republikës. Pra, maksimumi i kohës për të cilën një person mund të ushtrojë detyrën e presidentit të republikës është dhjetë (10) vite. Shikuar nga ky aspekt, kufizimi i të drejtës për rikandidim në vetëm një herë shihet si një kusht publik i kufizimit të mandatit të institucioneve, me qëllim që të parandalohen qeverisjet monopoliste pa kufizim kohor. Një shembull interesant i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, shtyt interpretimin që kufizimi i mandateve, apo ndalimi i më shumë se dy mandateve i paraparë me Kushtetutën e vitit 1990 (pra regjimin kushtetues paraprak) nuk vlen për mandatet e kaluara të cilat ishin të bazuara në ligjet në fuqi para hyrjes në fuqi të kushtetutës aktuale.⁴⁰⁵ Një interpretim i tillë mund të thuhet që ka hapësirë aplikimi edhe në rastin e kësaj norme kushtetuese në Kosovë.
6. Draft amendamenti kushtetues dhjetë (X), në paragrafin e tretë theksonte se “presidentët që kanë shërbyer para hyrjes në fuqi të këtyre amendamenteve, kanë të drejtë të zgjidhen dhe rizgjidhen edhe njëherë si President i Republikës së Kosovës”. Më këtë dispozitë nuk numërohet si mandat koha e mandatit të parë të ish presidentëve të Kosovës që janë zgjedhur para deklaramit të pavarësisë më 17 shkurt 2008. Kjo paraqet diskriminim karshi atyre që do të jenë president në të ardhmen

mars 2012 dhe 4 maj 2012’, më 20 korrik 2012, Ref.: AGJ 284/12.

⁴⁰³ Duhamel, Oliver, (2001) ‘France’s New Five - Year Presidential Term. BROOKINGS, 1 March 2001. Në internet, në këtë ueb-faqe: <http://www.brookings.edu/research/articles/2001/03/france-duhamel> (herën e fundit shikuar në nëntor të vitit 2012).

⁴⁰⁴ Kushtetuta e Koresë së Jugut, e 17 korrikut 1948, në nenin 128, iniciativa për ndryshim të saj, përcakton: “(2) Amendamentet në Kushtetutë për zgjatje të kohës së mandatit të Presidentit apo për lejimin e rizgjedhjes së tij nuk mund të hyjnë në fuqi për Presidentin në detyrë në kohën e parashtrimit të tyre”. Komisioni i Venedikut këtë dispozitë e konsideron si një standard të mirë dhe si masë matëse për vlerësim të kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese që prekin mandatet e organeve kryesore të shtetit. Cf. Report on Constitutional Amendment, adopted by the Venice Commission at its Plenary Session, Venice, 11-12 December 2009, paragrafi 145.

⁴⁰⁵ Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë, Nr. U-VII-700/1997 i datës 11.6.1997.

sepse disa do të kenë të drejtën e shërbimit si president republike një përkatësisht dy mandate më shumë. Kjo është kështu për dy arsye: arsyeja e parë ka të bëjë me kontinuitetin institucional, kurse e dyta i referohet garantimit të funksionimit dhe stabilitetit të institucioneve. Thënë shkurt, kjo dispozitë e propozuar synon t'i vejë në pozitë të pabarabartë të gjithë kandidatët tjerë dhe presidentët e mundshëm kundrejt atyre që kanë shërbyer njëherë, duke mos ua llogaritur këtyre të fundit mandatin e parë të ushtruar si president republike. Kjo, pra, është diskriminim dhe kundër Kapitullit II, III, si dhe parimeve e vlerave kushtetuese, kundër vetë letrës, shpirtit dhe frymës së Kushtetutës së Kosovës si një kushtetutë me premisa të theksuara moderne. Këtë pikëpamje, megjithatë, nuk e ka mbrojtur Gjykata kur ka vendosur për këtë dispozitë të amendamentit dhjetë (10).⁴⁰⁶

Neni 88 [Papajtueshmëria]

- (1) **Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër publik.**
- (2) **Pas zgjedhjes, Presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike.**

Neni 88

1. Ky nen e rregullon çështjen e papajtueshmërisë së detyrës së presidentit me ndonjë detyrë tjetër. Si parim, ky nen ka zbatueshmëri dhe relevancë vetëm prej momentit kur presidenti i republikës e fillon ushtrimin e mandatit të tij. Ky nen, në anën tjetër, duhet shikuar ngushtësisht me parimin që presidenti i republikës është përfaqësues i unitetit të popullit, i sanksionuar me nenin 83, dhe në linjë me komentimet e dhëna në atë seksion të këtij komentari. Shkurtimisht, ky nen vendos ndalesën që presidenti i republikës të ushtrojë çfarëdo funksioni publik apo funksion partiak, që është në përputhje me konceptin e ndarjes së pushteteve⁴⁰⁷ dhe rolin e presidentit si garantues dhe balancues i funksionimit normal të institucioneve të sistemit kushtetues. Në anën tjetër, ky nen pengon hyrjen e presidentit të republikës në konflikt interesi me funksionin e tij, sipas nenit 83. Sipas interpretimit të rastit *Rrustemi et al v. Presidenti i Republikës*, koncepti “ushtroj” i përcaktuar nga ky paragraf nënkupton edhe “mbajtjen” pasive të një posti nga ana e presidentit. Thënë kjo, mjafton që një presidenti republike të mbaj një post tjetër publik apo partiak, dhe që të mos e ushtroj atë aktivisht, që ai/ajo të konsiderohet se po shkel detyrimin që vjen nga ky nen.⁴⁰⁸

⁴⁰⁶ Cf. Paragrafi 273. Aktgjykimi në rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/, ‘Amendamentet e propozuara kushtetuese, të dorëzuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars 2012 dhe 4 maj 2012’, datë 20 korrik 2012, Ref.: AGJ 284/12.

⁴⁰⁷ Shih: Calabresi, G., Steven and Larsen, L., Joan (1994) ‘One Person One Office: Separation of Powers or Separation of Personnel’. *Cornell Law Review*. Vol. 79, p. 1045-1057; Shih gjithashtu sa i përket parimit të ndarjes së pushtetit në kuptim të ndalesave sikur në këtë nen, në: Bruff, H., Harold (2007) ‘The Incompatibility Principle’. *Administrative Law Review*. Vol. 59, No. 2, pp. 225-268.

⁴⁰⁸ Cf. Paragrafet 63-70. Aktgjykim, Rasti Nr. KI 47/10, ‘Naim Rrustemi dhe 31 deputetë tjerë

2. Ndalesat e vendosura me Nenin 88 i shërbejnë idesë së një presidenti republike që përmbush funksionin e një përfaqësuesi të unitetit të popullit. Logjika themelore në këtë aspekt është që bartja e çfarëdo funksioni tjetër publik apo partiak nga ana e presidentit të republikës është në kundërshtim me detyrën e tij që t'i shërbejë përfaqësimit të unitetit të popullit, të shpjeguar me komentimin e Nenit 83. Prandaj, ky nen e përmbyll qarkun e përcaktimit që presidenti i republikës të ushtroj vetëm detyrën e tij, dhe të mos bëj pjesë në institucione apo rryma/parti politike që e sjellin atë në konflikt me detyrimin sipas nenit 83.⁴⁰⁹

Neni 89 [Imuniteti]

Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të Presidentit të Republikës së Kosovës.

Neni 89

1. Ky nen e rregullon çështjen e imunitetit të presidentit të republikës. Sipas këtij neni, presidenti i republikës gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda funksionit të tij si president republike. Imuniteti i dhënë me këtë nen është i tipit funksional, pra, imunizon presidentin e republikës vetëm në kuadër të kryerjes së funksionit të tij. Veprimet e presidentit të republikës jashtë funksionit të tij kushtetues nuk mbrohen nga imuniteti i dhënë me këtë nen kushtetues. Imuniteti sipas këtij neni, sa i përket ushtrimit të funksionit, nuk është thjeshtë në fushën penale por edhe në atë civile (sipas modelit të rastit *Nixon v. Fitzgerald*),⁴¹⁰ dhe të përgjegjësive politike. Presidenti i republikës, prandaj, nuk mundet as të shkarkohet, as të paditet, por as të ndjeket penalisht për veprimet dhe vendimet e marra në kuptim të kryerjes së funksionit të tij. Koncepti “veprim dhe vendim” i presidentit, natyrisht, përfshin edhe rastet kur presidenti i republikës “nuk vepron”. Pra, nëse ka shmangie nga një veprim që është dashur të ndërmerret, presidenti i republikës është sërish i mbrojtur me këtë nen të kushtetutës.
2. Çështja më e vështirë në interpretimin e këtij neni është shënjimi i kufirit në mes të asaj që konsiderohet veprim në kuadër të funksionit të tij/saj dhe veprim jashtë funksionit të tij/saj zyrtar. Pra, për t'u kualifikuar si i mbrojtur proceduralisht nga

të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës’, datë 28 shtator 2010, Nr. ref.: AGJ 43/10.

⁴⁰⁹ Si shembull gjyqësor krahasues, Gjykata Kushtetuese e Moldavisë në vendimin e saj 1/2008 theksoi se në bazë të Kushtetutës, posti i Presidentit të Republikës është në papajtueshmëri me anëtarësinë në një parti politike apo ndonjë organizim politik përgjatë mandatit të Presidentit. Shih: Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Moldavisë, Nr. 1/2008 i datës 03.04.2008.

⁴¹⁰ Shih një kritikë mbi gjerësinë e imunitetit civil për presidentin e republikës, të ngjashëm me këtë nen të kushtetutës: Orenstein, A., Aviva (1983) ‘Presidential Immunity from Civil Liability: *Nixon v. Fitzgerald*’. *Cornell Law Review*. Vol. 68, No. 2, p. 236.

çfarëdo procedure gjyqësore apo edhe nga shkarkimi, duhet që fillimisht të vlerësohet nëse një veprim i presidentit të republikës hyn në çadrën e funksionit të tij/saj kushtetues. Ky vlerësim, sipas një logjike institucionale, duhet të marrë parasysh këto indikacione: a) nëse veprimi ose lëshimi i presidentit të republikës është bërë me bazë në një kompetencë kushtetuese; b) nëse veprimi ose lëshimi i bërë nga presidenti i republikës, pavarësisht nëse bazohet në një kompetencë eksplicite kushtetuese, është në përputhje me funksionin qëllimor të presidentit të republikës sipas nenit 83; dhe c) nëse veprimi ose lëshimi i presidentit të republikës nuk i ka tejkaluar arsyeshmërisht kufijtë institucional të vendimmarrjes dhe pushtetit të përcaktuar me Kushtetutë. Kalimi me sukses i këtij testi, e bën veprimin ose lëshimin e presidentit të republikës të imunizuar nga ndjekja penale, padia civile ose shkarkimi në kuptim të këtij neni.

3. Interpretimi i ngushtë i imunitetit shihet nga dejetarët e fushës si përparësi, meqë nuk lejon që presidenti i republikës të vendoset mbi ligjin.⁴¹¹ Në këtë kontekst, kufizimi i imunitetit të presidentit dhe dhënia e hapësirës për kontroll gjyqësor të funksionit të tij/saj shihet me vlerësim pozitiv nga autorët e fushës.⁴¹² Për më tepër, studiuesit argumentojnë që veprimet dhe lëshimet e presidentit të republikës gjatë kryerjes së funksionit të tij/saj, në kuptim të këtij neni, nuk duhet lejuar të imunizohen nëse ato shkelin norma të së drejtës ndërkombëtare.⁴¹³ Kjo çështje u bë aktuale në veçanti pas luftës në ish Jugosllavi (1991-1999), e cila shtroi nevojën e ndjekjes dhe ndëshkimit të zyrtarëve të lartë, duke përfshirë presidentët e disa prej ish republikave jugosllave. Gjykata e Hagës për Krimet e Kryera në Ish Jugosllavi (ICTY), e njohur si Gjykata e Hagës për Ish Jugosllavi, u themelua në muajin maj 1993 dhe akuzoi e gjykoi disa funksionarë të lartë shtetëror ish jugosllav, duke përfshirë presidentin serb. Praktika e ndjekur nga kjo gjykatë në esencë ka ndjekur standardin e Gjykatës së Njrembergut (1945-1946), e cila nuk njohu asnjë lloj imuniteti shefave të shteteve dhe zyrtarëve të lartë shtetëror për krimet kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare, si dhe për krimet tjera që cenojnë normat *jus cogens* të së drejtës ndërkombëtare. Në vijim të kësaj, vlen të theksohet këtu se në nenin 16.3 dhe 19.2 të Kushtetutës faktojnë këtë konstatim: neni 16.3 thotë se “Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare”, kurse për epërsinë e normave *jus cogens* në rendin ligjor dhe kushtetues kosovar flet neni 19.2.
4. Në kuptim të këtij neni, kohëzgjatja e imunitetit funksional për presidentin e republikës vazhdon edhe pas përfundimit të mandatit të tij,⁴¹⁴ meqë veprimet/lëshimet e bëra gjatë

⁴¹¹ Shih një kritikë bazuar mbi këtë argument: Amar, Reed, Akhil and Katyal, Kumar, Neal (1995) ‘Executive Privileges and Immunities: The Nixon and Clinton Cases’. *Harvard Law Review*. Vol. 108, No. 3, p. 701-726.

⁴¹² Long, Jennifer L., (1995) ‘How to Sue the President: A Proposal for Legislation Establishing the Extent of Presidential Immunity’. *Valpo University Law Review*. Vol 30. No. 1, p.283-333.

⁴¹³ Shih: Michael J. Glennon (1986) ‘Can the President Do No Wrong?’. *The American Journal of International Law*, Vol. 80, No. 4, p. 923-930.

⁴¹⁴ Shih p.sh. problemet që lindin nga kjo: Bass, Evan, Peter (1987) ‘Ex-Head of State Immunity: A Proposed Statutory Tool of Foreign Policy’. *The Yale Law Journal*, Vol. 97, No. 2, p. 299-319.

kohës sa ka kryer funksionin e tij mbesin të imunizuara me imunitetin sipas këtij neni. Edhe praktika e Gjykatës Kushtetuese ka ndjekur këto vija arsyetimi në rastin e njohur të imuniteteve të funksionarëve të lartë shtetëror të Republikës së Kosovës.⁴¹⁵ Me këtë rast, Gjykata i është përgjigjur pyetjes së Qeverisë lidhur me imunitetin e të gjithë funksionarëve qendror të Kosovës: Presidentit, Qeverisë, si dhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës, duke elaboruar në mënyrë ekstensive të gjitha format dhe caqet e imunitetit të funksionarëve të lartë të Republikës së Kosovës.

5. Në pikën II të Aktgjykimit, Gjykata ka theksuar qartë se, në përputhje me nenin 75.1, nenin 89 dhe nenin 98 të Kushtetutës, deputetët e Kuvendit të Kosovës, Presidenti i Republikës dhe anëtarët e Qeverisë gëzojnë imunitet funksional për veprimet dhe vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre përkatëse. Prandaj, deputetët e Kuvendit, Presidenti i Republikës dhe anëtarët e Qeverisë lirohen nga përgjegjësia në procedura gjyqësore të çfarëdo natyre lidhur me pikëpamjet e shprehura, mënyrën e votimit apo vendimet e ndërmarra brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre. Ky lloj i imunitetit ka kohëzgjatje të pakufizuar. Në këtë drejtim, pra në drejtim të imunitetit funksional, të gjithë janë të barabartë dhe gëzojnë imunitet të njëjtë. Përjashtimi vlen vetëm për Presidentin për sa i përket arrestimit, pra jo edhe llojeve tjera të imunitetit. Në këtë drejtim, Presidenti, për dallim nga funksionarët tjerë të lartë shtetëror, gëzon imunitet nga arrestimi për shkak të natyrës së funksionit i cili kërkon që ai/ajo të jetë përherë në dispozicion për t'i kryer detyrat (paragrafi operativ VII.4 i Aktgjykimit).

Neni 90 [Mungesa e Përkohshme e Presidentit]

- (1) Në rast se Presidenti i Republikës së Kosovës përkohësisht nuk është i aftë për të përmbushur përgjegjësitë e tij/saj, ajo/ai mund t'ia kalojë vullnetarisht detyrat e postit të tij/saj, Kryetarit të Kuvendit, i cili do të jetë ushtrues i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. Urdhri i Presidentit për kalimin e përgjegjësive duhet të përmbajë veçanërisht arsyet dhe kohëzgjatjen e kalimit të përgjegjësive, nëse ka njohuri për to. Presidenti i Republikës së Kosovës do të rifillojë ushtrimin e përgjegjësive kur të jetë në gjendje t'i ushtrojë përgjegjësitë, dhe kështu Kryetarit të Kuvendit i pushon posti i ushtruesit të detyrës së Presidentit.
- (2) Në rast se nuk ka ndodhur kalimi vullnetar i përgjegjësive, Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me konsiliumin mjekësor, me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve vendos nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është përkohësisht i paaftë për të ushtruar përgjegjësitë e veta. Kryetari i Kuvendit të Kosovës do të shërbejë si ushtrues i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës derisa ajo/ai të bëhet i aftë që të rifillojë ushtrimin e përgjegjësive të Presidentit.

⁴¹⁵ Aktgjykim në rastin, Nr. K098/11, 'Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës, dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës', më 20 shtator 2011, Nr. ref.: AGJ138/11.

(3) Posti i ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj.

Neni 90

1. Ky nen e rregullon çështjen e mungesës së përkohshme të presidentit të republikës për shkak të paaftësisë së tij/saj, dhe procedurën konstatimit të paaftësisë së tij/saj. Janë dy lloje të procedurave që mund të ndodhin, sipas përcaktimit të këtij neni, sa i përket paaftësisë së ushtrimit të funksionit të presidentit të republikës. *Një*, nëse presidenti i republikës, për shkak të paaftësisë së tij/saj, vendos që vullnetarisht t'ia lëshoj detyrën Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, i cili mund ta ushtroj detyrën e tillë për 6 muaj.⁴¹⁶ Me rastin e kalimit të detyrës tek Kryetari i Kuvendit, presidenti i republikës duhet të jap arsyet mbi vendimin e tillë. Postin e ushtruesit të detyrës, Kryetari i Kuvendit mund ta ushtroj në maksimum për gjashtë muaj. Nëse edhe pas 6 muajsh presidenti i republikës nuk e rimerr detyrën e tij/saj, atëherë duhet të konsiderohet që mandati i tij/saj ka përfunduar, dhe shpallen zgjedhjet për zgjedhjen e presidentit të ri. *Dy*, Kuvendi i Kosovës, për shkak të paaftësisë së presidentit (këtu, ky nen i referohet paaftësisë mjekësore, qoftë fizike apo mendore), në bazë të një vendimi kredibil nga ana e një kolegji mjekësor, me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve, vendos mbi bartjen e ushtrimit të funksionit të presidentit të republikës te Kryetari i Kuvendit. Sikur edhe në rastin e parë, nëse brenda 6 muajsh gjendja fizike/mendore e presidentit të republikës nuk ndryshon, në bazë të konstatimit të kolegjit mjekësor, atëherë përfundon mandati i presidentit dhe shpallen zgjedhjet për presidentin e ri.
2. Sa i përket garancionit prej dy të tretave (2/3) të votave të të gjithë deputetëve, ky është një prag që mëton të garantoj që vendimi i Kuvendit mbi transferimin e detyrës së presidentit të republikës të jetë konsensual në kuptimin partiak, do të thotë që të ketë një shumicë më të gjerë se sa mazhoranca parlamentare. Natyrisht, sa i përket kuptimit të vendimit të këtij paragrafi, nëse presidenti i republikës konsideron që vendimi i kolegjit mjekësor dhe rrjedhimisht vendimi i Kuvendit për t'ia marr detyrën përkohësisht kanë qenë të abuzuar, presidenti i republikës ka të drejtë që vendimin e tillë të Kuvendit, në bazë të së drejtës për referim të çështjeve në Gjykatën Kushtetuese, ta dërgojë për kontroll të kushtetutshmërisë në këtë të fundit.

Neni 91 [Shkarkimi i Presidentit]

(1) Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga Kuvendi nëse ai/ajo është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë ose nëse ajo/ai nuk është i/e aftë për të ushtruar përgjegjësitë e këtij posti për shkak të

⁴¹⁶ Në një shembull të tillë, Gjykata Kushtetuese e Portugalisë ka vendosur që kur vetë Presidenti kërkon të deklarohet përkohësisht i paaftë për t'ia ushtruar detyrat e tij/saj, nuk ka nevojë që Gjykata Kushtetuese të thërrasë dëgjim e as të kërkojë vërtetime mjekësore, siç është paraparë më nënin 88 të Ligjit nr.28/82. Shih: Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë, Nr. 976/96 i datës 27.07.1996.

sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës.

- (2) Procedura për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Kosovës mund të iniciohet nga një e treta (1/3) e deputetëve të Kuvendit, të cilët nënshkruajnë një peticion, i cili shpjegon arsyet për shkarkim. Në rast se peticioni supozon sëmundjen e rëndë, Kuvendi do të kërkojë mendimin e konsiliumit mjekësor për gjendjen shëndetësore të Presidentit. Në rast se peticioni supozon ndonjë shkelje të rëndë të Kushtetutës, peticioni duhet t'i dorëzohet menjëherë Gjykatës Kushtetuese, e cila vendosë për këtë çështje brenda shtatë (7) ditësh nga marrja e peticionit.
- (3) Nëse Presidenti i Republikës së Kosovës është dënuar për ndonjë krim të rëndë ose kur nëse Kuvendi, në pajtim me këtë nen, konstaton që Presidenti nuk është i aftë të ushtrojë përgjegjësitë e tij/saj për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, Kuvendi mund të shkarkojë Presidentin me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij.

Neni 91

1. Ky nen shtjellon çështjen e shkarkimit të Presidentit të Republikës. Si i tillë, ky nen mëton të rregulloj edhe anën procedurale edhe atë materiale të shkarkimit të Presidentit të Republikës. Paragrafi i parë flet për anën materiale të shkarkimit, pra për arsyet që mund të çojnë deri të shkarkimi, kurse dy paragrafët tjerë e rregullojnë anën procedurale të shkarkimit.
2. Paragrafi i parë flet për shkarkimin e Presidentit në rastet kur ai/ajo kryen veprë të rëndë penale, mirëpo në praktikë vështirë se mund të imagjinohet një situatë e tillë ku Presidenti të ngelë në detyrë edhe pse ka kryer ndonjë veprë “të lehtë “ (jo të rëndë). Cilado që mund të jetë natyra e veprës penale, Presidenti i Republikës do të shkarkohej nga Kuvendi, nëse ai/ajo vetë nuk do të jepte dorëheqje. Kjo e fundit, çuditërisht, nuk parashihet teknikisht në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kjo në asnjë mënyrë nuk nënkupton se dorëheqja përjashtohet si mënyrë e përfundimit të mandatit të Presidentit të Republikës, nisur nga natyra krejt e vetëkuptueshme e aktit të dorëheqjes. Sa i përket bazës tjetër për shkarkim, asaj të paaftësisë për të kryer detyrat dhe ushtuar përgjegjësitë për shkak të sëmundjes së rëndë, vlejné të njëjtat argumente, *mutatis mutandis*, të dhëna me nenin 90, si më sipër.
3. Paragrafi i dytë flet për peticionin për shkarkim. Edhe këtu, kur flitet për shkaqet e sëmundjes së rëndë si bazë për nisje të peticionit. Por, peticioni mund të paraqitet edhe për shkaqet tjera objektive. Edhe këtu vlejné argumentet e njëjta, *mutatis mutandis*, si ato të dhëna për paragrafin e mësipërm të këtij neni. Mirëpo, ndryshe qëndron puna kur si bazë për shkarkim shërben shkelja e rëndë e pohuar e Kushtetutës. Këtu kemi të bëjmë me situatat e cenimit të rëndë të Kushtetutës, të cilat janë të hapura, momentale dhe brutale. Për kësi situatash, Kushtetuta përcakton si anën materiale ashtu dhe atë procedurale. Këtu Kushtetuta ia cakton Gjykatës një afat tepër të shkurtër për vendimarrje, afatin shtatë (7) ditor nga dita e marrjes së

peticionit. Kjo është arsyeja që e dallon këtë bazë për shkarkim nga ajo e paraparë në kuadër të dispozitave që flasin për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, në nenin 113.6 të Kushtetutës. Për këtë bazë të shkarkimit në kuadër të juridiksionin do të flitet më vonë. Këtu mjafton të thuhet se ky paragraf i nenit 91 flet për “shkelje të rënda”, kurse në nenin 113.6 të Kushtetutës është përdorur fjala “shkelje serioze” të Kushtetutës. Këto shprehje kanë edhe pasojat e tyre të cilat dallojnë esencialsht nga njëra tjetra. Ky dallim në rend të parë reflektohet në afatin tepër të shkurtër, shtatë (7) ditor, të paraparë për nisjen e peticionit kur flitet për “shkeljet e rënda” të Kushtetutës. Ky nuk është rasti me “shkeljet serioze” nga neni 113.6 i Kushtetutës.

4. Përveç kësaj, numri i deputetëve që kërkohet në rastin e parë është më i madh se në rastin e dytë, gjë që flet për një dallim tjetër thelbësor. Mirëpo, dallimi krejtencial nuk qëndron te procedurat, por te përmbajtja e dy fjalëve të përdorua. Siç është parë edhe nga rasti i ish Presidentit të Republikës, Z. Fatmir Sejdiu, të “cenimet serioze” të Kushtetutës, më shumë bëhet fjalë për veprime joserioze, të pallogaritura mirë, të Presidentit të Republikës, të cilat lidhen me natyrën dhe pozitën e shefit të shtetit siç përcaktohet me nenet 4.3 [“Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit”] dhe 83 [“Statusi i Presidentit”] të Kushtetutës. Në rastin e dytë, ndërkaq, fjala është më shumë për cënimet e rënda të llogaritura mirë të Kushtetutës nga ana e Presidentit që kanë të bëjnë, kryesisht, me veprimet ultra vires të tij/saj (siç është, ta zëmë, nënshkrimi apo hyrja në një marrëveshje ndërkombëtare që cenon sovranitetin dhe tërësinë territoriale të vendit). Në këto “shkelje të rënda” hyjnë edhe mosveprimet apo tolerimet nga ana e Presidentit të situatave të caktuara me të cilat cenohet rendi kushtetues kosovar (siç është, ta zëmë, mosveprimi ndaj, apo tolerimi, i kaosit në vend në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme, pa marrë parasysh si janë shkaktuar gjendjet e tilla të jashtëzakonshme). Nga kjo që u tha deri këtu, del se “cenimet serioze” mund të jenë veprime të pavërejtshme për laikët dhe mund të zgjasin e të përbëhen nga disa veprime zingjirore, në ndërkohë që “cenimet e rënda” paraqesin veprime, apo mosveprime (tolerime) të momentit, brutale dhe të hapura të cilat ndërmerren (apo tolerohen) jo për të komprometuar rolin dhe pozitën e shefit të shtetit por për rendin kushtetues si tërësi.⁴¹⁷

⁴¹⁷ Si shembull gjyqësor, Gjykata Kushtetuese e Lituaniës, në vendimin e saj Nr. 24/04, duke elaboruar kushtet për kandidimin për President të Republikës, theksoi se sipas Kushtetutës, kur një person ka shkelur rëndë Kushtetutën, ka shkelur betimin apo ka kryer një vepër penale përmes së cilës ka shkelur rëndë Kushtetutën ose është shkelur betimi i dhënë, dhe ai person është shkarkuar - në përputhje me procedurat e shkarkimit (impeachment) - nga pozita e Presidentit të Republikës, Kryetarit apo Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, Kryetarit apo Gjyqtarit të Gjykatës Supreme, Kryetarit apo Gjyqtarit të Gjykatës së Apelit, ose i është revokuar mandati parlamentar, ai person nuk mund të zgjidhet kurrë President i Republikës, anëtar i parlamentit dhe nuk mundet kurrë të mbajë një pozitë të Gjyqtarit në Gjykatë Kushtetuese, Gjykatë Supreme apo Gjykatë të Apelit, anëtar i Qeverisë apo Auditorit Shtetëror: Shih: Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituaniës, Nr. 24/04, datë 25.5.2004.

Kapitulli VI: Qeveria e Republikës së Kosovës

Hyrje e Përgjithshme

1. Në kuptim të pozitës kushtetuese, Qeveria është instrumenti ekzekutiv i shtetit. Në një pozicion të tillë, Qeveria është veshur me detyrën kushtetuese për të ushtruar funksionin ekzekutiv të shtetit. Kufijtë e pushtetit ekzekutiv jo gjithmonë përcaktohen nga Qeveria. Në këtë përcaktim, në pikëpamje teknike, një rol mund ta luaj autoriteti ekzekutiv i shefit të shtetit si dhe i organeve tjera të pavarura ekzekutive. Qeveria, si organi që ushtron pothuajse tërësisht pushtetin ekzekutiv në një republikë parlamentare sikur Kosova, përbën mekanizmin më të rëndësishëm të shtetit. Shteti, argumenton Heywood, mund të ekzistojë pa parlament, pa parti politike, pa kushtetutë, pa gjyqësor, por nuk mund të ekzistoj pa një mekanizëm që bën vënien në jetë të politikës.⁴¹⁸ Shikuar në këtë kontekst, Qeveria është burimi i fuqisë udhëheqëse të shtetit, kurse mekanizmat si gjyqësori, parlamenti, kushtetuta apo partitë politike janë ndërtuar për të ushtruar kufizimin (dhe ruajtjen) prej tendencave për diktaturë të pushtetit ekzekutiv.⁴¹⁹
2. Duhet thënë që pushteti ekzekutiv ka një trend rënës dhe kufizim të fuqisë së tij, trend që ka pasur pothuajse natyrë historike. Ndryshimi i regjimeve në botë, revolucionet demokratike në Evropë përgjatë shekujve, apo edhe shembjet tiranike të pushtetit, gjithherë kanë rezultuar në dobësim të pushtetit ekzekutiv, dhe në ndërtim të mekanizmave që e kufizojnë atë. Në këtë kuptim, pushteti ekzekutiv ka qenë historikisht burimi i diktaturës dhe tiranisë së shteteve, dhe natyrshëm edhe shkaktari i dhunës së pakontrolluar të shtetit. Në këtë kontekst, pushteti ekzekutiv, historikisht, por edhe në ditët e sotme, ka qenë burimi i fuqisë reale të shtetit, si në kuptimin e brendshëm ashtu edhe në atë të jashtëm. I vënë në këtë pozicion, pushteti ekzekutiv duhet shikuar si arma e shtetit përmes së cilit është kontrolluar *dëgjueshmëria* qytetare dhe *kontrolli* i dhunës si mjet sovraniteti brenda shtetit.
3. Tkurrjen më të madhe të fuqisë së vet, pushteti ekzekutiv, në kuptimin historik, e pëson me revolucionet borgjeze, e më vonë, ato republikane, por natyrshëm, ky trend vazhdon qoftë edhe në valën e tretë të demokratizimit të shteteve në Evropë, me rrëzimet e pushteteve autoritare në Portugali dhe Spanjë, por edhe në Greqi, natyrshëm, për të vazhduar me shembjet e regjimeve komuniste, dhe me revolucionet demokratike në tërë Evropën lindore, për të përfunduar deri në ditët e

⁴¹⁸ Heywood, Andrew (1997) *Politics*. London: Macmillan Foundations (chapter 16);

⁴¹⁹ Shih më shumë në lidhje me argumentin për nevojën e kufizimit të pushtetit ekzekutiv: Martinez, S. Jenny (2006) 'Inherent Executive Power: A Comparative Perspective'. *The Yale Law Journal* Vol. 115 (9): p. 2482-2511; Shih një kritikë mbi trendet zgjeruese të pushtetit ekzekutiv amerikan prej versionit të tyre kushtetues fillestar, në: Morton J. Frisch (1987) 'Executive Power and Republican Government—1787'. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 17 (2), Bicentennial Issue: The Origins and Invention of the American Presidency (SPRING 1987): p. 281-291;

sotme në valët e kthimit të pushtetit tek populli në revolucionin e *Pranverës Arabe*. Në këtë kuptim, pushtetet ekzekutive kanë qenë natyrshëm objektet e revolucioneve popullore, që qëllim parësor kishin zbutjen e rolit të ekzekutivit në drejtimin e shtetit dhe rritjen e legjitimitetit popullor të pushtetit.⁴²⁰ Ndryshimet e sistemeve politike në Evropë gjithmonë kanë sjellë në jetë mekanizma institucional që kanë vendosur linja kontrolli dhe kufizimi të pushtetit ekzekutiv dhe që pretendonin të ndërtonin një jetë institucionale që kufizon mundësinë e një qeverisjeje diktatoriale.

4. Pozita kushtetuese e pushtetit ekzekutiv dallon varësisht prej modelit të qeverisjes. Në kuptimin e një shteti republikan, pozita e pushtetit ekzekutiv dallon varësisht prej modelit të ndarjes së pushtetit, fuqisë së parlamentit dhe rolit të presidentit të republikës. Logjikshëm, në sistemin presidencial të qeverisjes, pushteti ekzekutiv bartet *i vetëm* nga ana e presidentit të shtetit, dhe ky i fundit e *qeveris* atë pa asnjë kufizim brenda konturave të pushtetit ekzekutiv. Në këtë sistem, pushteti ekzekutiv ka një qeverisje individuale, dhe nuk i nënshtrohet mekanizmave të brendshëm të *ndërvarjes* dhe *kontrollit*.⁴²¹ E kundërt është pozita kushtetuese e pushtetit ekzekutiv në sistemet qeverisëse parlamentare, megjithëse, edhe këtu ka një variacion që lidhet me nëntipin e këtij sistemi qeverisës.⁴²²
5. Në sistemin parlamentar të qeverisjes, pushteti ekzekutiv ka *natyrshëm* dy institucione brenda terrenit të saj, që janë: presidenti i republikës, i cili njëkohësisht luan rolin e shefit të shtetit (në ushtrimin e të cilit rol ai/ajo nuk hyn në terrenin e pushtetit ekzekutiv) dhe ka një numër shumë të kufizuar të kompetencave ekzekutive, dhe Qeveria, që përbën një organin kolegjal, që kryen

⁴²⁰ Pavarësisht kësaj, Shtetet e Bashkuara janë një model ku roli i pushtetit ekzekutiv në kuptim të trendeve të globalizimit ka sjellë rritje të rregullt të fuqisë së pushtetit ekzekutiv, një argument i disave që argumentojnë që pushteti ekzekutiv është instrumenti më i përshtatshëm për të ushtruar disa kompetenca që lidhen me politikën e jashtme dhe luftën. Shih: Joel R. Paul (1998) 'The Geopolitical Constitution: Executive Expediency and Executive Agreements'. *California Law Review*, Vol. 86 (4): p. 671-773;

⁴²¹ Shih logjikën që i parapriu liberalizimit të pushtetit ekzekutiv, dhe idenë e substancializuar në kushtetutën amerikane, në: Morton J. Frisch (1987) 'Executive Power and Republican Government—1787'. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 17 (2), Bicentennial Issue: The Origins and Invention of the American Presidency (SPRING 1987): p. 281-291;

⁴²² Ekzistojnë këto lloje marrëdhëniesh në mes të kryeministrit dhe qeverisë si trup kolegjal, sipas modelit të parë, parlamenti zgjedh kryeministrin, kurse kryeministri më pastaj vendos vetë për ministrat që do të punojnë me të. Sipas modelit të dytë, kryeministri thjeshtë është vetëm njëri nga të barabartit, kurse parlamenti i zgjedh të gjithë përnjëherë. I treti model ka filluar në Francën e vitit 1792 dhe njihet me emrin "direktorat", i cili ka udhëhequr me ekzekutivin si një trup kolektiv. Ky model është ruajtur akoma në Zvicër, ku parlamenti zgjedh trupin kolegjal kolektiv por i cili nuk i përgjigjet parlamentit fare. Në modelin e fundit fjala është për sistem semipresidencial ku kryetari i këshillit të ministrave nominohet nga presidenti i republikës kurse anëtarët tjerë të qeverisë nominohen nga presidenti sipas rekomandimit të kryeministrit. Në këtë rast, ekziston vota e mosbesimit por në një rast të tillë vjen deri te vetëshpërbërja e parlamentit. Presidenti në këtë model mund të kryesoj mbledhjet e qeverisë. Cf. më shumë për këtë në Andras Sajo (1999) 'Limiting the Government. An Introduction to Constitutionalism'. Budapest: CEU Press, p. 180-183.

shumicën e kompetencave ekzekutive të shtetit.⁴²³ Në bërjen e dallimit të këtyre dy sistemeve, rol qendror luan pozita e parlamentit: në të parin, parlamenti nuk gëzon asnjë autoritet *mbikëqyrës* ndaj pushtetit ekzekutiv, por luan rolin e një legjislatori klasik, dhe ku ndarja e pushteteve është shumë më e ngurtë, përdërisa, në të dytin, parlamenti përveç rolit të tij legjislativ, ushtron edhe autoritetin e kontrollit politik të Qeverisë, që mund të rezultojë edhe në ushtrimin e mosbesimit dhe rrjedhimisht shkarkimin e saj,⁴²⁴ dhe ku ndarja e pushteteve është më fleksibile. Në mes të këtyre dy sistemeve, ekziston edhe modeli parlamentar-presidencial i shtetit, ku një balancë në mes të dy modeleve gjendet e portretuar në terrenin e relacionit të presidentit të republikës, qeverisë dhe parlamentit.

6. Qeveria është ushtruese e funksionit ekzekutiv të shtetit, dhe e ushtron këtë pothuajse e vetme në një sistem parlamentar të pastër.⁴²⁵ Funksioni ekzekutiv i qeverisë lidhet me detyrimet e saj të natyrës funksionale. Qeveritë janë natyrshëm të veshura me funksione që lidhen me zbatimin e së drejtës, por në raste të caktuara edhe bërjen e politikave publike, me menaxhimin e procesit të politik-bërjes, dhe, natyrshëm, roli themelor i qeverive, megjithëse dallon nga modeli qeverisës, konsiston në ushtrimin e lidërshiptit popullor.⁴²⁶ Sa i përket detyrës së parë, qeveria si instrument ekzekutiv i shtetit është në detyrë të zbatimit të së drejtës, dhe këtë detyrim nuk lejohet që ta lidh me diskrecionin politik apo përgjegjësinë politike që ajo bart. Ky detyrim është thjeshtë i natyrës juridike, dhe nuk mund të lidhet me diskrecion të vlerësimit politik nga parlamenti apo shefi i shtetit. Në kuptim të detyrës së dytë, qeveria është zbatuese e politikave publike, që rrjedhin nga një procedurë e vendimmarrjes e bazuar në normë juridike.
7. Në këtë funksion, Qeveria zbaton në praktikë politikat publike në fushën e kompetencave të saj, duke qëndruar e varur me përgjegjësi politike përballë parlamentit apo shefit të shtetit në republikat presidenciale dhe gjysmë-presidenciale. Përveç zbatimit të politikave publike, qeveria është në shumicën e fushave e veshur edhe me kompetencën e “bërjes” së politikave publike. Në ushtrimin e kësaj të drejte, qeveria “ushqen” lidhjen e saj me elektoratin dhe në

⁴²³ Konflikti për kompetenca ekzekutive në mes të presidentit dhe qeverisë mund të sjell krizë kushtetuese dhe rrezikim të funksionalitetit të sistemit institucional të shtetit. Prandaj, ndarja e qartë e funksioneve kushtetuese sa i përket kompetencave ekzekutive është e rëndësishë së veçantë. Shih rastin e Mongolisë, në: Lhamsuren Munkh-Erdene (2010) ‘The Transformation of Mongolia's Political System: From Semi-parliamentary to Parliamentary?’. *Asian Survey*. Vol. 50 (2): p. 311-334;

⁴²⁴ Shkarkimi i qeverisë në sisteme parlamentare mbetet i varur jo thjeshtë nga modeli kushtetues, por gjithashtu edhe nga vlerat politike të shoqërisë si dhe faktori objektiv që mund të paraqiten në një kohë të caktuar. Shih: Baron, P. David (1998) ‘Comparative Dynamics of Parliamentary Governments’. *The American Political Science Review*. Vol. 92,(3): p. 593-609.

⁴²⁵ Cf. Taylor, Hannis (1895) ‘The Outlook for Parliamentary Government’. *The North American Review*. Vol. 160, No. 461: p. 479-491;

⁴²⁶ Shih p.sh.: Mansfield, Jr. Harvey C (1987) ‘The Modern Doctrine of Executive Power’. *Presidential Studies Quarterly*. Vol. 17, No. 2, Bicentennial Issue: The Origins and Invention of the American Presidency: p. 237-252;

përgjithësi popullin,⁴²⁷ duke ushtruar dhënien e përgjegjesisë shoqërore përballë shoqërisë, por edhe përgjegjesisë politike përballë parlamentit apo shefit të shtetit. Në kryerjen e këtij funksioni, qeveria ushtron diskrecion politik sa i përket mënyrës, hapësirës, substancës apo edhe qëllimit të vet politikave publike në fushën e saj. Prandaj, argumenti themelor është që detyrimi i zbatimit të së drejtës si një funksion themelor i qeverisë dallon shumë nga funksioni i saj për zbatimin dhe bërjen e politikave publike. Nëse në rastin e parë qeveria nuk gëzon diskrecion dhe nuk mund ta shtrojë për vlerësim politik detyrimin për të zbatuar të drejtën, në rastin e dytë qeveria gëzon diskrecion politik dhe zakonisht e shtron për vlerësim politik çështjen e bërjes dhe zbatimit të politikave publike në fushën e saj. Në kuptimin filozofik, ka pasur autorë, si p.sh. *Locke*, që kanë argumentuar se Qeveria duhet të vishet me diskrecion që duhet të shfrytëzohet për interesin publik edhe nëse bie ndesh me përcaktimet e ligjit.⁴²⁸ Në demokracitë moderne, megjithatë, shfrytëzimi i këtij diskrecioni për qëllime të interesit të përgjithshëm, nëse bie në kundërshtim me ligjin, është i ndaluar, ndërkohë që Qeveria gëzon diskrecion në mënyrë ekskluzive vetëm në kuadër të hapësirës që e lejon norma juridike, por jo jashtë saj.

8. Një funksion shumë natyral i qeverisë, përveç dy të përmendurve më lartë, është edhe menaxhimi i administratës publike të shtetit. Prandaj, duhet thënë që në kuptimin e gjerë, koncepti qeveri përfshin dy nivele: një, nivelin politik, i cili gjendet në krye të qeverisë dhe përbëhet nga të zgjedhurit politik të shtetit, dhe dy, nivelin administrativ civil, i cili përbëhet nga shërbyesit civil, përkatësisht administrata publike si një instrument profesional dhe civil që i nënshtrohet nivelit politik të udhëheqjes në realizimin e funksionit ekzekutiv të qeverisë.
9. Menaxhimi i administratës publike, apo i komponentit më të ngushtë të saj, administratës shtetërore, nga ana e qeverisë, megjithatë, i nënshtrohet rregullave të shërbimit civil, ku kontrolli politik nuk lejohet të shtrihet mbi parimet e profesionalizmit, meritës, efikasitetit dhe apatiakizmit të shërbimit civil. Në menaxhimin e administratës publike, funksioni i qeverisë nuk mbetet thjeshtë politik dhe vendimmarrës, por edhe shënon zbritje deri në pikën më të ulët të pushtetit shtetëror. Në këtë aspekt, qeveria duhet shikuar si një kontrollues dhe menaxhues i pothuajse tërë hallkave të administratës shtetërore, të cilat, zakonisht, përbëjnë pjesën më të madhe të volumit të pushtetit shtetëror. Në shtetet ku kjo ndarje nuk ekziston, vjen në shprehje dukuria e politizimit të administratës shtetërore, që nënkupton se administrata shtetërore udhëhiqet sipas interesit të ngushtë të vet partisë që e kontrollon atë.⁴²⁹ Prandaj, në kuptim të

⁴²⁷ Literatura sugjeron që kontrolli shoqëror i qeverisë, apo edhe bërja e dallimit në mes të një qeverie të kënaqshme dhe jo të kënaqshme, bëhet zakonisht me shumë pak gjasa nga këndi shumicës së popullit. Shih: Posner, Eric A. & Vermeule, Adrian (2007) 'The Credible Executive'. *The University of Chicago Law Review*. Vol. 74 (3): p. 865-913;

⁴²⁸ Lee Ward (2005) 'Locke on Executive Power and Liberal Constitutionalism'. *Canadian Journal of Political Science / Revue canadienne de science politique*. Vol. 38 (3): p. 719-744;

⁴²⁹ Cf. Kontrolli partiak mbi agjendën e Qeverisë dhe administratës: Sayers, M. Anthony & Moon, Jeremy (2002) 'State Government Convergence and Partisanship: A Long-Run Analysis

standardeve demokratike, ekziston një nevojë imanente për ndarje vertikale të pushtetit ekzekutiv, që nënkupton ndarjen si institucionale ashtu edhe ndarjen e shkarkimit të përgjegjësive në mes të nivelit politik dhe atij civil brenda pushtetit ekzekutiv. Në kuptim të kësaj, duhet thënë se kjo ndarje vertikale mundëson gjithashtu që në rastet e krizave politike, kur nuk mund të ketë një Qeveri të zgjedhur për shkak të një krize parlamentare, shërbimi civil, apo në përgjithësi administrata publike, vazhdon të ushtrijë funksionin e vet në mënyrë të rregullt, dhe t'i shkarkoj përgjegjësitë e saj juridike përballë ligjit në fuqi.

10. Përveç funksioneve strukturore dhe institucionale që ushtron qeveria, siç u shpjegua më sipër, ajo gjithashtu ushtron edhe rolin e një lidhësi politik të vendit, rol, vëllimi i të cilit dallon varësisht nga sistemi i qeverisjes së një shteti dhe rrethanat në të cilat gjendet ajo në një kohë të caktuar.⁴³⁰ Në kuptim të këtij roli, Qeveria zakonisht përbën mekanizmin që ushtron lidhësin politik të shoqërisë dhe shtetit, meqë shefi dhe anëtarët e saj janë zakonisht përfaqësuesit më të votuar në zgjedhjet e përgjithshme. Në ushtrimin e këtij roli, Qeveria gjithashtu shkarkon përgjegjësinë e saj politike ndaj elektoratit që e ka votuar,⁴³¹ por edhe përgjegjësinë shoqërore ndaj tërë shoqërisë së shtetit.⁴³² Duhet thënë që në ushtrimin e këtij roli, Qeveria zakonisht shfrytëzohet si mjet për qëllime partiake të partisë që e udhëheq atë, duke kontekstualizuar kështu lidhësin politik me një rol më shumë partizan në sajë të bartjes dhe shfrytëzimit të kompetencave të këtij institucioni.
11. Në këtë aspekt, me rëndësi të veçantë është edhe fakti që Qeveria, në sistemet parlamentare, si instrument ekzekutiv i shtetit, është e dizajnuar në mënyrë të tillë që të mund t'i nënshtrohet mocioneve të mosbesimit, që shpiejnë në mundësinë për ndërrim dhe rrëzim të shpeshtë të saj. Duhet thënë që ndërrimi i qeverisë, apo edhe dhënia e mundësisë përmes një dizajni kushtetues fleksibil, në kuptim të kontrollit parlamentar, përbën hapësirën ku shtrohet konkurrenca politike dhe dhënia e përgjegjësive politike. Prandaj, sistemet kushtetuese parlamentare që nuk predisponojnë kontroll fleksibil dhe të shpeshtë të Qeverisë nga ana e parlamentit,

of Australian Ministerial Portfolios'. *Canadian Journal of Political Science / Revue canadienne de science politique*. Vol. 35 (3): p. 589-612;

⁴³⁰ Lidhësi i tillë mëton të jetë thjeshtë lidhësi ekzekutiv, por, për shkak të kontrollit edhe të shumicës parlamentare nga ana e qeverisë, mund të përkthehet edhe në lidhësi legjislativ. Shih: Ferguson, Robertson Margaret (2003) 'Chief Executive Success in the Legislative Arena'. *State Politics & Policy Quarterly*. Vol. 3 (2): p. 158-182;

⁴³¹ Krahaso se si votuesit që kanë votuar për një parti që nuk ka fituar shumicën e kontestojnë legjitimitetin e agjendës së qeverisë, dhe qasjen e saj ndaj interesave të përgjithshme: Anderson, J. Christopher & Tverdova, V. Yuliya (2001) 'Winners, Losers, and Attitudes about Government in Contemporary Democracies'. *International Political Science Review / Revue internationale de science politique*. Vol. 22 (4), 'The Dynamics of Democratic Satisfaction. *Dynamique de la satisfaction démocratique*': p. 321-338;

⁴³² Argumentohet që konfidenca ndaj institucioneve, duke përfshirë qeverinë, lidhet me rolin që luan partia që bart qeverinë përballë përgjegjësive të saj shoqërore. Shih: Kelleher, A. Christine & Wolak, Jennifer (2007) 'Explaining Public Confidence in the Branches of State Government'. *Political Research Quarterly*. Vol. 60 (4): p. 707-721;

apo edhe që nuk lejojnë hapësirë për mocione efektive mosbesimi ndaj qeverisë, janë të paraprirja që të dëmtojnë garën politike dhe të ngushtojnë hapësirën për kontroll efektiv parlamentar. Në anën tjetër, sistemet kushtetuese parlamentare që ofrojnë mundësi për kontroll fleksibil dhe më të lehtë për kalimin e mocioneve të mosbesimit ndaj qeverisë janë të paraprirja që të mos lejojnë monopolizim të pushtetit ekzekutiv nga një rrymë partiake.⁴³³

12. Në fund, duhet thënë që funksioni i Qeverisë brenda sistemit politik të shtetit është shumë i varur nga vet tipi i skenës politike, i sistemit elektoral, por edhe nga sistemi partiak i shtetit. Modelet parlamentare të shtetit dypartiak, me një sistem elektoral mazhoritar të pastër, lejojnë mundësinë që Qeveria të jetë thjeshtë një instrument i partisë në pushtet, dhe që ajo të ketë fuqinë e pakontestuar për aq kohë sa partia bart shumicën parlamentare. Modelet parlamentare të shtetit shumëpartiak, zakonisht lejojnë më pak hapësirë për një parti të vetme politike për të kontrolluar Qeverinë, meqë ndërtimi i koalicioneve partiake si e vetmja mundësi për të mbledhur numrin e nevojshëm të votave për të emëruar Qeverinë kërkon konsensus brenda disa partishë, duke e kufizuar në këtë mënyrë hapësirën për një parti të vetme politike.⁴³⁴
13. Në këto modele të shtetit, Qeveria më shumë shndërrohet në një funksion të raportit të forcave në mes të partnerëve të koalicionit, përderisa parlamenti bëhet logjikshëm vendi ku ndërtohet ky konsensus i partnerëve të koalicionit. Prandaj, në këtë model të shtetit, parlamenti luan rol shumë më aktiv përballë Qeverisë, kurse partitë politike zakonisht kanë rol më të zbehtë, dhe funksionin e tyre mund ta ushtrojnë thjeshtë përmes ndërtimit të konsensusit në parlament.⁴³⁵ Natyrisht, duhet thënë që rol shumë të rëndësishëm për stabilitetin parlamentar ka edhe disiplina brenda-partiake, si dhe roli i shefit të partisë brenda strukturës së vet qeverisë.⁴³⁶ Në vijim të kësaj që u tha, grosso modo, mund të thuhet se disiplina

⁴³³ Shih p.sh. rastin në Itali: Fabbrini, Sergio (2000) 'Political Change without Institutional Transformation: What Can We Learn from the Italian Crisis of the 1990s?'. *International Political Science Review / Revue internationale de science politique*. Vol. 21 (2): p. 173-196;

⁴³⁴ Kështu, ta zëmë, argumentohet që lufta për përballje me mocione mosbesimi ndaj qeverisë zakonisht është e kontrollueshme nga një qeveri që nuk dëshiron të lëshoj hapësirë për opozitën. Shih: Baron, P. David (1998) 'Comparative Dynamics of Parliamentary Governments'. *The American Political Science Review*. Vol. 92 (3): p. 593-609;

⁴³⁵ Përvoja argumenton se sa më i gjerë koalicioni, Qeveria mbetet më e varur dhe jostabile ndaj shumicës parlamentare. Shih p.sh: Diermeier, Daniel & Vlaicu, Razvan (2011) 'Executive Control and Legislative Success'. *The Review of Economic Studies*. Vol. 78 (3): p. 846-871; Literatura argumenton që qeveritë që ndërtohen sipas marrëveshjes së koalicionit, dhe të tillat që nuk kanë një bazë shumë të gjerë parlamentare, janë shumë më të predispozuara që të mos shfrytëzojnë fuqinë e shtetit për të nxitur konflikte apo luftëra, dhe i nënshtrohen logjikës së frikës ndaj rrëzimit parlamentar. Shih: Ireland, J. Michael & Gartner, Sigmund Scott (2001) 'Time to Fight: Government Type and Conflict Initiation in Parliamentary Systems'. *The Journal of Conflict Resolution*. Vol. 45 (5): p. 547-568;

⁴³⁶ Krahaso me rastin Gjerman: Edinger, Michael & Vogel, Lars (2005) 'Role Perceptions, Party Cohesion and Political Attitudes of East and West German Parliamentarians: Findings from the Jena Parliamentary Survey (2003-4)'. *Sociologický Časopis / Czech Sociological Review*. Vol. 41 (3): p. 375-399;

partiake paraqet një faktor të rëndësishëm në vendet që modelohen sipas sistemit britanik, në ndërkohë që përtej Atlantikut, në SHBA, dega ekzekutive shikohet me dyshim dhe në Kongres ruhet autonomia individuale ligjvënëse si pasojë e mungesës së disiplinës partiake.⁴³⁷

Neni 92 [Parimet e Përgjithshme]

- (1) Qeverinë e Kosovës e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat.
- (2) Qeveria e Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligj.
- (3) Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësiive të përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj.
- (4) Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo.

Neni 92

1. Neni 92 i Kushtetutës përcakton parimet bazike institucionale dhe funksionale të Qeverisë. Në përgjithësi, neni 92 vendos parimet në lidhje me përbërjen e Qeverisë, limitet në ushtrimin e funksionit të saj, vet funksionin origjinal të saj, si dhe përcakton në përgjithësi rolin substancial të saj në sistemin politik.

Neni 92.1

1. Neni 92.1 përcakton përbërjen e Qeverisë. Sipas këtij Neni, Qeveria përbëhet nga kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat.⁴³⁸ Në kuptim të këtij neni, kryeministri luan rolin e shefit të Qeverisë, përbën shefin individual të Qeverisë.⁴³⁹ Përveç kryeministrit, Qeveria përbëhet gjithashtu nga zëvendëskryeministrat dhe ministrat.

⁴³⁷ Sajo, Andras (1999) 'Limiting the Government. An Introduction to Constitutionalism'. Budapest: CEU Press, p. 161;

⁴³⁸ Çdo vendim që në bazë të Kushtetutës duhet të nxirret nga Qeveria e Republikës së Sllovakisë nuk mund të suprimohet nga një vendim i vetëm një anëtar i Qeverisë apo nga ndonjë institucion apo person tjetër. Kompetenca për të vendosur në çështje të paraparë me Kushtetutë nuk mund të anashkalohej përmes një deklarate, opinionit apo konkluzionit qeveritar apo çfarëdo forme tjetër e shprehjes pa karakter detyrues (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë PL. US 1/86 I datës 14.11.1996);

⁴³⁹ Gjë e cila lidhet me faktin nëse kryeministri, sipas nenit 94.4 të Kushtetutës, mund të shkarkojë dhe emërojë ministra pa lejen e parlamentit. Cf. për rastet e kundërta me Kosovën në King, Anthony & Nicholas Allen (2010) 'Off With Their Heads': British Prime Ministers and the Power to Dismiss'. *British Journal of Political Science*. Vol. 40 (2): p. 249-278;

2. Në kuptim të nenit 92.1, Qeveria, në aspektin organizativ, është organ kolektiv. Ajo përbëhet nga shumë anëtarë, dhe, logjikshëm, vendimet e saj merren nga një proces i votimit brenda saj. Aspekti organizativ i Qeverisë përbën faktor që tregon për natyrën vendimmarrëse të Qeverisë. Megjithëse në kohët e fundit në kuptimin komparativ ekziston një rol në rritje i kryeministrave, i quajtur shpesh “kryeministrizim” i qeverisjes,⁴⁴⁰ në kuptimin organizativ kryeministri është vetëm një anëtar i Qeverisë, dhe i nënshtrohet konceptit kolektiv të vendimmarrjes së saj.
3. I rëndësishëm është fakti i përbërjes së qeverisjes në kuptim të këtij neni edhe përballë modelit të vet qeverisë. Karakteri kolektiv i qeverisë, me ministrat dhe zëvendëskryeministrat në përbërje të tij, është gjithashtu përcaktor i rolit që kryeministri ka në tërësinë e qeverisë. Në këtë aspekt, duhet thënë që qeveria bart kompetenca që i takojnë asaj si kolektiv, por gjithashtu kryeministri ka kompetenca të tij individuale në kuadër të kompetencave kushtetuese të qeverisë, siç përcaktohet qartas nga neni 94 i Kushtetutës.

Neni 92.2

1. Neni 92.2 përcakton natyrën e funksionit të qeverisë, dhe përcakton kushtet mbi të cilat një funksion i tillë duhet të ushtrohet. Ky nen përcakton burimin e autorizimit të qeverisë, “territorin” funksional të saj, si dhe kufijtë e saj.⁴⁴¹ Sipas këtij neni, prandaj, qeveria është bartëse e pushtetit ekzekutiv, duke shtuar që ky është funksion origjinal i qeverisë. Megjithatë, i njëjti nen vendos kufijtë e ushtrimit të pushtetit ekzekutiv të qeverisë, duke përcaktuar që kushtetuta dhe ligjet e shtetit përcaktohet si limite të të njëjtit pushtet.
2. Duhet shpjeguar se pavarësisht që Neni 92.2 e përcakton qeverinë si bartëse të pushtetit ekzekutiv të shtetit, ky përcaktim nuk duhet kuptuar me ngurtësi absolute. Shumë institucione tjera të shtetit, ndër ta edhe presidenti i republikës, bartin kompetenca që kanë karakteristika ekzekutive, dhe natyrshëm, të njëjtën ndajnë një “hise” të pushtetit ekzekutiv.⁴⁴² Mirëpo, këto karakteristika, sipas nenit 92.2, nuk i vendosin institucionet e tilla në kuadrin e ekzekutivit sepse kompetencat e tyre nuk derivohen nga Kapitulli VI dhe, në të shumtën e rasteve, janë të deleguara si pasojë e “rritjes së shtetit administrativ” dhe ushtrohen nga agjencitë e pavarura shetërore të cilat në rastin e Kosovës normohen me nenin 142 të Kushtetutës. Kompetencat që kanë karakteristika ekzekutive të cilat ushtrohen nga presidenti i republikës parlamentare më shumë janë relikte të së kaluarës dhe njihen me emrin “pushteti ekzekutiv pasiv”,⁴⁴³ term ky i krijuar nga Benjamin Konstant (Benjamin Constant) në kohën e Revolucionit Francez.⁴⁴⁴

⁴⁴⁰ Krauss, S. Ellis & Nyblade, B (2005) 'Presidentialization' in Japan? The Prime Minister, Media and Elections in Japan'. *British Journal of Political Science*. Vol. 35 (2): p. 357-368;

⁴⁴¹ Cf me sistemet e ndryshme të ndarjes së pushtetit, në: 'The Division of Powers in Government' (1913). *Harvard Law Review*, Vol. 26, No. 8: p. 744-747;

⁴⁴² Shih: Baylis, A. Thomas (1996) 'Presidents versus Prime Ministers: Shaping Executive Authority in Eastern Europe'. *World Politics*. Vol. 48 (3): p. 297-323;

⁴⁴³ Mj. Vile, J. C (1998) 'Constitutionalism and the Separation of Powers'. Indianapolis: Liberty

3. Në kuptim të nenit 92.2, duhet thënë që bartja e pushtetit ekzekutiv nuk duhet nënkuptuar si monopol i qeverisë,⁴⁴⁵ dhe kjo për dy arsye bazike kushtetuese. E para, funksioni ekzekutiv i shtetit, pjesa më e madhe e të cilit ushtrohet nga ana e qeverisë, është funksion i kontrolluar institucionalisht nga dy pushtetet tjera, përkatësisht pushteti legjislativ dhe gjyqësor. Prandaj, në ushtrimin e këtij funksioni, qeveria kontrollohet substancialisht nga të dy pushtetet tjera, dhe ushtrimi i funksionit ekzekutiv nga ana e qeverisë kufizohet në mënyrë kontinueale. I vetmi monopol që bart qeveria në këtë aspekt është që, edhe pse të dy pushtetet tjera ushtrojnë kontroll dhe kufizim të pushtetit ekzekutiv të qeverisë, ato nuk lejohet që këtë pushtet ta ushtrojnë vetë, meqë neni 92.2 qartësisht këtë autoritet ia njeh vetëm qeverisë së shtetit, dhe, e dyta, në ushtrimin e pushtetit ekzekutiv, qeveria nuk gëzon diskrecion të plotë në ushtrimin e veprimeve ekzekutive, meqë veprimet ekzekutive që duhet të ushtrojë qeveria përcaktohen apo limitohen në shumicën e rasteve me anë të normave juridike përkatëse. Bazuar në këto dy arsye, neni 92.2 nuk duhet shikuar si një autorizues i pakufishëm i monopolit mbi funksionin ekzekutiv të shtetit.

Neni 92.3

1. Neni 92.3 përcakton detyrimin e qeverisë përballë akteve të miratuara nga ana e Kuvendit të Kosovës, si dhe rregullon hapësirat nga ku qeveria mund të vishet me autorizime ekzekutive.
2. Sa i përket çështjes së parë, neni 92.3 vendos detyrimin e qeverisë për të zbatuar aktet e nxjerra nga ana e Kuvendit. Në vendosjen e këtij detyrimi, neni 92.3 dallon dy lloje aktesh: një, aktet juridike të formës së ligjit, dhe dy, të gjitha aktet tjera juridike të miratuara nga ana e Kuvendit. Në këtë kontekst, sa i përket ligjeve, ky nen përcakton qartësisht relacionin e qeverisë si organ ekzekutiv përballë Kuvendit, si organi legjislativ i shtetit. Në këtë kuadër, qeveria është e detyruar të zbatoj ligjet e nxjerra nga ana e Kuvendit, dhe nuk ka asnjë hapësirë autoriteti prej nga mund t'i ikë një detyrimi të tillë.⁴⁴⁶ Prandaj, detyrimi i vendosur me nenin 92.3

Fund; Kapitulli i Trembëdhjetë ("Epilogue: The Separation of Powers and the Administrative State), p. 285-420;

⁴⁴⁴ Sajo, Andras (1999) 'Limiting the Government. An Introduction to Constitutionalism'. Budapest: CEU Press, p. 173-204, ku autori jep një analizë komparative të pushtetit ekzekutiv, përfshirë dhe llojet e origjinës së tij.

⁴⁴⁵ Shih një argument mbi dyshimin nëse një limitim kushtetues i pushtetit ekzekutiv është praktikisht i mundshëm, në rastin amerikan: Sutherland, George (1910) 'The Internal and External Powers of the National Government'. *The North American Review*. Vol. 191, No. 652: p. 373-389;

⁴⁴⁶ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Lituaniës në vendimin e saj 70/06 theksoi se në bazë të Kushtetutës, procedurat lidhur me përdorimin dhe tjetërsimin e pronës shtetërore duhet të parashihen me legjislacion. Një legjislacion i tillë duhet të përcaktojë qartë institucionet shtetërore që do të kenë kompetencë të transferojnë pronësinë e pronës shtetërore. Kjo gjithashtu vlen edhe për Qeverinë, e cila nuk ka diskrecion të vendos për "mos-zbatimin" e dispozitave të caktuara të një ligji përkatës, përveç se një mos-zbatim i tillë është paraparë expressis verbis brenda legjislacionit (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituaniës 70/06 i datës 23.05.2007);

që qeveria të zbatojë ligjet e nxjerra nga ana e Kuvendit, nuk mund të përjashtohet në asnjë mënyrë, për më tepër, as Kuvendi në kuptim të këtij neni nuk mund t'ia lejojë qeverisë që të mos e zbatojë një ligj të caktuar. Është i rëndësishëm të kuptohet struktura logjike e nenit 92.3 sa i përket detyrimit të qeverisë për të zbatuar ligjet e Kuvendit: neni në fjalë, nuk e përcakton detyrimin e qeverisë për zbatimin e ligjeve të Kuvendit thjeshtë si një funksion i vullnetit të këtij të fundit, por si një detyrim kushtetues të vet qeverisë. Me një fjalë, qeveria dhe Kuvendi, si dy institucione që përfaqësojnë pushtete të ndara dhe të kundërbalancuara, nuk kanë asnjë hapësirë autoriteti për të ndryshuar apo ndaluar detyrimin e zbatimit të ligjit nga ana e qeverisë, të vendosur sipas nenit në fjalë.

3. Sa i përket çështjes së dytë, neni 92.3 përcakton detyrimin e qeverisë që të zbatojë “aktet tjera të miratuara” nga ana e Kuvendit. Në këtë aspekt, duhet thënë që termi “të gjitha aktet tjera” të miratuara nga Kuvendi, përbën një detyrim shumë të gjerë të qeverisë përballë funksionit legjislativ të Kuvendit. Termi në fjalë, prandaj, vendos detyrimin e qeverisë që të zbatojë të gjitha aktet tjera juridike, përveç ligjit, të miratuara nga ana e Kuvendit, pavarësisht se çfarë formë juridike kanë ato (p.sh. rezolutë, mocion, vendim, etj.). Ky përcaktim e bën qeverinë të detyruar që të zbatojë çdo akt juridik që mund të nxjerrë Kuvendi i Kosovës, si një trup kolektiv, dhe e zgjeron shumëfish hapësirën mbi të cilën qeveria mban përgjegjësinë e saj ekzekutive përballë Kuvendit.
4. I rëndësishëm për komentim është gjithashtu edhe përcaktimi që qeveria “ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësisë së saj të përcaktuara me kushtetutë dhe me ligj”. Natyrisht, një pyetje bazike është nëse kompetencat apo pushteti i qeverisë kanë karakter statik? Bazuar në nenin në fjalë, autoriteti ekzekutiv i qeverisë mund të ndryshoj sipas përcaktimit kushtetues dhe ligjor. Kjo shpie në argumentin që gjerësia dhe masa e pushtetit të qeverisë është përcaktim i kushtetutës dhe ligjit, dhe pushteti në fjalë mund t'i shtrohet ndryshimit konstant përmes ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore. Në këtë aspekt, ky nen vendos detyrimin e qeverisë që t'i nënshtrohet një ligji apo një amendamenti kushtetues të miratuar në Kuvend, i cili ka prekur një kompetencë të qeverisë. Prandaj, në kuptim të këtij neni, qeveria nuk mund t'i shtojë apo heq vetes kompetenca ekzekutive, dhe një gjë e tillë është prerogativ i funksionit kushtetudhënës dhe legjislativ të Kuvendit, e materializuar përmes kushtetutës dhe nxjerrjes dhe ndryshimit të ligjeve. U mor vesh se amendamentet kushtetuese të cilat i referohen rolit dhe pozitës së ekzekutivit duhet t'i nënshtrohen kufizimeve të njëjta nga neni 113.4 dhe 9 në lidhje me nenin 114.3 të Kushtetutës.

Neni 92.4

1. Neni 92.4 përcakton autoritetin e qeverisë në rolin e saj si propozues legjislativ, dhe/apo propozues/iniciues i akteve tjera juridike. Në kuptim të funksionit të saj ekzekutiv, neni 92.4 përsërit rolin e qeverisë si një organ që vendimet e saj i nxjerr në përputhje me procedurën dhe detyrimet substanciale të vendosura me kushtetutë dhe ligje përkatëse, duke vendosur njëkohësisht që vendimet e qeverisë që nuk

burojnë dhe që nuk respektojnë detyrimet e dala nga dy aktet përkatëse të jenë *ipso iure* nul.

2. Neni 92.4 e autorizon qeverinë që të ndërhyj në procesin legjislativ përmes dy rrugëve: një, si një propozues direkt i projektligjeve si dhe iniciues i amendamentimit të tyre, dhe dy, si një organ që mund të jap opinionin e tij zyrtar për një projektligj të propozuar nga një iniciues tjetër.
3. Sa i përket rolit të saj në rastin e parë, qeveria është e veshur me autorizimin kushtetues për të propozuar projektligje në Kuvendin e Kosovës, apo edhe të inicioj amendamentimin e ligjeve që tanimë janë në fuqi. Në rolin e saj iniciues, në kuptim të këtij neni, qeveria nuk është e kufizuar nga ndonjë procedurë e veçantë apo detyrim substancial, dhe iniciativa e saj për një projektligj është direkte, meqë e detyron në anën tjetër Kuvendin që ta procedojë të njëjtin projektligj në procedurë të miratimit parlamentar. Kjo e drejtë e qeverisë, prandaj, përbën një nga rrugët e komunikimit të saj me organin legjislativ, rrugë përmes së cilës qeveria paraqitet me të drejtën e plotë të iniciativës legjislative. Në kuptim të këtij neni, Kuvendi nuk është i obliguar në asnjë formë nga propozimi legjislativ i qeverisë, përderisa detyrimi i vetëm i Kuvendit është nxjerrja e projektligjit të propozuar nga qeveria, apo amendamentit ndaj një ligjit ekzistues, në seancë plenare për votim sipas procedurës ligjvënëse. Duhet thënë që, autorizimi i dhënë me nenin 92.4, në një republikë parlamentare sikur Kosova, nuk përbën vetëm të drejtë por edhe përgjegjësi për qeverinë, meqë kjo e fundit nuk duhet të jap përgjegjësi politike dhe shoqërore vetëm për faktin nëse ka zbatuar një ligj të caktuar, por edhe për faktin nëse ka qenë mjaftueshëm e përgjegjshme që të inicioj miratimin e një projektligji të duhur për shtetin. Prandaj, neni 92.4 e fut qeverinë në “rrethin” e përgjegjësive legjislative, duke e bërë atë aktor aktiv sa i përket bërjes së ligjeve, dhe jo thjeshtë zbatimit të tyre.
4. Sa i përket rolit të saj të dytë, neni 92.4 i jep të drejtë qeverisë që të jap mendimin e saj për projektligjet e iniciuara nga palët tjera të autorizuar. Në ushtrimin e kësaj të drejte, qeveria vepron si një organ kolektiv, ku procesi i dhënies së opinionit të saj i nënshtrohet votimit kolektiv në mbledhjen e saj. Në kuptim të këtij neni, duhet thënë që opinionin e qeverisë i dhënë për një ligj të caktuar që është propozuar nga një palë tjetër e autorizuar, nuk është obligativ, dhe nuk e detyron as Kuvendin por as iniciuesin e projektligjit. Arsyeja e dhënies së kësaj të drejte për qeverinë lidhet thjeshtë me faktin që qeveria duhet të ketë mundësinë që të jap arsyetimin lidhur me implikimet apo/dhe dështimet në zbatimin e një ligji që mund të jetë propozuar nga ana e një pale tjetër të autorizuar. Pavarësisht opinionit të qeverisë, kur projektligjit në fjalë votohet në Kuvend dhe hyn në fuqi, ai bëhet i detyrueshëm për zbatim nga ana e qeverisë.

Neni 93 [Kompetencat e Qeverisë]

Qeveria ka këto kompetenca:

- (1) propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;
- (2) mundëson zhvillimin ekonomik të vendit;
- (3) propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;
- (4) merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;
- (5) propozon Buxhetin e Republikës së Kosovës;
- (6) udhëzon dhe mbikëqyr punën e organeve të administratës;
- (7) udhëzon veprimtarinë dhe zhvillimin e shërbimeve publike;
- (8) i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës emërimet dhe shkarkimet për shef të misioneve diplomatike të Kosovës;
- (9) propozon amendamentimin e Kushtetutës;
- (10) mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
- (11) ushtron edhe funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve të tjera qendrore ose vendore.

Neni 93

1. Neni 93 i Kushtetutës përcakton kompetencat e qeverisë, në kuptim të funksionit të saj ekzekutiv. Bazuar në këtë nen, qeveria ushtron një mandat që buron nga kushtetuta, dhe vetëm në bazë të të cilit, qeverisja e saj legjitimohet në aspektin kushtetues.
2. Shikuar në kuptimin e natyrës së kompetencave të qeverisë sipas nenit 93, qeveria bart katër lloje të kompetencave: një, kompetencat në fushën e zbatimit të normave juridike dhe të ndërtimit të politikave publike sipas autorizimeve nga këto të fundit, dy, kompetencat në fushën legjislative, tre, kompetencat në fushën e emërimit të bartësve të disa institucioneve të shtetit, dhe katër, kompetencat e saj në fushën e inicimit të amendamenteve kushtetuese dhe të referimit të pyetjeve gjykatës kushtetuese. Nga numërimi taksativ i 13 kompetencave të përcaktuara me nenin 93, rezulton që numri më i madh i tyre i referohen funksionit bazik të qeverisë si një ekzekutues i akteve juridike përkatëse dhe i zbatimit të politikave publike në fushat e caktuara. Prandaj, t'i komentojmë të gjitha kompetencat një nga një.

Neni 93.1

1. Neni 93.1 përcakton kompetencën e qeverisë për të propozuar dhe zbatuar politikën e brendshme dhe të jashtme⁴⁴⁷ të vendit. Ky paragraf përcakton rregullën

⁴⁴⁷ Gjykata Kushtetuese e IRJM-së në vendimin e saj U. br. 140/99 theksoi se një akt i Qeverisë me të cilën themelohen marrëdhëniet diplomatike me një shtet përkatës nuk i ka elementet e një marrëveshje ndërkombëtare që është pjesë e rendit të brendshëm juridik. Ky është një akt përmes të cilit një shtet demonstroi vullnetin politik për themelimin e marrëdhënieve diplomatike me një shtet të tjetër, dhe si i tillë nuk i nënshtrohet kontrollit gjyqësor, por vetëm

më bazike të një kompetence të zgjeruar të qeverisë, që është funksioni natyral i saj. Dy karakteristikat e këtij paragrafi janë: një, që ai e vendos qeverinë në pozicionin e një propozuesi të politikës së brendshme dhe të jashtme, dhe dy, në pozicionin e zbatuesit të saj. Ky paragraf, i shikuar i izoluar nga tërësia e normave tjera kushtetuese, jep përshtypjen që politika e brendshme dhe e jashtme e shtetit nuk vendosen nga qeveria, dhe se qeveria është vetëm propozuesi dhe zbatuesi i saj.

2. Megjithatë, nga një vlerësim sistemor i kësaj dispozite, komentimi më real është që qeveria në shumë raste është edhe dizajnuar dhe vendimmarrës për politikën themelore të brendshme dhe të jashtme,⁴⁴⁸ dhe jo thjeshtë një propozues dhe zbatues i saj. Koncepti që qeveria është propozuesi dhe zbatuesi i politikës së brendshme dhe të jashtme, në mënyrën në të cilën normohet në këtë paragraf, nënkupton që vendimmarrja mbi politikën e brendshme dhe të jashtme të shtetit përcaktohet përmes legjislativës përkatës, i cili pastaj duhet zbatuar nga ana e qeverisë. Megjithatë, vet legjislativi përkatës lejon hapësirë shumë të gjerë në pothuajse çdo fushë të politikave publike (si në fushën e brendshme ashtu edhe në atë të jashtme) ku qeveria mund të ushtrojë diskrecionin e saj dhe të marrë vendime të pavarura.
3. Në kuptim të këtij paragrafi, i rëndësishëm është fakti që termi politikë e brendshme dhe e jashtme nënkuptojnë tërësinë e politikave publike të shtetit që kanë objekt çështje të natyrës brenda shtetit dhe çështje të natyrës së relacioneve të shtetit të Kosovës me shtetet dhe entitetet tjera të huaja. Megjithatë, pozicioni i qeverisë si propozues dhe si zbatues i politikës së brendshme dhe të jashtme në kuptim të këtij paragrafi duhet komentuar dhe lexuar brenda tërë kompetencave të institucioneve tjera, meqë shumë fusha të politikave publike të fushës së brendshme dhe të jashtme janë pronë kushtetuese e institucioneve tjera. Kjo nënkupton gjithashtu se asnjë ligj apo rregull tjetër në lëminë e brendshme apo të jashtme nuk guxon të jetë në kundërshtim me këtë nen dhe me vetë natyrën e ekzekutivit në një sistem parlamentar siç është Kosova.

Neni 93.2

1. Neni 93.2 përcakton që qeveria mundëson zhvillimin ekonomik të vendit. E listuar si kompetencë, mundësimi i zhvillimit ekonomik paraqitet më shumë si një detyrim pozitiv për qeverinë. Në këtë aspekt, kompetenca e tillë e qeverisë duhet komentuar jo thjeshtë si një autorizim i qeverisë për të nxjerr dhe zbatuar tërësinë e nevojshme të politikave publike për të mundësuar zhvillimin ekonomik të vendit, por gjithashtu edhe si një detyrim pozitiv i qeverisë për të ndjekur një kurs të tillë

kontrollit politik që ushtrohet brenda kornizave të demokracisë parlamentare (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të IRJM-së U.br. 140/99, i datës 14.6.2000);

⁴⁴⁸ Roli i qeverisë në politikën e jashtme të shtetit, në kuptim të dëshmimeve empirike, varet shumë nga modeli i lidershit të kryeministrit. Shih: Kaarbo, Juliet (1997) 'Prime Minister Leadership Styles in Foreign Policy Decision-Making: A Framework for Research'. *Political Psychology*. Vol. 18 (3): p. 553-581;

kushtetues. Ky paragraf duhet nënkuptuar si thelbi i vetë legjitimitimit të jashtëm në arsyetimin e nevojës për të pasur një qeveri me kompetenca kushtetuese, përderisa koncepti i mundësimit të zhvillimit ekonomik është thjeshtë thelbi i një detyrimi kushtetues të qeverisë për të plotësuar interesat bazike qytetare.

2. Për t'iu qasur kësaj çështjeje në mënyrë më të thellë, është i nevojshëm dekonstruktimi i termit “mundësim” i zhvillimit ekonomik, i përdorur në këtë paragraf. Shikuar në aspektin e një ekonomie të tregut, koncepti kushtetues që qeveria detyrohet të “mundësoj” zhvillimin ekonomik ka shumë kontrast me konceptin e qeverisë si “zhvillues” ekonomik. Prandaj, ky paragraf ndërton detyrimin që qeveria vetëm të përkujdeset për ndërtimin e një ambienti ekonomik ku zhvillimi i kësaj të fundit të mund të jetë i mundshëm, përderisa kjo kompetencë nuk e “detyron” qeverinë që të luaj rolën e motorit të zhvillimit ekonomik. E shikuar në debatin ekonomik *majtas apo djathtas*, ky paragraf qëllimisht përcakton një detyrim shumë djathtist për qeverinë sa i përket zhvillimit ekonomik, meqë e detyron këtë të fundit që vetëm të ndërtoj kushtet e nevojshme ekonomike ku mundësohet zhvillimi, përderisa vet zhvillimi ekonomik të bartet nga ana e sektorit privat. Në këtë kuptim, ky paragraf logjikshëm ndërton rolin e qeverisë si një mekanizëm që instalon një ambient biznesor ku zhvillimi i ekonomisë pastaj bartet nga ana e vet sektorit privat, dhe që qeveria nuk është aktori që drejtpërdrejtë e bartë dhe e zhvillon ekonominë kombëtare.⁴⁴⁹

Neni 93.3

1. Ky paragraf përcakton kompetencën e qeverisë në relacion me procesin legjislativ të Kuvendit, duke vendosur që qeveria të ketë të drejtën e propozimit të projektligjeve dhe akteve tjera në Kuvend. E drejta e qeverisë për të propozuar projektligje dhe akte të tjera për miratim në Kuvend, e vendosur me këtë paragraf, përbën një nga rolet më bazike të qeverisë në një demokraci parlamentare çfarë është Kosova. Meqë në kushtet bashkëkohore të zhvillimit të shtetit shteti ligjor ka pësuar një zgjerim të fuqishëm, shumica e politikave publike kërkohet që të shndërrohen në ligje para se ato të mund të zbatohen në jetën publike. Në këtë kuptim, praktikisht, pothuajse çdo politikë publike e qeverisë shndërrohet në të tillë pasi që ajo të ketë marrë formën e ligjit nga ana e Kuvendit. Prandaj, roli i qeverisë si propozues i ligjeve përbën hapësirën në të cilën qeveria i legjitimon dhe i legalizon në formë të ligjeve propozimet e saj për politika publike në pothuajse çdo fushë të jetës publike.
2. Funkzioni i qeverisë si propozues i projektligjeve, në anën tjetër, duhet shikuar edhe në relacion me komunikimin ndërmjet vet tri degëve të pushtetit. Në një republikë parlamentare si Kosova, qeveria është motori i propozimit të

⁴⁴⁹ Duhet thënë që, në kuptim të mendimit juridik amerikan, hapësirat e tilla të dhëna me kushtetutë shpeshherë shihen si burime të autorizimeve kushtetuese që nuk kanë kufij, dhe që e lejojnë qeverinë që të kapërcejë të ashtuquajturit kufij të pushtetit të saj. Shih: Sutherland, George (1910) ‘The Internal and External Powers of the National Government’. *The North American Review*. Vol. 191, No. 652: p. 373-389;

projektligjeve në Kuvend, përderisa ky i fundit luan thjeshtë një rol pasiv të kontrollit dhe të miratimit të tyre. Në këtë mënyrë, si parim, në një qeveri parlamentare, projektligjet e qeverisë të dërguara në Kuvend përmes autorizimit të këtij paragrafi shërbejnë jo thjeshtë për legjitimimin e tyre parlamentar por edhe për legjitimimin e politikës publike të vet qeverisë nga përfaqësuesit e popullit të përfaqësuar në Kuvend. Në këtë praktikë, logjikshëm, qeveria është në kontroll të shumicës parlamentare e cila e ka fuqinë, në parim, për të miratuar projektligjet e propozuara nga qeveria. Prandaj, një qeverisje ekzekutive efektive, në një model demokracie si Kosova, mund të funksionojë vetëm në një relacion mirëbesimi në mes të qeverisë si propozues ligjor dhe shumicës parlamentare në Kuvend si një kontrollues dhe miratues i projektligjeve të propozuara nga qeveria.

3. Pavarësisht se autorizimi i dhënë me këtë paragraf ka karakter thjeshtë legjislativ,⁴⁵⁰ ai gjithashtu luan edhe një rol të fuqishëm të (mos) besimit parlamentar që ka qeveria. Ligjet e propozuara nga qeveria dhe të refuzuara nga shumica parlamentare në Kuvend mund të rezultojnë gjithashtu edhe me dorëheqjen e qeverisë, apo shkarkimin e saj, meqë në një rast të tillë mungon një korrelacion pozitiv konstant në mes të propozimit të ligjeve nga qeveria dhe mbështetjes parlamentare të saj në institucionin legjislativ.

Neni 93.4

1. Neni 93.4 përcakton autorizimin e qeverisë për të nxjerrë akte nënligjore dhe vendime për të zbatuar ligjet e miratuara nga Kuvendi.⁴⁵¹ Ky paragraf, praktikisht, vendos instrumentet juridike përmes së cilave qeveria autorizohet për të vënë në jetë detyrimet abstrakte që rrjedhin nga ligjet e miratuara nga Kuvendi. Instrumenti i tillë juridik i qeverisë mundëson që qeveria të ushtrojë veprimtarinë e saj të zbatimit të detyrimeve ligjore përmes nxjerrjes së akteve juridike me fuqi nënligjore dhe akteve juridike individuale, në mënyrë që i tërë procesi i zbatimit të së drejtës të jetë juridikisht i qëndrueshëm dhe i sigurt.⁴⁵²

⁴⁵⁰ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë theksoi se Parlamenti ka pushtet legjislativ dhe ushtron kontroll parlamentar mbi ekzekutivin. Komisioni parlamentar për Radion dhe Televizionin është shpërbërë më 1990, dhe BNTv dhe BNR janë bërë institucione të pavarura, autonome, gjithëkombëtare dhe të ndara nga çfarëdo partie. Komisioni i përhershëm parlamentar është vetëm organ ndihmës dhe nuk ka asnjë kompetencë të nxjerrë vendime që ndryshojnë aktet e votuara në Parlament, e as nuk mund të ushtrojnë pushtet ekzekutiv (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë 16/95 i datës 19.9.1995);

⁴⁵¹ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Lituanisë vendosi se dispozitat e një akti ekzekutiv që i mundësoi Qeverisë ta caktojë shumën e premisë (shpërblimit) për Kryetarin e Gjykatës Supreme, Prokurorin e Përgjithshëm dhe Auditorin Shtetëror, si dhe normat për caktimin e shpërblimeve për gjyqtarët, është në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet përkatëse, (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, 3/95 i datës 06.12.1995);

⁴⁵² Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë ka dhënë qëndrimin që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë nuk mund të kufizohen me dispozita nënligjore të nxjerra nga ana e Qeverisë dhe autoriteteve tjera me fuqi ekzekutive. Qeveria nuk ka kompetencë të kufizojë të drejtën e pronës apo ligjin kundër konkurrencës përmes dekreteve qeveritare (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë PL.US 7/96 i datës 27.02.1997);

2. Autorizimi për të nxjerrë akte nënligjore, megjithatë, kufizohet me këto kushte: a) që akti nënligjor të rregullojë një fushë juridike që rregullohet përmes ligjit të nxjerrë nga ana e Kuvendit; b) që akti nënligjor të mos shkel një ndalesë të vënë nga ana e ligjit përkatës; c) që akti nënligjor të ndjek qëllimin dhe objektivat e ligjit, dhe që akti nënligjor përkatës të jetë në përputhje të plotë me kushtetutën; dhe, d) që akti nënligjor të ketë karakter konkretizimi të normave abstrakte të ligjit përkatës. Nëse akti nënligjor përkatës plotëson këto katër kushte, atëherë fuqia e tij juridike buron drejtpërdrejtë nga ky paragraf i kushtetutës.⁴⁵³
3. Në kuptim të këtij paragrafi, autorizimi për të nxjerrë akte nënligjore përbën një fuqi shumë të rëndësishme sublegjislative të qeverisë,⁴⁵⁴ përmes së cilës ajo e juridizon procesin e zbatimit të ligjit.⁴⁵⁵ Megjithatë, në procesin e nxjerrjes së akteve nënligjore, qeveria nuk lejohet që të keqpërdor këtë autorizim si mënyrë e bishtnimit të normave abstraktë të ligjit.⁴⁵⁶ Në të njëjtën kohë, kjo nënkupton se aktet nënligjore të qeverisë, të nxjerrura sipas kushteve të mësipërme dhe sipas autorizimit të këtij paragrafi, shndërrohen në instrumente të detyrueshme ligjore për të gjithë personat që ato iu drejtohen, në kuptim të vet zbatimit të ligjit. Prandaj, në ushtrimin e autorizimit kushtetues për të nxjerr akte nënligjore, qeveria paraqitet thjeshtë si një aktor neutral në funksion të konkretizimit për qëllim të zbatimit të ligjeve përkatëse, dhe jo si një legjislator i pavarur.

Neni 93.5

1. Neni 93.5 përcakton autorizimin e qeverisë për të propozuar buxhetin e Republikës së Kosovës.⁴⁵⁷ Dy janë çështjet që duhen komentuar në kuptim të këtij neni: një, që

⁴⁵³ Gjykata Kushtetuese e Polonisë ka dhënë qëndrimin që fusha e çështjeve që mund të rregullohen përmes një akti ekzekutiv kufizohet përmes autorizimit të dhënë për t'i lëshuar ato akte, (Vendim i Tribunalit Kushtetues të Polonisë U 5/95 I datës 17.6.1997);

⁴⁵⁴ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë gjeti se “Konkluzionet” e Qeverisë janë akte që kanë të bëjnë me çështje preliminare dhe nuk janë rregullore. Prandaj ato nuk mund të kontestohen përmes procedurës së kontrollit abstrakt të ligjshmërisë. Pra, kërkesa për t'i shqyrtuar “Konkluzionet” u hodh poshtë (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-II-1095/1995, U-II-1021/1995 i datës 27.12);

⁴⁵⁵ Si shembull krahasues, Gjykata Supreme e Estonisë, në vendimin e saj 3-4-1-5-2000 lidhur me vlerësimin e një rregulloreje të Qeverisë theksoi se Qeveria mund të nxjerrë rregullore përderisa ligji që i jep kompetenca të lëshojë rregullore të tillë është në fuqi. Nëse ligji zëvendësohet me një ligj tjetër, Qeveria gjithashtu duhet të lëshojë rregullore të re (Vendim i Gjykatës Supreme të Estonisë 3-4-1-5-2000, i datës 15.5.2000);

⁴⁵⁶ Gjykata Kushtetuese e Moldavisë në vendimin e saj 21/2004 theksoi se në pajtim me Kushtetutën, Qeveria nxjerr akte nënligjore (dekrete) për implementimin e ligjeve. Sidoqoftë, Dekreti nr. 782-37 nuk përmban ndonjë klauzolë që thekson se cilën dispozitë ligjore do ta implementojë. Duke nxjerrë një dekret të tillë Qeveria ka tejkaluar kufizimet e saja kushtetuese (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Moldavisë nr. 21 i datës 2.9.2004);

⁴⁵⁷ Kushtetuta e parë që ka përcaktuar të drejtën ekskluzive të qeverisë për propozim të buxhetit është ajo e Spanjës e vitit 1812, e njohur si Kushtetuta e Cadiz-it. Më pas, gati të gjitha kushtetuta moderne kanë ndjekur, pak a shumë, logjikën e njëjtë e cila mund të përmbledhet për sa vijon: qeveria ka rol të veçantë në propozimin e buxhetit dhe në ushtrimin e këtij roli ajo duhet të jetë neutrale. Përcaktimi dhe shpërndarja e shpenzimeve publike, në parim, nuk i

autorizimi për të propozuar buxhetin e shtetit, nuk përbën thjeshtë një të drejtë, por edhe një detyrim që planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve publike të ndërtohet në linjë me politikat publike të programuara për vitin e ardhshëm financiar, dhe dy, që përmes këtij autorizimi kushtetues, qeveria shndërrohet në mekanizmin që bën planifikimin financiar dhe tavanet e shpenzimeve buxhetore të tërë institucioneve shtetërore, duke pasur gjithashtu tagrin që të vendos mbi vëllimin e shpenzimeve financiare që do të ketë çdo institucion shtetëror.

2. Natyrisht, koncepti i propozimit të buxhetit, si një autorizim kushtetues për qeverinë, është i kufizuar me të drejtën në pavarësi financiare të shumë institucioneve të pavarura, prandaj, në këto raste, qeveria nuk guxon të shfrytëzoj autorizimin kushtetues nga ky paragraf për t'i zvogëluar buxhetin e propozuar nga një institucion i pavarur i shtetit.⁴⁵⁸
3. Duhet argumentuar që autorizimi kushtetues për të propozuar buxhetin e shtetit, sipas këtij paragrafi, nuk përbën detyrim për Kuvendin për ta miratuar buxhetin e propozuar nga qeveria. Për më tepër, Kuvendi bart tagrin kushtetues që ta ndryshojë një propozim të tillë, dhe që ta miratojë një buxhet sipas versionit të tij. Megjithatë, koncepti që propozimi i buxhetit të bartet nga qeveria ndërton në këtë të fundit edhe detyrimin që t'i përgjigjet publikut për racionalitetin e ndarjeve buxhetore dhe legjitimitetin e shpërndarjes së një buxheti të tillë.

Neni 93.6

1. Neni 93.6 përcakton autorizimin e qeverisë për të udhëzuar dhe mbikëqyrur punën e organeve të administratës publike. Në kuptim të këtij neni, ndërlidhur edhe me nenin 101 të Kushtetutës, sistemi kushtetues i Kosovës përcakton një ndarje vertikale të pushtetit ekzekutiv. Pjesa e lartë e pushtetit ekzekutiv përbën nivelin politik të qeverisë, nën të cilën është e varur e tërë administrata shtetërore, e cila përbën, në anën tjetër, nivelin civil të pushtetit ekzekutiv. Kjo ndarje vertikale në mes të nivelit politik dhe atij civil të pushtetit ekzekutiv përbën një karakteristikë të sistemeve kushtetuese demokratike që ofrojnë hapësirë për zhvillim të një strukture shtetërore që nuk ka prirje dhe afilim partiak, dhe që përbën pjesën e

nënshtrohet kontrollit gjyqësor kushtetues përveç nëse një gjë e tillë shkel parimin e barazisë në mes të institucioneve kushtetuese apo të drejtat dhe liritë fundamentale njerëzore. Shpenzimi i buxhetit dhe mbikëqyrja e tij, ndërkaq, mund të jetë vetëm i mëpastajmë. Për këtë qëllim, zakonisht formohen organizata të veçanta nga ana e parlamentit, siç është zyra e auditorit të përgjithshëm, apo gjykatat e ndryshme të auditimit (Franca). Cf. më shumë për këtë në Sajo, Andras (1999) 'Limiting the Government. An Introduction to Constitutionalism'. Budapest: CEU Press, p. 158-159 & 190-193.

⁴⁵⁸ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë në vendimin 01/10 theksoi se ekzekutimi i buxhetit shtetëror i është besuar Këshillit të Ministrave. Në ushtrimin e kësaj kompetence Qeveria duhet të veprojë në pajtim me Ligjin për Buxhetin shtetëror ashtu siç është aprovuar nga Parlamenti, por nuk ka të drejtë ta ndryshojë atë. Një dispozitë ligjore e cila i jep kompetencë Këshillit të Ministrave kompetenca të cilat i takojnë Parlamentit sipas Kushtetutës, është deklaruar kundër-kushtetues (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë 01/10 i datës 31.3.2010);

përhershme, meritore, profesionale dhe civile të shtetit, që është shërbimi civil. Prandaj, ndarja vertikale e pushtetit ekzekutiv, e cila bëhet në bazë të modelit të emërimit (varësisht pra nëse emërimi në nivelin përkatës është politik apo civil), përbën një garancion shumë të rëndësishëm demokratik në kuptim të strukturës së pushtetit ekzekutiv, meqë mundëson që një strukturë e përhershme shtetërore, e ashtuquajtura administratë shtetërore, të mund të ushtrojë funksionin e saj në mënyrë të përhershme dhe pa qenë e prirur politikisht në ushtrimin e funksionit të saj.

2. Në këtë kuptim, neni 93.6 vendos autorizimin e qeverisë për të udhëzuar dhe mbikëqyrur punën e administratës shtetërore, e cila është një përbërje institucionale e varur në pikëpamje strukturore për qeverinë, mirëpo në substancë paraqet një trup mekanizmesh jopolitik. I rëndësishëm në kuptim të këtij neni është dekonstruktimi i termit “udhëzim” dhe “mbikëqyrje” për administratën.
3. Termi “udhëzim” i shfrytëzuar nga paragrafi në fjalë i referohet autorizimit të qeverisë për të drejtuar punën e administratës shtetërore. Megjithatë, ky term nënkupton që qeveria është e autorizuar të veprojë vetëm në kuadër të normatives juridike që përcakton garancionet dhe funksionet e shërbimit civil. Megjithëse termi “udhëzim” që buron nga ky paragraf i jep fuqi qeverisë që të vendos drejtimet e politikave publike nga duhet të veprojë administrata publike, ajo nuk ka të drejtë që të njëjtës t’ia ndryshojë funksionin e saj ligjor të zbatimit profesional dhe të pavarur të së drejtës. Në këtë kuptim, koncepti i qeverisë si “udhëzues” i administratës publike nënkupton autorizimin e saj që t’ia përcaktoj objektivat dhe metodat e zbatimit të politikave publike që miraton qeveria, por që funksioni zbatues i administratës shtetërore të jetë profesional dhe i pavarur, jashtë ndikimeve me karakter politik apo partiak të qeverisë.
4. Termi “mbikëqyrje”, ndërkaq, i shfrytëzuar nga paragrafi në fjalë, i referohet autorizimit të qeverisë për të kontrolluar rregullsinë dhe racionalitetin e veprimtarisë së administratës publike, gjë që nënkupton se kjo e fundit jep përgjegjësi ligjore përballë qeverisë. Duhet thënë që koncepti “mbikëqyrje” i shfrytëzuar nga ky paragraf nuk jep asnjë autorizim për ta marrë në përgjegjësi politike administratën publike, por thjeshtë për ta kontrolluar rregullsinë ligjore dhe eficiencën e veprimtarisë së saj civile. Natyrshëm, koncepti i “mbikëqyrjes” së administratës publike nënkupton edhe autorizimin e qeverisë për të shkarkuar bartësit e administratës shtetërore në rast se ata duhen veshur me përgjegjësi juridike sa i përket kryerjes së funksionit të tyre, e gjitha kjo brenda garancioneve të një shërbimi civil, të pavarur, profesional dhe meritore, sipas nenit 101.

Neni 93.7

1. Neni 93.7 përcakton autorizimin e qeverisë për të udhëzuar veprimtarinë dhe zhvillimin e shërbimeve publike. Në kontrast me nenin 93.6, ky paragraf vendos një lloj detyrimi për qeverinë për të udhëzuar dhe për të zhvilluar shërbimet publike të shtetit. Është e rëndësishme të thuhet që shërbimet publike janë

shërbimet bazike shtetërore që çdo shtet është në detyrim t'i ofrojë qytetarëve të saj, dhe që zakonisht përfshijnë shërbimet publike në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes civile të qytetarëve, apo edhe shërbimet publike në fushën e rritjes së standardit jetësor të qytetarëve.

2. Një dekonstruktiv i kësaj norme juridike thjeshtë nuk përcakton vetëm autorizimin e qeverisë për të "udhëzuar" shërbimet publike, dhe për t'i dizajnuar asaj politikat e nevojshme publike, por përbën edhe një lloj detyrimi të qeverisë për të organizuar dhe bartur shërbimet publike themelore. Termi "udhëzohet veprimtarinë dhe zhvillimin" e shërbimeve publike, gjuhësisht, shpreh gjithashtu edhe detyrimin kushtetues që qeveria ka për të bartur dhe garantuar se shteti ofron një numër bazik të shërbimeve publike për qytetarët dhe personat juridik të saj. Një interpretim i tillë natyrshëm nënkupton se qeveria nuk ka mundësi të heq dorë nga dhënia e shërbimeve publike në fushat bazike, meqë kjo përbën jo thjeshtë një autorizim por një detyrim kushtetues. Gjerësia dhe lloji i shërbimeve publike që "duhet" të ofrojë shteti përmes qeverisë, nuk janë përcaktim i këtij neni, dhe ato janë substancë e vet substancës së politikave publike që ndërton qeveria.

Neni 93.8

1. Neni 93.8 përcakton kompetencën e qeverisë për t'i propozuar Presidentit të Republikës emërimet dhe shkarkimet e të gjithë shefave të misioneve diplomatike të Kosovës. Në kuptim të këtij paragrafi, qeveria e ushtron këtë autorizim në kompozicion kolektiv, përdorisa presidenti i republikës nuk është i detyruar që të pranojë propozimin e qeverisë. Megjithatë, në kuptim të këtij paragrafi, presidenti i republikës nuk mund të emërojë dikë shef të një misioni diplomatik të Kosovës në vendet e huaja nëse ai/ajo nuk ka ardhur në formë të propozimit të qeverisë.
2. Ky autorizim, prandaj, i mundëson qeverisë që të luaj funksionin e një filtruesi të personave që mund të ushtrorjnë detyrën e shefit të misionit diplomatik, përdorisa e luan të njëjtin funksion edhe në kuptim të shkarkimit të shefave të misioneve diplomatike. Thënë shkurtimisht, ky paragraf i mundëson qeverisë që të ushtrorjë funksionin e ushtrimit të politikës së jashtme të vendit në bashkërendim me presidentin e republikës, meqë supozimi ekziston që pas një konsensusi në mes të qeverisë dhe presidentit të republikës sa i përket shefave të misioneve diplomatike, këta të fundit do të kenë një linjë të përgjegjësive politike edhe përballë qeverisë. Përgjegjësia e tillë politike përballë qeverisë e shefave të misioneve diplomatike nënkupton se ata duhet të sillen si "të bindur" ndaj drejtimeve të politikave që ata marrin nga qeveria e shtetit.
3. Duhet thënë që autorizimi i dhënë nga ky paragraf për qeverinë varet shumë nga fakti nëse presidenti i republikës është një "i dëgjuar" i qeverisë, dhe/apo nëse presidenti i republikës vjen nga i njëjti kamp politik. Në rastin e tillë, ky autorizim kushtetues për qeverinë shndërrohet në mjet të kontrollit direkt dhe të kërkimit të përgjegjësive politike nga shefat e misioneve diplomatike. Në të kundërtën, nëse presidenti i republikës luan rolin e një kundërshtari/kundërbalancuesi të qeverisë,

ky autorizim i qeverisë është shumë i vështirë për t'u përdorur nga ajo si e vetme në kërkimin e përgjegjësive politike nga shefat e misionëve diplomatike të Kosovës në shtetet e huaja.

Neni 93.9; 93.10 dhe 93.11

1. Nenet 93.9 dhe 93.10 e autorizojnë qeverinë që të marrë pjesë në procesin e amendamentimit të kushtetutës dhe të kontrollit kushtetues të akteve juridike me fuqi nën-kushtetuese. Në rastin e parë, qeveria është e autorizuar nga ky nen që të inicioj procesin e amendamentimit të kushtetutës, dhe të ofrojë një amendament kushtetues për Kuvendin, duke e luajtur kështu rolin e palës së autorizuar. Natyrisht, amendamenti i propozuar duhet që pastaj t'i nënshtrohet procedurës së kontrollit parlamentar dhe të votimit, që shikuar në terma praktik lë shumë pak hapësirë për qeverinë si e vetme që të imponojë votimin e një amendamenti në procedurën me shumicën e dyfishtë dhe të kualifikuar të votimit. U mor vesh, kjo nënkupton se kontrolli kushtetues preventiv i amendamenteve në fjalë bëhet sipas dispozitave të nenit 113.3 (4) dhe 9 lidhur me nenin 144.3 të Kushtetutës. Në rastin e dytë, qeveria autorizohet që të referojë çështje para gjykatës kushtetuese, në të cilin rast, referimi i çështjeve dhe shqyrtimi i tyre nga gjykata bëhet në kuadër të juridiksionit gjeneral dhe special të përcaktuar nga paragrafët 2 dhe 3 të nenit 113 të Kushtetutës për këtë të fundit.
2. Duhet thënë që, me autorizimin për të ngritur çështje pranë gjykatës kushtetuese, qeveria është e veshur me të drejtën e kontestimit të kushtetutshmërisë së ligjeve të miratuara nga Kuvendi, që duhet parë si një kompetencë që e bën këtë të fundit mjaft të fuqishme në kuptim të relacionit të saj me organin legjislativ dhe produktin e tij legjislativ. Përveç juridiksionit nga dy paragrafët e cekur më sipër të nenit 113 të Kushtetutës, në praktikën e Gjykatës Kushtetuese ka pasur raste kur qeveria e ka vënë në lëvizje Gjykatën edhe për çështje tjera jashtë atyre të parapara me këta dy paragrafë. Kështu, ta zëmë, qeveria ka kërkuar interpretim të dispozitave kushtetuese lidhur me caqet dhe vëllimin e imunitetit të zyrtarëve të lartë shtetëror në Republikën e Kosovës, gjë që nuk lidhet fare me kontrollin kushtetues të normës në fjalë. Në këtë rast, Gjykata njohu të drejtën e qeverisë për të ngritur çështje kushtetuese para saj jashtë paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 113, përkatësisht, për të njohur të drejtën e qeverisë për të ngrehur para Gjykatës çdo çështje që ajo konsideron vetë se ka natyrë kushtetuese. Në fakt, këtë të drejtë, Gjykata e kishte njohur më herët në “rastin Pacolli”, kur qeveria kishte kërkuar një sqarim nga Gjykata lidhur me atë nëse deputetët duhej të rrinin në sallë me rastin e votimit për president të republikës në të ardhmen.
3. Qeveria këtë kërkesë e kishte bërë në mbështetje të nenit 93.10 të Kushtetutës që thotë se qeveria “mund të referoj çështja kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese”. Më një fjalë, në këtë rast qeveria ka kërkuar në njëfarë mënyre “mendim këshillëdhënës” apo “mendim interpretativ”, i cili nuk njihet formalisht në sistemin kushtetues kosovar. U mor vesh, kjo nuk është kështu me vendet tjera, si p.sh. me Italinë, Bullgarinë, etj., për çka folëm kur komentuam nenin 84.9 mbi Presidentin.

Siç u pa me atë rast, neni 84.9 dhe neni 93.10 i Kushtetutës kanë përmbajtje tërësisht identike dhe përdorin formulim tërësisht identik gjuhësor.

4. Në kuptim të Nenit 93.11, qeveria ushtron edhe funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve tjera qendrore ose lokale. Ky nen përcakton të ashtuquajturën listë të kompetencave ekzekutive të “papërmendura” nga kushtetuta, të cilat, si parim, nuk supozohet t’i jenë dhënë në mënyrë eksplicite ndonjë institucioni tjetër shtetëror. Në bazë të këtij paragrafi, qeveria autorizohet që të gëzojë çdo kompetencë kushtetuese që nuk i është përcaktuar në mënyrë eksplicite një institucioni tjetër shtetëror.⁴⁵⁹ Megjithatë, ekzistojnë gjashtë kushte që duhen plotësuar në mënyrë që qeveria të mund të gëzojë një kompetencë të “papërmendur” sipas nenit 93.11: një, që kompetencat të cilën qeveria pretendon ta gëzojë të mos i jetë dhënë në mënyrë eksplicite një institucioni tjetër shtetëror; dy, që kompetenca të ketë karakter ekzekutiv, dhe të mos i përkas funksioneve tjera shtetërore (gjyqësore, legjislativ); tre, që kompetenca në fjalë të mos jetë një instrument themelor për arritjen e një objekti kushtetues që ka funksioni i një organi tjetër shtetëror; katër, që kompetenca në fjalë të mos dëmtojë raportin në mes të tre pushteteve, dhe që të mos rrezikoj modelin e ndarjes horizontale dhe vertikale të pushteteve; pesë, që kompetenca e tillë të jetë legjitime, në kuptim të ndalesave që vendosen nga ana e kushtetutës sa i përket pushtetit ekzekutiv, dhe, gjashtë, që kompetenca e tillë të mos ndërhyjë në garancionet e qeverisjes lokale që përcaktohen më kushtetutë, dhe të drejtat e vetëqeverisjes që gëzojnë komunat.

Neni 94 [Kompetencat e Kryeministrit]

Kryeministri ka këto kompetenca:

- (1) përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë;**
- (2) siguron që të gjitha Ministritë të veprojnë në pajtim me politikat qeveritare;**
- (3) siguron zbatimin e ligjeve dhe të politikave të përcaktuara të Qeverisë;**
- (4) ndërron anëtarët e Qeverisë, pa pëlqimin e Kuvendit;**
- (5) kryeson Këshillin e Sigurisë të Kosovës;**
- (6) emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;**
- (7) këshillohet me Presidentin e Republikës së Kosovës mbi çështjet e Inteligjencës;**
- (8) së bashku me Presidentin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë;**
- (9) këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit;**
- (10) kryen edhe punë të tjera, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.**

⁴⁵⁹ Krahaso me argumentin se si dispozitat e tilla mund të rrezikojnë konceptin që pushteti ekzekutiv është i limituar. Shih: Sutherland, George (1910) ‘The Internal and External Powers of the National Government’. *The North American Review*, Vol. 191, No. 652: p. 373-389;

Neni 94

1. Neni 94 përcakton kompetencat individuale të kryeministrit të cilat duhen parë në dritën e funksionit të tërësishëm të qeverisë dhe kompetencave të saj të përcaktuara me nenin 93. Prandaj, kompetencat e kryeministrit të përcaktuara me këtë nen janë suplement funksional i nenit 93, dhe përbëjnë listën e autorizimeve/detyrimeve që kryeministri bart brenda vet autoritetit të qeverisë së shtetit. Duhet thënë se kompetencat individuale të kryeministrit janë tregues i rolit të tij brenda qeverisë, dhe i vet karakterit të qeverisë në aspektin vendimmarrës, por edhe i përgjegjësisë dhe pozitës së anëtarëve tjerë të qeverisë përballë kryeministrit dhe institucioneve jashtë terrenit ekzekutiv.⁴⁶⁰ Duhet thënë se, megjithatë, në një demokraci parlamentare, kryeministrat janë padiskutim aktorët praktikisht shumë të rëndësishëm të tërë sistemit politik, por në veçanti të degës ekzekutive.⁴⁶¹
2. Neni 94 përcakton 10 kompetenca për kryeministrit, megjithëse shumica nga to nënkuptojnë autoritet shumë më të gjerë se sa ai i shkruar gjuhësisht në këtë nen. Prandaj, t'i komentojmë të gjitha kompetencat e kryeministrit në mënyrë individuale.

Neni 94.1

1. Neni 94.1 përcakton kompetencën e kryeministrit për të përfaqësuar dhe udhëhequr qeverinë. Kompetenca e përcaktuar me këtë nen e rregullon pozitën e kryeministrit brenda tërë organizatës së qeverisë. Në njërin anë, ky nen i jep fuqi kryeministrit që të jetë përfaqësues i qeverisë, përderisa, në anën tjetër, ky nen gjithashtu e vendos kryeministrin në rolin e udhëheqësit të qeverisë. T'i komentojmë individualisht secilën nga këto dy koncepte kushtetuese.
2. Sa i përket autorizimit të përfaqësimit të qeverisë, ky paragraf e vendos kryeministrit në rolin e përfaqësuesit të qeverisë,⁴⁶² si në kuptimin e brendshëm institucional, ashtu edhe atë të jashtëm. Prandaj, kryeministri është i vetmi zyrtar i autorizuar që të komunikojë qëndrimin e qeverisë brenda strukturës institucionale të pushtetit ekzekutiv, por edhe në relacion me dy degët e tjera të pushtetit shtetëror. Është i rëndësishëm fakti që roli përfaqësues i kryeministrit, si i tillë, është më shumë rol formal, meqë kryeministri thjeshtë komunikon me palët institucionale në bazë të vendimeve të marra nga qeveria në nivelin e përcaktuar procedural. Megjithatë, roli përfaqësues i kryeministrit duhet shikuar edhe në kontekst të llojit të vendimit/kompetencës mbi të cilën vepron qeveria, meqë, në

⁴⁶⁰ Shih në përgjithësi: Rhodes, R. A. W. and Dunleavy, Patrick (1995) 'Prime Minister, Cabinet and Core Executive'. Basingstoke, Hants.: Macmillan;

⁴⁶¹ O'Malley, Eoin (2007) 'The Power of Prime Ministers: Results of an Expert Survey'. *International Political Science Review / Revue internationale de science politique*. Vol. 28 (1): p. 7-27;

⁴⁶² Ku kryeministri ngarkohet edhe me rolin e një lideri unifikues. Cf: Stark, Frank (1973) 'The Prime Minister as Symbol: Unifier or Optimizer?'. *Canadian Journal of Political Science / Revue canadienne de science politique*. Vol. 6, No. 3: p. 514-515;

shumë raste kushtetuta përcakton kompetencë kolektive për qeverinë, në të cilin rast kryeministri është i detyruar të përfaqësojë qeverinë si një kolektiv zërash, dhe jo të jetë përfaqësues i zërit të tij individual.

3. Sa i përket termit “udhëheq” me qeverinë, ky nën i jep një autorizim shumë të fuqishëm individual pozitës së kryeministrit në tërë modelin vendimmarrës të qeverisë, por edhe në vet strukturën e saj qeverisëse.⁴⁶³ Koncepti “udhëheq” i shfrytëzuar në këtë nen i referohet autorizimit kushtetues të kryeministrit për të drejtuar dhe menaxhuar tërë qeverinë. Shikuar thjeshtë në aspektin juridik kushtetues, koncepti “udhëheqje” i vënë në këtë paragraf e shndërron kryeministrin në shefin e qeverisë, dhe me këtë i jep karakter të të parit dhe udhëheqësit të qeverisë kryeministrit të vendit. Në këtë aspekt, sipas këtij neni, kryeministri nuk është i pari ndërmjet të barabartëve, por është shefi individual i tërë qeverisë, të cilit anëtarët e tjerë të qeverisë i përgjigjen politikisht.⁴⁶⁴
4. Koncepti “udhëheqje” sipas këtij neni, i jep kryeministrit të paktën katër prerogativa qeverisëse ndaj anëtarëve të qeverisë dhe ndaj tërë aparatit ekzekutiv: një, që drejtimi i qeverisë është fuqi ekzekutive që i takon kryeministrit, dhe asnjë anëtar i qeverisë nuk lejohet që ta kontestojë politikisht një urdhër të dhënë nga kryeministri; dy, që udhëzimet e dhëna nga kryeministri janë kushtetutshmërisht të obligueshme për anëtarët e qeverisë, dhe ata janë të përgjegjshëm politikisht për ndjekjen e tyre; tre, që menaxhimi i qeverisë është përgjegjësi individuale e kryeministrit, dhe ai përgjigjet individualisht përballë Kuvendit dhe institucioneve tjera për veprimtarinë e qeverisë së tij, dhe katër, që udhëzimet e dhëna nga kryeministri përbëjnë drejtime politikash që duhen ndjekur nga tërë aparati institucional i qeverisë, dhe jo thjeshtë nga anëtarët politik të qeverisë. Ky normim juridik i pozitës së kryeministrit sendërtohet dhe fuqizohet edhe me paragrafët e mëposhtme të këtij neni, të cilat i shpjegojmë në vijim.
5. Duhet thënë në fund se pavarësisht që koncepti “udhëheqje”, i cili është atribut kushtetues i kryeministrit, e pozicionon kryeministrin në një relacion kushtetues shumë të fuqishëm dhe i mundëson që të jetë shef individual i tërë qeverisë,⁴⁶⁵ pozita reale e kryeministrit varet shumë edhe nga modeli i koalicionit parlamentar që e ka bërë zgjedhjen e tij. Në rastet e koalicioneve parlamentare, siç është rasti

⁴⁶³ Krahaso këtë me kushtëzimet në kontekstin e sistemit kushtetues Italian, në: Campus, Donatella and Pasquino, Gianfranco (2006) 'Leadership in Italy: The Changing Role of Leaders in Elections and in Government'. *Journal of Contemporary European Studies*. Vol. 14 (1): 25-40;

⁴⁶⁴ Krahaso këtë me modelin e qeverisë ku kryeministri është i *pari ndërmjet të barabartëve*, në: Weiler, Patrick (1985) 'First Among Equals: Prime Ministers in Westminster Systems'. Sydney: George Allen & Unwin: p. 74 & 85-7;

⁴⁶⁵ Kjo shkon shumë ngjashëm me linjën e modelit japonez të qeverisë, ku e tërë qeveria varet substancialisht për kryeministrin. Shih: Angel, C. Robert (1988-1989) 'Prime Ministerial Leadership in Japan: Recent Changes in Personal Style and Administrative Organization'. *Pacific Affairs*. Vol. 61 (4): p. 583-602; Shih për këtë, dhe krahaso, me fjalimin e Uilson, në: Woodrow Wilson (1897) 'Leaderless Government'. *The Virginia Law Register*. Vol. 3 (5): p. 337-354;

me modelin parlamentar të shtetit të Kosovës i cili përbën pothuajse situatën më normale mbi të cilën një qeveri mund të ndërtohet,⁴⁶⁶ kryeministri praktikisht është i varur nga interesat e partnerëve të koalicionit të tij, ashtu që menaxhimi/drejtimi i anëtareve të partnerëve të koalicionit është pothuajse praktikisht tepër i vështirë.⁴⁶⁷

Neni 94.2 dhe 94.3

1. Këta dy paragrafë, të nenit 94, përcaktojnë që kryeministri siguron që të gjitha ministrinë e qeverisë veprojnë në pajtim me politikat e qeverisë, dhe siguron zbatimin e ligjeve dhe politikave të përcaktuara të qeverisë. Këta dy paragrafë e veshin kryeministrin me përgjegjësinë e garantimit që ministrinë, të cilat janë organet kryesore administrative të qeverisë, veprojnë në përputhje me politikat e qeverisë, garancion ky që mundëson që ministrinë të jenë të varura institucionalisht dhe praktikisht nga kryeministri dhe qeveria që kryesohet nga ai. Kjo përgjegjësi e kryeministrit, në anën tjetër, mund të shihet edhe si e drejtë e tij që të marrë në përgjegjësi kushtetuese ministrinë e qeverisë së tij, nëse ato nuk ndjekin kursin e politikave të përcaktuara nga qeveria. Përveç përcaktimit të detyrimit të kryeministrit për të siguruar që ministrinë ndjekin linjat e politikave të përcaktuara nga qeveria, ky nen gjithashtu e vesh kryeministrin me përgjegjësinë e sigurimit që legjislacioni në fuqi dhe politikat e qeverisë zbatohen në përgjithësi, dhe jo thjeshtë nga ministrinë përkatëse. Përgjegjësia e vënë me nenin 94.3, praktikisht, e bën kryeministrin përgjegjës individual për kontrollimin/sigurimin që ligjet dhe politikat publike që hyjnë në fushëveprimin e qeverisë të zbatohen në përgjithësi nga të gjitha institucionet relevante.⁴⁶⁸
2. Duhet thënë këtu që koncepti “siguron” i shfrytëzuar nga të dy paragrafët e mësipërme i referohet përgjegjësisë por edhe të drejtës së tij të pakontestuar që të kërkojë përgjegjësi kushtetuese, por edhe t’i udhëzojë në mënyrë të detyrueshme, ministrinë e qeverisë së tij, dhe të gjithë aparatit administrativ të varur nga qeveria me qëllim që të zbatojnë politikat dhe ligjet që janë detyrim i qeverisë. Shikuar më thellë, koncepti “siguron” i përdorur këtu, ka këto karakteristika juridike: një, që kryeministri është i veshur me përgjegjësinë individuale për t’i kërkuar përgjegjësi kushtetuese ministrive dhe të gjitha mekanizmave administrativ të varur nga qeveria, sa i përket detyrimit të tyre për të zbatuar politikat publike dhe legjislacionin përkatës; dy, që të gjitha ministrinë dhe mekanizmat tjerë administrativ e shkarkojnë detyrimin e tyre kushtetues për zbatimin e politikave publike dhe ligjeve tek kryeministri, dhe i raportojnë këtij të fundit mbi progresin në këtë fushë; tre, që kryeministri është përgjegjës individualisht, në emër të

⁴⁶⁶ Shih p.sh. një rast krahasues në: Golder, Nadenichek Sona (2006) ‘Pre-Electoral Coalition Formation in Parliamentary Democracies’. *British Journal of Political Science*. Vol. 36 (2): p. 193-212;

⁴⁶⁷ Shih p.sh: Laver, Michael (2008) ‘Governmental Politics and the Dynamics of Multiparty Competition’. *Political Research Quarterly*. Vol. 61 (3): p. 532-536;

⁴⁶⁸ Cf: O'Malley, Eoin (2007) ‘The Power of Prime Ministers: Results of an Expert Survey’. *International Political Science Review / Revue internationale de science politique*. Vol. 28 (1): p. 7-27;

qeverisë, përballë Kuvendit dhe shoqërisë sa i përket funksionit kushtetues të qeverisë për zbatimin e ligjeve dhe politikave shtetërore në fushën ekzekutive, dhe katër, që të gjithë anëtarët e qeverisë dhe shefat e institucioneve tjera ekzekutive të varura tek qeveria, detyrohen sipas kushtetutës t'i përgjigjen udhëzimeve të kryeministrit sa i përket procesit të zbatimit të ligjeve dhe politikave publike nën kompetencën kushtetuese të qeverisë.

3. Duhet thënë që termi “siguron” i shfrytëzuar në këtë paragraf, përfshin vetëm autorizimin e kryeministrit për të siguruar dhe kontrolluar zbatimin e mekanizmit institucional që është sipas kushtetutës i varur për qeverinë dhe kompetencat e saj të përcaktuara me Kushtetutë.⁴⁶⁹ Kjo nuk përbën në asnjë rast autorizim për kryeministrin që të njëjtën fuqi ta ushtroj përballë institucioneve të pavarura dhe atyre që i takojnë degëve tjera të pushtetit shtetëror.

Neni 94.4

1. Ky nen përbën elementin më substancial që e plotëson autoritetin e kryeministrit si udhëheqës i qeverisë⁴⁷⁰ sipas nenit 94.1. Sipas nenit 94.4, kryeministri është i autorizuar që të ndërrojë anëtarët e qeverisë, pa pasur nevojë për pëlqimin e Kuvendit, megjithëse kompozicioni i parë i qeverisë duhet të emërohet në Kuvend si kolektiv qeverisë. Shikuar në aspektin struktural, ky paragraf e përcakton mekanizmin përmes së cilit kryeministrit i mundësohet që të ushtrojë funksionin e tij si udhëheqës i qeverisë. Në anën tjetër, garantimi i autorizimit kushtetues që kryeministri të ndërrojë një ministër jashtë kontekstit parlamentar të dhënies së pëlqimit, vendos garancionin që kryeministri të mund të ushtrojë kontrollin e brendshëm të qeverisë së tij dhe të kërkimit të përgjegjësive politike ministrave të tij jashtë kontekstit të kontrollit dhe/apo kushtëzimit parlamentar. Kërkimi i përgjegjësive politike ministrave të tij mund të bëhet mbi shumë baza, siç mund të jenë: performanca, konceptet ideologjike, qasja dhe/ose qëndrimi mbi politikat publike, etj.⁴⁷¹
2. Autorizimi i dhënë me nenin 94.4 kryeministrit, ka këto karakteristika juridike: një, që kryeministri ka në të drejtën e tij individuale, i pakushtëzuar nga ndonjë institucion brenda apo jashtë tij, që të ndërrojë një ministër të tij, dhe që vendimi i tij për këtë çështje të ketë efekt direkt në shkarkimin e ministrit.⁴⁷² dy, që vendimi i

⁴⁶⁹ Cf. me konceptin e një qeverie pa lider, në: Wilson, Woodrow (1897) ‘Leaderless Government’. *The Virginia Law Register*. Vol. 3 (5): p. 337-354;

⁴⁷⁰ Shih të njëjtin argument në rastin anglez, në: King, Anthony and Allen, Nicholas (2010) ‘Off With Their Heads’: British Prime Ministers and the Power to Dismiss’. *British Journal of Political Science*, Vol. 40 (2): p. 249-278; cf. Huber, D. John and Martinez-Gallardo, Cecilia (2008) ‘Replacing Cabinet Ministers: Patterns of Ministerial Stability in Parliamentary Democracies’. *The American Political Science Review*. Vol. 102 (2): p. 169-180;

⁴⁷¹ Shih për këtë të fundit, në: King, Anthony and Allen, Nicholas (2010) ‘Off With Their Heads’: British Prime Ministers and the Power to Dismiss’. *British Journal of Political Science*. Vol. 40 (2): p. 249-278; Krahaso me: Patrick Weiler (1985) ‘First Among Equals: Prime Ministers in Westminster Systems’. Sydney: George Allen & Unwin, p. 74, 85-7;

⁴⁷² Gjykata Kushtetuese e Hungarisë, duke analizuar karakteristikat kryesore të statusit juridik të

kryeministrit për ndërrim të një ministri të mos ketë nevojë të jetë i arsyetuar mbi bazën e të cilës kryeministri e merr një vendim të tillë, dhe që kjo natyrisht shihet si një e drejtë e plotë e kryeministrit për të marrë në përgjegjësi politike ministrat e tij; tre, që kompetenca e kryeministrit për ndërrim të një ministri të mos ketë nevojë për miratim nga Kuvendi, çfarë e bën pozitën e kryeministrit si shefin e pakontestuar të qeverisë dhe kompozicionit të saj kolektiv; katër, në ushtrimin e një të drejte të tillë, kryeministri ushtron edhe detyrën e tij si udhëheqës i qeverisë, dhe si garantues i funksionimit të saj sipas kompetencave kushtetuese; dhe pesë, në vendosjen për një çështje të tillë, nuk kërkohet ekzistimi i ndonjë rrethane të veçantë pasojë e së cilës të jetë vendimi i kryeministrit për ndërrim të ministrit.

3. Autorizimi i kryeministrit sipas neni 94.4 e plotëson fuqishëm rolin e tij si udhëheqës i qeverisë, meqë i jep mundësinë kushtetuese që të ndërrojë një ministër në rast se ky i fundit nuk i përgjigjet politikisht për veprimet e tij kryeministrit. Autorizimi për të ndërruar një ministër, e bën kabinetin qeveritar të varur në mënyrë të plotë nga kryeministri, dhe praktikisht, koncepti i një qeverie kolektive dobësohet fuqishëm.⁴⁷³ Megjithëse qeveria vazhdon të ketë karakter kolektiv, dhe një procedurë parimisht kolektive të vendimmarrjes, mekanizmi që kryeministri mund të shfrytëzojë sipas nenit 94.4 në ndërlidhje me nenin 94.1, i bën praktikisht anëtarët e qeverisë të detyruar që të ndjekin përcaktimin e kryeministrit gjatë procesit të vendimmarrjes kolektive. Në rastin e kundërt, kryeministri mund të shfrytëzojë të drejtën e tij kushtetuese sipas këtij paragrafi për ndërrim të ministrave të “padëgjueshëm”.
4. Kjo karakteristikë kryeministrorë e qeverisë, prandaj, lirshëm sjell tek konstatimi që modeli kushtetues i qeverisë së shtetit, sipas nenit 93 dhe nenit 94, ka tendencë të plotë të “kryeministrizimit” të qeverisë, ku kryeministri paraqitet si figura themelore kushtetuese që udhëheq dhe drejton praktikisht dhe në pikëpamje kushtetuese qeverinë e shtetit. Kryeministrizimi i qeverisë, sipas këtyre dy neneve, rezulton në një model qeverisjeje ku përgjegjësia kolektive e qeverisë përballë Kuvendit shndërrohet realisht në përgjegjësi individuale të kryeministrit përballë Kuvendit dhe tërë shoqërisë. Prandaj, në kuptimin kushtetues, kryeministri ka rolin e shefit të pakontestuar të qeverisë, në të cilin rast i njëjti është i veshur me mekanizmin e mjaftueshëm kushtetues për t’i kërkuar ministrave të tij përgjegjësi kushtetuese dhe politike pa asnjë kushtëzim nga ana e Kuvendit, gjë që juridikisht mundëson që tërë anëtarët e qeverisë të jenë të varur institucionalisht dhe politikisht për kryeministrin.

zyrtarëve qeveritarë theksoi se zyrtarët qeveritarë mbajnë poste publike; statusi i tyre rregullohet me ligj dhe jo me kontrata private. Emërimi dhe shkarkimi i tyre bëhet në bazë të vendimeve administrative. Prandaj korniza ligjore duhet të jetë e qartë sa i përket vendimeve për emërim apo shkarkim të zyrtarëve qeveritarë (Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë nr. 8/2011 i datës 18.2.2011);

⁴⁷³ Ndërlidhe këtë me argumentet nga: Alderman, R. K. and Cross, J. A (1985) 'The Reluctant Knife: Reflections on the Prime Minister's Powers of Dismissal'. *Parliamentary Affairs*. Vol. 38 (4): p. 387-407;

5. Duhet thënë që modeli kryeministor i qeverisë, megjithatë, është praktikisht i varur nga lloji/modeli i koalicionit qeverisës mbi bazën e të cilit ndërtohet qeveria në Kuvend në një rast të caktuar dhe se kompetencat kushtetuese sipas nenit 94 mund që të mos i lejojnë praktikisht kryeministrit që të udhëheq me anëtarët e qeverisë apo edhe t'i ndërrojë ata nëse nuk janë nga kampi i tij politik. Logjika e koalicionit parlamentar mbi të cilën është ndërtuar qeveria, prandaj, në aspektin praktik përcakton edhe pozitën faktike të kryeministrit në qeveri, që në shumë raste mund të mos i lejojë kryeministrit gëzim të plotë të kompetencës sipas nenit 94.1 dhe nenit 94.4.

Neni 94.5; 94.6; 94.7; dhe 94.8

1. Paragrafet 5, 6 dhe 7 të nenit 94 përcaktojnë kompetenca për kryeministrin në fushën e kryesimit dhe emërimeve të larta, si dhe në lidhje me këshillimin në fushën e inteligjencës së shtetit.
2. Sa i përket nenit 94.5, kryeministri është kryesuesi i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, që është një organ i përcaktuar me Kushtetutë. Roli i kryeministrit sa i përket kryesimit të Këshillit të Sigurisë nuk nënkupton të drejtën e tij për të qeverisur apo udhëhequr me të në kuptimin detyrues.⁴⁷⁴ Koncepti “kryesim” i shfrytëzuar në këtë paragraf i referohet udhëheqjes së mbledhjeve të Këshillit të Sigurisë, dhe të drejtës për të moderuar sesionet e tij. Megjithëse në rolin e tij kryesues, kryeministri sipas këtij paragrafi vihet në krye të një organi shumë të fuqishëm dhe të rëndësishëm të politikës së sigurisë së shtetit. Në këtë kontekst, kompetenca për të kryesuar Këshillin e Sigurisë përkthehet në njëfarë forme në një autorizim për të shërbyer si një ombrellë e politikave të sigurisë së shtetit, sidomos atyre që lidhen me gjendjet e sigurisë në kohë krizash.
3. Neni 94.6 përcakton kompetencën e kryeministrit për të emëruar Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në kuptim të këtij paragrafi, kryeministri gëzon kompetencën individuale që të emërojë Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, që është një autorizim shumë i fuqishëm sa i përket drejtimit të njërit prej institucioneve kyçe të sigurisë së shtetit. Kjo kompetencë e kryeministrit, natyrshëm, përcakton karakterin e përgjegjesisë së drejtpërdrejtë që Drejtori i Përgjithshëm i Policisë bart përballë kryeministrit, dhe natyrshëm, vendos edhe linjën e përgjegjesisë “politike” që ky pritet të ketë përballë tij. Duhet thënë që, pavarësisht që në një demokraci të brishtë kjo kompetencë mund të shpie në politizim të Policisë së Shtetit, përgjegjësia e Drejtorit të Përgjithshëm përballë kryeministrit i shkon logjikës që polica e shtetit të ketë një linjë të drejtpërdrejtë dhe eficiente të përgjegjesisë ndaj strukturës më të lartë ekzekutive të vendit.

⁴⁷⁴ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë theksoi se Qeveria është e obliguar të kërkojë miratim paraprak nga Parlamenti për çfarëdo përdorimi të forcave të armatosura të Gjermanisë. Ky prerogativ rrjedh nga një traditë e gjatë kushtetuese që i daton nga Kushtetuta e Vajmarit e vitit 1918. Fushëveprimi i saktë dhe modalitetet e pjesëmarrjes së parlamentit në këtë fushë duhet të përcaktohen me ligj (Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë, No. 1 BvR 1595/92; 1BvR 1606/92, i datës 14 korrik 1994).

4. Pavarësisht faktit që Kushtetuta i vesh kryeministrit të vendit kompetencën e emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, kontrolli i drejtpërdrejtë i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nga ana e kryeministrit nuk mund të konsiderohet të jetë vendosur me këtë nen të Kushtetutës. Neni në fjalë, në të njëjtën kohë, nuk autorizon kryeministrin që të ketë mundësinë e shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, gjë që e cila rregullohet me ligj të veçantë për policinë e Kosovës. Me një fjalë, Kryeministri nuk bartë të drejtën e shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë sipas konstruksionit të normës së vënë në nenin 94.6 të Kushtetutës por sipas normës ligjore. Një mundësi e tillë për kryeministrin parashihet në nenin 39.1 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë të datës 2 mars 2012. Në këtë nen flitet për mundësinë e shkarkimit të Drejtorit të Përgjithshëm vetëm në raste të caktuara, njëri prej të cilëve është “për shkak të performancës jo të mirë të dokumentuar” (neni 39.1.6 e Ligjit). Kjo nënkupton se akti i kryeministrit për shkarkim mbi këtë bazë dhe mbi çdo bazë tjetër ligjore i nënshtrohet kontrollit gjyqësor të ligjshmërisë pranë Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore me seli në Prishtinë (në kuadër të procedurave mbi konfliktin administrativ). Pastaj, u mor vesh, vendimi i Gjykatës Themelore mund të goditet me ankesë në Gjykatë të Apelit kurse vendimi i kësaj të fundit mund të goditet në Gjykatë Supreme me mjete të jashtëzakonshme të goditjes. Në fund, sipas kërkesës individuale të palës së autorizuar, mund të ketë kontroll të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese.
Në vijim për sa më sipër, ky akt i kryeministrit për emërim të Drejtorit të Përgjithshëm mund t’i nënshtrohet kontrollit politik të Kuvendit, si çdo akt tjetër i qeverisë. Kjo nënkupton se ky emërim mund të jetë objekt interpelance e vlerësimi politik në kuadër të aktiviteteve të rregullta të Kuvendit.
5. Neni 94.7 përcakton relacionin e kryeministrit me presidentin e republikës sa i përket çështjeve të inteligjencës së shtetit. Ky nen përcakton që kryeministri ka kompetencë të këshillohet me presidentin e republikës në lidhje me çështjet e inteligjencës. Dekonstruktimi i këtij neni rezulton në këto nënkuptime juridike: një, që kryeministri ka të drejtë dhe detyrë që të konsultohet me presidentin e republikës sa i përket çështjeve të inteligjencës së shtetit; dy, neni në fjalë lë hapësirë të nënkuptimit që kryeministri nuk ka autorizim të vendos në lidhje me çështjet e inteligjencës pa konsultim paraprak me presidentin e republikës; tre, që kryeministri ka autoritet që të përgjigjet në lidhje me politikën e inteligjencës së shtetit, përgjegjësi të cilën duhet ta shkarkoj edhe përballë Kuvendit. Në bashkëlidhje me këtë nen, neni 94.8 përcakton kompetencën e kryeministrit që, së bashku me Presidentin e Republikës, të emërojë Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, që nënkuptohet të jetë një kompetencë e ndarë me Presidentin e Republikës. Autorizimi i dhënë me nenin 94.8, në anën tjetër, ndërton linjën e përgjegjesisë së dyfishtë që të tre funksionarët e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë kanë përballë kryeministrit dhe presidentit të shtetit, dhe, anasjelltas, fjala “këshillim” e përdorur në paragrafët 7 dhe 8 të këtij neni nënkupton se duhet të ekzistoj pëlqimi i presidentit të republikës në mënyrë që veprimet e ndërmarra në zbatim të këtyre dy paragrafëve të konsiderohen si veprime kushtetuese.

Neni 94.9

1. Neni 94.9 përcakton udhëzimin kushtetues që kryeministri të këshillohet me presidentin e republikës sa i përket zbatimit të politikës së jashtme të shtetit. Ky paragraf, në njërin anë, vendos detyrimin që kryeministri të këshilloj presidentin e republikës sa i përket zbatimit të politikës së jashtme të shtetit, dhe në anën tjetër, ky paragraf vendos përcaktimin kushtetues që kryeministri të jetë zyrtari i qeverisë që zbaton politikën e jashtme të shtetit në kuptim të rolit kushtetues të qeverisë në këtë fushë. Natyrshëm, zbatim praktik i politikës së jashtme nga ana e qeverisë, dhe sipas udhëzimeve të kryeministrit, në kuptim të këtij neni, kryhet nga ana e një organi të posaçëm administrativ (ministrie) brenda qeverisë që i përgjigjet kryeministrit.
2. Konteksti i këshillimit me presidentin e republikës sa u përket zbatimit të politikës së jashtme të shtetit, sipas këtij neni, vendos një kuptim detyrues që zbatimi i politikës së jashtme të shtetit nga ana e qeverisë të bëhet duke pasur parasysh opinionin e presidentit të republikës. Termi “këshillim” i shfrytëzuar nga ky paragraf duket sikur nuk ka natyrë detyruese sa i përket zbatimit të opinionit të presidentit të republikës, mirëpo në esencë këtu vlen e njëjta si për rastet nga paragrafët 7 dhe 8 të nenit paraprak. Gjithashtu, duhet thënë se në kuptim të këtij paragrafi, qeveria nuk autorizohet të vendos në lidhje me politikën e jashtme, por vetëm që ta zbatoj atë.

Neni 94.10

1. Ky nen përcakton kompetencën e kryeministrit për të ushtruar çdo lloj detyre/autorizimi tjetër të përcaktuar me kushtetutë dhe ligje përkatëse. Në këtë kuptim, duhet thënë se pozicioni i kryeministrit mund të fuqizohet edhe më tej përmes kompetencave shtesë që i përcaktohen atij me legjislacionin përkatës nga ana e Kuvendit. Kompetencat shtesë që mund t'i vishen kryeministrit sipas këtij paragrafi, megjithatë, mund të vendosen me ligj vetëm nëse plotësohen kushtet si në vijim: një, që kompetencat shtesë mos të interferojnë me kompetencat kushtetuese të kryeministrit sipas nenit 94, në kuptim të zvogëlimit të mundshëm të tyre; dy, që kompetencat shtesë të kryeministrit të jenë të fushës ekzekutive, në kuadër të funksionit kushtetues të qeverisë sipas nenit 93; tre, që kompetencat shtesë të mos ndërhyjnë në garancionet kushtetuese të kompetencave të institucioneve tjera të përcaktuara me kushtetutë, dhe, katër, që kompetencat shtesë t'i përshtaten funksionit udhëheqës të kryeministrit në kuadër të qeverisë, si organ ekzekutiv i përcaktuar me Kushtetutë.

Neni 95 [Zgjedhja e Qeverisë]

- (1) Pas zgjedhjeve, Presidenti i Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit kandidatin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë.
- (2) Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit të Kosovës dhe kërkon miratimin nga ana e Kuvendit.
- (3) Qeveria konsiderohet e zgjedhur nëse merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.
- (4) Nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti i Republikës së Kosovës, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.
- (5) Nëse Kryeministri jep dorëheqjen ose për arsye të tjera, posti i tij/saj mbetet i lirë, Qeveria bie, dhe Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me partitë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën në Kuvend, mandaton kandidatin e ri, për të formuar Qeverinë.
- (6) Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes, japin betimin para Kuvendit. Teksti i betimit rregullohet me ligj.

Neni 95

1. Neni 95 përcakton procedurën e zgjedhjes/emërimit të qeverisë së shtetit. Procedura e zgjedhjes së qeverisë, e përcaktuar me këtë nen, e para përcakton edhe llojin kushtetues të qeverisë dhe luan rol në përcaktimin e modelit të demokracisë parlamentare që ka Kosova. Kjo nuk nënkupton thjeshtë që qeveria është produkt indirekt i popullit të përfaqësuar në Kuvend nga përfaqësuesit e tyre, por gjithashtu edhe që ajo është produkt i një konsensusi të gjerë të partive parlamentare për një kabinet qeverisës të ndërtuar mbi bazën e tillë.⁴⁷⁵ Neni 95, prandaj, përcakton procedurën që kalon nga momenti i përfundimit të certifikimit të rezultateve zgjedhore të zgjedhjeve parlamentare, e deri tek miratimi i opsionit përfundimtar të propozimit për kryeministër dhe qeveri të shtetit.

Neni 95.1

1. Neni 95.1 përcakton që pas zgjedhjeve parlamentare, Presidenti i Republikës i propozon Kuvendit kandidatin për kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar qeverinë. Katër janë momentet themelore kushtetuese që duhen komentuar në kuptim të këtij neni.

⁴⁷⁵ Shih: Diermeier, Daniel Hülya Eraslan, and Merlo, Antonio (2003) 'A Structural Model of Government Formation'. *Econometrica*. Vol. 71 (1): p. 27-70;

2. Një, emërimi i qeverisë lidhet me përfundimin e procesit të zgjedhjeve parlamentare, çfarë flet për faktin se mandati i qeverisë është i lidhur strukturalisht me mandatin e Kuvendit. Zgjedhjet parlamentare për Kuvend konsiderohen të përfunduara, apo të certifikuara, kur ato të jenë certifikuar nga organi kushtetues përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve parlamentare, pas përfundimit të cilitdo proces gjyqësor të rregullt dhe eventualisht pranë Gjykatës Kushtetuese mbi rregullsinë zgjedhore, dhe pasi që të jenë shpërndarë dhe pranuar mandatet e deputetëve (duke përfshirë momentin e betimit të tyre). Kur ky moment kohor të ketë arritur, presidenti i republikës, sipas detyrimit të Nenit 95.1, obligohet që të propozojë kandidatin për kryeministër.
3. Dy, në kuptim të nenit në fjalë, presidenti i republikës është i detyruar që të përmbushë obligimin kushtetues të propozimit të kandidatit për kryeministër kur të ketë arritur momenti kohor i përshkruar në pikën e mësipërme. Ky obligim i presidentit të republikës nuk mund të tejkalohet apo të shtyhet. Presidenti, sipas nenit 95.1, propozon kandidatin për kryeministër në “konsultim” me partinë apo koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar qeverinë. Termi “konsultim” i shfrytëzuar në këtë paragraf, paraqet detyrim kushtetues për presidentin, dhe nënkupton obligimin e presidentit që propozimin e tij për kandidatin për kryeministër ta bëjë në përputhje me kërkesën e partisë/koalicionit përkatës. Duhet thënë që, në kuptim të këtij paragrafi, termi “në konsultim me” nuk i jep asnjë të drejtë presidentit të republikës që të neglizhojë apo ndryshojë kandidatin e propozuar nga partia/koalicioni në fjalë. Detyrimi në fjalë i presidentit të republikës është një obligim që ky i fundit e ushtron në detyrën e kreut të shtetit, dhe nuk mund të ushtrojë diskrecion në një fushë të tillë. Prandaj, termi “në konsultim me”, sipas Nenit 95.1, e detyron presidentin e republikës që të procedojë pasivisht me kandidaturën e preferuar nga partia/koalicioni fitues. Në të kundërtën, presidenti i republikës do të shkelte përcaktimin kushtetues të efektit direkt që duhet të kenë zgjedhjet parlamentare mbi kompozicionin e qeverisë pasuese, përderisa detyrimi i presidentit për të propozuar kandidatin për kryeministër është një funksion ceremonial ku presidenti i republikës nuk është i autorizuar që të zgjedhë apo të refuzojë kandidatin e preferuar të partisë/koalicionit përkatës.
4. Tre, neni 95.1 përcakton që propozimi i presidentit të republikës për kandidatin për kryeministër,⁴⁷⁶ të bëhet pas konsultimit të partisë/koalicionit fitues që ka “shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar qeverinë”. Praktikisht, në rast se një parti politike ka fituar votat e mjaftueshme që e vetme të emërojë qeverinë në Kuvend, i takon asaj e drejta për t’ia dhënë emrin e kryeministrit të propozuar te presidenti. Megjithatë, në rast se shumica e nevojshme për të formuar qeverinë bartet nga një koalicion parazgjedhor përkatës, është koalicioni përkatës që ai bën propozimin e tij tek presidenti i republikës në lidhje me kandidaturën për kryeministër.

⁴⁷⁶ Cf. me mënyrën e funksionalizimit të kësaj kompetence nga monarkët: Morgan, C (1964) ‘Selecting a Prime Minister’. *The Australian Quarterly*. Vol. 36 (2): p. 35-43;

5. Termi “koalicion”, në kuptim të këtij paragrafi, i referohet një koalicioni parazgjedhor,⁴⁷⁷ dhe jo një koalicioni pas zgjedhor, kur disa parti politike apo nisma qytetare kanë garuar me një listë të përbashkët deputetësh për Kuvendin e Kosovës. Arsyetimi i argumentit të fundit lidhet me faktin që ky nen përcakton që kandidatura rrjedh nga partia apo koalicioni që “ka fituar” votat e nevojshme. Pra, termi “ka fituar” i referohet një gjendjeje ku një koalicion parazgjedhor ka garuar me një listë të përbashkët të kandidatëve për deputetë, dhe jo një koalicioni që mund të lindë “pas” konstituimit të Kuvendit. Duhet thënë gjithashtu se termi “shumicën e votave” i referohet shumicës së ulëseve në Kuvend, dhe jo votave qytetare/popullore, meqë ka mundësi që një parti/koalicion që ka fituar shumicën e ulëseve në Kuvend të mos ketë edhe shumicën popullore të votave. Ky paragraf, prandaj, i referohet shumicës së ulëseve në Kuvend, që praktikisht i bie shumicës së deputetëve në Kuvend.
6. Megjithatë, pyetja është se çfarë do të ndodhte nëse në Kuvend nuk ka asnjë parti/koalicion parazgjedhor që ka shumicën e nevojshme për të formuar qeverinë, dhe se kujt duhet drejtuar presidenti i republikës për t’ia kërkuar kandidaturën që duhet propozuar për kryeministër? Paragrafi në fjalë nuk jep shpjegim se çfarë duhet bërë në një situatë të tillë. Megjithatë, sikur del logjikshëm se presidenti i republikës në një rast të tillë duhej të ishte i detyruar që të konsultonte partinë/koalicionin parazgjedhor që ka fituar shumicën e votave për të formuar qeverinë për të marrë emrin e kandidatit që ai do ta propozonte për kryeministër në Kuvend.
7. Katër, në konsultimin e partisë/koalicionit që ka fituar shumicën e nevojshme për të formuar qeverinë, presidenti i republikës nuk ka autorizim të kërkojë edhe përbërjen e qeverisë që kandidati në fjalë do të propozojë në Kuvend. Autorizimi/përgjegjësia e presidentit të republikës lidhet thjeshtë dhe vetëm më momentin e kërkimit të emrit të kryeministrit, jo të anëtarëve të kabinetit qeveritar që ky i fundit do t’i përfshij në kabinetin e tij qeverisë. Duhet thënë që, në këtë rast, në kuptim të këtij paragrafi, presidenti i republikës nuk lejohet të negocioj për emrin e kandidatit që propozon partia/koalicioni fitues. Ky i fundit nuk bart asnjë detyrim për të dhënë sqarime apo për ta arsyetuar kandidatin për kryeministër para presidentit të republikës.

Neni 95.2

1. Neni 95.2 përcakton se hapi i dytë pas propozimit të presidentit të republikës të kandidatit për kryeministër, ky i fundit duhet që të sjell në Kuvend, jo më vonë se pesëmbëdhjetë ditë pas propozimit të presidentit të republikës, përbërjen e qeverisë për miratim.⁴⁷⁸ Në kuptim të këtij neni, përcaktimi i propozimit për përbërjen e

⁴⁷⁷ Cf: Golder, Nadenichek. Sona (2006) ‘Pre-Electoral Coalition Formation in Parliamentary Democracies’. *British Journal of Political Science*. Vol. 36 (2): p. 193-212; Shih gjithashtu se mbi çfarë bazash zakonisht ndërtohen koalicionet paraelektorale, në: Debus, Marc (2009) ‘Pre-Electoral Commitments and Government Formation’. *Public Choice*. Vol. 138 (1/2): p. 45-64;

⁴⁷⁸ Roli i kandidatit të kryeministrit në këtë rast, i ashtuquajtur *formatori* i qeverisë, është tejet i

qeverisë është e drejtë e plotë e kandidatit për kryeministër⁴⁷⁹ të propozuar nga ana e presidentit të republikës, dhe që një përcaktim i tillë i kompozicionit të qeverisë duhet të jetë rezultat i vet aranzhmanit konsensual të koalicionit/partisë që ka numrin e nevojshëm të votave për të emëruar qeverinë në Kuvend.

Neni 95.3

1. Neni 95.3 përcakton që qeveria konsiderohet e emëruar në Kuvend, nëse ajo merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.⁴⁸⁰ Termi “shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit” i referohet shumicës së votave të tërë trupit të Kuvendit prej 120 anëtarësh, që në aspektin praktik i bie të jetë 61 deputetë. Miratimi i qeverisë së propozuar nga kandidati për kryeministër, prandaj, kërkon një shumicë absolute që rrallë herë mund të ndërtohet thjeshtë dhe vetëm nga një parti e vetme politike. Prandaj, neni 95.3, në ndërlidhje me konceptin politik mbi të cilin ndërtohet sistemi kushtetues i vendit, parapërcakton që qeveria të jetë e ndërtuar mbi bazën e një koalicioni prej më shumë se sa një partie, meqë, logjikshëm, asnjë parti politike nuk do të ishte në gjendje në një rrethanë normale të bartte një numër të tillë votash e vetme. Koncepti i një qeverie koalicioni, që sendërtohet praktikisht me këtë nen, nuk ka të bëjë thjeshtë me faktin e formimit të qeverisë nga më shumë se një parti politike, por me bashkëjetesën dhe balancimin konstant që ndodh mes partnerëve të koalicionit gjatë bashkëqeverisjes.⁴⁸¹

rëndësishëm për modelimin e qeverisë në kuptim të resurseve humane. Shih një analizë komparative mbi këtë çështje, në: Bäck, Hanna and Dumont, Patrick (2008) ‘Making the First Move: A Two-Stage Analysis of the Role of Formateurs in Parliamentary Government Formation’. *Public Choice*. Vol. 135 (3/4): p. 353-373;

⁴⁷⁹ Cf. me rastin japonez: Angel, C. Robert (1988-1989) ‘Prime Ministerial Leadership in Japan: Recent Changes in Personal Style and Administrative Organization’. *Pacific Affairs*. Vol. 61 (4): p. 583-602;

⁴⁸⁰ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Lituaniës ka dhënë qëndrimin që programi i Qeverisë është obligues për të për gjatë gjithë periudhës gjatë së cilës është në pushtet Qeveria. Qeveritë e reja paraqesin programet para Seimas (Kuvendi Lituanëz) me qëllim që të fitojnë fuqinë e veprimit. Aprovimi nga Seima i programit të Qeverisë shpreh besimin ndaj Qeverisë për periudhën sa Seima është në pushtet. Me rastin e dorëheqjes së Qeverisë, programi i njëjtit nuk është ë domosdoshme të aprovohet nga Seima (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituaniës Nr. 19/97 i datës 10.1.1998);

⁴⁸¹ Shih: Laver, Michael (2008) ‘Governmental Politics and the Dynamics of Multiparty Competition’. *Political Research Quarterly*. Vol. 61 (3): p. 532-536; Shih gjithashtu këtë model, dhe krahaso me atë Italian të koalicioneve qeverisëse dhe stabilitetit qeverisë, në: Campus, Donatella and Pasquino, Gianfranco (2006) ‘Leadership in Italy: The Changing Role of Leaders in Elections and in Government’. *Journal of Contemporary European Studies*. Vol. 14: 25-40; Shih gjithashtu se mbi çfarë bazash ndërtohen koalicionet dhe ndarja e ministrive ndërmjet anëtarëve të koalicionit, në: Adachi, Takanori and Watanabe, Yasutora (2008) ‘Ministerial Weights and Government Formation: Estimation Using a Bargaining Model’. *Journal of Law, Economics, & Organization*. Vol. 24 (1): p. 95-119;

Neni 95.4

1. Neni 95.4 përcakton që nëse përbërja e qeverisë e propozuar nga kandidati i caktuar për kryeministër nga ana e presidentit të republikës nuk merr numrin e nevojshëm të votave, presidenti i republikës detyrohet që brenda dhjetë ditësh të emërojë një kandidatë tjetër për kryeministër sipas së njëjtës procedurë. Neni 95.4 gjithashtu përcakton se nëse as herën e dytë kandidati i nominuar për kryeministër nuk arrin të gjej mbështetjen e nevojshme në Kuvend, presidenti i republikës shpall zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të cilat duhet të organizohen jo më vonë se 40 ditë nga dita e shpalljes së tyre.
2. Neni 95.4, prandaj, lë të kuptohet që në rast se Kuvendi është i pasuksesshëm dy herë radhas për të zgjedhur qeverinë në bazë të propozimeve të presidentit të republikës, *ipso iure* shteren mundësitë për të kërkuar një kandidat të tretë apo një përbërje të tretë të qeverisë. Në këtë kuptim, ndalesa kushtetuese që të kalohet në një tentativë të tretë për propozim të kandidatit të ri për kryeministër, dhe një përbërje të qeverisë rrjedhimisht, arsyetohet me logjikën se partia/koalicioni fitues të ketë mundësinë stabile për të propozuar një kandidat për kryeministër të cilin do të jetë natyrshëm i prirë për ta mbështetur në Kuvend gjatë mandatit të tij.
3. Duhet thënë që, në kuptim të nenit 95.4, nuk është e lejuar që kandidati për kryeministër që caktohet nga ana e presidentit të vije nga një proces konsultues me një parti/koalicion që nuk e ka shumicën e ulëseve në Kuvend. Kjo, prandaj, e bën ndalimin që kandidati për kryeministër të zgjidhet nga një parti/koalicion që nuk e ka shumicën në Kuvend.
4. Sa i përket rezultatit të zgjedhjeve të parakohshme, e njëjta procedurë e zgjedhjes së kandidatit për kryeministër dhe e miratimit të qeverisë duhet ndjekur sërish. Prandaj, neni 95.4 nuk lejon ndonjë përjashtim apo procedurë më të lehtë të zgjedhjes së qeverisë pas zgjedhjeve të parakohshme, dhe e lejon nenin 95.1, nenin 95.2 dhe nenin 95.3 që të jenë të vetmet procedura mbi të cilat zgjidhet qeveria që duhet të dal pas zgjedhjeve të parakohshme.
5. Në kuptim të nenit 95.4, në rast se nuk ka mundësi që të zgjidhet një qeveri edhe herën e dytë, procedura juridike e përcaktuar me këtë nen vazhdon të jetë mënyra e cila e rregullon situatën kur dështon miratimi i kandidatit për kryeministër në tentativën e dytë.

Neni 95.5

1. Neni 95.5 përcakton që nëse kryeministri jep dorëheqje, apo nëse për çfarëdo arsye ulësja e tij mbetet e lirë, qeveria bie, dhe presidenti i republikës procedon me caktimin e kandidatit për kryeministër sipas neneve të mësipërme, dhe miratimi i qeverisë ndjek të njëjtën procedurë.

2. Në kuptim të nenit 95.5, qeveria bartet nga kryeministri, dhe shkarkimi, dorëheqja apo mbetja e ulëses së kryeministrit vakante, sjell *ipso iure* pasojën e konsiderimit të qeverisë si të shkarkuar. Në një rast të tillë, procedura e zgjedhjes së qeverisë ndiqet sipas neneve të mësipërme. Duhet thënë që në kuptim të këtij neni, është kryeministri ai që e ndërton relacionin me Kuvendin sa i përket zgjedhjes së parë pas zgjedhjeve të kabinetit të ri qeverisës.

Neni 95.6

1. Neni 956 përcakton që anëtarët e qeverisë japin betimin para Kuvendit pas miratimit të qeverisë nga ana e Kuvendit. Ky nen, prandaj, lë të kuptohet që mandati i qeverisë fillon në momentin kur qeveria/anëtarët e saj të jenë betuar në Kuvend, dhe jo në momentin e miratimit të qeverisë nga kjo e fundit.

Neni 96 [Ministritë dhe Përfaqësimi i Komuniteteve]

- (1) **Ministritë dhe organet e tjera ekzekutive themelohen, sipas nevojës, për kryerjen e funksioneve brenda kompetencave të Qeverisë.**
- (2) **Numri i anëtarëve të Qeverisë përcaktohet me aktin e brendshëm të saj.**
- (3) **Në Qeveri do të jenë së paku një (1) Ministër nga komuniteti Serb dhe një (1) Ministër nga ndonjë komunitet tjetër joshumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë ministra, Qeveria do të ketë edhe një ministër të tretë, i cili përfaqëson një nga komunitetet joshumicë në Kosovë.**
- (4) **Do të jenë së paku dy (2) zëvendësministra nga komuniteti Serb i Kosovës dhe dy (2) zëvendësministra nga komunitete të tjera joshumicë në Kosovë. Nëse janë më shumë se dymbëdhjetë (12) ministra, Qeveria do të ketë edhe një zëvendësministër të tretë, i cili përfaqëson komunitetin Serb, dhe një (1) tjetër zëvendësministër, i cili përfaqëson një nga komunitetet e tjera joshumicë në Kosovë.**
- (5) **Zgjedhja e këtyre ministrave dhe zëvendësministrave do të vendoset pas konsultimit me partitë, me koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë në Kosovë. Nëse caktohen kandidatë jashtë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për këta ministra e zëvendësministra kërkohet miratimi formal i shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë.**
- (6) **Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat e Qeverisë mund të zgjidhen nga deputetë të Kuvendit të Kosovës ose nga persona të kualifikuar, që nuk janë deputetë të Kuvendit.**
- (7) **Papajtueshmëria e anëtarëve të Qeverisë lidhur me funksionet e tyre rregullohet me ligj.**

Neni 96

1. Neni 96 përcakton strukturën e brendshme të qeverisë, si dhe rregullon mënyrën e organizimit të saj dhe mekanizmit që e përcakton një rregullim të tillë. Ky nen gjithashtu përcakton edhe rezervimin e vendeve në qeveri për përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, si dhe garanton aspektet procedurale që duhet të rezultojnë në një qeveri shumë-etnike.

Neni 96.1

1. Neni 96.1 përcakton se ministrinë dhe organet tjera ekzekutive themelohen, sipas nevojës, për kryerjen e detyrave brenda kompetencave të qeverisë. Në këtë kuptim, ky nen përcakton që njësitë administrative më të përgjithshme në kuadër të qeverisë janë ministrinë, të cilat në fakt në natyrën e tyre institucionale janë organe administrative që ushtrojnë zbatimin e së drejtës dhe politikave shtetërore. Neni 96.1, gjithashtu, përcakton detyrimin që funksioni i ministrive apo organeve tjera më të ulëta se to të jetë në kuadër të kompetencave të qeverisë, sipas nenit 93. Sipas kësaj që cekëm, ministrinë ndalohet të marrin kompetenca që nuk hyjnë në kuadrin e kompetencave të qeverisë.
2. Është e rëndësishme të thuhet që termi “organe të tjera ekzekutive” i referohet çdo strukture institucionale ekzekutive e cila është e nevojshme për të mundësuar që qeveria të ushtrojë funksionin e saj ekzekutiv, sipas kompetencave të nenit 93. Organet ekzekutive, natyrshëm, mund të themelohet vetëm në kuadër të mandatit kushtetues të qeverisë, dhe janë të varura për këtë të fundit.

Neni 96.2

1. Neni 96.2 përcakton numrin e anëtarëve të qeverisë, dhe mënyrën e rregullimit të tyre. Ky nen ndjek një model të hapur sa i përket numrit të anëtarëve të qeverisë, duke vendosur që numri i anëtarëve të qeverisë përcaktohet me aktin e brendshëm të saj. Në këtë kuptim, janë tri komente që e shoqërojnë këtë normë kushtetuese.
2. Një, që numri i anëtarëve të qeverisë, sipas këtij neni, është i hapur, dhe mund të vendoset nga çdo qeveri sipas nevojave të saj. Kjo nënkupton që pavarësisht kompetencave të qeverisë, është vet qeveria që vendos mbi numrin e anëtarëve të saj dhe pozicionin e tyre brenda kabinetit të qeverisë. E drejta për të shtuar apo zvogëluar numrin e anëtarëve të qeverisë, prandaj, përbën një hapësirë ku vet qeveria vendos për gjerësinë e kolektivit të saj sipas nevojave apo/edhe politikës së distribuimit të vendeve për partnerët e një koalicioni qeverisës.
3. Dy, që përcaktimi i numrit të anëtarëve të qeverisë bëhet me anë të një akti të brendshëm të vet qeverisë. Kjo nënkupton që, në njërin anë, vendosja në lidhje me numrin e anëtarëve të qeverisë të jetë autorizim i qeverisë si kolektiv vendimmarrës, dhe dy, që kompetenca mbi numrin e anëtarëve të qeverisë, në kuptim të nenit 96.2, nuk mund t’i merret dhe/apo të përcaktohet me anë të një ligji

të Kuvendit, meqë kjo do të konsiderohej ndërhyrje në fushën ekskluzive të fushëveprimit të qeverisë të përcaktuar me kushtetutë.

4. Në fund, tre, autorizimi për të përcaktuar numrin e anëtarëve të qeverisë nënkupton njëkohësisht edhe autorizimin e qeverisë për të themeluar ministritë përkatëse, shefat e të cilëve bëhen në mënyrë automatike edhe anëtar qeverie. Kjo kompetencë, prandaj, sa i përket themelimit të ministrive me anë të aktit të brendshëm nuk mund të pengohet apo zvogëlohet me anë të një akti tjetër të Kuvendit.

Neni 96.3

1. Neni 96.3 përcakton përbërjen shumë-etnike të qeverisë, dhe garanton ulësen e ministrit për përfaqësuesit e komunitetit serb. Neni 96.3 vendos që në qeveri duhet të ketë së paku një ministër nga komuniteti serb dhe një ministër nga ndonjë komunitet tjetër jo shumicë në Kosovë. Megjithatë, neni në fjalë gjithashtu përcakton që nëse në qeveri ka më shumë se 12 ministra, qeveria duhet të ketë edhe një ministër të tretë nga komunitetet jo shumicë.
2. Rezervimi i ulëses për të paktën dy ministra nga komunitetet jo shumicë është garancion i përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë në kompozicionin e qeverisë. Duhet thënë që, në kuadër të nenit 96.3, rezervimi i ulëses për të paktën dy ministra nga komunitetet jo shumicë nuk e përjashton mundësinë që qeveria të ketë më shumë se dy të tillë. Por, sipas detyrimit nga ky nen, të paktën dy ministra nga komunitetet jo shumicë në Kosovë duhet gjithnjë të jenë pjesë e qeverisë. Përfaqësimi i rezervuar i komuniteteve jo shumicë në qeveri përbën të ashtuquajturin parim të “qeverisë së gjerë” në kuptim të shumë etnicitetit dhe paraqet kushtin themelor të demokracisë konsociale (“consociational democracy”). Ky model i strukturës së qeverisë mundëson që karakteri multietnik i shtetit të gjejë shprehje të garantuar jo thjeshtë për shkak të përfaqësimit të rezervuar në përbërjen e qeverisë, por edhe për shkak që ministrat që burojnë nga ky nen i kushtetutës përfaqësojnë zërin e komuniteteve të tyre në procesin e politik-bërjes në qeveri.

Neni 96.4

1. Neni 96.4 përcakton gjithashtu që së paku dy zëvendësministra nga komuniteti serb i Kosovës dhe dy zëvendësministra nga komunitetet tjera jo shumicë në Kosovë do të ketë në përbërjen e qeverisë. Nëse në qeveri ka më shumë se 12 ministra, qeveria do të ketë edhe dy zëvendësministra shtesë, një nga komuniteti serb dhe një nga komunitetet tjera jo shumicë në Kosovë. Ky nen prandaj mundëson që përveç rezervimit të ulëseve në nivel ministror, komunitetet jo shumicë të kenë të garantuara edhe vendet në nivel të zëvendësministrave.

Neni 96.5

1. Neni 96.5 përcakton mënyrën e zgjedhjes së ministrave dhe zëvendësministrave nga komunitetet jo shumicë në qeverinë e shtetit, dhe vendos mbi procedurën e emërimit të tyre. Ky nen përcakton që emërimi i ministrave dhe zëvendësministrave nga komunitetet jo shumicë, sipas nenit 96.4, bëhet pas konsultimit me partitë, koalicionet ose grupet që përfaqësojnë komunitet që nuk janë shumicë në Kosovë. Nëse caktohen kandidatë jashtë strukturës së deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për emërimin e tyre kërkohet votimi nga shumica e deputetëve të Kuvendit që u përkasin partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin në fjalë.
2. Shikuar në aspektin juridik, termi “konsultim” i shfrytëzuar në këtë nen i referohet një procedure ku partia/koalicioni që përfaqëson komunitetin në fjalë në Kuvendin e Kosovës jep kandidaturën e saj në përbërjen e qeverisë që ndërton një i caktuar për kryeministër. Marrja e detyrueshme e kandidatit të propozuar nga partia/koalicioni që përfaqëson komunitetin joshumicë përkatës është e detyrueshme në kuptim të nenit 96.5, përndryshe, në të kundërtën, do të konsiderohet që nuk është përmbushur detyrimi për një konsultim të plotë me partinë/koalicionin sipas këtij neni. Kjo do të thotë se ky nen imponon një lloj koalicioni parlamentar, qoftë edhe implicit, në mes të partisë/koalicionit që pretendon të formoj qeverinë dhe deputetëve nga komunitetet jo-shumicë, meqë marrja e kandidatit të tyre në përbërjen e qeverisë është detyrim sipas nenit në fjalë. Ky lloj i koalicionit, qoftë edhe implicit, rezulton në një koalicion parlamentar shumetnik, që është e vetmja rrugë nga mund të zbatohet dispozita që buron nga ky nen.
3. Në rastin kur ministri/zëvendësministri caktohet jashtë përbërjes së parlamentit, atëherë neni 96.5 e bën të detyrueshme që kandidati të votohet nga shumica e deputetëve që i përkasin komunitetit në fjalë në Kuvend. Kështu, ta zëmë, nëse kandidati që zë ulësen e rezervuar në qeveri të ministrit që duhet të vije nga komuniteti serb caktohet jashtë përbërjes së Kuvendit, atëherë shumica e deputetëve serb të Kuvendin e Kosovës duhet që ta pranojnë një përcaktim të tillë të kryeministrit përmes votimit, në të kundërtën, kandidatura e caktuar nga kryeministri nuk kalon.

Neni 96.6

1. Neni 96.6 përcakton që kryeministri, zëvendëskryeministrat, dhe ministrat e qeverisë mund të zgjidhen nga deputetë të Kuvendit të Kosovës ose nga persona të kualifikuar që nuk janë deputetë të Kuvendit. Ky nen e lë mundësinë që kryeministri, ministrat dhe zëvendëskryeministrat e qeverisë të jenë persona që nuk bëjnë pjesë në përbërjen e parlamentit, dhe që nuk janë pjesë e listët së fituesve të mandateve parlamentare. Duhet thënë këtu që ky nen nuk e rregullon faktin nëse është e pajtueshme që kryeministri, ministrat, zëvendëskryeministri dhe zëvendësministrat të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të parlamentit. Një gjë e tillë

është e përcaktuar gjetiu në Kushtetutë, përkatësisht në nenin 72 të saj, ku rregullohet papajtueshmëria e postit të deputetit me çfarëdo posti tjetër ekzekutiv në administratën publike ose në ndonjë ndërmarrje në pronësi publike. Termi “persona të kualifikuar” sipas nenit 96.6, ndërkaq, i referohet personave të aftë mendërisht, fizikisht dhe të moshës madhore pavarësisht përgatitjes shkollore dhe profesionale për të ushtruar detyrën e kryeministrit, zëvendëskryeministrit dhe ministrave.

Neni 96.7

1. Ky nen përcakton që çështja e papajtueshmërisë së anëtarëve të qeverisë lidhur me funksionet e tyre rregullohet me ligj. Prandaj, ky nen e autorizon Kuvendin që të zgjidh këtë çështje me anë të nxjerrjes së ligjit përkatës.

Neni 97 [Përgjegjësia]

- (1) **Qeveria, për punën e vet, i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.**
- (2) **Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat mbajnë bashkëpërgjegjësinë për vendimet që merr Qeveria, dhe përgjegjësinë individuale për vendimet që marrin në fushat e përgjegjësive të tyre.**

Neni 97

1. Neni 97 përcakton përgjegjësinë politike të qeverisë përballë Kuvendit, si dhe mënyrën e kërkimit të përgjegjësisë. Natyra e relacionit mbi të cilin ndërtohet përgjegjësia në mes dyve përbën instrumentin më të rëndësishëm ku edhe ndërtohet nyja parlamentare e demokracisë së shtetit.⁴⁸²

Neni 97.1

1. Neni 97.1 përcakton që qeveria për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Kjo është dispozita kushtetuese që e detyron qeverinë që të jetë politikisht përgjegjëse përballë Kuvendit për veprimtarinë e saj. Në anën tjetër, është ky nen që e sendërton funksionin mbikëqyrës të Kuvendit përballë qeverisë, dhe në përgjithësi degës së ekzekutivit.⁴⁸³

⁴⁸² Duhet dhënë argumentin që nga kontrolli i tepërt parlamentar mund të paraqitet e ashtuquajtura “anarki parlamentare”, që përbën rrezikun e një demokracie parlamentare në kuptim të aftësisë së sa funksionuese. Cf. Garner, W. James (1914) ‘Cabinet Government in France’. *The American Political Science Review*. Vol. 8 (3): p. 353-374;

⁴⁸³ Cf. me modelin amerikan të përgjegjësisë politike të presidentit si shef i pushtetit ekzekutiv, dhe krahaso përparësitë e secilit sistem, në: Haines, Grove Charles (1922) ‘Ministerial Responsibility Versus the Separation of Powers’. *The American Political Science Review*. Vol. 16 (2): p. 194-210;

2. Shikuar më thellësisht, përgjegjësia politike që ka qeveria ndaj Kuvendit, përbëhet nga këto karakteristika juridike: një, që qeveria është e detyruar të bart përgjegjësi përpara Kuvendit për mënyrën dhe dinamikën e ushtrimit të funksionit të saj kushtetues; dy, që Kuvendi ka autorizimin e pakufizuar që t'i kërkoj përgjegjësi politike qeverisë në lidhje me detyrimet e saj dhe/apo premtimet e dhëna; tre, që qeveria është e detyruar të mbaj konstant të informuar Kuvendin mbi zhvillimet e rëndësishme në fushën e kompetencave të qeverisë; katër, që Kuvendi ka të drejtë të mbikëqyrë çdo veprim të qeverisë në fushat e kompetencave të saj, pas asnjë kufizim kohor apo procedural.
3. Dhënia e përgjegjësisë politike të qeverisë përballë Kuvendit natyrshëm kërkon edhe mekanizmin e nevojshëm kushtetues që të garantoj se në rast se qeveria nuk i përgjigjet Kuvendit, dhe/apo nuk është në dinamikën e kërkuar nga Kuvendi, ky i fundit ta shkarkoj atë. Instrumenti i shkarkimit të qeverisë, që është mjeti final të cilin e disponon Kuvendi në dënimin e qeverisë në rast të mos-shkarkimit të duhur të përgjegjësisë nga kjo e fundit, rregullohet me një nen të veçantë kushtetues, prandaj edhe e komentojmë në pjesët e mëposhtme. E kemi fjalën këtu për institucion e njohur si “mocioni i mosbesimit” (neni 100 i Kushtetutës).

Neni 97.2

1. Neni 97.2 përcakton që kryeministri, zëvendëskryeministri, dhe ministrat mbajnë bashkëpërgjegjësinë për vendimet që merr qeveria, dhe përgjegjësinë individuale për vendimet që marrin në fushat e përgjegjësisë së tyre. Neni 97.2 duhet interpretuar ngushtë me Nenin 94, meqë kompetencat e kryeministrit përballë qeverisë janë substanca më kryesore e cila përcakton nëse qeveria bart përgjegjësi kolektive apo individuale në secilin rast.
2. Në kuptim të nenit 97.2, qeveria i përgjigjet Kuvendit në dy forma: një, si kolektiv i përbërë nga tërë anëtarët e saj, dhe dy, secili anëtar individualisht për veprimtarinë e tij/saj brenda fushave të kompetencave individuale. Sa i përket përgjegjësisë kolektive, natyrshëm, edhe në ndërlidhje me Nenin 94, është kryeministri i qeverisë ai që bart tërë tagrin e ndërtimit të këtij relacioni me Kuvendin, duke qenë përfaqësues i qeverisë dhe udhëheqës i saj. Duhet thënë megjithatë që përgjegjësia kolektive sipas këtij neni është substancialisht e lidhur me funksionin e kryeministrit, dhe praktikisht është kryeministri ai që merret në përgjegjësi, edhe pse kjo normë përcakton një model kolektiv të përgjegjësisë. Në rastin e dytë, Kuvendi ushtron kontroll të përgjegjësisë individuale ndaj secilit anëtar të qeverisë në fushat e kompetencave të tyre individuale. Në kuptim të përgjegjësisë individuale, sërish në ndërlidhje me Nenin 94, është kryeministri që përbën ombrellën e përgjegjësisë së tërë qeverisë,⁴⁸⁴ meqë ai përgjigjet individualisht për kompetencën e tij të përfaqësimit, të udhëheqjes së qeverisë dhe

⁴⁸⁴ Cf. O'Malley, Eoin (2007) 'The Power of Prime Ministers: Results of an Expert Survey'. *International Political Science Review / Revue internationale de science politique*. Vol. 28 (1): p. 7-27;

të sigurimit që qeveria ushtron kompetencat e saj në mënyrën e përcaktuar me legjislacion dhe në përputhje me politikat publike të përcaktuara nga vet ajo.

3. Përgjegjësia politike e qeverisë përballë Kuvendit është tregues gjithashtu edhe i legjitimitetit indirekt popullor që ajo duhet të marrë në Kuvend. Meqë qeveria nuk zgjidhet nga ndonjë burim i drejtpërdrejtë popullor, ajo i detyrohet përgjegjësisë ndaj Kuvendit edhe për shkak të supozimit që Kuvendi është përfaqësues i popullit në modelin parlamentar të shtetit të Kosovës. Në këtë aspekt, shkarkimi i përgjegjësisë politike në Kuvend nënkupton edhe legjitimim indirekt popullor të vet veprimtarisë dhe funksionit të qeverisë, mënyrë e cila mundëson që qeveria të qeveris në mënyrë të supozuar si legjitime. Prandaj, përgjegjësia politike e vendosur me nenin 97.2 që ka qeveria ndaj Kuvendit strukturalisht përbën rrugën ku qeveria supozohet se legjitimon veten e saj.

Neni 98 [Imuniteti]

- (1) **Anëtarët e Qeverisë së Kosovës gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Qeverisë.**

Neni 98

1. Neni 98 përcakton imunitetin e anëtarëve të qeverisë. Sipas këtij neni, anëtarët e qeverisë gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Qeverisë.
2. Çështja e parë që kërkon komentim është se kë mbulon imuniteti i dhënë me nenin 98? Termi “anëtarët e qeverisë” duhet interpretuar në përputhje me nenin 92.1, i cili përcakton që anëtarë të qeverisë janë kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat. Që të tre këto pozita politike janë të veshur me imunitetin e dhënë me nenin 98.
3. Sa i përket vëllimit të imunitetit të dhënë me nenin 98, duhet thënë që ky është imunitet i pastër funksional,⁴⁸⁵ dhe e mbron kryeministrin, zëvendëskryeministrat dhe ministrat vetëm për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të tyre ekzekutiv. Termi “veprim dhe vendim” brenda fushëveprimit të tyre konsiderohet i mbuluar nga imuniteti i nenit 98 nëse plotëson këto kushte: një, që zyrtari në fjalë të ketë marrë një vendim/veprim brenda kompetencës së tij të dhënë me kushtetutë

⁴⁸⁵ Që shkon në kundërshtim të plotë me llojin e imunitetit sovran. Cf. Chemerinsky, Erwin (2001) ‘Against Sovereign Immunity’. *Stanford Law Review*. Vol. 53 (5), *Symposium: Shifting the Balance of Power? The Supreme Court, Federalism, and State Sovereign Immunity* (May, 2001), p. 1201-1224. Imuniteti sovran është ai imunitet që mbron bartësit e tij nga çdo ndjekje penale dhe lidhet me cilësinë e bartësit, jo me funksionin e tij. Imunitetin e pastërt funksional e ka mbrojtur edhe Gjykata në vendimin e saj i cili u komentua me nenin 89 të Kushtetutës.

dhe ligj përkatës; dy, që në kryerjen e veprimit/vendimit të tillë, zyrtari përkatës të ketë ushtruar kompetencën e tij në përputhshmëri me ndalimet kushtetuese dhe ligjore, dhe që t'i jetë përmbajtur detyrimeve që e shoqërojnë kompetencën në fjalë; tre, që vendimi/veprimi i zyrtarit përkatës të mos ketë cenuar të drejtat subjektive të personave tjerë,⁴⁸⁶ dhe, katër, që vendimi/veprimi i ndërmarrë nga zyrtari përkatës të përfshijë vetëm autoritetin e tij si anëtar qeverie, dhe jo ndonjë kompetencë që mund ta ketë fituar jashtë këtij funksioni.

4. Është i rëndësishëm të thuhet që termi “veprim” i dhënë në nenin 98 i referohet jo thjeshtë veprimeve aktive të zyrtarëve përkatës, por edhe veprimeve pasive të tyre, apo heqjes dorë të tyre nga ushtrimi i një veprimi si funksion i kompetencës së tyre diskrecionale. Prandaj, kjo përfshin si veprimet ashtu edhe mosveprimet që hyjnë në kuadër të kompetencave përkatëse të zyrtarit të caktuar.⁴⁸⁷
5. Neni 98, në anën tjetër, i mbron anëtarët e qeverisë nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi brenda funksionit të tyre. Termi “ndjekja penale”, si e tillë, përfshin procesin kur hetimi merr autorizim prokurorial, dhe kur zyrtari fillon të hetohet dhe të procedohet penalisht nga ana e prokurorit publik. Termi “padi civile” i referohet padisë për dëmshpërblimin material apo jo-material që një subjekt me interes të drejtpërdrejtë juridik mund ta procedojë në gjykatë kundër një anëtari të qeverisë. Termi “shkarkim” i referohet shkarkimit të anëtarit të qeverisë jashtë logjikës së përgjegjësisë politike, meqë anëtari i qeverisë nuk bartë imunitet nga shkarkimi në parlament, përderisa ky lloj imuniteti nuk e mbron ministrin/zëvendëskryeministrin nga kompetenca e kryeministrit për ta ndërruar atë për shkak të veprimeve/vendimeve të tij brenda kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore.

Neni 99 [Procedurat]

(1) Mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në Qeveri rregullohen me ligj dhe me rregullore.

Neni 99

1. Neni 99 përcakton që mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në qeveri rregullohen me ligj dhe rregullore. Prandaj, është lehtësisht e kuptueshme që mënyrën e organizimit të vendimmarrjes së qeverisë e rregullon Kuvendi përmes një ligji, ndërsa e plotëson vet qeveria përmes një rregulloreje të punës së saj. Mundësia që

⁴⁸⁶ Meqë konsiderohet që ka një lidhje strukturale në mes të gjerësisë së imunitetit të zyrtarëve të lartë dhe hapësirës për shkeljen e të drejtave të njeriut. Shih: van Alebeek, Rosanne (2010) ‘Immunity and Human Rights? A Bifurcated Approach’. *Proceedings of the Annual Meeting (American Society of International Law)*. Vol. 104, (March 24-27, 2010), p. 67-72;

⁴⁸⁷ Kjo supozon që personi përkatës është i mbrojtur për veprimet e tilla edhe pas lëshimit të pozitës përkatëse. Shih, Një argument mbi dhënien e imunitetit ish zyrtarëve të lartë shtetëror, në: Bass, Evan Peter (1987) ‘Ex-Head of State Immunity: A Proposed Statutory Tool of Foreign Policy’. *The Yale Law Journal*. Vol. 97 (2): p. 299-319;

Kuvendi të rregullojë mënyrën e punës dhe të vendimmarrjes së qeverisë përmes një ligji është garancion që standardet e transparencës, rregullsisë procedural dhe të eficiencës të vendosen si detyrim mbi qeverinë përmes një ligji të cilit ajo i obligohet.

Neni 100 [Mocioni i Vetëbesimit]

- (1) Mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë mund të ngrihet me propozimin e një të tretës (1/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit.**
- (2) Vetëbesimin e Qeverisë mund ta kërkojë Kryeministri.**
- (3) Mocioni i mosbesimit vihet në rendin e ditë të Kuvendit, jo më vonë se pesë (5) ditë e as më herët se dy (2) ditë nga data e parashtrimit të tij.**
- (4) Konsiderohet se mocioni i mosbesimit është pranuar, nëse për të kanë votuar shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.**
- (5) Nëse mocioni i mosbesimit dështon, mocioni tjetër i mosbesimit nuk mund të ringrihet gjatë nëntëdhjetë (90) ditëve të ardhshme.**
- (6) Nëse mocioni i mosbesimit votohet për Qeverinë në tërësi, Qeveria konsiderohet në dorëheqje.**

Neni 100

1. Neni 100 përcakton procedurën e vendosjes së përgjegjësisë politike të Kuvendit mbi qeverinë përmes mocionit të vetëbesimit.⁴⁸⁸ Ky nen, gjithashtu, përcakton edhe palët e autorizuara që mund të iniciojnë mocionet e vetëbesimit mbi qeverinë, si dhe përcakton garancionet procedurale që i veshën qeverisë në këtë kuptim.

Neni 100.1

1. Neni 100.1 përcakton që mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë mund të ngritet me propozimin e një të tretës të të gjithë deputetëve. Praktikisht, një pakicë parlamentare prej 1/3 të të gjithë deputetëve, dyzetë (40) deputetë, ka autorizim kushtetues që të procedojë në Kuvend një mocion mosbesimi ndaj qeverisë. Dhënia e mundësisë një pakice të tillë të deputetëve krijon një ambient relativisht vibrant politik ku deputetët e opozitës të mund të sfidojnë përkrahjen parlamentare të qeverisë,⁴⁸⁹ dhe eventualisht të tentojnë rrëzimin e saj përmes kalimit të mocionit të mosbesimit në seancë plenare në Kuvend.⁴⁹⁰

⁴⁸⁸ Krahaso këtë me sistemin kushtetues ku pushtetet janë të ndara të mënyrë rigjide, në: Haines, Charles Grove (1922) 'Ministerial Responsibility Versus the Separation of Powers'. *The American Political Science Review*. Vol. 16 (2): p. 194-210;

⁴⁸⁹ Cf: Diermeier, Daniel, Eraslan, Hülya and Merlo, Antonio (2003) 'A Structural Model of Government Formation.' *Econometrica*. Vol. 71 (1): p. 27-70;

⁴⁹⁰ Në rastin kanadez, kishte lindur problem në interpretimin nëse mocioni i vetëbesimit të qeverisë nënkuptonte realisht "vetëbesimin" e qeverisë. Ky rast lë nënkuptimin që duhet pasur kujdes në konstruktimin e mocionit të mosbesimit, dhe në qartësinë e tij. Shih rastin kanadez në: Heard, Andrew (2007) 'Just What Is a Vote of Confidence? The Curious Case of May 10, 2005'. *Canadian Journal of Political Science / Revue canadienne de science politique*. Vol. 40 (2): p. 395-416;

Neni 100.2

1. Neni 100.2 përcakton që palë tjetër e autorizuar për të ngritur mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë të jetë edhe kryeministri, i cili mund të procedojë mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë së tij në kuvend.⁴⁹¹ Dhënia e këtij autorizimi për kryeministrin lidhet me dhënien e mundësisë këtij të fundit që të testojë ose të argumentojë mbështetjen parlamentare të qeverisë së tij, dhe/apo që të rrëzojë qëllimisht qeverinë e tij në rastet kur kjo paraqitet si opsion politik i tij. Dhënia e mundësisë së vet kryeministrit për të proceduar një mocion, mosbesimi ndaj qeverisë së tij gjithashtu lë mundësinë që kryeministri të provojë përballë opozitës parlamentare mbështetjen nga shumica e deputetëve, apo thjeshtë të testoj numrin e ulëseve parlamentare që e mbështesin qeverinë e tij.

Neni 100.3

1. Neni 100.3 përcakton që mocioni i mosbesimit vihet në rend dite ne Kuvend jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e parashtrimit të tij, por as më shpejt se dy (2) ditë nga dita e parashtrimit të tij. Vënia e kufirit kohor prej pesë (5) ditësh për të votuar mocionin e mosbesimit të qeverisë në Kuvend është një lloj garantuesi që qeveria të shkojë në procedurën e kontrollit parlamentar apo edhe të rrëzimit pa humbur kohë.

Neni 100.4

1. Neni 100.4 vendos rregullën që mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë konsiderohet i pranuar nëse për të kanë votuar shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës, dhe rrjedhimisht konsiderohet që qeveria është shkarkuar nga Kuvendi. Shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit përbën formulën e njëjtë të votimit që shfrytëzohet edhe në rastin e zgjedhjes së qeverisë, e që është gjashtëdhjetë e një (61) vota deputetësh.
2. Me kalimin e mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë, qeveria humb të gjithë autoritetin kushtetues për të kryer kompetencat e saj, dhe *ipso iure* kalohet në procesin e ri të emërimit të qeverisë, përmes propozimit të një kandidati nga ana e presidentit të republikës, sipas procedurës së shpjeguar më sipër.

⁴⁹¹ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese bullgare ka vendosur që kryeministri është i obliguar sipas Kushtetutës të ofrojë dorëheqjen në rast se Asambleja Kombëtare kalon mocion mosbesimi apo kur Qeveria dështon të marre votat e mjaftueshme në rast të kërkimit të votëbesimit. Përveç këtyre dy rasteve të cilat janë të parapara në mënyre eksplicite në Kushtetutë, Kryeministri nuk është i obliguar të dorëzojë dorëheqjen e Qeverisë. Një obligim i tillë nuk kërkohet me Kushtetutë nëse Asambleja Kombëtare hedh poshtë propozimet e bëra nga Kryeministri, përfshirë nismat legjislative. Prandaj, Kryeministri nuk është i obliguar të ofrojë dorëheqjen e Qeverisë kur Asambleja Kombëtare i refuzon propozimin për themelimin e ministrive të reja apo ndryshimeve në Qeveri (Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë Nr. 4/94 i datës 21.6.1994);

Neni 100.5

1. Neni 100.5 përcakton që nëse mocioni i propozuar i mosbesimit ndaj qeverisë nuk kalon, atëherë një mocion tjetër mosbesimi ndaj qeverisë nuk mund të ngrihet gjatë nëntëdhjetë (90) ditëve të ardhshme prej momentit të mos-kalimit të mocionit të fundit. Kjo përbën një garancion kualitativ që e mbron qeverinë për një periudhë kohore prej 90 ditësh, si një mënyrë që qeveria të mos lëkundet nga kërkesat e shpeshta të opozitës për mosbesim të qeverisë.

Neni 100.6

1. Neni 100.6 përcakton që nëse mocioni i mosbesimit votohet për qeverinë në tërësi, qeveria konsiderohet në dorëheqje. Ky nen, prandaj, përcakton pasojën juridike të kalimit të mocionit të mosbesimit ndaj qeverisë në Kuvend.
2. Në anën tjetër, ky nen qëllimshëm i referohet konceptit “mocion i mosbesimit për qeverinë në tërësi”. Kjo lë nënkuptimin juridik që një mocion mosbesimi mund të ngrihet edhe ndaj një anëtari individual të qeverisë, p.sh. një ministri apo zëvendëskryeministri. Në rastin e tillë, Kuvendi bart autorizimin që të kalojë një mocion mosbesimi individual, ku edhe pasoja juridike do të ishte shkarkimi i një anëtari të qeverisë, për dallim ndaj qeverisë si kolektiv. Megjithatë, duhet thënë që mocioni individual mosbesimi nuk mund të ngrihet ndaj kryeministrit si i vetëm, meqë shkarkimi i tij do të kishte pasojë shkarkimin e tërë qeverisë *ipso iure*.
3. Prandaj, në nënkuptim të nenit 100.6, Kuvendi mund të kalojë një mocion mosbesimi kolektiv ndaj qeverisë dhe një mocion mosbesimi individual ndaj një anëtari të qeverisë (përfshirë kryeministrin). Në cilindo rast, Kuvendi ushtron mekanizmin e veshjes me përgjegjësi politike qeverinë, duke e shkarkuar atë, në rastin kur Kuvendi gjen që qeveria ka dalë jashtë kornizave të saj të përgjegjësisë ndaj Kuvendit. Në fund, duhet qartësuar se pavarësisht që Kuvendi, në nënkuptim të Nenit 100.6, mund të ngrit mocion mosbesimi ndaj një anëtari individual të qeverisë, ky nen nuk i jep Kuvendit asnjë autorizim për të emëruar një anëtar qeverie (individualisht) sepse kjo është kompetencë ekskluzive e kryeministrit sipas nenit 94.

Neni 101 [Shërbimi Civil]

- (1) Përbërja e shërbimit civil do të pasqyrojë shumëllojshmërinë e popullit të Kosovës, duke marrë në konsideratë parimet e barazisë gjinore, të njohura ndërkombëtarisht.
- (2) Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës.

Neni 101

1. Neni 101 përcakton rregullat bazike të shërbimit civil të shtetit. Siç është argumentuar edhe në pjesën e parë të këtij kapitulli, pushteti ekzekutiv ka një ndarje vertikale në mes të nivelit politik, që janë të zgjedhurit politik të këtij pushteti (kryeministri, ministrat, etj.), dhe nivelit profesional e civil, që është shërbimi civil i shtetit. Shërbimi civil përbën një mekanizëm profesional, neutral ndaj politikës, civil dhe meritore, i përhershëm, që është i varur institucionalisht për qeverinë, dhe i cili ushtron në mënyrë profesionale dhe të përhershme funksionin e zbatimit administrativ të detyrave administrative të qeverisë. Shërbimi civil, që përbën komponentin human të administratës shtetërore, garantohej me nenin 101, ku ngërthehen parimet që i ruajnë atij neutralitetin, karakterin civil, profesional dhe meritore.

Neni 101.1

1. Neni 101.1 përcakton që përbërja e shërbimit civil të Kosovës duhet të pasqyroj shumë etnicitetin e popullit të Kosovës, duke marrë për bazë parimet e barazisë gjinore, dhe standardet e tjera të njohura ndërkombëtarisht. Në kuptim të këtij neni, këtu vendoset garancioni që komunitetet jo shumicë në Kosovës duhet të kenë të drejtë të pjesëmarrjes në shërbimin civil në bazë të kuotave proporcionale, sipas pozitës së secilit komunitet në tërësinë e popullit, dhe që kjo do të garantojë që pjesëmarrja shumetnike në shërbimin civil të rezultojë me zbatimin praktik të multietnicitetit në strukturën e administratës shtetërore të Kosovës.

Neni 101.2

1. Neni 101.2 përcakton që një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil do të sigurojë respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil të Kosovës, si dhe që ky i fundit të pasqyrojë diversitetin e popullit të Kosovës.⁴⁹² Në këtë kuptim, neni 101.2 e vendos Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në funksionin e një institucioni të pavarur që duhet të garantoj që standardet e meritës, profesionalizmit, neutralitetit ndaj politikës dhe të karakterit civil të shërbimit civil të gjejnë shprehje në punën/veprimtarinë e shërbimit civil të shtetit. Natyrshëm, në kuptim të këtij neni, qeveria zhvishet nga kompetenca që të kujdeset për ruajtjen e integritetit profesional dhe civil të shërbimit civil ashtu që kjo kompetencë i bartet një institucioni të pavarur që themelohet sipas këtij neni.
2. Vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës janë përfundimtare dhe, si të tilla, paraqesin titull të vlefshëm ekzekutiv. U mor vesh, vendimet në fjalë mund të kontestohen në procedurë të konfliktit administrativ vetëm sa i përket ligjshmërisë së tyre. Këtë cilësi të titullit ekzekutiv ato e ruajnë si kur flitet për prestime në të holla ashtu dhe në rastet e prestimeve tjera jo monetare. Këtë pozitë e ka mbrojtur

⁴⁹² Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Hungarisë në vendimin e saj 29/2011 theksoi se shërbyesit civilë nuk mund të shkarkohen nga detyra pa iu ofruar arsytim i detajuar për një gjë të tillë (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë 29/2011 i datës 7.4.2011);

Gjykata Kushtetuese në rastet e njohura si “rastet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës” gjatë viteve 2011-2012. Me këtë rast, Gjykata ka theksuar se procedurat para këtij organi gjysmë gjyqësor duhet të respektojnë rregullat mbi gjykimin e drejtë dhe të paanshëm, duke përfshirë këtu edhe procedurën e ekzekutimit të vendimeve të Këshillit, gjë e cila ishte mohuar më parë kur bëhej fjalë për prestimet jo monetare.⁴⁹³

⁴⁹³ Cf. rastet si vijon: *Aktgjykim në Rastin Nr. KI47/12. Parashtruesi: Islam Thaçi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev. Nr. 188/2009, të 7 dhjetorit 2011.* Datë: 16 korrik 2012 (Nr.ref.: AGJ 278/12); *Aktgjykim në Rastin Nr. KI 55/11. Parashtruesi: Fatmir Pireci. Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren Ac. nr. 518/2010, të 26 nëntorit 2010.* Datë: 16 korrik 2012 (Nr. ref.: RK/277/12); *Aktgjykim në Rastin Nr. KI 129/11. Parashtruesi: Viktor Marku. Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac. Dr. 158/2011 të 5 korrikut 2011 dhe vendimit nr. 02/197/2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga ana e Komunës së Klinës.* Datë: 17 korrik 2012 (Nr. ref.: AGJ/282/12); *Aktgjykim në Rastin Nr. I50/ 12. Parashtruesi: Agush Llolluni. Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac. nr. 153/2011, të 4 tetorit 2011, dhe Vendimit Nr. 02 (207) 2010, të 4 tetorit 2010, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Republikës së Kosovës nga Komuna e Junikut.* Datë: 16 korrik 2012 (Nr. ref.: AGJ/279/12); *Aktgjykim në Rastin Nr. KI 108/10. Parashtruesi: Fadil Selmanaj. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. nr. 170/2009, të 25 shtatorit 2009.* Datë: 5 dhjetor 2011. Nr. Ref.: AGJ. 163/11); dhe *Aktgjykim në Rastin nr. 104/12. Parashtruesi: Esat Kelmendi. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, të 30 nëntorit 2011.* Datë: 20 korrik 2012 (Nr. Ref.: AGJ 285/12).

Kapitulli VII: Sistemi i Drejtësisë

Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]

- (1) Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovë ushtrohet nga gjykatat.
- (2) Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.
- (3) Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.
- (4) Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm.
- (5) Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese.

Neni 102

1. Neni 102 i Kushtetutës përcakton parimet themelore funksionale të pushtetit gjyqësor të Republikës së Kosovës. Pushteti gjyqësor është dega e tretë e pushtetit shtetëror, e ndarë sipas logjikës së parimit të ndarjes së pushtetit. Rrënjët filozofike të ndarjes së pushtetit gjyqësor nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ mbështeten, ndër të tjera, në idenë e Montesksesë i cili argumentonte se “nuk ka liri, nëse pushteti gjyqësor nuk është i ndarë nga ai legjislativ dhe ekzekutiv”.⁴⁹⁴ Megjithatë, ndarja e pushtetit gjyqësor nga dy pushtetet tjera merr zhvillim filozofik sidomos në procesin e ndërtimit kushtetues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në *Letrat e Federalistit* arsyetohej që nuk mund të ketë qeverisje të përshtatshme dhe të sigurt për një popull të lirë pa pasur një pushtet gjyqësor të pavarur, siç qe argumentuar edhe në *Cohens v. Virginia*.⁴⁹⁵ Argumenti themelor i etërve amerikan ishte që nëse një sistem kushtetues nuk ka një pushtet gjyqësor për të interpretuar, promovuar dhe zbatuar ligjin, për të vënë në jetë të drejtat e njeriut dhe për të zgjidhur kundërthënie juridike, qeverisja ose do të kalbet nga imbiciliteti i saj, ose degët tjera të pushtetit do të uzurpojnë autoritetin shtetëror për të pushtuar lirinë, me qëllim të komandimit të *dëgjueshmërisë*.⁴⁹⁶ Prandaj, vazhdonte argumentimi,

⁴⁹⁴ Cohler, M., Anne, Miller, C., Basia, and Stone, S. Harold, (eds.) (1989) ‘Montesquieu. Spirit of Laws’. Cambridge Texts in the History of Political Thought. Cambridge: Cambridge University Press.

⁴⁹⁵ Shih, ndër të tjera: Hamilton, Alexander, Madison, James and John, Jay ‘The Federalist’, in Pole, R., J., (ed.) (2005) ‘The Federalist’. Indianapolis: Hackett Publishing Company, Inc; Kent, James, (1851) ‘Commentaries of American Law. Volume I. Seventh Edition’. New York: William Kent - Van Norden&Ameeman, Printers, p. 316-319; and *Cohens v. Virginia*, 6 Wheat. R. 384.

⁴⁹⁶ Kent, James, (1851) ‘Commentaries of American Law. Volume I. Seventh Edition’. New York: William Kent- Van Norden&Ameeman, Printers, p. 316-319.

mungesa e pushtetit gjyqësor do të bënte që vullneti i qeverisësve të kalonte në arbitraritet dhe despotizëm. Si rezultat i kësaj, fuqia e vullnetit të pushtetit do të bëhej përcaktor i të drejtave të njeriut, pavarësisht se mbi çfarë baze mbështetet vullneti i tillë. Andaj, kërkesa për të pasur një pushtet gjyqësor që kryen funksionin e saj duke i bërë kontroll qeverisjes nga dy pushtetet tjera, sipas Raull-it, është kusht themelor për një sistem kushtetues të mirë-organizuar.⁴⁹⁷

Neni 102.1

1. Kushtetuta përcakton qartësisht që funksioni gjyqësor i shtetit ushtrohet *ekskluzivisht* nga gjykatat. Kjo është në fakt një rregull parimore që ndalon në mënyrë eksplicite që një institucion jo-gjyqësor të mund të ushtrojë funksionin gjyqësor. Kjo rregull *ndaluese* i shërben garantimit të sigurisë juridike, meqë e parandalon në formë eksplicite okupimin ose marrjen e kompetencave gjyqësore të një gjykate nga një organ jo-gjyqësor. Në anën tjetër, kjo rregull mundëson që interpretimi final i normave juridike - të cilësdo instancë - të bëhet vetëm nga një organ i specializuar e profesional, jashtë ndikimit të pushteteve tjera. Prandaj, argumenti themelor për nevojën që Kushtetuta të përcaktojë në mënyrë shprehimore që ushtrimi i pushtetit gjyqësor të mund të bartet vetëm nga gjykatat lidhet me ndarjen e ngurtë që duhet të kenë degët e pushtetit shtetëror, përkatësisht me ndalimin që pushteti legjislativ ose ai ekzekutiv të mund të ushtrojnë ose të mund të okupojnë kompetenca të karakterit gjyqësor. Një shembull praktik i kësaj dukurie ka qenë ndalimi që ligjet të interpretohen nga gjykatat i cili u zbatua në Francë pas Revolucionit Borgjez, ndalesë e cila realisht tentonte të theksonte që vullneti i popullit i shprehur përmes përfaqësuesve të zgjedhur në organin legjislativ nuk mund të mbetet në dorën e gjykatave që nuk zgjidheshin nga populli. Kjo praktikë më vonë ndryshoi me Kodin e Napoleonit, dhe ishte thjeshtë një tendencë e parlamentit Francez që provonte të okuponte funksionin gjyqësor.⁴⁹⁸ Kjo praktikë, prandaj, mbetet absolutisht e ndaluar me parimin e vendosur në këtë paragraf të nenit 102.

Neni 102.2

1. Ky paragraf vendos gjashtë parime themelore mbi organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor të Republikës së Kosovës. Prandaj, interpretimi i normave të veçanta (*lex specialis*) qoftë kushtetuese qoftë ligjore në lidhje me organizimin dhe funksionimin e gjyqësorisë duhet të vendosen nën dritën e këtyre parimeve. Për ta bërë më të lehtë shpjegimin, komentimin e ofrojmë individualisht për secilin parim të përshkruar në këtë paragraf.

⁴⁹⁷ Rawle, William, (2009) 'A View of the Constitution of the United States of America'. USA: BiblioLife (reprinted). Chapter, 21, p. 199.

⁴⁹⁸ Cappelletti, Mauro, Merryman, Henry, John, and Perillo, M., Joseph (1967) *The Italian Legal System* Stanford: Stanford University Press, f. 150.

a) “Pushteti gjyqësor është unik...”

1. Ky përcaktim i Kushtetutës vendos parimin e unitetit të pushtetit gjyqësor, që nënkupton se pushteti gjyqësor përbën një sistem hierarkik me unitet të brendshëm. Ky proklamim mund të shihet në tri rrafshje. E para, që pushteti gjyqësor i Republikës së Kosovës nuk mund të ndahet mbi çfarëdo baze, qoftë ajo etnike, territoriale, faktike, etj. Si e tillë, kjo është një rregull *ndaluese* që nuk lejon që një gjykatë në territorin e shtetit të dalë jashtë sistemit të pushtetit gjyqësor. E dyta, ky parim ndalon konkurrencën nga ndonjë institucioni paralel gjyqësor në territorin e shtetit, duke ndaluar që ndonjë institucion paralel gjyqësor të mund të ekzistojë në territorin ku shtrihet sovraniteti i kësaj Kushtetute. Dhe e treta, ky parim i jep karakter ekskluziv vetëm vendimeve gjyqësore të sistemit gjyqësor të instaluar në bazë të kësaj Kushtetute, duke përjashtuar shprehimisht që ndonjë vendim gjyqësor i një gjykate që nuk buron nga kjo Kushtetutë të ketë fuqi juridike në territorin e Kosovës. U mor vesh, kjo përjashton rastet kur Kosova, sipas rregullave ndërkombëtare, detyrohet t’i jep fuqi vendimeve të huaja gjyqësore. Kjo do të thotë se përjashtimet nga kjo rregull janë të lejuara vetëm nëse mbështeten në parimet, vlerat dhe normat e të drejtës pozitive ndërkombëtare. Kjo, në anën tjetër, përbën obligim aktiv për shtetin që të *mos* lejojë ekzistencën e institucioneve gjyqësore që e konkurrojnë ose e sfidojnë sistemin gjyqësor të dalë nga kjo Kushtetutë. Marrë në përgjithësi, parimi i unitetit të pushtetit gjyqësor e plotëson parimin e sovranitetit territorial të Kosovës të proklamuar nga Kushtetuta, duke ndaluar çdo mundësi që ndonjë sistem paralel gjyqësor të mund të ekzistojë në Kosovë. Në këtë aspekt, në bazë të kësaj, është detyrim i institucioneve kushtetuese të shtetit që të ndalojnë që ndonjë strukturë paralele gjyqësore të mund të thyej këtë parim të organizimit të pushtetit gjyqësor.

b) “Pushteti gjyqësor është i pavarur,... dhe i paanshëm...”

1. Këto dy parime fundamentale, pavarësia dhe paanshmëria, mbeten dy dimensionet më të rëndësishme të pushtetit gjyqësor të një shteti modern. Pavarësia dhe paanshmëria e pushtetit gjyqësor janë tashmë dy parime jo thjesht të së drejtës kushtetuese,⁴⁹⁹ por edhe të së drejtës ndërkombëtare, rëndësia e të cilave, sipas GjEDNj në *Stafford v. the United Kingdom*,⁵⁰⁰ po pëson rritje të vazhdueshme në kuptimin e gjyqësisë bashkëkohore.⁵⁰¹ Shumë organizata ndërkombëtare, në këtë

⁴⁹⁹ Parimi i pavarësisë së gjyqësorit inter alia nënkupton që një gjyqtar nuk guxon t’i ekspozohet interesave të palëve të treta dhe nuk guxon t’i merr parasysh interesat e palëve në procesin e vendim-marrjes. Nëse një gjyqtar kërkon nga prokurori publik të përfshihet në proces, atëherë ai gjyqtar i ekspozohet ndikimit nga pala e tretë (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë PL. US i datës 10 shtator 1996);

⁵⁰⁰ *Stafford v. the United Kingdom* [GC], No. 46295/99, § 78, ECHR 2002-IV.

⁵⁰¹ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Hungarisë e shpalli jo-kushtetuese një dispozitë ligjore e cila i jepte kompetencë Ministrsit të Drejtësisë të ndajë mirënjohje gjyqtarëve. Mirënjohjet diskrecionale për punën e gjyqtarëve në gjykata nga një përfaqësues i pushtetit ekzekutiv e rrezikon paanshmërinë e gjyqësorit (Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, Nr. 45/1995 (X. 21.) AB hatarozat i datës 18.10.1994);

kontekst, kanë dhënë kontribut në ndërtimin e një sistemi standardesh që përcaktojnë dhe flasin për pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

2. “Pavarësia e pushtetit gjyqësor” është një parim shumëdimensional, që përcaktohet pothuajse hollësisht në Parimet Bazike mbi Pavarësinë e Gjyqësorit të Kombeve të Bashkuara (PBPgJKB),⁵⁰² Parimet e Bangalores mbi Ushtrimin e Gjyqësorit (PBUGj),⁵⁰³ Standardet Minimale të Pavarësisë Gjyqësore të Odës Ndërkombëtare të Avokatëve (SMPGjONA),⁵⁰⁴ Rekomandimin Nr. 94(12) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (R. 94(12)),⁵⁰⁵ Kartën Evropiane mbi Statutin e Gjykatësve (KESGj),⁵⁰⁶ dhe Kartën e Pavarësisë Gjyqësore të Odës së Avokatëve të Australisë (KPGjOAA).⁵⁰⁷
3. Përveç parimeve dhe rregullave që sanksionojnë parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë si më sipër, në nivelin evropian rëndësi të veçantë kanë luajtur edhe sqarimet dhe rekomandimet e Komisionit të Venedikut. Kjo rëndësi ka qenë e jashtëzakonshme për vendet e lindjes ish komuniste. Lirisht mund të thuhet se sqarimet dhe rekomandimet e këtij Komisioni kanë shërbyer si një udhërrëfyes për punën e organeve gjyqësore nëpër këto vende, duke përfshirë këtu punën e gjykatave kushtetuese. Nuk ka arsye të jetë ndryshe në rastin e gjyqësisë kushtetuese të Kosovës, e cila modelohet tërësisht sipas standardeve të GjNDNJ dhe i merr seriozisht në punën e saj, përcaktimet e Komisionit të Venedikut.
4. Sipas Komisionit të Venedikut, pavarësia gjyqësore ka dy aspekte: aspektin objektiv, që është shprehje e kualitetit të pavarësisë institucionale të gjykatave përballë çdo ndikimi nga jashtë, dhe aspektin subjektiv, që është e drejta e secilit

⁵⁰² United Nations Congress on the Prevention of Crime and the Treatment of Offenders, ‘Basic Principles on the Independence of the Judiciary’, adopted on the Seventh United Nations Congress on the Prevention of Crime and the Treatment of Offenders held at Milan from 26 August to 6 September 1985 and endorsed by General Assembly resolutions 40/32 of 29 November 1985 and 40/146 of 13 December 1985.

⁵⁰³ The Bangalore Draft Code of Judicial Conduct (2001) adopted by the Judicial Group on Strengthening Judicial Integrity, as revised at the Roundtable Meeting of Chief Justices held at the Peace Palace, The Hague, November 25-26, 2002.

⁵⁰⁴ International Bar Association (1982) ‘Minimum Standards of Judicial Independence 1982’, available at: http://www.ibanet.org/About_the_IBA/IBA_resolutions.aspx.

⁵⁰⁵ Council of Europe (1994) ‘Recommendation of the Committee of Ministers to Member States on the Independence, Efficiency and Role of Judges’, No. R (94) 12, adopted by the Committee of Ministers, 13 October 1994 at the 518th meeting of the Ministers’ Deputies, available at: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.Cmd-BlobGet&InstranetImage=534553&SecMode=1&DocId=514386&Usage=2>.

⁵⁰⁶ Council of Europe, European Charter on the statute for judges and Explanatory Memorandum’, DAJ/DOC (98) 23, adopted on multilateral meeting on the statute for judges in Europe, organized by the Council of Europe, between 8-10 July 1998, available at: http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/greco/evaluations/round4/European-Charter-on-Statute-of-Judges_EN.pdf.

⁵⁰⁷ Australian Bar Association (2004) ‘Charter of Judicial Independence’, available at: http://www.austbar.asn.au/index.php?option=com_content&view=article&id=27:general-papers&catid=33&Itemid=42.

individ që të drejtat dhe liritë e tij të gjykojnë nga një gjykatës dhe gjykatë e pavarur. Prandaj, interpretimi i drejtë i ligjit dhe kushtetutës, dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në këtë proces, mund dhe duhet të bëhet vetëm nga gjykata të pavarura. E kundërta e kësaj do të ishte në kundërshtim me vet rolin e pushtetit gjyqësor. Kjo më tutje nënkupton se pavarësia gjyqësore nuk është *qëllim* në vetvete, por thjesht një instrument që mundëson që kushtetuta, ligji dhe në përgjithësi çdo normë juridike të interpretohet në mënyrë të drejtë.⁵⁰⁸ KPGjOAA e bën të qartë në Parimin nr. 7 që pavarësia e gjyqësorit mbrohet për interesin e publikut, dhe jo të gjyqtarëve. Për më tepër, në parimin 8, KPGjOAA proklamoi që pavarësia gjyqësore i shërben konfidencës së publikut të gjerë në pushtetin gjyqësor, dhe se pa pavarësi gjyqësore koncepti i shtetit të së drejtës do të shembej. Në tërësi, si e tillë, pavarësia gjyqësore e përcaktuar nga KPGjOAA në parimin 9, nënkupton që gjyqtarët dhe gjykatat mund të tejkalojnë kufijtë e neutralitetit, përgjegjësisë, dhe sjelljes që është etike dhe e përshtatshme.

5. Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut, në rastin *TFH van Rooyen*,⁵⁰⁹ e lidh pavarësinë gjyqësore me parimin e ndarjes së pushteteve, duke dhënë argumentin implicit që shkelja e pavarësisë gjyqësore është paralelisht edhe rrënim i parimit të ndarjes së pushteteve. Vlera 1 e PBUGj përcakton në anën tjetër se: “pavarësia gjyqësore është parakusht për shtetin e së drejtës dhe garanci bazike për gjykimin e drejtë. Një gjykatës duhet, prandaj, të mbajë dhe të shprehë pavarësinë gjyqësore në aspektin individual dhe institucional.” Në të njëjtin drejtim, sipas një analize logjike të PBPGjKB, pavarësia e gjyqësorit shprehet në dy rrafshë: a) pavarësia institucionale, dhe b) pavarësia individuale.

- Pavarësia institucionale e gjyqësorit -

PBPGjKB në parimin 1 përcakton që: “Pavarësia e Gjyqësorit duhet të garantohet nga Shteti dhe të jetë e inkuadruar në Kushtetutë apo në të drejtën e shtetit. Është obligim i të gjitha institucioneve shtetërore dhe të tjera që të respektojnë dhe vëzhgojnë pavarësinë e gjyqësorit”. Ky përcaktim i PBPGjKB shpreh anën institucionale të pavarësisë së gjyqësorit nga pushtetet tjera, duke kërkuar që pushteti gjyqësor të mos ketë asnjë lidhje strukturale, horizontale apo vertikale, me ndonjë strukturë tjetër të shtetit.⁵¹⁰ Për më tepër, PBPGjKB e bën të qartë që është obligim aktiv, dhe jo thjesht pasiv, i çdo institucioni shtetëror që të vëzhgojë dhe

⁵⁰⁸ European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) (2010) ‘Report on the Independence of the Judicial System Part I: The Independence of Judges’, adopted by the Venice Commission at its 82nd Plenary Session, Venice, 12-13 March 2010. CDL-AD(2010)004, paragraph 6.

⁵⁰⁹ Constitutional Court of South Africa, *TFH van Rooyen and Two Others v The State and Six Others*, Judgment, Case No 21/01.

⁵¹⁰ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Letonisë në rastin 04-07(99) theksoi se: Vendimi për zgjidhjen e një kontesti civil ndërmjet personave juridikë mund të merret vetëm nga gjykata dhe jo nga kabineti i ministrave, edhe nëse njëra nga palët në kontest është kompani (ndërmarrje) shtetërore e përfshirë në procesin e privatizimit nën mbikëqyrjen e Agjencisë Shtetërore të Privatizimit (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Letonisë 04-07(99), i datës 24.3.2000);

respektojë pavarësinë e gjyqësorit. Në këtë logjikë, pavarësia institucionale e gjyqësorit sipas këtij përcaktimi nuk është *gjendje* që duhet supozuar, por një situatë që kërkon mbikëqyrje të vazhdueshme. PBPGjKB në parimin 7 përcakton që është obligim i secilit shtet që të ofrojë burimet e mjaftueshme për të mundësuar që gjyqësori të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të *përshtatshme*. Obligimi për shtetet sipas Parimit 7 është i natyrës aktive, meqë obligon shtetet që të mos lejojnë që gjyqësori të përballlet me të ashtuquajturën dukuri e *pamjaftueshmërisë* si rezultat i mungesës së kushteve apo burimeve për të ushtruar funksionin e tij në mënyrë të rregullt. Nga një analizë logjike e PBPGjKB, del se pavarësia institucionale e gjyqësorit është shprehje e katër përcaktorëve: a) pavarësia në vendimmarrje, b) pavarësia administrative, c) pavarësia juridiksionale, dhe d) pavarësia financiare.

1. “Pavarësia në vendimmarrje” është një tregues shumë i rëndësishëm i pavarësisë së gjyqësorit. Parimi 4 i PBPGjKB përcakton se: “Nuk duhet të ketë asnjë ndërhyrje të pavend apo të pajustificuar në procesin gjyqësor, dhe nuk duhet që vendimet gjyqësore të gjykatave t’i nënshtrohen ndryshimit. Ky parim nuk paragjykon rishikimin gjyqësor, zbutjen apo zvogëlimin nga ana e autoriteteve kompetente të vendimeve të marra nga gjyqësori, në pajtim me ligjin”. Pra, pavarësia në vendimmarrje sipas parimit 4 të PBPGjKB, i cili proklamohet edhe nga R. 94(12) I(2)a(i), ka dy kuptime: një, që ndalohet ndikimi apo ndërhyrja nga një institucion apo faktor i jashtëm në proceset gjyqësore, përveç kur kërkohet nga vet gjykatat si pjesë e procedurës gjyqësore, dhe dy, që vendimet gjyqësore nuk mund të rishikohen, ndryshohen, vihen në dyshim apo korrigjohen nga institucione të jashtme (përveç sipas procedurës së paraparë të apelimit gjyqësor). Kjo gjithashtu përbën obligim pozitiv për institucionet tjera shtetërore që të zbatojnë vendimet gjyqësore, siç përcaktohet edhe nga parimi 7 i SMPGjONA, meqë refuzimi apo anashkalimi i vendimit gjyqësor do të konsiderohej tendencë për ndryshimin e tij faktik. Për më tepër, sipas SMPGjONA, gjyqësori duhet të jetë absolutisht i lirë të marrë pjesë në vëzhgimin e ekzekutimit të vendimeve të saj. Prandaj, pavarësia në vendimmarrje është një tregues aktiv i matjes së pavarësisë institucionale të gjyqësorit, që duhet të matet në secilin rast dhe nuk mund të supozohet.
2. “Pavarësia administrative” është përcaktori i dytë i pavarësisë institucionale të gjyqësorit. Kjo lidhet me të drejtën e pushtetit gjyqësor, sipas parimit 14 të PBPGjKB, që vendimi për caktimin e rasteve për gjykim tek gjyqtari/ja apo gjyqtarët e caktuar të jetë vetëm kompetencë e brendshme e saj,⁵¹¹ dhe të mos ketë ndonjë faktor të jashtëm që mund të ndikoj në këtë procedurë. Për më tepër, alokimi i rasteve tek gjyqtarët, sipas Komisionit të Venedikut, duhet të bëhet në bazë të kriterëve objektive, dhe zakonisht nuk duhet të lihet në dorën e kryetarit të gjykatës.⁵¹² Përveç kësaj, siç përcaktohet edhe me parimin 8 të SMPGjONA,

⁵¹¹ Si shembull krahasues nga jurisprudenca Polake, termi “administrim i drejtësisë” duhet të kuptohet objektivisht si një proces i zgjidhjes së konflikteve ligjore, jo subjektivisht si kompetencë vetëm e gjykatave (Vendim i Tribunalit Kushtetues të Polonisë K41/97 i datës 8.12.1998);

⁵¹² European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the

pavarësia administrative lidhet edhe me të drejtën e gjykatave që të jenë në udhëheqje të plotë dhe të pakufizuar, përveç nëse është e përcaktuar me ligj, të administratës së saj, jashtë ndikimit të pushteteve tjera.

3. “Pavarësia juridiksionale” lidhet me autoritetin e gjykatave për të mos u ndikuar, penguar apo detyruar në të drejtën e tyre për t’u deklaruar nëse kanë apo jo juridiksion për të gjykuar një çështje të caktuar, dhe në autoritetin e tyre ekskluziv për të gjykuar çështje gjyqësore, duke ndaluar që ndonjë institucion tjetër të vendos mbi çështje të kësaj natyre. Parimi 3 i PBPGjKB përcakton se: “Gjyqësori ka juridiksion mbi të gjitha çështjet të natyrës gjyqësore dhe do të ketë autoritet ekskluziv për të vendosur nëse një çështje e ngritur para saj është brenda kompetencave të saj të vendosura me ligj.” Në përgjithësi, pavarësia juridiksionale i jep të drejtë ekskluzive gjyqësorit që të ushtrojë funksionin gjyqësor të shtetit, dhe ndalon të tjerët që t’i okupojnë gjyqësorit ndonjë kompetencë të tij. Në anën tjetër, pavarësia juridiksionale, siç përcaktohet edhe nga R. 94(12) [I.2.a.iii], ndalon që ndonjë institucion të ndërhyjë në përcaktimin nëse një gjykatë është apo jo kompetente për të gjykuar një çështje të caktuar - qoftë në kuptimin e pohimit qoftë të mohimit të kompetencës - duke i dhënë të drejtë ekskluzive gjykatave që ato të vendosin nëse kanë apo jo juridiksion për të gjykuar një çështje të caktuar. Pavarësia juridiksionale, prandaj, bën të mundur që demarkimi i juridiksionit të gjykatave sipas kufijve të vënë nga Kushtetuta dhe ligjet të vlerësohet dhe interpretohet nga *vet* gjyqësori.
4. “Pavarësia financiare” lidhet me detyrimin e shtetit, siç përcaktohet me Parimin 7 të PBPGjKB dhe Parimin 10 të SMPGjONA, për t’i dhënë gjyqësorit burime të mjaftueshme financiare për të ushtruar funksionin e vet në mënyrë të përshtatshme. Ky parim nënkupton që dy pushtetet tjera nuk mund të kufizojnë apo të zvogëlojnë shpenzimet financiare të gjyqësorit, pavarësisht që mund t’i auditojnë ato, si dhe që gjyqësori të vendos vet në mënyrë të pavarur për administrimin e financave të veta, sipas ligjeve përkatëse. Pavarësia financiare është përcaktor themelor i pavarësisë së pushtetit gjyqësor, meqë pamundësia e gjyqësorit për të ushtruar funksionin e saj për shkak të mungesës së burimeve financiare mund ta bëjë atë të varur për dy pushtetet tjera, si dhe t’ia zvogëlojë aftësinë e saj administrative për të ushtruar detyrat gjyqësore.

- Pavarësia individuale e gjyqësorit -

1. Përveç pavarësisë institucionale, që shpreh pavarësinë strukturore të gjykatave, pavarësia individuale e gjyqësorit është rrafshi i dytë nga ku sendërtohet pavarësia

Compatibility with Constitutional Principles and the Rule of Law of Actions Taken by the Government and the Parliament of Romania in Respect of Other State Institutions and on the Government Emergency Ordinance on Amendment to the Law No. 47/1992 regarding the Organisation and Functioning of the Constitutional Court and on the Government Emergency Ordinance on amending and completing the Law No. 3/2000 regarding the Organisation of a Referendum of Romania’, No. 685/2012, adopted by the Venice Commission at its 93rd Plenary Session, Venice, December 2012. CDL-AD(2012)026, paragraph 70.7.

e pushtetit gjyqësor. Pavarësia individuale është shprehje e pavarësisë së gjykatësve në kryerjen e funksionin të tyre gjyqësor. Kjo, në përgjithësi, nënkupton që gjykatësit duhet të jenë meritore, objektiv, neutral dhe të liruar nga çdo ndjenjë e ndikimit kur ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor. Pavarësia individuale, thënë shkurtimisht, duhet shprehur jo vetëm përballë ndikimeve të jashtme që mund të kenë gjyqtarët, por edhe përballë ndikimeve nga brenda vet pushtetit gjyqësor, apo edhe nga ndikimet subjektive të vet gjyqtarit. PBUGj⁵¹³ japin një tërësi standardesh që përcaktojnë më detajisht çështjen e pavarësisë individuale të gjyqtarëve,⁵¹⁴ të cilat standarde përbëjnë burime kushtetuese zakonore për shtetet demokratike, dhe të cilat në fakt kanë karakterin e zakoneve ndërkombëtare.

2. Sipas PBUGj, janë gjashtë vlera që shprehin standarde substanciale mbi pavarësinë individuale të gjyqtarëve: a) *pavarësia e gjyqtarëve*, e shprehur si ushtrim i pavarur i profesionit gjyqësor në bazë të vlerësimit individual të fakteve dhe ndërgjegjes. Gjyqtari duhet të jetë i pavarur si përballë shoqërisë, ashtu edhe përballë palëve në gjykim. Për më tepër, gjyqtari nuk duhet të jetë vetëm i pandikuar dhe i liruar nga ekzekutivi dhe legjislativi, por duhet të jetë edhe vëzhgues i lirisë së tij përballë tyre. Gjithashtu, gjyqtari duhet të jetë plotësisht i liruar nga ndikimet e kolegëve të tij, dhe duhet të kujdeset që pavarësia e gjykatës ku ai ushtron detyrën e tij të vëzhgohet nga ai në mënyrë të vazhdueshme. Pavarësia e gjyqtarit duhet të mbështetet edhe në arsyetimin e arsyeshem të vendimeve të tij, meqë kjo do të rrit konfidencën e publikut mbi gjyqësorin dhe punën e gjyqtarëve.⁵¹⁵ b) *paanshmëria*, e shprehur si një administrim i duhur i detyrës gjyqësore nga ana e gjyqtarëve gjatë marrjes së vendimeve. Kjo nënkupton që gjyqtari duhet të marrë vendimet e tij pa anësi, favorizim apo supozim mbi ndonjë palë.⁵¹⁶ Sipas kësaj, gjyqtari duhet të kujdeset që vendimet e tij të rrisin konfidencën e publikut, të palëve dhe të profesionistëve ligjor në gjyqësor. Për më tepër, gjyqtarët duhet të minimizojnë prodhimin e rrethanave që i bëjnë ata të përjashtuar nga gjykimi i çështjeve të

⁵¹³ The Bangalore Draft Code of Judicial Conduct (2001) adopted by the Judicial Group on Strengthening Judicial Integrity, as revised at the Roundtable Meeting of Chief Justices held at the Peace Palace, The Hague, November 25-26, 2002.

⁵¹⁴ Si shembull krahasues nga jurisprudenca çeke, një rregullore që lejon emërime të përkohshme të gjyqtarëve për te kryer punë në Ministrinë e Drejtësisë është kundërkushtetuese, sikur që është edhe rregullorja që nuk përmban mënyra për mbrojtjen e zyrtarëve gjyqësorë nga largimi i përkohshëm prej detyrës nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, dhe rregullorja që i lejon Presidentit të Republikës të caktojë numrin e zëvendës-kryetarëve të Gjykatës Supreme (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke Pl. US 39/08 i datës 6.10.2010);

⁵¹⁵ The Bangalore Draft Code of Judicial Conduct (2001) adopted by the Judicial Group on Strengthening Judicial Integrity, as revised at the Roundtable Meeting of Chief Justices held at the Peace Palace, The Hague, November 25-26, 2002, Vlera 1, paragrafet 1-6.

⁵¹⁶ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Lituaniës në vendimin 39/06 theksoi se në disa raste, ndarja e drejtësisë nuk varet vetëm nga materialet që i ofrohen gjykatës, dhe gjyqtarët do të duhet të ndërmarrin disa veprime, siç është mbledhja e provave të munguara, për t'i hulumtuar rrethanat e rastit në mënyrë të hollësishme dhe objektive, dhe të vijë deri te e vërteta. Me ndërmarrjen e aktivitetëve të tilla, gjykata duhet të veprojë në atë mënyrë që të mos ofrojë mundësi për t'u akuzuar për anshmëri apo ndikim (Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Lituaniës 39/06 i datës 28 maj2008);

caktuara.⁵¹⁷ Kjo i detyron gjyqtarët që të mos komentojnë apo publikojnë ndonjë ide, fakt ose mendim që mund të ndikojë në vendimin që ata do marrin në ndonjë çështje specifike përballë gjykatës. Për më tepër, gjyqtarët duhet të vetë-përrjashtohen nga gjykimet në të cilat ata kanë konflikt interesi me vet objektin e gjykimit;⁵¹⁸ c) *integriteti*, e shprehur si sjellje e gjykatësit si një lojtar që qëndron mbi kufirin e qortimit nga një vëzhgues racional. Kjo e detyron gjykatësin që të bind publikun përmes vendimeve të tij që gjykata ka integritet, dhe në të njëjtën kohë kërkon nga gjykatësit që integriteti i çështjeve që gjykohen duhen parë dhe jo thjesht vendosur.⁵¹⁹ Në rastin e shteteve multietnike, siç është argumentuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut, në *TFH van Rooyen*,⁵²⁰ duhet pasur parasysh diversitetin shoqëror në aspektin etnik për t'u vlerësuar nëse sjellja e gjyqtarëve është brenda kufijve të pranueshmërisë nga një vëzhgues i arsyeshëm. c) *drejtësia*, si shprehje e drejtshmërisë së sjelljes së gjykatësit në punën e tij. Gjyqtarët duhet të kujdesen që vendimet e tyre të duken të drejta në sytë e publikut, gjë që kërkon, ndër të tjera, që gjyqtarët të kufizojnë sjelljet e tyre personale, për t'i lënë publikut shijen e drejtësisë në vendimet e tyre. Gjykatësit duhet të mos ndërtojnë marrëdhënie personale me palët në gjykim, dhe me bartësit e profesionit ligjor, duke shmangur çfarëdo favorizimi ndaj kujtdo. Gjyqtarët gjithashtu duhet të jenë të liruar nga ndonjë konflikt interesi financiar, qoftë edhe të familjarëve të tyre, dhe duhet të ndërtojnë marrëdhënie thjesht zyrtare me çdo person, përfshirë edhe kolegët e tyre;⁵²¹ d) *barazia*, si shprehje e trajtimit të barabartë të të gjitha palëve para gjykatës. Kjo i detyron gjykatësit që të kenë respekt për shprehjet e të tjerëve, dhe të mos diskriminojnë njerëz apo grupe mbi çfarëdo baze shoqërore.⁵²² Kjo gjithashtu nënkupton që gjyqtarët duhet t'i trajtojnë njëjtë palët, kolegët e tyre, avokatët, dhe çdo person tjetër që merr pjesë ne

⁵¹⁷ Si shembull krahasues nga jurisprudenca kroate, Këshilli Shtetëror Gjyqësor vendos vet lidhur me kërkesën për përjashtimin e kryetarit të saj dhe/apo anëtarëve në procedurë disiplinore të udhëhequra kundër një kryetari të një gjykate apo ndonjë gjyqtari. Refuzimi për një përjashtim të tillë, me arsyetimin se është inkompetent për një vendim të tillë, në rastet e procedurave disiplinore para Këshillit Shtetëror Gjyqësor nënkupton pranimin e gjyqtarëve të anshëm, që përbën shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (Vendim i Gjykatës kushtetuese të Kroacisë U-IV-947/1996 i datës 8.janar 1997);

⁵¹⁸ The Bangalore Draft Code of Judicial Conduct (2001) adopted by the Judicial Group on Strengthening Judicial Integrity, as revised at the Roundtable Meeting of Chief Justices held at the Peace Palace, The Hague, November 25-26, 2002, Vlera 2, paragrafët 1-5.

⁵¹⁹ The Bangalore Draft Code of Judicial Conduct (2001) adopted by the Judicial Group on Strengthening Judicial Integrity, as revised at the Roundtable Meeting of Chief Justices held at the Peace Palace, The Hague, November 25-26, 2002, Vlera 3, paragrafët 1-2.

⁵²⁰ Constitutional Court of South Africa, *TFH van Rooyen and Two Others v The State and Six Others*, Judgment, Case No 21/01.

⁵²¹ The Bangalore Draft Code of Judicial Conduct (2001) adopted by the Judicial Group on Strengthening Judicial Integrity, as revised at the Roundtable Meeting of Chief Justices held at the Peace Palace, The Hague, November 25-26, 2002, Vlera 4, paragrafët 1-16.

⁵²² Si shembull krahasues, në rastet kur gjykatat e rregullta nuk i kanë caktuar palëve mbrojtje të të drejtave fundamentale dhe lirive themelore, përkundër faktit që Gjykata Kushtetuese tanimë i ka njohur të drejtën për mbrojtje palëve në raste faktikisht analoge, duhet të shikohet si shkelje e parimit të barazisë para ligjit (Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke III. US 206/98 I datës 09.07.1998);

procesin gjyqësor;⁵²³ e) *përgjegjësia dhe zelli*, si shprehje të përparësisë ndaj profesionit gjyqësor që duhet të shpreh gjykatësi, duke provuar që çdo aktivitet tjetër nuk mund t'i konkurroj detyrës së tij gjyqësore. Ky standard përcakton që gjyqtarët, gjithashtu, duhet të jenë të kujdesshëm që të ngrisin njohuritë e tyre profesionale gjatë tërë kohës, dhe të ushtrojnë detyrën e tyre me zell dhe vetëpërmbytje.⁵²⁴

3. Përveç kësaj, Komisioni i Venedikut e ka bërë të qartë që pavarësia individuale e gjyqtarëve nënkupton që gjyqtarët e gjykatave më të ulëta nuk mund t'i nënshtrohen urdhrave të gjykatave të larta, dhe se duhet të ndihen të pavarur ndaj gjyqtarëve më të lartë. Natyrisht, gjykatat e larta kanë fuqinë e rishikimit të vendimeve të gjykatave më të ulëta,⁵²⁵ por nuk mund të marrin rol influencues mbi gjykatësit më të ulët, meqë kjo do të përkthehej në varësinë e gjyqtarëve të ulët ndaj gjyqtarëve më të lartë.⁵²⁶
4. Pavarësia individuale e gjyqtarëve varet nga disa faktor, siç janë: a) emërimi i gjyqtarëve, b) kohëzgjatja e mandatit të tyre, c) promovimi i gjyqtarëve, c) rregullat dhe mekanizmat për disiplinimin e gjyqtarëve, d) lartësinë dhe sigurinë e pagave të tyre, dhe e) lirinë e shprehjes dhe bashkimit.
5. Emërimi i gjyqtarëve duhet të bëhet në bazë të standardeve të caktuara ndërkombëtare, meqë është përcaktor i fuqishëm i pavarësisë individuale të gjyqtarëve. Modelet e emërimit që lejojnë ndikime nga jashtë, ose që mundësojnë që personat e paafte ose të padenjë për pozitën e gjyqtarit të mund të emërohen gjyqtarë janë rrugë që mundësojnë rrezikimin e pavarësisë individuale të gjyqtarëve. Parimi 10 i PBPGjKB përcakton se: “Personat e zgjedhur që të punojnë në pushtetin gjyqësor duhet të jenë individë me integritet dhe aftësi e kualifikime të përshtatshme në fushën e profesionit ligjor. Çfarëdo metode e zgjedhjes së

⁵²³ The Bangalore Draft Code of Judicial Conduct (2001) adopted by the Judicial Group on Strengthening Judicial Integrity, as revised at the Roundtable Meeting of Chief Justices held at the Peace Palace, The Hague, November 25-26, 2002, Vlera 5, paragrafët 1-5.

⁵²⁴ The Bangalore Draft Code of Judicial Conduct (2001) adopted by the Judicial Group on Strengthening Judicial Integrity, as revised at the Roundtable Meeting of Chief Justices held at the Peace Palace, The Hague, November 25-26, 2002, Vlera 6, paragrafët 1-7.

⁵²⁵ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Republikës Çeke në vendimin e saj IV. US 613/06 theksoi se jurisprudenca/praktika gjyqësore (case-law) vazhdimisht zhvillohet dhe gjithmonë ka mundësi që të plotësohet nga konkludime interpretative, madje edhe të ndryshojë plotësisht praktikën paraprake. Ndryshimet në praktikën vendim-marrëse gjyqësore nuk janë të dëshirueshme, posaçërisht në gjykata më të larta, të cilat janë të autorizuar të unifikojnë praktikën gjyqësore të gjykatave më të ulta, për të shmangur shkeljen e parimit të sundimit të ligjit, apo parimin e parashikueshmërisë së vendim-marrjes gjyqësore (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke IV. US 61306 i datës 8.4.2007);

⁵²⁶ Shih: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the draft constitution of the Nakhichevan Autonomous Republic (Azerbaijan Republic)’, approved by the Commission at its 33rd Plenary Meeting, Venice, December 1997.CDL-INF (97) 6, p.6.

gjqqtarëve duhet të mbrohet nga zgjedhjet me motive të padrejta. Gjatë zgjedhjes së gjykatësve, nuk duhet të ketë diskriminim kundër një kandidati mbi bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, religjionit, opinioneve politike apo të tjera, origjinës kombëtare apo sociale, pasurisë, lindjes apo statusit, përjashtuar nga kjo kërkesën që mund të përcaktohet që kandidati të jetë shtetas i shtetit ku do të ushtrohet detyra.” PBPGjKB, prandaj, vendos tri standarde sa i përket emërimit të gjyqtarëve: a) që gjyqtarët të jenë persona me integritet dhe të aftë profesionalisht në fushën gjyqësore, në mënyrë që të mund të ushtrojnë detyrën e tyre denjësisht, b) që procesi i emërimit të gjyqtarëve të jetë i mbrojtur nga motivet e padrejta, qofshin ato politike, pasurore, shoqërore, etj., në mënyrë që mekanizmi i emërimit të gjyqtarëve të garantojë që vetëm personat meritore për të ushtruar këtë detyrë mund të marrin postin e gjyqtarit, dhe c) që zgjedhja e gjyqtarëve të bëhet jashtë çdo diskriminimi, si mënyrë për të garantuar që gjyqtarët të ushtrojnë profesionin e tyre të liruar nga prejardhja e tyre, klasa, statusi social, etj.

6. Sipas SMPGjONA-s, siç përcaktohet në parimin 1, pavarësia individuale e gjyqtarëve është e dylojshme: a) e shprehur si pavarësi personale, e cila nënkupton që “termat dhe kushtet e shërbimit në gjyqësor janë të siguruara në mënyrë adekuate në mënyrë që gjyqtarët individual të mos jenë subjekt i kontrollit nga ekzekutivi”, dhe b) e shprehur si pavarësi substanciale, e cila nënkupton që “në kryerjen e funksionit të tij/saj gjyqësor gjykatësi nuk është subjekt i asgjëje pos ligjit dhe direktivave të ndërgjegjes së tij/saj personale.”
7. Sipas GjEDNj, pavarësia individuale është përcaktor i respektit për të drejtën e njeriut për një gjykim të drejtë dhe të ndershëm. Në rastin *Incal v. Turkey*, GjEDNj ka përcaktuar që: “Për të përcaktuar nëse një gjykatë mund të konsiderohet e pavarur në bazë të nenit 6 (1) të KEDNj, duhet t’i kushtohet vëmendje, ndër të tjera edhe çështjes së emërimit dhe kohëzgjatjes së mandatit të tij...”⁵²⁷ Për më tepër, në *Lanko v. Slovakia*,⁵²⁸ GjEDNj përcaktoi që gjykimi i një çështjeje nga një autoritet që zgjidhet nga qeveria e shtetit, konsiderohej shkelje e së drejtës së njeriut që të dëgjohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. *Lanko v. Slovakia* është shpjegim që GjEDNj-a ka vendosur standardin që thotë se zgjedhja e gjyqtarëve nga një institucion qeveritar përbën shkelje të pavarësisë së gjyqtarëve dhe, për pasojë, është rrjedhimisht shkelje e së drejtës për gjykim të drejtë. Sipas kësaj pikëpamjeje, ndërhyrja në zgjedhjen e gjyqtarëve nga autoritetet politike, sipas GjEDNj-s, përbën paralelisht edhe shkelje të së drejtës së palëve në gjykim të drejtë që gjykohen nga gjykatësit e tillë.
8. Në vijim për sa më sipër, KPGjOAA⁵²⁹ vendos një numër standardesh eksplicite sa i përket emërimit të gjyqtarëve, që shërbejnë si rregulla ndërkombëtare për shumë

⁵²⁷ GjEDNj, *Incal v. Turkey*, 9 June 1998, Judgment, Reports 1998-IV, f.1571, paragraph 65.

⁵²⁸ GjEDNj, *Lanko v. Slovakia*, 2 September 1998, Judgement, Reports 1998-VI, f. 2497-2498, para. 12-17.

⁵²⁹ Australian Bar Association (2004) ‘Charter of Judicial Independence’, available at: http://www.austbar.asn.au/index.php?option=com_content&view=article&id=27:general-papers&catid=33&Itemid=42.

sisteme kushtetuese moderne. KPGjOAA përcakton që emërimi i gjyqtarëve duhet bërë duke pasur konsiderim të lartë për cilësinë meritore dhe përshtatshmërinë e tyre për pozitën gjyqësore.⁵³⁰ Në përputhje me këto standarde, procedurat e emërimit të gjyqtarëve duhen përcaktuar në mënyrë të detajuar dhe duhen të jenë të formalizuara.⁵³¹ Mbi të gjitha, procesi i emërimit të gjyqtarëve duhet bërë publik në çdo rast.⁵³² Gjithashtu, KPGjOAA e bën të qartë që asgjë nuk duhet të lejohet në procesin e emërimit që do të sillte ndjenjën e arsyeshme që kandidati për gjyqtar është në mënyrë të vazhdueshme në përgjegjësi ndaj qeverisë apo institucionit që e zgjedh.⁵³³ Pas emërimit, gjyqtarët duhet të lihen të qëndrojnë në detyrë derisa përcaktimi ligjor mbi pensionimin të arrihet, të paktën pas moshës 65 vjeçare.⁵³⁴ Për më tepër, procesi i shkarkimit të gjyqtarëve duhet të jetë i përcaktuar me standarde të qarta, dhe nuk duhet lejuar në asnjë mënyrë që të dëmtojë konfidencën e publikut në pushtetin gjyqësor.⁵³⁵ Në këtë aspekt, nuk duhet lejuar që shkarkimi të ndodh para se të jetë nxjerrë një raport preliminar mbi arsyet e bazuara për shkarkimin në fjalë.⁵³⁶

9. SMPGjONA, në nenin 20, vendos edhe një standard tjetër ndërkombëtar sa i përket relacionit në mes të legjislaturës dhe gjyqtarëve. Ajo përcakton që parlamenti nuk mund të ndryshojë me një ligj të caktuar statusin e gjyqtarëve aktual, përveç nëse kjo është në favorin e vet gjyqtarëve. Gjithashtu, SMPGjONA përcakton që riorganizimi i gjykatave përmes ligjeve të parlamentit nuk mund të bëjë transferime të gjyqtarëve pos në gjykata të të njëjtit status ku në momentin e kalimit të legjislationit gjyqtarët e caktuar shërbejnë. Këto dy standarde ndërkombëtare ofrojnë siguri që gjyqtarët nuk mund të afektohen nga ligjet e parlamentit sa i përket postit të tyre, si mënyrë për të ndikuar në pavarësinë e tyre individuale.

⁵³⁰ Australian Bar Association (2004) 'Charter of Judicial Independence', available at: http://www.austbar.asn.au/index.php?option=com_content&view=article&id=27:general-papers&catid=33&Itemid=42, paragraph 10.

⁵³¹ Australian Bar Association (2004) 'Charter of Judicial Independence', available at: http://www.austbar.asn.au/index.php?option=com_content&view=article&id=27:general-papers&catid=33&Itemid=42, paragraph 11.

⁵³² Australian Bar Association (2004) 'Charter of Judicial Independence', available at: http://www.austbar.asn.au/index.php?option=com_content&view=article&id=27:general-papers&catid=33&Itemid=42, paragraph 12.

⁵³³ Australian Bar Association (2004) 'Charter of Judicial Independence', available at: http://www.austbar.asn.au/index.php?option=com_content&view=article&id=27:general-papers&catid=33&Itemid=42, paragraph 13.

⁵³⁴ Australian Bar Association (2004) 'Charter of Judicial Independence', available at: http://www.austbar.asn.au/index.php?option=com_content&view=article&id=27:general-papers&catid=33&Itemid=42, paragraph 16.

⁵³⁵ Australian Bar Association (2004) 'Charter of Judicial Independence', available at: http://www.austbar.asn.au/index.php?option=com_content&view=article&id=27:general-papers&catid=33&Itemid=42, paragraph 17.

⁵³⁶ Australian Bar Association (2004) 'Charter of Judicial Independence', available at: http://www.austbar.asn.au/index.php?option=com_content&view=article&id=27:general-papers&catid=33&Itemid=42, paragraph 18.

10. Kohëzgjatja e mandatit të gjyqtarëve është segment themelor i pavarësisë individuale të tyre, meqë një mandat i shkurtër mund ta bëjë gjyqtarin të varur nga institucionet që e zgjedhin atë, dhe si rezultat edhe favorizues ndaj interesave të tyre. E njëjtë është çështja edhe me lartësinë e pagës së gjyqtarëve. Parimi 11 i PBPGjKB përcakton se: “Kohëzgjatja e postit të gjykatësve, pavarësia e tyre, siguria, pagesa adekuate, kushtet e shërbimit, pensionet dhe mosha e pensionit duhet të sigurohen në mënyrë të përshtatshme me ligj.” Për më tepër, në parimin 12, PBPGjKB përcakton se: “Gjykatësit, të zgjedhur apo të emëruar, duhet të kenë të garantuar mbajtjen e postit deri në një moshë të caktuar për pensionim apo kalimin e afatit të mandatit të tyre kur ekziston një i tillë.” SMPGjONA, në nenin 22, kërkon që mandati i gjyqtarëve të jetë i përjetshëm, dhe të mos mund të shkëputet përveç në raste të caktuara, meqë kjo do të mundësonte që gjyqtari të mos ishte i varur ndaj kërkesës për riemërim. I njëjtë është edhe propozimi i Këshillit Konsultativ të Gjykatësve Evropian (KKGjE) i propozuar në faqen 48 të Opinionit 1. Për më tepër, në nenin 23, SMPGjONA kërkon që të mos lejohen praktikatat e mandateve provuese për gjyqtar,⁵³⁷ dhe të ndalohen praktikatat e emërimit të gjyqtarëve të përkohshëm. Gjithashtu, SMPGjONA në nenin 25 kërkon që nëse sistemi gjyqësor mundëson emërimin e gjyqtarëve me gjysmë orari pune, kjo të bëhet me një kontroll të veçantë.

Çështja e pamundësisë së shkarkimit të gjyqtarit është e rëndësishme primare për pavarësinë e tyre, siç përcaktohet edhe nga KKGjE në faqen 60 në Opinionin 1. Për më tepër, Komisioni i Venedikut kërkon që çështja e pamundësisë së shkarkimit të gjyqtarëve të përcaktohet shprehimisht me kushtetutë. Në anën tjetër, KESGj, në parimin 7, përcakton shprehimisht bazat se kur mund të përfundojë mandati i një gjykatësi, që janë: a) sipas dorëheqjes, b) sipas një certifikate mjekësore apo paaftësie fizike, c) mbërritjen e moshës së caktuar, d) skadimin e afatit të mandatit, e) në mënyrë strikte, në rastet kur për gjyqtari është subjekt i procedurës së disiplinimit nga një organ i pavarur rregullator i gjyqësisë, vendimi i të cilit për shkarkim duhet të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, dhe duhet të ketë mundësi që të ankimohet tek një organ i lartë gjyqësor (shih edhe Nenin 27 të SMPGjONA). Në R. 94(12), në pikën VI.2, të Këshillit të Evropës, përcaktohet edhe një rrethanë mbi të cilën mund të shkarkohet gjykatësi: në rastin kur kryen një vepër penale. Jashtë këtyre shkaqeve, përfundimi i mandatit të gjyqtarit do të konsiderohej jashtë standardeve ndërkombëtare.

11. Sa i përket pagës së gjyqtarëve, KKGjE në Opinionin 1⁵³⁸ përcakton se “duhet bërë dispozita juridike të veçanta që garantojnë që rrogat e gjykatësve nuk mund të reduktohen, dhe të garantohet që të paktën *de facto* rritja e rrogave të gjyqtarëve të

⁵³⁷ Edhe sipas Komisionit të Venedikut kjo është pikë problematike, dhe duhet të kufizohet në maksimum, meqë e bën gjyqtarin të varur në vendimet e tij ndaj organit që do ta rizgjedh. Shih: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Judicial Appointments’, No. 403/2006, adopted by the Venice Commission at its 70th Plenary Session Venice, March 2007. CDL-AD(2007)028, paragraph 40.

⁵³⁸ European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Judicial Appointments’, Opinion No. 403/2006, adopted by the Venice Commission at its 70th Plenary Session Venice, March 2007. CDL-AD(2007)028, paragraph 62.

bëhet në proporcion të drejtë me rritjen e kostos së jetesës”. Për më tepër, KKGJë në Opinionin 2 (paragrafi 5), përcakton se buxhetet e gjykatave nuk mund të jenë pjesë e lëvizjeve politike, dhe që asnjë institucion nuk mund të bëjë presion mbi gjykata kur ato të përcaktojnë buxhetin që e kërkojnë prej shtetit.⁵³⁹ Çështja e sigurisë në lartësinë e rrogave për gjyqtarët është garancion që ata të mos mund të joshen nga jashtë apo të afektohen nga pasiguria për pagën e tyre, gjë e cila do të bënte që gjyqtarët të ishin subjekt i pasigurisë private financiare përballë funksionit të tyre gjyqësor. Gjykata Supreme e Kanadasë, në rastin *Manitoba Prov. Judges Assn. v. Manitoba*,⁵⁴⁰ kishte gjykuar që zvogëlimi i pagave të gjyqtarëve është një ndikim në pavarësinë e tyre, dhe përbën në anën tjetër një shkak të mjaftueshëm që gjyqtarët në mënyrë të arsyeshme të ndjehen të penalizuar nga qeveria. Në këtë kuptim, Gjykata Supreme e Kanadasë ndoqi argumentimin që zvogëlimi i pagave të gjyqtarëve është sulm në pavarësinë e tyre, dhe se ky sulm përbën shkelje themelore të lirisë së gjyqtarëve që të ndihen arsyeshëm të shkëputur nga pushtetet tjera, apo edhe skemat politike të ndikimit.⁵⁴¹ I njëjti argumentim është shfrytëzuar edhe nga Gjykata Kushtetuese e Afrikës së Jugut në rastin *TFH van Rooyen*.⁵⁴²

12. “Paanshmëria e pushtetit gjyqësor” është një parim i lidhur ngushtë me pavarësinë e pushtetit gjyqësor, siç është argumentuar nga GjEDNj në *Findlay v. the United Kingdom*.⁵⁴³ Megjithëse shumë nga aspektet e paanshmërisë janë komentuar më lartë në kuptim të pavarësisë individuale të gjyqtarit, në këtë pjesë shpjegohen disa nga standardet ndërkombëtare të paanshmërisë së gjyqësorit. Parimi 2-të i PBPGjKB përcakton shprehimisht që: “Gjyqësori duhet të vendos lidhur me çështjet para tij në mënyrë të paanshme, duke u bazuar në fakte dhe në pajtim me ligjin, pa asnjë kufizim, ndikim të papërshtatshëm, pa nxitje, presione, kërcënime apo ndërhyrje direkte apo jodirekte nga ndonjë drejtim apo me ndonjë arsye.” Këshilli i Evropës, përmes R. 94(12) I(2)d, ka përcaktuar që në procesin e vendosjes gjyqësore, gjyqtarët duhet të ndihen të pavarur, dhe të liruar nga çfarëdo presioni i jashtëm, kërcënimi, ndikimi direkt apo indirekt, për çfarëdo arsye dhe mbi çfarëdo baze. Në këtë aspekt, në R. 94(12) I(2)d përcaktohet që legjislacioni duhet të parashoh dënime për subjektet që tentojnë të influencojnë paanshmërinë e gjyqtarëve, dhe argumentohet që gjyqtarët duhet të ndihen të lirë që të vendosin

⁵³⁹ Si shembull krahasues, gjyqësori disponon me buxhetin e vet, prandaj Ministri i Drejtësisë nuk ka të drejtë të menaxhojë me asnjë pjesë të tij (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë 01/99 i datës 14.1.1999);

⁵⁴⁰ Canadian Supreme Court, *Manitoba Prov. Judges Assn. v. Manitoba (Minister of Judges)*, Judgement, 1997.

⁵⁴¹ Si shembull krahasues, një arsye më tepër se pse gjyqësori nuk duhet të varet në pushtetet tjera është fakti se është i vetmi pushtet që formohet në bazë profesionale e jo politike. Vetëm kur gjyqësori të jetë i pavarur nga pushtetet tjera, mund ta ushtrojë funksionin e tij të vertetë, administrimin e drejtësisë (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituaniës Nr. 16/98 I datës 21.12.1999);

⁵⁴² Constitutional Court of South Africa, *TFH van Rooyen and Two Others v The State and Six Others*, Judgment, Case No 21/01.

⁵⁴³ ECtHR, *Findlay v. the United Kingdom*, 25 February 1997, Judgment, *Reports of Judgments and Decisions 1997-I*, p. 281, § 73.

për rastet e tyre dhe nuk duhet të kenë asnjë përgjegjësi për t'i raportuar ndonjë subjektin të jashtëm në lidhje me arsyet e vendosjes për rastet konkrete.

13. Gjykata Supreme e Kanadasë ka dhënë një shpjegim në lidhje me paanshmërinë e gjyqësorit. Në rastin *Valiente v. The Queen*,⁵⁴⁴ Gjykata Supreme e Kanadasë përcaktoi se paanshmëria është “një gjendje shpirtërore apo qëndrim i gjykatës përballë çështjes dhe palëve të përfshira në një rast të veçantë.” GjEDNJ-a në disa nga rastet e saj ka gjykuar edhe çështjen e paanshmërisë së gjyqësorit në kuptim të nenin 6.1 të KEDNJ, duke dhënë argumentin që konstatimi i paanshmërisë së një gjykate në rastin konkret është shkelje e nenit në fjalë. Në rastin *Daktaras v. Lituania*,⁵⁴⁵ GjEDNJ-a ka argumentuar që paanshmëria e gjyqësorit duhet shikuar në dy aspekte, në aspektin subjektiv dhe atë objektiv. Aspekti subjektiv i paanshmërisë shprehet me kërkesën që gjyqtarët të jenë të lirë nga vlerësimet e tyre subjektive kur gjykojnë çështje të caktuara, dhe të vlerësojnë vetëm të bazë të arsyes. Kurse aspektin objektiv të paanshmërisë, GjEDNJ-a e lidh me ndalimin që gjykata të jetë e ndikuar apo e lidhur me ndonjë rrethanë apo fakt objektiv gjatë procesit të gjykuarit. Komiteti për të Drejta të Njeriut i KB, në rastin *Arvo O. Karttunen*,⁵⁴⁶ ka dhënë gjithashtu një përcaktim sa i përket paanshmërisë së gjyqësorit, duke argumentuar që gjyqtarët nuk duhet të paragjykojnë asgjë në lidhje me çështjet që paraqiten para tyre, dhe se nuk mund të përkrahin interesat e ndonjërisë palë në gjykim.
14. Paanshmëria subjektive është pra përcaktor i neutralitetit në qëndrimin e gjyqtarit përballë mendimeve apo arsyeve subjektive të tij, përderisa gjyqtari nuk lejohet të paragjykojë apo anoj nga qëndrimet e njërit apo të palës tjetër. GjEDNJ-a, në rastin *Klein et al v. The Netherlands*,⁵⁴⁷ ka përcaktuar që paanshmëria subjektive e gjyqtarëve të një paneli duhet të konstatohet individualisht. Në rastin *Remli v. France*,⁵⁴⁸ GjEDNJ-a konstatoi se gjyqtari i një jurie ishte i anshëm pasi ishte dëgjuar ta thërriste të akuzuarin me qasje raciste. I njëjtë ishte qëndrimi i GjEDNJ-së në *Lavents v. Latvia*,⁵⁴⁹ kur konstatoi se gjyqtari ishte treguar i anshëm meqë kishte bërë një deklaratë paraprake duke e quajtur të akuzuarin fajtor. Sa i përket barrës së provës për të konstatuar nëse një gjyqtar është i paanshëm, GjEDNJ-a ka vlerësuar që paanshmëria subjektive e gjyqtarëve duhet të supozohet, siç është thënë në rastin *Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere v. Belgium*,⁵⁵⁰ dhe se anshmëria e gjyqtarit mund të ngrihet si shkelje e nenit 6.1 të KEDNJ vetëm pasi që dikush të ketë sjellë prova për ekzistencën e saj. Pra, nuk është e nevojshme që të testohet çdo herë paanshmëria e gjyqtarëve, por ajo bëhet vetëm pasi që palët të kenë sjellur prova për ekzistencën e saj. Megjithatë, GjEDNJ në *Hauschildt v.*

⁵⁴⁴ Supreme Court of Canada, *Valiente v. The Queen*, Judgment, 1985, p.2.

⁵⁴⁵ GjEDNJ, *Daktaras v. Lituania*, 10 October 2000, Judgment, para. 30-32.

⁵⁴⁶ U.N. Doc. CCPR/C/46/D/387/1989, *Karttunen v. Finland*, Communication No. 387/1989, at 108 (1992).

⁵⁴⁷ ECHR, *Klein and others v. The Netherlands*, [2003].

⁵⁴⁸ ECHR, *Remli v. France*, [1996].

⁵⁴⁹ ECHR, *Lavents v. Latvia*, [2002].

⁵⁵⁰ ECHR, *Le Compte, Van Leuven and De Meyere v. Belgium*, [1981].

*Denmark*⁵⁵¹ ka argumentuar që provat e palëve për paanësinë e gjyqtarit nuk janë të mjaftueshme, por kërkohet që të matet nëse dyshimet mbi paanësinë e gjyqtarëve janë objektivist të justifikueshme. Për të tepër, GjEDNj-a ka shkuar aq larg, saqë në rastin *Ettl et al v. Austria*,⁵⁵² ka gjykuar që paanshmëria nuk duhet të shprehet vetëm tek gjyqtarët, por edhe tek gjyqtarët porotë dhe bashkëpunëtorët profesional që kanë marr pjesë në gjykimin e çështjes, duke e thënë në mënyrë implicite që p.sh. konstatimi i paanshmërisë së një bashkëpunëtori profesional do të ishte shkelje e nenit 6.1 të KEDNj.

15. Paanshmëria objektive, siç është thënë edhe në rastin *Daktaras v. Lituania*⁵⁵³ nga GjEDNj, lidhet me kërkesën që gjyqtarët të mos kenë ndonjë arsye objektive që e bën të jetë favorizues apo kufizues në qëndrimin e tyre, dhe që të përjashtojnë të gjitha rrethanat apo indiciet që mund të sjellin tek ky paragjykim. Prandaj, siç është argumentuar edhe në rastin *Hauschildt v. Denmark*⁵⁵⁴ nga GjEDNj-a, duhet konstatuar nëse ka fakte të jashtme që sjellin dyshime mbi paanësinë e gjyqtarëve në një gjykim të caktuar sepse thelbi i paanshmërisë objektive lidhet me pavarësinë funksionale të gjyqtarëve gjatë gjykimit të një rasti të caktuar. Për më tepër, GjEDNj-a në rastin *Thorgeirson vs. Ireland*,⁵⁵⁵ ka kërkuar që paanshmëria e gjyqtarëve të jetë e dukshme nga jashtë. *Dukshmëria* e paanshmërisë duhet shikuar si tek sytë e publikut ashtu edhe tek sytë e palëve sepse, pavarësisht se gjykatësit mund të jenë të paanshëm, fakti që ata duken të anshëm nga jashtë prodhon ulje të kredibilitetit të gjykatësve në publik dhe si rezultat rënie të perceptcionit për një gjykim të drejtë. Kjo është një argument që gjykatësit nuk mjafton që vetëm të jenë të paanshëm, por ata duhet edhe të duken në sytë e të tjerëve si të tillë. Prandaj, sipas GjEDNj-së janë dy kushte që e bëjnë paanësinë objektive: a) që gjykatësit të jenë objektivist të paanshëm, dhe b) që ata të *duken* në sytë e të tjerëve si të paanshëm.

16. Duke e zhvilluar më tej nocionin e paanshmërisë në kuptimin e procedurës penale, GjEDNj-a ka vënë tri standarde. Një, në rastin *Piersack vs. Belgium*,⁵⁵⁶ është kërkuar që procesi i ndjekjes penale të jetë i ndarë nga procesi i gjykimit, dhe kështu që personat e përfshirë në këto dy procese të mos kenë lidhshmëri apo ndikim objektiv ndërmjet vete. Dy, në rastin *De Cubber vs. Belgium*,⁵⁵⁷ është kërkuar që procesi i hetimit të jetë i ndarë nga procesi i gjykimit, dhe që personat e përfshirë në këto dy procese të mos kenë lidhshmëri apo ndikim objektiv ndërmjet vete. Dhe tre, në rastin *Huber vs. Switzerland*,⁵⁵⁸ është kërkuar që procesi i ndjekjes penale (prokurorët) dhe procesi i hetimit (policët, etj.) të jenë të ndara,

⁵⁵¹ ECtHR, *Hauschildt v. Denmark*, 24 May 1989, Judgment, Series A No. 154, p. 21, § 48.

⁵⁵² ECHR, *Ettl and others v. Austria*, [1987].

⁵⁵³ GjEDNj, *Daktaras v. Lituania*, 10 October 2000, Judgment, Para. 30-32.

⁵⁵⁴ ECHR, *Hauschildt v. Denmark*, [1989].

⁵⁵⁵ ECHR, *Thorgeirson vs. Ireland*, [1992].

⁵⁵⁶ ECHR, *Piersack vs. Belgium*, [1984].

⁵⁵⁷ ECHR, *De Cubber vs. Belgium*, [1984].

⁵⁵⁸ ECHR, *Huber vs. Switzerland*, [1990].

dhe kështu që personat e përfshirë në këto dy procese të mos kenë ndonjë lidhshmëri apo ndikim të ndërsjellë objektiv ndërmjet vete.

17. Në përgjithësi, GjEDNj-a në rastet *Fey vs. Austria* dhe *Padovani vs. Italy*,⁵⁵⁹ por edhe gjetiu, ka argumentuar se dyshimet mbi paanshmërinë e një gjyqtari duhen matur në rrethanat konkrete të rastit që gjykohet. Në rastin *Nortier vs. The Netherlands*,⁵⁶⁰ GjEDNj-a ka gjykuar që fakti që një gjyqtar është bërë i ditur me rastin në një procedure paraprake të gjykimit, p.sh. gjatë vendosjes apo konfirmimit të kërkesës së prokurorit për paraburgim, nuk është fakt i mjaftueshëm për të konsideruar që gjyqtari do të jetë i anshëm në gjykimin e pastajmë. Me këtë GjEDNj ka konfirmuar serish se secili rast dhe fazë konkrete duhet të gjykohe në kontekst.

c) “*Pushteti gjyqësor është... i drejtë... dhe siguron qasje të barabartë në gjykata.*”

18. Këto dy përcaktime janë standarde të ndërlidhura ngushtë me dy konceptet më fundamentale të shpjeguara më lartë: pavarësinë dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor. Kur Kushtetuta flet për pushtetin gjyqësor si pushtet i “drejtë”, ajo në fakt i referohet të drejtës së njeriut për një “gjykim të drejtë” apo për një “dëgjim të drejtë” nga gjyqësori. E drejta në dëgjim të drejtë, sidoqoftë, është shumë ngushtë e lidhur me të drejtën e njeriut për qasje të barabartë në gjykata. E drejta në gjykim të drejtë, në përgjithësi, siç është e përcaktuar edhe në nenin 6 (1) të KEDNj-së ka të bëjë me të drejtat e palëve në gjykim që të trajtohen në mënyrë të paanshme nga gjykata, të mund të sfidojnë dëshmitarët, të pyeten personalisht, si dhe të trajtohen në mënyrë të dinjitetshme nga gjyqtarët. E lidhur ngushtë me këtë, e drejta për qasje në gjykata përcaktohet nga neni 6 (1) i KEDNj si garancion që çdo person të ketë të drejtë që të dorëzojë një parashtresë pranë gjykatave, mbi të cilën do të veprojë gjykata, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij, siç e thënë nga GjEDNj në rastin *Golder v UK*.⁵⁶¹ Kjo nënkupton që qasja në gjykatë, si një e drejtë njerëzore, nënkupton që askush nuk mund të pengohet apo të ndalohet që t’i drejtohet një gjykate për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tij, dhe ndalesat nuk mund të bëhen as nga kushtetuta, ligji, apo çfarëdo akti tjetër, por as nga vendimet individuale të ndonjë gjykate apo autoriteti tjetër.
19. E drejta për qasje në gjykatë, siç përcaktohet nga Kushtetuta, duhet të ofrohet në mënyrë të barabartë për secilin. Në këtë aspekt, qasja e *barabartë* në gjykata lidhet me barabarësinë e palëve në gjykim, p.sh. të prokurorit dhe të akuzuarit, ose të paditësit dhe të të paditurit, si dhe me trajtimin e barabartë të tyre nga ana e gjykatës, përfshirë edhe standardin *nemo index in parte sua* në kuptim të gjërë. Në rastin *D. Wolf v. Panama*,⁵⁶² Komiteti për të Drejtat e Njeriut i KB konsideroj se e drejta për qasje të barabartë në gjykatë përfshin edhe të drejtën e të akuzuarit për të

⁵⁵⁹ ECHR. *Fey vs. Austria*, [1993] and ECHR *Padovani vs. Italy*, [1993].

⁵⁶⁰ ECHR, *Nortier vs. The Netherlands*, [1993].

⁵⁶¹ ECtHR, *Golder v UK*, 21 February 1975, Judgment, Series A, No 18, para. 36.

⁵⁶² UN Human Rights Committee, *D. Wolf v. Panama*, UN Doc. GAOR, A/48/40, (vol. 2), p. 44, para. 6.4.

pasur një akuzë të arsyetuar dhe të duhur, duke i dhënë mundësinë që i akuzuari të bindet që organi i akuzës ka arsye të mjaftueshme për ta sfiduar atë para gjykatës.⁵⁶³ GjEDNj, në rastin *Bulut v. Austria*,⁵⁶⁴ argumentoi se e drejta për qasje të barabartë në gjykatë është standard i së drejtës për gjykim të drejtë, dhe nënkupton që secila palë në procedurën gjyqësore duhet t'i ofrohet ambient dhe kohë e arsyeshme për të dhënë shpjegime mbi rastin, në mënyrë që të mos shihet në sytë e të tjerëve që njëra palë ishte paarsyeshëm e kufizuar ndaj kundërshtarit të tij/saj. Për më tepër, GjEDNj, në rastin *Machado v. Portugal*,⁵⁶⁵ argumentoi që e drejta për qasje të barabartë në gjykatë përfshin si rastet penale ashtu edhe ato civile, dhe nënkupton ndër të tjera që palët të njihen me dëshmitë e palëve tjera, faktet e paraqitura nga to, dhe të paraqesin versionin e tyre të komentimit mbi të gjitha këto. Në rastin *Brandstetter v. Austria*,⁵⁶⁶ GjEDNj vendosi që palës së akuzuar i ishte shkëlur e drejta për qasje të barabartë në gjykatë pasi që ankesa e prokurorisë e bërë në gjykatë nuk i ishte dërguar edhe palës së akuzuar, dhe rrjedhimisht kjo e fundit nuk ishte ofruar mundësia e përgjigjes ndaj pretendimit të ankesës së prokurorit. E drejta për qasje në gjykatë, megjithatë, mundet *përrjashtimisht* të kufizohet nëse kufizimi ka qëllim legjitim dhe nëse masat kufizuese nuk e shkelin parimin e proporcionalitetit në mes të masës së vendosur dhe qëllimit që tentohet të arrihet, me kusht që kufizimi i tillë të mos dëmtojë vet esencën e ekzistencës së të drejtës në fjalë, siç është vendosur nga GjEDNj në *Lithgow et al v. The United Kingdom*,⁵⁶⁷ *Stubbings et al v. the United Kingdom*,⁵⁶⁸ dhe *Fayed v. the United Kingdom*.⁵⁶⁹

20. E drejta për qasje në gjykatë, nga sa u tha më sipër, duhet lidhur, ndër të tjera, me tri çështje: a) kur gjykatat refuzojnë të pranojnë një palë mbi baza *locus standi*, duke e konsideruar që çështja e palës nuk mund t'i qaset gjykatës; b) kur e drejta për qasje në gjykatë kufizohet nga procedura apo kufizime të ndryshme; dhe c) kur vendimet finale gjyqësore nuk zbatohen nga institucionet përkatëse. Në rastin

⁵⁶³ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Lituaniës në vendimin e saj 35/03-11/06 theksoi se parimet kushtetuese se vetëm gjykatat janë institucione kompetente për ndarjen e drejtësisë, se ligjet duhet të jenë transparente dhe se rastet duhet të shqyrtohen në mënyrë të drejtë, gjithashtu nënkupton se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara me argumente juridike. Vendimet gjyqësore duhet të përmbajnë në tërësi argumentet mbi të cilat bazohen. Pas publikimit të vendimeve, argumente tjera nuk mund të dorëzohen për rastin përkatës dhe gjykatave nuk u lejohej tjetërsimi i vendimit (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituaniës 35/03-11/06 I datës 21.09.2006);

⁵⁶⁴ ECtHR, *Bulut v. Austria*, 22 February 1996, Judgment, Reports 1996-II, f. 359, para 47.

⁵⁶⁵ ECtHR, *Lobo Machado v. Portugal*, 20 February 1996, Judgment, Report 1996-I, para 31, fq. 207.

⁵⁶⁶ ECtHR, *Brandstetter v. Austria*, 28 August 1991, Judgment, Series A. No. 21, f. 28, para. 68.

⁵⁶⁷ ECtHR, *Lithgow et al v. The United Kingdom*, Application no. 9006/80; 9262/81; 9263/81; 9265/81; 9266/81; 9313/81; 9405/81, 8 July 1986, Judgment.

⁵⁶⁸ ECtHR, *Stubbings et al v. the United Kingdom*, 22 October 1996, Judgment Reports 1996-IV, p. 1502, § 50.

⁵⁶⁹ ECtHR, *Fayed v. the United Kingdom*, 21 September 1994, Judgment, Series A no. 294-B, pp. 49-50, para. 65

Golder v UK,⁵⁷⁰ një i burgosur kishte tentuar ta padiste rojën e burgut për shpifje sipas procedurës civile, gjë që nuk ishte pranuar nga gjykata nacionale, prandaj GjEDNj vendosi që refuzimi i gjykimit të një padie të tillë nga gjykata ishte shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë të të burgosurit. Në mënyrë të njëjtë, në rastin *Campbell and Fell v. The United Kingdom*,⁵⁷¹ GjEDNj vendosi që mohimi i së drejtës së të burgosurve për t'u konsultuar me një avokat për shkak të një dënimi disiplinor të vendosur nga burgu konsiderohej shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë. Në të njëjtën linjë, GjEDNj në rastin *Immobiliare Saffi v. Italy*,⁵⁷² vendosi që pamundësia e një pale që padia e saj të dëgjohet efektivisht nga një gjykatë në lidhje me një kontest civil është shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë, dhe rrjedhimisht në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës. Sa i përket kufizimeve procedurale në lidhje me qasjen në gjykatë, në rastin *Kreuz v. Poland*,⁵⁷³ GjEDNj vendosi që kërkesa për të paguar një shumë të caktuar parashë si kusht që një parashtrësë të gjykohej nga gjykata është shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë. Për më tepër, si pjesë e së drejtës për qasje në gjykata, GjEDNj në rastin *Airey v. Ireland*⁵⁷⁴ ka vendosur që shteti ka për detyrim që të ofrojë ndihmë juridike falas për paditësin edhe në çështjet civile, meqenëse obligimi për ndihmë juridike në çështjet penale garantohet me nenin 6(3) të KEDNj, ashtu që pamundësia për të bërë një gjë të tillë është në kundërshtim me të drejtën në fjalë. Në të njëjtën linjë, në rastin *Artico v. Italy*,⁵⁷⁵ GjEDNj konsideroi që është shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë nëse i akuzuari shërbehej nga një avokat i caktuar nga gjykata, i cili ishte nën nivelin e nevojshëm të vetëdijes për ta mbrojtur klientin, dhe se gjykata në raste të tilla obligohej ose ta detyronte avokatin për ta mbrojtur klientin e tij në mënyrë të nevojshme ose duhet ta ndërronte atë. Në rastin *John Murray v. the United Kingdom*,⁵⁷⁶ GjEDNj argumentoi që në rastet e caktuara, ndihma juridike e obliguar duhet të ofrohet për të arrestuarit që në fazën e marrjes në pyetje nga policia, dhe jo vetëm kur çështja të shkojë në prokurori apo gjykatë. I njëjtë ishte qëndrimi në *Magee v. the United Kingdom*,⁵⁷⁷ ku u argumentua që marrja e një të arrestuari në pyetje nga policia pa prezencën e një avokati, për shkak të frymës kërcënuese nga policia, përbënte shkelje të së drejtës për qasje në gjykatë. Për më tepër, GjEDNj në rastin *Brusco v. France*⁵⁷⁸ argumentoi që marrja në pyetje e një dëshmitari nga policia, i cili konsiderohej edhe i dyshuar, pa prezencën e avokatit konsiderohet shkelje në kuptim të së drejtës për qasje në gjykatë. Në anën tjetër, sa i përket çështjes së zbatimit të vendimeve gjyqësore në kuptim të së drejtës për qasje në gjykatë, në rastin *Hornsby v. Greece*,⁵⁷⁹ GjEDNj ka argumentuar që moszbatimi i një vendimi

⁵⁷⁰ ECtHR, *Golder v UK*, 21 February 1975, Judgment, Series A No 18, para. 36

⁵⁷¹ ECtHR, *Campbell and Fell v. The United Kingdom*, Application No. 8342/95, 28 June 1984, Judgement.

⁵⁷² ECtHR, *Immobiliare Saffi v. Italy*, Application No. 22774/93, 28 July 1999, Judgement.

⁵⁷³ ECtHR, *Kreuz v. Poland*, 19 June 2001, Application No 28249/95, Judgment

⁵⁷⁴ ECtHR, *Airey v. Ireland*, 11 September 1979, Judgment Series A, No 32.

⁵⁷⁵ ECtHR, *Artico v. Italy*, May 13 1980, Judgment Series A, No 37, para.35.

⁵⁷⁶ ECtHR, *John Murray v. the United Kingdom*, 25.01.1996, Judgment.

⁵⁷⁷ ECtHR, *Magee v. the United Kingdom*, 06.06.2000, §40, Judgment.

⁵⁷⁸ ECtHR, *Brusco v. France*, 14.10.2010, Judgment,

⁵⁷⁹ ECtHR, *Hornsby v. Greece*, 19 March 1997, Judgment, Reports 1997-II, p. 510, para. 40.

gjyqësor gjithashtu konsiderohet shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë. I njëjtë ishte qëndrimi i GjEDNj në rastin *Van de Hurk v. The Netherlands*,⁵⁸⁰ ku u argumentua që vënia në dyshim apo moszbatimi i vendimit gjyqësor nga një organ jo-gjyqësor është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në pavarësinë e gjyqësorit, dhe shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë.⁵⁸¹ I njëjtë ishte qëndrimi i GjEDNj edhe në rastin *Immobiliare Saffi v. Italy*.⁵⁸²

Është e rëndësishme të thuhet se e drejta për qasje në gjykatë është konsideruar si një e drejtë me kufij shumë të gjerë nga GjEDNj, edhe jashtë këtyre tre bazave të cekura më sipër. Në rastin *Marini v. Albania*,⁵⁸³ GjEDNj argumentoi që dështimi i Gjykatës Kushtetuese për t'u marrë me rastin e një shkeljeje individuale ishte shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë. Këtu GjEDNj e zgjeroi kuptimin e qasjes në gjykatë jo thjesht si një e drejtë përballë gjykatave të rregullta, por edhe përballë atyre subsidiare. Për më tepër, në të njëjtin rast, GjEDNj gjykoi që zgjatja e tepërt e procedurës gjyqësore, në kuptim të kohës, është gjithashtu shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë. Në të njëjtën logjikë, refuzimi i një gjykate që të pranojë juridiksionin për të zgjidhur një çështje të parashtruar para saj me arsyetimin se gjykatat nuk kanë kompetencë për të vlerësuar kërkesën për kontroll ndaj një shkeljeje të një të drejte të caktuar të njeriut, siç është thënë në *Brumărescu v. Romania*,⁵⁸⁴ u konsiderua shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë.

21. Një ndër pengesat themelore të qasjes në gjykatë është çështja e imunitetit të organizatave ndërkombëtare apo një numri të caktuar të zyrtarëve shtetëror, siç dokumentohet gjerësisht edhe nga Kloth.⁵⁸⁵ Në aspektin parimor, e drejta për qasje në gjykatë duhet të jetë e pakusht, në kuptim të subjekteve të paditura apo të akuzuara ashtu që mbetet për diskutim të mëtejshëm çështja nëse imuniteti, ta zëmë, për ambasadorët, apo edhe misionet tjera të huaja në Kosovë është shkelje e së drejtës për qasje në gjykatë sipas Kushtetutës dhe KEDNj. Kjo nga shkak se rregullat dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare mbi imunitetin sovran nganjëherë pengojnë, apo zvarrisin, realizimin e kësaj të drejte kushtetuese. Për këtë arsye debati më i thellë dhe më i strukturuar rreth realizimit të kësaj të drejte zhvillohet kur është fjala për imunitetin sovran. Kosova nuk bën përjashtim në këtë drejtim, nisur nga fakti se deri më 17 shkurt 2008 ka ekzistuar një administrim ndërkombëtar i vendit i kryer nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, OKB.⁵⁸⁶

⁵⁸⁰ ECtHR, *Van de Hurk v. The Netherlands*, Application No. 16034, 19 April 1994, Judgement.

⁵⁸¹ Si shembull krahasues nga jurisprudenca lituaneze, vendimet gjyqësore që kane marrë formën e plotfuqishme kanë fuqinë e ligjit dhe ekzekutimi i tyre garantohet nga ana e shtetit. Prandaj ato janë të detyrueshme ndaj të gjitha institucioneve shtetërore dhe administrative si dhe ndaj të gjithë personave juridikë dhe fizikë (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Lituaniës Nr. 6/97 I datës 13.11.1997);

⁵⁸² ECtHR, *Immobiliare Saffi v. Italy*, Application No. 22774/93, 28 July 1999, Judgement.

⁵⁸³ ECtHR, *Marini v. Albania*, Application No. 3738/02, 18 December 2007, Judgment.

⁵⁸⁴ ECtHR, *Brumărescu v. Romania*, Application no. 28342/95, 28 October 1999, Judgment.

⁵⁸⁵ Kloth, Matthias (2010) 'Immunities and the Right of Access to Court under Article 6 of the European Convention on Human Rights'. The Hague: Martinus Nijhoff.

⁵⁸⁶ I njohur në Kosovë është rasti tragjik i vrasjes më 10 shkurt 2007 i Mon Balajt dhe Arben Xheladinit nga forcat policore rumune të cilat kanë vepruar në kuadër të OKB-së sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit, të datës 10 qershor 1999. Kjo Rezolutë akoma në

Edhe pas datës 17 shkurt 2008, një pjesë bukur e madhe e rregulloreve të kësaj administrate, e njohur si UNMIK, kanë mbetur në fuqi.⁵⁸⁷

d) “Pushteti gjyqësor është... apolitik...”

22. Ky përcaktim shprehet mbi karakterin jo-politik të pushtetit gjyqësor, që në fakt është një derivat i pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit të komentuar në pjesën e mësipërme. Në aspektin logjik, kjo nënkupton dy garancione: a) që pushteti gjyqësor nuk ndjek linja politike, dhe nuk përkrah apo kufizohet me bindjet politike në punën e vet; dhe b) që pushteti gjyqësor nuk është i ndikuar apo nuk ka lidhje strukturore me agjentë apo subjekte politike, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Janë këto dy parime, që natyrisht janë derivate të detajuara të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit, që e legjitimojnë anën e jashtme të pushtetit gjyqësor si pushtet që udhëhiqet nga ndjenja e profesionit ligjor dhe e neutralitetit ndaj bindjeve apo rrymave politike që bartin dy pushtetet tjera.
23. Sipas kuptimit të parë, pushteti gjyqësor nuk mund të jetë përkrahës i një linje politike, qoftë ajo edhe politikë publike e caktuar, në dëm të një tjetre, por duhet të gjykojë i liruar nga çdo bindje, ide apo perceptcion politik.⁵⁸⁸ Pushteti gjyqësor, prandaj, nuk duhet të kujdeset për faktin se si do të duken në publik vendimet e saj nëse ato lexohen nga përkrahës politik të një rryme partizane, meqë kjo do ta bënte atë të varur për faktin e mostrazimit të ujërave politike apo partizane.
24. Sipas kuptimit të dytë, pushteti gjyqësor duhet të jetë absolutisht i mbrojtur nga sulmet apo ndikimet e agjentëve politik, qofshin ato institucione shteti, dhe atyre

pikëpamje formale është në fuqi dhe prodhon pasoja juridike sa i përket imunitetit dhe privilegjeve të personave dhe institucioneve të cilat mbulohen me këtë Rezolutë. Një hetim i brendshëm i bërë në atë kohë pranonte se ka pasur përdorim të tepruar dhe pa nevojë të forcës, gjë që ka shkaktuar vdekjen e dy personave në fjalë. Jo vetëm hetimi brendshëm i UNMIK-ut por edhe Amnesty International në vijimësi ka insistuar në përgjegjësinë e kryerësve të veprës dhe ka konstatuar tejkalim të autorizimeve ligjore për përdorim të forcës, mirëpo asgjë deri më tani nuk është ndërmarrë para ndonjë gjykate të paanshme për të çuar drejtësinë në vend. Cf. *Telegrafi* (datë 28 shkurt 2013). Në internet: <http://www.telegrafi.com/lajme/ai-te-nise-hetimi-per-vrasjen-e-mon-balajt-dhe-arben-xheladinit-2-29593.html>

⁵⁸⁷ Për rastet e imunitetit sovran pranë GjEDNj, dhe qasjen e njëjtë me këtë diskutim tonin, që përfshinë edhe dy raste e Kosovës pranë kësaj Gjykate, Cf. me shumë në: Omejec, Jasna (2013) ‘*Konvencija Za Zastitu Ljudskih Prava I Temeljnih Sloboda U Praksi Evropskog Suda Za Ljudska Prava. Strasbourski Acquis*’. Zagreb, fq. 618-630; 642-644; 660-672. Në dy këto raste të Kosovës pranë GjEDNj fjala ka qenë për kërkesë të palejueshme, jo vetëm për shkak të imunitetit por edhe për shkak të mungesës së juridiksionit të kësaj Gjykate ndaj Kosovës dhe shtetasve të saj. Kjo shihet edhe nga fakti se këto dy raste janë trajtuar në kuadër të jo-lejueshmërisë së rastit *ratione personae* (fq. 623-675). Sidoqoftë, trajtimi në fjalë i këtyre dy rasteve kosovare ka qenë mjaft interesant sepse ka provuar kufizimet e fitimit të drejtësisë në rastet kur cenimet e të drejtave të njeriut kryhen nga organizatat apo shtetet që gëzojnë imunitet sovran.

⁵⁸⁸ Shih p.sh: John R. Lott, Jr. (2001) ‘The American Bar Association, Judicial Ratings, and Political Bias’. *Journal of Law & Politics*. Vol. 17, p. 41-61.

partiake, apo edhe lëvizjeve a rrymave politike, dhe kjo mbrojtje duhet të mundësohet si në aspektin strukturor ashtu edhe në aspektin e sjelljes. Në kuptimin implicit të këtij përcaktimi, konsiderohet si ndalim implicit që persona të veshur me petkun politik apo të lidhur me kampe të ndryshme politike të japin deklarime publike apo të ndikojnë në ndërtimin e opinionëve publike në lidhje me çështje gjyqësore që gjykohen nga pushteti gjyqësor. Në anën tjetër, agjitimi politik kundër vendimeve gjyqësore, siç janë të shumta rastet në shtetet në tranzicion, do të ishte shkelje e hapur e karakterit jo-politik të gjyqësorit, dhe tendencë për të lidhur punën dhe detyrën e saj me rryma politike kundërshtarë, veprime të cilat dërgojnë në de-legitimim dhe humbje të autoritetit të pushtetit gjyqësor në sytë e publikut, siç është konstatuar në përgjithësi në *Morris v. the United Kingdom*.⁵⁸⁹

Neni 102.3

Ky paragraf i nenit 102 është përcaktor mbi kufijtë e veprimit, të sjelljes së gjykatave, si dhe të burimit të autoritetit për të gjykuar. Thënë në aspektin juridik, pushteti i gjykatave për të gjykuar buron nga Kushtetuta dhe ligjet, dhe nuk mund të ketë lëvizje nga ky parim. Si i tillë, ky paragraf përcakton tri gjëra: a) burimin e pushtetit gjyqësor, b) kufijtë e pushtetit gjyqësor; dhe c) natyrën e legjitimitetit të gjykatave dhe vendimeve të tyre.

1. Në rend të parë, ky paragraf është përcaktor i burimit të juridiksionit të gjykatave për të ushtruar detyrën e tyre. Prandaj, sipas këtij përcaktimi kushtetues, gjykatat nuk lejohet të marrin pushtet pos sipas Kushtetutës dhe ligjeve. Kjo, në anën tjetër, shënon kufijtë e jashtëm të autoritetit gjyqësor, meqenëse nuk lejon që gjykatat të kufizohen pos nga Kushtetuta dhe ligjet. Burimin e pushtetit të gjykatave nga Kushtetuta dhe ligjet, siç përcaktohet nga ky paragraf, duhet shikuar si në kuptim të juridiksionit të tyre, ashtu edhe në kuptim të burimit të autoritetit për të gjykuar çështje të procedurës dhe vendosjes mbi meritën e rasteve. Kufizimi i gjykatave që të mund të kenë pushtet jashtë kufijve të vendosur nga Kushtetuta dhe ligjet është standard i mbrojtjes nga arbitrariteti i pushtetit gjyqësor, në njërën anë, dhe në anën tjetër, standard themelor i demokracisë i shprehur si kushtetutshmëri dhe ligjshmëri.
2. Në praktikë, ky paragraf i Kushtetutës i detyron gjykatat që pushteti i tyre të burojë vetëm nga Kushtetuta dhe ligjet. Në aspektin krahasues, ka shumë sisteme kushtetuese në botë që nuk lejojnë gjykatat e rregullta të merren me interpretimin e drejtpërdrejtë të Kushtetutës, meqë kjo është një kompetencë më e rezervuar për një gjykatë të specializuar kushtetuese, ashtu që puna e tyre kufizohet thjesht në interpretimin e ligjeve. 3. Nëse gjykata e rregullt ka mëdysheje në lidhje me kushtetutshmërinë e një ligji, sipas këtyre sistemeve, ajo e referon çështjen në gjykatën e specializuar për kontrollin abstrakt të normës (i ashtuquajtur i kontrolli incidental).⁵⁹⁰ Një përcaktim të këtillë ka vendosur Gjykata Federale Kushtetuese e

⁵⁸⁹ ECHR, *Morris v. the United Kingdom*, No. 38784/97, § 58, 2002-I.

⁵⁹⁰ Si shembull krahasues nga jurisprudenca ruse, gjykatat e rregullta nuk kanë të drejtë, por e kanë obligim të kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së një ligji të aplikueshëm në një rast specifik, e që ato gjejnë se ai ligj bie ndesh me Kushtetutën (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Federatës Ruse (nuk ka numër) i datës 17.7.1998);

Gjermanisë,⁵⁹¹ e cila ka gjykuar që nuk është në rolin e gjykatave të rregullta që të interpretojnë drejtpërdrejtë Kushtetutën, dhe se ato duhet të kufizohen vetëm në konsiderimin e ligjeve. Ky paragraf i Kushtetutës së Kosovës vendos detyrimin që gjykatat e rregullta në Kosovë të mos jenë të kufizuara vetëm në ligje, por të bëjnë edhe interpretimin e Kushtetutës në mënyrë të drejtpërdrejtë në kuptim të zgjidhjes së rasteve të tyre konkrete. Pavarësisht se e thënë në mënyrë implicite, ky paragraf kushtetues i detyron apo i lejon gjykatat e rregullta të Kosovës që të bëjnë zgjidhje të rasteve konkrete duke mos u kufizuar vetëm në kufijtë e ligjeve, por duke bërë edhe interpretim të normave kushtetuese. Kjo është kështu vetëm nëse kihen parasysh dy rrethana: e para, vetëm Gjykata Kushtetuese ka autorizim për interpretim të normave kushtetuese; dhe, e dyta, gjykatat e rregullta nuk mund të gjykojnë vetëm në bazë të Kushtetutës. E thënë ndryshe, dispozita në fjalë duhet të kuptohet si vijon: vetëm Gjykata Kushtetuese ka monopol për interpretim përfundimtar të Kushtetutës kurse gjykatat e rregullta gjatë interpretimit të ligjeve duhet ta kenë parasysh që nuk duhet të cenojnë dispozitat kushtetuese dhe standardet tjera të konstitucionalizmit modern.⁵⁹²

3. Sa i përket aspektit të legjitimacionit, ky paragraf i shërben idesë së legjitimitetit të gjykatave si institucione profesionale, që vendosin në bazë të rregullave abstrakte të Kushtetutës dhe ligjit. Si të tilla, vendimet e gjykatave nuk janë asgjë tjetër pos një produkt operacional i këtyre të fundit. Në këtë kuptim, vendimet e gjykatave përkthehen si produkte të vet Kushtetutës dhe ligjeve, dhe legjitimohen me vet kërkesën e shoqërisë për zbatimin e Kushtetutës dhe ligjeve si standarde themelore të demokracisë. Prandaj, edhe pse gjykatat nuk kanë anëtarë të zgjedhur nga populli, dhe kanë mungesë të *inputit* në legjitimimin e tyre⁵⁹³, ato legjitimohen me

⁵⁹¹ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë në vendimin e saj, 1 BvR 1508/96 theksoi se interpretimi i normave juridike ligjore (që nuk kanë karakter kushtetues) dhe zbatimi i tyre në raste individuale janë çështje e gjykatave të rregullta të juridiksionit të përgjithshëm. Vetëm atëherë kur gjatë procedurave gjykatat e rregullta shkelin të drejtat kushtetuese të individëve, Gjykata Federale Kushtetuese mund të intervenojë dhe të përgjigjet në një ankesë kushtetuese (Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale të Gjermanisë 1 BvR 1508/96 I datës 07.06.2005);

⁵⁹² Sadurski, Wojciech (1990) 'Rights Before Courts. A Study of Constitutional Courts in Post-Communist States of Central and Eastern Europe'. The Netherlands: Springer, kapitujt 2 ("Constitutional Courts in Search of Legitimacy") dhe 3 ("The Model of Judicial review and Its Implications"); Schwartz, Herman (2000) 'The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe'. Chicago: The University of Chicago Press, kapitujt 1 ("The Beginning") dhe tetë ("Conclusion"); Sadurski, Wojciech 'Constitutional Justice, East and West: Introduction', në Wojciech Sadurski (ed.) (2010) 'Constitutional Justice, East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in A Comparative Perspective'. The Hague: Kluwer Law International, fq. 1-18; Ferejohn, John and Pasquino, Pasquale 'Constitutional Courts as Deliberative Institutions: Towards an Institutional Theory of Constitutional Justice', në Wojciech Sadurski (ed.) (2010) 'Constitutional Justice, East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in A Comparative Perspective'. The Hague: Kluwer Law International, fq. 21-36; Sweet, Stone Alec 'Constitutional Courts', në Rosenfeld, Michel and Sajo, Andras (eds.) (2012) 'The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law'. Oxford: Oxford University Press, p. 816-830.

⁵⁹³ Në disa vende, si në SHBA, gjyqtarët zgjedhen drejtpërdrejt nga populli. Kjo, megjithatë, nuk

nevojën e shtetit që thotë se vetëm organet profesionale dhe të pavarura duhet të interpretojnë dhe të vendosin mbi kuptimin e Kushtetutës dhe ligjeve, të cilat janë produkte të popullit në mënyrë të tërthortë.⁵⁹⁴

Neni 102.4

1. Ky paragraf vendos standardet e pavarësisë dhe paanësisë së gjykatësve në kuptim të ushtrimit të funksioneve të tyre. Këto dy standarde janë shpjeguar më lartë, meqë janë derivate të konceptit të pavarësisë dhe paanësisë së pushtetit gjyqësor, të vendosura në paragrafin 2 të këtij neni të Kushtetutës. Vlen të thuhet këtu se në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, cenimi i të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm përbën një pjesë të konsiderueshme të punës.

Neni 102.5

1. Ky paragraf përcakton disa standarde, qoftë shprehimisht apo tërthorazi, në lidhje me shfrytëzimin e mjeteve juridike në procedurat gjyqësore. Në përgjithësi, janë tri gjëra që dalin nga ky paragraf: a) e drejta e ankesës ndaj vendimeve gjyqësore, b) çështja e së drejtës së mjeteve të jashtëzakonshme, dhe c) mundësia për të dërguar çështje drejtpërdrejtë në gjykatën më të lartë.
2. Megjithëse ky paragraf garanton të drejtën në ankesë ndaj një vendimi gjyqësor të shkallës së parë, në të njëjtën kohë ai vendos parimin që nëse përcaktohet ndryshe

ndryshon asgjë sepse detyrim i tyre kushtetues është që të gjykojnë jo sipas preferencave të zgjedhësve por sipas rregullave të profesionit gjyqësor.

⁵⁹⁴ Ndër debatet më të vjetra në të drejtën kushtetuese janë dy: i pari ka të bëjë me dilemën kundër-mazhoritare, kurse i dyti i referohet rolit dhe vendit të pushtetit të krijuar (“*pouvoir constitue*”) në të cilin pushtet bëjnë pjesë, përveç gjyqësorit, edhe dy pushtetet tjera. Kjo çështje bëhet më komplekse në vendet ku gjyqësia kushtetuese është e ndarë nga gjyqësia e rregullt. Në rastet e tilla, legjitimitimi i gjyqësisë kushtetuese kryhet sipas rregullave të respektit për profesionin për të gjykuar në bazë të kushtetutës dhe ligjit si dhe përmes mosfutjes së gjyqësisë kushtetuese në kuadër të gjyqësorit të rregullt. Dilema kundër-mazhoritare ka filluar në SHBA që nga rasti *Marbury vs. Madison* (1803) e tutje dhe akoma është e gjallë atje. Dilema në fjalë mund të përmbledhet në këtë: si ka mundësi që një pushtet që nuk i përgjigjet popullit të vendos për anulimin e ligjeve dhe dispozitave tjera që janë vullnet i shumicës së popullit (“parimi i demokracisë”). Mirëpo, aktualisht arsyetimi i punës së gjyqësorit, të rregullt dhe atij kushtetues, bazohet në tre faktor: i pari, legjitimitimi i tyre nga organet përfaqësuese (parlamenti), përmes involvimit në krijimin e infrastrukturës kushtetuese dhe ligjore, zgjedhjen e gjyqtarëve, miratimin e buxhetit, etj.etj.; i dyti faktor ka të bëjë me vendimet e tyre të arsyetuara dhe të arsyeshme; dhe, së fundi, tre, në faktin që parimet e konstitucionalizmit kufizojnë realizmin e demokracisë në formën e saj radikale. Cf. përmbledhjen e shkëlqyeshme të eseve mbi këto çështje në: Loughlin, Martin and Walker, Neil (eds.) (2008) ‘*The Paradox of Constitutionalism. Constituent Power and Constitutional Form*’. Oxford: Oxford University Press; Smilov, Daniel, ‘The Least Dangerous Branch?’, në Michel Rosenfeld and Andras Sajó (eds.) (2012) ‘*The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*’. Oxford: Oxford University Press, p. 859-873; Holmes, Stephen, ‘Constitutions and Constitutionalism’, në Michel Rosenfeld and Andras Sajó (eds.) (2012) ‘*The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*’. Oxford: Oxford University Press, p. 189-216.

me ligj, e drejta në ankesë edhe mund të ndalohej. Kur ky paragraf i referohet mundësisë së përcaktimit “ndryshe” me ligj të së drejtës në ankesë, në të njëjtën kohë nuk përjashton edhe mundësinë e kufizimit të saj. Në kuptim të një interpretimi sistemor të Kushtetutës, shprehja “përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe” i referohet një përcaktimi ligjor që mund ta kufizojë të drejtën në ankesë vetëm në procedura ku ekzistenca e kësaj të drejte nuk i shërben qëllimit të saj. Prandaj, ky përcaktim “ndryshe” i së drejtës në ankesë ndaj një vendimi gjyqësor mund të bëhet vetëm përjashtimisht.

3. E drejta në ankesë ndaj një vendimi gjyqësor është standard i së drejtës ndërkombëtare të drejtave të njeriut, jo thjesht një e drejtë që buron nga e drejta e brendshme e një shteti. Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP) e sanksionon këtë të drejtë në Nenin 14(5). E drejta në ankesë, në kuptimin e gjerë, nënkupton të drejtën e një subjekti që ka qenë palë në një procedurë gjyqësore, dhe mbi të cilin vepron një vendim gjyqësor i shkallës së parë, që të ketë mundësi të ankohet tek një gjykatë më e lartë për vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Natyrisht, ankesa në gjykatën më të lartë duhet të lidhet me pretendimet e palës se është dëmtuar nga vendimi i gjykatës më të ulët sa i përket garancioneve të vëna nga Kushtetuta dhe ligjet. Në këtë kuptim, e drejta në ankesë është e drejtë procedurale, që në teorinë juridike njihet edhe si mjet juridik, e cila mundëson rishikimin e një vendimi gjyqësor nga një gjykatë më e lartë sa i përket fakteve, ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së tij. Përveç garantimit të kësaj të drejte, ky paragraf i Kushtetutës vendos paralelisht edhe parimin e dyshkallësisë së gjykimit, meqë detyron që në çdo rast të ekzistojë një gjykatë më e lartë se sa ajo e shkallës së parë për të rishikuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Sa i përket gjerësisë së rishikimit që duhet të bëhet nga gjykata më e lartë, është standard themelor që rishikimi gjyqësor nga një gjykatë më e lartë të përfshijë si kontrollin e të drejtave procedurale ashtu edhe kontrollin e meritës së rastit, duke mundësuar që një gjykatë më e lartë të bëjë një rishikim si formal ashtu edhe substancial të rastit të gjykuar në shkallë të parë.
4. Sa i përket KEDNj, ajo nuk e garanton në mënyrë specifike të drejtën për ankesë ndaj vendimeve gjyqësore në shkallë të parë, megjithatë GjEDNj në rastin *Delcourt v. Belgium*⁵⁹⁵ ka kërkuar që gjatë procesit të apelimit të ruhen të gjitha garancionet e së drejtës për gjykim të drejtë. Për më tepër, GjEDNj argumentoi në *Sutter*⁵⁹⁶ që e drejta për gjykim të drejtë dhe qasje në gjykatë duhet të shikohet edhe në kuptim të procesit të ankimimit. Shkurt, GjEDNj kërkon që garancionet e së drejtës për gjykim të drejtë të zbatohen edhe gjatë procesit të ankimimit të një vendimi gjyqësor të shkallës së parë, duke u pasur parasysh rrethanat reale të vet procedurës së ankimimit.
5. E drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor të shkallës së parë, shikuar më hollësisht, përmban në vete një sërë standardesh më të detajuara, siç janë: a) që çështja të shqyrtohet në mënyrë të plotë në procesin e ankimimit, b) që palët të jenë

⁵⁹⁵ ECtHR, *Delcourt v. Belgium*, 17 January 1970, Judgment, Series A No. 11, pp. 14-15, para. 25.

⁵⁹⁶ ECtHR, *Sutter case*, 22 February 1984, Judgment, Series A no. 74, p. 13, § 28.

të njohura zyrtarisht me vendimin e shkallës së parë, c) që palët të kenë qasje në transkriptet e gjykimit në shkallën e parë, d) që dëshmitë e shkallës së parë të ruhen, dhe f) që palët të kenë të drejtën e tyre në ndihmë juridike.

6. Sa i përket standardit të parë, Komiteti për të Drejtat e Njeriut i KB (KDNjKB), në rastin *Domukovsky et al v. Georgia*,⁵⁹⁷ ka vendosur që procesi i rishqyrtimit duhet të përfshijë jo thjesht aspektin procedural të vendosjes në shkallën e parë, por edhe një shqyrtim tërësor të dëshmimeve dhe të vendosjes gjatë tërë procesit të gjykimit në shkallë të parë. Në të njëjtën linjë, KDNjKB argumentoi në rastin *Gómez v. Spain*⁵⁹⁸ që Spanja kishte dështuar të siguronte të drejtën e ankesës ndaj një vendimi gjyqësor të shkallës së parë, pasi që gjykata e lartë e kishte rishqyrtuar vetëm anën procedurale të vendimit dhe nuk e kishte rishqyrtuar dëshminë e palëve. Kjo, sipas KDNjKB, përbënte shkelje të nenin 14(5) të PNDCP. Sa i përket standardit të dytë, KDNjKB ka argumentuar në *V. Francis v Jamaica*⁵⁹⁹ se e drejta për ankesë përfshin edhe të drejtën e palëve që brenda një kohe të arsyeshme të kenë në dispozicion vendimet gjyqësore me shkrim, dhe të njëjtat të jenë të arsyetuara, me qëllim që pala të mund të ndërtojë një ankesë që mund të rishikohet me korrektësi nga gjykata më e lartë.⁶⁰⁰ Në të njëjtën logjikë, GjEDNJ ka vendosur në rastin *Garcia Ruiz v. Spain*⁶⁰¹ që vendimet gjyqësore duhet të tregojnë në mënyrë të duhur të gjitha arsyet ku ato bazohen, duke e lidhur këtë standard me administrimin e mirë të drejtësisë. Sa i përket standardit të tretë, PNDCP ka argumentuar në rastin *Pinkney v. Canada*⁶⁰² se në kuadër të së drejtës për ankimim të vendimit gjyqësor hyn edhe detyrimi i gjykatës së shkallës së parë që t'i ofroj palës brenda një kohe të arsyeshme transkriptin e gjykimit, e cila mund t'i shërbej si provë asaj në procesin e ankimit në gjykatën më të lartë. Sa i përket standardit të katërt, PNDCP ka argumentuar në rastin *M. Robinson v. Jamaica*⁶⁰³ se dëshmitë e dhëna gjatë fazës së gjykimit në shkallë të parë duhet të ruhen me qëllim të

⁵⁹⁷ *Victor P. Domukovsky, Zaza Tsiklauri, Petre Gelbakhiani and Irakli Dokvadze v. Georgia*, Communications N 623/1995, 624/1995, 626/1995, 627/1995, U.N. Doc. CCPR/C/62/D/623/1995, CCPR/C/62/D/624/1995, CCPR/C/62/D/626/1995, CCPR/C/62-D/627/1995 (29 May 1998). Para. 18.

⁵⁹⁸ *Gómez v. Spain*, UN Human Rights Committee, Communication No. 701/1996. Para. 11.1.

⁵⁹⁹ *V. Francis v Jamaica*, UN Human Rights Committee, Communication No. 320/1988, para 12.2.

⁶⁰⁰ Si shembull krahasues, Tribunali Kushtetues i Polonisë në vendimin e saj, SK 30/05, theksoi se kërkesa që vendimet gjyqësore duhet të përmbajnë arsyetimin e qartë, si komponentë kryesore për të drejtën e gjykimit të drejtë, përmbush disa funksione të rëndësishme: vepron si mekanizëm i kontrollit mbi gjykatat që duhet të dëshmojnë se vendimet e tyre janë korrekte si nga ana formale ashtu edhe nga ajo substanciale; i dokumenton argumentet në favor të vendimit; paraqet bazë për rishikim nga instancat më të larta gjyqësore; inkurajon aprovimin individual të vendimit gjyqësor; nxit tek qytetarët ndjenjën e besimit shoqëror dhe kontrollit demokratik ndaj administrimit të drejtësisë; dhe fuqizon sigurinë juridike (Vendim i Tribunalit Kushtetues të Polonisë SK 30/05 i datës 16.1.2006);

⁶⁰¹ ECtHR, *Garcia Ruiz v. Spain*, 21 January 1999, Judgement, para 26.

⁶⁰² *Pinkney v. Canada*, UN Human Rights Committee, Communication No. 7/27, para. 35.

⁶⁰³ *M. Robinson v. Jamaica*, UN Human Rights Committee, Communication No. 731/1996, para 10.7.

administrimit të mirë të rishqyrtimit gjyqësor në shkallën e dytë. Sa i përket standardit të pestë, kërkohet që palët të jenë të vëna në dispozicion të një ndihme juridike nga një profesionist ligjor, siç është diskutuar më lart në kuptim të së drejtës për qasje në gjykatë.

7. Sa i përket llojit të mjeteve juridike, ky paragraf i Kushtetutës përcakton në mënyrë implicite që legjislacioni duhet të bëjë të mundur shfrytëzimin e mjeteve të jashtëzakonshme. Qëllimi i këtij përcaktimi lidhet thjesht me zgjerimin e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të drejtës për qasje në gjykatë, edhe pse vendimet gjyqësore mund të kenë marrë formë të prerë, duhet lejuar që në rast të paraqitjes së fakteve të reja apo ndryshimit radikal të situatave, palët të mund të kërkojnë rishqyrtimin e çështjeve të tyre me mjete të jashtëzakonshme juridike. Prandaj, ky përcaktim i Kushtetutës në këtë paragraf e fuqizon dhe e pasuron konceptin e gjykimit të drejtë dhe qasjes në gjykatë, meqenëse lejon që palët të mund të kërkojnë rigjykim të vendimeve përfundimtare në rastet kur paraqiten rrethana që e arsyetojnë rihapjen e rastit, e gjithë kjo e drejtuar në kuptim të administrimit të duhur të drejtësisë dhe respektimit të të drejtave të njeriut.
8. Sa i përket përcaktimit të këtij paragrafi që një çështje të mund të dërgohet drejtpërdrejt për gjykim në Gjykatën Supreme, mund të thuhet që kjo i referohet logjikisht rasteve kur kërkohet që një çështje për shkak të rëndësisë që ka të mund të gjykohet vetëm nga kjo e fundit. Një rast i tillë është p.sh. vendimi për shkarkimin e një gjyqtari të rregullt sipas procedurës së disiplinimit nga autoriteti rregullator i gjyqësisë, kur gjyqtarit në fjalë i lejohet që të ankimoj vendimin e tillë vetëm në Gjykatën Supreme. Prandaj, thënë logjikisht, ky paragraf është i ndërtuar që të lejojë qasje të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme vetëm për rastet shumë sensitive që mund të parashihen me ligj, dhe nuk i dedikohet rasteve që burojnë nga procedurat civile, penale apo administrative.

Neni 103 [Organizimi dhe Jurisdiksioni i Gjykatave]

- (1) **Organizimi, funksionimi dhe jurisdiksioni i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave të tjera, rregullohen me ligj.**
- (2) **Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor.**
- (3) **Të paktën pesëmbëdhjetë përqind (15%) e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, por jo më pak se tre (3) gjyqtarë, do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.**
- (4) **Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës e emëron dhe shkarkon Presidenti i Kosovës, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, për mandat shtatëvjeçar, pa mundësi të riemërimit, pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin ose shkarkimin e saj/tij.**
- (5) **Kryetarët e të gjitha gjykatave të tjera emërohen në mënyrën e përcaktuar me ligj.**
- (6) **Të paktën pesëmbëdhjetë përqind (15%) e gjyqtarëve nga cilado gjykatë tjetër, e themeluar me jurisdiksionin e apelit, por jo më pak se dy (2)**

gjqtarë do të jenë nga radhët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.

- (7) Gjykata të specializuara mund të themelohen me ligj kur kjo të jetë e nevojshme, por në asnjë mënyrë nuk mund të themelohen gjykata të jashtëzakonshme.**

Neni 103

1. Neni 103 vendos parime mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave të rregullta në Kosovë, duke e plotësuar nenin 102. Neni 103, prandaj, përcakton autoritetin që autorizohet nga ana e Kushtetutës për të themeluar gjykata, për të përcaktuar juridiksionin e tyre, dhe për të vendosur mbi nivelet e kompetencave të tyre. Gjithashtu, neni 103 e përcakton gjykatën më të lartë të vendit, sa i përket gjyqësorit të rregullt, dhe përcakton parimet që udhëheqin me pjesëmarrjen e komuniteteve pakicë në përbërjen e gjykatave të rregullta në Kosovë. Ky nen po ashtu vë linjat që përcaktojnë zgjedhjen e gjyqtarëve, përfshirë edhe procedurën, dhe përcakton zgjedhjen e kryetarit/es të gjykatës më të lartë në vend. Përveç këtyre parimeve, neni 103 vendos edhe mbi ndalimin e themelimit të gjykatave të jashtëzakonshme, si dhe jep drejtime mbi themelimin e gjykatave të specializuara. Thënë në përgjithësi, neni 103 vendos parimet dhe standardet që duhet të sendërtohen me legjislacionin përkatës sa i përket organizimit dhe funksionimit të gjykatave të rregullta, në veçanti gjykatës më të lartë.

Neni 103.1

1. Ky paragraf vendos parimet themelore sa i përket themelimit të gjykatave në Kosovë. Në përgjithësi, Kushtetuta nuk përcakton llojin, nivelet dhe juridiksionin e gjykatave në Kosovë. Kushtetuta vetëm përcakton parime në lidhje me themelimin, juridiksionin, dhe organizimin e gjykatave në Kosovë. Ky paragraf përcakton tri parime themelore sa i përket gjykatave në Kosovë. një, që themelohet me Kushtetutë një gjykatë, që quhet Gjykata Supreme e Kosovës, e cila përbën autoritetin më të lartë të gjyqësorit të rregullt. Dy, që themelimi dhe organizimi i gjykatave tjera, të çdo niveli, i besohet Kuvendit të Kosovës, i cili duhet ta ushtrojë këtë kompetencë përmes të drejtës së saj për nxjerrjen e ligjeve. Pra, themelimi dhe organizimi i gjykatave tjera në Kosovë bëhet me ligj, dhe Kushtetuta qëllimisht heq dorë nga themelimi direkt prej saj i të gjitha gjykatave tjera me nivel të instancës më të ulët se Gjykata Supreme, dhe tre, që juridiksioni i të gjitha gjykatave në Kosovë përcaktohet me ligj, dhe rrjedhimisht kjo mbetet një kompetencë e Kuvendit të Kosovës, e cila sendërtohet përmes së drejtës së tij për nxjerrjen e ligjeve.⁶⁰⁴

⁶⁰⁴ Ligji që rregullon çështjet që kanë të bëjnë me Gjykatën Supreme dhe Gjykatat tjera të rregullta quhet Ligji 03/L-199 për Gjykatat, i datës 22 korrik 2010, i cili ka 43 nene. Sipas këtij Ligji, i tërë sistemi gjyqësor në Kosovë përbëhet prej: Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme. Ekzistojnë shtatë (7) Gjykata Themelore të cilat mbulojnë tërë territorin e Kosovës, kurse degët e tyre themelohen nëpër komunat e caktuara me saktësi. Në Gjykatën e Apelit ekzistojnë vetëm departamente të cilat janë të specializuara për gjykimin e çështjeve të caktuara.

2. Sa i përket autorizimit për themelimin, përveç Gjykatës Supreme, organizimin dhe funksionimin e të gjitha gjykatave tjera që i besohet Kuvendit të Kosovës përmes së drejtës së tij për nxjerrjen e ligjeve, mund të thuhet që ky autorizim përfshin: a) përcaktimin e numrit të gjykatave të rregullta që do të ketë Kosova, përveç Gjykatës Supreme, b) përcaktimin e numrit të gjyqtarëve që do të ketë secila gjykatë, c) ndarjen e territorit shtetëror në zona gjyqësore, me qëllim të demarkacionit të hapësirave territoriale ku shtrihet juridiksioni i gjykatave të rregullta, si dhe përcaktimin e juridiksionit të tyre c) përcaktimin e llojit të gjykatave, dhe instancave të tyre, me qëllim të sendërtimit të parimit të shumë-shkallshmërisë të vendosur me nenin 102 të Kushtetutës, d) përcaktimin e mënyrës së udhëheqjes së gjykatave, dhe të marrjes së vendimeve në to, sipas llojit të juridiksionit, dhe e) përcaktimin e mënyrës së ekzekutimit të vendimeve të tyre, përfshirë edhe mekanizmin përcjellës.
3. Sa i përket arsyes së lënies Kuvendit të Kosovës të autorizimit për të themeluar, organizuar, dhe përcaktuar funksionimin dhe juridiksionin e gjykatave përmes të drejtës së tij për nxjerrjen e ligjeve, mund të thuhet që kjo është bërë me qëllim të lënies së mundësisë që këto çështje të mund të jenë subjekt i një regjimi rregullues më efikas, i cili mund t'i përshtatet rrethanave të kohës në mënyrë më të shpejtë, përmes një procedure të nxjerrjes së ligjeve. Këtu duhet qartësuar që, megjithatë, e drejta e Kuvendit të Kosovës për të themeluar dhe përcaktuar organizimin dhe funksionimin, si dhe për të vendosur juridiksionin e gjykatave në Kosovë, nuk mund të bëhet jashtë parimeve të vendosura në veçanti në nenin 102, por edhe sipas standardeve tjera të vendosura nga Kushtetuta. Kjo do të thotë se ligjet e Kuvendit të Kosovës që e rregullojnë këtë materie, sipas autorizimit të nenit 103 të Kushtetutës, i nënshtrohen kontrollit të kushtetutshmërisë, dhe si të tilla nuk mund të shkelin standardet e vëna nga Kushtetuta sa i përket pushtetit gjyqësor. Autorizimi që i jepet Kuvendit të Kosovës për të themeluar, përcaktuar organizimin dhe funksionimin, si dhe juridiksionin e gjykatave në Kosovë është absolutisht i kufizuar dhe nuk lejohet që ky autorizim të shfrytëzohet për të përvetësuar pushtet nga gjyqësori, apo për t'i kufizuar atij një veprim që shkel parimet e sendërtuara me nenin 102, por edhe me nenet tjera të kësaj Kushtetute.

Neni 103.2

1. Ky paragraf përcakton gjykatën më të lartë brenda pushtetit gjyqësor të Kosovës, përkatësisht Gjykatën Supreme të Kosovës. Në përgjithësi, ky është paragrafi i vetëm që përcakton parim hierarkik në pushtetin gjyqësor të vendit, duke e lënë që çështja e rregullimit të gjykatave më të ulëta, dhe e instancave të tyre juridiksionale të bëhet me anë të ligjit.
2. Sa i përket këtij paragrafi, Gjykata Supreme përcaktohet si instanca më e lartë juridiksionale brenda pushtetit gjyqësor të Kosovës. Kushtetuta, megjithatë, nuk përcakton se çfarë është juridiksioni i përgjithshëm apo i specializuar i kësaj gjykate. Përcaktimin e juridiksionit të përgjithshëm dhe të specializuar, Kushtetuta ia njeh Kuvendit, i cili duhet ta përcaktojë atë përmes ligjeve përkatëse. Në kuptim

të këtij paragrafi, Gjykata Supreme është instanca më e lartë gjyqësore e cila ka kompetencë në tërësinë territoriale dhe lëndore. Si parim, Gjykata Supreme nuk vepron si shkallë e parë në asnjë rast gjyqësor, dhe ky juridiksion mund t'i njihet kësaj gjykate vetëm përjashtimisht. Prandaj, Gjykata Supreme vepron si gjykatë e apelit përfundimtar. Në këtë aspekt, i mbetet rregullimit ligjor që të përcaktojë nëse juridiksioni i Gjykatës Supreme, dhe në cilat raste, është i karakterit të apelit të rregullt apo të jashtëzakonshëm.

3. Nevoja që Kushtetuta të rregullojë dhe themelojë vetëm instancën më të lartë gjyqësore të pushtetit gjyqësor, dhe jo gjykatat tjera, lidhet me faktin se Gjykata Supreme duhet të ketë pozicion dhe parime kushtetuese që udhëheqin me të, duke mos lënë mundësi që kjo çështje të rregullohet nga legjislatura. Shkurt, garantimi kushtetues i pozitës dhe i rolit të Gjykatës Supreme paraqet garancionin kyç i cili vërteton se ky institucion nuk do të lihet në mëshirën e ndryshimeve politike që ndodhin në Kuvend. Si i tillë, garancioni kushtetues paraqet një standard kushtetues gjerësisht të pranuar në të drejtën kushtetuese komparative të vendeve demokratike.⁶⁰⁵

Neni 103.3

1. Ky paragraf përcakton përbërjen etnike të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës. Fillimisht, është e rëndësishme të ceket se Kushtetuta nuk përcakton mënyrën e vendimmarrjes dhe numrin e përgjithshëm të gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, duke e lënë që një gjë e tillë të rregullohet me ligj. Ky paragraf vetëm vendos proporcionin etnik që, si standard minimal, duhet të ketë përbërja e Gjykatës Supreme. Përcaktimi që së paku 15% e gjyqtarëve të kësaj gjykate duhet të jenë me prejardhje etnike nga radhët e komuniteteve pakicë është standard i modelit të demokracisë konsociale (“consociational”) që vendos Kushtetuta e Kosovës, si dhe shprehje e karakterit multi-etnik të Kosovës si standard i proklamuar me Kushtetutë. Në këtë kuptim, ky paragraf mundëson që komunitetet etnike në Kosovë të jenë të përfaqësuar në instancën më të lartë gjyqësore të vendit në mënyrë ekstra-proporcionale, duke mundësuar që përbërja multi-etnike e Kosovës të jetë e reflektuar edhe në Gjykatën Supreme.
2. Duhet thënë që, pavarësisht faktit që ky paragraf i jep karakter multi-etnik dhe konsocial përbërjes së Gjykatës Supreme, i njëjti nuk vendos të drejtë të vetos apo përparësi votimi për gjyqtarët që përfaqësojnë komunitetet pakicë në Kosovë. Kjo, prandaj, tregon që Kushtetuta nuk lejon që vendimet që merren nga një trup gjyqësor me përbërje multi-etnike të mund të bllokohen nga gjyqtarët nga komunitetet pakicë, gjë e cila do t'ia humbiste Gjykatës Supreme karakterin e saj unitar dhe gjyqësor.

⁶⁰⁵ Shapiro, Martin (1981) ‘Courts. A Comparative and Political Analysis’. Chicago: The University of Chicago Press; Jacob, Herbert, Blankenburg, Erhard, Kritzer, M., Herbert, Provine, M., Doris, and Sanders, Joseph (eds.) (1996) ‘Courts, Law, and Politics in Comparative Perspective’. New Haven and London: Yale University Press.

1. Ky paragraf përcakton mënyrën e zgjedhjes dhe kohëzgjatjen e mandatit të Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës.
Sa i përket mënyrës së zgjedhjes, ky paragraf përcakton që kryetari i Gjykatës Supreme emërohet nga ana e Presidentit të Kosovës, nga radhët e gjyqtarëve aktual të Gjykatës, pas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. E njëjta procedurë ndiqet edhe me rastin e shkarkimit të kryetarit të Gjykatës Supreme. Fillimisht, duhet thënë që kryetari i Gjykatës Supreme duhet propozuar nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, një organ i pavarur rregullator i pushtetit gjyqësor, propozimi i së cilës pastaj konfirmohet në formë të emërimit nga ana e Presidentit të Republikës. Kompetenca e Presidentit të Republikës është kompetencë e *ndarë* me Këshillin Gjyqësor, që nënkupton se Presidenti i Republikës nuk mund as të emërojë as të shkarkojë kryetarin e Gjykatës Supreme pa pasur propozimin e Këshillit Gjyqësor. Pyetje themelore në këtë aspekt mbetet nëse Presidenti i Republikës mund ta refuzojë emërimin e një kandidati të propozuar nga Këshilli Gjyqësor për kryetar të Gjykatës Supreme? Kjo çështje kërkon shpjegime më të thella, qoftë edhe filozofike, që nënkupton se, në parim, ky paragraf i Kushtetutës nuk duhet lexuar në mënyrë të thjeshtë. Argumenti themelor për këtë është që, sikur Presidenti i Republikës të kishte të drejtën e *vendosjes* për ta pranuar apo jo propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, atëherë kjo do të përbënte një veprim të shkeljes së Presidentit të Republikës në terrenin e pushtetit gjyqësor dhe, si rezultat, do të shkelte parimin e ndarjes së pushteteve. Në këtë aspekt, argumenti themelor këtu mbetet që, kur ky paragraf thotë që Presidenti i Republikës *emëron* Kryetarin e Gjykatës Supreme, termi *emëron* i referohet shfrytëzimit të një kompetence që Presidenti i Republikës e ka si *kreu i shtetit*. Natyrisht, kjo kompetencë është e karakterit *ceremonial*, dhe jo vendimmarrës. Argumenti themelor për këtë është se kompetenca për të *emëruar* kryetarin e Gjykatës Supreme është thjesht një detyrim për ta *konfirmuar* propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Refuzimi eventual për ta bërë një gjë të tillë me arsyetimin se Presidenti i Republikës është i veshur me kompetencë *ekzekutive* për ta emëruar kryetarin e Gjykatës Supreme, përbën veprim me anë të së cilit gjyqtarët e Gjykatës Supreme do të ndiheshin të afektuar nga *joshjet* e Presidentit të Republikës dhe, si rezultat, parimi i ndarjes së pushtetit dhe i pavarësisë gjyqësore do të rrezikoheshin seriozisht.
2. Ky paragraf, gjithashtu, përcakton që kryetari i Gjykatës Supreme ka një mandat shtatëvjeçar, dhe se i njëjti nuk mund të riemërohet. Sa i përket kohëzgjatjes së mandatit, argumenti themelor është që kohëzgjatja e mandatit të Gjykatës Supreme është relativisht e gjatë, sa për të garantuar që i njëjti të mos bie nën presionin e kohës në kuptim të pavarësisë së punës së tij. Natyrisht, përfundimi i mandatit të një Kryetari të Gjykatës Supreme mund të bëhet edhe më herët, në rast se përfundon mandati i tij/saj si gjyqtar i Gjykatës në fjalë.

Neni 103.5

1. Ky paragraf përcakton mënyrën e zgjedhjes së kryetarëve të gjykatave tjera, përveç Gjykatës Supreme të Kosovës. Sipas këtij paragrafi, zgjedhja e kryetarëve të gjykatave tjera mbetet çështje që rregullohet përmes ligjit. Thënë shkurtimisht, Kushtetuta nuk e përcakton mënyrën e zgjedhjes së kryetarëve të gjykatave tjera.

Neni 103.6

1. Ky paragraf përcakton përbërjen etnike të gjykatave të apelit, duke ndjekur shembullin e njëjtë me përcaktimin për Gjykatën Supreme. Prandaj, ky paragraf përcakton një minimum prej 15% të gjyqtarëve nga radhët e komuniteteve pakicë si përbërje e detyrueshme për çdo gjykatë të apelit, duke e fuqizuar karakterin konsocial (“consociational”) dhe multietnik të proklamuar nga Kushtetuta, siç u shpjegua në pjesën e mësipërme.

Neni 103.7

1. Ky paragraf jep autorizimin kushtetues për themelimin e gjykatave të specializuara, përveç atyre të rregullta, duke e bërë të qartë se themelimi i tyre mund të bëhet vetëm me ligj. Gjykatat e specializuara janë gjykata me kompetencë lëndore të një dege të caktuar materiale, p.sh. gjykata administrative, të cilat kanë juridiksion të specializuar dhe ekskluziv për gjykimin e çështjeve në atë fushë. Lejimi që ky paragraf bën për themelimin e gjykatave të specializuara i shërben trendeve moderne për rritjen e efikasitetit të pushtetit gjyqësor përmes themelimit të gjykatave të specializuara për materie të caktuara, megjithatë themelimi i gjykatave të tilla mbetet subjekt i standardeve kushtetuese të proklamuar më lartë.
2. Në anën tjetër, ky paragraf ndalon në mënyrë eksplicite themelimin e gjykatave të jashtëzakonshme, duke vënë një standard mbrojtjeje ndaj qytetarëve në kuptim të rregullsisë së procedurave gjyqësore.

Neni 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve]

- (1) Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- (2) Përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Kosovës dhe parimet e pranuar ndërkombëtarisht të barazisë gjinore.
- (3) Përbërja e gjykatave pasqyron përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Para dhënies së propozimit për emërim ose riemërim, Këshilli Gjyqësor i Kosovës këshillohet me gjykatën përkatëse.
- (4) Gjyqtarët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një veprë të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave.
- (5) Gjyqtarët kanë të drejtë të ankohen ndaj vendimit mbi shkarkimin drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës.

(6) Gjyqtarët nuk mund të transferohen kundër vullnetit të tyre, përveç nëse është parashikuar ndryshe me ligj, për shkak të funksionimit efikas të gjyqësorit ose masave disiplinore.

Neni 104

1. Neni 104 përcakton procedurën e emërimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve, si dhe vendos garancionet procedurale dhe meritore për një proces të tillë. Në kuptim të këtij neni, përzgjedhja e gjyqtarëve kalon nëpër disa etapa juridikisht të përcaktuara, garantimi i kredibilitetit të të cilave i vishet në përgjegjësi Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Përveç kësaj, ky nen përcakton edhe disa standarde të cilat lidhen me përfaqësim multietnik dhe gjinor në kontekstin kosovar. Këto përcaktime janë në nivel parimi, ashtu që nuk ka nevojë të përsëriten. Si të tilla, ato shërbejnë si standarde bazë për çdo aktivitet dhe punë të cilat duhet të kryhen nga organet kushtetuese e ligjore. Thënë shkurt, këto standarde shërbejnë si matës që dëftojnë për kushtetutshmërinë e veprimtarisë dhe të punës të cilën e kryejnë organet kushtetuese në kontekstin kosovar.

Neni 104.1

1. Neni 104.1 përcakton që gjyqtarët në Republikën e Kosovës emërohen dhe shkarkohen nga ana e Presidentit të Republikës, me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ky përcaktim kushtetues nënkupton se emërimi i gjyqtarëve të rregullt është një kompetencë e ndarë, të paktën formalisht, në mes të Presidentit të Republikës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Në këtë kuptim, janë tri pyetje që lindin nga ky paragraf, si vijon: një, cilës kategori të gjyqtarëve i referohet neni 104.1 dhe procedura përkatëse për zgjedhjen e tyre; dy, çfarë nënkuptimi kushtetues kanë termet “emërim” dhe “propozim” që janë dy segmentet më të rëndësishme të këtij paragrafi; dhe, tre, sa është gjerësia e emërimit dhe shkarkimit të vendosur me këtë nen.
2. Sa i përket pyetjes së parë, neni 104.1 i referohet ekskluzivisht gjyqtarëve të rregullt në Republikën e Kosovës, përkatësisht gjyqtarëve që janë pjesë e gjyqësorit të rregullt.⁶⁰⁶ Natyrisht, ky nen nuk përfshin çështjen e emërimit të gjyqtarëve kushtetues, meqë këta të fundit përbëjnë një kategori jo të rregullt gjyqësore, dhe procedura për emërimin e tyre përcaktohet me anë të një neni të veçantë të Kushtetutës (neni 114).
3. Në kuptim të pyetjes së dytë, neni 104.1 përcakton që presidenti i republikës emëron dhe shkarkon gjyqtarët e rregullt sipas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Dy pyetje bazike lindin nga një përcaktim i tillë: një, a është i obliguar

⁶⁰⁶ Si një shembull krahasues nga jurisprudenca shqiptare, urdhërat e përsëritura të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit për pezullimin e procedurës përbarimore të një vendimi në procedurë civile të formës së prerë, dhe pezullimi i përbarimit janë veprime antikushtetuese dhe antiligjore (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë i datës 31.9.1995 (nuk ka numër të vendimit));

presidenti i republikës që të ndjek “detyrueshëm” propozimin e Këshillit Gjyqësor?; dhe, dy, a mundet që presidenti i republikës t’i ushtroj kontroll, dhe, nëse po, çfarë lloji, sipas propozimit të Këshillit Gjyqësor? Në kuptim të pyetjes së parë, siç është argumentuar edhe në pjesën e mësipërme të komentarit, kompetenca e presidenti të republikës për të “emëruar” gjyqtarët e rregullt është thjeshtë një kompetencë formale, që ai e ushtron si shef i shtetit. Prandaj, neni 104.1 nuk e vesh presidentin e republikës me një kompetencë të llojit ekzekutiv, ku ky i fundit të mund të ushtronte diskrecionin e tij mbi një propozim të Këshillit Gjyqësor. Nëse kjo kompetencë do të interpretohej si autoritet me diskrecion i presidenti të republikës ku ky i fundit të kishte edhe mundësinë e refuzimit të propozimeve të Këshillit Gjyqësor, një interpretim i tillë do të shkonte në kundërshtim me parimin kushtetues të pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore dhe të ndarjes së pushteteve. Prandaj, në këtë kuptim të nenit 104.1, presidenti i republikës është i detyruar që një propozim të Këshillit Gjyqësor për emërim apo shkarkim të gjyqtarëve ta dekretojë sipas detyrimit të tij si kreu i shtetit, situatë në të cilën ky i fundit nuk ka asnjë hapësirë juridiksionale për të kontrolluar substancën e propozimeve të Këshillit. E vetmja hapësirë sipas nenit 104.1 ku presidenti i republikës të mund të refuzojë dekretimin e një propozimi për emërim apo shkarkim të një gjyqtari që vjen nga Këshillit Gjyqësor është rasti kur presidenti është në gjendje të arsyetojë që propozimi i Këshillit Gjyqësor ka shkelje procedurale, raste të tilla siç mund të jetë mungesa e votave të mjaftueshme në Këshill për të kaluar një vendim të tillë, apo edhe mangësitë formale në vendimin e Këshillit. Kontrolli substancial/meritor i propozimeve të Këshillit Gjyqësor sa i përket emërimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve është plotësisht i ndaluar në kuptim të nenit 104.1 dhe standardeve juridike që rrjedhin nga parimet e pavarësisë dhe paanësisë gjyqësore që janë shpjeguar më lartë.

4. Në kuptim të paragrafit të fundit, duhet thënë megjithatë që presidenti i republikës, sipas nenit 104.1, nuk gëzon mundësi që të emërojë apo shkarkojë një gjyqtar pa propozimin e Këshillit Gjyqësor, përderisa ky i fundit nuk mund që të ushtrojë i vetëm procesin e emërimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve.
5. Në kuptim të pyetjes së tretë që del nga neni 104.1, duhet thënë që presidenti i republikës dhe Këshilli Gjyqësor, në ushtrimin e autorizimeve, sipas nenit 104.1, nuk janë të kufizuar në numrin apo kohën e emërimit të gjyqtarëve. Kompetenca e riemërimit të gjyqtarëve, e dhënë sipas këtij neni, ka të njëjtin komentim sikur edhe për “emërimin”.

Neni 104.2

1. Neni 104.2 përcakton që përbërja e gjyqësorit pasqyron shumëllojshmërinë etnike të Kosovës dhe parimet e pranuara ndërkombëtarisht të barazisë gjinore. Si i tillë, ky nen vendos detyrimin kushtetues që gjykatat e rregullta në Republikën e Kosovës të kenë një përfaqësim etnik sipas pasqyrës etnike të Kosovës, ku komunitetet etnike jo-shumicë kanë status të garantuar të përfaqësimit në nivel gjyqtarësh. Ky standard sa i përket përfaqësimit të komuniteteve etnike jo-shumicë

i vendosur me këtë nen shërben si prag minimal i garancionit, ashtu që nenet *speciale* të kushtetutës apo ligjet përkatëse kanë hapësirë për të dhënë garancinë që e tejkalojnë një prag të tillë.

Neni 104.3

1. Neni 104.3 përcakton që përbërja e gjykatave, në kuptim të gjyqtarëve, pasqyron përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Në të njëjtën kohë, ky paragraf përcakton që Këshilli Gjyqësor, para dhënies së propozimit për emërim apo riemërim, këshillohet me gjykatën përkatëse. Me këtë nen, prandaj, vendoset standardi që përfaqësimi etnik në përbërjen e gjyqësorit garantohej sipas përbërjes/pasqyrës etnike të territorit ku një gjykatë e caktuar ka juridiksionin territorial. Kjo do të thotë që, nëse marrim shembullin e Gjykatës Themelore të Pejës, përbërja etnike e kësaj gjykate duhet të jetë pasqyrim etnik proporcional i popullsisë lokale në territorin ku shtrin juridiksionin kjo gjykatë. Ky parim mundëson që komunitetet joshumicë të kenë përfaqësim të garantuar në rrethet gjyqësore ku ato jetojnë, përderisa, në të njëjtën kohë, ky parim pamundëson që përfaqësimi i komuniteteve joshumicë të bëhet në rrethet gjyqësore ku nuk jetojnë komunitetet joshumicë. Ky garancion mundëson që komunitetet joshumicë të kenë gjyqtarë nga etnia e tyre në gjykatën përkatëse që mbulon territorialisht lokalitetin ku jetojnë ato.
2. Në anën tjetër, ky nen gjithashtu kërkon që në rastet e tilla, propozimet për emërim të Këshillit Gjyqësor të jenë më parë të këshilluara me gjykatën përkatëse. Termi “këshillim” i përdorur në këtë rast, nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që gjykata të ketë mundësinë e “refuzimit” të propozimit që do të procedojë Këshilli Gjyqësor, por vetëm që gjykata përkatëse të “vlerësoj” nëse kandidati për gjyqtar që është për t’u propozuar nga Këshilli Gjyqësor i takon komunitetit për të cilën Këshilli e vesh zgjedhjen e tillë. Në një vendim të tillë, gjykata përkatëse nuk ka fuqi që t’i ushtroj refuzim për arsye substanciale një propozimi të Këshillit, pos nëse është në diskutim etniteti i kandidatit të propozuar nga Këshilli, dhe përputhshmëria e një kandidature të tillë sipas standardit të këtij neni.

Neni 104.4

1. Neni 104.4 përcakton që gjyqtarët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër penale ose për shkak të mosrespektimit të rëndë të detyrave gjyqësore. Si i tillë, ky paragraf vendos një garanci shumë të fuqishme mbi mandatin e gjyqtarëve, që shërben gjithashtu si një mjet mbrojtjes nga shkarkimet e motivuara apo të ndikuara politikisht. Prandaj, në kuptim të këtij neni, gjyqtarët mund të shkarkohen vetëm mbi dy baza, atë të dënimit për një vepër të rëndë penale, përcaktimin e së cilës e bën Kodi Penal i Republikës së Kosovës, dhe për shkak të mosrespektimit të rëndë të detyrave gjyqësore. Sa i përket kësaj të fundit, duhet thënë që standardet e shkarkimit me një vendim të arsyetuar mbi bazë faktike të verifikuar, siç është shpjeguar në pjesën e mësipërme të këtij komentari, vlejnë edhe këtu.

Neni 104.5

1. Neni 104.5 përcakton që gjyqtarët kanë të drejtë të ankohen ndaj një vendimi mbi shkarkimin e tyre në Gjykatën Supreme të Kosovës. Neni 104.5, prandaj, vendos garancionin që shkarkimi i gjyqtarëve të mos mund të bëhet thjeshtë dhe vetëm nga një interaksion i Këshillit Gjyqësor dhe presidentit të republikës, por që gjyqtari i shkarkuar të ketë mundësi që vendimin për shkarkimin e tij ta dërgojë për kontroll gjyqësor në Gjykatën Supreme. Ky garancion, prandaj, mundëson që vendimi mbi shkarkimin e një gjyqtari t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor, nga instanca më e lartë e gjyqësorit të rregullt, në mënyrë që ligjshmëria e vendimit për shkarkim të vet gjyqtarit të lejohet apo refuzohet nga vet instanca më e lartë e gjyqësorit të rregullt. Duhet thënë që, në kuptim të këtij paragrafi, vendimi i Gjykatës Supreme për ligjshmërinë e vendimit mbi shkarkimin e gjyqtarit është i formës së prerë dhe prodhon efekt juridik të detyrueshëm për palët. Prandaj, vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit për shkarkim nga ana e Gjykatës Supreme mund të ketë pasojë anulimin e vendimit për shkarkim të dekretuar nga presidenti i republikës, sipas propozimit të Këshillit Gjyqësor.
2. Thënë në përgjithësi, shkarkimi i gjyqtarëve sipas këtij neni, sipas kërkesës së gjyqtarit të shkarkuar, i nënshtrohet kontrollit gjyqësor nga Gjykata Supreme, andaj edhe shërben si standard për garantimin e rregullsisë procedurale dhe meritës së vet vendimit për shkarkim të dhënë nga presidenti i republikës kundër një gjyqtari të caktuar.

Neni 104.6

1. Neni 104.6 përcakton që gjyqtarët nuk mund të transferohen kundër vullnetit të tyre, përveç nëse është parashikuar ndryshe me ligj, për shkak të funksionimit efikas të gjyqësorit dhe masave disiplinore. Në këtë kuptim, neni 104.6 vendos garancionin juridik që gjyqtarët të mos mund të transferohen jashtë vullnetit të tyre, apo edhe që transferimi i gjyqtarëve të shfrytëzohet si një formë e presionit kundër tyre. Megjithatë, transferi i gjyqtarëve mund të ndodhë vetëm në dy rrethana të caktuara, të cilat duhen të jenë të detajuara me ligj, si vijon: një, për shkak të efikasitetit të gjyqësorit, dhe dy, për shkak të masave disiplinore të marra nga një gjyqtar. Në këtë kuptim, sipas nenit 104.6, nëse vendimi për transfero hyn në kuadrin e këtyre dy përjashtimeve, ai duhet të jetë i arsyetuar nga Këshilli Gjyqësor sa i përket arsyeshmërisë faktike të provimit të njëres nga këto dy rrethana. Çdo vendim i Këshillit që nuk respekton këto dy standarde kushtetuese për transfer është arbitrar, kurse ligji i nxjerrë në mosrespektim të tyre do të ishte kundër kushtetues sepse, si i tillë, ai do të cenonte parimin e proporcionalitetit i cili thotë se “të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur e demokratike të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi” (neni 55.2 i Kushtetutës).

Neni 105 [Mandati dhe Riemërimi]

- (1) Mandati fillestar për gjyqtarët është trevjeçar. Në raste të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar më ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin.**
- (2) Kriteret dhe procedurat për riemërimin e një gjyqtari, përcaktohen nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe ato mund të dallojnë në shkallë nga kriteret e përdorura për shkarkimin e gjyqtarëve.**

Neni 105

1. Neni 105 përcakton kohëzgjatjen e mandatit të gjyqtarëve të gjyqësorit të rregullt, dhe vendos disa nga parimet themelore të përjetshmërisë së mandatit gjyqësor në rast të rizgjedhjes. Në këtë kuptim, neni 105 përbën burimin kushtetues ku përcaktohen kategoritë e mandatit të gjyqtarëve. Siç mund të vërehet këtu, ka dy përcaktime kushtetuese lidhur me mandatin e gjyqtarëve. I pari përcaktim kushtetues i jep ligjit hapësirë për rregullim të mandatit fillestar, kurse përcaktimi i dytë lejon Këshillin Gjyqësor që të përcaktojë kriteret dhe procedurat e mandateve të cilat fitohen përmes riemërimeve. Ky përcaktim kushtetues është në frymën e standardeve krahasuese kushtetuese, përveç disa dallimeve që lidhen me formën institucionale të realizimit të tij.

Neni 105.1

1. Ky nen përcakton që mandati fillestar për gjyqtarët është trevjeçar, përderisa, në rast të riemërimit, mandati i gjyqtarit është i përjetshëm deri në moshën e pensionit. Mosha e pensionimit, natyrshëm, përcaktohet me ligj, përderisa një gjyqtar i riemëruar mund t'i nënshtrohet procesit të shkarkimit.
2. Në kuptim të nenit 105.1, ekzistojnë dy lloje mandatesh të gjyqtarëve, si vijon: një, mandati fillestar i gjyqtarit, ku ai/ajo gëzon një mandat në kohëzgjatje prej 3 vjetësh, dhe dy, mandati i përjetshëm, që i vishet një gjyqtari të riemëruar sipas këtij neni. Shikuar në perspektivën e mekanizmit, qëllimi i këtij neni është që të lejojë mundësinë që, një gjyqtari të emëruar për tri vite, t'i vlerësohet performanca si standard bazik mbi bazën e të cilit të vendoset nëse gjyqtari do të fitojë mandat të përjetshëm. Nëse, megjithatë, gjyqtari riemërohet, ai vishet me një mandat të përjetshëm, deri në pensionim sipas ligjit. Mandati i përjetshëm i mundëson gjyqtarit përkatës që të ushtrojë funksionin e tij pa qenë i varur nga aktorët institucional të cilët do të mund të ishin shndërruar në faktorë përcaktues në rast të nevojës së tij për rizgjedhje. Prandaj, ky standard juridik, siç është shpjeguar mësipër, përbën një nga parimet më të rëndësishme ndërkombëtare që shërbejnë për të mundësuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve, dhe hapësirën e tyre të nevojshme për të vepruar jashtë ndikimeve të institucioneve që kanë dorë në zgjedhjen e gjyqtarëve. Duhet thënë që, megjithatë, fitimi i së drejtës për një mandat të përjetshëm, nuk e përjashton gjyqtarin përkatës nga mundësia e

përfashtimit sipas parimeve të cekura më sipër, por as nuk e përjashton atë nga një procedurë eventuale e transferit, sipas dy bazave juridike të shpjeguara më herët.

Neni 105.2

1. Neni 105.2 përcakton që kriteret dhe procedurat për riemërimin e një gjyqtari përcaktohen nga Këshilli Gjyqësor, dhe ato mund të dallojnë në shkallë nga kriteret e përdorura për shkarkimin e gjyqtarëve. Prandaj, neni 105.2 e përcakton që autorizimi për të vendosur standardet substanciale mbi të cilat vendoset mbi riemërimin e një gjyqtari që ushtronte një mandat fillestar 3 vjeçar i takon Këshillit Gjyqësor, duke e përjashtuar Kuvendin që të vendos për standardet e tilla përmes nxjerrjes së një ligji. Kjo dispozitë kushtetuese ka rëndësi tepër të madhe për të garantuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve dhe të gjyqësorit sepse pengon trupat politik, siç është Kuvendi, që të ushtrojnë ndikim në riemërimet e gjyqtarëve. Pa këtë dispozitë, Kuvendi do të kishte mundësinë e ndikimit thelbësor në punët e gjyqësorit duke i vlerësuar gjyqtarët fillestar sipas kriterëve politike, dhe për pasojë, duke nxjerrë ligje që përcaktojnë kriteret procedura për riemërim krejtësisht mbi baza joprofesionale. Përmes këtij përcaktimi kushtetues edhe më shumë sigurohet ndarja e pushteteve sepse largohet distanca dhe mundësia e ndikimit të organeve politike në punët e gjyqësorit.

Neni 106 [Papajtueshmëria]

- (1) **Gjyqtari nuk mund të ushtrojë ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit, të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet politik ose ndonjë aktivitet tjetër të ndaluar me ligj.**
- (2) **Gjyqtarëve nuk u lejohe të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve, të cilat në çfarëdo mënyre, do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paansësisë së rolit të gjyqtarit.**

Neni 106

1. Neni 106 përcakton rrethanat faktike dhe juridike të cilat e bëjnë të papajtueshëm një gjyqtar të caktuar për ushtrimin e funksionit gjyqësor. Çështja e papajtueshmërisë apo e konfliktit të interesit, paraqet një fenomen gjerësisht të elaboruar nga teoria, me fillim që nga Monteskje, dhe praktika, me fillim që nga ditët e para të Revolucionit Amerikan dhe atij Francez. Në fakt, papajtueshmëria e ushtrimit të njëkohshëm të disa funksioneve ka lindur në vijim të përsiatjeve njerëzore për të gjetur zgjidhje që garantojnë ndarjen e plotë dhe balancimin e pushteteve. Si e tillë, kjo përsiatje i takon teorisë dhe praktikës së konstitucionalizmit perëndimor.
2. Zgjedhjet kushtetuese që flasin për papajtueshmërinë e gjyqtarëve kanë ndjekur këtë vijë arsyetimi, pra që të sigurohet sa më shumë që të jetë e mundur ndarja dhe balancimi i pushteteve. Kjo është arsyeja që disa profesione, siç është rasti me

gjyqtarët e gjykatave të rregullta, kanë zënë vend të veçantë nëpër dispozitat e kushtetutave perëndimore. Më një fjalë, për dallim nga kufizimet e profesioneve tjera, ta zëmë të atyre mjekësore apo ngjashëm me to, për të cilat kushtetutat iu lejojnë hapësirë organeve përfaqësuese që t'i normojnë kufizimet e tilla ekskluzivisht me ligje, në rastin e gjyqtarëve dhe të disa profesioneve tjera që reflektojnë gjymtyrët kryesore të pushtetit (legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor), kushtetutat ë vendeve perëndimore në mënyrë shprehimore përcaktojnë kufizimet, përkatësisht rastet e konfliktit të interesit (papajftueshmërisë). Kosova këtë e ka bërë me këtë nen, të cilin do ta komentojmë në vijim.

Neni 106.1

1. Neni 106.1 përcakton që gjyqtari nuk mund të ushtroj ndonjë funksion në institucionet shtetërore jashtë gjyqësorit, të jetë i përfshirë në ndonjë aktivitet politik, apo në ndonjë aktivitet tjetër të ndaluar me ligj. Në këtë kuptim, janë tre rrethana faktike që e bëjnë një gjyqtar të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e tij gjyqësor, si vijon: 1) në rast se gjyqtari bart një funksion tjetër shtetëror, të çfarëdo lloji apo natyre, funksion i cili nuk hyn në terrenin gjyqësor; 2) në rast se gjyqtari është i përfshirë në ndonjë aktivitet politik, standardet mbi të cilat janë shpjeguar në pjesën e mësipërme, që nënkupton një përfshirje jo thjeshtë aktive por edhe pasive, dhe, 3) që gjyqtari të jetë i përfshirë në çfarëdo aktiviteti tjetër që është i ndaluar me ligj, si për gjyqtarët ashtu edhe për personat fizik në përgjithësi.

Neni 106.2

1. Neni 106.2 përcakton që gjyqtarët janë të ndaluar që të marrin përgjegjësi ose të jenë bartës të funksioneve që do të ishin në kundërshtim me parimet e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqtarit. Në respektimin e një ndalimi të tillë, gjyqtarët nuk lejohet që të bartin por as të ushtrojnë funksione të cilat ua paragjykojnë atyre pavarësinë dhe paanshmërinë, që janë përcaktuar si standarde gjerësisht të pranuar në botën demokratike të cilat i sqaruar në pjesën e mësipërme të komentarit.

Neni 107 [Imuniteti]

- (1) Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, gëzojnë imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni, për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera të ndërmarra që janë brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisë të tyre si gjyqtarë.
- (2) Gjyqtarët, përfshirë edhe gjyqtarët porotë, nuk gëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga funksioni, kur të kenë shkelur ligjin me qëllim.
- (3) Kur një gjyqtar akuzohet ose arrestohet, duhet të njoftohet pa vonesë Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Neni 107

1. Neni 107 përcakton imunitetin e gjyqtarëve, kufijtë e tij, si dhe procedurat ku imuniteti në fjalë garantohet.⁶⁰⁷ Në këtë aspekt, neni 107 vendos standardet e mbrojtjes së gjyqtarëve nga procedimet gjyqësore kundër tyre, si mënyrë e garantimit që ata të mund të ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë të pavarur dhe jashtë çdo presioni apo ndikimi. Ky përcaktim kushtetues ka një rëndësi të madhe në vendet e tranzicionit siç është rasti me Kosovën. Në vendet jostabile, imuniteti garanton që gjyqtarët e të gjitha profileve nuk do të kenë pasoja për punën e kryer në kuadër të kushtetutës, ligjeve dhe rregullave të profesionit. Kjo dispozitë fiton peshë të madhe kur kihet parasysh fakti se Kosova ka pasur një histori tragjike në zhvillimin e saj kushtetues në njëzet vitet e fundit para shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008. Si pasojë e atij zhvillimi, gjyqtarët e të gjitha profileve në Kosovë jo rrallë janë përndjekur nga organi i akuzës dhe nga individët privat për punët e tyre të kryera brenda rregullave të profesionit, të normave kushtetuese dhe ligjeve në fuqi në atë kohë.

Neni 107.1

1. Neni 107.1 vendos ndalimin që gjyqtarët, duke përfshirë edhe gjyqtarët porotë, të ndiqen penalisht, të paditën në procedurë civile, dhe të shkarkohen nga funksioni për vendimet e marra, votimin e bërë, mendimin e shprehur si dhe veprimet tjera të ndërmarra brenda fushëveprimit të funksionit të tyre gjyqësor. Natyrshëm, neni 107.1 i vesh gjyqtarët vetëm me imunitet funksional, që nënkupton se ata janë të mbrojtur nga ndjekja penale, paditë civile apo edhe shkarkimi vetëm për veprimet apo mosveprimet e ndërmarra në kuadër të autorizimeve që rrjedhin nga funksioni i tyre. Ky ngushtim i imunitetit për gjyqtarët, në këtë aspekt, lejon hapësirë që ata të ndjekin penalisht, të paditen apo edhe të shkarkohen për veprimet apo mosveprimet e tyre jashtë funksionit të tyre gjyqësor.

Neni 107.2

1. Neni 107.2 përcakton që gjyqtarët, duke përfshirë edhe gjyqtarët porotë, nuk gëzojnë imunitet dhe mund të shkarkohen nga funksioni nëse kanë shkelur ligjin me qëllim. Ky paragraf, prandaj, vendos standardin që gjyqtarët të mund të shkarkohen për shkelje ligjore vetëm nëse këtë e kanë bërë me qëllim. ‘Qëllimi’ për të shkelur ligjin, sado e vogël të ketë qenë shkelja, i zhvesh gjyqtarët nga imuniteti i dhënë me nenin 107.1.

⁶⁰⁷ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë në vendimin e saj 13/02 theksoi se në bazë të Kushtetutës, vetëm Zyra e Prokurorit Publik ka kompetenca të ngrejë padi dhe të ndërmarë hapa që mund të çojnë në përgjëgjësi penale, si dhe të takohet, kontrollojë dhe vlerësojë informacionet në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Prandaj, është kundër-kushtetuese t'i garantohet një të pestës (1/5) të anëtarëve të Komisionit të Shërbimit Gjyqësor (origj. Judicial Service Commission) e drejta për të kërkuar heqjen e imunitetit gjyqësor të ndonjë gjyqtari (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë 13/02 i datës 16.12.2002);

1. Neni 107.3 përcakton që në rast të akuzimit apo arrestimit të një gjyqtari, duhet njoftuar menjëherë Këshilli Gjyqësor. Detyrimi që policia, pas arrestimit, apo prokuroria, pas ngritjes së akuzës, të njoftojë Këshillin Gjyqësor pa asnjë vonesë i shërben qëllimit të monitorimit të veprimeve të policisë dhe prokurorisë kur objekt i veprimeve të tyre është një gjyqtar, duke e vlerësuar nëse mbi këtë të fundit po ushtrohet presion apo nëse vërtetë ky i fundit ka bërë shkelje ligjore për të cilën edhe është arrestuar/akuzuar.

Neni 108 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës]

- (1) Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor.
- (2) Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Këshilli Gjyqësor i Kosovës siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale e të paanshme, dhe të pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Republikës së Kosovës e të ndjekin parimet e barazisë gjinore. Këshilli do t'u japë përparësi për emërim si gjyqtarë, anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuara në mënyrën e përcaktuar me ligj.
- (3) Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim për pozita gjyqësore. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është po ashtu përgjegjës për transferimin dhe për procedurën disiplinore kundër gjyqtarëve.
- (4) Propozimet për emërimin e gjyqtarëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për emërim, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj.
- (5) Këshilli Gjyqësor i Kosovës është përgjegjës për inspektimin gjyqësor, administrimin gjyqësor, përpilimin e rregullave për gjykatat në pajtim me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administratorëve të gjykatave, hartimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit për gjyqësorin, përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin juridiksion dhe bën rekomandime për themelimin e gjykatave të reja. Themelimi i gjykatave të reja bëhet me ligj.
- (6) Këshilli Gjyqësor i Kosovës përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, me kualifikime dhe ekspertizë profesionale. Anëtarët emërohen për një mandat pesëvjeçar dhe zgjedhën në këtë mënyrë:
 1. Pesë (5) anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga anëtarët e gjyqësorit;
 2. Katër (4) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve. Të paktën

- dy (2) nga katër (4) anëtarët duhet të jenë gjyqtarë, dhe një (1) do të jetë anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës;
3. Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komunitetit Serb në Kosovë, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar;
 4. Dy (2) anëtarë i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve të tjera, dhe të paktën njëri prej këtyre të dyve, duhet të jetë gjyqtar;
 5. Papajtueshmëria e të qenit anëtar i Këshillit Gjyqësor rregullohet me ligj.
- (7) Këshilli Gjyqësor i Kosovës, nga radhët e anëtarëve të vet, zgjedh kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin me mandat trevjeçar. Zgjedhja në këto funksione nuk e zgjat mandatin e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
 - (8) Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës i drejtohet Kuvendit të Republikës së Kosovës së paku një herë në vit lidhur me Sistemin Gjyqësor.
 - (9) Kandidatët për pozita gjyqësore, të cilat janë të rezervuara për pjesëtarët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, mund të rekomandohen për emërim vetëm nga anëtarët e Këshillit të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për pjesëtarët e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë. Nëse ky grup i anëtarëve të Këshillit nuk e propozon kandidatin për këtë pozitë gjyqësore pas dy seancave të njëpasnjëshme të Këshillit, atëherë cilido anëtar i Këshillit ka të drejtë të rekomandojë kandidatin për atë pozitë gjyqësore.
 - (10) Kandidatët për pozita gjyqësore të gjykatave themelore, nën jurisdikcionin e të cilave përfshihet ekskluzivisht territori i një a më shumë komunave, ku shumica e popullsisë i takon komunitetit Serb të Kosovës, mund të rekomandohen për emërim vetëm nga dy (2) anëtarët e Këshillit që i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për komunitetin Serb në Republikën e Kosovës të cilët veprojnë bashkërisht dhe në mënyrë unanime. Nëse këta dy (2) anëtarë nuk rekomandojnë kandidat gjyqësor për këtë pozitë, gjatë dy seancave të njëpasnjëshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, atëherë cilido anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka të drejtë të propozojë kandidat për atë pozitë.

Neni 108

1. Neni 108 i vendos bazat për themelim dhe vendosje të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si një organ i pavarur shtetëror që rregullon, udhëheq dhe ruan integritetin e gjyqësisë së rregullt të shtetit. Ky nen vendos parimet organizative dhe funksionale të Këshillit Gjyqësor, përcakton përbërjen e tij, si dhe vendos mekanizmin përmes së cilit garantohet pjesëmarrja e përfaqësuesve të

komuniteteve joshumicë në të si dhe, përmes tij, në tërë sistemin e gjykatave të rregullta.

2. Nga dhjetë (10) paragrafët e këtij neni me të cilët normohet roli, pozita dhe rëndësia e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në kuadër të sistemit kushtetues, një pjesë bukur e madhe e tyre është kontekstuale që nënkupton se, si të tilla, këto dispozita synojnë rregullimin me efekt konstitutiv të pozitës së komuniteteve kosovare joshumicë në gjyqësorin e rregullt. Në këtë synim hyjnë edhe çështjet e administrimit dhe menaxhimit të kësaj dege të pushtetit. Pjesa tjetër e këtyre dispozitave të këtij neni, pesë (5) paragrafet e para, nuk janë kontekstuale dhe, si të tilla, gjenden edhe në kushtetutat e vendeve tjera demokratike, me disa dallime formale që lidhen me mekanizmin e emërimit të organit që ushtron kompetencat e njëjta me ato të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Dispozitat e paragrafeve 6-10, siç thamë, janë kontekstuale dhe adresojnë me efekt konstitutiv çështjet e përfaqësimit në gjyqësor të komuniteteve joshumicë. Dispozita të ngjashme gjenden edhe në kushtetutat e vendeve tjera, jo vetëm në rajon (p.sh. Maqedonia), por edhe më gjerë në Evropë (p.sh. në Belgjikë, Qipro, etj.).

Neni 108.1

1. Neni 108.1 përcakton që funksioni i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është sigurimi i pavarësisë dhe paanësisë së sistemit gjyqësor të shtetit. Meqë në pjesën e mësipërme është dhënë një sqarim i gjerë, sipas standardeve ndërkombëtare, i termeve “pavarësi” dhe “paanësi” gjyqësore, në këtë pjesë mbetet për t’u sqaruar vetëm “natyra” e funksionit të Këshillit Gjyqësor përballë këtyre dy parimeve. Neni 108.1, në këtë aspekt, vendos qartësisht që Këshilli Gjyqësor “siguron” pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësorit. Në këtë kuptim, koncepti “siguron”, si funksion bazik i Këshillit, përbën substancën kushtetuese që vendos funksionin e Këshillit.
2. “Sigurimi” i pavarësisë dhe paanësisë gjyqësore, sipas këtij neni, nënkupton detyrimin e Këshillit që, si i vetëm, të gëzojë njësinë e mjaftueshme të autoritetit të pavarur, të zbatojë standardet ndërkombëtare në mënyrë të pavarur, dhe të ruaj gjyqësorin nga ndikimet e jashtme. Sipas kësaj, kompetenca për të “siguruar” pavarësinë e gjyqësorit përbën një autoritet shumë të gjerë kushtetues, ku Këshilli vepron *aktivisht* dhe *pasivisht* në garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjyqësore, dhe në këtë funksion asnjë institucion tjetër nuk ka autoritet kushtetues që të ndërhyj. Këshilli është plotësisht me pushtet të garantuar kushtetues për të qenë i vetmi mekanizëm kushtetues që garanton pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit, që ndërmerr masat e nevojshme në mënyrë të papenguar për të vendosur një garancion të tillë, dhe që ndërton politikat publike përmes së cilave synohet arritja e këtij objektivi.
3. Duhet thënë që, ky paragraf, *në asnjë mënyrë* nuk nënkupton, që Këshilli ka kompetencë gjyqësore. Këshilli është organ që rregullon dhe e siguron pavarësinë dhe paanshmërinë gjyqësore vetëm përmes autoritetit të tij mbi resurset humane të

pushtetit gjyqësor. Si i tillë, Këshilli nuk ka asnjë të drejtë për të ndikuar në vendimet gjyqësore, për të ndërhyrë në funksionin gjyqësor të gjyqtarëve, për të nxjerrë vendime gjyqësore, apo për të dhënë interpretime se si duhet interpretuar legjislacioni përkatës nga ana e gjykatave. Këshilli, në këtë kuptim, nuk ushtron funksion gjyqësor, por siguron kushtet që gjyqtarët të ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë profesionale, të pavarur dhe pa asnjë ndikim politik.

Neni 108.2

1. Neni 108.2 përcakton që Këshilli Gjyqësor është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Në anë tjetër, ky paragraf po ashtu e detajizon funksionin e Këshillit, duke përcaktuar që Këshilli siguron që gjykatat në Kosovë janë të pavarura, profesionale e të paanshme, dhe se pasqyrojnë plotësisht natyrën shumetnike të Kosovës, duke pasur gjithashtu përgjegjësinë për të respektuar standardet e barazisë gjinore në strukturën e gjyqësorit. Ky paragraf, gjithashtu, vendos detyrimin që Këshilli t'i jap përparësi komuniteteve të nënpërfaqësuar për emërim në poste gjyqtarësh, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Prandaj, neni 108.2 e vendos detyrimin që Këshilli të jetë një institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij, karakteristikë themelore që e legjitimon vet funksionin e Këshillit si sigurues i pavarësisë dhe paansisë së gjyqtarëve. Detyrimi që Këshilli të jetë institucion i pavarur duhet parë në dy aspekte: një, si pavarësi objektive, ku Këshilli duhet të shihet nga jashtë si institucion i pavarur, dhe dy, si pavarësi subjektive, ku anëtarët e Këshillit nuk duhet të kenë asnjë lidhje strukturale me ndonjë interes, rrymë apo grup që e pengon atë t'i shërbej funksionit të tij në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.
3. Në kuptim të nenit 108.2, Këshilli, përveç sigurimit që gjykatat të jenë të pavarura dhe profesionale, duhet që të garantojë gjithashtu që procesi i emërimit të gjyqtarëve, ku Këshilli luan rol qendror, të rezultojë me një përbërje shumetnike të gjykatave. Në kryerjen e këtij detyrimi, Këshilli duhet të garantojë që anëtarët e komuniteteve jo shumicë nuk janë të nënpërfaqësuar, një detyrim që Këshilli duhet ta materializoj sipas përcaktimit të ligjit përkatës.

Neni 108.3

1. Neni 108.3 përcakton kompetencën bazike të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur që ky i fundit të jetë përgjegjës për rekrutimin dhe propozimin e kandidatëve për emërim dhe riemërim në pozitat gjyqësore. Ky nen, gjithashtu, i vesh kompetencën Këshillit që të bëj transferin dhe të menaxhoj procedurën disiplinore kundër gjyqtarëve.
2. Është në kompetencën eksplicite të Këshillit që të bëj rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, duke e organizuar tërë procesin e konkurrencës dhe vlerësimit profesional të tyre, sipas standardeve plotësisht profesionale. Në ushtrimin e kësaj kompetence, Këshilli është i detyruar që të jetë plotësisht i pavarur dhe i lirë në

vendosjen për rekrutimin e kandidatëve, sepse vetëm kjo mund të lejojë që Këshilli të ushtrojë detyrimin e tij si sigures i pavarësisë dhe paanësisë gjyqësore. Kompetenca e Këshillit për transferim dhe disiplinim të gjyqtarëve, natyrshëm, i mundëson atij që të menaxhoj sistemin e gjykatave në mënyrë efikase, dhe që të dënoj gjyqtarët që nuk respektojnë rregullat e profesionit dhe funksionit të tyre.

Neni 108.4

1. Neni 108.4 përcakton që propozimet e Këshillit për emërimin e gjyqtarëve duhet të kalojnë nëpër një proces të hapur për emërime, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe që propozimet e tilla të reflektojnë parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të juridiksionit territorial të gjykatës përkatëse. Në këtë kuptim, neni 108.4 vendos tri parime bazike që duhet të udhëheqim procesin e propozimit të emërimeve të gjyqtarëve nga ana e Këshillit: një, që procesi për emërime të jetë i hapur dhe kompetitiv, ku të gjithë të interesuarit janë të lirë të aplikojnë, dhe ku palët por edhe publiku janë të lirë që të marrin informacionin e duhur mbi hapat ku gjendet procesi dhe mbi arsyet e zgjedhjes së një kandidati përballë tjetrit; dy, që seleksionimi i kandidatëve të bëhet thjeshtë dhe vetëm mbi baza të meritës profesionale dhe kapacitetit për të ushtruar funksionin gjyqësor, kriter që kërkon që Këshilli të arsyetoj para publikut zgjedhjen e secilës kandidaturë bazuar në këtë kriter, dhe tre, që propozimet e dhëna nga Këshilli të kenë pasqyrim gjinor dhe etnik sipas parimeve të shpjeguara në nenin paraprak. Në kuptim të dy kritereve të para të këtij neni, Këshilli është nën detyrimin kushtetues që t'i ofroj publikut arsyetimin kredibil dhe të provuar mbi meritën e zgjedhjes së secilit kandidat përballë tjetrit, një vlerësim që duhet të jetë i bazuar në kritere të matshme.

Neni 108.5

1. Neni 108.5 përcakton që Këshilli Gjyqësor është përgjegjës për inspektimin gjyqësor, administrimin gjyqësor, përpilimin e rregullave për gjykatat në pajtim me ligjin, punësimin dhe mbikëqyrjen e administrative të gjykatave, hartimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të gjyqësorit, si dhe përcaktimin e numrit të gjyqtarëve në secilin juridiksion territorial, si dhe ushtron të drejtën e rekomandimit për themelimin e gjykatave të reja. I njëjti nen përcakton që themelimi i gjykatave të reja bëhet vetëm përmes ligjit.
2. Në kuptim të nenit 108.5, Këshilli vishet me kompetencën e inspektimit të gjykatave, një kompetencë që mundëson që Këshilli të mund të sigurojë pavarësinë dhe paanësinë e gjyqësor, natyrshëm duke e zbatuar edhe autoritetin e tij për disiplinimin e gjyqtarëve. Përveç kësaj, kompetenca që zakonisht i takon ministrive të drejtësisë në shumicën e vendeve evropiane, që është kompetenca për organizimin dhe menaxhimin e administratave të gjykatave, sipas këtij neni në Kosovë i vishet Këshillit Gjyqësor. Prandaj, Këshilli është i autorizuar që të rekrutojë, menaxhojë si dhe organizojë shërbimin civil të gjykatave, dhe se kjo përbën një kompetencë ekskluzive të Këshillit, ku qeveria nuk ka asnjë mundësi ndërhyrjeje. Dhënia e kësaj kompetence Këshillit, në anën tjetër, mundëson që

ekzekutivi të mos ketë as edhe mundësinë e ndërtimit të ndonjë linje interference në punën e gjykatave përmes shërbyesve civil të emëruar në ato gjykata. Përveç kësaj, Këshilli është i veshur edhe me autoritetin për përpilimin e rregullave për gjykatat në pajtim me ligjin, që nuk duhet nënkuptuar si autorizim për të përpiluar rregulla që ndërtojnë detyrime substanciale për palët në gjykim, por thjeshtë rregulla që ndërtojnë detyrime për gjyqtarët dhe sjelljet e tyre në ushtrimin e funksionit në aspektin profesional dhe etik.

3. Në kuptim të këtij neni, Këshilli është gjithashtu përgjegjës për hartimin e buxhetit të pushtetit gjyqësor si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij. Propozimi i Këshillit për buxhetin e gjyqësorit, natyrisht, duhet të miratohet nga ana e Kuvendit, siç është shpjeguar më sipër. Ky nen gjithashtu e vesh Këshillin me të drejtën ekskluzive të përcaktimit të numrit të gjyqtarëve që secili rreth juridiksional territorial duhet të ketë, kompetencë që i mundëson Këshillit të jetë dizajnuer i përbërjes gjyqësore si dhe menaxhues i efikasitetit të gjykatave në kuptim të lëndëve që parashtrihen aty. Natyrisht, themelimi i gjykatave të reja, sipas këtij neni, mund të bëhet vetëm me ligj, dhe se Këshilli këtu ka vetëm të drejtën e rekomandimit e një hapi të tillë pranë Kuvendit.

Neni 108.6

1. Neni 108.6 përcakton përbërjen e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe vendos standardet profesionale që secili anëtar duhet të disponojë. Ky nen gjithashtu vendos edhe në lidhje me rrugët përmes së cilave ushtrohen propozimet dhe miratimet e kandidaturave për anëtar të Këshillit.
2. Neni 108.6 përcakton që Këshilli përbëhet nga trembëdhjetë anëtarë, që është një përbërje që nuk mund të ndryshohet me ligj. I njëjti përcakton që anëtarët e Këshillit duhet të jenë persona me kualifikime dhe ekspertizë profesionale, dy standarde që duhen ndjekur detyrimisht. Neni 108.6, në detaje, përcakton që nga 13 anëtarët e Këshillit, përbërja do të jetë si vijon: a) pesë anëtarë do të jenë gjyqtarë të zgjedhur nga ana e vet gjyqësorit, pa nevojën për miratim të ndonjë organi të jashtëm apo për vlerësim të një përbërje të tillë; b) katër anëtarë zgjidhen nga ana e Kuvendit, dy prej të cilëve duhet të jenë gjyqtarë, përderisa një nga ta duhet që të jetë anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës; c) dy anëtarë shtesë duhet zgjedhur nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vendet e fituara nga komuniteti serb, ku së paku një prej tyre duhet të jetë gjyqtar; dhe d) dy anëtar i zgjedhin deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vendet e rezervuara nga komunitetet joshumicë që nuk janë serbe, ku të paktën njëri nga ta duhet që të jetë gjyqtar. Papajtueshmëria e anëtarëve të Këshillit, në kuptim të kësaj përbërjeje dhe procedure zgjedhjeje, përcaktohet që duhet rregulluar me anë të ligjit.
3. Në kuptim të kësaj përbërjeje, Këshilli ka një shumicë anëtarësh që burojnë nga vet pushteti gjyqësor, që mund të shihet si një garancion që Këshilli të ketë një përbërje të paktën jopolitike. Gjithashtu, përbërja etnike e Këshillit tregon një strukturë shumë plurale, që lejon hapësirë të gjerë për komunitetet etnike

joshumicë. Në anën tjetër, ky nen nuk i lejon Kuvendit që, duke vepruar në shumicën absolute, një shumicë që zakonisht është nën kontrollin e qeverisë, të zgjedh shumicën e anëtarëve të Këshillit. Tërë kjo arkitekturë juridike, prandaj, mundëson një përbërje plurale, jo të varur nga një institucion i vetëm, dhe me një përzierje etnike, por me një dominim të kandidatave që burojnë nga vet gjyqësori.

Neni 108.7

1. Neni 108.7 përcakton zgjedhjen e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit të Këshillit Gjyqësor, duke vendosur që të dy duhet zgjedhur nga vet përbërja e Këshillit, me një mandat tre-vjeçar. Sipas të njëjtit nen, zgjedhja në këtë pozitë nuk e zgjat mandatin që ka në Këshill kryesuesi apo zëvendëskryesuesi. Prandaj, ky nen lejon për një autonomi të kryesimit të Këshillit Gjyqësor, përmes vendosjes së rregullës që kryesimi i saj të bëhet nga një zyrtar i zgjedhur nga vet ajo, brenda përbërjes së vet, dhe duke mos lejuar që emërimi i zyrtarit në fjalë të bëhet nga një organ i jashtëm, siç mund të jetë presidenti i republikës. Ky standard, prandaj, mundëson një hapësirë pavarësie të plotë institucionale të Këshillit ndaj cilitdo institucion që mund të kishte autorizimin për të zgjedhur kryesuesin e saj, dhe në të njëjtën kohë e bën të panevojshme që cilido anëtar i Këshillit të vihej nën ndikimin e një institucioni/subjekti të jashtëm në rastet kur eventualisht disa nga anëtarët e saj synojnë pozitën e kryesuesit të saj.

Neni 108.8

1. Neni 108.8 përcakton që kryesuesi i Këshillit Gjyqësor i drejtohet Kuvendit së paku një herë në vit në lidhje me gjendjen në sistemin gjyqësor të vendit. Duhet thënë që, në kuptim të këtij neni, ky përbën thjeshtë një detyrim për të informuar Kuvendin për gjendjen në sistemin gjyqësor, por që në asnjë mënyrë nuk mund të shihet si detyrim raportimi i kryesuesit përballë Kuvendit. Këshilli, dhe kryesuesi i saj, nuk kanë asnjë detyrim raportimi apo dhënie përgjegjësie në Kuvend sa i përket aktivitetit apo gjendjes së sistemit gjyqësor, dhe ky nen në asnjë mënyrë nuk e synon një objektiv të tillë. Prandaj, Këshilli nuk i detyrohet me përgjegjësi Kuvendit, por Neni 108.8 i kërkon atij që një herë në vit t'i drejtohet Kuvendit me informacion në lidhje me sistemin gjyqësor. Në të kundërtën, kjo dispozitë kushtetuese nuk nënkupton mundësinë që Kuvendi të marrë në përgjegjësi kryesuesin e Këshillit, apo të hap debat për gjendjen në gjyqësor.

Neni 108.9

1. Neni 108.9 përcakton që kandidatët për pozita gjyqësore nga radhët e komuniteteve joshumicë mund të propozohen nën ombrellën e Këshillit, vetëm nga anëtarët e Këshillit që janë të zgjedhur nga deputetët e Kuvendit që përfaqësojnë komunitetet joshumicë në Kuvend. Sipas këtij neni, nëse ky grup i anëtarëve të Këshillit nuk e propozon kandidatin për pozitën gjyqësore dy herë radhas, atëherë cilido anëtar i Këshillit ka të drejtën që të bëjë një gjë të tillë. Prandaj, neni 108.9

ndërton garancionin që, në rastet e propozimeve për gjyqtarë të komuniteteve joshumicë, propozimi të bëhet vetëm nga anëtarët e Këshillit që vijnë nga komunitetet joshumicë, dhe jo nga tërë përbërja e Këshillit. Ky model i garantimit të rekrutimit të gjyqtarëve nga komunitetet joshumicë vetëm nga ana e anëtarëve që vijnë nga komunitetet joshumicë të Këshillit, në njërin anë, përbën garancion që gjyqtarët nga komunitetet joshumicë të jenë zgjedhur vetëm nga persona me etni joshumicë në Kosovës, por, në anën tjetër, kjo dispozitë mundëson që Këshilli të mos veproj si një organ kolektiv me vendimmarrje të shumicës në rastet e zgjedhjes së gjyqtarëve nga komuniteti joshumicë në Kosovë. Si i tillë, ky nen përbën garancion për ruajtjen e kredibilitetit të përfaqësimit të komuniteteve joshumicë në pozitat gjyqësore, por në anën tjetër e ulë karakteristikën unike mbi të cilën supozohet që duhet të funksionojë një organ kolektiv dhe i pavarur sikur Këshilli.

Neni 108.10

1. Neni 108.10 përcakton që kandidatët për pozita gjyqësore të gjykatave themelore, nën juridiksionin e të cilave përfshihet ekskluzivisht territori i një a më shumë komunave, ku shumica e popullsisë i takon komunitetit Serb të Kosovës, mund të rekomandohen për emërim vetëm nga dy (2) anëtarët e Këshillit që i zgjedhin deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vendet e rezervuara ose të garantuara për komunitetin Serb në Republikën e Kosovës të cilët veprojnë bashkërisht dhe në mënyrë unanime. Nëse këta dy (2) anëtarë nuk rekomandojnë kandidat gjyqësor për këtë pozitë, gjatë dy seancave të njëpasnjëshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, atëherë cilido anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka të drejtë të propozojë kandidat për atë pozitë.
2. Kjo dispozitë përbën një garancion që i bashkëngjitet modelit të decentralizimit të dhënë nga Pakoja e Ahtisaarit sa i përket modelit të vetëqeverisjes lokale për komunitet serbe.⁶⁰⁸ Më praktikisht, në kuptim të Nenit 109.10, zgjedhja e gjyqtarëve

⁶⁰⁸ Duke marrë parasysh faktin se Pakoja e Ahtisaarit (mars 2007) ka qenë e pranuar nga kosovarët në mënyrë të njëanshme si bazë me rastin e deklarimit të pavarësisë më 17 shkurt 2008, si dhe faktin tjetër që ky dokument sanksionon vlerat, parimet dhe normat më sublimë të civilizimit juridik-kushtetues perëndimor ku Kosova synon të shkojë, çdo herë komentimi i Pakos në fjalë duhet të jetë një përpjekje e padiskutueshme dhe një lloj udhërrëfyese për të gjetur kuptimin e ndonjëres prej dispozitave kushtetuese kosovare. Kjo është kështu edhe për faktin shtesë se vetë Kushtetuta e Kosovës është derivat i letres, frymës dhe shpirtit të Pakos së Ahtisaarit. Në vijim të kësaj duhen shikuar edhe dispozitat mbi vetëqeverisjen lokale në Kosovë. Cf. nenin 3 (“Të Drejtat e Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre”); nenin 6 (“Vetëqeverisja Lokale dhe Decentralizimi”); neni 7 (“Trashëgimia Fetare dhe Kulturore”); si dhe Aneksat: I (“Dispozitat Kushtetuese”); II (“Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Komuniteteve”); III me aneksin e vet (“Decentralizimi”); dhe V (“Trashëgimia Fetare dhe Kulturore”). Në Aneksin mbi dispozitat kushtetuese përbahen po ashtu dispozita që flasin për vetëqeverisjen lokale dhe llojin e saj (neni 3). Në fakt, në Kushtetutën e Kosovës gjenden të përshkruara pjesa më e madhe e dispozitave të Pakos së Ahtisaarit të cilat paraqesin shtyllën kyçe të sistemit kushtetues dhe juridik kosovar.

që shërbejnë në një gjykatë themelore të një komune me shumicë serbe bëhet nga të dy kandidatët që përfaqësojnë komunitetin serb në Këshill. Kjo mundëson që, propozimet për emërimet të gjyqtarëve të një gjykate themelore në një komunë me shumicë serbe t'i nënshtrohen vullnetit të dy përfaqësuesve serb në Këshill, dhe që shumica tjetër e anëtarëve të mos ketë hapësirë për të vendosur për një gjë të tillë. Prandaj, Neni 109.10 vendos garancionin që gjyqtarët e gjykatave themelore në komunat me shumicë serbe të jenë produkt i një konsensusi në mes të vet përfaqësuesve serb, dhe që përfaqësuesit e komuniteteve tjera të mos kenë dorë në një procedurë të tillë, si mënyrë për të garantuar një gjyqësi etnikisht sipas përbërjes së popullsisë së një komune me popullsi shumicë serbe.

Neni 109 [Prokurori i Shtetit]

- (1) Prokurori i Shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.**
- (2) Prokurori i Shtetit është institucion i paanshëm, dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe të ligjit.**
- (3) Organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit rregullohen me ligj.**
- (4) Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore.**
- (5) Mandati fillestar për prokuror është trevjeçar. Në rast të riemërimit, mandati është i përhershëm deri në moshën e pensionimit, sikurse është përcaktuar me ligj, përveç nëse shkarkohet në pajtim me ligjin.**
- (6) Prokurorët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mosrespektimin e rëndë të detyrave.**
- (7) Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi.**

Neni 109

1. Prokurori publik është institucion që ushtron përgjithësisht funksionin e ndjekjes së kryerësve të veprave penale, sipas një procedure të përcaktuar paraprakisht me legjislacionin përkatës. Institucioni i prokurorit publik i ka rrënjët në një periudhë të hershme të ndërtimit të shtetit, megjithatë ai ka kaluar nëpër një tranzicion gradual që nga koha kur gjenden rrënjët e para të tij. Ky tranzicion, natyrisht, e ka shndërruar funksionin e prokurorit publik pothuajse në një rol tërësisht të ri. Transformimi i rolit të prokurorit publik gjatë shekujve ka ecur paralelisht me lëvizjet e reformimit dhe ndryshimit të regjimit të vet shteteve,⁶⁰⁹ dhe në këtë

⁶⁰⁹ Shih p.sh: Langbein, H., John, (1993) 'The Origins of Public Prosecution and Common Law'. *American Journal of Legal History*. Vol. 17, No. 4, p. 313-335; Edwards, L., John, (1964) 'Law Officers of the Crown: A Study of the Offices of Attorney General and Solicitor General of

mënyrë, ky institucion shpeshherë është bërë urë kalimi e ndryshimeve të regjimeve në botë.

2. Me funksionin e ndjekjes dhe akuzimit të kryerësve të veprave penale, institucioni i prokurorit publik ka qenë gjithherë instrument i natyrshëm për kontroll të pushtetit nga ana e qeveritarëve. Në periudhën e shtetit feudal, ky institucion ishte thjesht një dorezë e pushtetit për të goditur oponentët politikë apo edhe rrezikuesit e rendeve shoqërore, ekonomike e politike. Me këtë rol, institucioni i prokurorit publik realisht i përshtatej nevojës së pushtetmbajtësve për të inkriminuar politikisht njerëzit që mund të rrezikonin fronet e tyre. Si pjesë e kësaj praktike tiranie, institucioni i prokurorit publik ishte rruga përmes së cilës kontrollohej lëvizja e masave shoqërore, dhe mbylleshin rrugët që ushqenin mundësinë për revolta shoqërore. I vënë në këtë pozitë, ky institucion përbënte shembullin e shkeljes së të drejtave të njeriut dhe i shërbente thjeshtë kërkesave politike të pushtetmbajtësve.⁶¹⁰
3. Me transformimet shoqërore dhe politike që sjellën revolucionet e ndryshme përgjatë historisë, edhe institucioni i prokurorit publik kalon nëpër një lëvizje transformuese të vazhdueshme, paralelisht me ndryshimin e natyrës së vet shtetit. Megjithëse në kuptimin origjinal, Prokurori publik ka funksion mbrojtjen e interesit të shtetit, rreziku që ky të shndërrohet në instrument për nevoja të elitave politike çimentoj nevojën për kufizimin e mundësive që ky të shndërrohet në një institucion që mbron interesat e shtetarëve dhe jo të shoqërisë në përgjithësi. Në këtë kuptim, ndryshimet e natyrës së shtetit - që nga Revolucioni francez e deri në shembjen e Murit të Berlinit - bartnin me vete nevojën për ndërtimin e infrastrukturës legjislativë të nevojshme për të garantuar në vazhdimësi rolin neutral të institucionit të Prokurorit Publik. Nga ky prizëm, mund të thuhet që legjislacioni për të garantuar profesionalizmin dhe neutralitetin e Prokurorit publik ka gjetur zhvillim të vazhdueshëm, për të mos thënë që reforma për të rritur pavarësinë e këtij institucioni mbetet sfidë edhe në ditët e sotme.

England, with an Account of the Office of the Director of Public Prosecutions of England. London: Sweet & Maxwell; van Alstyne, M., Scot, (1952) 'The District Attorney: A Historical Puzzle'. *Wisconsin Law Review*. Vol. 11, No. 3, pp. 125-138.

⁶¹⁰ Shih, ndër të tjera: Langbein, H., John, (1993) 'The Origins of Public Prosecution and Common Law'. *American Journal of Legal History*. Vol. 17, No. 4, p. 313-335; Edwards, L John, (1964) 'Law Officers of the Crown: A Study of the Offices of Attorney General and Solicitor General of England, with an Account of the Office of the Director of Public Prosecutions of England'. London: Sweet & Maxwell; van Alstyne, M., Scot, (1952) 'The District Attorney: A Historical Puzzle'. *Wisconsin Law Review*. Vol. 11, No. 3, pp. 125-138; Goebel, Jr., Julius, and Naughton, T., Raymond, (1944) 'Law Enforcement in Colonial New York: A Study in Criminal Procedure'. New York: Commonwealth Fund, p. 1664-1776; Reiss, J., Jr, Albert (1975) 'Public Prosecutors and Criminal Prosecution in the United States of America'. *Juridical Review*. New Series, Vol. 20: 1-21; Scott, P., Arthur (1930) 'Criminal Law in Colonial Virginia'. Chicago: University of Chicago Press; Surrency, C., Erwin (1967) 'The Courts in the American Colonies'. *American Journal of Legal History*. Vol. 11, No.3, p. 253-276; McConville, M., (1984) 'Prosecuting Criminal Cases in England and Wales: Reflections of an Inquisitorial Adversary'. *Liverpool Law Review*. Vol. 6, No.1, p. 15-30;

4. Në kuptim të një shteti në tranzicion, funksioni i Prokurorit publik, profesionalizmi, neutraliteti dhe dinamika e tij mbeten indikatorët themelor të zhvillimit të demokracisë në një vend. Nga prizmi ndërkombëtar, organizatat që masin nivelin e shtet-ndërtimit dhe demokracisë - si Freedom House, Transparency International apo Amnesty International - i japin vend të veçantë rolit të Prokurorit Publik në evidentimin e përparimit apo ngecjeve të një shteti. I njëjhtë është pozicioni edhe i Bashkimit Evropian, Raporti i Progresit të Komisionit Evropian - në kuptim të politikës së zgjerimit të BE-së, vë theksin themelor në institucionin e Prokurorit Publik kur bën vlerësimin mbi performancën dhe progresin e një shteti kandidat.⁶¹¹ I trajtuar në këtë kuptim, institucioni i Prokurorit Publik përbën pikën neurgjike të një shteti në ndërtim, prandaj edhe standardet që udhëheqin me të janë pikënisje e rëndësishme e rolit që ky institucion ka në ndërtimin e një shteti në tranzicion sikur Kosova.
5. Institucioni i Prokurorit Publik, për shkak të modeleve të ndryshme të shtetit, gjen shprehje në dy forma: a) në formë të sistemit inkuizitor (*inquisitorial prosecutorial system*), dhe b) në formë të sistemit kundërshtues (*adversarial prosecutorial system*).⁶¹² Këto dy sisteme të këtij institucioni janë thjesht produkt i përcaktimit të së drejtës penale procedurale, meqë dallimi që bëjnë këto dy sisteme lidhet thjesht me rolin/funksionin procedural të prokurorit, si dhe në përgjithësi procedurës së gjyqimit në kuptim të kompetencave të prokurorit.⁶¹³ Meqë roli dhe natyra e institucionit të Prokurorit Publik ndryshon varësisht nga modeli i tij,⁶¹⁴ ne i japim një shpjegim solid të dy këtyre modeleve në këtë kapitull.
6. Modeli inkuizitor i institucionit të Prokurorit Publik gjen shprehje në shtetet me sisteme juridike civile (*civil legal systems*). Ky sistem i Prokurorit Publik karakteristike themelore të tij ka pjesëmarrjen aktive të gjykatës në evidentimin e fakteve dhe vërtetimin e provave të ofruara nga prokurori, siç nuk ndodh me sistemet e prokurorisë të sistemit kundërshtues. Në këtë sistem, Prokurori Publik nuk është hallka e vetme e prezantimit dhe mbrojtjes së akuzës, dhe se nuk gëzon monopolin e ofrimit të dëshmive dhe hetimit të fakteve. Megjithëse Prokurori Publik gëzon të drejtën ekskluzive të ndjekjes penale të personave, në sistemin inkuizitor gjen

⁶¹¹ Shih psh. në rastin e Kosovës: Commission Staff Working Document: 'Kosovo 2011 Progress Report'. Commission of the European Communities, SEC(2011) 1207, Brussels; Commission Staff Working Document: 'Kosovo 2010 Progress Report'. Commission of the European Communities, SEC(2010)1329, Brussels;

⁶¹² Historikisht, por edhe sot në disa shtete, ka ekzistuar edhe modeli i prokurorit privat. Shih një shpjegim në lidhje me këtë, në: Decision on 'Criminal Prosecution. Power of Court to Appoint Private Attorney to Conduct Prosecution'. *Columbia Law Review* (1936) Vol. 36, No. 2, pp. 323-324;

⁶¹³ Shih p.sh. Glendon MA, Carozza PG, Picker CB., (2008) '*Comparative Legal Traditions*'. Brand: West Law School, Thomson-West, p.101; Goldstein, S., Abraham & Marcus, Martin (1977) 'The Myth of Judicial Supervision in Three "Inquisitorial" Systems: France, Italy, and Germany'. *Yale Law Journal*. Vol. 87, No. 2, pp. 240-283;

⁶¹⁴ Shih shembullin francez dhe një përzierje të elementeve të të dy sistemeve: Ploscowe, Morris (1932) 'Development of Inquisitorial and Accusatorial Elements in French Procedure'. *Journal of Criminal Law and Criminology*. Vol. 23, No. 3, pp. 372-394;

shprehje parimi që kërkon pjesëmarrjen e obligueshme të gjykatës në konfirmimin, vërtetimin dhe hetimin e mëtejshëm të provave të paraqitura nga prokurori.⁶¹⁵ Natyrisht, roli ndërhyrës i gjykatës në punën e prokurorit është i *detyrueshëm*, dhe zakonisht fillimi, vazhdimi dhe procedimi i çdo hapi hetimor nga ana e Prokurorit duhet të jetë i konfirmuar nga ana e një gjyqtari hetues. Megjithatë funksioni i Prokurorit Publik në sistemin inkuizitor është qendror sa i përket nisjes së hetimit, gjykata bart të drejtën dhe detyrimin që të mbi-hetoj provat e prokurorit dhe të kërkoj prova shtesë, apo edhe të detyrojë prokurorin që të procedojë një hap tjetër hetimor edhe pa vullnetin e tij/saj. Në sistemin inkuizitor Prokurori Publik bart monopolin e nisjes së ndjekjes penale, pasi që gjykata nuk mund të nis hetimin penal *sua sponte*. Gjykata, megjithatë, ka rol aktiv në procesin e hetimit, si dhe mund të ndërmarra hapa hetimor paralel me ato që prezantohen nga ana e prokurorit. Gjithashtu, në këtë sistem Prokurori Publik nuk mund të akuzojë një të pandehur pa pasur konfirmimin e gjykatës - zakonisht të një gjyqtari hetues - meqë secili veprim procedural hetues i nënshtrohet kontrollit dhe konfirmimit gjyqësor. Në përgjithësi, sistemi inkuizitor përbën një model më të përhapur të prokurorisë, dhe ku roli i Prokurorit Publik i nënshtrohet një mbikëqyrjeje nga ana e gjykatës përkatëse. Kjo mund të shihet si një garanci që veprimet hetimore të prokurorit të mund të procedohen vetëm pasi institucioni gjyqësor gjykon arsyeshmërinë dhe kredibilitetin e tyre procedural dhe substancial,⁶¹⁶ me qëllim që subjekteve të hetuara mos t'u shkelen të drejtat e tyre nga një prokurori e anshme.⁶¹⁷

7. Modeli kundërshtues i institucionit të Prokurorit Publik gjen shprehje në shtetet me sisteme juridike anglo-saksone (*common law systems*).⁶¹⁸ Karakteristikë themelore e këtij sistemi është që prokurori publik gëzon monopolin e plotë të hetimit, dhe që në kryerjen e këtij funksioni gjykata nuk ka kurrfarë roli. Në sistemin kundërshtues, prokurori është palë plotësisht e barabartë me mbrojtjen përballë gjykatës, përderisa kjo e fundit nuk merr aspak pjesë në procesin hetimor. Institucioni i Prokurorit Publik në këtë sistem ka monopol të plotë mbi ndjekjen penale dhe hetimin, përderisa procedura gjyqësore nuk lejon përfshirjen e gjykatës në mbi-hetimin/konfirmimin e hapave hetimor të ndërmarra nga prokurori.⁶¹⁹ Në

⁶¹⁵ Shih p.sh: Langbein, H., John, (1977) 'Comparative Criminal Procedure: Germany'. St. Paul, Minnesota: West Group.

⁶¹⁶ Shih një argument implicit për këtë në: Jackson, H., Robert (1941) 'The Federal Prosecutor'. *Journal of Criminal Law and Criminology*. Vol. 31, No. 3, p. 3-6.

⁶¹⁷ Shih një argument bazë edhe në: Ploscowe, Morris, (1932) 'Development of Inquisitorial and Accusatorial Elements in French Procedure'. *Journal of Criminal Law and Criminology*. Vol. 23, No. 3, pp. 372-394.

⁶¹⁸ Shih p.sh: Poserina, J., John, (1959) 'Appointed Attorney General's Power to Supersede an Elected District Attorney,' *Temple Law Quarterly*. Vol. 33, pp. 78—88, Grosman, A., Brian, (1978) 'The Prosecutor. An Inquiry into the exercise of discretion'. Toronto: University of Toronto Press; Gjithashtu, shih: Fisher, Z., Stanley, (1988) 'In Search of the Virtuous Prosecutor: A Conceptual Framework'. *American Journal of Criminal Law*. Vol. 15, pp. 204-15; Goldstein, A., S., & Marcus, M., (1977) 'The Myth of Judicial Supervision in Three "Inquisitorial" Systems: France, Italy, and Germany'. *The Yale Law Journal*. Vol. 87, No. 2, pp. 240-283.

⁶¹⁹ Shih p.sh: Langbein, H., John, (1977) 'Comparative Criminal Procedure: Germany'. St. Paul, Minnesota: West Group; Shih gjithashtu: Goldstein S., A., & Marcus M., (1977) 'The Myth of

këtë model, prokurori mban anën e akuzës - duke pasur diskrecion⁶²⁰ të plotë në materializimin, vendosjen e objektivave dhe caqeve të saj⁶²¹ - përderisa mbrojtja mbron të akuzuarin, kurse gjykata luan rolin e një arbitri pasiv që gjykon në bazë të asaj që ofrohet nga të dy palët dhe nuk merr pjesë aktive në hetimin e provave apo edhe thellimin e dëshmimeve që ofrohen nga të dyja palët.⁶²² Në sistemin kundërshtues, roli i prokurorit është shumë herë më me përgjegjësi, meqenëse kredibiliteti i akuzës së ngritur varet vetëm nga ai/ajo që nga nisja e hetimit e deri në përfundimin e gjykimit. Gjithashtu, në këtë sistem, prokurori dhe mbrojtja lejohet të bëjnë marrëveshje mbi nivelin/natyren e dënimit,⁶²³ duke i dhënë gjykatës mundësi që ta vendos çështjen në bazë të marrëveshjes së palëve. Kjo natyrisht që shihet me dyshim në kuptim të së drejtës për gjykim të drejtë, meqë në këtë sistem prokurori bëhet subjekt i marrëveshjeve pa kaluar nëpër filtrin gjyqësor, dhe pa garancinë apo kontrollin gjyqësor që marrëveshja e tillë apo edhe kërkesa e prokurorit janë të drejta dhe kredibile.⁶²⁴ Natyrisht, roli i prokurorit në këtë sistem është shumë i fuqishëm, përderisa mbajtja e monopolit të plotë mbi akuzën nga ana e prokurorit lejon hapësirë⁶²⁵ që ajo të keqpërdoret duke i shkelur të drejtat e të akuzuarit. Në anën tjetër, karakteristika që prokurori të bëjë marrëveshje mbi bazën e diskrecionit të tij⁶²⁶ me mbrojtjen e vënë në dyshim kredibilitetin e gjykimit të drejtë që rezulton nga ajo marrëveshje.⁶²⁷

Judicial Supervision in Three "Inquisitorial" Systems: France, Italy, and Germany'. *The Yale Law Journal*. Vol. 87, No. 2, pp. 240-283.

⁶²⁰ Shih për më tepër në lidhje me diskrecionin prokurorial: Sarat, A. and Clarke, C. (2008) 'Beyond Discretion: Prosecution, the Logic of Sovereignty, and the Limits of Law'. *Law & Social Inquiry*. Vol. 33, pp. 387-416;

⁶²¹ Shih p.sh: Goldstein S., A., & Marcus, M., (1977) 'The Myth of Judicial Supervision in Three "Inquisitorial" Systems: France, Italy, and Germany'. *The Yale Law Journal*. Vol. 87, No. 2, pp. 240-283.

⁶²² Shih një shembull të ndërtimit të elementeve të këtij modeli mbi bazë të legjislacionit kontinental: Pizzi, William T. & Marafioti, Luca (1992) 'The New Italian Code of Criminal Procedure: The Difficulties of Building an Adversarial Trial System on a Civil Law Foundation'. *Yale Journal of International Law*. Vol. 17, No. 1, pp. 15-27.

⁶²³ Goldstein, A., S., & Marcus, M. (1977) 'The Myth of Judicial Supervision in Three "Inquisitorial" Systems: France, Italy, and Germany'. *The Yale Law Journal*. Vol. 87, No. 2, pp. 240-283.

⁶²⁴ Shih një argument implicit për këtë në: Jackson, H., Robert (1941) 'The Federal Prosecutor'. *Journal of Criminal Law and Criminology*. Vol. 31, No. 3, p. 3-6.

⁶²⁵ Shih p.sh. rolin e prokurorit në kuptim të bindjes orale të jurisë në këtë sistem: Nidiry, Rosemary (1996) 'Restraining Adversarial Excess in Closing Arguments'. *Columbia Law Review*. Vol. 96, No. 5, pp. 1299-1334.

⁶²⁶ Shih disa kritika mbi këtë: LaFREE, G. D (1985) 'Adversarial and Non-adversarial Justice: A Comparison of Guilty Pleas And Trials'. *Criminology*. Vol. 23, pp. 289-312. doi: 10.1111/j.1745-9125.1985.tb00338; Shih gjithashtu: Frase, S., Richard (1990) 'Comparative Criminal Justice as a Guide to American Law Reform: How Do the French Do It, How Can We Find Out, and Why Should We Care?'. *California Law Review*. Vol. 78, No. 3, pp. 539-683.

⁶²⁷ Shih p.sh: Farr, K., Ann (1984) 'Administration and Justice'. *Criminology*. Vol. 22, pp. 291-319. doi: 10.1111/j.1745-9125.1984.tb00302.x; Shih gjithashtu: Roach, Kent, (2010) 'Wrongful Convictions: Adversarial and Inquisitorial Themes'. *North Carolina Journal of International Law and Commercial Regulation*. Vol. 35, No. 2, pp. 388-444; Krahaso me: Langbein, H. John, (1979), 'Land Without Plea Bargaining: How the Germans Do It'. *Michigan Law Review* Vol. 78, No. 2, pp. 204, 225

8. Sa i përket modelit organizativ të prokurorisë publike, shumica e shteteve në botë i kanë dhënë asaj pozicion të pavarur mbi bazë kushtetuese. Meqenëse funksioni i ndjekjes penale dhe hetimit kërkon një pozitë neutrale të institucionit që e kryen funksionin e tillë⁶²⁸ - në mënyrë që procesi i ndjekjes të priret nga profesionalizmi dhe neutraliteti - prokuroritë publike në shumicën e vendeve në botë kanë statusin e zyrave të pavarura nga të tre degët e pushtetit. Megjithatë, modelet kushtetuese anglo-saksone janë të prirura që prokuroritë publike t'i vendosin nën pushtetin ekzekutiv - p.sh, siç është rasti me ShBA-në, ku në nivel federativ, funksioni i prokurorisë publike kryhet nga Departamenti i Drejtësisë, që është pjesë e pushtetit ekzekutiv. Një numër i kufizuar i shteteve i vendosin prokuroritë publikë në kuadër të pushtetit gjyqësor,⁶²⁹ megjithëse kjo mund të shihet si një pabarazi e armëve në rast se personat ndiqen penalisht dhe gjykohen nga dy institucione që janë pjesë e një ombrelle. Përderisa, shumica e shteteve në botë - siç është rasti edhe me Kosovën - e vendosin prokurorinë publike si një institucion të pavarur kushtetues, pa asnjë lidhje ndikimi qoftë funksionale qoftë organizative me ndonjë nga tre pushtetet shtetërore. Ndërtimi i prokurorisë publike si një institucion i pavarur nga të tri pushtetet e fuqizon rolin e saj si një ndjekës penal me garancione për profesionalizmin dhe neutralitetin e saj, duke mos lënë hapësirë që prokuroria të shndërrohet apo të jetë e varur në kryerjen e funksionit të saj qoftë nga institucionet politike qoftë nga institucionet që gjykojnë procedimet penale të saj.
9. Në kuptim të mënyrës së emërimit, shumica e kushtetutave në botë përcaktojnë zgjedhjen e prokurorëve publik nga ana e institucioneve/ rregullatorëve të pavarur që mbikëqyrin dhe rekrutojnë, promovojnë dhe disjelojnë prokurorët. Ky model i emërimit është më i përhapuri, dhe përbën parim në juridiksionet evropiane. Shumë nga këto sisteme, lejojnë që parlamenti ose shefi i shtetit të jetë aktor i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në këtë proces, duke e bërë parlamentin ose shefin e shtetit një lloj kontrolluesi politik të denjshmërisë së prokurorëve mbi bazën e propozimeve të institucioneve të pavarura. Në anën tjetër, një model më konvencional i emërimit gjen zbatim ende në juridiksionet anglo-saksone, ku emërimi i prokurorëve bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga populli. Kjo formë e emërimit, siç tregon praktika, lejon që prokurorët realisht të bëjnë luftë elektorale për të fituar pozitën e tyre, dhe natyrisht që modeli i tillë i zgjedhjes i bën ata të lidhur për zgjedhësit dhe interesat e caktuara. Në këtë mënyrë, ky lloj i emërimit të prokurorëve publik - siç p.sh. ekziston sot në shumë njësi federale të ShBA-së - i bën prokurorët lojtarë politikë, dhe mundëson ndërhyrjen e korporatave apo njerëzve të fuqishëm në përkrahjen e kandidatëve të caktuar për prokuror publik. Natyrisht, si rezultat, prokurorët e zgjedhur në këtë formë mund të jenë skajshëm të predispozuar që të veprojnë në linjë me klanet që kanë përkrahur luftën e tyre

⁶²⁸ Shih një argument mbi këtë në: Melilli, Kenneth J. (1992) 'Prosecutorial Discretion in an Adversary System'. *Brigham Young University Law Review*. Vol. 1992, No.3, pp. 669-704.

⁶²⁹ Shih p.sh: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the Draft Law on the Public Prosecutors' Service of Moldova', No. 473/2008, adopted by the Venice Commission at its 75th Plenary Session, Venice, June 2008. CDL-AD(2008)019.

elektorale për të fituar postin prokurorial, prandaj edhe ky model i emërimit lë hapësirë për implikime të natyrshme në neutralitetin dhe profesionalizmin e prokurorëve pas zgjedhjes së tyre.

10. Në përgjithësi, prandaj, duhet argumentuar që funksioni i prokurorit publik kërkon denjshmëri dhe integritet profesional, si dhe pavarësi në kryerjen e funksionit të tij/saj.⁶³⁰ Në këtë kuptim, parimi i pavarësisë dhe integritetit të prokurorisë publike janë themelet mbi të cilat duhet ndërtuar qoftë modeli i zgjedhjes së tyre apo vetë procedurat për kryerjen e funksionit të saj. Për këtë shkak, shumica e standardeve ndërkombëtare për funksionin dhe natyrën e prokurorisë publike ndërtohen duke ruajtur dhe garantuar pavarësinë e prokurorëve, në mënyrë që rezultati i punës së prokurorisë publike të jetë i legjitimuar me fuqinë e profesionalizmit, integritetit dhe neutralitetit. E tërë kjo realisht i shërben konceptit të ruajtjes që shteti të shndërrohet në ndjekës penal mbi baza selektive, dhe që profesioni i prokurorit publik të jetë hambar i kërkesave të politikës apo politikanëve. Prandaj, komentari në vazhdim e trajton Nenin 109 të kushtetutës mbi prokurorinë publike të Kosovës prej një këndi ndërkombëtar të standardeve, duke pasur parasysh që standardet ndërkombëtare në fjalë janë themeli i të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
11. Neni 109 i Kushtetutës së Kosovës i përcakton parimet themelore të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë së shtetit, si dhe vendos caqet e punës së prokurorisë publike. Neni 109, gjithashtu, përcakton parime në lidhje me emërimin dhe bartjen e detyrës nga ana e prokurorëve publik, si dhe vendos parime në lidhje me strukturën etnike të institucionit të prokurorisë së shtetit. Në përgjithësi, neni 109 i Kushtetutës së Kosovës mbetet burimi i vetëm dhe më i rëndësishmi brenda Kushtetutës sa i përket rregullimit të prokurorisë publike dhe çështjeve që lindin në kontekst të saj. Ligji Nr. 03/ L-225 mbi Prokurorin e Shtetit i datës 30 mars 2010 nuk bën asgjë tjetër veçse operacionalizon këtë nen të Kushtetutës. Si i tillë, ky Ligj themelon dhe rregullon organizimin, juridiksionin, funksionimin, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit. Në të përfshihen të gjitha këto që u thanë më lartë për rolin dhe pozitën e prokurorit të shtetit dhe institucionit që personifikohet përmes prokurorit të shtetit.⁶³¹

Neni 109.1

1. Paragrafi 1 i nenit 109 i përcakton qëllimin dhe objektivat e institucionit të prokurorisë së shtetit, si dhe subjektet mbi të cilat vepron kjo e fundit. Ky paragraf, më saktësisht, e vë standardin e pavarësisë së institucionit të prokurorisë së shtetit,

⁶³⁰ Shih p.sh: Green, A., Bruce (1995) 'Policing Federal Prosecutors: Do Too Many Regulators Produce Too Little Enforcement'. *St. Thomas Law Review*. Vol. 8, pp. 69-79.

⁶³¹ Sipas nenit 14 të këtij Ligji, Prokurori i Shtetit në Republikën e Kosovës organizohet dhe funksionon në prokuroritë si në vijim: Prokuroria Themelore (e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm, nga Departamenti për të Mitur dhe nga Departamenti për Krime të Rënda; Prokuroria e Apelit (e përbërë nga Departamenti i Përgjithshëm dhe Departamenti për Krime të Rënda i Prokurorisë); Prokuroria Speciale; dhe, së fundi, nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

parim i cili gjithashtu ripërsëritet në paragrafin 2 në kuptim të paanshmërisë së prokurorisë. Përveç përcaktimit të institucionit të prokurorisë si i pavarur, ky paragraf gjithashtu përcakton që funksioni i prokurorisë është ndjekja penale e personave të akuzuar për vepra penale apo ndonjë veprë tjetër sipas përcaktimit ligjor.

2. Meqë karakteristika themelore e një prokurorie publike moderne është pavarësia dhe paanshmëria e saj, është tejet e rëndësishme që të shqyrtohen standardet ndërkombëtare, qoftë si pjesë e së drejtës ndërkombëtare, apo në formë të praktikave të mira ndërkombëtare, në kuptimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së prokurorisë publike. Rëndësia themelore e një prokurorie publike efektive, të përgjegjshme dhe të pavarur lidhet me një sërë standardesh, vëzhgimi dhe praktikimi i të cilave duhet të jetë si një prioritet themelor i një shteti funksional dhe demokratik. Prokuroria publike vepron në emër të tërë shtetit apo shoqërisë, prandaj përgjegjësia e saj është tejet e madhe si për efikasitetin e shtetit ashtu edhe për standardet demokratike në të.⁶³² Prokuroria publike, prandaj, duhet të veprojë me pavarësi dhe paanshmëri, si dhe përgjegjësi ligjore, profesionale dhe shoqërore në kryerjen e funksionit të saj, duke pranuar detyrimin që të veprojë mbi bazën e standardeve profesionale sa i përket ndjekjes dhe akuzimit të subjekteve të së drejtës.⁶³³ Kjo bëhet edhe më e rëndësishme në shtetet ku ekziston mundësia që prokuroritë publike të bëhen instrumente të pushtetit për të goditur subjektet e caktuara.
3. Meqë pyetje themelore në këtë kontekst mbetet nëse është e mjaftueshme që pavarësia dhe paanshmëria e prokurorëve të garantohet me ligj, Kushtetuta e Kosovës ka ndjekur rekomandimin e Komisionit të Venedikut që garancionin mbi pavarësinë dhe paanshmërinë, si dhe standardet themelore që rrjedhin nga kjo, t'i vendos me kushtetutë,⁶³⁴ duke mos lejuar që parlamenti të mund të abrogojë apo dërgojë standarde themelore mbi organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, gjë e cila në të njëjtën kohë bën që garancioni mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e prokurorisë të bëhet objekt i kontrollit nga gjyqësia kushtetuese.
4. Standardi i vënë me Paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni të Kushtetutës, prandaj, duhet shikuar dhe komentuar në kontekst të këtyre dokumenteve ndërkombëtare që janë referencë për organizimin dhe funksionimin e prokurorive të sotme në botë. Ky standard abstrakt kushtetues, në mënyrë që të komentohet sipas parimeve bashkëkohore dhe përcaktimeve ndërkombëtare, duhet interpretuar, përveç sipas

⁶³² Shih European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Report on European standards as regards the independence of the judicial system'. CDL-AD(2010)040, paragrafi 14.

⁶³³ Shih European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Report on European standards as regards the independence of the judicial system'. CDL-AD(2010)040, paragrafi 15.

⁶³⁴ Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the Regulatory Concept of the Constitution of the Hungarian Republic', adopted at the Commission's 25th Plenary Meeting, Venice, November 1995, kapitulli 11. CDL(1995)073Rev.

rekomandimeve të sipërcekura të Komisionit të Venedikut, edhe sipas këtyre dokumenteve ndërkombëtare:

- a) Rekomandimi i Kombeve të Bashkuara mbi Rolin e Prokurorëve, i vitit 1990 (The 1990 United Nations Guidelines on the Role of Prosecutors) - në tekstin e mëtejshëm: RKBRP 1990;
- b) Rekomandimi (2000)19 i Komitetit të Ministrave të Këshilli të Evropës mbi Rolin e Prokurorëve Publike në Sistemin e Drejtësisë Penale (Recommendation Rec(2000)19 of the Committee of Ministers of the Council of Europe on the Role of Public Prosecution in the Criminal Justice System) - në tekstin e mëtejshëm: R(2000)19 i KMKE;
- c) Standardet e Përgjegjësisë Profesionale dhe Deklarata e Detyrave dhe e të Drejtave Themelore të Prokurorëve të Asociacionit Ndërkombëtar të Prokurorëve, e vitit 1999 (The 1999 IAP (International Association of Prosecutors) Standards of Professional Responsibility and Statement of the Essential Duties and Rights of Prosecutors) - në tekstin e mëtejshëm SPPDDDDThPANP 1999;
- d) Deklarata Bordeaux e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian dhe e Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropian mbi ‘Gjyqtarët dhe Prokurorët në një Shoqëri Demokratike’ (The Bordeaux Declaration of the Consultative Council of European Judges (CCJE) and the Consultative Council of European Prosecutors (CCPE) on “Judges and Prosecutors in a Democratic Society”) - në tekstin e mëtejshëm Deklarata Bordeaux;
- e) Parimet Evropiane mbi Etikën dhe Veprimet e Prokurorëve Publik e Këshillit të Evropës, e ashtuquajtura ‘Parimet e Budapestit’ 2005 (The European Guidelines on Ethics and Conduct for Public Prosecutors (Council of Europe, “Budapest Guidelines”, 2005) - në tekstin e mëtejshëm: Parimet e Budapestit;
- f) Deklarata e Standardeve Minimale mbi Sigurinë dhe Mbrojtjen e Prokurorëve Publik dhe Familjeve të Tyre e Asociacionit Ndërkombëtar të Prokurorëve (Declaration on Minimum Standards Concerning the Security and Protection of Public Prosecutors and their Families) - në tekstin e mëtejshëm: DSMSMPPFANP;
- g) Rekomandimet e Komisionit të Venedikut për këtë fushë, bazuar në studimet e kohëpaskohshme.

Statusi i prokurorisë publike në kuptim të nenit 109 Paragrafi 1

1. R(2000)19 i KMKE, në Nenin 1, përcakton që prokuroria publike është autoritet e cila, në emër të shoqërisë apo shtetit, garanton zbatimin e ligjit aty ku përfshihet sanksioni penal, duke pasur parasysh për efektivitetin e tërë sistemit të drejtësisë penale si dhe të të drejtave themelore kushtetuese të njeriut. Komisioni i Venedikut, në rastin e Rusisë, e ka përcaktuar qartësisht që autoriteti dhe përgjegjësia e prokurorisë publike është e kufizuar në ndjekjen penale të kryerësve brenda kuadrit të veprave penale dhe në përgjithësi në rolin e tij si mbrojtës i interesit publik në kuadër të sistemit të drejtësisë penale.⁶³⁵ RKBRP 1990 në Nenin

⁶³⁵ Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), CDL-AD(2005)014. Opinion on the Federal Law on the Prokuratura (Prosecutor's Office) of the

3 përcakton që prokurorët publik janë agjent themelor të administrimit të drejtësisë, dhe se dinjiteti e ndershmëria e tyre profesionale duhet mbajtur në vazhdimësi. Në kuptim të RKBRP 1990, pozita e prokurorit publik mbetet themelore sa i përket garantimit të të drejtave themelore të njeriut, përderisa statusi i prokurorit publik shihet në kuptim të tërë përgjegjësisë dhe paanësisë së administrimit të drejtësisë. Në kuptim të statusit të prokurorisë publike, Komisioni i Venedikut ka argumentuar që duhet pasur kujdes që funksioni i prokurorit publik të kufizohet në kuptim të ‘mospenetimit’ eventual në ‘oborrin’ e funksionit gjyqësor, legjislativ apo ekzekutiv.⁶³⁶ Kjo me qëllim që funksioni i prokurorit të mos mund të keqpërdoret në dëm të parimit të ndarjes së pushtetit, apo në funksion të ‘goditjes’ së kundërshtarëve politikë.

2. Deklarata Bordeaux, në nenin 1 të saj, përcakton që prokuroria publike duhet të garantojë që të drejtat e njeriut janë të garantuara në të gjitha fazat e procedurës penale, përderisa vëmendje e veçantë i jepet mbrojtjes së rendit publik.⁶³⁷ Deklarata, gjithashtu, përcakton që një vendim i prokurorit për të ndjekur apo jo penalisht një subjekt duhet të jetë i hapur për kontroll nga një gjykatë kompetente,⁶³⁸ përderisa viktimës i duhet dhënë garancioni që në rast se prokurori nuk e dërgon çështjen në gjykatë, këtë ta bëjë viktima drejtpërdrejtë.⁶³⁹ Në anën tjetër, në nenin 2, Deklarata e përcakton qartësisht që një barazi e armëve në mes të prokurorit dhe mbrojtjes duhet garantuar dhe vëzhguar në mënyrë konstante, siç është argumentuar edhe nga GjEDNJ në *Nideröst-Huber v. Switzerland*⁶⁴⁰ dhe *Kress v. France*,⁶⁴¹ duke pasur respekt për pavarësinë e gjykatës, parimin e ndarjes së pushtetit si dhe duke marrë për bazë fuqinë përfundimtare të vendimeve gjyqësore.

Russian Federation, para. 75; Shih gjithashtu: Council of Europe, ‘Role of the public prosecutor’s office in a democratic society governed by the rule of law’, Recommendation 1604 (2003) of the Parliamentary Assembly.

⁶³⁶ Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) CDL-AD(2005)014. Opinion on the Federal Law on the Prokuratura (Prosecutor’s Office) of the Russian Federation. para 13;

⁶³⁷ Krahaso me: Henning, J., Peter (1999) ‘Prosecutorial Misconduct and Constitutional Remedies’. *Washington University Law Quarterly*. Vol. 77, No. 3, pp. 713-832.

⁶³⁸ Si shembull krahasues, Prokurori Publik, sipas Kushtetutës, i është besuar pushteti të kryej, ndërmar, vazhdoj apo ndërprej hetimet penale sipas diskrecionit të tij. Këto kompetenca i ushtron në interes të publikut. Në kuptim të nenit 113.2, Prokurori Publik është arbitri kryesor i interesit publik. Veprimet apo mosveprimet e tij lidhur me një hetim apo ndjekje penale nuk mund të jenë subjekt i vlerësimit gjyqësor sipas Kushtetutës (Vendim i Gjykatës Supreme të Qipros (pa numër) i datës 1.12.2010);

⁶³⁹ Krahaso me: Hall, J., Donald (1975) ‘The Role of the Victim in the Prosecution and Disposition of a Criminal Case’. *Vanderbilt Law Review*. Vol. 28, No. 5, pp. 931-985; Shih edhe: Gillis, W. John, Belof, E., Douglas (2001) ‘Next Step for a Maturing Victim Rights Movement: Enforcing Crime Victim Rights in the Courts’. *McGeorge Law Review*. Vol. 33, No. 3, pp. 689-704.

⁶⁴⁰ *Nideröst-Huber v. Switzerland*, GjEDNJ, 18 February 1997, § 23, Reports of Judgments and Decisions 1997-I;

⁶⁴¹ *Kress v. France* [GC], GjEDNJ, no. 39594/98, § 72, ECHR 2001-VI

3. E një rëndësie të veçantë është fakti që GjEDNj, p.sh. në *Zlinsat, spol. s r.o., v. Bulgaria*,⁶⁴² ka refuzuar që ta konsiderojë prokurorinë publike si një institucion me karakteristika gjyqësore në kuptim të nenit 6.1 të KEDNj, dhe kjo për shumë arsye: a) për shkak se funksioni prokuroria ka mungesë të garancive procedurale gjyqësore, b) për shkak se prokuroria vepron mbi bazë të mocioneve të ngritura nga vet ajo, dhe jo mbi mocionet e të tjerëve, apo edhe për shkak, siç është argumentuar në *Vasilescu v. Romania*,⁶⁴³ prokuroria nuk mund të ketë juridiksionin e plotë për të zgjidhur një rast të vetëm dhe pa kontroll gjyqësor, c) për shkak se prokuroria gëzon diskrecion të gjerë sa i përket mënyrës së qasjes ndaj rastit, provave apo edhe argumenteve, dhe d) për shkak se prokuroria nuk mund të shihet si e paanshme përballë të akuzuarit, meqë akuza e saj është kundër këtij të fundit. Gjithashtu, në *Varbanov v. Bulgaria*,⁶⁴⁴ GjEDNj ka argumentuar që një të mbajturi në arrest i duhet dhënë çdo herë një mundësi për ta apeluar vendimin e prokurorit në gjykatë, dhe jo thjesht tek një prokuror më i lartë. Prokuroria publike, në kuptim të standardeve të GjEDNj, nuk mund të jetë instanca që vendos për çfarëdo rasti e vetme, por që çdo veprim i saj duhet të ketë mundësi që të rishikohet nga gjykata. Në të kundërtën, nëse prokurori publik do të kishte fuqi të vendoste i vetëm në një rast - pra pa kontroll gjyqësor - kjo do të konsiderohej shkelje e së drejtës së subjektit juridik për qasje në gjykatë.
4. Një dallim themelor që duhet bërë në këtë kontekst, siç është argumentuar në mënyrë shprehimore edhe nga Komisioni i Venedikut, është që duhet bërë dallimi thelbësor në mes të *interesit të shoqërisë* dhe *interesit të bartësve të pushtetit*.⁶⁴⁵ Në këtë kuptim, vlerësimi i funksionit të prokurorit si mbrojtës i interesit shoqëror nuk duhet lejuar që të kalojë në kufijtë e mbrojtjes së qeverisë apo partive politike që bartin pushtetin, meqë kjo do të transformohej në një instrument të pushtetit për të shtypur qytetarët. Prandaj, është e rëndësishë së veçantë që të ndërtohet një dallim i qartë në mes të funksionit të prokurorit si mbrojtës i interesit të shoqërisë vetëm sa i përket domenit të së drejtës penale, dhe e tërë kjo në komplementaritet me funksionet e mbrojtjes së interesave shoqërore që kanë institucionet tjera, siç është p.sh. Avokati i Popullit, pushteti gjyqësor, etj.

Pavarësia dhe paanshmëria e prokurorisë publike në kuptim të nenit 109 Paragrafi 1

1. Meqë paragrafi 1 dhe 2 i nenit 109 e vendosin pavarësinë dhe paanshmërinë e prokurorisë publike si parime themelore kushtetuese, ky kapitull i komenton këto dy parime kushtetuese prej një prizmi të standardeve ndërkombëtare. R(2000)19 i KMKE, në Nenin 4, përcakton që shtetet duhet të marrin të gjitha veprimet e nevojshme për të garantuar që prokurorët publik të disponojnë dhe të jenë të garantuar me të gjitha resurset profesionale, organizative, duke përfshirë ato

⁶⁴² *Zlinsat, spol. s r.o., v. Bulgaria*, GjEDNj, No. 57785/00, § 78, 15 June 2006

⁶⁴³ *Vasilescu v. Romania*, GjEDNj, Judgment of 22 May 1998, Reports of Judgments and Decisions 1998-III.

⁶⁴⁴ *Varbanov v. Bulgaria*, GjEDNj, No. 31365/96, ECHR 2000-X.

⁶⁴⁵ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Report on European standards as regards the independence of the judicial system'. CDL-AD(2010)040.

buxhetore, si dhe të kenë në disponim hapësirë të mjaftueshme resursesh për t'i dhënë mundësi prokurorëve që të ushtrojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre juridike në mënyrë të plotë.⁶⁴⁶ Këto, sipas R(2000)19 i KMKE, duhen arritur në përputhje me vlerësimin e vet prokurorëve, si dhe me miratimin e tyre, në mënyrë që vet prokurorët publik të jenë subjekt i vendimeve që i garantojnë atyre hapësirën e nevojshme për të ushtruar funksionin e tyre në mënyrën e duhur.⁶⁴⁷ Për më tepër, Deklarata Bordeaux, në nenin 6, përcakton që zbatimi i së drejtës nga ana e prokurorisë kërkon që pozicioni i prokurorit në procedurë të jetë i garantuar me ligj, ngjashëm sikur gjyqtarëve, duke garantuar pavarësi dhe autonomi në vendimmarrje dhe ushtrim të funksionit të tyre në mënyrë të ndershme, objektive dhe të paanshme.

2. Komisioni i Venedikut e bën ndarjen e pavarësisë së prokurorisë publike në kontekstin e brendshëm dhe të jashtëm. Sa i përket pavarësisë së jashtme, SPPDDDDThPANP 1999, në nenin 2.1, përcakton që, në kuptim të pavarësisë së prokurorisë, shfrytëzimi i diskrecionit prokurorial në kuptim të hapësirës ligjore duhet shfrytëzuar në mënyrë të pavarur dhe duke përjashtuar çdo ndërhyrje politike.⁶⁴⁸ Për më tepër, SPPDDDDThPANP 1999, në nenin 2.2, përcakton që nëse institucionet jo-prokuroriale kanë të drejtë të intervenojnë apo të ndërhyjnë në procedurat prokuroriale me anë të udhëzimeve, atëherë udhëzimet në fjalë duhet të jenë transparente, në përputhje me autoritetin ligjor, si dhe në përputhje me parimet që e garantojnë vëzhgimin dhe perceptimin e pavarësisë së prokurorisë në publik.⁶⁴⁹ Komisioni i Venedikut e bën një dallim në këtë kontekst, duke argumentuar që prokurorët duhet të jenë plotësisht të pavarur sa i përket funksionit të tyre të ndjekjes penale. Megjithatë, në kuptim të ndërtimit të politikës penale të shtetit, Komisioni argumenton që parlamenti dhe qeveria mund të kenë rol në kuptim të vendosjes së llojit të veprave penale që duhen shqyrtuar me prioritet, mënyrën e bashkëpunimit me institucionet ndihmëse, apo edhe kohën për ndjekjen e veprave të caktuara.⁶⁵⁰ E thënë në këtë mënyrë, Komisioni i Venedikut lë hapësirë edhe për parlamentin dhe qeverinë në kuptim të bërjes së politikës penale

⁶⁴⁶ Shih gjithashtu: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the Draft Law on the Public Prosecutors' Service of Moldova', No. 473/2008, adopted by the Venice Commission at its 75th Plenary Session, Venice, June 2008. CDL-AD(2008)019. para. 69.

⁶⁴⁷ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Ukrainës në rastin 4-rp/2000 theksoi se një deputeti nuk i lejohet t'i drejtohet Zyrës së Prokurorit Publik me kërkesa, propozime apo udhëzime në raste specifike (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës 4-rp/2000 i datës 11.4.2000);

⁶⁴⁸ Krahaso me rastin amerikan: Pizzi, T., William (1993) 'Understanding Prosecutorial Discretion in the United States: The Limits of Comparative Criminal Procedure as an Instrument of Reform'. *Ohio State Law Journal*. Vol. 54, pp. 1325-1375.

⁶⁴⁹ Krahaso me: Joy, A., Peter (2006) 'Relationship between Prosecutorial Misconduct and Wrongful Convictions: Shaping Remedies for a Broken System'. *Wisconsin Law Review*. Vol. 2006, No. 2, pp. 399-431;

⁶⁵⁰ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Report on European standards as regards the independence of the judicial system'. CDL-AD(2010)040. Part II - The Prosecution Service, paragrafi 43;

të shtetit, por natyrisht duke qëndruar jashtë çdo ndikimi eventual mbi funksionin e ndjekjes penale që gëzon prokurori publik.

3. R(2000)19 i KMKE, në nenin 11, përcakton që shtetet duhet të garantojnë që prokurorët publik të kryejnë funksionin e tyre pa u vënë nën ndjekje penale, paditur për shkaqe civile ose pa dhënë përgjegjësi tjetër pa shkaqe të arsyeshme. Për më tepër, R(2000)19 i KMKE përcakton që prokuroria publike nuk mund të ndërhyjë në kompetenca legjislative apo ekzekutive, në mënyrë që të ruhet ndarja e pushteteve në mënyrë të përcaktuar nga kushtetuta. R(2000)19 i KMKE, në nenin 14, gjithashtu vendos kushtin që shtetet të garantojnë mekanizmin që përcakton pavarësinë e prokurorisë me anë të ligjit. Për më tepër, R(2000)19 i KMKE, në Nenin 16 përcakton që prokurorët publik duhet dhënë hapësirë të lirë dhe të nevojshme që të jenë në gjendje për të ndjekur penalisht zyrtarët publik - të cilitdo pushtet - pa kufizim, për veprat penale që lidhen me ushtrimin e pushtetit në mënyrë të paligjshme. Nëse eventualisht, procedura penale përcakton pjesëmarrjen e ndonjë institucioni ekzekutiv në vendosjen në lidhje me një çështje të ndjekjes penale, atëherë, siç rekomandon Komisioni i Venedikut, rëndësi themelore i duhet dhënë transparencës së ekzekutivit në procedurën e përcaktuar me ligj.⁶⁵¹ Komisioni i Venedikut, gjithashtu, e ka bërë të qartë që duhet ndaluar çdo mundësi që parlamenti ose qeveria të mund të kthejnë mbrapshtë apo anulojnë një vendim të prokurorisë publike. Megjithatë, raportimi gjeneral, pra, jo sipas rasteve individuale, mund të jetë i lejuar përballë parlamentit.⁶⁵² Megjithatë, Komisioni i Venedikut ka argumentuar që nuk mund të lejohet që prokuroria të ketë pavarësi absolute në kryerjen e funksionit të saj, meqë kjo mund të shpie në modele të prokurorisë që shkelin mbi të drejtat e njeriut.⁶⁵³ Kjo nënkupton se duhet vënë në dispozicion mekanizma që e kontrollojnë cilësinë e pavarësisë së prokurorisë përballë detyrimeve ligjore të saj, por pa penguar apo pa ndërhyrë në punën e saj profesionale. Sa i përket detyrimit përballë parlamentit, Komisioni i Venedikut gjithashtu ka rekomanduar që do të ishte e papëlqyeshme nëse shefi i prokurorisë së shtetit vishet me të drejtën e propozimit të legjislacionit në parlament në fushën e kompetencës së tij.⁶⁵⁴ Në anën tjetër, Komisioni i Venedikut ka përcaktuar që prokurorët mund të marrin pjesë në trupat koordinues ekzekutiv që merren me administrimin e drejtësisë, por pa u obliguar për pjesëmarrje.⁶⁵⁵

⁶⁵¹ Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the Draft Law amending the Law of Ukraine on the Office of the Public Prosecutor', CDL-AD(2004)038, para. 26;

⁶⁵² Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the regulatory concept of the Constitution of the Hungarian Republic', adopted at the Commission's 25th Plenary Meeting, Venice, 24-25 November 1995, chapter 11, CDL(1995) 073rev.;

⁶⁵³ Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the Draft Law amending the Law of Ukraine on the Office of the Public Prosecutor', CDL-AD(2004)038. para. 23;

⁶⁵⁴ Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the Draft Law amending the Law of Ukraine on the Office of the Public Prosecutor', CDL-AD(2004)038para. 24;

⁶⁵⁵ Shih p.sh: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission)

4. Deklarata Bordeaux, në nenin 8, vendos kushtet minimale sa i përket pavarësisë së prokurorëve. Deklarata kërkon që pozita dhe funksioni i prokurorëve publik të mos jetë i ndikuar apo i penguar nga ndonjë burim i jashtëm nga vet prokuroria publike, si dhe që rekrutimi, zhvillimi i karrierës, sigurimi i mandatit, si dhe shpërblimi të jenë të garantuar me mekanizma efikas ligjor. Në kushtet e përgjegjësisë së prokurorit, duhet shmangur çdo mundësi që prokurori të vishet me detyrimin që të raportojë për raste individuale përballë parlamentit, apo që ky i fundit të bëjë presion mbi prokurorët në raste penale që mund të jenë jopopullore.⁶⁵⁶ Në anën tjetër, Komisioni i Venedikut ka rekomanduar që ‘presioni’ i medias dhe hulumtimi gazetaresk të mos kufizohet dhe të mos interpretohet si ndërhyrje në punët e prokurorisë, meqë kjo mund të kufizojë lirinë e shprehjes dhe atë të medias, siç është thënë shprehimisht edhe në Rekomandimin 2003(13) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.⁶⁵⁷ Nëse eventualisht presioni medial mund të paragjykojë apo dëmtoj procesin penal, atëherë e drejta për të ndërhyrë përballë medias duhet t’i takoj vetëm gjykatave.⁶⁵⁸
5. Në kuptim të relacionit të prokurorëve dhe gjykatësve, R(2000)19 i KMKE vendos disa parime themelore. R(2000)19 i KMKE, në nenin 17, përcakton që statusi i prokurorëve duhet të jetë i tillë që mos të lejojë dyshime eventuale mbi rolin ndikues të tyre mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve. Për më tepër, e njëjta kërkon që të pamundësohet që i njëjti person të mund të ushtrojë edhe rolin e prokurorit edhe atë të gjyqtarit. Në vijim të kësaj, ky standard kërkon që relacioni i prokurorëve dhe gjyqtarëve të jetë i tillë që të mos lërë dyshime legjitime mbi lidhjen apo mundësinë eventuale që prokurorët të kenë fuqinë e ndikimit mbi gjyqtarët, apo edhe që këta të fundit të kenë ndonjë varësi ndaj prokurorëve. R(2000)19 i KMKE, në Nenin 19, gjithashtu kërkon që prokurorët të mos shprehin ndonjë dyshim mbi pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve, dhe që të mos i kundërshtojnë apo pengojnë vendimet e gjykatave, përveç se në procedurë të ankimit të lejuar me ligj. Pavarësia dhe autoriteti i prokurorëve nuk mund të ketë shprehje të tillë që të cenojë apo shkelë në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve, meqë kjo do të shkatërronte balancën që kërkohet të mbahet për të garantuar barazinë e armëve dhe gjykimin e drejtë. Gjithashtu, R(2000)19 i KMKE në nenin 20 përcakton që prokurorët duhet të jenë objektiv dhe të drejtë në administrimin e provave përballë gjykatës, si dhe duhet të informojnë gjykatën mbi çdo fakt dhe argument që lidhet me rastin.⁶⁵⁹ Prandaj, sipas komentimit logjik të

‘Opinion on the Draft Law amending the Law of Ukraine on the Office of the Public Prosecutor’, CDL-AD(2004)038, para. 25;

⁶⁵⁶ Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), ‘Opinion on the Draft Law on the Public Prosecutors Office and the Draft Law on the Council of Public Prosecutors of “the former Yugoslav Republic of Macedonia”’, CDL-AD(2007)011, para. 25;

⁶⁵⁷ Recommendation Rec(2003)13 of the Committee of Ministers to member states on the provision of information through the media in relation to criminal proceedings;

⁶⁵⁸ Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the Draft Law amending the Law of Ukraine on the Office of the Public Prosecutor’, CDL-AD(2004)038, para.28;

⁶⁵⁹ Krahaso me: White, W., Thomas (1977) ‘Reliance on Apparent Authority as a Defense to Criminal Prosecution’. *Columbia Law Review*. Vol. 77, No. 5, pp. 775-809;

R(2000)19 i KMKE, prokurorët nuk kanë pavarësi që të vendosin sa i përket administrimit apo jo të provave dhe fakteve relevante për një rast, por këtë e kanë detyrim në kuptim të garantimit të gjyqimit të drejtë dhe të paanshëm.⁶⁶⁰

6. Për më tepër, Deklarata Bordeaux në nenin 36 e përcakton që prokurori publik dhe gjyqtarët duhet të kenë një sjellje të tillë që nuk lejon dyshime sa i përket objektivitetit dhe paanshmërisë së tyre jo thjesht në kuptimin subjektiv por edhe në sytë e publikut. Gjithashtu, Deklarata përcakton që duhet hequr çdo konfuzion sa i përket funksioneve të të dyve, dhe që prokurori publik dhe gjyqtarët duhet të kujdesen që kryerja e aktiviteteve të tyre të mos ketë përzjerje apo ndërrim pozicionesh në kuptim të funksionit që ata kryejnë.
7. Të rëndësishëm në kuptim të pozicionit të prokurorit përballë gjykatës janë disa nga standardet e GjEDNj-së në lidhje me këtë. Kështu, ta zëmë, në *Vermeulen v. Belgium*⁶⁶¹ GjEDNj ka përcaktuar që prezenca e prokurorit në procesin e vendimmarrjes së gjykatës në proceset jo-penale - e ashtuquajtura *teoria e dukjes* - do të nënkuptonte që prokurori të mund të shtynte përpara argumentet e tij pa u frikësuar nga kundërshtimi apo kontestimi i mbrojtjes. Kjo, prandaj, prodhon pabarazi përballë palëve, dhe mund të shihet me kontestim të madh nga pala e akuzuar, prandaj, siç është thënë në *F.W. v. France*,⁶⁶² kjo është absolutisht në kundërshtim me të drejtën për gjykim të drejtë meqë mund të prodhojë ndjenjën e pabarazisë ndërmjet palëve. Prandaj, siç është argumentuar nga GjEDNj në *Martinie v. France*,⁶⁶³ pavarësisht faktit nëse prokurori ndërhyr në vendimmarrjen e gjykatës, mjafton vetëm prezenca e tij pasive që të shkelet parimi i barazisë së armëve në një proces jo-penal dhe neni 6.1 i KEDNj.
8. Në kontekstin e raportit të prokurorit me gjykatën, GjEDNj-ja ka përcaktuar që fakti se gjykata i lëshon informacionet apo dokumentet vetëm për prokurorin dhe jo për palën e akuzuar, siç është thënë në *Reinhardt and Slimane-Kaid v. France*,⁶⁶⁴ do të përbente shkelje të barazisë së armëve. Prandaj, siç është thënë edhe në *Lilly France v. France*,⁶⁶⁵ dhënia e informacionit të privilegjuar prokurorisë apo mosinformimi i barabartë me shkresat dhe provat e lëndës shkel të drejtën për gjykim të drejtë. Në këtë aspekt, GjEDNj-ja e ka dhënë argumentin që pozicioni i prokurorit nuk guxon të jetë i privilegjuar nga ana e gjykatës, dhe nëse ndodh kjo, shkelet parimi i barazisë së armëve dhe i së drejtës për gjykim të drejtë.⁶⁶⁶

⁶⁶⁰ Krahaso me: Joy, A., Peter (2006) 'Relationship between Prosecutorial Misconduct and Wrongful Convictions: Shaping Remedies for a Broken System'. *Wisconsin Law Review*. Vol. 2006, No. 2, pp. 399-431.

⁶⁶¹ *Vermeulen v. Belgium*, GjEDNj, Judgment of 20 February 1996, Reports of Judgments and Decisions 1996-I, paragraph 34.

⁶⁶² *F.W. v. France*, GjEDNj, No. 61517/00, § 27, 31 March 2005

⁶⁶³ *Martinie v. France* [GC], GjEDNj, No. 58675/00, ECHR 2006-VI paragraph 53.

⁶⁶⁴ *Reinhardt and Slimane-Kaid v. France*, GjEDNj, Judgment of 31 March 1998, Reports of Judgments and Decisions 1998-II

⁶⁶⁵ *Lilly France v. France*, GjEDNj, No. 53892/00, § 25, 14 October 2003

⁶⁶⁶ Krahaso me: Henning, J., Peter (1999) 'Prosecutorial Misconduct and Constitutional Remedies'. *Washington University Law Quarterly*. Vol. 77, No. 3, pp. 713-832.

9. Megjithatë, GjEDNj ka bërë disa përjashtime sa i përket barazisë së armëve në mes prokurorit dhe të akuzuarit. Në *Guigue and SGEN-CFDT v. France*,⁶⁶⁷ GjEDNj ka vendosur se fakti që ligji i lejon afat më të gjatë për ankesë prokurorit se sa palës së akuzuar nuk mund të konsiderohet që substancialisht e pengon pozicionin e barabartë të palës së akuzuar me prokurorin. Apo, siç është thënë në *Blanco Callejas v. Spain*,⁶⁶⁸ rregulla që vetëm prokurori mund të apelojë vendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese Spanjolle sa i përket rasteve të mbrojtjes nuk bie në kundërshtim me parimin e barazisë së palëve.
10. Përveç relacionit me gjykatat, prokurorët kanë detyrime të përcaktuara edhe në kuptim të rolit të tyre përballë policisë. R(2000)19 i KMKE, në nenin 21, përcakton që prokurorët duhet të mbikëqyrin hetimet që zhvillohen nga policia, si dhe të kenë të drejtën për të vendosur mbi vazhdimin apo ndalimin e tyre. Theks të veçantë në këtë kontekst, R(2000)19 i KMKE i jep detyrimin që prokurorët duhet të kenë përballë kontrollit të respektimit të të drejtave të njeriut nga ana e policisë, sa i përket funksionit të tyre hetues. R(2000)19 i KMKE gjithashtu kërkon që policia të vepron nën urdhrat e prokurorit sa i përket hetimit penal, dhe që policia të ndjek një linjë të subordinimit efektiv ndaj urdhrave të prokurorisë. R(2000)19 i KMKE, në Nenin 23, kërkon që të ketë një bashkëpunim efektiv në mes të prokurorisë dhe policisë, në kuptimin që kjo e fundit të mos mund t'i ikë subordinimit ndaj rolit mbikëqyrës të prokurorisë apo edhe që të shndërrohet në mjet të luftës së qeverisë ndaj prokurorisë publike.⁶⁶⁹ Megjithatë, GjEDNj në rastin *Ramsahai and Others v. the Netherlands*,⁶⁷⁰ ka përcaktuar që duhet pasur parasysh që marrdhënia në mes të prokurorisë dhe policisë të mos jetë i bazuar në influencim apo varshmëri personale, meqë kjo mund të interpretohet si në kundërshtim me nenin 6.1 të KEDNj. GjEDNj-ja, në rastin *Huber vs. Switzerland*,⁶⁷¹ ka kërkuar që procesi i ndjekjes penale dhe procesi hetimor të jenë të ndara, dhe që personat e përfshirë në këto dy procese të mos kenë ndikim subjektiv apo objektiv të ndërsjellë. Në këtë aspekt, *Huber vs. Switzerland* vendos parimin që hetimi teknik policor i rastit të jetë i ndarë teknikisht nga subjekti që bën ndjekjen penale, pra subjekti që e administron ngritjen e akuzës dhe dhënien e argumenteve përballë gjykatës dhe të akuzuarit.
11. Përveç pavarësisë së jashtme, e një rëndësie të veçantë është edhe pavarësia e brendshme e prokurorëve. Meqë prokuroria publike është një institucion hierarkik, i prirur nga një shëf i prokurorisë publike, ushtrimi i funksionit prokurorial rrjedh në kuadër të linjës së hierarkisë. Deklarata Bordeaux, në nenin 9, përcakton që edhe pse organizimi i prokurorisë publike është hierarkik, efektiviteti i saj duhet shikuar në lidhje të veçantë sa i përket transparencës me linjat e autoritetit prokurorial, përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë. Gjithashtu, Deklarata përcakton që udhëzimet

⁶⁶⁷ *Guigue and SGEN-CFDT v. France* (dec.), GjEDNj, No. 59821/00, 6 January 2004

⁶⁶⁸ *Blanco Callejas v. Spain* (dec.), GjEDNj, no. 64100/00, 18 June 2002

⁶⁶⁹ Krahaso me: Thomas W. White (1977) 'Reliance on Apparent Authority as a Defense to Criminal Prosecution'. *Columbia Law Review*. Vol. 77, No. 5, pp. 775-809;

⁶⁷⁰ *Ramsahai and Others v. the Netherlands* [GC], GjEDNj, No. 52391/99, ECHR 2007-VI

⁶⁷¹ *Huber vs. Switzerland*, [1990] ECHR.

apo urdhrat që i jepen prokurorëve individual nga prokurori më i lartë, sipas përcaktimit ligjor, duhen dhënë në formë të shkruar dhe në linjë me parimet e prokurorisë profesionale. Në anën tjetër, rishikimi i vendimit të një prokurori për të ndjekur apo jo penalisht një subjekt nga ana e një prokurori më të lartë duhet bërë në përputhje me parimin e objektivitetit dhe paanësisë, duke i dhënë viktimës respektin e duhur.⁶⁷² Deklarata vendos kërkesën që linjat e transparencës, objektivitetit dhe paanshmërisë e pavarësisë të shprehen jo vetëm në relacionin e prokurorisë publike me institucionet tjera, por gjithashtu edhe brenda vet institucionit të prokurorisë. Komisioni i Venedikut argumenton që përveç ndërtimit të një balance institucionale në mes të prokurorisë publike, qeverisë, policisë dhe publikut, është po aq e rëndësishme që të ketë një balancë në mes vet prokurorëve më të ulët dhe prokurorit gjeneral, në mënyrë që këta të fundit të kryejnë detyrën e tyre në mënyrë të pavarur dhe efektive.⁶⁷³ Komisioni i Venedikut, gjithashtu, duke e bërë vlerësimin e sistemit kushtetues të Ukrainës, ka argumentuar që megjithëse sistemi i prokurorisë publike duhet organizuar sipas hierarkisë, nuk duhet lejuar hapësira që prokurori më i lartë të ketë qasje në drejtimin direkt të prokurorëve më të ulët, por që modeli i drejtimit dhe llogaridhënies të ndërtohet sipas kaskadave.⁶⁷⁴ Në anën tjetër, në rastin e Moldavisë, Komisioni i Venedikut e ka bërë të qartë që vendimet e prokurorit më të ulët mund të rishikohen dhe anulohen nga prokurori më i lartë vetëm nëse vërehet paligjshmëri dhe gabime në zbatimin e ligjit,⁶⁷⁵ duke dhënë argumentin që autonomia e një prokurori në zbatimin e ligjit nuk mund të cenohet nga prokurori më i lartë pa arsye. Në anën tjetër, Komisioni e ka bërë të qartë që udhëzimet e prokurorit më të lartë për prokurorin më të ulët mund të jenë vetëm të natyrës së përgjithshme, dhe se prokurori më i lartë nuk mund ta drejtoj prokurorin më të ulët se si të veprojë në lidhje me një rast individual.⁶⁷⁶ Kjo, prandaj, mundëson që autonomia në kryerjen e funksionit të prokurorit më të ulët të ruhet nga arbitrariteti i një prokurori më të lartë, në funksion të kryerjes së detyrës me përgjegjësi dhe paanshmëri.

⁶⁷²Shih mbi mekanizmat që e garantojnë këtë: Gillis, W. John, Beloof, E., Douglas (2001) 'Next Step for a Maturing Victim Rights Movement: Enforcing Crime Victim Rights in the Courts'. *McGeorge Law Review*. Vol. 33, No. 3, pp. 689-704.

⁶⁷³Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the regulatory concept of the Constitution of the Hungarian Republic' adopted at the Commission's 25th Plenary Meeting, Venice, 24-25 November 1995, chapter 11, CDL(1995) 073rev.;

⁶⁷⁴ Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on the Draft Constitution of Ukraine (Text approved by the Constitutional Commission on 11 March 1996 (CDL (96) 15)', adopted at the 27th meeting of the Venice Commission on May 1996. CDL-INF (96) 6;

⁶⁷⁵ Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on the draft law on the Public Prosecutors' service of Moldova', No. 473/2008, adopted by the Venice Commission at its 75th Plenary Session, Venice, June 2008. CDL-AD(2008)019, para. 13;

⁶⁷⁶ Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on the draft law on the Public Prosecutors' service of Moldova', No. 473/2008, adopted by the Venice Commission at its 75th Plenary Session, Venice, June 2008. CDL-AD(2008)019, para. 19;

12. Sa i përket pavarësisë së brendshme, R(2000)19 i KMKE në nenin 9 e bën të qartë që në kuptim të organizimit dhe veprimit të brendshëm të prokurorisë publike, shpërndarja dhe delegimi i rasteve duhet bërë në përputhje me parimin e paanësisë dhe pavarësisë, duke i dhënë hapësirë të mjaftueshme çdo rasti. Në anën tjetër, R(2000)19 i KMKE, në Nenin 10, përcakton që prokurorët më të ulët duhet të gëzojnë të drejtën që të kërkojnë që udhëzimet apo urdhrat e dhëna nga prokurorët më të lartë të jepen në formë të shkruar, dhe që në rast që prokurori më i ulët vëren që një urdhër nga një prokuror më i lartë është i paligjshëm, atëherë duhet të ketë mekanizma të përgjegjshme të brendshme që të adresojnë kërkesën e tillë dhe ta rishikojnë vendimin.

Paanshmëria e prokurorëve në kuptim të nenit 109 Paragrafi 1 & 2

1. Sa i përket paanshmërisë subjektive, SPPDDDDThPANP 1999, në nenin 3, vë parimet themelore mbi paanshmërinë e prokurorëve publik. Sipas SPPDDDDThPANP 1999, prokurorët duhet të kryejnë detyrat e tyre pa frikë, favorizim apo paragjykim. Kjo komentohet si heqje dorë e prokurorit nga favorizimi subjektiv ndaj ndonjë subjekti, dhe në të njëjtën kohë duke mos lejuar që frika ndaj ndonjërit nga të akuzuarit të jetë përcaktor i veprimeve në procedurën penale të prokurorit. Po ashtu, siç e kërkon SPPDDDDThPANP 1999, prokurorët nuk duhet të ndikohen nga interesat e ndonjë individi apo grupi, dhe nuk duhet të priren nga presioni i publikut apo medias, por duhet të kenë referim tek e mira e përgjithshme publike. Prokurorët, gjithashtu, duhet të veprojnë me objektivitet, që nënkupton se duhet të veprojnë duke u bazuar në tërë rrethanat që e mbështjellin një rast penal, pavarësisht nëse janë rrethana lehtësuese apo ndihmëse për cilindo nga palët në gjykim. Gjithashtu, prokurorët duhet që në përputhje me kërkesat e ligjit të brendshëm, të bartin procedurën penale duke u bazuar në tërë faktet dhe provat e shikuara në mënyrë racionale, si dhe duke mos mohuar shfrytëzimin dhe administrimin e çdo prove, pavarësisht raportit të saj në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e palëve.
2. SPPDDDDThPANP 1999 gjithashtu përcakton që prokurorët duhet që gjithmonë të kërkojnë të vërtetën, duke i dhënë mundësi gjykatës që të vendos drejtësi në rastin e ndjekur, si dhe që viktima dhe komuniteti të jenë të bindur me arsye mbi drejtësinë dhe ligjshmërinë e vendosjes mbi rastin. Për më tepër, Parimet e Budapestit, në nenin 1, kërkojnë që prokurorët publik të ushtrojnë detyrat e tyre jo thjesht në linjë me të drejtën e brendshme por edhe me atë ndërkombëtare. Parimet e Budapestit, gjithashtu, përcaktojnë që prokurorët duhet t'i ndërmarrin veprimet e tyre hetimore në mënyrë koherente dhe të shpejtë, duke mos lejuar që palëve t'u dëmtohet kredibiliteti publik dhe që procedura gjyqësore të vazhdojë me humbje kohe. Në këtë kontekst, Parimet përcaktojnë që një balancë e drejtë në mes të rolit të prokurorit si mbrojtës i interesit publik dhe të drejtave individuale të qytetarëve duhet siguruar në vazhdimësi. Prandaj, funksioni i prokurorit publik nuk duhet t'i shërbej interesit publik nëse shkel mbi të drejtat e njeriut, që do të thotë se balanca në mes të interesit publik dhe të drejtave të njeriut duhet vëzhguar dhe zbatuar me qëllim të mbrojtjes së të drejtave individuale. Megjithëse Parimet e Budapestit e

proklamojnë këtë, teorikisht argumentohet që është konflikt interesi që prokurori në të njëjtën kohë të jetë akuzues i personave dhe mbrojtës i të drejtave të tyre,⁶⁷⁷ duke argumentuar që kryerja e funksionit prokurorial është në kundërshtim natyror me qëllimin për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Megjithatë, Deklarata e Budapestit nuk i referohet funksionit të prokurorit si ‘mbrojtës’ i të drejtave të njeriut, por përcakton që prokurori duhet të kujdeset që të drejtat e njeriut të mos shndërrohen në objekt shkeljeje gjatë kryerjes së funksionit të tij.

3. Në anën tjetër, Deklarata e Budapestit, në nenin 11 pika f, përcakton që prokurorët publik duhet të jenë të paanshëm dhe koherent por edhe të shihen nga të tjerët si të tillë. Prandaj, Deklarata e Budapestit e bën të qartë që nuk mjafton vetëm fakti që prokurorit t’i konsiderohet paanshmëria në këndin subjektiv, por që në mënyrë të arsyeshme të matet nëse kjo është e dukshme edhe për publikun. Pra, paanshmëria, në kuptim të Deklaratës, nuk mjafton të supozohet nga brenda por duhet që të testohet edhe nga jashtë sepse dukja në publik përbën një tregues *aktiv* të matjes së paanshmërisë. Këtu duhet pasur parasysh që Deklarata, kur i referohet paanshmërisë objektive, ka parasysh që dukja në publik të jetë me arsyeshmëri e paraqitur si e paanshme, meqë duhet pasur parasysh që nëse vendimet e prokurorit janë pa përkrahje popullore, kjo nuk do të thotë që pozicioni i tij shihet nga jashtë si i anshëm. Për të garantuar që paanshmëria e prokurorëve gjendet edhe në anën e jashtme, Deklarata e Budapestit përcakton në Nenin 2 pika o që prokuroria publike duhet të garantojë që interesat personale, përfituese, familjare apo interesat tjera jashtë funksionit të tij/saj të mos ndikojnë në punën e prokurorit publik, si dhe në marrjen e vendimeve të tij. Kjo, në anën tjetër, është përcaktim për detyrimin që prokuroria publike të garantojë që prokurorët e saj që kanë konflikt interesi personal, familjar, përfitues apo tjetër me rastet e caktuara, të përjashtohen nga ndjekja e rasteve.
4. RKBRP 1990, në nenin 11, përcakton detyrën që prokurorët të kenë rol aktiv në procedurën penale, duke e vënë theksin në nisjen e hetimit penal sipas përcaktimit ligjor. Në vijim të zbatimit të kësaj detyre, RKBRP 1990 kërkon që prokurorët të mos jenë aktor pasiv në kuptim të mbrojtjes së interesit të shoqërisë, por që funksioni i tyre të shikohet në kontekst të performancës në luftë ndaj kriminalitetit. RKBRP 1990, gjithashtu përcakton që prokurorët duhet që kujdesen në mënyrë koherente dhe të arsyeshme mbi ligjshmërinë e veprimeve hetimore,⁶⁷⁸ si dhe të kenë kujdes të vazhdueshëm mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe vendimeve tjera në relacion me procedurat penale. Për më tepër, RKBRP 1990 vë theksin në rolin aktiv të prokurorit, jo thjesht përballë detyrës së tij si ndjekës penal, por edhe në vëzhgimin e vazhdueshëm dhe sistematik të tërë sistemit të administrimit të drejtësisë penale.

⁶⁷⁷ Shih p.sh: Opinion, ‘The Nature and Consequences of Forensic Misconduct in the Prosecution of a Criminal Case’. *Columbia Law Review*. Vol. 54, No. 6 (Jun., 1954), pp. 946-983;

⁶⁷⁸ Krahaso me: Fisher, T., Michael (1988) ‘Harmless Error, Prosecutorial Misconduct, and Due Process: There’s More to Due Process than the Bottom Line’. *Columbia Law Review*. Vol. 88, No. 6, pp. 1298-1324;

5. Në kryerjen e funksionit të tyre, prokurorët kërkohet që të kenë kujdes profesional ndaj objektit penal, përndryshe palët në procedurë penale e fitojnë të drejtën e ankimit të rastit në kuptim të shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë. Në këtë aspekt, RKBRP 1990, në nenin 13, si dhe R(2000)19 i KMKE, në nenin 24, kërkon që prokurorët të heqin dorë nga çfarëdo diskriminimi, që të veprojnë me objektivitet sa i përket të drejtave të palëve, si dhe që të kenë referim të veçantë në të drejtat e viktimave në përputhje me Deklaratën e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimin dhe Abuzimit të Pushtetit. R(2000)19 i KMKE, në nenin 27, përcakton që prokurorët duhet të heqin dorë nga ndjekja penale e subjekteve nëse një hetim i pavarur tregon që provat janë të paqëndrueshme. Gjithashtu, R(2000)19 i KMKE, në nenin 28, përcakton që prokurorët nuk duhet të prezantojnë prova që janë marr në mënyrë të paligjshme, apo duke shkelur të drejtat procedurale të palëve, si dhe të vëzhgojnë në vazhdimësi barazinë e armëve në procesin penal, duke mos e privuar mbrojtjen prej informacioneve që duhen t'i dinë. GjEDNj, në rastin *Kelly and Others v. the United Kingdom*,⁶⁷⁹ ka përcaktuar që mbledhja e provave dhe procesi hetues nuk guxojnë të shkelin mbi parimin e efektivitetit. Për më tepër, sipas R(2000)19 i KMKE, nëse përjashtimisht veprimi hetimor shkel ndonjë të drejtë të njeriut, rishikimi gjyqësor mbi veprimin e tillë hetimor të prokurorit duhet të jetë i mundshëm dhe efektiv. R(2000)19 i KMKE, në nenin 34, kërkon që vendimet e prokurorëve publik për të mos ndjekur penalisht një subjekt të caktuar, të mund të jenë të ankimuara nga ana e viktimave, në mënyrë që këto të fundit të mund të marrin pozicionin e akuzuesit privat nëse prokurori publik vendos të mos e akuzojë penalisht një subjekt të caktuar.⁶⁸⁰

6. SPPDDDDThPANP 1999, në nenin 4.2, kërkojnë që përveç rolit të tyre aktiv përballë procedurës penale, prokurorët duhet të kenë rol mbikëqyrës dhe aktiv përballë institucioneve tjera ndihmëse që japin kontribut për procedurën penale, si p.sh. policinë. Mbetet në rolin e prokurorëve, sipas SPPDDDDThPANP 1999, që objektiviteti, paanshmëria dhe profesionalizmi i policisë të mbikëqyret në vazhdimësi. Përveç kësaj, SPPDDDDThPANP 1999 kërkon që prokurorët duhet që të mbikëqyrin respektin për të drejtat e njeriut, të shërbimeve ndihmëse penale, duke përfshirë policinë, dhe që ndjekja penale të jetë konstant e varur nga provat në dispozicion. SPPDDDDThPANP 1999, në nenin 4.3, kërkojnë gjithashtu që prokurorët të ruajnë konfidencialitetin e tyre profesional, si dhe që të kujdesen që të drejtat dhe interesat e viktimave të mos afektohen. Sipas SPPDDDDThPANP 1999, prokurorët duhet të sigurojnë që palët e pakënaqura me veprimet e tyre të jenë të informuar mbi mundësinë e përsëritjes së veprimeve të tyre tek një instancë më e lartë apo institucion relevant, në mënyrë që palët e pakënaqura të mund të veprojnë mbi vendimin e prokurorit. Përveç kësaj, prokurorët janë të obliguar që të hapin para të akuzuarit informacionet relevante paragjyqësore, si dhe që të

⁶⁷⁹ *Kelly and Others v. the United Kingdom*, GjEDNj, No. 30054/96, §§ 96-97, 4 May 2001

⁶⁸⁰ Shih p.sh. në kontekst të mjeteve të përcaktuara me kushtetutë: Henning, J., Peter, (1999) 'Prosecutorial Misconduct and Constitutional Remedies'. *Washington University Law Quarterly*. Vol. 77, No. 3, pp. 713-832; Shih gjithashtu: Hall, J., Donald, (1975) 'The Role of the Victim in the Prosecution and Disposition of a Criminal Case'. *Vanderbilt Law Review*. Vol. 28, No.5, pp. 931-985.

vërtetojnë nëse evidenca e propozuar është marrë në mënyrë të ligjshme, përfshirë detyrimin që të marrin masa ndaj institucioneve, ta zëmë ndaj policisë, që kanë mbledhur prova në formë të paligjshme.⁶⁸¹ Në kuptim të kësaj, Komisioni i Venedikut ka argumentuar që kompetencat mbikëqyrëse të prokurorit i duhen shtruar kontrollit gjyqësor apo mundësisë për kontroll gjyqësor,⁶⁸² meqë në të kundërtën rrezikohet që prokuroria publike të dalë jashtë kompetencave të saj dhe të shkel mbi parimet e shtetit të së drejtës. Në të njëjtën linjë, Komisioni i Venedikut insiston që vendimet gjyqësore të mos mund të kontestohen nga prokuroria jashtë procedurave të ankesës sipas ligjit, duke e përjashtuar specifikisht mundësinë që prokurorët të vishen me kompetenca jashtë-gjyqësore sa i përket kundërshtimit të një vendimi gjyqësor. E tërë kjo, në kontekst të Komisionit, synon që të pengojë mundësinë që prokuroria publike të shndërrohet në monopol të keqpërdorimit të pushtetit të ndjekjes penale.⁶⁸³ Një praktikë e tillë e keqpërdorimit të pushtetit ndodhte në ish sistemin sovjetik të prokurorisë, ku kjo e fundit ishte e veshur me të drejtën e kontrollit të ligjshmërisë dhe kishte të drejtën e hapjes së rasteve sipas diskrecionit të saj,⁶⁸⁴ gjë e cila bënte që prokuroria publike të merrte attribute gjyqësore në dëm të të drejtave të njeriut.

7. Në kuptim të Komitetit për të Drejtat e Njeriut i KB, rasti *D. Wolf v. Panama*,⁶⁸⁵ prokurorët kanë detyrimin që të ushtrojnë të drejtën e tyre për akuzë duke e bazuar dhe arsyetuar atë, si dhe duke ia dhënë të akuzuarit të drejtën që të njihet dhe bindet me provat e dhëna. GjEDNj-ja, në rastin *Bulut v. Austria*,⁶⁸⁶ ka argumentuar që prokurori duhet t'i ofroj të akuzuarit informacionet e duhura mbi të cilat është ngritur akuza, në mënyrë që ky i fundit të ketë mundësi që në kohë të mjaftueshme të mund të përgatitet për të mbrojtur veten e tij. Në mënyrë të ngjashme, GjEDNj në rastin *Machado v. Portugal*,⁶⁸⁷ ka argumentuar që të akuzuarit duhet të njihen nga prokurori për të gjitha provat, faktet apo dëshmitë e palëve sa i përket akuzës së ngritur, në mënyrë që ato të mund të bëhen objekt i ankimit gjyqësor nga ana e palës së akuzuar, sikur që është thënë edhe në *Kamasinski v. Austria*.⁶⁸⁸ Në këtë

⁶⁸¹ Krahaso me: Fisher, T., Michael (1988) 'Harmless Error, Prosecutorial Misconduct, and Due Process: There's More to Due Process than the Bottom Line'. *Columbia Law Review*. Vol. 88, No. 6, pp. 1298-1324;

⁶⁸² European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on European Standards As Regards The Independence of The Judicial System: Part II - The Prosecution Service'. CDL-AD(2010)040, paragrafi 73;

⁶⁸³ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on European Standards As Regards The Independence of The Judicial System: Part II - The Prosecution Service'. CDL-AD(2010)040, paragraph 82.13.

⁶⁸⁴ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on European Standards As Regards The Independence of The Judicial System: Part II - The Prosecution Service'. CDL-AD(2010)040, paragrafi 76;

⁶⁸⁵ *D. Wolf v. Panama*, UN Human Rights Committee, UN Doc. GAOR, A/48/40 (vol. 2), f. 44, para 6.4.

⁶⁸⁶ ECtHR, *Bulut v. Austria*, Judgement, 22 February 1996, Reports 1996-II, f. 359, para 47.

⁶⁸⁷ ECtHR, *Lobo Machado v. Portugal*, Judgement, 20 February 1996, Report 1996-I, para 31, fq. 207.

⁶⁸⁸ GjEDNj, *Kamasinski v. Austria*, Judgment, 19 December 1989 in, § 79

kontekst, GjEDNj në rastin *Brandstetter v. Austria*,⁶⁸⁹ ka përcaktuar që palës i është shkëlur e drejta për qasje të barabartë në gjykatë për shkak që nuk i ishte bërë e ditur ankesa e prokurorit drejtuar gjykatës në procedurën e apelit. Në anë tjetër, GjEDNj ka argumentuar që në kuptim të KEDNj, prokuroria duhet të kujdeset që të ofrojë ndihmë juridike që nga procesi i marrjes në pyetje në polici, siç është thënë në *John Murray v. the United Kingdom*,⁶⁹⁰ dhe *Magee v. the United Kingdom*.⁶⁹¹

8. Në kuptim të mundësimi që prokurorët të kenë hapësirë që të ushtrojnë funksionin e tyre në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, si dhe që të plotësohet kushti për mosndërhyrje në funksionin e tyre, DSMSMPPFANP ka përcaktuar një numër standardesh themelore që shtetet duhet t'u garantojnë prokurorëve të tyre. Standardet në fjalë jo vetëm që mundësojnë që parimi i mosndërhyrjes në punët e tyre të plotësohet, por e mundësojnë edhe një segment shumë të rëndësishëm të pavarësisë së jashtme të prokurorëve. Në këtë kontekst, DSMSMPPFANP, në nenin 1, dhe R(2000)19 i KMKE në nenin 5, përcaktojnë që shtetet duhet të garantojnë që prokurorët dhe familjet e tyre të mbrohen fizikisht dhe efektivisht nga çdo sulm i mundshëm që mund të vije si rezultat i kryerjes së detyrës së tyre zyrtare. Në veçanti, në nenin 2, DSMSMPPFANP kërkon që shtetet të ofrojnë siguri të plotë për prokurorët në vendin e tyre të punës, dhe në kryerjen e aktiviteteve të tyre zyrtare, si dhe të ofrojnë mbrojtje fizike në shtëpitë e tyre. DSMSMPPFANP kërkon gjithashtu që vlerësimi i rrezikut që mund të kenë prokurorët të bëhet nga një organ i pavarur dhe i specializuar, dhe që prokurorëve t'u vlerësohet siguria në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu, DSMSMPPFANP përcakton që shtetet duhet të jenë në gjendje që të garantojnë që sulmet eventuale ndaj prokurorëve për shkak të kryerjes së detyrave të tyre të hetohen dhe ndiqen në mënyrë efektive dhe të arsyeshme.
9. Përveç kësaj që u tha deri këtu, në kryerjen e funksionit të tyre më specifik, në kuptim të parimit të pavarësisë, paanshmërisë dhe përgjegjësisë së përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 109, prokuroria publike duhet t'i ketë pasur parasysh këto instrumente të Këshillit të Evropës, të cilat mbeten standarde themelore në administrimin e drejtësisë procedurale penale:
 - a) Rekomandimi Nr. R(80) 11, në lidhje me gjykimin në pritje sa i përket arrestimit;
 - b) Rekomandimi Nr. R(83) 7, në lidhje me pjesëmarrjen e publikut në politikën kriminale;
 - c) Rekomandimi Nr. R. (85) 11, në lidhje me pozitën e viktimës në strukturën e së drejtës penale materiale dhe asaj procedurale; (këtu më poshtë duhet të vazhdohet me alfabetin shqip)

⁶⁸⁹ ECtHR, *Brandstetter v. Austria*, Judgement, 28 August 1991, Series A. No. 21, f. 28, para. 68.

⁶⁹⁰ ECtHR, *John Murray v. the United Kingdom*, Judgement, 25.01.1996

⁶⁹¹ *Magee v. the United Kingdom*, 06.06.2000, §40).

- d) Rekomandimi Nr. R. (87) 18, në lidhje me thjeshtësimin e gjyqësisë penale, dhe më konkretisht në lidhje me seksionin që ka të bëjë me prokurorinë diskrecionale;
- e) Rekomandimi Nr. R. (87) 21, në lidhje me ndihmën viktimave dhe parandalimin e viktimizimit;
- f) Rekomandimi Nr. R. (92) 17, në lidhje me koherencën në dënim;
- g) Rekomandimi Nr. (94) 12, në lidhje me pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve;
- h) Rekomandimi Nr. R. (95) 12, në lidhje me menaxhimin e drejtësisë penale;
- i) Rekomandimi Nr. R. (97) 13, në lidhje me kërcënimin e dëshmitarëve dhe të drejtat e mbrojtjes;
- j) Rekomandimi Nr. R. (99) 19, në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale.

10. Në kuptim të paragrafit 1, prokurori publik përbën institucionin që ka përgjegjësinë për të ndjekur 'personat' e akuzuar për ndonjë vepër penale. I rëndësishëm në këtë aspekt është koncepti 'person' në kuptim të këtij paragrafi. Në këtë aspekt, i rëndësishëm është konstatimi që e drejta ndërkombëtare, por edhe e drejta e brendshme, ka filluar njohjen e personave juridik si subjekte kryerës të veprës penale. Kjo, jo vetëm në kontekst të traktateve të Kombeve të Bashkuara, por edhe ato të Këshillit të Evropës dhe OECD-së.⁶⁹² Termi 'persona' në kuptim të paragrafit 1 të nenit 109 është i rëndësishëm në aspekt të kompetencës së prokurorit për të ndjekur penalisht. Prandaj, pyetje themelore këtu është nëse termi 'persona' mund të interpretohet edhe si përgjegjësi e prokurorit për të ndjekur penalisht edhe personat juridik - përveç personave fizik? Bazuar në argumentin e dhënë më sipër, mbështetur gjithashtu në rastin *AAB University LLC v. Government of the Republic of Kosovo*,⁶⁹³ logjikisht është e kuptueshme që termi 'persona' në paragrafin 1 të nenit 109 i përfshin jo vetëm personat fizikë por edhe ata juridikë, prandaj kompetenca kushtetuese e prokurorisë publike sipas këtij paragrafi përfshin edhe kompetencën për ndjekjen penale të personave juridikë si subjekte kryerës të veprave penale korporative. Kjo nënkupton se personat juridik bëhen në mënyrë automatike subjekt i të drejtave procedurale, për aq sa e lejon rendi juridik, në kontekst të ndjekjes penale të prokurorit ndaj personave juridik. Se kjo është kështu qartë, është përcaktuar në Ligjin për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridik, Ligji Nr. 04/030, i cila ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013. Me këtë Ligj, i cili ka gjithsej 34 nene, rregullohet përgjegjësia e personave juridik për

⁶⁹² Shih p.sh: Engle, Eric, (2003) 'Extraterritorial Corporate Criminal Liability: A Remedy For Human Rights Violations?'. *St. John's Journal of Legal Commentary*. Vol. 20, No. 2, pp. 287-329.

; Shih gjithashtu: OECD, Convention on Combating Bribery of Foreign Public Officials in International Business Transactions, Art. 2, 1997; UN, Optional Protocol to the Convention on the Rights of the Child on the sale of children, child prostitution and child pornography (Article 3 § 4), 2000; P.H.P.H.M.C. van Kempen, Human Rights and Criminal Justice Applied to Legal Persons. Protection and Liability of Private and Public Juristic Entities under the ICCPR, ECHR, ACHR and AfChHPR, vol. 14.3 Electronic Journal of Comparative Law, (December 2010), <<http://www.ejcl.org/143/art143-20.pdf>>.

⁶⁹³ Constitutional Court of Kosovo, *AAB University LLC v. Government of the Republic of Kosovo*, Case 41/09, Decision on Inadmissibility.

vepra penale, sanksionet penale të cilat mund të zbatohen ndaj personave juridik dhe dispozitat e posaçme që e rregullojnë procedurën penale të zbatueshme ndaj personit juridik.

11. Përveç rolit të tyre si ndjekës të kryerësve të veprave penale, siç kërkohet qartësisht edhe në R(2000)19 i KMKE, në Nenin 1, paragrafi 1 i nenit 109 lejon hapësirë që prokurorët publik të kenë autoritet edhe për ndjekjen ‘për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj’. Kjo vepër ‘tjetër’, siç përcaktohet me këtë paragraf të Nenit 109, duhet komentuar me ngushtësi dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Roli i prokurorit *jashtë* domenit të së drejtës penale duhet shikuar me kritikë dhe arsyeshëm bazuar në rrezikun që prokurori publik të mund të shndërrohet në autoritet që ndërhyjnë në degë tjera të së drejtës, duke e fuqizuar rolin e tij në dëm të të drejtave të njeriut.
12. Komisionit i Venedikut,⁶⁹⁴ siç është thënë në R(2000)19 i KMKE, ka përcaktuar që funksioni primar dhe, sipas mundësisë, i vetëm i prokurorit publik duhet të jetë brenda fushës së të drejtës penale, më saktësisht, ndjekjen e kryerësve të veprave që bartin me vete sanksion penal të përcaktuar me ligj. Paragrafi 1 i nenit 109 të Kushtetutës lejon megjithatë që prokurori të ketë edhe ndonjë rol tjetër në ndjekjen e kryerësve të veprave, jashtë kuptimit të ndjekjes së veprave penale. Këshilli Konsultativ i Prokurorëve Evropian, në Opinionin 3 (2008)⁶⁹⁵ ka dhënë një vlerësim sa i përket rolit të prokurorit jashtë fushës së ndjekjes së kryerësve të veprave penale. Këshilli ka argumentuar që ‘nuk ka norma të së drejtës ndërkombëtare zakonore që përcaktojnë detyrat, funksionet dhe organizimin e shërbimit prokurorial jashtë fushës së të drejtës penale’. Kjo, natyrisht, lë hapësirë që prokurorët publik të vishen me kompetenca në ndjekjen e kryerësve apo përfaqësimin e interesit publik edhe jashtë fushës së të drejtës penale. Megjithatë, Komisioni i Venedikut, në rastin e Moldavisë, e ka kontestuar faktin nëse prokurori publik është institucioni i duhur për të mbrojtur interesin publik në një procedurë jo-penale,⁶⁹⁶ duke argumentuar në mënyrë implicite që ekzistojnë institucione tjera të pavarura që mund të jenë më adekuate në kryerjen e funksioneve të mbrojtjes së interesit publik në fusha jo-penale. Për më tepër, ta zëmë në rastin e Ukrainës, Komisioni i Venedikut ka argumentuar që prokurori publik nuk është institucioni i duhur për të ndërhyrë në procedura jo-penale në

⁶⁹⁴ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), ‘Opinion on the Draft Law on Judges and Prosecutors of Turkey’, Opinion No. 610 / 2011, adopted by the Venice Commission at its 86th Plenary Session, Venice, March 2011. CDL-AD(2011)004, paragraph 82.13.

⁶⁹⁵ Consultative Council of European Prosecutors (CCPE), ‘Opinion on the Role of Prosecution Services outside the Criminal Law Field, the Consultative Council of European Prosecutors’, No. 3 (2008), adopted by the CCPE at its 3rd plenary meeting, Strasbourg, October 2008. CCPE(2008)3, paragrafi 31.

⁶⁹⁶ Shih: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), ‘Opinion on the draft law on the Public Prosecutors’ service of Moldova’, No. 473/2008, adopted by the Venice Commission at its 75th Plenary Session, Venice, June 2008. CDL-AD(2008)019, paragraph 30.

kuptim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe se ky funksion mund të kryhet shumë herë në mënyrë më legjitime nga avokati i popullit.⁶⁹⁷

13. Rekomandimi 1604 (2003) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës,⁶⁹⁸ në nenin 7 pika v përcakton saktësisht që çfarëdo roli për prokurorinë publike në kuptimin jo-penal sa i përket mbrojtjes së të drejtave të njeriut duhet të shikohet me kujdes, meqë kjo mund të lind konflikt interesi në funksionin e prokurorit dhe mund t'i pengoj personat në kërkimin e të drejtave të tyre. Prandaj, Komisioni i Venedikut ka argumentuar që prokurori publik mund të jetë në konflikt interesi kur ka fuqinë që të ndërtojë në një procedurë jo-penale me qëllim të mbrojtjes së interesit publik për aq kohë sa intervenimi i tillë mund t'i shkoj në dëm vet shtetit, apo edhe mund të keqpërdoret nga prokurori për ndërhyrje në fushën e të drejtave të njeriut.⁶⁹⁹ Për më tepër, GjEDNJ ka argumentuar që vetë prezenca e prokurorit publik në një procedure jo-penale - qoftë si aleat apo si kundërshtar i njëjës palë - është në kundërshtim të hapur me parimin e gjykimit të drejtë dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.⁷⁰⁰ Kjo, si fakt i vetëm, siç është argumentuar edhe në *Borgers v. Belgium*,⁷⁰¹ lë hapësirë që njëra nga palët ta shoh prokurorin publik si ndikues në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatës, dhe lë dukje të pabarazisë në mes palëve.
14. Prandaj, bazuar në mendimet e Komisionit të Venedikut, GjEDNJ-së, dhe Rekomandimit 1604 (2003), gjerësisht argumentohet se roli i prokurorit publik në procedura jo-penale duhet kufizuar skajshmërisht, si dhe që duhet arsyetuar skajshmërisht, në të kundërtën rrezikohet që pozicioni i prokurorit në procedurë jo-penale të shndërrohet në instrument që prodhon konflikt interesi dhe keqpërdorim të pushtetit prokurorial në kuptim të Nenit 6.1 të KEDNJ-së.
15. Paragrafi 1 i nenit 109 e përcakton saktësisht që prokurori publik e ushtron funksionin e tij bazuar në ligj, parim i cili ripërsëritet edhe në paragrafin 2 dhe 3, prandaj edhe do të komentohet më poshtë.
16. Çështja e fundit që duhet të komentohet në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni është përcaktimi që prokurori i shtetit është institucion me 'autoritet dhe përgjegjësi' për ndjekjen penale të personave të akuzuar për vepra penale. Siç qëndron në përputhje edhe me nenin 11 dhe 12 të RKBRP 1990, paragrafi 1 i nenit 109 e ndërton parimin që ndjekja penale nuk është vetëm e drejtë e prokurorit por edhe përgjegjësi e tij përballë kushtetutës. Në këtë aspekt, paragrafi 1 nuk lejon hapësirë

⁶⁹⁷ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on the Draft Law of Ukraine on the Office of the Public Prosecutor', adopted by the Venice Commission at its 79th Plenary Session, Venice, June 2009. CDL-AD(2009)048, paragrafi 17;

⁶⁹⁸ Council of Europe, Parliamentary Assembly, 'Recommendation on the role of the public prosecutor's office in a democratic society governed by the rule of law' No. 1604 (2003).

⁶⁹⁹ Shih p.sh: European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on European Standards As Regards The Independence of The Judicial System: Part II - The Prosecution Service'. CDL-AD(2010)040, paragrafi 83.

⁷⁰⁰ *Menchinskaya v. Russia*, GjEDNJ, No. 42454/02, 15 January 2009, paragrafi 32.

⁷⁰¹ *Borgers v. Belgium*, GjEDNJ, 30 October 1991, § 24, Series A no. 214-B

që funksioni i prokurorit publik të shihet vetëm si e drejtë e tij por edhe si detyrim kushtetues. Prandaj, paragrafi 1 nuk lejon hapësirë që prokurori publik të qëndroj pasiv në rastet kur ligji përcakton që duhet kryer funksioni i ndjekjes penale.

Neni 109.2

1. Paragrafi 2 i nenit 109 është vetëm përsëritje e parimit të pavarësisë së prokurorit publik në kuptim të gjerë i garantuar me paragrafin 1 të po këtij neni. Komentimi i dhënë në paragrafin 1 ka përfshirë edhe konceptim e ‘paanshmërisë’ që garantohet me këtë paragraf, prandaj nuk ka hapësirë për komentim të mëtejshëm sa i përket konceptit të ‘paanshmërisë’ së prokurorit publik. Në anën tjetër, paragrafi 2 përcakton që prokurori publik vepron ‘në bazë të kushtetutës dhe ligjit’. Këtu në fakt ndërtohet parimi që funksioni i prokurorit publik buron vetëm nga kushtetuta dhe ligjit, dhe që prokurorit publik nuk mund t’i bashkëngjitet, hiqet apo ndryshohet funksioni me akt juridik më të ultë se ligji. Komisioni i Venedikut, në rastin e Hungarisë,⁷⁰² e ka bërë të qartë që parimet mbi pavarësinë e prokurorit duhen përcaktuar vetëm me kushtetutë, pasi që nëse kjo bëhet vetëm me ligj, ekziston rreziku që ky i fundit të abrogohet apo derogohet në bazë të preferencave të partive politike. Në këtë aspekt, rol themelor në sendërtimin e këtij parimi ka Gjykata Kushtetuese, e cila duhet të garantojë që legjislativi sa i përket prokurorit publik t’i shtrohet kontrollit kushtetues për të përcaktuar nëse qëndron në linjë me konceptin e ‘pavarësisë’ të përcaktuar me paragrafin 1 dhe standardet ndërkombëtare të komentuara më sipër. Në anën tjetër, Komisioni i Venedikut në rastin e Moldavisë ka përcaktuar që çdo funksion i dhënë për prokurorin me anë të ligjit duhet përcaktuar vetëm me ligjin mbi prokurorinë publike, dhe dispozita që përcaktojnë funksionin e prokurorit nuk duhet lejuar në asnjë akt tjetër ligjor.⁷⁰³ Kjo, me qëllim që të garantohet një qartësi juridike sa i përket funksionit të prokurorit publik, dhe me qëllim që të mos lejohen hapësira për keqpërdorim apo mëdyshje në funksionin e prokurorit me anë të komplikimit të legjislativit.
2. Në kuptim më specifik, paragrafi 2 i nenit 109 duhet shikuar në katër perspektiva sa i përket veprimeve të prokurorit: a) që prokurori publik nuk mund t’i supozoj apo vesh vetes kompetencë e cila nuk është e dhënë me kushtetutë apo me ligj, b) që prokurori publik është i ndaluar të ndërmer veprime të cilat janë të ndaluara me kushtetutë dhe ligj, c) që prokurori publik mund të veproj vetëm në bazë të kompetencave të dhëna me kushtetutë apo me ligj, dhe d) që prokurori publik detyrueshëm të veproj në rastet kur ashtu kërkohet me kushtetutë apo me ligj. Në këtë aspekt, paragrafi 2 është parandalues që roli i prokurorit të del jashtë

⁷⁰² European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the regulatory concept of the Constitution of the Hungarian Republic’ adopted at the Commission’s 25th Plenary Meeting, Venice, 24-25 November 1995, chapter 11, CDL(1995)073rev., chapter 11.

⁷⁰³ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), ‘Opinion on the draft law on the Public Prosecutors’ service of Moldova’, No. 473/2008, adopted by the Venice Commission at its 75th Plenary Session, Venice, June 2008. CDL-AD(2008)019, para. 21;

kornizave ligjore - si në kuptimin pasiv ashtu edhe aktiv - duke garantuar që roli i tij të shprehet në kuptim të konceptit të shtetit ligjor.

Neni 109.3

1. Paragrafi 3 i nenit 109 përcakton parimin e garantuar gjithashtu me paragrafin 2, megjithëse pak në mënyrë të pacaktuar, megjithatë koncepti i veprimit brenda kornizës së kushtetutës dhe ligjit të prokurorisë publike u komentua në kuadër të mësipërm.

Neni 109.4

1. Paragrafi 4 i nenit 109 përcakton detyrimin kushtetues për një pjesëmarrje proporcionale të etniteteve në tërë institucionet e Kosovës, përfshirë edhe prokurorinë publike. Në këtë aspekt, institucioni i Prokurorisë së Shtetit, sipas paragrafit 4, duhet të reflektoj një përfaqësim proporcional në strukturën e saj të komuniteteve etnike pakicë, me komunitetin serb me pjesëmarrjen më të madhe. Paragrafi 4 e vë detyrimin që prokuroria publike të ushtrohet edhe nga prokurorë që vijnë nga komunitetet etnike pakicë, duke i mundësuar në të njëjtën kohë komuniteteve etnike pjesëmarrje dhe fuqizim të pozicionit të tyre brenda institucionit të ndjekjes penale. Gjithashtu, paragrafi 4 vendos edhe parimin e barazisë gjinore në kuptim të strukturës së resurseve humane në institucionin e prokurorisë publike të Kosovës.

Neni 109.5, 6 dhe 7

1. Paragrafët 5, 6 dhe 7 të Nenit 109 i dedikohen kryesisht mënyrës së zgjedhjes, shkarkimit dhe disiplinimit të prokurorëve të Kosovës. Fillimisht, është me rëndësi që pavarësia e prokurorëve publik, por edhe e Prokurorit të Shtetit, varen qenësisht nga mënyra dhe standardet e zgjedhjes së tij. RKBPR 1990, në nenin 2, përcakton që standardet për zgjedhjen e prokurorëve duhet qartësisht të përjashtojnë mundësitë për çfarëdolloj diskriminimi. Për më tepër, R(2000)19 i KMKE, në nenin 5 pika a, përcakton që rekrutimi, ngritja në detyrë, dhe transferimi i prokurorëve duhet bërë sipas procedurave qartësisht të paanshme dhe të ndershme, jashtë çdo ndikimi të grupeve apo jashtë diskriminimit në çfarëdo baze. Prandaj, standardet mbi rekrutimin, promovimin dhe disiplinimin e prokurorëve janë indikator shumë të fuqishëm të pavarësisë së prokurorisë publike, prandaj edhe i duhet dhënë rëndësi të veçantë. SPPDDThPANP 1999, në nenin 5, për më tepër përcakton që rekrutimi dhe promovimi i prokurorëve duhet bërë bazuar në faktorë objektivë, që janë aftësitë dhe meritat profesionale, integriteti moral, eksperiencia, etj. Po ashtu, vendimi mbi rekrutimin apo promovimin duhet bazuar në procedura që janë të hapura dhe të paanshme, duke aluduar në detyrimin që këto procedura të mos bazohen në elemente subjektive.
2. Komisioni i Venedikut i ka dhënë rëndësi të madhe procesit dhe strukturës së procedurës mbi emërimin e prokurorëve, në veçanti, prokurorit të shtetit. Në rastin e Hungarisë, Komisioni i Venedikut ka argumentuar që mënyra e zgjedhjes së

prokurorit të shtetit duhet të jetë e konstruktuar në mënyrë të tillë që të fitoj konfidencën e publikut, të sistemit gjyqësor dhe të tërë komunitetit ligjor. Prandaj, në procesin e emërimit, Komisioni e ka vënë theksin në profesionalizmit, jo-partizanizmin dhe integritetin e personave që e bëjnë zgjedhjen e prokurorit.⁷⁰⁴ Për më tepër, Komisioni ka parapëlqyer që procesi i emërimit të gjyqtarëve të përfshij disa organe shtetërore, përfshirë ndihmë nga komuniteti i juristëve dhe shoqëria civile, me qëllimin që zgjedhja e prokurorit të shtetit të mos jetë monopol i vetëm një institucioni.⁷⁰⁵ Komisioni gjithashtu ka tërhequr vërejtjen që zgjedhja e prokurorit të shtetit të mbrohet nga procedurat ku shumica i takon partive politike që bartin pushtetin, apo që garantojnë një pjesëmarrje vendimtare të përfaqësuesve partizan në zgjedhjen e prokurorit të shtetit.⁷⁰⁶ Në rastin e Hungarisë, Komisioni i Venedikut ka argumentuar që komisioni që e bën rekrutimin apo nominimin e prokurorit të shtetit, në mënyrë që të fitoj konfidencën e publikut, duhet që të ketë përbërje plurale, dhe të përfshij një mori institucionesh të pavarura, si p.sh. kryetarët e gjykatave të larta, kryetarin e asociacionit të avokatëve, dekanët e fakulteteve të drejtësisë, avokatit të popullit, etj.⁷⁰⁷

3. Neni 84 pika 17 dhe 18 e Kushtetutës së Kosovës përcaktojnë që prokurorët në Kosovë, përfshirë edhe prokurorin e përgjithshëm, emërohen dhe shkarkohen nga ana e Presidentit të Republikës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Në këtë kontekst, emërimi i prokurorëve në Kosovë - përfshirë Prokurorin e Shtetit - bëhet në një procedurë uniforme. Ekzistojnë dy shkallë që duhet t'i kaloj procedura e emërimit: a) propozimi i dhënë nga ana e Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe b) akti i emërimit nga ana e Presidentit të Republikës. Argumenti themelor është që Presidenti i Republikës nuk është institucioni që emëron *i vetëm* prokurorin e shtetit apo prokurorët në përgjithësi, por këtë e bën vetëm në bazë të rekomandimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, një institucion i pavarur sipas kushtetutës. Në këtë aspekt, praktikisht, kompetenca për emërim të prokurorëve është e ndarë në dysh në mes të Këshillit Prokurorial dhe Presidentit të Republikës, në mënyrë që të sigurohet një kundërbalancim i dyanshëm sa i përket cilësisë dhe paanshmërisë së emërimit në fjalë. Një pyetje themelore në këtë aspekt është nëse Presidenti i Republikës mund të emëroj prokuror i vetëm, pra pa propozimin e Këshillit Prokurorial, apo edhe nëse presidenti i republikës mund të *refuzojë* emërimin e një prokurori, edhe nëse ai/ajo është propozuar nga ana e

⁷⁰⁴ European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the regulatory concept of the Constitution of the Hungarian Republic' adopted at the Commission's 25th Plenary Meeting, Venice, 24-25 November 1995, chapter 11, CDL(1995)073rev., chapter 11.

⁷⁰⁵ European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on European Standards As Regards The Independence of The Judicial System: Part II - The Prosecution Service'. CDL-AD(2010)040, paragrafi 35.

⁷⁰⁶ European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on European Standards As Regards The Independence of The Judicial System: Part II - The Prosecution Service'. CDL-AD(2010)040, paragrafi 36.

⁷⁰⁷ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the regulatory concept of the Constitution of the Hungarian Republic' adopted at the Commission's 25th Plenary Meeting, Venice, 24-25 November 1995, chapter 11, CDL(1995)073rev, chapter 11;

Këshillit Prokurorial? Kjo pyetje dërgon në analizën e natyrës së ‘propozimit’ që shprehet brenda këtij paragrafi të Kushtetutës.

4. Komisioni i Venecias, në rastin e Malit të Zi, ka argumentuar që sa më shumë kompetencë i jepet një këshilli të pavarur për emërimin apo shkarkimin e prokurorëve, dhe i hiqet një institucioni politik, siç është presidenti i republikës, aq më kredibile dhe e mbrojtur nga politizimi do të jetë akti i emërimit të prokurorëve.⁷⁰⁸ Kjo është kështu, sipas Komisionit, nisur nga fakti se funksioni i Këshillit Prokurorial konsiston në garantimin e pavarësisë dhe integritetit të prokurorisë publike.⁷⁰⁹ Pra, çështja në lidhje me rastin e Kosovës, e parashtuar më sipër, duhet marrë përgjigje nën dritën e rekomandimeve të Komisionit të Venedikut. Kjo do të thotë se kompetenca e presidentit të republikës për të emëruar prokurorët dhe prokurorin e përgjithshëm duhet parë thjeshtë e lidhur me propozimin e Këshillit Prokurorial. Kjo, një komentim bazuar në standardet e Komisionit të Venedikut i paragrafit në fjalë, tregon që kompetenca e presidentit për të emëruar është e lidhur dhe e varur në mënyrë strukturore nga propozimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Në këtë kuptim, Presidenti i Republikës as nuk mund të emërojë ndonjë prokuror pa propozimin e Këshillit Prokurorial por as nuk mund të refuzojë propozimin e Këshillit Prokurorial për emërimin e prokurorëve. E vetmja hapësirë ku presidenti i republikës, në kuptim të kompetencës në paragrafët 5, 6 dhe 7 të nenit 109 mund të veprojë, është që të refuzojë një propozim të Këshillit Prokurorial nëse ai/ajo nuk i përmbush kushtet formale, por kurrësi ta refuzoj atë për arsye substanciale.
5. E shikuar në tërësi, emërimi i prokurorëve publik në Kosovë - me kusht që struktura e Këshillit Prokurorial të jetë e tillë ku të ketë epërsi përfaqësimi linja e personave profesionist, dhe të pavarur nga institucionet politike - qëndron në linjë me standardet e Komisionit të Venedikut, megjithatë standardet e tilla duhen vëzhguar në kuptim të legjislacionit që mund të kalojë në atë fushë.
6. Mandati fillestar i prokurorëve sipas Paragrafit në fjalë është trevjeçar, përderisa nëse prokurori/ja riemërohet, mandati i tij/saj bëhet i përjetshëm. Në anën tjetër, paragrafi në fjalë përcakton që mandati i Prokurorit të Shtetit të jetë shtatë vjeçar, pa ndonjë mundësi të rikandidimit. Kjo qëndron në linjë me Komisionin e Venedikut, i cili ka rekomanduar që prokurorit të shtetit nuk i duhet dhënë mundësia për rizgjedhje, meqë kjo do ta sillte që funksioni i tij t’i shërbente institucioneve që do të merrnin pjesë në rizgjedhjen e tij/saj.⁷¹⁰

⁷⁰⁸ European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the Draft Amendments to the Law on the State Prosecutor of Montenegro’, No. 467/2008, adopted by the Venice Commission at its 74th Plenary Session, Venice, March 2008. CDL-AD(2008)005, para. 32;

⁷⁰⁹ European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the Constitution of Montenegro’ No. 392/2006, adopted by the Venice Commission at its 73rd Plenary Session, Venice, December 2007. CDL-AD(2007)047, para. 110-111;

⁷¹⁰ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), ‘Opinion on European Standards As Regards The Independence of The Judicial System: Part II - The Prosecution Service’. CDL-AD(2010)040, paragrafi 36.

7. Paragrafi në fjalë gjithashtu përcakton që shkarkimi i prokurorëve bëhet në procedurë të njëjtë sikur edhe emërimi, prandaj të njëjtat standarde procedurale dhe i njëjti komentim vlen edhe për procedurën e shkarkimit. Shkarkimi, megjithatë, sipas paragrafit në fjalë mund të bëhet vetëm nëse prokurori ka kryer një vepër të rëndë penale, sipas përcaktimit të Kodit Penal, apo ka shkelur rëndë detyrën e tij. E tërë kjo, prandaj, duhet vërtetuar nga ana e Këshillit Prokurorial, e cila sipas kushtetutës ka të drejtën e vlerësimit substancial të shkeljeve eventuale të një prokurori. Në këtë aspekt, në rastin e Ukrainës, Komisioni i Venedikut ka argumentuar që shkaqet e shkarkimit të prokurorit duhen përcaktuar shprehimisht me ligj, dhe që është e preferueshme që shkaqet e shkarkimit të prokurorit të jenë të qartësuara që me kushtetutë, siç ndodh me rastin e Paragrafit 6 të Nenit 109, i cili përcakton shprehimisht kushtet mbi të cilat do të mund të shkarkohej një prokuror. Komisioni, për më tepër, ka argumentuar që përpara shkarkimit eventual të prokurorit të shtetit, duhen marrë qëndrimi i ndonjë trupi profesional nëse ka shkaqe të mjaftueshme për shkarkim.⁷¹¹ R(2000)19 i KMKE, në Nenin 5 pika e dhe f, përcakton që është detyrim i shteteve që procedurat disiplinore mbi prokurorët të mund të ankimohen në një gjykatë, dhe që procedurat e tilla të jenë të pavarura dhe transparente. Komisioni i Venedikut, gjithashtu, ka përcaktuar që duhet të ekzistojnë mekanizma të brendshme të ankimimit të vendimit për disiplinim të prokurorëve,⁷¹² p.sh. brenda Këshillit Prokurorial, dhe që vendimet finale mbi disiplinimin të mund të atakohen në një institucion gjyqësor.⁷¹³
8. Në fund, megjithëse Kushtetuta nuk e përcakton shprehimisht, Komisioni i Venedikut ka rekomanduar që prokurorët nuk duhet të jenë të veshur me imunitet gjeneral, por vetëm me imunitet funksional. Gjithashtu, Komisioni rekomandon që prokurorët assesi të mos lejohen të mbajnë çfarëdo pozicioni tjetër shtetëror, dhe që të heqin dorë prej çfarëdo aktiviteti që e sjell në dyshim objektivitetin dhe paanshmërinë e tyre përballë publikut dhe palëve.⁷¹⁴ Lidhur me imunitetin e prokurorëve, duhet thënë këtu, vlen krejt ajo që është thënë për imunitetin e funksionarëve të lartë shtetëror kosovar, siç është vendosur nga Gjykata

⁷¹¹ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on the Draft Law of Ukraine Amending the Constitutional Provisions on the Procuracy', No. 380/2006, adopted by the Commission at its 68th plenary session, Venice, October 2006. CDL-AD(2006)029, paragraph 34.

⁷¹² Krahaso me rastin amerikan: Steele, W., Jr., Walter (1984) 'Unethical Prosecutors and Inadequate Discipline'. *Southwestern Law Journal*. Vol. 38, no. 3, pp 965-985;

⁷¹³ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on European Standards As Regards The Independence of The Judicial System: Part II - The Prosecution Service'. CDL-AD(2010)040, paragrafi 51 & 52; Krahaso me: Zacharias, C., Fred (2001) 'The Professional Discipline of Prosecutors'. *North Carolina Law Review*. Vol. 79, pp. 721-778; Shih gjithashtu rastin amerikan pwr krahasim: Atwood, K., Melissa (1998) 'Who Has the Last Word: An Examination of the Authority of State Bar Grievance Committees to Investigate and Discipline Prosecutors for Breaches of Ethics'. *Journal of Legal Profession*. Vol. 22, pp. 201;

⁷¹⁴ European Commission For Democracy Through Law (Venice Commission), 'Opinion on European Standards As Regards The Independence of The Judicial System: Part II - The Prosecution Service'. CDL-AD(2010)040, paragrafi 61 & 62.

Kushtetuese.⁷¹⁵ Shkurt, komentet tona për nenin 89 të Kushtetutës vlejné, *mutatis mutandis*, edhe për prokurorin e shtetit.

Neni 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës]

- (1) Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij, në pajtim me ligjin. Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë personat në Kosovë. Këshilli Prokurorial i Kosovës siguron që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm dhe pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës dhe parimet e barazisë gjinore.
- (2) Këshilli Prokurorial i Kosovës do të rekrutojë, propozojë, avancojë, transferojë, disiplinojë prokurorët në mënyrën e rregulluar me ligj. Këshilli do t'i japë përparësi emërimit për prokurorë të anëtarëve të komuniteteve të nën përfaqësuar në mënyrën e përcaktuar me ligj. Të gjithë kandidatët duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara me ligj.
- (3) Propozimet për emërimin e prokurorëve duhet të bëhen në bazë të procesit të hapur për emërim, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe ky propozim pasqyron parimin e barazisë gjinore dhe përbërjen etnike të juridiksionit territorial përkatës.
- (4) Përbërja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe dispozitat për emërimin, shkarkimin, mandatin, strukturën organizative dhe rregullat e procedurës, rregullohen me ligj.

Neni 110

1. Neni 110 përcakton themelimin, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, që përbën organin e pavarur që kontrollon dhe menaxhon sistemin prokuroria të shtetit. Neni 110, prandaj, vendos edhe strukturën e Këshillit Prokurorial, si dhe garanton standardet që duhet të udhëheqin me punën e tij. Koncepti i rregullimit kushtetues të Këshillit Prokurorial është i ngjashëm me atë të Këshillit Gjyqësor. Kjo nënkupton se ky organ është rregullativ dhe jo përcaktues i juridiksionit dhe i mënyrës së punës së Prokurorit të Shtetit. Në këtë drejtim, duke pasur parasyshë dallimet që burojnë nga puna dhe juridiksioni i gjyqësorit krahasuar me punën dhe juridiksionin e Prokurorit të Shtetit, shumica e asaj që është thënë për Këshillin Gjyqësor, *mutatis mutandis*, vlen edhe për Këshillin Prokurorial.

Neni 110.1

1. Neni 110.1 përcakton që Këshilli Prokurorial i Kosovës është institucion plotësisht i pavarur në ushtrimin e funksionit të tij, dhe funksionon në përputhje me ligjin.

⁷¹⁵ Cf. Aktgjykim në rastin Nr. K098/11, 'Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës', më 20 shtator 2011, Nr. ref.: AGJ138/11.

Këshilli detyrohet sipas këtij neni që të ofrojë qasje të barabartë për të gjithë në sistemin e drejtësisë prokuroriale. Këshilli gjithashtu vishet me detyrimin që të sigurojë që Prokurori i Shtetit të jetë i pavarur, i paanshëm, profesional dhe që pasqyron natyrën shumetnike të Kosovës si dhe parimet e barazisë gjinore.

2. Në këtë kuptim, Këshilli Prokurorial vishet me detyrën e “sigurimit” të pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit dhe të përbërjes shumetnike të Prokurorit të Shtetit, që përbën institucionin shtetëror që ushtron funksionin e ndjekjes penale. Në ushtrimin e këtij funksioni, Këshilli është i detyruar që të veprojë me pavarësi të plotë, dhe të garantojë që prokurorët e Prokurorit të Shtetit të jenë të përgjegjshëm përpara profesionit dhe ligjeve përkatëse. Detyrimi i Këshillit për të siguruar pavarësinë, paanshinë dhe profesionalizmin e Prokurorit të Shtetit e bëjnë atë të ketë autoritet të gjerë edhe disiplinor përballë prokurorëve të shtetit.

Neni 110.2

1. Neni 110.2 përcakton që Këshilli Prokurorial i Kosovës ka autoritet për të rekrutuar, propozuar, avancuar, transferuar dhe disiplinuar prokurorët e shtetit, sipas detajeve të përshkruara me ligj. Në të njëjtën kohë, Këshilli është i detyruar që t’i jap përparësi kandidatëve për prokurorë që vijnë nga komunitetet e nën-përfaqësuar në Kosovës, një procedurë që përcaktohet në mënyrë të detajuar me ligj.
2. Në kuptim të nenit 110.2, Këshilli Prokurorial i Kosovës përbën institucionin që bartë detyrimin kushtetues për të garantuar që prokurorët e propozuar për emërim dhe shkarkim t’i plotësojnë standardet e profesionit, të meritës dhe të ligjit. Në ushtrimin e këtij funksioni, Këshilli Prokurorial përbën institucionin e vetëm që ka fuqinë për të ushtruar në mënyrë të pavarur garantimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së plotë të Prokurorit të Shtetit.

Neni 110.3

1. Neni 110.3 përcakton që propozimet për emërimin e prokurorëve duhet bërë përmes një procedimi të hapur për emërim, në bazë të meritave të kandidatëve, dhe që një proces i tillë të respektojë standardet e barazisë gjinore si dhe pasqyrën etnike të popullsisë së shtetit. Në dhënien e këtij garancioni, Këshilli nuk kufizohet në aplikimin e standardeve nga asnjë institucion, dhe propozimet e saj për emërim dhe shkarkim që i dërgohen presidentit të republikës nuk mund t’i nënshtrohen kontrollit substancial/ merititor nga ky i fundit.

Neni 110.4

1. Neni 110.4 përcakton që përbërja e Këshillit Prokurorial, si dhe rregullat në lidhje me emërimin, riemërimin, shkarkimin, mandatin si dhe strukturën organizative të Prokurorit të Shtetit përcaktohen me ligj. Në kuptim të kësaj dispozite, organizimi dhe funksionimi i Këshillit Prokurorial, si dhe procedurat në lidhje me emërim dhe

shkarkim, janë pothuajse tërësisht të lira për vendosje nga ana e Kuvendit përmes një ligji të caktuar, që nuk është rasti me Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Neni 111 [Avokatura]

- (1) Avokatura është profesion i pavarur, e cila ofron shërbime sikur është e rregulluar me ligj.**
- (2) Mënyra e fitimit të së drejtës për të ushtruar profesionin e avokatit, si dhe marrja e kësaj të drejte, rregullohen me ligj.**

Neni 111

1. Neni 111 përcakton avokaturën, si një profesion i pavarur i dhënies së ndihmës juridike për palët me interes të përfshihen apo të përfshira në një proces gjyqësor në kuptimin e ngushtë dhe të gjerë. Ky nen, megjithatë, e lë pothuajse në tërësi përcaktimin e organizimit dhe funksionimit të avokaturës tek Kuvendi, i cili duhet që ta rregullojë këtë përmes një ligji të caktuar, gjë që është bërë.⁷¹⁶
2. Siç mund të vërehet nga kjo dispozitë kushtetuese, Kuvendi ka një autorizim të gjerë për të përcaktuar me ligj të drejtat dhe detyrat e profesionit të avokaturës. Sipas vendit dhe mënyrës së trajtimit në Kushtetutë, avokati ka rol të dyfishtë: ai/ajo është përfaqësues i palëve dhe, në të njëjtën kohë, pjesë e një prej organeve në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Vlen të theksohet, megjithatë, se Ligji për Avokatinë i Kosovës parasheh disa kufizime të dyshimta nga ana kushtetuese. Kështu, ta zëmë, në nenin 6 Ligjit thotë se avokat nuk mund të jetë personi që nuk e ka të dhënë provimin e judikaturës në Kosovë dhe që nuk është rezident permanent i Kosovës. Cilësi të dyshimtë në pikëpamje kushtetuese ka edhe dispozita e nenit 28 të Ligjit, e cila parasheh njëfarë kontrolli qeveritar ndaj punës dhe veprimtarisë së përgjithshme të Odës së Avokatëve.⁷¹⁷
3. Me dispozitat e Ligjit të ri të vitit 2013 ekzistojnë kushtet për ushtrimin e avokatisë në Kosovë nga të huajt, sipas dy parimeve themelore. Parimi i parë është ai i reciprocitetit kurse i dyti ai i të drejtës për ushtrim të këtij profesioni pa kufizime

⁷¹⁶ Ligji që rregullon këtë materie është Ligji Nr. 03/L-117 për Avokatinë i datës 20 nëntor 2008, i shpallur me Vendim të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 03-V-085, datë 12 shkurt 2009.

⁷¹⁷ Neni 28 i Ligjit [Mbikëqyrja dhe bashkëpunimi me organet të tjera]:

1. Qeveria e Kosovës mbikëqyr ligjshmerinë e akteve të përgjithshme të Odës së Avokatëve dhe ka të drejtë që, gjer në vendimin e Gjykatës Supreme, të ndaloj ekzekutimin e aktit i cili është në kundërshtim me ligjin. Kjo mbikëqyrje kufizohet në përfilljen e ligjit dhe të së drejtës, duke mos e cenuar autonominë administrative të Odës së Avokatëve.
2. Oda e Avokatëve bashkëpunon me organet qeveritare dhe organizatat tjera, në promovimin e të drejtave themelore të njeriut dhe në avancimin demokratik të shoqërisë.
3. Oda e Avokatëve e informon Kuvendin e Kosovës, Qeverinë e Kosovës si dhe organet e tjera qeveritare për punën e saj.
4. Oda duhet të jetë aktive në dhënien e iniciativave tek organet kompetente për nxjerrjen e ligjeve.

nga të gjithë shtetasit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.⁷¹⁸ Ky përcaktim ligjor është mjaft modern dhe në frymën e orientimit të përgjithëm kushtetues të Kosovës për ndërtimin e një shoqërie të hapur ndaj ndikimeve të huaja dhe konkurrenente me to, në të gjitha sferat e jetës, duke përfshirë këtu edhe ushtrimin e avokatisë në territorin e huaj nën kushte të barabarta.

Neni 111.1

1. Neni 111.1 përcakton që avokatura është profesion i pavarur, e cila ofron shërbime sipas përcaktimit të ligjit përkatës. Detyrimi që shërbimet e dhënies së ndihmës juridike të jenë të pavarura përbën një garancion kushtetues që ofrimi i shërbimeve të tilla të mbroj të drejtat e palëve, si një garancion i vendosur dhe i shpjeguar edhe nën të drejtën e gjyqimit të drejtë, në pjesën e mësipërme të komentarit. Detyrimi që avokatura të jetë një shërbim i pavarur, në anën tjetër, përbën një standard që obligon edhe ofruesit e një shërbimi të tillë që t'i përgjigjen kushtetutës në kuptim të mbrojtjes së interesit të palëve të tyre sipas rregullave të profesionit, dhe jo të prirë nga interesat personale ose politike që dërgojnë në dëmtrim të të drejtave të palëve të përfaqësuara. Kjo nënkupton po ashtu edhe atë se ofrimi i shërbimeve profesionale të avokatisë nuk mund t'i mohohet askujt për çfarëdo arsye qoftë, siç është ta zëmë, rasti i arsyeve politike apo etnike. Për këtë arsye, Oda e Avokatëve të Kosovës duhet të kujdeset që të krijojë standarde të qëndrueshme etike të profesionit të cilat mundësojnë që të gjithë, pa marrë parasysh peshën apo natyrën e krimit që iu ngarkohet, të jenë të përfaqësuar nga profesionistë të pavarur. Mohimi i kësaj të drejte paraqet cenim të rëndë të kodit profesional të etikës së avokatit.

Neni 111.2

1. Neni 111.2 përcakton që mënyra e fitimit të së drejtës për të ushtruar profesionin e avokatit përcaktohet me anë të ligjit. Prandaj, është në kompetencë të Kuvendit që përmes një ligji përkatës ta rregulloj një procedurë të tillë, duke respektuar standardet e mbrojtjes së palëve sipas precedentit gjyqësor të GjEDNJ të shpjeguar në pjesët e mësipërme të këtij komentari.

⁷¹⁸ Cf. neni 40 i Ligjit të vitit 2013 ("Ushtrimi i avokatisë nga avokatët e shteteve tjera në Republikën e Kosovës").

Kapitulli VIII: Gjykata Kushtetuese

Hyrje e përgjithshme

1. Gjyqësia kushtetuese përbën një inovacion të demokracisë në kuptim të “freskimit” të ngjyrës së republikanizmit që prodhoi revolucioni amerikan në fund-shekullin e XVIII-të. Duke ndjekur një linjë logjike të reformës institucionale që kushtetuta amerikane pësonte në vazhdimësi, gjyqësia kushtetuese u paraqit si një rrymë institucionale e përmirësimit të qeverisjes përmes kontrollit gjyqësor të akteve të parlamenteve të shteteve. E vënë në diskursin historik, gjyqësia kushtetuese lindi si rezultat i kërkesës për kufizim të konceptit republikan të shtetit, meqë sundimi i shumicës kërkonte që një institucion i pavarur të gjykonte përshtatshmërinë e vendimeve të shumicës me parimet bazike të shtetit të sendërtuara në një dokument të quajtur kushtetutë. Megjithëse e paraprirë nga revolucioni republikan amerikan, gjyqësia kushtetuese ilustronte kërkesën për fuqizim të një kuadri institucionesh të pavarura përtej pushtetit të rregullt gjyqësor⁷¹⁹.
2. Shikuar prej një këndi më shumë juridik, gjyqësia kushtetuese lindi si një reformë institucionale, e cila, me apo pa dashje, e fuqizoi karakteristikën kushtetuese të shtetit, dhe i dha garancione institucionale observimit material të zbatueshmërisë së kushtetutës. Në këtë mënyrë, gjyqësia kushtetuese i parapriu ndërtimit edhe më të fuqishëm të konceptit të shtetit kushtetues, që në teorinë e sotme të demokracisë cilësohet si demokraci kushtetuese⁷²⁰. Koncepti i demokracisë kushtetuese, që nënkupton një shtet ku qeveris indirekt populli përmes mekanizmave, parimeve dhe kufizimeve kushtetuese, vë theksin kryesor tek mekanizmi që ushtron gjyqësia kushtetuese, meqë, ky mekanizëm bart fuqinë apo “detyrën” e sigurimit që parimet kushtetuese gjejnë shprehje në veprimet e institucioneve shtetërore.⁷²¹ Këta mekanizma të gjyqësisë kushtetuese kanë forma të ndryshme institucionale varësisht prej modelit historik të shtetit apo llojit të revolucionit institucional që një shtet ka kaluar. Një gjykatë e centralizuar kushtetuese apo një tërësi gjykatash të rregullta janë mekanizmat përmes të cilëve është e institucionalizuar gjyqësia kushtetuese.

⁷¹⁹ Cf. Elly, John (1980) ‘Democracy and Distrust: A Theory of Judicial Review’. MA: Harvard University Press. fq. 43-73; Nelson, William E., Hull N.E.H. and Hoffer, Peter Charles (2000) ‘Marbury v. Madison: The Origins and Legacy of Judicial Review’. Lawrence, Kansas: University Press of Kansas. në vecanti kapitujt 2 (“The Politics of Constitutional Changes) dhe 3 (“John Marshall”);

⁷²⁰ Cf. më shumë për origjinën e teorisë dhe praktikës së demokracisë kushtetuese, në: Murphy, Walter F (2007) ‘Constitutional Democracy: Creating and Maintaining Just Political Order’. Baltimore: The John Hopkins University Press;

⁷²¹ Shih rëndësinë e kësaj në rastin gjerman, në: Kommers, Donald P. (1994) ‘The Federal Constitutional Court in the German Political System’. *Comparative Political Studies*. Vol. 26: p. 470-491; Shih gjithashtu debatin nëse gjyqësia kushtetuese përbën rrezik për vendimet popullore/demokratike, dhe si gjyqësia kushtetuese i fuqizon të drejtat e njeriut, në: Harel, Alon (2003) ‘Rights-Based Judicial Review: A Democratic Justification’. *Law and Philosophy* Vol. 22 (3/4), pp. 247-276;

3. Në kuptim të rolit të gjyqësisë kushtetuese përballë vendimeve me bazë populliste, është e rëndësishme të kuptohet që agjentët e kontrollit kushtetues, siç janë gjykatat kushtetuese, janë mekanizma që i kundërbalancojnë vendimet populliste me parime kushtetuese. Kjo nënkupton se, gjykatat kushtetuese shpeshherë, për të mos thënë gati rregullisht, i shërbejnë konceptit të një qeverisjeje kundërmazhoritare,⁷²² duke shikuar nëse një version mazhoritar i qeverisjes bie ndesh me parimet kushtetuese. Funkzioni shpeshherë kundërmazhoritar i gjyqësisë kushtetuese ka prodhuar vendime që shkojnë në kundërshtim me qëllimet populliste të qeverive,⁷²³ megjithatë, ruajtja e parimeve shtetërore prej mbisundimit të shumicës reflektohet historikisht si lëvizje e shëndetshme për vet demokracinë, këtë rol qendror e luan gjykata kushtetuese.⁷²⁴
4. Që në shekullin e XVII, në Evropë ekzistonte koncepti që në një shtet demokratik duhet të gjej shprehje doktrina e supremacionit legjislativ,⁷²⁵ që supozonte një pozicion superior të organit legjislativ mbi cilindo mekanizëm tjetër institucional.⁷²⁶ Doktrina e supremacisë legjislative, që sot është baza mbi të cilën ndërtohet shteti britanik dhe që ishte parimi themelor pas Revolucionit Borgjez Francez,⁷²⁷ kishte në rrënjë të saj idenë që vendimet e përfaqësuesve të popullit, të sendërtuara përmes legjislationit të nxjerra nga parlamenti i vendit, nuk mund t'i nënshtroheshin kontrollit jo-popullor. Kështu, ta zëmë, Deklarata Franceze e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit 1789, në nenin 6, përcaktonte që “akti i parlamentit është shprehje e vullnetit të përgjithshëm”, prandaj, kundërshtimi i tij supozohej të shkelte vullnetin e popullit. Si e tillë, supremacia legjislative nënkuptonte që ndalohej kontrolli i akteve të nxjerra nga parlamenti, që gjykatat nuk kishin juridiksion të gjykonin çështjet e të drejtave të njeriut, dhe që funksioni gjyqësor ishte i varur apo i kontrolluar nga pushteti legjislativ. Në këtë kuptim, supremacia legjislative bënte që superioriteti i ligjeve të nxjerra nga parlamenti të

⁷²² Kjo tendencë gjente kundërshtim të fuqishëm në fazën e hershme të zhvillimit kushtetues të Shteteve të Bashkuara, sepse konsiderohej që linte hapësirë për shkelje të interesit nacional. Shih: Corwin, Edward S. (1934) ‘The Twilight of the Supreme Court - A History of Our Constitutional Theory’. New Haven: Yale University Press; Shih edhe rastin e Gjermanisë, ku shtjellohet juridizimi i politikës përmes gjyqësisë kushtetuese: Landfried, Christine (1992) ‘Judicial policy making in Germany: The federal constitutional court’. *West European Politics*, Vol. 15 (3): p. 50-67;

⁷²³ Shih p.sh: Schwartz, Bernard (1993) ‘A History of the Supreme Court’. Oxford: Oxford University Press;

⁷²⁴ Shih më shumë për konceptin e demokracisë kushtetuese në: Epstein, L., Knight, J., and Shvetsova, O. (2001) ‘The Role of Constitutional Courts in the Establishment and Maintenance of Democratic Systems of Government’. *Law and Society Review*. Vol. 35: p. 117-63;

⁷²⁵ Shih p.sh: King, Jerome B (1965) ‘Constitutionalism and the Judiciary in France’. *Political Science Quarterly*, Vol. 80 (1): p. 62-87;

⁷²⁶ P.sh: Gardbaum, Stephen (2001) ‘The New Commonwealth Model of Constitutionalism’. *American Journal of Comparative Law* Vol. 49: p. 714-15;

⁷²⁷ Troper, Michel (2007) ‘Judicial Power and Democracy’, in 1 *European Journal Of Legal Studies* (EJLS) No.2 1; Shih gjithashtu: Fabbrini, Federico (2008) ‘Kelsen in Paris: France’s Constitutional Reform and the Introduction of a Posteriori Constitutional Review of Legislation’. *German Law Journal*. Vol. 9: p. 1297-1312, available at <http://www.germanlawjournal.com/index.php?pageID=11&artID=1020>;

mos mund të kontestohet, dhe që ligjet e nxjerra nga përfaqësuesit e popullit përbënin kulmin e rendit juridik.⁷²⁸ Kontrolli kushtetues i ligjeve, për këto arsye, supozohej që do të vinte në rrezik ekzistencën e demokracisë parlamentare dhe vet unitetin e shtetit.⁷²⁹

5. I vënë në këtë kontekst institucional, parlamenti shndërrohej në një mekanizëm të thjeshtë dhe vetëm të kontrolluar nga partitë politike apo rrymat politike, dhe pa mundësi të kontrollit të jashtëm të punës së tij legislative.⁷³⁰ Si e tillë, demokracia klasike parlamentare e vendoste ligjin në një pozicion të pakontrollueshëm nga një sistem institucional i pavarur dhe profesional, përderisa parlamenti kryente një funksion të pabalancueshëm dhe me predispozicion diktature parlamentare⁷³¹.
6. E kundërt ka qenë qasja në zhvillimin kushtetues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.⁷³² Megjithëse kushtetuta federale amerikane nuk paraqiste asnjë mekanizëm apo hapësirë eksplicite për zhvillim të funksionit të gjyqësisë kushtetuese,

⁷²⁸ Meqë kjo shihet si një relik e *Ancient Règime*., Sweet, Alec Stone (1992) 'The Birth of Judicial Politics in France: The Constitutional Council in Comparative Perspective'. New York: Oxford University Press;

⁷²⁹ Sweet, Alec Stone (2002) 'Constitutional Courts and Parliamentary Democracy'. *West European Politics*. Vol. 25 (1): p.77-100;

⁷³⁰ Shih p.sh. rastin francez: King, Jerome B (1965) 'Constitutionalism and the Judiciary in France'. *Political Science Quarterly*, Vol. 80 (1): pp. 62-87;

⁷³¹ U mor vesh, këtu nuk e kemi fjalën për diktaturë parlamentare në kuptimin e përdorur nga Karl Shmit (Carl Schmitt). Sipas këtij kuptimi shmitian parlamenti cilësohej si një organ politik i përçarë, i paafte dhe mbrojtës i interesave parciais politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Këto cilësi të parlamentit, të treguara nga Karl Shmit në kontekstin e Gjermanisë së Vajmarit, e bënin atë një institucion të pafuqishëm, të paafte dhe të padenjë për të përfaqësuar unitetin e krejt popullit gjerman. Këto cilësi, sipas tij, i posedonte vetëm presidenti i Rajh-ut gjerman sepse zgjidhej drejtpërdrejt nga popullii dhe, gjithnjë sipas Karl Shmitit, kishte autorizimin që bazohej në nenin 48 të Kushtetutës së Vajmarit për të balancuar dhe për të shërbyer si një "pushtet i tretë", neutral dhe i paanshëm kundruall dy pushteteve tjera. Sipas Karl Shmit, autorizimet nga nenii 48 ishin autorizime të ndërmjetme dhe neutrale, "pouvoir neutre et intermediaire". Kjo, nënkuptohet, nuk ka qenë e sakët sepse autorizimet në fjalë kanë qenë autorizime diktatoriale të cilat patën mundësuar ardhjen e Adolf Hitlerit në pushtet. Si të tilla, ato ato kanë qenë autorizime ekzekutive dhe jo neutrale dhe të ndërmjetme. Nga kjo del se, shkurt, fjala këtu është për diçka krejt tjetër, përkatësisht për një kuptim tjetërfare të pozitës, rëndësisë dhe rolit të parlamentit nga ai që ka ekzistuar dhe ekziston në Britani, Francë dhe gjetiu nëpër botë. Për pozicionet e Karl Shmitit, Cf. më shumë në Cf. Smit, Karl (2001) 'Cuvur Ustava' në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Odluka. Karl Smit i njegovi kriticari*. Beograd: Filip Visnjic, fq. 211-253. Titulli i origjinalit: Carl Schmitt, "Der huter der verfassung". *Archiv des öffentlichen rechts*. Neue Folge 16 Band J.C.B. Mohr (Paul Siebeck), Tübingen 1929; Karl Smit, *Tri vrste pravnonaucnog misljenja* (Biblioteka *Parerga*: Beograd, 2003) fq. 16-17; 34-42; 46-54. Titulli në origjinal: Carl Schmitt, *Über die drei Arten des rechtswissenschaftlichen Denkens* (Hamburg, Hanseatische Verlagsanstalt, 1934). Pwr kritikwn e Kal Shmit, Cf. mw shumw nw: Hans Kelsen, "Ko treba da bude cuvar Ustava". Në Slobodan Samardzic (ed.), *Norma i Olduka*, fq. 256-297. Titulli në original: Hans Kelsen, *Wer soll der huter der verfassung sein?* (Dr. Walther Rothschild, Berlin-Grunewald, 1931); Cf. Dyzenhaus, David (1997) 'Legality and Legitimacy. Carl Schmitt, Hans Kelsen and Herman Heller in Weimar'. Oxford: Oxford University Press, p. 51-58 & 70-84;

⁷³² Shih: Beth, Loren P. (1962) 'Politics, the Constitution, and the Supreme Court; an Introduction to the Study of Constitutional Law'. New York: Harper & Row;

Gjykata Supreme amerikane shfrytëzoi prerogativën e saj si interpretuese përfundimtare gjyqësore për t'i veshur vetes funksionin e kontrollit abstrakt të ligjeve të Kongresit. Nën këtë prerogativë, Gjykata Supreme në njëfarë mënyre ushtroi një amandamentim faktik të kushtetutës, duke bërë që si rezultat të lindte një mekanizëm i ri dhe shumë të rëndësishëm për tërë sistemin kushtetues dhe demokracinë e vendit. Në këtë frymë, Gjykata Supreme amerikane i vuri bazat e gjyqësisë kushtetuese, megjithëse kjo e fundit merr hov dhe dimension më të zhvilluar në Evropë shumë vite më vonë.⁷³³ Në kuptimin amerikan, gjyqësia kushtetuese kishte nxitës për zhvillim vetë formulën e ndarjes së pushtetit dhe konceptin e kontrollit dhe balancit ndërmjet pushteteve. Në këtë kuptim, gjyqësia kushtetuese në Shtetet e Bashkuara ishte rrjedhojë logjike e forcimit të pozitës së gjyqësorit të rregullt, dhe një formule shumë rigjide të ndarjes dhe kundërbalancimit të ndërvarur të pushteteve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.⁷³⁴

7. Në anën tjetër, përballë shkollës dominante deri në shek. XX të supremacisë legjislative në Evropë,⁷³⁵ që kishte marrë rrënjë të fuqishme sidomos pas Revolucionit Borgjez Francez,⁷³⁶ Hans Kelsen,⁷³⁷ një ndër pozitivistët më të shquar të kohës moderne, solli konceptin që demokracia mund të funksiononte vetëm nëse në të do të kishte një mekanizëm të pavarur që kontrollonte kushtetutshmërinë e ligjeve të nxjerra nga parlamenti. Koncepti kelzenian i gjyqësisë kushtetuese u shndërrua shumë shpejt në formulën mbi të cilën filloi vala e demokratizimit kushtetues të shteteve evropiane në mesin e gjysmëshekullit të XX.⁷³⁸ Shikuar prej një këndi më shumë historik, lindja e gjyqësisë kushtetuese ishte pasojë e nevojës për rishikim të konceptit të demokracisë konvencionale parlamentare dhe partiakëzimit (diktaturës) që kishte burim parlamentet e zgjedhura nga populli. Gjyqësia kushtetuese, prandaj, ishte një reformë e logjikshme institucionale që kishte për qëllim të rivendoste një sistem më të balancuar të qeverisjes, ku parlamenti megjithatë i nënshtrohej një kontrolli të jashtëm profesional dhe të

⁷³³ P.sh: Corrado, Michael Louis (2004) 'Comparative Constitutional Review: Cases and Materials'. Durham, NC: Carolina Academic Press;

⁷³⁴ Shih p.sh: Schwartz, Bernard (1993) 'A History of the Supreme Court'. Oxford: Oxford University Press; Shih gjithashtu: Abraham, Herry J (1998) 'Judicial Process - An Introductory Analysis of the Courts of the United States, England, and France'. New York: Oxford University Press (seventh edition);

⁷³⁵ Gardbaum, Stephen (2001) 'The New Commonwealth Model of Constitutionalism'. *American Journal of Comparative Law*. Vol. 49: p. 714-15;

⁷³⁶ Shih p.sh: Corrado, Michael Louis (2004) 'Comparative Constitutional Review: Cases and Materials'. Durham, NC: Carolina Academic Press, 2004 (kapitulli I); Troper, Michel (2007) 'Judicial Power and Democracy', in 1 *European Journal Of Legal Studies* (EJLS) No.2 1; Shih gjithashtu: Fabbrini, Federico (2008) 'Kelsen in Paris: France's Constitutional Reform and the Introduction of a Posteriori Constitutional Review of Legislation'. *German Law Journal*. Vol. 9: p. 1297-1312, available at <http://www.germanlawjournal.com/index.php?pageID=11&artID=1020>;

⁷³⁷ Jabloner, Clemens (1998) 'Kelsen and His Circle: The Viennese Years'. *European Journal of International Law*. Vol. 9: 368, 374;

⁷³⁸ Comella, Victor Ferreres (2004) 'The European Model of Constitutional Review of Legislation: Toward Decentralization'. *International Journal of Constitutional Law*. Vol 2 (3): 461-491;

pavarur për aq kohë sa standardet kushtetuese ishin në pyetje.⁷³⁹ Në këtë kontekst, koncepti Kelzenian i gjyqësisë kushtetuese u shndërrua shumë shpejt në një version mbarë evropian të demokracisë ku linjat normative të sjelljes së shtetit u bënë baza mbi të cilat duhej të lëvizte pushteti.

8. Modeli kelzenian i gjyqësisë kushtetuese kishte katër karakteristika, që më vonë shndërrohen në parimet themelore të gjyqësisë kushtetuese pothuajse në çdo shtet evropian. Ky model ndërtohet mbi teorinë e *grundnormes*, që është një zhvillim logjik kundërshtimi me doktrinën e supremacisë legjislativë. Esenca e dominimit të këtij modeli në Evropë pas vitit 1945 lidhet me triumfin ndaj nacizmit dhe aleatëve të tij dhe me përpjekjet institucionale për sanimin e pasojave të sundimit nacist në Evropë.⁷⁴⁰
9. E para karakteristikë konsiston në faktin se një gjykatë e centralizuar me kompetenca ekskluzive të kontrollit kushtetues dhe interpretimit të kushtetutës kryen funksionin e gjyqësorit kushtetues. Në këtë kuptim, gjykata kushtetuese vishet me monopolin e vlerësimit të kushtetutshmërisë, përderisa gjyqësori i rregullt parimisht nuk hyn në këtë terren juridiksional. E dyta cilësi flet për atë se në këtë model ndërtohet një ndarje e qartë e përgjegjësisë në mes të gjyqësorit të rregullt dhe gjykatës kushtetuese, ku kjo e fundit nuk hyn në rrethin juridiksional të gjyqësorit të rregullt për të gjykuar çështje gjyqësore të zakonshme. E treta, gjykatat kushtetuese kanë një lidhje funksionale si me gjyqësorin e rregullt ashtu edhe me legjislativin, ku hapësira kushtetuese kontrollohet vetëm nga gjykata kushtetuese. Në këtë hapësirë, gjykata kushtetuese parimisht mbetet e lidhur me kërkesat e palëve tjera në lidhje me iniciimin e procedurës për kontroll kushtetues. Së fundmi, ekziston një pozicion i qartë në kuptim të funksioneve të gjyqësorit të rregullt dhe atij kushtetues: i pari kujdeset për ruajtjen e supremacisë juridike të ligjit, ndërsa i dyti për ruajtjen e supremacisë juridike të kushtetutës.⁷⁴¹ Bazuar në këto karakteristika, modelimi i gjyqësisë kushtetuese sipas Kelzenit përbën një koncentrim dhe specializim të funksionit të kontrollit kushtetues dhe rritje të rolit të gjykatës kushtetuese në procesin legjislativ. Në këtë formë, zhvillimi i mëtejshëm i gjyqësisë kushtetuese ka rezultuar në një tip të qeverisjes të konceptuar si demokraci kushtetuese, që është një hap më përpara se sa demokracia e tipit klasik parlamentar. Demokracia kushtetuese, prandaj, në thelb të saj ka idenë që vendimet e popullit apo të institucioneve

⁷³⁹ Shih: mungesa e një sistemi të tillë çfarë pasojash solli në Gjermani pas luftës së parë botërore, në: Lindseth, Peter L (2003-2004) 'The Paradox of Parliamentary Supremacy: Delegation, Democracy, and Dictatorship in Germany and France, 1920s-1950s'. *Yale Law Journal*. Vol. 113: p. 1343-1412;

⁷⁴⁰ Kështu, ta zëmë, në Gjermani, Gjykata Federale Kushtetuese modelohet duke reflektuar mënyrat më të mira për të sanuar dëmet e regjimit nacional-socialist. Cf. Borowski, M (2003) 'The Beginnings of Germany's Federal Constitutional Court'. *Ratio Juris*. Vol. 16: p. 155-186; Shih gjithashtu: Öhlinger, T (2003) 'The Genesis of the Austrian Model of Constitutional Review of Legislation'. *Ratio Juris*. Vol. 16: p. 206-222; Cole, Taylor (1959) 'Three Constitutional Courts: A Comparison'. *The American Political Science Review*. Vol. 53 (4): p. 963-984;

⁷⁴¹ Sweet, Alec Stone (2002) 'Constitutional Courts and Parliamentary Democracy'. *West European Politics*. Vol. 25 (1): p.77-100;

përfaqësuese të tij, por edhe të organeve tjera shtetërore, i nënshtrohen një kontrolli kushtetues dhe duhet të jenë në përputhje me standardet kushtetuese.⁷⁴² Në demokracitë kushtetuese, çështja e përputhshmërisë së akteve juridike më të ulëta se kushtetuta me kushtetutën përbën shpeshherë hapësirë për një version kundër-popullor të vendimmarrjes.

10. Përveç kontrollit kushtetues të vendimmarrjes mazhoritare, duhet thënë që çështja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në kuadër të një sistemi juridik të supremacionit legjislativ vihej shpeshherë në pikëpyetje për shkak të epërsisë së pakundërshtueshme të akteve të parlamentit përballë çdo standardi tjetër. Kjo u bë e dukshme në veçanti atëherë kur kushtetutat e vendeve të ndryshme futen në gjirin e dispozitave të tyre korpuse të tëra të të drejtave të njeriut, pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Modeli i demokracisë kushtetuese, në këtë kontekst, bëri çështjen e mbrojtjes së të drejtave kushtetuese në funksion të gjyqësisë kushtetuese, ku kjo e fundit i jep “lirshëm” përparësi këtyre të fundit qoftë edhe përballë akteve të parlamentit.⁷⁴³ Në këtë version të sistemit juridik, prandaj, mbrojtja e të drejtave të njeriut është shumëfish më e sigurt dhe më e fuqishme sepse gjyqësia kushtetuese paraqet instrumentin që mbron të drejtat e njeriut qoftë edhe atëherë kur ato mund të rrëzohen nga një vendim popullor i sendërtuar përmes ligjit të parlamentit.⁷⁴⁴ Demokracia kushtetuese, prandaj, ndërton praktikisht një hierarki në mes të të drejtave kushtetuese të njeriut dhe akteve të parlamentit, duke i dhënë epërsi të parave. Kjo hierarki, në anën tjetër, bën që vendimet shpeshherë popullore të parlamentit t’i nënshtrohen kontrollit të përputhshmërisë së tyre me listën e të drejtave kushtetuese të njeriut.⁷⁴⁵ U mor vesh, këto zhvillime nuk kanë qenë pjesë e idesë fillestare të Hans Kelsen-it, i cili mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të njeriut e përjashtonte në tërësi në shtjellimet e veta. Ky segment i gjyqësisë kushtetuese, tepër i fuqishëm dhe dinamik për momentin, ka ardhur si rezultat i zhvillimeve tragjike të Luftës së Dytë Botërore. Ngjashëm ka ndodhur edhe me segmentin tjetër, atë të “ligjvënësit pozitiv” të cilin e ushtrojnë nganjëherë gjykatat kushtetuese. Kjo anë po ashtu nuk ka qenë pjesë e idesë fillesatre të Hans Kelsen. Mirëpo, siç e ka thënë një autor, “I kemi borxh Hans Kelsen-it, mirë që skillever të tij

⁷⁴² Krahaso me modelin amerikan: Corrado, Michael Louis (2004) ‘Comparative Constitutional Review: Cases and Materials’. Durham, NC: Carolina Academic Press; Psh: Öhlinger, T (2003) ‘The Genesis of the Austrian Model of Constitutional Review of Legislation’. *Ratio Juris*. Vol. 16: p. 206-222;

⁷⁴³ P.sh.: Rosenfeld, Michel, (2002) ‘Constitutional Adjudication in Comparative Perspective: The European Model as Against the American in Terms of Politics, Law and Interpretation’. Association of American Law Schools, Conference on Constitutional Law, Washington, 5-8 June 2002), available at:

<http://www.aals.org/profdev/constitutional/rosenfeld.html>;

⁷⁴⁴ Shih perspektivën e Gjykatës Federale Kushtetuese të Gjermanisë për këtë kontekst: Baer, Susanne (1998-1999) ‘Equality: The Jurisprudence of the German Constitutional Court’. *Columbia Journal of European Law*. Vol. 5: p. 249-260;

⁷⁴⁵ Shih p.sh.: Öhlinger, T (2003) ‘The Genesis of the Austrian Model of Constitutional Review of Legislation’. *Ratio Juris*. Vol. 16: p. 206-222; Shih rëndësinë e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në debatin për demokracinë, në: Harel, Alon (2003) ‘Rights-Based Judicial Review: A Democratic Justification’. *Law and Philosophy*. Vol. 22 (3/4), “Judicial Review”. p. 247-276;

nuk jemi”⁷⁴⁶ Prandaj, në përgjithësi, modeli i demokracisë kushtetuese përbën një zhvillim shumëfish më pozitiv dhe më të sigurt juridikisht sa i përket mbrojtjes së të drejtave të njeriut,⁷⁴⁷ përderisa këto të fundit nxirren nga hapësira e kontrollit apo ‘lojës’ politike që mund të luaj parlamenti i vendit. Në anën tjetër, demokracia kushtetuese e formës së tillë lejon shumë më pak hapësirë monopolistike për partitë politike, dhe e vendos ‘lojën’ politike në kuadër të kufizimeve dhe standardeve kushtetuese. Përmes kontrollit kushtetues të kësaj natyre, në të njëjtën kohë, mundësohet që parimi i ndarjes së pushtetit të jetë shumëfish më i fuqishëm, dhe që ndërvarja e pushteteve të jetë shumëherë më e balancuar se sa në modelet tjera.⁷⁴⁸ Natyrisht, kundërbalancimi kushtetues i vendimeve që merren nga të tri pushtetet është funksion që bartet nga ana e gjykatës kushtetuese në shtetet me modelin kelzenian të gjyqësisë kushtetuese, por që nuk është rasti me shembullin e një sistemi të decentralizuar dhe të pakoncentruar të gjyqësisë kushtetuese sikur ai i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Autorët e ndryshëm nga lëmia kushtetuese, me të drejtë dhe në mënyrë mjaft bindëse argumentojnë se kërkesa për një sistem të gjyqësisë kushtetuese është kusht për legjitimitetin e pushtetit, dhe se kjo duhet shikuar edhe në kuptim të të drejtave të njeriut.⁷⁴⁹

11. Në kuptim të modeleve institucionale të gjyqësisë kushtetuese, sistemi klasik amerikan dhe modeli austriak (evropian, kelsenian) janë dy tipet kryesore të organizimit dhe funksionimit.⁷⁵⁰ Megjithëse të dy tipet e gjyqësisë kushtetuese kanë pothuajse të njëjtin mision, mënyra e organizimit institucional, juridiksioni i tyre, efekti i vendimeve të tyre janë plotësisht të ndryshme. Përderisa të dy modelet e gjyqësisë kushtetuese janë ndërtuar mbi baza të ndryshme historike dhe mbi koncepte të ndryshme filozofike, modeli austriak (kelzenian) i gjyqësisë kushtetuese është më i zhvilluar dhe shprehje e specializimit të funksionit të kontrollit kushtetues por edhe të demokracisë kushtetuese.
12. Modeli austriak (evropian, kelzenian) i gjyqësisë kushtetuese është tipi më i pranuar i ndërtimit institucional të gjyqësisë kushtetuese në Evropë⁷⁵¹ Ky model i gjyqësisë kushtetuese i ka këto karakteristika bazike:⁷⁵²

⁷⁴⁶ Brewer-Carias, Allan R. (2011) ‘Constitutional Courts As Positive Legislators. A Comparative Law Study’. Cambridge: Cambridge University Press, p. 31 (fusnota 74);

⁷⁴⁷ Harel, Alon (2003) ‘Rights-Based Judicial Review: A Democratic Justification’. *Law and Philosophy*. Vol. 22 (3/4), “Judicial Review”, p. 247-276;

⁷⁴⁸ Shih një argument të përgjithshëm mbi këtë logjikë sipas teorisë së rendit shoqëror, në: Cappelletti, Mauro (1970) ‘Judicial Review in Comparative Perspective’. *California Law Review*. Vol. 58 (5): p. 1017-1053;

⁷⁴⁹ Louis L. Jaffe (1958) ‘The Right to Judicial Review I’. *Harvard Law Review*. Vol. 71 (3): p. 401-437;

⁷⁵⁰ Rosenfeld, Michel (2002) ‘Constitutional Adjudication in Comparative Perspective: The European Model as Against the American in Terms of Politics, Law and Interpretation’. Association of American Law Schools, Conference on Constitutional Law, Washington, 5-8 June 2002, available at: <http://www.aals.org/profdev/constitutional/rosenfeld.html>;

⁷⁵¹ Comella, Victor Ferreres (2004) ‘The European Model of Constitutional Review of Legislation: Toward Decentralization’. *International Journal of Constitutional Law*. Vol. 2(3): p. 461-491;

⁷⁵² Shih rrënjët historike në: Öhlinger, T. (2003) ‘The Genesis of the Austrian Model of

- a) Funkzioni i kontrollit kushtetues ushtrohet nga ana e një gjykate të vetme, pra nga një institucion i centralizuar.⁷⁵³ Gjyqësori i rregullt nuk ka autoritet për të ushtruar kontroll të kushtetutshmërisë së akteve juridike. Centralizimi i kontrollit kushtetues në një gjykatë të vetme bën ndarjen e plotë të funksioneve në mes të kësaj të fundit dhe gjykatave të rregullta të cilat gjykojnë çështje të natyrës ligjore. Kjo bën që rreziku nga një divergjencë gjyqësore në interpretim kushtetues të mos ekzistojnë, dhe që uniformiteti i sistemit juridik të garantohet më fuqishëm.⁷⁵⁴
- b) Juridiksioni i kontrollit abstrakt të akteve juridike të përgjithshme është karakteristika më dominante e gjykatave kushtetuese në këtë model institucional. Këto të fundit kanë autoritet që të kontrollojnë drejtpërdrejtë kushtetutshmërinë e një akti abstrakt pa pasur nevojë që një kontest i caktuar të lind nga një situatë individuale (konkrete). Autoriteti për të ushtruar kontroll abstrakt bën që gjykata kushtetuese të vishet me fuqinë e legjislatorit, megjithëse përgjithësisht legjislatorit negativ (që gjykon se çfarë *nuk* është kushtetuese), dhe të ushtrojë funksionin e rehabilitimit të rendit juridik nëse ky i fundit ka qenë objekt i një shkeljeje abstrakte kushtetuese.
- c) Efekti juridik i vendimeve të gjykatës kushtetuese është *erga omnes* dhe i ekzekutueshëm. Vendimet për kundërkushtetutshmëri të një akti abstrakt, p.sh. ligjit, e bëjnë përjashtimin e menjëhershëm të tij nga rendi juridik. Kjo në anën tjetër sjell detyrimin për parlamentin që të mos miratoj substancën e tillë të njëjtë. Nëse ndodh një sjellje e tillë, parlamenti shkel vet kushtetutën e vendit.⁷⁵⁵
- d) Përveç kontrollit *a posteriori*,⁷⁵⁶ në këtë model të gjyqësisë kushtetuese lejohet në raste të caktuara edhe kontrolli *a priori*, që nënkupton kontrollin kushtetues të një akti të caktuar juridik përpara se ai të ketë kaluar procedurën e miratimit në organin përkatës. Vendimet në këtë model të gjyqësisë kushtetuese mund të jenë si *ex tunc* ashtu edhe *ex nunc*.⁷⁵⁷

Constitutional Review of Legislation'. *Ratio Juris*. Vol. 16: p. 206-222;

⁷⁵³ Shih psh: Comella, Victor Ferreres (2003-2004) 'The Consequences of Centralizing Constitutional Review in a Special Court: Some Thoughts on Judicial Activism'. *Texas Law Review*. Vol. 82 (7): p. 1705-17015;

⁷⁵⁴ Comella, Victor Ferreres (2003-2004) 'The Consequences of Centralizing Constitutional Review in a Special Court: Some Thoughts on Judicial Activism'. *Texas Law Review*. Vol. 82 (7): p. 1705-17015;

⁷⁵⁵ Venice Commission. 'The Relationship Between Constitutional Courts, Legislators And Judicial Power In The European System Of Judicial Review Towards A Decentralised System As An Alternative To Judicial Activism?' Strasbourg, 7 July 2010, CDL-JU(2010)012;

⁷⁵⁶ Shih reformën e modelit francez të gjyqësisë kushtetuese sa i përket kësaj në: Federico Fabbrini (2008) 'Kelsen in Paris: France's Constitutional Reform and the Introduction of a Posteriori Constitutional Review of Legislation'. *German Law Journal*. Vol. 9: 1297-1312, available at <http://www.germanlawjournal.com>;

⁷⁵⁷ Venice Commission. Report "Some Comparative Comments To The Introduction Of Constitutional Review In The State Of Palestine" by Mr Arne Marjan Mavčič (Liaison Officer, Constitutional Court, Slovenia) CDL-JU(2008)026 Seminar On "Models Of Constitutional Jurisdiction", Ramallah, 25-26 October 2008;

13. Në tri valët e demokratizimit në Evropë, shtetet kanë aplikuar modelin e gjyqësisë kushtetuese kelzeniane e jo atë amerikane. Në periudhën e parë pas Luftës së Dytë Botërore, Gjermania dhe Italia kanë ndërtuar sistemin kelzenian të gjyqësisë kushtetuese.⁷⁵⁸ E njëjta gjë ndodhi edhe në valën e dytë të demokratizimit në Evropë, pas rrëzimit të regjimit autoritar në Spanjë, Portugali dhe Greqi, ku u ndërtuan modele kushtetuese të tipit kelzenian.⁷⁵⁹ Për fund, edhe në valën e tretë të demokratizimit në Evropë, pas rrëzimit të regjimeve komuniste, shtetet post-komuniste në Evropë instaluan modele kelzeniane të gjyqësisë kushtetuese. Kushtetuta e Kosovës ndjek të njëjtën linjë.
14. Modeli amerikan i gjyqësisë kushtetuese, që përveç Shteteve të Bashkuara të Amerikës, p.sh. në Evropë gjithashtu aplikohet nga Danimarka, Irlanda, etj, karakterizohet nga veçori të gjyqësisë së rregullt (si rezultat i *Marbury v. Madison*,⁷⁶⁰ dhe doktrinës fillestare të zhvilluar nga Gjykatësi Xhon Marshall).⁷⁶¹ Pothuajse e njëjtë është trajta mbi të cilën ushtrohet kontrolli kushtetues në Bashkimit Evropian.⁷⁶² Ky model i gjyqësisë kushtetuese i ka këto karakteristika bazike:
- a) Funkzioni i kontrollit kushtetues në këtë model institucional ushtrohet nga ana e gjykatave të rregullta, prandaj është sistem i decentralizuar i kontrollit kushtetues. Nuk ekziston një gjykatë me juridiksion të specializuar në kontrollin kushtetues. Në këtë model, gjykatat e rregullta ushtrojnë kontrollin kushtetues edhe të akteve abstrakte, Megjithatë, vendimet e gjykatës më të ulët i nënshtrohen pastaj procedurës së apelit nga ana e një gjykate më të lartë.
 - b) Kontrolli kushtetues abstrakt në këtë model nuk lejohet të bëhet në bazë të inicimit direkt. Kontrolli abstrakt kushtetues, prandaj, mund të bëhet vetëm nëse ai lind në kuadër të një rasti individual (“case and controversy”). Pra, në këtë model të gjyqësisë kushtetuese, kontrolli abstrakt i akteve të përgjithshme bëhet vetëm në kuadër të zgjidhjes së një rasti individual nga një gjykatë e rregullt, e cila, përveç vendosjes për rastin individual, mund të ushtrojë edhe kontrollin abstrakt të një akti të përgjithshëm në të cilin ka lindur rasti individual që është objekt i gjykimit në fjalë. Përveç kësaj, në mënyrë që gjykata e rregullt të ketë juridiksion për të ushtruar kontrollin abstrakt të një

⁷⁵⁸ Volcansek, Mary I (2000) ‘Constitutional Politics in Italy: the Constitutional Court’. St. Martin's Press. p. 1- 15;

⁷⁵⁹ Gardbaum, Stephen (2001) ‘The New Commonwealth Model of Constitutionalism’. *American Journal of Comparative Law*. Vol 49: p. 714-15, në fq. 715;

⁷⁶⁰ *Marbury v. Madison*, Gjykata Supreme e ShBA, Aktgjykim, 5 U.S. 137, 177-78 (1803); Disa argumentojnë që gjyqësia kushtetuese ishte mjaft e zhvilluar edhe para *Marbury*. Shih: Treanor, William Michael (2005) ‘Judicial Review before "Marbury"’. *Stanford Law Review*. Vol. 58 (2): p. 455-562;

⁷⁶¹ Shih bazën krahasuese në: Kelsen, Hans (1942) ‘Judicial Review of Legislation: A Comparative Study of the Austrian and the American Constitution’. *Journal of Politics*. Vol. 4: p. 185-86;

⁷⁶² Shih: Schroth, Peter W (1979) ‘Marbury and Simmenthal: Reflections on the Adoption of Decentralized Judicial Review by the Court of Justice of the European Community’. *Loyola Law Association Law Review*. Vol. 12: p. 869-902, available at: <http://digitalcommons.lmu.edu/llr/vol12/iss4/4>;

akti juridik, duhet të plotësohet kushti që rasti individual që gjykohet të ketë lidhje kauzale apo që interesi juridik i palës në rastin individual të jetë i lidhur drejtpërdrejtë me aktin juridik të përgjithshëm ndaj të cilit gjykata pastaj ushtron kontrollin kushtetues.

- c) Në këtë model të gjyqësisë kushtetuese, efekti i vendimeve për kundërkushtetutshmëri ka natyrë *inter-partes*, dhe nuk i drejtohet të gjithë personave/ subjekteve. Megjithatë, për shkak të parimit *stare decisis* që është baza e sistemit juridik anglo-sakson, vendimet mbi kushtetutshmërinë e akteve të caktuara të gjykatave të larta shndërrohen në precedent të detyrueshëm gjyqësor dhe, si rrjedhojë, detyrohen të ndiqen nga i tërë sistemi gjyqësor. Kjo bën që, në aspektin praktik, vendimet mbi kushtetutshmërinë e gjykatave të larta në këtë sistem të jenë *praktikisht* të vlefshme *erga omnes*, megjithëse jo juridikisht.
- d) Në këtë model të gjyqësisë kushtetuese, kontrolli i kushtetutshmërisë mund të bëhet vetëm *a posteriori*, meqë rasti mund të gjykohet vetëm në kuadër të një shkeljeje individuale, e cila është dashur të mbështetet në një akt abstrakt efektiv (të zbatueshëm). Në këtë model, gjithashtu, efekti i vendimeve është thjeshtë retrospektiv (*ex tunc*).⁷⁶³

15. Përveç këtyre dy modeleve tipike, ekziston edhe modeli i përzier i gjyqësisë kushtetuese, ku pavarësisht faktit që ekziston një gjykatë e centralizuar e kontrollit kushtetues, gjykatat e rregullta mund të kontrollojnë kushtetutshmërinë e akteve juridike, me kusht që vendimet e tyre të mund të apelojnë në gjykatën kushtetuese.⁷⁶⁴

16. Në kuptim të një sistemi shumë-nivelesh Evropian të gjyqësisë, i rëndësisë së veçantë është roli i gjyqësisë kushtetuese në ndërtimin e raporteve me gjykatat ndërkombëtare dhe në projektimin e raportit të së drejtës së brendshme me të drejtën ndërkombëtare. Në kuptim të disenjit shumë-nivelesh të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Evropë, gjykatat kushtetuese janë institucionet më të larta shtetërore që sendërtojnë komunikimin juridik si me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ), ashtu edhe me tribunatet tjera ndërkombëtare. Në këtë prizëm, gjykatat kushtetuese përbëjnë mekanizmat institucional që e mundësojnë futjen e standardeve të GjEDNJ-së në të drejtat e brendshme, duke e ruajtur pozitën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në të drejtën e brendshme. Për më tepër, në kuptim të një Evrope të supranacionalizuar, gjykatat kushtetuese janë mekanizmat që ofrojnë mundësinë për të ‘akomoduar’ parimet e

⁷⁶³ Venice Commission. Report “Some Comparative Comments To The Introduction Of Constitutional Review In The State Of Palestine” by Mr Arne Marjan MAVČIČ (Liaison Officer, Constitutional Court, Slovenia) CDL-JU(2008)026 Seminar On “Models Of Constitutional Jurisdiction”, Ramallah, 25-26 October 2008; Shih gjithashtu: Schwartz, Bernard (1993) ‘A History of the Supreme Court’. Oxford: Oxford University Press; Abraham, Herry J (1998) ‘Judicial Process - An Introductory Analysis of the Courts of the United States, England, and France’. New York: Oxford University Press (seventh edition);

⁷⁶⁴ Ibid, Venice Commission, CDL-JU(2008)026 Seminar On “Models Of Constitutional Jurisdiction”, Ramallah, 25-26 October 2008;

epërsisë të së drejtës primare të BE-së në sistemet juridike nacionale,⁷⁶⁵ kur shtetet bëhen anëtare të BE-së. I njëjtë është edhe pozicioni i gjykatave kushtetuese sa i përket raportit të së drejtës së brendshme me të drejtën ndërkombëtare,⁷⁶⁶ kur dizajnimi i kësaj lidhjeje dhe ndërtimi i hierarkisë dhe i mekanizmit të ndërvarjes është thjeshtë një funksion që sendërtohet nga ana e gjykatave kushtetuese.

17. Në kuptim të juridiksionit të gjykatave kushtetuese në Evropë, ose organeve të centralizuara që e kryejnë funksionin e kontrollit kushtetues, shumica e tyre janë te veshura me dy lloje bazike të juridiksionit. Një, juridiksioni abstrakt, që është kompetenca tipike e një mekanizmi që kryen funksionin e kontrollit të kushtetutshmërisë. Në kuptim të këtij juridiksioni, gjykatat ushtrojnë kontrollin e përputhshmërisë së normave juridike të përgjithshme me kushtetutën, dhe, dy, juridiksioni individual, kur gjykata kushtetuese aktivizohet sipas kërkesës së individit, të cilit, në bazë të një akti juridik individual (shumë përjashtimisht edhe abstrakt) iu është shkelur një e drejtë kushtetuese. Në kuptim të këtij juridiksioni, gjykata kushtetuese kufizohet në gjykimin e kushtetutshmërisë së aktit juridik individual, të cilin, nëse e shpall antikushtetues, ia kthen organit më të ulët përkatës me instruksionet që duhet të ndiqen në mënyrë që akti i tillë të nxjerret në përputhje me kushtetutën. Hapësira juridiksionale e një gjykate kushtetuese është në fakt përcaktor i fuqisë që mekanizmi i kontrollit kushtetues ka përballë tre pushteteve shtetërore.

Neni 112 [Parimet e Përgjithshme]

- (1) Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.
- (2) Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Neni 112

1. Neni 112 përcakton parimet themelore funksionale të Gjykatës Kushtetuese të shtetit. Gjithashtu, neni në fjalë përcakton edhe natyrën e përgjithshme të autoritetit të Gjykatës Kushtetuese, duke vënë bazat mbi karakterin kelzenian të rolit të saj.

⁷⁶⁵ P.sh: Bogdany, Armin Von (2000) 'The European Union as a Human Rights Organization? Human rights and the core of the European Union'. *Common Market Law Review*. Vol. 37: p. 1307-1338;

⁷⁶⁶ Shih p.sh.: Cartabia, Marta (1990-1991) 'The Italian Constitutional Court and the Relationship between the Italian Legal System and the European Community'. *Michigan Journal of International Law*. Vol. 12: p. 173-203;

1. Ky paragraf përcakton që ‘Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e kushtetutës dhe kontrollin e përputhshmërisë së ligjeve me kushtetutën.’ Për dallim nga Kushtetuta e SHBA-ve, e cila nuk përcakton nëse dhe cili është institucioni që bën interpretimin përfundimtar të kushtetutës,⁷⁶⁷ ky paragraf bën përcaktimin shprehimor të institucionit që bën interpretimin përfundimtar të kushtetutës dhe kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve. Ky përcaktim i këtij paragrafi vendos tre parimet themelore kelzeniane të gjyqësisë kushtetuese: a) që ushtrimi i funksionit të kontrollit kushtetues bëhet nga ana e një organi të centralizuar, i cili bart monopolin e kontrollit të kushtetutshmërisë (*‘Normverëerfungsmonopo’*⁷⁶⁸); b) që gjykata kushtetuese është e veshur me autoritetin e kontrollit abstrakt të normës juridike, në kuptim të kushtetutshmërisë së saj; c) që efekti i vendimeve të kësaj gjykate, në kuptim të fuqisë së tyre juridike, është përfundimtar dhe nuk mund t’i nënshtrihen rishikimit nga cilido institucion/mekanizëm shtetëror. Përmes përcaktimit që gjykata kushtetuese është interpretuesi përfundimtar i kushtetutës, ky paragraf vendos mekanizmin që duhet të kujdeset për pozitën hierarkike të kushtetutës përballë akteve tjera juridike të përgjithshme, duke emëruar institucionin përgjegjës për këtë detyrë. Në parim, kushtetuta përcakton që Gjykata është *vetëm* kontrollor i kushtetutshmërisë dhe jo ligjshmërisë, siç janë shumë gjykata kushtetuese në Evropën Juglindore.⁷⁶⁹
2. I rëndësisë së veçantë për këtë paragraf është koncepti që gjykata kushtetuese është “autoriteti përfundimtar... për interpretimin e kushtetutës”. Tri janë gjërat që duhet zbërthyer. Një, se çfarë kuptimi juridik ka përcaktimi që gjykata kushtetuese është autoriteti përfundimtar në kryerjen e këtij funksioni? Dy, se çfarë natyre juridike ka koncepti ‘interpretim’ i vënë në këtë paragraf? Dhe tre, se çfarë strukture ka funksioni i interpretimit që ushtron gjykata sipas këtij paragrafi? Sa i përket çështjes së parë, koncepti që Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar i interpretimit të kushtetutës është i lidhur me pozitën hierarkike institucionale që kësaj gjykate i jep ky paragraf. Në këtë kuptim, ky paragraf e vendos Gjykatën Kushtetuese në pikën më të lartë të hierarkisë institucionale sa i përket funksionit të interpretimit të kushtetutës. Kjo, në kuptimin institucional ka tri domethënie: a) që asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund t’i marrë apo të ushtrojë në emër të Gjykatës Kushtetuese funksionin e interpretimit përfundimtar kushtetues; b) që, edhe nëse cilido institucion tjetër shtetëror ka bërë interpretimin apo është referuar tek kushtetuta për të ushtruar një kompetencë të tij/saj, kjo mund të konsiderohet përfundimisht e përcaktuar vetëm nëse kalon përmes filtrit të vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese; c) asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund të shfrytëzojë

⁷⁶⁷ Hostettler, Honorable John N. and Washburne, Thomas W (1997) ‘The Constitution's Final Interpreter: We the People’. *Regent University Law Review*. Vol. 8: 13-32;

⁷⁶⁸ Grabenwarter, Christoph (2011) ‘Separation of Powers and the Independence of Constitutional Courts and Equivalent Bodies’. Keynote Speech, 16 January 2011, 2nd Congress of the World Conference on Constitutional Justice, Rio de Janeiro;

⁷⁶⁹ Shih, ta zëmë, rastin kroat, në: Kushtetuta e Republikës së Kroacisë, neni 125;

prerogativat e tij/saj faktike për të vendosur nënkuptime të domethënies së kushtetutës, dhe se prerogativat e tilla mund të konsiderohen kushtetuese vetëm nëse kalojnë përmes vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese, dhe d) asnjë institucion tjetër shtetëror nuk mund t'i ikë detyrimit (bishtnoj) që të ndjek interpretimin e kushtetutës sipas Gjykatës Kushtetuese, meqë kjo e fundit sipas këtij paragrafi është autoriteti i fundit institucional për interpretimin e saj. Sa i përket çështjes së dytë, koncepti “interpretim” është i rëndësishëm së veçantë për të përcaktuar natyrën juridike të vendimeve dhe autoritetin e Gjykatës Kushtetuese. Në kuptim të këtij paragrafi, Gjykata Kushtetuese vishet me kompetencën e ‘vendosjes’ së domethënies së normave të kushtetutës. Relevanca e këtij paragrafi sa i përket kësaj çështjeje ka tri domethënie juridike: a) që interpretimi i kushtetutës nënkupton vendosjen në lidhje me nënkuptimin e normave të saj abstrakte, dhe aplikimin e tyre në rastet e caktuara abstrakte por edhe në rastet individuale/konkrete. Vendosja mbi domethënien e normave kushtetuese, në anën tjetër, lë të kuptohet që normat kushtetuese duhet të lexohen dhe zbatohen ashtu siç interpretohen nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, sipas këtij paragrafi, kushtetuta nuk mund të interpretohet sipas versionit të lirë të cilitdo institucion, por ka një mekanizëm të specializuar dhe me kompetencë ekskluzive të interpretimit të saj përfundimtar. b) vendimet e Gjykatës Kushtetuese për interpretimin e kushtetutës, sipas konceptit për interpretim të këtij paragrafi, shndërrohet në substancë të vet kushtetutës, meqë, normat kushtetuese kanë atë kuptim që Gjykata Kushtetuese i vendos sipas vendimeve të saj; c) koncepti interpretim, i vënë në këtë paragraf, nuk nënkupton një funksion fakultativ apo konsultativ sa i përket domethënies së normave kushtetuese. Në kuptim të këtij paragrafi, koncepti ‘interpretim’ shfrytëzohet për të nënkuptuar një vendim detyrues sipas së cilit të gjitha institucionet e shtetit duhet të sillen, dhe që kjo nuk lejon asnjë hapësirë për cilindo institucion që të thirret në të drejtën vetanake të interpretimit të kushtetutës.

3. Në kuptim të këtij paragrafi, Gjykata Kushtetuese nuk është interpretuesi ekskluziv i kushtetutës. Interpretimi i kushtetutës ndodh në çdo sekondë të jetës institucionale për aq kohë sa institucionet i shkarkojnë detyrimet e tyre të cilat juridikisht rrjedhin nga kjo kushtetutë. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese ka autoritet ekskluziv institucional sa i përket filtrit të fundit të interpretimit të kushtetutës. Kjo nënkupton se kur rasti shkon për interpretim në Gjykatën Kushtetuese, atëherë vendimi i kësaj të fundit bëhet përfundimtar në kuptimin institucional dhe juridik. Koncepti i interpretimit ekskluziv përfundimtar, megjithatë, nuk duhet ngatërruar me interpretimin ditor që i bëhet kushtetutës nga ana e mekanizmave të cilëve i buron kompetenca nga kjo e fundit.
4. Një çështje shumë e rëndësishme në kuptim të këtij paragrafi është nëse ekziston ndonjë mekanizëm institucional përmes së cilit vendimet mbi interpretimin përfundimtar të kushtetutës mund të *rrëzohen*? Në kuptim të sistemit të gjyqësisë kushtetuese amerikane, vendimet interpretuese të gjykatës supreme mund të rrëzohen vetëm përmes amandamentimit të kushtetutës dhe ndryshimit eksplicit të dispozitës mbi të cilën mbështetet interpretimi i gjykatës në fjalë. Një gjë e tillë ka ndodhur shumë herë në Shtetet e Bashkuara, dhe se vendimet përfundimtare të

Gjykatës Supreme mbi interpretimin e kushtetutës janë rrëzuar përmes amendamenteve kushtetuese.⁷⁷⁰ Pyetja e njëjtë shtrohet edhe sa i përket vendimeve interpretuese të kushtetutës të nxjerra nga ana e Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 112.1. Prandaj, a mund që vendimet e Gjykatës Kushtetuese të lëshuara sipas këtij paragrafi të rrëzohen përmes amendamenteve kushtetuese?

5. Çështja e parë është që Kushtetuta në nenin 144.3 dhe 4 përcakton që ndryshimet kushtetuese mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liri të përcaktuar në Kapitullin II të Kushtetutës. Neni 144.3 de 4, prandaj, bën që Kushtetuta e Kosovës të mos mund të ndryshohet nëse liritë dhe të drejtat e garantuara aty pakësohen. Neni 112.1 shikuar në ndërlidhshmëri me Nenin 144.3 dhe 4 nënkuptojnë që vendimet e Gjykatës Kushtetuese sa i përket interpretimit të cilësdo normë të Kapitullit II *nuk mund të rrëzohen me anën e amendamentit kushtetues*, nëse ky i fundit pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut të kapitullit në fjalë.⁷⁷¹ Ky përcaktim është eksplicit. Megjithatë, pyetja vazhdon nëse, përveç Kapitullit II, a mund që amendamentet kushtetuese të rrëzojnë vendime interpretuese të Gjykatës Kushtetuese? Kushtetuta nuk jep përgjigje eksplicite sa i përket kësaj çështjeje. Mendimi i përgjithshëm është që amendamentet kushtetuese mund të rrëzojnë vendime interpretuese të Gjykatës Kushtetuese nëse ato nuk janë të ndërlidhura apo nuk interferojnë në liritë dhe të drejtat e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës.
6. Në një aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, megjithatë, në mënyrë të qartë është theksuar se Kapitulli II nuk duhet të shikohet i izoluar nga Kapitulli III (“Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjestarëve të Tyre”) dhe nga Kapitulli I (“Dispozitat Themelore”), në veçanti kur është fjala për sundimin e ligjit dhe barazinë para ligjit, si dhe vlerat e parimet tjera kushtetuese. Ky qëndrim i Gjykatës Kushtetuese është rikonfirmuar disa herë. Si i tillë, ky paraqet versionin kosovar të thënë përmes interpretuesit të fundit të Kushtetutës, Gjykatës Kushtetuese, të asaj që doktrina gjermane e ka cilësuar si “unitet strukturor i kushtetutës, letrës dhe frymës së saj”.⁷⁷² Nga kjo që u tha, del hapur se amandamentet kushtetuese mund të rrëxojnë aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese vetëm nëse si të tilla nuk çenojnë dispozitat, parimet dhe vlerat kushtetuese të përmbajtura në Kapitujt I, II, dhe III të Kushtetutës së Kosovës, përkatësisht letrën, frymën dhe shpirtin e saj.

⁷⁷⁰ McClellan, James (1989) ‘Liberty, Order, and Justice: An Introduction to the Constitutional Principles of American Government’ (3rd ed.). Indianapolis: Liberty Fund: në veçanti pjesa e shtatë (7) (“Changing the Constitution - Together with an Explanation of the Amendments Added Since 1791);

⁷⁷¹ Korenica, Fisnik and Doli, Dren (2011) ‘Constitutional Rigidity in Kosovo: Significance, Outcomes, and Rationale’. *Pace International Law Review Online Companion*. at 1;

⁷⁷² Për komentet shtesë, Cf. Kommers, Donald P. (1991) ‘German Constitutionalism: A Prolegomenon’. *Emory Law Journal*. Vol. 40 (1): 837-873; Kommers, Donald P (1997) ‘The Constitutional Jurisprudence of the Federal Republic of Germany’. Second Edition. Durham and London: Duke University Press, p. 3-60;

7. Çështje shumë e rëndësishme në këtë kuptim, por në ndërlidhmëri edhe me Nenin 113, është pyetja nëse Gjykata Kushtetuese është organ brenda oborrit të pushtetit gjyqësor? Tri janë çështjet që duhen shikuar për të nxjerrë një përgjigje në këtë aspekt: a) nëse Gjykata Kushtetuese është gjykatë e shkallës së katërt, e cila vepron si instancë e mjetit juridik të ankesës ndaj një gjykate të rregullt?; b) nëse Gjykata Kushtetuese ushtron funksion ‘gjyqësor’?; dhe c) nëse Gjykata Kushtetuese ka ndonjë ndërlidhmëri strukturore me ndonjërin nga tri pushtetet shtetërore (ekzekutivin, legjislativin dhe gjyqësorin)? Përgjigjja në këtë pyetje është relativisht e thjeshtë. E para, shikuar në kuptim të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit nuk përbën gjykatë të instancës së katërt dhe as gjykatë të rregullt. Gjithashtu, në kuptim të këtij paragrafi, Gjykata Kushtetuese kryen një funksion subsidiar, atë të kontrollit kryesisht abstrakt por edhe konkret kushtetues, dhe në asnjë rast nuk është e lidhur strukturalisht me pushtetin gjyqësor apo me ndonjë pushtet tjetër. Gjykata Kushtetuese përbën një mekanizëm subsidiar të kontrollit kushtetues, e cila vendos thjeshtë dhe vetëm mbi çështje të natyrës kushtetuese, duke ia lënë organeve tjera të pushtetit sendërtimin e tyre individual. Prandaj, duhet thënë që Gjykata Kushtetuese nuk është pjesë e ‘terrenit’ të asnjë nga tre pushtetet shtetërore (duke përfshirë atë gjyqësor), nuk është gjykatë e rregullt, dhe ka pozicion mbi të tre pushtetet. Kjo do të thotë se Gjykata Kushtetuese përbën gardianin e kushtetutës i cili ushtron rolin e tij të kontrollit të kushtetutshmërisë përmes kontrollit të akteve juridike të të tri pushteteve, dhe ka pozicion institucional mbi të tri këto të fundit për aq kohë sa është në pyetje funksioni i saj.⁷⁷³ Ajo çka kanë të përbashkët Gjykata Kushtetuese dhe tri pushtetet tjera është se të gjitha së bashku janë pjesë e asaj që quhet “pushtete të krijuara” (“pouvoir constitue”), të cilat funksionojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve.
8. Në fund, funksioni i Gjykatës Kushtetuese sipas logjikës *kelzeniane*, por jo vetëm, është që të veproj si një *legjislator negativ*, duke treguar se çfarë *nuk* është kushtetuese.⁷⁷⁴ Prandaj, në parim, funksioni i Gjykatës Kushtetuese është *thjeshtë* të rrëzojë akte juridike, gjatë kontrollit kushtetues, për shkak të *kundërshtisë* së tyre me kushtetutën. Ky rol i legjislatorit negativ përfundon *thjeshtë* në momentin kur Gjykata Kushtetuese vendos se *çfarë nuk është* kushtetuese. Megjithatë, me rolin në rritje të gjyqësisë kushtetuese, ekziston një tendencë që gjykatat

⁷⁷³ Pozita kushtetuese e Gjykatës Kushtetuese është shumë e njëjtë me pothuajse shumicën e modeleve Evropiane. Shih për karakteristikat themelore të modelit Evropian, në: Schwartz, Herman (1998) ‘Eastern Europe’s Constitutional Courts’. *Journal of Democracy*. Vol. 9 (4): p. 100-114; Comella, F. Victor (2004) ‘The European model of constitutional review of legislation: Toward decentralization?’. *International Journal of Constitutional Law*. Vol. 2 (3): p. 461-491; Shih gjithashtu: Lopez Guerra, Luis (1994) ‘The Role and Competences of the Constitutional Court’, in *THE ROLE OF THE CONSTITUTIONAL COURT IN THE CONSOLIDATION OF THE RULE OF LAW*, European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), UniDem Seminar Bucharest, 8-10 June 1994, CDL - STD (1994) 010, available at [http://www.venice.coe.int/docs/1994/CDLSTD\(1994\)010.e.asp](http://www.venice.coe.int/docs/1994/CDLSTD(1994)010.e.asp);

⁷⁷⁴ Shih origjinën e idesë së tillë: Kelsen, H (1945) ‘General Theory of Law and State’. Cambridge, MA: Harvard University Press, p. 268/269; Shih gjithashtu: Bustamante, Thomas & Bustamante, Evanilda de Godoi (2010) ‘Constitutional Courts as “negative Legislators”: The Brazilian Case’. *Revista Jurídica Piélagus*, pp. 137-156;

kushtetuese të shndërrohen edhe në *legjislator pozitiv*, ku Gjykata nuk kufizohet vetëm me vendosjen mbi atë se çfarë *nuk është* kushtetuese por vendos edhe mbi atë se *çfarë është* (duhet të jetë) kushtetuese,⁷⁷⁵ duke ndërtuar norma të reja dhe *faktike* kushtetuese përmes interpretimeve të saj. Gjykata në fakt mund të hyjë në këtë terren për aq kohë sa është *bindshëm* e nevojshme për të ruajtur të drejtat dhe liritë e njeriut. Ky trend i gjykatave kushtetuese si legjislator pozitiv është në fakt i inspiruar edhe nga GjEDNj, e cila në shumë raste jep versione vendimesh si legjislator pozitiv, sikur në rastet *Assenov and Others v. Bulgaria*, *Osman v. the United Kingdom*, *McCann and Others v. the United Kingdom*, etj.⁷⁷⁶ Për të përcaktuar nëse Gjykata mund të dalë në terrenin e *legjislatorit pozitiv*, GjEDNj ka përcaktuar disa kushte që duhen plotësuar fillimisht: një, që duhet pasur kujdes ndaj një bilanci të qartë në mes të interesit të komunitetit/publikut dhe të drejtës së individit, dy, gjerësia e obligimit pozitiv që vendos gjykata mund të ndryshojë, varësisht nga kontrolli që kërkohet në kuptim të prioriteteve dhe rrethanave në rastin konkret, dhe tre, obligimi i tillë pozitiv nuk duhet ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përbëjë një detyrim të pamundur ose një *rëndesë* disproporcionale për autoritetin publik mbi të cilin vendoset për autoritetin publik mbi të cilin vendoset (GjEDNj, p.sh. në: *Osman v. the United Kingdom* dhe *Rees v. the United Kingdom*).⁷⁷⁷ Në kryerjen e rolit të saj si legjislator pozitiv, prandaj, Gjykata Kushtetuese është e kufizuar me këto standarde të GjEDNj-së, duke pasur në konsideratë që funksioni origjinal i Gjykatës është *vetëm* i një legjislatori negativ.

Neni 112.2

1. Ky paragraf përcakton që Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kuptimin organizativ dhe funksional. Parimet e pavarësisë/paanshmërisë, të komentuar në pjesën mbi pushtetin gjyqësor, në këtë koment, përbëjnë standardet e njëjta që duhen ndjekur edhe në komentimin e këtij paragrafi. Prandaj, ne nuk bëjmë ndonjë komentim të mëtejshëm në këtë pjesë. E vetmja çështje që duhet konsideruar si e veçantë nga pjesa e komentimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor është çështja e detyrimit të gjyqtarëve për të *ndjekur ligjin* duke mos e *bishtnuar atë* gjatë kryerjes së funksionit gjyqësor. Meqë funksioni i gjyqtarëve kushtetues është i ndryshëm prej gjyqtarëve të rregullt, ky element i pavarësisë së gjyqtarëve dhe i normimit të detyrimit të tyre vetëm përballë ligjit ka një dallim thelbësor. Duke marrë parasysh që funksioni bazik i gjyqtarëve kushtetues është kontrolli dhe vlerësimi i kushtetutshmërisë së ligjeve, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre ata nuk i nënshtrohen detyrimit që të *ndjekin ligjin* për interpretimin e

⁷⁷⁵ Shih: SMITH, Eivind (2010) ‘Constitutional Courts As “Positive Legislators”’. Paper presented at the: International Academy Of Comparative Law. XVIII International Congress of Comparative law. Washington, D.C., July 25-31, 2010;

⁷⁷⁶ GjEDNj, *McCann and Others v. the United Kingdom*, § 161; GjEDNj, *Osman v. the United Kingdom*, §§ 115-117; ose GjEDNj, *Assenov and Others v. Bulgaria*, §102); Për një trajtim të gjatë krahasues të gjykatave kushtetuese si “legjislator pozitiv”, Cf. Allan R. Brewer-Carias, *Constitutional Courts As Positive Legislators. A Comparative Law Study* (Cambridge University Press: Cambridge, 2011).

⁷⁷⁷ GjEDNj, *Osman v. the United Kingdom*, §§ 115-117 dhe *Rees v. the United Kingdom*, § 37.

kushtetutës. Në ushtrimin e funksionit të tyre të kontrollit kushtetues, gjyqtarët kushtetues, funksionalisht, nuk i nënshtrohen përcaktimit të ligjit, por i vlerësojnë këtë të fundit kushtetutshmërinë. Andaj, gjyqtarët kushtetues, në kuptim të paanshmërisë/pavarësisë së tyre individuale, nuk janë të përgjegjshëm “përballë ligjit” në ushtrimin e funksionit të tyre të kontrollit kushtetues, por vetëm përballë kushtetutës. Funksioni i tyre natyral është të vendosin mbi përjashtimin ose jo të ligjit në kuptim të kushtetutshmërisë së tij. Kjo nuk duhet nënkuptuar që gjyqtarët kushtetues nuk i nënshtrohen ligjit jashtë funksionit të tyre kushtetues. Kjo është një çështje që vetëkuptohet në çdo sistem që bazohet në standardet dhe normat e konstitucionalizmit modern perëndimor ku askush nuk është mbi kushtetutën e ligjet.

2. Në vijim, për sa u tha më sipër, pra në kuptim të instrumentit primar mbi të cilin mbështete juridiksioni kushtetues, ekzistojnë dy përjashtime. I pari ka të bëjë me faktin se në çështjet procedurale dhe organizative, Gjykata Kushtetuese është e lidhur me Ligjin 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 16 dhjetor 2008. Sipas nenit 16.2 të këtij Ligji, Gjykata zbaton edhe ligjet tjera procedurale të Republikës së Kosovës në mënyrë të përshtatshme, për aq sa lejon natyra e çështjes dhe veçoritë e procedurës para gjykatës Kushtetuese. Nga kjo dispozitë dalin tri përfundime. E para, kur ka zbrastësira juridike në Ligj mund të vij deri te zbatimi i ligjeve procedurale penale, civile dhe administrative. E dyta, ky zbatim eventual i dispozitave të ligjeve procedurale në fjalë duhet të mos jetë në kundërshtim me natyrën e çështjes, dhe, tre, ky zbatim duhet të jetë i mundur dhe nuk guxon të lëndojë premisat themelore të procedurës pranë Gjykatës Kushtetuese.
3. Sa i përket përjashtimit të dytë, vlen të theksohet se ai ka të bëjë me rastet kur në një rast individual Gjykata gjen se vetë ligji, qoftë për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit apo për shkak të zbatimit të ligjit të gabuar, është shkaktar imediat i cënimit të të drejtave dhe lirive individuale. Pra, këtu fjala është për procedurat e kërkesave individuale nga neni 113.7, me kusht që analizimi dhe marrja parasysh e ligjit, i cili nga Gjykata vlerësohet si shkaktar i cënimit të të drejtave e lirive individuale, ndodhë në kuadër të procedurave sipas kërkesave individuale. Një situatë e tillë është e mundur sepse modeli kosovar i gjyqësisë kushtetuese në pikat kyçe modelohet sipas atij gjerman ku kërkesat individuale i referohen çështjeve faktike, me kusht që ekziston një kontekst individual.⁷⁷⁸

⁷⁷⁸ Dorsen, Norman, Rosenfeld, Michel, Sajo, Andras, and Baer, Susanne (2003) (eds.), ‘Comparative Constitutionalism. Cases and Materials’. West Group: St. Paul, MN, p. 127. Për procedurat individuale do të flasim më shumë në vijim.

Neni 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara]

- (1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
- (2) Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria dhe Avokati i Popullit janë të autorizuar të ngrenë rastet në vijim:
 1. çështjen e përputhshmërisë së ligjeve, të dekreteve të Presidentit e të Kryeministrit dhe të rregulloreve të Qeverisë, me Kushtetutën;
 2. përputhshmëria e Statutit të Komunës me Kushtetutën.
- (3) Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Qeveria janë të autorizuar të ngrenë çështjet në vijim:
 1. konflikti në mes të kompetencave kushtetuese të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës;
 2. përputhshmëria e referendumit të propozuar me Kushtetutën;
 3. përputhshmëria e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme me Kushtetutën;
 4. përputhshmëria e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute dhe rishikimi i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur;
 5. nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit.
- (4) Komuna është e autorizuar të kontestojë kushtetutshmërinë e ligjeve ose të akteve të Qeverisë, të cilat cenojnë përgjegjësitë komunale ose zvogëlojnë të hyrat e komunës, në rast se komuna përkatëse është prekur nga ai ligj ose akt.
- (5) Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.
- (6) Tridhjetë (30) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, janë të autorizuar të ngrenë çështjen nëse Presidenti i Republikës së Kosovës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës.
- (7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
- (8) Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.
- (9) Kryetari i Kuvendit të Kosovës duhet të referojë amendamentet kushtetuese të propozuara para miratimit në Kuvend, me qëllim që të konsta-

tohet nëse amendamenti i propozuar I zvogëlon të drejtat dhe liritë e garantuara me kapitullin II të Kushtetutës.

(10) Jurisdiksioni shtesë mund të rregullohet me ligj.

Neni 113

1. Neni 113, përcakton parimet themelore të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, burimin dhe kufijtë e juridiksionit të saj, dhe palët proceduralisht të autorizuar për të ngritur çështje përpara saj. Neni 113, prandaj, është baza mbi të cilën Gjykata Kushtetuese e ushtron juridiksionin e saj të specializuar, megjithëse neni 112 e bën përcaktimin e funksionit të saj të përgjithshëm. Shikuar në këtë kontekst, neni 113 është përcaktori kushtetues i detajuar i juridiksionit të Gjykatës, megjithëse i njëjti nen lejon që juridiksioni shtesë për Gjykatën mund të përcaktohet me ligj. Në kuptim të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, tri çështje janë thellësisht të rëndësishme: një, lloji i kontrollit kushtetues që Gjykata mund të ushtrojë, duke përfshirë edhe kufijtë e tij; dy, aktorët të cilët mund dhe lejohet të iniciojnë procedurën e kontrollit kushtetues para Gjykatës, dhe, tre, natyra e vendimeve që nxjerr Gjykata në kuptim të ushtrimit të juridiksioneve të specializuara.

Neni 113.1

1. Neni 113.1 përcakton që Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para saj në mënyrë ligjore dhe nga pala e autorizuar. Ky paragraf është përcaktor i faktit që konkretizimi i juridiksionit të përcaktuar në këtë nen bëhet nga ana e një ligji, i cili në fakt do të jetë baza mbi të cilën bëhet vlerësimi i rregullsisë procedurale të çështjeve të ngritura përballë Gjykatës. Nenet mbi Gjykatën Kushtetuese nuk e veshin atë me asnjë juridiksion i cili mund të iniciohej *ex officio*, por vetëm mbi bazën e kërkesës së palëve tjera, dhe kjo qëndron në linjë me standardet e Komisionit të Venedikut.⁷⁷⁹ Ky paragraf, në anën tjetër, përcakton detyrimin që Gjykata Kushtetuese *duhet* të vendos vetëm mbi çështjet të cilat plotësojnë kushtet procedurale të përcaktuara me Ligjin mbi Gjykatën Kushtetuese, me kusht që të jenë ngritur nga palët e autorizuar, sipas nenit 113 (2-3) të Kushtetutës. Në këtë mënyrë, Neni 113.1 është përcaktor i një detyrimi pozitiv për Gjykatën sa i përket rregullsisë procedurale të procedimit të çështjeve, duke i dhënë fuqi një ligji të nxjerrë nga parlamenti që të konkretizojë procedurat e ushtrimit të juridiksionit të përcaktuar me këtë nen. Nga kjo del se juridiksioni i Gjykatës mund të përcaktohet edhe me ligj, përveç më dispozitat kushtetuese, por jo edhe palët e autorizuar. Palët e autorizuar janë vetëm ato të përcaktuara nga neni 113 (2-8), kurse procedurat e ushtrimit të juridiksionit kushtetues përcaktohen përveç me Kushtetutë, edhe me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese.

⁷⁷⁹ Opinion on the Draft Law on the Constitutional Court of Montenegro, European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Opinion no. 479/2008, 24 October 2008, CDL-AD (2008) 030;

1. Neni 113.2 përcakton juridiksionin kryesisht abstrakt të Gjykatës Kushtetuese sa i përket kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve,⁷⁸⁰ statutit të komunës, dekreteve të presidentit dhe kryeministrit dhe të rregulloreve të qeverisë. Në kuptim të nenit 113.2, ekzistojnë katër subjekte të autorizuar për të ngritur para Gjykatës Kushtetuese çështjen e kushtetutshmërisë së ligjeve, statutit të komunës, dekreteve të presidentit dhe të kryeministrit dhe rregulloreve të qeverisë, që janë: Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës, Qeveria dhe Avokati i Popullit.
2. Çështja e parë që duhet konsideruar është numri dhe aktorët që mund të bëjnë ngritjen çështjeve për kontroll kushtetues kryesisht abstrakt para Gjykatës Kushtetuese. Në rend të parë, ky paragraf nuk lejon hapësirë, apo nuk përcakton autorizim, që personat (fizik apo juridik) të mund të iniciojnë procedurën e kontrollit abstrakt para Gjykatës Kushtetuese. Me fjalë të tjera, *actio popularis* nuk lejohet sipas paragrafit të tillë, që nënkupton se personat nuk mund të iniciojnë para Gjykatës Kushtetuese çështje të kontrollit kushtetues abstrakt. Në anën tjetër, paragrafi i tillë *nuk* vendos kurrfarë kushti për katër subjektet e autorizuar për të ngritur çështjen e kontrollit kushtetues para Gjykatës në kuadër të juridiksionit të përcaktuar me këtë paragraf. Kjo do të thotë se paragrafi në fjalë *nuk* kërkon që institucionet e përmendura të *kenë* interes direkt në çështjen që mund ta ngrinin para Gjykatës, apo edhe që të plotësojnë ndonjë kusht tjetër. Në këtë kuptim, katër subjektet e autorizuar janë plotësisht të lira që të procedojnë kurdoherë çështje para Gjykatës brenda juridiksionit të tillë, pa pasur nevojë të plotësojnë ndonjë kusht specifik.
3. Sa i përket të autorizuarit të parë, Kuvendit të Kosovës, ky paragraf lë të kuptohet Kuvendi sipas procedurës së saj të brendshme, me shumicë votash, mund të iniciojë para Gjykatës kontrollin kushtetues të ligjeve,⁷⁸¹ statutit të komunës, dekreteve të presidentit dhe kryeministrit dhe rregulloreve të Qeverisë. Megjithatë, kjo nuk është çdo herë kështu. Në fakt, kjo edhe mund të ndodhë kështu, por me pak gjasa mund ndodhë që Kuvendi me shumicë votash të vendos për shfuqizimin e ligjeve të veta. Përjashtim bëjnë dekretet e Presidentit, të Kryeministrit,

⁷⁸⁰ Kontrolli abstrakt kundërshtojë fuqishëm në Letrat e Federalistit, meqë shihej si mundësi e kundërbalancimit të vullnetit popullor. Shih: Corwin, Edward S. (1934) 'The Twilight of the Supreme Court - A History of Our Constitutional Theory'. New Haven: Yale University Press; Në rastin e Kroacisë, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se nuk ka juridiksion të vlerësojë përputhshmërinë e akteve 'ordinare' dhe organike me aktet kushtetuese nëse këto akte janë 'kushtetuese' vetëm në emër, dhe nuk janë nxjerrë në përputhje me procedurat e përcaktuara për ndryshimin e Kushtetutës. Prandaj për nga natyra e tyre juridike dhe përmbajtja nuk mund të konsiderohen akte kushtetuese me fuqi të Kushtetutës. (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-I-3760/2007 et al, i datës 08.12.2010);

⁷⁸¹ Si shembull, në Brazil, Gjykata hodhi poshtë një kërkesë duke theksuar se efekti *erga omnes* i konrollit gjyqësor nuk e obligon edhe pushtetin legjislativ; i obligon vetëm ekzekutivin dhe gjyqësorin. Legjislativi është i lirë të nxjerrë akte legjislative me përmbajtje të ngjashme me cilindo ligj që mund të jetë shpallur jo-kushtetues nga Gjykata Supreme (Vendim i Gjykatës Federale Supreme të Brazilit, Nr. 2617 i datës 23.2.2005);

rregulloret e Qeverisë dhe Statuti i Komunës. Në këto raste mund të ndodhë që Kuvendi të vendos me shumicë votash. Kjo këtu nuk ka rëndësi sepse Ligji mbi Gjykatën Kushtetuese ka zgjedhur këtë dilemë në frymën e standardeve të zbatuara në vendet tjera ish komuniste të cilat tani janë demokraci kushtetuese. Ky Ligj në nenin 29.1 flet për një të katërtën (1/4) e deputetëve si palë në këtë procedurë. Kjo bëhet pikërisht sipas standardeve të demokracive kushtetuese të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e pakicave parlamentare nga tirania e shumicës.

4. Në pozicionin e tij si palë e autorizuar për të iniciuar kontrollin e kushtetutshmërisë për këto akte juridike, Kuvendi është i kufizuar me kohë: Kuvendi mund ta ushtroj këtë të drejtë brenda periudhës kohore prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar (neni 30 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese). Autorizimi për Kuvendin si iniciues i procedurës së kontrollit kushtetues, sipas këtij paragrafi, nuk duhet shikuar në ndërlidhmëri me procedurën e përcaktuar me nenin 113.3, meqë ky i fundit përbën procedurë tjetër të të veçantë që dallon nga ajo e përcaktuar në nenin 113.2. Në literaturë, procedurat që zhvillohen sipas nenit 113.2 të Kushtetutës cilësohen si procedura që kanë për qëllim mbrojtjen e kushtetutës për dallim nga procedurat tjera që zhvillohen sipas kërkesave individuale dhe që kanë për qëllim interpretimin e kushtetutës.⁷⁸²
5. Është e rëndësishme të argumentohet që pozita e Kuvendit si palë e autorizuar për të ngritur çështjen e kontrollit kushtetues të ligjeve, pavarësisht që mund të duket e palogjikshme për aq kohë sa Kuvendi mund ta shfuqizojë me shumicë votash cilindo ligj, ka një bazë racionale mbi të cilën sendërtohet. E para, nuk përjashtohet mundësia që Kuvendi mund ta shikojë si më të udhës kërkimin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së një ligji nga ana e Gjykatës Kushtetuese, e jo ta bëjë këtë me anën e vendimit të saj për shfuqizim, në kohën kur Kushtetuta ia përcakton Gjykatës kompetencës e shërbimit profesional të mbrojtjes së kushtetutshmërisë, dhe, e dyta, pavarësisht që një shumicë parlamentare e cila mund ta ngrit çështjen e kontrollit kushtetues të ligjeve para Gjykatës mundet në anën tjetër e *vetme* ta shfuqizojë ligjin nëse e konsideron si kundërkushtetues, rasti i tillë mund të mos ndodh kur bëhet fjalë për ligjet e interesit vital politik në kohën dhe hapësirën e dhënë. Në këtë rast, pakicat e Kuvendit nuk do të mund të ishin në gjendje që, edhe për shkak që ligji mund të duket kundërkushtetues, ta shfuqizojnë atë, prandaj, rruga e iniciimit të kontrollit kushtetues të saj përmes Gjykatës do të ishte e vetmja mënyrë që të tejkalonte vullnetin e *shumicës* për të shfuqizuar ligjin në fjalë. Në anën tjetër, autorizimi i Kuvendit që të kërkojë kontrollin e kushtetutshmërisë së dekreteve të presidentit, kryeministrit, statutit të komunës por edhe rregulloreve të Qeverisë i shërben konceptit që Kuvendi të mund të prodhojë përmes aktivitetit të saj një procedurë përmes së cilës e kundërbalancojnë një akt jo-kushtetues të tre institucioneve tjera. Por, kjo vlenë edhe për vlerësimin e kushtetutshmërisë së prodhimeve të Kuvendit nga ana e Qeverisë, Presidentit dhe Avokatit të Popullit.

⁷⁸² Cf. Guerra, Luis Lopez (1994) 'The Role and Competences of the Constitutional Court'. The European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *The role of the constitutional courts in the consolidation of the rule of law. UniDem Seminar, Bucharest on 8-10 June 1994*. Strasbourg: Council of Europe Press, p. 20-23;

6. Sa i përket të autorizuarit të dytë, Qeverisë, ky paragraf lë të kuptohet që kjo e fundit - si një organ kolektiv, duke vendosur me një shumicë votash - mund të inicioj kontrollin kushtetues para Gjykatës Kushtetuese. Duke e shfrytëzuar këtë të drejtë, Qeveria mund të kontestojë kushtetutshmërinë e një ligji të Kuvendit si mënyrë e kundërbalancimit të tij përmes inicimit të kontrollit të aktit të saj. Qeveria është e autorizuar ta bëjë të njëjtën iniciativë edhe përballë statutit të një komune, apo dekreti të presidentit të republikës apo kryeministrit. Pyetje bazike në këtë rast mund të jetë se ku është logjika prapa autorizimit të Qeverisë që të kërkojë kontrollin e një dekreti të kryeministrit, për aq kohë sa ky i fundit është vet shefi i Qeverisë? Logjika pas këtij autorizimi lidhet me faktin që një kryeministër, megjithatë, në kuadër të një qeverie koalicioni mund të mos e ketë në dorë kontrollin e Qeverisë, prandaj, nën këtë autorizim, një shumicë votash e Qeverisë në fakt mund ta sjellin një dekret të kryeministrit para Gjykatës Kushtetuese për kontroll kushtetues.
7. Sa i përket të autorizuarit të tretë, paragrafi e autorizon në mënyrë eksplicite presidentin e republikës që të kërkojë kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve përkatëse para Gjykatës Kushtetuese. Edhe në këtë rast, autorizimi i dhënë për presidentin e republikës i shërben konceptit të ndarjes së pushteteve dhe kundërbalancimit të tyre, meqë e drejta e presidentit në iniciativë në këtë rast shihet si rrugë përmes së cilës presidenti e ushtron rolin e tij kundërbalancues ndaj pushteteve tjera.
8. Sa i përket të autorizuarit të katërt, ky paragraf e autorizon Avokatin e Popullit që të ketë të drejtën e iniciativës në kërkesën për kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve përkatëse. Duhet thënë që, prej të gjithë aktorëve në kuadër të këtij paragrafi, vetëm Avokati i Popullit është aktori institucional jo-politik dhe i pavarur që është i veshur me të drejtën e iniciativës për kontroll të kushtetutshmërisë së akteve përkatëse. Logjika prapa kësaj formule është që një aktor institucional i pavarur, misioni i të cilit është mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut, të ketë legjitimitetin procedural për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve përkatëse përpara Gjykatës Kushtetuese. Shikuar në kuptimin e një *actio popularis*, që ky paragraf e ndalon praktikisht, iniciativa që mund të ngrejë Avokati i Popullit është megjithatë një rrugë përmes së cilës ky i fundit mund të shpreh një brengë qytetare përgjatë ushtrimit të së drejtës së tij. Prandaj, iniciativa që bart Avokati i Popullit duhet shikuar edhe nga këndi i mundësisë që ky i fundit, duke kanalizuar kërkesat individuale qytetare, të inicioj kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve përkatëse sipas iniciativës së tij në kuptim të këtij paragrafi. Modeli i ngjashëm me modelin kosovar ekziston edhe në vendet tjera, sikurse ta zëmë, në Portugali, ku organet jopolitike mund të paraqiten si palë në procedurë.⁷⁸³
9. Për fund, sa i përket të autorizuarve sipas këtij paragrafi, është e rëndësishme të thuhet që *actio popularis* nuk gjen shprehje në kushtetutën e vendit, dhe se

⁷⁸³ Cf. Belletti, Michele (2009) 'Il sistema di giustizia costituzionale portoghese'. Nw Luca Mezzetti (ed.), *Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale*. Padova: CEDAM, p. 267-29;

kontestimi direkt nga ana e personave i një akti abstrakt nuk është i mundur (ekziston një model i gjysmë-actio-popularis që është shfrytëzuar nga Gjykata Kushtetuese, dhe që komentohet në pjesën e mëposhtme). Në anën tjetër, në kuptim të këtij paragrafi, iniciativa për ngritjen e kontrollit të kushtetutshmërisë është thjeshtë monopol i institucioneve shtetërore. Edhe në kuptim të kësaj, ky monopol përfshin thjeshtë një rreth shumë të ngushtë institucionesh, tre prej të cilave janë aktorë politikë institucional, përderisa vetëm njëri nga ta është aktor institucional i pavarur dhe jo-politik. Në anën tjetër, ky paragraf nuk lejon hapësirë as për iniciativa qytetare (si kolektive ashtu edhe individuale) për kontroll të kushtetutshmërisë së akteve përkatëse. Shikuar si tërësi, e drejta e ngritjes së iniciativës për kontroll të kushtetutshmërisë së ligjeve, statutit të komunës, dekretive të presidentit dhe kryeministrit, dhe të rregulloreve të Qeverisë është pothuajse instrument thjeshtë i vënë në kuptim të sendërtimit të kontrollit të ndërvarur që secila nga këto institucione i bëjnë tjetrës. E vënë në kontekstin teorik, kjo ngushtësi institucionale përmes së cilës mund të rrjedh iniciativa për kontroll të kushtetutshmërisë së këtyre akteve lejon mundësinë që Gjykata Kushtetuese të mos jetë objekt i kërkesave të tepërta për kontroll abstrakt, dhe që roli i saj subsidiar të jetë i disejnuar më fuqishëm.

10. Përveç palëve të autorizuar sa i përket këtij paragrafi, i rëndësishëm për konsideratë është edhe çështja e llojit të akteve që mund t'i shtrohen kontrollit të kushtetutshmërisë sipas këtij paragrafi. Sipas këtij paragrafi, fillimisht, Gjykata Kushtetuese vishet me autoritetin e kontrollit vetëm të kushtetutshmërisë, duke qëndruar në kufijt tipik të një juridiksioni kushtetues kelzenian. Në anën tjetër, aktet juridike që mund t'i nënshtrohen kontrollit të kushtetutshmërisë janë: ligjet, dekretet e presidentit dhe kryeministrit, rregulloret e Qeverisë dhe statutet e komunave. Sa i përket kategorisë së akteve juridike të formës së ligjit, Gjykata ushtron kontrollin e përputhshmërisë abstrakte të aktit ligjor me kushtetutën, që është në fakt juridiksioni që përbën *raison d'être* për vet Gjykatën Kushtetuese.⁷⁸⁴ Ky kontroll, në kuptim të këtij paragrafi, është i tipit klasik *represiv*, që nënkupton se ai mund të ushtrohet vetëm pasi që të jetë nxjerrur ligji.⁷⁸⁵
11. Sa i përket dekretit të presidentit të republikës, këtu Gjykata vishet me të drejtën e ushtrimit të kontrollit të një akti juridik individual, meqë dekreti në parim është akt juridik që zgjidh një situatë individuale. Në këtë aspekt, këtu Gjykata bën kontrollin e aktit ekzekutiv (i formës së dekretit) të presidentit të republikës, duke ushtruar në fakt një lloj të kontrollit individual/konkret. I njëjti koment mund të jepet edhe sa i përket kryeministrit. Logjikisht, koncepti 'dekret' i shfrytëzuar në

⁷⁸⁴ Lopez Guerra, Luis (1994) 'The Role and Competences of the Constitutional Court, in The Role Of The Constitutional Court In The Consolidation Of The Rule Of Law'. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), UniDem Seminar Bucharest, 8-10 June 1994, CDLSTD (1994) 010, available at [http://www.venice.coe.int/docs/1994/CDLSTD\(1994\)010 - e.asp](http://www.venice.coe.int/docs/1994/CDLSTD(1994)010 - e.asp);

⁷⁸⁵ Shih më shumë mbi kontrollin represiv, në: Helmut Steinberger, Models of Constitutional Jurisdiction, European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), 1993, CDL - STD (1993) 002;

kuptim të këtij paragrafi i referohet çdo akti juridik individual përmes së cilit presidenti i republikës apo kryeministri e ushtrojnë një të drejtë kushtetuese. Në këtë rast, koncepti ‘dekret’ përfshin të gjithë listën e akteve juridike individuale që nxjerrin të dy institucionet shtetërore, pavarësisht se si i vihet emri formal aktit të tillë nga ana e institucionit përkatës. I njëjti problem paraqitet në rastin e konceptit ‘rregullore’ të shfrytëzuar nga ky paragraf i kushtetutës. Pyetja që shtrohet këtu është: a përfshin ky juridiksion thjeshtë dhe vetëm aktet juridike të formës së rregullores, apo çdo akt juridik të përgjithshëm që nxjerr Qeveria? Shikuar në aspektin logjik, nuk ka arsye që Gjykata të ketë juridiksion të ushtrojë kontrollin e kushtetutshmërisë së dekreteve të kryeministrit, dhe të jetë e kufizuar vetëm në kontrollin e kushtetutshmërisë së akteve juridike qeveritare të formës së rregullores. Prandaj, shikuar në këtë aspekt, koncepti ‘rregullore’ i shfrytëzuar nga ky paragraf nënkupton të gjitha aktet juridike të Qeverisë që kanë substancë abstrakte (udhëzimet, direktivat, etj.).⁷⁸⁶ Praktikisht, prandaj, ky paragraf bën që çdo akt juridik i përgjithshëm që buron nga autoriteti i Qeverisë, dhe çdo akt juridik individual që buron nga autoriteti i kryeministrit, hyn në listën e akteve juridike që i nënshtrohen kontrollit kushtetues sipas juridiksionit të këtij paragrafi.

12. I rëndësishëm është edhe komentimi i logjikës prapa juridiksionit të Gjykatës që të kontrollojë kushtetutshmërinë e statuteve të komunës. Në këtë aspekt, argumenti është që komunat janë të veshura me autoritet të bartur sipas kushtetutës, limitet e të cilit janë shumë qartë të përcaktuara, dhe tejkalimi i tyre përbën shkelje të unitetit/karakterit unitar të Republikës së Kosovës. Prandaj, kontrolli i kushtetutshmërisë së statuteve të komunave, në rastet kur konsiderohet që ato përbëjnë tendencë për të tejkaluar parimet e vetëqeverisjes lokale apo për të përvetësuar autoritet qendror, apo thjeshtë për të cenuar natyrën unitare të shtetit, arsyetohet me detyrimin e ruajtjes së kufijve kushtetues të vetëqeverisjes lokale dhe integritetit e unitetit territorial dhe administrativ të shtetit. Në anën tjetër, ruajtja e të drejtave për vetëqeverisje lokale të komunave nga uzurpimi i organeve qendrore është gjithashtu i mbrojtur në kuptim të juridiksionit të Gjykatës, por që komentohet në kuadër të një neni të mëposhtëm të kushtetutës.

Neni 113.3

1. Neni 113.3 përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese sa i përket kontrollit kushtetues të konfliktit të kompetencave kushtetuese në mes të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës dhe Qeverisë, kontrollit kushtetues të referendumit të propozuar, kontrollit kushtetues të Gjendjes së Jashtëzakonshme, kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese sa i përket përputhshmërisë së tyre me marrëveshjet ndërkombëtare, dhe kontrollit kushtetues të zgjedhjeve të Kuvendit. Në përgjithësi, neni 113.3 përbën një hapësirë mjaft të gjerë juridiksionale të Gjykatës Kushtetuese, e cila, në kuptim të këtij paragrafi, prek shumë çështje të rëndësishme.

⁷⁸⁶ Shih p.sh.: Doli, Dren & Korenica, Fisnik (2010) ‘Kosovar Constitutional Court’s Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses’. *German Law Journal*. Vol. 11: 803-836, në internet: <http://www.germanlawjournal.com/index.php?pageID=11&artID=1268>;

2. Në kuptim të nenit 113.3, vetëm tre aktorë institucional janë të autorizuar që të iniciojnë çështje para Gjykatës Kushtetuese, këta janë: Kuvendi i Kosovës, Presidenti i Republikës dhe Qeveria. Për të komentuar pozitën e secilës palë të autorizuar, për secilin juridiksion të specializuar që rrjedh nga ky nen, këtë e bëjmë në kuadër të komentimit të secilit juridiksion specifik si më poshtë.

Neni 113.3 (1)

1. Në kuptim të Nenit 113.3 (1), Gjykata Kushtetuese është e autorizuar që të zgjidh konfliktin e kompetencave kushtetuese në mes të Kuvendit të Kosovës, Presidentit të Republikës dhe Qeverisë, sipas kërkesës së njërit nga ta. Në kuptim të këtij juridiksioni, rrethi i institucioneve që mund të kërkojnë zgjidhje të kompetencave në Gjykatën Kushtetuese është relativisht i ngushtë, dhe përfshin vetëm institucionet politike të shtetit, që në njëfarë mënyrë përbën një mekanizëm për kontrollim të balancit kushtetues të pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv, si dhe të shefit të shtetit. Në këtë kuptim, ky juridiksion i jep autoritet Gjykatës Kushtetuese që të ruaj balancin kushtetues në aspektin real të kufijve të autoritetit të secilit nga institucionet e mësipërme, duke garantuar kështu që logjika kushtetuese mbi ndarjen e pushtetit dhe kundërbalancimin e ndërvarur kontrollohet dhe garantohet nga një mekanizëm i gjyqësisë kushtetuese. Sa i përket logjikës prapa këtij juridiksioni, duhet thënë që shpeshherë përcaktimet kushtetuese mbi kompetencat e institucioneve shtetërore tejkalohen apo ndryshohen *faktikisht* nga prerogativat që institucionet përkatëse i veshin vetes, bazuar edhe në fuqinë faktike që ato mund të gëzojnë. Prandaj, ky juridiksion special vendos garancionin që prerogativat e veshura nga njëri prej tri institucioneve në mënyrë kundërkushtetuese të mund të rrëzohen nga gjyqësia kushtetuese, dhe që fuqia faktike e njërit institucion të mos jetë hapësirë për ‘okupim’ të kompetencave kushtetuese të institucionit tjetër. Duhet thënë që koncepti ‘kompetencë’ i shfrytëzuar në këtë paragraf i referohet jo thjeshtë konfliktit pozitiv të kompetencës por edhe konfliktit negativ për kompetencë në mes të tri institucioneve. Gjithashtu, është e rëndësishme të thuhet që ky juridiksion i Gjykatës, përfshin vetëm zgjidhjen e konfliktit për kompetencat *kushtetuese*, duke mos hyrë në kompetencat që mund të jenë përcaktuar me anë të ligjit apo akteve tjera juridike. Shikuar në këtë kontekst, Kuvendi, realisht sipas këtij juridiksioni, nuk mundet që duke shfrytëzuar funksionin e tij legjislativ t’ia okupoj një kompetencë Presidentit të Republikës apo Qeverisë, apo edhe që ta shfrytëzojë funksionin e tij legjislativ duke hyrë në kufijtë e autoritetit të dy institucioneve tjera. Thënë në përgjithësi, prandaj, ky juridiksion parandalon mundësinë që të ketë një hapësirë ‘luftë’ për kompetenca në mes të tri institucioneve, meqë ky juridiksion i Gjykatës e përcakton mënyrën e zgjidhjes së tyre.

Neni 113.3 (2)

1. Neni 113.3 (2) përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me kontrollin e kushtetutshmërisë së referendumit të propozuar. Është e rëndësishme të thuhet që në kuptim të modelit *konsociacional* (“*consociational*”) të

demokracisë që vendos kushtetuta, kontrolli kushtetues i referendumit është pikë shumë thelbësore në ruajtjen e këtij modeli të demokracisë.⁷⁸⁷ Në ushtrimin e këtij juridiksioni, Gjykata Kushtetuese duhet që të marrë në konsideratë dy çështje: një, nëse referendumi është shpallur sipas nenit 65 të kushtetutës, dhe nga ana e organit të autorizuar; dhe dy, nëse referendumi është në linjë me ndalesën e nenit 81.2, ku ndalohet që ligjet vitale të nxjerren në referendum. Në kuptim të këtij juridiksioni, çështja e dytë është pika më e rëndësishme meqë shpallja e referendumit, sipas nenit 81.2, është e ndaluar për ligjet *vitale*, të përcaktuara sipas nenit 81.1. Ky kontroll kushtetues, prandaj, është një mekanizëm që i mbron *ligjet vitale*, që janë karakteristika themelore të modelit *konsociacional* (“*consociational*”) të demokracisë në sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës, prej votës së shumicës së popullit. Duhet thënë që *ligjet vitale* janë ligje të tilla që kërkojnë votimin e dyfishtë në Kuvend për ndryshimin, miratimin apo shfyqizimin e tyre, meqë substanca e tyre është qenësore për pozitën e komuniteteve etnike në sistemin kushtetues/shtetëror të Kosovës. Në kuptim të këtij juridiksioni, Gjykata është mekanizmi që duhet të garantojë që parimi kushtetues i mbrojtjes së *ligjeve vitale* nga referendumi të mbikqyret dhe, si rrjedhojë, të mbrohet modeli *konsociacional* (“*consociational*”) i demokracisë që prodhon kushtetuta e vendit.

Neni 113.3 (3)

1. Neni 113.3 (3) përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese sa i përket kontrollit kushtetues të aktit të shpalljes së Gjendjes së jashtëzakonshme, dhe kontrollit kushtetues të veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme. Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme sipas disa autorëve, ta zëmë Karl Shmit(Carl Schmitt),⁷⁸⁸ përbën instrumentin që përcakton atë që është sovran sipas kushtetutës. Gjendja e jashtëzakonshme përbën situatën kur pushteti shtetëror lirohet në një masë të madhe nga detyrimet juridike, dhe kur pushteti ekzekutiv *detyrohet* të ushtroj pushtetin pothuajse pa asnjë kontroll efektiv. Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, liritë dhe të drejtat e njeriut mund të suspendohen, duke

⁷⁸⁷ Korenica, Fisnik & Doli, Dren (2010) ‘The Politics of Constitutional Design in Divided Societies: The Case of Kosovo’. *Croatian Yearbook of European Law and Policy*. Vol. 5: p.265-292; Shih më shumë për ndërlidhjen e pjesëmarrjes së drejtëpërdrejtë të popullit në vendimmarrje sa i përket këtij modeli të demokracisë në: Lijphart, A (1968) ‘The Politics of Accommodation: Pluralism and Democracy in the Netherlands’. LA: University of California Press; Për përpjekjet e para për ta definuar këtë çështje, Cf. Lijphart, Arendt (1969) ‘Consociational Democracy’. *World Politics*. Vol. 21: p. 207-225. See also KD McRae (1974) (ed), *Consociational Democracy: Political Accommodation in Segmented Societies*. Toronto: McClelland & Stewart; Lijphart, A (1977) ‘Democracy in Plural Societies’. New Haven: Yale University Press; Lijphart, A (1979) ‘Consociation and Federation: Conceptual and Empirical Links’. *Canadian Journal of Political Science*. Vol. 12: p. 499-515; Lijphart, A (1981) (ed), *Conflict and Coexistence in Belgium: the Dynamics of a Culturally Divided Society*. Institute of International Studies. Berkeley: University of California; Lijphart, A (2008) ‘Thinking about Democracy. Power-sharing and Majority Rule in Theory and Practice’. New York: Routledge;

⁷⁸⁸ Cf. Schmitt, Carl (1985) ‘Political Theology. Four Chapters on the Concept of Sovereignty’. Chicago: The University of Chicago Press, Kapitulli 1 (“Definition of Sovereignty”), p. 5-15;

përfunduar liritë dhe të drejtat absolute.⁷⁸⁹ Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme por edhe veprimet e ndërmarra gjatë saj, përbëjnë hapësirë për keqpërdorim real të pushtetit dhe cenim të të drejtave dhe lirive njerëzore.⁷⁹⁰ Shikuar në aspektin e së drejtës ndërkombëtare, neni 4 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike lejon suspendimin e të drejtave të garantuara me të në rastet e emergjencave publike, që është një referim për gjendjen e jashtëzakonshme. Sidoqoftë, nën detyrimin e Konventës në fjalë, çfarëdo suspendimi i të drejtave në fjalë *duhet të bëhet* vetëm në kufijtë e kërkuar për ta sjellë situatën nën kontroll, përderisa gjendja e tillë duhet që të lajmërohet tek Sekretari Gjeneral i Kombeve të Bashkuara⁷⁹¹.

2. Në kuptim të këtij paragrafi, juridiksioni i Gjykatës sa i përket kontrollit të kushtetutshmërisë së gjendjes së jashtëzakonshme ngërthen në vete dy çështje: një, kontrollin kushtetues të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme; dhe dy, kontrollin kushtetues të veprimeve të ndërmarra gjatë Gjendjes së jashtëzakonshme. Sa i përket çështjes së parë, Gjykata kontrollon përveç dy parimeve të mësipërme edhe standardet tjera të aplikuara që sollën vendimin për shpalljen e tillë. Në kryerjen e këtij kontrolli, Gjykata shërben si mekanizëm i kontrollimit të kufijve të shfrytëzimit të kompetencës për shpallje, dhe nëse kjo është e bazuar në nevoja reale të shtetit. Sa i përket çështjes së dytë, Gjykata kontrollon veprimet e ndërmarra prej momentit të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme e deri në përfundim të saj. Kjo nënkupton që Gjykata kontrollon arsyeshmërinë dhe proporcionalitetin e masave të ndërmarra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, nevojën për suspendimin e të drejtave të njeriut, gjykon nëse ndonjë nga të drejtat absolute të njeriut janë shkelur gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, si dhe nëse është tejkaluar arsyeja për të vazhduar gjendja e tillë. Ky funksion është vital sa i përket nevojës për të siguruar që gjendja e jashtëzakonshme nuk keqpërdoret nga institucionet ekzekutive në dëm të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe kufijve të arsyeshëm të pushtetit, duke kontrolluar vazhdimisht nëse masat e ndërmarra janë në linjë me parimin e proporcionalitetit. Në kuptim të këtij juridiksioni, Gjykata merr vendime përfundimtare, të cilat janë efektive, që nënkupton që mund t'i shpall kundërkushtetuese dhe t'i përjashtojë nga rendi juridik cilindo veprim të ndërmarrë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Në ushtrimin e këtij juridiksioni, Gjykata vishet me detyrën e garantimit që gjendja e jashtëzakonshme të mos keqpërdoret nga pushteti ekzekutiv, duke u bërë institucioni i vetëm i autorizuar nga kushtetuta për të kontrolluar kushtetutshmërinë/arsyeshmërinë e gjendjes dhe masave të ndërmarra në të.

⁷⁸⁹ Cf. Prémont, D., Stenersen, C., and Oseredczuk, I. (1996) (eds.), *Non Derogable Rights and States of Emergency*. Brussels: Bruylant, p. 644;

⁷⁹⁰ Shih p.sh: Agamben, Giorgio, 'A Brief History of the State of Exception: An excerpt from *State of Exception*', Në internet: <http://www.press.uchicago.edu/Misc/Chicago/009254.html>

⁷⁹¹ Për shtjellime të detajuara doktrinare të raportit në mes të gjendjes së jashtëzakonshme dhe të drejtave të njeriut, si dhe të rasteve e modeleve të kufizimeve të këtyre të fundit në gjendjet e tilla, Cf. Agamben, Giorgio (2005) 'State of Exception'. Chicago: University of Chicago Press.; Barzilai, Gad (1996) 'Wars, Internal Conflicts, and Political Order'. Albany: State University of New York Press;

1. Ky paragraf përcakton juridiksionin e Gjykatës për të kontrolluar përputhshmërinë e një amendamenti të propozuar kushtetues me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara sipas kësaj Kushtetute, dhe rishikimin e procedurës së ndjekur. Fillimisht, është e rëndësishme të argumentohet se, përveç që kushtetuta nuk i jep juridiksionin Gjykatës për të kontrolluar kushtetutshmërinë e traktateve ndërkombëtare (sidomos para ratifikimit), ky paragraf e ndërton detyrimin pozitiv për Gjykatën Kushtetuese që të kontrollojë përputhshmërinë e amendamenteve kushtetuese me traktatet e detyrueshme ndërkombëtare ku Kosova është palë. Shikuar në këtë aspekt, ky juridiksion prodhon detyrimin pozitiv që amendamentet kushtetuese nuk mund të prishin detyrime ndërkombëtare të marra sipas të drejtës ndërkombëtare, që është në përputhje me nenin 56 të Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve i cili përcakton që shtetet nuk mund të shfrytëzojnë mjetet e brendshme juridike për t'i anuluar detyrimet e tyre ndërkombëtare.⁷⁹² Kjo në fakt është edhe në përputhje me kërkesat e Komisionit të Venedikut sa i përket mekanizmave të së drejtës së brendshme që duhet ta ndalojnë zhvelërsimin e detyrimeve të marra sipas së drejtës ndërkombëtare.⁷⁹³ Në këtë kuptim, Gjykata vendoset në pozitën e mekanizmit që kontrollon përgjegjësinë ndërkombëtare të shtetit sa i përket marrëveshjeve të nënshkruara ndërkombëtare, duke u bërë mekanizmi shtetëror që garanton nga brenda përgjegjësinë ndërkombëtare ndaj së drejtës ndërkombëtare dhe aplikimit *bonna fide* të detyrimeve të marra ndërkombëtare.⁷⁹⁴
2. Përveç si një juridiksion i specializuar për Gjykatën, ky paragraf, përmes një obligimi pozitiv që e vendos mbi Gjykatën, bën që realisht të sendërtoj një raport shumë *monist* të së drejtës së brendshme me të drejtën ndërkombëtare, me kuptim epërsinë e kësaj të fundit.⁷⁹⁵ Detyrimi që e drejta e brendshme të qëndroj në linjë me detyrimet e marra ndërkombëtare projekton një lloj hierarkie ku e drejta e

⁷⁹² Vienna Convention on the Law of Treaties, 1155 U.N.T.S. 331, 8 I.L.M. 679, entered into force 27 January 1980, Art. 56. Në internet në: http://untreaty.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/1_1_1969;

⁷⁹³ Comments on the Draft Law on the Constitutional Court of the Republic of Serbia, European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Opinion no. 445/2007, 7 November 2007, CDL - AD (2007) 039; Shih gjithashtu: Doli, Dren & Korenica, Fisnik (2010) 'Kosovar Constitutional Court's Jurisdiction: Searching for Strengths and Weaknesses'. *German Law Journal*. Vol. 11: p. 803-836. Në internet në: <http://www.germanlawjournal.com/index.php?pageID=11&artID=1268>;

⁷⁹⁴ Krahaso me rolin e Gjykatës Kushtetuese italiane sa i përket detyrimeve që rrjedhin nga traktatet e BE-së: Cartabia, Marta (1990-1991) 'The Italian Constitutional Court and the Relationship between the Italian Legal System and the European Community'. *Michigan Journal of International Law*. Vol. 12: p. 173-192;

⁷⁹⁵ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Hungarisë ka vendosur që në rastin në të cilin Gjykata shpall kundërkushtetues një traktat ndërkombëtar në tërësi apo pjesërisht, të ratifikuar nga Parlamenti hungarez nuk krijon asnjë efekt në detyrimet që merr Republika e Hungarisë në fushën e të drejtës ndërkombëtare (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Hungarisë 4/1997 I datës 22.1.1997);

brendshme, duke përfshirë ato kushtetuese, qëndrojnë të varura për të drejtën ndërkombëtare (një version kelzenian i raportit në mes të së drejtës ndërkombëtare dhe asaj të brendshme, i cili nuk sheh nevojë për kundërvënje sepse e drejta ndërkombëtare është vazhdim i të drejtës së brendshme që bazohet në normën themelore apo në “grundnorm”). Në anën tjetër, ky juridiksion i specializuar mundëson që Gjykata përveç që të ketë nën kontroll kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese sa i përket përputhshmërisë së tyre me Kapitullin II të Kushtetutës, gjithashtu të kontrollojë përputhshmërinë e tyre me të traktatet ndërkombëtare të marra përsipër nga Kosova. Në këtë mënyrë, juridiksioni për kontrollimin e kushtetutshmërisë së amendamenteve kushtetuese zgjerohet shumëfish, dhe e drejta ndërkombëtare e kontraktuar nga shteti i Kosovës bëhet baza e dytë mbi të cilën gjykohej kushtetutshmëria e amendamenteve kushtetuese. Kjo përbën një rast të rrallë në kuptimin krahasues kushtetues. Vendet tjera ish komuniste, ta zëmë Shqipëria, kanë juridiksion në çështjet e amendamenteve kushtetuese, por në një drejtim të kundërt: atje bëhet vlerësimi nëse traktatet ndërkombëtare bien ndesh me dispozitat kushtetuese. I tillë ka qenë rasti me deklarinimin jokushtetues të marrëveshjes për kufijt detar në mes të Shqipërisë dhe Greqinë⁷⁹⁶.

3. Në kryerjen e këtij juridiksioni, Gjykata realisht nuk kontrollon kushtetutshmërinë në kuptimin klasik, por shndërrohet në një mekanizëm që kontrollon ligjshmërinë dhe legjitimitetin ndërkombëtar të amendamenteve kushtetuese. Në këtë kuptim, Gjykata vihet në pozitën e një organi gjysëm ndërkombëtar sepse mbron dispozitat e Konventës së Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve dhe, përmes saj, rendin juridik-kushtetues ndërkombëtar. Kjo është kështu sepse Gjykata, përmes vënies në jetë të këtij detyrimi kushtetues, siguron partnerët ndërkombëtarë të Kosovës se detyrimet e saj ndërkombëtare prevalojnë kundrejt detyrimeve të brendshme juridiko-kushtetuese. Në këto raste, caqet e kontrollit kushtetues të amendamenteve kushtetuese janë më të gjëra se caqet e këtij kontrolli kur ndërmerret në zbatim të nenit 113.9 të Kushtetutës. Në këtë rast nuk flitet për kapitujt I-III të Kushtetutës, përkatësisht për respektim të letrës, frymës dhe shpirtit të Kushtetutës si një tërësi organike e pandarë. Këtu flitet, për të qenë më të saktë, për detyrueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara sipas Kushtetutës, pa marrë parasysh nëse këto marrëveshje kanë të bëjnë me të drejtën e përgjithshme apo të veçantë ndërkombëtare. Edhe kontrolli i kushtetutshmërisë së procedurës së ndjekur, u mor vesh, mund të jetë cak i kontrollit kushtetues. Në një rast të tillë do të ishte, ta zëmë, vlerësimi nëse marrëveshjet ndërkombëtare nga neni 18.1 (1-4) i Kushtetutës janë ratifikuar me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve.

⁷⁹⁶ Cf. “Gjykata Kushtetuese rrëxon Marrëveshjen për kufijt detar me Greqinë”. *Gazeta Shqiptare / TVNews24 / Pashtriku.org* (27. 01. 2010). Për vendet tjera ish komuniste, Cf. Steinberger, Helmut (1994) ‘Models of Constitutional Jurisdiction’. Venice Commission: Strasbourg, 1994, Kapitulli I (“Review of the Constitutionality of Laws”), p. 5-20;

Neni 113.3 (5)

1. Neni 113.3 (5) përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës. Në kuptim të këtij paragrafi, Gjykata Kushtetuese është mekanizmi që vlerëson nëse standardet kushtetuese mbi zgjedhjet janë aplikuar në rastin e zgjedhjeve për Kuvendin. Logjika prapa këtij juridiksioni është që Gjykata të jetë mekanizmi që garanton zgjedhjet për Kuvend⁷⁹⁷ të jenë zhvilluar sipas Kushtetutës. Meqë ky paragraf përbën një hapësirë shumë të gjerë juridiksionale, Gjykata realisht vishet me autoritetin e konsiderimit si të aspektit procedural kushtetues ashtu edhe të atij substancial në kuptim të kushtetutshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së zgjedhjeve të tilla, në anën tjetër, e fut Gjykatën në konsiderimin jo thjeshtë të anës normative të zhvillimit të tyre por edhe të anës teknike/praktike, duke lejuar hapësirë që Gjykata realisht të konsiderojë çështje *fakti* dhe jo thjeshtë çështje *norme*.⁷⁹⁸
2. Në përgjithësi, juridiksioni i vënë me këtë paragraf ofron hapësirë që zgjedhjet për Kuvend, që është institucioni që kryen funksionin legjislativ dhe përfaqësues në rastin e sistemit kushtetues të Kosovës, t'i nënshtrohen kontrollit të gjyqësisë kushtetuese, duke i dhënë mundësi Gjykatës që të bart autoritet edhe për ruajtjen e kredibilitetit kushtetues të institucionit përfaqësues të shtetit. Nga kjo dispozitë, siç mund të vërehet, janë përjashtuar zgjedhjet për nivelet tjera, pra për llojet tjera të zgjedhjeve. I vetmi rast që involvon Gjykatën Kushtetuese është ai certifikimit të zgjedhjeve. Sipas nenit 106.1 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Ligji Nr.L/03-073 i datës 5 qershor 2008, zgjedhjet mund të certifikohen vetëm pasi të jenë mbyllur procedurat ankimore pranë Gjykatës Kushtetuese. Mirëpo, këtu nuk flitet për juridiksion origjinal të Gjykatës, siç është rasti me vlerësimin e kushtetutshmërisë së zgjedhjeve për Kuvend nga neni 113.3 (5) i Kushtetutës, por për një procedurë sipas kërkesës individuale në pajtim me dispozitat e nenit 113.7 të Kushtetutës. Në këto raste, Gjykata nëse autoritetet publike, siç është rasti me Gjykatën Supreme si instancë e fundit, kanë cënuar të drejtat individuale zgjedhore dhe të pjesëmarrjes nga neni 45 i Kushtetutës, gjithnjë të interpretuara si të drejta në dritën e letrës, shpirtit dhe frymës së Kushtetutës (normat, principet dhe vlerat e konstitucionalizmit bashkëkohor).

⁷⁹⁷ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin e saj të datës 07.01.2005 theksoi se përdërisa ligjvënësi ka të drejtë t'i vlerësojë dhe t'i definojë kriteret lidhur me termin 'votes', është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të shqyrtojë nëse vendimet e ligjvënësit janë në pajtim me Kushtetutën (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë i datës 7.1.2005);

⁷⁹⁸ Në rastin e Kroacisë, Gjykata Kushtetuese ka vendosur që Parlamenti ka fuqinë ekskluzive për të vendosur për sistemin e zgjedhjes së anëtarëve të tij dhe të përcaktojë rregullat brenda sistemit që zgjedh. Zgjedhja e parlamentit nuk mundet *per se* të jetë subjekt i vlerësimit kushtetues para Gjykatës Kushtetuese, përveç në rastet kur një zgjidhje e caktuar legjislative i cenon vlerat kushtetuese të garantuara të votimit universal dhe të barabartë apo parimet apo vlerat tjera kushtetuese që lidhen me realizimin e sistemit demokratik shumë-partiak dhe përfaqësues (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-I-3789/2003 et al, i datës 8.12.2010);

1. Neni 113 (4) përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjeve ose akteve juridike të Qeverisë të cilat cenojnë autoritetin kushtetues të komunave ose zvogëlojnë të hyrat e komunës.⁷⁹⁹ Palë e autorizuar për të iniciuar këto çështje para Gjykatës është komuna.
2. Shikuar në kuptim të juridiksionit, në përgjithësi, neni 113.4 përbën garantuesin e të drejtave të vetëqeverisjes lokale me të cilat janë të veshura komunat, meqë Gjykata vendoset në rolin e garantuesit të autoritetit kushtetues me të cilin komunat janë veshur në kuptim të të drejtave të bartura. Për të pasur të drejtë në iniciativë, sipas paragrafit në fjalë, komuna duhet që të jetë ‘prekur nga ligji apo akti në fjalë’. Kjo do të thotë që legjitimiteti procedural i një komune për të iniciuar çështje sipas këtij juridiksioni, fitohet vetëm në atë moment kur ‘ligji apo akti juridik i Qeverisë’ e prek drejtpërdrejtë një interes të komunës që lidhet me dy bazat e paraqitura në këtë paragraf. Prandaj, ky juridiksion nuk përbën një të drejtë të komunës për të iniciuar çështje përpara Gjykatës pa qenë e lidhur me një objekt juridik, referimi tek i cili është bërë përmes një ligji apo akti juridik të Qeverisë.
3. Në anën tjetër, i rëndësishëm është konstatimi i akteve juridike që mund të jenë objekt i këtij juridiksioni. Neni 113 (4), përcakton vetëm dy akte juridike që mund t’i nënshtrohen kontrollit kushtetues: një, ligjet, dhe dy, aktet juridike të Qeverisë. Sa i përket ligjeve, vlen komentimi i bërë në pjesën e mësipërme. Sa i përket akteve juridike të Qeverisë, ky paragraf e vesh Gjykatën me juridiksion që të kontrollojë kushtetutshmërinë e çfarëdo akti juridik të nxjerr nga Qeveria, i cili prek në çështje të autoritetit të komunave. Termi ‘akt’ i shfrytëzuar në këtë paragraf i referohet çdo lloj akti të nxjerrë nga Qeveria, qoftë ai akt i natyrës së përgjithshme apo i natyrës individuale (konkrete).
4. Në ushtrimin e këtij juridiksioni, Gjykata është e autorizuar që të kontrollojë kushtetutshmërinë e akteve juridike në fjalë vetëm sa i përket dy çështjeve: një, nëse një ligj apo akt i Qeverisë cenon autoritetin e komunave, pra, vëllimin e kompetencave të qeverisjes lokale të cilat i takojnë komunave, dhe dy, nëse një ligj apo akt juridik i Qeverisë zvogëlon të hyrat financiare të komunës. Në ushtrimin e këtij juridiksioni, megjithatë, Gjykata mund të hyj edhe në terrenin ligjor, duke e tejkaluar normat kushtetuese mbi këtë çështje, meqë substanca mbi të cilën mund të ushtrohet ky juridiksion kërkon kalimin në çështje më të detajuara që janë rëndom të pozicionuara në terrenin ligjor. Jashtë këtyre dy bazave, komunat nuk kanë legjitimitet procedural për të iniciuar çështje të tilla para Gjykatës.
5. Për fund, duhet të thuhet që ky paragraf përbën një hapësirë të kontrollit gjyqësor/kushtetues të raportit në mes të pushtetit qendror dhe atij lokal, dhe se kushtetuta e vë këtë mekanizëm si një garantues i ndarjes vertikale të pushtetit

⁷⁹⁹ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Sllovenisë ka vendosur që nuk ka juridiksion për ta vlerësuar pajtueshmërinë reciproke të dispozitave të dekreteve komunale. (Vendim i Gjykatës Kushtetues të Sllovenisë U-I-196/97 i datës 29.10.1997);

qendror dhe lokal, dhe balancit kushtetues të tyre. Si e tillë, kjo procedurë dallon nga procedura të cilën mund ta fillojë zëvendëskryetari për komunitete, në bazë të nenit 62.4 të Kushtetutës. Kjo procedurë është individuale, që do të thotë se zhvillohet në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës. I vetmi dallim është që në këto raste nuk kërkohet “shterrja e të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj”, sepse, sipas paragrafit 4 të nenit 62 të Kushtetutës, zëvendëskryetari mund të parashtrij çështjen drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, u mor vesh nëse ai/ajo mendon dhe vlerëson se aktet apo vendimet e kuvendit të komunës shkelin të drejtat e komuniteteve jo shumicë të garantuara me Kushtetutë. Pra, këtu kemi të bëjmë me kërkesa individuale të komuniteteve joshumicë të cilat njihen sipas Kapitullit III të Kushtetutës (“Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjestarëve të Tyre”). Rasti i vetëm që Gjykata Kushtetuese ka vendosur mbi këtë bazë është i njohur si “rasti i llogos së Prizrenit”. Me këtë rast, Gjykata pat shpallur si jokushtetues nenin 7 të Statutit të Komunës së Prizrenit sepse nuk reflektonte identitetin e të gjitha komuniteteve që jetojnë në këtë komunë, përkatësisht se logoja në fjalë reflektonte vetëm identitetin nacional të komunitetit shumicë, duke përjashtuar komunitetet tjera⁸⁰⁰. Në fakt, Gjykata në pikën II të pjesës operative kishte konstatuar se “është bërë shkelje e të drejtave të komuniteteve jo shumicë në Prizren për të ruajtur, mirëmbajtur dhe promovuar identitetin e tyre”.

Neni 113.5

1. Neni 113.5 përbën një juridiksion *plotësues* të nenit 113.2. Përderisa neni 113.2 e autorizon një të katërtën (1/4) e Kuvendit, që të mund të ngrisin para Gjykatës Kushtetuese çështjen e kushtetutshmërisë së ligjeve brenda afatit gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi, neni 113.5 e autorizon një pakicë deputetësh prej së paku dhjetë vetësh, që të iniciojnë para Gjykatës Kushtetues çështjen e kontrollit të kushtetutshmërisë së një ligji apo vendimi të Kuvendit. Neni 113.5, prandaj, është një autorizim për një minorancë parlamentare që të shfrytëzojë mundësinë për të kontestuar kushtetutshmërinë e ligjeve dhe vendimeve të Kuvendit, pavarësisht vullnetit të shumicës parlamentare, brenda një afati të përcaktuar kohor, para se prodhimi i miratuar nga Kuvendit të hyj në fuqi. Pra, fjala është për kontroll preventiv, jo represiv, të kushtetutshmërisë së prodhimit të Kuvendit, për dallim nga kontrolli represiv nga neni 113.2 (1) i Kushtetutës.
2. Shikuar në kuptim të demokracisë parlamentare, neni 113.5 përbën një mekanizëm shumë efektiv përmes së cilit një grup i vogël deputetësh, një pakicë prej 10 vetash, të mund të kontestojnë një ligj apo vendim të shumicës në Kuvend për shkak të kundërkushtetutshmërisë së supozuar. Kjo hapësirë juridiksionale, prandaj, është një rrugë shumë efikase që e fuqizon kontrollin parlamentar që një opozitë mund t'i bëjë vendimeve të shumicës, duke i dhënë mundësi Gjykatës që ta ushtrojë kontrollin e saj kushtetues. Në ushtrimin e këtij autorizimi, grupi prej së paku 10 deputetësh i hapin rrugë Gjykatës që ta kundër balancoj një prodhim kundërkushtetues të Kuvendit. Prandaj, ky paragraf përbën një autorizim

⁸⁰⁰ Cf. *Qemajl Kurtishi kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit*,. Rasti Nr. KO 01/09. Aktgjykim, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (Ref. Nr.: AGJ 07/10): datë 18 mars 2010;

procedural për një pakicë në parlament, që, shikuar nga këndi i aktivizimit parlamentar, i jep mundësi të njëjtës që të shfrytëzojë të mirat e një kontrolli të pavarur kushtetues. Megjithëse e shëndetshme për kuptimin e demokracisë parlamentare, Komisioni i Venedikut konsideron që një autorizim i tillë për një numër kaq të vogël të deputetëve mund ta stërngarkoj Gjykatën, andaj edhe e kundërshton.⁸⁰¹ Në anën tjetër, sipas Epstein,⁸⁰² kjo mund ta fus Gjykatën në çështje shumë politike dhe ta shndërrojë në një aktor politik. Përkundër të gjitha kritikave që mund t'i ketë, kjo procedurë, si në Kosovë ashtu dhe vendet tjera ish komuniste, ka qenë dhe mbetet instrument kyç i kontrollit dhe zbutjes së demokracisë radikale (populiste).⁸⁰³

3. Shikuar në ndërlidhmëri me nenin 113.2, neni 113.5 vendos disa limite në ushtrimin e kësaj të drejte. Fillimisht, duhet argumentuar që përderisa neni 113.2 e autorizon Kuvendin që të ngreh çështjen e kontrollit kushtetues të ligjeve para Gjykatës pas hyrjes së tyre në fuqi, brenda gjashtë (6) muajsh, neni 113.5, i jep këtë të drejtë një pakice në Kuvend prej dhjetë (10) deputetësh, vetëm brenda një periudhe kohore prej dhjetë (10) ditësh nga miratimi i një prodhimi në Kuvend. Në këtë kuptim, pakica prej dhjetë (10) deputetësh detyrohet që, ose ta shfrytëzojë këtë të drejtë kushtetuese brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore, ose që ta humbas autorizimin, dhe që çështja pastaj të mund të ngritet vetëm nga ana e Kuvendit duke vepruar në bazë të një vendimi prej një të katërtës (1/4) së numrit të tërësishëm të deputetëve. Prandaj, ky autorizim *ratio tempore* për grupin prej 10 deputetësh i shërben konceptit të kufizuar të aftësisë për të shfrytëzuar një të drejtë përmes një baze të dobët mbështetjeje parlamentare.
4. Përveç autorizimit për të ngritur kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjeve, neni 113.5 i autorizon të paktën dhjetë (10) deputetë që të mund të iniciojnë kontrollin edhe të kushtetutshmërinë e *vendimeve* të Kuvendit, një prodhim tjetër ky i Kuvendit. Në fakt, duhet thënë që neni 113.2 nuk e autorizon këtë juridiksion për Gjykatën edhe nëse kjo do të iniciohej nga një e katërta (1/4) e deputetëve në parlament. Prandaj, juridiksioni për të kontrolluar *vendimet* e Kuvendit, në kuptim të nenit 113.5, përbën një hapësirë shumë të gjerë juridiksionale për Gjykatën, por njëkohësisht një kanal shumë efikas për një pakicë në parlament që të

⁸⁰¹ Shih në rastin e Moldavisë: Opinion on the Draft Law on the Constitutional Court and Corresponding Amendments of the Constitution of the Republic of Moldova, European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), Opinion no. 200/2001, 15 July 2002, CDL-AD (2002) 16;

⁸⁰² Epstein, Jack Knight & Shvetsova, Olga (2001) 'The Role of Constitutional Courts in the Establishment and Maintenance of Democratic Systems of Government'. *Law and Society Review*. Vol. 35 (1): p. 117-164, (që citon një intervistë nga Leonid Nikitinsky me Boris Ebzeev, botuar në shkrimin "Justice of the Constitutional Court of the Russian Federation". *WINTER E. EUR. CONST. REV.* 83-85, 87 (1997);

⁸⁰³ Ky segment i demokracisë kushtetuese, pra e drejta e një organi të pazgjedhur nga populli, paraqet pikën rreth të cilës sillet vërdallë debati mbi vetë legjitimitetin e gjyqësisë kushtetuese. Në diskursin akademik të së drejtës kushtetuese kjo njihet, siç u theksua më heret, si "dilemë kundermazhoritare", dilemë që akoma nuk ka gjetur zgjidhje dhe vazhdon të torturojë doktrinën dhe praktikën kushtetuese.

kundërbalancojë një vendim të shumicës përmes kërkesës për kontroll kushtetues. Termi ‘vendim’ i shfrytëzuar nga neni 113.5 i referohet çdo veprimi të Kuvendit, i cili prodhon pasoja juridike sipas kompetencave kushtetuese të tij. Prandaj, termi ‘vendim’ përfshin jo thjeshtë një akt juridik të Kuvendit, por vendimin e këtij të fundit përmes së cilit është bërë nxjerrja e tij. Kështu ta zëmë, Gjykata Kushtetuese e Rusisë nuk ka juridiksion represiv për të kontrolluar kushtetutshmërinë e traktateve, diçka që ajo e bën vetëm përmes kontrollit kushtetues të kushtetutshmërisë së ligjeve përmes së cilave është bërë ratifikimi i traktateve.⁸⁰⁴ E njëjtë është situata edhe sipas nenit 113.5. Pavarësisht që Gjykata Kushtetuese, ta zëmë, nuk ka juridiksion për të kontrolluar kushtetutshmërinë e propozimeve të gjykatësve kushtetues të Kuvendit, ajo mundet megjithatë të ushtrojë kontrollin e kushtetutshmërisë së *vendimit* të Kuvendit për të ushtruar propozimet e tilla. Neni 113.5 përbën një hapësirë shumë të gjerë juridiksionale të Gjykatës, përmes së cilës, kjo e fundit mund të kontrollojë çdo vendim të Kuvendit. Prandaj, mund të argumentohet që çdo *veprim* i Kuvendit që prodhon pasoja juridike (i përgjithshëm apo individual), qoftë i lëshuar në formë të shkruar apo të pashkruar, si në lidhje me çështje substanciale ashtu edhe me çështje procedurale, mund t’i nënshtrohet kontrollit kushtetues. Në kuptim të nenit 113.5, ky kontroll kushtetues mund të ndodhë vetëm në mënyrë *represive* dhe përfshinë vetëm ligjet si prodhim primar i Kuvendit.

5. Është e rëndësishme të merret në konsideratë baza mbi të cilën mund të ushtrohet kontrolli i kushtetutshmërisë së *vendimeve* të Kuvendit, sipas nenit 113.5. Paragrafi në fjalë, qartësisht, e autorizon Gjykatën që të bëjë ushtrimin e kontrollin e kushtetutshmërisë si për procedurën e ndjekur ashtu edhe për përmbajtjen e vendimeve të Kuvendit. Në këtë kuptim, juridiksioni i Gjykatës është shumë i gjerë përballë kontrollit të kushtetutshmërisë së vendimeve të Kuvendit, meqë Gjykata është e autorizuar që të kontrollojë edhe substancën e vendimeve të tilla. Prandaj, juridiksioni sipas nenit 113.5 përbën një mekanizëm shumë të fuqishëm kundërbalancimi që Gjykata mund ta ushtrojë përballë Kuvendit, mekanizëm që vihet në lëvizje me anë të një iniciative prej një pakicë shumë të vogël në parlament.⁸⁰⁵

⁸⁰⁴ Danilenko, G. M. (1994) ‘The New Russian Constitution and International Law’. *The American Journal of International Law*. Vol. 88(3): 451-470;

⁸⁰⁵ Rasti më i rëndësishëm në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës është i njohur si “Rasti Pacolli”, kur Gjykata shpalli jo kushtetues Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-04, përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës të 22 shkurtit 2011. Me këtë rast, Gjykata gjeti mangësi kushtetuese si në formën ashtu dhe në përmbajtjen e vendimit në fjalë.

Gjykata në rastin e cekur si më sipër konstatoi se mosprania e një numri prej dy të tretave (2/3) të deputetëve me rastin e fillimit të zgjedhjes së shefit të shtetit kosovar paraqiste një cenim të kushtetutës nga ana e Kuvendit sepse ky cilësim i votës së deputetëve, sipas Gjykatës, ishte bërë për të treguar peshën e madhe që ka zgjedhja e institucionit të shefit të shtetit. Këtu nuk flitej për kuorum, gjë që është diçka tjetër, por për prezencën e dy të tretave (2/3) më rastin e fillimit të votimit për shefin e shtetit. E njëjta vlen edhe për kandidatët, dy ose më shumë, siç e thot Kushtetuta, të cilët duhet të garojnë në garën për President. Nisja e votimit me më pak se dy të tretat (2/3) dhe me vetëm një kandidat paraqiste, sipas Gjykatës, cenim cenim të Kushtetutës nga

1. Neni 113.6 përcakton juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për të bërë konstatimin nëse Presidenti i Republikës ka kryer shkelje serioze të Kushtetutës. Iniciativa për të ushtruar juridiksionin sipas këtij paragrafi mund të paraqitet nga së paku 30 deputetë të Kuvendit. Në *Rrustemi v. Presidenti i Kosovës*,⁸⁰⁶ Gjykata Kushtetuese ka ushtruar juridiksionin e saj për të kontrolluar nëse Presidenti i Republikës, sipas këtij paragrafi, kishte bërë shkelje serioze të Kushtetutës. Fillimisht, pyetja themelore ishte nëse kërkesa mund të ishte e pranueshme edhe nëse pas deponimit të kërkesës nga 30 deputetë, disa nga ta disa ditë më pas kishin hequr dorë nga kërkesa. Gjykata, në *Rrustemi v. Presidenti*, vendosi që shfrytëzimi i këtij autorizimi nga ana e 30 deputetëve përbën ushtrim të një të drejtë kolektive, dhe, edhe nëse disa deputetë heqin dorë nga kërkesa pas një kohe të caktuar, ky veprim nuk mund të ndryshonte inicimin e juridiksionin që ishte bërë sipas ushtrimit të një të drejte kolektive.
2. Dy janë çështje substanciale që lidhen me këtë paragraf: një, kuptimi i konceptit të ‘shkeljes serioze’ sipas këtij paragrafi; dhe, dy, efekti juridik i vendimit të Gjykatës në rast se konstatohet që Presidenti i Republikës ka bërë shkelje serioze të kushtetutës. Sa i përket çështjes së parë, në *Rrustemi et al v. Presidenti i Kosovës*, Gjykata ka zhvilluar një formulë logjike mbi bazën e së cilës mund të vlerësohet nëse shkelja kushtetuese e Presidentit të Republikës është ‘e rëndë’. Shtjellimi juridik i konceptit ‘shkelje e rëndë e kushtetutës’, nën dritën e *Rrustemi et al v. Presidenti i Kosovës*, bazohet në këto katër karakteristika:
 - a) Që, shkelja kushtetuese e Presidentit, e evidentuar nga ana e Gjykatës, të prek një substancë themelore të kushtetutës. Thënë kjo, ky kusht kërkon që të evidentohet që presidenti i republikës, në ushtrimin e pozitës së tij kushtetuese, ka shkelur një normë të përcaktuar në mënyrë eksplicite në kushtetutë.
 - b) Që, shkelja e bërë nga ana e Presidentit të Republikës të ketë efekte praktike në jetën publike. Prandaj, kërkohet të evidentohet që në kryerjen e shkeljes së tillë, Presidenti i Republikës i ka privuar të tjetër nga gëzimi i një garancie kushtetuese dhe që privimi i tillë ka qenë *real*.
 - c) Që, shkelja e bërë nga ana e Presidentit të Republikës është e pakthyeshme, dhe nuk mund të riparohet/restaurohet nga ana e tij, dhe që pasojat e saj janë reflektuar praktikisht në rendin juridik. Prandaj, e vetmja mënyrë e ndërprerjes së shkeljes së tillë, dhe e kthimit të gjendjes kushtetuese në mënyrë kredibile në atë situatë, është përmes këputjes së mandatit të Presidentit të Republikës.

ana e Kuvendit, të atyre dispozitave që flasin dhe sanksionojnë pozitën dhe rolin e shefit të shtetit në një sistem parlamentar siç është Kosova. Cf. Paragrafët 63-87 të Aktgjykimit në Rastin KO 29/11: *Sabri Hamiti dhe Deputetët e tjerë*. Vlerësimi Kushtetues i Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 04-V-04, Përkitazi me zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës të 22 shkurtit 2011 (Ref. No.: AGJ 107/11). Datë: 30 mars 2011;

⁸⁰⁶ *Naim Rrustemi dhe 31 Deputetë Tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kundër Shkëlqesisë së tij, Fatmir Sejdiu, President i Republikës së Kosovës*. Rasti KI Nr. 47/10, Aktgjykim, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në datë: 28 shtator 2010 (nr. ref.: AGJ 43/10);

- d) Që, Gjykata Kushtetuese të konstruktoj dhe të evidentoj pasojat që janë sjellë nga një shkelje e tillë kushtetuese nga ana e Presidentit të Republikës, dhe të faktoj ndikimin kundër kushtetues që shkelja e tillë ka prodhuar në jetën publike.
3. Duhet thënë që ky juridiksion i Gjykatës e bën praktikisht të nevojshme që, përveç kontrollit juridik, Gjykata të konstatoj edhe faktet mbi të cilat mbështetet shkelja e tillë e supozuar. Në këtë aspekt, sipas nenit 113.6, Gjykata shndërrohet edhe në vlerësues fakti, meqë kërkohet që ndikimi i shkeljes së tillë të Presidentit të Republikës të evidentohet edhe praktikisht.
4. Sa i përket çështjes së dytë, në përputhje edhe me nenin 91 të Kushtetutës, vendimi i Gjykatës në rast të shkeljes serioze të kushtetutës nga ana e Presidentit të Republikës *detyron* Kuvendin që ta votojë atë. Kjo nënkupton që neni 91.3, në ndërlidhje me nenin 113.6 dhe nenin 116.1, përcakton detyrimin e Kuvendit që të votojë me *pro* vendimin e tillë të Gjykatës, meqë, konstatimi i shkeljes serioze kushtetuese të Presidentit të Republikës nuk *mund* të kthehet nga ana e Kuvendit. Në këtë procedurë *vetimi*, Kuvendi vepron thjeshtë si një *shpallës* i vendimit të Gjykatës, dhe nuk ka autoritet që ta refuzoj vendimin e tillë. Në të kundërtën, përcaktimi i nenit 116.1 të Kushtetutës do të shkelej, duke marrë parasysh gjithashtu që Gjykata, sipas nenit 113.6, nuk vepron në juridiksion *opinion-dhënës*, por nën një juridiksion *represiv*. Me një fjalë, nëse në nenin 116.1 përcaktohet se vendimet e Gjykatës janë të detyrueshme për të gjithë, atëherë nuk ka ndonjë arsye që t'i lejohet Kuvendit për të vendosur nëse do të zbatoj vendimin e Gjykatës në të cilën konstatohej shkelja serioze Kushtetutës. Për këtë arsye, vendimi i Kuvendit sipas nenit 91.3 për shkarkim të Presidentit me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij duhet nënkuptuar si vendim deklarativ, jo konstitutiv. Përveç këtij argumenti, fakti se Gjykata nuk ka juridiksion këshilldhënës, siç kanë disa gjykata (ta zëmë, ajo bullgare, italiane, etj.)⁸⁰⁷ flet në favor të asaj që Kuvendi nuk ka diskrecion në vendosjen për fatin e aktgjykimit të Gjykatës me të cilin konstatohet shkelja serioze e Kushtetutës nga Presidenti. Juridiksioni represiv në këtë kontekst duhet të nënkuptohet si sanksion kushtetues për Presidentin e Republikës në rastet kur ai/ajo bën shkelje serioze, të rënda, të Kushtetutës. Kjo është kështu, fundja, nëse kihet parasysh fakti se Presidenti është i vetmi institucion që ka sanksion kushtetues që mund të zbatohet në mënyrë efektive ndaj tij/saj. Në përgjithësi, prandaj, Gjykata vishet me një juridiksion shumë të fuqishëm përballë Presidentit të Republikës, juridiksion që faktikisht e bën Gjykatën të ushtrojë rolin e një kundër balancuesi të pavarur të institucionit në fjalë, institucion që edhe vetë sipas neneve 4.3, 83 dhe 84.1 të Kushtetutës, supozohet se është balancues i tri pushteteve tjera.

⁸⁰⁷ Cf. Schwartz, Herman (2000) 'The Struggle for Constitutional Justice in Post - Communist Europe'. Chicago: The University of Chicago Press, p. 164-193; Rola, Giancarlo and Groppi, Tania (2010) 'Between Politics and the Law: The Development of Constitutional review in Italy', në Wojciech Sadurski (ed), *Constitutional Justice, East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in A Comparative Perspective*. The Hague: Kluwer Law International, p. 143-159;

1. Përveç juridiksionit abstrakt, përmes së cilit Gjykata Kushtetuese bën kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së akteve juridike, kontroll i iniciuar vetëm nga aktorët institucional sipas neneve të mësipërme, neni 113.7 i Kushtetutës përcakton që individët janë të autorizuar që të iniciojnë shkeljet e autoriteteve publike ndaj të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese pasi që të kenë shtetur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Në përgjithësi, neni 113.7 përbën hapësirën e vetme ku kushtetuta i autorizon individët që të iniciojnë një procedurë të kontrollit kushtetues para Gjykatës Kushtetuese, përderisa, sipas këtij juridiksioni, Gjykata ushtron një kontroll të tipit individual/konkret. Në këtë aspekt, neni 113.7 përbën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese përmes së cilës ajo bën kontrollin e kushtetutshmërisë së veprimeve të organeve publike, në raste individuale, të ngritura sipas kërkesës së individëve. Prandaj, kjo përbën kanalin e vetëm juridik ku Gjykata kontrollon kushtetutshmërinë e akteve individuale të autoriteteve publike,⁸⁰⁸ në kuptim të përputhshmërisë së tyre me të drejtat dhe liritë individuale të përcaktuara me kushtetutë. Chaper, ta zëmë, argumenton që ky juridiksion përbën legjitimimin e vetëm për të cilin edhe duhet të ekzistoj kontrolli kushtetues.⁸⁰⁹ Në anën tjetër, sipas një autori tjetër, Steiberger, ky juridiksion përbën një mekanizëm përmes së cilit garantohet pozita më e lartë hierarkike për të drejtat e njeriut në rendin juridik.⁸¹⁰ Nën këtë juridiksion, gjykatat kushtetuese bëhen gjykatës të gjyqtarëve të rregullt, dhe tejkalojnë kufirin tradicional të gjyqësisë kushtetuese të vendosur nga Kelzen.⁸¹¹

⁸⁰⁸ Si një shembull nga modeli i Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese ka juridiksion për t'i ekzaminuar kërkesat e dorëzuara nga personat fizikë dhe ata juridikë që pretendojnë shkelje të të drejtave të tyre themelore nga vendimet e paligjshme. Termi 'vendim' siç përdoret në ligjin themelor nuk mbulon vetëm vendimet e organeve tjera shtetërore, por edhe ato të gjykatave të rregullta. (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë Nr. 57 I datës 04.11.1998);

⁸⁰⁹ Wolfe, C. (2004) 'The Rise of Modern Judicial Review: From Constitutional Interpretation to Judge-Made Law'. London: Rowman & Littlefield Publishers, p. 337;

⁸¹⁰ Steinberger, Helmut (1993) 'Models of Constitutional Jurisdiction'. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), 1993, CDL STD (1993) 002; Kështu, ta zëmë, modeli i gjyqësisë kushtetuese franceze nuk lejon hapsirë për një lloj të tillë të juridiksionit: Aucoin, Louis M. (1992) 'Judicial Review in France: Access of the Individual Under French and European Community Law in the Aftermath of France's Rejection of Bicentennial Reform'. *Boston College International & Comparative Law Review*. Vol. 15: p. 443-469, p. 443. Në internet gjendet në: <http://lawdigitalcommons.bc.edu/iclr/vol15/iss2/7>). Kjo gjendje, megjithatë, ka ndryshuar në njëfarë mase pas marsit të vitit 2010, kur në Francë hyri në fuqi reforma kushtetuese. Tani atje lejohet që individët të sfidojnë në kuadër të procedurave të kontrollit incidental ligjet të cilat çënojnë të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese. Cf. Mathieu, Bertrand (2011) 'Le Conseil Constitutionnel "legislateur positif". Ou la question des interventions du juge constitutionnel français dan l' exercice de la fonction législative'. Nw Alain R. Brewer-Carias (ed.), *Constitutional Courts as Postive Legislators. A Comparative Law Study*. Cambridge: Cambridge University Press, 471-495, nw p. 476-477; Boyron, Sophie (2011) "France", në Dawn Oliver and Carlo Fusaro (eds.), *How Constitutions Change. A Comparative Study*. Oxford and Portland, Oregon: Hart Publishing, p. 115-142, nw fq. 139-142;

⁸¹¹ Guerra, Luis Lopez (1994) 'The Role and Competences of the Constitutional Court, in The Role of the Constitutional Court in the Consolidation of the Rule of Law'. European Commission for

2. Në kuptim të këtij juridiksioni, dy mund të jenë rastet kur konstatohet kundërkushtetutshmëria: një, nëse ka një vendim individual që është *si i tillë* kundërkushtetues (shkelje e menjëhershme e kushtetutës); apo, dy, nëse një akt individual i një institucioni publik bazohet në një ligj i cili për çfarëdo arsye është kundërkushtetues (shkelja derivative e kushtetutës).⁸¹² Këto dy aspekte të kundërkushtetutshmërisë përbëjnë thelbin e “kërkesës së plotë kushtetuese (“echte”), e cila burimin e ka në të drejtën kushtetuese gjermane dhe sipas të cilës modelohet dispozita e nenit 113.7 e Kushtetutës së Kosovës. Të rralla janë vendet që njohin “kërkesën e plotë kushtetuese” (“echte”): shumica e shteteve e njohin vetëm “kërkesën jo të plotë kushtetuese” (“unechte”). Kjo e fundit nënkupton atë lloj të kërkesës ku individët dhe personat juridikë mund ta vënë në lëvizje gjykatën kushtetuese vetëm sa i përket llojeve të kufizuara të të drejtave, siç janë, ta zëmë, rasti i Maqedonisë dhe Shqipërisë, apo vetëm për segmente të caktuara të cenimeve të të drejtave dhe lirive themelore, ta zëmë, vetëm sa i përket aspekteve juridike të kërkesës individuale.⁸¹³
3. Në rekonstruktimin e këtij juridiksioni, sipas nenit 113.7, çështja e parë që duhet marrë në konsideratë është subjekti i autorizuar për të ngritur para Gjykatës këtë kontroll kushtetues. Ky paragraf përcakton që ‘individët’ janë e vetmja palë e autorizuar për ta ngritur këtë juridiksion. Koncepti individ, megjithatë, i shfrytëzuar në këtë kuptim, duhet dekonstruktuar në mënyrë që të përcaktohet nëse ai përfshin vetëm personat fizikë apo edhe ata juridikë. Në rastin *Universiteti AAB ShPK v. Qeveria e Republikës së Kosovës*,⁸¹⁴ Gjykata ka përcaktuar që koncepti individ i shfrytëzuar në kuptim të këtij juridiksioni përfshin jo vetëm personat fizikë por edhe ata juridikë. Prandaj, për aq sa është e mundur që personat juridikë të gëzojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me kushtetutë, ata janë gjithashtu të autorizuar që të ngrenë kontrollin kushtetues sipas këtij juridiksioni në Gjykatën Kushtetuese. Çështja e dytë që duhet konsideruar në kuptim të këtij juridiksioni, është koncepti i shterjes së mjeteve juridike përpara se çështja të bëhet proceduralisht legjitime për tu ngritur para Gjykatës Kushtetuese.
4. Në kuptim të juridiksionit sipas këtij paragrafi, personat mund të ngrejne çështje përpara Gjykatës Kushtetuese *vetëm pasi* të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, në të kundërtën, çështja nuk lejohet që të ngritet në Gjykatë. I rëndësishëm në komentimin e konceptit të *shterjes së mjeteve juridike* është precedenti gjyqësor i GjEDNJ-së, i cili është shumë i pasur me standarde në këtë

Democracy Through Law (Venice Commission), UniDem Seminar Bucharest, 8-10 June 1994, CDLSTD (1994) 010, [http://www.venice.coe.int/docs/1994/CDLSTD\(1994\)010_e.asp](http://www.venice.coe.int/docs/1994/CDLSTD(1994)010_e.asp);

⁸¹² Steinberger, Helmut (1993) ‘Models of Constitutional Jurisdiction’. European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), CDLSTD (1993) 002, point IV, para. 10;

⁸¹³ Cf. më shumë për këtë, një studim të thellë e të gjatë të Komisionit të Venedeikut: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission), *Study on Individual Access to Constitutional Justice* (Adopted by the Venice Commission at Its 85th Plenary Session: Venice, 17-18 December 2010). Study No. 538/2009 (Strasbourg, 27 January 2011);

⁸¹⁴ *Universiteti AAB - RIINVEST L.L.C, Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*. Rasti Nr. KI 41/09. Aktvendim për Papranueshmëri. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 27 janar 2010 (Nr. Ref.: RK 04/10);

fushë (megjithëse GjEDNj i shfrytëzon ato në kuptim të shterjes së mjeteve nacionale juridike). Prandaj, edhe komentimi ynë bazohet në të njëjtin burim. Gjykata Kushtetuese⁸¹⁵ e arsyeton konceptin e shterjes së mjeteve juridike përpara se çështja të mund të ngritet në Gjykatën Kushtetuese me argumentin e GjEDNj-së që së pari duhet lejuar që gjykatat e rregullta, por edhe institucionet shtetërore në përgjithësi, ta korrektojnë shkeljen e supozuar. Nëse ky sistem nuk funksionon, atëherë hyn në terren juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese si një gjykatë subsidiare. (Cf. rastet e GjEDNj-së: *Selmouni v. France* dhe *Azinas v. Cyprus*).⁸¹⁶ Me shterje të mjeteve juridike duhet nënkuptuar jo vetëm mjetet juridike në kuptim formal, siç janë ankesa, revizioni, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, etj., por edhe mjetet juridike në kuptim të shterjes së mundësisë, por pa sukses, për të paraqitur kërkesat e ndryshme në procedurat e rregullta ligjore para gjykatave dhe organeve tjera. Kjo nënkupton se parashtruesi i kërkesës individuale pranë Gjykatës Kushtetuese nuk do të ketë sukses në realizimin e kërkesës së vet nëse e njëjta kërkesë nuk është paraqitur (ngritur) me kohë në procedurat e rregullta ligjore para gjykatave dhe organeve tjera. Ky quhet efekti prekluziv i mosrespektimit të rregullësisë për shkeljen e të gjitha mjeteve (efektive) juridike para paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.

5. Në konsiderimin e shterjes së mjeteve juridike, GjEDNj ka kërkuar që aplikimi i rregullës të bëhet me fleksibilitet dhe pa shumë formalitet, sikur në *Kenneth LEHTINEN v. Finland*.⁸¹⁷ Për më tepër, në *Van Oosterwijck v. Belgium*,⁸¹⁸ GjEDNj ka përcaktuar që rregulla mbi shterjen e mjeteve juridike nuk është as *absolute* dhe as *automatike*, dhe që shterja e mjeteve juridike duhet shikuar në kuptim të rrethanave reale të parashtruesit të kërkesës. GjEDNj, në *Akdivar et al v. Turkey*,⁸¹⁹ gjithashtu ka përcaktuar që në vlerësimin e shterjes së mjeteve juridike nga ana e parashtruesit duhet vlerësuar jo thjeshtë aspekti formal i sistemit të mjeteve juridike, por edhe rrethanat e përgjithshme, sistemi juridik dhe politik në të cilin ka pasur akses parashtruesi, si dhe kontekstin personal të tij. Prandaj, GjEDNj kërkon që mjeti juridik të jetë si i *mundshëm* ashtu edhe *efektiv*, meqë, siç është thënë në *D. H. et al. v. The Czech Republic*,⁸²⁰ kërkohet të konstatohet nëse parashtruesi i ka shfrytëzuar mjetet që janë *pritur* se do të shfrytëzohen nga parashtruesi. Kjo është

⁸¹⁵ Cf. *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit të Panelit të Zgjedhjeve për Ankesa dhe Parashtrësia*. Rasti KI 22/11. Aplikues: Bojana Denic., A. No. 263/2010. Aktvendim për Pa pranueshmëri. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Datë: 19 maj 2011 (Ref. No.: RK 124/11);

⁸¹⁶ GjEDNj, *Selmouni v. France*, No. 25803/94, decision of 28 July 1999, ECtHR; dhe, GjEDNj, *Azinas v. Cyprus*, No. 56679/00, decision of 28 April 2004, ECtHR;

⁸¹⁷ GjEDNj, *Kenneth LEHTINEN v. Finland*, Application no. 39076/97, Decision as to Admissibility, Chamber of ECtHR (referring to the Cardot v. France judgment of 19 March 1991, Series A no. 200, 18, para. 34);

⁸¹⁸ GjEDNj, *Van Oosterwijck v. Belgium*. Judgment of 6 November 1980, Series A no. 40, para. 35, 18.

⁸¹⁹ GjEDNj, *Akdivar and Others v. Turkey* Judgment of 16 September 1996, Reports of Judgments and Decisions 1996-IV, p. 1210-1211, paras. 65-68;

⁸²⁰ GjEDNj, *D. H. et al. v. The Czech Republic*, Application no. 57325/00, Judgement, Grand Chamber, ECtHR, 13 November 2007, para. 116 (referring to İlhan v. Turkey [GC], no. 22277/93, para. 59, ECHR 2000-VII);

kështu sepse mund të ketë rrethana të tilla në të cilat, shfrytëzimi i mjetit juridik nga ana e aplikantit do ta vendoste atë në rrethana rreziku. Prandaj, në raste të tilla Gjykata mund ta aplikoj parimin që parashtruesi nuk ka pasur qasje në mjet juridik *të mundshëm dhe efektiv*, edhe t'ia pranoj parashtrësën pa i shtjerrur mjetet juridike.⁸²¹

6. Kjo qasje fleksibile ndaj shterjes së mjeteve juridike është shfrytëzuar nga Gjykata Kushtetuese p.sh. në rastin *Tome Krasniqi v. RTK et al.*,⁸²² ku Gjykata, për shkak të faktit që parashtruesi nuk mund të atakonte në gjyqësorin e rregullt një akt juridik të përgjithshëm në mënyrë direkte, kërkoj nga Gjykata që *shkeljen e supozuar direkte nga akti i përgjithshëm* t'ia vlerësonte kushtetutshmërinë edhe pa i shterur mjetet juridike në gjyqësorin e rregullt. E njëjtë ishte qasja edhe në rastin *Valon Bislimi v. Ministry of Interiors et al.*,⁸²³ ku Gjykata, për shkak që konstatoi që parashtruesi nuk kishte qasje në një mjet juridik efektiv, i lejoi shfrytëzimin e këtij juridiksioni edhe pa shterur ndonjë mjet juridik. Në *Bislimi v. Ministry of Interiors et al*, parashtruesi argumentoi që për shkak që ishte objekt i një shkeljeje të së drejtës së tij kushtetuese nga një *mosveprim* i shkaktuar përmes *heshtjes administrative* të Ministrisë së Brendshme, ai nuk kishte mundësi që aktin e *mosveprim*it ta ankimonte në sistemin e rregullt gjyqësor. Prandaj, Gjykata ia pranoi kërkesën si të pranueshme, me arsyetimin që parashtruesi nuk i ishte dhënë mundësia në qasje, në mjete efektive juridike *të pritshme* dhe *të mundshme*.
7. Një kusht tjetër sipas nenit 113.7 është që parashtruesi, në mënyrë që të autorizohet për të shfrytëzuar juridiksionin përkatës të Gjykatës, duhet që të jetë *prekur* nga një *shkelje* e një institucioni publik të shtetit. Me një fjalë, parashtruesi mund të iniciojë çështje individuale pranë Gjykatës *vetëm* nëse ka interes të drejtpërdrejtë në të. *Interesi i drejtpërdrejtë* për çështjen, sipas GjEDNj-së, vlerësohet të jetë atëherë kur parashtruesi është *viktimë* e një shkeljeje të një autoriteti publik. Prandaj, siç ka përcaktuar edhe GjEDNj në *Scordino v. Italy*,⁸²⁴ parashtruesi duhet të *dëshmojë* se është viktimë e një shkeljeje të së drejtës së tij kushtetuese, në mënyrë që të mund të hyjë nën tutelën e këtij juridiksioni. Megjithatë, vlerësimi nëse një palë është viktimë e një akti të një institucioni publik, siç është thënë nga GjEDNj në *Gorraiz Lizarraga et al. v. Spain*,⁸²⁵ duhet të bëhet në mënyrë të

⁸²¹ Shih psh: Barnstedt, Elke Luise (2009) 'Differences Between Constitutional Complaints That Challenge Court Rulings And Those That Challenge Statutes'. European Commission For Democracy Through Law. Fourth Conference of Secretaries General of Constitutional Courts and Courts of Equivalent Jurisdiction, Ankara, Turkey, 1-2 October 2009. Venice Commission. CDL-JU(2009)055 (page 2);

⁸²² *Tome Krasniqi kundër RTK et Al*. Vendim. Masë e Përkohshme (MP) në Rastin KI 11/09. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 16 tetor 2009. Nr. Ref.: MP 01/09;

⁸²³ *Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë*. Aktgjykim. Rasti KI 06/10. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 30 tetor 2010 (Nr. Ref.: AGJ 63/10);

⁸²⁴ GjEDNj, *Scordino v. Italy* (no. 1), Application no. 36813/97, Judgement, Grand Chamber, ECtHR, 29 March 2006 (para. 179);

⁸²⁵ GjEDNj, *Gorraiz Lizarraga et al. v. Spain*, Application no. 62543/00, Judgement, Chamber, 27 April 2004 (para. 38);

arsyeshme dhe liberale, në përputhje me gjendjen politike dhe rrethanat në shtetin ku është bërë shkelja e të drejtës së parashtruesit. Në anën tjetër, parashtruesi, sipas GjEDNj-së në *Amuur v. France*,⁸²⁶ duhet që të ketë qenë viktimë direkt në shkeljen e supozuar, në të kundërtën, nuk mund që të jetë palë e legjitimuar sipas nenit 113.7. Megjithatë, përcaktimi i viktimës së drejtpërdrejtë duhet të bëhet në një mënyrë jo të ngurtë, siç është thënë nga GjEDNj në *Karner v. Austria*,⁸²⁷ duke lënë mundësinë që nëse viktima e drejtpërdrejtë nuk ka mundësi shfrytëzimi të këtij juridiksioni, këtë ta bëjë viktima indirekte (p.sh. *McCann et al. v. The United Kingdom*).⁸²⁸ Për më tepër, për t'i dhënë qasje shumë të fuqishme në gjyqësor, GjEDNj në *Vijayanathan & Pusparajah v. France*,⁸²⁹ ka argumentuar që edhe vet bindja apo supozimi i parashtruesit që është viktimë e arsyeshme e një akti publik duhet që t'i vlerësohet nga ana e Gjykatës si e mjaftueshme për ta shfrytëzuar juridiksionin përkatës.

8. E rëndësishme sa i përket juridiksionit sipas nenit 113.7 është edhe gjerësia dhe natyra e veprimit të këtij juridiksioni. Fillimisht, duhet thënë që ky juridiksion është i tipit *ex post*, meqë mekanizmi i kontrollit kushtetues të një shkeljeje të supozuar individuale vihet në veprim vetëm pasi që pala të ketë absorbuar një pasojë që supozohet që i shkel asaj një të drejtë kushtetuese.⁸³⁰ Në këtë kuptim, ky juridiksion është i varur nga një situatë kundër kushtetuese që duhet të ketë ndodhur, situatë e cila mbulohet me një akt të një autoriteti publik, dhe mbi të cilën parashtruesi e ushtron të drejtën e tij të ankesës në Gjykatën Kushtetuese. Në kuptim të natyrës së këtij juridiksioni, Gjykata është e autorizuar që të kontrollojë vetëm kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik sa i përket të drejtave të njeriut dhe lirive njerëzore të garantuara me Kushtetutë. Kjo përfshin të gjitha të drejtat e garantuara me kushtetutë, si ato procedurale (ta zëmë, e drejta në gjykim të drejtë) ashtu edhe ato substanciale (ta zëmë, e drejtë në pronë ose e drejta në arsim).
9. I rëndësishë së veçantë në këtë aspekt është koncepti 'shkelje' e autoritetit publik ndaj një personi, si bazë mbi të cilën mund të iniciohet ushtrimi i këtij juridiksioni. Duhet thënë që, në parim, në mënyrë që shkelja e një të drejte apo lirie kushtetuese të ndodh, duhet që të ketë një veprim të një organi publik. Megjithatë, në kuptim të interpretimit të këtij juridiksioni, Gjykata, p.sh në *Bislimi v. Ministria e Brendshme*⁸³¹ dhe në *Trashëgimtarët e Ymer Loxhes dhe Sehit Loxhes v. Supreme*

⁸²⁶ GjEDNj, *Amuur v. France*, 17/1995/523/609, Judgement, Chamber, ECtHR, 25 June 1996 (para. 36);

⁸²⁷ GjEDNj, *Karner v. Austria*, Application no. 40016/98, Judgement, Chamber, ECtHR, 24 July 2003 (para. 25);

⁸²⁸ GjEDNj, *McCann et al. v. The United Kingdom*, Application no. 18984/91, Judgement, Grand Chamber, ECtHR, 27 September 1995;

⁸²⁹ GjEDNj, *Vijayanathan & Pusparajah v. France*, Application no. 17550/90; 17825/91, Judgement, Chamber, ECtHR, 27 August 1992 (para. 46);

⁸³⁰ Cf. Hasani, E et al (2012) 'Individual Complaint Mechanism as a Means to Protecting Fundamental Human Rights and Freedoms: The Case of the Constitutional Court of Kosovo'. *European Yearbook of Human Rights*. The Hague: Intersentia.

⁸³¹ *Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe*

Court,⁸³² ka vendosur parimin që jo vetëm shkelja kushtetuese e bërë përmes një veprimi të një institucioni publik, por edhe *heqja dorë* apo *abstenimi* i një institucioni publik për të ndërmarrë një veprim e cila si pasoj sjell një shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese është bazë për ushtrimin e këtij juridiksioni. Në kuptim të nenit 113.7, pra, *veprimi* dhe *mosveprimi* i një autoriteti publik mund të jenë shkaqe mbi të cilat kryhet *shkelja* kushtetuese, e cila është bazë për ushtrimin e autorizimit të palës për të ngritur çështjen para Gjykatës në kuptim të këtij neni.

10. Në kuptim të efektit juridik të vendimeve të Gjykatës të lëshuara sipas këtij juridiksioni, duhet thënë që, në kundërshtim me kontrollin kushtetues abstrakt ku vendimet kanë karakter *erga omnes* të veprimit, në këtë juridiksion vendimet e Gjykatës kanë efekt *inter partes*, për aq kohë sa objekti i vendimit është restaurimi i një të drejte apo lirie kushtetuese të palës të shkelur në një rast individual/konkret. Megjithatë, Gjykata nuk është e kufizuar në lëshimin e vendimeve *inter partes* kur ushtron juridiksionin sipas këtij neni. Kështu, ta zëmë, në rastin *Krasniqi v. RTK et al.*, Gjykata vepronte në kuadër të juridiksionit 113.7. Megjithatë, për të sanuar shkeljen kushtetuese individuale të palës, Gjykata ishte e detyruar që të pezullonte zbatimin e një akti juridik abstrakt. Prandaj, pjesa e vendimit që e invalidin aktin abstrakt për shkak të antikushtetutshmërisë ka karakter *erga omnes*, pavarësisht që jepet në kuadër të juridiksionit nga neni 113.7, ndërsa, pjesa që i referohet shkeljes specifike dhe restaurimit të të drejtës së adresantit, ka efekt juridik *inter partes*.
11. Në ushtrimin e këtij juridiksioni, megjithatë, Gjykata Kushtetuese nuk *shndërrohet* në një instancë të katërt gjyqësore. Megjithëse juridiksioni sipas këtij neni ka natyrë mjaft gjyqësore, vendimet e Gjykatës janë thjeshtë vlerësuese të kushtetutshmërisë së rastit. Si të tilla, vendimet sipas këtij juridiksioni bëhen të detyrueshme për gjyqësorin e rregullt, dhe ky i fundit nuk e humb juridiksionin në rigjykimin e tyre. Por, rigjykimi i rastit, pastaj, duhet të bëhet në linjë me rekomandimet (gjetjet) kushtetuese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duke bërë që juridiksioni i gjyqësorit të rregullt realisht të *mos huazohet* në asnjë mënyrë nga Gjykata Kushtetuese.⁸³³
12. Është e rëndësishme të argumentohet pse Kushtetuta nuk lejon hapësirë për një *actio popularis*. Ky juridiksion nuk përbën një *actio popularis* për parashtruesit, dhe këtë për dy arsye: një, sepse në fitimin e autorizimit për të ankimuar një *shkelje kushtetuese* në Gjykatën Kushtetuese, parashtruesi duhet që të ketë qenë *viktimë* e shkeljes së tillë, dhe të ketë interes direkt në rastin. Kjo përbën kusht

Ministrisë së Drejtësisë. Aktgjykim. Rasti KI 06/10. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 30 tetor 2010 (Nr. Ref.: AGJ 63/10);

⁸³² *Trashëgimtarët e Ymer Loxhës dhe Sehit Loxhës kundër Vendimit Nr. PKL Nr. 21 /07 të Gjykatës Supreme të republikës së Kosovës*. Rasti Nr. 14/09., i datës 17 dhjetor 2008. Vendim për Papranueshmëri. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Datë: 15 tetor 2010 (Nr. Ref.: RK 47/10);

⁸³³ Shih p.sh: Garlicki, Lech (2007) 'Constitutional Courts Versus Supreme Courts'. *International Journal of Constitutional Law*. Vol. 5 (1): p. 44-68;

procedural sipas nenit 113.7; dhe dy, sepse në fitimin e autorizimit për të ankimuar një *shkelje kushtetuese*, parashtruesi duhet që parimisht të *faktoj* që një akt individual (qoftë në formë të veprimt apo mosveprimt) i institucionit publik ngërthen shkeljen e të drejtës apo lirisë së tij kushtetuese. Me rastin *Krasniqi v. RTK*, Gjykata ka vendosur një mekanizëm inovativ të konsiderimit të kësaj çështjeje: megjithëse e aktivizuar sipas juridiksionit të nenit 113.7, Gjykata pranoi të gjykonte çështjen me kërkesën e palës që pohonte se *ishte privuar nga një e drejtë kushtetuese në mënyrë të drejtpërdrejt nga një ligj*. Në këtë rast, prandaj, objekti i kontestit mbi të cilin parashtruesi e argumentonte shkeljen e të drejtës së tij kushtetuese ishte një ligj i parlamenti (përkatësisht, një akt juridik abstrakt). Gjykata inovoj një lloj gjysmë-*actio-popularis*, duke lejuar që megjithatë një parashtrues të mund të kontestoj kushtetutshmërinë e një ligji nëse *ligji në fjalë është direkt burim i shkeljes së të drejtës së tij/saj kushtetuese*. Nga kjo del se, në kuptim të *Krasniqi v. RTK*, shfrytëzimi i juridiksionit të nenit 113.7 nga ana e një parashtruesi individual, për të kontestuar kushtetutshmërinë e një ligji për shkak të shkeljes së një të drejte të tillë, është i lejueshëm për aq kohë sa parashtruesi është në gjendje të argumentojë që është *viktimë direkte* e një normë abstrakte që i shkel atij një të drejtë kushtetuese. Jo vetëm kaq. Në kuptim të rastit *Krasniqi v. RTK*, një parashtrues individual (person fizik apo juridik), mund të kontestojë para Gjykatës kushtetutshmërinë e një akti abstrakt me kusht që:

- a) parashtruesi është viktimë e një akti të përgjithshëm, për shkak se i është shkelur një e drejtë kushtetuese;
- b) parashtruesi është në gjendje të argumentojë që akti i tillë i përgjithshëm përbën *veprim* direkt në shkeljen e të drejtës së tij kushtetuese;
- c) parashtruesi është dhe ka *interes direkt* në restaurimin e shkeljes së tillë, dhe që akti abstrakt që përbën shkelje të së drejtës së tij kushtetuese është efektiv, dhe nuk ka mjet tjetër efektiv për të kërkuar shfuqizimin e tij.

13. Në ushtrimin e këtij juridiksioni, siç është vendosur edhe në rastin *Krasniqi v. RTK*, Gjykata është e lirë që *sua sponte*, përderisa është në zgjidhje të kërkesës së parashtruesit, *ultra petitem* të vlerësojë dhe të hap rrethin e akteve juridike që *Gjykata mendon* se janë duke shkaktuar shkeljen e paraqitur nga pala. Prandaj, në ushtrimin e këtij juridiksioni, Gjykata mund të veprojë *ultra petitem*, dhe të kontrollojë edhe kushtetutshmërinë e akteve tjera juridike, pavarësisht nëse janë objekt i kërkesës së palës, derisa *bindshëm* të jetë arsyetuar që shkelja e pretenduar nga ana e parashtruesit është sanuar.

Neni 113.8

1. Neni 113.8 përcakton juridiksionin *incidental* të Gjykatës Kushtetuese, që nënkupton veprimin e Gjykatës në ushtrimin e kontrollit abstrakt sipas iniciativës së një gjykate të rregullt. Ky nen përcakton që gjykatat e rregullta mund t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese pyetje në lidhje me kushtetutshmërinë e një ligji, të cilin gjykata në fjalë është duke e zbatuar në një rast individual (konkret) para saj, dhe ku gjykata në fjalë është e pasigurt një rast individual (konkret) para saj, dhe ku gjykata në fjalë është e pasigurt në lidhje me kushtetutshmërinë e ligjit në fjalë,

prej së cilës varet edhe rezultati i rastit që është duke u zgjidhur prej gjykatës referuese. Juridiksioni incidental, në fakt, është hapësirë ku gjykatat e rregullta, duke u bazuar në një rast konkret që lind para tyre në kuptim të interpretimit të ligjit, e iniciojnë çështjen e kushtetutshmërisë së ligjit në fjalë para Gjykatës Kushtetuese. Juridiksioni incidental përbën mekanizmin që mundëson ndarjen e funksioneve të gjykatave të rregullta dhe Gjykatës Kushtetuese, dhe ku gjykatat e rregullta nuk vazhdojnë me zbatimin e një ligji para se ta kenë kërkuar qartësimin e kushtetutshmërisë së tij nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Sistemet e gjyqësisë kushtetuese me sistem incidental janë ato që kanë një ndarje në mes të gjyqësisë së rregullt dhe gjykatës kushtetuese, dhe ky lloj i juridiksionit nuk gjendet në modelin e decentralizuar të gjyqësisë kushtetuese.

2. Në kuptim të nenit 113.8, juridiksioni *incidental* i Gjykatës mund të aktivizohet nga cilado gjykatë e rregullt e Republikës së Kosovës, me kusht që ligji, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit kërkohet, është burim referimi për çështjen që është duke u zgjidhur nga ana e gjykatës së rregullt në fjalë. Me iniciimin e kërkesës për kontroll të kushtetutshmërisë së një ligji, gjykata e rregullt obligohet që të mos nxjerrë vendimin përkitazi me rastin në fjalë përpara se ligji të ketë kaluar filtrin e Gjykatës Kushtetuese. Duhet thënë që, në kuptim të këtij paragrafi, vetëm gjykatat e rregullta, përkatësisht gjyqtarët/kolegjet e gjyqtarëve që janë duke gjykuar një çështje, kanë të drejtë të ushtrojnë iniciativën e kontrollit kushtetues të ligjeve sipas këtij juridiksioni, dhe se kjo e drejtë nuk u takon palëve në rastin që është duke u zgjidhur nga gjykata e rregullt.
3. Në disa sisteme kushtetuese, kërkesa e palëve e detyron gjykatën që menjëherë t'i ndalë procedurat që janë në vijim para saj dhe ta referoj çështjen në gjykatën kushtetuese. Ky nuk është rasti në Kosovë sepse gjykata e rregullt e çështjes ka diskrecion të plotë për të vendosur mbi referimin apo jo të çështjet në gjykatën kushtetuese. Por, nëse gjykata e rregullt refuzon kërkesën, atëherë ajo duhet ta arsyetoj mirë atë dhe ta konstatoj përmes procesverbalit sepse, në të kundërtën, vendimi për refuzim mund të shpallet më vonë si vendim që ka cenuar të drejtat dhe liritë kushtetuese.⁸³⁴
4. Në vijim, për sa u tha më sipër, në ushtrimin e këtij juridiksioni në disa vende, gjykata kushtetuese detyrohet të shqyrtoj edhe çështje *fakti*, jo thjeshtë vetëm çështje juridike, meqë kërkesa e parashtruesit mundet që t'i referohet fakteve që kanë sjellë tek shkelja e së drejtës kushtetuese të parashtruesit.⁸³⁵ Ky nuk është

⁸³⁴ Cf. më shumë për aspekte komparative të kësaj çështjeje ashtu siç zbatohen në vendet tjera në: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission). *Study on Individual Access to Constitutional Justice* (Adopted by the Venice Commission at Its 85th Plenary Session: Venice, 17-18 December 2010). Study No. 538/2009 (Strasbourg, 27 January 2011);

⁸³⁵ Shih p.sh.: Smith, Eivind (2005) 'Courts of people, not of norms? Law and fact in constitutional review as performed by courts of general or administrative jurisdiction'. International Conference Law and Fact in Constitutional Jurisprudence, 30 June-1 July 2005, Vilnius, Lithuania. Venice Commission. CDL-JU(2005)022 (p. 4);

rasti në Kosovë, ku Gjykata duhet të kufizohet vetëm në çështjet juridike duke i lënë çështjet faktike për zgjedhje gjykatave të rregullta.⁸³⁶

5. Juridiksioni *incidental* i Gjykatës Kushtetuese, prandaj, përbën një procedurë ku gjyqësori i rregullt komunikon me Gjykatën Kushtetuese, përmes së cilit gjyqësori i rregullt gjithashtu e luan rolin e një iniciatori të kontrollit të kushtetutshmërisë dhe uniformitetit të rendit juridik. Shikuar në këtë kuptim, sipas logjikës së nenit 113.8, gjykatat e rregullta nuk kanë autoritet për të vendosur në lidhje me kushtetutshmërinë e çështjeve, dhe se ky funksion bëhet monopol i Gjykatës Kushtetuese.⁸³⁷

Neni 113.9

1. Ky nen përcakton që kryetari i Kuvendit *duhet* të referoj amendamentet e propozuara kushtetuese, para miratimit të tyre në Kuvend, në Gjykatën Kushtetuese për t'i kontrolluar nëse ato zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës. Ky paragraf, prandaj, përbën juridiksionin e kontrollit të amendamenteve kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese, i cili vihet në veprim *detyrueshëm* sa herë që propozohen amendamente kushtetuese sipas procedurës së amandamentimit të Kushtetutës.⁸³⁸
2. Në kuptim të këtij paragrafi, dy janë çështjet që duhet komentuar. Një, hapësira e veprimit të Gjykatës në kuptim të kontrollit nëse amendamentet e propozuara kushtetuese zvogëlojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës; dhe, dy, nëse vendimi i Gjykatës për mospërputhshmëri në rastin konkret prodhon efekt juridik të detyrueshëm për Kuvendin. Sa i përket çështjes së parë, Gjykata në parim është e autorizuar që të kontrollojë *thjeshtë* dhe *vetëm* përputhshmërinë e amendamenteve të propozuara kushtetuese dhe Kapitullit II të kushtetutës. Megjithatë, duhet thënë që Kapitulli II i kushtetutës, që përbën listën e të drejtave dhe lirive të garantuara nga kushtetuta, duhet të interpretohet në linjë me detyrimin e nenit 53 të kushtetutës (që kërkon *ndjekjen* e detyrimeve të

⁸³⁶ Si shembull krahasues nga juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese çeke, në përputhje me praktikën gjyqësore konsistente të saj, Gjykata Kushtetuese çeke ka vendosur që nuk i rishqyrton provat e shqyrtuara nga gjykatat e rregullta. Megjithatë, në rrethanat kur një aktgjykim dënues bazohet vetëm në një dëshmi të tërthortë (rrethanore), veç kësaj, të karakterit thjesht mbështetës apo subsidiar, dhe kur gjykata ka refuzuar t'i shqyrtojë provat tjera të ofruara nga i padituri, gjykata e rregullt i ka shkelur të drejtat dhe liritë fundamentale të të paditurit, të garantuara me Kushtetutë (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke I. US 394/97 i datës 4.3.1998);

⁸³⁷ Shih logjikën e njëjtë të argumentuar nga: Kelsen, Hans (1942) 'Judicial Review of Legislation: A Comparative Study of the Austrian and the American Constitution'. *Journal of Politics*. Vol 4: p. 185-186.

⁸³⁸ Si një shembull krahasues mbi rëndësinë e regjimit paraprak kushtetues, Gjykata Kushtetuese e Republikës Jug-Afrikane refuzoi ta certifikojë Kushtetutën e Republikës Jug-Afrikane të vitit 1996, pasi që një numër dispozitave nuk ishin në përputhje me Parimet Kushtetuese të Kushtetutës që përmbante Kushtetuta (e përkohshme) e Republikës Jug-Afrikane e vitit 1993, (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Jug-Afrikane CCT 23/96 i datës 6.9.1996);

precedentit gjyqësor të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) dhe instrumenteve juridike ndërkombëtare të garantuara me nenin 22 të Kushtetutës. Shikuar në këtë kuptim, hapësira juridiksionale e Gjykatës sa i përket kontrollit përkatës të përputhshmërisë është shumëfish më e gjerë se sa që mund të duket në shikim të parë. Precedenti gjyqësor i GjEDNj-së, instrumentet ndërkombëtare të kushtetutëzuar dhe precedentet gjyqësore/interpretuese të lidhura me to përbëjnë një hapësirë tejet të gjerë mbi të cilën duhet që të interpretohet Kapitulli II i Kushtetutës. Kjo nënkupton se kontrolli i përputhshmërisë së amendamenteve kushtetuese të propozuara me Kapitullin II të Kushtetutës përbën një terren që ngërthen në vete jo thjeshtë një listë të drejtash dhe lirisht të njeriut, por një terren standardesh ndërkombëtare të cilat duhet të shërbëjnë si bazë për interpretim të të drejtave dhe lirive kushtetuese. Kjo praktikisht nënkupton se çdo interpretim, siç e tham më heret, duhet të bëhet duke respektuar letrën, frymën dhe shpirtin e Kushtetutës së Kosovës, e kuptuar si një tërësi organike e modeluar sipas standardeve të konstitucionalizmit modern.

3. Sa i përket çështjes së efektit juridik të vendimit të Gjykatës nëse konstaton mospërputhshmëri në mes të amendamentit të propozuar dhe Kapitullit II, duhet thënë që neni 113.9 është i ndërtuar në formë të një detyrimi pozitiv që *ndalon* amendamentimin e Kushtetutës nëse kjo i pakëson të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara në Kapitullin II. Prandaj, Kuvendi është i lidhur me vendimin e Gjykatës sa i përket përputhshmërisë së tillë, dhe *i ndalohet* që t'i procedoj për votim amendamentet e propozuara të cilat janë konstatuar si të tilla që pakësojnë liritë dhe të drejtat e njeriut sipas Kapitullit II të Kushtetutës.
4. Në anën tjetër, detyrimi *rrjedhës* që prodhohet nga ky juridiksion është që amendamentet kushtetuese nuk *mund* të ndryshojnë/shfuqizojnë *as* vendime të Gjykatës Kushtetuese të cilat ushtrojnë interpretime të të drejtave dhe lirive të njeriut sipas Kapitullit II. Në përgjithësi, prandaj, neni 113.9 jepet në formë të një detyrimi pozitiv për Gjykatën, i cili nënkupton gjithashtu *ndalesën* që amendamentet kushtetuese të pakësojnë të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara në Kapitullin II. Në këtë kuptim, Gjykata vihet në funksionin e një garantuesi që amendamentet kushtetuese të mos pakësojnë të drejtat e njeriut, por që në aspektin e standardeve ndërkombëtare, në ndërlidhmëri edhe me nenet tjera të cituara më lartë, kjo duhet shikuar edhe si ndalesë që amendamentet kushtetuese të pakësojnë standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.
5. Deri më tani, në Gjykatën Kushtetuese ka pasur dy raste kur është vendosur mbi kushtetutshmërinë e amendamenteve të propozuara kushtetuese. Në rastin e parë, Gjykata ka vendosur për kushtetutshmërinë e amendamenteve kushtetuese që përfundonin pavarësinë e mbykqyrur të Kosovës të përcaktuar nga Plani Ahtisari i marsit të vitit 2007⁸³⁹. Në këtë rast, Gjykata pat gjetur se shumica e tyre nuk

⁸³⁹ *Vlerësimi i kushtetutshmërisë së propozimeve të Qeverisë për amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më datën 12 prill 2012. Aktgjykim në Rastin KO 38/12, (Nr. ref.:K 234 /12), Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë 15 maj 2012;*

cënonin dispozitat e Kapitullit II të Kushtetutës, por as dispozitat e Kapitullit III dhe vlerat e parimet tjera kushtetuese. Në rastin e dytë, ndërkaq, Gjykata anuloi mbi gjashtëdhjetë për qind (60 %) të amendamenteve të propozuara sepse si të tilla binin ndesh me Kapitujt II dhe III, si dhe me parimet e vlerat tjera kushtetuese. Më i rëndësishmi nga këto amendamente antikushtetuese është amendamenti dhjetë (10), i cili synonte të ndërpriste mandatin pesëvjeçar (5) të shefit kosovar të shtetit përmes përdorimit të teknikës juridike të amendamentit kushtetues. Këtë përpjekje për konstitucionalizim të konjunkturave politike momentale e pengoi Gjykata me Aktgjykimin në Rastet K.O. 29/12 dhe K.O. 48/12, të datës 20 korrik 2012 (Nr. Ref. AGJ 284/12), me të cilin shpallte antikushtetues, siç u tha, mbi gjashtëdhjetë për qind (60%) të amendamenteve, duke përfshirë edhe amendamentin dhjetë (10).⁸⁴⁰

Neni 113.10

1. Neni 113.10 përcakton që juridiksioni shtesë i Gjykatës Kushtetuese, përveç këtij të përcaktuar me nenin 113, mund të përcaktohet me ligj. Ky paragraf, prandaj, i jep mundësinë Kuvendit që të përcaktoj juridiksion shtesë për Gjykatën. Kjo, megjithatë, duhet lexuar edhe si ndalesë që Kuvendi të mund të zvogëlojë apo heq juridiksionin e përcaktuar me nenin 113.⁸⁴¹ Duhet thënë që, në ushtrimin e të drejtës së tij për të caktuar juridiksion shtesë me anë të ligjit, Kuvendi i nënshtrohet juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese për kontroll të kushtetutshmërisë së ligjeve. Kjo nënkupton se Gjykata është gjithashtu e autorizuar që të kontrollojë nëse ligji për juridiksion shtesë, i iniciuar për kontroll kushtetues përmes një pale të autorizuar, është në përputhje me parimet kushtetuese, dhe nëse eventualisht cenon ndonjë standard të funksionit të saj kushtetues.

Neni 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese]

- (1) **Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë, të cilët do të jenë juristë të shquar dhe personalitete me moralin më të lartë, jo me më pak se dhjetë (10) vjet përvojë profesionale përkatëse. Kualifikimet e tjera përkatëse rregullohen me ligj. Parimet e barazisë gjinore do të respektohen.**
- (2) **Gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit, për një mandat nëntëvjeçar, pa mundësi vazhdimi.**

⁸⁴⁰ *Vlerësimi i kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara kushtetuese nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 23 mars dhe 4 maj.* Aktgjykim në Rastet KO 29/12 dhe KO 48/12 (Nr. Ref.: AGJ 284/12), Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 20 korrik 2012;

⁸⁴¹ Si shembull krahasues, Gjykata Supreme Federale e Brazilit në vendimin ADI 2.797 theksoi se një ligj statusor nuk mund të zgjërojë kompetencat në fushën e juridiksionit kushtetues. Çdo ligj që i interpreton dispozitat kushtetuese uzurpon kompetencat e Gjykatës Supreme Federale, (Vendim i Gjykatës Supreme Federale të Brazilit ADI 2.797 i datës 15.9.2005);

- (3) **Vendimi për të propozuar shtatë (7) nga gjyqtarët, varet nga miratimi i dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë. Vendimi për të propozuar dy (2) gjyqtarët e tjerë, merrret me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, por që mund të bëhet vetëm pas pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët i mbajnë vendet që janë rezervuar ose garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.**
- (4) **Nëse mandati i gjyqtarit përfundon para mbarimit të mandatit të rregullt, emërimi i gjyqtarit të ri bëhet në pajtim me këtë nen, me mandat të plotë, pa të drejtë rizgjedhjeje.**
- (5) **Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Gjykatës Kushtetuese, bëhet nga gjyqtarët të Gjykatës Kushtetuese me votim të fshehtë të gjyqtarëve të Gjykatës, për mandat trevjeçar. Zgjedhja në këto funksione nuk e zgjat mandatin e gjyqtarit.**

Neni 114

1. Neni 114 përcakton përbërjen e Gjykatës Kushtetuese, mandatin kohor të gjyqtarëve, si dhe procedurën dhe kriteret për emërimin e gjyqtarëve. Ky nen, po ashtu, përcakton edhe disa çështje bazike mbi organizimin e brendshëm të Gjykatës.⁸⁴²

Neni 114.1

1. Neni 114.1 përcakton që Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë (9) gjyqtarë, të cilët veprojnë në kolegji dhe në seanca plenare. Gjykata Kushtetuese është organ kolegjal, e cila merr vendimet e saj në seancë plenare me shumicën e votave. Kolegjet shqyrtuese, ndërkaq, nuk janë vendimmarrës. Ky paragraf vendos tre kushte sa i përket kandidatëve për pozitën e gjyqtarit kushtetues,⁸⁴³ që janë: një, që kandidati për gjyqtar kushtetues të jetë jurist i shquar, dy, që kandidati për gjyqtar kushtetues të ketë personalitet të lartë, dhe tre, që kandidati për gjyqtar kushtetues të ketë jo më pak se 10 vite përvojë pune. Përveç këtyre kushteve, ky paragraf përcakton që kriteret tjera mund të vendosen me ligj. Sa i përket kushtit të parë, karakteristika ‘jurist i shquar’ të cilës i referohet ky paragraf nënkupton një kandidat që ka vlera krahasueshmërisht dhe bindshëm të larta profesionale në fushën e drejtësisë në përgjithësi. Duhet pasur parasysh që pozita gjyqtar

⁸⁴² Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë, si shembull krahasues, theksoi se kandidatura e një anëtari të Gjykatës Kushtetuese për president të Republikës Federale nuk e diskualifikon atë automatikisht nga ushtrimi i funksionit në Gjykatë Kushtetuese, e as nuk përbën bazë të mjaftueshme për ta vënë në dyshim paanshmërinë e tij (Vendimi i Gjykayës Kushtetuese të Republikës Federale Gjermane Nr. 1BvR 1693/92 i datës 8 shkurt 1994);

⁸⁴³ Si një shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Belgjikës ka vendosur që pjesëmarrja e një deputeti në elaborimin e një ligji që është kontestuar në Gjykatën Kushtetuese, që konsiston në përkrahjen e shumicës parlamentare së cilës i përkiste duke votuar për ligjin dhe kundër amandamenteve të paraqitura nga opozita, nuk është arsyeim objektiv i mjaftueshëm për dyshimet e parashtruesve sa i përket aftësive së tij pasuese që si gjyqtar të shqyrtojë paanshmërinë dhe kushtetutshmërinë e ligjit të kontestuar (Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Belgjikës (atëbotë quhej: Gjykata e Arbitrazhit), Nr. 35/94 i datës 10 maj 1994).

kushtetues, në kuptim të vet rolit të gjyqësisë kushtetuese, nënkupton jurist të shquar jo thjeshtë në aspektin teknik, siç mund të jenë gjyqtarët dhe avokatët e rëndomtë, por juristë të natyrës filozofike.

2. Duhet thënë këtu që gjyqësia kushtetuese natyrshëm kërkon aftësi juridike jo thjeshtë të nivelit të teknikës së konstruksionit të normës, por edhe të natyrës filozofike dhe prapavijës teorike të normës kushtetuese. Shumica e normave kushtetuese, megjithëse nga jashtë duket se kanë shumë pak kuptim tekstual/teknik, ato referojnë tek koncepte që janë zhvilluar me shekuj si në kuptimin teorik ashtu edhe në atë filozofik, interpretimi i të cilave kërkon aftësi që shkojnë përtej interpretimit teknik të normës juridike. Shikuar në këtë kontekst, koncepti 'jurist i shquar' i shkruar në këtë paragraf është referim për tek aftësitë përtej anës teknike të së drejtës, duke përfshirë edhe aspektet teorike dhe filozofike mbi bazën e së cilave janë zhvilluar konceptet kushtetuese, të cilat, megjithatë, mund të duken shumë teknike në shikim të parë. Prandaj, koncepti 'jurist i shquar' i shfrytëzuar në këtë normë, dallon thelbësisht nga karakteristika e juristit që kërkohet të ushtrojë profesionin e gjyqtarit të rregullt, dhe se kjo ngërthen në vete një pamje shumëfish më komplekse të shkencës juridike dhe filozofisë së të drejtës. Rasti gjerman i gjyqësisë kushtetuese është shembull shumë i mirë, në të cilin më shumë se 75% e gjyqtarëve janë profesorë/akademik të fushës së tillë, jashtë rrethit të rregullt gjyqësor.
3. Sa i përket kushtit të dytë, koncepti 'personalitet me vlera të larta morale' është referim për tek pastërtia e figurës së kandidatit që do ta ushtrojë detyrën e gjyqtarit kushtetues, që nënkupton një personalitet të pranueshëm publikisht si të ndershëm dhe të besueshëm moralisht për të ushtruar funksionin e tillë. Sa i përket kushtit të tretë, kandidati duhet që të ketë pasur së paku 10 vite përvojë pune profesionale. Sikur në rastin e kushtit të parë, kjo nënkupton një përvojë pune që shkon përtej kërkesës së profesionit të një juristi teknik, dhe përfshin një prapavijë profesionale që ngërthen në vete detyrimisht edhe vlera të terrenit teorik dhe filozofik. Historia e gjyqësisë kushtetuese të ish vendeve komuniste ka treguar se sukcesi më i madh është arritur në ato raste kur gjykatat kushtetuese kanë qenë të përbëra jo nga gjyqtarë të rregullt, avokatë dhe juristë tjerë teknik por nga personalitetet e jetës akademike dhe të papërvojë dogmatike në punët e gjyqësorisë të rregulltë.⁸⁴⁴

⁸⁴⁴ Cf. Për një analizë të shkëlqyer të përvojave të të gjitha vendeve ish komuniste, si dhe për rolin dhe pozitën e gjykatave kushtetuese gjatë tranzicionit, duke përfshirë këtu krahasimin e tyre me vendet e përparuara perëndimore, shih më shumë në: Schwartz, Herman (2000) 'The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe'. Chicago: The University of Chicago Press, p. 1 - 21 dhe 226-248; Gonenc, Levent (2002) 'Prospects for Constitutionalism in Post-Communist Countries'. The Hague: Kluwer Law International, në veçanti kapitujt 1 ("Conceptual Framework") dhe 3 ("Constitution-Making"), fq. 3-25 dhe 103-208; Massias, Jean - Pierre (2008) 'Droit constitutionnel des Etats d'Europe de l'Est' (2e édition). Paris: Presses Universitaires de France, p. 13- 63; Mezzeti, Luca (2011) (ed.), *Sistemi e Modeli di Giustizia Costituzionale*. Tomo I (CEDAM: Padova, 2009) et Tomo II. Padova: CEDAM, pjesët e autorëve që flasin për vendet ish komuniste (kapitujt 10, 11, dhe 18 të vëllimit të I-rë, dhe kapitulli 5 i vëllimit të II-të).

Neni 114.2 dhe 114.3

1. Neni 114.2 dhe 114.3 përcaktojnë procedurën e zgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues dhe subjektet e autorizuar për të vënë propozimin e tyre dhe për t'i emëruar ato. Sipas neneve në fjalë, gjyqtarët kushtetues propozohet nga ana e Kuvendit dhe emërohen nga ana e Presidentit të Republikës për një mandat nëntëvjeçar,⁸⁴⁵ pa mundësi vazhdimi.⁸⁴⁶ Prej nëntë gjyqtarëve që ka Gjykata, shtatë nga gjykatësit propozohen përmes një vendimi prej 2/3 të Kuvendit *të pranishëm dhe që votojnë*. Dy gjyqtarët tjerë propozohen nga shumica e deputetëve të pranishëm, pasi që të kenë marrë pëlqimin e shumicës së deputetëve që mbajnë vendet që janë rezervuar apo garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
2. Shikuar në kuptimin e përgjithshëm, gjyqtarët kushtetues kërkohet që të propozohen nga një shumicë e kualifikuar parlamentare, e cila natyrshëm që është shumëfish më e lartë se sa shumica që bart *zakonshëm* një qeveri e koalicionit. Propozimi që rrjedh nga Kuvendi, meqë duhet të mbërrij shkallën prej 2/3 të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, është i prirur të jetë *konsensual*, në kuptimin që asnjë parti politike (apo as koalicioni që kontrollon qeveria) të mos mund ta votojë e vetme. Në këtë kuptim, propozimi për emërimin e gjyqtarëve kushtetues duhet që të jetë konsensual, dhe, natyrshëm, një vendim i tillë konsiderohet juridikisht si neutral dhe i pakontrollueshëm nga një parti apo koalicioni i vetëm. Ky në fakt është një garancion kushtetues që kandidatët e zgjedhur për gjyqtar kushtetues të jenë figura konsensuale, në kuptimin që një shumicë e kualifikuar parlamentare t'i sheh si të denjë për ta ushtruar këtë funksion jashtë ndikimeve eventuale politike.
3. Pas marrjes së propozimit të Kuvendit, Presidenti i Republikës *duhet* të bëjë emërimin e gjyqtarëve kushtetues. Pyetje me rëndësi për këtë kontekst është nëse Presidenti i Republikës mund të refuzojë një propozim të Kuvendit? Kushtetuta nuk jep ndonjë përgjigje të qartë për këtë, megjithatë, për aq kohë sa Presidenti i Republikës vishet me të drejtën e *emërimit*, natyrshëm që mund edhe ta ushtroj të drejtën e refuzimit të emërimit të një propozimi të Kuvendit. Në ushtrimin e kësaj të drejte, megjithatë, Presidenti i Republikës duhet të arsyetojë që një nga kushtet e kërkuara nga kushtetuta për kandidatët për gjyqtar kushtetues nuk është zbatuar. Në të kundërtën, Presidenti është i detyruar ta bëjë emërimin sipas propozimit të Kuvendit. Kjo mundësi për refuzim të emërimit dhënë Presidentit bëhet edhe më e

⁸⁴⁵ Kjo është shumë e ngjashme me shumicën e vendeve tjera post-komuniste: Ludwikowski, Rett R (2000) 'Constitutional Culture of the New East-Central European Democracies'. *Georgia Journal of International & Comparative Law*. Vol. 29 (1): p. 24; Megjithatë, në rastin rus, gjyqtarët kushtetues kanë mandate 12 vjeçar. Shih: Weisman, Amy J. (1995) 'Comment, Separation of Powers in Post-Communist Government: A Constitutional Case Study of the Russian Federation'. *American University Journal of International Law and Policy*. Vol. 10 (4): p. 1365-1398;

⁸⁴⁶ Kjo është e ngjashme me shumicën e vendeve tjera post-komuniste: Cholewinski, Ryszard (1998) 'The Protection of Human Rights in the New Polish Constitution'. *Fordham International Law Journal*. Vol. 22 (2): p. 236-291;

arsyeshme nëse kihet parasysh fakti se propozimet për kandidat nuk vijnë nga një trup profesional, siç është rasti, ta zëmë, me Këshillin Gjyqësor, por nga një organ krejtësisht politik, përfaqësues dhe jo profesional. Por, siç u cek, Presidenti duhet çdo refuzim ta arsyetojë deri në detaje meqë bëhet fjalë për një të drejtë kushtetuese individuale. Kjo nënkupton se çdo vendim i Presidentit për refuzim mund të përfundoj për kontroll gjyqësor të ligjshmërisë së tij sipas rregullave mbi konfliktin administrativ dhe, më pas, në kontroll të kushtetutshmërisë së tij pranë Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.

Neni 114.4

1. Neni 114.4 përcakton që nëse mandati i një gjyqtari kushtetues përfundon para mandatit të rregullt kohor, emërimi i një gjyqtari të ri bëhet sipas të njëjtit nen, dhe pa të drejtë rizgjedhjeje. Në këtë kuptim, emërimi i një gjyqtari të ri pas mbetjes së vendit vakant para kohe, duhet të bëhet sipas së njëjtës procedurë. Në vendet ish komuniste, zvarritja e zgjedhjes së gjyqtarëve të ri me qëllim të plotësimit të vendeve vakante ka qenë fenomen shqetësues. Kjo zvarritje ka ndodhur si pasojë e synimeve të politikës për t'i futur në gjykatë kushtetuese njerëzit me lojalitet politik. Në disa raste, ta zëmë rasti i Shqipërisë (1992-1997), Ruisë (1995-1999), Bjellorusisë (deri më tani që nga themelimi), etj., politika ka pasur sukses. Në rastet më të suksesshme dhe më tragjike llogaritet rasti hungarez pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2011. Me këtë rast, Gjykata Kushtetuese e Hungarisë, nga një gjykatë e cila kishte qenë shembull i krejt vendeve ish komuniste, u kthye në një institucion pa ndikim dhe në një hije të asaj çfarë kishte qenë.⁸⁴⁷ Në rastet tjera, ky sukses nuk ka qenë i thellë përkundër përpjekjeve të mëdha të politikës (ta zëmë, rasti i Sllovakisë gjatë kohës së kryeministrit Meciar). Në disa vende, zvarritja e pafund është zgjidhur duke lejuar gjyqtarët me mandat të skaduar që të vazhdojnë punën e tyre si gjyqtarë deri në zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj. Në rastin e Kosovës ka pasur zvarritje njëvjeçare kur në qershor të vitit 2012 u bë zgjedhja e vetëm njërit prej dy gjyqtarëve sa duheshin zgjedhur për vendet vakante.

Neni 114.5

1. Neni 114.5 përcakton që kryetari dhe zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga vet gjyqtarët kushtetues, me anë të votimit të fshehtë, për një mandat trevjeçar. Zgjedhja në funksione drejtuese të Gjykatës, në të dy rastet, nuk mund t'i shtyjej mandatin e tyre si gjyqtar, sipas të njëjtit paragraf të nenit 114. Në këtë kuptim, kushtetuta i hap rrugë një lloj autonomie të brendshme të Gjykatës sa i përket zgjedhjes së kryetarit të saj, duke mos lejuar participimin e aktorëve të tjerë

⁸⁴⁷ Ngjashëm me rastin e Hungarisë ku politika arriti më 2012 t'i fus nën kontroll, përveç gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, edhe Bankën Qendrore e Medien, një vit më vonë Rumania gati e pësoi të njëjtin fat. Në rastin rumun, reagimi evropian për fat të mirë që i shpejt dhe me kohë, i ashpër deri në fund, ashtu që përpjekjet e politikës rumune për ta futur në kontroll Gjykatën Kushtetuese dështuan. Cf. "Is Romania Worse Than Hungary?" *The Economist* (OpEd): 17/07/2012. Në internet: <http://www.economist.com/blogs/easternapproaches/2012/07/romanian-politics>;

shtetëror në përcaktimin e tij/saj. Kjo duhet të shihet si një standard i pavarësisë së Gjykatës, meqë nuk lejon hapësirë që emërimi i kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bëhet me ndikim nga jashtë. Në kuptim të këtij paragrafi, emërimi i kryetarit dhe të zëvendëskryetarit të Gjykatës bëhet me shumicën e votave të gjyqtarëve të Gjykatës.

Neni 115 [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese]

- (1) Gjykata Kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës, proceset e vendimmarrjes dhe çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin.**
- (2) Gjykata Kushtetuese publikon raportin vjetor.**

Neni 115.1 dhe 115.2

1. Neni 115 përcakton disa parime bazike sa i përket rregullimit të brendshëm të Gjykatës Kushtetuese. Sipas paragrafit të parë, Gjykata Kushtetuese vishet me autorizimin që të përcaktojë organizimin e brendshëm, të nxjerr rregulloren e punës, dhe të vendos në lidhje me çështje të tjera organizative në pajtim me ligjin.⁸⁴⁸ Në këtë aspekt, ky paragraf bën që Gjykata të ketë një autorizim të brendshëm për të vënë rregulla mbi mënyrën e kryerjes së funksionit të saj, përfshirë organizimin e brendshëm, gjë që shkon në linjë me pavarësinë e saj institucionale. Paragrafi i dytë, në anën tjetër, vendos detyrimin që Gjykata të nxjerr çdo vit raportin e saj vjetor. Në këtë aspekt, Gjykata *nuk obligohet* t'i raportojë asnjë institucioni, përveç se të nxjerr një raport vjetor të punës për qëllime informimi të publikut të gjërë.

Neni 116 [Efekti Juridik i Vendimeve]

- (1) Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.**
- (2) Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktojë dëme të riparueshme.**
- (3) Përveç nëse është përcaktuar ndryshe me vendim të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i ligjit, i aktit ose i veprimit hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës.**
- (4) Vendimet e Gjykatës Kushtetuese shpallet në Gazetën Zyrtare.**

⁸⁴⁸ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë ka vendosur që kushtetuta përcakton se çka duhet të rregullohet me Aktin Kushtetues për Gjykatës Kushtetuese. Asnjë akt tjetër legjislativ nuk mund të rregullojë kompetencat e Gjykatës Kushtetuese (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-III-317/1996 i datës 3.2.1999);

1. Neni 116 rregullon çështjen e efektit juridik të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe mekanizmin e efektizimit të tyre.

Neni 116.1

1. Neni 116.1 përcakton që vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin,⁸⁴⁹ dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Kjo nënkupton se ky paragraf përcakton që vendimet e Gjykatës *nuk janë* me karakter deklarativ, pra nuk bëjnë thjeshtë kualifikimin e një çështjeje si kushtetuese apo kundërkushtetuese, por *kanë efekt konstitutiv juridik* të drejtpërdrejt.⁸⁵⁰ Në këtë kuptim,⁸⁵¹ vendimet e Gjykatës në kuptim të efektit të tyre të detyrueshëm prodhojnë këto pasoja juridike (të marra së bashku):
 - a) janë të detyrueshme për adresantin/adresantët,⁸⁵² dhe duhet të zbatohen nga ana e tyre ose nga ana e institucionit të emëruar në vendim mbi zbatimin e tyre. Refuzimi i zbatimit të tyre përbën shkelje kushtetuese të këtij paragrafi;
 - b) si të tilla, ato nuk mund t'i shtrohen rishikimit nga cilido institucion, duke përfshirë gjyqësorin;

⁸⁴⁹ Në një rast të ngjashëm, Gjykata e Lartë e Greqisë ka vendosur që ajo është kompetente të vendosë lidhur me kushtetutshmërinë e një ligji, edhe në rastet kur ai ligj nuk ka fushëveprim të gjërë, por rregullon një rast individual. Vetëm aktgjykimet e Gjykatës së Lartë, të nxjerra në rastet e vendimeve kundërkushtetuese, janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat dhe autoritetet (Vendim i Gjykatës së Lartë të Greqisë Nr. 45/97 i datës 25.6.1997);

⁸⁵⁰ Si shembull krahasues ku vendimet e gjykatës nuk janë direkt efektive në rastin e parë, Gjykata Kushtetuese e Bosnjes dhe Hercegovinës në vendimin e saj U 1/99 theksoi se në bazë të Rregullores së Punës së kësaj Gjykate, në rastet kur një akt është shpallur jokushtetues, dhe se organi përgjegjës ka dështuar që ta kthejë kushtetutshmërinë brenda tre muajve, atëherë Gjykata Kushtetuese, përmes një vendimi, duhet ta shpallë atë akt të pavlefshëm që nga data e publikimit në Gazetën Zyrtare të këtij vendimi (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të B&H U 1/99, i datës 20.1.2000);

⁸⁵¹ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë në vendimin e saj U-II-1315/2001 theksoi se Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente të vlerësojë kushtetutshmërinë e ligjeve apo ligjshmërinë e akteve tjera juridike (rregulloreve) atëherë kur kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese sfidon një ligj apo rregullore për arsye se organi që ka nxjerrë atë ligj apo rregullore ka anashkaluar (original: omitted) të rregullojë një çështje të caktuar me atë ligj apo rregullore (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-II-1315/2001, i datës 9.7.2003);

⁸⁵² Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë në vendimin e saj 24/04 duke elaboruar fuqinë juridike të vendimeve të saj theksoi se U-III-B-1005/2004 theksoi se organet kompetente me rastin e përsëritjes së procedurave, në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe dispozitat ligjore të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, janë të detyruara t'i zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, duke theksuar se vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë karakter detyrues dhe çdo individ dhe person juridik duhet t'i respektojë. Gjatë procedurave të përsëritura, organet kompetente gjyqësore apo administrative, organet e një njësie rajonale vetë-qeverisëse dhe autoritetet tjera publike janë të detyruara t'i zbatojnë vendimet juridike të Gjykatës Kushtetuese të shprehura në vendimet e tyre (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-III-B-1005/2004 i datës 8.7.2004);

c) prodhojnë efekt të menjëhershëm juridik (*eo ipso*) në rendin juridik sa i përket objektit mbi të cilin është vendosur,⁸⁵³

Nga sa pamë sipër, ky paragraf përcakton mekanizmin kushtetues mbi *përgjegjësinë* e zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 116.2

1. Ky nen e vesh Gjykatën me të drejtën e suspendimit të përkohshëm të një akti juridik i cili gjendet në filtrin e kontrollit kushtetues të Gjykatës Kushtetuese, përderisa nuk përfundon procedura e kontrollit kushtetues dhe zgjidhja meritore e rastit. Praktikisht, ky paragraf vendos mundësinë e shfrytëzimit të së drejtës për masë të përkohshme të Gjykatës mbi një akt juridik që është objekt i kontrollit të saj kushtetues.

Neni 116.3 dhe 116.4

1. Neni 116.3 përcakton që, përveç nëse përcaktohet ndryshe, vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi në ditën e publikimit të tyre. Në anën tjetër, neni 116.4 përcakton detyrimin që vendimet e Gjykatës Kushtetuese të shpallen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 117 [Imuniteti]

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga detyra për vendimet e marra, mendimet e shprehura dhe veprimet e marra Brenda fushës së përgjegjësi si gjykatës të Gjykatës Kushtetuese.

Neni 117

1. Neni 117 përcakton që gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese janë të veshur me imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga detyra për sa i përket kryerjes së funksionit të tyre, mendimeve të shprehura, dhe në tërësi veprimeve të ndërmarra në kapacitetin e tyre si gjyqtar kushtetues. Ky paragraf, prandaj, vendos imunitet funksional për gjyqtarët kushtetues, duke mos i imunizuar ata nga veprimet e ndërmarra jashtë funksionit të tyre si gjyqtar kushtetues. Interpretimi që Gjykata i ka bërë çështjes së caqeve dhe llojit të imuniteteve të funksionarëve

⁸⁵³ Shih një shpjegim të Komisionit të Venecias, të ngjashëm, me këtë argument: Venice Commission. ‘The Binding Effect Of Federal Constitutional Court Decisions Upon Political Institutions’. Report by Ms Anke Eilers, Federal Constitutional Court, Karlsruhe. Seminar on “The effects of Constitutional Court decisions” (Tirana, 28-29 April 2003) CDL-JU (2003) 1. Shih gjithashtu: Venice Commission Report, “Reflections on the Execution of Constitutional Court Decisions in a Democratic State under the Rule of Law on the Basis of the Constitutional Law Situation in the Federal Republic of Germany” by Mr Siegfried BROSS, Judge of the German Federal Constitutional Court. Strasbourg, 27 January 2009, CDL-JU(2009)00;

publik në Kosovë vlej në tërësi edhe për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Ai interpretim i Gjykatës, në fakt, ka pasur parasyshtë vijat e përgjithshme të përmbajtjes së këtij neni.⁸⁵⁴ Kjo çështje u diskutua më heret më rastin e komentimit të nenit 89 të Kushtetutës.

Neni 118 [Shkarkimi]

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese mund të shkarkohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, vetëm për kryerjen e krimeve të rënda ose për mospërfillje të rëndë të detyrave.

Neni 118

1. Neni 118 përcakton procedurën dhe rrethanat se kur mund të ndodh shkarkimi i gjyqtarëve kushtetues. Sipas këtij Neni, gjyqtarët kushtetues mund të shkarkohet nga Presidenti i Republikës me propozimin e dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve kushtetues. Shikuar në kuptim të procedurës, ky nen i mbron gjyqtarët kushtetues nga shkarkimi nga një institucion i jashtëm, duke iu garantuar ushtrim të funksionit jashtë mundësisë që kjo të kthehet në një mundësi shkarkimi nga një institucion i jashtëm. Përveç kësaj, kushti që propozimi i bërë për shkarkim të jetë prej dy të tretave (2/3) të gjyqtarëve (nga nëntë sa duhet të jetë në tërësi), bën që propozimi për shkarkim realisht të jetë shumë vështirë i arritshëm, dhe që të ketë një konsensus shumë të gjerë në mes vet gjyqtarëve kushtetues për të propozuar shkarkimin e një gjyqtari. Megjithatë, propozimi për shkarkimin e një gjyqtari kushtetues mund të procedohet vetëm mbi dy baza: një, për shkak të kryerjes së një krimi të rëndë, dhe dy, për shkak të mospërfilljes së rëndë të detyrave. Në rastin e parë, propozimi për shkarkim sipas këtij neni duhet që të ketë bazë të besueshme gjyqësore që vlerëson që gjyqtari kushtetues ka kryer një krim të rëndë sipas legjislacionit penal. Në rastin e dytë, ky nen bën që çështja e disiplinimit të gjyqtarëve kushtetues të mund të bëhet nga vet kolegji i gjyqtarëve, dhe që, për të dhënë propozimin për shkarkim, duhet që të ketë një bazë të arsyetuar që evidenton shkeljet disiplinore të bëra nga ana e gjyqtarit kushtetues që propozohet për shkarkim tek Presidenti i Republikës. Në përgjithësi, nga kjo del se gjyqtarët kushtetues janë shumë të mbrojtur nga shkarkimi. Realisht ky nen kushtetues i mbron ata prej dhënies së përgjegjësisë ndaj institucioneve jashtë Gjykatës si mënyrë për t'u mbrojtur prej shkarkimit eventual.

⁸⁵⁴ *Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtareve të Qeverisë së Republikës së Kosovës*. Aktgjykim në rastin Nr. K098/11. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, datë: 20 shtator 2011 (Nr. ref.: AGJ138/11);

Kapitulli IX: Marrëdhëniet Ekonomike

Neni 119 [Parimet e Përgjithshme]

- (1) Republika e Kosovës siguron një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike e private.
- (2) Republika e Kosovës siguron të drejta ligjore të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme.
- (3) Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj.
- (4) Republika e Kosovës promovon mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj duke inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.
- (5) Republika e Kosovës do të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur vetë tregu nuk mundet që në masë të mjaftueshme të mbrojë interesin publik.
- (6) Investitorit të jashtëm i garantohet nxjerrja e lirshme e fitimit dhe kapitalit të investuar jashtë vendit, në pajtim me ligjin.
- (7) Garantohet mbrojtja e konsumatorëve, në pajtim me ligjin.
- (8) Secili person është i obliguar të paguajë tatimet dhe kontributet e tjera të parapara me ligj.
- (9) Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje që ajo kontrollon në pajtim me interesin publik, me qëllim që të maksimalizojë vlerën afatgjate të ndërmarrjes.
- (10) Shërbimet publike të detyrueshme mund të imponohen mbi këto ndërmarrje në pajtim me ligjin, i cili duhet të përcaktojë edhe kompensimin e drejtë.

Neni 119

1. Neni 119 përcakton parimet e përgjithshme të sistemit ekonomik të shtetit, dhe vendos disa nga garancitë bazike të ekonomisë së tregut. Përveç kësaj, neni 119 rregullon edhe çështjen e qarkullimit të investimeve të huaja në Kosovë, si dhe vendos standardet bazike të mbrojtjes së tyre. Në kuptimin kushtetues, neni 119 mbetet kapitulli më i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës, parimet e së cilës janë bazë për legjislacionin që duhet të rregullojë ekonominë e shtetit. Prirja e këtij neni për një ekonomi të hapur dhe të lirë është tregues i natyrës së një ekonomie tregu të lirë që garantohet me Kushtetutë. Nga ky Kapitull shihet qartë se modeli kosovar i marrëdhënieve ekonomike është i njëjtë me modelin e vendeve tjera ish komuniste ku ekonomia e lirë e tregut, pluralizmi i pronës dhe barazia e aktorëve vendor dhe të huaj në treg shoqërohet me një sistem politik liberal ku demokracia kushtetuese, sundimi i ligjit dhe respekti për të drejtat e njeriut dhe të minoriteteve

paraqesin shtyllat kyçe pa të cilat nuk mund të ketë ekonomi të tregut dhe marrëdhënie liberale ekonomike.

2. Në doktrinë zakonisht është bërë dallim në mes të këtij modeli dhe modelit amerikan në sensin që në modelin ish komunist, ku futet Kosova, roli dhe rëndësia e shtetit në sferën ekonomike është më e madhe në ndërkohë që në atë amerikan ky rol është minimal dhe, për pasojë, iniciativa e lirë prevalon. Në këto vende ka pasur pak dëshirë që të përqafohet pa rezervë modeli amerikan i konstitucionalizmit liberal, sado që është pranuar pa përjashtim roli dhe rëndësia e iniciativës dhe tregut të lirë si dhe postulatet kyçe të demokracisë liberale.⁸⁵⁵ Në këtë kuadër, ka autorë që thonë se edhe kontrolli kushtetues dhe forma e tij diktohet nga modeli i marrëdhënieve ekonomike. Në rastin e ish vendeve komuniste, ku hyn Kosova, ekziston një model i kontrollit kushtetues ku autoritetet shtetërore qendrore kanë ndikim në procedurat e kontrollit të ligjit, në ndërkohë që në modelin amerikan këto autoritete shtetërore nuk kanë asnjë ndikim dhe sovraniteti i parlamentit mbetet suprem. Sipas këtyre autorëve, përveç këtij dallimi ekziston edhe një dallim tjetër që lidhet me ankesën kushtetuese dhe llojin e procedurave për mbrojtjen e të drejtave individuale dhe lirive fundamentale: në modelin ish komunist, këtu hyn edhe Kosova, ekziston një prirje më e madhe kah lejimi i ankesave individuale në ndërkohë që një gjë e tillë mungon në sistemin amerikan. Shkurt, nga kjo që u tha del se ekonomia politike, sipas këtyre autorëve, dikton llojin dhe formën e procedurave të kontrollit kushtetues. U mor vesh, kjo deri diku është e vërtetë, grosso modo, por nuk është në tërësi përcaktues i natyrës së kontrollit gjyqësor sepse institucioni i kontrollit gjyqësor në botën e demokracive kushtetuese perëndimore paraqet një institucion kyç që shkon krahas sistemit liberal politik që bazohet në sundim të ligjit dhe liri të tregut⁸⁵⁶.
3. Nga një analizë e dispozitave të këtij kapitulli, dalin në pah dy gjëra që duhen pasur parasysh. E para ka të bëjë me Kapitujt I (“Dispozitat Themelore”) dhe II (“Të drejtat dhe Liritë Themelore”) kurse e dyta me rolin dhe rëndësinë e ligjit në një sistem demokratik (“parimi i proporcionalitetit”). Kjo, shikuar nga aspekti i ekonomisë politike, lidhet me rolin dhe rëndësinë e ligjit në evoluimin e rendit politik-kushtetues. Nga ky aspekt, që nga koha e Adam Smith-it, kushtetuta ka një kuptim më të gjerë dhe paraqitet si një kuadër përcaktues i marrëdhënieve në mes të shtetit dhe tregut, i tensionit në mes të aktivitetit individual/kolektiv në shoqëri në njërën anë, dhe i ndërhyrjes/tregullimit shtetëror, në anën tjetër. Kjo ndryshe

⁸⁵⁵ Ewing, K. D (2012) ‘Economic Rights’, në Michel Rosenfeld and Andras Sajó (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*. Oxford Oxford University Press, p. 1037-1053, në veçanti p. 1047-1048.

⁸⁵⁶ Për këtë debat interesant që akoma vazhdon dhe që flet për rolin dhe rëndësinë e ekonomisë politike në kontrollin gjyqësor, Cf. më shumë në: Sadurski, Wojciech (2010) ‘Legitimacy and Reasons of Constitutional Review After Communism’, në Sadurski, Wojciech, *Constitutional Justice East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post-Communist Europe in a Comparative Perspective*. The Hague: Kluwer Law International, p. 163- 187, në veçanti p. 178-185; Rose-Ackerman, Susan (2012) ‘The Regulatory State’, në Rosenfeld, Michel and Sajó, Andras (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*. Oxford: Oxford University Press, p. 671-685, në veçanti p. 673-676.

quhet “ekonomia e qeverisjes”, përkatësisht “ekonomia e re institucionale” (NIE), qasje që nënkupton se kushtetutat duhet të synojnë që fuqitë rregullative (ndërrhyrëse) dhe vetërrregullative (jo ndërrhyrëse, pra e lënë në ndërmarrësi private) të jenë pjesë e strukturës kushtetuese.⁸⁵⁷ Ky vizion tërësisht reflektohet në dispozitat e Kushtetutës së Kosovës të cilat komentohen këtu. Këto dy aspekte i ka pasur parasysh Gjykata në vendimin e saj të njohur si “rasti i mikrofinancave në Kosovë” (lidhur me ekonominë dhe marrëdhëniet e tregut të lirë të cilat vlejnë në Kosovë)⁸⁵⁸ dhe në vendimin tjetër të njohur si “rasti Ligjit për Shëndetësinë e Kosovës” (lidhur me proporcionalitetin dhe të drejtën për punë në një shoqëri të lirë dhe demokratike)⁸⁵⁹. Nga leximi kontekstual i këtyre dy aktgjykimeve të Gjykatës lirisht mund të thuhet se del që marrëdhëniet ekonomike nuk duhet të shikohen të izoluar nga Kapitulli I (“Dispozitat Themelore”) dhe II (“Të drejtat dhe Liritë Themelore”) të Kushtetutës sepse këto marrëdhënie zhvillohen në një kontekst më të gjerë socio-politik dhe juridik-kushtetues të normuar nga këta dy kapituj.

Neni 119.1

1. Neni 119.1 vendos detyrimin që shteti i Kosovës të sigurojë një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike dhe private. Në kuptim të këtij neni, institucionet shtetërore janë të detyruara që të vendosin tërë mekanizmat e nevojshëm institucional dhe ligjor për të garantuar që në Kosovë të ketë një treg të hapur, ku oferta dhe kërkesa përbëjnë modelin e qarkullimit të kapitalit në sistemin ekonomik, dhe ku operatorët ekonomik privat janë të mbrojtur me një sistem të mjaftueshëm juridik për të qarkulluar lirshëm në tregun e vendit. Kjo natyrshëm që shpie edhe në detyrimin e institucioneve të shtetit për të garantuar që shteti nuk lejohet të shtetëzoj pronën private, apo edhe të ndërhyj në qarkullimin e kapitalit brenda tregut konkurrues, me subjektet privatet si konkurrenca në të.

Neni 119.2

1. Neni 119.2 përcakton detyrimin për shtetin që të sigurojë të drejta të barabarta për të gjithë investitorët dhe të gjitha ndërmarrjet vendore dhe të jashtme. Koncepti “të drejta ligjore të barabarta” nuk i referohet një barazie radikale, por faktit që

⁸⁵⁷ Cf. Zumbansen, Peer (2012) ‘Carving Out Typologies and Accounting for Differences Across Systems: Towards a Methodology of Transnational Constitutionalism’. në Rosenfeld, Michel and Sajo, Andras (eds.), *The Oxford Handbook of Comparative Constitutional Law*. Oxford: Oxford University Press, p. 75-97, në veçanti p. 91-92.

⁸⁵⁸ Cf. *Avokati i Popullit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve: 90, 95 (1.6), 110, 111 dhe 116, të Ligjit për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, Nr. 04/L-093, të 12 prillit 2012*. Aktgjykim në Rastin Nr. K0. 97/12. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Datë: 12 prill 2013 (Nr. ref.: AGJ403/13).

⁸⁵⁹ Cf. *Dr. Shaip Muja dhe 11 Deputetë të Kuvendit të Kosovës. Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 18, 19, 41 dhe 60 të Ligjit mbi Shëndetësinë No. 04/L-125, i miratuar nga Kuvendi më 13 dhjetor 2012*. Aktgjykim në Rastin KO. 131/12. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Datë: 10 prill 2013 (Ref. No.: MPM 406/13).

ndërmarrjet e huaja dhe ato të brendshme operojnë lirshëm në një ambient të rrafshët ekonomik, dhe ku barrierat apo tagrat e shtetit mbi operatorët ekonomik të huaj dhe të brendshëm janë të njëjtë, dhe synojnë të arrijnë të njëjtin efekt juridik.

Neni 119.3

1. Neni 119.3 përcakton që veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominante, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj. Ky nen, prandaj, vendos disa nga parimet e politikës së konkurrencës, që janë ndalimi i pozitës dominante në treg të një subjekti ekonomik dhe ndalimi i abuzimeve që rrjedhin nga monopolizimi i tregut. Në kuptim të këtij neni, përjashtimet nga liria e konkurrencës dhe ndalimi i abuzimeve me pozitën dominante dhe me monopolin ekonomik duhet vendosur vetëm me ligj, të shoqëruar me kushtin që ato të jenë të cekura në mënyrë eksplicite.

Neni 119.4

1. Neni 119.4 përcakton detyrimin e shtetit të Kosovës që të promovojë mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj, duke e inkurajuar zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Dy janë parimet bazike që rrjedhin nga neni në fjalë: një, që shteti të ketë detyrimin për të garantuar një mjedis bazik të mirëqenies sociale për qytetarët e saj; që është një detyrim relativisht i rëndësishëm por edhe intervencionist; dhe dy, që shteti të inkurajojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik përmes politikave të saj publike. Në kuptim të kësaj të fundit, neni 119.4 nuk e bën shtetin bartës të zhvillimit ekonomik, por i vë detyrimin që të ndërtojë kushtet bazike në mënyrë që sektori privat të mund ta çoj një zhvillim të tillë përpara.

Neni 119.5

1. Neni 119.5 përcakton detyrimin e shtetit që të themelojë organe të pavarura për rregullimin e tregut atëherë kur tregu, si i tillë, nuk mund që në masë të mjaftueshme të mbroj interesin publik. Ky nen në mënyrë implicite e autorizon qeverinë që të rregulloj tregun në ato fusha ku ky i fundit e dëmton interesin publik të shtetit. Autorizimi për rregullim të tregut i dhënë me këtë nen shoqërohet edhe me autorizimin për të themeluar institucione të pavarura, në formë të rregullatorëve, të cilët do të ushtronin funksionin e rregullimit të sektorëve të caktuar të tregut. Kushti i vënë, megjithatë, në mënyrë që shteti të ketë të drejtë të rregullojë një sektor të caktuar të ekonomisë, është që një sektor i caktuar të shihet si rrezik për interesin publik të shtetit.

Neni 119.6

1. Neni 119.6 përcakton garancinë që investitorëve të jashtëm t'iu garantohet nxjerrja e lirshme e fitimit dhe kapitalit të investuar jashtë vendit, në pajtim me ligjin. Praktikisht, ky nen vendos garancionin e mbrojtjes së investitorëve të jashtëm nga

marrja eventuale e fitimit nga ana e qeverisë, jashtë standardit të trajtimit të barabartë, siç është i proklamuar siç u tha më sipër.

Neni 119.7

1. Neni 119.7 vendos garancionin për mbrojtjen e konsumatorëve, në pajtim me ligjin. Një garancion i tillë, megjithëse i vënë si një detyrim pozitiv për shtetin, shndërrohet në mënyrë automatike në të drejtë subjektive të konsumatorëve. Ky garancion përbën një standard që mbron anën e blerësve në treg nga keqpërdorimet eventuale të ofertuesve.

Neni 119.8

1. Neni 119.8 përcakton detyrimin që secili person të paguaj tatimet dhe kontributet tjera të vendosura me ligj. Më këtë përcaktim, Kushtetuta vendos detyrimin e qytetarëve për të paguar detyrimet tatimore dhe financiare ndaj shtetit, dhe i jep mundësinë Kuvendit, që përmes ligjeve, të përcaktoj llojet dhe vlerën e tagrit financiar që qytetarët duhet ta paguajnë.

Neni 119.9

1. Neni 119.9 përcakton që Republika e Kosovës ushtron të drejtën e pronësisë mbi çdo ndërmarrje publike që ajo kontrollon, në pajtim me interesin publike, me qëllim që të maksimalizohet vlera afatgjatë e ndërmarrjeve në fjalë. Detyrimi pozitiv për institucionet e shtetit, në kuptim të këtij neni, është që ato të përkujdesen për pronën publike si ruajtës me mirëbesim, dhe që të sigurojnë që rritja e pronës së tillë ka trend pozitiv në kuptimin afatgjatë.

Neni 119.10

1. Neni 119.10 përcakton që shërbimet publike të detyrueshme mund të imponohen mbi ndërmarrjet publike me anë të ligjit, i cili edhe duhet të përcaktoj një kompensim të drejtë për to. Në kuptim të këtij neni, Kuvendi vishet me të drejtën që t'iu imponoj ndërmarrjeve publike të caktuara, me anë të ligjit, që ato të ofrojnë shërbime publike për qytetarët, në kundërvlerë të një kompensimi të drejtë gjithashtu të përcaktuar me ligj.

Neni 120 [Financat Publike]

- (1) Shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet të bazohen në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës.**
- (2) Administrimi i politikës fiskale në të gjitha nivelet e qeverisë do të jetë në pajtim me kushtet për inflacion të ulët dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe për krijimin e vendeve të punës.**

(3) Huat publike rregullohen me ligj dhe duhet të jenë në pajtim me stabilitetin ekonomik dhe qëndrueshmërinë fiskale.

Neni 120

1. Neni 120 përcakton parimet bazike mbi të cilat ndërtohet sistemi i financave publike në Republikën e Kosovës. Sipas këtij neni, institucionet janë të detyruara që të zbatojnë një sërë standardesh si në kuptim të mbledhjes së të hyrave ashtu edhe në kuptim të modelit të harxhimit, të shpenzimeve publike.

Neni 120.1

1. Neni 120.1 përcakton që shpenzimet publike dhe mbledhja e të hyrave publike duhet bazuar në parimet e llogaridhënies, efektshmërisë, efikasitetit dhe transparencës. Të katër parimet e përcaktuara këtu, janë detyrime bazike kushtetuese për secilin institucion publik që mbledh apo shpenzon të hyra publike. Garantimi kushtetues i zbatimit të këtyre katër parimeve, në kuptim të këtij neni, duhet bërë individualisht nga secili punonjës shtetëror por edhe institucionalisht, nga secili institucion shtetëror. Garancionet që rrjedhin nga këto katër parime e legjitimojnë autorizimin e shtetit, të përcaktuar më sipër, për të mbledhur tatime nga personat fizik dhe juridik, dhe mundësojnë që paraja publike të jetë e kontrollueshme nga taksapaguesit.

Neni 120.2

1. Neni 120.2 përcakton që administrimi i politikës fiskale në të gjitha nivelet e qeverisjes duhet të jetë në pajtim me kushtet për inflacion të ulët dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, dhe hapësirë për vende të reja të punës. Të tri këto parime bazike ekonomike janë themelet mbi të cilat duhet të sendërtohet çdo politikë fiskale, dhe si të tilla, ato përbëjnë detyrime pozitive për institucionet publike që bëjnë politika publike në këtë fushë.

Neni 120.3

1. Neni 120.3 përcakton që huatë publike rregullohet me ligj, dhe duhet të jenë në përputhje me stabilitetin ekonomik dhe qëndrueshmërinë fiskale të shtetit. Këto dy garancione kushtetuese janë detyrime pozitive për institucionet ekzekutive që marrin hua për të kryer shpenzime publike, dhe në të njëjtën kohë janë mekanizma garantues që e mbrojnë shtetin nga falimentimi financiar eventual.

Neni 121 [Prona]

- (1) Llojet e pronës rregullohen me ligj.**
- (2) Personat fizikë të huaj dhe organizatat e huaja mund të sigurojnë të drejta të pronësisë mbi pronën e paluajtshme në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare.**
- (3) Personat fizikë të huaj dhe organizatat e huaja në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, mund të sigurojnë të drejta të koncesionit dhe të drejta të tjera për shfrytëzim dhe/ose eksploitim të resurseve në pronësi publike, përfshirë këtu resurset natyrore, dhe të infrastrukturës në pronësi publike.**

Neni 121

1. Neni 121 rregullon çështjet e pronës, dhe garancionet kushtetuese që e garantojnë të drejtën në të.

Neni 121.1

1. Neni 121.1 përcakton që llojet e pronës rregullohen me ligj. Dhënia e mundësisë që llojet e pronës të rregullohen me anë të ligjit është garacion që prona mbrohet në nivel të ligjit, dhe kushtetuta delegon detyrimin për rregullimin e llojeve të pronës tek Kuvendi.

Neni 121.2

1. Neni 121.2 përcakton që personat fizik të huaj dhe organizatat e huaja mund të sigurojnë të drejta të pronësisë mbi pronën e paluajtshme në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj ose me anë të një marrëveshjeje ndërkombëtare. Ky nen, prandaj, u garanton të huajve që të mund të gëzojnë të drejta pronësore mbi pronat në Kosovë, dhe kërkon që kufizimet ndaj një të drejte të tillë të jenë të arsyeshme dhe të vendosen me anë të ligjit. Kjo e drejtë u njihet në mënyrë të barabartë si personave juridik ashtu edhe atyre fizik të huaj. Kjo në të njëjtën kohë nënkupton se të huajt nuk guxojnë të diskriminohen në fitim dhe humbje të pronësisë vetëm pse janë të huaj. Diskriminimi eventual mund të përcaktohet nga kushtet tjera të tregut, jo të imponohet në mënyrë administrative.

Neni 121.3

1. Neni 121.3 përcakton që personat fizik të huaj dhe organizatat e huaja, në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, mund të sigurojnë të drejta të koncesionit dhe të drejta për shfrytëzim ose eksploitim të resurseve në pronësi publike, duke përfshirë këtu edhe resurset natyrore dhe të infrastrukturës në pronësi publike. Kjo e drejtë që u garantohet personave fizik dhe juridik të huaj u mundëson atyre që të mund të shfrytëzojnë resurset natyrore ose veprat infrastrukturale publike për një kohë të caktuar, dhe sipas një kontrate shumëvjeçare,

Neni 122 [Përdorimi i Pasurisë dhe Burimeve Natyrore]

- (1) Populli i Republikës së Kosovës në pajtim me kushtet e arsyeshme të përcaktuara me ligj, mund të gëzojë resurset natyrore të Republikës së Kosovës, por nuk mund të shkel obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare për bashkëpunim ekonomik.**
- (2) Pasuritë natyrore, si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë e tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, pjesët e tjera të natyrës, paluejtshmëria dhe të mirat e tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike, të cilat përcaktuar me ligj se janë përcaktuar me interes për Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë, në pajtim me ligjin.**
- (3) Kufizimet e të drejtave të pronarëve dhe të drejtave të tjera mbi eksplotimin e të mirave me interes të veçantë për Republikën e Kosovës dhe kompensimi për kufizimet e tilla rregullohen me ligj.**

Neni 122

1. Neni 122 vendos disa parime në lidhje me përdorimin e pasurisë dhe burimeve natyrore, si dhe përcakton disa mekanizma juridik që synojnë ruajtjen e integritetit të standardeve të tilla.

Neni 122.1

1. Neni 122.1 përcakton që populli i Kosovës, në pajtim me kushtet e arsyeshme të vendosura me ligj, mund të gëzojë resurset natyrore të Kosovës, por nuk duhet të shkelin marrëveshjet ndërkombëtare mbi bashkëpunimin ekonomik që dalin në këtë fushë. Kjo dispozitë kushtetuese, prandaj, autorizon shfrytëzimin e resurseve natyrore, duke e vendosur kushtin që një shfrytëzim i tillë të mos cenojë marrëveshjet ndërkombëtare të Kosovës për bashkëpunim ekonomik. Me marrëveshje ndërkombëtare duhen nënkuptuar jo vetëm ato që ka lidhur Kosova që nga bërja e saj shtet sovran dhe i pavarur por edhe ato që i ka trashëguar në procesin e trashëgimit ndërkombëtar të ish Jugosllavisë, përkatësisht të pjesëve të caktuara të saj.

Neni 122.2

1. Neni 122.2 përcakton që pasuritë natyrore si ujërat, hapësira ajrore, pasuritë minerare dhe pasuritë tjera natyrore, si dhe trualli, pyjet, bota bimore e shtazore, pjesët tjera të natyrës, paluejtshmëria dhe të mirat tjera me rëndësi të veçantë kulturore, historike, ekonomike dhe ekologjike, të cilat janë përcaktuar me ligj se janë përcaktuar me interes për Republikën e Kosovës, gëzojnë mbrojtjen e tyre të veçantë, në pajtim me ligjin. Prandaj, ky nen përcakton autorizimin kushtetues për Kuvendin, që përmes ligjit, të vendosë zonat me interes të veçantë, si mënyrë e garantimit dhe mbrojtjes së tyre të veçantë nga ana e institucioneve shtetërore.

Neni 122.3

1. Neni 122.3 përcakton që kufizimet e të drejtave të pronarëve dhe të drejtave të tjera mbi eksploatimin e të mirave me interes të veçantë për Republikën e Kosovës dhe kompensimi për kufizimet e tilla rregullohet me ligj. Një garancion i tillë e ndalon degën ekzekutive të pushtetit që të ndërhyj në kufizimet e të drejtave pronësore, dhe këtë autorizim ekskluziv ia bart Kuvendit, i cili mund ta rregullojë vetëm përmes një ligji.

Kapitulli X: Qeverisja Lokale dhe Organizimi territorial

Hyrje e Përgjithshme

1. Modeli i përfaqësimit që një rend kushtetues përcakton, domosdo që prek linjat tradicionale të vendosjes së kontrollit dhe të ndërveprimit në mes të qytetarit dhe institucioneve/autoriteteve që ushtrojnë funksionet publike. Modeli tradicional i ndërveprimit dhe përfaqësimit të interesave legjitime të qytetarit kryesisht ndërtohet mbi një sistem parimesh që mbështetet në argumentin që përfaqësimi i duhur dhe efikas i qytetarit, si dhe mbrojtja e interesave të tyre, më së miri realizohet nga institucionet/organet që qëndrojnë në krye të hierarkisë institucionale. Ky model frymëzohet nga filozofia e shtetit centrist dhe të njëtrajtshëm, ku lidhja e qytetarit dhe shtetit realizohet nëpërmjet pushtetit qendror, i cili, ndër të tjera, mban edhe ekskluzivitetin e përcaktimit të cilësisë dhe sasisë së legjitimitetit që një vendim bartë në vete. Një model i tillë, i bazuar kryesisht në teoritë e përfaqësimit të interesave dhe mbrojtjes së tyre, ideon atë skemë të qeverisjes ku pushteti qendror është jo vetëm bartës i autorizimeve shtetërore por edhe përcaktues i interesave legjitime të qytetarëve.⁸⁶⁰
2. Përkundër linjave të modelit tradicional si më sipër, rendi kushtetues në Kosovë përcakton një strukturë koherente të ndërtimit të raportit në mes të përfaqësimit të qytetarit dhe interesave të tij në njërin anë dhe të pushtetit në anën tjetër. Modeli i qeverisjes lokale dhe organizimit territorial në Kosovë, kryesisht, është i bazuar mbi parimin e *devoluimit*, që nënkupton vendosjen e një sistemi të vetëqeverisjes lokale që bart kompetenca, të cilat sipas sistemit tradicional të organizimit shtetëror janë ushtruar nga organet e pushtetit qendror. Kjo lëvizje drejt një modeli të ri të përfaqësimit të gjerë të interesave të qytetarit, për më tepër, vjen si rezultat i një trendi historik ku karakteristikat e shtetit tradicional vihen në pyetje.⁸⁶¹ Ky ndryshim dinamik i raporteve në mes të qytetarit dhe organeve shtetërore qendrore në esencë paraqet reflektim të lëvizjeve qytetare për zgjerim të të drejtave qytetare dhe lirisë njerëzore. Thënë ndryshe, modeli i vetëqeverisjes lokale është rezultat i zhvillimeve historike dhe lëvizjeve qytetare për më shumë demokraci, dhe mund të kuptohet në kontekst të zhvillimit të të drejtave dhe lirisë të njeriut prej një perspektive të kualitetit të qeverisjes.⁸⁶²

⁸⁶⁰ Cf. Jensen H T, Plum V (1993) 'From centralised state to local government. The case of Poland in the light of Western European experience'. *Environment and Planning D: Society and Space*. Vol. 11(5): p. 565 - 581;

⁸⁶¹ Cf. Jeffery, Charlie (2006) 'Devolution and Local Government'. *Publius*. Vol. 36 (1): p. 57-7; Steve Martin, *et al* (2010) 'Validity, Utilization and Evidence-Based Policy: The Development and Impact of Performance Improvement Regimes in Local Public Services'. *Evaluation*. Vol. 16: p. 31-42; Cf. gjithashtu edhe Briffault, Richard (1990) 'Our Localism: Part I--The Structure of Local Government Law'. *Columbia Law Review*. Vol. 90 1): p. 1-115;

⁸⁶² Cf. Sathyamurthy, T. V. (1996) 'Centralised State Power and Decentralised Politics: Case of India'. *Economic and Political Weekly*. Vol. 31 (13): p. 835-843;

3. Duhet thënë që zhvillimi dhe modeli i vetëqeverisjes lokale në vendet demokratike në përgjithësi, dhe në veçanti në Kosovë, kryesisht bazohet në parimin e *subsidiaritetit* dhe dimensionet që ky i fundit ka marrë në faza të ndryshme të zhvillimit të tij. Parimi i subsidiaritetit, sikundër edhe vet ndërtimi i sistemit qeverisës lokal, në kuptimin filozofik, ka lindur kryesisht si pasojë e zhvillimit të ideve që kundërshtojnë njëllor centralizimin e pushtetit shtetëror dhe pakësimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Si i tillë, zhvillimi i parimit të subsidiaritetit korrespondon me ndryshimet e përgjithshme shoqërore që kryesisht mëtojnë të shquajnë rëndësinë e lirive dhe të drejtave të njeriut në raport me vendimmarrjen dhe ushtrimin e pushtetit në mënyrë më efektive dhe legjitime, sikundër dhe adresimin e nevojave që lindin nga zbatimi i këtyre të fundit.⁸⁶³
4. Nga sa u tha më lartë, parimi i subsidiaritetit në kontekst të modelit të vetëqeverisjes lokale shërben si udhëzues mbi përcaktimin e autorizimeve të organeve jo-qendrore. Shikuar nga perspektiva institucionale, ky parim aplikohet në tri nivele të ndryshme të modelit të vetëqeverisjes lokale dhe organizimit territorial. Së pari, aplikimi i këtij parimi bëhet në nivelin e organizimit institucional, që nënkupton procesin e ndarjes së kompetencave dhe autorizimeve shtetërore ndërmjet niveleve të ndryshme të pushtetit.⁸⁶⁴ Së dyti, zbatimi i parimit të subsidiaritetit në kontekstin e vetëqeverisjes lokale nënkupton vënien në funksion të këtij parimi edhe si kriter për ndërtimin e politikave publike dhe përcaktimit të rolit të institucioneve lokale.⁸⁶⁵ Për fund, parimi i subsidiaritetit kuptohet edhe si bazë që përcakton modelin e ekzekutimit të politikave publike.⁸⁶⁶ Sipas këtij përcaktimi, procesi i zbatimit të politikave publike në asnjë rast nuk mund të interpretohet dhe modelohet në atë formë e cila vë në rrezik autorizimet e institucioneve të vetëqeverisjes lokale dhe të drejtat e grupeve të njerëzve që jetojnë nën atë territor.

⁸⁶³ Cf. Brown, A. J. (2002) 'Subsidiarity or Subterfuge? Resolving the Future of Local Government in the Australian Federal System'. *Australian Journal of Public Administration*. Vol. 61: p. 24-42; Cf. në kuptim të subsidiaritetit në nivel të Bashkimit Evropian: Vause, W. Gary (1995) 'The Subsidiarity Principle in European Union Law--American Federalism Compared'. *Case Western Reserve Journal of International Law*. Vol. 27: p. 61-75;

⁸⁶⁴ Steering Committee on Local and Regional Authorities 'Definition and Limits of the Principle of Subsidiary: Report prepared for the Steering Committee on Local and Regional Authorities (CDLR), Local and regional authorities in Europe', *Report No. 55*. Në internet: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?Index=no&command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1276048&SecMode=1&DocId=1348640&Usage=2>;

⁸⁶⁵ Steering Committee on Local and Regional Authorities 'Definition and Limits of the Principle of Subsidiary: Report prepared for the Steering Committee on Local and Regional Authorities (CDLR), Local and regional authorities in Europe'. *Report No. 55*. Në internet: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?Index=no&command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1276048&SecMode=1&DocId=1348640&Usage=2>;

⁸⁶⁶ Steering Committee on Local and Regional Authorities 'Definition and Limits of the Principle of Subsidiary: Report prepared for the Steering Committee on Local and Regional Authorities (CDLR), Local and regional authorities in Europe'. *Report No. 55*. Në internet: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?Index=no&command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1276048&SecMode=1&DocId=1348640&Usage=2>;

5. Vështruar historikisht, parimi i subsidiaritetit mbi të gjitha është parim që qeverisë me modelin e organizimit social të një shoqërie. Ky është kuptimi parësor i parimit të subsidiaritetit, kuptim që përdoret për të shquar liritë e individit dhe për të mundësuar aplikim sa më të gjerë të tij në kuadrin e një sistemi politik.⁸⁶⁷ Së dyti, aplikimi dhe zhvillimi i tij supozon ekzistimin e grupeve të ndryshme shoqërore. Në këtë kuptim, identifikimi dhe njohja e karakteristikave të veçanta të grupeve të ndryshme shoqërore në anën tjetër nënkupton bartjen e autorizimeve të veçanta mbi ato grupe duke ua përshtatur vlerave që ato grupe posedojnë. Në një dimension tjetër, të tretë, parimi i *subsidiaritetit* shërben si bazë e përcaktimit apo kufizimit të rolit të institucioneve qendrore kundrejt niveleve më të ulëta të pushtetit.⁸⁶⁸ Ky parim kryesisht ka si qëllim të kufizojë autoritetin e organeve qendrore kundrejt atyre lokale, dhe në këtë formë tregon një trend të përgjithshëm të ri-përcaktimit të kufijve të autoritetit qendror: karakteristikat historike dhe krahasuese të shfaqjes dhe ndërtimit të parimit të subsidiaritetit tregojnë që ky parim ka tendencë të mbështes një model të rregullimit territorial që shtytë dhe autorizon autonomi më të madhe për institucionet lokale.⁸⁶⁹

6. Cilësitë e përcaktuara si më lartë të parimit të subsidiaritetit janë prezentë edhe në sistemin kushtetues kosovar: parimi i subsidiaritetit, përkatësisht atributet mbi të cilat bazohet modeli i vetëqeverisjes lokale në Kosovë mbart në vetvete kërkesën për më shumë autonomi në ndërtimin dhe zbatimin e politikave lokale kundrejt intervenimit dhe përcaktimit të tyre nga organet qendrore. Në këtë kontekst, zhvillimi i modelit të vetëqeverisjes lokale dhe i parimeve mbi të cilat ky model shfaqet, në kuptimin krahasues, mëton të balancojë marrëdhëniet ndërmjet institucioneve të ndryshme nën kontekstin e autonomisë së zgjeruar, në njërën anë, dhe të drejtat dhe liritë e individit përballë një mori organesh të nivelit qendror dhe rolit të tyre mbikëqyrës, në anën tjetër.⁸⁷⁰ Për këto arsye, bëjnë që parimi i

⁸⁶⁷ Shih Steering Committee on Local and Regional Authorities ‘Definition and Limits of the Principle of Subsidiary: Report prepared for the Steering Committee on Local and Regional Authorities (CDLR), Local and regional authorities in Europe’, *Report No. 55*. Në internet: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?Index=no&command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1276048&SecMode=1&DocId=1348640&Usage=2>;

⁸⁶⁸ Shih Steering Committee on Local and Regional Authorities ‘Definition and Limits of the Principle of Subsidiary: Report prepared for the Steering Committee on Local and Regional Authorities (CDLR), Local and regional authorities in Europe’, *Report No. 55*. Në internet: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?Index=no&command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1276048&SecMode=1&DocId=1348640&Usage=2>;

⁸⁶⁹ Shih Steering Committee on Local and Regional Authorities ‘Definition and Limits of the Principle of Subsidiary: Report prepared for the Steering Committee on Local and Regional Authorities (CDLR), Local and regional authorities in Europe’, *Report No. 55*. Në internet: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?Index=no&command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1276048&SecMode=1&DocId=1348640&Usage=2>;

⁸⁷⁰ Steering Committee on Local and Regional Authorities ‘Definition and Limits of the Principle of Subsidiary: Report prepared for the Steering Committee on Local and Regional Authorities (CDLR), Local and regional authorities in Europe’, *Report No. 55*. Në internet: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?Index=no&command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1276048&SecMode=1&DocId=1348640&Usage=2>;

subsidiaritetit, në Kosovë dhe gjetiu, të mbetet njëri ndër shtyllat kryesore që ka modeluar marrëdhëniet në mes niveleve të ndryshme të organeve shtetërore në shtetet moderne. Në shtetet federale kjo është më e theksuar, por nuk mungon si cilësia as në shtete jo-federale sepse pushtetit dhe mënyra e ushtrimit të tij janë kryesore këtu jo rregullimi shtetëror⁸⁷¹.

7. Në rastin kosovar, janë tri çështje që në parim duhen dalluar nga koncepti i vetëqeverisjes lokale. Këto çështje, të cilat në vijim më në detaje do të diskutohen, janë të përcaktuara me dispozitat e nenit 12 në lidhje me nenet 123 dhe 124 të Kushtetutës së republikës së Kosovës dhe kanë të bëjnë për sa vijon:
 1. reflektimin e shtetit unitar në modelin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, përkatësisht me modelin dy-shkallësh;
 2. reflektimin e kompozicionit etnik dhe idenë e akomodimit të interesave të komuniteteve pakicë; dhe, së fundi,
 3. ruajtjen e unitetit territorial dhe aplikimin e autonomisë në ushtrimin dhe bartjen e kompetencave të caktuara lokale.

8. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në kapitullin mbi dispozitat themelore, neni 12, vendos parimet të cilat përcaktojnë konstruksionin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Ky nen përcakton që njësitë themelore territoriale të vetëqeverisjes në Kosovë janë komunat. Mbi bazën e këtij përcaktimi janë tri çështje që duhet komentuar: një, koncepti i komunave si bartëse të drejtpërdrejta të autorizimeve shtetërore, dy, koncepti i komunave si njësi themelore për jetësimin e regjimit të demokracisë, si dhe tre, koncepti i komunave si sistem i organeve autonome lokale që ushtrojnë funksione të administrimit dhe menaxhimit të shërbimeve publike lokale.
 1. Së pari, duhet thënë që koncepti që përcakton komunat si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale në Kosovë është segment që determinon modelin e vetëqeverisjes lokale. Pra, sipas këtij koncepti ndarja administrative dhe territoriale në Kosovë realizohet mbi baza të organizimit një shkallësh ku komunat njihen si bartëse të drejtpërdrejta dhe të vetme të autorizimeve shtetërore në nivelin lokal. Thënë më ndryshe, institucionet komunale, gjithnjë sipas përcaktimit kushtetues, do të jenë bartësit e drejtpërdrejtë të qeverisjes lokale dhe kompetencave të bashkëngjitura me atë funksion. Komunat, duke marrë parasysh modelin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, shërbejnë si njësi thelbësore që bartin tagrin për të ushtruar funksionet e autoritetit publik, si dhe për të ndërtuar dhe zbatuar politikatat publike në nivelin lokal. Prandaj, kuptimi që norma kushtetuese në këtë rast bart, shndërrohet në përcaktor të modelit të vetëqeverisjes lokale dhe funksionimit të saj. Siç ka vendosur Gjykata Kushtetuese e Kroacisë, si një shembull krahasues, e drejta kushtetuese për

⁸⁷¹ Gjermania, Austria dhe Zvicra, për komentet Cf. Steering Committee on Local and Regional Authorities 'Definition and Limits of the Principle of Subsidiary: Report prepared for the Steering Committee on Local and Regional Authorities (CDLR), Local and regional authorities in Europe', *Report No. 55*, Në internet: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?Index=no&command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1276048&SecMode=1&DocId=1348640&Usage=2>;

vetëqeverisje lokale nuk përfshin të drejtën e një njësie lokale të vendosë për kufijtë e saj.⁸⁷²

2. Së dyti, përcaktimi kushtetues domosdo shquan rolin e komunave si njësi themelore përgjegjëse në jetësimin e regjimit të demokracisë dhe të decentralizimit të ushtrimit të pushtetit shtetëror. Në kuptim të zhvillimit të konceptit të vetëqeverisjes lokale, funksioni që modeli i vetëqeverisjes lokale luan, lidhet kryesisht me zgjerimin e aplikimit të regjimit të demokracisë dhe formësimin e decentralizimit në ushtrimin e autoritetit shtetëror. Pra, Kushtetuta e Kosovës u njuh komunave autoritetin e organeve lokale që në thelb përbëjnë grupin e njërive territoriale që bartin bazat e zhvillimit të regjimit të demokracisë përfaqësuese, dhe që mundësojnë zhvillimin e jetës legjitime institucionale, si dhe garantojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në përcaktimin e politikave publike në nivelin lokal. Për më tepër, në këtë kuadër, Kushtetuta përcakton që e drejta e qytetarit për të marrë pjesë në vendimmarrje mund të ushtrohet më drejtpërdrejtë në nivelin lokal dhe komunat, gjithnjë sipas normës kushtetuese, që janë bartëse të këtij procesi.
 3. Së treti, përkufizimi kushtetues që komunat janë bartëse themelore të vetëqeverisjes lokale, vesh autoritetet komunale me të drejtën autonome për të vendosur dhe themeluar institucione komunale që ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë të pavarur nga ndikimi i qeverisë qendrore. Pra, koncepti i komunave si bartëse të vetëqeverisjes lokale jo vetëm që përcakton rrethin e autonomisë së organeve komunale për të kontrolluar dhe menaxhuar kompetencat komunale, por zgjerohet edhe në kontekstin e përcaktimit të modelit të organizimit të brendshëm administrativ. Kjo nënkupton se përcaktimi kushtetues është i qartë në atë se autonomia në vendosjen e modelit të strukturës së brendshme dhe organizimit të brendshëm të strukturave administrative komunale është e drejtë e komunave dhe ushtrohet nga to. Nenet 123 dhe 124 të Kushtetutës, të cilat komentohen këtu, nuk bëjnë asgjë tjetër pos që operacionalizojnë më tej modelin kosovar të vetëqeverisjes lokale të përcaktuar nga neni 12 i Kushtetutës dhe i përmbajtësuar në substancë me nenin 81.
9. Janë dy gjëra të rëndësishme që duhen shquar. Së pari, Kushtetuta përcakton që organizimi dhe kompetencat e organeve komunale duhet të jenë të bazuara në ligj, duke mos tkurrur rrethin e autonomisë së komunave për të vendosur dhe themeluar struktura të brendshme administrative sipas specifikave që ato posedojnë. Pra, norma kushtetuese në fjalë vendos parimin që përcaktimi i organizimit të qeverisjes lokale dhe strukturave që do të jenë bartëse të vetëqeverisjes lokale duhet të bëhen me ligj, sipas procedurave të përcaktuara kushtetuese. Duke marrë parasysh përmbajtjen e Kushtetutës dhe parimet që ajo proklamonte (më gjerësisht shih më poshtë), miratimi i ligjeve të natyrës së tillë kërkon vënien në jetë të një procedure të veçantë ligjvënëse duke u bazuar në parimin e shumicës së dyfishhtë. Së dyti, modeli i ndërtimit të normës në fjalë nuk përcakton që kompetencat e të gjitha komunave duhet të jenë të njëjta në kuptim të sasisë dhe cilësisë së tyre, përjashto këtu rregullimin kushtetues mbi modelin, zgjedhjen, organizimin dhe

⁸⁷² Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-I-200/1996 i datës 12.6.1996;

funksionimin e organeve qeverisëse që në sqarimet në vazhdim Kushtetuta i proklamon. Në kapitullin e ardhshëm do të flitet më gjerësisht mbi kuptimin që norma kushtetuese e cila përcakton që organizimi dhe kompetencat e njësisive vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj, përmban Kushtetuta (Cf. neni 123.1).

10. Nga sa u tha më lartë, domosdo duhet sqaruar që regjimi kushtetues në Kosovë i ofron një mbrojtje të veçantë vetëqeverisjes lokale dhe njësisive që janë bartëse të kompetencave që lidhen me ushtrimin e funksionit të tillë. Prandaj, duhet thënë që Kushtetuta e Kosovës kërkon aplikimin e një procedure të veçantë për miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e ligjeve që rregullojnë organizimin dhe kompetencat e komunave. Në këtë kuptim, neni 81.1 vendos modelin e shumicës së dyfishtë në rastet kur kërkohet miratimi, ndryshimi dhe/ose shfuqizimi i ligjeve që rregullojnë organizimin dhe kompetencat e komunave. Thënë më ndryshe, ky parim kërkon që shumica e deputetëve të Kuvendit të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë, si dhe shumica e deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, të cilët mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e Komuniteteve që nuk janë shumicë, duhet të shprehin vullnetin e tyre për të vendosur mbi miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e ligjeve që rregullojnë organizimin dhe kompetencat e komunave.⁸⁷³
11. Për më tepër, Kushtetuta e Kosovës shkon edhe më tutje dhe përcakton që ligjet e natyrës së tillë nuk mund t'i nënshtrohen referendumit (Cf. neni 81.2). Duke marrë parasysh regjimin kushtetues në Kosovë, vendosja e një norme të tillë, mëton që ta ndalojë shndërrimin e vullnetit të shumicës të shprehur nëpërmjet referendumit në mjet për të tkurrur të drejtat dhe liritë e një pjese të shoqërisë dhe zvogëlimit të rolit të vetëqeverisjes lokale. Prandaj, duke marrë parasysh rolin që vetëqeverisja lokale mban dhe dimensionin që liritë dhe të drejtat e komuniteteve marrin në kontekstin e vetëqeverisjes lokale, norma kushtetuese ndalon aplikimin referendumit në raste kur funksioni dhe qëllimi i vendosjes së vetëqeverisjes lokale dhe lirive dhe të drejtave të njeriut të bashkëngjitur me të mund të humbasin kuptimin e tyre.

Neni 123 [Parimet e Përgjithshme]

- (1) E drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj.**
- (2) Vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet organeve përfaqësuese të zgjedhura në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta dhe me votim të fshehtë.**

⁸⁷³ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Federatës Ruse ka vendosur që me rastin e themelimit apo ndryshimit të strukturës së administrimit territorial dhe formës së vetë-qeverisjes së territoreve, është e papranueshme t'i përfundohet parakohe mandati organeve ekzistuese të vetë-qeverisjes pa e marrë parasysh mendimin e popullatës në këto territore. Kjo do të përbënte shkelje të të drejtës kushtetuese për ushtrimin e vetë-qeverisjes lokale (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Federatës Ruse (nuk ka numër) i datës 24.1.1997);

- (3) Veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale bazohet në këtë Kushtetutë dhe në ligjet e Republikës së Kosovës dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Republika e Kosovës merr parasysh dhe zbaton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.**
- (4) Vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve publike, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave dhe brengave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre.**

Neni 123

1. Neni 123 përcakton parimet e përgjithshme të vetëqeverisjes lokale dhe organizimit territorial. Në këtë kontekst duhet sqaruar që lista e parimeve mbi të cilat modelohet sistemi i vetëqeverisjes lokale në Kosovë është i shpërndarë në disa pjesë të kushtetutës, prandaj neni 123 duhet lexuar dhe kuptuar gjithnjë në kuadër dhe në ndërveprim të plotë me parimet tjera të përgjithshme që rregullojnë pjesë të vetëqeverisjes lokale.

Neni 123.1

1. Ky paragraf përcakton që e drejta e vetëqeverisjes lokale garantohet dhe rregullohet me ligj. Sipas këtij përkufizimi janë dy pika të rëndësishme që duhet sqaruar. Së pari, ky paragraf kërkon që detyrimet që dalin nga e drejta e vetëqeverisjes lokale në Kosovë duhet të rregullohen dhe njëkohësisht të garantohen me ligj. Në këtë kuptim, ky paragraf autorizon dhe obligon organet gjegjëse të republikës që të garantojnë, nëpërmjet nxjerrjes së ligjeve, themelimin dhe funksionimin e një sistemi të vetëqeverisjes lokale. Ky paragraf kushtetues, prandaj, ua bart organeve gjegjëse të republikës autorizimin që nëpërmjet procedurës ligjvënëse të miratojnë ligje që garantojnë ushtrimin e të drejtës së vetëqeverisjes lokale. Duke evituar rregullimin e çështjeve që lidhen me organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale në Kushtetutën e Kosovës, në të njëjtën kohë, u mundësohet organeve ligjvënëse, që në bazë të parimeve të përgjithshme kushtetuese të ndërtojnë rregullat mbi organizimin dhe funksionimin e vetëqeverisjes lokale, pa nevojën e inicimit të ndryshimeve kushtetuese. Së dyti, kjo normë kushtetuese, për më tepër, modelohet sipas Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, e cila kërkon që parimet e vetëqeverisjes lokale duhet të garantohen me ligj.⁸⁷⁴ Për këtë arsye, përcaktimi i tillë mëton që të ndërtojë rregulla të vetëqeverisjes lokale që mund të përcjellin dinamikën e zhvillimeve të brendshme, pasi që nuk e lidh funksionimin e vetëqeverisjes lokale me kalimin e ndryshimeve kushtetuese dhe kohëzgjatjen e tyre si dhe me konsensusin e gjerë të përfaqësuesve politik në Kuvendin e Kosovës që kërkohet me rastin e ndryshimeve

⁸⁷⁴ Cf. më tepër në *European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report* Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe Council of Europe (March 2010) 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report'. Strasbourg: Council of Europe Publishing;

kushtetuese. Sikur përmbajtja dhe forma e realizmit të vetëqeverisjes lokale të ishte lënë tërësisht në mëshirën e procedurave të ndryshimeve kushtetuese, atëherë një gjë e tillë seriozisht do të kishte vënë në pikëpyetje realizimin e vetëqeverisjes lokale sipas standardeve evropiane.

Neni 123.2

1. Ky paragraf përcakton që vetëqeverisja lokale ushtrohet nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të lira e të drejtpërdrejta, dhe me votim të fshehtë. Në fillim duhet thënë që nëpërmjet këtij paragrafi, Kushtetuta jetëson konceptin e komunave si bartëse të regjimit të demokracisë në nivelin lokal.
2. Në këtë, paragraf përcaktohet që konstituimi i autoritetit që bartë funksionet e pushtetit lokal kushtëzohet me plotësimin e disa kushteve. Së pari, nga ajo që u tha më lartë, ky përkufizim sqaron që vetëm organet komunale që burojnë nga zgjedhjet mund të përbëjnë autoritetin lokal që mund të ushtrojë funksionet e vetëqeverisjes lokale. Së dyti, në kuptimin e këtij paragrafi, zgjedhjet e drejtpërdrejta në vetvete nuk plotësojnë kushtin që Kushtetuta parasheh mbi shkallën e legjitimitetit popullor që organet lokale duhet të posedojnë. Përveç kësaj dhe nga një këndvështrim tjetër, paragrafi kërkon që zgjedhjet e përgjithshme komunale të karakterizohen si të barabarta, të lira, të drejtpërdrejta, dhe të bazuara në votim të fshehtë, për të plotësuar kushtin kushtetues dhe për të konstituuar autoritetin lokal që bart tagrin për të ushtruar rolin e organeve të vetëqeverisjes lokale. Pra, norma kushtetuese përcakton që kushtet në fjalë janë të *detyrueshme* dhe plotësimi i secilës prej tyre është i nevojshëm që qeverisja lokale të jetë në linjë me parimet kushtetuese. Së treti, ky paragraf ndalon konstituimin e organeve të qeverisjes lokale në Kosovë nëse këto të fundit nuk janë produkt i një procesi zgjedhor të lirë dhe të ndershëm. Së katërti, paragrafi në fjalë mohon të drejtën e çdo autoriteti apo organi tjetër shtetëror që të vendosë, apo në ndonjë formë tjetër të autorizojë, ushtrimin e funksionit të vetëqeverisjes lokale nga organet tjera që nuk janë të zgjedhura sipas kërkesave të këtij paragrafi. Së pesti, duhet thënë që kjo logjikë e rregullimit të parimeve të vetëqeverisjes lokale mbrohet edhe nga Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale, e cila kërkon që të drejtat mbi vetëqeverisjen lokale duhet të ushtrohen nga organet e zgjedhura në formë demokratike. Për më tepër, sipas Kartës, ky parim bën thirrje për themelimin e kuvendeve përfaqësuese që kontrollojnë rolin e organeve ekzekutive në kuadër të kompetencave të parapërcaktuara të tyre.⁸⁷⁵ Në këtë kuptim, Karta po ashtu përcakton që parimet në fjalë limitojnë autoritetin e organeve tjera të pushtetit qendror për të ndërhyrë në pushtetin e dhënë. Pra, autoriteti që ushtron funksionet e dhëna në kuadër të vetëqeverisjes lokale duhet të burojë vetëm nga vullneti i

⁸⁷⁵ Cf. më tepër *European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report*. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, and Council of Europe (2010) 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report'. Strasbourg: Council of Europe Publishing;

popullit, dhe të jetë përgjegjës për ushtrimin e drejtë, në rend të parë kundrejt popullit që e zgjedh atë autoritet lokal.

Neni 123.3

1. Ky paragraf përcakton që veprimtaria e organeve të vetëqeverisjes lokale duhet të bazohet në Kushtetutë dhe ligjet e Republikës, dhe respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale për aq sa zakonisht kërkohet nga një vend nënshkruar i saj.⁸⁷⁶ Së pari, duhet thënë që paragrafi në fjalë tregon që burimi i autoritetit të organeve të vetëqeverisjes lokale qëndron në Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet që nxirren në bazë të saj. Pra, kuptimi që norma kushtetuese në këtë rast mban, lidhet kryesisht me përcaktimin e burimit të autoritetit dhe ushtrimit të tij. Së dyti, ky paragraf përcakton edhe detyrimin e organeve të vetëqeverisjes lokale që të kufizojnë veprimtarinë e tyre brenda kufijve të kompetencave që Kushtetuta dhe ligjet e Republikës së Kosovës përcaktojnë. Së treti, ky përkufizim tregon që organizimi i modelit të vetëqeverisjes lokale, si dhe organizimi dhe funksionimi i organeve të vetëqeverisjes lokale duhet të ndjek parimet që udhëzon Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale. Me fjalë tjera, organet e pushtetit qendror janë të obliguara që t'i japin dimension vetëqeverisjes lokale në Kosovë sipas parimeve që përcakton Karta, dhe në masën e kërkuar nga vendi nënshkruar. Kjo dispozitë është futur në rastin e Kosovës sepse është supozuar se aderimi i Kosovës në Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale do të jetë i vonuar si pasojë e statusit të saj të pakonsoliduar në planin ndërkombëtar. Për këtë arsye është vënë si pikë referimi detyrimi që kanë vendet nënshkruese të Kartës, në mënyrë që Kosova ta ketë të qartë se cili është detyrimi i saj kundrejt dispozitave të vetëqeverisjes lokale të përcaktuara në truallin evropian. Së katërti, duke marrë parasysh rëndësinë që vetëqeverisja lokale ka, si dhe rëndësinë që parimet e qartësisë dhe sigurisë juridike kanë në këtë kuadër, paragrafi në fjalë kërkon që autorizimet themelore dhe kufizimet në veprimtarinë e autoriteteve lokale duhet të përcaktohen me Kushtetutë dhe ligj.
2. Në linjë të njëjtë, Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale proklamon që veprimtaria e vetëqeverisjes lokale nënkupton të drejtën e organeve lokale që të rregullojnë dhe menaxhojnë çështjet komunale ashtu siç është definuar me ligj.⁸⁷⁷ Andaj, gjithnjë në kuptim të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, kompetencat dhe kufizimet e organeve lokale mund të përcaktohen edhe me ligj, mirëpo gjithnjë duke pasur parasysh autonominë e organeve lokale. Është e rëndësishme të thuhet se përkundër autorizimeve që ka organi ligjvënës për

⁸⁷⁶ Si shembull krahasues për këtë koncept, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë ka vendosur që liria e tubimit, si e drejtë kushtetuese, përjashtimisht mund të kufizohet me ligj të miratuar nga Parlamenti, por jo me akte të pushtetit të vetëqeverisjes lokale (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Kroacisë U-I-241/1998 i datës 31.3.1999);

⁸⁷⁷ Cf. më tepër në *European Charter of Local Self-Government*, Explanatory Report. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, and Council of Europe (2010) 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report'. Strasbourg: Council of Europe Publishing;

nxjerrjen dhe ndryshimin e ligjeve të cilat rregullojnë organizimin dhe funksionimin e organeve të vetëqeverisjes lokale, Kushtetuta vendos një mekanizëm të veçantë të mbrojtjes së kufijve të autonomisë së organeve lokale, në rastet kur këto të fundit mund të jenë subjekt i ndryshimit nga ana e organeve qendrore. Një autonomi e tillë gëzon mbrojtje gjyqësore kushtetuese, përveç mbrojtjes administrative dhe mbrojtjes tjetër që mund të ushtrohet në rrugë të rregullta gjyqësore. Disa nga segmentet e kësaj autonomie mund të mbrohen në mënyrë të drejtpërdrejt pranë Gjykatës Kushtetuese. Kështu, sipas nenit 113.4 të Kushtetutës, komunat janë të autorizuara që të kontestojnë në Gjykatën kushtetuese kushtetutshmërinë e ligjeve të cilat cenojnë përgjegjësitë dhe të hyrat e tyre. Ky autorizim u mundëson organeve komunale, që nëpërmjet këtij mjete juridik të ruajnë autonominë e tyre dhe gjerësinë e shtrirjes së tyre. Sipas kuptimit të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, mjete juridik nënkupton të drejtën e organeve komunale që të jenë palë e autorizuar në gjykatë apo organ tjetër të pavarur që mban të drejtën për të vendosur dhe sqaruar nëse ligji, dhe veprimet ose mosveprimet e organeve ligjvënëse janë në pajtueshmëri me autonominë e organeve të vetëqeverisjes lokale.⁸⁷⁸ Me një fjalë, Karta garanton, siç bënë Kushtetuta e Kosovës, rrugën gjyqësore në dobi të organeve komunale për realizimin e të drejtave të tyre nga lëmi i vetëqeverisjes lokale. Kjo më tutje nënkupton se autorizimet që organet ligjvënëse posedojnë për të rregulluar kufijtë e veprimtarisë së organeve të vetëqeverisjes lokale, në kuptimin e këtij paragrafi, nuk mund të shfrytëzohen për të ndryshuar shkallën e autonomisë të organeve lokale që e ka vendos Kushtetuta dhe Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.

Neni 123.4

1. Ky paragraf përcakton që vetëqeverisja lokale bazohet në parimet e qeverisjes së mirë, transparencës, efikasitetit dhe efektivitetit gjatë ofrimit të shërbimeve komunale, duke u kushtuar kujdes të veçantë nevojave specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre. Paragrafi në fjalë, duke marrë parasysh edhe parimet mbi të cilat qeverisjet demokratike bazohen, përcakton një listë parimesh që duhet të jetësohen nga organet e vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Së pari, duhet thënë që parimi i qeverisjes së mirë dhe transparencës duhet të përbëjë bazat e funksionimit të pushtetit vendor apo lokal. Në të njëjtën kohë është e rëndësishme të thuhet që parimi i qeverisjes së mirë përfshinë një numër cilësish dhe parimesh që shquhen nga paragrafi në fjalë, si p.sh, transparenca, efikasiteti dhe efektiviteti. Në këtë kuptim, është e rëndësishme të sqarohet koncepti i qeverisjes së mirë dhe elementet që ai bart në kuptim të qeverisjes lokale. Së pari, duhet thënë që koncepti i qeverisjes së mirë mban në vete një mori elementesh, që kryesisht i referohen modelit të regjimit politik, mjeteve me anën të së cilave shtrihet autoriteti shtetëror, si dhe aftësisë së organeve publike për të ndërtuar dhe zbatuar politikat publike dhe

⁸⁷⁸ Cf. më tepër në *European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report*. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe Council of Europe 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report'. Strasbourg: Council of Europe Publishing;

për të ushtruar funksionet që i takojnë.⁸⁷⁹ Në këtë kontekst, së pari duhet thënë që koncepti i qeverisjes së mirë supozon ekzistimin e një qeverie të zgjedhur nga qytetari në zgjedhje të lira të cilat kanë si qëllim të legjitimojnë ushtrimin e pushtetit që kjo e fundit do ta ushtrojë, si dhe një qeverisje që qëndron përgjegjëse për veprimet ose mos veprimet e saj ndaj qytetarit. Në të njëjtën kohë, qeverisja e mirë, në anën tjetër, supozon edhe qeverisje politikisht të përgjegjshme. Së dyti, koncepti i qeverisjes së mirë supozon ekzistimin një sistemi të administratës publike që është në gjendje të mbikëqyr dhe kontrolloj performancën e institucioneve të saj kundrejt parimeve të kualitetit, efikasitetit, dhe efektivitetit të shërbimeve. Së treti, duhet thënë që transparenca në veprimet që pushteti ndërmerr, dhe respektimi i të drejtës së qytetarëve apo grupeve të interesit për t'u informuar dhe monitoruar veprimtarinë e organeve lokale, përbën njërin ndër elementet e qeverisjes së mirë. Së katërti, qeverisja e mirë, po ashtu, nënkupton realizimin e së drejtës së qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t'u konsultuar në të gjitha fazat e politikë-bërjes dhe vendimmarrjes, sidomos në rastet kur vendimet apo politikat në fjalë prekin interesat e drejtpërdrejta të qytetarit. Së pesti, koncepti i qeverisjes së mirë nënkupton ushtrimin e aktiviteteve qeverisëse sipas dhe brenda ligjit, dhe në respekt të plotë për liritë dhe të drejtat e njeriut.

2. Së dyti, paragrafi në fjalë jetëson parimet e subsidiaritetit dhe decentralizimit të pushtetit shtetëror. Ai kërkon që kompetencat dhe funksionet e administratës shtetërore duhet të ushtrohen nga organet e vetëqeverisjes lokale duke marrë parasysh afërsinë me qytetarin dhe efikasitetin dhe efektivitetin e ushtrimit të funksionit të tillë. Ky kuptim, domosdo inspirohet edhe nga vet Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, e cila mëton të përdor parimin e subsidiaritetit si model për organizimin institucional të organeve vetëqeverisëse lokale, dhe kërkon që veprimtaria e tyre të definohet mbi bazën e vlerësimit të: a) afërsisë me qytetarin, b) shtrirjes dhe natyrës së veprimtarisë, si dhe c) kriterit të efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimit të ofruar.⁸⁸⁰
3. Së treti, duke marrë parasysh nevojat e grupeve etnike dhe anëtarëve të tyre, paragrafi në fjalë kërkon nga organet e vetëqeverisjes lokale që t'u kushtojnë vëmendje të veçantë mbrojtjes dhe realizimit të interesave të grupeve jo-shumicë dhe anëtarëve të tyre. Modeli i mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të grupeve etnike jo-shumicë në Kosovë domosdo kërkon që vëmendje e veçantë gjatë ofrimit

⁸⁷⁹ Cf. Srivastava, Meetika (2009) 'Good Governance - Concept, Meaning and Features: A Detailed Study'. Në internet: <http://ssrn.com/abstract=1528449> or <http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.1528449>;

⁸⁸⁰ Cf. Steering Committee on Local and Regional Authorities 'Definition and Limits of the Principle of Subsidiary: Report prepared for the Steering Committee on Local and Regional Authorities (CDLR), Local and regional authorities in Europe'. *Report No. 55*. Në internet: <https://wcd.coe.int/com.instranet.InstraServlet?Index=no&command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1276048&SecMode=1&DocId=1348640&Usage=2>; European Charter of Local Self-Government, *Explanatory Report*. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe Council of Europe (2010) 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report'. Strasbourg: Council of Europe Publishing;

të shërbimeve publike t'u kushtohet grupeve etnike jo-shumicë dhe anëtarëve të tyre. Në këtë kuptim, janë dy koncepte që duhet sqaruar. Së pari, sipas paragrafit në fjalë, në lidhje me kërkesat e komuniteteve etnike, organet komunale janë të detyruara që të adresojnë kërkesat grupore të tyre. Së dyti, paragrafi kërkon që edhe kërkesat e individëve që i takojnë grupeve etnike jo-shumicë të kenë vëmendje të veçantë.

Neni 124 [Organizimi dhe Funksonimi i Vetëqeverisjes Lokale]

- (1) Njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës është komuna. Komunat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale dhe inkurajojnë e sigurojnë pjesëmarrje aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.**
- (2) Themelimi i komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre, rregullohen me ligj.**
- (3) Komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin. Autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.**
- (4) Komunat kanë të drejtë për bashkëpunimin ndërkomunal dhe për bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin.**
- (5) Komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat e veta si dhe të marrin fonde nga Qeveria qendrore, në pajtim me ligjin.**
- (6) Komunat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.**
- (7) Rishikimi administrativ i akteve të komunave nga autoritetet qendrore në fushën e kompetencave të tyre, kufizohet në sigurimin e përputhjes me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me ligjin.**

Neni 124

1. Neni 124 rregullon parimet e përgjithshme të organizimit dhe funksionimit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë, themelimit dhe përcaktimit të kufijve të komunave, kompetencat dhe ndarjen e tyre, organizimin e buxheteve komunale, si dhe përgjegjësitë e tyre kundrejt kushtetutës dhe ligjeve. Në pjesët në vijim do të sqarojmë parimet në fjalë.

Neni 124.1

1. Ky paragraf përcakton që njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna, të cilat gëzojnë shkallë të lartë të vetëqeverisjes, dhe që janë të detyruara që të sigurojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale. Fillimisht, duhet sqaruar që paragrafi në fjalë i përcakton komunat si njësi themelore që do të bartin funksionet e vetëqeverisjes lokale në Kosovë. Po ashtu, paragrafi përcakton që modeli i organizimit territorial në Kosovë do të

bazohet në modelin e qeverisjes dy-shkallësh, ku raporti në mes komunave dhe pushtetit qendror do të jetë i drejtpërdrejt pa ndërhyrjen e autoriteteve të ndërmjetme.

2. Së dyti, në kontekstin e autorizimeve që ky paragraf bart, është i rëndësishëm fakti që përmes tij detyrohen organet qendrore, që në fazën e ndërtimit të legjislacionit përkatës, t'u garantojnë komunave shkallë të lartë të vetëqeverisjes lokale. Për më tepër, gjithnjë në kuptimin e paragrafit në fjalë, koncepti i vetëqeverisjes ndërlidhet me shkallën e autonomisë që komunat duhet të gëzojnë në fusha të ndryshme dhe kompetencat që këto të fundit duhet të posedojnë në bazë të aplikimit të parimit të efikasitetit dhe efektivitetit në ofrimin e shërbimeve komunale.
3. Së treti, ky paragraf po ashtu përcakton edhe modelin e funksionimit të komunave dhe organeve të saj, duke kërkuar kështu përfshirjen e qytetarëve të komunave në procesin e vendimmarrjes. Prandaj, është e rëndësishme të thuhet që ky paragraf, së pari, detyron komunat dhe organet e saj që të garantojnë përfshirjen e qytetarëve të komunave në procesin e vendimmarrjes.⁸⁸¹ Kjo njëherësh, është shprehje e konceptit të funksionimit transparent dhe të hapur të komunave dhe organeve të saj. Së dyti, kjo dispozitë kushtetuese, kërkon edhe nga organet ligjvënëse, që nëpërmjet ligjeve të vendosin mekanizmat e nevojshëm që mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes lokale.
4. Në vijim, për sa u tha më sipër, edhe protokollat shtesë të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale përcaktojnë që e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në vendimmarrjen lokale duhet të garantohet.⁸⁸² Jo vetëm kaq! Protokollat e Kartës shkojnë më tutje dhe përcaktojnë edhe masat që duhet të merren me anë të cilave organet komunale duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e qytetarëve. Në këtë kontekst, Protokollat kërkojnë që organet komunale të zbatojnë praktika të konsultimeve publike me qytetarët, të aplikojnë referendume lokale dhe mjete që mundësojnë

⁸⁸¹ Në rastin KI 56/09: Fadil Hoxha dhe 59 tjerët kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit të datës 15 dhjetor 2009 (Ref. No.: MP 06/09), Gjykata vendosi në favor të vënies së masës së përkohëshme sepse Kuvendi Komunal kishte dështuar për t'u dhënë mundësi qytetarëve të një lagjeje në Prizren për të ndikuar në vendimet lokale të planifikimit hapësinor në mjedisin jetësor ku ata jetojnë. Parashtruesit në veçanti patën theksuar se Kuvendi Komunal i Prizrenit me vendimin e vet të datës 30 prill 2009, për ndryshim të planit urbanistik të lagjës së tyre ka cenuar nenin 52.2 të Kushtetutës dhe Ligjin për Planifikimin Hapësinor No. 2003/14 dhe Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale No. 03/L-040. Në të gjitha këto pohime, të cilat Gjykata i gjeti si të bazuara, parashtruesit kanë pohuar cenimin e të drejtës për pjesëmarrje direkte individuale në çështjet lokale që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe vetëqeverisjen lokale. Cf. *Fadil Hoxha dhe 59 tjerët kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit*, Aktgjykim, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Datë: 15 dhjetor 2009 (Ref. No.: MP 06/09);

⁸⁸² Additional Protocol to the European Charter of Local Self-Government on the right to participate in the affairs of a local authority, *CETS No. 207*, Utrecht, 16.XI.2009. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/207.htm>; dhe Additional Protocol to the European Charter of Local Self-Government on the right to participate in the affairs of a local authority *CETS No. 207*. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/Html/207.htm>;

pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nëpërmjet peticioneve.⁸⁸³ Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe Protokollet e saj shtesë përcaktojnë që në kuadër të konceptit të garantimit të pjesëmarrjes së qytetarit në jetën publike komunale, organet komunale duhet të garantojnë mekanizma që merren dhe përgjigjen ndaj ankesave dhe sugjerimeve mbi funksionimin e autoriteteve lokale dhe shërbimeve publike⁸⁸⁴ që menaxhohen nga këto të fundit.⁸⁸⁵ Po ashtu, gjithnjë në kuptim të Kartës dhe protokolleve të saj, pjesëmarrja e qytetarëve duhet të përfshijë mundësinë e këtyre të fundit që të kenë qasje të papenguar në dokumente zyrtare në çdo kohë.⁸⁸⁶

Neni 124.2

1. Ky paragraf përcakton që themelimi i komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre, rregullohen me ligj. Së pari, duhet thënë që paragrafi autorizon organin ligjdhënës që të nxjerrë ligje të veçanta që rregullojnë themelimin e komunave, kufijtë, kompetencat dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre. Por, natyrisht, një lexim sistemor i kushtetutës, tregon që organi ligjdhënës duhet të bazohet në modelin e ndarjes së kompetencave dhe modelin e kufizimeve të ndikimit të pushtetit qendror kundrejt pushtetit lokal, si dhe ruajtjen e gjerësisë së autonomisë që kushtetuta përcakton. Në këtë kuptim, siç kemi sqaruar më lartë, Kushtetuta e Kosovës vendos një procedurë të veçantë ligjdhënëse në lidhje me miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e ligjeve që rregullojnë fushën e themelimit të komunave, kufijtë, kompetencat, dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre. Në këtë kontekst, rregullimi i kompetencave dhe çështje të ndërlidhura me komunat me anë të ligjeve, i jep mundësi Gjykatës

⁸⁸³ Additional Protocol to the European Charter of Local Self-Government on the right to participate in the affairs of a local authority, *CETS No. 207*, Utrecht, 16.XI.2009. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/207.htm>; dhe Additional Protocol to the European Charter of Local Self-Government on the right to participate in the affairs of a local authority *CETS No. 207*. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/Html/207.htm>;

⁸⁸⁴ Si shembull krahasues, Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë ka vendosur që aktivitetet komunale janë pjesë e interesit publik, dhe kushtet dhe mjetet për rregullimin e tyre janë të parapara me ligj. Ndërmarrjet publike që ushtrojnë aktivitete komunale nuk mund të merren me aktivitete tjera, sepse një veprim i tillë përbën konkurrencë jo të drejtë. Vendosja e ndërmarrjeve publike në pozitë të privilegjuar, që është në kundërshtim me parimin kushtetues të barazisë ligjore për të gjithë pjesëmarrësit në treg (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të IRJM-së U.br. 161/98 i datës 20.1.1999);

⁸⁸⁵ Additional Protocol to the European Charter of Local Self-Government on the right to participate in the affairs of a local authority, *CETS No. 207*, Utrecht, 16.XI.2009. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/207.htm>; dhe Additional Protocol to the European Charter of Local Self-Government on the right to participate in the affairs of a local authority *CETS No. 207*. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/Html/207.htm>.

⁸⁸⁶ Additional Protocol to the European Charter of Local Self-Government on the right to participate in the affairs of a local authority, *CETS No. 207*, Utrecht, 16.XI.2009. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/207.htm>; dhe Additional Protocol to the European Charter of Local Self-Government on the right to participate in the affairs of a local authority *CETS No. 207*. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/Html/207.htm>;

Kushtetuese që të vlerësojë kushtetutshmërinë e ligjit në fjalë, dhe kjo bën që ky model të jetë i kontrollueshëm në kuptimin e rishikimit gjyqësor.

2. Në anën tjetër, duket që rregullimi i çështjeve në fjalë me anë të kategorive të ligjeve organike apo të interesit të veçantë është praktikë e vendosur, dhe si e tillë mund të konsiderohet në linjë me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale për aq sa ligjet në fjalë nuk rrezikojnë të shndërrohen në mjete për të pakësuar autonominë komunale dhe shtrirjen e saj.⁸⁸⁷
3. Së fundi, sidomos në lidhje me kufijtë e komunave, paragrafi në fjalë shkon në një linjë me Kartën Evropiane e cila përcakton që kufijtë e komunave nuk duhet të ndryshohen në mënyrë arbitrare nga organet qendrore, përveç se me ligj.⁸⁸⁸

Neni 124.3

1. Ky paragraf përcakton që komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, dhe përcakton që autoriteti shtetëror që delegon kompetencat përballon shpenzimet për ushtrimin e delegimit.
2. Ky paragraf bën dallimin në mes të tri kategorive të kompetencave që organet komunale bartin dhe këtë e bën fare të qartë, përkatësisht faktin që komunat do të kenë kompetenca *vetanake* apo *ekskluzive*, *kompetenca të zgjeruara* dhe *kompetenca të deleguara*.
3. Në kontekstin krahasues, kompetencat vetanake apo ekskluzive nënkuptojnë grupin e funksioneve që sipas kushtetutës dhe ligjeve në fuqi u takojnë vetëm komunave, dhe të cilat përjashtojnë përfshirjen e çdo organi apo pushteti tjetër në ushtrimin e tyre. Po ashtu, koncepti në fjalë nënkupton që autoriteti i bartur tek organet komunale është i plotë dhe nuk mund të rrezikohet ose kufizohet nga autoritetet qendrore përveç nëse përcaktohet me ligj. Përtej kësaj, shprehja kompetenca vetanake tregon që autoritetet lokale duhet të kenë një shkallë të autonomisë që buron nga niveli i kompetencave që ato bartin, dhe kufizon ato që të shndërrohen në agjent të organeve qendrore.⁸⁸⁹ Thënë shkurt, kompetencat

⁸⁸⁷ European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the Draft Constitutional Law on Changes and Amendments to the Constitution of Georgia (Chapter VII - Local Self-Government)’, adopted by the Venice Commission at its 82nd Plenary Session, (Venice, 12-13 March 2010) Strasbourg, 15 March 2010 Opinion no. 543/2009, CDL-AD(2010)008;

⁸⁸⁸ European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe, Council of Europe (2010) ‘Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report’, (Council of Europe Publishing, Strasbourg, March 2010);

⁸⁸⁹ Cf. European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe, Council of Europe (2010) ‘Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report’, (Council of Europe Publishing, Strasbourg, March 2010);

vetanake nënkuptojnë që organet komunale posedojnë autoritet të vendosin mbi çështje të cilat mund të ushtrohen më së mirë në nivel të vetëqeverisjes lokale.

4. Tjetër, paragrafi përcakton që komunat mund të posedojnë kompetenca të zgjeruara. Në literaturën krahasuese, kompetencat e zgjeruara kanë të bëjnë me rrethanat e zhvillimit të përgjithshëm që vejnë në pah mundësi të reja që organet lokale të veprojnë në një fushë të caktuar. Në këtë kuptim, organet lokale nuk mund të përjashtohen nga menaxhimi i çështjeve të caktuara të cilat domosdo kanë implikime lokale, dhe në rastet kur funksioni i tyre do të përmbushej nëse këto të fundit veprojnë si entitete të pavarura për të mbrojtur interesat e tyre dhe qytetarëve të saj.⁸⁹⁰ Kompetencat e zgjeruara aplikohen për komunat të cilat bartin status të veçantë autonom sipas decentralizimit të vendosur nga Plani i Ahtisaarit⁸⁹¹.
5. Kompetencat e deleguara, në kuptim të paragrafit, nënkuptojnë grupin e kompetencave që organet qendrore mund të transferojnë tek organet lokale. Por, ushtrimi i këtyre kompetencave është subjekt i disa kufizimeve. Sipas Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, në rastet e kompetencave të deleguara, për aq sa logjika e zbatimit të këtyre kompetencave lejon, organet komunale duhet të kenë shkallë të domosdoshme të diskrecionit për të vendosur në modelin e ushtrimit të kompetencave të tyre.⁸⁹² Po ashtu, Karta përcakton që organet komunale duhet të njoftohen paraprakisht, për aq sa është e arritshme, mbi planifikimin dhe proceset e vendimmarrjes për të gjitha çështjet që u takon drejtpërsëdrejti atyre.⁸⁹³ Në këtë fazë është shumë e rëndësishme të thuhet që kompetencat e deleguara nuk mund të ndikojnë në autoritetin e organeve komunale, prandaj hapësira diskrecionale që komunat duhet të kenë në vendosjen e modelit të aplikimit të kompetencave të deleguara është shumë e rëndësishme edhe kundrejt ruajtjes së pavarësisë së organeve komunale.
6. Së fundmi, duhet thënë që paragrafi në fjalë përcakton që organet që delegojnë kompetencat tek organet komunale duhet të marrin përsipër të gjitha shpenzimet që

⁸⁹⁰ Cf. European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report, available at: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe, Council of Europe (2010) 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report', (Council of Europe Publishing, Strasbourg, March 2010);

⁸⁹¹ Cf. Propozimi Gjithëpërfshirës për Marrëveshjen për Statusin e Kosovës (2 shkurt 2007). neni 6 ("Vetëqeverisja Lokale dhe Decentralizimi"); Neni 8 Decentralizimi/ Vetëqeverisja Lokale" në kuadër të Dispozitave Kushtetuese të Propozimit); pastaj Aneksi III ("Decentralizimi") dhe Shtojcë Aneksit III ("Përkufizimi i komunave të reja");

⁸⁹² Cf. European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report, available at: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe, Council of Europe (2010) 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report', (Council of Europe Publishing, Strasbourg, March 2010);

⁸⁹³ Cf. European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe, Council of Europe 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report'(Council of Europe Publishing, Strasbourg, March 2010);

rrjedhin nga ushtrimi i kompetencave të deleguara. Ky kufizim u pamundëson organeve qendrore që nëpërmjet procedurës së delegimit të kompetencave të ndërhyjnë në punët e organeve komunale, duke kërkuar që të ndryshojnë politikat komunale dhe të kufizohen të ushtrojnë veprimtaritë e caktuara.

Neni 124.4

1. Ky paragraf përcakton që komunat kanë të drejtë të vendosin marrëdhënie bashkëpunimi ndërkomunale dhe ndërkufitare në pajtim me ligjin. Duhet thënë që paragrafi në fjalë njih të drejtën e organeve komunale që të nënshkruajnë marrëveshje ndërkomunale dhe ndërkufitare në fushën e kompetencave të tyre. Për më tepër, në kontekstin e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar, komunat nuk mund të bartin, të marrin përsipër ose të ushtrojnë funksione që sipas ligjeve nuk u përkasin.
2. Në kuptim të Kartës Evropiane, bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkufitar konsiderohet mjet i nevojshëm për arritjen shkallë më të lartë të efektivitetit në ushtrimin e funksionit të tyre nëpërmjet projekteve të ndryshme, ose duke bartur obligime që nuk mund të bartën nga një organ i vetëm.⁸⁹⁴
3. Për më tepër, duhet cekur që paragrafi në fjalë u njih organeve komunale të drejtën e asociimit. Kjo nënkupton se e drejta për t'u futur në marrëdhënie ndërkomunale dhe ndërkufitare gjithsesi nënkupton edhe të drejtën e organeve lokale që të formojnë apo të jenë pjesë e asociacioneve dhe organizatave të ndryshme, kombëtare dhe ndërkombëtare, që ndihmojnë në zgjerimin e rolit të komunave. Në të njëjtë kohë, paragrafi kërkon që të gjitha veprimtaritë e organeve komunale në kuptim të asociimit dhe organizimit ndërkomunal dhe ndërkufitarë duhet të jenë në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet në fuqi.

Neni 124.5

1. Ky paragraf përcakton që komunat kanë të drejtë të vendosin, të caktojnë, të mbledhin dhe të shpenzojnë të hyrat publike si dhe të marrin fonde nga qeveria qendrore në pajtim me ligjin. Fillimisht, duhet thënë që ushtrimi i vetëqeverisjes lokale dhe rrjedhimisht jetësimi i tij, lidhjet ngushtë me një sistem të pavarur të të hyrave publike komunale.
2. Fillimisht duhet sqaruar që e drejta e komunave për të organizuar një sistem autonom të të hyrave publike mëton të garantojë komunat që të përcaktojnë lirshëm dhe në mënyrë të pavarur prioritetet e shpenzimeve që rrjedhin nga ushtrimi i funksioneve të vetëqeverisjes lokale.⁸⁹⁵ Kjo tendencë shprehet hapur

⁸⁹⁴ Cf. European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report, available at: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe Council of Europe 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report' (Council of Europe Publishing, Strasbourg, March 2010);

⁸⁹⁵ Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë ka vendosur që autoritetet lokale kanë të

edhe në kuptim të Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.⁸⁹⁶ Për më tepër, ky paragraf, përcakton që organet komunale kanë kompetencë të plotë për të themeluar, menaxhuar një sistem autonom të të hyrave publike, me qëllim të ndërtimit të një raporti të qartë në mes të kryerjes së funksioneve publike dhe të hyrave publike që komuna posedon. Me fjalë tjera, duhet thënë që ekziston një ndërlidhje e drejtpërdrejt me funksionet që komuna bart dhe ekzistimit të një buxheti të pavarur komunal, dhe si i tillë, kjo marrëdhënie afekton njëjtë pavarësinë dhe vet funksionimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale. Po ashtu, është e rëndësishme të theksohet që në kuptimin të paragrafit në fjalë, organet qendrore duhet të respektojnë pavarësinë e organeve të pushtetit lokal mbi modelin dhe mjetet e mbledhjes së të hyrave publike, për aq sa këto të fundit i garantojnë plotësimin e funksioneve të administratës komunale dhe ushtrimit të pushtetit komunal.

3. Në të njëjtën kohë, paragrafi nënkupton që organet komunale mund të jetë përfituese të granteve qeveritare, pa rrezikuar autonominë dhe ushtrimin e pavarur të funksioneve të besuara për to. Pra, në rastet e tilla, diskrecioni dhe funksionet e organeve komunale nuk mund të tkurren apo pavarësia e veprimit të tyre të zvogëlohet. Për më tepër, sipas Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, në rastin e ndërtimit të legjislacionit përkatës që rregullon modelin e komunikimit në mes të organeve qendrore dhe lokale, si dhe vendosjes së granteve apo linjave të veçanta të kontributit të organeve qendrore në buxhetin e organeve komunale, duhet të ketë parasysh përfshirjen dhe konsultimin në çdo fazë të organeve komunale. Tutje, Karta po ashtu sqaron që, për aq sa është e mundshme, grantet e qeverisë qendrore nuk mund t'i rezervohen financimit të projekteve të veçanta komunale, duke marrë parasysh lirinë e plotë dhe diskrecionin e autoriteteve komunale që të vendosin mbi prioritetet buxhetore të komunave dhe mënyrës së shpenzimit të granteve të organeve qendrore.
4. Ky segment i autonomisë komunale, siç u tha më herët, gëzon mbrojtje gjyqësore pranë Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit 113.4 të Kushtetutës, komunat është e autorizuar që të ngrejë procedurë pranë Gjykatës në çdo rast kur konsideron se një ligj apo akt i autoritetit qendror zvogëlon të hyrat komunale (pa marrë parasysh burimin e tyre).

drejtë të caktojnë obligime për *individët* deri në një shkallë të caktuar, brenda kufijve të të drejtave dhe lirive të rregulluara me Kushtetutë...(Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë II.US 94/95 i datës 13.12.1995); Kjo nënkupton që vendosja e taksave individuale nga ana e autoriteteve komunale mbetet një kompetencë që duhet shikuar në kuptim të të drejtave dhe lirive të njeriut.

⁸⁹⁶ Cf. European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe, Council of Europe (2010) 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report'. Strasbourg: Council of Europe Publishing;

Neni 124.6

1. Ky paragraf përcakton që komunat duhet të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore. Së pari duhet thënë që paragrafi në fjalë i njeh komunat si pjesë e sistemit të organeve shtetërore dhe jo të shkëputura nga to, dhe si të tilla duhet të respektojnë parimet që vendosen në Kushtetutë dhe ligje. Sipas paragrafit në fjalë, komunat janë të obliguara që gjatë ushtrimit të funksioneve që u janë besuar të respektojnë në përgjithësi kufijtë e veprimtarisë së tyre që u janë përcaktuar me Kushtetutë dhe ligje, dhe duhet të veprojnë në pajtueshmëri me vendimet gjyqësore.

Neni 124.7

1. Ky paragraf përcakton që rishikimi administrativ i akteve të nxjerra nga komunat duhet të kufizohet në sigurimin e vlerësimit të përputhshmërisë së akteve në fjalë me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi. Së pari, duhet thënë paragrafi kufizon autoritetin e organeve qendrore që të vlerësojnë aktet e organeve komunale vetëm përkundrejt përputhshmërisë së tyre me kushtetutën dhe ligjet. Në anën tjetër, rishikimi administrativ realizohet nga organet administrative qendrore, dhe si i tillë kufizohet vetëm në vlerësimin e përputhshmërisë së aktit të organeve komunale me ligjet në fuqi.
Në një kontekst tjetër, duhet thënë që paragrafi kërkon që rishikimi administrativ i akteve të organeve komunale të bazohet në procedurë të rregullt administrative, dhe në asnjë mënyrë të mos shndërrohet në procedurë të përkohshme dhe të rastësishme të rishikimit administrativ. Kjo linjë e arsyetimit të rishikimit administrativ të bazuar në ligj jetësohet edhe nga Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale.⁸⁹⁷
2. Së dyti, në kuptimin e Kartës, rishikimi administrativ duhet të kufizohet në çështjen e vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të organeve komunale dhe assesit të vlerësojë *përshtatshmërinë* dhe *dobinë* e aktit në fjalë.⁸⁹⁸ Në rastin konkret, duhet thënë që në vlerësimin e akteve që nxirren për të ushtruar kompetencat e deleguara apo transferuara, organet qendrore mund të vlerësojnë edhe përshtatshmërinë dhe dobinë e aktit në fjalë.⁸⁹⁹

⁸⁹⁷ Cf. European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report, available at: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe Council of Europe. 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report'. Strasbourg: Council of Europe Publishing;

Cf. European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe, Council of Europe (2010) 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report'. Strasbourg: Council of Europe Publishing;

⁸⁹⁹ European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the Draft Constitutional Law on Changes and Amendments to the Constitution of Georgia (Chapter VII - Local Self-Government)', adopted by the Venice Commission at its 82nd Plenary Session, (Venice, 12-13 March 2010) Strasbourg, 15 March 2010 Opinion no. 543/2009, CDL-AD(2010)008;

3. Së treti, dhe gjithnjë në kontekstin e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, rishikimi administrativ i akteve komunale jetësohet në bazë të parimit të proporcionalitetit, i cili kërkon nga organet qendrore që bartin rolin e organit gjegjës për të kontrolluar ligjshmërinë e aktit administrativ, që të zbatojë metoda të kontrollit të ligjshmërisë të cilat më së paku prekin autonominë e autoriteteve lokale, duke mundësuar kështu arritjen e rezultatit të nevojshëm pa prekur në çështje të autonomisë lokale.⁹⁰⁰

⁹⁰⁰ Cf. European Charter of Local Self-Government, Explanatory Report. Në internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/HTML/122.htm>, dhe, Council of Europe 'Reference: European Charter of Local Self-Government and Explanatory Report'. Strasbourg: Council of Europe Publishing;

Kapitulli XI: Sektori i Sigurisë

Hyrje e Përgjithshme

1. Kapitulli i njëmbëdhjetë i Kushtetutës së Kosovës vendos parimet e përgjithshme të sektorit të sigurisë, identifikon institucionet kryesore që bartin kompetencat e lidhura me këtë sektor, si dhe përcakton gjerësinë e autoritetit të institucioneve në fjalë. Për më tepër, kjo pjesë e Kushtetutës sendërton parimet e kontrollit civil përkundrejt institucioneve të sigurisë. Përveç kësaj, Kushtetuta themelon një numër institucioneve të sigurisë udhëheqja e së cilave vendoset mbi parimin e ekuilibrit në mes të pushteteve. Pra, parimet e vendosura jo vetëm që rregullojnë gjerësinë e shtrirjes së autoritetit të tyre por, siç do të tregojmë në pjesët në vazhdim, zbatojnë edhe një sistem ekuilibri ndërmjet pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv në njërin anë, si dhe në mes të institucionit të Presidentit dhe Qeverisë në anën tjetër. Pikërisht, duke marrë parasysh gjerësinë e autoritetit që institucionet e sigurisë bartin, kontrolli i tyre jo vetëm që zbatohet nga organet civile, por autoriteti mbi kontrollin e tyre është i vendosur në ekuilibër të mirëpërcaktuar. Kjo duhet të kihet parasysh me rastin e çdo interpretimi të këtij kapitulli të Kushtetutës, pra kontrolli civil dhe ekuilibri në ushtrimin e kompetencave në lëmin e sigurisë. Si të tilla, këto dy segmente të këtij kapitulli ngërthejnë sanksionimin e standardeve më të avancuara për sa i përket përdorimit të forcës fizike kolektive nga ana e një shteti, në kohë paqeje dhe në kohë lufte.⁹⁰¹ Në këtë kapitull, më tutje, operacionalizohet edhe zotimi kushtetues nga neni 2.3 lidhur me nenet 17.2 dhe 20.1 të Kushtetutës të cilët i lejojnë Kosovës pjesëmarrje në aleanca politike - ushtarake dhe marrje pjesë ne operacione të paqes dhe të luftës jashtë territorit të saj shtetëror (në kuadër të detyrimeve ndërkombëtare). Kjo në të njëjtën kohë nënkupton se ky kapitull më shumë e vë në spikamë faktin se Kosova dhe organet e institucioneve të saj të sigurisë i nënshtrohen ligjit ndërkombëtar dhe nuk mund të përdorin detyrimet kushtetuese si arsye dhe pretekst për t'i ikur kësaj përgjegjësie para ligjit ndërkombëtar.

⁹⁰¹ “*Vis consilii experts mole ruit sua*” (forca pa kontroll shembet nga vetë pesha e saj), ka thënë shkrimtari i njohur romak Horaci në lirikën e tij, CARMINA, një përmbledhje në katër libra i poemave lirike ndër më të mirat në antikitet. Ky mesazh ka kuptimin se forca duhet të kontrollohet nga syri publik, ku parlamentet përbëjnë trupën kryesore të këtij kontrolli, diçka që qartë reflektohet në këtë kapitull të Kushtetutës, si në kohë paqeje ashtu dhe në kohë gjendjesh të jashtëzakonshme. Cf. më shumë për këtë kontroll në vendet demokratike, për parimet, mekanizmat dhe praktikën në doracakun e shkëlqyer të Geneva Centre for Democratic Control of Armed Forces, të titulluar si *Parliamentary Oversight of the Security Sector* (IPU and DCAF: Geneva, 2003).

Neni 125 [Parimet e Përgjithshme]

- (1) Republika e Kosovës ka pushtet mbi zbatimin e ligjit, sigurinë, drejtësinë, sigurinë publike, inteligjencën, organet civile emergjente dhe mbi kontrollin e kufijve në territorin e vet.**
- (2) Institucionet e sigurisë në Republikën e Kosovës mbrojnë sigurinë publike dhe të drejtat e të gjithëve në Republikën e Kosovës. Institucionet veprojnë me transparencë të plotë dhe në pajtim me standardet demokratike e me të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht. Institucionet e Sigurisë duhet të pasqyrojnë shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës.**
- (3) Republika e Kosovës respekton plotësisht të gjitha marrëveshjet e aplikueshme ndërkombëtare dhe ligjin përkatës ndërkombëtar dhe bashkëpunon me organet ndërkombëtare të sigurisë e me homologët rajonalë.**
- (4) Kontrolli civil dhe demokratik mbi institucionet e sigurisë garantohej.**
- (5) Kuvendi i Republikës së Kosovës mbikëqyr buxhetin dhe politikat e institucioneve të sigurisë, sikur rregullohet me ligj.**

Neni 125

1. Neni 125 i Kushtetutës përcakton parimet e përgjithshme të cilat qeverisin veprimtarinë e institucioneve të sigurisë. Po ashtu, ky nen, ndërton modelin e ushtrimit të mandatit të institucioneve të sigurisë dhe përcakton autoritetin e përgjithshëm kushtetues për kontrollin e tyre. Si në aspektin formal ashtu dhe në atë institucional, ky nen sanksionon pesë parime të cilat duhen pasqyruar në çdo rast me rastin e interpretimit të këtij kapitulli të rëndësishëm të Kushtetutës.
2. Parimi i parë është ai i përjashtimit në kuptimin e përcaktuar nga Maks Veber të çdo autoriteti tjetër jo-shtetëror për t'u marrë me çështje nga sektori i sigurisë. Kjo d.m.th. se Republika e Kosovës është e vetmja që ka monopol në këtë lëmi duke përjashtuar çdo aktor tjetër, lokal dhe qendror, për t'u marrë me çështje të sigurisë në mënyrë legjitime. Parimi i dytë është ai që lidhet me barazinë e të gjithëve në Kosovë në sektorin e sigurisë, si kur është fjala për funksionimin e këtij sektori ashtu dhe për shfrytëzimin e të mirave që vijnë nga ky sektor, gjithnjë duke u bazuar në standardet më të larta ndërkombëtare që vlejné për funksionimin e këtij sektori, siç janë respektimi i të drejtave të njeriut dhe i diversitetit kulturor, etnik, gjuhësor, fetar dhe tjetër. Kjo dispozitë duhet të shikohet në kuptim të trendeve globale të vendeve të demokracisë kushtetuese të cilat po bëjnë përpjekje të vazhdueshme për prodhim të sigurisë përmes respektimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut, ajo që quhet "siguria përmes të drejtave të njeriut", që d.m.th. se investimi në të drejtat e njeriut, në realizimin dhe promovimin e tyre është rruga më e mirë për realizimin e sigurisë dhe stabilitetit rajonal, ndërkombëtar dhe global. Në vijim të kësaj, parimi i tretë natyrshëm plotëson dy parimet e para kur flet për respektim të traktateve ndërkombëtare dhe të ligjit ndërkombëtar në përgjithësi në çështjet e sigurisë në kuptim të gjerë, duke përfshirë këtu edhe bashkëpunimin ndërkombëtar në mes të Kosovës dhe vendeve përreth dhe më gjerë. Parimi i

parafundit flet për kontrollin civil demokratik të forcës shtetërore, në çdo rrethanë, gjë që duhet të normohet me ligj më tutje nga ana e Kuvendit si një ndër organet kyçe në një shoqëri demokratike për kontrollin e sektorit të sigurisë dhe sigurimin që ky sektor nuk del nga kontrolli civil.

Neni 125.1

1. Neni 125.1 përcakton që Republika e Kosovës, gjegjësisht institucionet shtetërore të saj, kanë autoritetin kushtetues mbi zbatimin e ligjit, drejtësisë, sigurinë publike, inteligjencën, organet civile emergjente dhe mbi kontrollin e kufijve në territorin e vet. Pra, ky nen, konfirmon që autoritetet e vetme kushtetuese që bartin kompetencat në fushat e lartpërmendura janë institucionet e Republikës së Kosovës. Në këtë kuptim, kushtetuta përjashton mundësinë që tagri kushtetues mbi fushat e përcaktuara të konkurrohet nga ndonjë autoritet tjetër në vend. Në të njëjtën kohë, kjo nënkupton se edhe përgjegjësia eventuale për çështjet e sigurisë në tërë territorin e Kosovës bie mbi Republikën e Kosovës, standard ky i njohur në të drejtën ndërkombëtare. Përjashtimet e kësaj përgjegjësie eventuale janë të rralla dhe duhet të provohen me kujdes nga institucionet e Republikës së Kosovës duke i marrë parasysh rrethanat e rastit konkret (p.sh. lufta civile dhe humbja e kontrollit ndaj një pjese të territorit, gjë që duhet të bëhet e ditur me kohë për tërë botën, sepse ndryshe nuk mund t'i iket përgjegjësisë ndërkombëtare për dëmet apo pasojat eventuale të shkaktuara personave, sendeve dhe shteteve të treta).⁹⁰²

Neni 125.2

1. Neni 125.2 përcakton mandatin dhe natyrën e institucioneve të sigurisë. Në përgjithësi, ky nen proklamon tri parime themelore të veprimtarisë së institucioneve të sigurisë. Së pari, ky nen përcakton që institucionet e sigurisë kanë mandatin që të mbrojnë sigurinë publike të Kosovës dhe të drejtat dhe liritë e të gjithëve. Pra, përveç funksionit të mbrojtjes së sigurisë publike, institucionet në fjalë janë të obliguara që të mbrojnë të drejtat dhe liritë e të gjithë personave që jetojnë në Kosovë, pa marrë parasysh nëse këta të fundit gëzojnë shtetësinë e Kosovës. Me fjalë të tjera, mbrojtja nga institucionet e Kosovës ka shtrirje më të gjerë se sa vet koncepti i shtetësisë dhe aplikohet përgjithësisht ndaj të gjithë personave që jetojnë në Kosovë. Së dyti, neni proklamon që veprimtaria e institucioneve të sigurisë publike duhet të jetë transparente dhe në përputhje me standardet e sjelljes demokratike si dhe në respekt të plotë me të drejtat e njeriut të mbrojtura me akte ndërkombëtare. Sipas këtij përcaktimi, institucionet e sigurisë

⁹⁰² Në doktrinë flitet, bazuar në praktikën e shteteve dhe disa dokumente ndërkombëtare, për trashëgiminë e shteteve jo vetëm në sferën tradicionale të të drejtave e detyrimeve në lëmin e traktateve, borxhit të jashtëm shtetësisë, arkivave dhe çështjeve të ngjashme, por edhe për trashëgiminë e shteteve për aktet ndërkombëtarisht të ndaluara të kryera para datës së trashëgimit. Si datë e trashëgimit është data kur ka ndodhur ndërrimi i sovraniteteve territoriale mbi një vend dhe popullatë të caktuar. Cf. për një studim të shkëlqyer të kësaj tematike në Dumberry, Patrick *State Succession to International Responsibility* (Leiden, Boston: Martinus Nijhoff Publishers, 2007), në veçanti fq. 224-258 & 419-435;

gjatë ushtrimit të mandatit të tyre duhet të respektojnë dy grupe standardesh ndërkombëtare, që janë, standardet mbi transparencën dhe ato mbi respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Prandaj, ky nen përcakton që sjellja dhe veprimtaria e institucioneve të sigurisë nuk mund të kalojë përtej kufijve në të cilat shtrihen liritë dhe të drejtat e njeriut. Në të njëjtën kohë, ushtrimi i mandatit të dhënë kushtetues duhet të bëhet në mënyrë transparente dhe duhet të jetë i hapur ndaj qasjes në informacion apo dokumente që lidhen me veprimtarinë e tyre.

2. Natyrisht, Kushtetuta nuk përcakton që institucionet në fjalë, në situata të veçanta, nuk mund të vendosin një numër kufizimesh mbi qasjen në informacion dhe aplikimin e parimit të transparencës. Së treti, ky nen përcakton që institucionet e sigurisë duhet të pasqyrojnë shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës. Pra, sipas këtij parimi, përfaqësimi dhe pjesëmarrja në institucionet e sigurisë e individëve që vijnë nga komunitetet etnike, duhet të jetë proporcionale. Prandaj, ky nen edhe njëherë rikonfirmon që modeli i përfaqësimit proporcional të të gjitha grupeve etnike në sistemin e institucioneve të sigurisë publike duhet të vihet në jetë edhe brenda këtyre strukturave.

Neni 125.3

1. Neni 125.3 kërkon nga institucionet gjegjëse të Republikës së Kosovës që të respektojnë të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare dhe rregullat e së drejtës ndërkombëtare në fushën e sigurisë, si dhe kërkon nga institucionet në fjalë që të bashkëpunojnë me organet përkatës ndërkombëtare dhe ato rajonale. Kjo dispozitë, pra, proklamon që Republika e Kosovës duhet të respektojë të gjitha parimet dhe rregullat e njohura ndërkombëtare në fushën e sigurisë, dhe, ku është e mundur, të aderohet në marrëveshje të tilla. Kërkesa për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e sigurisë tregon që institucionet e Kosovës duhet të jenë pjesë e iniciativave rajonale dhe ndërkombëtare me qëllim të mbrojtjes dhe zhvillimit të parimeve të demokracisë. Në këtë rast, Kushtetuta afirmon dhe inkurajon të drejtën e institucioneve të Kosovës për të qenë pjesë e aleancave ushtarake, marrëveshjeve ndërkombëtare të karakterit të ndryshëm ushtarak apo policor dhe që kanë për qëllim mbrojtjen, promovimin dhe avancimin e parimeve demokratike ndërkombëtare.

Neni 125.4

1. Paragrafi i katërt i nenit 125 e jetëson parimin e kontrollit civil mbi institucionet e sigurisë. Ky parim, në kontekstin teorik, është shfaqur si rezultat i kundërthënies mbi legjitimitetin e veprimtarisë së institucioneve ushtarake dhe policore në regjimet autokratike. Në këtë kontekst, kontrolli i përhershëm civil dhe përfaqësues mbi veprimtarinë e institucioneve të sigurisë shndërrohet në mjet të fuqishëm të ekuilibrit në mes të natyrës së institucioneve të sigurisë dhe përfaqësimit legjitim politik. Në një tjetër dimension, ushtrimi i kontrollit civil mbi institucionet e sigurisë nënkupton që rolin mbikëqyrës kundrejt këtyre institucioneve e kanë organet përfaqësuese dhe të zgjedhura të cilat, si të tilla, reflektojnë fuqishëm dimensionin e demokracisë parlamentare që Kosova aplikon. Ky parim tregon që

ushtrimi i veprimtarisë së institucioneve të sigurisë duhet të jetë në përputhje me vullnetin e institucioneve të zgjedhura civile dhe assesi ndryshe. Çdo projektim i forcës jashtë këtij parimi quhet si kundërkushtetues.

Neni 125.5

1. Neni 125.5 autorizon dhe mandaton Kuvendin e Republikës si organin i cili duhet të sigurojë mbikëqyrje të përhershme të buxhetit dhe politikave të institucioneve të sigurisë. Andaj, sipas kësaj dispozite, Kuvendi është përgjegjës për rregullimin e formës dhe modelit të ushtrimit të kontrollit të institucioneve të sigurisë, sidomos kontrollit në hartimin dhe planifikimin e shpenzimeve të buxhetit të aprovuar, si dhe në hartimin dhe zbatimin e politikave të institucioneve të sigurisë. Për më tepër, ky nen i njuh të drejtën ekskluzive Kuvendit që të ndërtoj mekanizmat gjegjës për ushtrimin e kontrollit të institucioneve të sigurisë në dy aspekte, atë të shpenzimeve buxhetore dhe të politikave të këtyre institucioneve. Në këtë pikë vlen të theksohet që Kushtetua i njuh Kuvendit rolin e institucionit civil i cili, në këtë rast, duhet të ushtroj kontroll civil mbi institucionet e sigurisë.

Neni 126 [Forca e Sigurisë e Kosovës]

- (1) **Forca e Sigurisë e Kosovës është forcë kombëtare e sigurisë për Republikën e Kosovës, dhe mund të dërgoj pjesëtarët e saj jashtë vendit në përputhje të plotë me përgjegjësitë e saj ndërkombëtare.**
- (2) **Forca e Sigurisë e Kosovës mbron qytetarët dhe komunitetet e Republikës së Kosovës në bazë të kompetencave të përcaktuara me ligj.**
- (3) **Presidenti i Republikës së Kosovës është Komandant i Përgjithshëm i Forcës së Sigurisë të Kosovës, e cila gjithmonë i nënshtrohet kontrollit të autoriteteve civile të zgjedhura në mënyrë demokratike.**
- (4) **Forca e Sigurisë e Kosovës është profesioniste, pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës dhe rekrutohet nga shtetasit e Republikës së Kosovës.**
- (5) **Komandantin e Forcës së Sigurisë të Kosovës e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të rekomandimit të Qeverisë. Organizimi i brendshëm i Forcës së Sigurisë të Kosovës rregullohet me ligj.**

Neni 126.1

1. Neni 126.1 themelon Forcën e Sigurisë së Kosovës e cila është forcë ushtarake kombëtare, një dhe unike, për të gjithë Republikën e Kosovës. Për më tepër, ky nen përcakton që FSK ka autorizimin që të dërgojë pjesëtarët e saj jashtë vendit në përputhje me kërkesat që dalin nga marrëveshjet dhe përgjegjësitë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës. Pra, Kushtetuta kufizon të drejtën Forcës së Sigurisë që të dërgojë jashtë vendit trupa të saj nëse misioni i tyre nuk është në përputhje me rregullat ndërkombëtare dhe përgjegjësinë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.

Neni 126.2

1. Neni 126.2 përcakton veprimtarinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Së pari, sipas nenit në fjalë, FSK ka si mision kryesor mbrojtjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Pra, kushtetuta përcakton që mbrojtja e të drejtave individuale dhe individëve është njëra ndër veprimtaritë themelore të saj. Së dyti, FSK përveç mbrojtjes së individëve, i kërkohet që të mbrojë edhe komunitetet dhe të drejtat kolektive të tyre. Në këtë kuptim, FSK ka mandatin kushtetues që të mbrojë grupet e ndryshme të qytetarëve dhe rrjedhimisht të garantojë që këta të fundit të gëzojnë të drejtat e tyre kolektive.

Neni 126.3

1. Neni 126.3 përcakton që Komandant i Përgjithshëm i Forcës së Sigurisë është Presidenti i Republikës. Në pjesën mbi Presidentin e Republikës ne kemi sqaruar funksionin e Presidentit si Komandant i Përgjithshëm i FSK-së dhe modelin e manifestimit së këtij autoriteti. Por, duhet thënë që kjo dispozitë jetëson parimin e kontrollit civil mbi FSK-në, duke njohur Presidentin e Republikës si Komandant të Përgjithshëm të saj.

Neni 126.4

1. Neni 126.4 përcakton që FSK duhet të jetë forcë profesioniste, e cila pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Kosovës dhe e cila përbëhet nga shtetasit e saj. Në këtë pikë janë tri gjëra që duhet sqaruar. Së pari, Kushtetuta e njëj FSK-në si organizatë ushtarake profesioniste, e përbërë nga individë që ushtrojnë aktivitetin e tyre të përditshëm profesional. Me fjalë tjera, FSK duhet të jetë organizatë që mbanë një numër anëtarësh, që ushtrojnë funksionin e ushtrimit/es përherë, pa-shkëputje dhe brenda konceptit të profesionit. Së dyti, duhet sqaruar që ky nen përcakton që përbërja etnike e FSK-së duhet të jetë proporcionale, në atë formë që të reflektojë përbërjen etnike të popullit të Kosovës, dhe, së fundit, duhet thënë që FSK, gjithnjë sipas kuptimit që norma ka, përbëhet vetëm nga shtetasit e Republikës së Kosovës, dhe përjashton çdo mundësi që grupet apo individët që nuk mbajnë shtetësinë e Kosovës të anëtarësohen në të. Pra, anëtarë të FSK mund të bëhen vetëm shtetasit e Republikës së Kosovës, të cilët gëzojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky status.

Neni 126.5

1. Neni 126.5 përcakton mënyrën e zgjedhjes së Komandantit të FSK-së. Fillimisht duhet sqaruar që Kushtetuta bën dallimin në mes të Komandantit të Përgjithshëm, funksion që ushtrohet nga Presidenti i Republikës *ex-officio*, dhe Komandantit të FSK-së, funksion që duhet të ushtrohet nga individë që janë pjesë e trupës ushtarake të FSK-së. Neni në fjalë, prandaj, përcakton që Komandanti i FSK-së emërohet nga Presidenti në bazë të rekomandimit të qeverisë. Në këtë pikë është e rëndësishme të thuhet që Kushtetuta vendos një ekuilibër, në kuptim të

institucioneve të përfshira në zgjedhjen e Komandantit të FSK-së, në mes të institucionit të Presidentit dhe në institucionit të Qeverisë. Pra, Kushtetuta kërkon që emërimi i Komandantit të FSK-së të jetë rrjedhë e konsensusit në mes të institucionit të Presidentit dhe të Qeverisë. Po ashtu, ky nen përcakton që organizimi i brendshëm i Forcës së Sigurisë duhet të bëhet me ligj. Në këtë kuptim, Kuvendi i Kosovës mban mandatin e plotë kushtetues për të përcaktuar formën e organizimit të brendshëm të FSK-së, u mor vesh pa cenuar parimet e përgjithshme të këtij kapitulli dhe të dispozitave të komentuara me sipër. Ndryshe, ligji quhet si kundërkushtetues.

Neni 127 [Këshilli i Sigurisë i Kosovës]

- (1) Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Presidentin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë, përgatit strategjinë e sigurisë për Republikën e Kosovës. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës ka edhe rol këshillues në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në Republikën e Kosovës.**
- (2) Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës kryesohet nga Kryeministri me mbështetje nga Qeveria, përveç gjatë periudhës së Gjendjes së Jashtëzakonshme, sikurse është parashikuar me këtë Kushtetutë.**
- (3) Presidenti i Republikës së Kosovës mund të kërkojë takime të Këshillit të Sigurisë të Republikës së Kosovës, dhe Këshilli është i obliguar të bashkërendojë punën e tij ngushtësisht me Presidentin. Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtësisht me autoritetet ndërkombe-tare.**
- (4) Anëtarët e Këshillit të Sigurisë të Republikës së Kosovës emërohen dhe shkarkohen në mënyrën e përcaktuar me ligj.**

Neni 127.1

1. Neni 127.1 themelon Këshillin e Sigurisë së Kosovës, si organ këshillues për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë. Pra, Këshilli i Sigurisë, vepron si organ, kolektiv, këshillëdhënës dhe profesional. Po ashtu, Kushtetuta mandaton Këshillin që, në bashkëpunim me Presidentin e Republikës dhe Qeverinë, të hartojë dhe miratojë strategjinë e sigurisë së Republikës. Me një fjalë, ky nen përcakton dy funksione kyçe për Këshillin e Sigurisë së Kosovës. I pari është në planin strategjik, përkatësisht mandaton atë që të përpilojë strategjinë e sigurisë për Republikën e Kosovës. I dyti funksion është këshillues dhe, si i tillë, plotëson funksionin e parë të Këshillit.

Neni 127.2

1. Neni 127.2 përcakton që Këshilli i Sigurisë kryesohet nga Kryeministri i Kosovës dhe për funksionimin e tij mbështetet nga Qeveria. Pra, Kushtetuta përcakton që Kryeministri i Kosovës siguron mbarëvajtjen e punës së Këshillit dhe garanton

funksionimin e tij. Por, sipas përcaktimit kushtetues, gjatë periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme, udhëheqja e Këshillit merret përsipër nga Presidenti i Republikës, sipas kushteve të përcaktuara.

Neni 127.3

Neni 127.3 përcakton që Presidenti i Republikës mund të kërkojë që Këshilli të mblidhet dhe të bashkërendoj punën me Presidentin e Republikës. Pra, Kushtetuta përcakton që Këshilli duhet që ngushtësisht të bashkërendoj punën me Presidentin e Republikës dhe t'i përgjigjet kërkesave të këtij të fundit për t'u mbledhur. Në të njëjtën kohë, Kushtetua përcakton që Këshilli duhet të sigurojë që të mbaj komunikim të përhershëm me autoritetet ndërkombëtare, me qëllim të ushtrimit të funksionit të tyre. Si duhet të kuptohet kjo dispozitë që mandaton Këshillin për të bashkëpunuar me autoritetet ndërkombëtare? Cili është ky mandat, i detyrueshëm apo fakultativ? Së fundi, çka duhet nënkuptuar me termin “autoritete ndërkombëtare” i përdorur në këtë nen?

1. Në rend të parë, kjo dispozitë në formën e dhënë këtu dhe në përmbajtjen e vet duhet të kuptohet në kontekstin kosovar. Çështjet e sigurisë në Kosovë janë specifike dhe si të tilla janë reflektuar edhe në disa dispozita të Kushtetutës, kjo këtu duke qenë një rast tipik. Siç dihet mandati i pranisë ushtarake ndërkombëtare në Kosovë, *stricto sensu*, ishte përcaktuar fillimisht me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të datës 10 qershor 1999. Si e tillë, kjo prani, mbi bazën e kësaj rezolute, u realizua nga aleanca veri-atlantike, NATO, dhe u njoh që atëherë me emërtim “KFOR”. Prania në fjalë me pas u sanksionua me Planin Ahtisari dhe si e tillë akoma mbetet në fuqi.⁹⁰³
2. Së dyti, mandati është i detyrueshëm sepse po të ishte fakultative nuk do të kishte asnjë kuptim marrë parasysh faktin se fjala është për çështje të sigurisë. Plani Ahtisari, por edhe vetë Kushtetuta e Kosovës pas ndryshimeve që janë bërë në pranverën e vitit 2012 me amendamentet e miratuara që mbyllin pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës, sërish lejnë hapësirë për prani ushtarake dhe të sigurisë në Kosovë edhe për një kohë të caktuar.⁹⁰⁴ Së fundi, me autoritete ndërkombëtare në kuptim të këtij neni janë ato autoritete të cilat sanksionohen me Planin Ahtisari, me përjashtim të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, i cili pat qenë autoritetit kyç për mbikëqyrjen dhe interpretimin e Planit Ahtisari deri në shtatorin e vitit 2012.
3. Nga sa u tha më lartë, vlen të theksohet se çdo interpretim i këtij neni dhe i kapitullit në përgjithësi duhet të ketë parasysh këto komentime që u thanë këtu sa i përket formës dhe përmbajtës së termin autoritet ndërkombëtar në kontekstin kosovar.

⁹⁰³ Cf. Nenet 9 (“Sektori i Sigurisë”) dhe 13 (“Prania Ushtarake Ndërkombëtare”), të operacionalizuar më tutje në anekset VIII (“Sektori i Sigurisë së Kosovës”) dhe XI (“Prania Ushtarake Ndërkombëtare”) të Propozimit gjithëpërfshirës për marrëveshjen për statusin e Kosovës (“Plani Ahtisari”), i 2 shkurtit 2007.

⁹⁰⁴ *Vlerësim i kushtetutshmërisë së propozimeve të Qeverisë për amendamentimin e Kushtetutës, dorëzuar nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës me 12 prill 2012*. Rasti KO 38/12. Vendim. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (Nr. Ref.: K 234/12), datë 15 maj 2012;

Neni 127.4

1. Neni 127.4 përcakton se për mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve tjerë të Këshillit të Sigurisë, Kuvendi i Kosovës duhet të nxjerr një ligj. Pra, Kuvendi i Kosovës është organi përgjegjës për të rregulluar mënyrën e zgjedhjes dhe shkarkimit të anëtarëve të Këshillit të Sigurisë së Republikës së Kosovës. Kjo nuk mund të bëhet në asnjë formë tjetër dhe me asnjë akt tjetër juridik pos me ligj.

Neni 128 [Policia e Kosovës]

- (1) **Policia e Republikës së Kosovës mban përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.**
- (2) **Policia e Republikës së Kosovës është profesioniste dhe pasqyron shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës.**
- (3) **Kryeministri emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Republikës së Kosovës me rekomandimin e Qeverisë dhe në pajtim me ligjin. Organizimi i brendshëm i Policisë së Kosovës, rregullohet me ligj.**
- (4) **Policia e Republikës së Kosovës ka zinxhir të unifikuar komandues në tërë Republikën e Kosovës, me stacione policore të cilat korrespondojnë me kufijtë komunalë. Policia e Kosovës lehtëson bashkëpunimin me autoritetet komunale dhe udhëheqësit e bashkësive përmes themelimit të Këshillave Lokale, sikur është rregulluar me ligj. Përbërja etnike e policisë brenda një komune duhet të pasqyron, deri në shkallën më lartë të mundshme, përbërjen etnike të popullsisë brenda komunës përkatëse.**
- (5) **Policia e Republikës së Kosovës mban përgjegjësinë për kontrollin e kufirit në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me autoritetet vendore dhe ndërkombe-tare.**

Neni 128.1

1. Neni 128, përcakton organizimin dhe funksionimin e Policisë së Kosovës. Paragrafi i parë përcakton që Policia e Kosovës është institucioni përgjegjës për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Kosovës. Pra, Kushtetuta përcakton që Policia e Kosovës ka autoritetin kushtetues që të vërë në funksion mjetet e nevojshme për të garantuar ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në Kosovë.

Neni 128.2

1. Neni 128.2 përcakton që Policia e Kosovës është forcë policore profesioniste dhe duhet të pasqyrojë shumëllojshmërinë etnike të popullit të Republikës së Kosovës. Në këtë kuptim, ky nen ndjek parimin kushtetues të përfaqësimit proporcional të komuniteteve etnike në Policinë e Kosovës. Po ashtu, ky nen përcakton vizionin që institucioni i Policisë së Kosovës duhet të ndjek, duke garantuar që pjesëtarët e saj të ushtrojnë veprimtarinë e tyre mbi baza të kualifikimeve profesionale. Pra,

Policia e Kosovës duhet të garantojë që pjesëtarët e saj të kenë përgatitje të mjaftueshme profesionale për të ushtruar veprimtarinë e tyre në bazë të parimeve të sjelljes profesionale. Parimi i përfaqësimit etnik dhe i profesionalizmit duhet të interpretohen në mënyrë të ndërlidhur me njëri tjetrin. Kjo d.m.th. se asnjëri prej tyre nuk guxon të realizohet në dëm të tjetrit.

Neni 128.3

1. Neni 123.3 përcakton që Kryeministri i Kosovës pas rekomandimit të Qeverisë emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë. Pra, Kushtetuta i njeh tagrin Kryeministrit që pas propozimit të Qeverisë të emërojë Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë. Kjo normë, përcakton që Kryeministri mban të drejtën dhe diskrecionin për të vendosur mbi kandidaturat e propozuara nga Qeveria. Me një fjalë, rekomandimi i Qeverisë duhet të kuptohet në kontekst të nenit 94.6 të Kushtetutës, i cili i jep të drejtë ekskluzive Kryeministrit që të emërojë Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë. U mor vesh, procedurat e shkarkimit të Drejtorit rregullohen me ligj dhe Kryeministri nuk mund ta shkarkojë Drejtorin e Përgjithshëm veçse sipas ligjit, siç e kemi komentuar me nenin 94.6 të Kushtetutës.
2. Më tutje, ky nen përcakton që organizimi i brendshëm i Policisë rregullohet me ligj. Pra, në këtë rast Kuvendi mban autoritetin kushtetues për të përcaktuar se cili është modeli i organizimit dhe funksionimit të Policisë së Kosovës.

Neni 128.4

1. Neni 128.4 vendos parimet e përgjithshme të organizimit të Policisë së Kosovës. Në këtë kuptim, kjo normë përcakton që Policia e Kosovës duhet të ketë një zinxhirë të përbashkët dhe të unifikuar komandues për tërë territorin e Kosovës. Kjo ka rëndësi të madhe sepse zinxhirin komandues e vëjnë si një detyrim kushtetues i cili nuk mund të mënjanohet me ligj apo ndonjë marrëveshje politike. Çdo shmangie nga ky parim kushtetues është kundërkushtetues.
2. Zinxhiri komandues nuk nënkupton udhëheqje autoritare, por të centralizuar dhe të dekoncentruar. Kjo e dyta manifestohet në pjesën e dispozitës së këtij neni që përcakton se Policia e Kosovës duhet të themelojë stacione policore me të cilat korrespondojnë me kufijtë e përcaktuar komunal. Në të njëjtën kohë, neni në fjalë përcakton që Policia e Kosovës duhet të shtrijë bashkëpunimin me autoritetet komunale dhe udhëheqësit e atyre njësive lokale. Pra, sipas përcaktimit kushtetues, Policia e Kosovës duhet të ketë parasysh bashkëpunimin me njësitë e përfaqësimit të qytetarëve dhe t'i shërbej komunitetit. Po ashtu, sipas këtij paragrafi, përbërja etnike e policisë në njësi komunale duhet të pasqyroj, përbërjen etnike të popullsisë brenda komunës përkatëse. Pra, Kushtetuta përcakton që përveç garantimit të përfaqësimit të pjesëmarrjes së pjesëtarëve të komuniteteve etnike në nivelin qendror duhet gjithashtu të ekzistojë përfaqësim adekuat etnik edhe në njësitë e policisë të nivelit lokal.

Neni 128.5

1. Neni 128.5 përcakton që njëri ndër funksionet kryesore të Policisë së Kosovës është kontrolli i kufirit në bashkëpunim të drejtpërdrejt me autoritet vendore dhe ndërkombëtare. Pra, Kushtetuta i njeh Policisë së Kosovës autoritetin për të garantuar kontrollin e kufirit të Kosovës me vendet fqinje. Në të njëjtën kohë, Kushtetua kërkon nga Policia e Kosovës që të bashkëpunojë me institucionet tjera vendore që janë pjesë e integruar e menaxhimit të kufirit. Po ashtu, duke njohur rolin e pranisë ndërkombëtare në fushën e sigurisë, Kushtetuta kërkon që Policia e Kosovës të vendos bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare që ushtrojnë autoritetin e tyre në fushën e sigurisë.

Neni 129 [Agjencia e Kosovës për Inteligjencë]

- (1) **Agjencia e Kosovës për Inteligjencë zbulon, heton dhe mbikëqyr kërcënimet ndaj sigurisë në Republikën e Kosovës.**
- (2) **Agjencia e Kosovës për Inteligjencë është profesioniste, politikisht e paanshme, shumetnike dhe i nënshtrohet mbikëqyrjes nga Kuvendi në mënyrën e përcaktuar me ligj.**
- (3) **Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri, pas konsultimit me Qeverinë, së bashku emërojnë Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Kualifikimi dhe mandati, rregullohen me ligj.**
- (4) **Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri marrin të njëjtat informacione në lidhje me inteligjencën.**

Neni 129.1

1. Kushtetuta e Kosovës themelon edhe një institucion në kuadër të strukturës së institucioneve të sigurisë. Në këtë kuptim, Kushtetuta përcakton që Agjencia e Kosovës për Inteligjencë ka kompetencë për të hetuar dhe mbikëqyrur kërcënimet ndaj sigurisë në Kosovë. Pra, sipas përcaktimit kushtetues, veprimtaria e AKI-së lidhet drejtpërdrejt me hetimin dhe kontrollin e kërcënimeve ndaj sigurisë në Kosovë.

Neni 129.2

1. Sipas nenit 129.2, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë duhet të jetë institucion i pavarur, profesionist, politikisht i paanshëm dhe shumetnik. Pra, kjo normë përcakton që AKI nuk mund të jetë dhe nuk mund të pranojë në gjirin e saj persona që janë të përfshirë në aktivitete të partive politike apo të ndjek ndonjë agjendë politike. Në të njëjtën kohë, Kushtetuta përcakton që përbërja shumetnike e AKI-së duhet të garantohet. Në anën tjetër, Kushtetuta përcakton që Agjencia e Kosovës për Inteligjencë kontrollon vetëm nga Kuvendi i Kosovës, gjë që nënkupton se parimi i kontrollit civil jetësohet nëpërmjet kontrollit që Kuvendi i Kosovës

ushtron ndaj AKI-së. Çdo aktivitet i AKI-së, me një fjalë, është transparent dhe nuk mund t'i ikë kontrollit të syrit të publikut.

Neni 129.3

1. Neni 129.3, përcakton autoritetin që emëron zyrtarët kryesorë të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Pra, sipas Kushtetutës, autoriteti për emërimin Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë ndahet në mes të Presidentit dhe Kryeministrit të Kosovës. Sipas, këtij neni, Presidenti dhe Kryeministri, bashkërisht, pas konsultimit me Qeverinë, vendosin, mbi bazën e konsensusit të tyre, për emërimin e Drejtorit, Zëvendësdrejtorit dhe Inspektorit të përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë. Në këtë kuptim, autoriteti për emërimin e tri figurave kryesore të administrimit të AKI-së është kompetencë e ndarë në mes të institucionit të Presidentit dhe Kryeministrit. Në të njëjtën kohe, Kushtetuta përcakton që kualifikimi dhe mandati i Drejtorit, Zëvendësdrejtorit dhe Inspektorit të përgjithshëm të Agjencisë duhet të rregullohet me ligj, të nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës. Pra, përfshirja e Kuvendit në përcaktimin e kriterëve të përzgjedhjes, si dhe mandatin e zyrtarëve të institucionit në fjalë në njërin anën, si dhe përfshirja e Presidentit dhe Kryeministrit në emërimin e zyrtarëve të lartpërmendur në anën tjetër, tregon modelin e ekuilibrit që Kushtetuta ndjek. Kjo, në të njëjtën kohë, paraqet pjesë të zinxhirit të kontrollit civil mbi institucionet dhe organet e sigurisë në Kosovë.

Neni 129.4

1. Neni 129.4 përcakton detyrimin që Agjencia e Kosovës për Inteligjencë kundrejt institucionit të Presidentit dhe Kryeministrit. Pra, Kushtetuta përcakton që Agjencia është e detyruar që të transmetoj të njëjtat informacione të inteligjencës Presidentit dhe Kryeministrit. Edhe njëherë këtu Kushtetuta vendos një ekuilibër në mes të Presidentit dhe Kryeministrit edhe në kuptim të marrjes së informacionit mbi inteligjencën. Ngritja në detyrim kushtetues të një veprimtarie në shikim të parë teknike, siç është kjo e ndarjes së informacionit në mes të Presidentit dhe Qeverisë në mënyrë të njëjtë, flet shumë përkushtimin e Kushtetutës së Kosovës që të sigurohet dhe garantohet një ekuilibër i përhershëm në mes të institucioneve të sigurisë ashtu që asnjëri prej institucioneve qendrore të mos ketë mundësi të akumulimit të pushtetit më shumë se i takon me Kushtetutë e ligje.

Neni 130 [Autoriteti Civil i Aviacionit]

- (1) **Autoriteti Civil i Aviacionit të Republikës së Kosovës rregullon veprimtarinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës dhe është ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror, sikur është përcaktuar me ligj.**
- (2) **Autoriteti Civil i Aviacionit bashkëpunon plotësisht me autoritetet relevante ndërkombëtare dhe vendore, të përcaktuara me ligj.**

Neni 130.1 & 130.2

1. Neni 130.1 përcakton që Autoriteti Civil i Aviacionit të Republikës ka mandatin kushtetues që të rregullojë veprimtarinë aviacionit civil, dhe ofron shërbimet e navigacionit ajror. Pra, Kushtetuta mandaton Autoritetin e Civil të Aviacionit të shërbej si rregullator i veprimtarisë në fushën e aviacionit civil. Në të njëjtën kohë, neni 130.2, përcakton që Autoriteti Civil i Aviacionit duhet të bashkëpunojë me autoritetet relevante ndërkombëtare për të koordinuar funksionimin e mandatit të tij. Kjo nënkupton se vlerësimi i kushtetutshmërisë së çdo akti apo veprimi në lëmën e aviacionit civil në Kosovë duhet të ketë për pikë referimi primar standardet dhe normat ndërkombëtare për aviacionin civil.

Neni 131 [Gjendja e Jashtëzakonshme]

- (1) **Presidenti i Republikës mund të shpallë Gjendjen e Jashtëzakonshme, kur:**
 1. ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes;
 2. ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike;
 3. ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij.
- (2) **Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk suspendohet. Kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë Kushtetutë, bëhen vetëm deri në shkallën e nevojshme, për sa më pak kohë që të jetë e nevojshme dhe në përputhje të plotë me këtë Kushtetutë. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ligji për zgjedhjet e Kuvendit dhe të Komunave nuk mund të ndryshohet. Parimet e tjera për veprimet e institucioneve publike gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme rregullohen me ligj, por ato nuk duhet të jenë në shpërputhje me këtë nen.**
- (3) **Nëse paraqitet nevoja për marrjen e masave emergjente të mbrojtjes, Presidenti i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me Kryeministrin, shpallë Gjendjen e Jashtëzakonshme. Me shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, Presidenti i Republikës së Kosovës shpallë menjëherë dekretin, i cili përcakton natyrën e kërcënimit dhe çfarëdo kufizimi për të drejtat dhe liritë. Brenda dyzet e tetë (48) orësh, Kuvendi mund të japë pëlqimin me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse nuk jepet pëlqimi, dekreti i Presidentit nuk ka forcë as efekt.**
- (4) **Nëse ka rrezik ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë publike në Republikën e Kosovës, ose ekziston një fatkeqësi natyrore në tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij, Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me Kryeministrin, mund të shpallë Gjendjen e Jashtëzakonshme. Me shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, Presidenti i Republikës së Kosovës shpallë menjëherë një dekret, i cili përcakton natyrën e gjendjes së emergjencës dhe çfarëdo kufizimi mbi të drejtat dhe liritë. Brenda dyzet e tetë (48) orësh, Kuvendi mund të japë**

pëlqimin e tij me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Nëse nuk jepet pëlqimi, dekreti i Presidentit nuk ka forcë as efekt.

- (5) Gjendja e Jashtëzakonshme zgjat për aq kohë sa vazhdon të kërcënojë rreziku dhe nuk mund të zgjatë më shumë se për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh. Me pëlqimin e shumicës së deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë, Gjendja e Jashtëzakonshme, nëse është e nevojshme, mund të zgjatet për periudha pasuese prej tridhjetë (30) ditësh, por jo më shumë se për nëntëdhjetë (90) ditë shtesë gjithsej.
- (6) Kuvendi mund të vendosë kufizime të tilla, sipas nevojës, për sa i përket kohëzgjatjes dhe shkallës së Gjendjes së Jashtëzakonshme. Kur Presidenti konstaton se rreziku ndaj Republikës së Kosovës është i natyrës së jashtëzakonshme, Kuvendi mund të vendosë që Gjendja e Jashtëzakonshme të zgjasë më shumë se njëqind e pesëdhjetë (150) ditë, vetëm nëse për të votojnë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit.
- (7) Presidenti i Republikës së Kosovës, pas konsultimit me Qeverinë dhe Kuvendin, mund të urdhërojë mobilizimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës, për të ndihmuar në Gjendjen e Jashtëzakonshme.
- (8) Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës, vetëm gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, ushtron funksione ekzekutive që kufizohen në funksionet që ndërliken në veçanti me Gjendjen e Jashtëzakonshme. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të drejtohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, sikur rregullohet me ligj. Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojë ngushtësisht me Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet ndërkombëtare.
- (9) Ligji përcakton parimet, lëmit dhe mënyrën e kompensimit të dëmeve të shkaktuara si pasojë e kufizimeve të vendosura gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme.

Neni 131.1

1. Neni 131 përcakton mënyrat e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme. Sipas përcaktimit kushtetues, Presidenti i Republikës mund të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme në tri raste: a) kur ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes; b) kur ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike; dhe, së fundi, c) kur ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij.
2. Sipas kuptimit të normës kushtetuese, Presidenti mund të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme vetëm në rastet kur njëra nga rrethanat e përcaktuara kushtetuese është evidente. Pra, kushtetuta nuk lejon që shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme të bëhet jashtë rrethanave tjera që nuk janë përcaktuar me Kushtetutë.

Neni 131.2

1. Neni 131.2 përcakton detyrimet që institucionet e Republikës bartin në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme. Pra, sipas nenit në fjalë, janë katër parime që udhëheqin gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë. Së pari, neni në fjalë përcakton që Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk mund të suspendohet. Pra, gjendja e jashtëzakonshme nuk mund të shërbejë si arsytim për të ndaluar efektin apo suspenduar tërësinë e parimeve që ajo proklamon. Së dyti, neni kushtetues përcakton që liritë dhe të drejtat e individëve në rastin e gjendjes së jashtëzakonshme mund të kufizohen. Por, duhet thënë që, përkundrejt këtij fakti, Kushtetuta proklamon që kufizimet mbi të drejtat dhe liritë e garantuara me këtë akt mund të bëhen deri në atë shkallë dhe për aq kohë sa është e nevojshme, dhe sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar me Kushtetutë. Kjo nënkupton se kufizimet e lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë nuk mund të vendosen në rastet kur gjendja e tillë nuk arsyeton kufizimin e vendosur. Së treti, neni në fjalë përcakton që ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe ligji për zgjedhjet lokale nuk mund të ndryshohen gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Pra, Kushtetuta përcakton që për aq kohë sa vlen gjendja e jashtëzakonshme, Kuvendi nuk mund të ndryshojë ligjin mbi zgjedhje e përgjithshme dhe atë për zgjedhjet lokale. Në këtë kuptim, ky nen parandalon mundësinë që Kuvendi, nëpërmjet shumicës politike të përfaqësuar në të, të ndryshojë në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme ligjet mbi zgjedhjet. Së katërti, ky nen autorizon Kuvendin e Republikës që të listojë parime tjera shtesë që rregullojnë qeverisjen dhe veprimtarinë e institucionet gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme, por në asnjë mënyrë nuk mund të ndryshojnë apo të kundërshtojnë parimet që janë të proklamuar në këtë nen. Çdo ligj që shpërfillë këto kufizime kushtetuese është kundërkushtetues. Këto kufizime, shikuar në kontekstin historik të zhvillimit të demokracisë kushtetuese në rajon dhe më gjerë, paraqesin garanci që pamundësojnë abuzimin me gjendjet e jashtëzakonshme nga ana e autoriteteve shtetërore dhe subjekteve tjerë. Ky normim kushtetues kaq i detajuar i gjendjes së jashtëzakonshme, jo vetëm në këtë dispozitë por në tërë këtë nen si tërësi, shpjegon faktin se ndër çështjet kyçe të juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese është edhe vlerësimi i kushtetutshmërisë së shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe veprimeve të ndërmarra gjatë gjendjes së tillë (neni 113.3.3 i Kushtetutës).

Neni 131.3

1. Duhet thënë që Kushtetuta përcakton që autoriteti i Presidentit për të shpallur gjendjen e jashtëzakonshme është në fakt i ndarë në mes të Presidentit dhe Kuvendit. Pra, neni 131.3 përcakton se në rastet kur paraqitet nevoja për marrjen e masave emergjente të Presidenti, pas konsultimit me Kryeministrin, shpall gjendjen e jashtëzakonshme. Në këtë kuptim, pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, Presidenti duhet të shpall dekretin i cili duhet të plotësoj dy kushte. Së pari dekreti i Presidentit duhet të përcaktojë natyrën e kërcënimit që është shfaqur. Së dyti, dekreti i presidentit duhet të përcaktojë kategorinë dhe llojin e kufizimeve të të drejtave dhe lirive të njeriut. Në të njëjtën kohë, duhet thënë që

Kushtetuta përcakton që Kuvendi i Kosovës duhet të jap pëlqimin e tij për dekretin e Presidentit me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë, brenda dyzet e tetë (48) orësh. Nëse Kuvendi nuk e miraton dhe jep pëlqimin e tij për dekretin e Presidentit, ky i fundit konsiderohet pa-efekt dhe nuk ka fuqi juridike. Pra, Kushtetuta përcakton që dekreti i Presidentit duhet të konfirmohet nga ana e Kuvendit përpara se të marrë fuqinë e nevojshme juridike dhe të ketë efekt.

Neni 131.4

1. Ky nen përcakton mënyrën e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në rastet kur ekziston rrezik ndaj rendit kushtetues dhe sigurisë publike apo në rastet e ndonjë fatkeqësie natyrore në tërë territorin e Kosovës ose një pjesë të tij. Pra, sipas nenit në fjalë, Presidenti i Republikës, në konsultim me Kryeministrin, mund të shpallë gjendjen e jashtëzakonshme. Si në rastin e mësipërm, ky nen përcakton që Presidenti duhet të nxjerrë një dekret i cili duhet të plotësojnë dy kushtet e njëjta. Në të njëjtën mënyrë, Kushtetuta parashikon që Kuvendi i Kosovës, brenda dyzet e tetë orëve duhet të miratojë dekretin e Presidentit, me shumicë votash të të gjithë deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë. Sipas kuptimit që norma mban, nëse Kuvendi brenda dyzetë e tetë (48) orëve nuk jep pëlqimin e tij për dekretin e Presidentit, i njëjti nuk ka efekt dhe është i pavlefshëm. Pra, siç thamë edhe më lartë, Kushtetuta bën që Kuvendi i Kosovës të jetë autoriteti i fundit kushtetues që vendos për vendosjen ose jo të gjendjes së jashtëzakonshme.

Neni 131.5, 6 & 7

1. Neni 131.5 përcakton periudhën kohore sa mund të zgjasë gjendja e jashtëzakonshme. Pra, sipas nenit në fjalë, gjendja e jashtëzakonshme dhe kufizimi i vendosur mund të zgjasë për aq kohë sa zgjatë rreziku, por jo më shumë se gjashtëdhjetë ditë. Por, Kuvendi i Kosovës mund të vendos të zgjasë gjendjen e jashtëzakonshme edhe për tridhjetë ditë tjera, me shumicë të votave të deputetëve që janë të pranishëm dhe që votojnë. Por, ky nen, determinon që gjendja e jashtëzakonshme nuk mund të zgjatet më shumë se 90 ditë shtesë gjithsej. Sipas nenit në fjalë Kuvendi mund të vendos të kufizojë kohëzgjatjen dhe shkallën e gjendjes së jashtëzakonshme nëse e sheh të arsyeshme një veprim të tillë.
2. Por, ky nen po ashtu garanton që në rastet kur Presidenti konstaton rreziku ndaj Republikës është i natyrës së vazhdueshme dhe i përmasave të jashtëzakonshme, Kuvendi me dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve mund të vendos që gjendja e jashtëzakonshme të zgjasë më shumë se njëqind e pesëdhjetë ditë (150). Në këto raste, Presidenti i Republikës, pas konsultimit me Qeverinë dhe Kuvendin, si dhe duke ushtruar rolin e tij si komandant i përgjithshëm i Forcës së Sigurisë së Kosovës mund të mobilizojë këtë të fundit për të ndihmuar në situatën e dhënë.

Enver Hasani

Neni 131.8

1. Neni 131.8 përcakton që në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme Këshilli i Sigurisë së Kosovës mund të ushtroj funksione ekzekutive që lidhen me gjendjen e jashtëzakonshme. Gjatë kohës sa zgjat gjendja e jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë udhëhiqet nga Presidenti i Republikës, dhe duhet të bashkëpunojë për veprimtarinë e tij me Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet ndërkombëtare.

Neni 131.9

1. Ky nen përcakton që Kuvendi i Kosovës ka autoritetin kushtetues që të nxjerrë një ligj që përcakton parimet, formën dhe kushtet e kompensimit të dëmeve të shkaktuara si pasojë e kufizimeve të vendosura gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

Kapitulli XII: Institucionet e Pavarura

Hyrje e Përgjithshme

1. Në fillim duhet sqaruar që kapitulli i dymbëdhjetë i Kushtetutës së Kosovës përcakton autoritetin dhe veprimtarinë e institucioneve të pavarura të Kosovës. Në këtë kuptim, në kapitullin në fjalë renditen një numër institucionesh qendrore, të cilat sipas përcaktimit kushtetues, duhet të funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e dhëna në mënyrë të pavarur nga ndërhyrja dhe/ose ndikimi i organeve tjera të Republikës së Kosovës. Po ashtu, kapitulli mbi institucionet e pavarura vendos kufij të qartë që përcaktojnë formën e ushtrimit të autoritetit të organeve tjera shtetërore kundrejt fushëveprimit të organeve të pavarura, si dhe përcakton kriteret sipas së cilave agjencitë e pavarura mund të krijohen dhe funksionojnë. Në pjesët në vazhdim komentohen dhe sqarohen kuptimi i normave kushtetuese që rregullojnë institucionet e renditura në këtë kapitull.
2. Dy çështje janë parimore të cilat vlejné për të gjitha institucionet e pavarura. E para, institucionet e pavarura janë prodhim i shekullit XX gjatë të cilit filloi ngritja e shtetit administrativ, ngritje e cila kërkonte vendimmarrje të shpejt e cila duhej bartur te tjerët me qëllim të menaxhimit të halleve të përditshme të qytetarëve dhe punëve të shtetit. Ky aktivitet vendimmarrës, megjithatë, duhej të vihej në një kuadër ligjor të kontrollueshëm nga ana e instancave jo administrative, gjyqësore dhe kuazi-gjyqësore. Kjo nënkuptonte se shteti administrativ delegonte përgjegjësi në institucione përkatëse për të menaxhuar sa më mirë që të ishte e mundur me problemet e llojllojshme të subjekteve të së drejtës. Në këtë bartje (delegim) hynte edhe aktiviteti i shtuar legjislativ të cilin e ushtronin këto agjenci, aktivitet ky që kërkonte me urgjencë një kontroll gjyqësor të ligjshmërisë së tij.
3. Në vijim, për sa u fol më sipër, e dyta, ky aktivitet legjislativ i deleguar paraqiste dhe aktualisht paraqet pikën e referimit për përcaktimin e përgjegjësisë kushtetuese të agjencive të pavarura kundrejt kushtetutës dhe ligjeve. Kjo më tutje nënkupton që, parimisht, shteti administrativ delegon aktivitete të ndryshme tek institucionet e ndryshme për qëllime krejt të ndryshme, mirëpo ligji është ai i cili duhet të shërbej si bazë për të përcaktuar përgjegjësinë e këtyre institucioneve kundrejt kushtetutës. Nëse me një ligj që rregullon aktivitetin e një institucioni të pavarur përcaktohet një shkallë e lartë e autonomisë, ku kushtetuta shërben vetëm si bazë juridiko-kushtetuese në kuptimin formal për nxjerrjen e ligjit të tillë, atëherë përgjegjësia e institucionit të pavarur respektiv duhet të përcaktohet mbi bazën e kësaj autonomie ligjore. U mor vesh, do të ishte kundërkushtetuese sikur institucioni i pavarur do të autorizohet me një ligj për të ushtruar një aktivitet i cili fare nuk përkon me natyrën dhe funksionin e institucionit të pavarur respektiv, ta zëmë, sikur me ligj të përcaktohej se auditori i përgjithshëm mund të ushtrojë kontroll mbi punën e bizneseve private.

4. Thënë shkurt, Gjykata me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së veprimeve apo ligjeve të institucioneve të pavarura duhen t'i ketë parasysh dy gjëra. E para, nëse ai ligj apo aktivitet ka bazë juridiko-kushtetuese në këtë kapitull. E dyta, nëse ky është rasti, më pastaj Gjykata duhet të shikojë ai ligj apo aktivitet përkon me natyrën e institucionit të pavarur.

Neni 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit]

- (1) Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.**
- (2) Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në**
- (3) Republikën e Kosovës.**
- (4) Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.**

Neni 132.1

1. Neni 132 përcakton rolin dhe kompetencat e institucionit të Avokatit të Popullit. Kushtetuta e Kosovës në nenin 132.1 të saj, rëndit institucionin e Avokatit të Popullit në kuadër të listës së institucioneve që gëzojnë karakterin e organeve kushtetuese dhe të pavarura. Fillimisht, duhet thënë që ekzistenca e institucionit të Avokatit të Popullit garantohet në nivel kushtetues. Si e tillë, kjo zgjidhje, në kuptim të praktikës Evropiane, konsiderohet si mënyra më e duhur e sigurimit të pavarësisë së institucionit në fjalë.⁹⁰⁵ Për më shumë, duhet thënë që mbrojtja e pavarësisë dhe neutralitetit të institucionit në fjalë, si dhe funksionimi efektiv i tij varen kryesisht nga modeli i garancionit kushtetues të vendosur.⁹⁰⁶ Po ashtu,

⁹⁰⁵ Shih për më tepër: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) 'Compilation of the Ombudsman Institution' adopted up to and including the Venice Commission's 87th Plenary Session, 17-18 June 2011, Strasbourg, 1 December 2011, CDL(2011)079. Në internet: [http://www.venice.coe.int/docs/2011/CDL\(2011\)079-e.pdf](http://www.venice.coe.int/docs/2011/CDL(2011)079-e.pdf), fq. 4; Venice Commission (2004) 'Joint Opinion on the Law on the Ombudsman of Serbia by the Venice Commission, the Commissioner for Human Rights and the Directorate General of Human Rights of the Council of Europe', CDL-AD(2004)041, Strasbourg, 24 November 2004. Garantimi i statusit, funksionit dhe rolit të Avokatit të Popullit përmes normave kushtetuese kërkohet edhe nga rekomandimet e Këshillit të Evropës. Cf. Council of Europe, Parliamentary Assembly, (2003) 'The institution of Ombudsman', Recommendation 1615, 8 September 2003. Në internet: <http://assembly.coe.int/documents/adoptedtext/TA03/EREC1615.htm>.

⁹⁰⁶ Shih për më tepër: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on the possible reform of the Ombudsman Institution in Kazakhstan adopted by the Venice Commission at its 71st Plenary Session', Venice, 1-2 June 2007, CDL-AD(2007)020 - paragrafët 7, 9, 10 dhe 12.

rëndësia që norma kushtetuese i jep natyrës së pavarur të institucionit të Avokatit të Popullit është e veçantë, nëse merret parasysh edhe tërësia e kompetencave që ky i fundit bart sipas Kushtetutës. Pra, neni 132.1 definon që veprimtari themelore e institucionit të Avokatit të Popullit është mbikëqyrja dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të individëve nga veprimet dhe/ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike në Kosovë. Në kuptim të nenit 132.1, janë tri gjëra që duhet sqaruar. Së pari, duhet thënë që Kushtetuta i njeh institucionit të Avokatit të Popullit autoritetin e plotë për të mbikëqyrur veprimtarinë e organeve publike të Kosovës kundrejt respektimit ose jo të lirive dhe të drejtave të njeriut. Pra, norma në fjalë bart autoritetin kushtetues tek institucioni në fjalë që të shërbejë si vëzhgues i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe të vlerësojë nëse veprimi dhe/ose mosveprimi i institucioneve publike në Kosovë pakëson tërësinë e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë.

2. Së dyti, në vijim të asaj që u tha më sipër, neni në fjalë përcakton që kompetenca e institucionit të Avokatit të Popullit për të mbikëqyrur dhe mbrojtur liritë dhe të drejtat e individëve nuk kufizohet vetëm kundrejt institucioneve të zgjedhura politike, por përfshinë një listë të gjerë të institucioneve publike, veprimet dhe/ose mosveprimet e të cilave mund të jenë objekt i shqyrtimit të institucionit në fjalë. Me një fjalë, kompetenca e institucionit të Avokatit të Popullit për të mbikëqyrur respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut nuk kufizohet vetëm ndaj institucioneve të zgjedhura shtetërore, por përfshinë të gjitha ato institucione të cilat bartin dhe ushtrojnë veprimtari të karakterit publik, për funksionimin e të cilave roli i shtetit është i dukshëm.

Në një tjetër dimension, roli i Avokatit të Popullit, gjithnjë sipas kuptimit që norma në fjalë transmeton, kërkon nga ky i fundit që të mbikëqyr dhe mbroj liritë dhe të drejtat e njeriut nga veprimet e institucioneve gjegjëse, të cilat, në bazë të vlerësimeve paraprake të institucionit të Avokatit të Popullit, klasifikohen si të paligjshme dhe të parregullta. Pra, kompetenca që Kushtetuta bart tek institucioni i Avokatit të Popullit, nuk mund të shndërrohet në mjet arbitrar, mbi bazën e së cilit, institucioni në fjalë, në mënyrë të vazhdueshme të pengojë, pamundësojë ose delegitimojë ushtrimin e autoritetit të institucioneve tjera shtetërore. Për këtë arsye norma kushtetuese përcakton që funksioni kushtetues i institucionit të Avokatit të Popullit ushtrohet për aq kohë sa veprimi ose mosveprimi i institucionit gjegjës cilësohet, mbi bazën e kërkimeve paraprake, si i paligjshëm ose i parregullt. Thënë ndryshe dhe me pak fjalë, funksioni i Avokatit të Popullit, edhe sipas literaturës kushtetuese, është që të shërbej si ndërmjetës në mes të popullit dhe institucioneve, për të bërë të mundur që të drejtat dhe liritë e njeriut të respektohen nga këto të fundit.⁹⁰⁷

3. Së treti, një lexim sistematik i normave kushtetuese mbi institucionin e Avokatit të Popullit tregon që funksioni i mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut nuk kufizohet vetëm në kuadër të të drejtave dhe lirive të individëve, por

⁹⁰⁷ European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the possible reform of the Ombudsman Institution in Kazakhstan adopted by the Venice Commission at its 71st Plenary Session’, Venice, 1-2 June 2007, CDL-AD(2007)020.

përfshinë edhe mbrojtjen e parimeve të përgjithshme të të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me kushtetutë. Pra, norma kushtetuese, shikuar në prizmin e nenit 135.4 dhe 5, siç do të sqarojmë edhe në pjesët në vijim, nënkupton që autoriteti i institucionit të Avokatit të Popullit për mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të individëve, nuk tkurret vetëm në kufijtë e të drejtave individuale, por përfshinë edhe mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e parimeve të përgjithshme të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Neni 132.2

1. Neni 132.2 përcakton që institucioni i Avokatit të Popullit është i pavarur në ushtrimin e kompetencave të dhëna, dhe nuk pranon udhëzime dhe ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet tjera që e ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës. Në kuptimin e teorisë së të drejtës kushtetuese, kjo normë kushtetuese vendos themelet dhe përcakton gjerësinë e pavarësisë së institucionit të Avokatit të Popullit. Në bazë të këtij përcaktimi, kuptimi që norma kushtetuese i jep kufizimit të ushtrimit të funksioneve të organeve respektive dhe institucionit të Avokatit të Popullit është i dyanshëm. Së pari, norma kushtetuese, përcakton që institucioni i Avokatit të Popullit duhet të ushtrojë funksionin e dhënë kushtetues dhe ligjor pavarësisht nga drejtimet dhe udhëzimet e organeve tjera shtetërore. Më një fjalë, kjo nënkupton se pavarësia e institucionit në fjalë duhet të garantohet në rend të parë nga vet sjellja e institucionit, i cili duhet të refuzojë ushtrimin e funksionit të tij sipas, apo në bazë të, udhëzimeve të një pale të tretë. Në të njëjtën kohë, institucioni i Avokatit të Popullit, duhet të sigurohet që ndërhyrjet gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues të mos pengojnë vlerësimet e pavarura të institucionit në fjalë. Së dyti, duhet thënë që norma kushtetuese përcakton që pavarësia e institucionit të Avokatit të Popullit është e pacenueshme nga veprimet ose mosveprimet e organeve dhe institucioneve tjera shtetërore. Kjo normë kushtetuese, prandaj, përcakton që organet dhe institucionet që mbartin dhe ushtrojnë kompetenca shtetërore dhe publike, janë të obliguara që të kufizojnë ushtrimin e funksionit të tyre nëse një gjë e tillë cenon pavarësinë e institucionit të Avokatit të Popullit. Në përgjithësi, ky paragraf, përcakton që veprimet e organeve tjera të Republikës së Kosovës, nuk mund të udhëzojnë, kufizojnë, apo përndryshe, pengojnë ushtrimin e pavarur të funksionit kushtetues të Avokatit të Popullit. Pra, në këtë linjë të arsyetimit, autorë të ndryshëm tregojnë që sfidat që institucioni i Avokatit të Popullit të jetë i pavarur kryesisht lidhen me nevojën për të ruajtur pavarësinë dhe për të shmangur statusin e të qenit i kontrolluar nga institucionet apo organet tjera shtetërore, por, në anën tjetër, të sigurojë që masat dhe rekomandimet e këtij të fundit të respektohen.⁹⁰⁸

⁹⁰⁸ Shih për më tepër: Ugglja, Fredrik (2004) 'The Ombudsman in Latin America', *Journal of Latin American Studies*, Vol. 36 (3), p. 423-450;

Neni 132.3

1. Ky paragraf përcakton detyrimin që institucionet e Republikës së Kosovës kanë kundrejt kërkesave që vijnë nga institucioni i Avokatit të Popullit. Në fillim duhet sqaruar që kjo normë kushtetuese rrjedh nga përcaktimi fillestar që ushtrimi i funksionit të Avokatit të Popullit të jetë i pavarur. Këtu përcaktohet që qasja e institucionit të Avokatit të Popullit në dokumente zyrtare, dhe rrjedhimisht, ushtrimi i mandatit të dhënë kushtetues nëpërmjet qasjes në dokumentet zyrtare, nuk mund të jetë, pjesërisht apo në tërësi, subjekt i autorizimit të organeve shtetërore relevante. Kjo më tutje nënkupton se kjo dispozitë kërkon nga çdo institucion apo autoritet shtetëror në Kosovë t'u përgjigjet kërkesave të institucionit të Avokatit të Popullit, dhe t'i ofroj këtij të fundit të gjitha informacionet e kërkuara. Kjo normë, prandaj, pamundëson që ushtrimi i funksionit kushtetues të institucionit të Avokatit të Popullit të kufizohet nga veprimet e institucioneve tjera të cilat refuzojnë qasjen në dokumentet dhe të dhëna zyrtare. Institucionet e Republikës janë të detyruara që t'i ofrojnë qasje të plotë, institucionit në fjalë, në dokumentet, të dhënat, shkresat dhe informacionet tjera të nevojshme, sipas procedurave ligjore.
2. Paragrafi 3 i nenit 132, përcakton më tutje që organet shtetërore dhe publike nuk mund të refuzojnë kërkesën e institucionit të Avokatit të Popullit për qasje në dokumente zyrtare. U mor vesh, kjo njëherësh nënkupton se kjo normë kushtetuese përcakton që qasja e institucionit të Avokatit të Popullit në të dhënat zyrtare të institucioneve gjegjëse përcaktohet dhe kufizohet me ligj, duke njohur në këtë mënyrë organin ligjdhënës si të vetmin institucion me autoritetin e nevojshëm kushtetues që të rregullojë formën dhe mënyrën e qasjes në dokumentet përkatëse. Çdo kufizim tjetër i kësaj të drejte të Avokatit të Popullit është kundërkushtetuese.

Neni 133 [Zyra e Avokatit të Popullit]

- (1) Zyra e Avokatit të Popullit është e pavarur, dhe propozon e administron buxhetin e vet, në pajtim me ligj.**
- (2) Avokati i Popullit ka një (1) ose më shumë zëvendës. Numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i tyre, rregullohen me ligjin për Avokatin e Popullit. Të paktën një (1) nga zëvendësit e Avokatit të Popullit është pjesëtar i komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.**

Neni 133.1

1. Paragrafi në fjalë rikonfirmon që institucioni i Avokatit të Popullit është i pavarur. Për më tepër, gjithnjë sipas normës në fjalë, pavarësia e institucionit të Avokatit të Popullit shtrihet edhe në të drejtën e këtij të fundit që të propozojë buxhetin e institucionit, të planifikojë si dhe të administrojë me të. Pavarësia e institucionit të Avokatit të Popullit shprehet edhe në kontekstin e pavarësisë financiare, jo vetëm duke u kufizuar në aktin e themelimit të një linje të veçantë buxhetore për

institucionin, por përfshinë, në këtë kontekst, edhe pavarësinë e tij në planifikimin paraprak dhe administrimin e përgjithshëm të buxhetit të institucionit. Ky përcaktim i Kushtetutës udhëzon që pavarësia e institucionit të Avokatit të Popullit duhet të jetësohet edhe në kuptim të hartimit, planifikimit, dhe administrimit të tërësishëm të buxhetit të veçantë të tij. Procesi i planifikimit buxhetor dhe ndarja buxhetore, nuk mund të shfrytëzohet si mjet për të ndikuar në funksionimin e pavarur të institucionit të Avokatit të Popullit.⁹⁰⁹ Ky segment i pavarësisë së Avokatit të Popullit është më i ndjeshmi gjë që shihet nga praktika e ish vendeve komuniste në Evropë ku politika ka provuar që të ndikoj në pavarësinë e këtij institucioni përmes ndërhyrjeve në financat e tij⁹¹⁰.

Neni 133.2

1. Paragrafi 2, përcakton që Avokati i Popullit duhet të ketë të paktën një zëvendës. Këtu dhe menjëherë, Kushtetuta bën dallimin në mes të institucionit të Avokatit të Popullit dhe Avokatit të Popullit si bartës i funksionit të udhëheqësit të institucionit në fjalë. Pra, edhe përkundër faktit që institucioni i Avokatit të Popullit mendohet të reflektojë institucion individual, sidomos në kuptim të përbërjes së tij, Kushtetuta e Kosovës ndjek një linjë tërësisht bashkëkohore kundrejt funksionimit të institucionit të Avokatit të Popullit. Megjithatë, Kushtetuta në asnjë formë nuk vë në dyshim autoritetin vendimmarrës të Avokatit të Popullit. Krejt çka kërkohet me këtë dispozitë është që puna e Avokatit të Popullit të asistohet nga një ose më shumë zëvendës të tij/saj. Për më tepër, Kushtetuta përcakton që, të paktën njëri nga Zëvendësit e Avokatit të Popullit duhet të jetë pjesëtar i komuniteteve etnike jo-shumicë në Kosovë. Por, duhet sqaruar që kjo normë kushtetuese nuk përjashton mundësinë që një pjesëtar i komuniteteve jo-shumicë në Kosovë të mund të emërohet si Avokat i Popullit, por rregullon një rrethanë tjetër ku përfaqësimi i pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë të bëhet i nevojshëm.⁹¹¹ Po

⁹⁰⁹ European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on Amendments to the Law on the Human Rights Defender of Armenia adopted by the Venice Commission at its 69th Plenary Session’, Venice, 15-16 December 2006, CDL-AD(2006)038.

⁹¹⁰ Edhe në praktikën kosovare ka pasur një ankesë nga Avokati i Popullit në këtë drejtim. Në rastin KO 148/11, Avokati i Popullit pat kërkuar nga Gjykata Kushtetuese që të shfuqizojë disa nga dispozitat e Ligjit mbi Avokatin e Popullit, Ligji Nr. 03/L-195 i datës 22 korrik 2010, sepse cenonte pavarësinë e këtij institucioni pasi që Kuvendi i Kosovës kishte zvogëluar pagat e Avokatit dhe Zëvendësve të tij. Cf. *AKTVENDIM PER PAPANUESHMERI në Rastin nr. KO 148/11. Parashtruesi: Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës. Vlerësimi i kushtetutshmërisë të nenit 11 par. 1, nenit 32 par. 1 dhe 2, nenit 34 par. 2, dhe te nenit 38 ne lidhje me nenin 11, 32 e 34 te Ligjit për Avokatin e Popullit, Ligji Nr. 03/L-195 i 27 gushtit 2010, dhe i kërkesës për masë të përkohshme. Prishtinë: 26 tetor 2012 (Nr. ref. K33S/12).*

⁹¹¹ Ky përcaktim është dhënë edhe nga Komisioni i Venecias në rastin e vlerësimit të Ligjit të Ombduspersonit të Bosnjë dhe Hercegovinës, dhe ku shprehimisht përcaktohet që kërkesa për të zgjedhur zëvendës të Avokatit të Popullit nga radhët e komuniteteve nuk përjashton këta të fundit të mos zgjidhen në atë pozitë. Shih për më tepër: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the Draft Law on Amendments to the Law on Ombudsman for Human Rights in Bosnia and Herzegovina adopted by the Venice Commission at its 60th Plenary Session’, Venice, 8-9 October 2004, CDL-AD(2004)031.

ashtu, paragrafi në fjalë përcakton që numri, mënyra e përzgjedhjes dhe mandati i zëvendësve të Avokatit të Popullit duhet të rregullohen me ligj. Në këtë kuptim, duhet thënë që Kushtetuta bartë autoritetin e nevojshëm kushtetues tek organi ligjdhënës që të përcaktojë, mbi bazën e ruajtjes së pavarësisë së institucionit të Avokatit të Popullit, numrin, mënyrën e emërimit dhe mandatin e zëvendësve të Avokatit të Popullit. Andaj, organi ligjdhënës duhet të ketë parasysh, që gjatë përcaktimit të mënyrës së emërimit, mandatit, dhe numërimit të kompetencave, të vendos baraspeshën e nevojshme në mes të autoritetit personal të Avokatit të Popullit në kuadër të institucionit, si dhe rolit, emërimit dhe mandatit të zëvendësve të tij.

Neni 134 [Kualifikimi, Zgjedhja dhe Shkarkimi i Avokatit të Popullit]

- (1) Avokatin e Popullit e zgjedh Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të tij, për një mandat pesë (5) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.**
- (2) Avokat i Popullit ka të drejtë të zgjidhet çdo shtetas i Republikës së Kosovës, me arsim të lartë, me karakter e moral të lartë, i ndershëm, me eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut.**
- (3) Avokati i Popullit dhe zëvendësit e saj/tij nuk mund të jenë anëtarë të asnjë partie politike, as të ushtrojnë veprimtari politike, shtetërore a private profesionale dhe as të marrin pjesë në organizmat drejtues të organizatave civile, ekonomike dhe tregtare.**
- (4) Avokati i Popullit gëzon imunitetin nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet ose vendimet që janë brenda fushës së përgjegjësive të Avokatit të Popullit.**
- (5) Avokati i Popullit mund të shkarkohet vetëm me kërkesën e më shumë se një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve, dhe në këtë rast Kuvendi vendos me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij.**

Neni 134.1

1. Neni 134 përcakton kriteret themelore të përzgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit. Paragrafi i parë, përcakton që zgjedhja e Avokatit të Popullit bëhet nga Kuvendi i Kosovës, me shumicë të votave të të gjithë deputetëve, për një mandat pesë vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje. Sipas Komisionit të Venecias mënyra e zgjedhjes së Avokatit të Popullit është shumë e rëndësishme në kuptim të ruajtjes së pavarësisë së këtij të fundit.⁹¹² Andaj, mënyra e zgjedhjes dhe vet mandati i Avokatit të Popullit duhet konsideruar në prizmin e ruajtjes dhe jetësimit të pavarësisë së institucionit. Fillimisht, duhet sqaruar që emërimi i Avokatit të Popullit bëhet nga Kuvendi i Kosovës, me një shumicë të votave të të gjithë

⁹¹² Shih: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) ‘Opinion on the Draft Law on the Public Attorney of “The former Yugoslav Republic of Macedonia” adopted by the Venice Commission at its 54th Plenary Session’, Venice, 14- March 2003, CDL-AD(2003)007.

deputetëve të tij. Pra, sipas përcaktimit kushtetues, emërimi i kandidatit për Avokat të Popullit konsiderohet kushtetues, për aq kohë sa, shumica e deputetëve të Kuvendit votojnë pro kandidaturës së tij/saj. Andaj, një shumicë absolute e votave pro është kushti i domosdoshëm që emërimi i kandidatit/es për pozicionin e Avokatit të Popullit të jetësohet. Po ashtu, paragrafi në fjalë, përcakton që Avokati i Popullit zgjidhet vetëm për një mandat pesë vjeçar pa të drejtë rizgjedhjeje. Kufizimi i së drejtës për t'u rizgjedhur në pozitën e lartpërmendur, është një praktikë në shumë vende evropiane, e cila, mëton të mbrojë pavarësinë profesionale të Avokatit të Popullit dhe ushtrimin e lirë të funksionit të garantuesit të zbatimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.⁹¹³

Neni 134.2 & 134.3

1. Paragrafi në fjalë përcakton kushtet e përgjithshme dhe të domosdoshme që kandidatët për pozitën e Avokatit të Popullit duhet ta plotësojnë. Pra, sipas nenit 134.2, të drejtë zgjedhje në pozitën e Avokatit të Popullit kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, që kanë kualifikim të lartë universitar, që posedojnë dhe reflektojnë karakter të lartë moral, ndershmëri, si dhe eksperiencë dhe njohuri të dalluara në fushën e të drejtave të njeriut. Sipas normës kushtetuese, lista e cilësive morale dhe profesionale të numëruara me Kushtetutë, përbëjnë grupin e kushteve të domosdoshme dhe të përgjithshme që kandidatet duhet të plotësojnë. Për më tepër, lista e cilësive të kandidatëve ka karakter komplementar dhe kandidatët duhet doemos të kenë të veçuar brenda personalitetit të tij/saj të gjitha cilësitë e lartpërmendura. Gjithsesi, kjo listë mban të hapur konkurrencën në mes të kandidatëve, por ngushton rrethin e kandidatëve të përshtatshëm për pozitën në fjalë mbi bazë të cilësive morale dhe kualifikimeve të tyre profesionale. Në këtë rast, duhet sqaruar këtu, cilësitë dhe vlerat morale që kandidatët duhet të kenë janë reflektim i mbështetjes popullore që ky i fundit duhet ta gëzojë.⁹¹⁴ Me fjalë tjera, mandati i Avokatit të Popullit kufizohet vetëm në propozimin e masave që, në bazë të vullnetit të institucioneve tjera, mund të ndërpresin shkeljen e të drejtave të njeriut, dhe pikërisht kjo bën që mjeti më efikas në arritjen e ushtrimit të mandatit të tij të jetë mbështetja që Avokati i Popullit gëzon në shoqëri.
2. Paragrafi i tretë i nenit 134 rendit një listë të pozicioneve profesionale dhe politike bartja e së cilave do të bëjë të papranueshme ushtrimin funksionit të Avokatit të Popullit. Paragrafi në fjalë përcakton që Avokati i Popullit si dhe zëvendësit e tij/saj gjatë bartjes së mandatit të dhënë kushtetues nuk mund të jenë anëtarë të

⁹¹³ Shih për më tepër komentet e dhëna në dokumentet në vijim: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) 'Consolidated Opinion On the Law on Ombudsman in the Republic of Azerbaijan', Strasbourg, 7 September 2001, CDL(2001) 083; dhe European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) 'Opinion on Amendments to the Law on the Human Rights Defender of Armenia adopted by the Venice Commission at its 69th Plenary Session', Venice, 15-16 December 2006, CDL-AD(2006)038.

⁹¹⁴ Shih: Ugglja, Fredrik (2004) 'The Ombudsman in Latin America', *Journal of Latin American Studies*, Vol. 36 (3), p. 423-450.

ndonjë partie politike apo të ushtrojnë veprimtari të karakterit politik, shtetëror ose privat, si dhe të marrin pjesë në organizma drejtues të organizatave të karakterit civil, ekonomik dhe tregtare. Në këtë kuptim, janë dy çështje që duhet sqaruar. Së pari, sipas paragrafit në fjalë, efekti i rregullave të papajtueshmërisë jetësohet që nga momenti i pranimit zyrtar të funksionit të Avokatit të Popullit dhe/apo zëvendësit/ve të tij, dhe mbaron/ndërpritet pas përfundimit kushtetues ose ligjor të mandatit të këtyre të fundit. Së dyti, norma kushtetuese në fjalë përcakton rregullat e papajtueshmërisë së funksionit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij me funksionet tjera personale dhe politike. Thënë shkurt, rregullat e papajtueshmërisë përcaktojnë karakterin e punëve dhe të veprimtarive personale të cilat janë të ndaluara të ushtrohen gjatë gjithë periudhës kohore që mandati i Avokatit të Popullit dhe/apo zëvendësve të tij/saj rrjedh.

Neni 134.4 & 134.5

1. Paragrafi i katërt dhe i pestë i nenit 134 përcaktojnë gjerësinë e imunitetit të Avokatit të Popullit dhe mënyrën e shkarkimit të tij/saj. Paragrafi i katërt qartëson që Avokati i Popullit gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe nga shkarkimi për veprimet ose vendimet e marra brenda fushës së përgjegjësisë të Avokatit të Popullit. Në këtë rast duhet sqaruar që imuniteti që Avokati i Popullit gëzon, është i llojit funksional, i cili, për më tepër, mbron këtë të fundit nga veprimet që rrjedhin në kuadër të ushtrimit të mandatit të dhënë kushtetues dhe ligjor. Kjo nënkupton se Avokati i Popullit nuk gëzon imunitet i cili do ta mbronte për veprimet e tij/saj të kryera jashtë funksionit të tij/saj. Është interesante të sqarohet që norma kushtetuese përcakton që veprimet e Avokatit të Popullit brenda fushës së përgjegjësisë të tij/saj nuk mund të shërbejnë si element apo argument për të filluar procedurat e shkarkimit të tij/saj. Pra, imuniteti që Avokati i Popullit gëzon në këtë rast e mbron atë nga shkarkimi për shkak të veprimeve të ndërmarra në kuadër të mandatit dhe përgjegjësisë të dhëna. Për më tepër, ky model i imunitetit nuk pengon ushtrimin e funksionit të organeve tjera shtetërore në mënyrë që të kontrollohen veprimet jashtë funksionit të dhënë kushtetues.⁹¹⁵
2. Në një tjetër dimension, duhet sqaruar që imuniteti në fjalë mbron Avokatin e Popullit edhe pas kalimit të mandatit të tij/saj për të gjitha ato veprime dhe vendime që janë marrë gjatë ushtrimit të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor. Andaj, duhet të jetë e qartë që veprimet ose vendimet e marra gjatë ushtrimit të funksionit të tij/saj nuk mund të jenë objekt i ndjekjes penale dhe padisë civile edhe pas përfundimit të mandatit të tij/saj.

⁹¹⁵ Këtë lloj imuniteti, si në formë ashtu dhe në përmbajtje, e ka përkrahur edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj për imunitetin e funksionarëve të lartë publik kosovar, të cilin e përfolem më herët kur komentuam nenin 89 të Kushtetutës. Cf. *Aktgjykim në rastin Nr. K098/11. Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës* (Datë: 20 shtator 2011 (Nr. ref.: AGJ138/11).

3. Në anën tjetër, paragrafi i pestë përcakton që procedura e shkarkimit të Avokatit të Popullit mund të iniciohet nga një e treta (1/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Kurse, shkarkimi i tij/saj bëhet me votat e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës të cilët votojnë pro kërkesës për shkarkim. Kushtetuta vendos një kusht paraprak për shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe kërkon që procedura e shkarkimit të iniciohet dhe të mbështetet nga një e treta (1/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit. Për sa i përket shkarkimit të tij/saj, paragrafi në fjalë përcakton që ky akt mund të jetësohet vetëm nëse një shumicë e kualifikuar e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve voton pro mocionit për shkarkim.

Neni 135 [Raportimi i Avokatit të Popullit]

- (1) **Avokati i Popullit paraqet raport vjetor para Kuvendit të Republikës së Kosovës.**
- (2) **Me kërkesën e Kuvendit, Avokati i Popullit duhet të dorëzojë raporte periodike ose tjera Kuvendit. Me kërkesën e Avokatit të Popullit, Kuvendi duhet t'ia lejojë që të dëgjohet.**
- (3) **Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.**
- (4) **Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.**

Neni 135.1 & 135.2

1. Neni 135 sqaron se Avokati i Popullit duhet të raportoj para Kuvendit të Republikës së Kosovës së paku një herë në vit. Paragrafi i parë, përcakton që institucioni i Avokatit të Popullit është i detyruar që të paraqes një raport vjetor, brenda fushëveprimit të dhënë, Kuvendit të Kosovës, i cili mund të kërkoj nga institucioni në fjalë edhe raporte periodike apo raporte tjera të karakterit të veçantë. Pra, raportimi i institucionit të Avokatit të Popullit ka karakter informues, dhe nuk ka si qëllim që të shndërrohet në mjet ku Kuvendi merr në përgjegjësi institucionin e Avokatit të Popullit. Në anën tjetër, paragrafi i dytë, po ashtu përcakton që Avokati i Popullit mund të kërkojë nga Kuvendi i Kosovës që ta caktoj një mbledhje të veçantë plenare në mënyrë që ai/ajo të raportojë brenda fushës së përgjegjësisë së tij/saj, apo të informojë Kuvendin për një çështje të veçantë, jashtë kornizës së raportimit vjetor.

Neni 135.3 & 135.4

1. Në kuadër të ushtrimit të funksionit të dhënë kushtetues dhe ligjor, paragrafi 3 vesh institucionin e Avokatit të Popullit me të drejtën që të bëjë rekomandime dhe propozoj masa nëse konstaton që ekzistojnë shkelje të të drejtave të njeriut nga ana e institucioneve dhe organeve tjera shtetërore dhe publike. Pra, paragrafi në fjalë, autorizon institucionin e Avokatit të Popullit që të drejtojë rekomandime dhe të

propozojë marrjen e masave ndaj çdo organi shtetëror apo institucioni publik, nëse sipas vlerësimeve paraprake rezulton se ekzistojnë shkelje të të drejtave të njeriut. Në këtë kuptim, institucioni i Avokatit të Popullit, është i lirë që të përcaktojë formën dhe përmbajtjen e rekomandimeve dhe masave që ia drejton organit apo institucionit gjegjës.

Neni 135.4

1. Paragrafi në fjalë i vesh të drejtën Avokatit të Popullit që të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese. Në kuptimin teorik, duhet thënë që funksioni kushtetues i Avokatit të Popullit që të shërbejë si mbikëqyrës dhe mbrojtës i respektimit të lirive dhe të drejtave të individëve, materializohet, veçanërisht nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së tij për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese. Në veçanti duhet sqaruar që natyra e referencës që institucioni i Avokatit të Popullit mund të parashtrijë, i referohet vetëm atyre çështjeve që kanë të bëjnë me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese që Kushtetuta parasheh në nenin 113.2 (tanimë të komentuar nga ne). Kjo nënkupton se përmbajtja e autorizimit të Avokatit të Popullit kufizohet brenda kufijve të juridiksionit të Gjykatës Kushtetues dhe llojit të autorizimit që Avokati i Popullit bart sipas nenit të sipër-cekur të Kushtetutës. Por, për fund duhet sqaruar që pikërisht mandati i Avokatit të Popullit për të referuar çështje në Gjykatën Kushtetuese bën që kuptimi i funksionit kushtetues të këtij të fundit të mos lidhet vetëm me mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e respektimit të lirive dhe të drejtave të individëve, por që të shërbej edhe si garantues i respektimit të parimeve të përgjithshme të të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me kushtetutë.⁹¹⁶

Neni 136 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]

- (1) **Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar.**
- (2) **Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës, përcaktohen me Kushtetutën dhe me ligj.**
- (3) **Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës zgjidhet nga Kuvendi, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, në bazë të propozimit të Presidentit të Republikës së Kosovës.**
- (4) **Kuvendi vendos për shkarkimin e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës me shumicën e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të tij, në bazë të propozimit të Presidentit ose me nismën e një të tretës (1/3) së deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.**

⁹¹⁶ European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission) 'Joint Opinion on the Law on the Protector of Human Rights and Freedoms of Montenegro' prepared by the Venice Commission and the OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights (OSCE/ODIHR) and adopted by the Venice Commission at its 88th Plenary Session (Venice, 14-15 October 2011).

(5) Mandati i Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës është pesë (5) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm edhe për një mandat.

Neni 136.1 & 136.2

1. Nenet 136, 137 dhe 138 rregullojnë parimet mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit të Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës. Sipas nenit 136.1, institucioni i Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar. Sipas kësaj të fundit, institucioni në fjalë është i autorizuar që të ushtrojë, mbi bazën e mjeteve të përcaktuara ligjore dhe kushtetuese, kontrollin e shpenzimit të buxhetit publik dhe kontrollin e shpenzimeve financiare ndaj të gjitha organeve shtetërore dhe institucioneve publike në Kosovë. Për më tepër, raportet, gjetjet dhe kualifikimet që nxjerr institucioni i Auditorit të Përgjithshëm nuk mund të revidohen apo ndryshohen nga ndonjë institucion tjetër shtetëror. Paragrafi i dytë përcakton që organizimi i brendshëm, kompetencat dhe administrimi i zyrës së Auditorit të Përgjithshëm përcaktohen me Kushtetutë dhe me ligj.

Neni 136.3, 136.4 & 136.5

1. Neni 136.3 përcakton që Auditori i Përgjithshëm zgjidhet nga Kuvendi i Republikës, me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, në bazë të propozimit të Presidentit të Republikës së Kosovës. Së pari, në kuptimin teorik, duhet thënë që Kushtetuta e Kosovës tregon që institucioni i Auditorit të Përgjithshëm udhëhiqet nga Auditori i Përgjithshëm. Zgjedhja e Auditorit të Përgjithshëm, sipas përcaktimit kushtetues, përfshinë edhe institucionin e Presidentit të Republikës, i cili duhet t'i propozojë Kuvendit një kandidaturë për miratim. Ky i fundit, pas marrjes së propozimit të Presidentit voton, me shumicë absolute të votave të të gjithë deputetëve të tij për emërimin e kandidatit në postin e Auditorit të Përgjithshëm, për një mandat 5 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Në këtë pikë, duhet dalluar rolin e Presidentit dhe Kuvendit të Republikës në këtë proces. Sipas përcaktimit kushtetues, Presidenti i Republikës është i detyruar që t'i ofrojë një kandidat për miratim Kuvendit të Kosovës Mirëpo, mbetet brenda kufijve të autorizimit kushtetues të Kuvendit nëse emëron apo refuzon emërimin e propozimit të Presidentit. Sikundër shihet, kjo normë vendos një balancë në mes të Presidentit dhe Kuvendit, apo shprehur ndryshe, në mes të kërkesave të mazhorancës politike dhe Presidentit të Republikës duke kërkuar në të njëjtën kohë nga këta të fundit që të arrijnë pajtim për kandidatin/en e preferuar.
2. Edhe në kuptim të procedurës së shkarkimit, paragrafi 4 përcakton që vendimi për shkarkim të Auditorit të Përgjithshëm merret nga Kuvendi i Republikës me shumicë të kualifikuar prej dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Edhe në këtë rast duhet thënë që iniciimi i procedurës së shkarkimit mund të bëhet nga veprimi i njëres nga dy palët e autorizuara. Pra, paragrafi në fjalë, përcakton që Kuvendi voton për shkarkimin ose jo të Auditorit të Përgjithshëm në bazë të propozimit të Presidentit të Republikës ose në bazë të propozimit të një të tretave

(1/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Andaj, është i mjaftueshëm propozimi i njëres nga palët e përfshira që Kuvendi i Kosovës të vendos mbi shkarkimin ose jo të Auditorit të Përgjithshëm.

Neni 137 [Kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës]

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës kontrollon:

- (1) veprimtarinë ekonomike të institucioneve publike dhe të personave të tjerë juridikë shtetërorë;**
- (2) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe lokal;**
- (3) veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve publike dhe personave juridikë të tjerë, tek të cilët Shteti ka një pjesë të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantojnë nga Shteti.**

Neni 137

1. Neni 137 përcakton fushëveprimin dhe rregullon gjerësinë e shtrirjes së kompetencave të institucionit të Auditorit të Përgjithshëm. Sipas neni 137, Auditori i Përgjithshëm ka tagrin që të ushtrojë kontroll financiar ndaj të gjitha veprimtarive ekonomike të të gjitha institucioneve publike dhe organeve tjera shtetërore. Pra, kontrolli i institucionit të Auditorit të Përgjithshëm shtrihet ndaj të gjitha institucioneve që ushtrojnë pushtet publik apo shtetëror. Së dyti, neni në fjalë, autorizon Auditorin e Përgjithshëm që të kontrollojë mënyrat e përdorimit të fondeve publike nga ana e pushtetit qendror dhe lokal, si dhe të mbrojtë fondet në fjalë nga menaxhimi jo i duhur i tyre nga institucionet e lartpërmendura. Së treti, sipas neni 137, juridiksioni i Auditorit të Përgjithshëm shtrihet edhe në ushtrimin e kontrollit të veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjeve publike, dhe personave juridike ku shteti ka një pjesë të aksioneve, pa përjashtuar personat juridik, huatë, kreditë dhe detyrimet rrjedhëse të të cilëve janë të garantuara nga shteti. Për fund, duhet sqaruar që kompetenca e Auditorit të Përgjithshëm për të ushtruar funksionin e kontrollit financiar dhe veprimtarive ekonomike, përfshinë një numër të madh të institucioneve dhe personave juridike të cilat menaxhojnë pjesë të fondeve publike.

Neni 138 [Raportimi i Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës]

- (1) Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës, Kuvendit i paraqet:**
 - 1. raport për zbatimin e Buxhetit të Shtetit;**
 - 2. mendimin për raportin e Qeverisë për shpenzimet e vitit financiar të shkuar, para se të miratohet nga Kuvendi;**
 - 3. informacione për rezultatet e kontroleve, sa herë që kërkohet nga Kuvendi.**
- (2) Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës i paraqet Kuvendit raportin vjetor për veprimtarinë e vet.**

Neni 138.1 & 138.2

1. Neni 138 përcakton raportet që institucioni i Auditorit të Përgjithshëm duhet t'i paraqes Kuvendit të Kosovës. Në përgjithësi, institucioni i Auditorit të Përgjithshëm duhet t'i paraqes Kuvendit raportin vjetor për veprimtarinë e këtij të fundit. Kjo nënkupton se Auditori sipas përcaktimit kushtetues është i detyruar që të informojë Kuvendin e Kosovës për ushtrimin e funksionit të tij gjatë vitit paraprak. Paragrafi në fjalë ndër të tjera kërkon nga Auditori i Përgjithshëm që t'i raportoj rregullisht Kuvendit të Kosovës edhe në tri fusha të rëndësishme. Së pari, Auditori i Përgjithshëm duhet t'i ofrojë Kuvendit të Kosovës raport të detajuar mbi zbatimin e Buxhetit të Kosovës. Pra, Auditori i Përgjithshëm mban detyrimin që të përcjellë dhe njoftojë Kuvendin e Kosovës për mënyrën e zbatimit të buxhetit të Kosovës nga ana e organizatave buxhetore. Së dyti, Kushtetuta kërkon që Auditori i Përgjithshëm duhet t'i paraqes Kuvendit të Kosovës mendim profesional për raportin e Qeverisë për shpenzimet e vitit financiar, para se ky i fundit të miratohet në Kuvend, dhe, së treti, paragrafi i parë i nenit 137, obligon Auditorin e Përgjithshëm që të informojë Kuvendin mbi rezultatet e kontrolleve të zhvilluara nëse një gjë e tillë kërkohet nga Kuvendi.
2. Në një dimension tjetër, është veçanërisht e rëndësishme të thuhet që roli i Kuvendit të Kosovës që të mbikëqyr institucionin e Qeverisë dhe institucionet tjera publike, ndër të tjera, jetësohet duke shfrytëzuar funksionin e dhënë kushtetues të institucionit të Auditorit të Përgjithshëm. Raportimi i Auditorit të Përgjithshëm në Kuvendin e Kosovës nuk nënkupton që Auditori i Përgjithshëm mban përgjegjësi vetëm ndaj Kuvendit të Republikës për ushtrimin e mandatit të tij/saj. Ky komunikim në mes të këtyre institucioneve shërben si mjet me anë të së cilit ushtrimi i plotë i kompetencave të ndërlidhura të institucioneve respektive vihet në jetë. Veçanërisht duhet sqaruar që modeli i përgjegjësisë që Kushtetuta e Kosovës ndërton në lidhje me punën e Auditorit të Përgjithshëm është i ndarë dhe i ndryshëm kundrejt institucionit të Presidentit dhe Kuvendit.

Neni 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve]

- (1) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm që përgatit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumet dhe shpall rezultatet e tyre.
- (2) Komisioni përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë.
- (3) Kryesuesin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, e emëron Presidenti i Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave me juridiksion apeli.
- (4) Gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë. Një (1) anëtarë emërohet nga deputetët

e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës dhe tre (3) anëtarë nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.

Neni 139.1

1. Neni 139 përcakton kompetencat dhe autoritetin kushtetues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Paragrafi i parë i këtij neni proklamon që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm, që përgatit, mbikëqyrë, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe referendumet, si dhe shpall rezultatet e tyre. Pra, roli që Kushtetuta i atribuon Komisionit Qendror Zgjedhor është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Së pari duhet sqaruar që sipas paragrafit në fjalë, Komisioni Qendror Zgjedhor i atribuohet natyra e organit të përhershëm shtetëror. Në kontekstin teorik, duhet thënë që ky atribut përdoret me qëllim që funksionimi i modelit të demokracisë të mos vihet në pyetje nga shuarja e organit që menaxhon, ndër të tjera, konstituimin e vullnetit politik të popullit të ushtruar nëpërmjet zgjedhjeve apo referendumit. Për më tepër, në ndërlidhje edhe me funksionin e dhënë kushtetues, referenca në organin e përhershëm, parandalon që menaxhimi, kontrolli, dhe rrjedhimisht shpallja e rezultateve të zgjedhjeve apo referendumeve, në veçanti procesi i konstituimit të organeve përfaqësuese në nivelin qendror dhe lokal, të ushtrohet nga një institucion i ndryshëm nga Komisioni Qendror Zgjedhor. Së dyti, Komisioni Qendror Zgjedhor, sipas nenit në fjalë, mban tagrin që të përgatit dhe drejtojë procesin e zgjedhjeve dhe referendumeve në të gjithë territorin e Kosovës.

Po ashtu, norma në fjalë autorizon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të mbikëqyr dhe verifikoj të gjitha procedurat gjatë dhe pas përfundimit të procesit zgjedhor, por në mënyrë të veçanet të kujdeset që të shpall rezultatin e pritur. Në këtë fazë të këtij diskutimi, duhet thënë që, Kushtetuta e Kosovës, i njeh autoritetin e vetëm dhe të pavarur Komisionit Qendror Zgjedhor për të kontrolluar dhe certifikuar mandatin e institucioneve përfaqësuese, si dhe për të certifikuar rezultatet që dalin nga referendumet apo konsultat qytetare.

Kontrolli kushtetues i akteve dhe veprimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk mund të jetë i drejtpërdrejtë meqenëse Kushtetuta nuk i njeh Gjykatës Kushtetuese juridiksion origjinal në çështjet e zgjedhjeve. Ai juridiksion është vetëm individual dhe vihet në lëvizje përmes ankesës kushtetuese, si me çdo akt tjetër të autoritetit publik përkatës në Republikën e Kosovës sipas nenit 113. 7 të Kushtetutës. Megjithatë, këtu ka dy përjashtime kur mund të ndodhë vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve dhe veprimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Rasti i parë buron nga juridiksioni origjinal të cilin Kushtetuta ia njeh Gjykatës Kushtetuese në materien e zgjedhjeve qendrore: sipas nenit 113. 3. 5 të Kushtetutës Gjykata ka tagër të vlerësojë nëse është shkelur Kushtetuta gjatë zgjedhjes së Kuvendit. Rasti i dytë është i terrenit të kërkesave individuale sipas nenit 113.7 të Kushtetutës. Komisioni nuk mund të certifikojë rezultatin e zgjedhjeve nëse ka procedura ankimore pranë Gjykatës Kushtetuese. Nëse e bën një gjë të tillë, atëherë pala e afektuar me vendimin për certifikim mund t'i drejtohet Gjykatës për

vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimit për certifikim të zgjedhjeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 139.2, 139.3 & 139.4

1. Paragrafi i dytë i nenit 139, përcakton që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përbehet nga 11 anëtarë, të zgjedhur sipas procedurës në vijim. Së pari duhet thënë që kryesuesi i Komisionit Qendror Zgjedhor emërohet nga Presidenti i Republikës, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme dhe të Gjykatave të Apelit. Pra, kushtetuta përcakton që emërimi i Kryesuesit të Komisionit Qendror Zgjedhor është kompetence ekskluzive e Presidentit të Republikës. Por, mandati i Presidentit të Kosovës për të emëruar kryesuesin kufizohet në kuptim të rrethit të individëve që mund të jenë të emëruarit e Presidentit. Me fjalë tjera, Presidenti, në bazë të mandatit të dhënë kushtetues, emëron kryesuesin e KQZ-së nga radhët e Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme ose Gjykatave me juridiksion apeli. Anëtarët e mbetur, emërohen nga grupet parlamentare të përfaqësuara në Kuvend.
2. Kushtetuta, përcakton që 6 nga anëtarët e KQZ-së emërohen nga gjashtë grupet më të mëdha parlamentare në Kuvend, dhe nëse numri i grupeve parlamentare është më i vogël se numri i vendeve të lira në KQZ, atëherë grupet me numrin më të madh të përfaqësuesve në Kuvend duhet të emërojnë anëtarët shtesë. Anëtarët e mbetur, gjegjësisht një (1) prej tyre emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara për komunitetin Serb, kurse tre (3) tjerët emërohen nga deputetët që mbajnë vende të rezervuara për komunitetet tjera që nuk janë shumicë. Nga kjo del se përbërja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve jo vetëm që reflekton përbërjen politike të Kuvendit, por pasqyron edhe modelin e qeverisjes, i cili garanton përfaqësimin e duhur të komuniteteve jo-shumicë në organet shtetërore.

Neni 140 [Banka Qendrore e Kosovës]

- (1) Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, është institucion i pavarur i cili i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës.**
- (2) Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ushtron kompetencat dhe pushtetin e vet vetëm në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me instrumentet e tjera ligjore të zbatueshme.**
- (3) Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ushtron edhe detyrën e Kryeshefit Ekzekutiv të saj.**
- (4) Qeverisja e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe procedurat e zgjedhjes dhe të nominimit të anëtarëve të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës rregullohen me ligjin, cili duhet të sigurojë pavarësinë dhe autonominë e saj.**

Neni 140.1, 140.2, 140.3 & 140.4

1. Neni 140.1 përcakton që Banka Qendrore e Kosovës është institucion i pavarur, e cila i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Për ndryshim nga përcaktimet mbi pavarësinë institucionale të institucioneve tjera të pavarura, në rastin e Bankës Qendrore të Kosovës Kushtetuta i njeh autoritet Kuvendit të Kosovës që të marrë në përgjegjësi për veprimet dhe mosveprimet e tyre personat që udhëheqin me Bankën, trupat dhe dikasteret e saj. Institucioni i Bankës i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës për ushtrimin e funksionit të dhënë kushtetues. Sqarimet apo shkëmbimi i informacionit, me qëllim të realizimit të misionit të përbashkët të Bankës dhe institucioneve tjera relevante nuk nënkupton edhe përgjegjësinë e Bankës ndaj atyre të fundit.
2. Sipas paragrafit dy të këtij neni, Banka Qendrore e Kosovës obligohet që të ushtrojë kompetencat dhe pushtetin e dhënë kushtetues në pajtim me udhëzimet që lindin nga kjo e fundit. Përkundër faktit që Kushtetuta njeh që Banka i përgjigjet për punën e saj Kuvendit të Kosovës, ushtrimi i mandatit të dhënë kushtetues nuk udhëzohet apo drejtohet nga Kuvendi, por është i pavarur nga ndikimi apo udhëzimi i institucionit të Kuvendit apo institucioneve tjera.
3. Më tutje, ky nen përcakton që Banka duhet të themelojë Bordin e saj, procedurat e përzgjedhjes së anëtareve të të cilit, sipas Kushtetutës përcaktohen me ligj nga ana e Kuvendit të Kosovës. Po ashtu, neni 140, sqaron që në kuptim të organizimit të saj të brendshëm, Banka do të ketë Guvernatorin e saj i cili duhet njëherësh të ushtrojë detyrën e zyrtarit më të lartë administrativ të saj, gjegjësisht, Kryeshefi Ekzekutiv. Për më tepër, ky nen, përcakton që ligji mbi Bankën Qendrore të Kosovës duhet, përveç tjerash, të garantojë që ushtrimi i funksioni të Bankës dhe trupave të saj të jetë i pavarur nga organet dhe institucionet tjera shtetërore.

Neni 141 [Komisioni i Pavarur i Medieve]

- (1) **Komisioni i Pavarur i Medieve është organ i pavarur që rregullon spektrin e Frekuencave Transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj.**
- (2) **Anëtarët e Komisionit të Pavarur të Medieve zgjedhen sipas ligjit, përmes një procesi transparent.**

Neni 141.1 & 141.2

1. Kushtetuta e Kosovës me nenin 141 të saj themelon Komisionin e Pavarur të Medieve, i cili është organ i pavarur rregullator. Pra, neni 141 përcakton që Komisioni i Pavarur i Medieve është organ rregullator në fushën e frekuencave transmetuese dhe i cili ka autorizimin kushtetues që të licencojë transmetuesit publik dhe privat, të definojë dhe zbatojë politikën e transmetimit, dhe të ushtrojë

kompetencat tjera shtesë të përcaktuara me ligj. Nga ana tjetër, Kushtetuta autorizon organin ligjdhënës që të përcaktoj numrin dhe procedurat e emërimit të anëtarëve të Komisionit përmes një procesi që duhet të jetë proces transparent. Transparenca me rastin e përzgjedhjes është fjalë kyçe këtu dhe çdo veprim që nuk përmbush këtë kusht kushtetues mund të sfidohet pranë Gjykatës Kushtetuese sipas kërkesave mbi lejueshmërinë e ankesave private të përcaktuara në nenin 113.7 të Kushtetutës.

Neni 142 [Agjencitë e Pavarura]

- (1) Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të krijuara nga Kuvendi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Agjencitë e pavarura funksionet e tyre i kryejnë në mënyrë të pavarur nga çdo organ ose autoritet tjetër në Republikën e Kosovës.**
- (2) Agjencitë e pavarura kanë buxhetin e tyre, i cili administrohet në mënyrë të pavarur, në pajtim me ligj.**
- (3) Secili organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'u përgjigjet kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore, në pajtim me ligj.**

Neni 142

1. Neni 142 përcakton formën dhe mënyrat e themelimit të Agjencive të Pavarura. Neni në fjalë përcakton katër parime bazë që duhet të shoqërojnë themelimin dhe funksionimin e Agjencive të Pavarura. Së pari, Kuvendi i Kosovës është autoriteti kushtetues i cili mban tagrin e themelimit të Agjencive të Pavarura. Për themelimin e tyre, neni në fjalë përcakton që Kuvendi duhet të nxjerrë ligjet përkatëse, që rregullojnë, ndër të tjera, funksionimin, dhe fushëveprimin ligjor të tyre. Së dyti, Kushtetuta përcakton që Agjencive të Pavarura duhet t'u garantohet që ushtrimi i funksionit të tyre ligjor të realizohet pa ndikim dhe në mënyrë të pavarur nga çdo udhëzim apo ndërhyrje e organeve tjera shtetërore. Së treti, për garantimin e pavarësisë së tyre, neni 142 përcakton që Agjencitë e Pavarura duhet të posedojnë buxhetin e tyre të veçantë, dhe të administrojnë me këtë të fundit në mënyrë të pavarur, dhe, parimi i fundit kushtetues i cili duhet të shoqërojë themelimin e Agjencive të Pavarura, lidhet me garancionin kushtetues që organet tjera shtetërore të bashkëpunojnë dhe t'u përgjigjen kërkesave të agjencive të pavarura gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore.

Kapitulli XIII: Dispozitat përfundimtare

Hyrje e Përgjithshme

1. Dispozitat përfundimtare zakonisht paraqiten si dispozita në fund të ligjeve, kushtetutave dhe akteve tjera të përgjithshme me qëllim të rregullimit të hyrjes në fuqi dhe mënyrës së zbatimit të aktit përkatës të përgjithshëm. Kjo përfshinë çështjes si, ta zëmë, përcaktimin e kohës dhe mënyrës së hyrjes në fuqi të aktit përkatës të përgjithshëm, kush do ta zbatoj dhe si, cilat akte të përgjithshme pushojnë së vlefturi me hyrjen në fuqi të aktit të ri të përgjithshëm, si dhe çështjet tjera të ngjashme. Nëse ka më shumë dispozita të tilla përfundimtare apo nëse ka nevojë për një garancion më të madh për mënyrës dhe kohën e mbetjes në fuqi të disa dispozitave të aktit përkatës të përgjithshëm, atëherë dispozitat përfundimtare ndahen në një kapitull të veçantë. Kjo është bërë edhe në rastin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Përndryshe, dispozitat përfundimtare zakonisht, për shkak të lidhshmërisë së tyre të ngushtë me dispozitat kalimtare, paraqitet në aktet e përgjithshme si një kapitull i përbashkët me titullin “dispozitat përfundimtare dhe kalimtare”.
2. Në rastin e Kosovës, Kushtetuta për hir të qartësisë së vendit dhe rëndësisë në sistemin kushtetutës të disa detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës, dispozitat përfundimtare kanë përmbajtur vetëm tri nene të gjata me të cilat janë përcaktuar detyrimet e Kosovës karshi bashkësisë ndërkombëtare. Përrjashtim nga këto përbëjnë dispozitat e nenit 144 të cilat flasin për amendamentimin e Kushtetutës së Kosovës.
3. Me amandamentet I-XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës⁹¹⁷, neni 143 është fshirë në tërësi, kurse nenet në vijim 144 dhe 145 kanë kaluar në Kapitullin I - Dispozitat Themelore, pa treguar se ku dhe në cilin nen të ri të Kushtetutës (sic!). Sado të shfuqizuara, dispozitat e nenit 143 paraqesin një sistem vlerash të cilat në pjesën dërrmuese janë të integruara thellësisht, të shtratëzuara, në Kushtetutën e Kosovës. Si të tilla, ato paraqesin pjesë të pandarë të letrës dhe shpirtit të Kushtetutës së Kosovës. Kjo më tutje nënkupton se çdo interpretim i Kushtetutës së Kosovës, sot dhe në të ardhmen, duhet t'i ketë parasysh vlerat e mishëruara në këtë dokument, përveç atyre dispozitave të tij që kanë natyrë thjeshtë teknike.

⁹¹⁷ Vendimi i Kuvendit të Kosovës, Nr. 04-V-436, datë 7 shtator 2012. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, Nr. 25, datë 7 shtator 2012.

Neni 143 [Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës]

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:

- (1) Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës veprojnë në pajtim me të gjitha detyrimet e Republikës së Kosovës sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Ato do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e tyre.
- (2) Dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007 kanë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë.
- (3) Kushtetuta, ligjet dhe aktet tjera ligjore të Republikës së Kosovës interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë.

Neni 143

1. Ky nen flet për vendin, rolin dhe statusin juridik-kushtetutës të Propozimit gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, i njohur si Plani Ahtisari (26 mars 2007). Ky nen ka tre paragrafë dhe përbën një tërësi unike, dhe modelohet sipas filozofisë dejtoniane. Me Marrëveshjen e Dejtonit (nëntor 1995),⁹¹⁸ ka filluar në Ballkan një fazë e re e zhvillimit kushtetues të vendeve ballkanike, ku cilësi themelore dalluese e teksteve kushtetuese të këtyre vendeve është inkorporimi i njëanshëm i detyrimeve ndërkombëtare. Kjo në fillim u nis me Bosnje-Hercegovinën dhe pastaj ka vazhduar me Kosovën e Rambujesë, ku Kosova pranoi njëanshëm shumë detyrime ndërkombëtare në sistemin e saj hipotetik kushtetues, i cili megjithatë nuk u materializuan kurrë. Pas Kosovës, kjo praktikë u ndoq edhe me Malin e Zi me të ashtuquajturën Marrëveshje për Unionin Serbi-Mali i Zi (2001), e njohur edhe si Solana (sipas ish shefit të NATO-s dhe të Evropës për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, Javier Solana, i cili ndërmjetësoi këtë marrëveshje), me Maqedoninë, ku Marrëveshja e Ohrit e 13 gushtit 2001,⁹¹⁹ për ndalimin e luftës në këtë shtet fqinj parashihte detyrime të madha për shtetin maqedon sa i përket trajtimit të pakicave dhe të drejtave të njeriut dhe sistemit qeverisës, dhe, së fundi, në Luginën e Preshevës, ku Marrëveshja e Konçulit e 13 shkurtit të vitit 2001,⁹²⁰ me të cilën u ndal konflikti në këtë pjesë të banuar me

⁹¹⁸ *The General Framework Agreement for Peace in Bosnia and Herzegovina*, e njohur si Marrëveshja e Dejtonit, është një marrëveshje e paqes që është arritur në bazën ajrore ushtarake amerikane Wright - Patterson afër qytetit Dejton në shtetin Ohajo në nëntor 1995, kurse formalisht është nënshkruar në Paris më 14 dhjetor 1995.

⁹¹⁹ *Marrëveshja e Ohrit*, datë 13 gusht 2001. Teksti i plotë në: <http://www.bdi.mk/documents/MARREVEESHJA-E-OHRIT.pdf>. Për komentet, Cf. Blerim Reka (ed.) (2011). *Dhjetë vite nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit*. UEJL: Tetovë.

⁹²⁰ *Marrëveshja e Konçulit*, datë 13 shkurt 2001. Teksti i plotë në: <https://vargmal.org/Ig/dan5806>.

shumicë shqiptare, parashihte garanci kushtetuese për popullsinë lokale atje sa i përket trajtimit të barabartë si dhe dispozitat për çështjet tjera që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale.

Neni 143.1

1. Ky paragraf përcakton detyrimin e të gjitha autoriteteve publike në Republikë që të veprojnë në pajtim me detyrimet e marra sipas Propozimit gjithëpërfshirës. Për të vënë këtë detyrim në jetë, fjalia e fundit e këtij paragrafi e bënë të qartë edhe detyrimin e Kosovës për të vepruar në zbatim të detyrimeve të dala nga teksti i Propozimit.
2. Nga ky paragraf dalin dy gjëra të rëndësishme që duhen komentuar. E para se detyrimet nga Propozimi i referohen vetëm autoriteteve publike dhe si të tilla këto autoritete duhet t'i kuptojnë. Kjo do të thotë se sfera horizontale e marrëdhënieve ndërmjet subjekteve të së drejtës (sfera private) përjashtohet nga normimi. E dyta, në vijim të kësaj, autoritetet publike kosovare detyrohen që të veprojnë me qëllim të vënies në jetë të detyrimeve nga Propozimi, gjë të cilin në pjesën më të madhe e kanë bërë duke nxjerrë ligje e akte tjera të përgjithshme të njohura si “ligjet e Pakos Ahtisari”.⁹²¹ Sa i përket procedurave në Gjykatën Kushtetuese, vlen të thuhet se çdo akt i nxjerrë në vijim të zbatimit të këtij paragrafi i nënshtrohet kontrollit kushtetues nëse parashtrrohet nga palët e autorizuar dhe sipas procedurës e kushteve të parapara me Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e Punës së Gjykatës. Deri më tani ka pasur procedura të këtij paragrafi me rastin e dy ligjeve, ai për Hoçën e Madhe dhe për Prizrenin⁹²², në ndërkohë që Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj pa ndërprerë e ka bërë të qartë se dispozitat e këtij paragrafi janë pjesë integrale e burimeve të së drejtës kushtetuese në Kosovë.

Neni 143.2

1. Ky paragraf më tutje operacionalizon atë që u tha më sipër sepse në mënyrë krejt të qartë, pa asnjë ekuivok, parashikonte se dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës kanë epërsi absolute ndaj Kushtetutës, ligjeve dhe akteve tjera të Kosovës. Kjo duhet kuptuar kështu sado që në këtë paragraf është përdorur fjala “dispozita tjera ligjore”. Kjo sepse paragrafi në vijim e bënë të qartë se çka nënkuptohet me “dispozita tjera ligjore”.

⁹²¹ Në aneksin XII të Propozimit Gjithëpërfshirës parashihet agjenda legjislativ e Kosovës. Nga kjo agjendë Kosova ka kryer të gjitha detyrimet, me përjashtim të Ligjit për Restituimin e Pronës i cili nuk është nxjerr akoma edhe pas përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrrur në shtator të vitit 2012.

⁹²² Cf. *AKTGJYKIM në Rastet K045/12 dhe K046/12. Kërkesa e Liburn Aliut dhe 11 deputetëve të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vlerësim të kushtetutshmërisë së Ligjit për fshatin Hoça e Madhe dhe të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit*, Nr. Ref.:AGJ 255/12, Prishtinë: 25 qershor 2012.

1. Në këtë paragraf sqarohet se asnjë interpretim kushtetues e ligjor në Kosovë nuk guxon të bie ndesh me dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës dhe, nëse bien, atëherë Propozimi prevalon në çdo aspekt.
2. Kjo dispozitë, së bashku me dy të tjerat si më sipër, sikundër mund të shihet, në pikëpamje teknike më nuk gjen zbatim. Në pikëpamje të vlerave që ngërthen, megjithatë, mund të thuhet lirisht se Kushtetuta e Kosovës reflekton në dispozitat e saj vlerat e Propozimit Gjithëpërfshirës dhe, si i tillë, do të jetë pjesë e interpretimeve kushtetuese e juridike e autoriteteve publike kosovare.

Neni 144 [Amendamenti]

- (1) **Qeveria, Presidenti ose një e katërta (1/4) e deputetëve të Kuvendit, sipas Rregullores së Punës të Kuvendit, mund të propozojnë ndryshime dhe amendamente të kësaj Kushtetute.**
- (2) **Çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e dy të tretave (2/3) të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës.**
- (3) **Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.**
- (4) **Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës.**

Neni 144

1. Në këtë nen rregullohen forma dhe mënyra e amendamentimit kushtetues në Kosovë. Dy janë çështjet që vihen në spikamë në këtë nen. E para, Kushtetuta e Kosovës është një dokument rigjid kur është fjala për amendamentimin e vet, gjë që nënkupton se ndryshimi i saj kërkon një konsensus të gjerë politik, etnik dhe social. E dyta, amendamenti i Kushtetutës së Kosovës përveç këtij konsensusi kërkon edhe pasjen e dritës së gjelbër të Gjykatës Kushtetuese, gjë që e cila parashihet shumë rrallë (në vetëm katër ose pesë kushtetuta në botë).⁹²³

⁹²³ Kontrolli preventiv, si në rastin e Kosovës, është i rrallë dhe ekziston vetëm në disa vende, siç janë Azerbajxhani, Kirgizia, Moldavia, Turqia dhe Ukraina. Cf. Analizën komparative të Komisionit të Venedikut: *Report on Constitutional Amendment, Adopted by The Venice Commission at Its Plenary Session*, Venice, 11-12 December 2009. Në internet mund të gjendet në: www.venice.coe.int, me këtë shenjë: CDL-AD (2010) 001 Study No. 469/2008, Starsbourg, 19 January 2010. Për aspektet teorike të kontrollit preventiv të amendamenteve kushtetuese, Cf.

Neni 144.1

1. Ky paragraf përcakton se kush janë palët e autorizuar për të nisur procedurën e amendamentimit të Kushtetues së Kosovës. Vetëm Qeveria, Presidenti dhe tridhjetë (30) deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë iniciativën për amendamentim. Askush tjetër. Të ashtuquajturat komisione kushtetuese në sistemin kushtetues kosovar kanë ekzistuar në ish Jugosllavi dhe më nuk i njih Kushtetuta e Kosovës. Vetëm këto tri kategori subjektsh, askush tjetër, mund të propozojnë në çdo kohë ndryshime e amendamente të Kushtetutës së Kosovës.

Neni 144.2

1. Dispozita e këtij paragrafi qartë e radhitë Kosovën në vendet me kushtetutë rigjide meqë për ndryshimin e saj kërkohen dy të tretat (2/3) jo vetëm e të gjithë deputetëve por edhe të komuniteteve jo-shumicë. Nuk ka asnjë dyshim se ndryshimi i Kushtetutës së Kosovës has në pengesa procedurale tejkalmi i të cilave duhet të bëhet përmes arritjes së një konsensusi të gjerë në shoqërinë kosovare. Çdo vendim i Kuvendit që nuk respekton këtë dispozitë është antikushtetues.

Neni 144.3

1. Kjo dispozitë tani më është komentuar gjetiu kur është folur për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Fjala, pra, është për kontrollin preventiv të amendamenteve kushtetuese, si një ndër mekanizmat të cilët pengojnë që Kushtetuta të ndryshohet shpesh dhe pa kontroll. Kjo dispozitë pengon aktorët politik që të shndërrojnë Kushtetutën në një akt të thjeshtë i cili mund të ndryshohet sipas tekeve të konjunkturave të momentit pa respektuar dispozitat kushtetuese aktuale që kanë të bëjnë me Kapitullin II, kryesisht, por edhe më Kapitullin III, si dhe me vlerat e [parimet tjera kushtetuese bashkëkohore. Në vijim të kësaj, palë e autorizuar para gjykatës është, në emër të Kuvendit, vetëm Kryetari i Kuvendit dhe askush tjetër, pa marrë parasysh kush janë iniciuesit e ndryshimeve dhe amendamenteve kushtetuese.

Neni 144.4

1. Kjo dispozitë e fundit e këtij neni përcakton se hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese bëhet menjëherë posa të miratohen në Kuvend. Mosekzistimi i një *vacatio legis* për hyrjen në fuqi të ndryshimeve kushtetuese mund të shpjgohet me disa arsye. E para, ndryshimet kushtetuese zakonisht përcillen nga një debat i gjerë publik ku qytetarët tregojnë interesim të jashtëzakonshëm. E dyta, fjala është për ndryshime kushtetuese të cilat janë të rralla dhe kanë, jo ndryshime të rregullta

Gozler, Kemal, (2008). *Judicial Review of Constitutional Amendmenets. A Comparative Study*. EKIN PRESS: Bursa; Jacobsohn, J., Gary (2006). An unconstitutional constitution? A comparative perspective. *Intnernational Journal of Constitutional Law. Vol. 4, No. 3, pp. 460-475.*

ligjore që ndodhin përditë. E treta, më kryesorja arsye, ka të bëjë me faktin se ekziston një kontroll preventiv i ndryshimeve të propozuara kushtetuese të cilat sigurojnë qytetarin se ndryshimi i kryer nuk bie ndesh me Kapitujt II dhe III, por as me vlerat dhe parimet tjera kushtetuese të sanksionuara me Kushtetutën e Kosovës. Kjo nënkupton se ndryshimet kushtetuese bëhen të ditura shumë kohë para miratimit të tyre në Kuvend, përkatësisht gjatë debatit publik dhe vlerësimit të kushtetutshmërisë së tyre në Gjykatë.

Neni 145 [Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe e Legjislacionit të Aplikueshëm]

- (1) Marrëveshjet ndërkombëtare dhe aktet e tjera për bashkëpunimin ndërkombëtarë, që janë në fuqi ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të vazhdojnë të respektohen deri atëherë kur ato marrëveshje ose akte të rinegociohen ose kur të bëhet tërheqja nga to në pajtueshmëri me kushtet e tyre ose deri atëherë kur ato të zëvendësohen nga marrëveshje ose akte të reja ndërkombëtare me të cilat mbulohen fushat e njëjta dhe që janë miratuar në pajtim me këtë Kushtetutë.**
- (2) Legjislacioni i aplikueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute vazhdon të zbatohet për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohet, zëvendësohet ose amendamentohet në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë.**

Neni 145

1. Ky nen flet për dy çështje. E para ka të bëjë me vazhdimësinë e marrëveshjeve ndërkombëtare kurse e dyta i referohet vazhdimësisë së ligjit të zbatueshëm në ditën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Kjo qasje kushtetuese është e njohur gjerësisht në teori dhe praktikë dhe ka për synim themelor moslejimin e vakuimit kushtetues-juridik në marrëdhëniet shoqërore. Si i tillë, qëllimi i këtij neni duhet të dallohet nga nenet tjera të pjesës kryesore të Kushtetutës që flasin për raportin në mes të drejtës kushtetuese dhe asaj ndërkombëtare në Kosovë, mbi rolin dhe rëndësinë e marrëveshjeve ndërkombëtare në sistemin kushtetues-juridik kosovar. Nuk ka asnjë dyshim se marrëveshjet ndërkombëtare të Kosovës kanë fuqi më të madhe se ligji dhe vijnë menjëherë pas Kushtetutës. U mor vesh, përjashtim bëjnë marrëveshjet ndërkombëtare apo ajo pjesë e të drejtës ndërkombëtare që përmban norma *jus cogens* dhe të cilat rrinë mbi çdo detyrim apo normë kushtetuese kosovare. Ky nen, me një fjalë, rregullon vetëm çështjen e vlefshmërisë së normave juridike të cilat kanë qenë në fuqi në Kosovë ditën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës, pa marrë parasysh nëse burim i këtyre normave juridike është marrëveshja ndërkombëtare apo ligji i zakonshëm. Qëllim parësor i dispozitave të këtij neni është mënjanimi i vakuimit juridik dhe ruajtja e sigurisë juridike të qytetarëve dhe subjekteve tjera të së drejtës në Kosovë.

Neni 145.1

1. Ky paragraf rregullon vazhdimin e fuqisë juridike të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe akteve tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar të Kosovës. Vazhdimi i respektimit të normave të sipër-cekura ndërkombëtare, megjithatë, nuk është pa kufij dhe ka një afat kohor. Ai afat kohor lidhet me kohën derisa autoritetet kompetente kosovare të mos rinegociojnë marrëveshjet ekzistuese, nuk tërhiqen nga to si dhe, së fundi, derisa të mos bëhet zëvendësimi i tyre me marrëveshje tjera. E gjithë kjo mund të bëhet vetëm nëse respektohen procedurat e parashikuara me vetë marrëveshjet ekzistuese për ri-negociim apo tërheqje nga marrëveshja, standard ky ndërkombëtar i njohur për ri-negocim dhe tërheqje. Sa i përket zëvendësimit të marrëveshjeve ekzistuese me marrëveshje të reja, atëherë këtu vlen tjetër procedurë. Në rastet e zëvendësimit duhet të ndiqen procedurat e rregullta kushtetuese dhe jo ato të parapara me marrëveshje ndërkombëtare. Deri të zëvendësimi mund të vijë për shumë arsye, siç janë, ta zëmë, skadimi i kohës për vlefshmërinë e marrëveshjes së caktuar. Vlen të thuhet se në asnjë rast zëvendësimi, ri-negociimi apo tërheqja si më sipër nuk mund të përdoret me qëllim të bishtnimit të detyrimeve ndërkombëtare të Kosovës të cilat janë në fuqi.
2. Se detyrimet ndërkombëtare të Kosovës në fuqi në ditën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës duhen respektuar është thënë në një vendim të Gjykatës Kushtetuese me të cilin qenë sqaruar se marrëveshjet për ekstradim të lidhura në emër të Kosovës nga autoritetet ndërkombëtare do të kenë vlefshmëri deri në lidhjen e marrëveshjeve tjera nga kjo fushë.⁹²⁴

Neni 145.2

1. Ky paragraf është i ngjashëm me të parin, vetëm që i referohet akteve të brendshme juridike, ligjeve dhe normave tjera ligjore që kanë qenë në fuqi ditën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës. Me këtë dispozitë shumë qartë thuhet se afati kohor është përderisa mos të ketë ndodhur shfuqizimi, ndryshimi apo amendamenti i normave ekzistuese ligjore.
2. Në këtë dispozitë ka një fjali që thotë se normat e zbatueshme në ditën e hyrjes në fuqi të Kushtetues vazhdojnë të zbatohen për aq sa të jenë në pajtueshmëri me Kushtetutën. Kjo fjali në shikim të parë del sikur është e tepërt meqë edhe ashtu Gjykata Kushtetuese bën një vlerësim të tillë të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Këtu, megjithatë, nuk flitet për këtë kategori të juridiksionit të Gjykatës por për një detyrim kushtetues të të gjitha autoriteteve publike kosovare që të mos zbatojnë ligjet të cilat *prima facie* bien ndesh me realitetin e ri kushtetues të krijuar në Kosovë nga hyrja në fuqi e Kushtetutës sepse mund të ketë dispozita ligjore të cilat formalisht janë në fuqi mirëpo si të tilla cenojnë sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës. Kjo nënkupton në të njëjtën kohë edhe atë

⁹²⁴ Cf. *Vendim mbi Kërkesën për masë të përkohshme në rastin KI 22/09. Dode Gecaj kundër Vendimit PKL-KZZ 76/08 të Gjykatës Supreme të Kosovës* (Ref. Nr. MP 03/09). Prishtinë: 15 dhjetor 2009.

se autoritetet publike kosovare nuk guxojnë të zbatojnë ligjet dhe normat e vjetra të cilat janë zëvendësuar me ligje e norma të reja të nxjerra nga Kuvendi dhe autoritetet tjera pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës. Kjo ndalesë e paraparë me këtë dispozitë kushtetuese është vërtetuar shumë qartë edhe nga Gjykata Kushtetuese në rastin e njohur si “Agjencia Kosovare e Privatizimit”, apo rasti i “AKP-së”.⁹²⁵

3. Rasti i AKP-së është në mesin e atyre rasteve që nuk ka kapur vëmendjen e publikut, por që është i një rëndësie të madhe për sundimin e ligjit dhe sigurinë juridike të qytetarëve dhe subjekteve tjera juridike. Çështja kishte të bënte me një ankesë individuale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit si person juridik e cila pretendonte se iu kishin shkelur të drejtat e veçanta kushtetuese nga ana e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në çështjet e privatizimit. Arsyetimi i Gjykatës në këtë rast, megjithatë, shkoi shumë më larg se pohimet e palës ankuese duke prekur çështjet vitale të sundimit të ligjit në Kosovë: parashikueshëmërinë dhe sigurinë juridike që krijohet nga një zbatim jo i njëjtë i ligjeve nga ana e autoritetit më të lartë gjyqësor - Gjykatës Supreme, përkatësisht nga ana e Dhomës së Posaçme që vepron në kuadër të Gjykatës Supreme.
4. Me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimit të Dhomës së Posaçme, sipas kërkesës së AKP-së, vendim që në vijim diskutohet gjerësisht, Gjykata Kushtetuese u mbështet në Mendimin Këshillëdhënës për Kosovën të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Ky Mendim në mënyrë të qartë bënte dallimin midis fuqive konstitutive (“pouvoir constituit” apo “pouvoir constituant”) dhe fuqive të konstituara (“pouvoir constituee”). Të shohim më gjerësisht këtë shtjellim të Gjykatës Kushtetuese dhe rrethanat e rastit.
5. Esenca e çështjes së kësaj kërkesë individuale të AKP-së ka të bëjë me qëndrimin e përgjithshëm të Dhomës së Posaçme i cili thoshte se AKP paraqet një agjenci *de facto* dhe jo *de jure* sepse operonte sipas një ligji që për Dhomën e Posaçme kishte vetëm cilësinë e një rregulloreje të brendshme, e jo të një ligji të vërtetë për AKP⁹²⁶. Ky qëndrim i përgjithshëm i Dhomës së Posaçme, i cili u zbatua që nga themelimi i saj pas luftës së Kosovës (10 qershor 1999), preku esencën e “pouvoir constituit” apo “pouvoir constituant” të Kosovës ashtu siç ishte manifestuar nga përfaqësuesit e zgjedhur të popullit të Kosovës më 17 shkurt 2008 kur u shpall Deklarata e Pavarësisë së Kosovës. Përveç kësaj, ky qëndrim i Dhomës së Posaçme prekte edhe “pouvoir constituee”, pra të drejtën e ushtrimit të pushtetit nga ana e autoriteteve publike kosovare të themeluara në mënyrë ligjore pas asaj të shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008. Këtu ka nevojë të qartësohet me tutje se çka është Dhoma e Posaçme? Cili është autoriteti i saj? Çka është “AKP” dhe Ligji sipas të cilit vepron brenda rendit juridik-kushtetues kosovar?

⁹²⁵ Aktgjykimi në rastin Nr. KI 25/10. Parashtruesi i kërkesës: Agjencia Kosovare e Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC 09—89, të 4 shkurtit 2010.

⁹²⁶ Ligji Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 21 majit 2008

6. Procesi i privatizimit në Kosovë që filloi menjëherë pas instalimit të administratës ndërkombëtare të qershorit të 1999-ës, nën mbikëqyrjen e Kombeve të Bashkuara, e njohur si UNMIK (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë), ka pasur specifikat e veta. Në fakt, çdo proces i privatizimit pas kolapsit të komunizmit më 1989 ka qenë specifik në varësi të karakteristikave të secilit shtet.⁹²⁷ Në këtë drejtim, Kosova nuk bën përjashtim. Specifikat e Kosovës përbëhen, ndër të tjera, nga ajo që i tërë procesi i privatizimit ka qenë i udhëhequr nga UNMIK-u përderisa organet dhe autoritetet vendore shërbenin si autoritete jo-vendimmarrëse. Në thelb, prezenca e tyre aty ishte vetëm sa për sy e faqe.⁹²⁸
7. Baza juridike për këtë lloj privatizimi që zuri vend pas qershorit 1999 në Kosovë ishte Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit e 13 qershorit 2002. Sipas kësaj Rregulloreje, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) shërbente si institucion përgjegjës për të udhëhequr tërë procesin e privatizimit në Kosovë pas 10 qershorit 1999, përderisa Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës ishte organi për të gjykuar dhe vendosur për çështjet në lidhje me privatizimin.⁹²⁹
8. Pas deklarimit të pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës nxori Ligjin për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Ligji nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 21 majit 2008, duke u bazuar në “pouvoir constitue” të vet, si një organ ligjvënës i një shteti sovran dhe i pavarur. Sipas këtij ligji, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 pushonte së prodhuari efekte juridike në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit. Kuvendi i Kosovës më parë kishte nxjerr Ligjin nr. 03/L-053 për Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve dhe laktimin e gjyqtarëve të EULEX-it në Kosovë (13 mars 2008), i cili kishte për qëllim që të rregullojë integrimin dhe juridiksionin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, duke përfshirë edhe ata që punojnë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Ky Ligj, megjithatë, duket të ketë qenë burim i keqkuptimeve për shkak të interpretimeve të dhëna për të nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës. Dhoma e Posaçme, në vend se të shfrytëzonte këtë Ligj si bazë për të pajtuar dallimet në mes gjyqtarëve dhe prokurorëve kosovarë dhe kolegëve të tyre të EULEX-it, i mohoi statusin juridik AKP-së për çështjet e privatizimit dhe vazhdoi ta trajtojë Ligjin nr. 03/L-067 si një rregullore të brendshme e cila, megjithatë, duhej të respektohej dhe zbatohet nga AKP si një entitet *de facto*.

⁹²⁷ Cf. më shumë në lidhje me këtë në një studim elokuent nga Csongor, Kuti, (2009). *Post-Communist Restitution and the Rule of Law*. Central European University Press: Budapest/New York.

⁹²⁸ Cf. më shumë në lidhje me këtë në Gashi, Haxhi (2011). Konflikti lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore: Ndryshimi i Ligjit për Dhomën e veçantë të Gjykatës Supreme, i Ligjit për AKP-në dhe Ligjet Relevante. *E DREJTA/LAW* Nr. 2/2011, fq. 47-63.

⁹²⁹ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/13 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, me ndryshime, datë: 13 qershor 2002.

9. Ky qëndrim i Dhomës së Posaçme, i shprehur në vendimin e saj që u kontestua nga AKP-ja, Vendimi ASC-09-089 i datës 4 shkurt 2010, ishte objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin e saj nr. KI25/10 të datës 31 mars 2011. Me këtë Aktgjykim Gjykata konstatoi se Vendimi ASC-09-089 ishte në kundërshtim me shumë norma dhe vlera të Kushtetutës së Kosovës. Megjithatë, në komentimin tonë këtu nuk kanë shumë rëndësi pjesët kryesore të Aktgjykimit të cilat flasin për analizën e Gjykatës rreth shkeljeve nga ana e Dhomës së Posaçme të dispozitave të veçanta të Kushtetutës dhe të vlerave e parimeve të saj,⁹³⁰ por pjesa e përfshirë në analizën e Gjykatës në lidhje me “pouvoir constitif”/“pouvoir constituant”. Kjo analizë është e përfshirë në paragrafin 54 të Aktgjykimit të Gjykatës. Gjykata ia bëri të qartë Dhomës së Posaçme, në mënyrë shumë profesionale, se fuqitë (kompetencat) konstitutive/origjinale të Republikës së Kosovës, siç janë shprehur në vendimin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008, nuk bazohen në normat e një rendi të mëparshëm juridik, siç do ta formulonte Carl Schmitt.⁹³¹ Këto kompetenca konstitutive/origjinale tejkalojnë dhe u japin fund kompetencave të të gjitha autoriteteve tjera. Ato fuqi (kompetenca) janë ushtruar nga kosovarët përmes përfaqësuesve të tyre legjitim më 17 shkurt 2008, dhe si të tilla nuk burojnë nga një rend i mëparshëm juridik i krijuar nga UNMIK-u (bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillin e Sigurimit të OKB-së të datës 10 qershorit 1999). Për këtë arsye, ushtrimi i tyre më 17 shkurt 2008 nuk ka shkelur ndonjë normë të veçantë apo të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese është tërësisht në harmoni me arsyetimin dhe frymën e Mendimit Këshillëdhënës për Kosovën të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të 22 korrikut 2010.⁹³² Me këtë Aktgjykim, Gjykata Kushtetuese në mënyrë të qartë i ka treguar Dhomës së Posaçme se ajo është pjesë e pandashme e rendit kushtetues dhe juridik të Kosovës, me status të veçantë. Kjo nënkupton se Dhoma, sipas Gjykatës Kushtetuese, nuk ka pasur të drejtë të marrë e të zgjedhë sipas dëshirës ligjet që duhej t’i zbatonte në rastin konkret ose ta cilësojë si *de facto* entitete e caktuara juridike të Kosovës të themeluara me ligje të reja të nxjerra nga Kuvendi i Kosovës sovraane dhe të pavarur. Dhoma e Posaçme duhet të shërbejë, konstatonte Gjykata Kushtetuese, si një pjesë integrale e Gjykatës Supreme të Kosovës funksioni kryesor i së cilës është që të sigurojë zbatim të njëtrajtshëm të ligjit në tërë territorin e Kosovës. Fundja, ky është pikërisht roli edhe detyra e çdo gjykatë supreme ose e një ekuivalenti të ngjashëm me të që ka pozitën më të lartë në gjyqësorin e një vendi të caktuar. Me një fjalë, sipas interpretimit të Gjykatës Kushtetuese, Dhoma nuk ka pasur të drejtë të cilësojë si *de facto* AKP-në e as Ligjin për AKP-në sepse një fuqi e tillë i takon vetëm Kuvendit të Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur. Në momentin që Kuvendi ka nxjerrë një ligj me të cilin ka

⁹³⁰ Cf. Paragrafët 45-53 dhe 55-62 të Aktgjykimit.

⁹³¹ Cf. më shumë në lidhje me këtë në Schmitt, Carl (2005). *Political Theology; Four Chapters on the Concept of Sovereignty*. (The University of Chicago Press: Chicago, fq. 16-35; Samardzic Slobodan (ed) (2001). *Norma i Olduka: Karl Smit i Njegovi Kriticari*. Filip Visnjic: Beograd, fq. 85-124.

⁹³² *Pajtueshmëria me të Drejtën Ndërkombëtare e Shpalljes së njëanshme të Pavarësisë në lidhje me Kosovën. Mendim Këshillëdhënës*. Datë: 22 korrik 2010. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND). Cf. konkretisht paragrafët 52-56; 74-84; 96-109; 114-121.

Enver Hasani

shfuqizuar dispozitat e mëhershme ligjore që rregullojnë lëmin e njëjtë, atëherë të gjithë në Kosovë duhet t'i nënshtrohen këtij përcaktimi ligjor-kushtetues të Kuvendit. Kjo është në fakt vetë esenca e kësaj dispozite që komentohet këtu.

Kapitulli XIV: Dispozitat Kalimtare

Hyrje e Përgjithshme

1. Ato norma (dispozita) të një akti të përgjithshëm (kushtetues, ligjor apo tjetër) të cilat përcaktojnë mënyrën se si do të kalohet nga normat (dispozitat) normat e vjetra në të reja quhen norma (dispozita) kalimtare. Më një fjalë, normat (dispozitat) kalimtare janë ato norma (dispozita) të cilat përmbledhen në një akt të përgjithshëm (kushtetues, ligjor apo tjetër) përmes të cilave përcaktohet mënyra e kalimit nga një gjendje e vjetër në një gjendje të re juridike. Kjo bëhet nga shkak se çdoherë kur fillon zbatimi i një norme (dispozite kushtetuese, ligjore apo tjetër) domosdo që lindin vështirësi të cilat janë imanente me rastin e hyrjes në fuqi të një norme (dispozite) të re të përgjithshme dhe zbatimit të saj ndaj marrëdhënieve të cilat deri atëherë janë rregulluar me norma (dispozita) tjera të vjetra.
2. Në vijim për sa më sipër, jo rrallë lind nevoja për caktimin e një afati kalimtar gjatë të cilit, pjesërisht apo në tërësi, do të zbatohen normat (dispozitat) e vjetra të cilat zëvendësohen gjatë procesit me normat (dispozitat) e reja. Kjo periudhë transitore rregullohet me normat (dispozitat) kalimtare, të cilat zakonisht gjenden në fund të aktit të përgjithshëm (kushtetues, ligjor apo tjetër). Vetëkuptohet se edhe afati i tyre është kalimtar. Në veçanti kushtetutat si akte të përgjithshme kanë dispozita kalimtare të vëllimshme, jo rrallë edhe ligje të veçanta përmes të cilave përcaktohet mënyra e zbatimit të kushtetutës së re. Kjo nënkupton se dispozitat kalimtare kushtetuese mund të jenë objekt i një aktit tjetër të përgjithshëm, i një ligji kushtetues që përcakton mënyrën e zbatimit të kushtetutës së re si një akt më i lartë i përgjithshëm në një shoqëri. Fjala kyçe te normat (dispozitat) kalimtare është përcaktimi i mënyrës së zbatimit të aktit të përgjithshëm si pasojë e nxjerrjes dhe hyrjes në fuqi të një akti të ri të përgjithshëm që ka natyrë dhe fuqi të njëjtë kushtetuese, ligjore apo tjetër.
3. Përveç anës formale të fuqisë kushtetuese, ligjore dhe tjetër të hyrjes në fuqi të aktit të ri të përgjithshëm, dispozitat kalimtare përcaktojnë edhe mënyrën dhe formën e funksionimit të institucioneve të sistemit kushtetues - juridik gjatë kohës së tranzicionit. Kjo mënyrë përfshinë edhe përcaktimin kalimtar të mënyrës së zgjedhjes dhe autorizimet e institucioneve gjatë kohës kalimtare dhe mënyrën e zëvendësimit të tyre gradual.
4. Derisa disa prej dispozitave përfundimtare mund të kenë natyrë kalimtare, dhe anasjelltas, ky nuk është rasti: dispozitat kalimtare asnjëherë nuk janë përfundimtare dhe nuk kanë lidhje organike afatgjate me pjesët tjera të aktit të përgjithshëm kushtetues, ligjor apo tjetër. Dallimi themelor në mes tyre, pra, konsiston në atë se normat (dispozitat) përfundimtare të një akti të përgjithshëm (kushtetues, ligjor apo tjetër) kryesisht kanë një lidhje organike me pjesët paraprake të aktit të përgjithshëm (kushtetutës, ligjor apo tjetër) dhe si të tilla janë

fjala e fundit e hartuesit të aktit në fjalë për sa i përket origjinës dhe natyrës së sistemit kushtetues-juridik, në ndërkohë që normat (dispozitat) kalimtare të një aktit të përgjithshëm (kushtetues, ligjor apo tjetër) kryesisht merren me fatin e normave (dispozitave) të aktit të tillë të përgjithshëm si dhe fatin dhe institucioneve të vjetra që funksionojnë në bazë të normave (dispozitave) pararendëse gjatë periudhës kalimtare.

Ky dallim, jo edhe aq i prerë, në mes të dispozitave përfundimtare dhe kalimtare është reflektuar edhe në Kushtetutën e Kosovës.

5. Me amendamentet I-XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës të datës 7 shtator 2012,⁹³³ janë fshirë nenet 146-154 dhe nenet 157-160, kurse neni 155 (Shtetësia) është bartur tek Kapitulli I - Dispozitat Themelore, pa treguar se ku dhe në cilin nen të ri të Kushtetutës (sic!). Po ashtu, neni 156 (Refugjatët dhe Personat e zhvendosur brenda vendit) është bartur në Kapitullin II të Kushtetutës, sërish pa treguar se ku dhe në cilin nen të ri të Kushtetutës (sic!). I vetmi nen i ri, i cili ka zëvendësuar nenin e fshirë 161 (Tranzicioni i Institucioneve) është neni 161, tani i titulluar si “Dispozitë Kalimtare”, i cili thotë si vijon:
“Individët e emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në pajtim me Propozimin Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, mandati i të cilëve nuk ka përfunduar para deklaramit të përfundimit të pavarësisë së mbikëqyrur do të vazhdojnë të kryejnë funksionet e tyre në institucionet ku janë deri në fund të mandatit të specifikuar. Kosova do t’ua japë këtyre individëve të njëjtat privilegje dhe imunitete që i gëzojnë diplomatët dhe familjet e tyre sipas Konventës së Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike”.
6. Ky nen i ri që fuqizon një dispozitë tjetër kalimtare duhet të kuptohet për sa vijon: përveç pranisë ndërkombëtare në Gjykatën Kushtetuese, si dhe kur është fjala për Auditorin e Përgjithshëm, tjetra prani ndërkombëtare ka një mandat të paracaktuar ndërkombëtar të caktuar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar që zgjatë deri në fundin e verës së vitit 2014.⁹³⁴ Gjykata Kushtetuese bën përjashtim sepse fjala

⁹³³ Vendimi i Kuvendit Nr. 04-V-436 i datës 7 shtator 2012. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës* Nr. 25 (datë: 7 shtator 2012).

⁹³⁴ Kjo buron nga fakti se vendimet për emërim, përkatësisht riemërim të të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve dhe anëtarëve tjerët ndërkombëtar nëpër trupat kosovare të privatizimit, pronës dhe të ngjashme kanë mandate specifike deri në fund të gushtit 2014. Për Gjykatën Kushtetuese dhe Auditorin e Përgjithshëm është përdorur një formë tjetër e cila nuk e lidhë punën e tyre për ndonjë mandat specifik por për pasjen e fondeve për financim të tyre në dispozicion për kohën pas fundit të gushtit 2014. Cf. Vendimet e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar të Zyrës Civile Ndërkombëtare (PCN i ZCN), zt. Piter Feith, No. 17/2012 dhe 18/2012 të datës 17 korrik 2012 mbi emërimin e gjyqtarëve Almiro Rodrigues dhe Snezhana Botusharova, si dhe Vendimin No 19/2012 të datës 22 gusht 2012 mbi emërimin e gjyqtarit Robert Carolan; Për Auditorin e Përgjithshëm, Cf. Vendimin e PCN të ZCN No. 2012/16 të datës 16 korrik 2012.

Emërimet si më sipër janë bërë pas hyrjes në fuqi të amendamenteve kushtetuese të cilat komentohen këtu mbi përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës, të cilat janë bërë në vijim të zbatimit të marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian, e lidhur përmes këmbimit të letrave në mes të Kosovës dhe Shefes së Bashkimit Evropiane për

është për një institucion i cili nuk bën pjesë në strukturën e administratës shtetërore dhe ka një pavarësi absolute institucionale, personale dhe financiare të cilën e rregullon vet bazuar në Kushtetutë, Ligjin mbi Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullat e Procedurës. Institucionet tjera të cilat kanë pasur dhe akoma kanë prani ndërkombëtare janë institucione të pavarura të cilat janë pjesë përbërëse e administratës shtetërore, përkatësisht janë mekanizma shtetërore të pavarur cilat janë pjesë e shtetit administrativ në sensin modern të kësaj fjale. Kjo është arsyeja që Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar ka caktuar një mandat pak a shumë të qartë për praninë ndërkombëtare nëpër këto institucione të kuptuara si mekanizma shtetëror të shtetit administrativ në kuptimin modern të kësaj fjale, në ndërkohë që, siç do të sqarohet në vijim, për Gjykatën Kushtetuese e ka lënë mandatin të hapur dhe në vartësi të sigurimit financiar të kësaj pranie ndërkombëtare në Gjykatë pas fundit të verës së vitit 2014.

7. Sado të shfuqizuara, disa prej dispozitave të neneve të vjetra tanimë pa fuqi reflektojnë një sistem vlerash të cilat në pjesën dërmuese janë të integruara thellësisht, të shtratëzuara, në Kushtetutën e Kosovës. Si të tilla, ato paraqesin pjesë të pandarë të letrës dhe shpirtit të Kushtetutës së Kosovës. Kjo më tutje nënkupton se çdo interpretim i Kushtetutës së Kosovës, sot dhe në të ardhmen, duhet t'i ketë parasysh vlerat e mishëruara në këtë dokument, përveç atyre dispozitave të tij që kanë natyrë thjeshtë teknike. Jo vetëm kaq, dispozitat kalimtare tanimë të shfuqizuara në të ardhmen mund të shërbejnë si **travaux**

Politikë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë, znj. Baroneshë Catherine Ashton. Cf. *Ligji Nr. 04/L-148 Për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë*, i shpallur nga Presidentja e Republikës, znj. Atifete Jahjaga, me Dekretin Nr. DL - 039-2012, datë 7 shtator 2012.

Megjithatë, ka një dallim substancial në mes të pozitës së Auditorit të Përgjithshëm dhe anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Kjo e fundit nuk bën pjesë në agjenci apo institucione të administratës shtetërore, pra nuk është pjesë e shtetit administrativ, si një ndër pjesët e pushtetit të ndarë. Në të njëjtën kohë, Gjykata Kushtetuese nuk është as pjesë e pushteteve të ndara. Si e tillë, siç është cekur më herët disa herë, Gjykata bën pjesë në pushtetin e konstituuar ("Pouvoirs constituee"), e cila i përgjigjet Kushtetutës dhe qytetarëve të vendit. Kjo më tutje nënkupton se pavarësia institucionale, personale e financiare e Gjykatës është e plotë dhe nuk mund të ndikohet nga vullneti politik i Kuvendit apo i organeve tjera. Me fjalë tjera, mandati i dhënë nga ana e PCN të ZCN për anëtarët e gjykatës kushtetuese është i njëjtë me mandatin e plotë kushtetues të anëtarëve tjerë, sepse nuk është caktuar me short, kurse vazhdimi i mandatit në fjalë kushtëzohet nga rrethanat e sigurimit të financimit të tyre të mëtejme pas datës së skadimit të kontratës së tyre të fundit.

Derisa për vazhdimin e mandatit të gjyqtarëve e prokurorëve të EULEX-it, të cilët kanë vepruar sipas nenit 2.3 të Aneksit IX, është dashur një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të Kosovës, kurse për vazhdimin e mandatit të anëtarëve tjerë ndërkombëtar të agjensioneve e institucioneve të administratës kosovare është dashur vendim i veçantë i PCN i ZCN, për gjyqtarët ndërkombëtar të Gjykatës Kushtetuese nuk kërkohet një teknikë e tillë juridiko-kushtetuese e manifestimit të vullnetit të Kosovës: mandati i gjyqtarëve ndërkombëtar ekziston dhe ai vullnet është shprehur njëherë për një mandat të plotë për të cilin ata edhe janë betuar si gjyqtarët vendor. Vazhdimi i punës së tyre, megjithatë, kondicionohet me rrethanat financiare të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

préparatoires travaux préparatoit për ndonjë vendim të organeve publike në Kosovë, si dhe për qëllim doktrinar, pa përjashtuar këtu mundësinë që Gjykata Kushtetuese t'i përdorë ato si **travaux préparatoires** gjatë kontrollit kushtetutës së ndonjë akti të përgjithshëm apo të ndonjë vendimi individual të autoriteteve publike kosovare. Në fakt, i vetmi rast ku Gjykata mund të hulumtojë për kuptimin dhe historikun e kuptimit të **travaux préparatoires janë normat (dispozitat) e shfuqizuara që i referohen periudhës kalimtare.**

Neni 146 [Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil]

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute:

- (1) Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil dhe organizatat e akterët e tjerë ndërkombëtarë të mandatar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, kanë mandatin dhe kompetencat e përcaktuara me Propozimit Gjithëpërfshirës duke përfshirë zotësinë juridike si dhe privilegjet dhe imunitetet e përcaktuara me të.**
- (2) Të gjitha autoritetet në Republikën e Kosovës bashkëpunojnë plotësisht me Përfaqësuesin Ndërkombëtarë Civil, organizatat dhe akterët tjerë ndërkombëtarë të mandatar sipas Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007 dhe ndër të tjera i'u japin fuqi ligjore vendimeve ose akteve të tyre.**

Neni 146

1. Ky nen është fshirë me amendamentin 7 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I - XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Si i tillë, ky nen ka pasur dy paragrafë të cilët kanë përcaktuar vendin dhe pozitën e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar në sistemin kushtetues-juridik kosovar. Pikë referimi për këtë ka qenë Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës i datës 26 mars 2007. Në fakt, ky nen ka reflektuar në një mënyrë të kondensuar urdhrin e nenit 11 të Dispozitave të Përgjithshme të Propozimit Gjithëpërfshirës dhe të Aneksit IX (Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar). Në pikëpamje teknike, ky nen nuk është në fuqi, mirëpo fusha të cilën e ka pasur nën juridiksion ky organ sipas këtij neni ka qenë dhe mbetet aktuale në Kosovë, sado që tani mbulohet nga institucionet vendore. Ajo fushë kryesisht lidhet me sundimin e ligjit, qeverisjen e mirë dhe të përgjegjshme, si dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve.

Neni 146.1

1. Kjo dispozitë, sikundër dhe ajo pas kësaj, i referohen dispozitave të sipër-cekura të Propozimit Gjithëpërfshirës që përcaktonin autorizimet dhe statusin e Përfaqësuesit Civil në sistemin kushtetues-juridik kosovar.

1. Njëjtë me dispozitën pararendëse, këtu pikë referimi është Propozimi Gjithëpërfshirës, me një dallim që këtu kërkohet më fuqi kushtetuese kalimtare që institucionet kosovare t'u japin fuqi veprimeve të ndërmarra në kuadër të autorizimeve të mandatuara të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar. Kjo në fakt edhe ka ndodhur në shumicën e rasteve, gjë që shihet më së miri nga aktiviteti legjislativ i Kuvendit të Kosovës, i njohur si “ligjet nga Pakoja e Ahtisarit”, kur Kuvendi miratoi më shumë se 50 ligje me procedurë të përsheptuar.⁹³⁵ Jo vetëm kaq: pala kosovare ka qenë kooperative edhe në emërimet e guvernatorit të Bankës Qendrore si dhe në emërimet tjera të cilat kanë qenë përgjegjësi e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, në konsultim me institucionet vendore. Gjatë periudhës sa ka zgjatur pavarësia e mbikëqyrur (2008-2012) nuk është vërejtur ndonjë mospajtim serioz në mes të institucioneve vendore dhe Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar.

Neni 147 [Autoriteti Përfundimtarë i Përfaqësuesit Ndërkombëtarë Civil]

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj Kushtetute, Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, është autoriteti përfundimtarë në Kosovë lidhur me interpretimin e aspekteve civile të Propozimit Gjithëpërfshirës. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka jurisdiksion të rishikojë, të pakësojë ose në ndonjë mënyrë të kufizojë mandatin, kompetencat dhe detyrimet e përcaktuara në nenin 146 dhe në këtë nen.

Neni 147

1. Ky nen, me një strukturë të gjatë fjalishë, por pa paragrafë, përcaktonte se autoriteti përfundimtar për interpretim të aspekteve civile të Propozimit Gjithëpërfshirës do të ishte Përfaqësuesi Civil. Pra, fjala ka qenë vetëm për aspektet civile të Propozimit meqë aspektet ushtarake kanë qenë të përjashtuara nga jurisdiksioni i Përfaqësuesit Civil. Në të njëjtën kohë, ky nen përcaktonte kompetencat ekzekutive të Përfaqësuesit Civil. Ky lloj autoriteti i një përfaqësuesi ndërkombëtar ka qenë i njohur edhe gjetiu në periudhën e krijimit të shteteve të reja, përfshirë këtu, ta zëmë, Shqipërinë pas shpalljes së pavarësisë më 28 nëntor 1912, Bosnje-Hercegovinën pas Marrëveshjes së Dejtonit (nëntor 1995),⁹³⁶ apo rastet e të ashtuquajturave territore të internacionalizuara, më fillim që nga Danzingu (1815), Memeli (1918-1939), Saar-i (1920-1935) deri te rasti i territorit

⁹³⁵ Cf. Aneksin XII (“Agjenda Legjislative”) të Propozimit Gjithëpërfshirës të datës 26 mars 2007. Për kritikën e kësaj mënyre të nxjerrjes së ligjeve, Cf. GAP, *Rregulli 61: Ligjet e Ahtisarit - pasojat dhe mësimet e nxjerra nga miratimi i ligjeve në procedurë të përsheptuar* (Prishtinë: dhjetor 2010). Në internet: http://www.institutigap.org/documents/41927_Rregulli_61.pdf;

⁹³⁶ Për rastin e Shqipërisë, Cf. Omari, Luan dhe Anastasi, Aurela (2008) ‘E Drejta Kushtetuese’. Tiranë: Shtëpia Botuese ABC, fq. 10-11 dhe literaturën e cituar aty.

të Brçkos në veri të Bosnje-Hercegovinës (nëntor 1995 deri më tani), të cilat janë udhëhequr (administruar) nga trupa administrative ndërkombëtare.⁹³⁷

2. Në vijim për sa u tha më sipër, ky nen, thënë shkurt, ka përcaktuar se Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar ka fuqi ekzekutive, të cilat, megjithatë, në asnjë rast nuk i ka përdorur gjatë tërë ushtrimit të mandatit të tij në Kosovë (2008-1012).
3. Ky nen është fshirë me amendamentin 8 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I - XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Neni 148 [Dispozitat Transicionale për Kuvendin e Kosovës]

- (1) Për dy (2) mandatet e para zgjedhore, Kuvendi i Republikës së Kosovës do të ketë njëzet (20) vende të rezervuara për përfaqësim të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë në mënyrën si vijon: Dhjetë (10) vende do t'u ndahen partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, që janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin Serb të Kosovës, dhe dhjetë (10) vende do t'u ndahen komuniteteve të tjera si vijon: komunitetit Rom një (1) vend; komunitetit Ashkali një (1) vend; komunitetit Egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit Rom, Ashkali ose Egjiptian, i cili ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komunitetit Boshnjak tri (3) vende, komunitetit Turk dy (2) vende dhe komuniteti Goran një (1) vend. Çdo vend i fituar përmes zgjedhjeve, do të jetë vend shtesë, përveç dhjetë (10) vendeve të rezervuara që u ndahen përkatësisht komunitetit Serb të Kosovës dhe komuniteteve të tjera.
- (2) Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, mandati ekzistues në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute do të konsiderohet si mandati i parë zgjedhor i Kuvendit, në rast se ky mandat zgjat për së paku dy vite nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.

⁹³⁷ Për rastet e territoreve të internacionalizuar në të kaluarën, Cf. më shumë në Meir Ydit (1961) 'Internationalized Territories From the "Free City of Cracow" to the "Free City of Berlin". A Study in the Historical Development of a Modern Nation in International Law and Relations'. Leiden: A. W. Sythof; Rasti i territorit të Brçkos është sanksionuar me nenin V të Aneksit 2 të Marrëveshjes së Dejtonit (nëntor 1995).

Vlen të thuhet se edhe vetë Kosova me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, datë 10 qershor 1999, ka qenë një lloj territori i internacionalizuar i cili është administruar nga administrata e Kombeve të Bashkuara, e njohur si UNMIK. Dy janë cilësitë që duhet t'i plotësojë një territor për t'u konsideruar si territor i internacionalizuar. Në rend të parë, ai territor duhet t'i takoj një shteti sovran dhe, së dyti, territori duhet të ketë status të pacaktuar, ashtu që administrimi i tij bëhet për një periudhë kalimtare deri në përcaktimin e statusit përfundimtar të territorit.

Neni 148

1. Ky nen ka rregulluar gjendjen kalimtare në Kuvendin e Kosovës, duke përcaktuar në mënyrë shumë të qartë standardin e vënë nga Propozimi Gjithëpërfshirës të 26 marsit 2007.⁹³⁸ S i tillë, ka pasur dy paragrafë dhe mëtonte të siguronte barazinë e komuniteteve jo shumicë në organin përfaqësues kosovar në periudhën kalimtare. Standardi i vënë këtu njeh dy kategori të mekanizmave që mbrojnë të drejtat e komuniteteve jo shumicë. I pari mekanizëm ishin të ashtuquajturat vende të rezervuara, kurse i dyti kishte të bënte me të ashtuquajturat vendet e garantuara në Kuvend.
2. Ky nen është fshirë me amendamentin 9 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I - XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Në vijim të mbylljes së procesit të dialogut me serbët dhe lidhjes së marrëveshjes për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë⁹³⁹, ka zëra se duhet të rikthehet ky nen i Kushtetutës në formën e mëparshme edhe për një kohë të caktuar.

Neni 148.1

1. Ky paragraf ka folur për dy kategori të vendeve në parlament të cilat u takonin komuniteteve jo shumicë. Në kategorinë e parë hynin vendet e rezervuara dhe ishin gjithsejtë njëzetë (20) vende nga Kuvendi kosovar njëqind e njëzet anëtarësh, dhjetë (10) nga të cilat i takonin serbëve kurse dhjetë (10) vendet tjera u takonin komuniteteve joshqiptare dhe jo-serbe. Në këtë grup të komuniteteve joshqiptare dhe jo-serbe bënin pjesë: romët (një vend); ashkalitë (një vend); egjiptianët (një vend); boshnjakët (tri vende); turqit (tri vende) dhe goranët (një vend). Komuniteti rom-ashkali-egjiptian e kishte të rezervuar një vend shtesë në kuadër të këtij dhjetëshi dhe i takonte atyre nga ky komunitet që kishin fituar më së shumti vota të përgjithshme.
2. Fjalja e fundit e këtij paragrafi fliste për vendet e garantuara të cilat mund t'i fitonin si vende shtesë përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta. Kjo e bënte që Kuvendi i Kosovës të ketë më shumë joshqiptar se numri njëzet (20) sa ishte i rezervuar për komunitetet joshqiptare.

Neni 148.1

1. Në këtë paragraf parashihej që mandati më i gjatë se dy (2) vjet nga hyrja në fuqi e Kushtetutës do të llogaritej në mandatin e parë, gjë që efektivisht nënkuptonte se

⁹³⁸ Cf. Neni 3 i Aneksit I (“Dispozitat Kushtetuese”) të Propozimit

⁹³⁹ Cf. Marrëveshja e Parë ndërkombëtare që rregullon normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, nënshkruar më 19 prill 2013 nga Kryeministri i Republikës së Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Serbisë, miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 22 prill, 2013, Vendimi Nr. 01/126, dhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 22 prill, 2013, Rezoluta Nr. 04-R-10.

vetëm edhe mandati i viteve 2010-2014 do të llogaritej si mandat i dytë ashtu që në zgjedhjet e radhës më 2014 do të dilte nga fuqia ky mekanizëm kushtetues i paraparë për mbrojtjen e komuniteteve jo-shumicë.

Neni 149 [Miratimi Fillestar i Ligjeve me Interes Vital]

Pavarësisht nga dispozitat e Nenit 81 të kësaj Kushtetute, ligjet me interes vital të radhitura në atë nen, do të miratohen fillimisht me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm të Kuvendit dhe që votojnë.

Neni 149

1. Ky nen një-paragrafësh ka pasur të bëjë me miratimin fillestar, pra vetëm një herë, të ligjeve me interes vital. Me këtë nen parashihej zbatimi i një procedure që do të vrente vetëm një herë, vetëm me rastin e miratimit të parë të ligjeve me interes vital nga neni 81 i Kushtetutës. Siç është komentuar më herët, neni 81 parasheh një procedurë që veçantë për miratimin e legjislacionit me interes vital për komunitetet jo-shumicë të cilët mbajnë vende të rezervuara dhe të garantuara. Përveç standardit demokratik për miratimin e ligjeve me një shumicë të deputetëve që janë prezent dhe që votojnë, ky nen përcakton edhe një standard tjetër shtesë demokratik i cili ka të bëjë me komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Për miratimin e këtyre ligjeve me interes vital kërkohet që të ekzistojë krahas shumicës demokratike sa u tha më sipër, edhe shumica demokratike e pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë që në Kuvend mbajnë vende të rezervuara apo të garantuara. Ky nen më nuk gjen zbatim sepse është ezauruar rëndësia praktike e tij me mbylljen e pavarësisë së mbikëqyrur.⁹⁴⁰

Neni 150 [Procesi i Emërimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve]

- (1) Shqyrtimi gjithëpërfshirës mbarëkosovar për përshtatshmërinë e të gjithë kandidatëve për emërime të përhershme për gjyqtarë dhe prokurorë në Kosovë, deri në moshën e pensionimit të përcaktuar me ligj, do të vazhdojë të bëhet në pajtim me Urdhëresën Administrative 2008/2 dhe nuk do të ndikohet nga përfundimi i mandatit të UNMIK-ut, ose nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute.
- (2) Të gjithë kandidatët e suksesshëm, të cilët janë emëruar ose riemëruar për gjyqtarë dhe prokurorë nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, si pjesë e procesit të emërimit, do të vazhdojnë të shërbejnë në postet e tyre deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre, ose deri atëherë kur ata të shkarkohen në pajtim me ligjin.

⁹⁴⁰ Ky nen është fshirë me amendamentin 10 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I - XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës

- (3) **Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial do t'i paraqesë me shkrim Këshillit Gjyqësor të Kosovës rekomandimet për kandidatët për emërimin dhe riemërimin e tyre si gjyqtarë dhe prokurorë, i cili ushtron pushtetin përfundimtar, që t'ia propozojë Presidentit të Kosovës kandidatët për emërim dhe riemërim si gjyqtarë dhe prokurorë.**
- (4) **Të gjithë kandidatët e suksesshëm, të cilët janë emëruar ose riemëruar nga Presidenti i Kosovës si gjyqtarë dhe prokurorë, sipas propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si pjesë e procesit të emërimit, do të vazhdojnë të shërbejnë në këto poste deri në skadimin e natyrshëm të mandatit të tyre, ose deri atëherë kur ata të shkarkohen në pajtim me ligjin.**
- (5) **Pavarësisht nga dispozitat e nenit 105 të kësaj Kushtetute, mandati i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve që në mënyrë të suksesshme e kalojnë procesin e emërimit siç është përcaktuar në këtë nen dhe të cilët kanë ushtruar funksionin së paku dy vjet para emërimit, sipas këtij neni, është i përhershëm deri në moshën e pensionimit sikurse është përcaktuar më ligj, përveç nëse shkarkohen në pajtim me ligjin.**

Neni 150

1. Ky nen paraqitet si më i ndërlikuari në tërë korpusin e dispozitave kalimtare, pasojat e të cilit mund të zvarriten edhe një kohë të gjatë pas mbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur. Secili paragraf i këtij neni është tërësi në vete dhe duhet të shikohet i izoluar nga tjetri sepse si të ndarë rregullojnë secili prej tyre gjendje të caktuara juridike nga e kaluara që kanë qenë zvarrë ditën e nxjerrjes së Kushtetutës. Këto gjendje juridike mund të mbesin të tilla edhe për një kohë pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës.
2. Ky nen është fshirë me amendamentin 11 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I-XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Neni 150.1

1. Ky paragraf ka rregulluar vlefshmërinë e emërimeve të të gjithë prokurorëve të cilat janë kryer gjatë kohës së UNMIK-ut sipas Urdhëresës Administrative 2008/2.⁹⁴¹ Kjo nënkuptonte se qheshin legjitim dhe nuk mund të kontestoheshin, përveç rasteve ligjore, të gjithë ata gjyqtarë e prokurorë të cilët ishin emëruar nga administrata e misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK-ut.

⁹⁴¹ UNMIK Administrative Direction 2008/2 (Neni, paragrafi 11). Neni 2.13 i Urdhëresës Administrative 2008/2 saktëson se të gjithë kandidatët pa përjashtim duhet të kalojnë testin e Kodit të Etikës. Cf. edhe Raportin e Punës së Këshillit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, 29 tetor 2010, fq. 3.

Neni 150.2

1. Ky paragraf e bën edhe më të qartë paragrafin e sipërm sepse përcakton se përveç skadimit të mandatit të tyre apo shkarkimit sipas ligjit nuk mund të kontestohet në asnjë mënyrë vazhdimësia e punës së gjyqtarëve e prokurorëve të emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, si shef i UNMIK-ut.
2. Sikundër shihet dy paragrafë flasin vetëm për emërim, jo edhe për riemërim, nga shkakun se këtu flitet për gjeneratën e parë të gjyqtarëve e prokurorëve të emëruar nga administrata ndërkombëtare në Kosovë, UNMIK, pas 10 qershorit 1999.

Neni 150.3

1. Ky paragraf i referohet gjendjes së emërimeve dhe riemërimeve të cilat janë kryer nga ndërkombëtarët sipas përbërjes së përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 ka filluar një proces emërimi për të gjithë gjyqtarët e prokurorët. Në prill të vitit 2009, secili nga gjithsej 450 gjyqtarët e prokurorët e atëhershëm është dashur të riaplikojë për vendin e tij/saj të punës. Procesi i riemërimit ka qenë i hapur për të gjithë personat, jo vetëm ata gjyqtarë e prokurorë që ishin në mandat, të cilët përmbushnin kualifikimet për atë mandat. Rreth 898 persona hynë në atë proces. Ata që kanë hyrë, i janë nënshtruar një morie testesh, prej të cilave ka pasur edhe të tillë me natyrë eliminimi.⁹⁴² Një numër substancial, në fakt, më se 50% të gjyqtarëve dhe prokurorëve në punë, nuk i kaluan ato.⁹⁴³
2. Derisa gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë më herët janë emëruar nga institucionet ekzekutive të UNMIK-ut me kontrata afatshkurtra me mundësi vazhdimi, situatë kjo që ka çuar në kritika të shumta në vitin 2001 dhe 2002, sistemi në fjalë për të cilin flet ky paragraf i këtij neni tanimë të shfuqizuar, paraqiste një hap para në drejtim të duhur. Gjyqtarët tani rekrutoheshin dhe propozoheshin nga Këshilli

⁹⁴² Kjo nënkupton se baza ligjore e këtij procesi ka qenë e njëjtë, pra është bërë sipas Urdhëresës Administrative 2008/2. Megjithatë, ky proces dallon nga ai i kryer nga UNMIK-u sepse Këshilli Gjyqësor sipas Kushtetutës, përbërja e tij e përkohshme sipas nenit 151 të Kushtetutës, ishte akteri kyç në procesin e emërimit dhe riemërimit. Këshilli Gjyqësor sipas nenit 151 të Kushtetutës kishte në kompetencë emërimin ose riemërimin edhe të prokurorëve.

⁹⁴³ Janë shpallur 461 pozita të lira në fillim të procesit, 340 prej të cilave u plotësuan gjatë procesit. Cf. Raporti i Progresit të KE-së më 2010, f. 10: "Procesi i riemërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka përfunduar me sukses. Në të tri fazat, duke përfshirë Gjykatën Supreme, Gjykatat e Qarkut, Gjykatat Komunale, Zyrat e Prokurorëve gjegjëse, Gjykatat Ekonomike dhe Dhomën e Posaçme, Presidenti ka emëruar mbi 340 kandidatë. Sipas Raportit për punën e Këshillit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, "gjashtëdhjetë për qind të pozitive janë plotësuar me emra të rinj. Kjo paraqet një transformim madhor të sistemit gjyqësor në Kosovë." Cf. Raporti mbi Punën e Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës, 29 tetor 2010, fq. 1.

Gjyqësor i Kosovës dhe emërimi përfundimtar bëhej nga Presidenti i Kosovës. Këtu përfshiheshin edhe prokurorët.⁹⁴⁴

Neni 150.4

1. Ky paragraf përcakton se të gjithë kandidatët që janë emëruar apo riemëruar nga ana e Presidentit të Kosovës, që mund të përfshijë si ata që kanë qenë në punë gjatë kohës së UNMIK-ut ashtu dhe ata pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, do të vazhdojnë të kryejnë punët e njëjta si dhe më parë deri në skadim të mandatit të tyre që kanë mbajtur në momentin e shkrimit të kësaj dispozite, apo deri në shkarkimin e tyre eventual në bazë të ligjit.

Neni 150.5

1. Paragrafi i fundit është thelbi i vetë dispozitës kalimtare të këtij neni sepse plotëson nenin 105 të Kushtetutës që flet për mandatin dhe riemërimin e gjyqtarëve. Këtu fjala është vetëm për emërimet që janë kryer nga Presidenti i Kosovës, sipas propozimit të Këshillit Gjyqësor. Këto emërimet, të cilat janë bërë me ndërmjetësimin e ndërkombëtarëve, kanë përfshirë të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët të cilët janë emëruar me sukses sipas procedurave dhe kushteve nga paragrafi i tretë i këtij neni. Në rastet kur kanë qenë të suksesshëm dhe kanë ushtruar funksionin e gjyqtarit përkatësisht të prokurorit dy vjet para emërimit, sipas paragrafit të tretë të këtij neni, atëherë mandati i tyre është i përhershëm. Përfshirë nga kjo përbëjnë rastet e kandidatëve që kanë aplikuar dhe kanë qenë të suksesshëm vetëm në fazën sipas paragrafit të tretë të këtij neni. Në këtë rast, atëherë, këto dy vjet përvojë punë në funksion të gjyqtarit apo të prokurorit duhen nënkuptuar jo vetëm atë ushtrim funksioni në sistemin juridik sipas kushteve dhe procedurave të paracaktuara në paragrafët 1-3 të këtij neni, por edhe përvojën tjetër të punës, të kryer sipas kushteve dhe procedurave para 10 qershorit 1999. Në fakt, përvoja mbi dy vjet këtu në këtë paragraf ka qenë e lidhur ngushtë me suksesin e të gjithë kandidatëve në emërim për gjyqtarë dhe prokuror në fazën e fundit nga paragrafi i tretë, d.m.th. pas shpalljes së pavarësisë. Kjo duhet të kuptohet kështu sepse procesi në fjalë i emërimit ka qenë i hapur për të gjithë, si ata brenda ashtu edhe ata jashtë sistemit gjyqësor e prokurorial të kohës, dhe ka pasur për qëllim dhënien e mundësive të barabarta të gjithëve që janë kompetent dhe me integritet profesional e njerëzor për të ushtruar funksionin e gjyqtarit apo të prokurorit.

Neni 151 [Përbërja e Përkohshme e Këshillit Gjyqësor të Kosovës]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të përbëhet siç vijon:

⁹⁴⁴ Cf. më shumë për këtë në: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë (Janar 2012) 'Pavarësia e gjyqësorit në Kosovë: Dimensionet Institucionale dhe Funksionale'. Prishtinë.

- (1) Pesë (5) anëtarë janë anëtarë kosovarë të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, që janë verifikuar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, si pjesë e fazës së parë dhe të dytë të procesit të emërimit, në pajtim me Urdhëresën Administrative 2008/02. Prej këtyre pesë (5) anëtarëve, një (1) gjyqtar dhe një (1) prokuror të zgjedhur sipas metodës së rastësisë, do të shërbejnë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës deri në skadimin e natyrshëm të mandateve të tyre ekzistuese, kur do të zëvendësohen me një (1) gjyqtar dhe një (1) prokuror të verifikuar nga Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial dhe që janë zgjedhur nga ana e kolegëve të tyre, duke iu përmbajtur metodave që kanë për qëllim sigurimin e përfaqësimit sa më të gjerë të shërbimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë. Dy (2) gjyqtarët e mbetur dhe një (1) prokuror nga radhët e pesë (5) anëtarëve kosovarë të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial, do të shërbejnë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës për një mandat plotësues njëvjeçar pas skadimit të mandatit të tyre, kur ata do të zëvendësohen me procedurë të njëjtë sikur edhe ish-kolegët e tyre të Komisionit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Në rast të themelimit të një subjekti përgjegjës për çështjet e emërimit, disiplinës dhe shkarkimit të prokurorëve, të gjithë anëtarët e tjerë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të jenë gjyqtarë.
- (2) Tetë (8) anëtarët e tjerë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të zgjedhen nga Kuvendi i Kosovës në mënyrën e përcaktuar me këtë Kushtetutë, përveç dy (2) nga katër (4) anëtarët e zgjedhur nga deputetët e Kuvendit që mbajnë vende të fituara gjatë ndarjes së përgjithshme të vendeve, duhet të jenë ndërkombëtarë, të përzgjedhur nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil, sipas propozimit të Misionit Evropian për Politika të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Njëri nga anëtarët ndërkombëtarë duhet të jetë gjyqtar.

Neni 151

1. Ky nen ka rregulluar përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor e Prokurorial të Kosovës, sado që në titull flitet vetëm për “Përbërjen e Përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës”. Ky Këshill në këtë përbërje ka pasur kompetenca, *mutatis mutandis*, edhe sa i përket prokurorëve. Po të krahasohet dispozita e nenit 4 nga Aneksi IV (“Sistemi Gjyqësor”) i Propozimit Gjithëpërfshirës të 26 marsit 1007, atëherë mund të shihet qartë se fjala është për një ripërsëritje të një koncepti transitor që konsiston në krijimin e mekanizmave juridikë që mundësojnë realizimin e komponentës institucionale të sundimit të ligjit.
2. Neni ka pasur dy paragrafë të cilët kanë sanksionuar përbërjen trembëdhjetë (13) anëtarëshe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
3. Si i tillë është fshirë me amendamentin 12 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I-XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Neni 151.1

1. Ky paragraf ka parashikuar anëtarësimin në Këshill të njerëzve të profesionit. Më këtë paragraf përcaktohej se, përveç zgjedhjes së pesë (5) anëtarëve nga lëmi i profesionit gjyqësor apo prokurorial, Këshilli do të ushtrojë edhe funksione që kanë të bëjnë me prokurorët, emërimin dhe çdo gjë tjetër rreth punës së tyre.

Neni 151.2

1. Ky paragraf ka parashikuar mekanizmin për mbrojtjen dhe përfaqësimin e interesave të komuniteteve joshqiptare në Këshillin Gjyqësor. Këtu po ashtu parashihej edhe prezenca e anëtarëve të komunitetit ndërkombëtar, gjithnjë duke i dhënë Kuvendit të Kosovës një rol kyç në përzgjedhjen e tetë (8) kandidatëve për anëtar të Këshillit.

Neni 152 [Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare të zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të datës 26 mars 2007, Gjykata kushtetuese do të përbëhet si në vijim:

- (1) Gjashtë (6) nga nëntë (9) gjyqtarët emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës, me propozimin e Kuvendit.
- (2) Nga gjashtë (6) gjyqtarët, dy (2) do të shërbejnë për një mandat trevjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, dy (2) do të shërbejnë për një periudhë gjashtëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe dy (2) do të shërbejnë për një periudhë nëntëvjeçare, pa mundësi të rizgjedhjes. Mandatet e gjyqtarëve fillestarë do të zgjidhen me short, nga Presidenti i Republikës së Kosovës, menjëherë pas emërimit të tyre.
- (3) Nga gjashtë (6) gjyqtarët, katër (4) do të zgjidhen votat e dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe që votojnë. Dy (2) do të zgjidhen me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit, pas pëlqimit të shumicës së deputetëve të Kuvendit, të cilët mbajnë vendet që janë rezervuar ose garantuar për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë.
- (4) Tre (3) gjyqtarë ndërkombëtarë do të emërohen nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Tre (3) gjyqtarët nuk do të jenë qytetarë të Kosovës dhe as të ndonjë vendi fqinj.
- (5) Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil do të përcaktojë se kur skadon mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë, dhe gjyqtarët do të ndërrohen sikur është e parashikuar me Kushtetutë.

Neni 152

1. Ky nen ka folur për përbërjen e përkohshme të Gjykatës Kushtetuese dhe ka paraqitur operacionalizim të nenit 6 të Aneksit I të Propozimit Gjithëpërfshirës të datës 26 mars 2007⁹⁴⁵.
2. Ky nen ka pasur pesë paragrafë dhe është fshirë me amendamentin 13 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I - XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Neni 152.1

1. Ky paragraf ka theksuar faktin se gjashtë (6) gjyqtarë vendor emërohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Për këtë është folur më herët kur është bërë komentimi i kompetencave të Presidentit dhe për Gjykatën Kushtetuese.

Neni 152.2

1. Në praktikën e gjykatave kushtetuese në themelim në Evropë ekziston një përvojë e njëjtë me këtë që u pat sanksionuar nga ky paragraf. Në Itali, Gjermani, por edhe gjetiu në disa prej vendeve ish vendeve komuniste pas prishjes së komunizmit është bërë përzgjedhja me short e mandatit të gjyqtarëve të parë me qëllim që çdo tri vjet përkatësisht në periudha të caktuara të mëpastajme të sigurohej zgjedhja me qëllim të ruajtjes së kontinuitetit të gjyqtarëve tjerë në të ardhmen. Shkurt: ky paragraf flet për shortin si mjet që sigurimin e mandatit të parë tre, gjashtë dhe nëntë vjeçar të gjyqtarëve të parë të Gjykatës Kushtetuese. Kjo do të thotë se, në ndërkohë që Kuvendi voton për një mandat nëntë vjeçar të gjyqtarëve të parë të Gjykatës Kushtetuese, tërheqja e shortit nga ta e bën mandatin e tyre tri, gjashtë dhe nëntë vjet. Kjo dhe ka ndodhur me përbërjen 2009-2015 të Gjykatës Kushtetuese, ku dy gjyqtarët e parë patën një mandat tre vjeçar, dy tjerë tërhoqën shortin për gjashtë vjet, kurse dy tjerë për nëntë vjet. Të gjitha këto mandate nuk lejonin një mundësi rizgjedhjeje.
2. Sipas këtij paragrafi, ekzekutimi i kësaj detyre, pra i përcaktimit me short të mandatit të gjyqtarëve fillestar, i ka takuar Presidentit të Republikës.

⁹⁴⁵ Është interesant të vihet në dukje se Plani Gjithëpërfshirës e radhitë Gjykatën Kushtetuese në kuadër të sistemit të drejtësisë kosovare. Kjo qasje, e cila në Kushtetutë megjithatë nuk është reflektuar sepse Gjykata figuron menjëherë pas kapitullit që flet për sistemin e drejtësisë, paraqet një qasje që në doktrinë jo-rrellë është përkrahur. U mor vesh ka sisteme kushtetuese - juridike që e vejnë gjykatën kushtetuese në kuadër të sistemit gjyqësor por në përgjithësi doktrina kushtetuese pajtohet që gjykatat kushtetuese janë pushtet derivativ, përkatësisht pushtet i konstituuar ("pouvoir constitue"), i cili përgjigjet për punën e vet para Kushtetutës dhe qytetarit.

Neni 152.3

1. Ky paragraf ka folur për shumicën dyfish të kualifikuar të dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit. I pari kualifikim është i përgjithshëm dhe i referohet dy të tretave (2/3) të deputetëve të Kuvendit që janë prezent dhe votojnë, kurse i dyti kualifikim ka të bëjë me dy të tretat (2/3) e votave të deputetëve që kanë vende të rezervuara dhe të garantuara në Kuvend.

Neni 152.4

1. Ky paragraf ka diskutuar mënyrën e emërimit të gjyqtarëve ndërkombëtarë. Deri sa Kushtetuta ka folur përmes këtij paragrafi për emërimin e gjyqtarëve ndërkombëtar nga ana e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Plani Gjithëpërfshirës i datës 26 maj 2007 fliste për procesin e kundër të emërimit, pra për emërimin e tyre nga ana e Kryetarit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut pas këshillimit me Përfaqësuesin Civil Ndërkombëtar.⁹⁴⁶ Sidoqoftë, emërimi i tyre u bë nga ana e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar. Fjala konsultim ishte përdorur për shkak se nuk ka qenë e sigurt asnjëherë se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut do të pajtohej të involvohej në këtë proces, në një kohë që Kosova nuk ishte anëtare e Këshillit të Evropës dhe akoma kishte rezistencë nga Serbia dhe aleatët e saj për çfarëdo anëtarësimi të Kosovës në strukturat evropiane. Ajo çka ka rëndësi këtu është se gjyqtarët ndërkombëtarë nuk guxonin të ishin nga asnjë vend fqinj me Kosovën e as qytetarë të saj që eventualisht mund të kishin edhe shtetësi tjetër.

Neni 152.5

1. Me këtë paragraf mbyllet çështja e tranzicionit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këtu përcaktohet se mandatin e tyre e përcakton Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, gjë që nënkupton se ata nuk i nënshtrohen shortit si mënyrë e përcaktimit të kohëzgjatjes së mandatit të tyre. Aktualisht, siç dihet, në Gjykatën Kushtetuese janë tre gjyqtarë ndërkombëtar, një nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjyqtari Rober Carolin, një nga Bullgaria, gjyqtarja Snezhana Botoshrova, dhe një nga Portugalia, gjyqtari Almiro Rodriguez. Këta gjyqtarë kanë të siguar mbështetjen financiare deri në verën e vitit 2014 kurse emërimi i tyre i bërë nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar pak ditë para se të mbyllej pavarësia e mbikëqyrur e Kosovës është bërë për kohën sa të këtë mjete financiare të mbështetjes së tyre. Kjo do të thotë se mandati i gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese është i kushtëzuar me mbështetjen financiare të punës së tyre dhe mund të zgjatë aq sa zgjatë mandati i plotë i një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese që nuk i nënshtrohet shortit, pra një mandati nëntë (9) vjeçar.

⁹⁴⁶ Cf. Neni 6.1.3 (“Gjykata Kushtetuese dhe Sistemi i Drejtësisë”) i Aneksit I të Propozimit Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës të datës 26 maj 2007.

Neni 153 [Prania Ndërkombëtare Ushtarake]

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj Kushtetute, Prania Ndërkombëtare Ushtarake ka mandatin dhe kompetencat e përcaktuara nga instrumentet relevante ndërkombëtare, duke përfshirë Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007. Kryesuesi i Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake, në pajtim me Propozimin Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, është autoriteti final në zonën operative për sa i përket interpretimit të atyre aspekteve të marrëveshjes së përmendur që i referohen Pranisë Ndërkombëtare Ushtarake. Asnjë autoritet i Republikës së Kosovës nuk ka juridiksion të rishikojë, të pakësojë ose përndryshe të kufizojë mandatin, kompetencat dhe detyrimet e referuara në këtë nen.

Neni 153

1. Ky nen nuk ka pasur asnjë paragraf dhe është fshirë me amendamentin 14 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I - XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.
2. Shikuar nga rëndësia e tij strategjike, ky nen ka pasur një peshë të madhe sepse ka ndërprerë legjitimitetin e pranisë ushtarake ndërkombëtare të bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.⁹⁴⁷ Përveç kësaj, ky nen ka përcaktuar se Kosova dhe Forca e Sigurisë do të jenë në mënyrë graduale struktura e re ushtarake e Kosovës, Ushtria e Kosovës, mirëpo vetëm pasi FSK (Forca e Sigurisë së Kosovës) të ketë përmbushur kriteret që kërkohen nga strukturat veriatlantike civilo-ushtarake. U mor vesh, ky nen ka njohur fuqinë juridike të dokumenteve tjera ndërkombëtare relevante, duke përfshirë këtu edhe Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Kjo është kështu në veçanti për sa i përket privilegjeve dhe imuniteteve të pranisë ushtarake në Kosovës, e njohur si KFOR (“Kosovo Force”).
3. Ndryshimi i statusit të tanishëm të pranisë ushtarake në Kosovë mund të bëhet vetëm në bazë të marrëveshjeve bilaterale të lidhura në mes të Kosovës dhe vendeve apo organizatave të ndryshme ushtarake në bazë të partneritetit dhe barazisë reciproke. Marrëveshjet e tilla njihen si SOFA (“Status of Forces Agreement”) dhe zakonisht parashohin privilegje e imunitete të cilat për nga natyra kanë ekzistuar në Kosovë sipas Rezolutës 1244 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.⁹⁴⁸ Deri më tani marrëveshje të tillë Kosova ka lidhur vetëm me SHBA.⁹⁴⁹

⁹⁴⁷ Çdo interpretim i këtij neni, sot dhe në të ardhmen, duhet të bëhet në lidhje me dispozitat e neneve 1-2 të Aneksit XI të Propozimit Gjithëpërfshirës të datës 26 maj 2007 (“Prania Ushtarake Ndërkombëtare”).

⁹⁴⁸ Cf. më shumë për SOFA, historikun, kuptimin, formën dhe përmbajtjen e tyre në studimin gjithëpërfshirës Fleck, Dieter (ed. 2001) ‘The Handbook of The Law of Visiting Forces’.

4. Operimi i mëtejshëm i pranisë së huaj ushtarake në Kosovë bazohet në vendimin e njëanshëm të Kosovës të shprehur në pikën 5 të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës të 17 shkurtit 2008 me të cilën kërkohet dhe mirëpritet prania e tillë ushtarake në Kosovë deri në aftësimin e Kosovës për kryerjen e detyrave të tilla ushtarake si dhe anëtarësimin e Kosovës në Paktin e Atlantikut të Veriut (“NATO”).⁹⁵⁰

Neni 154 [Trupat e Mbrojtjes të Kosovës]

Trupat e Mbrojtjes të Kosovës do të shpërbëhen brenda një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute. Deri në shpërbërje, Prania Ndërkombëtare Ushtarake, në konsultim me Përfaqësuesin Ndërkombëtarë Civil dhe Republikën e Kosovës do të ketë autoritet ekzekutiv mbi Trupat e Mbrojtjes të Kosovës dhe vendos për dinamikën kohore të shpërndarjes.

Neni 154

1. Ky nen pa asnjë paragraf është fshirë me amendamentin 15 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I - XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.
2. Neni flet për ish Trupat e Mbrojtjes së Kosovës (“TMK”) dhe transformimin e tyre në FSK (“Forca e Sigurisë së Kosovës”). Koha e kryerjes së transformimit ka qenë një vit nga hyrja në fuqi e Kushtetutës. Vështirë se ky nen mund të jetë pjesë e ndonjë kontrolli gjyqësor në të ardhmen. Kjo nënkupton se ky nen ka rëndësi historike dhe mund të riaktualizohet si *travaux preparatoires* vetëm në rastin e ngritjes së çështjeve të pranisë ushtarake, të formës dhe strukturës së tyre, në të ardhmen në formë të ndonjë propozim amendamenti kushtetues.

Oxford: Oxford University Press: Oxford, në veçanti fq. 3- 47.

⁹⁴⁹ Marrëveshja për Statusin e Forcave në mes të SHBA-ve dhe Kosovës është nënshkruar më 18 shkurt 2012 në Prishtinë. Cf. *Signing of Status of Forces Agreement between The United States of America and The Republic of Kosovo*. US Embassy in Pristina, Kosovo (February 18, 2012) (Në internet: http://pristina.usembassy.gov/sofa_eng_0218_20122012.html)

⁹⁵⁰ Deklarata e Pavarësisë së Kosovës, datë 17 shkurt 2008, pika 5. Ne mirëpresim mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin tonë demokratik nëpërmjet të pranive ndërkombëtare të themeluara në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999). Ne ftojmë dhe mirëpresim një prani ndërkombëtare civile për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të Ahtisaarit dhe një mision të sundimit të ligjit të udhëhequr nga Bashkimi Evropian. Ne, po ashtu, ftojmë dhe mirëpresim NATO-n që të mbajë rolin udhëheqës në praninë ndërkombëtare ushtarake dhe të zbatojë përgjegjësitë që i janë dhënë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) dhe Planit të Ahtisaarit, deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës do të jenë në gjendje të marrin këto përgjegjësi. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me këto prani në Kosovë për të siguruar paqen, prosperitetin dhe stabilitetin në të ardhmen në Kosovë”.

Neni 155 [Shtetësia]

- (1) Të gjithë banorët e ligjshëm të Kosovës në datën e miratimit të kësaj Kushtetute, gëzojnë të drejtën e shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- (2) Republika e Kosovës ua njeh të drejtën në shtetësinë e Republikës së Kosovës, pavarësisht nga vendbanimi i tyre i tanishëm dhe shtetësia që ata kanë, të gjithë qytetarëve të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë, të cilët kanë qenë banorë të përhershëm të Kosovës me datën 1 janar 1998, dhe pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë.

Neni 155

1. Ky nen që ka vetëm dy paragrafë, ka vlerë universale. Me amendamentet e sipërcekura ka ndodhë vetëm zhvendosja e tij në Kapitullin I - Dispozitat Themelore, mirëpo, sikur me rastin e disa neneve të cekura më herët, nuk tregohet se ku, pas cilit nen në Kapitullin I - Dispozitat Themelore duhet të vihet tani e tutje (sic!).
2. Me këtë nen normohet çështja e shtetësisë në territorin e Kosovës si për kohën e administrimit ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara në kuadër të UNMIK-ut, ashtu dhe për kohën para fillimit të luftës së hapur në Kosovë në pranverë të vitit 1998.⁹⁵¹

Neni 155.1

1. Ky paragraf merret me çështjet e rregullimit të materies së shtetësisë në territorin e Kosovës për kohën pas mbarimit të luftës së fundit më 10 qershor 1999 e deri me shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008. Sikundër shihet, këtu është përdorur fjala “banorët e ligjshëm” të Kosovës në datën e miratimit të Kushtetutës së Kosovës më 9 prill 2008.
2. Kategoria “banor i ligjshëm” i Kosovës duhet të gjykohet sipas standardeve ligjore në fuqi ditën e miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës më 9 prill 2008. Në këtë ditë kanë qenë në fuqi normat e UNMIK-ut të përmbajtura në Rregulloren 200/13 mbi Regjistrin Qendror Civil të 17 marsit 2000 dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 200/8 i datës 27 prill 2008 mbi Implementimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 200/13 mbi Regjistrin Qendror Civil. Sipas këtyre dy normativave, në Kosovë në këtë kohë nuk ka pasur shtetësi, përkatësisht shtetësia e vlefshme deri në atë kohë ka qenë ajo e ish Jugosllavisë, përkatësisht e Republikës së Serbisë. Kjo nënkupton se UNMIK-u, sipas të drejtës ndërkombëtare, ka suspenduar ushtrimin e sovranitetit jugosllav, përkatësisht serb mbi Kosovën por jo edhe të gjitha atributet e tij formale. Ndër këto attribute bëjnë pjesë edhe shtetësia.

⁹⁵¹ Për një trajtim të hollësishëm të çështjes së shtetësisë në territorin e ish Jugosllavisë, duke përfshirë këtu Kosovën, Cf. më shumë në Krasniqi, Gëzim (2010) ‘The challenge of building an independent citizenship Regime in a partially recognized state: the case of Kosovo’. Working Paper no. 2010/04, Edinburgh: Scotland, 2010.

Për këtë arsye, këto dy normativa të UNMIK-ut përdorin termin “banor rezident i Kosovës” si parakusht për lëshimin e dokumenteve të identifikimit, atyre të udhëtimit si dhe dokumenteve tjera personale.⁹⁵²

Neni 155.2

1. Ky paragraf, i cili më tutje është operacionalizuar me nenin 29.1 të Ligjit Nr. 03/L-034 për Shtetësinë e Kosovës, datë 20 shkurt 2008, në fakt paraqet një standard pak a shumë ndërkombëtar rreth fitimit të shtetësisë në vendet e sapokrijuara.⁹⁵³ Edhe në vendet e krijuara nga shpërbërja e ish Jugosllavisë është marrë parasysh një datë e caktuar si pikë referimi për njohjen, fitimin dhe humbjen e shtetësisë. Esenca e tërë materies së shtetësisë në rastet e krijimit të shteteve të reja nga rrënojat e një shteti tjetër qëndrojnë atë që sa më pak të ketë persona pa shtetësi, përkatësisht që të mos ketë diskriminim të personave në njohjen, fitimin, dhe humbjen e shtetësisë. Për këtë qëllim, në të drejtën ndërkombëtare, e cila reflektohet në tërësi në Konventën e Këshillit të Evropës mbi Shtetësinë, njihet krahas diskrecionit të shteteve në këtë materie edhe detyrimi i tyre që të marrin parasysh këto rrethana me rastin e caktimit të shtetësisë së shtetit të ri: a) lidhja efektive dhe e vërtetë me shtetin e ri; b) rezidenca e përhershme; c) dëshira e personit; dhe c) origjina territoriale të atyre që kërkojnë shtetësi të shtetit të ri.⁹⁵⁴
2. Pse data 1 janar 1998 në rastin e Kosovës? Ka dy arsye për këtë. Në rend të parë, kjo ka të bëjë me faktin se në atë vit pat filluar lufta e armatosur në Kosovë, e cila është cilësuar si konflikt i armatosur në prill të vitit 1988 nga David Bluvit, atëbotë nënkryetar i Gjykatës së Hagës për Krimet e Kryera në Ish Jugosllavi (e njohur si Gjykata e Hagës). Ky kualifikim është bërë për qëllimet e vënies në jetë të normave mbi të drejtën ndërkombëtare humanitare, gjë që këtu nuk ka rëndësi. Arsyeja e dytë ka të bëjë më faktin se e njëjta datë është marrë si bazë edhe nga autoritetet ndërkombëtare të UNMIK-ut.⁹⁵⁵

⁹⁵² Sipas Seksionit 3 (“Banor Rezident i Kosovës”) të kësaj Rregulloreje si banorë rezident të Kosovës quheshin: a) personat që kanë lindur në Kosovë nga njëri prind i lindur në Kosovë; b) personat që mund të provojnë se kanë jetuar në Kosovë pesë vite pa ndërprerë; dhe c) personat që kanë qenë të detyruar për ta lënë Kosovën dhe, për pasojë, nuk mund ta plotësojnë kushtin nën b., apo fëmijët nën moshën 18 vjeçare të personave nën a. dhe nën b., apo edhe nën moshën 23 vjeçare por që kanë qenë në ndonjë shkollim me orar të plotë në një institucion kosovar të njohur të arsimit.

⁹⁵³ Për trashëgiminë në çështjet e shtetësisë në territorin e ish Jugosllavisë dhe mënyrën si u mbyll kjo çështje në mes të ish republikave jugosllave, Cf. më shumë në Hasani, Enver (2006) ‘The Evolution of the Succession Process in Former Yugoslavia’. *Thomas Jefferson Law Review*. Vol. 29(1).

⁹⁵⁴ Konventa Evropiane për Shtetësinë (Strasburg, 6 nëntor 1997). Neni 18. 2 (“Trashëgimi i Shteteve në Shtetësi”) (Ne internet: <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/166.htm>).

⁹⁵⁵ Kështu, seksioni 9.2 (a) i Udhëzimit Administrativ Nr. 200/8 i datës 27 prill 2008 mbi Implementimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 200/13 mbi Regjistrin Qendror Civil i referohet seksionit 7.1 dhe 7.2 të Rregullores së UNMIK-ut mbi Themelimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të datës 18 prill 2000, i cili përdor datën 1 janar 1998 si pikë referimi për votim pa marrë parasysh banimin aktual në ditën e nxjerrjes së këtyre dy rregulloreve të UNMIK-ut.

Neni 156 [Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit]

Republika e Kosovës promovon dhe lehtëson kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit, dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave dhe posedimeve të tyre.

Neni 156

1. Edhe ky nen është bartur në një pjesë tjetër të Kushtetutës, në Kapitullin II, pa përcaktuar se pas cilit nen në këtë kapitull (sic!). Më këtë nen vihet në spikamë detyrimi i Republikës së Kosovës për të ndihmuar në dy mënyra kthimin e sigurt dhe me dinjitet të refugjatëve dhe të personave tjerë të zhvendosur brenda vendit, përfshirë këtu kthimin e pronës dhe posedimeve të tyre. Mënyra e parë ka të bëjë me promovimin që autoritetet publike duhet t'i bëjnë këtij detyrimi ashtu që të krijohet një ambient i sigurt për kthim. E dyta mënyrë i referohet krijimit të lehtësirave substanciale nga ana e autoriteteve të Kosovës për rikthim të të gjithëve të cilët janë detyruar ta lëshojnë Kosovës si pasojë e luftës dhe e dhunës së tepërt të përdorur në Kosovë pas dhe para 10 qershorit 1999.
2. Bazuar në sa u tha më sipër, Gjykata Kushtetuese ka deklaruar si antikushtetues amendamentin 17 të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si pjesë e amendamenteve të cilat kanë mbyllur epokën e pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës, amendamenti i cili mëtonte fshirjen e këtij neni të Kushtetutës. Me këtë rast, Gjykata ka gjetur se fshirja e tij do të cenonte të drejtat kushtetuese të garantuara edhe me dokumente ndërkombëtare të cilat Kosova ka detyrim pozitiv që t'i zbatoj deri në fund, siç janë në veçanti e drejta e lëvizjes dhe e drejta e pronës.⁹⁵⁶

Neni 157 [Auditori i Përgjithshëm i Kosovës]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, Revizori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës do të jetë një ndërkombëtar i emëruar nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil.

Neni 157

1. Ky nen pa asnjë paragraf është fshirë me amendamentin 18 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I-XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

⁹⁵⁶ Cf. Rasti K038/12. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Propozimeve të Qeverisë për Amendamentimin e Kushtetutës, të dorëzuar nga kryetari i Kuvendit të Republikës me 12 prill 2012 (Nr. Ref.:K 234 /12 me 15 maj 2012), Paragrafët 80-93.

2. Mandati i Auditorit të Përgjithshëm që është ndërkombëtar vazhdon deri në mbarim të mandatit të dhënë nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar pak ditë para mbarimit të mandatit të këtij të fundit në Kosovë më 7 shtator 2012. E njëjta, siç u cek më herët, ka vlejtur edhe për gjyqtarët ndërkombëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Në rastin e Auditorit, njëjtë si në rastin e Gjykatës Kushtetuese, nuk ekziston një mandat i kufizuar në mënyrë specifike i tyre: në dy rastet, siç u tha më sipër, Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar këtë mandat e ka kushtëzuar me pasjen e fondeve për financim të tyre, jo me kohë specifike siç ka bërë me të gjitha emërimet tjera. Këtu, megjithatë, ka një dallim në mes të Auditorit të Përgjithshëm dhe anëtarëve ndërkombëtar të Gjykatës Kushtetuese, gjithnjë në planin doktrinar, sado që baza kushtetuese për krejt prezencën ndërkombëtare është e njëjtë.⁹⁵⁷ Ai dallim buron nga fakti se Auditori i Përgjithshëm është pjesë e pushtetit administrativë në kuptim të gjerë të fjalës dhe i nënshtrohet rregullave të kushtetutshmërisë e të ligjshmërisë që vlejné për institucionet e agjencitë e shtetit administrativ.

Neni 158 [Autoriteti Qendror Bankar]

Deri në fund të mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe zbatimit të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës do të emërohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, pas marrjes së pëlqimit nga Përfaqësuesi Ndërkombëtarë Civil.

Neni 158

1. Ky nen, gjithashtu pa asnjë paragraf, është fshirë me amendamentin 19 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I - XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Ajo çka u tha për Auditorin e Përgjithshëm vlen, *mutatis mutandis*, edhe për Autoritetin Qendror Bankar, me një dallim. Në rastin e parë, mandati vijon deri në fund-verën e vitit 2014 dhe më tutje në vartësi të sigurimit të fondeve për këtë, në ndërkohë që në rastin që diskutohet këtu ky mandat është mbyllur më 14 mars të vitit 2013 kur Kuvendi i Kosovës zgjodhi guvernatorin e ri të Bankës Qendrore të Kosovës.⁹⁵⁸

Neni 159 [Pronat dhe Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore]

(1) Të gjitha ndërmarrjet që ishin në tërësi ose pjesërisht në pronësi shoqërore, para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të privatizohen në pajtim me ligj.

⁹⁵⁷ Cf. Amendamenti 22 i cili ka krijuar nenin e ri 61 si një dispozitë të re themelore, i cili diskutohet më poshtë.

⁹⁵⁸ *Radio Evropa e Lirë*, datë 14 mars 2013. Në internet: <http://www.evropalire.org/content/article/24928887.html>

(2) Të gjitha interesat në pronësi shoqërore në prona dhe ndërmarrje në Kosovë do të jenë në pronësi të Republikës së Kosovës.

Neni 159

1. Ky nen, me dy paragrafë, është fshirë me amendamentin 20 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I-XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.
2. Duhet të theksohet se radhitja e dy paragrafëve të mësipërm është e gabuar dhe e çuditshme sepse në paragrafin e parë flet për privatizimin e ish ndërmarrjeve shoqërore, kurse në të dytin flet për kalimin në pronësi shoqërore të këtyre ndërmarrjeve pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës me datën e caktuar. Është dashur të jetë radhitja e kundërt, pra që në fillim të konstatohet se *per constitutionem* kalon në pronësi të Republikës e tërë prona shoqërore e cila akoma nuk ka qenë e privatizuar ditën e hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe vetëm pas kësaj të tregohet se procesi i privatizimit vazhdon sipas ligjeve dhe normativës tjetër kosovare, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe jo nga autoritetet ndërkombëtare. Këtu në rend të parë e kemi fjalën për Ligjin Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 21 majit 2008, të cilin Dhoma e Posaçme pranë Gjykatës Supreme e konsideronte si një rregullore të brendshme, jo si një ligj të një shteti sovran dhe të pavarur. Ky kontestim përbën esencën e rastit të njohur si “rasti i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), i vendosur meritorisht nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Parashtrues i kërkesës në Gjykatë kishte qenë vetë AKP-ja e cila pretendonte se Dhoma e Posaçme po cenonte të drejtat e saj kushtetuese.⁹⁵⁹ Dhoma e posaçme, përveç kësaj, e kishte vënë në dyshim të drejtën e AKP-së për të vazhduar procesin e privatizimit të ish ndërmarrjeve shoqërore, të nisur nga ndërkombëtarët pas datës 10 qershor 1999. Esenca e këtij vendimi është diskutuar gjerësisht në komentet tona me nenin 145.2. Prandaj, këtu nuk e shohim të arsyeshme të ndalemi më tepër.

⁹⁵⁹ Parashtruesi pretendonte, në veçanti se vendimi i lartpërmendur i Dhomës së Posaçme, që ishte objekt i vlerësimit të kushtetutshmërisë në Gjykatë, ka shkelur nenin 3.2 (Barazia para Ligjit); 31.2 dhe 3 (e Drejta për Gjykim të Drejtë e të Paanshëm); 54 (Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave); 102.1 dhe 4 (Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor); 112.2 (Parimet e Përgjithshme); 116.3 (Efekti Juridik i Vendimeve); 143 (Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës); 145.2 (Vazhdimësia e Marrëveshjeve Ndërkombëtare dhe Legjislacionit të Aplikuësëm) të Kushtetutës si dhe neni 13 (e Drejta për mjete efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ). Cf. Aktgjykimi në rastin Nr. KI 25/10. Parashtruesi i kërkesës: Agjencia Kosovare e Privatizimit. Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC 09—89, të 4 shkurtit 2010.

Neni 160 [Ndërmarrjet në Pronësi Publike]

- (1) Republika e Kosovës do t'i ketë në pronësi të vet të gjitha ndërmarrjet në Republikën e Kosovës që janë ndërmarrje në pronësi publike. Të gjitha obligimet që kanë të bëjnë me këto të drejta pronësore do të jenë obligime të Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës mund të privatizojë, të japë me koncesion ose të japë me qira ndërmarrjet në pronësi publike në mënyrën e rregulluar me ligj.
- (2) Të drejtat e pronësisë, që kanë të bëjnë me një ndërmarrje në pronësi publike e cila ofron shërbime vetëm në një komunë specifike ose në një numër të kufizuar të komunave, do të jenë të drejta pronësore të komunës ose komunave përkatëse. Obligimet në lidhje me të drejtat e tilla pronësore do të jenë obligime të komunës ose komunave përkatëse. Kuvendi mundet me ligj të identifikojë një ndërmarrje të tillë dhe komunën a komunat, që kanë të drejta pronësore dhe obligimet lidhur me to. Nëse përcaktohet me ligj, komuna a komunat përkatëse, ndërmarrjet në pronësi shoqërore mund t'i privatizojnë, t'i japin me koncesion ose t'i lëshojnë me qira.

Neni 160

1. Ky nen, me dy paragrafë, është fshirë me amendamentin 21 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I-XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.
2. Esenca e këtij neni konsiston në dy çështje. E para, me paragrafin një të këtij neni përcaktohet se prona publike është lloji primar i pronës republikane. Kjo nënkupton se prona publike, e administruar deri në ditën e pavarësisë nga ana e autoritetit ndërkombëtar UNMIK, kalon në pronë republikane e cila rregullohet me ligj të veçantë.⁹⁶⁰ Çështja e dytë ka të bëjë me atë se paragrafi në vijim i këtij neni i jep definim kushtetues pronës publike e cila mbetet në pronësi të një apo më shumë komune, me të drejta e detyrime për privatizim, dhënie me koncesion dhe qira njëjtë si kur është fjala për pronën publike republikane. Pra, me këtë paragraf bëhet barazimi i komunës apo i komunave që kanë ndërmarrje në pronësi publike me Republikën, gjithnjë kur flitet për privatizimin eventual të tyre, dhënien me koncesion apo me qira. Kjo qasje është në frymën e liberalizmit ekonomik dhe të pronës të proklamuar nga Kushtetuta në dispozitat mbi marrëdhëniet ekonomike, të cilat tanimë i kemi komentuar gjerësisht.

⁹⁶⁰ Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i datës 15 qershor 2008, me ndryshimet dhe plotësimet e datës 20 prill 2012 (Ligji Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimet e datës 20 prill 2012).

Neni 161 [Transicioni i Institucioneve]

- (1) Me përjashtim të rastet kur Kushtetuta përcakton një transicion tjetër, të gjitha kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrimet e institucioneve të përcaktuara me këtë Kushtetutë, do t'u kalojnë menjëherë atyre institucioneve në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute. Kohëzgjatja e mandatit të secilit institucion para hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, do të mbetet e paprekur dhe e pandryshuar deri në skadimin e rregullt, ose deri në zgjedhjet e reja.
- (2) Deri në zgjedhjet e para parlamentare pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, Kryesia e Kuvendit mbetet me kompetencat e parapara në mandatin e saj ekzistues. Pas seancës konstituive të Kuvendit të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute, Kryesia e Kuvendit ristrukturohet në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute.
- (3) Dispozitat e nenit 70.3.(3) nuk do të aplikohen deri në seancën konstituive të Kuvendit pas zgjedhjeve të para parlamentare pas hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute.
- (4) Deri në formimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, funksionet dhe përgjegjësitë e tij do të kryejë Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Neni 161

1. Ky nen, me katër paragrafë, është fshirë me amendamentin 22 të datës 7 shtator 2012, i cili ka qenë pjesë e amendamenteve I-XXII lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, dhe është zëvendësuar me një nen të ri me numër të njëjtë, por të titulluar si “dispozitë kalimtare”. Ky nen u komentua gjerësisht më sipër ashtu që këtu vetëm mbetet të thuhet se paragrafët 2, 3 dhe 4 janë vënë në jetë tanimë dhe nuk mund të prodhojnë ndonjë çështje kushtetuese, qoftë edhe në formën e një analize të tyre si travaux preparatoires sepse kanë qenë rregulla krejt teknike me një zbatim të ngushtë kohor, hapësinor e institucional. Sa i përket paragrafit të parë, këtu tanimë është sqaruar se mandati është i kufizuar deri në fundverën e vitit 2014 për të gjithë autoritetet ndërkombëtare civile që janë të pranishme nëpër institucionet kosovare, përveç rastit të gjyqtarëve ndërkombëtarë në Gjykatën Kushtetuese dhe Auditorit të Përgjithshëm. Kjo nënkupton se tranzicioni i institucioneve, i cili fillimisht është paraparë me nenin e vjetër 161 ndodhë *per constitutionem* vetëm në fundverën e vitit 2014 kurse për Gjykatën Kushtetuese (dhe në teori edhe për Auditorin e Përgjithshëm) duhet të vendosë vetë ajo për modalitetet e këtij tranzicioni sepse, ndryshe, mund të vijë deri te humbja e kuorumit për punë dhe, për pasojë, deri të mbyllja efektive e Gjykatës Kushtetuese.

Neni 162 [Hyrja në Fuqi]

Kushtetuta e Republikës së Kosovës hyn në fuqi më 15 qershor 2008.

Indeksi

- Aktgjykim, 55, 84, 104, 123, 432, 434, 436, 443, 447, 467, 469, 526, 614, 626, 654, 657, 663, 665, 670, 680, 683, 702, 741, 765
- Autorizimi i kryeministrit, 502
- Avokati i Popullit, 23, 262, 401, 590, 636, 639, 642, 683, 734, 737, 738, 739, 740, 741, 743, 744
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, 60, 750
- Betimi, 464
- Deklarata e Budapestit, 600
- Demokracia, 24, 324, 435, 622, 623
- Demokracia kushtetuese, 622, 623
- Departamenti, 585, 586
- Deputetët e Kuvendit, 319, 327, 367, 369, 462
- Dispozita, 18, 27, 94, 116, 128, 149, 184, 243, 327, 573, 758
- E drejta e vetëqeverisjes, 695
- E drejta për qasje, 544, 546
- Emërimi i gjyqtarëve, 536
- Funksioni ekzekutiv i qeverisë, 476
- GjEDNJ, 589, 590, 634
- Gjykata e Hagës për Ish Jugosllavi, 468
- Gjykata Kushtetuese, 7, 23, 29, 55, 57, 84, 102, 123, 124, 134, 137, 178, 186, 227, 232, 237, 245, 295, 297, 300, 329, 435, 438, 441, 442, 445, 446, 447, 454, 459, 460, 464, 467, 470, 471, 472, 483, 486, 489, 491, 492, 501, 503, 511, 522, 525, 526, 529, 531, 534, 535, 536, 541, 545, 550, 570, 591, 608, 614, 618, 628, 629, 630, 633, 634, 635, 636, 637, 639, 643, 646, 647, 650, 651, 652, 653, 654, 656, 657, 658, 660, 661, 662, 663, 665, 668, 670, 671, 675, 676, 678, 680, 683, 693, 695, 698, 702, 703, 706, 718, 738, 741, 756, 761, 762, 765, 768, 769, 770, 782, 788, 791
- Gjykata Supreme, 33, 234, 236, 491, 541, 542, 555, 557, 565, 621, 626, 639, 670
- Gjykatë Kushtetuese, 671
- Imuniteti, 327, 369, 371, 372, 373, 374, 375, 376, 381, 467, 519, 568, 679
- Interesi publik, 192
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës, 236, 560, 566, 568, 571, 572, 776, 778, 793
- Këshilli i Evropës, 105, 108, 179, 199, 542
- Këshilli i Sigurisë së Kosovës, 732
- Këshilli Konsultativ për Komunitete, 263, 279, 451
- Këshilli Prokurorial, 614, 615
- Këshillit Konsultativ të Gjykatësve Evropian, 540
- Kodi Penal, 563
- Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës, 437
- Komisioni i Venedikut, 465, 536, 540, 588, 590, 591, 592, 593, 597, 603, 606, 607, 608, 610, 613, 655
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 300, 301, 302, 323, 337, 748, 749, 750
- Komiteti për të Drejta të Njeriut, 542
- Kryeministri, 36, 78, 82, 84, 88, 317, 353, 407, 424, 480, 496, 505, 507, 513, 517, 521, 522, 717, 720, 721, 723, 724, 773
- Kryeprokurori i Shtetit, 579
- Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, 572
- Kushtetutë, 1, 3, 5, 6, 7, 8, 13, 14, 15, 19, 21, 22, 24, 28, 30, 33, 35, 37, 38, 43, 46, 54, 55, 59, 65, 71, 72, 76, 82, 87, 92, 93, 94, 95, 97, 98, 104, 108, 110, 114, 116, 117, 119, 121, 124, 125, 127, 128, 130, 136, 140, 141, 145, 146, 155, 156, 157, 159, 163, 164, 167, 169, 170, 171, 174, 176, 177, 178, 183, 185, 186, 187, 191, 193, 197, 199, 203, 208, 212, 220, 227, 229, 230, 231, 232, 237, 239, 240, 241, 242, 243, 244, 246, 249, 263, 264, 267, 268, 269, 270, 271, 272, 273, 275, 277, 278, 279, 281, 282, 284, 289, 292, 293, 294, 295,

296, 298, 300, 302, 306, 307, 309,
 310, 311, 312, 313, 314, 315, 319,
 329, 330, 332, 336, 340, 341, 342,
 344, 346, 347, 361, 362, 367, 376,
 378, 379, 380, 401, 402, 405, 409,
 410, 412, 413, 414, 416, 417, 419,
 420, 421, 437, 438, 445, 447, 457,
 464, 465, 468, 480, 489, 496, 501,
 503, 506, 517, 522, 529, 531, 555,
 558, 565, 616, 636, 638, 654, 664,
 668, 681, 696, 698, 707, 708, 717,
 724, 726, 728, 729, 740, 745, 750,
 756, 757, 759, 769, 778, 780, 781,
 793
 Kuvendi i Kosovës, 12, 43, 56, 67,
 224, 264, 298, 299, 302, 305, 314,
 319, 332, 384, 387, 421, 432, 470,
 480, 484, 636, 639, 646, 717, 720,
 724, 730, 732, 738, 739, 743, 746,
 753, 763, 765, 773, 778, 790
 Ligji, 1, 14, 22, 40, 41, 43, 55, 56, 57,
 60, 62, 63, 64, 65, 67, 68, 89, 128,
 137, 146, 149, 154, 157, 161, 164,
 165, 166, 172, 176, 177, 183, 184,
 185, 186, 187, 194, 195, 200, 201,
 207, 213, 214, 218, 219, 222, 224,
 233, 234, 266, 285, 288, 292, 312,
 327, 331, 334, 337, 343, 345, 352,
 353, 357, 365, 367, 372, 374, 402,
 403, 412, 413, 416, 556, 586, 605,
 616, 635, 640, 652, 727, 738, 762,
 763, 769, 792
 Mandati, 181, 279, 298, 299, 319, 321,
 326, 327, 328, 336, 337, 419, 464,
 566, 579, 611, 670, 745, 790
 Marrëveshjet ndërkombëtare, 74, 78,
 82, 83, 444, 759
 Mocioni i mosbesimit, 381, 424, 521
 Mocioni i Vetëbesimit, 521
 Ndarja e Pushtetit, 28, 472
 Organizata e Kombeve të Bashkuara,
 548
 Paanshmëria e pushtetit gjyqësor, 541
 Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat
 Civile dhe Politike, 552
 Parimet e Budapestit, 588, 599
 Pavarësia administrative, 532
 Pavarësia financiare, 533
 Pavarësia institucionale, 531
 Pavarësia juridiksionale, 533
 Pavarësia në vendimmarrje, 532
 Përgjegjësia politike, 519
 Pozita kushtetuese, 30, 308, 475, 633
 Presidenti i Republikës së Kosovës, 6,
 7, 28, 34, 78, 82, 84, 298, 299, 300,
 317, 353, 382, 396, 398, 401, 402,
 412, 414, 418, 419, 421, 423, 424,
 425, 437, 462, 464, 467, 469, 470,
 471, 507, 560, 579, 636, 671, 680,
 714, 717, 723, 726, 727, 748, 780,
 781, 790
 Prokurori i Shtetit, 579, 586, 614, 615
 Prokurori Publik, 580, 582, 589
 Pushteti ekzekutiv, 25, 340
 Qeveria e Kosovës, 65, 480, 616, 792
 Republika e Kosovës, 6, 11, 12, 13, 14,
 15, 16, 21, 22, 24, 25, 29, 38, 41, 43,
 44, 46, 48, 54, 55, 56, 59, 66, 68, 71,
 72, 73, 74, 75, 76, 82, 84, 86, 87, 89,
 92, 93, 94, 137, 139, 153, 156, 163,
 164, 189, 221, 222, 227, 234, 255,
 258, 259, 268, 269, 270, 271, 272,
 273, 274, 275, 276, 278, 285, 379,
 392, 417, 468, 681, 685, 696, 711,
 712, 713, 786, 788, 792
 Shefi i Shtetit, 434
 Shërbimet publike, 681
 Shërbimi civil, 525
 Shpërndarja e parlamentit, 440
 Sovraniteti i shtetit, 17
 SPPDDDDThPANP 1999, 588, 591,
 599, 602, 609
 Standardet, 125, 215, 530, 588, 604